Hyrje në

punën e referencave

Shërbimet themelore informative

VËLLIMI 1

William A. Katz

Prishtinë
2007

HYRJE NË PUNËN E REFERENCAVE
VËLLIMI 1
Shërbimet themelore informative
Botimi i Tetë

William A. Katz
Universiteti Shtetëror i Nju-Jorkut në Albani

Titulli i origjinalit:

Introduction to Reference Work
Basic Information Services
Volume I
Eighth Edition
By William A. Katz
State University of New York at Albany

Published by McGraw-Hill, an imprint of The McGraw-Hill Companies, inc. 1221 Avenue of the Americas, New York, NY, 10020. Copyright © 2002, 1997, 1992, 1987, 1982, 1978, 1974, 1969 by the McGraw-Hill Companies, Inc.
ISBN e origjinalit: 0-07-244107-0

Përktheu:
Avni Spahiu

Lektore:
Hazbije Qeriqi

Dizajni dhe realizimi kompjuterik:

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës
BKUK: Botime të veçanta;

HYRJE NË PUNËN E REFERENCAVE

VËLLIMI 1 Shërbimet themelore informative

Botimi i Tetë

William A. Katz
Universiteti Shtetëror i Nju-Jorkut në Albani

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS
THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY OF KOSOVA

Prishtinë
2007

SHËNIM MBI AUTORIN

WILLIAM A. KATZ është profesor në Fakultetin e Shkencës dhe Politikës Informative, në Universitetin Shtetëror të Nju-Jorkut në Albani. Ka punuar, katër vjet me radhë, si bibliotekar në Bibliotekën e King-Kuantit (Uashington) dhe në degën editoriale të Shoqatës Bibliotekare Amerikane. Është doktoruar në Universitetin e Çikagos dhe ka qenë editor i *RQ*, gazetë e Degës së Referencave dhe Shërbimeve Madhore të Shoqatës Bibliotekare Amerikane, si dhe i *Journal for Education for Librarianship (Gazeta mbi Edukimin Bibliotekar).* Profesor Katz tani është botues i *The Reference Librarian (bibliotekari i Referencave),* një botim çerek-vjetor që u dedikohet çështjeve në shërbimet moderne të referencës dhe informacionit, si dhe i *The Acquisition Librarian (bibliotekari përvetësues),* që ka të bëjë me zhvillimin koleksionar. Është redaktor i *The Columbia Granger's Guide to Poetry Anthologies* dhe po ashtu, redaktor i një serie, kushtuar historisë së librit për Scarecrow Press, që përfshin edhe librin e tij *A History of Book Illustration (Historia e ilustrimit të librit)* dhe *Dahl's History of the Book (Historia e librit e Dahlit).* Aktualisht është duke shkruar një histori kulturore mbi librat e referencës.

PËRMBAJTJA

Parathënie

PJESA E PARË HYRJE

1 *Bibliotekarët e referencës në autostradën informative.....*
Burimet e informacionit
Burimet elektronike
Kush i shfrytëzon shërbimet e referencës
Udhëzimet për shërbimin e referencës
Pyetjet dhe hulumtimet
Intervista dhe kërkimi i referencës
Vlerësimi i burimeve të referencave
Sugjerime për të lexuar

2 *Biblioteka elektronike*
Zgjidheni Internetin
Rrjetet bibliografike

Referencat në Internet
Makinat e kërkimit
Hulumtimi i web-it
Ardhmëria e shërbimeve të referencave
Sugjerime për të lexuar

PJESA E DYTË INFORMACIONI: KONTROLLI DHE QASJA

Bibliografia
Bibliografia numerative sistematike
Vlerësimi i bibliografisë
Udhëzim mbi përdorimin e burimeve të referencës
Ndihmësit aktualë përzgjedhës
Indekset e vështrimeve
Bazat elektronike të të dhënave
Bibliografitë: materialet jo të shtypura
Sugjerime për të lexuar

Bibliografitë kombëtare dhe tregtare
Katalogu i Unionit Kombëtar (MARC)
Bibliografitë kombëtare jashtë Shteteve të Bashkuara
Bibliografia e tregut
Veprimtaria botuese dhe bibliotekat
Bibliografitë: të përkohshmet dhe gazetat
Shërbimet këshillëdhënëse për lexues
Sugjerime për të lexuar

Shërbimet e indeksimit dhe abstraktimit:
të përgjithshme dhe të koleksioneve
Gjerësia dhe përmbajtja e indeksit
Kërkimi i një indeksi
Disponueshmëria e teksteve të plota
Vlerësimi i indeksit
Problemet e vlerësimit dhe kostoja
Indekset e përgjithshme të periodikëve
Worldwide Web në Internet
Përmbajtjet aktuale
Kërkimet retrospektive
Indekset e përgjithshme: formati i shtypur
Indekset për materialet nëpër koleksione
Sugjerime për të lexuar

6 *Indeksimi dhe abstraktimi i shërbimeve:*
subjekti dhe gazeta
Humanitetet
Shkencat shoqërore

Citimi i indekseve
Indekset e temave specifike
Ngjarjet aktuale: gazetat, indekset, dhe ndihmesat e referencave
Sugjerime për të lexuar

7 Enciklopeditë: e përgjithshme dhe kompletet tematike
Enciklopeditë elektronike kundruall atyre të printuara
Vlerësimi i enciklopedive
Pikat vlerësuese
Enciklopeditë për të rritur
Enciklopeditë e njohura për të rritur dhe ata në shkolla të mesme
Fëmijët dhe adoleshentët
Përmbledhje të tjera për fëmijë
Shtojcat në enciklopedi: vjetarët, CD-ROM-ët, Online
Enciklopeditë më një vëllim
Enciklopeditë me disa vëllime të botuara jashtë SHBA-ve/ versioni i shtypur
Enciklopeditë me një subjekt të veçantë
Arti dhe artet
Filozofia
Sugjerime për të lexuar

8 Burimet e gatshme të referencave: kalendarët, vjetarët, manualet dhe udhëzuesit
Vlerësimi
Librat e fakteve të përgjithshme
Almanakët dhe vjetarët
Vjetarët reprezentues
Doracakët dhe manualet
Këshillë dhe informacion
Udhëzuesit
Bibliotekat
Statistikat
Sugjerime për të lexuar

9 Burimet biografike
Kërkimi i burimeve biografike
Vlerësimi

Indekset në biografi
Burimet biografike aktuale dhe universale
Udhëzuesi: Forma Who's Who
Esetë biografike retrospektive
Biografitë profesionale dhe ato tematike
Biografitë grupore tematike
Sugjerime për të lexuar

10 Fjalorët
Vlerësimi
Fjalorët e pashkurtuar
Fjalorët për kolegje (fjalorët e tavolinës)
Fjalorët për fëmijë
Thesaurusët - sinonimet dhe antonimet
Fjalorët historikë
Fjalorët e gjuhëve të huaja (fjalorët dygjuhësorë)
Fjalorët tematikë
Sugjerime për të lexuar

11 Burimet gjeografike
Burimet gjeografike
Vlerësimi
Enciklopeditë dhe fjalorët gjeografikë
Atlaset dhe hartat
Gazeterët
Hartat dhe atlaset tematikë
Hartat e rrugëve
Udhëzuesit turistikë
Sugjerime për të lexuar

12 *Dokumentet qeveritare*
Organizimi dhe përzgjedhja
Udhëzuesit
Organizata qeveritare
Katalogët
Kongresi
Indekset dhe librat e regjistrimeve të përgjithshme
Raportet tekniko-shkencore
Dokumentet shtetërore dhe lokale
Sugjerime për të lexuar

PARATHËNIE

Si edhe në botimet e mëparshme, ky botim (i tetë) i *Hyrje në Punën e Referencës: Vëllimi I, Shërbimet themelore informative* është faktikisht i rishkruar. Është bindje e autorit se revolucioni që po ndodh në burimet e referencës dhe në procesin e referencës kërkon një revidim të tillë të plotë.

Ç'ËSHTË E RE NË KËTË BOTIM

Që nga botimi i mëparshëm i këtij teksti, i cili ofron një pasqyrë të shërbimeve të referencës për studentët e interesuar, revolucioni kompjuterik është bërë pjesë e pandashme e bibliotekës. Ajo që ka qenë radikale tani është një pjesë e pranueshme, e pritur, e punës së përditshme bibliotekare e referencës. Revolucioni ka përshpejtuar nga agjitimi te pranueshmëria brenda më pak se një dekade. Kjo nuk do të thotë se tashmë forma dhe metodologjia e Shërbimit të referencës është themeluar. Ndryshimi dhe lëvizja është ndërtuar në mrekullinë elektronike dhe vazhdon të transformohet. Referenca mund të përmblidhet në fjalët e të pavdekshmit Monty Python: "Tani, për diçka krejtësisht ndryshe". Nuk kalon as edhe një muaj që dikush, diku të mos zbulojë një metodë të re të kërkimit të përgjigjeve ndaj pyetjeve. Dhe, kjo normalisht është ngushtë e lidhur me kompjuterin.

Sot, bibliotekat e referencës u kthehen indekseve, enciklopedive, apo udhëzuesve për të njëjtin lloj informacioni, si edhe para një dekade. Ndryshimi thelbësor është i trefishtë:

- Së pari, dikush mund ta shfrytëzojë, jo vetëm, një burim të shtypur, por edhe një bazë elektronike të të dhënave, rëndom *Online* dhe me qasje të lehtë në Internet. CD-ROM-ët janë po ashtu të popullarizuar;
- Së dyti, biblioteka ofron qasje jo vetëm ndaj burimeve lokale, por edhe ndaj të gjitha atyre që janë botuar që nga fillimi i shtypit. Ka pak informacion që nuk ka qasje në kompjuter pothuajse në secilën bibliotekë në Shtetet e Bashkuara dhe në Kanada;
- Së treti, bibliotekari i referencës shfrytëzon vepra tradicionale themelore të referencës dhe tani vepron, madje edhe si një ndërmjetës, si një ndërhyrës ndërmjet masave të informacionit dhe shfrytëzuesit, i cili nuk është në gjendje ta dallojë të mirën nga e keqja, atë që është më e mirë nga ajo që është më pak e mirë. Gjithnjë e më shumë bibliotekari i referencës po bëhet ekspert kyç profesional i informacionit. Sot, ai/ajo është i domosdoshëm për filtrimin e masës së informacionit të padiferencuar, që rrjedh nëpër rrjetet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Trende të tjera në këtë revidim mbështeten mbi shërbimet e mundshme të referencës në dekadën e ardhshme. Ndryshimet paraqesin një konsensus në mesin e bibliotekarëve që punojnë në referencë:

1. Interneti me konfiguracionet dhe premtimet e tij të panumërta është bartësi kryesor i informacionit. Brenda një kohe të shkurtër ai do ta zëvendësojë shtypin standard dhe formatet e CD-ROM-ve;

2. Autostrada informative është e stërmbushur me tragë, gunga dhe rreziqe të shumta, të cilat vështirë të mënjanohen nga laikë. Bibliotekari i trajnuar i referencës jo vetëm që iu shmanget rreziqeve të tilla, por ai e çon shfrytëzuesin që nga fillimi deri në mbarim të kërkimit me vështirësi, fare të vogla;

3. Në saje të ndërhyrjes qeveritare, që siguron qasje të lirë në Internet, bashkë me një trend në rritje drejt, me një fjalë, dhënies falas të harduerit për t'i bindur njerëzit për ta përdorur Internetin, të gjitha bibliotekat do të kenë qasje në shërbimet e Internetit për publik;

4. Në të njëjtën kohë, burimet standarde të informacionit do të mbeten aty ku janë sot, paksa tepër të shtrenjtë. Krahas zgjerimit të qasjes ndaj

bazave të të dhënave të informacionit vërtetë të përpunuar, edhe biblioteka është po aq e rëndësishme për t'i siguruar publikut qasje të lirë të informacionit;

5. Bibliotekat publike, shkollore dhe akademike do të kenë në dispozicion më shumë baza të të dhënave. Bibliotekarët e referencave do të ftohen për t'i zgjidhur problemet që paraqiten për shfrytëzuesit individualë;

6. Teknologjitë e reja do ta shtojnë masën e shërbimeve të referencës;

7. Në saje të ndryshimeve konstante në teknologji dhe resurse, bibliotekari duhet të përtërijë vazhdimisht, të thellojë dhe të zotërojë mjeshtëri të reja;

8. Ekspertiza tematike është gjithnjë e më e rëndësishme, sidomos krahas specifikimit të numrit të burimeve të referencës dhe sofistikimit të shfrytëzuesve;

9. Kërkesa për udhëzime lidhur me shfrytëzimin e çdo gjëje, duke filluar nga kompjuterët e deri te rrjetet dhe pamfletet, si dhe në veçanti, hulumtimi në Internet i CD-ROM-ve do të vazhdojë të rritet.

Ky vëllim, i parë, është një lloj doracaku i trajnimit. Askush nuk mund të kalojë në pika më të mira të shërbimeve të referencës (tani dhe në të ardhmen) pa pasur një kuptim dhe zotërim të formave themelore të referencës, pa marrë parasysh se në çfarë paketimi janë dhënë. Qëllimi parësor, si dhe në botimet e mëparshme, është që të ofrojë një përshkrim të qartë dhe të saktë të burimeve standardeve të referencës.

PLANI I LIBRIT

Organizimi është pothuajse i njëjtë për të gjitha edicionet. Nuk ka arsye që të ndryshojë pasi që teksti merret me çështjet fundamentale, të cilat pa marrë parasysh se cilës autostradë informative i ngjajnë ose nga lëvizin, janë esenciale për të kuptuar informacionin.
Pjesa e parë merret me procesin e shërbimeve të referencës. Kapitulli I dhe Kapitulli II mbulojnë parametrat e bibliotekës elektronike. Që të dy këta kapituj janë zgjeruar në edicionet e mëparshme. Kapitujt fillestarë shërbe-

jnë si një shpjegim për fusha jetike të shërbimeve të referencës – komuniteti i shërbyer dhe teknologjitë e aplikuara në këtë shërbim.
Si edhe në botimin e mëparshëm, Pjesa II, Informacioni: Kontrolli dhe qasja, merret me bibliografinë dhe indekset. Mirëpo, në këtë pikë, ndryshon formati themelor. Së pari ka një format Interneti për një vepër reference, që pasohet nga versioni CD-ROM dhe së fundi nga një libër fillimtar i shtypur.

Internet: Titulli i burimit të referencës/botuesit se kur ka filluar botimin/dendësia – dhe rëndom me një URL, d.m.th., një adresë Interneti. Pasi të gjitha burimet e mëdha të referencës bëhen me pagesë, adresa e Internetit nuk është adresa aktuale e bazës së të dhënave (që kërkon një fjalëkalim), por adresa e botuesit dhe informacioni i sfondit të burimit. Hapeni web-sajtin e bibliotekës suaj për të gjetur burimin aktual të referencës në Internet. Po qe se e gjeni, atëherë përdoreni linkun për të gjetur burimin në Internet. Nëse nuk e keni nga biblioteka, atëherë kërkoni ndonjë bibliotekë tjetër dhe/apo përdoreni URL-në e botuesit që jepet këtu, pasi që bazat me pagesë të të dhënave mundësojnë një kërkim të kufizuar, që është ideal për studiuesit.

CD-ROM: Titulli dhe botuesi nuk jepen njësoj si për Internet. Por, të keni kujdes se aty ku titulli i CD-ROM-it ndryshon nga versioni në Internet, ky titull jepet kur ka filluar botimin/dendësia/çmimi ku ky është i njohur.

Shtypi: Titulli, i cili ndryshon shpesh nga Interneti dhe/apo nga CD-ROM-i kur ka filluar botimin/dendësia/çmimi (rëndom, le të dihet, shumë më herët se formatet elektronike).

Është me rëndësi të dihet se çmimet dhe të dhënat bibliografike ndryshojnë. Madje, edhe titujt dhe botuesit i nënshtrohen revidimit. Megjithëkëtë, informacioni i dhënë bazë mbetet pothuajse i njëjtë nga viti në vit.

Të dhënat bibliografike mbështeten në katalogët e botuesve, *Books in Print, Gale Directory of Database* dhe ekzaminimin e titujve. Titujt në Internet dhe në CD-ROM, të shumtën, përdoren në terminal kompjuterik. Po ashtu, autori ka konsultuar vështrimet e shkëlqyera për mbështetje dhe ndihmë – sidomos ato në *Library Journal, Booklist, Online, Database* dhe *Choice.* Informacioni është i aplikueshëm që nga viti 2000 dhe, sikurse edhe çmimi, i nënshtrohet ndryshimit.

Theksi është vënë mbi formë dhe jo në tituj të caktuar. Secila formë,

në çdo bibliografi, është diskutuar. Janë dhënë shembuj të titujve – sidomos të atyre titujve që kanë gjasë më të madhe të gjenden në shumicën e bibliotekave publike, akademike a shkollore.

Në përshkrimin e secilit titull të referencës, fokusimi parësor është në përmbajtje dhe në atë se si ndryshon ajo përmbajtje nga, të themi, tituj të ngjashëm. Shfrytëzimi i veprës së referencës është dhënë.

Nuk mund të bëhet asnjë përpjekje e shteruar lidhur me kërkimin e bazës së të dhënave X apo Y. Mostrat themelore të kërkimit, sidomos kur ato gjenden në baza të ngjashme të të dhënave, janë hulumtuar, por kërkimi i sofistikuar nuk është diskutuar. Pse? Së pari, shumica e shkollave dhe bibliotekave kanë kurse të veçanta, të domosdoshme, mbi kërkimin e bazave të të dhënave. Së dyti, softueri (në të cilën gjendet kërkimi) mund të ndryshojë po aq shpejt sa dhe mënyrat e ofrimit të informacionit. Ajo që sot mund të jetë sqarim valid i një kërkimi nesër mund të mos jetë më shumë se histori. Nga ana tjetër, përmbajtja themelore, qasja themelore e kërkimit, nuk ka gjasë të ndryshojë. Dhe, për këtë arsye, që të dyja janë vënë në pah.

Pjesa III, Burimet e Informacionit, ndjek mostrën e edicioneve të mëparshme. Edhe këtu, njësitë janë hartuar ngjashëm me ato të pjesës së parë. Këtu, ndërkaq, fokusimi është bërë në përdorimin e burimeve të "njëhershme" të informacionit dhe mënyrën se si janë përshtatur ato në aranzhimin mesatar të shërbimeve të referencës.

VERSIONI I INTERNETIT, I TEKSTIT DHE I PLOTËSIMEVE

Ky tekst, si dhe vëllimi shoqërues i tij, mund të blihet në formatin elektronik. Për më shumë informacion kontaktoni, qoftë shitësin tuaj të McGraw-Hill, ose vizitoni www.mhhe.com/primis/online .

Plotësimet e tekstit do të mund të bëhen në web-sajtin shoqërues: www.mhhe.com.katz.

SUGJERIM LITERATURE

Në të dy vëllimet, sugjerimet e literaturës gjenden në fusnota dhe në mbarim të secilit kapitull. Në rastin kur në një fusnotë citohet një botim, referenca rrallëherë dyfishohet në pjesën e "Sugjerim leximit". Që nga viti 1998, në të shumtën e rasteve, këto lexime kufizohen në botime. Përpos ofrimit të mendimit aktual të lexuesit, citimet më të vona janë kontribut

shtesë për t'ia lehtësuar punën studentit për t'i gjetur këto lexime. Natyrisht, është fare afër mendsh se nuk ka nevojë që e tërë literatura të jetë aktuale. Shumë artikuj dhe libra të vjetër janë po aq të vlefshëm, sot, sa edhe kur janë botuar. Në saje të mësuesve që kanë pasur botimet e mëhershme të këtij teksti, është e mundur që të gjendet bibliografia e literaturës së mëhershme.

Dy fjalë për literaturën e Internetit. Materiali në Internet daton që nga momenti i botimit, qoftë në formë të shtypit qoftë në Internet. Ajo që është shënuar këtu konsiderohet themelore, qoftë edhe për pak vite. Pika e dytë: *Books in Print* nga viti në vit ka nga 550 deri në 650 "linja Interneti". Shumica e këtyre janë jetëshkurta dhe të pavlefshme, por është bërë një përpjekje për t'i përzgjedhur disa që janë më meritore dhe të vlefshme për fillestarët.

MIRËNJOHJE

U jam mirënjohës kritikëve të këtij libri: Lesley Farmer, nga Universiteti Shtetëror i Kalifornisë, në Long-Biçë; Judith V. Lechner, Universitetit Auburn; Ketty Rodriguez, Universiteti i Misisipit Jugor; Gail M. Staines, Universitetit të Bufalos; Ibrahim M. Stwodah, Kolegjit Longvud.

Po ashtu, falënderoj editorët e këtij vëllimi, Valerie Raymond dhe Amy Shaffer, si dhe indeksuesin Kelly Lutz.

William A. Katz

HYRJE NË PUNËN E REFERENCËS

VËLLIMI I Shërbimet themelore informative

PJESA I
HYRJE

KAPITULLI I
BIBLIOTEKARËT E REFERENCËS NË AUTOSTRADËN INFORMATIVE

Që nga koha kur bibliotekari i parë i referencave doli nga shtrati në Sumeria, para afro 5000 vjetësh, aktivitetet ditore përbëhen nga pyetjet. Dhe, bibliotekari, i cili lulëzon nën një sërë përcaktimesh, që nga koha e hershme e "mbajtësit të tabelave" e deri te "shkencëtari modern,"[1] pritet të dalë me përgjigje të sakta në pyetje herë-herë të paqarta.

Në fillim, përgjigjet nxirreshin nga kujtesa. Nuk kishte shumë gjëra për t'u mbajtur në mend. Një njeri i mençur do të mund të thoshte se dinte çdo gjë që kishte për t'u ditur. Në bashkësi të vogla, më të vjetrit nderoheshin (dhe ishin të nevojshëm) ngaqë kujtesa e një të vjetri ruante historinë dhe informacionin ditor të punës për ekzistencë – qoftë duke iu shmangur plaçkitësve, qoftë duke ditur se nga duhej vajtur në rast të mungesës së ushqimit. Nga shekulli XVI, "kur regjistrat e famullive bëheshin më të sistemuar dhe kur shtypi po përhapej, të vjetrit dalëngadalë humbën rolin e tyre si kujtesë e komunitetit".[2]

Zbulimi i shtypit nga mesi i shekullit XV, përhapja e gjerë e librave në shekullin XVI, rritja e arsimimit në mesin e klasës së mesme në shekullin

[1] Herë-herë dëgjohet në vend të 'Bibliotekistit të referencave" edhe "menaxheri i diturisë". Kjo ka definicione të shumta, mirëpo "elementet themelore janë qasja, vlerësimi, menaxhimi, organizimi, filtrimi dhe shpërndarja e informacionit". Natyrisht, e tërë kjo i atribuohet definicionit të njëjtë të "Bibliotekistit të referencave". Për një pikëpamje më pak ambicioze të këtij zhvillimi shih Ernest Perez, "Knowledge Management…", *Database,* prill-maj, 1999, f. 75-77.

[2] George Minois, *History of Old Age,* Chicago, IL: University of Chicago Press, 1989, f. 248.

XVII e XVIII, si dhe lëvizja masive shekullore e arsimimit, shtuan si sasinë ashtu dhe kërkesën për informacion. Që nga mesi i shekullit XVIII, njerëzit ankoheshin se thjesht kishte tepër gjëra për t'u lexuar, tepër gjëra për t'i ditur. Ja, për shembull, ç'thotë shkrimtari Laurence Sterne në vitin 1760, duke bërë fjalë për një version të hershëm të shpërthimit informativ:

> "Kjo, të nderuar punëtorë dhe bashkëpunëtorë të mi, në këtë lëmë të madhe të mësimit, që tani po piqet para syve tanë; kjo është ajo, me hapa të vegjël të një rritjeje të rastit, që njohuritë tona fizike, metafizike, fiziologjike, polemike, nautike, matematike, enigmatike, teknike, biografike, romantike, kimike dhe obstetrike, me nga pesëdhjetë degë të tjera (shumica prej të cilave mbarojnë ngjashëm me to, me *ike)* janë... duke u zvarritur dalëngadalë përpjetë".[3]

Çdo vit botohen më shumë libra që përpiqen ta analizojnë shpërthimin e sotëm të informacionit sesa që gjenden në bibliotekat e manastireve, që nga rënia e Romës deri te shpikja e shtypit. Ky pohim nuk është aq absurd sa ç'mund të duket. Për 1 400 vjet (d.m.th. nga 100-1500) sasia e informacionit vetëm sa ishte dyfishuar. Sot, informacioni dyfishohet disa herë brenda një viti.

Shtimi i njohurive, sot nuk mund të quhet më "gradual". Gjithnjë e më shumë është e qartë se gjetja e pjesëve specifike të të dhënave në mesin e masës së informacionit të padiferencuar është sfidë e madhe. Dhe, kush ndeshet me këtë sfidë? Po, të paktën është dikush dhe këta janë bibliotekarët e referencave.

BURIMET E INFORMACIONIT

Para më pak se një dekade burimet e informacionit ishin sinonime me librin e shtypit. Sot, ky definicion ka të bëjë me kokën elektronike. Ekzistojnë më se tre milionë web-sajte në Internet, të cilat mund (apo nuk mund) të

[3] Laurence Sterne, *Tristram Shandy.* Nju-Jork, NY: Modern Library, 1928, Libri 1, Kapitulli 21, f.56. Letërsia ka shembuj të panumërt të informacionit masiv dhe të vështirësive të nxjerrjes së asaj që kërkohet, p.sh. Shih, për shembull, tregimin tashmë klasik *Biblioteka e Babilonit* të Jorge Luis Borgesit. Këtu njerëzit kanë qasje në një bibliotekë, e cila përmban përgjigjet në çdo pyetje, përfshirë edhe ngjarjet e ardhshme. Gëzimi kthehet në dëshprim kur shfrytëzuesit shohin se biblioteka është aq e madhe saqë është e pamundur të gjenden përgjigjet që ata i kërkojnë.

përmbajnë informacion të dobishëm. Përkundër këtij zhvillimi, bibliotekarët dhe laikët e mençur, më parë mbështeten në burime specifike të informacionit sesa në web-sajte të padiferencuara.

Burimet themelore të referencës mund të gjenden në Internet, ose si CD-ROM a DVD. Nuk është e rëndomtë që të shfrytëzohen vetëm vepra të shtypura të referencës, pos nëse kërkohen informacione para fillimit të viteve 1980. Burimet elektronike, të pakta, janë retrospektive. Mu nga fillimi i shekullit, të gjitha burimet kryesore të informacionit dhe sidomos ato që janë në përdorim ditor nga bibliotekarët e referencës, do të jenë në formë digjitale. Shumë prej tyre, në të vërtetë, nuk do të mund të gjenden në formë të shtypur.

Sidoqoftë, përmbajtja, nëse jo metodat e nxjerrjes, mbetet e njëjtë, pa marrë parasysh se çfarë formati do të zgjedhë botuesi. Është esenciale që bibliotekari profesionist t'i kthehet burimit X apo Y, për të gjetur përgjigjen e duhur në pyetjen X a Y. Me sa tituj duhet të njihet një bibliotekar i ri kur të ketë marrë postin e referencës?

Udhëzuesit, doracakët dhe bibliografitë e burimeve të referencës – siç janë *Guide to Reference Books* apo *Gale Directory of Databases* – përmbajnë dhe regjistrojnë prej afro 10 mijë baza të dhënash deri në 15 mijë libra të shtypur të referencave. Suazat e përzgjedhura për një temë të caktuar apo madhësi të bibliotekës mund të sillen nga disa qindra në afro 2 000. "Librat më të mirë të referencës të...", një kolumnë e rregullt vjetore në *Library Journal* përzgjedh nga 30 deri në 40 tituj si "më të mirët" e vitit.

Sondazhet, formale dhe joformale, bëhen vazhdimisht për të parë se çfarë burimesh referencash janë përdorur në një bibliotekë tipike. Sot, kjo është zgjeruar në përfshirjen e asaj se në ç'formate – të shtypura apo digjitale, janë ato. Përgjigjet paraqesin sa rëndomësi aq edhe seleksionim të konsideruar, personalisht të favorshme aq sa edhe shuma e përgjithshme e përzgjedhjeve nga ana e stafit. Po ashtu, shumëçka varet nga ajo se çfarë pyetje është shtruar, se si është parafrazuar ajo dhe se si është interpretuar nga bibliotekari individual. Brenda një dite të vetme e njëjta pyetje mund të shtrohet në disa mënyra të ndryshme nga sa më shumë bibliotekarë. Derisa përgjigja të jetë korrekte, kjo nuk prishë punë, të paktën nëse humbet kohë dhe përpjekje e njëjtë në pyetje.

Me të gjitha ato variante, mund të ketë mëdyshje për të gjitha pos për sondazhin e brendshëm të burimeve "më të mira" dhe "të mira" të referencës. Përgjithësimet janë rezultat, qoftë edhe i studimeve më të kujdesshme. Përgjithësimet shpesh shtojnë të njëjtën gjë. Për shembull,

pashmangshmërisht me rastin e shtruarjes së pyetjes se cili është burimi më i përdorur për pyetjet e referencës, së pari vjen katalogu, pastaj standarde të tilla si indekset periodike, *World Almanac, Statistical Abstract of the United States*, si dhe një numër burimesh shumë të përdorshme.[4]

Libri më i popullarizuar "i referencës" në Amerikë është Bibla. Ajo gjendet në 95% të shtëpive, kryesisht ngaqë 96% e amerikanëve besojnë në Zot. Një e treta e amerikanëve pohojnë se e lexojnë Biblën një herë në javë, por si dhe me librat e tjerë të referencës (brenda dhe jashtë bibliotekave) ruajtja e informacionit nuk është një pikë e fortë. Përgjigja e lexuesve të rregullt të Biblës në një kuiz tregon këtë përqindje të atyre që:

Nuk mund t'i emërojnë autorët e ungjijve: 54%;

Nuk e dinë se ç'është Ungjilli: 63%;

Nuk mund t'i numërojnë 5 nga 10 Urdhëresat: 58%;

Mendojnë se Zhan d'Ark ka qenë gruaja e Noas: 10%.[5]

Sa tituj referencash në shtyp, sa CD-ROM, sa në Internet dhe sa formate zbulimi duhet të zotërojë studenti? Nuk ka një përgjigje të vetme. Ka variante të panumërta. Po ashtu, secila bibliotekë ka koleksionin e vet

[4] Për shembull: Nancy Henry et al., "Shkallëzimi i piramidave: krijimi i një koleksioni të fondacioneve themelore", *Reference & User Services Quarterly,* pranverë 2000, f. 229-232. "Cilat janë të 5 librat e shtypur të referencës pa të cilët nuk mund të punosh?". Një konsensus përmban: *World Almanac, World Book, Encyclopedia of Association, Random House Unabridged Dictionary, 2nd ed., Britannica, Statistical Abstracts,* si dhe librat e telefonave lokalë, rajonalë dhe të qyteteve të mëdha (f. 235). Bazat e të dhënave në Internet, që konsiderohen si themelore janë: indekset e Gale Group InfoTrac; prodhimet e diskut telefonik apo të ngjashme; Disku Amerikan i Biznesit (American Business Disk); Biblioteka Elektrike (Electric Library)' Amazon.com, si dhe *Books in Print Plus.* Në vende të tjera, në biblioteka të tjera, lista pothuajse është e njëjtë. Shih Carol Tenopir, 'Statistikat për përdorim referencash", në *Library Journal.* 1 maj 1998, f. 32, 34. Në një sondazh të 44 bibliotekave universitare, autori ka gjetur "një përgjigje katalogu të Internetit të bibliotekës me përqindjen më të lartë të pyetjeve të referencës… pasuar nga libra të shtypur të referencës". OCLC, një rrjet bibliografik, zbulonte se në mesin e librave të shfrytëzuar më së shumti nga mbi 32 mijë anëtarë bibliotekash kishte vetëm disa tituj referencash. Ndër librat që gjenden më së shpeshti renditen: *A Manual for Writers* e Turabian-it, *Bartlett's Familiar Quotations, The New York Public Library Desk Reference, The Chicago Manual of Style, The Random House Dictionary;* si dhe rreth 6 të tjera përfshirë edhe doracakun e BIBLIOTEKISTIT *Guide to Reference Books. OCLC Newsletter,* korrik/gusht, 1999, f. 19-21.

[5] Rusell Shorto, "Belief by the Numbers (Besimi në shifra), *The New York Times Magazine,* 7 dhjetor 1997, f. 60-61.

"kyç", "kanunin" e vet. Në këtë tekst, nga 400 deri në 500 tituj konsiderohen themelorë. Në skajin tjetër, në *Distinguished Classics of Reference Publishing* (Feniks, AZ: Oryx Press, 1992), e cila kalon nga citime në enciklopedi, Xhejms Rreting (James Retting) dhe bashkëpunëtorët e tij pajtohen se ka të paktën 31 "vepra madhore të referencës", të cilat duhet të dijë secili që do ta meritojë emrin e bibliotekarit të referencës. Si një rregull i pashkruar, fillestari duhet të njihet me titujt që janë shumë në përdorim, nga bibliografia dhe indekset deri te enciklopeditë dhe almanakët, që gjenden në çdo bibliotekë. Kjo do të thotë zotërim i 100 deri në 300 librave të referencës. Përtej këtyre gjendet universi i 15 mijë e më shumë titujve.

Të gjitha veprat e mëdha të shtypura të referencës gjenden tani në Internet (dhe/apo në CD-ROM). Derisa formati ndryshon, përdorimi dhe përmbajtja e librit të referencës është njësoj në Internet dhe jashtë tij. Gjithashtu, tani ka me mijëra web-sajte që janë unike në Internet, të cilat kohë pas kohe mund të jenë të përdorshme në referencë. Për fat të mirë, njohja e titujve themelorë mjafton – të paktën për fillestarët.

Përpjekja për të mbajtur hapin me burimet më të fundit të informacionit jo vetëm që mund të jetë me stres, por mund të jetë edhe e rrezikshme për shëndetin. Një studim i botuar zbulon se "stresi mund të dëmtojë pjesën e trurit që mbush kujtesën". Kurse një studim tjetër, një vit më vonë, zbulon se "surfimi mund të jetë posaçërisht i rrezikshëm ngaqë mëton të jetë aktivitet i lirë dhe njerëzit janë më pak të vetëdijshëm me dhembjet dhe pësimet nga kompjuteri.[6]

Lloji i burimit "kontroll-qasje-udhëzim"

Klasa apo forma e parë e gjerë e burimeve të referencës është bibliografia. Kjo formë definohet në mënyrë të ndryshme, por në kuptimin me të përgjithësuar ajo është një listë përshkruese dhe sistematikisht e prodhuar e shënimeve.

Kontrolli. Bibliografia shërben si një mjet kontrolli, një lloj liste e kontrollimit. Ajo shënon inventarin e asaj që është prodhuar nga dita më ditë dhe nga viti në vit, në atë mënyrë që i mundëson si hartuesit ashtu dhe shfrytëzuesit ta ndiejë veten se ka kontroll, përmes organizimit, mbi

[6] *The New York Times,* 28 mars 1998, f. ËK4; 5 gusht 1999, f. G3.

rrjedhën e vazhdueshme të njohurisë. Bibliografia përgatitet përmes hulumtimit (duke gjetur burimin specifik), identifikimit, përshkrimit dhe klasifikimit.

Qasja. Pasi të jenë kontrolluar njësitë, njësitë individuale organizohen për qasje të lehtë të gjetjes së punës intelektuale. Të gjitha llojet e qasjes së veprave të referencës mund të definohen përgjithësisht si bibliografi, por ato mund të ndahen në nëngrupe, si në vijim:

1. Bibliografitë e burimeve të referencës dhe literatura e një fushe, qoftë e natyrës së përgjithshme, qoftë tematike, për shembull, *Guide to Reference Books* apo *The Information Sources of Political Science;*
2. Katalogu bibliotekar apo katalogët e bibliotekave të shumta të aranzhuara për qasje të lehtë në kompjuter. Praktikisht, këto nuk janë bibliografi, por përdoren shpesh në të njëjtën mënyrë;
3. Bibliografitë e përgjithshme, që përfshijnë forma të ndryshme temash të bibliografisë, për shembull, *The National Union Catalog;*
4. Indekset dhe abstraktet, që zakonisht trajtohen veç nga bibliografitë, por që konsiderohen si ndihmëse të bibliografive – regjistrime sistematike që ndihmojnë në identifikimin dhe gjurmimin e materialeve. Indekset e përmbajtjeve të revistave dhe të gazetave janë llojet më të përdorura në situata referencash. Shembuj: *The Readers' Guide to Periodical Literature* dhe *The New York Times Index.*

Udhëzimi. Normalisht, vetë bibliografitë nuk ofrojnë përgjigje definitive, por shërbejnë për t'i udhëzuar shfrytëzuesit te burimet e përgjigjeve. Për përdorim efektiv, njësitë e shënuara duhet të jenë qoftë në bibliotekë, qoftë të kenë qasje në një sistem tjetër bibliotekar.

Këtyre ditëve, shumica e burimeve të qasjes dhe të kontrollit të veprave të referencës mund të gjenden në formë digjitale. Të pakta janë ato që gjenden vetëm në shtyp.

Lloji i burimit

Veprat e llojit të burimit zakonisht janë të mjaftueshme për të ofruar përgjigje. Përkundër llojit të qasjes së veprës së referencës, ato janë sinoptike.

Enciklopeditë. Burimet e veçanta më të shfrytëzuara janë enciklopeditë: ato mund të definohen si vepra që përmbajnë artikuj informativë mbi tema të çdo fushe të diturisë, të renditura zakonisht në një radhitje alfabetike; ato shfrytëzohen për të gjetur përgjigje në pyetje të veçanta lidhur me një temë X apo për personin Y, apo grup pyetjesh që mund të fillojnë me "Dua të di diçka për Z". Shembuj: *Encyclopaedia Britannica; World Book Encyclopedia.* Sot, të gjitha ato mund të gjenden në shtyp, në Internet dhe në CD-ROM.

Burimet faktike. Vjetarët, almanakët, doracakët, guidat dhe udhëzuesit i takojnë kësaj kategorie. Secila prej tyre ka veti të ndryshme, por që të gjitha kanë një element të përbashkët: përdoren për të kërkuar materiale faktike për referencë të shpejtë. Së bashku, ato mbulojnë shumë fusha të diturisë njerëzore. Shembuj: *World Almanac, Statesman's Year Book.*

Fjalorët. Burimet që merren parësisht me aspekte të fjalëve, që nga definimi i duhur i tyre deri te shqiptimi klasifikohen si fjalorë. Shembuj: *Webster's Third International Dictionary; Dictionary of American Slang.*

Burimet biografike. Burimet dëshmuese të informimit mbi njerëz të dalluar në ndonjë fushë të interesimit njihen si burime biografike. Shembuj: *Who is Who; Current Biography.*

Burimet gjeografike. Format më të njohura janë atlasët, të cilat jo vetëm që tregojnë vende të caktuara, por mund të ilustrojnë tema të tilla si: ngjarje historike, zhvillime shoqërore dhe qendra shkencore. Burimet gjeografike përfshijnë, po ashtu edhe botime gazetareske, fjalorë të emrave të vendeve dhe libra udhëzues. Shembull: *The Times of Atlas of the World.*

Dokumentet qeveritare

Dokumentet qeveritare janë botime zyrtare që rëndom porositen apo botohen nga qeveritë federale, shtetërore apo lokale. Pasi që ato mund të përmbajnë edhe libra udhëzimesh dhe burimesh, ndarja e tyre në një njësi të veçantë bëhet me tepër për qëllime praktike sesa për përdorim alternativ reference. Shembuj: *Monthly Catalog of United States Government Publications* (lloj i qasjes); *United States Government Manual* (lloj burimi).

Kategorizimi i pastër i llojeve të referencës me anë të qasjes dhe të burimit nuk dallohet gjithmonë në një situatë të vërtetë. Bibliografia mund të jetë i vetmi burim i kërkuar nëse pyetja ka të bëjë thjesht më verifikimin apo me përpjekje për të plotësuar një citim bibliografik. Anasjelltas, bibliografia në mbarim të një artikulli enciklopedik apo një deklaratë në atë artikull mund ta drejtojë shfrytëzuesin në një burim tjetër. Përgjithësisht, dy kategoritë kryesore – qasja dhe burimi – shërbejnë për të bërë dallimin ndërmjet llojeve kryesore të veprave të referencës.

BURIMET ELEKTRONIKE

"Autostrada informative", "superstrada informative", "infrastruktura informative" dhe "rrjeti i komunikimeve" janë disa nga përshkruesit që tregojnë ndryshimin dhe konfuzionin. Pa marrë parasysh se si mund të quhen, qasja e domosdoshme kërkon një masë të madhe të teknologjisë. Dhe, kjo është ajo që i tërheq shumë bibliotekarë referencash në dhomën e çajit. Ndryshimi dhe kalimi konstant i teknologjisë dhe i bartësve të informacionit është jo vetëm konfuz, por edhe i shtrenjtë. Koha që kërkohet për zotërimin e formave dhe për mbajtjen e burimeve bibliotekare aktuale është frikësuese. Duke mos e mbajtur hapin, bibliotekari i sotshëm modern mund të shndërrohet nesër në një antikë.

Si një përkujtim i shkurtër: një CD-ROM ("compact disc-read-only memory') duket të jetë një CD nga e cila njeriu dëgjon muzikë. Ajo mban deri në 250 000 faqe tekst. Po ashtu, po qe se programohet me "multimedia", ajo mund të përmbajë edhe fotografi, zë, muzikë, e kështu me radhë.[7] DVD: burimisht, DVD do të thoshte "digital video disk" (video disku digjital). Shkurtesa mbetet, por emri është braktisur kur prodhuesit e kuptuan se disqet do të mund të përdoreshin për qëllime të tjera. Përdorimi kryesor komercial mbetet për televizionin, ngaqë disqet ofrojnë fotografi të rezolucionit të lartë dhe zë më të mirë sesa shiriti VCR.[8]

[7] Shumë njerëz mendojnë, përfshirë edhe autorin e këtij teksti, se CD-ROM-ët do të zhduken. Ata do t'ua lëshojnë vendin Internetit – të paktën sa i përket punës së referencës. Sa i përket zbavitjes, CD-ROM mund të jetojnë edhe shumë vite në të ardhmen. Shih: Peter Jacso, "Know When to Hold 'em…", *Computers in Libraries,* mars 1999, f. 38-42. Ai po ashtu mbështet nocionin se CD-së do t'i arijë fundi në shërbimet e referencës.

[8] Zhvillimet e DVD-ve paraqesin interes të madh për bibliotekarët. Në kohë, DVD-ROM (apo teknologji e ngjashme mbase me ndonjë emër tjetër) do t'i zëvendësojë CD-ROM-ët si bartës për shkak të mundësive të saj superiore të depozitimit, shtatë apo më shumë herë sesa CD-të. Edhe imazhet dhe zëri janë superiorë. Paul Nicholls, "DVD is Coming", *Computers in Libraries,* maj 1999, f. 57.

Online (Interneti) i referohet informacionit të mbledhur nga një server apo dritare e bazës kompjuterike të të dhënave.[9] Edhe kjo mund të ketë tipare multimediale dhe ato mund të bëhen të sofistikuara. Ka dy ndarje të mëdha në Internet, me pagesë dhe pa pagesë. Shitësit dhe botuesit komercialë në Internet (d.m.th. dilerët e të dhënave) presin pagesë për atë që paraqitet në linjë. Produktet e tyre, nga indekset e deri te enciklopeditë kërkojnë që biblioteka të paguajë për nxjerrjen e materialeve, me orë dhe që të abonohen apo të gjejnë ndonjë formë tjetër të marrëveshjes monetare me botuesin. (Zhargoni "përmbajtje portale – gated content") do të thotë se informacioni i është paguar nga shfrytëzuesi ndonjë firme komerciale, apo "portës"). Ndarja e dytë është tipizuar nga Internet World Wide Web, e cila, të shumtën e kohës, ofron informacion dhe zbavitje gratis.[10]

Pse elektronike?

Deri para disa vitesh, po të donit të lexonit një faqe nga *Oxford English Dictionary*, që gjurmon historinë e fjalëve, do të ishit të detyruar të nxirrnit vëllimin e rëndë nga rafti, të gjurmonit për informacionin dhe mundësisht ta kopjonit atë, apo ta fotokopjonit tërë faqen. Po të ishit në një bibliotekë që nuk e kishte këtë vepër reference, do të ishte e domosdoshme që t'ua dërgonin faqen, apo të shkonit në një bibliotekë që e kishte atë titull. Kishte dhe probleme të tjera. Vëllimi që do t'u duhej do të mund të kishte humbur, faqja që do t'u duhej do të mund të ishte grisur, e të tjera. Hyni në OED (*Oxford English Dictionary*) në formë të digjitalizuar. Tani njeriu mund të kërkojë për të njëjtën fjalë në terminalin kompjuterik. Për më tepër, është e mundur që ju të hulumtoni për fjalën që kërkoni në miliona citime në tërë kompletin. Ka pika të tjera të panumërta të të dhënave që mund t'i nxirrni elektronikisht brenda sekondash. Përdorimi i versionit të shtypur për të njëjtën gjë do të kërkonte orë të

[9] "Baza e të dhënave" (database) është formë elektronike e të dhënave, d.m.th. në këtë tekst ato përmbajtje që para disa vjetësh do të mund të gjendeshin në një libër referencash. Normalisht, baza e të dhënave deponohet në një dosje kompjuteri apo në një CD-ROM. Ajo mund të jetë tekst apo numerike, apo në të dy format dhe rëndom përmban tipare multimediale që nga toni deri te ato vizuale.

[10] Treguesi "me pagesë" apo "pa pagesë" mund të mos duket. I tërë informacioni mund të jetë gratis kur dhe nëse ka në dispozicion metoda të reja të nxjerrjes së profitit në Internet, p.sh. reklamat apo metoda të ngjashme, që i sjell Amerikës informacion të lirë në radio dhe television. Shumëkush, përfshirë edhe këtë autor, mendon se bazat e të dhënave me pagesë përgjithësisht mund të heqin dorë nga kjo, në mënyrë që të arrijnë deri te një auditor më i gjerë.

tëra, madje edhe muaj të tërë. Përshpejtime të ngjashme janë tani të mundura me vepra të panumërta referencash.

Bazat elektronike të të dhënave, qoftë në Internet qoftë në CD-ROM, janë praktike. Përparësia e shikimit të një artikulli enciklopedik në formë të digjitalizuar është se kjo ofron njëherit edhe tekstin, ilustrimet, mundësisht edhe efektet e zërit dhe të videos në çfarëdo teme, që nga jeta e shpezëve e deri te Çoseri. Studiuesit tani mund të këshillojnë arkivat, dorëshkrimet dhe tekstet e librave të rrallë.

Përse parapëlqejnë elektronikën në vend të shtypit botuesit në përgjithësi dhe botuesit e librave të referencës? Ka disa arsye themelore. Së pari, ajo është shumë më pak e shtrenjtë se shtypi. Po ashtu, nuk ka shpenzime të mëdha të paketimit dhe të postimit. Së dyti, të dhënat kompjuterike mund të përtërihen për çdo minut, gjë që shton përdorimin e veprës së referencës dhe shitjen e teksteve. Së treti, disa, por jo të gjithë, inkurajojnë ndërveprimin që u mundëson shfrytëzuesve të dërgojnë pyetje, apo 'fid-bek'. E katërta, ka një premtim të kalimit të tipareve multimediale nga video në audio.

Nuk ka dyshim lidhur me ardhmërinë e informacionit të digjitalizuar. Në vitin 2000, afro 80% e bibliotekave amerikane, pa marrë parasysh llojin apo madhësinë, kanë një lloj vepre elektronike të referencës, rëndom ndonjë enciklopedi dhe/apo indeks. Sa më e madhe dhe e pasur të jetë biblioteka aq më shumë ka dëshmi të formave elektronike të informacionit. Madje, edhe me qasjen në Internet, bibliotekat e vogla dhe me madhësi të mesme ende mbështeten kryesisht në vepra të shtypura të referencës. Pse? Sepse ato nuk janë në gjendje të paguajnë veprat e shtrenjta të referencës në Internet. Të gjitha seksionet e referencës mbështeten në ndonjë lloj materiali të shtypur. Shumica e pyetjeve retrospektive të referencës gjejnë përgjigje nga vepra të tilla. Bazat elektronike të të dhënave rrallëherë mbulojnë të dhëna të botuara para mesit të viteve 1980.

Pas një dekade a më shumë veprat e shtypura të referencës do të zhduken plotësisht, sidomos pasi indekset retrospektive të jenë futur në Internet. Duhet të dihet, ndërkaq, se kjo nuk do të thotë të gjitha të shtypura, por kryesisht ato vepra të referencës, të cilat mund të shfrytëzohen më lehtë nga kompjuteri.

Dituria e bazës së të dhënave

Bibliotekari lipset të ketë një dituri të gjerë të bazës elektronike të të dhënave dhe duhet të jetë në gjendje që të vërtetojë me shpejtësi gjëra të tilla si periudha e mbulimit, lloji i materialeve të konsideruara dhe dendësia e plotësimit.

Ka më se një duzinë bazash të të dhënave që përdoren nga një seleksionim prej më se 6 000 prej tyre. Bibliotekarët publikë dhe akademikë të referencës do të shfrytëzojnë para së gjithash këto, sipas një renditje të dendësisë së përdorimit: *Psychological Abstracts, ERIC, ABI/Inform, MLA (*Modern Language Association), *MEDLINE, Dissertation Abstract International, Social Sciences Citation Index, PAIS, Newspaper Abstracts* dhe *GPO Monthly Catalog.* Klientët, nga ana tjetër, më tepër janë të prirur të kufizohen në baza më të përgjithshme të të dhënave, siç janë ato që ofrojnë ENSCO, UMI, IAC apo H. W. Wilson Company. Dhe, aty ku janë në dispozicion, ata do të shfrytëzojnë përzgjedhje të tilla si OCLC *First Search*, si *ArticlesFirst* dhe katalogë të panumërt.

Sisteme dhe softuerë të ndryshëm i mundësojnë hulumtuesit të: (1) të hulumtojë baza të dhënash brenda një fushe të gjerë tematike dhe (2) të zbulojë se sa herë paraqitet një fjalë kyçe në secilën bazë të të dhënash. Shumë sisteme i bëjnë të mundur shfrytëzuesit që të shtypë një fjalë kyçe dhe të shohë se sa shpesh përsëritet ajo në 20 a më pak baza të dhënash të përafërta.

Ka mjete të dobishme mekanike për hulumtuesin e edukuar, por me një përdorim të kufizuar nga laikë. Së pari, duhet zgjedhur fushën e duhur të gjerë tematike, gjë që nuk është punë e vështirë; por, pastaj duhet vendosur se cilat baza të të dhënave duhet hulumtuar. Vetëm personi i njohur me baza të të dhënave mund të përzgjedh si duhet. Për shembull, a është më mirë të shfrytëzohet një bazë e të dhënave me 3 2026 njësi për 'mbeturinat bërthamore' apo ndonjë me 30 apo 3? Varet nga ajo se çfarë është indeksuar, nga situata dhe, ç'është më me rëndësi, nga ajo se sa është i njohur një hulumtues me atë bazë të të dhënave.

KUSH I SHFRYTËZON SHËRBIMET E REFERENCËS

Ku kërkojnë informacion shumica e njerëzve? Këtyre ditëve shumica i kthehen Internetit, sidomos në shtëpi. Me përjashtim të Internetit, apo të miqve dhe kolegëve të punës, studimet zbulojnë se 50 % iu kthehen bibliotekave. Më pas, menjëherë vijnë lëçitjet e revistave dhe gazetave, si

dhe bibliotekat shtëpiake të shtypura. Vërejtje alarmuese për prindërit, mësuesit dhe bibliotekarët është se tinejxherët tani parapëlqejnë Internetin kundruall bibliotekës, ndonëse kjo do të mund të marrë orë të tëra për të gjetur brenda minutash atë që duan në bibliotekë. Duke punuar në shtëpi ata nuk janë të detyruar të kërkojnë ndihmë apo ta mësojnë strukturën e informacionit të organizuar bibliotekar.

Padronët, klientët, shfrytëzuesit – njerëzit që bredhin brenda e jashtë bibliotekave dhe sektorëve të referencave - rëndom përbëhen nga tre a katër lloje themelore. Një përqindje e vogël, mbase nën 1 % te bibliotekat akademike dhe pallogaritshëm te bibliotekat publike, përbëjnë hulumtuesit, të cilët kërkojnë të dhëna të papërpunuara. Pos nevojës për të përcaktuar drejtimin në të cilin ata duhet të shikojnë apo të gjejnë shpejt atë që kërkojnë, ato rëndom bien jashtë qarkut të punës së bibliotekarit mesatar të referencës.

Grupi tjetër, i madh, përmban ata që kërkojnë përgjigje specifike (burime e jo fakte të shkurtra) në pyetje, po ashtu specifike. Ky është auditori kryesor i bibliotekarit të referencave si ndërmjetës. Shumica e këtyre njerëzve dinë pak apo aspak lidhur me bibliotekën dhe janë të interesuar vetëm në përgjigje, që duhet të jenë të sakta, të shkurtra dhe të merren drejtpërdrejt me çështjen. Prapë, kjo përbën, mbase jo më shumë se 5 deri në 10 % të shfrytëzuesve, të paktën në bibliotekat akademike dhe speciale. Bibliotekarët publikë do të gjejnë një përqindje më të vogël të këtij lloji, por ata normalisht mund të kategorizohen si të involvuar në biznes.

Grupin më të madh, të atyre që kanë nevojë për bibliotekarët e referencës e përbëjnë ata që kanë një kërkesë të padiferencuar për informacion. Ata mund të vijnë që nga studenti, i cili ka nevojë për të shkruar një studim mbi hobin e Linkolnit e deri te doktori, i cili mund të jetë duke kërkuar të dijë për hobi që do t'ia shmangin vëmendjen nga mjekësia. Asnjëri nuk kërkon përgjigje specifike. Që të dy kërkojnë materiale të ndryshme, në nivele të ndryshme të thellësisë dhe sofistikimit. Rreziku këtu qëndron se bibliotekari i referencës do t'i shohë këta njerëz si të tillë që do të duhej të kërkonin vetë informacionin, të cilët, të shumtën, do të duhej drejtuar te dikush në dhomën e përgjithshme të leximit. Bibliotekari, pra, ka hequr dorë nga procesi i ndërmjetësimit informativ aty ku ka nevojë më së shumti. Studiuesi dhe laiku, jo vetëm që duan të dinë se çfarë të lexojnë, por edhe se çka nuk duhet të lexojnë. Që të dy kërkojnë një analizë të tillë që disa bibli-

otekarë të referencës mund ta konsiderojnë si diçka që nuk është pjesë e punës së tyre profesionale.

Është vështirë të bëhet kategorizimi i njerëzve që kërkojnë ndihmën e bibliotekarëve të referencës. Ndërkaq, njëri grup shkakton kokëçarje më të madhe se tjetri. Ka lloje që nuk duan dhe nuk çajnë kokën. Ata futen në bibliotekë, të shtyrë nga prindërit dhe/apo nevoja për të kaluar ndonjë kurs. Kjo pjesë e publikut amerikan është bërë vazhdimisht më pak e informuar mbi ngjarjet aktuale, historinë, gjeografinë dhe pothuajse për çdo gjë tjetër.

> Unë jap mësim në një lëndë mbi opinionin publik në Universitetin e Miçiganit dhe në fillim të secilit semestër në 10 vjetët e fundit, studentët në këtë lëndë – kryesisht studentë të vitit të parafundit dhe të fundit – kanë hyrë në një kuiz të shkurtër lidhur me fakte të përzgjedhura historike. Rezultatet e semestrit të fundit më kanë shqetësuar posaçërisht. Vetëm 7 % e studentëve të mi kanë qenë në gjendje të dinë se kush janë emrat e dy senatorëve të këtij shteti në Senatin e Shteteve të Bashkuara, kurse për shembull as një e treta nuk e dinin emrin e Sekretarit të Shtetit. Më pak se gjysma e dinin se kur kishte filluar dhe kur kishte mbaruar Lufta e Dytë Botërore.[11]

Ka shpjegime të shumta, nga mungesa e interesimit në çdo gjë, që nuk avancon karrierën deri te mungesa e një armiku ndërkombëtar, që kërkon njohuri globale. Të tjerë thonë se ka tepër televizion, apo Internet, apo se shkollat janë të dobëta, apo se nuk ka motivim, apo se.... mund të shtoni edhe shpjegimin tuaj. Një bibliotekar më optimist i referencave do të inkurajonte ata që janë gjysmë të zgjuar e gjysmë të fjetur që të mësohen ta çmojnë, nëse jo ta duan studimin.

---

[11] Richard Craig. "Don't Know Much About History", *The New York Times, 8* dhjetor 1997, fq. A25. Një organizatë akademike jofitimprurëse me bazë në Uashington u kishte shtruar 556 studentëve të vitit të fundit në 55 kolegje dhe universitete kryesore (përfshirë shkollat Ivy League), pyetje të nivelit të shkollës së mesme që kishin të bënin me historinë. Rezultati mesatar: vetëm 53 % e pyetjeve morën përgjigje të duhur. Ndërkaq, asnjëra nga pyetjet nuk ishin mbi standardet e historisë së shkollës së mesme të kursit 101. *The New York Times,* 2 korrik, 2000, f. ËK7.

Çfarë kërkohet?

A do të bëheni bibliotekar i mirë?
Përgjigja varet po aq nga biblioteka sa edhe nga individi. Në kuadër të një stafi të madh, ai që ndjen kënaqësi në teknologji do të gjejë një post ndihmësi të hulumtuesve kompjuterikë, si dhe të këshillimit të të tjerëve lidhur me harduerët, softuerët, kthesat dhe risitë në autostradën informative. Aty ku bibliotekari është i vetmi profesionist në suaza të katër qyteteve, mundësitë e zotërimit të aftësive teknologjike varen nga paratë, mungesa e hapësirës dhe mungesa e luksit të përqendrimit në punën e referencës. Sipas të gjitha gjasave, bibliotekari mesatar i referencës është diku në mes.

Bibliotekarët e referencës janë të njëzëshëm lidhur me atë se cilat janë nevojat e një bibliotekari të suksesshëm? (1) Njohuri mbi fushën tematike (d.m.th. lidhur me atë se çfarë gjendet në dispozicion në formë të shtypur, në kompjuter, në burime të tjera etj.). Kjo do të thotë të ketë jo vetëm vlerësim të kualifikuar të burimeve të referencës në përgjithësi, por që të kuptojë më mirë se kushdo tjetër se si të gjurmojë të dhënat për një fushë të caktuar tematike. Përgjithësisht, me ekspertizë të caktuar është shumë i kërkuar. (2) Aftësi komunikimi. Kjo do të thotë të ketë aftësi për të folur me lloj-lloj njerëzish dhe të zbulojë se cilat janë nevojat e tyre. Për më tepër, ai duhet të dijë se a ka nevojë për një intervistë formale lidhur me referencat apo nëse është më lehtë vetëm të gjendet thjesht citati apo përgjigja. (3) Kompetencë në përzgjedhjen dhe nxjerrjen e materialeve – nga bazat e të dhënave deri te almanakët dhe burimet biografike.

Shërbimi publik është një nga aspektet më të këndshme të profesionit. Ka dhe të meta.[12] Herë-herë pyetjet e shtruara do të përsëriten, do të jenë monotone, apo të thjeshta, ndonëse të rëndësishme për personin që i parashtron. Nuk dëshiron secili të dijë qoftë kuptimin e artit a qasjen më të mirë për t'i dhënë fund një problemi me drogë. Në fakt, shumica e pyetjeve të referencës janë të llojit të referencës së gatshme, që kërkon një përgjigje të shpejtë faktike.

A është bibliotekari i referencës gjeneralist? A është ai i njohur njësoj si me Ajnshtajnin ashtu dhe me T.S. Eliotin? Para disa vjetësh, përgjigja ishte një "po" e padyshimtë. Librat dhe artikujt e mbështetnin bibli-

[12] Çdo vit bëhen sondazhe të panumërta për të përcaktuar kënaqësinë në punë në mesin e bibliotekarëve. Ka një konsensus se bibliotekaria është ekuivalente me profesione të tjera. Afro 54 % do ta rekomandonin bibliotekarinë si profesion. Rachel Gordon dhe Sarah Nesbeitt, "Who We Are…" *Library Journal,* 15 maj, 1999, f. 36-39.

otekarin në punën e tij. Gradualisht, në saje të përparimeve elektronike, si dhe burimeve të fragmentarizuara informative ky përcaktim krenar u tret. Tani, ai është specialist, të paktën në biblioteka, ku ka më shumë se një profesionist përreth. Bibliotekari, nganjëherë edhe me dy tituj magjistraturash, jo vetëm që ecën pa trazim në linjë të gjeneralistit, por në rast të thirrjes ai edhe jep përgjigje në pyetje në rolin e bibliografit, si ekspert i letërsisë së shekullit XIX, apo i shkencave. Ironikisht, po këta ekspertë të mprehtë, me gëzim të madh, po krijojnë softuerë për t'i zëvendësuar, ngjashëm me IBM-në që ia mori titullin kampionit botëror në shah me një fitore vendimtare. Ndërkaq, shumica e bibliotekarëve, ende gjurmojnë për libra të shtypura dhe jo për kompjuterë.[13]

Çfarë duhet mësuar në trajnimin bazë të punës së referencës apo, ndryshe, për këtë profesion në përgjithësi? Që të mund të ndihesh i familjarizuar në një punë reference duhet që fillestari të zotërojë veprat e referencës. Ai duhet ta ndiejë veten mirë pranë kompjuterit, si dhe gjatë bisedës me ndonjë shfrytëzues më shumë se verbal, i cili është duke kërkuar një recetë xhemi apo vetëm për mënyrën se si ta kalojë edhe një ditë.

Me kohë, fillestari bëhet veteran. Kurse, bibliotekarët veteranë kurrë nuk ndalen, ose përjashtohen, ose vdesin. Ata thjesht fitojnë famë si njerëzit më të mençur në botë. Një psikolog sugjeron "një dietë të vazhdueshme të kënaqësive të thjeshta që do t'u mbajë të lumtur". T'i shtohet kësaj edhe kënaqësia e të qenit bibliotekar reference. Është një lezet në formulën e jetës.[14]

UDHËZIMET PËR SHËRBIMIN E REFERENCËS

Departamenti i Shërbimeve të Referencës dhe i të Rriturve i Shoqatës Amerikane të Bibliotekarisë u ofron bibliotekarëve suaza udhëzimesh, të cilat ndihmojnë për të definuar punën dhe për të hartuar, qoftë edhe në mënyrë të përafërt, një filozofi të shërbimit. Udhëzimet quhen "Shërbimet informative për konsumues informativë: Udhëzime për ofertues" dhe "Udhëzime për sjellje performance të profesionistëve të

[13] Gordon dhe Nesbeitt, *op. cit.* Vetëm 20 nga 391 respondentë kanë zgjedhur biblotekarinë si profesion, ngaqë atyre u pëlqen të punojnë me teknologji/kompjutorë. Shumica e zgjedhin atë si profesion ngaqë i duan librat dhe leximin.

[14] *Harper's Magazine,* nëntor, 1997, f. 32.

shërbimeve të referencës dhe informacionit".[15] Dedikuar të gjithë atyre që kanë çfarëdo përgjegjësie në ofrimin e shërbimeve të referencës dhe informacionit, kontributi më i çmueshëm i udhëzimeve është përshkrimi më i ngjeshur i detyrave të bibliotekarit të referencës.

Udhëzimet merren me shërbimet e informacionit nga gjashtë pikëvështrime: shërbimet, burimet, qasja, personeli, vlerësimi dhe etika. Shërbimi parësor është "të ofrojë një produkt final: informacionin e kërkuar nga shfrytëzuesi". Të mësuarit e njerëzve se si ta gjejnë informacionin është detyra e dytë me e rëndësishme. "Udhëzimi i tillë fillon që nga shpjegimi individual i burimeve të informacionit apo nga krijimi i udhëzuesve dhe mediave të duhura për ndihmë formale". Ka një trysni të nevojës për burime aktuale, të sakta, si dhe për qasje të lehtë ndaj këtyre burimeve dhe bibliotekarit të referencës. Pjesa mbi personelin nënvizon rëndësinë e të qenit "tërësisht i njohur dhe kompetent me shfrytëzimin e burimeve të informacionit". Ka dhe shumë më tepër, por kjo deklaratë përfundon me një theksim të Kodit Etik të Shoqatës Amerikane të Bibliotekarisë, i cili "drejton sjelljen e të gjithë anëtarëve të stafit".

Kodi Etik çon drejt një kornize tjetër të udhëzimeve mbi vlerësimin e bibliotekarëve të referencës dhe të shërbimeve të tyre. Për ta siguruar "suksesin e përbashkët" në procesin shumë të ndërlikuar të referencës, "Udhëzimet bibliografike" kërkojnë nga bibliotekarët: (1) *të jeni të qasshëm*. "përgjigjet e para gojore dhe jogojore të bibliotekarit do të kenë ndikim në thellësinë dhe nivelin e ndërveprimit ndërmjet bibliotekarit dhe klientit". (2) *shfaqni interesim.* Një bibliotekar i suksesshëm duhet të demonstrojë nivel të lartë të interesimit në transaksionin referencial. (3) *bëni një intervistë reference.* Këtu atributet e sjelljes që çojnë te një intervistë e mirë njihen edhe si metoda të sqarimit të pyetjes së klientit. (4) *bëni një hulumtim*. Edhe këtu shënohen masat e sjelljes për të ndihmuar në hulumtim, ngaqë "pa një hulumtim efektiv, vështirë është të gjendet informacioni i saktë". (5) *ndiqni çështjen.* "Transaksioni i referencës nuk mbaron me largimin e bibliotekarit nga klienti. Bibliotekari është përgjegjës për përcaktimin nëse klienti është i kënaqur me rezultatet e hulumtimit".

[15] "Shërbimet informative për konsumues informativë: Udhëzime për ofertues", RQ dimër, 1990, f. 262-265. "Udhëzime për sjellje performance të profesionistëve të shërbimeve të referencës dhe informacionit", RQ, nr. 2, 1996, f. 200-203. Këto plotësohen rregullisht.

PYETJET DHE HULUMTIMET

Ka dy ose tri qasje tradicionale bibliotekare në analizimin e pyetjeve të referencës. E rëndomta është numërimi i pyetjeve të shtruara dhe se sa kohë duhet për të dhënë një përgjigje. Kjo vërehet te raportet statistikore dhe, jo rastësisht, me qëllim të racionalizimit të nevojës për më shumë shpenzime dhe personel. Kjo praktikë vazhdon edhe sot, por ka një përqendrim po aq të madh mbi lloje te pyetjeve. Jo që kategorizimi është i lehtë. Duke pasur parasysh qasjen që kanë shfrytëzuesit e hulumtimeve elektronike, herë-herë është vështirë të përcaktohet se çfarë lloj pyetjesh janë duke shtruar ata. Megjithëkëtë, aty ku aplikohet analiza suazat e pyetjeve mbeten pothuajse të njëjta. Kjo mund të ndahet në dy lloje të përgjithshme:

1. *Shfrytëzuesi bën pyetje lidhur me një njësi të njohur.* Kërkesa zakonisht bëhet për ndonjë dokument të caktuar, për ndonjë libër, artikull, film, apo artikull tjetër, i cili mund të identifikohet me citimin e ndonjë karakteristike të posaçme, siç është autori, titulli, a burimi. Bibliotekari vetëm se duhet ta gjejë artikullin e kërkuar përmes katalogut, indeksit, bibliografisë, apo ndonjë burimi të ngjashëm – dhe, shpesh që të gjitha mund të gjenden në një terminal kompjuterik.

2. *Shfrytëzuesi kërkon informacion pa pasur ndonjë njohuri mbi burimin e caktuar.* Një pyetje e tillë çon deri te intervista e referencës – një konsiderim i rëndësishëm në shërbimet e referencës të diskutuara në tërë këtë tekst dhe sidomos në vëllimin e dytë. Shumica e pyetjeve të referencës janë të një lloji të përgjithshëm, sidomos ato në shkolla dhe në biblioteka publike, ku shfrytëzuesi mesatar ka pak apo aspak njohuri lidhur me shërbimet e referencës që janë në dispozicion.

Ballafaqimi me këto dy lloje të gjera të pyetjeve mund të mos jetë punë aq e lehtë sa ç'mund të duket. Për shembull, ai që kërkon një libër të caktuar nga një autor mund (1) të ketë numër të gabuar, (2) në të vërtetë kërkon një libër tjetër nga po ai autor, (3) të zbulojë se libri i kërkuar nuk është ai që kërkohet (qoftë për informacion, qoftë për dëfrim), apo (4) të kërkojë nga bibliotekari ta sigurojë librin përmes huazimit ndërbibliotekar dhe

pastaj të mos paraqitet kur libri të jetë siguruar. E tërë kjo ka detyruar bibliotekarët më me përvojë që ta cilësojnë këtë si lloj "i sojit të njohur" të pyetjes. Supozimi që bën bibliotekari është zakonisht i drejtë dhe shfrytëzuesi në të vërtetë ka nevojë për më shumë informacion apo ndihmë ngaqë duket. Prandaj, bibliotekarët mëtojnë të bëjnë shumë pyetje për të sqaruar nevojën e vërtetë të shfrytëzuesit para se të pranojnë atë që në dukje është sinjal i dobët për ndihmë.

Një kategorizim më i mirë i pyetjeve të referencës mund të ndahet në katër lloje:

1. Udhëzimi. "Ku është katalogu?", "ku janë indekset?", "ku është telefoni?". Informacioni i përgjithshëm apo pyetja udhëzuese i takon llojit të dhënies së informacionit, kurse përgjigja rrallë kërkon diç më shumë se njohuri gjeografike për lokacionet kyçe. Koha e kërkuar për t'u përgjigjur në pyetje të tilla është e papërfillshme, por pyetjet udhëzuese mund të llogariten për 30 deri në 50 % të pyetjeve që i shtrohen një bibliotekari brenda ditës. Përqindja e dhënë këtu dhe në atë që do të pasojë është relative dhe mund të ndryshojë nga biblioteka në bibliotekë.

2. Referenca e gatshme. "Si quhet guvernatori i Alaskës?", "sa është i gjatë lumi Amazonë?", "cili është njeriu më i gjatë në botë?". Këto janë referenca të gatshme apo pyetje tipike që kërkojnë vetëm një përgjigje të thjeshtë, të vetme, të pandërlikuar dhe të drejtpërdrejtë. Informacioni i kërkuar normalisht gjendet pa vështirësi në librat standarde të referencës që nga enciklopeditë deri te almanakët dhe indekset. Shumica nga to mund të kenë qasje edhe në terminal kompjuterik.

Pyetjet e referencës së gatshme mund të ndahen dhe nëndahen në shumë mënyra. Duke kaluar pothuajse nëpër të gjitha linjat tematike, mund të krijohet një skemë e ngjashme me 5 pyetjet e njohura gazetareske. Ato janë *(a) kush?* Kush është...?; kush tha...?; e kështu me radhë. *(b) çfarë?* Çfarë është koreopsisi? *(c) ku?* Ku është qendra e Shteteve të Bashkuara? Ku gjendet palca e tokës? *(d) Pse?* Pse vlon uji? Pse, pse, pse... pothuajse çdo gjë. (Ky fillim i pëlqyer i të gjitha pyetjeve të fëmijëve, vazhdon te shumica prej nesh gjatë tërë jetës). *(e) Kur?* Kur është shkruar *Koriolani*? Kur është zbuluar automobili? Shumica e këtyre pyetjeve kërkojnë vetëm një pjesë specifike të të dhënave. Po ashtu, shumë prej tyre mund të jenë të modifikuara apo të rifrazuara në atë mënyrë sa për të marrë një përgjigje "po", "jo", apo "ndoshta": A është aspirina e dëmshme?

A është zbuluar Amerika në vitin 1492?

Rëndom kërkohet më shumë se një minut a dy për t'u përgjigjur në këtë lloj pyetjeje. Çështja është se derisa 90 % e pyetjeve të këtilla kanë përgjigje të thjeshtë, pjesa tjetër prej 5 deri 10 % kërkojnë orë të tëra hulumtimi, ngaqë nuk ka burim standard të referencës në bibliotekë që do të ofrojë të dhëna të nevojshme. Natyrisht, pyetjet e thjeshta herë-herë janë të ndërlikuara, si për shembull pyetja "cilat janë datat e Javës Kombëtare të Maces?", (përgjigja: fleksibile, por zakonisht në fillim të nëntorit); "kur dhe ku është lozur ruleti i parë rus?", (përgjigja: në Universitetin e Kembrixhit, në vitin 1801. Lordi Bajron e përshkruan këtë ndodhi në kujtimet e tij).

Përqindja e pyetjeve të referencës së gatshme do të ndryshojë nga biblioteka në bibliotekë, por pothuajse 50 deri në 60 % të pyetjeve që shtrohen në një bibliotekë publike janë të llojit të referencës së gatshme. Bibliotekat publike, të cilat mund të kenë shërbim telefonik të zhvilluar mirë për pyetje të referencës, si dhe një përqindje të lartë të shfrytëzuesve të rritur, mëtojnë të tërheqin më shumë pyetje të llojit të referencës së gatshme. Kërkesat për informacion plotësues përbëjnë pjesën tjetër prej 40 deri në 50 % të pyetjeve.

Në bibliotekat akademike, shkollore dhe speciale, pyetjet e veçanta hulumtuese përbëjnë një përqindje më të madhe të totalit.

3. Pyetjet e veçanta hulumtuese. "Ku mund të gjej informacion lidhur me seksizmin në biznes?"; "Cili është dallimi ndërmjet pikëpamjes konservatore dhe liberale mbi inflacionin dhe papunësinë?"; "A keni diçka mbi historinë e energjisë atomike?"; "Më duhet të shkruaj një punim lidhur me pinguinët për lëndën time të shkencës. Çfarë keni?"?. Ndryshimi esencial ndërmjet pyetjes së veçantë hulumtuese dhe pyetjes së referencës së gatshme është me rëndësi. Pyetjet e referencës së gatshme rëndom mund të kenë përgjigje me të dhëna, rëndom përgjigje të shkurtra nga burime reference. Përgjigjet e veçanta hulumtuese pothuajse gjithmonë marrin formën e dhënies së një dokumenti shfrytëzuesit, një listë citatesh, një libër, raport, një faqe Interneti etj.

Më shumë informacion kërkohet për shfrytëzuesin, i cili është duke shkruar një punim shkollor, është duke përgatitur ndonjë fjalim, apo thjesht është i interesuar të mësojë sa më shumë lidhur me një temë për nevojat e tij/saj. Ky lloj i pyetjeve shpesh quhet *kërkim bibliografik*, ngaqë pyetësi i referohet ndonjë ndihmësi bibliografik, siç është katalogu, indeksi,

apo bibliografia. Shumica prej tyre, madje edhe në biblioteka të vogla, janë në dispozicion në CD-ROM apo në Internet dhe e bëjnë hulumtimin më të lehtë – *nëse* dhe kjo "nëse" duhet të theksohet, shfrytëzuesi e di se si të marrë informacionin nga baza e të dhënave elektronike. Në këtë pikë, bibliotekari mund të ndërhyjë, në mënyrë që të ofrojë ndihmë.

Natyrisht, të gjitha pyetjet e veçanta hulumtuese nuk kanë të bëjnë me bibliografitë. Në një nivel më pak të sofistikuar, bibliotekari vetëm sa mund ta orientojë shfrytëzuesin ndaj një artikulli në enciklopedi, ndaj një pjese të caktuar në një koleksion libri, apo ndaj një indeksi digjital gazetaresk.

Koha që kërkohet për t'iu përgjigjur një pyetjeje të përdoruesit varet jo vetëm nga ajo që është në dispozicion, por po ashtu dhe nga bibliotekari. Nëse bibliotekari ofron një sasi të konsiderueshme të ndihmës, kërkimi mund të marrë nga 10 minuta deri në një orë a më shumë. Përkundrazi, një bibliotekar më pak asistues ose i zënë me punë mund ta kthejë këtë pyetje në një çështje orientuese dy-sekondëshe duke ia treguar përdoruesit thjesht katalogun a kompjuterin.

Disa lloje të pyetjeve të kërkimit specifik trajtohen nga ana e bibliotekarit si probleme këshilluese të lexuesit. Këto janë pyetje që në esencë kërkojnë të dinë se "çfarë është burimi më i mirë i informacionit për nevojat e mia?". Pyetësit mund të kërkojnë çdo gjë që nga fiksioni e poezia e deri te revistat e hobit. Varësisht nga madhësia dhe mostra organizative e bibliotekës, pyetjet e tyre mund të trajtohen nga subjekti apo bibliotekarët e kështillit të lexuesve apo nga bibliotekarët e referencës. Në një bibliotekë të vogël, ata janë i vetmi dhe i njëjti person.

4. Kërkimi. Pothuajse çdo lloj pyetjesh e përshkruar në pjesën mbi "kërkimin specifik" mund të shndërrohet në pyetje kërkimore. Një pyetje kërkimore rëndom identifikohet si pyetje që vjen nga një specialist i pjekur, i cili kërkon informacion për asistim në një vepër të caktuar. Kërkesa mund të jetë nga ndonjë profesor, drejtor biznesi, shkencëtar, ose person tjetër, i cili ka nevojë për të dhëna për ndonjë vendim apo informacion shtesë mbi ndonjë problem. Me përjashtim të ndonjë biblioteke akademike apo speciale, kjo lloj pyetjeje është pjesë e neglizhuar e mostrës së përgjithshme e referencës në biblioteka.

Pyetjet mbi referencat e gatshme dhe kërkimin specifik presupozon

përgjigje specifike dhe burime specifike, të cilat, në praktikë, bibliotekari zakonisht mund t'i gjejë lehtë. Pyetjet lidhur me kërkimin ndryshojnë nga pyetje të tjera në atë se ato involvojnë kërkimin e llojit sprovë-gabim apo brouzing, në rend të parë nga që (a) kërkuesi mesatar mund të ketë ndonjë ide të zbehtë lidhur me pyetjen, por rëndom nuk mund të jetë specifik; (b) përgjigja në pyetjen, jo gjithaq të formuluar, varet nga ajo se çfarë është në gjendje të gjejë kërkuesi (apo çfarë nuk mund të gjejë). Kërkuesi e njeh problemin, e identifikon fushën që mund ta mbulojë atë problematikë dhe pastaj përpiqet të gjejë atë që është shkruar mbi atë problem.

Vështirësia me kategorizimin e pyetjeve të referencës është se fare pak prej tyre mund të etiketohen lehtë. E vërteta, kur dikush shtron pyetjen lidhur me banjon, kjo është thjeshtë një pyetje orientuese. E vërteta, kur një person tjetër ka nevojë për material mbi salmonin, kjo është pyetje e kërkimit specifik. Në të njëjtën kohë, një pyetje orientuese mund të kthehet në një pyetje të referencës së gatshme dhe një kërkim specifik mund të zhvillohet në kërkim.

Për shembull, një i ri që kërkon material mbi salmonin, në të vërtetë, mund të jetë i interesuar lidhur me atë se ku mund të peshkojë salmonin në ambientin e afërt. Kështu, një pyetje e supozuar e kërkimit është në të vërtetë një pyetje e referencës së gatshme. Anasjelltas, dikush mund të pyes se ku mund të peshkojë salmon, ndonëse ai person në të vërtetë dëshiron të dijë lidhur me diskutimin e peshkimit. Një pyetje e referencës së gatshme është nxjerrë si një problem kërkimi apo madje edhe hulumtimi.

Çfarë lloj informacioni kërkojnë njerëzit në një bibliotekë publike? Jashtë detyrave shtëpiake, që përbëjnë një pjesë të madhe të pyetjeve, pyetjet tematike më të shpeshta që mund të dalin janë: së pari, problemet mjekësore dhe shëndetësore, përfshirë fituesin; së dyti, kompjuterët dhe teknologjia përkatëse; së treti, problemet personale financiare; dhe së katërti e së pesti, udhëtimet dhe biznesi. Nga fundi i listës janë pyetjet lidhur me: letërsinë dhe shkrimtarët; bibliografinë dhe botimet, si dhe shkencat shoqërore. Ndonëse rezultatet janë vetëm të përgjithësuara dhe u nënshtrohen ndryshimeve masive varësisht nga komuniteti me të cilin kemi të bëjmë, gjetjet të paktën tregojnë interesim themelor nga fillimi i shekullit. Ato, natyrisht, mund të ndryshojnë shpejt.[16]

[16] Norman Oder, "What Does the Public Want to Know", ("Çfarë dëshiron të dijë publiku?"), *Library Journal,* 15 nëntor 1997, f. S4-S6.

INTERVISTA DHE KËRKIMI I REFERENCËS

Ankesa më e shpeshtë në mesin e bibliotekarëve të referencës lidhur me punën e tyre është se fare pak njerëz dinë të shtrojnë pyetje referencash. Ka shumë arsye përse publiku mund të mos e vlerësojë nevojën për qartësi te tavolina e referencës dhe këto arsye janë diskutuar gjatë gjithë këtij teksti. Një mënyrë për ta qartësuar nevojën e individit është që ta inicojë një intervistë reference, e cila mund të marrë vetëm një minut apo të jetë plotësisht e angazhuar.

Intervista e referencës ka disa qëllime. E para është të zbulojë se për çfarë dhe për sa të dhëna ka nevojë përdoruesi. Kjo do të duhej të ishte mjaft e thjeshtë, pos se shumica e njerëzve as që dinë të shtrojnë pyetjen. Fëmija që kërkon informacion mbi kuajt mund të jetë i interesuar në fotografi, një artikull enciklopedik, apo ndonjë libër mbi kalërimin. Pa marrë parasysh gjerësinë e pyetjes, më në fund mbase do të përfundojë si "a keni diçka mbi kuajt?".

I rrituri ka ndonjë ide lidhur me atë se çfarë duhet, si në kuptim të sasisë, ashtu dhe në atë të cilësisë. Por, po ai shfrytëzues mund të jetë i paqartë lidhur me atë nëse artikulli do të duhej përdorur nga ndonjë revistë e veçantë. Cilësimet e autorit dhe të botuesit i janë më të njohura bibliotekarit sesa lexuesit mesatar. Për shembull, në një zinxhir prej 10 citatesh lidhur me energjinë diellore, a do të ishte më i kënaqur një nxënës i shkollës së mesme, një student kolegji, apo një laik me citatet nga *Time, Reader's Digest* dhe *Newsweek*, apo nga *Monthly Energy Review, EPRI Journal* dhe *Solar Energy*? Këto vendime fundamentale të bibliotekarit do të jenë ndihmë e madhe për një person të rëndomtë.

Intervista e referencës shpesh, tepër shpesh, ngec nga mungesa e interesimit nga ana e bibliotekarit, mungesa e njohurive për një ndihmë të tillë nga ana e përdoruesit dhe nga mungesa e durimit nga ana e përdoruesit a bibliotekarit me rastin e fillimit të intervistës. Kjo, thënë se paku, sikur dekurajon si fëmijët ashtu dhe të rriturit nga qasja e bibliotekarit. Nuk është çudi pse në një situatë të tillë një adoleshent i rëndomtë është më i gatshëm të gjejë përgjigjet në kompjuter.

Si adoleshentët, ashtu dhe të rriturit që janë të njohur me lehtësinë e kërkimit në një stacion kompjuterik në bibliotekë, shpesh i shmangen bibliotekarit. Shtypin disa fjalë kyçe, një emër personal, një titull tematik dhe nëse baza e të dhënave pajtohet me pyetjen, në ekran dalin katër a pesë citime. Kjo mjafton plotësisht për një student mesatar apo person

laik, i cili beson se këtu mbaron kërkimi. Ky mund të jetë vetëm fillimi apo një rrugë plotësisht pa krye dhe pikërisht këtu, apo edhe para fillimit të kërkimit, është e nevojshme intervista.

Para pak vitesh, shumica e bibliotekarëve të referencës pajtoheshin se ata kurrë nuk duhet ta interpretojnë apo ta analizojnë informacionin, por vetëm t'u ndihmojnë njerëzve që të gjejnë atë që u duhet. Ende ka diskutime lidhur me bibliotekarët e referencës, të cilët sugjerojnë se cili është një web-sajt i mirë, mesatar, apo i keq. Kjo nuk bën punë! Sot, detyra parësore profesionale e çdo bibliotekari të referencës është që të futet në informacionin në dispozicion, apo edhe në web-sajt dhe të tregojë se çfarë është e përshtatshme për një pyetje të veçantë, apo për një person të veçantë. Thjesht, nuk mjafton t'i ofrosh një individi një kopje të *The Physicians Desk Reference*, pa dhënë shpjegim se çfarë mund të gjejë apo nuk mund të gjejë ai.

Një njeri laik shikon bibliotekarin e referencës si një ekspert, i cili di lidhur me informacionin po aq sa di një mjek për mjekësinë, apo një mekanik për mekanikën. Është detyrë profesionale, që ai të ofrojë opinion dhe diskriminim – opinion lidhur me atë se çfarë është më e mirë dhe diskriminim se në çfarë niveli intelektual është. Kryeredaktori i *Library Journal* e përmbledh këtë kështu:

> Juristi na thotë se çfarë është e ligjshme, si dhe kë ta padisim dhe përse. Madje, edhe një agjent tregtar garanton itinerarin më të mirë dhe çmimet më të lira. Nëse synojmë që të jemi po aq "profesionistë" sa dhe këta, do të duhet të jemi të gatshëm për të dhënë vlerësime të tilla si ata dhe këshilla të ngjashme. Nëse synojmë të mbijetojmë në këtë epokë të re të qasjes së lehtë në çfarëdo lloj informacioni, ne nuk kemi zgjidhje tjetër pos ta ngremë veten dhe shërbimin tonë në lartësinë e këtij roli kyç të këshillëdhënësit informativ. Nëse nuk ofrojmë këtë lloj shërbimi të informacionit profesional, atëherë kush ka nevojë për ne?[17]

Kanë ndodhur shumë ndryshme, më shumë nga nevoja sesa nga disenjimi. Burimet elektronike detyrojnë bibliotekarët e referencës që të paktën të tregojë se si përdoren ato dhe, ne këtë proces, cilat duhet konsultuar për një pyetje të caktuar. Gjatë këtij procesi pashmangshmërisht ngrihen probleme të luhatshme, të cilat bëjnë që bibliotekari të japë udhëzime, që

[17] John Berrym "Risking Relevant Reference Work", *Library Journal,* 15 maj 1998, f.6.

rëndom shndërrohen në një intervistë joformale të referencës. Bibliotekari i sotshëm është më i lëvizshëm, shpenzon më pak kohë pranë tavolinës dhe më shumë kohë duke asistuar përdoruesit e ngatërruar të thelluar në web apo të tretur në materialet e librave të referencës.

Kush duhet të japë përgjigje?

Rezultati fascinues nga analiza e llojeve të pyetjeve është (1) shumica e dyshimeve janë të drejtpërdrejta ose thjeshtë kanë të bëjnë me referenca të gatshme, që janë më se të thjeshta; (2) në përgjithësi, dyshimet dhe burimet e përdoruara janë të thjeshta dhe të lehta për t'u kuptuar dhe (3) shumicës së pyetjeve, si rrjedhojë, mund t'u jepet përgjigje nga një person i trajnuar shumë mirë dhe që ka diplomë fakulteti.

Mirëpo, kjo nuk do të thotë se një person i trajnuar mirë, që është joprofesionist, mund dhe duhet të zëvendësojë bibliotekarin profesional me qëllim të dhënies së përgjigjeve në dyshimet që kanë të bëjnë me referencat e gatshme dhe ato të drejtpërdrejta. Shumë shpesh, pyetjet e thjeshta mund të shndërrohen në pyetje komplekse, për të cilat nevojitet ndihma profesionale. Edhe kur joprofesionistët përdoren në disa raste, biblioteka mund të mbështetet në bibliotekarët e tjerë (jo të referencave) vetëm për të dhënë ndihmë në tavolinën e referencave.

A ka ndonjë dallim se kush jep përgjigje në një pyetje reference, një bibliotekar profesionist apo një nëpunës i thjeshtë? Nuk ka-nëse përgjigjja i mjafton shfrytëzuesit/përdoruesit. Ka-nëse nëpunësi apo bibliotekari dështon që të japë informacione të mjaftueshme dhe të sakta. Nëse nëpunësi ka shkollim më të mirë, është më personal dhe, po ashtu, ka më shumë përvojë sesa bibliotekari, në këtë rast nëpunësi mund të marrë më shumë pikë sesa bibliotekari. Dallimet janë në faktin se besohet që profesionistët do të bëjnë punë më të mirë për shkak se janë më të shkolluar. Në fakt, profesionistët janë më të mirë, sepse ata dinë çka dhe sa informacion duhet për dyshimet dhe pyetjet individuale.

Me rastet tipike, ku bibliotekat po kanë më pak para dhe në të njëjtën kohë kërkesat për burimet më të sofistikuara elektronike të referencave po shtohen, bëhet pyetja se si një bibliotekë e mesme referencash apo e madhe i përballon këto presione? Disa përgjigjen "ata nuk janë duke u qëndruar presioneve" dhe i ngrijnë duart lart. Në të shumtën e rasteve, përderisa administrata e zvogëlon numrin e njerëzve profesionalë (zakonisht për të kursyer para për veprat e njëjta elektronike të referencave) dhe e rrit numrin

e para-profesionistëve. Një jo-bibliotekar, i cili punon mirë me kompjuter, mund të bëjë shumë duke ndihmuar përdoruesin rreth Internetit apo rreth bazave të komplikuara të të dhënave. Personat e tjerë jo-bibliotekarë mund të jenë në gjendje që t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me referencat e gatshme. Duke ndjekur kanalet, procesi i zakonshëm ka për qëllim që t'i kërkojë ndihmë bibliotekarit profesional vetëm në rastet kur ka problem serioz, apo një pyetje që s'mund t'i jepet përgjigje. Është duke u zhvilluar një debat i ashpër rreth kësaj "situate", e cila e ndihmon shpërndarjen e personelit dhe të burimeve të kufizuara. "Departamentet e referencave duhet gjithsesi të jenë të kujdesshme, që megjithatë, të mos bëjnë si trendi i HMO-së, i cili ka kufizuar ndjeshëm kohën e doktorit që shpenzon me një pacient. Shumica e bibliotekarëve të intervistuar thonë se kënaqen me punën e tyre në këtë periudhë elektronike, pikërisht për shkak të sfidave të reja dhe synimit për të gjetur përgjigje të duhura për pyetje të vështira.[18]

Kërkimi-hulumtimi

Në çdo kërkim-hulumtim merren disa hapa, gati të ndërgjegjshëm: (1) Pyetja është qartësuar, kështu që është e saktë sa më shumë që lejojnë rrethanat; (2) Pyetja është e lidhur me një burim të caktuar të referencës; (3) Metodat e kërkimit zbatohen këtu për ta zgjeruar apo për ta ngushtuar kërkimin, varësisht nga nevoja.

Problemi qëndron në faktin se ka shumë nga çdo gjë. Dredhitë e kërkimit të shpejtë dhe efikas dallojnë nga pyetja në pyetje, e nga situata në situatë. Prapëseprapë, metodat dhe teknikat e kërkimit janë më se të thjeshta. Shumica e tyre zbatohen si në kërkimin Online, po ashtu edhe në atë të shtypur. Metodat e kërkimit janë një nga dy kategoritë e mëdha. Mënyra më efikase është që të shkohet drejtpërdrejt te burimi i saktë. Për shembull: për një numër telefoni-te libri i numrave të telefonit; për kuptimin e fjalës botë-në fjalor; për statistikë-te libri i statistikës; për një pyetje rreth historisë së artit-te enciklopeditë e ndryshme. Gërshetimi i thjeshtë i pyetjes dhe i burimit nuk është gjithmonë i lehtë ose i drejtpërdrejtë. Mënyra e dytë, apo qasja më e zakonshme është që të shkohet nëpër një numër hapash, të cilët e bëjnë më të qartë marrëdhënien ndërmjet pyetjes apo dyshimit dhe burimit. Hapat themelorë për të gjetur një përgjigje korrekte ndjekin disa rrugë të njohura:

18 Carol Tenopir, "Reference Use Statistics", Library Journal, 1 maj, 1998, f. 34.

1. Hapi i parë është që të kuptohet pyetja, nëse është një dyshim i thjeshtë faktik (p.sh., sa është popullata e Sietllit?) apo një pyetje kërkuese (cilat janë argumentet pro dhe kundër kontrollimit të armëve?), apo një pyetje hulumtuese (cilat janë zgjidhjet më të mira që vendi të ketë lulëzim dhe rritje ekonomike në 50 vitet e ardhshme?). Secila nga këto lloj pyetjesh kërkon mënyra të ndryshme të kërkimit. Pyetjes së thjeshtë faktike mund t'i jepet përgjigje përmes një burimi të vetëm të referencës. Këtu, dredhia kryesore, që duhet ditur, është ajo se cili burim duhet konsultuar. Për pyetjet kërkuese duhen më shumë informacione, të cilat më së shpeshti gjenden në enciklopedi (për të kaluarën dhe historinë) me informacionet e modifikuara në indeks (për mendimet dhe argumentet aktuale). Dikush që është duke bërë kërkim për këtë apo atë subjekt e ndjek rrugën e njëjtë. Problemi i kërkimit e fut në lojë gjithë bibliotekën dhe jo vetëm një apo dy burimeve të referencave.

2. Kur pyetja është qartësuar, një tjetër e modifikon atë tutje duke ju kthyer edhe një herë fjalëve kryesore, frazave, dhe titujve të subjektit që më së mirë përshkruajnë çka një njeri dëshiron të gjejë. Në të vërtetë, në definimi dhe rafinimin e subjektit, kërkuesi-hulumtuesi ka të ngjarë që të ketë përdorur fjalë kryesore apo fraza, të cilat mund të përdoren për një kërkim të vërtetë. Dikush dëshiron informacione rreth arkitekturës angleze të renesancës. Ai njeri mund të filloj me nocionin e përgjithshëm rreth "arkitekturës" duke e ngushtuar atë në "Angli" dhe më pastaj të vendosë që ta ngushtojë edhe më tutje, duke u përqendruar vetëm në "periudhën e renesancës." Të gjitha fjalët në thonjëza janë fjalë kryesore, të cilat mund të përdoren në kërkim-hulumtim.

Fjalët kryesore duhet të jenë specifike. Për shembull, "arkitektura angleze e renesancës" e tregon vendin, kohën dhe subjektin. Dyshimi-pyetja mund të bëhet edhe më specifike duke shtuar ose zëvendësuar "Anglinë" me "Londrën". Sa më i ngushtë dhe sa më specifike që të jenë fjalët kryesore, aq më e lehtë është gjetja e materialit. Nëse bëhet shumë specifike, atëherë personi në fjalë mund ta zgjerojë atë, duke shtuar fjalë të tjera ose fraza.

Nëse keni mëdyshjen se çfarë fjalësh ose frazash duhet të përdoren, provo një apo dy gjëra: (a) shko te indeksi që është afër subjektit për të cilin jeni të interesuar dhe shiko se çfarë tituj të subjektit gjenden aty. Po ashtu, keni parasysh edhe referencat "shiko" dhe "shiko po ashtu" për të gjetur fjalët specifike të subjektit dhe përshtatjes së termave; (b) konsultohu me veprat standarde si Library of Congress Subject Headings, një libër

disa vëllimesh, i cili i jep subjektet sipas radhitjes alfabetike.

Kur tema dhe fjalët kryesore janë izoluar apo gjetur, ju duhet të dini se ku të shkoni për të gjetur informata. Vendimi kryesor ka të bëjë me atë nëse duhet shikuar në veprat e shtypura apo ato Online.

3. Në këtë pikë, janë së paku tri metoda të hapura për atë, i cili është duke kërkuar informacione në temën e lartpërmendur "arkitektura angleze në renesancë": (a) konsultohu me katalogët Online të bibliotekës dhe shiko nëse ka libra për këtë subjekt; (b) konsultohu me indeksin e periodikëve që ka të bëjë në radhë të parë me arkitekturën dhe/ose artin. Në këtë rast, do të ishte Indeksi i Artit apo Indeksi i Arkitekturës. Një tjetër mundësi do të ishte, çdo tjetër indeks i përgjithshëm Online, i cili përmban më pak artikuj teknikë. Kërkimi do të bëhej duke shënuar fjalët kryesore, ose titujt e subjektit të përdorur në katalogun e bibliotekës; (c) shko në Internet dhe kërko burimet e artit dhe të arkitekturës siç janë "Arti në Internet", e cila është një galeri vizuele e artistëve dhe e disa arkitektëve; ose shko te Biblioteka e Arkitekturës e Universitetit të Kalifornisë.

Ka edhe shumë metoda të tjera për të gjetur atë çka nevojitet. Për shembull, emri i një arkitekti, shumë të njohur, të kohës së renesancës ka gjasa që nuk është përfshirë në kërkimin e parë. Ju mund të kërkoni informacione rreth katedraleve të famshme dhe të kërkoni informacione rreth vendeve specifike të ushtrimit të besimit. Me fjalë të tjera, nuk ka kufizime në sulmimin e problemit, përveç imagjinatës së kërkuesit.

Mbaj shënime të vazhdueshme rreth mënyrës së gjetjes së informatave, së paku për pyetjet të cilat nuk kërkojnë më shumë se disa minuta për t'u përgjigjur. Kur gjeni një web-sajt të rëndësishëm në Internet, shënoje atë, kështu që në të ardhmen ta përdorësh si referencë. Nëse indeksi X apo Y duket se po ju bën punë dhe ju ndoshta dëshironi që t'i hidhni një sy përsëri, shënojeni emrin e tij dhe cilat vite i mbulon, duke mos harruar as titujt e subjektit që përdor.

Të gjithë hapat për të gjetur të dhëna ishin vetëm për të filluar kërkimin. A duhet të jetë katalog, një indeks, fjalor apo burim biografik? Cili indeks apo cili burim biografik? Sekreti i efikasitetit ekonomik të referencave qëndron në faktin se duhet të dish ku të shkosh. Fokusi është i tëri, sepse ka shumë mundësi për të humbur kohën, duke shkuar nga njëri web-sajt në tjetrin, duke dështuar që të lidheni me atë çka nevojitet dhe çka kërkohet.

Përmbledhja e kërkimit

Në aspektin se ku i gjen përgjigjet bibliotekari i referencave ka tri rrugë:

Nëse keni të bëni me një titull specifik, autor, apo subjekt, konsultohuni me katalogun e bibliotekës për një libër.

Nëse keni të bëni apo po kërkoni një burim specifik për një subjekt apo person, shkoni drejtpërdrejt te ai burim (te fjalori për definicione, te atlasi për harta; te vepra biografike e referencave për biografinë e një personi etj.).

Nëse ju mungojnë këto që u përmendën më lartë, që ndodh shumë shpesh, provo që të bashkosh apo koordinosh pyetjen me formën e referencës. A mund të gjendet informacioni më lehtë në enciklopedi, në indeks, apo në një burim bibliografik? Atëherë kur forma është gjetur, shkoni te burimet Online, CD-ROM, ose në Internet për të gjetur shënimin më efikas në atë fjalor, indeks, apo vepër tjetër të referencës.

Roli i bibliotekarit të referencave

Heroi i bibliotekës është bibliotekari i referencave, i cili me besim mund t'i lidhë burimet me përgjigjet, madje pa nervozizëm. Kur, për shembull, a është burimi biografik ai i cili m'i tregon mua emrat e tre djemve të Noas? (Shemi, Hami dhe Japhethi); ose cila enciklopedi shkencore mund t'i përgjigjet pyetjes së lexuesit, se "cili është dallimi në ndërtimin gjenetik ndërmjet meje dhe Xhoit"? (Secili nga ne ka 99.8 % përbërje të njëjtë gjenetike. Dallimi është më pak se 0.2% - që shpjegon se pse ju jeni i bukur, ndërsa Xhoi është një idiot).

Bibliotekarët me përvojë japin përgjigje të sakta dhe korrekte nëpërmes kujtesës së tyre dhe burimeve të konsiderueshme të referencave.

Bibliotekari superior i referencave ka kërkesa të tjera, përveç kujtesës së kalueshme. Logjika ndihmon. Mundësi dhe aftësia që të marrë një dyshim, ta deshifrojë atë, ta riformulojë dhe t'ia japë prapë personit, i cili e shkroi pyetjen sikurse të ishte e tij/saj; kjo është një aftësi e intervistuesit të referencave. Atributet e tjera të dëshirueshme përfshijnë shfaqjen e mençur dhe simpatike kur dikush ju pyet: "Çka është dashuria?", apo "cili është kurimi për gripin?", apo "si mund ta marrë notën A në test"?

Rruga deri te suksesi është qëndrimi i qetë, sikurse ai i Zenit. Kjo më shumë bazohet në gatishmërinë dhe besimin se kur duhet të thuhet, gjithmonë në mënyrë të kulturuar, "le të shohim se çka mund të gjejmë". Puna në

fushën e referencave do ta tregojë rrugën. Burimet e qarta të referencave do të japin përgjigje, madje edhe për pyetjet më të vështira. Dhe, nëse nuk keni një përgjigje të saktë, së paku do të jetë një shkëmbim prapa, i cili do të jetë i kënaqshëm.

Shërbimi i Referencave dhe biblioteka

Bibliotekari i referencave nuk funksionon i vetëm në bibliotekë, por është pjesë e një tërësie më të madhe, e një misioni më të madh. Në ditët e sotme, biblioteka është më shumë se vend ku ka dokumente - një depo.

Shumica e bibliotekave tanimë kanë zëvendësuar ose futur në përdorim kartën familjare të katalogut me qasjen Online dhe publike në katalog. Në letërsi, kësaj i referohet më shumë me emrin OPAC. Sot, këta katalogë shumicën e herave kanë edhe të dhëna të tjera dhe janë ndër pajisjet e para që përfshihen në rrjetet lokale dhe ato ndërkombëtare. Shumica e 225 katalogëve të bibliotekave të mëdha akademike në 10 vende kanë qasje nëpërmjet Internetit dhe linkeve të tjera. Bibliotekari, ose përdoruesi, ulet përpara kompjuterit, i shënon disa pjesë të fjalës dhe i jepet qasje e menjëhershme në dokumentet e bibliotekës apo bibliotekave – zakonisht me të dhëna shtesë.

Teknologjia. Zhvillimi i shpejtë i teknologjive të reja në ruajtjen e informacioneve dhe përmirësimin e tyre do të thotë se bibliotekat më të mëdha zakonisht kanë një zyrë speciale, divizion, apo seksion, i cili përkushtohet që (1) t'i këshillojë administratën dhe bibliotekarët për zhvillimet prej metodave të reja të rrjeteve deri te përmirësimi i monitorëve të kompjuterëve; (2) të bëjë vlerësimin e harduerëve, softuerëve dhe komponentëve të tjerë të sistemeve të informacionit modern; dhe, në shumë raste (3) të vendosë çka të blejë, çka të mënjanojë dhe si të punojë me një buxhet të kufizuar.

Shërbimi i lexuesve: Qarkullimi. Qarkullimi është një nga dy shërbimet primare publike në bibliotekë. Pasi është marr një libër dhe bëhet gati për një qasje të lehtë, departamenti i qarkullimit është i zënë me (1) dhënien e materialit në lexim (2) kthimin e materialit dhe (3) kthimin e tij në lokacionin e duhur.

Shërbimet për të rritur. Referencat. Një komponent i rëndësishëm i

Shërbimit të referencave është Shërbimi për të rritur, që zakonisht përdoret si një sinonim për "shkollimin e rritur". Kjo është një fushë e specializuar, edhe pse në punën e përditshme bibliotekari i referencave do të jetë i përfshirë në shërbimet për të rritur siç janë dhënia e asistencës me informacionet rreth punësimit apo shërbimi i njerëzve me aftësi të kufizuara.

VLERËSIMI I BURIMEVE TË REFERENCAVE

Me më shumë e më shumë burime të referencave, vlerësimi është gjithçka. Bibliotekari duhet të jetë në hap me shtimin e burimeve të informacionit, e më e rëndësishmja është se duhet të jetë në gjendje të gjykojë se çka nevojitet për një bibliotekë dhe audiencën e saj.

Si e di një bibliotekar nëse burimi i referencës është i mirë, i keq, apo indiferent? Një përgjigje më e detajuar dhe e hollësishme do të gjendet nga pak në secilin kapitull vijues të këtij libri. Thënë thjeshtë, një burim i mirë i referencës është ai që i përgjigjet pyetjeve, ndërsa një burim i keq i referencës është ai që dështon t'i përgjigjet pyetjeve. Përdorimi i vazhdueshëm do të ndihmojë në identifikimin e çdo burimi (pa marrë parasysh nëse është libër apo bazë e të dhënave) me një nga këto dy kategori.

Për shkak të çmimit të lartë të shumicës së burimeve të referencave, praktika e zakonshme është të lexohet së pari një apo më shumë analiza e më pas të merret vendimi për ta blerë apo për ta huazuar. Po ashtu, bazat e gatshme të të dhënave kërkojnë një vendim të tillë.

Bibliotekat më të mëdha, përpara blerjes, zakonisht kërkojnë apo automatikisht marrin kopje të ekzaminimit të veprave të shtypurave të referencave. Aranzhime të ngjashme bëhen edhe për provat Online, CD-ROM-ët, shitësit, e kështu me radhë. Idealisht, burimi i referencave duhet të ekzaminohet nga një bibliotekar i trajnuar i referencave përpara se ai burim të inkorporohet në koleksionin e bibliotekës. Analiza është më se e sigurt. Bibliotekat më të vogla zakonisht nuk kanë zgjidhje veçse të pranojnë botën e analistit.

Vlerësimet Online

Vlerësimet efektive të përmbajtjes së bazave digjitale të të dhënave varet në metodat që janë të ngjashme me ato që përdoren për vlerësimin

e veprave të shtypura. Në këtë rast, qëllimi, autoriteti dhe përmbajtja duhet të testohen.

Po ashtu, janë edhe disa aspekte të tjera, që duhet marr në konsideratë. Ju duhet të vlerësoni formatet e ndryshme: Si bëhet qasja në të dhëna? A i përmbush nevojat specifike të përdoruesit mestar? Si modifikohet vepra dhe sa shpesh bëhet ajo? Çfarë softueri është i nevojshëm për përdorimin e plotë të bazës së të dhënave? A është kërkimi i lehtë apo i vështirë për fillestari, apo për bibliotekarin e trajnuar? A ka dokumentime, pra manuale e kështu me radhë? A përgjigjet ndokush kur ndonjëri ka nevojë për ndihmë?

Ju, po ashtu duhet t'i krahasoni çmimet e ndryshme të shitësve të shumtë, formatet dhe pagesat për bazat individuale të të dhënave me shpejtësinë dhe efikasitetin e kërkimit të kompjuterit. Nuk duhet lënë anash as analiza e hollësishme e politikave të çmimit.

Masat e vlerësimit shtjellohen përgjatë këtij teksti ku secila nga bazat e të dhënave apo grup i bazave ekzaminohet. Pa marrë parasysh a është e shtypur apo bazë elektronike e të dhënave, janë disa pika të përbashkëta vlerësimi që kanë të bëjnë me rëndësinë e përmbajtjes. Në disa raste, kur kemi të bëjmë me afera dashurie me bazat e të dhënave dhe teknologjinë, bibliotekari (më shumë të ngjarë, publiku) harron qëllimin e vetëm të veprës së referencave dhe përmbajtjes së saj. Mjetet e drejtimit, zilet dhe fishkëllimat, çmimi i ulët dhe emocioni i së resë - të gjitha janë faktorë, të rëndësishëm apo më pak të rëndësishëm. Në gjuhën e trendit të veshjes - madje, as veshja më e mirë e dizajnuar nuk do ta kthente John apo Joan në personalitetet fituese, përderisa ata të dy nuk kanë një substancë të brendshme. Natyrisht, kjo është e qartë. Mirëpo, disa herë harrohet nga botuesit shumë të zellshëm të botimeve të referencave.

Në një anketë të zakonshme të 61 bibliotekave publike, të cilat ofrojnë qasje Online në bazat e të dhënave, është gjetur se: "Gati 87% e të anketuarve vlerësojnë përdorimin e përmbajtjes si të një rëndësi të madhe përderisa ¾ e të anketuarve thanë gjënë e njëjtë për kualitetin e përmbajtjes. Për bibliotekat e vogla me koleksione të kufizuara, përdorshmëria e përmbajtjes është posaçërisht vitale". Në të njëjtën kohë, menjëherë pas përdorimit të subjektit ishte përdorimi i lehtë- "arsyeja më e zakonshme se pse bibliotekat private përkrahin përdorimin e bazës Online të të dhënave".[19]

[19] Carol Tenopir, "Influencing Database Use in Public Libraries", Libraries Journal, 1 qershor, 1999, f. 40.

Përveç përmbajtjes, bibliotekari duhet të bëjë së paku katër pyetje themelore rreth një vepre të referencës: Cili është qëllimi i saj? Autoriteti i saj? Përmbajtja e saj? Audienca e saj? Së fundi, formati i veprës duhet marr parasysh për veçoritë drejtuese dhe të shtypit për bazat elektronike të të dhënave. Këto pyetje janë të aplikueshme si për World Almanac në versionin e shtypur, po ashtu edhe për indeksin Online, ABI/Inform.

Duhet të keni parasysh se madje edhe vlerësimi i ekspertit mund të harrojë atë çka është më se e qartë. Gabimi është përjetësuar në veprat më të mira të referencave. Moxarti nuk ishte varrosur në një varr prej letre as Uellingtoni nuk kishte thënë se Beteja e Waterloo-së ishte fituar në fushën e lojës së Etonit. Këto edhe nocionet e tjera faktike mund të gjenden shpesh në burimet e tjera të mrekullueshme të referencave, duke filluar nga ato të shtypura deri te ato në Internet.

Kriteri primar i vlerësimit

1. *Qëllimi*. Qëllimi i veprës së referencës duhet të jetë evident prej titullit apo formatit të tij. Pyetja vlerësuese duhet të shtrohet: A e ka përmbushur qëllimin autori apo përpiluesi? Në një enciklopedi të vallëzimit, për shembull, a është arritur qëllimi i përmbledhjes së informacioneve esenciale për vallëzimin? Menjëherë, bibliotekari duhet të pyes apo të shtroj pyetje të tjera: Çfarë lloji i vallëzimit dhe për çfarë periudhe kohore? Për çfarë grup moshe, grup moshe me përvojë apo të sofistikuar në vallëzim? Për cilat vende? A vihet theksi në histori, biografi, në zbatimet praktike, apo diku tjetër?

Qëllimi i një vepre zakonisht mund të gjendet në:

Përmbajtjet;

Hyrjet apo parathëniet, të cilat duhet të japin detaje rreth asaj se çka pret autori apo përpiluesi që kjo vepër të arrijë;

Indeksin, i cili në një fjalë tregon se cilat subjekte janë të mbuluara

Një vepër e shtypur referencash, e cila nuk ka një indeks, ka pak ose fare vlerë. Përjashtime këtu bëhen për fjalorët, udhëzuesit dhe titujt e tjerë, ku indeksi është i ndërtuar sipas radhitjes alfabetike. Ky sistem është shumë i përshtatshëm për llojin e të dhënave, si veprat e referencave, mirëpo kurrsesi për prozën ku indeksi është absolutisht esencial.

Ndihmesat e tjera rreth qëllimit të një vepre të caktuar zakonisht jepen në katalogun e botuesit, në shënimet që dërgohen me postë dhe në një

kopje në xhaketën tuaj apo në kopertinën e një libri. Përshkrimet e tilla mund të ndihmojnë për të treguar qëllimin dhe përdorshmërinë relative. Mirëpo, duhet thënë që nuk janë shumë objektive.

1. *Bazat elektronike të të dhënave*. Qëllimi tregohet qartë nga botuesit komercialë të bazave të të dhënave. Në formatin digjital, më shumë i besohet materialit përshkrues të botuesit apo shitësit sesa ekzaminimit të vërtetë. Këtu, në radhë të parë, për shkak të çmimit të lartë dhe mungesës së qasjes së menjëhershme, analizat e veprave të referencave janë të një rëndësi të madhe. Në Internet, mund të jetë e vështirë të përcaktohet qëllimi. Ju mund të shikoni për qëllimin e veprës në web-sajtin e parë (home page) apo diku në majën e faqes së parë, mirëpo kjo mund të mos jetë e përfshirë. Një shenjë e mirë, që tregon se informacioni është dyshues është mungesa e përcaktimit në shkrim të qëllimit, përmbajtjes, apo autoritetit nga ana e atij që ka bërë web-sajtin.

Një vepër e referencës është aq e mirë sa edhe indeksi i saj. E vërteta e rëndomtë, apo mos ndoshta kjo aplikohet vetëm për bazat elektronike të të dhënave? Po. Indeksimi mund të mos duket i rëndësishëm, për shkak se çdo kërkim mund të bëhet fjalë për fjalë, frazë për frazë. Mirëpo, për të gjetur atë që nevojitet, në mënyrë që të mënjanohen shumë goditje, çdo bazë e të dhënave duhet të jetë "e etiketuar" në mënyrë të saktë (p.sh. një lloj i indeksimit zakonisht bëhet me një program gjuhësor). Nëse kjo nuk bëhet ashtu siç duhet, humbet shumica e informacionit, në makinën e kërkimit dhe te kërkuesi individual.

2. *Përmbajtja dhe Aktualiteti*. Pyetjet e tjera që janë të një rëndësie të madhe në përzgjedhjen e një vepre të referencës janë: A do të jetë kjo një shtesë reale në koleksionin tonë dhe nëse po, çka saktësisht do të shërbejë? Botuesi zakonisht do të tregojë përmbajtjen e librit në parathënien e tij, mirëpo bibliotekari duhet të jetë i kujdesshëm. Autori mund të ketë apo të mos ketë arritur përmbajtjen që ka synuar. Për shembull, botuesi mund të thotë se atlasi historik mbulon të gjitha vendet, në të gjitha periudhat kohore. Bibliotekari duhet ta kontrollojë përmbajtjen e atlasit të ri historik duke e krahasuar atë me veprat/atlaset e tjerë standardë. A i përfshin vërtetë atlasi i ri të gjitha vendet dhe të gjitha periudhat kohore, apo a i përjashton materialet e gjetura në veprat e tjera standarde? Nëse indeksi thotë se mbulon të gjithë artikujt kryesorë, në disa periodikë të caktuar, një kontrollim i thjeshtë i artikujve të periodikëve dhe krahasimi i indeksit do të tregojë përmbajtjen e vërtetë të indeksit.

Në vlerësimin e përmbajtjes, merr në konsideratë se çka ka kontribuar

autori, kontribut që nuk mund të gjendet në bibliografitë, indekset, fjalorët dhe atlaset e tjerë. Nëse vepra është gjithëpërfshirëse në një fushë të caktuar të subjektit, ajo lehtë mund të krahasohet me burimet e tjera. Për shembull, Who's Who i edukimit, i cili kufizon veten vetëm në edukatorët apo mësimdhënësit, që ligjërojnë në kolegje dhe në universitete më kryesor në verilindje, mund të kontrollohet lehtë rreth përmbajtjes së tij, duke e krahasuar edhe katalogun aktual të kolegjit të P & Q University. Nëse numri i profesorëve mungon në veprën e re, ju mund të arrini në përfundim se përmbajtja nuk është ajo që pretendohet. Sa aktual është materiali? A modifikohet në bazë ditore (zakonisht Online), javore, mujore, apo më shpesh? A përfshin modifikimi gjithë materialin apo vetëm përmbajtjen kryesore të shërbimit? Pyetja rreth modifikimit është e rëndësishme për të gjitha veprat e referencave, mirëpo duhet thënë që është posaçërisht me vlerë të madhe për indekset, ku ka shënimet të aktiviteteve ditore. Në anën tjetër, modifikimi i një enciklopedie arti apo muzike mund të jetë i nevojshëm çdo katër apo pesë vjet, apo më gjatë. Shumica e veprave të referencave përfshijnë informacione të datuara.[20] Metoda më e mirë e përcaktimit nëse materiali i vjetër ka ndonjë vlerë dhe kontrollimit të faktorit të regjencës është që të shikohet vepra. Kjo ka të bëjë me shikimin e emrave, të cilët janë aktualisht në lajme, shifrat e popullatës, kufijtë gjeografikë, shënimet e të arriturave, ngjarjet aktuale dhe gati çdo fakt tjetër, që ka të bëjë me qëllimin dhe përmbajtjen e veprës. Është e rëndësishme të rikujtohet se asnjë vepër e referencës nuk duhet të pranohet apo të hedhet poshtë pasi të jenë kontrolluar një apo dy veçori.

Nëse vepra trumbeton se është një edicion i ri, shtrirja e revizioneve të përmendura duhet të vlerësohet me kujdes. Kjo mund të bëhet lehtë duke krahasuar veprën me edicionin më të ri (disk) apo duke hasur në mospërputhje ndërmjet datave të materialeve të cituara dhe datës së publikimit.

Data e së drejtës autoriale (copyright) – e cila zakonisht gjendet në

[20] Bazat Online të të dhënave, të cilat mund të modifikohen për një minut, janë më të aktuale ekuivalentët e tyre të shtypur apo ata në CD-ROM. Letra duhet të formatizohet dhe të dërgohet me postë përpara se të mund të përdoret në bibliotekë. Online nuk merr më shumë kohë sesa një prekje. Ka edhe shembuj kur Online nuk është edhe aq aktuale si burimet tradicionale të referencave. Bibliotekari duhet të jetë i njohur me këto dallime kohore, posaçërisht kur një burim i caktuar përdoret shpesh. Zakonisht, paraqitja fillestare e një baze të dhënash jep emrin e bazës së të dhënave dhe të dhënat e përgjithshme, përfshirë edhe datën e botimit të fundit. Keni parasysh se baza e të dhënave e cila mbahet nga kompanive të ndryshme, prej OCLC deri te DIALOG-mund të kenë modifikime të ndryshme. Për një diskutim të kësaj, shiko Peter Jacso "New Bottles? The Currency of Databases" Online, mars/prill, 1997, f. 69-72.

fund të faqes së parë të librit - përfaqëson dy kontrollime të rëndësishme në veprën e referencës. Së pari, data e dhënë jep një indikacion se kur materiali ishte vënë ne versionin e shtypur apo Online, dhe kur ishte modifikuar. Më e rëndësishme, nëse vepra ka shkelur të drejtën autoriale, p.sh. është së paku 50 vjet e vjetër (apo disa herë edhe më e vjetër), a është bërë ndonjë përpjekje që të modifikohet, apo është thjeshtë një version, i cila ka vlerë të vogël për kërkuesit-hulumtuesit e sotëm.

Bazat elektronike të të dhënave. Bazat Online të të dhënave i kanë bërë të dhënat aktuale një realitet. Tashmë, askush nuk ka nevojë që të presë për një indeks në version të shtypur, që të arrijë në bibliotekë, kështu që të jetë në gjendje të marrë vesh se çka ka ndodhur një javë apo muaj më parë. Duke përdorur Internetin, përgjigja mund të gjendet brenda disa minutave, nëse jo për vetëm disa sekonda.

Një përparësi e madhe e Internetit, e po ashtu edhe e disa bazave komerciale të të dhënave, është fakti se lejon që materiali të modifikohet brenda minutave. Natyrisht, shumë pak web-sajte janë aq aktuale, mirëpo shumica shumë vënë në pah të dhënat e "freskëta". Shumë web-sajte tregojnë se kur janë modifikuar së fundi. Kjo nuk është e rëndësishme për të dhënat historike, mirëpo është tjerr gjë me ngjarjet që kanë ndodhur ditën e djeshme. Gjithmonë, kontrollo datën. Nëse asgjë tjetër, tregon interesin e vazhdueshëm apo të humbur të sponsorit.

3. *Audienca (Publiku)*. Me përjashtim të enciklopedive për të rinj, shumica e veprave të referencave, pavarësisht nga formati i tyre, u dedikohen dhe janë për të rritur. Kur merr në konsideratë pyetjen e audiencës (Online apo në versionin e shtypur), bibliotekari duhet të shtrojë një pyetje të rëndësishme: A është kjo vepër për një studiues apo student të subjektit, apo është për një person laik, i cili ka pak apo fare njohuri? Për shembull, në fushën e kimisë organike, vepra Handbuch de Organischen Chemie nga Beilsten është shumë e njohur për kimistët. Pra, ju dedikohet studentëve, të cilët kanë njohuri të përgjithshme për kiminë. Zakonisht, ndarja në aspektin e audiencës nuk është fort e qartë.

Një metodë mjaft e mirë e kontrollimit të nivelit të leximit të audiencës së një vepre të referencës është që bibliotekari të ekzaminojë një subjekti që e njeh mirë ai/ajo dhe më pastaj t'i kthehet një subjekti tjetër, që nuk kuptohet lehtë. Nëse të dy janë të kuptueshëm, nëse gjuha e përdorur nuk përfshin terminologji teknike dhe zhargon, nëse stili informativ është i gjallë, bibliotekari mund të jetë i sigurt se vepra është

për persona laikë. Natyrisht, nëse vepra dhe subjekti në përgjithësi janë mbi kompetencat e bibliotekarit, duhet të merren këshilla prej një eksperti të subjektit. Mirëpo, kjo situatë nuk ndodh shpesh për shkak se bibliotekarët e referencave zakonisht janë ekspertë në fushat që operojnë ata.

Faktorët e tjerë në vlerësim

Përveç vlerësimit të përgjithshëm të përmbajtjes, pa marr parasysh formatin, janë edhe disa pika të tjera vlerësuese, që duhet marr në konsiderim. Shkurtimisht, ato përfshijnë:

1. *Çmimi*. Një faktor i rëndësishëm i frustrimit në vlerësimin dhe blerjen e veprave të referencave është çmimi që i shoqëron ato. Kjo është veçanërisht e vërtetë për burimet elektronike të referencave që gjenden kudo ku çmimi dhe metodat e shpenzuesve janë vazhdimisht në rritje. E vetmja gjë e sigurt është se ato kushtojnë zakonisht sa veprat e shtypura, apo edhe më shumë. Në fakt, disa çmime janë astronomike. Psycinfo, baza Online e të dhënave e Asociacionit Amerikan të Psikologjisë (që diskutohet edhe në vijim të këtij libri) kushton 26 000 dollarë për vit, për bibliotekat e mëdha të kolegjeve katër vjeçare. Indeksi nga Lexis-Nexis shkon deri $100 000 për vit për institucionet e mëdha. Në të vërtetë, çmimi për dy baza të njëjtë të të dhënave mund të jetë më shumë kur degët e tjera shtesë shfrytëzojnë shërbimet, p.sh. 10 komplekset e Universitetit Shtetëror të Floridës paguajnë $157 000 për Psycinfo. Shënim: të gjitha këto shifra janë nga fundi i vitit 2000.

Me kohë, kjo do të ndryshojë dhe çmimet e bazave digjitale të të dhënave do të bien ose do të hiqen fare. Në të njëjtën kohë, shumica e teknologjive të reja shkojnë dhe tejkalojnë buxhetin e bibliotekave që nuk janë të financuara mirë. Buxheti, e jo nevoja e klientit, mund të vendosin nëse një produkt i caktuar blihet apo jo.

Shërbimi i referencave, edhe në vlerësimin minimal, mund të jetë një luks. Përafërsisht 80 % e bibliotekave publike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës i shërbejnë një popullate më të vogël se 25 000 veta. Edhe pse jo të gjitha komunitete rurale nuk janë duke vdekur, shumica dërrmuese janë të varfra. Shumica e bibliotekave, në këto rajone, me apo pa ndihmën e shtetit apo atë federale, po vuajnë nga një mungesë e materialeve të referencave dhe 75 % nuk kanë përvojë në përdorimin e shërbimeve të referencave.

2. *Kërkimet*. Një prej pyetjeve më me kuptim rreth veprave të shtypura

ka të bëjë me aranzhimin-rregullimin e tyre, që trajtohet këtu si pjesë e formatit. Aranzhimi është i një rëndësie të madhe për veprat e referencave në formatin e shtypur. Në bazat elektronike të të dhënave, të cilat mund të hulumtohen nga përdoruesi, aranzhimi-rregullimi *per se* nuk ka fort rëndësi. Si të kërkohet-hulumtohet një bazë e të dhënash, megjithatë, është një çështje me rëndësi.

Edhe veprat që janë dizajnuar dhe shkruar me kujdesin më të madh mund të jenë një ngatërresë nëse faqet e saj nuk janë rregull apo nëse nuk bën dallime ndërmjet titujve dhe nëntitujve në një faqe të caktuar. Aparaturat e shkurtesave, tipografia, simboli dhe indikacionet e referencave të kryqëzuara duhet të jenë të qarta dhe të lehta që t'i vërejë përdoruesi/lexuesi. Përdorimi i fletëve të printuara nga kompjuteri ka rezultuar në shtjellimin e formatit. Për shembull, mund të jetë e pamundur që të dallohet West Virginia, kur ka vetëm inicialet e saj, prej Vestern Virginia. Po ashtu, shkronjat e uniformuara, në fund të faqes, mund të jenë konfuze. Mungesa e hapësirës ndërmjet rreshtave, letra e kualitetit të dobët, pak apo fare hapësirë në skajet e fletës dhe gjëra të tjera, që kanë të bëjnë me leximin janë shumë evidente në disa vepra standarde të referencave.

Disa fjalë rreth ilustrimeve: Kur përdoren fotografitë, tabelat, diagramet dhe grafikët, ato duhet të jenë aktuale, të qarta dhe që kanë të bëjnë me tekstin. Duhet të jenë të shoqëruara me tekst që të identifikohen qartazi.

Bazat elektronike të të dhënave. Shumë qartë, madje edhe web-sajt-i më i mirë komercial Online apo në Internet mund të mos përfaqësojë asgjë nëse është e vështirë për t'u hulumtuar dhe nëse dështon, sepse i aplikon disa veçori specifike. Pikat kryesore të vlerësimit janë të përfshira këtu: (a) Dizajni. A janë grafikët të përdorshëm apo janë kot fare? A janë fotografitë e qarta dhe të madhësisë së duhur? Kur lëviz nga një fushë në fushën tjetër, a jepen ndihma drejtuese që janë të lehta për t'u kuptuar? A është pamja e përgjithshme e paqes e përshtatshme për informacionin në fjalë? (b) Multimedia. A ka komponentë multimedialë dhe a e rrisin ata kuptimin, apo janë aty vetëm për argëtim? Nëse ka audio, a ka të bëjë me tekstin? Nëse ka materiale vizuele, sa shumë dhe çfarë është marrëdhënia në përgjithësi? (c) Drejtimi. Sa e lehtë është për t'u gjetur ajo që kërkohet? A mund të përdoret logjika Boolean? A janë linket të përdorshme dhe të vlefshme për qëllimin e faqes? A janë udhëzimet e qarta dhe të lehta për t'u ndjekur? Në të vërtetë, a ka udhëzime? A ka kërkues të fjalëve krye-

sore, modifikim të indeksit dhe veçori që lehtë përdoren në kërkim? (d) Organizimi. A është materiali i organizuar në mënyrë logjike dhe a janë linket të vendosura, në atë mënyrë, që vijnë njëri pas tjetrit si në formatin praktikë?

Fjala e fundit në vlerësim mund të tingëllojë si cinike apo e thjeshtë, nëse lexuesit merren me interpretimin e saj: Mos i beso askujt. Analisti, botuesi dhe autori bëjnë gabime, nganjëherë në masë të madhe. Bibliotekari, i cili bën vlerësimin e burimeve të referencave më dyshimin e vazhdueshëm, ka më pak gjasa që të bie viktimë e këtyre gabimeve. Gjithmonë kur është e mundshme, ekzamino dhe përdor veprën në fjalë. Bëj vlerësimin tënd personal!

Sikurse edhe me veprat e shtypura, tani jepen edhe linket e ndryshme të analizave të sakta, në bazat e të dhënave në Internet. Këto diskutohen gjatë këtij libri. Një hyrje e përgjithshme në vlerësimin e tillë mund të gjendet te Best Bet Internet: Reference and Research When You Don't Have Time to Mess Around nga Shirely Kennedy (Çikago, IL: Asociacioni Amerikan i Bibliotekave, 1998). Ky libër, më se 200 faqesh, ofron një metodë të saktë të vlerësimit dhe, çka është më e rëndësishme, jep ndihmë praktike rreth web-sajteve më të mirë dhe rrugëve më të mira për të kërkuar apo hulumtuar.

Botuesit-Shitësit- Dilerët e të dhënave

Një metodë e vlerësimit, e cila merret shumë rrallë në konsiderim, është në të vërtetë shumë efektive. Është një refuzim i botuesit, që të shkojë më tutje, me një vepër të referencës që kërkohet. Në esencë, vendimi për të botuar një tekst të caktuar është përcaktimi nëse ekziston një treg për titullin në fjalë dhe nëse ka dyfishim të mundit të propozuar në ndonjë vepër tjetër të botuar. Ndoshta, për shkak se tregu për titujt e veprave të referencave është në masë të madhe institucional dhe bibliotekat janë blerësit primarë, botuesit i ndajnë dhe i diskutojnë këto çështje me bibliotekat. Nëse duket dhe shihet se nuk ka treg, ideja, pa marrë parasysh se sa e përdorshme dhe se sa u hyn në punë bibliotekarëve, menjëherë bie nga kombinimi.

Përsëri, botuesi është filtri ndërmjet ajkës dhe mbeturinave në bazat komerciale të të dhënave. Në Internet, kjo është një çështje plotësisht tjetër. Çudia e Internetit është ajo se çdo njeri mund të hyjë Online me vetëm një porosi. Askush nuk qëndron ndërmjet porosisë dhe distribucionit. Duhet të mos ketë botues, redaktorë dhe as vlerësim mbi të gjitha.

Sikurse që u tha më lart, kjo vlen deri në momentin kur porosia ka një-farë vlere. Mirëpo, në mungesë së filtrit të botuesit, të ashtuquajturat materiale të besueshme të referencave nuk janë asgjë tjetër pos mendime të mbështetura nga animet e ndryshme dhe nga vendet e ndryshme në Internet.

Një botues i rëndësishëm i veprave të referencave përfshin botuesit e tregut prej Oxford University Press deri te Random House. Shumë pak bibliotekarë kanë vështirësi në identifikimin e këtyre botuesve. Këtu, lista e plotë e tyre ka të bëjë me veprat e referencave, në versionin e shtypur dhe në atë digjital. Botuesit kryesorë janë: The H.W. Wilson Company, shumë e njohur për The Reader Guide to Periodical Literature; Reed/Bowker, një firmë ndërkombëtare me tituj të tillë si Books in Print dhe Ulrich's International Periodical Directory; The Gale Group, një korporatë, e cila kontrollohet nga Thompson Corporation. Në këtë grup janë Gale Research; IAC, firma e indeksimeve dhe Primary Source Media. LEXIS-NEXIS, një kombinim i shërbimit të indeksit të përgjithshëm-legal; Bell & Howell, e cila mori kontrollin e University Microfilms dhe vuri një emër të ri ProQuest.

Disa lloje të caktuara të veprave të referencave identifikohen ngushtë me botuesit e tyre, (p.sh. abstraktet dhe indekset, ku menjëherë njeriu mendon në Wilson Company, UMI, Gale dhe Ebsco). Scribner's, si një shembull tjetër, konsiderohet si një burim mjaft i besueshëm i enciklopedive studiuese të subjektit. Dhe, kështu, kjo gjë nuk vlen vetëm për edicionet e shtypura, por edhe për ato digjitale. Një botues i mirënjohur dhe i besueshëm zakonisht shoqërohet me një vepër të pranuar të referencës.

Në Shtetet e Bashkuara, shitësi më i madh komercial (apo dileri i të dhënave) për shërbimet e referencave të përgjithshme është DIALOG i cili, me pronarin e ri, ndërroi emrin në mesin e vitit 2000. (Përgjatë këtij teksti, emri DIALOG përdoret në radhë të parë, edhe pse mund të jetë riemëruar disa herë).[21] Rreth 850 lojtarë të tjerë janë të listuar në seksionin "Shërbimet Online" të Gale Directory of Databases. (Shitësit më të mëdhenj, sa u përket bibliotekave, përveç DIALOG, do të përfshinin OCLC-First

[21] Problemi është se botuesit Online vazhdimisht ndryshojnë emrat e tyre, p.sh. shiko Carol Tenopir, "A Name (Un)like Any Other Name", Library Journal, 1 qershor, 2000, f. 36-38. Ajo thekson se çka ishte dikur Dow Jones & Company dhe grupi indeksor Reuters Group quhet tash "Factiva". UMI u bë Bell & Howell Information and Learning, dhe në qershor të vitit 2000, e mori një emër të ri: ProQuest. Sikurse që thekson edhe Tenopir, "Ndryshim edhe më i madh i emrave mund të pritet në të ardhmen".

Search; dhe Ovid (teknologji dhe shkencë-medicinë). I njëjti udhëzues liston më shumë se 2 000 baza të të dhënave dhe botues e prodhues të CD-ROM-ve.

Në përgjithësi, botuesi/prodhuesi është ai i cili grumbullon informacionet dhe i boton ato (Online, në CD-ROM, në versionin e shtypur, apo në kasetë magnetike, ose në një kombinim të këtyre). Shitësit, të cilët mund të jenë njëkohësisht edhe botues, ua ofrojnë materialin bibliotekave. Në disa raste rritet konfuziteti rreth asaj se kush çka është duke bërë. H.W. Wilson Company shpërndau-distribuoi MLA Bibliography, në versionin Online dhe atë CD-ROM, të botuar nga Asociacioni i Gjuhës Moderne. Wilson është botues, shitës dhe pikëshitëse për versionin CD-ROM. Kështu, prodhuesi, shitësi dhe distributori mund të jetë i njëjti, apo ata edhe mund të ndryshojnë. (Më vonë, Silver Platter, i cili thjesht boton informacionet e njerëzve të tjerë në CD-ROM, e mori mbi vete MLA Bibliography).

1. *Autoriteti/Objektiviteti*. Pika më e rëndësishme vlerësuese është testimi i autoritetit dhe i objektivitetit të informacionit të dhënë, posaçërisht atij Online.

2. *Objektiviteti*. Objektiviteti dhe pasqyrimi i drejt i punës janë pika që, posaçërisht në veprat e referencave, mbështeten në prozë e jo në statistikat e thjeshta apo koleksionet e fakteve. A ka autori implikime politike, të fesë, të racës, të seksit, apo llojin e duhur të ngjyrës për të ngjyrosur një studim? Askush nuk është plotësisht objektiv, mirëpo ata që shkruajnë vepra të referencave duhet patjetër të tregojnë vlerën e të dyja anëve kur kemi të bëjmë me çështje kontraverse.

Në disa fusha të caktuara, saktësia është më shumë opinion apo mendim. "Këshilla për publikun se çka duhet të hanë, çfarë medikamente duhet të marrin dhe në një mënyrë, si duhet të jetojnë, duket se nuk ia vlen, sa herë që një studim nga mjekësia publikohet... publiku mund të mos e njoh faktin se shkenca është esenciale për të arritur progres, bota më aktuale rrallë herë është e fundit".[22]

[22] "It's Good. No, It's Bad", The New York Times, 28 mars, 1998, f. ËK4. Shembujt e dhënë këtu tregojnë se marshi i informacioneve shkencore është në tërheqje e sipër: "Shumë gjatë është menduar se margarina është një lloj më i shëndetshëm i yndyrës sesa gjalpa, mirëpo së fundi u mësua se margarina është po aq e dëmshme për arteriet". Dhe "sallata është e mirë për ju në çdo mënyrë- përveç se më shumë e më shumë helmimet me ushqim po bëhen nga frutat dhe perimet e freskëta të cilat përmbajnë baktere". Jogurti mendohet se zgjat jetën, mirëpo raporti i 121 vjeçarit nga Azerbajxhani thotë se ai kurrë nuk ka pirë jogurt.

Bazat elektronike të të dhënave. Një rëndësi mjaft të madhe për veprat tradicionale të referencave është qëndrimi i botuesit prapa fakteve. Është e vërtetë se fokusi, disa herë është i gabuar, përmbajtja është shumë e gjerë apo shumë e ngushtë, mirëpo të dhënat kryesore janë të besueshme. Lexuesit vijnë për ta pranuar këtë si të vërtetë - e vërteta, që tashmë nuk mund të gjendet lehtë në Internet. Mund të mos ketë kontroll qendror të provave, mund të mos ketë redaktor, staf, metoda të rishikimit dhe të analizës, apo çdo gjë që ka të bëjë me titujt mestarë të referencave në versionin e shtypur dhe atë në CD-ROM[23]. Kur vepra referenciale, Online, nuk jep informacione rreth vetvetes, nuk ia vlen që të konsultohet ky burim, së paku për qëllime të referencave.

Një kritik i Internetit thotë kështu:

"Ne do të përdorim mendimin praktik kur lexojmë ndonjë artikull në Internet dhe do t'i mësojmë fëmijët tanë të bëjnë të njëjtën gjë.

> Juve dhe fëmijëve tuaj, së bashku, do t'u nevojiten detektorë të shkëlqyeshëm B.S. për të mbijetuar në shekullin XXI. Më mirë filloni që tani. Ju nuk mund të bëni para shpejt në Internet. Fëmija juaj adoleshent nuk është në bisedime me Tyra Banks. Virusi i Kohëve të Mira nuk ekziston. Ashtu sikurse ju, që i shikoni fjalët e ndyra nëpër fjalorë, fëmijët tuaj do të mundohen të zhdërvillen dhe të arrijnë atë gjënë me aromë, me ndoshta të njëjtat rezultate të ndryshimit të jetës"[24].

Internetit i mungon autoriteti, për shkak se nuk përfaqëson vetëm punën e njerëzve me përvojë, botuesve standardë, mirëpo përvetëson edhe mundësitë dhe përpjekjet individuale. Demokratike? Po. E kështillueshme? Po. Mirëpo, jo kur individi refuzon ta identifikojë burimin e të dhënave.

Pyetja primare është ajo se kush i jep të dhënat në Internet. Janë disa gjëra themelore, të cilat çojnë deri te autoriteti: (a) Nëse burimi i referencës

[23] Fjalimi hyrës i Kurt Vonnegut nga Instituti i Teknologjisë së Masaçusets në vitin 1997 është argëtues dhe një shembull tipik i gabimit të madh në Internet, talljeve e rrenave, apo gabimeve të paqëllimshme. Vonnegut kurrë nuk kishte qenë njëri i cili mbante fjalimet hyrëse. Fjalimi filloi me këto fjalë: "Nëse unë do t'ju thoja një fjalë për të ardhmen, atëherë "sunscreen" do të ishte ajo fjalë". Kjo u soll e u dërgua rreth botës me e-mail. Problemi ishte se: fjalimi kurrë nuk kishte qenë fjalim i vërtetë. Ishte një kolumne e marrë nga gazeta ditore The Chicago Tribune (1 qershor, 1997). Email-i i cili u dërgua nga njeriu në njeri, kishte arritur te shumë njerëz përpara se autori i vërtet i këtij fjalimi ishte zbuluar.

[24] Angela Gunn, "Balancing Acts", Yahoo, shtator, 1998, f. 68.

është gjetur në një nga 3 000 web-sajtet e bibliotekave, ka të ngjarë që burimi është kontrolluar dhe mund t'i besohet. Mund të mos jetë më i miri, por së paku, nëse është i certifikuar në web-sajte, ka gjasa të mira të jetë i besueshëm; (b) Kontrollo domenin (prapashtesën) në adresën e web-sajtit (p.sh. sponsori i të dhënave mund të mos e japë emrin, mirëpo adresa së paku tregon autoritetin). Këshillat më të zakonshme, lidhur me besueshmërinë: .edu do të thotë se ka një sponsor të edukimit; .gov – sponsor qeveritar; .org do të thotë se është një organizatë jo fitimprurëse. Ajo nga e cila duhet pasur kujdes është .com, pasi ky është një grup komercial, i cili mund të jetë apo të mos jetë shumë i përfshirë në shitjen, reklamimin dhe bërjen e propagandës; (c) Personi/kompania që qëndron prapa web-sajtit është i lehtë për t'u identifikuar (p.sh. nëse jepet një adresë, emër, apo numër telefoni?). (Shënim: adresa elektronike-e-mail nuk është e mjaftueshme, edhe pse në rastet e shumta e-mail është verifikimi i vetëm që jepet). Po ashtu, është e qartë se ku janë mbledhur këto fakte, apo është vetëm një opinion i thjeshtë; (d) Nëse ka reklamim, duhet të jetë i ndarë prej tekstit dhe multimedias, kështu që shfrytëzuesi e dinë se ku fillojnë kyçjet dhe ku përfundon informacioni. Janë dy burime kryesore Online të informacionit. I pari ofrohet falas dhe është vënë Online nga ndonjë person qeveritar apo nga ndonjë vegjetarian. Përderisa, materiali qeveritar ka autoritet, edhe pse shpesh është kontravers, puna dhe veprat e individëve apo të një grupi të vogël mund të mos jenë edhe aq të besueshme.

Besueshmëria, në anën tjetër, zakonisht sigurohet kur, ndoshta fatkeqësisht, bibliotekari apo individi paguan për informatën e marrë. Kjo është e njëjtë me blerjen e një libri të referencave apo të një CD-ROM-i. Ata që dikush i quan "dilerët e të dhënave" janë ekuivalentët (e ndonjëherë edhe të ngjashmit) e botuesve të librave të referencave. Këto burime të mëdha Online dhe të formateve të tjera të të dhënave elektronike ofrojnë burime të referencave, të cilat diskutohen në çdo kapitull të këtij libri. Ndër më të mirët janë: R.R. Bowker, OCLC, EBSCO, Gale Group, UMI, Wilson dhe Lexis-Nexis.

Kur një burim Online - posaçërisht në Internet - nuk ofrohet falas, por shitet për një çmim të caktuar dhe kur kompania që kërkon një çmim të tillë është një diler i njohur i të dhënave, bibliotekari mund të jetë i sigurt se burimi është autoritativ. Në të kundërtën, kur informacionet jepen ashtu, atëherë ju duhet të konsideroni aspektet që vijnë më pas.

Një mënyrë e besueshme për të gjetur përgjigjen rreth autoritetit, është leximi i faqes së mirëseardhjes në web-sajtit, apo burimit të njëjtë që flasin

rreth informacioneve nga e kaluara. Në këtë pjesë të web-sajtit kërko: (a) një përshkrim të përmbajtjes dhe të autoritetit në fillim apo mbarim të faqes; (b) fajllat "ndihmës" të cilët ndoshta edhe mund ta kenë këtë informacion; (c) FAQs (pyetjet që bëhen më së shpeshti), e cila mund të përfshijë atë çfarë kërkohet; (d) ekzamino përmbajtjen rreth datave dhe materialeve, siç janë librat dhe periodikët që mbulohen në të etj. Problemi është se kjo gjë merr kohë, shumë kohë. Si një rregull e pashkruar, mënjano çdo web-sajt, ku ky lloj kërkimi, i cekur më lart, është i nevojshëm.[25]

Sugjerime për të lexuar

Eberhard, George, ed., The Whole Library Handbook, edicioni 3, Çikago, IL: Asociacioni Amerikan i Bibliotekave, 2000. Nën dhjetë titujt e subjektit, duke filluar nga letërsia e bibliotekës deri te vogëlsirat e ndryshme, ky udhëzues mbulon gati të gjitha aspektet e edukimit, historinë dhe punën në bibliotekë. Është argëtues dhe me fakte reale. Është një libër me hyrje madhështore për studentin.

Hoffert, Barbara, "Book Report 2000", Library Journal, 15 Shkurt, 2000, f. 130-132. Në këtë raport vjetor, redaktori i Librit të Analizave nga Library Journal ekzaminon buxhetet e librave, si dhe ku dhe çka është harxhuar. Po ashtu, ndarja e fondeve ekzaminohet këtu. Mandej, shiko edhe "shpenzimet e subjektit" që tregojnë se çka dëshirojnë apo nuk dëshirojnë njerëzit, duke lexuar materialet e referencave në bibliotekë. Ky libër është një profil i blerjeve në bibliotekë dhe po ashtu i shërben edhe publikut. Mos harroni që të shikoni për këtë botim në muajin shkurt, kur edhe botohen botimet e reja të modifikuara.

Lipow, Anne Grodzins, "In Your Face Reference Service", Library Journal, gusht, 1999, f. 50-52. Këtu, bibliotekari bën thirrje prej bibliotekarit

[25] Ky tekst apo libër ka të bëjë me pyetjet dhe përgjigjet rreth referencave- përgjigjet që priten të jenë autoritative dhe të besueshme. Ky libër nuk ka të bëjë dhe nuk merret me mendimet personale Online, të cilat mund të jenë apo mos te jenë autoritative. Mendimi është një e drejtë demokratike e Internetit, mirëpo një kokëçarje e madhe për shërbimet e referencave. Reva Basch e përmbledh kështu: "Miratimi i përgjithshëm (p.sh., raportet medialet prej gazetave e televizioneve deri te revistat, e po ashtu edhe veprat e referencave) është i pamundshëm. Është e pamundshme dhe e paarritshme që të ketë një pajtim të plotë. Ky medium e përjashton autoritetin... Interneti ka prodhuar jo respekt universal për mençurinë. Çdo njëri është një reporter, kritik, apo komentator". "Reva's Wrap", Online, shtator/tetor, 1998, f. 96.

që "presin thirrje", p.sh. që janë të gatshëm për pyetje në çdo kohë, çdo vend në Internet. Përderisa ajo pranon se "teknologjia ekzistuese është e padenjë, që të bëjë funksionalizimin e plotë të shërbimeve që ndryshohen", autorja thekson qartë nevojën për planifikimin e këtij lloj shërbimi. Po ashtu, shiko edhe editorialin mbështetës nga John Berry në f. 6 rreth së njëjtës çështje.

Mangan, Katherine, "In Revamped Library Schools, Information Trumps Books", The Chronicle of Higher Education, 7 prill, 2000, f. 1+. Një studim se si bibliotekat e shkollave dhe punëdhënësit e vendit, kanë ndryshuar në mënyrë që t'u përshtaten nevojave të ekonomisë së re dhe të një periudhe të re të komunikimit.

Mendelsoh, Jennifer, "Learning Electronic Reference Resources: A Team Learning Project for Reference Staff", College & Research Libraries, korrik, 1999, f. 372-383. Nuk është vetëm çështje e kujtesës kur bibliotekari ballafaqohet me problemin që duhet të jetë në hap me ndryshimet në burimet e referencave. Kjo është ngjashëm çështje që ka të bëjë me tregimin dhe mësimin dhe në proces e sipër ju i njihni më mirë qasjet e reja, si dhe burimet e reja. Një përpjekje e tillë këtu shpjegohet në detaje. Do t'i bëjë mirë lexuesit, i cili ndihet si i stërngarkuar nga masa aq e madhe e informatave.

Quinn, Brian, "A Mutli-model Approach to Enhancing Memory in Reference Service", Reference & User Services Quarterly, pranverë, 1999, f. 257-266. Si e di bibliotekari i zakonshëm se cila vepër e referencës (e shtypur apo Online) i përgjigjet më së miri një pyetjeje të caktuar? Askush nuk e di këtë. Disa bibliotekarë kanë sukses në të, disa dështojnë fare. Mirëpo, një bibliotekar ofron qasje praktike në problemin e kujtesës. Ai rrezaton një numër të madh studimesh dhe një përvojë. Ndoshta nuk do ta zgjidhë problemin tuaj, mirëpo do t'ju ndihmojë shumë.

Retting, James, dhe *Cheryl LaGuardia*, "Beyond 'Beyond Cool' Reviewing Web Resources", Online, korrik/gusht, 1999. Dy prej analistëve më të mirë të vendit rreth veprave të referencave diskutojnë "një listë standarde me kritere, me të cilën, ne dhe përdoruesit e tjerë, mund ta masin efektivitetin e burimeve në Internet". Për më shumë, në këtë libër jepen edhe burime të tjera Online, të cilat ndihmojnë në

vlerësim. Zgjedhja e parë për këdo, për laik apo profesional, i cili kërkon udhëzues praktik në zgjedhjen dhe seleksionimin e bazave të të dhënave. Rekomandohet shumë.

Spencer, John dhe *Lucene Dorsey*, "Assessing Time Spent on Reference Questions at an Urban University Library", The Journal of Academic Librarianship, korrik, 1998, f. 290-294. Rreth 70 % e pyetjeve të shtruara në Universitetin Shtetëror të Arizonës, marrin më pak se 5 minuta kohë për t'u përgjigjur në to". Pyetjet që kërkojnë 11 minuta për t'u përgjigjur marrim vetëm 8 % të kohës së përgjithshme.

Tyckson, David, "What's Right with Reference", American Libraries, No.5, 1999, f. 57-63. Bibliotekari me përvojë diskuton rreth shërbimit të referencave dhe teknologjisë së re. Ai i analizon veprat ditë pas dite në aspektin e jetës së vërtetë e jo sikurse disa të ashtuquajtur "ekspertë" në letërsi, që merren me zhargonin dhe me mendimin e mjegulltë. Është një balancim i mirë i lavdërimit për krijimet e reja dhe kritikës kundër disa qasjeve të tjera.

Vavrek, Bernard, "Is the American Public Library Part of Everyone's Life", American Libraries, janar, 2000, f. 60-64. Një prej ekspertëve më të mirë të botës, sa i përket bibliotekave, ka gjetur se për së paku gjysmën e publikut amerikan, biblioteka ofron "shërbime dhe burime të mrekullueshme". Shumica prej tyre mbështetet në biblioteka kur është fjala për dyshime apo pyetje dhe shumica e këtyre njerëzve krijojnë qasje në biblioteka nga kompjuterët në shtëpitë e tyre.

White, Herbert, "Public Library Reference Service—Expectation and Reality", Library Journal, 15 qershor, 1999, f. 56, 58. Volteri i shërbimeve të referencave shpjegon se kjo nuk është bota më e mirë e mundshme për bibliotekarët e referencave, nëse ata nuk arrijnë pajtim se çka është ofruar dhe çka duhet ofruar në të ardhmen. Çka mund të bëhet? Artikulli jep disa solucione praktike.

Zlatos, Christy, ed., "Coming of Age in Reference Services: A Case History of the Washington State University Libraries", The Reference Librarian, nr. 64, 1999. Dëshironi të dini se si një shërbim akademik i referencave operon – në realitet e jo në teori? A jeni të interesuar në zhvillimin e një shërbimi të tillë? A jeni duke menduar se si bib-

liotekarët e shikojnë të ardhmen e shërbimeve të referencave? Të gjitha këtyre dhe shumë pyetjeve të tjera praktike u është dhënë përgjigje në analizën superiore nga Zlatos.

KAPITULLI II
BIBLIOTEKA ELEKTRONIKE

Biblioteka elektronike është këtu. Mirëpo, çka është ajo në të vërtetë? Biblioteka elektronike është një bibliotekë, ku informatat janë të ruajtura në mënyrë elektronike Online apo në CD-ROM ose DVD. Interneti është vendi kryesor për informacione të tilla. Të dhënat në formatin elektronik mund të jenë apo të mos jenë unike, p.sh. disa, nëse jo edhe shumica e këtyre dokumenteve janë të dyfishuara në versionin e shtypur. Sigurisht, të dhënat elektronike mund të printohen prej kompjuterit.[1]

Çdo njëri që shfleton një bibliotekë ka qasje në Internet, dhe çka është më e rëndësishmja, ka qasje në udhëzimin nga bibliotekarët e referencave. E njëjta gjë vlen edhe në biznes, në qeveri dhe në organizatat e tjera, në të cilat ofrohet qasje falas dhe e hapur e Internetit, zakonisht e udhëhequr nga një bibliotekar. Interneti është pjesë e punës së përditshme dhe një metodë e zakonshme dhe e dashur për shumë amerikanë.

Qasja në bibliotekë, edhe nga shtëpia, është bërë më e lehtë përmes

[1] Një përshkrim tjetër në bibliotekat e posaçme: "analist inteligjent". Shih Bonnie Hohhof dhe Lera Chitwood, "Crossroads", Information Outlook, Shkurt 2000, faqe 22-25. Janë edhe shumë terma të tjerë për bibliotekat me teknologjinë elektronike: "bibliotekë digjitale" ose "bibliotekë elektronike" ose "bibliotekë virtuale" që zakonisht përdoret si sinonim. Janë së paku edhe rreth 50 definicione të termave të tillë. Tash, kjo është vetëm në interes të atyre që janë duke numëruar engjëjt në kokën e një gjilpëre. Përdorimi i zakonshëm i teknologjisë në bibliotekë ka bërë që këto terme të jenë jorelevante. Më së miri dhe thjeshti është ta quash "bibliotekë" dhe lëre në atë mënyrë, me sigurinë se kjo bibliotekë do të përmbajë baza elektronike të të dhënave e po ashtu edhe libra të shtypur në shekullin XVII.

harduerëve dhe softuerëve, që nuk kushtojnë shtrenjtë. Bibliotekat shfrytëzojnë benificionin lokal, shtetëror dhe federal duke pasur qasje falas në Internet.

Zakonisht, qasja në Internet nga shtëpia bëhet nëpërmjet Ofruesve të Shërbimit të Internetit, shërbime këto si America Online dhe kushton diku rreth $20 në muaj.[2] Qasja në Internet me kabllo, një nga shërbimet më të shpejta, kushton diku rreth $40 në muaj. Në ditët e sotme, Interneti në shtëpitë amerikane është po aq i pranishëm sa edhe televizioni apo akulloret. Nga viti 2000, diku rreth 60-70 % e shtëpive amerikane kanë kompjuter dhe 45 deri në 50 % kanë qasje në Internet dhe në burimet informative, që mund të gjenden në të. Ky numër po rritet dita ditës. Çka do të thotë kjo për bibliotekarët e referencave?

Informacioni nuk është më monopol i bibliotekave, televizioneve, radiove, gazetave dhe revistave. Shtigje të reja janë hapur dhe tani janë mëse një miliard web-sajte me të dhëna në Internet (disa thonë se nga viti 2004, numri i këtyre faqeve do të arrijë në 13 miliardë). Bibliotekarët e referencave duhet që të marrin nga Interneti të dhënat relevante për pyetjet e posaçme. Web-sajtet e kërkimit, si Google, nuk mund ta bëjnë këtë gjë për shkak se ato përfshijnë vetëm 16-20 % të web-sajteve. Bibliotekarët e referencave janë Lewis and Clark në hapësirën më të madhe të Internetit.

ZGJIDHENI INTERNETIN

Nga viti 2000, Interneti u bë pjesë integrale e jetesës amerikane. “Rruga se si ata blejnë gjërat, duke filluar nga veturat deri te biletat e aeroplanit dhe mënyra se si ata komunikojnë, investojnë, punojnë dhe mësojnë, po transformohet në masë të madhe nga Interneti. Mirëpo, është bërë aq i shpejtë saqë njerëzit janë duke u ngopur me të.” Përkundër përparësive të dukshme, Interneti ka edhe të metat e veta: Interneti është “plotësisht i hapur, teknologji interaktive – mirëpo pa pasur redaktor, botues, censor, apo edhe filtër. Me një klikim të miut tuaj, ju mund të futeni në vendin

[2] Kompjuterët “falas” i ofrohen kujtdo që dëshiron dhe nënshkruhet për shërbim Interneti si CompuServe, p.sh. kompjuteri vjen falas nëse shfrytëzuesi pajtohet që të përdor shërbimin e Internetit për një kohë të caktuar. Kompanitë e tjera ka oferta të ngjashme. Shihet qartë se plani është të vihet çmimi duke e bërë shfrytëzuesin subjekt të një marketingu të madh. Po ashtu, duhet pasur parasysh se në shumë qendra urbane, në Amerikë dhe nëpër botë, janë të hapur për përdorim edhe kompjuterët publikë për një çmim modest. Natyrisht, një ofertë e njëjtë bëhet edhe nga bibliotekat. Mirëpo, në biblioteka ky shërbim ofrohet falas.

ku ka pirë birrë nazistët ose në bibliotekën pornografike... ose të bredhësh në bibliotekën e Sorbonës ku aty nuk ka asnjëri që t'ju ndalojë apo t'ju drejtojë..."[3]

Pamja e shpejtë sipërfaqësore e Internetit i bën të qarta dy pika: (1)shumë web-sajte nuk janë të organizuara mirë. Mund t'ju duhen shumë minuta për të gjetur një enciklopedi, që është në Internet e që po ashtu ofrohet edhe në versionin e shtypur; (2) besueshmëria e të dhënave që gjenden në web-sajtet e referencave, zakonisht janë nën nivelin e asaj se çka pret një njeri nga një burim standard i shtypur referencial. Me kohë Interneti do të jetë i organizuar dhe i rregullt sikurse që është Melvil Dewey për mëngjes, mirëpo tani për tani duhet të merren parasysh edhe të metat e tij.

Bibliotekat grupojnë librat e njëjtë me librat e njëjtë, periodikët e njëjtë me periodikët e njëjtë etj. Kjo arrihet, zakonisht, duke përdorur sistemin Decimal Dewey ose, në rastet e bibliotekave që janë më të specializuara, përdoren titujt sipas subjektit, si në Bibliotekën e Kongresit. Për shembull, shumica (nëse jo të gjithë) librat e "artit" dhe për "artistët" gjenden në rendin e njëjtë të raftit.

Nuk ka ndonjë rregullim të trashëguar në Internet. Nuk ka çadër, e cila shërben për t'i bashkuar të gjithë subjektet në një ose dy vende. Në të vërtetë, Interneti është një sfidë, ku njeriu duhet të vendosë një subjekt të caktuar në mesin e mijëra të tjerëve, nëse jo në mesin e qindra mijëra vendeve. Le ta marrim "artin" si shembull. Duke përdorur thjesht termin "art" kërkuesit të gjorë do t'i shfaqen me mijëra mundësi për kërkim të mëtutjeshëm. Përderisa ju mund të vendosni rreth fushave të caktuara të artit, nëse jeni në raftet e bibliotekës (kjo duke iu falënderuar klasifikimeve sipas subjektit), kjo gjë nuk vlen në Internet.[4]

Web-sajte të shumta dhe web-sajte të kërkimit (p.sh. Google) etj., tentojnë që ta izolojnë, ta rregullojnë dhe ta aplikojnë një skemë të brishtë të klasifikimit sipas fushave të subjektit. Kjo ndihmon shumë dhe në fakt,

---

[3] Shiko Gregory Crawford "Internet Issues" Public Libraries, maj/qershor 2000 për diskutimin rreth temës fëmijët në Internet dhe fulteret. Thomas A. Friedman, "Are You Ready," The New York Times, 1 qershor, 1999, f. A33. Këtu autori i adreson problemet e fëmijëve në Internet me të cilat përballen prindërit.

[4] Ka edhe shumë të meta të tjera në kërkimin e referencave në Internet. Profesori Robert Darnton ("No Computer Can Hold the Past, The New York Times, 12 qershor, 1999, f. A15) ofron tri gjëra të mira rreth kërkimit në Internet. Në të njëjtën kohë, ai paralajmëron se kjo gjë kërkon nga "studentët që të kuptojnë natyrën dhe historinë e dijes" e jo vetëm Internetin.

mund ta zgjidhë problemin e anarkisë së Internetit, nëse shfrytëzuesi e di se cilën web-sajt ta selektojë dhe cilën listë ta zgjedhë.

Kërkimi elektronik ka problemet e tij, posaçërisht për bibliotekarët e referencave, të cilët dëshirojnë dhe kërkojnë përgjigje të sakta dhe efikase. Për shembull, duke kaluar më se dy orë në përpjekje për të gjetur një material të përshtatshëm rreth zanateve Algonquin për klasën e katërt, nëpërmjet enciklopedisë së Microsoft – Encarta dhe më vonë, edhe nëpërmjet web-sajteve të tjera të ndryshme, një prind komentoi kështu: "Pra, cili ishte dallimi më i madh në mes të kërkimit sipas sistemit të bibliotekave të vjetra dhe kërkimit me kompjuter? Mundësitë. Në bibliotekë, ne do të gjenim informacione në disa libra të referencave për fëmijë ose diçka tjetër... Duke përdorur kompjuterin, megjithatë, ishte një përvojë e tipit "të tërën ose asgjë." [5]

Një bibliotekar i referencave mund t'i kishte ngushtuar mundësitë, së pari duke ndihmuar fëmijën që ta gjejë materialin e nevojshëm në libër ose periodik dhe/ ose duke e ditur, në mënyrë të saktë, se ku të kërkohet në Internet informacioni i tillë. Saktësia zvogëlon mundësitë dhe, në fakt, shërben për të arritur një balancim rreth asaj se kur duhet të shikohen informacionet digjitale e kur ato të shtypura. Bibliotekari kursen kohë të madhe duke gjetur të dhëna specifike në oqeanin me informacione dhe bërllok.

Publiku e di se biblioteka është pika me e mirë e qasjes për informacione të besueshme nga Interneti. P.sh. bibliotekat publike udhëheqin, në listën e lokacioneve për qasje publike në Internet. Për më shumë, në shkollat fillore dhe në ato të mesme, e po ashtu edhe në kolegje e universitete, Interneti është pjesë integrale e sistemit të bibliotekës.

Pyetja vitale për bibliotekarët është ajo se ku mund të gjejnë fondet për t'i lidhur në Internet këto shkolla, biblioteka dhe qendra të tjera, të cilat janë jo fort mirë të financuara dhe nuk janë në gjendje që të jenë në hap me materialet e reja në versionin e shtypur. Madje, edhe bibliotekat që janë relativisht më mirë të financuara po shpenzojnë më shumë e më shumë para në burimet elektronike dhe gjithnjë e më pak në materialet e shtypura prej ditarëve dhe librave.

Është më shumë se një autostradë informacioni

Madje, edhe njeriu i trashë në kokë e din faktin se më shumë ofrohet në Internet sesa në një sistem të kthyer të informacionit. Pa marrë parasysh

[5] The New York Times, 19 nëntor, 1998, f. G11.

nëse është lajm shokues për tregtinë ditore[6] ose për uljen e interesimit për librat Online, gjithë Interneti është i pranishëm. Informacionet, së paku në aspektin e bibliotekarit të referencave, është vetëm pjesë e sistemit. Interneti është më shumë i përfshirë në tregti dhe në argëtim sesa në gjetjen e fakteve. Aspekte të panumërta të Internetit përmendin përgjatë gjithë këtij teksti. Tani për tani, është e udhës të theksohet se: (1) Interneti është në procesin e ndryshimit drastik, jo vetëm në Shtetet e Bashkuara, por edhe në pjesët e tjera të botës. Në vendet ku kompjuterët janë të pakët, palët që sundojnë kanë ardhur në përfundim se vetëm një kompjuter në një komunitet të vogël mund të minojë, apo shkatërrojë regjimin totalitar. Kompjuteri është burimi më i madh i propagandës për politikanët, reklamuesit dhe grupet civile me buxhet të vogla, të cilat janë të përfshira në çdo gjë prej mjedisit deri te korridoret e qytetit; (2) Interneti është gjithnjë e më i pranishëm në ekonomi, e cila vazhdon të ndryshojë nga ajo industriale në atë të shërbimit; (3) Interneti ka fuqinë që të ndryshojë sjelljen, prej vetedukimit deri te zakonet e blerjes.

Interneti është shumë më shumë. Në një mënyrë ose tjetrën, ai përfshin çdokënd në vendet perëndimore dhe po ashtu në shumë vende të tjera. Informata është përbërësi kryesor, mirëpo vetëm njëri nga të shumtët.

RRJETET BIBLIOGRAFIKE

Përveç Internetit, gjendet edhe një numër i madh i rrjeteve bibliografike në Shtetet e Bashkuara dhe nëpër botë, që përdorin Internetin si bartës, e po ashtu edhe si shërbime të tyre të drejtpërdrejta, Online. Këto rrjete janë mjaft të njohura për bibliotekarët e referencave dhe zakonisht u referohen atyre vetëm sipas inicialeve.

Rrjetet më të mëdha jofitimprurëse në Shtetet e Bashkuara (të cilat përdoren edhe në shumicën e vendeve të botës) përfshijnë: (1) OCLC – Qendra Online e Bibliotekës Kompjuterike në Dublin, Ohio (http://www.oclc.org) e cila ofron qasje në libra, filma, raporte etj.; (2) RLIN (http://www.rlg.org) me përdorimin Online të librave dhe të artikujve të tjerë të ngjashëm, për bibliotekat hulumtuese.

Janë të rëndësishme të ceken të gjitha për faktin se të gjitha ofrohen falas, p.sh. duhet të paguhet për të gjitha informacionet që gjenden përmes

[6] Rregullatorët që kanë ekzaminuar librat e tregtisë ditore të firmave thonë se më shumë se 9 nga 10 tregti përfundojnë me humbje të parave". "Day Trading's Underbelly," The New York Times, 1 gusht, 1999, f. BU1.

rrjetit të tyre. Shumë pak ofrohet falas në këto rrjete dhe në fakt çmimi i përdorimit të tyre shkon prej mijëra deri në disa qindra mijëra dollarë në vit. Si bartës të informacioneve, ata janë shumë më superior sesa ata që ofrojnë të dhëna falas në Internet. Mund të ngjallet konfuzion për shkakun se të gjitha rrjetet bibliografike, që ofrohen falas, e përdorin Internetin si bartës. Kjo nuk do të thotë se shfrytëzuesi i zakonshëm mund ta përdorë rrjetin derisa ai/ajo të ketë qasje në to, përmes një biblioteke.

Shënim: Përgjatë gjithë këtij teksti, lexuesi shpesh do të gjejë referenca të DIALOG apo OCLC, të cilat janë sinjale automatike se informacionet e përshkruara ofrohen falas. (Përjashtim: disa baza qeveritare të të dhënave që funksionojnë nga këto rrjete).

Është e mundshme që Online (përmes OCLC, RLIN etj.) të shikohen materialet e mijëra bibliotekave, duke filluar nga Shtetet e Bashkuara deri në Australi. Shtimi i informatave dhe mundësia që t'i vendosësh dhe t'i marrësh të dhënat e tilla nëpërmes bibliotekave është më se madhështore.

OCLC

Qendra Online e Bibliotekës Kompjuterike (OCLC) ka numrin më të madh të anëtarëve, prej të gjitha llojeve dhe madhësive të bibliotekave, sesa ndonjë rrjet tjetër bibliografik. Nga viti 2000, OCLC thoshte se ka diku rreth 34 000 biblioteka anëtare në gjithë botën, edhe pse pjesa më e madhe e tyre janë në Shtetet e Bashkuara dhe Kanada.

Ky sistem mbështet bazën e të dhënave për libra, filma, raporte, ose monografive të nxjerra nga Biblioteka e Kongresit dhe katalogët e përbashkët e bibliotekave anëtare dhe po rritet çdo vit, çdo muaj dhe çdo ditë. Përafërsisht shtohen 2 milionë incizime në vit. Në vitin 2000, ky sistem përfshinte më shumë se 23 milionë libra, 1.5 milionë seriale dhe 700 000 media audio-vizuele, duke mos lënë anash as 600 000 incizime.

Duke u zhvendosur në fushat e tjera të informacionit, OCLC paraqiti First Search (Kërkimin e Parë) në mesin e viteve '90-të. Këtu, OCLC vepron si furnizues i bazave të të dhënave, përveç ofrimit të një numri të madh të katalogëve. Shfrytëzuesi do të gjejë në First Search diku rreth 60 baza elektronike të të dhënave prej indekseve deri te bibliografitë standarde, p.sh. ERIC, PAIS, MEDLINE dhe ABI/INFORM (të gjitha diskutohen në kapitujt e mëvonshëm). Në vitin 2000, OCLC raportoi se më shumë se 2000 biblioteka kanë nënshkruar First Search. Më shumë se 45 000 deri 50 000 kërkime Online bëhen në ditë.

RLIN

RLIN (Rrjeti i Informatave i Bibliotekave Hulumtuese) me qendër në Mountain View, Kaliforni, është një rrjet bibliografik që po zotëron tregun në këtë fushë. Përveç incizimeve të ligës universitare "ivy", ky rrjet përfshin në vete edhe shumë qendra të mëdha hulumtuese.

Përderisa anëtarësia është e kufizuar, numri i vërtetë i incizimeve është gati 40 milionë. Numri i vogël i anëtarëve kanë dy gjëra të përbashkëta: (1) një koleksion të madh të materialeve, zakonisht me të dhëna të fshehta; (2) një numër të madh të stafit për referenca, katalogë dhe përvetësim.

Citadel është një shembull i ngjashëm nga RLIN me First Search-in nga OCLC në atë që është një paketë e bazave të të dhënave prej ABI/INFORM deri te Newspaper & Periodical Abstracts. Nga viti 2000, numri i bazave të të dhënave që ofroheshin ishte shumë më i paktë sesa numri i atyre që ofrohen nga OCLC.

Rrjetet komerciale

Ka edhe burime të tjera të bazave të të dhënave, të cilat zakonisht kërkohen nga bibliotekarët për përdoruesit sesa vetë përdoruesit të kenë qasje në to. Ato janë të shtrenjta dhe përfshijnë si më poshtë:

DIALOG (http://www.dialog.com) është pjesë e Korporatës Dialog, e cila përfshin një numër të shërbimeve Online siç janë: CARL, që përdoret më së shumti për sistemin e saj të shpërndarjes së dokumenteve. DIALOG ofron më shumë se 500 baza të të dhënave Online, ku më e fuqishme është në informatat teknike dhe ato shkencore. Theks të veçantë vë edhe mbi biznesin, ligjin dhe lajmet.

OVID (http:www.ovid.com) e njohur formalisht si BRS, ka rëndësi të madhe ne teknologjinë mjekësore dhe bazat e tjera të ngjashme të të dhënave. Funksionon në masë të madhe njëjtë si DIALOG, mirëpo është më e specializuar sesa indekset e përgjithshme. Po ashtu, përdoret ekskluzivisht nga bibliotekarët dhe hulumtuesit/kërkuesit me përvojë.

Nga viti 2000, një numër i madh i kompanive të indekseve komerciale filluan të zhvendosin biznesin e tyre në rrjete të bazave të të dhënave. Duke bashkëpunuar me njëri tjetrin, tani ata ofrojnë jo vetëm indekse, por edhe shërbime të ngjashme informative, sikurse baza qeveritare të të dhënave, të dhëna bibliografike dhe burime shëndetësore. Një ndër rrjetet

më të suksesshme janë edhe firmat si: EBSCO, Gale Group, Bell Howell dhe H.w. Wilson Company (shih kapitullin për indekset e përgjithshme dhe diskutimin për secilin nga to). E gjithë kjo përfaqëson një bonus për bibliotekarët dhe do të thotë se konkurrenca, jo vetëm që do ta rrisë efikasitetin e hulumtimit Online, mirëpo mundësisht do ta bëjë atë më të lirë.

REFERENCAT NË INTERNET

Çka janë veprat e referencave në Internet?

Në të vërtetë, janë dy lloje të tyre: ato që ofrohen falas dhe ato që ofrohen me një çmim.

Ato që ofrohen falas përfshijnë shumicën e bazave qeveritare të të dhënave, e po ashtu edhe ato burime informative të institucioneve dhe organizatave sikurse 1 500 katalogët dhe qasja publike në katalogët Online (OPAC) prej Shteteve të Bashkuara dhe të gjithë botës. Kësaj duhet t'i shtohet edhe shifra prej 900 milionë web-sajteve. Këto web-sajte përfshijnë dhe mbulojnë çdo gjë prej astrologjisë deri te fizika. Sasia e të dhënave që ofrohen falas është shumë e madhe.

Në anën tjetër, kualiteti i materialeve që ofrohen për një çmim të caktuar është impresionues. Këto materiale mund të përdoren më lehtë sesa ato që ofrohen falas. Këtu përfshihen web-sajtet dhe bazat profesionale të të dhënave, si dhe ato komerciale. Ndër to janë edhe First Search nga OCLC, DIALOG, LexisNexis dhe firma të tjera, që mund të hasen përgjatë këtij libri.[7] (Shënim: Do të vijë koha, ka mundësi në vitet e ardhshme, kur do të jetë e mundshme të përfitohet jo drejtpërdrejt nëpërmjet caktimit të çmimit, mirëpo përmes reklamimit, mbështetjes qeveritare etj). Përderisa materialet e ofruara falas dhe ato me një çmim, çmohen, përvoja tregon për bibliotekarin e referencave, që janë disa fusha të caktuara në të cilat Interneti bën një punë të mirë në shërbimin e referencave:

1. *Ngjarjet aktuale*. Një numër i madh i njerëzve, posaçërisht ata më të shkolluarit dhe ata që janë nën moshën 30-vjeçare, kërkojnë në Internet

[7] Çmimi paguhet nga biblioteka ose në situatat e tjera edhe nga organizata biznesore (sikurse firma ligjore), agjencia qeveritare etj. Gati në të gjitha rastet, prej personit i cili vjen në bibliotekën publike deri te studentët e diplomuar universitarë, përdorimi me para i bazave të të dhënave ofrohen falas në bibliotekë. Biblioteka ose organizata, natyrisht, merr përsipër çmimin. Duke e bërë atë, shumica e personave laikë (jo profesionalë) e gjejnë të vështirë të bëjnë dallimin në mes atyre që ofrohen falas dhe atyre me para.

informata dhe lajme. Në vitin 1995, përqindja e të rriturve, të cilët përdornin Internetin për lajme ishte diku rreth 4%. Në vitin 2000, ky numër u rrit diku në shifrën 25 % dhe po shkonte lart e më lart.

Përveç tregimeve, që hasen kudo në lajme, përdoruesit e Internetit po kërkojnë edhe informacione praktike. Hobit, filmat dhe restorantet më të mira janë në majën e listës me 82 % të publikut. Diku rreth 64 % kërkojnë informacione shkencore dhe shëndetësore, përderisa teknologjia (zakonisht kompjuterët) përbëjnë 52 %, kurse financat rreth 52 %.

Lajmi është falas. Rreth 800 deri 900 gazeta të përditshme, amerikane dhe ndërkombëtare, i japin kolumnet në web-sajtet e tyre, duke shpresuar që ta joshin reklamimin. Vetëm gazeta Wall Street Journal detyron shfrytëzuesit që të paguajnë një shumë modeste prej $59 në vit për shfrytëzimin e 200 000 artikujve dhe shtesave të tjera të ndryshme. Gazeta prestigjioze The NewYork Times, në të cilën janë të regjistruar rreth 4 milionë përdorues amerikanë dhe ndërkombëtarë, nuk ka vënë ndonjë çmim për t'u paguar. Nga viti 2000, gazetat në përgjithësi panë një burim të të hyrave materiale te bibliotekat. Tashmë, më shumë se 100 gazeta detyrojnë shfrytëzuesit e tyre që të paguajnë për arkivin ose fajllat e tyre. Lajmet e sotme janë falas, mirëpo lajmet e djeshme ofrohen për një çmim.

Interneti është superior, në atë se çfarë është duke ndodhur sot, ose në atë se çka është paraparë për nesër (prej ngjarjeve civile, koncerteve, shfaqjeve të muzeve dhe lojërave të basketbollit). Është humbje kohe kur dikush kërkon informacione, që i takojnë se kaluarës. Kur mungon indeksi dhe, çka është më e rëndësishme, kur mungojnë çështjet e disa viteve të kaluara, shumica e burimeve aktuale të shtypura dhe ato në Internet nuk janë në gjendje që të hulumtojnë për informacionet e vjetra. Në dekadën e ardhshme, kjo do të ndryshojë dhe shumica e arkivave do të jenë Online. Mirëpo, tani për tani, ky është një problem i vërtetë për bibliotekat. (Shënim: Ka edhe përjashtime, për shembull, The Christian Science Monitor ka fajlla Online, në të cilat mund të hulumtohen ngjarjet deri në vitin 1980).

2. *Ngjarjet popullore dhe personalitetet*. Në mes të web-sajteve dhe entuziazmit të vazhdueshëm rreth kulturës popullore, Interneti është një minierë ari për informata aktuale. Qasja më e lehtë është që të shkruhet emri ose fraza në kutinë e web-sajtit, në të cilin po bëni kërkimin dhe të prisni për rezultatet. Yjet e televizionit dhe filmit, që vështirë gjenden edhe në indekset e gazetave dhe të revistave më të njohura, dominojnë

web-sajtet në Internet. Anasjelltas, kjo kërkon edhe kohë të madhe, vende kontraversale për të kërkuar të dhëna rreth figurave historike. Shih kapitullin mbi biografinë për diskutim të mëtutjeshëm të kësaj pike.

3. *Qeveria*. Zakonisht, informatat më të besueshme, aktuale, në Internet vijnë nga qeveria federale, kurse informacionet nga qeveritë shtetërore dhe ato urbane janë më pak të besueshme. Megjithatë, këtu njeriu mendon në kuptimin e nevojave specifike, e jo të "qeverisë". Për shembull, dikush që kërkon materiale rreth shkollave të mesme mendon së pari për ERIC (bazë qeveritare Online e të dhënave), për jo qeverinë dhe për ERIC. Përjashtim: informacionet rreth tri shtyllave të qeverisë dhe agjencitë specifike.

4. *Udhëtimi*. Janë shumë vende ku mund të gjendet çdo gjë rreth udhëtimit prej biletave të udhëtimit deri te moti dhe web-sajtet historike, të cilat mund të vizitohen (ose të anashkalohen gjatë sezonit turistik). Përsëri, ndoshta është më mirë dhe më e shpejtë që të kontrollohen udhëzuesit – posaçërisht për informacione të sakta rreth hoteleve dhe vendeve. Interneti është më i mirë se ato, natyrisht, për kushtet klimatike, çmimet aktuale të udhëtimit, e kështu me radhë.

Fushat e tjera të referencës diskutohen përgjatë këtij libri. Mirëpo, këto katër pika të përmendura më lart janë ndër më të popullarizuarat dhe, nëse asgjë tjetër, ato tregojnë shtigjet e informacionit, që ndiqen më së shumti nga bibliotekarët e referencave në Internet.

Kush dhe për çka: sajtet e popullarizuara

Kategoritë e lartpërmendura, shumë pak, filluan t'i shtjellojnë mundësitë e Internetit. Biznesi në Internet, për shembull, favorizohet dhe përdoret shumë nga bibliotekarët në seksionet brenda dhe jashtë biznesit. Shopingu (blerja), grupet e bisedave dhe vendet e ngjashme si "ejani të kënaqemi dhe të shpenzojmë para" joshin një numër të madh të personave laikë.

Shumica e konsideron Internetin një pikë argëtuese, më shumë sesa një burim solid i informatave. Si i tillë, Interneti josh një numër të madh njerëzish.

Çka bëjnë njerëzit në Internet? Çdo muaj, revista Yahoo! Internet Life liston web-sajtet më të popullarizuara. Argëtimi, personalitetet e famshme dhe sportet prijnë në këtë listë. Web-sajtet më të vizituara: Disney Online,

The Weather Channel, CBS Sports, CNN, USA Today dhe Warner Bros. Nëse dikush i kthehet çështjes se "çka je duke hulumtuar/kërkuar" fjalët më të kërkuara ndryshojnë me atë se çka ka në lajme apo edhe me periudhën kohore. Lista tipike për muajin e marsit: Pashkët, Tornamenti NCAA, Oskari dhe Shën Patriku. Grupet kryesore të bisedave fokusohen më shumë në personalitetet. Formati për web-sajtin Yahoo! si dhe emri i saj ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme, mirëpo prapëseprapë është një vend i mirë për të qenë në hap me kulturën popullore dhe rolit të saj në Internet.

Një kritik thekson: Interneti është "një refugjat për konspiracion të teoricienëve, fanatikëve dhe të atyre njerëzve të çoroditur, mirëpo shikoni anën e ndritur: I preokupon humoristët dhe budallenjtë e ndryshëm duke ua marrë gjithë kohën... Në internet, e vërteta i paraprin humorit." [8]

Web-sajtet

Një "web-sajt" është njësi themelore, e cila mund të jetë një ose disa faqe në vëllim, që mund të lexohet në vazhdimësi, pa u zhvendosur në ndonjë pikë tjetër. Anasjelltas, një "web-sajt" është një seri e web-sajteve, e cila mbulon fusha të ndryshme, por që mund të vizitohet në adresën e njëjtë. Një "adresë" është edhe Uniform Resource Locator (URL). "Shtëpia e

[8] Tom Kuntz, "The Information Age is Here. Ah-ha-ha-ha-ha-ha-ha"! The New York Times, 3 korrik, 1998, f. WK7. Ndër tregimet humoristike të cituara nga Tom Kuntz është edhe tregimi apokrif i një " bisede të vërtetë në radio ne mes të një anije lundruese amerikane dhe autoriteteve kanadeze në bregdetin e Newfoundland". Kjo bisedë është dërguar me postë elektronike poshtë dhe lart kontinentit të Amerikës Veriore.

Kanadezët: Ju lutemi, ndryshoni drejtimin tuaj 15 shkallë për në jug për të parandaluar përplasjen.

Amerikanët: Ne ju rekomandojmë që të ndryshoni drejtimin 15 shkallë në veri për të parandaluar përplasjen.

Kanadezët: Negative. Ju duhet të ndërroni drejtimin 15 shkallë në jug për të parandaluar përplasjen.

Amerikanët: Këtu flet kapiteni i anijes nga Flota Amerikane. Unë them që ju të ndryshoni drejtimin tuaj.

Kanadezët: Jo. Unë po them përsëri, ju duhet të ndryshoni drejtimin tuaj.

Amerikanët: Kjo është aeroplanmbajtësja ushtarake amerikane U.S.S. Lincoln, anija e dytë më e madhe e Shteteve të Bashkuara në Flotën e Atlantikut. Ne jemi të përcjellë nga tre shkatërrues, tri anije të mëdha dhe shumë anije të tjera përcjellëse. Unë kërkoj që ju të ndryshoni drejtimin 15 shkallë në veri. Unë po e përsëris që kjo është pesë shkallë në veri, në të kundërtën do të merren masat mbrojtëse për të siguruar sigurinë e kësaj anije.

Kanadezët: Kjo është shtëpia me drita. Vendim i mirë i juaji.

web-sajtit" është web-sajti në të cilin qasja sigurohet nëpërmjet URL. Në aspektin e bibliotekës, home page (shtëpia e web-sajtit – zakonisht kur një web-sajt hapet fillimisht) krijon lidhjen në mes të shfrytëzuesit dhe bibliotekës e po ashtu edhe për bibliotekat e tjera dhe pikat e tjera informative në Internet, të cilat janë me interes për bibliotekarët.

Në analizën për web-sajtet: (1) Diku rreth 65% e web-sajteve janë publike, p.sh. ofrojnë qasje të pakufizuar në përmbajtjen e tyre; vetëm 2 % janë private, përderisa diku rreth 27 % nuk janë në gjuhën angleze; rreth gjysma e tyre janë në Amerikën Veriore. Është shumë e mundshme që ky numër të rritet me kohë, mirëpo për shkak se gjuha angleze është gjuhë ndërkombëtare, numri nuk do të rritet edhe aq; (3) shumica e web-sajteve, diku rreth 70 %, përshkruajnë dhe japin informata rreth korporatës apo personit që e ka bërë atë web-sajt dhe, në shumë raste e zgjeron këtë në shitjet Online. Përqindja e bën të qartë se qëllimi kryesor i serverëve në Internet është për të shitur, të ngjashëm me kanalet e sotme televizive të shitjes; (4) rreth 11 % e të gjitha web-sajteve janë me vlerë për bibliotekarët, për shkak se ato me të vërtetë ofrojnë informata të tjera përveç atyre për sponsorin, p.sh. lajme, baza Online të të dhënave të referencave, përmbledhje – koleksione të linkeve të burimeve etj.

Tashmë, gati të gjitha bibliotekat e mesme dhe ato të mëdha kanë web-sajtet e tyre në Internet. Duke iu falënderuar programeve kompjuterike, nuk është edhe vështirësi e madhe teknologjike për të krijuar një web-sajt të tillë. Disa individë mund të flasin për bibliotekën, kështu që mbledhje të shumta të komisioneve duken si të nevojshme për të arritur, madje një pajtim të pjesërishëm. Është shumë e qartë se bibliotekarët e referencave duhet të kenë rol të veçantë dhe t'u dëgjohet zëri kur vendoset se çka duhet të përfshihet dhe, po aq e rëndësishme, cilat linke që përdoren në reklamimet e referencave duhet të përfshihen.

URL-të. Janë vetëm disa shenja që ndihmojnë në adresën URL dhe të cilat tregojnë burimin inicial. Këto janë të kufizuara nga qeveria dhe tregojnë qartë kush është sponsori i web-sajtit. Domenet më të mëdhenj: "edu" që përdoret nga shkollat dhe universitetet; "gov" që ofrohet vetëm për qeveritë; "org" është për organizatat joprofitabile dhe "net" për llojin e organizatave të rrjeteve, sikurse ofruesit e shërbimeve biznesor dhe web-sajtet për rrjet. Ndër domenet më të zakonshëm, më të përdorur dhe më të njohur është "com", i cili tregon për interesin biznesor.

Në vitin 2000, domenet shtesë e gjetën rrugën e tyre nëpër adresa. Kjo përmirëson cakun, madje edhe të shmanget, çka dhe në çfarë kohe, nëse

shfaqet një nga to. Shënimet e fundit: “rec” për rekreacion ose argëtim; “firm” për biznese; “store” për dikë që shet të mira; “web”për lajmet e Internetit dhe aktivitetet rreth Internetit; “nom” për adresat personale. Bibliotekarët referencialë do të kenë dëshirë, që të kërkojnë web-sajtet informative, që është e mundur të gjenden nën domenet e rinj: “info” jepet për shërbimet e informacionit, edhe pse këto mund të jenë dhe janë biznese komerciale; “arts” me theks të veçantë në art dhe në kulturë.

Ueb adresat janë një biznes i madh dhe profitabël – vetëm emri, asgjë tjetër. Pronari i www.drugs.come e shiti emrin për shumën diku rreth $900 000. Dhe, e gjithë që ju duhet juve për ta siguruar një web-sajt në Internet është shuma prej $70, që duhet paguar dhe një emër i padeklaruar me jo më shumë se 22 shkronja. Kjo nuk është e lehtë, pasi të gjithë emrat e “mirë” janë marr tashmë dhe kombinime të shumta po bëhen nga dita në ditë.[9]

Hulumtimi në Internet Nëse web-sajti botërore do të adaptonte një melodi që përsëritet vazhdimisht, do të bënte më zi sesa fjala “Unë ende nuk e kam gjetur atë që po kërkoj”. Kërkimi në Internet është aktiviteti më i popullarizuar Online – dhe shpesh është tejet frustues. Bazuar në shërbimin “matës” të Internetit Media Metrix, më shumë se gjysma e 10 top domeneve më të vizituar ishin web-sajte hulumtuese. Mirëpo, sa njerëz që vizituan këto web-sajte gjetën menjëherë atë çfarë po kërkonin?[10]

Kjo duket si e thjeshtë. Dikush, që kërkon fjalimin e Getisburgut të presidentit amerikan Linkoln i shënon këto tri fjalë në kutinë e kërkimit. Paramendimi është ai se ky fjalim gjenden në mesin e dhjetëra mijërave faqeve e teksteve në Internet. Adresa hulumtuese në Internet ndoshta nuk do ta gjejë gjithsesi atë fjalim, mirëpo në ekran do të shfaqen informacione lidhur me pushimet në Getisburg, vendet e quajtura Linkoln dhe lajmet rreth Lincoln Continental. Po, është edhe metoda e drejtpërdrejtë e gjetjes së fjalimeve të caktuara, mirëpo kjo metodë nuk përdoret shumë shpesh nga fillestarët.

Në çdo bibliotekë të mesme apo të madhe sipas madhësisë, studentët dhe personat laikë shikojnë dhe janë të dhënë vetëm në një fushë të seksionit të referencave - terminalin kompjuterik. Shumica besojnë se ky është vendi ku mund të gjendet ajo çka dëshirohet. Shumica kanë pak apo fare aftësi hulumtuese. Pra, e kanë vetëm aftësinë që të manipulojnë me format

[9] “First out of the startin gate,” New York Times, 23 gusht, 1999, f. C3. Ky është një nga artikujt e shumtë në Internet që emërtojnë biznesin. Po ashtu, shiko edhe: Ellen Rony, The Domain Name Handbook (Nju Jork: R & D Books, 1999).

[10] Mat Lake, “Despertately Seeking Susan or Suzie NOT Sushi,” The New York Times, 3 shtator, 1998, f. G1.

digjitale të të dhënave për lojërat.

Nëse u jepet një problem, me përjashtim të rastit kur ata duhet të vendosin për tualetin e bibliotekës apo daljen e saj, personi laik i kthehet kompjuterit, shënon një fjalë ose dy dhe pret për rezultatet. Është e vërtetë se ai/ajo duhet që së pari të gjejë një bazë të të dhënave, mirëpo kjo prapëseprapë është bërë automatike në bibliotekat, ku menytë tregojnë se secili duhet ta shikojë bazën e të dhënave X ose Y për pyetjet lidhur me kategoritë e mëdha prej "shkencës" deri te "humanitetet". Hulumtuesit e sprovuar duhet të përdorin një prej qasjeve të shumta të shpejta, të quajtur ArticleFirst nga OCLC, ku janë më se 17 000 të përkohshme me përgjigjet e mundshme. Të tjerët mund të zgjedhin Expanded Academic Index, i cili ka rreth 1 500 periodikë ose lloje të njëjta të indekseve, që mbulojnë materiale të shumta.

Për shkak se gjendet një numër shumë i madh i ditarëve dhe i revistave, madje edhe fjala më e vështirë ose më e marrë dhe fraza do të lidhet me një apo dy artikuj. Në të vërtetë, rezultati është i mundshëm të paraqesë prej 10 deri 100 artikuj. Citimet janë të shënuara dhe personi laik ose studenti pastaj zhvendoset te seksioni i periodikëve për të gjetur materialin. (Sistemet më të sofistikuara tregojnë nëse biblioteka ka periodik. Po ashtu, shumica ofrojnë edhe abstrakte ose tekste të plota të artikujve Online, të cilat e bëjnë kërkimin/hulumtimin e kërkuesit edhe më të lehtë). Nëse printeri nuk është prishur dhe nëse kompjuteri nuk është marrosur, hulumtuesi do të largohet i kënaqur dhe i bindur se qëllimi i tij është arritur. Shumë pak persona laikë kanë ndonjë koncept nëse artikujt do të përdoren plotësisht apo jo.

Bibliotekari si ndërmjetësues

Një vëzhgues shënon se " leximi në Internet ka qenë dhe vazhdon të jetë i lidhur me pirjen prej tubës. Tashmë, ka më shumë materiale në Internet sesa një qenieve njerëzore mund të absorbojë dhe të marrë gjatë gjithë jetës së tij. Duke u ballafaquar me bollëk materialesh, janë vetëm dy strategji të shpëtimit. Njëra është që të jesh jashtë mase përzgjedhës... Dhe tjetra është ajo që t'u besosh të tjerëve, që ta bëjnë filtrimin për ju".[11]

Interneti është një zgjedhje "Online bazë" për bibliotekarët... dhe shfrytëzuesit e fundit... Biblioteka (apo bibliotekari) që është si pikë qen-

[11] John Naughton, "Internet", Observer (Londër), 10 janar, 1999, f. 6.

drore është shumë e rëndësishme në dhënien e ndihmës për ta formësuar dhe për ta shndërruar Internetin në një vegël të përdorshme. Interneti është mjaft i madh dhe depërtues për të qenë domen ekskluziv i një grupi të profesionistëve apo i një qasje të një organizate. Bibliotekarët sjellin dijeni në grupet e shfrytëzuesve dhe në aftësitë e vlerësimit, të cilat mund të ndihmojnë në shndërrimin e Internetit në një lloj biblioteke digjitale si ç'do të dëshironim ne, e jo në një grumbull me materiale, gjoja, të mira.[12]

Rrjetet globale të shpejta dhe efikase janë çelësi për shërbimet e referencave. Roli i bibliotekarit të referencave në këtë mjedis të ri që ndryshon gjithnjë është tradicional dhe zbulues. Sikurse edhe në të kaluarën, bibliotekari i referencave duhet t'i gjejë përgjigjet për pyetjet dhe do ta përdor Internetin dhe rrjetet e ngjashme për atë qëllim. Për shkak të një numri të shumtë të mundësive dhe fushave, bibliotekari duhet gjithsesi, në rolin e ndërmjetësuesit, që të jetë në gjendje të marrë çka kërkohet.

Biblioteka në bashkësi/komunitet është vendi ku shfrytëzuesit do t'i gjejnë burimet e fundit elektronike dhe të shtypura për mbledhjen e informatave. Më e rëndësishmja është ajo se biblioteka duhet të jetë aty ku shfrytëzuesit mund të kërkojnë ndihmë aktuale, të saktë dhe shoqërore në njohjen më të mirë të rrugëve të tyre të drejtimit në rrugën e informacioneve.

Bibliotekari i referencave është zëri personal në detin me kompjuter dhe përgjigjet e digjitalizuara. Këtu, dialogu zëvendëson "shtypjen e egërsuar të pullës 1". Eksperti i hulumtimit/kërkimit bën gjithçka prej tregimit praktik se si duhet të përdoret Interneti deri te këshillimi se cilat baza të të dhënave (me para apo falas) duhet të përdoren për pyetje të caktuara. Pikë së pari, bibliotekari shërben për të zvogëluar nervozën dhe frustrimin, duke dhënë këshilla të sakta rreth vendeve më të mira, që duhet parë për gjetjen e përgjigjes për një pyetje.

Sa e mirë është përgjigja finale nga Interneti? Bibliotekari është aty për të sugjeruar metodat e analizës dhe të vlerësimit të informatave për të sigluar, që shfrytëzuesi ka çka i nevojitet në format të besueshëm.

Disa shfrytëzues të pafajshëm besojnë se Interneti është fillimi dhe fundi i informatave. Bibliotekari duhet të ndihmojë që shfrytëzuesi të vendosë se kur Interneti i shërben atij qëllimi dhe kur është më i mirë, sigurisht, më pak, frustues është përdorimin i formave të tjera. Për shembull, dikush që kërkon një citim, të kaluarën e një personi, një burim

[12] Carol Tenopir, "Shaping the Web", Library Journal, 1 mars, 1999, f. 36.

biografik, ose fakt historik, ndoshta është më mirë që të shfletonte një libër të citimeve, një burim biografik, ose një enciklopedi, në versionin e shkruar apo elektronik. Nëse dikush dëshiron të gjejë sasinë e ujit në lumin Kariba të Zambisë, ai duhet do të gjejë më shumë se 500 artikuj (rezultate) në Internet (2000). Mund të marrë prej një minute deri në gjysmë ore gjetja se sa ujë gjendet në lumin Kariba, mirëpo merr vetëm një moment që i njëjti informacion të gjendet në Enciklopedinë Britannica.

Sfida është që të integrohet Interneti në sistemin e informatave të përgjithshme, të plota, të bibliotekës. Çelësi është udhëheqja e shfrytëzuesve, në atë mënyrë, që ata të dinë se kur duhet të shikojnë një baza Online komerciale të të dhënave, kur një CD-ROM, kur një libër dhe kur ta hulumtojnë Internetin. Mënyra më e mirë, sot, edhe pse pak e ashpër për arsyen se po zgjerohet dita ditës, është që të ofrohen apo jepen linket e informatave prej web-sajtit së bibliotekës. Zgjedhjet, normalisht, marrin në konsiderim të gjitha burimet e informatave, jo vetëm Internetin.

Udhëzimi i bibliotekës ka marrë një kuptim të ri. Në të kaluarën, nuk do të thoshte më shumë sesa tregimi i katalogëve dhe vendeve se ku mund të gjenden disa libra të referencave. Sot, është shumë i komplikuar dhe merr shumë kohë. Për shembull, në një studim të 68 bibliotekave universitare, është gjetur se gati të gjitha ofrojnë trajnim për Internetin, përderisa gati më shumë se gjysma ofrojnë trajnim për të ndihmuar shfrytëzuesit. Më shumë se 95% mësojnë gjersa personi hulumton përgjigjen për një pyetje.[13] Bibliotekarët e veçantë, që u shërbejnë një grupi të shfrytëzuesve e kalojnë "diku rreth 30 % të kohës së tyre duke bërë hulumtim ose duke ndihmuar shfrytëzuesit, përfundimtar me detyrat e ngjashme të kërkimit. 37 % e kohës së tyre... është e dedikuar për detyrat e ndryshme administrative... dhe pjesa e mbetur, pra 28 % e kohës së tyre, shpenzohet në aktivitete më strategjike si planifikim, trajnim dhe zhvillim të shërbimit apo produktit".[14]

MAKINAT E KËRKIMIT

Makina e kërkimit, apo ajo që tashmë disa e quajnë "portë" është një shërbim i vështirë për bibliotekarin e referencave. Ideja është mjaft e

[13] Carol Tenopir, "Reference Use Statistics", Library Journal, 1 maj, 1998, f. 32.
[14] Doug Church, "Breaking Free of the Reference Shackles", Information Outlook, mars, 1999, f. 19.

thjeshtë. Që të hulumtohet/kërkohet përmbajtja e web-sajteve në Internet, të lexohen fjalët kryesore në faqe dhe të zgjidhet ajo çka është relevante për një kërkim të caktuar. Ka edhe llogari të tjera të konfiguracioneve në këtë formulë, mirëpo pushtimi i Internetit nga ana e kompjuterit është shumë e njëjtë.[15]

Makinat kërkuese mund të ndahen në disa mënyra, por indeksi i fjalës kryesore është baza. I pranon fjalët kryesore dhe kap rezultate të mëdha, zakonisht duke listuar me qindra web-sajte. Zakonisht, rezultatet vlerësohen dhe radhiten në atë mënyrë, që web-sajti kryesore, e cila e ka fjalën e shënuar nga shfrytëzuesi vjen e para në radhitje. Grremçi është aty se përderisa shfrytëzuesi është i papërvojë dhe i paaftë, rezultatet e shumta dhe masive ka gjasa të mëdha të jenë dërrmuese.

Janë disa rregulla themelore edhe për bibliotekarët edhe për personat laikë, të cilët dëshirojnë të dhëna përmes një web-sajt kërkuese në Internet: (a) kur është e mundshme, përdor kërkimin e avancuar të web-sajtit kërkues (advanced search), ose sido që mund të quhet; (b) kërko frazat dhe vendet ku fraza është cituar, për të kufizuar kështu kërkimin vetëm në ato fjalë specifike; (c) madje, edhe me kërkimin më të "ashpër" drejtpërdrejt përdor disa fjalë, në vend të një ose dy. Përjashtim: emër i duhur, i cili duhet të futet në thonjëza; (d) Duhet të kesh një listë të sinonimeve gati, në rast se dështon kërkimi me fjalën kryesore.

Disa metoda të tjera të kërkimit: (1) lexo fajllat ndihmës të web-sajtit kërkues, për të gjetur dhepër t'i kuptuar gjërat themelore prej sintaksës deri

[15] "Web Search Engine" është një temë e gjerë e botimit maj/qershor të vitit 1999 të Online. Po ashtu, edhe ditarët e tjerë si Choice, së paku një herë në vit, ia kushtojnë një pjesë të madhe të hapësirës së tyre zhvillimit të web-sajteve kërkuese "search engines". Për veçoritë e veçanta të web-sajteve më të mëdha kërkuese shiko Amalia Kassel, "Internet Power Searching..." Information Outlook, prill, 1999, f. 29-32. Shiko faqe 32 "Keeping Up" për listën e burimeve Online, të cilat i modifikojnë dhe vlerësojnë web-sajtet kërkuese dhe web-sajtet e zakonshme. Shiko: Micheal Specter, "Search and Deploy", The New York Times, 29 maj, 2000, f. 88-100. Pas hyrjes në të cilën ai diskuton web-sajtet kërkuese dhe problemet e tyre të përgjithshme (dhe fitoret), Specter i kthehet temës kryesore: zhvillimit të web-sajtieve kërkuese të quajtur Google në Universitetin e Standford-it. Ai shpjegon projektin, si filloj dhe kush ishte i përfshirë në të. Përgjatë librit, ai tregon se pse Google është web-sajt aq kërkues, superior dhe si do të përmirësohet ai. Një shkrim jashtëzakonisht i mirë dhe një prezantim i qartë e bën këtë botim të nevojshëm për një student.

Veçori e rregullt, "Internet Search Engine Updates" është e mirë për t'u përdorur në futjen e ndryshimeve të shpeshta në web-sajte kërkuese themelore. Këto lajme gjenden në çdo botim të Online dhe deri më tani janë informacionet më të mira. Madje, edhe një shikim i tërthortë i periodikëve kryesorë që mbulojnë Internetin do

te përdorimi i shenjës së minusit dhe plusit për përfshirjen apo mospërfshirjen e fjalëve; (2) përdor kufizime, limite p.sh. nëse web-sajti kërkuese e ofron, kufizoje kërkimin vetëm në gjuhën angleze, në buletine, në periodikë, në çdo gjë që ka lidhje me qëllimin/dyshim/pyetjen tuaj; (3) kur shfaqen disa qindra rezultate, rrallëherë është e nevojshme, që të shikohen më shumë se 10 apo 20 të parat. Është më mirë që të provohet një kombinim tjetër i fjalëve, i frazave etj., në kërkimin e dytë rreth temës apo çështjes së njëjtë. Sigurohuni që fjalët që kanë dy kuptime të kualifikohen me sinonime.

Një gjë e çuditshme është fakti se web-sajti kërkuese, me vendet e saj të panumërta për kërkim, ku të gjitha janë të vlerësuara sipas mundësisë, që ato të lidhin dyshim/pyetjen me përgjigjen, do t'i zëvendësojnë bibliotekarët e referencave. Hah! Çdo njëri, që ka kaluar më shumë se një orë ose dy në përpjekje për të gjetur përgjigje për një pyetje komplekse përmes një web-sajt kërkues, e kupton që këto web-sajte, jo vetëm që janë të pasakta, mirëpo janë edhe të marra. Madje, edhe më e mira, e disa janë vërtetë të mira, kërkojnë më shumë përpjekje për ta kuptuar sesa t'ia bëjë pyetjen një bibliotekari të referencave.

Përderisa koha e kërkimit/hulumtimit në Internet është më e zgjedhur sesa është sot, bibliotekari i referencave do të shpenzojë më shumë kohë në shtimin e përpjekjeve të web-sajteve kërkuese. Në fakt, sa më shumë informata e vërshojnë Internetin, është më e mundshme që bibliotekari i referencave do të jetë më i rëndësishëm si ndërmjetësues ndërmjet individit dhe informatës.[16] Pra, çka nuk është në rregull?

Dy gjëra: web-sajtet kërkuese janë të mira dhe të shkëlqyeshme dhe po përmirësohen gjithnjë e më shumë, mirëpo ato mbështeten në hulumtuesit që janë ekspertë. Ato janë shumë të varfra dhe jo të mira për personin mesatar, i cili vetëm shënon fjalën kryesore. Dikush që shënon fjalën "luftë" ose "paqe", do të vërshohet me informacione. Bibliotekari i mençur, hulumtuesi i aftë, e di se si ta përdorë logjikën Boolean dhe kualifikues të tjerë, në mënyrë që ta kufizojë kërkimin vetëm në 10 deri 20 gjëra, të cilat janë për specifikat e luftës apo paqes.

Interneti ofron një informatë paradoksale. "Kategori të tëra të pub-

[16] Greg R. Notes, "The Never Ending Quest", Online, maj/qershor 2000, f. 27-34. Në mesin e vitit 2000, web-sajt i ri kërkues që po vinte e quajtur FAST thoshte se do të indeksonte më shumë se 300 milionë faqe të 1 miliard faqeve në Internet. Web-sajtet e tjera kërkuese, prej AltaVista deri te Yahoo! dhe Google theksojnë numrin e njëjtë. Problemi është se parashikohet që web-sajtet të rriten edhe më shumë në shifrën 13 miliardë në vitin 2004. A mund web-sajtet kërkuese ta mbajnë hapin? Është e mundshme që jo.

likime nuk hyjnë në jetë, përderisa ne nuk e fusim veten në ndonjë librari dhe shikojmë raftet e saj. Shfletimi i ueb-aqeve, i quajtur "web browser", është në gjendje që të vë në kontakt çdo kënd me çdo gjë, me vetëm një shënim të vogël". Kjo është e përshtatshme, mirëpo mund të jetë shkatërruese. "Aftësitë e Internetit për të krijuar lidhje arbitrare të menjëhershme po tregohen si të shumta".[17]

E mbushur me zhargon dhe me shpresa komerciale, web-sajti kërkuese është një lloj indeksi apo katalogu, i cili i klasifikon miliona faqe të Internetit. As dy web-sajte kërkuese nuk janë të ngjashme, edhe pse ato i kanë tri gjëra të përbashkëta: (a) një indeks të web-sajteve ose ueb-vendeve, që hulumton rrënjët për elementet kryesore; (b) secili web-sajt kërkues mbledh të dhëna, mirëpo modifikimi i këtyre të dhënave është i ndryshëm; (c) secila nga to i dallon/ndan rezultatet dhe i vlerëson ato bazuar në vlerën e tyre relative, mirëpo përsëri duhet thënë se secila nga ato e bën këtë në mënyra të ndryshme. Ato vijnë në forma dhe formate të ndryshme, mirëpo janë në dy forma themelore. E para krijon indeksin e saj. Kurse e dyta (e cila shpesh quhet mega web-sajte kërkuese) hulumton indekset ekzistuese të web-sajteve të tjera kërkuese.

Kategoritë e tjera mund të përfshijnë: (1) Indekset e fjalëve kryesore, si AltaVista dhe Lycos. Këtu, web-sajti kërkuese lexon vetëm 200-300 fjalët e para në web-sajtin e Internetit. Pasi eliminon fjalët e tilla, si "dhe" "e" dhe "për", i radhit fjalët sipas rendit alfabetik dhe i fut ato në një indeks. Vendosja e fjalëve dhe shpeshtësia ndihmojnë për të vendosur radhitjen e një hulumtimi të caktuar. Kjo qasje është e shpejtë dhe e përgjithshme; (2) udhëzuesit e subjekteve sikurse Yahoo! kanë tituj të caktuar të subjektit, njëjtë sikurse katalogu i bibliotekës, për web-sajtin. Ky lloj është më specifik sesa indeksi i fjalëve kryesore, por nuk përgjithëson për shkak se janë dhënë shumë tituj të subjektit.

Secila nga këto dy metoda themelore ka problemet e saj. Kështu që, në frymën dhe përpjekjet për ta futur më të mirën e të dyjave, përdor meta web-sajtin kërkuese, e cila hulumton dhe bën kërkimin e një numri bazash të të dhënave dhe të web-sajteve kërkuese. Një tjetër metodë është linkimi i vizituesit në mekanizma të tjerë të mëdhenj, brenda mekanizmit që po hulumtohet. Për shembull, Yahoo! ofron qasje edhe për AltaVista dhe shërbime të ngjashme të tjera të fjalëve kryesore (keywords).

Përpjekja e tretë është për ta hequr qafe kaosin është mekanizmi i

[17] "Philip Agre", "Yesterday's Tomorrow", The Times Literary Supplement, 3 korrik, 1998, f. 4.

kërkimit të subjektit. Në vend se të mbulohet i gjithë Interneti, këto mekanizma koncentrohen në një fushë të veçantë të subjektit. web-sajti e degëzuar mund të jetë shumë e ngushtë apo të mbulojë një mal të tërë të fushave dhe interesimeve.

Ajo çka e bën të vështirë, është fakti se web-sajtet kërkuese nuk e shpjegojnë qartë se si dallojnë ato njëra nga tjetra. Yahoo! për shembull teknikisht nuk është web-sajt kërkues, mirëpo është një grup i web-sajteve nën titujt e një subjekti. Ndërkaq, të tjerat, duke filluar nga Hotbot deri te AltaVista përdorin agjentë të softuerëve (merimanga apo zvarritës) që automatikisht e indeksojnë përmbajtjen e faqes dhe ndjekin linket e faqeve të tjera të ngjashme.

Ka një numër të madh të finesave, të cilat të gjitha janë të nënvizuara në shumë artikuj. Për një modifikim Online shiko:

Search Engine Watch (http://www.searchenginewatch.com) shërben për dy qëllime. E redaktuar nga Greg Notess, e para dhe më e rëndësishmja është ajo se ofron linke për lajmet aktuale rreth web-sajteve kërkuese (search engines), p.sh. “see what’s new” ose “search engine headlines” etj. E dyta, analizon në mënyrë të rregullt dhe i vlerëson web-sajtet kërkuese: “Lexo analizat e krahasuara, shiko se cilat web-sajte kërkuese janë më të kërkuarat dhe kontrollo teste e statistika të ndryshme”. Një sërë veçorish të tjera përfshirë “search engine newsletter” e bëjnë këtë faqe një vend me vlerë për mbulim të gjerë të subjektit.

Search Engine Showdown (http:// www.searchengineshowdown.com), e cila e quan veten “udhëzuese të shfrytëzuesit për hulumtim në Internet”, mbulon një numër të madh të aktiviteteve aktuale në këtë fushë. E redaktuar nga Danny Sullivan, web-sajti kërkuese është e ndarë sipas veçorive, përmbledhjeve statistikore, strategjive të kërkimit e hulumtimit, udhëzuesit të subjektit, listës së adresave elektronike dhe veçorive të tjera. Duket se modifikohet në baza ditore dhe është vendi i vetëm dhe më i miri për të parë atë që sapo ka ndodhur.

Portat

Makinat kërkuese janë zgjeruar në “porta” dhe shumica prej tyre tanimë dëshirojnë të jenë të njohura si porta e jo si web-sajte kërkuese. Porta është thjesht një version më i zgjeruar i web-sajtit kërkues. Është një web-sajt i

madh kërkues, e cili ofron qasje, jo vetëm në kërkim/hulumtim, por edhe në adresën elektronike, në grupet e bisedave dhe në shërbimet e tjera. Po ashtu, një portë mund të jetë një grup i web-sajteve kërkuese, (zakonisht e rangut të dytë), i cili është mbledhur së bashku për të krijuar një mega web-sajt, në mënyrë që të mbijetojë.

Porta (anglisht: portal) nuk ka vetëm detyra udhëzuese, mirëpo edhe veçori të tjera, të cilat e bëjnë atë atraktive për shfrytëzuesit – dhe investitorët. Nëse ju mund të ofroni shërbime të mjaftueshme dhe përmbajtje në një adresë të vetme Interneti, atëherë ju mund të sillni aty shumë më shumë njerëz në vendin e njëjtë. Pra, njerëz që kanë interesime dhe nevoja të ndryshme. Kjo do të thotë dhe ofron mundësinë për të shitur më shumë reklama, bazuar në vlerën e dollarit për çdo 1 000 faqe të vizituara. Aksidentalisht, vetëm American Online dhe Yahoo, dy portat më të mëdha, janë duke fituar para nga kjo.

Nocioni portë mund të jetë problem për bibliotekarët e referencave. Përderisa web-sajtet kërkuese duhet t'i ndihmojnë njerëzit për të gjetur atë çka ata dëshirojnë, porta ka diçka tjetër në mendje. I dërgon shfrytëzuesit në destinacionet e njëjta, si më parë. Grremçi: mirëpo tani, destinacioni mund të jetë në pronësinë e portës apo të reklamuesit. Nëse porta është rob i reklamave, ka gjasa që të jetë më pak e besueshme sesa një udhëzues objektiv i informatave.

Makinat më të mira kërkuese

Cilat janë ueb makinat më të mira kërkuese për fillestarë dhe për ekspertë, të cilat përdoren për mbledhjen e informatave? Në përgjithësi, ato të cilat më së lehti përdoren dhe me rezultatet më specifike. Shumica e web-sajteve kërkuese mbulojnë prej 200 deri 300 milionë tekste të plota nga web-sajtet. Numri është më pak i rëndësishëm sesa kur hulumtimi, më pastaj pastrohet.

Disa prej web-sajteve themelore kërkuese, sipas radhitjes së preferencës nga shumë bibliotekarë, edhe pse sigurisht jo nga të gjithë, në vitin 2000 përfshijnë:

Google (http: www.google.com) është një punë e hulumtuesve në Universitetin e Standfordit, të cilët ishin goditur në kokë nga ideja për të vendosur vlerën e një web-sajt të caktuar, bazuar në numrin dhe kualitetin e web-sajteve të tjera, të cilat janë të lidhura me të. Në shumë aspekte,

Google është më efikasja e grupit në atë se ajo vetëm e drejton "shotganin", mirëpo nuk e përdor atë (pra i rekomandon shfrytëzuesit për adresat e caktuara). Shënim: "I'm feeling lucky", është një opsion që e dërgon hulumtuesin/kërkuesin drejtpërdrejt në një web-sajt të vetëm të Google-s, për atë temë apo fushë të caktuar. Pra, kursen mjaft kohë.

Madhësia nuk ka fort rëndësi kur kemi të bëjmë me atë se çka është vendosur dhe çka jo nga një web-sajt kërkues. Asnjë nga ato nuk mund të jetë në hap me një miliard a më shumë web-sajte, që ofrohen në Internet, por Google pretendon këtë. Ata theksojnë se nga viti 2001 do të jenë në gjendje që t'i hulumtojnë/kërkojnë, diku afër 600 milionë ueb- faqe me tekste të plota, plus rreth 500 milionë indekse të veçanta URL, p.sh. adresat Online.

Google është një shembull i mekanizmit hulumtues, e cila ka rreth vetes edhe ata që nuk e flasin gjuhën angleze. Këtë e bën duke ua mundësuar shfrytëzuesve, që ta përdorin Online gjuhën e tyre amtare. Shfrytëzuesit mund të hulumtojnë për përmbajtjen në çfarëdo gjuhe të caktuar. Nga viti 2001, kjo do të thoshte shërbim në 15 gjuhë të ndryshme, duke filluar nga gjuha frënge e ajo gjermane deri te japonishtja dhe kinezishtja. Është shumë e qartë se më pas ka zgjidhje, si në gjuhën angleze. Janë diku përafërsisht rreth 40 milionë web-sajte në japonisht – krahasuar me mbi 1 miliard në anglisht.

Fast (www.alltheweb.com) është punë e një grupi tjetër të akademikëve. Tani në Norvegji. Është një nga web-sajtet më të mëdha kërkuese me më shumë se 300 milionë web-sajte. Problemi këtu qëndron në faktin se ka shumë dublikate apo web-sajte të ngjashme dhe përderisa e ka përparësinë se mbulon më shumë fusha se çdo web-sajti tjetër kërkues, nuk është fort e mprehtë dhe e mirë në rezultate. Me kohë, ka të ngjarë që të përmirësohet.

Northern Light (http://www.northerlight.com). Ky është web-sajti kërkues i përgjithshëm, e po ashtu edhe specifik, që ofron qasje në materialet e specializuara, që ofrohen me para. Një marrëveshje me Bell & Howell's / UMI "ProQuest Direct" e lejon Nortehrn Light që të ofrojë qasje në artikujt me tekste të plota prej më shumë se 54 000 ditarëve, e po ashtu edhe librave. Përderisa konsumatori paguan për shërbimin me tekst të plotë, shumica e hulumtimeve/kërkimeve ofrohen falas. (Shiko, po ashtu, edhe diskutimin rreth faqes kërkuese nga Northern Light të

quajtur Usgovsearch në kapitullin e këtij teksti rreth dokumenteve qeveritare).

Yahoo! (http://www.yahoo.com). Është më e mira, nëse kërkoni dhe bëni hulumtim rreth temave të gjera dhe të përgjithshme. Teknikisht, ky është një udhëzues, që i ngjan një web-sajti kërkues, mirëpo rezultatet janë gati të ngjashme me web-sajtet e tjera kërkuese. Një përparësi, mjaft e madhe, e këtij web-sajti, në krahasim me të tjerat është fakti se kjo liston më shumë se 350 000 web-sajte, grupe të lajmeve etj., të cilat vlerësohen nga Yahoo! Me fjalë të tjera, në vend se të hulumtoni gjithçka që është aty, ata hulumtojnë vetëm pikat informative, që janë kapur me lehtësi. Ky web-sajt e ka një mekanizëm të hulumtimit/kërkimit, mjaft të sofistikuar, sipas subjektit dhe fjalëve kryesore, që e bën mjaft të lehtë për t'u përdorur. Shumicën e herave, vlerësohet dhe radhitet si më e "mira" nga bibliotekarët e referencave, e ndjekur më pas nga AltaVista.

AltaVista Network (http://www.altavista.com). Është më e mira për hulumtime specifike. Duke iu falënderuar sistemit të saj të sofistikuar të hulumtimit, i cili është po ashtu shumë i lehtë për t'u përdorur, AltaVista Network i gjen dhe tregon më shumë web-sajtet që duhet shikuar për gjetjen e një përgjigjeje specifike. Ata, njëjtë sikurse web-sajtet e tjera kërkuese, i radhisin të dhënat në bazë të asaj se sa përshtaten me nevojën e shfrytëzuesit, i cili dëshiron të zgjidhë mëdyshjen e tij. Radhitja nuk është gjithmonë e saktë, por normalisht, nëse bëhet më shumë hulumtim sesa që është problemi, kjo do të kalohet. Opsioni "live topics" i lejon shfrytëzuesit që t'i shënojnë fjalët kryesore dhe kur klikohet "live topics", në ekran shfaqen fjalë të tjera kryesore, të cilat mund të përdoren për hulumtim të mëtutjeshëm. Klikimi në njërën nga këto dhe refuzimi i një tjetri do ta ngushtojë ose do ta zgjerojë hulumtimin. Ju mund të hulumtoni dhe të kërkoni grafike, duke përdorur fjalën "imazh", si prefiks për hulumtim. Hulumtimet mund të bëhen në web-sajtet që janë në 25 gjuhë të ndryshme, p.sh. nëse shfrytëzuesi e pyet AltaVista Network që t'i kthejë rezultatet në gjuhën frënge dhe gjermane ose italiane, materiali do të shfaqet në ekran vetëm në ato gjuhë.

Lycos (http://www.lycos.com). Është më i miri për hulumtime specifike dhe të avancuara. Fillestarët duhet të fillojnë me faqen kryesore të web-sajtit ku jepen disa linke që përdoren lehtë. Për hulumtimet më të avancuara, duhet të shikoni "Lycos Pro".

Hot Bot (http://www.hotbot.com). Është pjesë e Lycos, e cila shërben për hulumtime fillestare dhe ato të avancuara. Kjo është për ekspertin ose

fillestarin hulumtues, i cili ka durim. Ofron ndihmën më të madhe për kërkesat më të komplikuara për informata. Janë disa ekrane, të cilat lejojnë shfrytëzuesin që ta zgjerojë hulumtimin me të dhëna, lokacion, organizmin dhe të ngjashme. Fillestari duhet të ndjekë shembujt e tillë, shumë kujdesshëm, mirëpo ç'është e vërteta, ia vlen barra qiranë.

Go (http://www.go.com). Është më e mira për hulumtimin e ngjarjeve aktuale. Është një web-sajt kërkues, i shpejtë, efikas dhe aktual, i cili është i lehtë për t'u përdorur. Metodat e hulumtimit janë veçanërisht të mira për radhitjen e web-sajteve relevante dhe për atë se janë më afër qëllimit në gjetjen e fjalëve të shkuara për hulumtim. Problemi qëndron në atë se ka një numër të kufizuar të web-sajteve dhe po ashtu një indeks të kufizuar.

Shërbimet meta-hulumtuese[18]

Për hulumtimin e më shumë se një shërbimi gjenden disa rrugë të shpejta. Të ashtuquajturat "shërbimet meta-hulumtuese" nuk e bëjnë hulumtimin e tyre, mirëpo u kthehen web-sajteve kërkuese ekzistuese. Dy shembuj të mirë: (1) Copernic (http//:www.copernic.com) është një nga mekanizmat më të mirë hulumtues. I merr disa dhjetëra ndihma hulumtuese prej Yahoo! deri te AltaVista. Ju mund të shënoni termin (et) dhe më pas disa web-sajte kërkuese hulumtohen në të njëjtën kohë. Më pas, ekrani i tregon një numër rezultatesh sipas rëndësisë së tyre, të cilat nuk mund të gjenden në ndonjë shërbim tjetër, aq më pak në një shërbim që ofrohet falas. Kjo hulumton një numër të web-sajteve kërkuese dhe për dallim nga disa prej konkurrentëve të saj, i heq web-sajtet e ngjashme dhe dublikatë dhe ofron web-sajte të nënvizuara, të cilat tregojnë ligje të mundshme. Grremçi: përdor shumë pak logjikën Boolean. Gjenden edhe një numër i madh i web-sajteve kërkuese p.sh. Profusion (http://www.profusion.com), e cila hulumton deri 9 web-sajte kërkuese dhe më pas i klasifikon rezultatet, i heq web-sajtet e ngjashme –dublikatë dhe përfundon me një listë të vetme të web-sajteve.

Savvy-Search (http://www.savvysearch.com) konsiderohet, nga disa bibliotekarë të referencave, që është ndër mekanizmat më të mirë meta-

[18] Për një sqarim të qartë dhe krahasim të shërbimeve meta-hulumtuese, shiko: "Judi Repman and Randal Carlson, "Surviving the Storm: Using Metasearch Engines Effectively", Computers in Libraries, maj, 1999, f. 50-56.

hulumtues. Pse? Për shkak se mund të përdoret për hulumtime jo të gjëra (p.sh. subjekte specifike/emra etj.) ose të gjera – dhe kështu vendos kufizime kur web-sajtet kërkuese hulumtojnë/kërkojnë të dhëna. Kjo në vete kursen shumë kohë në atë se qëndron afër asaj çka është relevante. Po ashtu, lejon edhe ruajtjen e hulumtimeve të profilizuara, të cilat mund të bëhen shumë e shumë herë.

Nuk ka web-sajte kërkuese, e as edhe metodë hulumtuese/kërkuese, që do t'i përfshinte të gjitha mundësitë. Një kërkesë tërësore për informacione nuk duhet të merrë në konsiderim vetëm rrugët që ndiqen nga uebfaqet kërkuese, mirëpo edhe ato si CD-ROM-ët, botimet e shtypura dhe formatet e tjera.

Multi-hulumtimet

Shumica e shitësve të mëdhenj, duke filluar prej DIALOG e deri te SilverPlatter, ofrojnë një opsion për hulumtimin e jo vetëm një baze të të dhënave, mirëpo të disave në të njëjtën kohë. Përderisa kjo është teknikë e njëjtë për të gjitha web-sajtet kërkuese, këtu hulumtimi është më i hollësishëm dhe më i pastruar (duke qenë i kufizuar në vetëm një numër të caktuar të bazave profesionale) e po ashtu edhe më i sofistikuar. Për shembull, "Major Papers" nga DIALOG lejon shfrytëzuesit që t'i hulumtojnë përmbajtjet e 16 shkrimeve në të njëjtën kohë. Një web-sajt i përgjithshëm kërkues mund të hulumtojë rreth 400 artikuj, mirëpo pa bërë ndonjë diskriminim të vogël.

"WebSPIRS" që vjen nga SilverPlatter është një rrugë e zakonshme interference për përdorim me veprat e kompanisë rreth referencave (në radhë të parë indekseve), të cilat ofrohen përmes Internetit. Dikush mund t'i zgjedhë së pari indekset për t'i hulumtuar ose shkruan fjalët kryesore dhe e lejon sistemin që të tregojë se sa shpesh ato fjalë, fraza, ose tituj të subjektit shfaqen në indekset e ngjashme. Hulumtimi mund të bëhet pastaj në një apo dhjetëra indekse për termin apo termat. Një përparësi e qartë është fakti se gjërat që gjenden vështirë dhe të vështira për t'u vendosur mund të gjenden lehtë. Po ashtu, përdorimi i tepruar është i dukshëm. Hulumto për termat e zakonshme dhe sistemi do t'ju tregojë me mijëra mundësi. Nëse përdoret në aspektin juridik, këto sisteme multi-hulumtuese kursejnë mjaft kohë.

HULUMTIMI I WEB-it

Janë tri lloje themelore të hulumtimeve që bëhen në terminalin e kompjuterit. E para është kur shënoni disa fjalë në kutinë e web-sajtit kërkues, në radhë të parë për llojin e referencave të gatshme që janë të njohura. (Sa është numri i popullatës në Indi? Kur ka lindur John Doe? Ku gjendet Albany, në Nju Jork apo diku në Nju Jork Siti? Kush është Kryeministri i Britanisë së Madhe?). Duke iu falënderuar metodave të thjeshta hulumtuese, personi i zakonshëm laik mund të gjejë atë çka i nevojitet, pa hasur në shumë vështirësi. Informacioni mund të ndodhë që të mos jetë gjithmonë më i miri, mirëpo së paku është diçka.

Lloji i dytë është kërkimi a hulumtimi pyetësor. Ju mund ta përdorni kutinë e web-sajtit kërkues, por aty nevojitet gjithsesi të shkruhet më shumë sesa fjalët kryesore. Në këtë pikë, ju zhvendoseni në cilinë e ekspertit, në hulumtimin e sofistikuar, të cilin çdo bibliotekar i referencave duhet domosdo ta dijë. Kjo kërkon goxha shkathtësi dhe aftësi nga bibliotekari. Këtu, ju mund të kërkoni, le të themi, çdo gjë lidhur me gasin radon që është botuar në gjashtë muajt e fundit, vetëm në Shtetet e Bashkuara, apo vetëm nga qeveria; ose për gasin radon në vendbanimet e bashkësive, e kështu me radhë. Përdorimi i burimeve të shtypura është mjaft i vështirë, mirëpo hulumtimi Online kërkon edhe më shumë aftësi.

Pika tipike shënuese në ndonjë vepër të shtypur të referencave është zakonisht (mirëpo jo gjithherë) është subjekti, autori dhe më rrallë titulli. Kjo nuk është e njëjtë në hulumtimet me kompjuterë. Këtu, ju mund të hulumtoni duke i përdorur të gjitha këto, plus opsionet e tjera. Këto opsione të tjera janë shumë të rëndësishme, ngase kompjuteri u lejon që të kërkoni një fjalë të caktuar kryesore në tekstin e një abstrakti, në titull, apo madje në të gjithë tekstin e artikullit apo të librit.

Për shembull, një njeri që bën katalog i jep artikullit vetëm një titull të subjektit rreth historisë së femrave të Romës. (Titulli i artikullit është "Nëna në Romë si Menaxhere"). Kompjuteri lejon shfrytëzuesit që ta hulumtojnë titullin, duke shënuar fjalën kryesore si "gratë", "Roma", "nëna" "menaxhere" dhe çdo fjalë tjetër të rëndësishme, e cila mund të gjendet në titull ose në ndonjë fjalë në tekstin e artikullit. Të gjitha pikat e shënimit sigurojnë që shfrytëzuesi të mos jetë i kufizuar vetëm në një titull të subjektit, sado vlerë të ketë ai, apo në emrin e autorit ose titullin. Pikat e tjera mund të jenë si gjuha, data, publikimi, e kështu me radhë. Më në fund, duhet të themi se ju mund t'i kombinoni të gjitha këto për ta

kufizuar ose për ta zgjeruar një hulumtim.

Metoda e tretë, e cila njëherësh është edhe metoda më efektive, është që të kesh URL, p.sh. adresën e web-sajtit. Kjo është e ngjashme si me kërkimin e një libri sipas emrit të autorit apo titullit. Kjo mënjanon përzierjen e titujve të subjektit dhe të referencave kryqësore. Kur është e mundshme, natyrisht, URL është hapi i parë i preferuar dhe hapi i vetëm i mundshëm për një hulumtim të suksesshëm.

Sot, të gjitha bibliotekat e mesme dhe të mëdha kanë web-sajtet e tyre me linke specifike për burimet e tjera të ngjashme Online të referencave, p.sh. URL. Këto tentojnë të jenë një përzierje e burimeve falas dhe atyre me para, të cilat zakonisht janë të listuara nën kategoritë e mëdha duke filluar nga katalogët te indekset e deri te enciklopeditë. Për shkak se këto web-sajte nuk janë vetëm specifike, mirëpo edhe specifike për faktin se përzgjedhin gjërat më të mira, të cilat i nevojiten bibliotekës. Pra, është vendi i parë, që duhet shikuar kur kemi të bëjmë me hulumtime të thjeshta. Po ashtu, është një ndihmë për kujtesën. Për shembull, Universiteti Shtetëror i Nju Jorkut në web-sajtin e bibliotekës së Albany (http://www.albany.edu/.library) liston, sipas rendit alfabetik, të gjitha indekset për të cilat ka qasje Online. Nëse ju nuk mund ta dalloni nëse është një indeks Interneti për antropologji, ju mund të ktheni këtu për një rikujtim, e po ashtu, edhe për të gjetur linkun e drejtpërdrejtë për indeksin apo shërbimet abstrakte. (Për një diskutim më të gjerë rreth bibliotekës dhe informacioneve të ngjashme për web-sajtet, shiko kapitullin "web-sajtet e bibliotekave" në këtë libër).

Hulumtimet falas dhe ato me pagesë

Përveç se janë të lehta për t'u përdorur, një përparësi tjetër e madhe e burimit të referencës, që ofrohet me para, është fakti se është shumë specifik. Ju mund të zhvendoseni prej indeksit të përgjithshëm ose enciklopedisë në fjalor specifik ose bibliografi në një web-sajt që ofrohet me para. Sikurse edhe me ato të shtypura, bibliotekari vetëm e përshtat pyetjen me një burim të mundshëm, që ofrohet dhe nuk shikon shumë në malin me materiale që ofrohen falas në Internet. Kërkon materiale rreth Pikasos? Kthe te Art Index, një indeks me para që ofrohet në Internet. Dëshironi të gjeni materiale rreth së kaluarës, përkatësisht rreth luftës Amerikano-Spanjolle? Atëherë shikoni Britannica Online – dhe në veçanti për versionet me para, të cilat kanë më shumë materiale sesa veprat që ofrohen

falas. Business Index jep informacione të menjëhershme rreth aktiviteteve të tregut të bursës në muajin e kaluar. Përgjigja mund të gjendet, po ashtu, edhe në web-sajtet që ofrohen falas, por duhet një punë më e madhe.

Natyrisht, jepen edhe mijëra web-sajte që ofrohen falas, të cilat janë po aq specifike në fushat e dhëna të subjektit, duke filluar nga moti dhe udhëtimi deri te të dhënat rreth këngëtarëve të famshëm. Shumica e tyre tentojnë të jenë të shpërndara dhe përderisa shfrytëzuesi nuk ka një URL (përsëri, vizito web-sajtin e bibliotekës për ndihmë) do t'i merrë orë të tëra për të gjetur diçka, që mund të gjendet për një minut në një burim të mirënjohur të referencave – Online apo tjetër.

Po ashtu, duhet theksuar se web-sajtet qeveritare, që ofrohen falas, janë të një vlere dhe rëndësie të njëjtë, në krahasim me shumë web-sajte komerciale. Mirëpo, prapëseprapë, këto web-sajtet përdoren më pak në rastin kur bibliotekari njeh dhe dinë shumë mundësi të tjera. Njëjtë, gazetat ofrohen Online falas, edhe pse vetëm për disa ditë apo deri në disa vjet. Mirëpo, përsëri ato zakonisht janë shumë të gjera për shumë pyetje specifike, së paku për gjërat e tjera, duke përjashtuar këtu ngjarjet aktuale. Duhet thënë se shumicës së tyre u mungon një indeksim adekuat Online ose sistemet korrigjuese (përmirësuese).

Përderisa metodat falas ose me para për përzgjedhjen e ndihmës së referencave janë të paarsyeshme, deri diku, së paku janë udhëzues të përgjithshëm për bibliotekarin e referencave. Po aq e rëndësishme është edhe njohuria rreth formave të referencave, p.sh. aftësia për ta ndarë një indeks prej një bibliografie standarde ose prej një enciklopedie. Por, pse të mundohemi me këtë? Për arsyen se kjo njohuri e bën mjaft të lehtë kombinimin apo përshtatjen e pyetjes me burimin e ngjashëm. Pa këto ndarje të informacioneve të referencave, është shumë më e vështirë për t'i gjetur përgjigjet Online, por edhe në librat e shtypur.

Kuptimi i formave të referencave, falas ose me para dhe aftësia që ta kuptosh pyetjen shpejt nga një burim specifik është shenjë e profesionalizmit. Çdo njëri mund t'i shënojë disa fjalë kryesore në sistemin e web-sajteve kërkuese dhe të bëjë diçka. Sikurse që u përmend në tekst, shumë herë, kjo nuk mjafton. Bibliotekari, sikurse edhe doktori, mekaniku dhe kuzhinieri, duhet t'i dijë veglat dhe metodat e tregtisë apo në të kundërtën do të përfundojë në një masë të madhe pyetjesh poshtëruese, pa pasur përgjigje të duhura.

Kërkimi/hulumtimi frustrues

Asgjë tjetër nuk i ilustron më mirë problemet potenciale të kërkimit/hulumtimit Online sesa përvoja e një studenti të zakonshëm. Metoda e hulumtimeve të studentit tanimë është një klishe në mesin e bibliotekarëve. Qasja standarde është ajo kur shënohet një ose dy fjalë kryesore në kutinë e kërkimit dhe shpresa për më të mirën. Kërkimi/hulumtimi fjalë për fjalë është tipik mbase në shumicën e web-sajteve të bibliotekave. Vetëm një nga nëntë shfrytëzues e merr në konsideratë përdorimin e logjikës Boolean dhe asnjë person në 1000 sosh nuk mund të gjejë përgjigje për një mëdyshje, duke përdorur të dhëna që gjenden vështirë.

Shumica e studentëve naivë ose optimistë besojnë se: (1) Interneti ose një bazë e të dhënave, e cila vizitohet përmes ekranit të kompjuterit duhet ta ketë përgjigjen patjetër. Përgjigja mund të jetë në çfarëdo pyetje duke filluar nga rruga e një projektligji në Kongres deri te "The OldBill", një grup anglez muzikor; (2) Metoda e zakonshme e hulumtimit/kërkimit është shënimi i fjalës kryesore. Në këtë rast, shënohet "projektligj". Përgjigja shfaqet në ekran; (3) Shumë rrallë lexohet citimi. Studenti printon ose shkarkon pesë apo dhjetë përgjigjet e para dhe e lë përmbajtjen në atë se gjithçka është në rregull.

Këtu tregohet përvoja e një nëne, e cila përdori dy web-sajte kërkuese: "Unë bëra kërkim në të dy web-sajtet dhe provova që t'i japë përgjigje pyetjes së vajzës sime 17-vjeçare rreth jetës mesatare të maces shtëpiake dhe rezultatet tregojnë që teknologjisë i duhet edhe shumë për të përparuar. Mua m'u deshën, diku rreth 10 minuta, për të klikuar në rezultatet e hulumtimet dhe për të mësuar se përgjigja është se macja jeton mesatarisht diku rreth 15 vjet (bazuar në një burim, i cili e identifikon vetveten vetëm si Zonja Mace. Ajo postoi në porosinë e saj buletinin e shëndetit të maces të Acme Pet)".[19]

Frustrimi i mamasë është i zakonshëm. Këtu, për shembull, jepet një studim i ekspertëve rreth asaj se si një shfrytëzues tipik kërkon të dhëna në Internet: Praktikisht, korrigjimi i informacioneve në Internet bëhet nga fjala kryesore. Shfrytëzuesi shënon (shkruan) një apo dy fjalë kryesore në kutinë kërkuese, e cila më pas i tregon të gjitha ato burime, që i përmbajnë ato fjalë. Megjithatë, kjo qasje mund ta përmbysë shfrytëzuesin me

[19] Michelle Slatalla, "Digital Bread Crumbs…" The New York Times, 2 korrik, 1998, f. G8.

burime të shumta dhe jo relevante. Le të mendojmë se, për shembull, ne jemi të interesuar në disa informata themelore rreth Grand Canyon (Grykës së Madhe, SHBA)- p.sh. sa e thellë është jo. Nëse shënojmë "Grand Canyon" në web-sajten kërkuese, AltaVista, atëherë ajo do të tregojë mëse 20 000 rezultate. Nëntë rezultatet e para ishin:

1. Web-sajti për një hotel afër Grand Canyon
2. Koleksion i fotografive të Grand Canyon
3. Informacione rreth Arizonës "Shteti i Grand Canyon"
4. web-sajte për një hotel afër Grand Canyon
5. Tregim narrativ rreth një udhëtimi nëpër Grand Canyon
6. Reklama për një përmbajtje thurjesh kryqësore me një pamje nga Grand Canyon
7. Udhëzues për udhëtim dhe dhoma me qira për Grand Canyon dhe të dhënat statistikore të Grand Canyon
8. Llogaria e një udhëtimi përgjatë Grand Canyon
9. Letër faktesh rreth Grand Canyon

Nga nëntë rezultatet e para, vetëm rezultati i shtatë dhe ai i nëntë duket se janë relevantë dhe lidhen me pyetjen tonë.[20]

Janë dy përgjigje për këtë situatë:

1. Bibliotekarët, sikurse që u tha shumë herë përgjatë këtij libri, duhet të jenë ndërmjetësues në mes të individëve dhe Internetit. Kjo duket se është veçanërisht e vërtetë për njerëzit që e kuptojnë vetëm hulumtimin "buckshot" për informata;

2. Për shkakun se nuk ka fakte nëse personi mesatar (i zakonshëm) do ta ndryshojë metodën e kërkimit, fjalë për fjalë, ata që merren me të dhënat komerciale janë duke punuar shumë që t'i përmirësojnë teknikat dhe metodat e kërkimit/hulumtimit. Asgjë nuk do të ndodhë së paku për disa dekada dhe asgjë nuk do ta zëvendësojë njohurinë dhe aftësitë intuitive të hulumtuesve të trajnuar. Janë shumë arsye për këtë, mirëpo në fakt prapë kemi të bëjmë me atë historinë e vjetër – shumë informacione. web-sajti kërkuese do ta ketë shumë të vështirë për ta gjetur një metodë, me të cilën do t'i klasifikojë faktet e reja, kur një numër i madh i të dhënave do të futej Online.

[20] OCLC Newsletter, nëntor/dhjetor, 1997, f. 22.

Hyn te bibliotekari

Në një aspekt, hulumtimi i studentit është i kompletuar dhe zakonisht bëhet pa ndihmën e bibliotekarit. Pyetja këtu është nëse hulumtimi është apo jo një përfaqësim i thjeshtë i një hulumtimi. Kualiteti dhe rezultatet e kërkimit e çojnë hulumtuesin/kërkuesin në dy konkluzione: (a) ka diçka më shumë në informata sesa njerëzit paramendojnë dhe mendojnë; (b) nëse njerëzit dëshirojnë që me të vërtetë të jenë të informuar, atyre iu duhet më shumë ndihmë nga bibliotekari. Kjo ndihmë kërkon domosdoshmërish një intervistë dhe një plan të detajuar të kërkimit/hulumtimit, e jo thjeshtë një njeri, i cili e drejton thjeshtë studentin te terminalet e kompjuterit. Nëse bibliotekari dëshiron të vazhdojë punën si profesionist, atëherë intervista dhe hulumtimi/kërkimi duhet që absolutisht të mësohen dhe të perfeksionohen mirë nga ta, të kuptohen dhe mbi të gjitha, t'i përdorin ato në shërbimet e tyre nga dita në ditë.

Kur merret vendimi në disa biblioteka për të bërë një hulumtim Online serioz dhe të detajuar, bibliotekarët i pyesin individët që ta plotësojnë një formular kualifikues, në të cilin edhe shënohet pyetja. Në disa raste, kjo bëhet shumë thjeshtë, mirëpo në rastet e tjera sugjerohet që shfrytëzuesi të shkruajë një ese të shkurtër rreth pyetjes së shtruar. Për shembull, në një model të kësaj forme, kërkesa është e tillë: emri dhe adresa e shfrytëzuesit, titulli dhe qëllimi i kërkimit/hulumtimit, termat dhe sinonimet që mund të përdoren në lidhje me temën në fjalë, listimi i emrave të famshëm në atë fushë, dhe disa herë, një shënim rreth çmimit më të lartë të mundshëm.

Futja në praktikë e formës para-intervistës dhe hulumtimit është mbase universale për shkakun e thjeshtë se kursen kohë. Forma e detyron shfrytëzuesin që ta marrë në konsideratë pyetjen dhe të jetë i saktë në formulimin e saj. Një formë e ngjashme për intervista të tjera të referencave domosdo do t'i përmirësonte të gjitha llojet e kërkimeve/hulumtimeve. Forma, po ashtu shërben si një pikënisje në formulimin dhe në zhvillimin e negociatave rreth fjalorit në atë se bibliotekari dhe padroni punojnë së bashku.

Disa herë, një "ekspert" i hulumtim/kërkimit do t'i prezantojë bibliotekarit një listë me fjalë kryesore (keywords) e jo tregimin e pritur "narrative". Problemi me listën e fjalëve kryesore qëndron në faktin se këto fjalë mund të mos jenë të pranueshme për sistemin. Shumë shpesh, ata nuk e marrin në konsiderim veçoritë interaktive të hulumtimit të kompjuterit.

Gjithmonë është më së miri që të dihet qartë se çka kërkohet, e jo thjeshtë ajo se çka shfrytëzuesi sheh si, kushtet e mëdha apo të vogla. Në të njëjtën kohë, dikush nuk dëshiron që të mos e pranoj këtë lloj ndihme. Më së miri është që shfrytëzuesi të jetë i interesuar sesa një shfrytëzues që shpreson se hulumtuesi/kërkuesi do t'i bëjë të gjitha.

Hulumtimi/kërkimi Online përmirësohet ndjeshëm – në shkurtimin e kohës që nevojitet për kërkim – kur gjendet një seksion i ndarë dhe i qetë për intervistë dhe për vetë hulumtimin. Edhe pse hulumtimi i referencave të gatshme mund të mos marrë më shumë se një apo dy minuta kohë dhe mund të bëhet në një situatë tipike kur kemi referenca, një kërkesë "në detaje" Online mund të marrë prej 50 deri 70 minuta. Ju mund të imagjinoni se sa më gjatë mund të zgjasë kjo, kur bëhet në mes të një kaosi normal në tavolinën e referencave.

Shfrytëzuesi i zakonshëm do të përplaset, shumë e shumë herë. Çka mund të jetë edhe më e keqe është ajo se shfrytëzuesi i njëjtë do të largohet i bindur se nuk ka pasur aksident dhe se vozitja për të gjetur informata ka qenë plotësisht e suksesshme. Ekspertët dhe njerëzit që janë aq të mençur sa ta kuptojnë kompleksitetin e informatave, zakonisht e dëshirojnë ndihmën e bibliotekarit. Për më shumë, atyre mund t'iu nevojitet ndihma, jo vetëm rreth bazave të të dhënave, por edhe me shumë teknika dhe metoda që përdoren.

Ndoshta, e gjithë kjo që do ta zgjidhë vetveten, kur masat e informatave do ta dërrmojnë, madje edhe shfrytëzuesin e papërvojë me besimin më të madh në vete. Mirëpo, për tani, bibliotekari i referencave duhet të shërbejë si një ndërmjetësues.

Teknikat e kërkimit

Kur bibliotekarët e referencave flasin rreth drejtimit të web-sajteve dhe Internetit, ata i kanë dy apo tri shtigje, që duhet t'i ndjekin. E para, e cila përdoret më së shumti nga ata, për abonimet me pagesë të bazave me të dhëna, p.sh. burimet që janë prodhuar në mënyrë komerciale për përfitime dhe profit. Shembujt të tillë janë indekset prej UMI, EBSCO e deri te H.W. Wilson Company. Sikurse që u tha përgjatë këtij libri, këto indekse janë më të organizuara në kuptimin se kanë informacione më aktuale dhe më të besueshme sesa web-sajtet që ofrohen falas. Së dyti, metoda që përdoret më së shumti për kërkesat rreth referencave të gatshme, bibliotekarët vizitojnë vendet dhe faqet e ngjashme, të cilat vizitohen

nga personat laikë – miliona web-sajte, të cilat ofrojnë të dhëna falas rreth çdo gjëje, duke filluar nga kodrat deri te bibliotekarët e gjallë. Dhe e treta, bibliotekarët mund thjeshtë të heqin dorë nga web-sajtet dhe t'i përdorin burimet më të njohura të shtypura. Vendimi më i vonshëm mund të dukët mjaft i thjeshtë, mirëpo prapëseprapë është e pazakonshme për personin e zakonshëm laik, që të marrë në konsideratë një alternativë tjetër përveç Internetit – një gabim i madh në aspektin e kohës dhe frustrimit.

Nëse bibliotekari e njeh teknologjinë që përdoret, e cila mund të jetë e pakapshme edhe në ditët e sotme, hulumtimi/kërkimi mund të fillojë... gjithmonë i ndërtuar mbi përvojën dhe njohurinë, sikurse që u sugjerua në faqet e lartpërmendura të këtij kapitulli.

Ekspertja e hulumtimit komercial Mary McCarty, sugjeron atë çka ajo e quan qasja 5-4-3-2-1 në hulumtimin Online:

> (5) apliko në burimet nga Interneti, të pesë kriteret që përdoren për vlerësimin e burimeve të shtypura (aktualiteti, autoriteti, fusha e veprimit/audienca, toni dhe sa është e lehtë për t'u përdorur); (4) provo dhe përdor së paku katër web-sajte kërkuese për secilin hulumtim/kërkim për shkak se web-sajtet kërkuese më të mira e mbulojnë pak njëra tjetrën dhe secila nga ato përfshin vetëm një përqindje të vogël të numrit total të web-sajteve; (3) "ndaje në treshe- përdor tri burime për t'i verifikuar informacionet e dyshimta nga Interneti" dhe përdor web-sajtet në Internet, të krijuara nga bibliotekarët për të marrë informacione me kualitet më të lartë; (2) çmimi dhe shpejtësia janë dy faktorët më të rëndësishëm për punëdhënësit dhe (1) gjithmonë ktheu prapa, në një burim origjinal, nëse burimi nga Interneti i referohet një informacioni tjetër.[21]

Mjetet e ekspertëve për hulumtim/kërkim

Hulumtimet e detajuara Online kanë qasje individuale, mirëpo shumica pajtohen se janë disa metoda, të cilat e shpejtojnë dhe e ulin çmimin e një hulumtimi/kërkimi. Përderisa këto metoda i ndjekin hapat, që u theksuan pak më parë, ato mund ta bëjnë këtë në metodën e shkurtimit.

Në këtë pikë, hulumtuesit/kërkuesit i kthehen kompjuterit për atë që njihet si "hulumtimi i shpejtë dhe i pistë".

[21] "Shaping the Web", Library Journal, 1 mars, 1999, f. 36. (McCarty është cituar nga Carol Tenopir në kolumnen e saj "Online Databases").

Kompozo një hulumtim "të shpejtë dhe të pistë" me disa terma, me operatorët logjikë dhe jo me më shumë se me një operator të afërsisë. Ky format i "hulumtim të shpejtë" ka qenë i përdorshëm për ndërmjetësit dhe ofron përparësinë e përdorimit të një numri të vogël të termave dhe operatorëve. Është me rëndësi që shfrytëzuesi/hulumtuesi/kërkuesi ta kuptojë se ky është një hulumtim provues. Ai/ajo duhet t'i përdorë informatat që ai/ajo i gjen, që ta modifikojë hulumtimin në mënyrë efektive.

Vëri rezultatet në formatin provues për vlerësim. Shumica e sistemeve të bazave të të dhënave ofrojnë një format që ofron një far lloj informate vlerësueses (titujt, paragrafët e parë, termat e indeksit). Shfrytëzuesit duhet të udhëzohen se si ta përdorin këtë informacion, në mënyrë që të vendosin dhe të shohin se si po u shkon puna. Po ashtu, ata duhet të mësohen edhe se si t'i modifikojnë hulumtimet e tyre.

Modifiko hulumtimin me një apo dy ndryshime të thjeshta. Kufizo modifikimet në këto gjëra: mos shto terma për ta përfaqësuar një koncept, mos përdor një format tjetër për konceptin (frazat e konceptit), ose mos elimino a kryqëzo konceptet. Mund të ketë nevojë për ndryshime të tjera, mirëpo këto tri ndryshime janë të mjaftueshme për shfrytëzuesin që në fillim atë ta mbajë nën kontroll.

Printo rezultatet finale në formatin që i përmban të gjitha fushat e nevojshme.

Shumica e ekspertëve e përdorin logjikën Boolean, mirëpo ka dallime në atë se si e përdorin. Dy qasjet kryesore: (1) në vend se të përdorni "edhe", përdor shenjën +; (2) fute edhe fjalën "afër", p.sh. shtëpia afër apartamentit. Kjo duhet të përdoret në web-sajtet kërkuese, siç janë AltaVista në vend të fjalës "dhe" në mes të dy fjalëve kryesore; (3) përdor citime të dyfishta për ta kufizuar hulumtimin vetëm në një subjekt të caktuar ose një emër, p.sh. "Napoleoni" apo "Revolucioni Francez".

Një mendim interesant dhe i rëndësishëm për hulumtimet në Internet është dhënë nga Laura Cohen në veprën e saj "këshilla të mira për hulumtime të qeta në Internet": Ajo i këshillon bibliotekarët që t'i "lexojnë fajllat ndihmës, që gjithmonë ofrohen në shumicën e web-sajteve kërkuese. Po ashtu, "web-sajtet kërkuese shpesh përdorin rregulla të ndryshme për shumë gjëra. Kupto dallimin dhe përdorimin e paravijës, e cila është e duhur për një pyetje".[22]

Konfuzioni rritet kur dikush zhvendoset nga një udhëzues në një kom-

[22] Laura Cohen, "Searching for Quality..." Choice, Botim shtesë, 1998, f. 21. Kjo përmbledhje e rregullave dhe sugjerimeve është e një vlere të madhe për bibliotekistët e referencave.

pjuter, që ndihmon në hulumtim. Problemet e shpeshta: (1) titujt e subjekteve mund të mos jenë të ngjashme në versionin e shtypur dhe në versionin e kompjuterit; (2) datat e mbulimit ndryshojnë, me datën e versionit të shtypur shumë të vjetër sesa ai i bazës së të dhënave në kompjuter. Shumica e bazave të të dhënave, për shembull, shkojnë pas në kohë vetëm deri në mesin e viteve '80-të, edhe pse indekset e shtypura mund të shkojnë pas në kohë 20 vjet më shumë sesa kompjuteri; (3) hulumtimi/kërkimi Online ka gjasa të ketë dhe të ofrojë më shumë materiale aktuale sesa burimet e shtypura; (4) në kompjuter ofrohet një numër i strategjive të hulumtimit/kërkimit, mirëpo me veprat e shtypura hulumtimi është i mbyllur vetëm në një kohë specifike, në autorin, ose në subjektin.

Cili lloj i hulumtimit/kërkimit ofron rezultatet më të mira për shfrytëzuesin? Ka shumë gjëra për këtë, që e bëjnë të vështirë arritjen e një konkluzioni të përgjithshëm. E para, aftësia e personit të referencave është një faktor shumë i rëndësishëm. Një bibliotekar, ekspert i referencave, do të jetë shumë më i mirë, sesa një hulumtues i ri i kompjuterit.

Logjika Boolean

Çelësi i suksesit në hulumtimet/kërkimet Online është Logjika Boolean. Kjo logjikë lejon shfrytëzuesin që të kombinojë fjalë dhe fraza, në mënyrë që ta kufizojë apo ta zgjerojë hulumtimin. Logjika Boolean është sinonim për metodat digjitale të sofistikuara të hulumtimit. Normalisht, është pjesë e gati të gjitha metodave të hulumtimit Online dhe është e ndërtuar brenda web-sajtit kërkues. Megjithatë, nuk është domosdo pjesë e bazave të të dhënave të referencave që ofrohen Online dhe falas – dhe ju tani duhet ta kuptoni efikasitetin e saj.

Metoda primare është mbledhja, së bashku, e një grupi fjalësh në një mënyrë që ose e zgjeron ose e kufizon hulumtimin. Kjo bëhet nga operatorët:

1. "Dhe" i lidh dy ose më shumë fjalë, të cilat duhet patjetër që të jenë më pas në rezultatet. Shembull: Tom DHE Jerry. Kjo e kufizon hulumtimin në atë aspekt, që të dy fjalët duhet të jenë në materiale përpara se ato të shfaqen në ekran. Një komandë e njëjtë është edhe shenja "+". (Shënim: shumica e web-sajteve kërkuese tanimë automatikisht e përfshijnë fjalën "dhe" në kërkimet e tyre, kështu që nuk është e nevojshme për ta përdorur këtë komandë);

2. "Apo" e kufizon hulumtimin, duke i treguar kompjuterit se dëshiron çdo gjë që e ka ose temën X ose Y. Shembull: Tom APO Jerry. Kjo e

zgjeron hulumtimin për shkak se hulumtuesi po kërkon çdo gjë që ka të bëjë ose me Tomin ose me Xherin, mirëpo jo me të dy së bashku;

3. "E Jo" është një operator më specifik. I përjashton fjalët nga rezultati i kërkimit. Shembull: Tom E JO Cat. Rezultati është i qartë. Në hulumtimin/kërkimin me kompjuter, ju mund të përdorni shenjën "-" në vend të asaj "e jo";

4. "" Thonjëzat e përmbyllin fjalën kur dikush dëshiron të gjejë një frazë, emër, apo objekt specifik. Shembull: "Enciklopedia Britannica", e cila e kufizon hulumtimin në vetëm këtë përmbledhje e jo në çdo faqe në Internet, që ka të bëjë me "enciklopedi"apo me "Britannica". Rezultatet nuk janë perfekte, por shumë më të mira sesa në rastin kur thonjëzat nuk përdoren fare.

Në hulumtimet e sofistikuara, bibliotekari mund t'i bëjë bashkë një grup fjalësh apo operatorësh, gjë që e kufizon apo e zgjeron hulumtimin, por në secilin rast e bën hulumtimin shumë më specifik: Shembull: "Tom DHE Jerry JO Pije JO Mace".

Sistemi ideal duhet ta lejojë shfrytëzuesin që (1) ta shënojë komandën në çdo kohë; (2) t'i korrigjojë të dhënat sipas datës, gjuhës, lokacionit gjeografik, ose kualifikuesve të tjerë; (3) të ketë përdorim të pakufizuar të operatorëve të logjikës Boolean dhe të një numri të gjërave hulumtuese; (4) t'i lidhë fjalët dhe thëniet nga hulumtimi; (5) ta vë në pyetje materialin që është në bazën e të dhënave, duke shënuar terma që janë natyrale dhe të mundshme dhe (6) të këtë në përdorim një thesar apo fjalor.

Metodat e hulumtimit/kërkimit janë të rëndësishme për shkak se shumica e personave laikë, të cilët përdorin burime elektronike preferojnë rrugë të thjeshta dhe të drejtpërdrejta. Në anën tjetër, bibliotekarët preferojnë rrugë më të sofistikuara, si ato që ofrohen nga logjika Boolean dhe të ngjashme. Në çdo rast, është tejet e rëndësishme që të vlerësohet një indeks Online në atë se a lejon përdorimin e logjikës Boolean apo a është më i thjeshtë në qasjet e tij.

ARDHMËRIA E SHËRBIMEVE TË REFERENCAVE

Bibliotekarët e referencave bëjnë një sërë gjërash përveç mësimit dhe përvetësimit të plotë të formateve elektronike. Ata janë ekspertë në mbledhjen e burimeve të informatave; e po ashtu janë po aq të aftë dhe e dinë se çka duhet hequr nga koleksioni i mbledhur me materiale. Prej ditës në ditë, ata marrin pjesë në mbledhje të shumta dhe e luajnë rolin e administratorëve. Këtu hyjnë edhe një mijë gjëra të tjera të këtij profe-

sioni. Rregulli i printerit që është afër terminalit të kompjuterit apo vendosja e më shumë letrave në makinën fotokopjuese mund të marrë po aq kohë sa edhe pjesëmarrja në takime. Ka raste kur bibliotekarët hamenden dhe mendojnë se pse është e nevojshme përgjigja në telefon kur janë më shumë se 10 njerëz duke pritur për shërbim.

Shko në ndonjë bibliotekë publike, akademike, apo shkollore dhe për 5 apo 10 minuta shiko se çka ndodh në seksionin e referencave. Pashmangshëm, bibliotekari nuk u përgjigjet vetëm pyetjeve standarde, mirëpo shpenzon një pjesë të kohës së tij duke i mësuar njerëzit se si ta përdorin hulumtimin elektronik.

Është një nocion, mendim i ushqyer nga reklamuesit dhe nga idetë optimiste të së ardhmes, rreth asaj se nuk do të shkojë edhe shumë gjatë kur Joe dhe shokët e tij do ta kundërshtojnë kompjuterin, p.sh. Hal (nga filmi "2001" i Kubrick) pa Halin, që është ndërtuar dhe krijuar nën frikën vrasëse. Vetëm shkruaj një pyetje dhe Hal do t'u përgjigjet shpejt dhe saktë. Përgjigjja do të jepet nga një zë i qetë. Jo ngjashëm si disa bibliotekarë, batakçi, të referencave, ndryshimet e zërit nuk do të tingëllojnë neveritëse për injorancën e njeriut. Deri më tani, bibliotekar të referencave, Tungjatjeta Hal.

Përfundimisht, kjo mund të ndodhë, apo si thotë Dorothy Parker: "Ohh, jeta është një rreth i mrekullueshëm i këngës, një potpuri e një paranoje ekstreme; dhe dashuria është një gjë që kurrë nuk mund të jetë e gabuar; dhe Unë jam Marie nga Rumania". Dhoma e referencave rreth kompjuterëve është e mbushur me Mbretër dhe Mbretëresha të Rumanisë, të cilët besojnë se duke shënuar një apo dy fjalë në bazën elektronike të të dhënave, përgjigjja në pyetjen e tyre do të shfaqet në ekran, pa marrë parasysh nëse pyetja ka të bëjë me popullatën e Nju Jorkut ose për kuptimin e jetës. Në mungesë të përvojës, i njëjti teveqel/teveqele pranon se përgjigjja nuk është gjithmonë e saktë, madje as nuk është afër. Mirëpo, megjithatë, kompjuterit duhet t'i jepet kohë.

Në të njëjtën kohë, përderisa prisni, ka të ngjarë që ju bibliotekarë i referencave do të jeni edhe për disa minuta. Kështu që, studimi i burimeve të referencave nga ana juaj nuk është humbje kohe. Hal është atje në hapësirë – me Mbretëreshën e Rumanisë.

Imagjinata dhe dija për nevojën e publikut do ta bëjë të nevojshme bibliotekarin e referencave edhe për disa gjenerata në të ardhmen. Nuk mjafton që të keni vetëm një depo, ku i ruani informacionet e shtypura dhe ato digjitale. Është e nevojshme që bibliotekari te jetë në lidhje me personin që ka pyetje, pa marrë parasysh nëse ai person gjendet në shtëpi apo në bibli-

otekë. Shembuj: (1) ofro përgjigje për pyetjet përmes e-mailit apo/me faks. Në të vërtetë, këto mund të jenë pyetje e referencave rreth asaj se si të gjenden materialet në Internet; (2) ofro materialet nga web-sajti e bibliotekës me linket për informatat me vlerë dhe me shënimet se çka mund të përdoret në shtëpi e çka në bibliotekë; (3) ofro metoda të parashtrimit të pyetjeve për shfrytëzuesin e indeksit digjital. Në përfundim të hulumtimit, pyete nëse hulumtimi ka qenë një sukses apo nëse shfrytëzuesit i nevojitet ndihmë; (4) ofro shërbim Online të referencave një në një si p.sh. bisedat në telefon; (5) modifiko shërbimin e telefonit, kështu që ky shërbim të jetë më shumë sesa thjeshtë dhënie e përgjigjeve në disa pyetje rreth referencave të gatshme.

> Po ashtu, jepen dhe tregohen edhe ide të tjera, të cilat praktikohen dhe përdoren nga bibliotekarët. Këto shërbime bëjnë që bibliotekarët e referencave të jenë disa hapa përpara nevojave të shfrytëzuesve. Pika fillestare, dhe e cila duhet të theksohet shumë e shumë herë nga bibliotekarët, është ajo se ata i ofrojnë shfrytëzuesit informata personale dhe profesionale pa para. Asnjë burim tjetër informacioni (duke përjashtuar këtu disa burime qeveritare dhe kapitaliste, të cilat së shpejti pritet të ofrohen për shfrytëzuesin me para) nuk e bën këtë. Informacioni më i miri, i cili ofrohet falas ka shumë të ngjarë, që të pëlqehet – dhe t'i influencojë taksapaguesit në kohën e buxhetit.[23]

Ardhmëria e Internetit[24]

Është viti 2020. Çfarë vendi do ta zënë kompjuterët në botën post-milenium të referencave?

---

[23] Pelegrinët, të cilët janë në përkrahje të kompjuterëve, janë pak optimistë rreth së ardhmes së bibliotekistëve të referencave. Në fakt, ata duket sikurse gëzohen me atë se këta bibliotekistë mund të zhduken pasi vendin e tyre mund ta zënë bazat digjitale të të dhënave. Duke bërë thirrje për më shumë "zbulime" të qasjeve të shërbimeve, këto bibliotekistë sugjerojnë që biblioteka, nëse nuk ka mbaruar, është para një ndryshimi drastik dhe kështu nuk i nevojiten më shërbimet tradicionale të referencave. Nëse marrim parasysh një periudhë kohore prej disa dhjetëra vjetësh, atëherë kjo mund të duket e saktë, mirëpo madje edhe ky duket bast i vështirë. Për qasje më tipike dhe të ndjeshme, shih: Gail Schlachter, "Clinging to Traditional Reference Services", Reference & User Services Quarterly, Pranverë 2000, f. 223-228. Michael Schuyler, "Prognostications on Technology Unbound, ose The Library to Come", Computers in Libraries, maj 1999, f. 30.

[24] Cecilia Preston, "Internet 2 and the Next Generation Internet: A Realistic Assessment", Searcher, shkurt, 1999, f. 66+. Një sqarim i qartë i zhvillimit të Internetit të ri dhe shanset e tij të mbijetimit, duke mos lënë anash as përdorimin e tij të mundshëm në biblioteka. Po ashtu, shiko edhe: Carol Tenopir, "Where Does Online Go from Here"? Library Journal, dhjetor, 1999, f. 47-50.

Jepen përgjigje të ndryshme rreth kësaj pyetje. Ka gjasa që të gjitha të dalin të pasakta. Megjithatë, është kënaqësi që t'i shohësh gëzimet dhe hidhërimet:

1. Të dhënat në Internet, apo disa ofrues të tjerë të paparashikuar të informatave, përfshijnë shumicën e përgjithshme të përvojës njerëzore në këtë planet, dijen kolektive nga 5 000 vjet të historisë njerëzore;

2. Tani, më shumë njerëz kanë qasje në informacionet elektronike sesa në telefona. Përdorimi i Internetit është përhapur në gjithë botën dhe është i ndarë në mënyrë të barabartë në mes të njerëzve;

3. Teknologjia e ka zvogëluar madhësinë e komponentëve të mikroçipit, kështu që tani është e mundshme të mendohet rreth krijimit të robotëve, të cilët kanë vetëdije, e kuptojnë dijen njerëzore dhe, po ashtu, mund t'i dërgojnë të gjitha informacionet e njohura botërisht;

4. Internet 2 është një edicion shumë më i avancuar sesa rrjeti i vjetër. I supozuar si 1 000 herë më i shpejtë se versioni i vjetër, thuhet se e gjithë përmbajtja nga Enciklopedia Britannica mund të dërgohet në mënyrë elektronike për një sekondë të vetëm. Ky sistem është paraparë që të fillojë funksionimin nga mesi i vitit 2000. Fillimisht, është financuar nga Departamenti i Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

5. Posta elektronike (e-mail), që është një nga veçoritë më të popullarizuara në kompjuterin e ditëve të sotme, mbetet i njëjti. Dallimi: Ju do të mund t'i paguani fakturat duke e futur kredit kartën tuaj në kompjuter. I njëjti kanal mund të përdoret për blerje në një shtëpi të mallrave, ku fotografitë e xhemperëve deri te orët e dorës tregohen, e po ashtu, edhe mund të porositen aty për aty.

Sugjerime për të lexuar

Borgman, Christine, "What are Digital Libraries? Comparing the Visions". Information Processing & Management, vëllimi 35, nr. 3. 1999, f. 227-243. Autori shqyrton definicionet e ndryshme të "bibliotekës digjitale" dhe shpjegon se pse ka shumë dallim në mes të definicionit dhe përmbajtjes së një biblioteke. Përfundimi është i qartë – bibliotekat, që janë më shumë të fokusuara në librat e shkruar dalëngadalë do të zëvendësohen me ato digjitale.

Brandt, D. Scott, "Deconstructing Internet Searching", Online & CD-ROM Review, vëllimi 23. nr. 4, 1999, f. 206-207. Një qasje thelbësore në kuptimin e "idesë së madhe prapa korrigjimeve informative". Në disa faqe, autori jep disa këshilla praktike rreth hulumtimit/kërkimit Online- për personat laikë dhe për bibliotekarët.

Brandt, D. Scott, "Do You Have an Ear for Searching", Computers in Libraries, Maj, 1999, f. 42-44. Një arsyetim rreth qasjeve të ndryshme në hulumtime. "Nëse dikush është hulumtues/kërkues më i ndryshëm sesa ti dhe unë, kjo nuk do të thotë se ai/ajo është një kandidat për t'u korrigjuar ose për ndryshim terapie". Gjatë librit, autori jep disa këshilla praktike rreth artit.

Chun, Tham Yoke, "Worldwide Web Robots: An Overview", Online & CD-ROM Review, vëllimi 23. nr. 3, 1999, f. 135-142. Rreth asaj se sa mirë funksionojnë robotët e web-sajteve? Autori fokusohet më shumë në AltaVista dhe Excite për ta gjetur përgjigjen. Një diskutim i plotë dhe i lehtë për t'u kuptuar rreth një teme, që në disa raste është shumë e komplikuar.

Fichter, Darlene, "Search Master: A New Role for Information Professionals", Online, Mars/Prill 2000, f. 76-78. Duke sqaruar idenë që shumica e njerëzve besojnë se të gjitha përgjigjet mund të gjenden në terminalin e kompjuterit, autori sugjeron që bibliotekari duhet të zhvendoset dhe të kalojë në rolin e "hulumtuesit të zot". Shumë shkurtë, kjo ka të bëjë me kuptimin e web-sajteve kërkuese, shfrytëzuesve dhe si të arrihet ajo pika, ku që të dy do të jenë të kënaqur me përgjigjet. Dikush mund të ketë ankesa rreth terminologjisë, mirëpo argumenti rreth nevojës së zotërimit të hulumtimit/kërkimit Online është shumë bindës.

Holland, William, Teaching the Internet to Library Staff and Users. Nju Jork: Neal-Schuman, 1999. Kjo është një seri e planeve rreth mbledhjeve të punës për trajnimin e stafit të bibliotekarëve dhe po ashtu të shfrytëzuesve. Sesionet që zgjasin nga 60 deri 90 minuta janë të fokusuara në mbulimin e çështjeve kryesore. Organizmi i një hapjeje të tillë të shpejtë është shumë e rëndësishme – dhe këtu është edhe suksesi. Në radhë të parë, ajo i kushtohet bibliotekarëve që merren me fazat e hershme të programeve trajnuese në Internet. Shënim: Autori është një bibliotekar i trajnuar në stafin e Microsoft-it.

Jasco, Peter, "Savvy Searching Starts With Browsing", Online & CD-ROM Review, vëllimi 23. nr. 3, 1999, f. 169-172. Këshilla rreth asaj

se si të bëhet kërkimi, i cili bazohet në radhë të parë në shfletimin e "indekseve në mënyrë që të shtjellohen variacionet në drejtshkrimin e termave të hulumtimit/kërkimit". Jepen indikacionet përgjatë librit se si duhet manovruar me shkurtesat në hulumtime.

Jasco, Peter, "Savvy Searching", Online & CD-ROM Review, botime të ndryshme. Kjo është një kolumnë e rregullt dhe një nga më të mirat nga anëtari i këshillit arsimor të Universitetit të Havait. Këshillat që jepen këtu kuptohen lehtë, përderisa në të njëjtën kohë jepen edhe shembuj. Rekomandohet shumë si për fillestarët ashtu edhe për ekspertët.

Jansen, Bernard et al., "Real Life, Real Users, and Real Needs; A Study and Analysis of User Queries on the Web", Information Processing & Management, nr. 36, viti 2000, f. 207-227. Autorët analizojnë trungun e disa transaksioneve që janë marrë nga 51 473 kërkesave, të cilat janë shtruar nga 18 113 shfrytëzues në një nga shërbimet më të mëdha të hulumtimit/kërkimit në Internet. Ata tregojnë hapat e shumtë dhe të ndryshëm që duhet ndërmarrë në pastrimin e hulumtimit e po ashtu edhe atë se çka çon në sukses dhe çka në dështim. Përfundimi kryesor: Ka nevojë që të studiohet më shumë rreth asaj se si njerëzit (dhe bibliotekarët) kërkojnë informacione në Internet.

Kennedy, L. et al., "The False Focus on Online Searching", Reference & User Services Quarterly, Pranverë, 1999, f. 1-12. Duke sqaruar një rast specifik të hulumtimit të materialit, autori shpjegon fillimet e gabueshme dhe si ato mund të shmangen në gati çdo hulumtim në Internet. Edhe pse një teknike e thjeshtë, ajo ka një vlerë të madhe për çdo njeri, i cili nuk ka më shumë përvojë në hulumtimet në Internet sesa "një përvojë disa ditëshe".

Kennedy, Lynn, et al., "The False Focus on Online Searching", Reference & User Services Quarterly, Pranverë, 1999, f. 267-273. Pse aq shumë studentë dhe persona laikë kanë vështirësi me hulumtimet Online? Kennedy dhe ekspertët e tjerë të hulumtimit shpjegojnë se kjo është çështje e "fokusimit të gabuar" që do të thotë se shfrytëzuesi mesatar dëshiron ta gjejë përgjigjen shpejtë dhe në anën tjetër, nuk dëshiron që t'i përshkojë hapat logjikë dhe ndonjëherë të mërzitshëm, por të nevojshëm të hulumtimit, të cilët janë shumë të njohur për bibliotekarët.

Klopper, Susan, "Finding a New Search Rhythm", Online, Shtator/Tetor, 1999, f. 38-42. Duke përdorur metaforën e hapave të rinj dhe të vjetër të vallëzimit, autori tregon të mirat dhe të metat ose problemet e

hulumtimit në bazat tradicionale të të dhënave dhe në anën tjetër të hulumtimeve në Internet. Zhvendosja dhe ndryshimi në hulumtimet Online përshëndetet dhe përkrahet këtu... por me disa rezervime.

Knopper, Steve "The Early Bird Catches the Word", Yahoo! Internet Life, Shkurt 2000, f. 128-132. Këtu ekzaminohet e tërë pyetja që ka të bëjë me emrin e regjistrimit të domenit në Internet, posaçërisht në pikëpamjen e legjislacionit të vitit 1999-2000. Vëmendja kryesore është në "cybersquatting" dhe në njerëzit që regjistrojnë adresa Interneti dhe emra duke menduar dhe shpresuar për t'i shitur ato më vonë dhe për të fituar para.

Latham, Joyce, "The World Online: IT Skills for the Practical Professional", *American Libraries*, mars 2000, f. 40-42. Nuk është e mjaftueshme t'i kuptosh vetëm burimet e referencave, por edhe çdo gjë që prej përdorimit të adresës elektronike deri te shfletuesit në Internet, që janë të domosdoshëm për një bibliotekar modern të referencave. "Ne duhet t'i përvetësojmë disa metoda dhe teknika të shkrimit, të cilat qëndrojnë... ndërmjet nesh dhe pamjes së profesionit tonë". Drejtori i automacionit në Bibliotekën Publike të Çikagos shpjegon se si duhet bërë kjo.

Lawrence, John, dhe *Mary Ross*, "Internet Reference: Boon or Bane"? American Libraries, maj, 1999, f. 74-78. Fillestari pyet ekspertin rreth pikave të mira dhe të këqija të referencave nga Interneti. Në përgjigjen e tij, Lawrence prek çdo gjë prej web-sajteve kërkuese deri te autoriteti. Dhe kur i përgjigjet pyetjes, ai mendon, natyrisht me disa hezitime, se Interneti shërben vetëm për të mirë.

Linden, Julie, "The Library's Website is the Library" C & RL News, shkurt 2000, f. 99-101. Një diskutim rreth një aspekti të web-sajtit të bibliotekës – mësimi nga largësia. Autori sugjeron një skicim të ueb - faqes, e cila do t'i përmbushte nevojat e tyre. Duke bërë kështu, skicohen problemet e web-sajtit së çfarëdo biblioteke.

"*MIllenium Special*: 2000 and Beyond", Yahoo!, dhjetor 1999, f. 89-206. Shumica e kësaj çështjeje diskutohet në komentet, opinionet dhe intervistat me ekspertët e fushave të ndryshme. Secili ka nocionin se çka do të thotë Interneti në aspektin e përmirësimit të shoqërisë. Temat zhvendosen nga pikëvështrimi nga ana e tetë shkrimtarëve prominentë, rreth së ardhmes deri te diskutimet e ekspertëve rreth argëtimit dhe kompjuterëve. Merre apo lere, është një vepër plot imagjinatë.

"*Navigating the Web*", Consumer Reports, shkurt 1999, f. 63. Një udhëzim një faqesh për personat laikë rreth asaj se si duhet të marrin maksimumin nga Interneti në aspektin e informimit. Shpjegimi është i qartë dhe i saktë – pra, një shpjegim që bibliotekari do të dëshironte t'ia jepte çdo njeriu që planifikon të kërkojë të dhëna në Internet.

Negrino, Tom, "The Macworld Web Searcher's Companion", Macworld, faqe. 1-76, maj, 2000. Një udhëzues i thjeshtësuar, jo vetëm për shfrytëzuesit e Mac-it, por për të gjithë: aftësia e hulumtimit për informata në Internet. Sugjerime të sakta hap pas hapi jepen në këtë vepër, së bashku me atë se çka duhet shmangur. Një vepër e jashtëzakonshme për fillestarët.

O'Leary, Mick, "Web Personalization Does it Your Way", Online, mars/prill, 1999, f. 79-80. Një kolumnist i njohur për këtë revistë të mirënjohur shpjegon si njerëzit e biznesit bëjnë që njerëzit, kohë pas kohe, t'i vizitojnë web-sajtet e tyre. Ai e quan atë "personalizim" dhe tregon se si termi është një çadër jo vetëm për hulumtimet komerciale, por edhe për shërbimin tradicional dhe aktual të njohur.

Proper, H.A. dhe *P.D. Bruza*, "What is Information Discovery About", Journal of the American Society for Information Science, vëllimi 50, nr. 9, 1999, f. 737-750. Bollëku i web-sajteve kërkuese nuk e ka zgjidhur problemin e hulumtimit në Internet për atë se çka është relevante. "Qëllimi i këtij artikulli është ofrimi i një kornize logjike për zbulimin e informatave dhe ta lidhë atë me fushën tradicionale të korrigjimit të informatave". Autori ia arrin që të shpjegojë, një zhargon të gjuhës së lirë, çelësin për kornizën informative.

Tennant, Roy, "Determining Our Digital Destiny", American Libraries, janar, 2000, f. 54-58. Përveç përdorimit të informacionit digjital dhe shërbimeve të referencave, bibliotekari duhet domosdo t'i zotërojë edhe zbulimet e tjera elektronike prej formateve të panumërta deri te kërkesa rreth video dhe audio konferencave teknologjike. Sikurse që thotë autori, "loja ka ndryshuar dhe nëse bibliotekat dëshirojnë të luajnë ende, ato duhet ta zbulojnë ardhmërinë e tyre".

Timmons, Mary E., ed. The Internet and Acquiditions in the Acquisitions Librarian, nr. 23, viti 2000. Artikuj të shumtë shpjegojnë aspekte të ndryshme dhe të panumërta të Internetit dhe çështjes se si ato mund të përdoren në shërbimet e referencave dhe të përvetësimeve. Jepen ueb -faqe specifike dhe vlerësuese prej web-sajteve këshilluese të shfrytëzuesve e deri te ato që u kushtohen autorëve. Burimet elektronike

janë treguar si me vlerë kur ato kufizohen në më të mirat dhe më e mira.

Vidmar, Dale, "Darwin on the Web: The Evolution of Search Tools", Computers in Libraries, maj, 1999, f. 23-28. Këtu jepet një histori e shkurtër dhe një listë praktike me sugjerime se si duhet të hulumtohet në Internet dhe cilat mjete ndihmojnë rreth kësaj. Autori citon dhe vlerëson disa mekanizma kërkues. Përfundimi i tij: "Mjetet e ndryshme japin rezultat të ndryshme, të cilat mund të jenë esenciale për zhvillimin e Internetit në të ardhmen".

PJESA E DYTË
INFORMACIONI: KONTROLLI DHE QASJA

KAPITULLI III
BIBLIOGRAFIA

Ku mund të gjej një web-sajt mbi Katherine Wheels-in? A gjendet ndonjë libër që bën fjalë për grumbullimin e brendshëm tubor? Sa romane të Nabokovit mund të gjenden ende në rafte të librarive? Ku mund të gjej informacion të besueshëm lidhur me Luftën Civile Amerikane në Internet? Kur është botuar libri që porsa është prezantuar në televizion *Fat Boy (Djaloshi trashaluq)* dhe nga kush? Sa do të më kushtoj një audio kasetë ushtrimesh? Dhe, cila është më e mira? A gjendet në bibliotekë libri i Singerit *Robi?* Jo. Pra, a mund ta huazoj nga ndonjë bibliotekë tjetër?

Këto janë pyetje të njohura referencash. Në një formë a tjetër ato kërkojnë përgjigje të drejtë dhe të saktë, ngaqë bibliotekari di sa i përket librave, web-sajteve dhe mediave përkatëse. Në saje të bibliografive, bibliotekari mund t'u përgjigjet kërkesave të publikut.

Laiku me njohuri rrjeti kompjuterik do të mund t'i drejtohet makinës gjurmuese për të gjetur përgjigje në këto pyetje. Kjo është në rregull dhe gjë e mirë, por kjo do të marrë shumë kohë dhe po ashtu do të kërkojë një pikë fati. Është shumë më pak frustruese të dish se ku të shikosh, të dish se në cilën faqe uebi të hysh sesa të gjurmosh në pyetësorë të përgjithshëm. Duhet përsëritur gjithnjë se puna në Internet është një mjet superior për gjetjen e përgjigjeve. Mirëpo, faktori vital është të dishë, në mënyrë specifike, për një burim reference dhe jo të peshkosh pa cak në një oqean faqesh uebi.

Njohuria mbi bibliografitë, të URL-ve për ato bibliografi (apo nëse

mund të gjenden vetëm në formë të shtypur dhe për cilën periudhë kohe, etj.), është një indikacion për bibliotekarin profesionist. Ka shumë definicione të bibliografisë, por nuk ka asnjë definicion të vetëm të përshtatshëm për të gjitha situatat. Për shumicën e njerëzve, bibliografia nuk është një "listë e librave". Ekspertët i japin asaj një kuptim tjetërfare: studim kritik dhe historik i librave të shtypur. Në Francë, sidomos gjatë shekullit XVIII, ky term lindi si formë e shkencës bibliotekare, do të thotë njohja e teorisë së listës së librave. Amerikanët dhe britanikët tani mëtojnë ta ndajnë atë në "analitike" dhe "tekstuale" për ndryshim nga listomi i thjeshtë.[1]

Bibliografia numerative (i.e. e listës) flet, ndër të tjera, lidhur me atë se cili është autori i librit, kush e ka botuar dhe ku, kur është botuar dhe sa do t'i kushtojë blerësit, qoftë në lidhje të fortë apo të butë, apo në ndonjë formë tjetër. Bibliografitë nuk kufizohen me çdo kusht në libra. Ato mund të përmbajnë forma të tjera të komunikimit që nga web-sajtet, filmat dhe rekordimet e deri te fotografitë. Një bibliografi, të themi, e hekurudhave do të mund të përfshinte, po ashtu edhe libra, web-sajte hekurudhash, si dhe filma dhe fotografi të hekurudhave.

Porsa të jetë gjetur një artikull në bibliografi, shfrytëzuesi dëshiron të dijë (1) se a gjendet ai në bibliotekë dhe mund të jetë në dispozicion për lexim, apo (2) nëse nuk gjendet në bibliotekë, a gjendet me porosi apo mund të merret; (3) apo në ndonjë web-sajte me pagesë, për të cilën biblioteka ofron qasje të materialit përmes kompjuterit. Nëse është pa pagesë, çështja do të jetë nëse ka faqe të tilla pa pagesë përmes kompjuterit apo jo. Katalogu ideal i bibliotekës apo web-sajti bibliotekare mund të sjellë përgjigje për të gjitha këto pyetje.

---

[1] Bibliografia analitike merret me përshkrimin fizik të librit. Bibliografia tekstuale bën një hap më larg dhe vë në pah disa variante tekstuale midis dorëshkrimit dhe librit të shtypur apo mes botimesh të ndryshme.

Shpesh, që të dyja kombinohen në një formë shkencore apo arti. Ky lloj hulumtimii bëhet me qëllim për të zbuluar çdo gjë të mundshme lidhur me qëllimet e fundit të autorit; qëllimi është të nxirren fjalë të sakta që ka synuar autori në të shprehurit e veprës së tij apo të saj. Kjo bëhet duke krahasuar botime të ndryshme të së njëjtës vepër në kërkim të dallimeve të mëdha dhe të vogla mes dy a më shumë vëllimesh. Puna në këtë nivel është një përpjekje për të gjetur veprën e vërtetë, origjinale, siç është përgatitur nga autori dhe jo nga printues herë-herë të shkujdesshëm. Një grup bibliografësh mund të jenë ekspertë në praktikat e shtypit dhe të libërlidhejs të shekullit nëntëmbëdhjetë dhe grupi tjetër në shtypin letrar apo faqosjen e titujve. Ka dallime mes bibliografive analitike dhe atyre tekstuale. Bibliografia analitike është më tepër e preokupuar me aspektet fizike të librit, kurse bibliografia tekstuale me fjalët e autorit, që do të thotë me tekstin e saktë siç e ka menduar autori të duket në formë të shypur.

BIBLIOGRAFIA NUMERATIVE SISTEMATIKE

Bibliografia e efektshme numerative duhet të ketë disa elemente nëse duam që ajo t'i plotësojë në mënyrë adekuate nevojat për kontroll dhe qasje.

Gjithëpërfshirja. Qoftë përmes një bibliografie të vetme, qoftë përmes një kombinimi bibliografish, bibliotekari duhet të ketë qasje në tërësinë e shënimeve të të gjitha fushave të interesit, jo vetëm në atë që gjendet aktualisht në dispozicion, por edhe në atë që është botuar në të kaluarën, atë që është në botim e sipër, si dhe në atë që është planifikuar të botohet nesër. Po ashtu, bibliografia ideale duhet të përfshijë botën dhe jo vetëm veprat e një vendi.

Qasje në pjesë. Normalisht, bibliotekari është i prirur t'i mendojë bibliografitë në kuptim të një njësie të plotë – një libër, e përkohshme, websajte, CR-ROM, dorëshkrim, apo të ngjashme. Por një bibliografi ideale duhet të jetë, po ashtu analitike, duke i mundësuar kështu bibliotekarit t'i qaset njësisë së caktuar në kuptim të pjesës më të imët të veprës, siç është subjekti, autori, botuesi etj.

Format e ndryshme. Një mjet gjithëpërfshirës bibliografik përfshin të gjitha format e komunikimit të publikuar, që nga raportet dhe dokumentet deri te llojet e ndryshme të bazës elektronike të të dhënave.

Përdorimi çdoditor

Si i përdor bibliotekari i referencës bibliografitë në bazë ditore? Bibliografia përdoret për tri qëllime themelore: (1) të identifikojë dhe të verifikojë, (2) të identifikojë dhe (3) të përzgjedhë.

1. *Identifikimi dhe verifikimi.* Citimi i rëndomtë bibliografik ofron informacion standard të ngjashëm me atë që gjendet në shumicën e katalogëve: autori, titulli, botimi (nëse është ndryshe nga botimi i parë), vendi i botimit, formati (d.m.th. numri i faqeve, ilustrimet, madhësia), si dhe çmimi. Një element tjetër i shtuar në shumë bibliografi është Numri Standard Ndërkombëtar i Librit (International Standard Book Number), apo shkurt ISBN apo vetëm SBN, që aplikohet nga botuesit për të dalluar një titull nga një tjetër. Numri ISBN rëndom është në prapafaqen e

faqes së kopertinës. Një sistem i ngjashëm, Numri Standard Ndërkombëtar i Serialeve (International Standard Serial Number – ISSN) aplikohet për t'i identifikuar seritë. Formatet elektronike ndjekin pothuajse një mostër të njëjtë, por kanë ndajshtime varësisht nga lloji i harduerit të nevojshëm për qasje në Net.

Në kërkimi të identifikimit apo të verifikimit të këtyre elementeve, bibliotekari do t'i kthehet bibliografisë së vërtetë, rëndom duke filluar nga burimi i përgjithshëm, siç është *Books in Print (Libra në shtyp)* apo *The National Union Catalog (Katalogu i bashkuar kombëtar)* dhe duke kaluar te e veçanta, siç është bibliografia në një fushë të ngushtë tematike.

2. *Identifikimi*. Identifikimi mund të jetë në kuptim të asaj se ku është botuar libri, ku mund të gjendet në bibliotekë, apo ku mund të blihet. Një web-sajt në kompjuter apo bazë e të dhënave mund të identifikohet përmes adresës në Internet.

3. *Përzgjedhja*. Qëllim i parë i një biblioteke është t'i krijojë përmbledhjet e dobishme për nevojat e përdoruesve. Kjo objektivë vetëkupton përzgjedhjen nga një numër i madh mundësish. Në mënyrë që të ndihmohet bibliotekari, disa bibliografi përmbajnë tabelën se me çfarë disponon në një fushë të caktuar tematike, nga një autor, në një formë të caktuar, apo në një formë të përshtatshme për grupe të caktuara të lexuesve. Një bibliografi mund të ofrojë një përllogaritje të përdorimit të mundshëm të një vepre të caktuar për nevojat e lexuesit.

Ekspertët dhe laikët të njohur mirë me një temë konsultojnë X apo Y në një bibliografi qoftë nga titulli, qoftë nga emri i autorit. Ata që nuk janë ekspertë mëtojnë të përdorin titujt tematikë. Sa më i sofistikuar dhe më i dijshëm të jetë një person në cilëndo fushë (qoftë automobilizëm apo psikologji), aq më i prirur do të jetë ai individ të përpiqet ta gjurmojë bibliografinë në bazë të autorit. Kjo është një qasje shumë e saktë, ngaqë nuk ka nevojë të mendohet për titullin e temës në bibliografi. Për shembull, a gjendet "automobili" nën "Automobilat" apo "Veturat" apo "Transporti"? Kërkimi më kompleks është kërkimi tematik. Po ashtu, kjo vlen edhe për kërkimet në Internet. Është më efektive të kemi një adresë të caktuar Interneti sesa të përpiqemi të gjejmë materialin përmes temës.

E ardhmja

Bibliografitë dhe librat e tjerë të referencës mund të kenë qasje në formë të shtypur dhe Internet. Sot, qasja në Internet është më e favorshme. Ajo do të çojë te dy rezultate:

1. Në fillim të këtij shekulli (i.e. 2000 plus) pak bibliografi kombëtare apo të përgjithshme do të jenë në dispozicion në formë të shtypur. Shumica do të kenë qasje vetëm në forme elektronike. Kjo është më pak e shtrenjtë, mundëson plotësim më të shpejtë të materialit dhe është më lehtë për t'u gjurmuar;

2. Megjithëkëtë, do të ketë bibliografi të shtypura "ezoterike". Këto do të jenë vepra të detajizuar studimore që kanë të bëjnë me ndonjë temë të caktuar. Ka pak gjasë që këto bibliografi do të jenë të kufizuara vetëm në qasje elektronike, ngaqë ato nuk shfrytëzohen shpesh dhe tash për tash kushtojnë më pak për t'u prodhuar në formë të shtypur.

Në ndërkohë, duhet të mësojmë për suazat e bibliografive. Pse? Ndonëse forma mund të bartet në një sistem elektronik, përmbajtja është e ngjashme. Metoda e kompilimit dhe problemet e involvuara janë të njëjta. Teoria themelore prapa qasjes intelektuale ndaj përmbajtjes bibliografike nuk ndryshon me format.

Bibliografia kombëtare

Një bibliografi e tillë si *National Union Catalog* e Shteteve të Bashkuara, përmban lista të të gjitha veprave që janë kataloguara nga Biblioteka e Kongresit dhe biblioteka të tjera anëtare të sistemit. Një bibliografi e këtij lloji ka normalisht shumë libra që nuk janë të botuara në vendin e origjinës. NUC, për shembull, ka në lista titujt në gjuhën kineze, frënge, ruse dhe gjuhë të tjera, nëse ato janë të kataloguara.

Katalogët e librarisë kombëtare nuk kufizohen në kohë, territor, gjuhë, temë, apo forma të komunikimit. Dhe, ndonëse asnjëra nuk mund të thuhet se është universale për nga gjithëpërfshirja, ato kolektivisht ofrojnë një tërësi pothuajse gjithëpërfshirëse të botimit ndërkombëtar.

Katalogu i Bashkuar Kombëtar (NUC) i Bibliotekës së Kongresit përmban

materiale nga mbarë bota dhe një përqindje e mirë e pasurisë së saj përbëhet nga libra, revista, muzikë dhe të ngjashme nga botues ndërkombëtarë. Numerikisht, një ide e gjerësisë së përmbajtjeve të Bibliotekës së Kongresit mund të supozohet nga fakti se Biblioteka përmban më se 20 milionë libra dhe 100 milionë artikuj diskretë. Afro pesë deri në gjashtë milionë artikuj të rinj shtohen çdo vit. Krahasimisht, numri mesatar i librave të botuara në Amerikë, çdo vit, sillet ndërmjet 40 000 e 50 000 tituj, një pjesë e vogël e asaj që merr për çdo vit rrjeti i Bibliotekës së Kongresit, që ka një fond prej mbi në milionë autorësh. Figura gati të njëjta vlejnë edhe për të gjitha bibliotekat kombëtare.[2]

Për t'u kualifikuar si duhet si bibliografi kombëtare, sistemi duhet të ketë dy elemente: (1) ka nevojë për një sistem depozitues legal që siguron që biblioteka kombëtare të marrë nga një kopje të çdo gjëje të botuar në vendin e origjinës së bibliografisë dhe (2) shënimet duhet të bëhen nga ekzaminimi i drejtpërdrejtë i materialeve dhe jo nga botuesi apo autori. Shumica e vendeve perëndimore tani kanë ekzaminime depozitore si bazë për bibliografinë kombëtare.

Bibliografitë e tregut[3]

Bibliografitë e tregut kufizohen në materiale të botuara brenda një vendi të caktuar. Më tej, ato mund të ngushtohen në një pjesë të vendit, qytetit, apo madje edhe të një fshati. Për lehtësi përdorimi, bibliografitë e tilla ndahen për nga koha, forma dhe origjina.

Koha. Kjo është çështje e regjistrimit të veprave të botuara më parë, e veprave që janë duke u botuar apo veprave që do të botohen. Bibliografitë

[2] Mund të pohohet se bibliografia universale është sot një realitet, vetëm sa për t'u frustruar nga një vend, rajon apo individ që refuzon të krijojë një listë metodologjike të asaj që është botuar. Madje, pjesa më e madhe e botës do të njohë procedurat standarde bibliografike në krijimin e një bibliografie universale, por kjo mundësi është tepër larg në të ardhmen.

[3] Bibliografia e *tregut* përdoret shpesh si sinonim për bibliografinë kombëtare. *Bibliografia e tregut* i referohet një bibliografie të botuar rëndom për dhe nga librërshitësit dhe botuesit e një vendi të veçantë. Theksi i bibliografisë së tregut bie në të dhënat bazë të blerjes. Informacioni për një bibliografi tregu mblidhet nga botuesit dhe artikulli individual i regjistruar nuk ekzaminohet nga hartuesi i bibliografisë së tregut. *Bibliografia kombëtare,* që përfshin informacionin shtesë (herë-herë të gjitha të dhënat e kataloguara) kompilohet nga bibliotekarët. Të dhënat merren drejtpërdrejt nga artikulli i ekzaminuar nga kataloguesi. Rezultati: Bibliografitë kombëtare janë më të plota dhe më të sakta sesa bibliografitë e tregut.

e tilla normalisht etiketohen qoftë si retrospektive apo qoftë si aktuale.

Forma. Ky klasifikim mund të jetë në kuptim të formës bibliografike: përmbledhje veprash, monografi, komponentë (p.sh. eseje, artikuj të të përkohshmeve, poezi); formë fizike (libra, bazë të dhënash, regjistrime, pamflete, mikrofilma) apo vepra të botuara dhe të pabotuara (dorëshkrime, disertacione).

Një bibliografi tipike e tregut do t'i vë vetes kufij në kohë, formë dhe patjetër në origjinë. Për shembull, *Books in print (Libra në shtyp)* kufizohet në libra që janë në dispozicion për t'u blerë (kohë); ajo përfshin vetëm libra të shtypura, qoftë me lidhje te fortë apo letre dhe disa monografi dhe seri (formë); dhe është bibliografi tregu ajo që botohet nga një organizatë komerciale (origjina).

VLERËSIMI I BIBLIOGRAFISË

Me rastin e shqyrtimit të meritave relative të një bibliografie duhet të përdorim kriteret e përgjithshme që përdoren me rastin e vlerësimit të të gjitha veprave të referencës: qëllimi, autoriteti, gjerësia etj. (Shih diskutimin mbi "Vlerësimi i burimeve të referencës" në Kapitullin I). Përtej konsiderimeve të përgjithshme, një bibliografi duhet vlerësuar në këtë mënyrë:

1. *Qëllimi.* Është me rëndësi që bibliografia të plotësojë një nevojë të vërtetë dhe që të mos jetë përsëritje e një vepre tjetër apo të jetë aq ezoterike saqë të ketë pak vlerë apo të mos ketë fare. Tema theksohet qartë ne titull dhe definohet mirë në parathënie;

2. *Gjerësia.* Bibliografia duhet të jetë sa më e plotë brenda qëllimit të saj të theksuar. Për shembull, një bibliografi librash dhe artikujsh periodikësh lidhur me hekurudhat e shekullit XIX në Amerikë do të përfshijë raporte bashkëkohëse të revistave lidhur me ndërtimin e hekurudhave. web-sajte të besueshme, po ashtu do të duhet të regjistrohen ashtu si dhe CD, regjistrime etj. Aty ku ka forma të ndryshme, ato duhet të identifikohen qartë;

3. *Metodologjia.* Metoda e kompilimit të bibliografisë duhet të jetë e drejtpërdrejtë dhe duhet ta bëjë të qartë se kompiluesi ka shqyrtuar të tërë listën e materialeve. Artikujt duhet të përshkruhen në një stil standard bibliografik dhe të përfshijnë elementet themelore të një njësie bibliografike;

4. *Organizimi.* Bibliografia duhet të organizohet në një mënyrë të qartë, të lehtë, kurse indekset (nga tema e autori e deri te vendndodhja gjeografike) duhet përfshirë aty ku synohet qasje e shumëfishtë. Në të njëjtën kohë, duhet të shikoni për materialin e renditur në mënyrë logjike që të mos jetë gjithmonë e domosdoshme të përdoret indeksi, për shembull, në mënyrë alfabetike me autor, me datë, me temë e kështu me radhë. Autori duhet të ofrojë një shpjegim të qartë se si të përdoret vepra, si dhe definicionet, një shpjegues shkurtesash e të tjera. Në Internet, softueri duhet të jetë mjaft i sofistikuar që të mund të bëhet kërkim i barabartë me pika hyrëse aty ku ka nevojë;

5. *Fusnotat dhe shpjegimet.* Aty ku për një njësi përdoren shënime përshkruese dhe kritike ato duhet të jenë të qarta, koncize dhe informative;

6. *Forma bibliografike.* Kjo është një njësi standarde me informacionin që i duhet dikujt për të identifikuar dhe për të gjetur artikullin;

7. *Aktualiteti.* Materiali duhet të jetë aktual, të paktën aty ku ky është qëllimi i bibliografisë. Është e logjikshme që dikush mund të regjistrojë vetëm botime të shekullit XVIII dhe XIX dhe në një rast të tillë përfshirja kohore nuk duhet të jetë faktor. Edhe këtu, përparësia e madhe e bibliografive kompjuterike është se aty mund të plotësohen dhe freskohen rregullisht, p.sh. shih *Books in print*;

8. *Saktësia.* Kuptohet, pa e thënë se materiali duhet të jetë i saktë. Duhet të ketë njëfarë aranzhimi, nëse është i mundshëm, për korreksionet që duhet bërë pas botimit, po të ketë nevojë.

UDHËZIM MBI PËRDORIMIN E BURIMEVE TË REFERENCËS

Shënim: Këtu, si dhe në tërë këtë kapitull dhe në tekstin në përgjithësi, adresat për parapagim (d.m.th. për një tarifë) për baza të dhënash janë të

botuesit dhe jo të bazës aktuale të të dhënave. Për të gjetur baza të dhënash me tarifë (të shënjuara me çmim abonimi): *(a)* konsultoni web-sajtin e bibliotekës suaj. Baza e të dhënave rëndomë është e regjistruar në të me një link në web-sajte; *(b)* provoni një bibliotekë tjetër në vendin tuaj, që u ofron shfrytëzuesve qasje të lirë në bazat e të dhënave me tarifë; *(c)* shfrytëzoni adresën e dhënë të botuesit në Internet. Do t'u duhet të kërkoni një titull specifik në katalogun kompjuterik të botuesit apo në sistemin e kërkimit. Porsa ta keni gjetur botuesi mund të ofrojë një a dy orë pa pagesë për kërkime mostrash.

Futuni drejtpërdrejt në adresën e bazës së të dhënave pa pagesë, d.m.th. në ato që kanë të shënjuar "free" (pa pagesë).

Shtypur: Balay, Robert, *Guide to Reference Books,* bot. 11-të, Çikago: American Library Association, 1996, 2040 f. $275.[4]

Internet: *Walford, Albert John.* Walford's Guide to Reference Material, *London. The Library Association, 2000 deri më tani, çerekshe. (URL pritet të shpallet) Tarifa ndryshon.*

Në shtyp: The Library Association, 1959 deri më tani, vjetore, 3 vëll. $195 deri në $225 për një kopje.

Shtypur: Wynar, Bohdan. *American Reference Books Annual.* Englewood, CO: Libraries Unlimited, Inc., 1970 deri më tani, vjetore. $110.

Qëllimi themelor i një udhëzuesi bibliografik për materiale reference është të iniciojë shfrytëzuesin në (1) burime të përgjithshme të referencës për ndihmë në kërkime në të gjitha fushat dhe (2) në burime të veçanta referencash që ndihmojnë në kërkime në fusha të caktuara. Udhëzuesit kanë forma të ndryshme, por ato kryesisht janë (1) ose lista me shpjegime titujsh me hyrje të shkurtra komentimesh para secilës pjesë apo kapitull, ose (2) regjistra që shënjojnë jo vetëm burimet themelore por prezantojnë para shfrytëzuesit mjetet kërkimore në një qasje diskursive, pothuajse tekstuale.

Ka disa udhëzues themelorë të dobishëm në përzgjedhjen dhe përdorimin e librave të referencës.

[4] Së shpejti kjo guidë do të jetë në dispozicion përmes Netit. Deri në vitin 2000 ka qenë vetëm në format shtypi.

1. *Udhëzuesi për Libra të Referencës* shënon dhe shpjegon më se 16 000 tituj që konsiderohen themelorë për bibliotekën e madhe. Titujt janë renditur në bazë të sektorëve kryesorë nga shkencat shoqërore deri te ato humaniste. Ajo është e njohur për indeksin e shkëlqyer prej 400 faqesh. *Udhëzuesi (Guide)*, ashtu si dhe ai anglez, fillon me një temë të gjerë dhe pastaj bën një nënndarje në tema më specifike dhe për nga forma. Për shembull, ka një pjesë mbi ekonominë nën shkencat shoqërore. Kjo është e nëndarë për nga forma: guida, bibliografi, të përkohshme, disertacione, indekse dhe zhurnalë abstraktë, fjalorë dhe enciklopedi, atlase, udhëzues e kështu me radhë. Pjesa mbi ekonominë më tutje ndahet në tema edhe më specifike dhe shpesh brenda një njësie tematike bëhet edhe ndonjë ndarje e re sipas vendit, siç është për shembull te pjesa e shkencave politike. *Udhëzuesi për materiale të referencës* bën një nënndarje të ekonomisë sipas bibliografive, thesareve, enciklopedive dhe fjalorëve, disertacioneve e kështu me radhë, duke ndjekur përgjithësisht mostrën e Balay-it. Në praktikë, aranzhimi nuk është vërtet i rëndësishëm. Çdo vëllim ka një titull të shkëlqyer, një autor dhe një indeks temash.

Që të dy udhëzuesit përmbajnë informacione të kufizuara mbi burimet elektronike të referencës duke dhënë shprehimisht atë që gjendet në formate të ndryshëm. Vëmendja për baza elektronike të të dhënave është rritur dukshëm, kurse udhëzuesit japin këshilla të shëndosha mbi atë se cilat formate janë më të mirat.

Problemi me *Udhëzuesin për libra të referencës* është mungesa e materialit aktual. Afati i fundit i edicionit të vitit 1996 është fillimi i vitit 1994 apo ata tituj që janë dy vjet prapa botimit të edicionit të njëmbëdhjetë. Edicioni i ri i premtuar i vitit 2001 është nën redakturimin e Robert Kiefit (kryebibliotekar në Kolegjin Harverford në Pensilvani), pas dorëheqjes së Balay-it. Ajo, po ashtu do të datohet para botimit. Shpresohet se kjo vepër do të jetë e gatshme në Internet për ta bërë sa më aktuale dhe, në të vërtetë, më të përdorshme. Shih botimin e janarit të *College & Research Libraries* (Çikago: American Library Association) "Selected Reference Books". Nga 50 deri në 75 tituj janë përzgjedhur me kujdes, sqaruar dhe renditur sipas tematikës së gjerë. Kjo ndihmon në pasurimin e edicionit paraprak të *Udhëzuesit të librave të referencës.*

2. *Udhëzuesi për materiale të referencës (Guide to Reference Material)* apo "Walford-i" britanik, është më aktual sesa vepra e ngjashme amerikane,

kështu që është më e parapëlqyer nga shumë biblioteka të mëdha. Të tri vëllimet e saj janë gjithnjë në revidim dhe botohen sipas një afati trevjeçar. Duke filluar nga viti 2000, të tri vëllimet kanë qasje edhe në ueb. Sipas botuesit, secili vëllim do të plotësohet elektronikisht në çdo tre muaj. Versionet e shtypura do të vazhdojnë të botohen si edicione të reja nga një në vit, apo nga tri brenda tri vjetësh.

Udhëzuesi për materiale të referencës ndjek të njëjtën ecuri, si dhe vepra amerikane, ndonëse pasi që bibliografia është në tri vëllime, numri i përgjithshëm i titujve është të paktën për një të tretën a më shumë më i madh sesa te *Udhëzuesi për libra të referencës.* Në këto vështrime ka shpesh edhe citime të bëra me kujdes. Fokusimi bëhet më shumë me Anglinë dhe Bashkimin Evropian.

Të tri vëllimet e Walford-it, botuar njëherë në vit me procesin e rifillimit me botimin e vëllimit të tretë, mbulojnë shkencën dhe teknologjinë, shkencat shoqërore dhe ato humanitare. (Vëll.1: *Shkencë dhe teknologji;* Vëll.2: *Shkencat shoqërore dhe historike, filozofi dhe religjion;* Vëll.3: *Të përgjithshme, gjuhë dhe letërsi, arte).* Mostra organizative ndjek UDC-në, i.e. Klasifikimin Decimal Universal. (Kjo do të thotë, për shembull, se vëllimi mbi shkencën përfshin antropologjinë, e cila nuk gjendet nën shkencat në një vepër amerikane).

Ana më e mirë e veprës trevëllimëshe është stili i shpjeguesit. Shënimet kritike janë shkruar me një elegancë që e ka bërë të famshëm Walford-in. Ato nuk janë vetëm përshkruese, por përmbajnë thumbime dhe lëvdata me vend aty ku është e domosdoshme. Shumica janë të këndshme për t'i lexuar. Para vdekjes së tij, në vitin 2000, Walford-i ua dorëzoi vëllimet një grupi editorësh, të cilët vazhdojnë stilin e tij të bukur. (Emri i tij vazhdon të mbetet si pjesë e titullit).

Ndonëse një pjesë e madhe e fokusimit të udhëzuesit të Waldorf-it është në vepra britanike dhe të Bashkimit Evropian, ai është mjaft i gjerë për të përfshirë edhe titujt themelorë amerikanë. Kjo është evidente në vëllimin e dytë, që mbulon shkencat shoqërore, filozofinë dhe religjionin, që paraqet një përzgjedhje të lakmueshme të veprave ndërkombëtare të referencës.

3. *Anuari Amerikan i Librave të Referencës (American Reference Books Annual – ARBA)* dallon shumë nga *Udhëzuesi për libra të referencës dhe Udhëzuesi për materiale të referencës* në tri aspekte të rëndësishme: (1) ai kufizohet në tituj të referencës të botuar apo të distribuuar në Shtetet e

Bashkuara dhe në Kanada; (2) është gjithëpërfshirës për një vit të caktuar dhe nuk bën përpjekje të jetë selektiv; (3) shpjeguesit janë të shkruar nga më se 350 ekspertë tematikë dhe janë edhe më kritikë dhe më të hapët sesa ata që gjenden te Balay dhe Walford-i. Varësisht nga gjerësia e botimeve amerikane, vëllimi anual, rëndom në dispozicion në mars apo prill të vitit vijues pas vitit të mbuluar në tekst, analizon deri në 1 800 tituj të veçantë reference. Vepra është e organizuar si duhet dhe përmban indekse. Në çdo pesë vjet botuesi boton një indeks përmbledhës në vëllime.

Librat e rekomanduar të referencës për biblioteka të vogla dhe të mesme dhe qendra mediale (Recommended Reference Books for Small and Medium Sized Libraries and Media Centers) – (Englewood, CO: Libraries Unlimited, 1980 e këtej) është një version i ndarë i të njëjtit botues, si dhe i *Anualit Amerikan të Librave të Referencës.* Vështrimet ndahen në kategori të mëdha tematike, kurse kodet tregojnë për përdorimin e tyre nga biblioteka akademike, publike apo shkollore. Ato përfshijnë nga 500 deri në 550 vepra referencash të botuara vitin paraprak, që plotëson nevojat koleksioneve të vogla dhe të mesme të referencës.

4. *Burimet kanadeze të referencës: bibliografia e anotuar (Canadian Reference Sources: An Annotated Bibliography)* – (Vankuver, University of British Columbia, 1997. 1076 f., $225). Kjo vepër e ngjashme me *Udhëzuesin për libra të referencës*, përmban afro 4 000 burime të referencës me interes parësor për bibliotekat kanadeze. Aranzhimi është i ngjashëm me veprat amerikane dhe angleze. Një dallim esencial: vepra është dygjuhësore, frëngjisht dhe anglisht. Ky udhëzues u hartua nga Mary Bond dhe Martine Caron nga Biblioteka Kombëtare e Kanadasë. Shënim: Ndonëse viti i botimit është 1997, shumica e burimeve janë të botuara para vitit 1996.

Udhëzuesit për biblioteka më të vogla

Shumica e bibliotekave janë të kategorisë së vogël dhe të mesme. Udhëzuesit më të mëdhenj janë tepër përmbajtësor. Një bibliotekë e vogël ka nevojë për vepra që janë dukshëm më pak shteruese. Redaktuar nga Scott Kennedy, *Burimet e referencës për biblioteka të vogla dhe të mesme (Reference Sources for Small and Medium Sized Libraries)*, botimi i VI.

(Çikago: American Library Association, 1999) ofron një listë të dobishme prej afro 2 000 titujsh bazë. Shpjeguesit përshkrues/vlerësues janë të shkëlqyeshëm dhe bibliotekarit i jepet mjaft informacion për të vendosur se a duhet blerë a jo atë vepër të referencës. Titujt standardë, që nga fjalorët deri te indekset, mbesin pothuajse të njëjtë si te *Udhëzuesi për libra të referencës.* Gjithashtu, përfshihen formatet elektronike.

Dukshëm më ambicioze, vepra e Shoqatës Bibliotekare Amerikane, *Udhëzues për qasje informacioni (Guide to Information Access* - 1994) merr parasysh afro 3 000 "burime më të mira standarde dhe elektronike në 36 kategori tematike më të hulumtuara". Mjeshtërisht e redaktuar nga Sandy Whiteley, ky udhëzues i ALA-s është në rend të parë një listë shpjeguese e titujve në tema që nga "burimet e përgjithshme të referencës" e deri te "shkrimet". Të 90 a më shumë faqet e para ofrojnë një hyrje në bazat e të dhënave kërkimore elektronike. Secili nga kontribuuesit e shumtë është ekspert në një fushë. Udhëzuesi mund të përdoret si nga bibliotekarë ashtu dhe nga laikë.

Bibliografitë tematike

Një hedhje shikimi në cilëndo fushë tematike, qoftë në *Udhëzuesin për libra të referencës*, qoftë në *Udhëzuesin për materiale të referencës* do të zbulojë qindra bibliografi tematike. Shumica e tyre ndjekin të njëjtën mostër të organizimit dhe prezantimit, por janë për një fushë të caktuar të interesimit. Disiplinat e ndryshme dhe fushat e gjera të diturisë kanë bibliografitë e veta, versionet e veta të *Udhëzuesit për libra të referencës.*

Disa shembuj të bibliografive tematike paraqesin një fushë të gjerë – emërtoni një temë dhe pashmangshmërisht do të keni nga një deri në 100 bibliografi që kanë të bëjnë me veprat në fusha të interesit. Të marrim, bie fjala, disa udhëzues tematikë që kanë tituj shpjegues: C.D. Hirt, *Burimet informative në shkencë e teknologji (Information Sources in Science & Technology,* bot. III (Englewood, CO: Libraries Unlimited, 1998); William Johnson, *Libra të fundit të referencës në religjion (Recent Reference Books in Religion.* (Nju-Jork; Dearborn, 1999).

Kërkoni në Ueb për bibliografi "statike" dhe aktuale në gati çdo fushë. Ato gjenden nën tituj të ndryshëm tematikë, por në mënyrë të përgjithshme hyrja është e mundshme nga "bibliografitë-mesjeta" apo "bibliografia-hekurudhat" etj.

Bibliografitë statike janë ato me sasi të kufizuar, nëse janë të pranishme,

të titujve të rinj, p.sh. *Letërsi në anglisht*, www.library.yale.edu/humanities/.

English/englit ofron udhëzues, doracakë, enciklopedi dhe burime të tjera të ngjashme që përbëjnë "një bibliografi të përzgjedhur të burimeve të referencës" në anglisht. Mirëpo, ka të ngjarë që kjo faqe të jetë në gjendje të përhershme të konstruktimit.

Bibliografia e bibliografive

E shtypur: Indeksi Bibliografik (Bibliographic Index), Nju-Jork: H. W. Wilson Company 1984 e tej. Shërbim.

Bibliografia e bibliografive është, siç sugjeron edhe emri, një listim bibliografish. Mund të gjendet një bibliografi mbi qentë në fund të një artikulli në një të përkohshme, në përmbyllje të një eseje në një enciklopedi, apo si pjesë e një libri mbi manarët. Nëse shënojmë këto tri bibliografi dhe shtojmë nga dhjetëra në mijëra të tjera lidhur me qentë, atëherë do të kemi një bibliografi të bibliografive mbi qentë.

Shembulli kryesor i një bibliografie të bibliografive është *Indeksi bibliografik.* Nën tituj të shumtë, njeriu mund të gjejë bibliografi mbi tema, persona dhe vende. Njësitë paraqesin (1) libra të veçantë të botuar dhe pamflete, që normalisht janë bibliografi në një fushë të caktuar tematike, për shembull, *East European and Soviet Economic Affairs: A Bibliography...;* (2) bibliografitë që janë pjesë e librave dhe pamfleteve, siç është bibliografia që paraqitet në fund të librit të David Kunzle-s *Stripi i hershëm komik;* dhe (3) bibliografitë që botohen ndaras apo me artikuj në afro 3000 të përkohshme në gjuhën angleze dhe në gjuhë të huaja. Theksi bie mbi botime amerikane, kurse bibliografia duhet të përmbajë më se 50 tituj për t'u regjistruar.

Mangësia e pashmangshme për shumë vepra të referencës është e pranishme në këto raste: (1) bibliografitë nuk regjistrohen deri në gjashtë muaj a një vit pasi të jenë botuar dhe (2) ndonëse librat dhe, deri diku, edhe pamfletet, janë të mbuluara, indeksi nuk mund të jetë i besueshëm për përfshirjen e shumë bibliografive të të përkohshmeve. Pse? Sepse, botohen mbi 120 000 të përkohshme, shpesh me bibliografi, kurse indeksi bën analizën e vetëm 3 000 prej tyre. Për më tepër, bibliografia duhet të përfshijë një minimum prej 50 titujsh apo ajo nuk regjistrohet.

NDIHMËSIT AKTUALË PËRZGJEDHËS

Në Internet: Books in Print With Book Reviews. (Libra në shtyp me vështrime librash). Nju-Jork: R. R. Bowker, 1992 e tej, mujore, www.booksinprint.com, pa pagesë. Dosje DIALOGU 470, $30 në orë. Çmimi ndryshon. OCLC dhe bartës të tjerë.

Librat në shtyp me vështrime librash në disk, 1992 e tej, mujore, *$1.600.*

Në Internet: Booklist ("Reference Book Bulletin") – Lista e librave ("Bilteni i librit të referencës"), Çikago: American Library Association, 1997 e tej, gjysmëmujore, www.ala.org/booklist/index). Pa pagesë.

Në shtyp: 1905 e tej, gjysmëmujore. $56. *Në Internet: Library Journal,* Nju-Jork: R. R. Bowker, 1997 e tej, gjysmëmujore, www.libraryjournal.com. Pa pagesë.

Në shtyp: 1876 e tej, gjysmëmujore. $79.

Në iInternet: Choice (Zgjedhja), Çikago: American Library Association, 1988 e tej, mujore, www.ala.org/acrl/choice/home. Çmimi ndryshon.

Në shtyp: 1994 e tej, mujore. $200.

Në Internet: Reference & User Services Quarterly (ish RQ), Çikago: American Library Association, www.ala.org/rusa/rusq. Pa pagesë.

Në shtyp: 1960 e tej, çerekshe. $50 (pa pagesë për anëtarë).

Përzgjedhja e burime të referencës është një mjeshtri madhore e bibliotekarit profesionist të referencës, i cili do të kalojë një kohë të madhe të kohës duke zgjedhur librat e duhur për nevojat e auditorit, të cilit i shërben. Dhe, këto nevoja ndryshojnë nga biblioteka në bibliotekë. Përzgjedhja e parë dhe më e rëndësishme është të dihen nevojat e njohura dhe ato të pritura nga ana e shfrytëzuesve.

Si mund të arrihet një politikë e kënaqshme e seleksionimit? Duhet të ketë një bibliotekar me kompetencë tematike; do të thotë një që di literaturën bazë të një fushe apo të shumë fushave, përfshirë jo vetëm veprat e referencës por edhe filozofinë, zhargonin, idetë, idealet dhe problemet që ka në atë fushë. Nuk ka zëvendësim për dituri përmbajtësore. Bibliotekari duhet të ketë njohuri të thella mbi llojin e shkrimit dhe të

botimit të bërë në atë fushë speciale. Ku mund të ketë vështrim më të mirë? Kush janë autorët më të mirë, botuesit dhe editorët në këtë fushë? Për cilën mund të ketë përgjigje të gatshme e për cilën jo?

Përzgjedhja planifikohet por nuk diktohet nga këto:

1. Të kesh sa më shumë njohuri lidhur me nevojat e atyre që përdorin koleksionin e referencës.

2. Të kërkohet këshilla e ekspertit. Në një situatë shkolle, eksperti mund të jetë mësuesi, i cili ka njohuri në një fushë të caktuar. Në një bibliotekë publike ky mund të jetë një person laik, praktikant, profesionist apo specialist tematik, i cili e shfrytëzon bibliotekën. Shumica e njerëzve janë të lajkatuar nga kërkesa për të mësuar nga përvoja dhe dituria e tyre dhe një nga burimet më të mira të materialeve të referencës është shfrytëzuesi i informuar.

3. Mbajtja e shënimeve të pyetjeve. Kjo bëhet për të përcaktuar, jo vetëm se çfarë materialesh ka në bibliotekë, por edhe çfarë nuk ka. Për më tepër, një shënim mbi pyetje të papërgjigje shpesh do të jetë baza e vlerësimit të përmbledhjes së referencës.

4. Njohuria lidhur me atë se çfarë kanë bibliotekat e tjera dhe çfarë burimesh ka në dispozicion. Për shembull, biblioteka e vogël që mendon për blerjen e një sërë të përkohshmeve të shtrenjta apo të një bibliografie do të shihte patjetër së pari se a janë në dispozicion të njëjtat materiale në një bibliotekë të afërt.

Këto katër pika vetëm sa sugjerojnë ndërlikueshmërinë e përzgjedhjes. Shumë biblioteka kanë deklarata të hollësishme të politikës së përzgjedhjes, të cilat shqyrtojnë në thellësi hapat e domosdoshëm administrativë, të cilat vetëm sa janë prekur këtu.

Formatet dhe sidomos faqet e Internetit paraqesin një pjesë tjetër të problemeve të përzgjedhjes. Siç bëhet e ditur, gjatë tërë këtij udhëzuesi, së pari duhet gjetur dhe duhet shtruar pyetjen gjithmonë lidhur me përmbajtjen, besueshmërinë e saj, përshtatshmërinë për auditorin bibliotekar, etj. Neti kërkon vlerësim në kuptim të saktësisë, autoritetit dhe lidhur me atë se sa jepen informata dhe sa mbahen. Dendësia e plotësimit është me rëndësi po aq të madhe. Dhe, aty ku ka link me faqet e tjera, pyetja esen-

ciale është: "Sa janë të besueshëm linkët e faqes dhe pse janë zgjedhur ato?". Përtej kësaj janë pyetjet teknike lidhur me versionet elektronike. Si për Internet ashtu dhe për CD-ROM, cilësia dhe mjeshtëria e prezantimit, si dhe navigimi dhe ndihmësit medialë janë të një rëndësie të madhe.

Të gjitha burimet bazë të vështrimeve të referencës, të cituara këtu, tani shqyrtojnë mediat elektronike, si dhe ato të shtypura. Në fakt, me shtimin gjithnjë më të madh të rëndësisë së burimeve digjitale në shërbimet e referencës, koha do të vijë kur burimet elektronike, që u kushtohen veprave të referencës do të jenë më të gjera sesa ato që i dedikohen shtypit.

Ndërkaq, problemi me disa vështrime të formatit elektronik është se ato i japin theks tepër teknologjisë kundruall përmbajtjes. Ka më shumë preokupim me navigimin sesa çfarë ka në të vërtetë në një vepër të referencës. Një shikim, ta zëmë, në vështrimet e shkëlqyera të referencës në revistën *Choice* do ta dëshmonte këtë. Duke dalë në krye të çdo numri ato paraqesin kryesisht mendimin e mësuesve dhe të bibliotekarëve. Shumica e autorëve të vështrimeve i japin rëndësi përmbajtjes.

Pyetjet themelore lidhur me përzgjedhjen vazhdojnë të mbesin, pa marrë parasysh se për cilin format e kemi fjalën. Në Ueb:

Duhet të japim përgjigje në pyetjet esenciale: kush është pararendësi i këtij informacioni? Mbi çfarë autoriteti paraqitet ai? Cila është ekspertiza e provajderëve? Sa është ai i saktë, i thellë, gjithëpërfshirës dhe aktual? Cili është auditori i tij? Ne do të shtojmë edhe kritere të tjera vlerësimi. Çfarë ofron ai në kuptim të mediumit të vet? A është më i lirë, më i lehtë, më i shpejtë, i përdorshëm? Si krahasohet ai me versionin e shtypur apo me atë në CD-ROM apo me produkte të ngjashme në format të njëjtë a të ndryshëm?[5]

Librat në shtyp me vështrime librash

Shumica e bibliotekave, pa marrë parasysh madhësinë, do të abonohen me të paktën dy a tri revista standarde vështrimesh. Bibliotekat më të mëdha do t'i kenë në dispozicion vështrimet si pjesë e bazave të të dhënave më të mëdha elektronike. *Books in Print With Book Reviews (Librat*

[5] Francine Fialkoff, "Reviewing Electronic Media," *Library Journal,* janar, 1999, f. 73.

në shtyp me vështrime librash) përfshin revistën *Booklist*, *Library Journal* dhe *Choice*, si dhe zhurnalët me dobi të ngjashme si: *Publishers Weekly, Kirkus, BIOSIS, School Library Journal, Reference and Rsearch Book News, University Press Book News, sci-Tech Book News*, si dhe gjashtë të tjera. (Për përshkrim të burimeve madhore të vështrimeve të referencës shih më poshtë). Ka afro 400 000 vështrimesh librash (jo të gjitha mbi vepra të referencës, natyrisht) që janë të dispozicion në këtë mega-burim të vetëm. Asnjëri nga zhurnalët nuk është plotësisht i kënaqshëm sa u përket vështrimeve të ofertës në Internet, por të paktën ato mbulojnë bazën e interesimit të shumicës së bibliotekave – dhe patjetër të studentëve.

Vështrimet standarde

"Buletini i librave të referencës" ("Reference Books Bulletin"), një pjesë në botimin dy herë në muaj të revistës *Booklist* është vendi më i rëndësishëm për një bibliotekar për të kërkuar vështrime të sakta, aktuale dhe të thella të veprave të përgjithshme të referencës. Secila pjesë ka një hyrje me nga një sërë shënimesh lidhur me botimin, shërbimet e referencës dhe veprat e reja. Kjo vazhdon me vështrimet e panënshkruara. Emrat e anëtarëve që i shkruajnë vështrimet dhe ua shërbejnë komiteteve (bibliotekarëve dhe mësuesve) jepen në çdo botim.

Gjatë vitit, ky shërbim vështron nga 100 deri në 150 vepra të mëdha dhe dyfish më shumë të titujve më konvencionalë dhe më të lirë. Kohë pas kohe, një numër i tërë, apo pjesa më e madhe e një numri, i dedikohet një vështrimi të enciklopedive, fjalorëve, veprave të referencës për fëmijë dhe të ngjashme. Vështrimet mblidhen, çdo vit, në një botim të posaçëm. Vështrimet paraqiten jo më shumë se gjashtë muaj nga botimi i librit të vështruar dhe nganjëherë edhe më herët. Ka vështrime të detajuara në CD-ROM dhe baza të të dhënave që do të mund të përdoren në një bibliotekë me madhësi të mesme. Analiza është e rëndësishme sidomos për persona laikë që duan të mësojnë mbi pikat e mira dhe të dobëta në punën kërkimore të një laiku. Në fakt, vështrimet e bazave të të dhënave janë tani ndër më të mirat që mund të gjenden. Shënim: *Booklist* gjendet pa pagesë në Net. Vështrimet në Internet plotësohen rregullisht dhe kanë një arkiv të kufizuar të vështrimeve të mëparshme.

Vështrime të tjera aktuale të librave të referencës dhe të burimeve të informacionit janë:

1. Coice. Ndonëse e menduar enkas për biblioteka kolegjesh, kjo revistë profesionale vlerëson një numër titujsh të referencës me vlerë për të gjitha bibliotekat. Ato janë të regjistruara nën listën "Referencë". *Choice* bën vështrime të bazave elektronike të të dhënave në çdo numër të saj. Bazat joreferencë të të dhënave janë të shpërndara në të gjitha fushat e ndryshme tematike. Po ashtu, herë-herë esetë në hyrje japin një pasqyrë të titujve të referencës. Ka përafërsisht 6 800 vështrime në vit, prej të cilave 500 mbulojnë libra të referencës. Vështrimet janë rëndomë me 120 deri në 500 fjalë gjatësi dhe janë të nënshkruara. Pothuajse të gjithë autorët e vështrimeve bëjnë përpjekje për të krahasuar titullin në vështrim me tituj të botuar më parë në të njëjtën fushë tematike, një karakteristikë që është pjesërisht e dobishme, por që gjendet rrallë te vështrime të tjera. Kur buxhetet janë të pakta, kur duhet bërë seleksionim, është me rëndësi të madhe që të bëhen krahasime.

Numri i gushtit, "shtojcë speciale" është një përmbledhje vjetore e burimeve më të mira të burimeve të referencës / temave në dispozicion në Internet. Ajo është një udhëzues i shkëlqyer i referencës aktuale në burime Interneti. Shumica e tyre merren nga botime të mëparshme. Ka karakteristika të veçanta, si ato në Internet nga Laura Cohen, që e bëjnë këtë dukshëm më shumë se përmbledhje e vështrimeve të mëparshme. Material bazë si për biblioteka publike, ashtu dhe për ato universitare.

Ndonëse më të shtrenjta në Internet sesa në formë të shtypur, vështrimet e revistës *Choice* në këtë format kanë karakteristikat e zakonshme të shtuara të të dhënave elektronike. Karakteristikat janë të ngjashme me vështrimet e tjera në Internet, p.sh. mundësia për të kërkuar jo vetëm sipas autorit dhe titullit, por edhe sipas fjalëve kyçe, datës, nivelit të leximit etj. Po ashtu, vështrimet shpesh paraqiten para se të futen në shtyp.

2. *Library Journal.* Edhe këtu, pjesa që ka të bëjë me vështrimin e përgjithshëm të librit nis me "Referencë". Ka afro 450 vështrime mbi referenca në vit. Ato janë 100 deri në 150 fjalë të gjata, rëndom të shkruara nga bibliotekarë apo mësues dhe të gjitha janë të nënshkruara. Po ashtu, *School Library Journal* përfshin vështrime të titujve të referencës.

Disa nga vështrimet më të mira të bazave të të dhënave për qëllime reference gjenden në *Library Journal.* Cheryl LaGuardia e Harvardit vlerëson si CD-ROM-ët ashtu dhe bazat e të dhënave në Internet në vështrimin e

saj "Baza e të dhënave dhe vështrimet e disqeve". Në mënyrën e saj metodike sistematike ajo vë në pah pikat e forta dhe të dobëta të secilës prej tyre dhe përfundon me sugjerimin e "më së mirës" për një situatë të caktuar të referencës. Vetë kolumna mjafton për shumicën e bibliotekarëve për të marrë vendime lidhur me titujt elektronikë të referencës.

Kolumna të tjera mbulojnë web-sajtet aktuale (p.sh. "Web Watch"), si dhe të fundit në teknologjinë kompjuterike.

Shënim: *Library Journal* mund të gjendet falas, në një formë të shkurtuar, në Internet. Jo të gjitha vështrimet janë në Internet. Një shërbim më shumë, *Academic Newswire* (www.bookwire.com/ljdigital/newswire/newswire.htm) mbledh lajme nga mbi 100 korrespondentë mbi kampuse dhe raporte librash.

3. *Reference & User Services Quarterly.* Pjesa e fundit e kësaj të përkohshmeje i kushtohet tërësisht vështrimit të librave të referencës. Në të trajtohen edhe një numër titujsh që janë të përafërt, por përkundër *Library Journal* dhe *Choice*, kjo nuk bën përpjekje për të vështruar libra të përgjithshëm. Afro 300 tituj të referencës trajtohen për çdo vit. Vështrimet kanë mesatarisht nga 200 fjalë secila.

Pos pjesës mbi "librat e referencës", vlerësohen edhe bazat elektronike të të dhënave. Ato janë vështrime të shkëlqyera, kritike, që merren me shërbimet që përdoren më së shpeshti në Internet. Së fundi, nën "materiale profesionale", ka 10 deri në 12 libra të vështruara për bibliotekarë që merren me punë reference. Sipas editorit, qëllimet e web-sajtit janë "t'i shërbejnë një sistemi të alarmimit të hershëm dhe një reference të përmbajtjes së botimeve të mëparshme".

4. *American Libraries*, revista mujore e Shoqatës Bibliotekare Amerikane (ALA), nuk bën vështrime të rregullta të librave të referencës, por ajo ka një prezantim vjetor të një fushe të interesit: "Burimet e jashtëzakonshme të referencës gjatë vitit", që del në botimin e majit, si një kompilim i titujve më të mirë të referencës gjatë vitit përzgjedhur nga Komiteti i Botimeve të Referencës i ALA-s. Zgjedhja bëhet mbështetur në cilësi dhe përshtatshmëri për biblioteka të vogla dhe të mesme. Përzgjedhja përfshin burimet digjitale. Përzgjidhen nga 35 deri në 45 tituj, kurse rezultatet, rëndom me secilën vepër të pajisur me shpjegues, paraqiten në botime të tjera bibliotekare. *Library Journal* ofron një konkurs, "Librat e referencës (të vitit)", me tituj të zgjedhur nga redak-

torët e vet të vështrimeve të librit. Kjo del në botimin e 15 prillit që i kushtohet pothuajse tërësisht shërbimeve të referencës.

5. "Librat e zgjedhur të referencës (të vitit)", botohet në numrin e marsit të *Colleges and Research Libraries.* Kjo është një listë e zgjedhur me kujdes e titujve që do të mund të prezantohen në numrin e ardhshëm të *Guide to Reference Books.* Dhe, ndonëse me vlerë parësore për bibliotekat akademike, ajo është një listë e dobishme e të gjitha llojeve dhe madhësive të bibliotekave.

Vështrimet e faqeve në Internet dhe faqet e uebit janë tipare të rregullta të burimeve të porsadiskutuara bazë të referencës së përgjithshme. Pos kësaj, në tërë këtë udhëzues, ka dhe burime të sugjestuara të Internetit për vështrime. Dhe, pothuajse nuk kalon javë që ky apo ai botues të mos ofrojë një udhëzues për burimet më të mira dhe të mira të Internetit, nëse jo gjithmonë për referencë, të paktën për nevojat e informimit të përgjithshëm të publikut. Shënim: Paradoksi është se pothuajse të gjithë udhëzuesit gjenden në shtyp dhe jo në formate elektronike.

Ka qasje të tjera për vepra reference dhe për informacion në fushën e shërbimeve të referencës. Këtu prin *Reference Services Review* (Ann Arbor, MI: Pierian Press, 1972 e tej, çerekshe). Kjo nuk vështron gjithaq libra të rinj saqë ofron më se 12 bibliografi. Ato mund të përfshijnë regjistrin e shpjeguesit mbi AIDS-in apo në gëzimin e ngjitjes në bjeshkë. Të gjithë autorët apo hartuesit janë ekspertë në fushat e tyre gjegjëse. Kohë pas kohe, po ashtu, ka vështrime të përgjithësuara të shërbimeve të referencës.

Ndonëse nuk ka vështrime, *The Reference Librarian* (Nju-Jork: Haworth Press, 1981 e tej, gjysmë-vjetore) përmban 15 deri në 25 artikuj mbi një temë të vetme me interes për bibliotekarët e referencës. Temat mund të renditen nga kërkimi në Internet deri te etika dhe mësimi nga distanca. Autorët janë bibliotekarë aktivë, të cilët ofrojnë një qasje unike në tema të ndryshme interesi.

INDEKSET E VËSHTRIMEVE

Në Internet: Book Review Digest. Nju-Jork: H. W. Wilson Company, 1984 e tej, javore, www.hwwilson.com. $25 deri $40 në orë. OCLC dhe shitës të tjerë.

CD: 1983 e tej, çerekshe, $1.095.

E shtypur: 1905 e tej, mujore. Shërbim.

Në Internet: Book Review Index. Detroit: Gale Group, 1969 e tej, 3 herë në vit; www.gale.com. Çmimi ndryshon. Dosja DIALOG 137, $57 në orë.

CD: Book Review Index në CD-ROM, 1965 e tej, vjetore. $1.250. Plotësim vjetor, $495.

E shtypur: 1965 e tej, dymujore. $215. Përmbledhjet 1965 e deri më sot. Çmimi ndryshon.

Titujt e diskutuar këtu janë të specializuar. Qëllimi i tyre i vetëm është të regjistrojë vështrimet mbi librat. Ato përdoren nga studentë dhe të tjerë që kërkojnë materiale plotësuese mbi një vepër të caktuar, si dhe nga bibliotekari i referencës lidhur me shënimet mbi libra të caktuar të referencës. Vështrimet *kufizohen* në libra të botuar. Me pak përjashtime, formatet elektronike nuk merren parasysh. Shënim: burimet e vështrimeve të burimeve elektronike do të gjenden në një pjesë tjetër të këtij teksti.

Revista jetëgjatë, e mirënjohur *Book Review Digest* është vendi ku bibliotekarët me përvojë shikojnë më së pari për vështrime – të paktën nëse libri është nga ndonjë autor i njohur apo kontravers. Autorë më pak të njohur rrallëherë mund të gjenden këtu, ngaqë është kërkesë e botuesit që (1) të paktën katër vështrime të një romani të botohen para se të regjistrohet romani dhe që (2) një minimum prej dy vështrimesh të jofiksionit të botohen para se të regjistrohet. Kjo zgjidh problemin e hapësirës, së paku në shtyp, por paraqet vështirësi – ngaqë romani i parë ndodhë rrallë që të ketë vështrim. Po kështu vlen edhe për titujt e rëndësishëm, por jo shumë të popullarizuar të jofiksionit.

Megjithatë, nëse libri bie relativisht në sy, atëherë *Book Review Digest* paraqet një burim ideal. Pse? Ngaqë ai ofron një përmbledhje të shkurtër të përmbajtjes së titullit të vështruar dhe, ç'është me më rëndësi, jep mjaft nga një fragment vështrimi për lexuesin, zakonisht për të mësuar se libri vërtet e vlen të kihet parasysh. Ky lloj i shpjegimit kursen mjaft kohë për të kërkuar vështrimin origjinal. Një përparësi tjetër e dukshme është se vepra e shtypur daton që nga viti 1905, duke i dhënë kështu kërkuesit një burim të rëndësishëm për vështrime bashkëkohore të shumë titujve, që tashmë janë bërë klasikë. Po ashtu, ka një qasje tematike ndaj shumë titujve të vështruar. Kjo mund të jetë e vlefshme kur dikush është duke

kërkuar një libër, të themi, mbi piratët dhe nuk e ka idenë lidhur me autorin apo titullin.

Bibliotekari duhet të dijë datën e përafërt kur është botuar libri. Metoda më e shpejtë është që thjeshtë të kërkohen vëllimet kumulative apo ata vjetorë me indekse, që nga viti 1983, CD-ROM-ët, apo shërbimi i Internetit. Nëse data nuk mund të gjendet dot në këto indekse, bibliotekari duhet të kërkojë në katalog, ku titulli do të ketë mundur të hyjë apo në ndonjërën nga bibliografitë kombëtare apo tregtare, siç është *Books in Print.* Një mundësi tjetër është të kërkohet titulli duke përdorur rrjetin bibliografik, siç është OCLC.

Book Reviews Index mbulon vështrimet në më se 900 të përkohshme që nga viti 1965 e tej. Botuesi nxjerr mbi 3 milionë citate nga afro 1.5 milionë tituj të veçantë. Përkundër *Book Review Digest-it,* ka vetëm një citim nga secili vështrim dhe jo një rezymim të përmbajtjes së vështrimit. Prandaj, përdoruesi duhet të gjurmojë për vështrimin para se të mund të marrë çfarëdo vendimi lidhur me cilësinë dhe pëlqyeshmërinë e librit. Nga ana tjetër, ka shumë më shumë tituj nga ç'gjenden në *Book Review Digest* (900 kundruall 100 të BRD-së). Është vendi i parë ku duhet kërkuar tituj që mund të gjenden në vetëm një a dy të përkohshme.

Vështrimet e shtypura janë të regjistruar në dy pjesë; së pari sipas autorit dhe së dyti sipas titullit. Për fat të keq, nuk ka qasje tematike. Mesatarisht, afro 75 000 libra mbulohen në vit, me afro një a dy vështrime për çdo titull. Kjo është në kontrast të thellë me një revistë tjetër kyçe të vështrimeve *Book Review Digest.* Këtu mund të gjenden vetëm 6 000 tituj të trajtuar.

Një tipar i dobishëm i indeksit për bibliotekarët e referencës është se të gjitha veprat e referencës janë të shënuara me një "r". Kështu, dikush mund të kërkojë nëpër botimet dymujore për informacion të plotësuar mbi vepra të reja ose t'i huq ato. Kode të tjera janë edhe "p" për një vështrim periodik dhe "c" dhe "y" për fëmijë (children) dhe të rinj (young people).

Versioni elektronik, natyrisht një zgjedhje më e mirë për ta blerë sesa një formë e shtypur, ofron një metodë të drejtpërdrejtë të kërkimit nga viti 1965 apo 1969 deri në ditët e sotme. Pikat e qasjes janë, natyrisht, autori dhe titulli; por pos kësaj mund të përzgjidhet kërkimi sipas të përkohshmeve, ku është paraqitur vështrimi, viti i botimit dhe të ngjashme. Po ashtu, përkundër formës së shtypur, këtu mund të kërkohet sipas temës, si dhe në bazë të fjalëve kyçe në tituj.

Buxhetet modeste të referencës do të diktojnë *Book Review Digest-in* si përzgjedhje të parë. Bibliotekat më të mëdha do të kenë që të dy shërbimet e vështrimeve.

Shumica e indekseve të të përkohshmeve dhe gazetave, të diskutuara në Kapitullin 4, përfshijnë citate të vështrimeve të librave. Me rastin e kërkimit të një vështrimi, të themi, mbi nj bestseller aktual, indeksi i përgjithshëm i revistave, sidomos në Internet, do të ishte vendi i parë ku duhet gjurmuar.

BAZAT ELEKTRONIKE TË TË DHËNAVE

Në Internet: Gale Directory of Databases. Farmington Hills, MI: Gale Group, 1994 e tej, gjysmëvjetore (shtator, mars), www.gale.com. Çmimi ndryshon. Po ashtu, dosja DIALOG 230, që përfshin *Cyberbound's Guide to Internet Databases* (të diskutuar më tutje në këtë tekst).

CD: 1993 e tej, gjysmëvjetore, $390.

Në shtyp: 1993 e tej, gjysmëvjetore, 2 vëllime. $340.

Udhëzuesi më i mirë i bazave elektronike të të dhënave, që nga CD-ROM-ët dhe shërbimet e Internetit e deri te shiriti magnetik është udhëzuesi gjithëpërfshirës *Gale Directory of Databases.* Nuk ka asgjë që i afrohet dhe është i domosdoshëm për ta blerë për çdo bibliotekë që ka pyetje lidhur me përmbajtjen dhe disponimin me baza elektronike të të dhënave. Në të, përshkruhen hollësisht më se 14 000 burime.

Një pikë me rëndësi: kjo është bibliografi e bazave aktuale të të dhënave. Ajo regjistron atë që është në dispozicion. Është jovlerësuese dhe nuk mund të përdoret si "më e mira" apo "më e mirë" më tej, ngaqë për nevoja të tilla mund të konsultohet *Books in Print.* Për të përcaktuar se cila është baza e të dhënave më e dobishme për një bibliotekë të caktuar duhet bërë lexime të tjera dhe sidomos vlerësime që gjenden nëpër të përkohshmet që diskutohen gjatë tërë këtij teksti.

Versioni i shtypur përbëhet nga dy vëllime. E para mbulon vetëm deri në 7 500 baza të të dhënave në Internet. E dyta përbëhet kryesisht prej afro 6 500 CD-ROM-ve, me pjesë të tjera në disketa, shirita magnetikë, produkte dore dhe artikuj qasjesh të përbashkëta. Në që të dy vëllimet, ka tre indeksa ndihmës: prodhuesit e bazës së të dhënave (afro 4 000), me emrat dhe adresat e tyre, si dhe të gjitha produktet e tyre, të cilat nga ana tjetër,

janë të shumta dhe kanë të bëjnë me pjesën e parë të udhëzuesit. Shërbimet e Internetit (afro 2 500) përmbajnë kryesisht regjistra të shitësve, si dhe një indeks gjeografik. Indeksi tematik është paksa tepër i gjerë, por loz njëfarë roli. Së fundi, indeksi i plotë master mbulon çdo gjë lidhur me librat.

Një ese hyrëse (që përsëritet në çdo vëllim) jep një pasqyrë të gjendjes së artit të të dhënave për vitin paraprak. Kjo duhet të lexohet me detyrim. Shpesh e shkruar nga ekspertja e ekspertëve, Martha Williams, ajo pasqyron sasinë dhe cilësinë e burimeve elektronike të informacionit. Shih po ashtu botimin e Williams-it, "New Database Products", që del dy herë në vit në revistën *Online & CD-ROM Review.*

Brenda secilit vëllim ka njësi individuale për tituj të aranzhuar në rend alfabetik. Një qasje sistematike ofron informacion të ngjashëm bazë për secilin artikull. Ka 21 pjesë të ndryshme të të dhënave që nga adresa dhe numri i faksit dhe telefonit të prodhuesit e deri te "formatet alternative elektronike" për produktin, aty ku kjo është e mundur. Thelbi i informacionit është shënimi mbi "përmbajtjen", që sjell informacion të saktë lidhur me atë që është përfshirë në bazën e të dhënave. Vitet e mbulimit, dendësia, çmimi, si dhe informacioni tjetër janë pjesë e secilës njësi përshkruese.

Versionet në Internet dhe në CD-ROM janë, s'do mend, shumë më të lehta për t'u kërkuar sesa ato të dy vëllimeve të shtypura. Por informacioni në që të dyja është pothuajse i njëjtë. Sidoqoftë, udhëzuesi i referencës ka të ngjarë të përdoret po aq nga laikë sa dhe nga bibliotekarë dhe, në cilëndo formë qoftë, ajo duhet të gjendet në shumicën e bibliotekave.

BIBLIOGRAFITË: MATERIALET JO TË SHTYPURA

Diskutimi i mëparshëm është kufizuar në udhëzues dhe indekse te bibliografi të shtypura dhe elektronike. Ka dhe një grup tjetër i madh i veprave të referencës që quhen "jo të shtypura". Nën këtë term, jo fort të saktë ombrelle, mund të gjenden dy formate të njohura universalisht: (1) Fotografitë lëvizëse, qoftë si animacion, qoftë video apo pjesë të hipertekstit të CD-ROM-ve; (2) Zëri, nga muzika në CD deri te sinkronizimit në DVD. Përpos këtyre dy burimeve jo të shtypura të komunikimit, ka artikuj të tjerë, si globet, materiale e projektorëve mbi mur e deri te modelet. Këto referencës, sidomos në biblioteka shkollore, apo, siç quhen, "media qendra shkollore" apo "qendra të të mësuarit".

Me rastin e punës me burime të tjera nga librat, bibliotekari i referencës funksionon ngjashëm me kur punon me media tradicionale:

1. Në shkolla, universitete dhe kolegje, bibliotekari do të ftohet nga kujdestari i klasës për informacion nga mediat që janë në dispozicion në bibliotekë dhe që mund të porositen, apo madje edhe të huazohen nga biblioteka të tjera;

2. Studentët do të mund të kërkojnë informacion dhe këshilla lidhur me multimediat për procesin parësor të të mësuarit;

3. Nevojat e një laiku do të jenë gati të ngjashme, ndonëse këtu theksi kryesor do të mund të përqendrohet në këshillimin lidhur me videot, regjistrimet e bibliotekës e të tjera, që mund të zgjerojnë diturinë (apo interesin rekreativ) përtej librit tradicional.

Bibliotekari i referencës duhet të jetë komunikues me të paktën bibliografitë themelore dhe mjetet e kontrollit të medias. Njohuria mbi bibliografitë dhe burimet është e rëndësishme për të gjetur përgjigje në pyetjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me materialet audiovizuale: “Ku mund të gjejë këtë e atë, një katalog filmash, regjistrimesh, shiritash?”, “A keni diçka në video që do ta ilustrojë këtë apo atë?”, “Çfarë keni të regjistruar apo në video që ka të bëjë me historinë vendore?”. Në biblioteka të mëdha, pyetje të tilla mund t’i shtrohen departamentit përkatës, por në biblioteka të vogla dhe të mesme, këto pyetje rëndom duhet të marrin përgjigje nga bibliotekari i referencës.

Udhëzuesit dhe bibliografitë

Në internet: A-V Online, Norwood, MA: Silver Platter, 1988 e tej, çerekshe, www.silverplatter.com. Çmimet ndryshojnë. Dosja DIALOG 46, $30 në orë.

CD: NICEM Reference CD-ROM, 1999 e tej. Çmimet ndryshojnë.

E shtypur: NICEM Media Index. Albuquerque, NM: NICEM (National Information Center for Educational Media – Qendra Kombëtare Informative për Media Edukative), 1964 – nuk është më në shtyp. Çmimet ndryshojnë.

Nuk ka bibliografi plotësisht të kënaqshme për materiale jo të shtypura. Nuk ka asgjë që jep një pasqyrë të materialeve siç gjendet në *Books in Print*

apo *Guide to Reference Books* për materiale të shtypura. Në mungesë të kontrollit të përgjithshëm bibliografik, materialet është vështirë të gjurmohen. Mungesa e mjeteve të tilla janë në masë të madhe shkaktare për zhvillimin e ekspertëve të mediave, që janë të njohur me shumë mënyra qasjeje.

Gjëja më e afërt me *Books in Print* për materiale audiovizuale është *A-V Online.* (Në shtyp kjo ishte *NICEM Media Indexes).* Qëllimi i *A-V Online* është që të ofrojë informacion jokritik lidhur me atë se çfarë ka në dispozicion nga materialet jo te shtypura. Dhe, ndonëse u drejtohen nevojave të shkollave fillore dhe të mesme, një pjesë e madhe e të dhënave janë të aplikueshme te lloje të tjera të bibliotekave. Së këndejmi, ato mund të përdoren për t'u përgjigjur në pyetje të tilla si "çfarë transparencash ka në dispozicion për gjeografinë?", "Çfarë filmash edukativë ka për shtazët?", "Po, për studimet mjedisore?", e kështu me radhë. Faktikisht, baza e të dhënave përmban më se 455 000 regjistrime, shpesh me abstraksione, të materialeve edukative. Kjo "edukative" duhet të theksohet. Nuk ka asgjë këtu që do të mund të kalonte për, të themi, një film standard të shkallës B. Baza e të dhënave përfshin: shirita filmi prej 16 e 35 milimetrash, transparencat, audio dhe video shiritat, regjistrimet që nga shtypi i hershëm deri te CD-të e avancuara, slajdet dhe fishekët 8-milimetërsh të filmit, CD-ROM-ët dhe softuerët janë të indeksuara po ashtu, ndonëse jo tërësisht.

NICEM Print Indexes (tani jashtë shtypit) kanë qenë një sërë indekseshindividuale dhe jo një fjalë e vetme. Secili artikull shpjegohet shkurtimisht, por me vetëm një përshkrim dhe jo me vlerësim. Informacioni i plotë është dhënë lidhur me koston, huazimin (kur është në dispozicion), si dhe informacioni i domosdoshëm bibliografik për identifikim dhe renditje.

Books in Print (shih kapitullin e ardhshëm) është burim i materialit A-V, por këto janë të kufizuara për nga lloji. BIP ofron një *Complete Video Directory* (1991 e tej, çerekshe), që mbulon jo vetëm materialet edukative, por edhe zbavitjen popullore që nga videot ushtrimore deri te filmat. Shih, po ashtu, serinë vetëshpjeguese *Words on Cassette* (1994 e tej, vjetore), që ofron një informacion jetik për audio librat. Që të dy këto pjesë janë pjesë e versionit digjital të *Books in Print.* Një udhëzues tjetër i dobishëm bibliografik është *World Cat* i OCLC-së, që është diskutuar më vonë, që shpesh do të ofrojë me shumë regjistrime A-V nga ç'ka në *A-V Online.*

Indeksi te vështrimet mediale

CD-ROM: Media Review Digest. Ann Arbor, MI: The Pierian Press, 1989 e tej, vjetore. $395 deri në $600.

E shtypur: 1970 e tej, vjetore. $250.

Media Review Digest indekson vështrimet e mediave që janë paraqitur në më shumë se 150 të përkohshme. Mbi 20 000 vështrimet e indeksuara për çdo vit përfshijnë citate të plota sipas llojit të medias. Disa nga ekspertët e vështrimeve jepen dhe një shenjë vlerësuese tregon se a janë komentet të favorshme apo jo. Bibliotekari mund ta përdorë atë pothuajse njësoj si indekse të vështrimeve të librave, do të thotë, të vëzhgojë vështrimet, mbase me qëllim të blerjes apo të huazimit të një artikulli të caktuar. Informacioni i ofruar është i plotë dhe përfshin shpesh përshkrime të materialit, si dhe informacion katalogizues.

Formati elektronik ka jo vetëm vështrimet e librave, por ofron edhe linket për afro 300 000 vështrime në Internet.

Prapë, si dhe me vështrimet e librave, bibliotekari mund t'i kthehet indeksit të të përkohshmeve, mundësisht një në Internet, për vështrime të fundit të mediave, që nga videot e deri te filmat dhe CD-të.

Precision One MediaSource (Williamsport, PA: Brodart Automation,1994 e tej, vjetore, $395) është një CD-ROM që i ofron përdoruesit qasje në mijëra njësi mediale nga CD-ROM-ët e videot deri te filmat dhe regjistrimet. Këto paraqesin përmbajtjet dhe përpjekjet e Konsorciumit të Qendrave Mediale të Kolegjeve dhe Universiteteve që punon me Brodartin për të prodhuar bazën e të dhënave. Për secilën është dhënë informacion i plotë bibliografik, si dhe informacion lidhur me koston për blerje apo huazim. Bibliografia mund të gjendet përmes titullit, temës, kohës së botimit, prodhuesit dhe të ngjashme. Më e kufizuar se burimet e tjera të shënuara këtu, ajo shërben nj qëllimi të dobishëm për identifikim dhe verifikim.

Mikroforma

E shtypur: Guide to Microforms in Print: Author – Title. New Providence, NJ: R. R. Bowker, 1961 e tej, vjetore, 2 vëllime. $430.

Ndonëse ka shumë arsye për të besuar se pas një a më shumë dekade

mikroforma do të zëvendësohet plotësisht nga tekste të plota në formë digjitale (në Internet, CD-ROM, etj.), sot ajo mbetet një pjesë e rëndësishme e shumë koleksioneve bibliotekash.[6] Mikroforma përdoret në biblioteka për të kursyer hapësirën për të mbajtur bibliografitë dhe ndihmësit e tjerë të referencës relativisht aktualë dhe për të pasur qasje të lehtë për përdoruesit.

Mikroforma ekziston në dy formate: në rrotulla dhe transparencë të rrafshët apo në kartë. Rrotulla 35-milimetërshe ka ekzistuar në biblioteka për aq gjatë saqë shumë bibliotekarë dhe përdorues kanë parasysh vetëm këtë formë sa herë që përmendet mikroforma. Mikroforma e rrafshët gjendet në disa forma themelore: (1) mikrofish, apo fish, është në dispozicion në madhësi të ndryshme, por më e favorshme është forma standarde 4 me 6 inçë, me mesatarisht 8 faqe në një fletë. Reduktime të ndryshme mund ta shtojnë apo pakësojnë numrin e faqeve në një fletë; (2) Ultrafish, siç vetëkupton emri, është një reduktim ultra e lëmuat, rëndom në një transparencë prej 4 inçë me 6. Një kartë mund të përmbajë deri në 100 faqe të tekstit në 10 radhë dhe 10 shtylla.

Për qëllime të deponimit dhe praktike, shumica e bibliotekarëve me përmbajtje substanciale të të përkohshmeve dhe gazetave i deponojnë ato në mikroformë. Librat, sidomos ato që mund të gjenden vështirë apo që janë jashtë shtypit, janë në mikroformë, siç janë dhe vepra të ndryshme të shtypura, që nga raportet deri te dokumentet qeveritare.

Ekuivalenca e *Books in Print* për mikroformën është versioni gjithnjë në rritje *Guide to Microforms in Print.* Ajo përmban një listë alfabetike me mbi 100 000 tituj nga më se 500 botues, përfshirë dhe firma ndërkombëtarë. Radhitur sipas titullit dhe autorit në një listë alfabetike, ky udhëzues shënon libra, revista, gazeta, botime qeveritare dhe materiale gjegjëse. Gjashtëmbëdhjetë lloje të ndryshme të mikroformës janë përfshirë, kurse llojet, me shpjegime, janë dhënë në parathënie. Ky është një partner i *Subject Guide to Microforms in Print* (2 vëllime, $430), që përmban të njëjtët tituj nën afro 400 njësi tematike. Vëllimi i tretë është një shtojcë që botohet gjashtë muaj pas botimit kryesor dhe shton afro 2 500 tituj.

[6] Minuesi i ardhmërisë së mikrofilmit është kryesisht prodhuesi, Bell Howell. “Iniciativa digjitale e arkës” e tij (një eufemizëm ky për vdekjen e afërt të mikrofilmit) do të sjellë 5.5 miliardë faqe të asaj që tani është në mikrofilm në formë digjitale, që do të mund të lexohet në kumpjuter. Një lojëtar tjetër, Chadwyck-Healey ofron 3.500 revista dhe materiale të tjera të shtypura që nga fundi i shekullit XVIII.

SUGJERIME PËR TË LEXUAR

Bordeianua, Sever et al., "Paraqitja e burimeve elektronike me ueb OPAC...", *Reference Services Review,* pranverë 2000, f. 111-118. Autorët përshkruajnë katalogët kompjuterikë të mbështetur në ueb të qasjes publike (OPAC) që janë një link vital në zinxhirin bibliografik. Literatura është shqyrtuar dhe autorët dalin me disa sugjerime lidhur me atë se si të përmirësohet ky shërbim. Po ashtu, merren parasysh njësi të tjera me bazë ueb-i në përmbajtjet e bibliotekës.

Harmon, Robert, *Elements of Bibliography (Elementet e bibliografisë).* Metuchen, NJ: Scarecrow Press, 1989. Ky është një udhëzues bazë në themelet e bibliografisë për fillestarë. Është sidomos e mirë në diskutimin e bibliografive numerative që përdoren shpesh. Vëmendje i është kushtuar edhe formave elektronike të bibliografisë.

Jordy, Matthew et al., "Vështrimet e librave si mjet i vlerësimit së reputacionit të botuesit", *College & Research Libraries,* mars, 1999, f. 132-142. Variantet dalluese në vështrimet rëndom pozitive i mundësojnë lexuesit të kujdesshëm që të sigurohet se cilët janë botuesit e mirë dhe më të mirë. Studimi në thellësi e qartëson këtë, si dhe relacionet e ndryshme ndërmjet çmimit dhe cilësisë – jo gjithnjë në lidhshmëri. Po ashtu, ka një shikim të përqendruar në *Choice* si burim vështrimi. Mattos, Jodie dhe Joseph Yue, "Kursimi i parasë duke përdorur libraritë në Internet", *Computers in Libraries,* maj 2000, f. 42-47. Derisa fokusi bie mbi shërbimet dhe premtimet e Amazon.com, përdorimet e ndryshme të librarive në Internet për qëllime bibliografike do t'u interesojë shumë bibliotekarëve të referencës.

Stokes, Roy, *A Bibliographical Companion (Shoqëruesi bibliografik).* Metuchen, NJ: Scarecroë Press, 1989. Një fjalor termash që zbatohen në bibliografi. Përshkrimet, terminologjia dhe qasja e përgjithshme janë sa përndriçuese aq edhe argëtuese për lexim. Shumë e rekomanduar si për fillestarë ashtu dhe për ekspertë të ardhshëm.

Studies in Bibliography (Studime në bibliografi), Charlottesville, VA: Universiteti i Virxhinisë, data të ndryshme. Botuar për Shoqërinë Bibliografike të Universitetit të Virxhinisë, ky botim vjetor përmban artikuj me interes të veçantë për bibliografë tekstualë dhe analitikë.

Një shikim kursor në cilindo nga kontributet do t'i japë studentit një ide të shkëlqyer lidhur me atë se për çfarë është ky proces. Përpos kësaj, shumë nga pjesët janë vetvetiu pjesë të mira leximi.

Zalewski, Daniel, "Përmes xhamit të shikimit", *Lingua Franca,* qershor/korrik 1997, f. 6-7. Një përshkrim i përdorimit të Kolatorit Portabël McLeod, një mjet që i mundëson bibliotekarit analitik dhe tekstual për të krahasuar edicione të ndryshme të të njëjtit libër. Në përshkrimin e makinës modeste, autori vë në pah gëzimin dhe harenë e gjurmimit të diskrepancave, të mëdha dhe të vogla, në variacione të ndryshme të një titulli të njëjtë.

KAPITULLI IV
BIBLIOGRAFITË KOMBËTARE DHE TREGTARE

"Çfarë ka në dispozicion lidhur me shtizën dhe gjuajtjen e balenave?", pyet një lexues i pasionuar i *Mobi Dikut.* Ka aq shumë mënyrë për t'u përgjigjur në këtë pyetje, sa ka edhe ahabë të ditëve të kaluara. Një qasje e shëndoshë, sidomos për një person, i cili dëshiron sa më shumë material sa ç'ka në dispozicion (apo që ai/ajo mendon) është që ta konsultojë një bibliografi kombëtare dhe/apo tregtare.

Po, pyetjet do të mund të ushqehen në një aparaturë gjurmuese Interneti. Po, rezultatet do të gjendeshin aty. Problemi me këtë qasje, siç është theksuar gjatë tërë tekstit, është se ajo është e ngjashme me përdorimin e një revoleje për të goditur syrin e një demi në largësi. Është më efikase, më kursyese dhe gjithsesi më e saktë që të përdoret një pushkë, apo një shigjetë dhe shtizë. Jo që të teprohet me metaforë, por bibliografia i jep bibliotekarit armën e duhur për të gjetur atë që është e nevojshëm pa huqur asnjë plumb në Internet.

Dallimi i parë ndërmjet bibliografisë së tregut dhe asaj kombëtare, siç është definuar në kapitullin e mëparshëm, është se e para kufizon punën e vet në vepra të botuara apo që kanë burimin nga një vend i caktuar. Biblioteka kombëtare kalon përtej kufijve kombëtar për të marrë të tërë atë që ka vlerë anembanë botës.

Bibliografi të panumërta kombëtare, si katalogu i Bibliotekës së Kongresit, *National Union Catalog* kanë fjalën "union" në përbërjen e tyre. Pse? Sepse, katalogu jo vetëm që zbulon çdo gjë lidhur me një publikim – por ai tregon, po ashtu, se ku mund ta gjejë bibliotekari artikullin X apo Y.

Përtej theksimit të atributeve të një artikulli, një katalog unioni tregon edhe se kush çfarë ka. Një definicion më i plotë, shpesh i përsëritur është ky: Një katalog unionin është një inventar i zakonshëm për disa biblioteka; ai shënon disa apo të gjitha publikimet e tyre të ruajtura në një a më shumë biblioteka. Përdoruesi i kthehet një liste unioni për të gjetur një libër të caktuar, CD-ROM, të përkohshme, apo gazetë në një bibliotekë tjetër, që mund të jetë njëkohësisht në të njëjtin qytet, apo mijëra milje më larg. Duke pasur parasysh lokacionin dhe funksionimin e huazimit ndërbibliotekar, procesin e kopjimit apo shërbimet e Internetit, përdoruesi mund ta ketë atë libër apo artikull të veçantë të huazuar nga biblioteka përmbajtëse.

Vallë, a janë të përdorshëm katalogë të tillë në një epokë elektronike? Po, vërtet janë të nevojshëm. Nëse asgjë tjetër, ata ndihmojnë për të ngushtuar kërkimin e artikujve relevantë dhe specifikë. Ndihmës të tillë do të vazhdojnë, në dhe jashtë Internetit, me gjenerata të tëra.

KATALOGU I UNIONIT KOMBËTAR (MARC)[1]

Në Internet: Library of Congress Catalogs. Uashington, DC: U.S. Library of Congress, 1968 e tej, javore. Dosja DIALOG 426, $30 në orë. OCLC, RLIN, plus bartës të tjerë.

CD: CDMARC Bibliographic, 1968 e tej, çerekshe. $1.200. *Në Internet: Library of Congress Online Catalogue*, http://1cweb.loc.gov/catalog. Pa pagesë.

Katalogu i Unionit Kombëtar (*National Union Catalog)* apo NUC, siç quhet shpesh, është bibliografi që konsultohet shpesh. Sot, NUC-ja është aq shpesh pjesë e kërkimeve në Internet sa çdo vepër reference në bib-

[1] Shënim: Këtu, si gjetiu në këtë kapitull dhe në tekst në tërësi, adresa për abonim (i.e. për një pagesë) në bazat e të dhënave është ajo e botuesit dhe jo e bazës së të dhënave. Për të gjetur bazat e të dhënave me pagesë (siç shprehet përmes çmimit të abonimit): (a) futuni në web-sajtin e bibliotekës. Baza e të dhënave rëndom shënohet aty me një link për qasje të lirë për qasje në baza të të dhënave me pagesë; (b) Përdorni adresën elektronike të botuesit të dhënë këtu. Do të mund t'u duhet që të gjurmoni për titull të veçantë në katalogun në Internet apo sistemin e kërkimit. Porsa ta keni gjetur, botuesi do të mund t'u ofrojë një a dy mostra të kërkimit. Futuni menjëherë në adresë për baza të të dhënave pa pagesë, ato që bartin shenjën "free".

liotekë. Pos për raste të parëndomta, mikrofilmi apo vëllime të shtypura (që janë përdorur para të bazave të të dhënave elektronike) nuk përdoren. Mikrofishi është, të themi të paktën, i parëndomtë dhe i lodhshëm si shikim kursor, siç do të dëshmohet në udhëzimet e botuara nga Biblioteka e Kongresit.

Sot, bibliotekat dhe individët konsultojnë NUC-në si pjesë e një sistemi më të gjerë bibliografik, siç është OCLC. Dikush kërkon një libër nga Amy Cruse në Internet përmes OCLC-së. Në shumicën e rasteve, ajo është një shënim NUC. Dikush mund të bëjë edhe një hap më tej dhe të shohë se cilat biblioteka e kanë këtë libër. Pashmangshmërisht, del simboli i Bibliotekës së Kongresit, si dhe simbolet e bibliotekave në pjesë të ndryshme të vendit dhe madje edhe jashtë.

Vlen të përmendet se poenta këtu është kjo: këtyre ditëve të pakta janë ato biblioteka që hyjnë drejtpërdrejt në NUC. Ato e përdorin atë si pjesë të një shërbimi bibliografik me pagesë. Ndërkaq, gëzimi këtu është se personat laikë që kërkojnë informacion pa pagesë mund të kërkojnë NUC-në e shkurtuar drejtpërdrejt përmes *Library of Congress Online Catalog (Katalogu në internet i Bibliotekës së Kongresit).* Kjo është e mundur pasi që të gjitha bazat e të dhënave qeveritare janë pa pagesë për publikun.

Kushdo që është duke kërkuar një libër (sipas autorit, temës, apo sipas titullit) në një katalog bibliotekar lokal në Internet mund të kuptojë gjerësinë dhe qëllimin e katalogut *National Union Catalog.* NUC-ja është një version shumë i zgjeruar i universitetit tuaj, publikut apo katalogut të bibliotekës shkollore.

Sfondi

Katalogu i Unionit Kombëtar filloi në formë kartele në vitin 1901. Më 1926, NUC-ja kishte mbi dy milionë kartela, të vendosura fizikisht në Bibliotekën e Kongresit. Kushdo që dëshironte të konsultonte NUC-në duhej të pyeste Bibliotekën e Kongresit apo të shkonte atje personalisht. Problemi u zgjidh, apo mendohej ashtu, duke dërguar kartela të dyfishta të NUC-së bibliotekave kyçe kërkimore anembanë Shteteve të Bashkuara. Kjo procedurë u dëshmua si e shtrenjtë pasi që ishte joefikase. Prandaj, duke filluar që nga fillimi i viteve 1940, puna filloi në katalogun e shtypur – libër. Kartelat individuale u reprodukuan në formë të njohur libri të NUC-së, në vend se t'u dërgohej bibliotekave kartelë më kartelë.

Megjithëkëtë, nuk u vendos deri më 1 janar 1956 m që katalogët e librit duhej të zgjeroheshin për të përfshirë pos depozitimet e Bibliotekës së Kongresit, por edhe ato të bibliotekave të tjera.

Çfarë do të bëhej me *Katalogun e Unionit Kombëtar* të para vitit 1956, do të thotë me katalogun me kartela në Bibliotekën e Kongresit, që nuk ishte në formë libri? Përgjigja u gjet në vitin 1968 kur *Katalogu i Unionit Kombëtar: dokumentet e para vitit 1956* filluan të botoheshin.

Dokumentet e para vitit 1956 (Londër: Mansell, 1968-1981, 754 vëllime, $35.000. Mikroformë: $11.750) janë një *Katalog i Unionit Kombëtar* kumulativ. Më se 11 milionë njësi paraqesin përmbajtjet e NUC-së para vitit 1956. Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë, nga mikrofishi në katalogë Interneti, zvogëlon gjasat që të ketë ndonjëherë një bibliografi tjetër të shtypur të kësaj madhësie. (E balancuar njëra mbi tjetrën, vëllimet 13.6 inçë të trasha në një libër të vetëm do të arrinte lartësinë e ndërtesës së Pan-Amit në Nju-Jork). Me tërë këtë, kthesa ndodhi te formatet elektronike nga mesi i viteve 1980. Vendin e tyre e zuri NUC-ja në Internet.

Fushëveprimi

Cili është fushëveprimi i NUC-së së sotme?

Në një terminal kompjuterik mund të kërkohet përshkrimi i plotë bibliografik i materialit, pjesa më e madhe e të cilit gjendet në Bibliotekën e Kongresit dhe që është kataloguar që nga themelimi i koleksionit. Në të njëjtën kohë, mund të gjenden tituj që janë unike për një a më shumë nga 1500 bibliotekat e tjera që i ushqejnë informacione NUC-së. Në të vërtetë, fushëveprimi është shumë i gjerë sa për të përmbajtur virtualisht çdo libër të botuar nga shtypshkronja e parë në Koloni e deri te ditët e sotme. Fusha e veprimit është shumë më e gjerë ngaqë ajo përfshin edhe tituj nga mbarë bota.

Pos afro 4 milionë librave, ka artikuj në formate të ndryshme, që nga hartat dhe të përkohshmet deri te dorëshkrimet dhe regjistrimet. Që të gjitha mund të gjenden përmes NUC-së së njëjtë. Ato janë në dispozicion në Internet si pjesë e familjes LCMARC, d.m.th. pas *LCMARC: Books All* (*librat*) ka dhe *LCMARC: Maps (hartat)*, (me afro 150 000 harta); muzikë (110 000 a më shumë pjesë të shtypura muzikore dhe dorëshkrime muzikore); seri (mbi 700 000 seri); dhe materiale vizuele (140 000 njësi në dispozicion).

Përgjithësisht, *National Union Catalog* i ofron individit mesatar të gjitha informacionet bibliografike që i nevojiten. Megjithëkëtë, ka raste kur do të ketë nevojë për më shumë detaje, kur një artikull është aq i rrallë, aq i pagjëshëm dhe aq ezoterik saqë nuk mund të përshkruhet në tërësi (sidomos në kuptim të rëndësisë së tij në zhvillimin e një teme) në NUC. Në këtë rast, kërkimi çon drejt një prej bibliografive të shumta retrospektive, numerative, analitike apo tekstuale. Bibliografitë themelore të këtij lloji vështirë gjenden të regjistruara si në *Guide to Reference Books* ashtu dhe në *Guide to Reference Materials*, si dhe bibliografitë e specializuara që kanë të bëjnë me çdo gjë që nga historia e të shtypurit e deri te historia e mjekësisë.

Përdorimi

Si përdoret katalogu *National Union Catalog (NUC)* në vepra të referencës? (Ajo që pason këtu ka të bëjë sidomos me formatin e shtypur, por përmbajtja është e njëjtë edhe për format e digjitalizuara).

1. Pasi që ky është një katalog unioni që tregon jo vetëm fondet e Bibliotekës së Kongresit, por edhe titujt në mbi 1 500 biblioteka të tjera, ai i mundëson bibliotekarit të referencës që të gjejë shpejt një titull të caktuar. Kështu që, përdoruesit që u duhet një vepër që nuk e kanë në bibliotekën e tyre mund të gjejnë lokacionin më të afërt në *National Union Catalog.* Për shembull, botimi i parë i *I Remember (Më kujtohet)* i J. Henry Harper, identifikohet si libër që gjendet në tetë biblioteka të tjera. Simbolet e lokacionit për që të tetat janë: OOxM, TxU, OCU, OCL, MnU, NIC, ViBibV dhe WU. Këto iniciale përfaqësojnë bibliotekat në anë të ndryshme të Shteteve të Bashkuara dhe shpjegohen në fillim të vëllimeve kumulative dhe në Internet. Varësisht nga politika e fondeve të bibliotekës, bibliotekari mund apo nuk mund të huazojë titullin përmes huazimit ndërbibliotekar. Po qe se huazimi nuk është i mundur, atëherë mund të bëhet kopjimi i pjesëve. Të gjithë titujt pa ndonjë indikacion nga ana e bibliotekës kontribuuese mbahen nga Biblioteka e Kongresit. (Simboli i kësaj Biblioteke është DLC).

2. *National Union Catalog* barazohet në të vërtetë me një bibliografi

të plotë themelore autoriale. Kushdo që dëshiron të dijë për çdo libër (artikull revistash dhe njësi të tjera të tilla) që ka botuar autori X vetëm duhet ta konsultojë emrin e tij.[2]

3. Nuk ka fund të mundësive të kërkimit të temës, sidomos të bazave digjitale të të dhënave, ku është e mundur të kërkohet jo vetëm për titujt tematikë të shënuar të Bibliotekës së Kongresit, por gjithashtu edhe për fjalët kyçe në tituj dhe materiale përshkruese. Pos nëse është një temë jashtëzakonisht ezoterike, bibliotekari pashmangshmërisht do të ketë nevojë të modifikojë sipas vendit, kohës e kështu me radhë, apo që të zhytet në një tepri materialesh.[3]

4. *NUC-ja* jep detajet mbi një libër (p.sh. se kur është botuar, nga kush dhe ku) dhe i ndihmon bibliotekarit të referencës që të verifikojë se ai ekziston – një çështje me rëndësi kur kemi të bëjmë me pyetjen se një botues i caktuar vërtet e ka botuar atë apo këtë. Mirëpo, verifikimi është edhe më i rëndësishëm kur bibliotekari i referencës përpiqet të ndreq keqshqiptimin e një titulli apo emrin e ndonjë autori. Me fjalë të tjera, NUC krijon rregull në shënime aty ku ka dyshim lidhur me validitetin e një pjesë të informacionit.

5. Në kuptim të krijimit të fondusit, sidomos me artikuj të shtrenjtë apo të rrallë, NUC-ja i lejon një biblioteke që të përqendrohet në fusha tematike me sigurime se fushat më pak të zhvilluara mund të përmirësohen përmes huazimit ndërbibliotekar nga biblioteka të tjera.

---

[2] NUC referohet në Internet në dy pjesë: (1) MARC, një shkurtesë për *machine-readable cataloging (katalogimi me lexim mekanik)*, ka referencë në NUC që nga viti 1968 e deri më sot dhe tani përbëhet nga më shumë se 3 milionë shënime. Ajo plotësohet për çdo muaj me afro 15 000 shënime të reja në muaj; (2) REMARC, një shkurtesë për *retrospective machine-readable cataloging (katalogimi retrospektiv me lexim mekanik)*, apo MARC retrospektiv ka referencë kryesisht, ndonëse jo ekskluzivisht, tek shumë nga shënimet në *Pre-1956 Imprints set.* Për një shpjegim të lehtë të detajuar të MARC shih: *Understanding MARC Bibliographic (*Washington, DC*:* The Library of Congress). I plotësuar shpesh, 30 faqe janë pa pagesë për bibliotekarë. OCLC *WorldCat* (thelbi i së cilës është NUC-ja) raportonte në *OCLC Newsletter* (nëntor 1997, f. 13) se Uiliam Shekspiri i prin listës së 100 autorëve të mëdhenj me më shumë njësi (31.187) në katalog. Pak më shumë se gjysma (14.118) gjendën nën emrin e Carls Dikensit, pasuar nga Gete (10.323), Ualter Skot (9.733) dhe Martin Luteri (8.332).

[3] Titujt tematikë vijnë nga *Library of Congress Subject Headings,* që diskutohet në kapitullin mbi indekset.

6. Në kuptim të katalogimit (që është themelor për shërbimin e referencës), NUC-ja ofron një numër përparësish. Mjeti kryesor është katalogimi qendror, i cili do ta kufizojë sasinë e katalogimit origjinal të domosdoshëm.

7. Përparësia e shtatë e *Katalogut Kombëtar të Unionit* është psikologjike sa dhe reale. Vetë ekzistenca e tij i ofron bibliotekarit (dhe shfrytëzuesve të tij laikë më të angazhuar) një ndjenjë të rregullit dhe kontrollit, që ndryshe do të mungonte në një botë që thërret për njëfarë lloj rendi.

Versioni i NUC-së në Internet mund të përdoret (1) duke pasur qasje përmes një OCLC-je apo RLIN-i; (2) përmes një biblioteke individuale që ka NUC-në si pjesë të katalogut bibliotekar në Internet dhe (3) thjeshtë duke blerë CD-ROM-ët apo shirita të botuar nga Biblioteka e Kongresit për përdorime të ndryshme, private dhe publike.

Në Ueb

NUC-ja që mund të gjendet në Ueb, si pjesë e një mjeti më të madh bibliografik, siç është OCLC-ja, bëhet me abonim, d.m.th. me parapagim.

Një version tjetër i NUC-së është pa pagesë, por ai kufizohet vetëm në libra që janë të kataloguar nga Biblioteka e Kongresit dhe jo te ato që gjenden në bibliotekat e NUC-së. Ky është *The Library of Congress Online Catalog (Katalogu në internet i Bibliotekës së Kongresit).* Pasi të ketë gjetur titullin në këtë katalog, shfrytëzuesi mund të përcaktojë nëse ai është në dispozicion në bibliotekën X apo Y me anë të konsultimit të "Search Other Catalogs" ("Kërkoni katalogë të tjerë"), një karakteristikë e Katalogut LC në Internet.

Katalogu pa pagesë në Internet nga LC-ja ka mbi 12 milionë shënime – që nga librat deri te filmat. Krahasimisht, NUC-ja ka mbi 100 milionë shënime. Megjithëkëtë, 12 milionë mjaftojnë për shumicën e kërkuesve, p.sh. *Books in Print* ka vetëm mbi 3 milionë tituj, të kufizuar, që të jemi të sigurt, vetëm në libra.

Të gjitha metodat standarde të kërkimit janë në dispozicion që nga autori e tema deri te titulli dhe numri regjistrues. Një kërkim tipik do të

kalojë nëpër 5-6 tituj për tema më ezoterike dhe ekran pas ekrani për tema të përgjithshme apo për autorë të mirënjohur. Informacioni bibliografik është i plotë. Po qe se janë të domosdoshëm më shumë detaje, atëherë ka kushte për t'iu kthyer standardit MARC apo katalogimit LC të shtypur. Ka metoda të sofistikuara të kërkimit (bazike, të avancuara, numërore dhe të navigimit) sidomos nëse nuk jemi të sigurt lidhur me shqiptimin e mënyrës së saktë të një teme, date etj. Po aq me rëndësi është që kufizohemi në kërkimin sipas datës, gjuhës etj.

Arkivat në Ueb

Kërkuesit që punojnë me arkiva kanë një ndihmë të dobishme në *Archives USA* (www.chadwyck.com) në faqen e Internetit (London: Chadwyck-Healey, 1998 e tej, çerekshe, çmimi ndryshon). Ajo ofron qasje për secilën nga afro 5 000 koleksione arkivale që përmbajnë afro 110 000 tema sipas emrit. Ka dhe afro 1 000 linke për faqe depozitore ueb-i, si dhe pothuajse po aq linke të kërkimit për arkivat. Këtu ndiqen mostra të rëndomta të kërkimit dhe rezultatet janë po aq të plota sa do të ishin edhe nga arkivat individuale.

Baza e të dhënave përfshin dhe bën plotësimin e udhëzuesve (1) *Directory of Archives and Manuscript Repositories in the United States (Udhëzuesi i repozitorëve të dorëshkrimeve në Shtetet e Bashkuara),* e cila u botua në vitin 1988; (2) *The National Union Catalogue of Manuscript Collections (Katalogu Kombëtar i Unionit i Përmbledhjeve të Dorëshkrimeve),* nga Biblioteka e Kongresit; (3) dhe afro 44 000 koleksione shtesë të botuara veç nga (1) dhe (2).

Kujtesa amerikane

Ndonëse nuk është një bibliografi si e tillë, ka një pjesë në sistemin e Bibliotekës së Kongresit që ka gëzuar popullaritet të madh. Ajo është: Biblioteka e Kongresit. *National Digital Library Project American Memory (Projekti bibliotekar kombëtar digjital i kujtesës amerikane)* – www.loc.gov) apo (http://rs6.loc.gov/amhome.html). Qëllimi i Bibliotekës Digjitale është të ruajë dokumentet kryesore të historisë amerikane në formë digjitale. Kjo do të mundësojë përdorimin e dokumenteve pa rrezik dëmtimi

të origjinaleve. Për më tepër, ajo hap materialet për bibliotekat anembanë botës, si dhe për individë, të cilët nuk kanë nevojë të bëjnë më udhëtime të shtrenjta deri te bibliotekat që përmbajnë dokumentet.

Deri më tani [2000] afro 300 000 njësi (prej mbi 70 deri 80 milionë) janë në dispozicion, të grupuara në 17 koleksione sipas emrit të *American Memory*, përfshirë fotografi që dokumentojnë jetën gjatë Depresionit, kujtesën teatrore... pamfletet afrikano-amerikane dhe filma të tërmetit të San Franciskos. Sajti tërheq për çdo muaj më se 20 milionë qasje.

Internet/OPAC

Katalogët e NUC-së dhe të bibliotekave lokale janë në dispozicion përmes kanaleve të tjera në Internet. Shumë njerëz këtyre ditëve thjesht duan të zbulojnë se çfarë gjendet në katalogun e bibliotekës së tyre, të njohur si "katalogu në Internet me qasje publike", apo OPAC. Tani ka më se 1 500 katalogë në Internet nga biblioteka nga mbarë bota. Të gjitha institucionet e mëdha mbajnë nga një OPAC, i cili ka qasje, ndër vende të tjera, edhe në Internet pa pagesë.[4] Shumica e faqeve bibliotekare të ueb-it ofrojnë linke të katalogëve bazë në biblioteka të tjera.

Një shembull i veçantë i katalogut bibliotekar që duhet kërkuar do të përfshinte koleksionin e madh kërkimor të Bibliotekës Publike të Nju-Jorkut:

The New York Public Library Catalog: CATNYP (www.nypl.org/catalogs/catalogs). CATNYP (Katalogu i Bibliotekës Publike të Nju-Jorkut) paraqet "fondin e bibliotekave kërkimore, që nuk qarkullojnë. Këtu përfshihen librat, të përkohshmet, dorëshkrimet, hartat, mikrofilmat, pentagramet, printet, fotografitë dhe materiale të tjera të kataloguara që nga viti 1971". Kërkimi bëhet sipas temës, titullit, autorit, numrit të regjistrit etj. Katalogu lokal (Leo: Library Entrance Online) kërkon Telnet.

Me përdorimin e softuerit bibliografik (siç është "End Note" dhe "End Link") mund të ndërtohet një dosje deri në 32 000 a më shumë referenca. Për shembull, mund të hyhet në katalogun e Universitetit të Kalifornisë

[4] *OPAC Directory* (Medford, NJ: Information Today, 1995 e tej, vjetore) përmban adresa të mbi 1 500 katalogëve me qasje publike në SHBA dhe jashtë. Pos informacionit bazë mbi adresën, udhëzimet e qasjes etj., zakonisht ka të dhëna lidhur me anët e forta tematike të bibliotekës. Mirëpo, pashmangshmërisht, faqja e bibliotekës lokale në web – dhe patjetër NUC-ja – do të kenë linke me shumicën e OPAC-ëve të shënuar në Udhëzues.

në Internet – MELVIL dhe të gjejë shënimet bibliografike mbi mjedisin apo mbi Xhek Londonin, apo për çfarëdo që të jetë e nevojshme. Paraqiten shënimet dhe përdoruesi shënon atë që i duhet (madje edhe mund të specifikojë se çfarë të përfshijë dhe çfarë të heqë nga shënimet, si për shembull një numër regjistri). Bibliografia e plotësuar pastaj mund të shkarkohet apo të dërgohet nga MELVIL përmes e-mailit.

BIBLIOGRAFITË KOMBËTARE JASHTË SHTETEVE TË BASHKUARA[5]

Bibliotekat kombëtare evropiane ndjekin pothuajse të njëjtën mostër si dhe Biblioteka e Kongresit. Çdo vend ka bibliografinë e vet. Ato janë të regjistruara në detaje në *Guide to Reference Books (Udhëzuesi për Libra të Referencës)* dhe këtu vetëm mund të përmenden. Sot, që të gjitha janë në disa forma që nga libri tradicional i shtypur e deri te Interneti.

Për më tepër, që të gjitha përmbajnë linke me mjete bibliografike, siç është PCLC-ja dhe RLIN. Që të dyja kanë të regjistruar nga disa miliona tituj në bibliografitë e huaja kombëtare. Amerikanët hapin bibliografitë kombëtare evropiane dhe të tjera vetëm kur të kenë shterur përmbajtjet e OCLC-së dhe të RLIN-it.

Ndërkaq, bibliografitë kombëtare kanadeze dhe britanike kanë një përdorim të gjerë. Arsyeja për këtë, natyrisht, është se merren kryesisht me libra në gjuhën angleze.

Bibliografia kombëtare në Kanada

CD: CD-CATSS. Etobicoke, Në: ISM Library Information Services, 1983 e këtej, çerekshe. $2.532.

Në Internet: National Library of Canada Catalogue (Katalogu kanadez i Bibliotekës Kombëtare). Otava, Në: Biblioteka Kombëtare e Kanadasë, 1952 e këtej, javore, http://bibcat.gallery.ca/ apo www.nlc-bnc.ca/canlib/eindex.htm. Pa pagesë.

E shtypur: Canadiana: Canada's National Bibliogrphy (Kanadiana: Bibliografia Kombëtare e Kanadasë). Otava: Biblioteka Kombëtare e Kanadasë,

[5] Ka një numër të madh listash/linkesh të katalogëve kombëtarë dhe shumë faqe të bibliotekave kanë linke të tilla.

1867 e këtej, mujore, vjetore. Çmimi ndryshon. (Gjendet edhe në mikrofish).

Versioni kanadez i NUC në Internet i serisë LCMARC, *National Library of Canada Catalogue (Katalogu kanadez i Bibliotekës Kombëtare)* ka mbi nëntë milionë shënime bibliografike. Vetëm një pjesë e këtyre shënimeve gjenden ose në format shiriti magnetik ose në version të shtypur. Me fjalë të tjera, ky është vendi i parë, më i mirë dhe, për disa, vendi i vetëm për të gjetur titujt në Bibliotekën Kombëtare të Kanadasë, si dhe në afro 1 000 biblioteka kooperuese. Afro 45 000 seri janë në shkencat shoqërore dhe humanitare, si dhe afro 70 000 në shkenca. Një shumësi e madhe materialesh të tjera detyrimisht janë të kataloguara. Dosjet mund të kërkohen në mënyrë standarde, si dhe përmes numrave të Bibliotekës së Kongresit. Një pjesë e madhe e materialit është përsëritje e asaj që gjendet në shënimet e Bibliotekës së Kongresit, si dhe përmes OCLC dhe RLIN.

Versioni kanadez i OCLC/RLIN është *ISM Library Information Services* (më pare *UTLAS International Canada)* apo, siç është quajtur në mënyrë më specifike, CATSS (Catalogue Support System – Sitemi mbështetës i katalogut) që ka 60 milionë shënime nga Biblioteka Kombëtare e Kanadasë, Biblioteka e Kongresit, Biblioteka Britanike dhe të gjitha bibliotekat e mëdha kombëtare. E plotësuar për çdo ditë, ky është një sistem i shkëlqyer që përdoret nga shumë biblioteka më të mëdha amerikane, si dhe nga shumica e bibliotekave kanadeze.

Disa shënime retrospektive dhe shumica e shënimeve aktuale nga mjeti bibliografik në Internet janë në dispozicion në CD-ROM si CD-CATSS. Kjo përmban afro dy milionë (kundruall mbi nëntë milionë) shënime në Internet dhe plotësohet katër herë në vit. Ajo u shërben nevojave të bazës aktuale të të dhënave LCMARC në Shtetet e Bashkuara.

Bibliografia kombëtare në Britani

Në Internet: "Blaise" British Library Catalogue (Katalogu i Bibliotekës Britanike "Bleiz"), Boston Spa: Biblioteka Britanike, 1980 e këtej, mujore, http://blaiseweb.bl.uk. Çmimi ndryshon. Regjistrimi vjetor $170. Pas 1976: "OPAC 97" (http://opac97.bl.uk). Në Internet pa pagesë.

CD: BLGC në CD-ROM. 1991. Nuk plotësohet. $18.500.

E shtypur: The British Library General Catalogue of Printed Books (Katalogu u përgjithshëm i Bibliotekës Britanike i librave të shtypur). Londër: Bingley, 1980-87. 360 vëll. 1975 (pas 1975 plotësimet e aktualizojnë botimin. Çmimi ndryshon.

Katalogu u përgjithshëm i Bibliotekës Britanike, si dhe *Katalogu i Unionit Kombëtar,* mbulon lloje të ndryshme të materialeve me bazë të ndara të të dhënave për materiale të shtypura, muzikë, harta etj. Në Internet, ato mund të kërkohen si njësi e vetme. *Katalogu* themelor përmban citime të artikujve të botimit të quajtur *British Museum Department of Printed Books (Sektori i Librave të shtypur i Muzeut Britanik).* Deri në vitin 1976 ai ka marrë afro 3.8 milionë tituj. Pas kësaj, *Katalogu* plotësohet, si në shtyp ashtu dhe në Internet me tituj aktualë. Në përgjithësi, ai përmban mbi 19 milionë citime.

Versioni në CD-ROM, i cili nuk freskohet, ka afro 8.5 milionë tituj që paraqesin shumicën e materialeve që ka marrë biblioteka para vitit 1976. Ai shërben parësisht si burim për ata që nuk duan të hapin versionin më gjithëpërfshirës dhe të plotësuar në Internet.

Katalogu Britanik, mu si dhe *Katalogu i Unionit Kombëtar* ofrohet në pjesë dhe pa pagesë, në Internet OPAC 97 pa pagesë në Internet përmban libra që janë kataloguar që nga viti 1980; vepra të referencës që nga viti 1975; dhe seri dhe të përkohshme që nga viti 1900. Përfshirja kohore e kufizuar kronologjike nuk paraqet problem për këdo që punon me tituj aktualë, por shkakton kokëçarje për atë që kërkon, të themi, komente lidhur me romanin para mesit të viteve 1970.[6] Këtu duhet kthyer te "Bleiz".

"Blaise" është versioni me pagesë në Internet i *Katalogut të përgjithshëm të Bibliotekës Britanike i librave të shtypur* që nga fillimi e deri aty ku fillon OPAC në vitin 1976. Ai përfshin edhe *Katalogun e Bibliotekës së Kongresit NUC* në Internet nga viti 1968. Kjo ofron qasje në mbi 19 milionë shënime bibliografike që nga "materialet e mbledhura anembanë botës nga Biblioteka në një sërë temash". "Blaise" përfshin gjithashtu 21 katalogë. Një mostër: *British National Bibliography*

6 Shih faqen në Internet të Bibliotekës Kombëtare (The British Library Portico: http://portico.bl.uk) për qasje në "informacion lidhur me të gjitha aspektet e shërbimeve dhe koleksioneve të bibliotekës kombëtare të Mbretërisë së Bashkuar". Ka një të metë, që me mungesën e një pjese të madhe të materialit retrospektiv të *Katalogut të Bibliotekës Britanike* në Internet duhet kthyer te COPAC http://curlopac.ac.uk/copac) që ofron "një qasje të njësuar në katalogë në Internet të disa nga bibliotekat më të mëdha universitare kërkimore në Britaninë e Madhe dhe në Irlandë".

(Bibliografia Kombëtare Britanike), 1950 e këtej, *Katalogut të përgjithshëm të Bibliotekës Britanike i librave të shtypur, Books in Boston Spa (Librat në Boston Spa)*, 1980 e këtej dhe të tjerë. Po ashtu, përmban dhe bibliografi të tjera të specializuara mbi "Blaise", siç është *The English Short Title Catalogue (Katalogu anglez i titujve të shkurtër)*, me shënime në afro 1 500 biblioteka anembanë botës, që nga shekulli XV deri në atë XVIII. Është në dispozicion edhe në CD-ROM nga "Primary Source Media" për $2.295.

Shënim: Në fillim të vitit 2000, është diskutuar çështja e vënies së pjesës më të madhe të katalogut të Bibliotekës Britanike në Internet pa pagesë, d.m.th. siç bëjnë Shtetet e Bashkuara me *Katalogun e Unionit Kombëtar* të versionit të shkurtër.

Deri në ç'masë ka dyfishim ndërmjet katalogut masiv britanik dhe *Katalogut të Unionit Kombëtar*? Walford ka bërë një provë dhe ka zbuluar se 75 deri në 80 % e titujve në veprën britanike nuk gjenden në ekuivalentin e tij amerikan, kurse për titujt e botuar para vitit 1800, ai numër rritet në 90 %. Disa ekspertë llogarisin se ka prej 900 000 deri në 1 milion tituj në katalogun e Bibliotekës Britanike që nuk gjenden në bibliografitë e tjera kombëtare. Me interesimin e shtuar në përfshirjen e titujve nga mbarë bota, në *Katalogun e Unionit Kombëtar*, masa e dyfishimit do të shtohet gjatë viteve që do të vijnë.

BIBLIOGRAFIA E TREGUT

Shumica e bibliografive numerative që gjenden nëpër biblioteka mund të klasifikohen si bibliografi kombëtare apo të tregut. Bibliografia amerikane e tregut është mjet parësor i kontrollit me qëllim për të sjellë njëfarë rendi në librat e botuara në Shtetet e Bashkuara për çdo vit, e të mos zëmë në gojë pamfletet, raportet, regjistrimet, filmat dhe artikujt e tjerë. Funksioni pragmatik i bibliografisë së tregut është që t'ia bëjë të ditur bibliotekarit se çfarë ka qenë, çfarë është dhe çfarë do të jetë në dispozicion në rend të parë nga botues amerikanë. (Vendet e tjera kanë bibliografi të ngjashme). Bibliografitë japin informacione të domosdoshme (p.sh. botuesi, çmimi, autori, fusha tematike dhe Biblioteka e Kongresit apo numrat e Dewey-it, që përdoret për një sërë qëllimesh duke filluar nga sqarimi i shqiptimit të duhur e deri te gjetja e një artikulli sipas fushës tematike. (Bazat e të dhënave mëtojnë të regjistrohen të ndara në bibliografi të veçanta. Për to është bërë fjalë më poshtë).

Procesi i hartimit të bibliografive të tregut ndryshon nga vendi në vend, por ka një mostër bazë. Bëhet një përpjekje fillimtare për të bërë një listë të titujve aktualë të botuar në javën, muajin apo çerekun e mëparshëm. Ky informacion pastaj grumbullohet për mbarështrimin vjetor të titujve të botuar dhe përtej kësaj, të atyre që gjenden në shtyp, atyre që janë jashtë shtypit dhe atyre që do të botohen. (Procesi i njëjtë ndiqet edhe te forma të tjera jashtë librit).

Në saje të të dhënave elektronike në Internet dhe në CD-ROM, i tërë procesi është përshpejtuar dhe lehtësuar për shfrytëzuesin. Një tastaturë dhe një monitor i vetëm mjaftojnë për kërkuar mundësi të panumërta për një titull të caktuar, autor, temë e kështu me radhë. Kjo jo vetëm që përmirëson kërkimin, por edhe ul çmimin e atyre kërkimeve. E tërë kjo ilustrohet nga seritë e "Reed Reference Publishing" (d.m.th. Kompania R.R. Bowker), që është thelbi i bibliografisë amerikane të tregut.[7]

Bibliografia e tregut e Shteteve të Bashkuara

Të gjithë titujt e regjistruar botohen nga Kompania R.R. Bowker, një nëndegë e shtëpisë botuese Reed Elsevier Publishing dhe mund të gjenden në Internet nga Bowker, si dhe nga ofertues të tjerë. Shënim: Bowker, si dhe botues të tjerë të mëdhenj bibliografikë, po kalonte nga formati fillestar në CD-ROM në fillim të vitit 2000, në përdorim pothuajse ekskluziv në Internet dhe, në një masë më të vogël, në shtypin standard. Formati CD-ROM në këtë edicion të tekstit deri në edicionin e ardhshëm do të mund të jetë zhdukur fare.

Në Internet: Books in Print (libra në shtyp). 1991 e këtej, javore, www.booksinprint.com. $1.850. Po ashtu, dosja DIALOG 470, $30 në orë. OCLC, OVID dhe bartës të tjerë.[8]

---

[7] Si botues kryesor i bibliografisë së tregut, R.R Bowker është pjesë e konglomeratit, Reed Elsevier Inc. e Anglisë, Shtetet e Bashkuara dhe Evropa. Reed kontrollon kompanitë e tjera të referencës, p.sh. LEXIS-NEXIS; *Marquis Who's Who;* Martindale Hubbell dhe botuesi i *Library Journal* dhe *Publishers Weekly…* që janë vetëm disa prej tyre.

[8] Numri i parë i *Books in Print* u botua në vitin 1880 nga Frederick Leypoldt i cili angazhoi Richard Rogers Bowker-in për t'i ndihmuar. Me 70 000 tituj, *Books in Print* së pari u quajt *Katalogu Amerikan (The American Catalogue).* Botimi i parë i *Books in Print* (me atë emër) përbëhej nga një vëllim i vetëm prej 85 000 titujsh nga afro 400 botues. Afro 50 vjet më vonë, të nëntë vëllimet kanë më se 3 milionë tituj.

CD: Books in Print në disk, 1986 e këtej, mujore. $1.155.(Çmime më të ulëta për CD çerekshe, gjysmëvjetore dhe vjetore).

Në shtyp: Books in Print, 1948 e këtej, vjetore. 9 vëll. $550; *Shtojca,* 1973 e këtej, 3 vëll.; vjetore.

Në shtyp: Subject Guide to Books in Print (Udhëzues tematik i Books in Print), 1957 e këtej, vjetore, 5 vëll. $370.

Të dy titujt poshtë janë pjesë e Internetit dhe të CDROM-it përmbi. Po ashtu janë të botuar ndaras.

Në shtyp: Forthcoming Books, 1966 e këtej, dymujore.

Në shtyp: Paperbound Books in Print, 1955 e këtej, dy herë ne vit, 3 vëllime.

Titulli më shumë i konsultuar bibliografik i tregut është *Books in Print (BIP)* dhe *Subject Guide to Books in Print.*[9] Më se tre milionë libra në shtyp të të gjitha llojeve (me lidhje të fortë, lidhje të butë, libra tregu, libra shkollorë, tituj të rriturish, për të rinj) janë të indeksuar sipas autorit dhe titullit në *Books in Print. (In print - në shtyp* është një term që tregon se libri gjendet ende në dispozicion nga ana e botuesit. Nëse nuk gjendet në dispozicion, ai do të quhet "jashtë shtypit"). Ky botim është në katër pjesë: (1) autorët, (2) titujt, (3) O.P. (out of print – jashtë shtypit), dhe O.S. (out of stock – nuk gjendet në stoqe) dhe (4) botuesit. Në të vërtetë, vëllimi i fundit mund të përdoret pavarësisht, siç është dhënë këtu, si një udhëzues i mirë për botuesit.

Pos informimit të shfrytëzuesit lidhur me atë se a mund të blihet libri, nga kush dhe me çfarë çmimi, bibliografia e tregut u përgjigjet edhe pyetjeve të tilla si: "Cilat libra të Uilliam Foknerit gjenden në shtyp, përfshirë edicionet me lidhje të fortë dhe të butë me çmime të ndryshme?", "Kush është botuesi i *Ekspresit të vjetër patagonian*?", A gjendet romani i parë i Xhon Irvingut ende në shtyp?".

---

[9] Bibliotekat në Internet janë mënyrë e shpejtë e kontrollimit të informacionit mbi titujt e shtypur. Të dy shtëpitë më të mëdha virtualisht kanë *Books in Print* në Internet. "Amazon" (www.amazon.com) pohon se përmban informacion mbi 2.5 milionë tituj, përfshirë edhe mijëra tituj jashtë shtypit. Rivali i tij kryesor, "Barnes and Nobles" (www.barnesandnoble.com) ka më se 1 milion tituj në katalogun e vet. Punëmarrësit e librit, si Baker & Taylor praktikisht kanë *Books in Print* në internet për nevojat e klientëve. Pos kësaj, ata rëndom ofrojnë edhe tabela të përmbajtjeve për vepra më të popullarizuara si dhe për citime. Shih, për shembull, shërbimin e Baker & Taylor në (www.btebis.com).

Pothuajse çdo njësi në *BIP* përmban autorin, bashkautorin (nëse ka), botuesin, çmimin, vitin e botimit, numrin e vëllimeve, numrin e kartës së Bibliotekës së Kongresit dhe numrat e standardeve ndërkombëtare të librit (ISBN).

Shumica e titujve të shënuar në *BIP* gjenden po ashtu në *Subject Guide to Books in Print.* Në qasjen tematike, nuk është përfshirë asnjë njësi për fiksion sipas emrit të autorit të fiksionit; kritikat e veprës së Henri Xhejmsit, për shembull, gjenden nën Xhejms). Përdorimi i udhëzuesit tematik, i cili në fakt rirendit *BIP* nën 77 000 emra titujsh të Bibliotekës së Kongresit, vetëkuptohet.[10] Ajo jo vetëm që gjen librat lidhur me një temë të caktuar, por mund të përdoret edhe për të zgjeruar koleksionin e bibliotekës në një fushë të caktuar. Nëse, për shembull, librat lidhur me veterinarët janë shumë të kërkuar, udhëzimi ofron një listë të plotë librave në dispozicion nga botues amerikanë. Një vërejtje me rëndësi: lista është gjithëpërfshirëse, jo selektive. Nuk ka ndonjë shenjë vëmendjeje që veçon librin më të keq lidhur me veterinarët nga, të themi, 20 librat më të mirë të regjistruar. Bibliotekari duhet t'u kthehet bibliografive të tjera dhe vështrimeve për gjykim dhe vlerësim të titujve në çfarëdo fushe tematike. Vëllimi i pestë regjistron dhe përmban referenca të të gjithë titujve nga *Subject Guide (Udhëzuesit Tematik).* Fakti se nganjëherë nuk mund të gjenden përgjigje në pyetje nuk është gjithmonë e metë e shqiptimit të gabuar nga ana e pyetësit të titullit apo të emrit të autorit. *Books in Print*, ndërkaq, qoftë përmes mbulimit të gabimeve apo të keqinformimit nga ana e botuesve mund të dështojë në të udhëzuarit e shfrytëzuesit ndaj një titulli, për të cilin shfrytëzuesi e di se është korrekt.

I botuar në muajin shtator çdo vit, *Books in Print* ka një shtojcë trevëllimshe në mars të vitit pasues. Botuesit sjellin lista të titujve të porsabotuar, ndryshimeve në çmim, si dhe të titujve që janë jashtë shtypit apo që do të dalin nga shtypi para vëllimeve të ardhshme vjetore të *BIP.* Këto lista renditen sipas autorit, sipas titullit dhe sipas temës. Kështu, shtojca e *Books in Print* është po ashtu shtojcë e *subjekt Guide to Books in Print. Shtojca* përmban një listë të plotësuar të të gjithë botuesve, me të

[10] Katalogimi tematik i Bibliotekës së Kongresit përdoret si udhëzues dhe Bowker, apo botuesi shpesh ofron tituj të modifikuar të Bibliotekës së Kongresit. Kjo, bashkë me vetëm 1.1 emra titujsh në libër, rezulton në një zbulim jo gjithaq të kënaqshëm. Po ashtu, shpesh një numër i madh i titujve mund të vihen nën një emërtim aq të gjerë sa që kërkimi bëhet pothuajse i pamundur. Zgjidhja është baza digjitale e të dhënave *BIP* që mundëson kërkimin e temës dhe të fjalës kyç.

gjitha ndryshimet e adresave. Për qëllime normale, *BIP* mjafton për shumicën e pyetjeve. Në raste kur data origjinale e botimit është më e vjetër se një apo dy vjet, kur ka pasur një shpërthim inflacioni, apo kur bibliotekari nuk mund të gjejë një titull, atëherë do të ishte i këshillueshëm një kërkim i serishëm në *Books in Print Supplement*. Pasi që *BIP* në Internet plotësohet vazhdimisht, çdo bibliotekë që përdor këtë botim gjerësisht, do të duhej të përdorte Internetin në vend të versionit të shtypur, duke kursyer kështu nevojën për kërkim të *Forthcoming Books (Librat që pritet të dalin)*. Kjo ka gjasë të jetë më e vlefshme për personelin e furnizimit dhe të katalogimit sesa atë të referencës, por ai sjell përgjigje në pyetjet lidhur me një libër të ri apo madje edhe lidhur me ndonjë libër për të cilin patroni ka dëgjuar të diskutohet në ndonjë program radiojeje apo televizioni para se të jetë botuar. Kjo e përdymuajshme shënon librat që duhet të botohen brenda pesë muajve të ardhshëm sipas autorit dhe titullit. Secili botim prej afro 75 000 titujsh përfshin nga një udhëzues të veçantë tematik.

Botimi *Paperbound Books in Print (Librat në shtyp me lidhje të butë)* nxjerr titujt me lidhje të butë nga *Books in Print* dhe i rirendit ata sipas autorit, titullit dhe temës. Rezultati përfundimtar është nj vepër e veçantë me afro 500 000 tituj në shtyp. Kjo ka dy përparësi të dukshme kundruall vëllimeve amë: (1) ajo plotësohet dy herë në vit, në pranverë dhe vjeshtë. Plotësimi pranveror përfshin afro 25 000 tituj të rinj, plus 100 000 plotësime njësish; (2) ajo kufizohet vetëm në botime me lidhje të butë, prandaj i shmanget çfarëdo konfuzioni lidhur me format e ndryshme, në të cilat mund të paraqitet titulli.

Si dhe në serinë *Books in Print*, të gjitha vendet perëndimore kanë pothuajse të njëjtin sistem të mbajtjes së shënimeve lidhur me titujt e botuar dhe ata në shtyp. Në Angli, për shembull, ka një botim të quajtur *Whitaker's Cumulative Book List (Lista kumulative e librave e Uitakerit)*, (Londër: Whitaker, 1924 e këtej, çerekshe), i cili pastaj akumulohet për çdo vit. Vëllimi vjetor ka afro 600 000 tituj të renditur në bazë të alfabetit, sipas autorit, titullit dhe temës.

Për Kanadanë, ka një *Canadian Books in Print (Librat kanadezë në shtyp)*, (Downsview, ON.: University of Toronto Press, 1967 e tej, vjetor). Ky del në dy vëllime. I pari mbulon autorin dhe titullin; i dyti, temat. Një edicion mikrofishi i vëllimit të autorit/titullit botohet në çdo çerek viti. *Books in Print Plus – Canadian Edition* sjell informacion mbi 1.6 milionë titujsh kanadezë dhe ndjek mostrën e njëjtë si edhe *Books in Print Plus*, që është diskutuar më poshtë.

Inerneti dhe CD-ROM

Të katër bibliografitë themelore të tregut – *Books in Print, Books in Print Supplement, Subject Guide to Books in Print;* dhe *Forthcoming Books* – janë të grupuara së bashku në një CD-ROM me titullin *Books in Print on Disc* (apo *Books in Print* në Internet). Versionet e ndryshme të *Books in Print* tani përfshijnë edhe audio e video libra, si dhe të dhjetë vjetët e fundit të *Books Out of Print (Libra jashtë shtypit).* Videot mund të kërkohen sipas titullit, regjisorit, aktorëve etj., kurse audio-librat përmbajnë edhe mundësinë e kërkimit të emrit të narratorit. Versioni elektronik i *Books in Print* përfshin tekstin e plotë të vështrimeve të librave nga një sërë burimesh, siç janë *Library Journal (Revista e bibliotekarisë), Publishers Weekly (Javorja e botuesve),* dhe *School Library Journal (Revista e bibliotekarisë shkollore).* Nga mesi i vitit 2000, ka pasur më se 400 000 vështrime me tekst të plotë dhe ky numër rritet çdo javë. Pos kësaj, ky sistem mburret edhe me të dhëna mbi 165 000 botues, distributorë etj., si dhe me biografi autorësh, lista bestsellerësh etj.

Në saje të një sërë menysh të lehta për t'u ndjekur, të cilat paraqiten në ekranin kompjuterik, mund të kërkohet një dosje (file) me fare pak mundim. Këtu ndiqen mostra standarde të kërkimit. Mund të gjendet një titull në bazë të një prej elementëve parësorë në veprën e shtypur, siç është autori, titulli, data e botimit, apo ISBN-ja. Mbase përparësia më e madhe e bibliotekarit të referencës është mundësia për të kërkuar në Internet sipas fjalëve kyçe, në kuptim të autorit, temës dhe titullit. Kështu, dikush me një dijeni të zbehtë mbi titullin e një libri mund të mbetet i kënaqur pasi do t'i ofrohet jo një, por nganjëherë dhjetëra tituj të përafërt për shqyrtim. Detajet janë të domosdoshme. Po qe se hyjmë me fjalët bazë, si p.sh. fjala *ekonomi,* rezultati i kërkimit mund të tregojë 3 000 a më shumë fjalë të tilla që gjenden si tituj librash. Ky problem mund të tejkalohet me përdorimin e çelësit shumëfjalësh të kërkimit të termave (search). Kërkimi mund të modifikohet sipas kërkimit të një çmimi të caktuar, auditorit, me apo pa ilustrime, datës së botimit, e kështu me radhë.

Ka disa derivate nga libri bazë *Books in Print.* Ato gjenden në disa biblioteka si vëllime të lidhura veçan. Ato janë: *Scientific and Technical Books & Serials in Print (Libra shkencorë dhe teknikë dhe seriale në shtyp), Medical and Health Care Books & Serials in Print (Libra të përkujdesjes mjekësore dhe shëndetësore dhe seriale në shtyp)* dhe *Children's Books in Print (Libra për fëmijë në shtyp).* Bibliotekat që i kanë blerë këta tituj, në vend

të vëllimeve të plota të *Books in Print*, vazhdojnë ta bëjnë këtë, por një hap më i mençur do të ishte po të merrej formati elektronik, që përfshin të gjithë këta tituj dhe të harrohen derivatet individuale.

Qasja digjitale ndihmon në përshpejtimin e porosive të librave. Shumë punëmarrës të librave (Baker & Taylor, Ingram Book Company, Brodart, etj.) u mundësojnë bibliotekave që t'ua transmetojnë drejtpërdrejt informacionin e gjetur në *Books in Print*. Me shtypjen e disa tasteve kompjuterike, porosia lëviz elektronikisht nga biblioteka deri te shitësi me shumicë i librit. Kjo kursen nga puna e mundimshme e porosive shumëfaqëshe dhe është shumë më e shpejtë dhe mbase më e saktë.

VEPRIMTARIA BOTUESE DHE BIBLIOTEKAT

Të gjithë titujt e mëposhtëm janë botuar nga Kompania R.R. Bowker dhe mund të gjenden në Internet përmes (www.Bowker.com/main/home).

Në Internet dhe CD: Publishing Market Place Reference (Referenca mbi tregun e botimeve). 1994 e këtej. Çmimi ndryshon.

Në Internet: Publishers, Distributors and Wholesalers in the United States (Botuesit, distributorët dhe shitësit me shumicë në Shtetet e Bashkuara). 1990 e këtej, mujore. Dosja e DIALOG-ut 450. $60 në orë.

Në shtyp: Publishers, Distributors and Wholesalers in the United States. 1988 e këtej, vjetore, 2 vëllime. $185.

Në shtyp: American Book Trade Directory (Udhëzuesi amerikan i tregut të librit). 1915 e këtej, vjetore. $250.

Në shtyp: Bowker Annual Library and Book Trade Almanac (Almanaku vjetor bibliotekar dhe tregut të librit i Bokuerit). 1965 e këtej, vjetor. $185.

Në internet: LMP (Literary Market Place – Tregu Letrar), 1998 e këtej, vjetor. $216.

CD: Literary Market Place on Disk, 1996 e këtej, vjetore. Dosja DIALOG 460, $290.

Në shtyp: 1940 e këtej, vjetor. $190.

Në Internet: American Libary Directory (Udhëzuesi bibliotekar amerikan). 1991 e këtej, vjetor. Dosja DIALOG 460, $30 në orë.

CD: 1998 e këtej, vjetore, çmimet ndryshojnë duke filluar nga $260.

Në shtyp: 1923 e këtej, vjetor, 2 vëllime. $260.

Në shtyp: World Guide to Libraries (Udhëzuesi botëror i bibliotekave). 1983 e këtej, vjetor. $350.

Shënim: *The American Library Directory* dhe *American Book Trade Directory* janë botuar po ashtu së bashku në një CD-ROM të vetëm (1998 e këtej, vjetor, $395).

Ata që duan të gjejnë përgjigje të shpejtë për një adresë apo numër telefoni të botuesit apo një emër të një editori u duhet vetëm të shfletojnë disa burime shtypi. Më i logjikshmi për informacion bazë është vëllimi i fundit i *Books in Print*, që përfshin distributorët dhe botuesit. Ka një numër të madh burimesh të tjera, por ombrella e përgjithshme për një informacion të tillë është botimi *Publishing Market Place (Tregu i botimeve),* që është diskutuar më vonë në këtë pjesë. Këtu janë të grupuar së bashku burimet e informacionit të llojit udhëzues mbi botuesit, bibliotekat, furnizuesit dhe shitësit e librit. Versionet në Internet dhe në disk kanë këto përmbajtje, të cilat po ashtu gjenden edhe në vëllimet individuale të shtypura:

1. *Publishers, Distributors and Wholesalers in the United States (Botuesit, distributorët dhe shitësit me shumicë në Shtetet e Bashkuara)* ofron një qasje të përshtatshme në kompanitë botuese të renditura sipas alfabetit. Të dhënat themelore përfshijnë personelin kryesor, numrat e telefonave, adresat, si dhe emrat e vartësve, degët e ndryshme dhe llojin e shtypit. Prefikset e ISBN-së që i jepen një botuesi janë përfshirë, si dhe çfarëdo shkurtese. Ky shërbim ofrohet në Internet, pasi që është me rëndësi që të jetë sa më aktual. Këtu informacioni pasurohet çdo muaj;

2. *American Book Trade Directory (Udhëzuesi amerikan i tregut të librit)* ka të regjistruar shitësit e librave, shitësit me shumicë dhe botuesit sipas shtetit dhe qytetit, me informacion shtesë mbi Kanadanë, Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën. Edicioni mesatar përfshin mbi 31 000 dilerë me pakicë dhe me shumicë;

3. *Bowker Annual Library and Book Trade Almanac (Almanaku vjetor bibliotekar dhe tregut të librit i Bokuerit)* është një vepër e ngjashme që përfshin informacion bazë mbi botuesit dhe veprimtarinë botuese. Ajo është sidomos e vlefshme për statistikat që kanë të bëjnë me botimet e një viti më parë. Pos kësaj, siç sugjeron edhe vetë titulli, ajo përmban artikuj vështrimesh dhe përmbledhjesh të veprimtarisë së një viti më parë në lloje të ndryshme të bibliotekave. Informacioni tjetër ka të bëjë me plotësime lidhur me pagat e bibliotekarëve, raporte të organizatave, udhëzime prodhimesh dhe furnizimesh, rrjetet dhe konsorciumet, fituesit e çmimeve, dhe lajme. Edhe këtu ofrohen të dhëna statistikore;

4. *Literary Market Place (Tregu Letrar)* ofron informacion të llojit udhëzues mbi 12 000 firma që janë të angazhuara drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë në veprimtarinë botuese në Shtetet e Bashkuara (janë të regjistruar afro 4 250 botues). Kjo sjell një përgjigje të pjesshme në pyetjen që dëgjohet shpesh te tavolina e referencës: "Ku mund ta botoj romanin [poezinë, biografinë apo ndonjë vepër] time?". Po ashtu, kjo është mjaft e dobishme për bibliotekarët e furnizimit, pasi që ofron një informacion më të plotë mbi botuesit sesa bibliografitë, siç është *Books in Print.* Përafërsisht, këtu janë përfshirë 500 botues dhe shtypshkronja të mëdha dhe të vogla, do të thotë ata që nuk botojnë më tepër se tre tituj në vit. Të dhënat standardet, që nga adresat dhe numrat e fakseve e deri te emrat e personelit kryesor janë dhënë për secilin botues. Ajo, po ashtu ka kapituj lidhur me marketingun dhe publicitetin, përgatitjen e librit dhe shitjen e distribuimin.

Literary Market Place përfshin emra të agjentëve, të cilët do të dëshironte t'i takonte autori. Mirëpo, kjo parasupozon një masë njohurie lidhur me botuesin dhe nuk i përgjigjet drejtpërdrejt pyetjes: "A boton kjo shtëpi botuese fiksion, apo poezi, apo gjëra të tjera?". Për këtë arsye, fillestari duhet të konsultojë disa tituj shumë të përdorur, siç është *Writer's Market (Tregu i shkrimtarit),* (Cincinnati, Ohio: Writer's Digest, 1929 e këtej, vjetor). Ai përmban një kapitull mbi librat e botuar me pasuse lidhur me llojet e materialeve të kërkuara, me tatimet e paguara dhe mënyrën se si do të mund të jepet një kopje. Pjesa tjetër e udhëzuesit, prej dy vëllimesh, ofron informacion të ngjashëm për mijëra botues të të përkohshmeve, të cilëve mund t'u dërgojnë materiale shkrimtarët e pavarur. *The Writer's Handbook (Doracaku i shkrimtarit),* (Boston; The Writer, Inc.,

1936 e këtej, vjetor) ofron një pjesë të materialit të njëjtë, por të paktën gjysma e secilit vëllim u përkushtohet artikujve mbi mënyrën e të shkruarit, kurse listat e tij nuk janë aq të plota sa në *Writer's Market.* Autorët që duan të kenë informacion lidhur me shtypshkronja të vogla duhet të konsultojnë botimin *The International Directory of Little Magazines and Small Presses (Udhëzuesi ndërkombëtar mbi revista dhe shtypshkronja të vogla),* (Paradise, CA: Dustbooks, 1965 e këtej, vjetor);

5. *The International Literary Market Place (Tregu ndërkombëtar letrar)* është një zgjerim i thjeshtë i suazave të LMP-së së parë. Këtu mund të gjenden mbi 10 000 botues që regjistruar nga 170 vende, si dhe afro 18.000 distributorë, furnizues etj. Dy indekse – mbi temat dhe llojet e botimeve – bëjnë këtë lidhshmëri të përbashkët. Ese të shkurtra informative mbulojnë gjëra të tilla si të drejtat autoriale, çmimet letrare dhe ISBN-në. Kjo është në dispozicion edhe në Internet si pjesë e *Literary Market Place.* S'do mend, vetëm për më pak më shumë dollarë, versionet e Internetit të dy këtyre veprave janë më të preferueshme kundruall versionit të shtypur – nëse për asgjë tjetër, nga që ato nuk zënë vend dhe gëzojnë përparësinë e metodave të avancuara të kërkimit. Edhe këtu, ky është shembulli i vetëm pse bibliotekarët dhe botuesit nxitojnë që të kenë udhëzues të veprave të referencës në Internet;

6. *American Libary Directory (Udhëzuesi bibliotekar amerikan)* është i përfshirë këtu për të vënë në pah se ka udhëzues pothuajse për çdo lloj profesioni. I botuar që nga viti 1923, ai ofron informacion themelor lidhur me 37 500 biblioteka publike, akademike dhe speciale në Shtetet e Bashkuara, Kanada dhe Meksikë. Renditur sipas shteteve dhe qyteteve, regjistrat përfshijnë emra të personelit, adresa të bibliotekave dhe numra telefonikë, buxhete libri, numra të vëllimeve, koleksione të veçanta, paga, interesime tematike e kështu me radhë. Ai ka përdorim të shumëfishtë që nga kërkimi i adresave për ndonjë pasqyrë apo blerës potencialë të librit e deri tek ofrimi i të dhënave të domosdoshme për ata që kërkojnë ndonjë post në një bibliotekë të caktuar. (Për shembull, informacioni mbi madhësinë e një koleksioni dhe mbi pagat nganjëherë do t'u thotë më shumë kërkuesve nga ç'mund të gjendet në reklama). Për fat të keq, të gjitha versionet plotësohen vetëm një herë në vit. Cilin format duhet ta blejë biblioteka? Edhe këtu, kjo varet në rend të parë nga sasia e përdorur. Nëse ka pak kërkesa për atë vepër, atëherë versioni në Internet është më

ekonomik. Nëse ka pak kërkesa për formë të shkruar, për të gjetur pjesë të vjetra të të dhënave, atëherë Interneti do të ishte i dobishëm;

7. *World Guide to Libraries (Udhëzuesi botëror i bibliotekave)* ka të regjistruar 40 000 biblioteka në 167 vende të botës, përfshirë edhe shumë institucione shkollore. Renditur sipas kontinentit, vendit, qytetit dhe llojit të bibliotekës, ky udhëzues përmban informacion bazë, por jo edhe aq sa gjendet në udhëzuesin e ngjashëm amerikan.

Forma digjitale e *Publishing Market Place* (që përfshin shumicën e titujve të lartpërmendur) ndjek të njëjtën mostër të të kërkuarit siç është diskutuar edhe më herët tek *Books in Print On Disc* – një plus i vërtetë, nëse biblioteka do që të ketë që të dy sistemet. Mund të kërkohet një pjesë specifike e informacionit duke përshkuar të tërë udhëzuesit dhe doracakët. Ka shtojca të tjera, që nuk gjenden në versionet individuale të shtypura: (1) afro 100 000 adresa për organizata shkollore dhe shërbyese ofrojnë mundësi adresimi. Ky është një plus për njerëzit e marketingut, por ka pak vlerë për bibliotekarët; (2) Një udhëzues "për shërbimet dhe furnizimet në SHBA dhe ato ndërkombëtare" që sjell afro 16 000 shënime mbi botues dhe korporata të ngjashme.

Si një regjistër aktual se çfarë po ndodhë në veprimtarinë botuese, *Publishers Weekly (Javorja e botuesve)*, (Nju-Jork: R.R. Bowker Company, 1872 e këtej) është një botim i rekomanduar për bibliotekarët e referencës. Kjo është revistë tregu e botuesve amerikanë dhe, pos kësaj, përmban shpesh artikuj, reportazhe dhe artikuj informativë më vlerë për bibliotekarë. Është vështirë të paramendohet një bibliotekar i angazhuar i referencës, që të mos i shfletojë numrat javorë të kësaj reviste për "parashikime të PV-së". Këtu, citimet kritike mbi përafërsisht 50 deri në 100 tituj i jep lexuesit një nocion të asaj që duhet pritur në fiksionin popullor dhe jofiksionit, që do të botohet në muajin e ardhshëm a më larg.

Udhëzues të tjerë

Bibliotekat speciale kanë trajtim shumë më të detajuar në udhëzuesin *The Directory of Special Libraries and Information Centers (Udhëzuesi i bibliotekave speciale dhe qendrave informative)*, (Farmington Hills, MI: Gale

Group, vjetor.

CD-ROM: Çmimi ndryshon. *I shtypur:* 1963 e këtej, dy herë në vit, 3 vëllime, $360 deri në $435 për vëllim).

Kjo vepër përmban mbi 22 000 njësi që janë ose biblioteka speciale ose aso me koleksione speciale, përfshirë një numër të bibliotekave publike dhe universitare. Renditja është sipas rendit alfabetik, me një indeks tematik jo fort të kënaqshëm. (Titujt tematikë janë dhënë nga bibliotekat dhe pasi që nuk ka një regjistrim të vetëm standard, atëherë ajo është paksa me të meta). Vëllimi i dytë është indeksi gjeografik/personel dhe i treti është një shtojcë periodike që mbulon materialet e reja ndërmjet botimeve. Derivat i botimeve bazë është *Subject Directory of Special Libraries (Udhëzuesi tematik i bibliotekave speciale),* (Feniks, AZ: Oryx Press, 1987 e tej, jo i rregullt). Në botimin e dytë (1993), janë shënuar mbi 2 500 njësi, jo vetëm në Shtetet e Bashkuara, por anembanë botës. Indekset mbulojnë vendin, temën dhe llojin e bibliotekës.

BIBLIOGRAFITË: TË PËRKOHSHMET DHE GAZETAT

Në Internet: Ulrich's International Periodicals Directory (Udhëzuesi ndërkombëtar i të përkohshmeve i Ulrikes). Nju-Jork: R.R. Bowker, 1991 e këtej, mujore, www.ulrichesweb.com. Çmimi ndryshon. Po ashtu: dosja DIALOG 480, $15 në orë. OVID: çmimi i negociueshëm nga sajti.

CD: Ulrich's On Disc. 1994 e këtej, çerekshe. $595.

Në shtyp: 1932 e këtej, vjetor, 5 vëllime. $459. Përfshin plotësime në çdo gjysmë viti.

Në Internet: EBSCONET, Ipsuiç, MA: EBSCO Publishing, 1997 e këtej, mujore, EBSCO, www.ebsco.com. Çmimi ndryshon.

CD: The Serials Directory, 1988 e këtej, çereksh. $525.

I shtypur: 1986 e këtej, vjetor, 3 vëllime. $349.

Në Internet: Magazines for Libraries (Revistat për biblioteka). Nju-Jork:

R.R. Bowker, 1995 e këtej, dy herë në vit. [Në *Ulrich's International Periodicals Directory Online]*.

CD: 1995 e këtej, dy herë në vit, Çmimi ndryshon.

I shtypur: 1969 e këtej, dy herë në vit, 1.500 faqe. $185.

Kur bibliotekarët flasin për revistat, ata rëndom u referohen atyre si pjesë e një familje më të madhe të serialeve. Një *serial* mund të definohet në shumë mënyrë, por si më themelore është se ai është një publikim që botohet në pjesë (p.sh. një revistë që del një herë në javë) për një periudhë të pacaktuar (d.m.th. revistat do të botohen sa më gjatë që të jetë e mundur; nuk ka datë të prerë). Serialet mund të ndahen në disa mënyrë, për shembull: (1) serialet jo të rregullta: ka disa lloje të tyre, siç janë procesverbalet e takimeve që mund të dalin në çdo të tretën apo të katërtën e vitit. "jo të rregullta" i referohet faktit se nuk ka datë të prerë të botimit; (2) të përkohshmet: (a) revistat, nga shkollore dhe shkencore deri te ato profesionale; (b) magazinat e llojit që gjenden në kioske; dhe gazetat. Disa nuk do t'i ndanin revistat dhe magazinat, kurse të tjerët do të ofronin nënndarje të tjera ezoterike.

Ulrich's International Periodicals Directory (Udhëzuesi ndërkombëtar i të përkohshmeve i Ulrikes) është një udhëzues për të përkohshmet nga Shtetet e Bashkuara dhe nga pika globale.[11] Ai del në pesë vëllime dhe përfshin afro 250 000 tituj, përfshirë edhe 7 400 gazeta ditore dhe javore (në vëllimin e pestë) të botuara në Shtetet e Bashkuara. Të përkohshmet janë të renditura sipas titujve të 600 temave të mëdha dhe aty ka dhe një indeks titujsh. Fjala "ndërkombëtar" është një indikacion i vërtetë i përmbajtjes, pasi që 70 000 botues janë nga 200 vende.

Është jashtëzakonisht i lehtë të përdoret. Të themi, për shembull, se duam të kërkojmë një të përkohshme nën temën e arkitekturës. Titulli dhe informacioni themelor do të gjendet nga viti kur është botuar për herë të parë, si dhe nga dendësia e botimeve (mujore, çerekshe etj.) dhe çmimi. Aty është dhënë adresa e botuesit, si dhe emri i botuesit dhe shpesh ka edhe indikacione të përmbajtjes në një rresht prej 10 a 20

[11] Kjo rëndom referohet nga bibliotekarët e referencës si e "Ulrikes", sipas emrit të gruas që hartoi këtë udhëzues në rend të parë. Disa vepra të tjera themelore, jetëgjatë të referencës quhen vetëm sipas emrit të autorit/hartuesit, p.sh. e Uebsterit, e Bruerit, e Foulerit, e Cheimersit, e Piersit (një enciklopedi angleze), e Uisdenit, e Debretit, e Bërkes, etj.

fjalësh përshkrimi të më se 12 000 titujve të njohur.

Me interes të veçantë për bibliotekarët e referencës: (1) Jepen vendet parësore se ku është indeksuar një e përkohshme; (2) Ka shpesh një figurë qarkulluese që jep një ide të përafërt të popullaritetit; (3) Jepet mjaft informacion bibliografik për t'ia mundësuar qoftë bibliotekarit, qoftë ndonjë personi laik, që të verifikojë dhe porosisë të përkohshmen nga ndonjë shitës; (4) Janë dhënë të përkohshmet që janë në dispozicion edhe në Internet, edhe në CD-ROM.

Versioni në Internet përbëhet nga vepra kryesore, si dhe titujt e ngjashëm me emra vetësqarues: *Magazines for Libraries (Revista për biblioteka), Irregular Serials and Annuals (Seriale jo të rregullta dhe vjetarë)* – që përfshin vepra të shumta vjetore të referencës), *The Bowker International Serials Databases Update (Plotësime të serialeve bazës së të dhënave ndërkombëtare Bouker),* si dhe *Sources of Serials (Burimet e serialeve).* Të njëjtat të dhëna janë edhe në versionin në Internet.

Në Internet shërbimi pasurohet për çdo muaj, CD-ROM në çdo çerek viti, kurse vëllimet e shtypura dalin vetëm një herë në vit. (Ka një shtojcë pa pagesë që botohet dy herë në vit, por është vështirë të përdoret dhe shkakton kokëçarje që duhet të kërkosh gjetiu informacion që nuk gjendet në vëllimet vjetore). Përparësi e dukshme e formateve elektronike është shpeshtësia dhe, për të qenë të sigurt, lehtësia e kërkimit. Ka 23 pika të hyrjes, përfshirë edhe qarkullimin dhe editorin. Dhe, derisa vëllimet e shtypura janë të mira për një bibliotekë mesatare, të vogël deri te e mesme, institucionet më të mëdha që kanë shumë punë me seriale do të kenë nevojë për versione elektronike.

Edhe këtu, versioni i referencës digjitale është i preferueshëm kur kemi të bëjmë me punë rutinore me seriale. Pse? Përpos njësive dhe titujve shtesë: (1) Bibliotekari mund të gjejë një serial të veçantë kur dihen vetëm disa të dhëna lidhur me veprën, siç është ndonjë fjalë kyçe në titull; (2) Mund të verifikohet lehtë emri i botuesit, të gjendet adresa, numri i telefonit e të tjera; (3) Bibliotekari mund të gjenerojë lista të gazetave, jo vetëm sipas temës, por edhe sipas botuesit, krahasimit të çmimeve e kështu me radhë. Gazetat me referencë në një fushë të caktuat tematike mund të veçohet; (4) Shërbimet e dorëzimit të dokumenteve, aty ku ekzistojnë, lidhen me ndonjë titull apo me tituj të caktuar, në mënyrë që bibliotekari të mund të porosisë nga UnCover, Faxon, UMI, Qendra e Furnizimit me Dokumente e Bibliotekës Britanike, e kështu me radhë.

Publist.com (www.publist.com) është kryesisht një version i shkurtuar

pa pagesë i *Ulrikes.* Derisa ka disa opsione të kërkimit *Ulrike,* mungojnë fusha të shumta përshkruese, që nga çmimet e abonimit e deri te data e parë e fillimit, emri i botuesit tjetër etj. Vlera e vetme e web-sajtit është ta kontrollojë adresën e botuesit, titullin e të përkohshmes dhe, aty ku është e nevojshme, edhe web-sajtin URL. Ka shumë mangësi për ta bërë atë si mjet për përgjigje në pyetjet e referencës.

Shitësi më i madh vendor i të përkohshmeve, EBSCO, nxjerr botimin *The Serials Directory (Udhëzuesi i serialeve).* Ky botim është sajuar nga lista e firmës e të përkohshmeve që shet ajo, si shitëse, në biblioteka, librari dhe korporata. Ndonëse jo të gjithë titujt në *Udhëzuesin* e EBSCO-s janë në dispozicion nga vetë firma, shumica mund të porositen prej tyre. Si ndryshon ky nga *Ulrike*? Numri i titujve (256 000) të regjistruar është pothuajse i njëjtë, prandaj nuk ka ndryshim të vërtetë. Lloji i materialit (nga serialet jo të rregullta e deri te revistat e popullarizuara) është i njëjtë, ashtu si dhe qasja themelore tematike me një indeks titujsh. Pra, ndryshimet, në të vërtetë, janë fare të vogla. *Udhëzuesi* tregon shërbimet kryesore të indeksimit për secilin titull, por shton edhe datat e mbulimit të një artikulli të veçantë, ndonëse jo për të gjitha njësitë. Ai përmban një regjistër të 6 000 gazetave anembanë botës dhe nganjëherë përshkrimet e shkurtra janë më të plota sesa ke *Ulrike.*

Duke pasur parasysh këto dy vepra referencash që janë pothuajse identike sa i përket qëllimit dhe përfshirjes, kërkohet që të bëhet edhe një përfundim lidhur me elementet e tjera. Së pari, është çështja e saktësisë dhe mbulueshmërisë së plotë. Këtu, udhëzuesi i *Ulrikes* prin, mbase për të vetmen arsye se ka qenë i pranishëm për një kohë të gjatë, prandaj dhe ka një staf dukshëm më me përvojë. Sidoqoftë, informacioni i detajizuar te *Ulrike* mëton të jetë më aktual, më gjithëpërfshirës dhe më i plotë sa u përket detajeve.

Revistat për biblioteka

Udhëzuesit serialë janë të ngjashëm me *Books in Print* në atë se ata shënojnë atë që është në dispozicion dhe jo atë që është më e mirë. Për të përcaktuar këtë, bibliotekari duhet ta konsultojë botimin *Magazines for Libraries.* Edicioni i dhjetë (2000), si dhe ata para tij, kanë të regjistruar dhe të cituar afro 8 000 revista që konsiderohen si më të mirat të llojit të tyre. Versionet në Internet të të gjithë titujve janë dhënë bashkë me URL-

të e tyre. Pos kësaj, revistat që mund të gjenden vetëm në Internet janë dhënë të veçanta në fund të secilës pjesë tematike. Seleksionimi është bërë nga mbi 180 ekspertë tematikë. Titujt ndërkombëtarisht të rekomanduar janë regjistruar sipas temës që nga "reklamimi" deri te "gratë". Ka një indeks titujsh, si dhe një indeks të veçantë tematik. Ajo që e bën këtë vepër ndryshe nga të tjerat, është fakti se pos të dhënave të plota bibliografike për secilin titull, secili titull ka nga një përmbledhje përshkruese dhe vlerësuese prej 100 deri në 200 fjalë. Rezultat i kësaj është një udhëzues i paçmueshëm si për bibliotekarin, ashtu dhe për një person laik i cili duhet të vendosë se a ta përzgjedhë apo ta refuzojë atë revistë. Edicionet e reja botohen në çdo dy vjet.

Tani ka afro 6 000 shtypshkronja të vogla dhe pothuajse po aq revista të vogla që botohen në Shtetet e Bashkuara, Kanada dhe vende të tjera anglishtfolëse. Ato detyrimisht janë përfshirë sipas një rendi alfabetik dhe sipas titujve në *International Directory of Little Magazines & Small Presses (Udhëzuesi ndërkombëtar i revistave dhe shtypjeve të vogla)* të Len Fulton-it (Paradise, CA: Dustbooks, 1963 e këtej, vjetore, $30). Për secilin titull ka nga një përshkrim prej 50 deri në 300 fjalë jovlerësues të revistës apo shtypit. Është dhënë informacion bazë sa i përket asaj se çfarë lloji doreshkrimesh kërkohet, çmimet e abonimit, frekuenca e botimit e të tjera.

Një problem i zakonshëm te referencat ka të bëjë me domethënien e ndonjë iniciali aspo shkurtese që përdoret në fusnota për ndonjë titull të përkohshmeje. Shkurtesat janë larg standardit dhe mund të ndodhë që ndonjë autor të ketë një pjesë vitale të informacionit të fshehur nën ndonjë shkurtesë të së përkohshmes, që ngatërron të gjithë. Zgjidhja gjendet në të paktën 99 % të rasteve, në *Periodical Title Abbreviations (Shkurtesat e titujve të të përkohshmeve),* (Farmington Hills, MI: Gale Group, 1976 e këtej, jo e rregullt). Ky udhëzues përfshin afro 145 000 shkurtesa. Vëllimi i parë ka të regjistruar shkurtimet, si dhe titullin e plotë. Vëllimi i dytë të kundërtën e këtij procesi.

Një çështje tjetër urgjente e këtyre ditëve është edhe kjo: "Si e dini ju nëse e përkohshmja X apo Y është ka qasje në Internet?". Kjo pyetje mund të ndahet në dy pjesë: (1) Cila revistë është e indeksuar apo e abstraktuar në Internet?"; (2) Cila revistë është në Internet me tekst të plotë në mënyrë që e tërë përmbajtja e revistës të mund të shtypet sipas dëshirës apo që teksti të mund të kërkohet me fjalë kyçe që të mund të drejtojë dikë në artikull apo pjesë të artikullit me interes?".

Ulrikes përfshin një pjesë të të përkohshmeve në Internet në rend alfabetik sipas titullit. Në *Magazines for Libraries* të gjitha revistat e regjistruara që janë në Internet janë të shënuara në të dhënat individuale bibliografike. Pos kësaj, shih më poshtë.

Zhurnali elektronik dhe udhëzuesit e gazetave

Në Internet: Electronic Journal Access (Qasja në zhurnalin elektronik). Colorado Alliance of Research Libraries, www.coaliance.org/ejournal/. Pa pagesë.

Në shtyp: Directory of Electronic Journals: Newsletters and Academic Discussion Lists (Udhëzuesi i zhurnalëve elektronikë: informatorët dhe listat e diskutimit akademik). Uashington, DC: Association of Research Libraries (Shoqata e Bibliotekave Hulumtuese), 1991 e këtej.

Shënim: Pa pagesë në Internet për ata që blejnë vëllimin në formë të shtypur, www.arl.org/scomm/edir. Veçoritë e e-zhurnalit të sotshëm mund të përmblidhen me pak fjalë: (1) Ky është një medium relativisht i ri. Eksperimentet me këtë formë janë bërë që në vitet 1970, por ato janë bërë realitet vetëm në fillim të viteve 1990. Kuantitavisht, çdo javë shtohen në Internet afro 6 të përkohshme. Deri në mbarim të shekullit, numri i përgjithshëm sillej diku ndërmjet 4 000 dhe 5 000; (2) E-zhurnalët përgjithësisht ndahen sipas formatit: *(a)* tituj të shtypur që janë në dispozicion në formë të shtypur dhe në atë elektronike, apo *(b)* tituj vetëm në formë elektronike pa ekuivalent të shtypur. Shumica e titujve akademikë dhe atyre madhorë të popullarizuar janë pak më shumë se versione elektronike "me tekst të plotë" të titullit të shtypur. Ato kanë qasje në Internet (d.m.th. përmes Internetit apo ndonjë shërbimi komercial, siç është DIALOG, NEXIS apo ndonjë organizate të ofrimit dokumentar si UnCover). Arkivat dhe dosjet mëtojnë të jenë në CD-ROM. Kërkohet një tarifë për përdorim të versioneve elektronike të shumicës së zhurnalëve të shtypur akademikë; (3) E-zhurnali i vërtetë nuk ka ekuivalent të shtypur dhe është në dispozicion vetëm përmes kompjuterit, rëndom përmes Internetit. Disa prej tyre janë shumëmediale, d.m.th. përmbajnë jo vetëm formë të shkruar, por edhe zë, pamje etj. Nuk ka tarifë për nëntë nga dhjetë e-zhurnalë "të pastër". Shumica e titujve që janë vetëm në Internet

janë punë e një apo dy personave (kryesisht entuziastë) me aspak apo me fare pak mbikëqyrje. Shpresa e vërtetë për të ardhmen është për të zgjeruar e-zhurnalin me qasje vetëm në Internet për t'i përfshirë si disiplinat akademike ashtu dhe interesin e publikut. Deri më tani, numri më i madh i e-zhurnalëve me qasje vetëm në Internet gjenden në lëmin e shkencave dhe të arsimit. Për një dekadë a më shumë numri i tyre do të mund të rritet, ashtu si dhe ai i titujve në Internet.

Qasja elektronike e zhurnalëve është vendi i parë ku duhet kërkuar si për informacionin specifik ashtu dhe për atë të përgjithshëm lidhur me zhurnalët elektronikë. Ka linke për më shumë se 2 000 seri (përfshirë informatorët, kumtesat, gazetat etj.). Pothuajse në të gjitha rastet lexuesi mund të gjejë botimet aktuale dhe shpesh edhe të kaluara të e-zhurnalëve në Internet pa pagesë. Për më tepër, ajo ka indeksin më të shteruar tematik nga çdo sajt e-zhurnalësh në rrjet. Aplikimi i titujve tematikë të Bibliotekës së Kongresit i mundëson përdoruesit të përzgjedh shkronjën e parë të një teme dhe pastaj ta kërkojë atë. Ata që kërkojnë një temë të caktuar mund të kërkojnë te tituj të veçantë, apo me fjalë kyçe në tabelën e përmbajtjes, abstrakte etj. Po ashtu, ka dhe një listë titujsh me renditje alfabetike.

Një udhëzues tjetër në Internet është ai i quajtur *NewJour* (Universiteti i Kalifornisë: Universiteti i San Diegos dhe i Jelës dhe Universiteti i Pensilvanisë, http://gort.ucsd.edu/newjour). Një nga udhëzuesit më të sofistikuar të burimeve, *NewJour* ka në dispozicion mbi 4 000 tituj (përfshirë edhe informatorë, si dhe të përkohshme). Ky sistem filloi në vitin 1993 dhe ka fituar famë ndërkombëtare jo vetëm për shkak të listave aktuale të e-zhurnalëve të rinj (prej këtej vjen dhe titulli *New Jour*, d.m.th. zhurnalë të rinj). Afro 2 500 lexues në ditë shikojnë *NewJour-in* – që shpjegohet nga fakti se ai është një sistem aq i shkëlqyer, si dhe për shkak të pasurimit me materiale dy herë në ditë. Edhe të përkohshmet mund të kërkohen sipas renditjes alfabetike në bazë të titullit. Kërkimi i titujve bëhet në dy hapa, d.m.th, hapi i parë përfshin tërë informacionin bibliografik lidhur me të përkohshmet, si dhe adresën në Internet. Si dhe në sisteme të tjera të e-zhurnalëve edhe këtu mund të kalohet nga të dhënat bibliografike te teksti i plotë i zhurnalit në Internet. Shumica përmbajnë arkiva të botimeve të mëparshme. Dhe, pothuajse që të gjitha janë pa pagesë.

Burimi më i mirë individual i informacionit në zhurnalin në Internet gjendet në *Directory of Eletronic Journals (Udhëzuesi i Zhurnalëve*

Elektronikë). Ai përfshin informacion të plotë bibliografik (kur është në dispozicion), si dhe adresën e titullit në Internet . Ai është një përzierje e zhurnalëve dhe informatorëve që kanë qasje vetëm në Internet dhe zhurnalëve të shtypur që janë bartur në Internet. Të parat janë rëndom pa pagesë, kurse të fundit pashmangshmërisht kërkojnë një tarifë. Ata që blejnë vëllimin e formës së shtypur, do të pajisen me një fjalëkalim për të përdorur po atë material pa pagesë në Internet.

Përpos 4 000 a më shumë të përkohshmeve, ka afro 4 000 studime akademike dhe grupacione informacionesh, që janë dhënë me një shpjegim të qëllimit të tyre. Kjo listë është selektive dhe është nxjerrë nga një listë tjetër më e gjerë. Shih, po ashtu, hyrjen për një vështrim të shkëlqyer të të përkohshmeve elektronike dhe ardhmërisë së tyre. Një shtesë është informatori i Aleancës, "DataLink", që mban lexuesin të informuar jo vetëm lidhur me projektin, por edhe mbi zhurnalët elektronikë në mbarë botën. Ai është i shkruar mirë, aktual dhe gjithëpërfshirës.

Ka, po ashtu, edhe artikuj mbi sfondin e një teme, si dhe "udhëzues të tjerë të zhurnalëve elektronikë" mjaft të dobishëm. Me interes të veçantë është "udhëzuesi i botuesve kryesorë të zhurnalëve elektronikë", që pasuron informacionin mbi atë se kush çfarë bën në Internet.

Books and Periodicals Online (Libra dhe të Përkohshme në Internet), Uashington: Library Technology Alliance, 1995 e këtej, vjetore, 2 vëll., $325) është një listë me renditje alfabetike sipas titujve të "më se 97 000 burimeve të veçanta të botuara në mbi 200 vende". Pos titullit, secila njësi përfshin edhe informacionin se cili ka bartur botimin edhe në Internet dhe se a është tekst i plotë apo vetëm citim dhe fragment i artikujve. Tre indekse: shitësi, botuesi dhe emra të mëparshëm. Përmes një tarife, natyrisht, udhëzuesi i njëjtë është në dispozicion edhe në Net (www.periodicals.net).

Net Journal Directory (Udhëzuesi i Zhurnalëve në Net), (Hillside, Nj: Hermograph, 1997 e këtej, gjysmëvitesh, $220) përmban listat më të detajuara të të përkohshmeve që gjenden në ueb. Botimi i parë përmbante afro 9 500 tituj, por deri në vitin 2000 ajo përmbante mbi 11 000. Aty përfshihen gazetat, revistat, si dhe zhurnalët. Një njësi tipike përfshin URL-të, të dhënat në format, çmimin (nëse ka) dhe datat e mbulimit. Ka një indeks tematik paksa skicor. Ka pak dyfishime me shërbimet e tjera më të gjera.

Ka dhjetëra udhëzues për e-zhurnalët në Rrjet. Shembull tipik: *Ejournal SiteGuide: a MetaSource* (www.library.ubc.ca/ejour). Prodhuar nga Joseph Jones i bibliotekës së Universitetit të Kolumbisë Britanike, kjo

paraqet "një sërë linkesh të sajteve për e-zhurnalë, që nga ana e tyre ofrojnë linke për tituj individualë..."

Së fundi, shitësit e mëdhenj të serive, si EBSCO dhe Faxon, ofrojnë qasje në informacionin e zhurnalëve elektronikë. Që të dy këto shërbime sjellin lista të detajuara të atyre zhurnalëve që mund të blihen përmes tyre. Duhet ditur, ndërkaq, se shumica e rasteve të veçanta janë ato që kërkojnë një tarifë për materiale që do të lexohen në Internet. Titujt pa pagesë, të mbuluar në burime të tjera, regjistrohen rrallë.

Gazetat

Gazetat me qasje në Net rëndom konsultohen për informacion ditor. Në këtë prin moti, si më i popullarizuari, pasuar nga faqja e parë dhe sporti. Në kuptim të hulumtimit, një gazetë e mirë ditore është e paçmueshme. Mbase as që do të duhet shpjeguar se nuk ka burim më të mirë i lajmeve aktuale dhe ngjarjeve kulturore sesa ato që gjenden në një gazetë kombëtare, p.sh. si *New York Times* apo *Los Angeles Times.*

Por, me punën e gazetave në Net ka një problem.

Janë në dispozicion mbi 800 gazeta dhe vetëm një prej tyre (*The Wall Street Journal)* është me pagesë që nga viti 2000. Po ashtu, është e vërtetë se mund të shfletohen gazetat dhe revistat kryesore në Net pa pagesë; ndonëse kjo rrallë ndodh me revistat akademike, që kërkojnë tarifë të lartë. Rrallë herë ka dosje të botimeve paraprake apo indekse (të paktën jo indekse pa pagesë) për të kërkuar këto gazeta dhe revista pa pagesë. Kjo do të mund të ndryshojë deri në vitin 2001. Afro 100 gazeta janë duke sajuar arkiva të botimeve të kaluara me metoda kërkimi në Internet për nxjerrjen e të dhënave. Puna është se shumica do të kërkojnë një tarifë për kërkimin e botimeve të mëparshme.

E tëra përmblidhet në një ekuacion të thjeshtë. Revista dhe gazeta ditore, javore, apo mujore – me kërkim të përmbajtjeve pa pagesë. Botime të mëparshme, arkiva të po atyre revistave dhe gazetave – me pagesë. Pa marrë parasysh çmimin, asnjë indeks në Internet apo shërbimi abstrakt në këtë kohë nuk ofron kërkim të plotë retrospektiv. Shumica e dosjeve arkivore fillojnë nga mesi i viteve 1980 apo në fillim të viteve 1990. Nëse një student kërkon një artikull gazete, të themi, para mesit të viteve 1980, më e mira që mund të bëjë është të shikojë te Indeksi i Nju-Jork Tajmsit. Tani vetëm në formë të shtypur, ato ekzistojnë që nga viti 1851. (Shih kapitullin mbi indekset).

Nga ana e gazetave aktuale, ka burime të panumërta të dosjeve të botimeve të vjetra. Ato shfrytëzohen kryesisht nga historianë. Për shembull: *Historical Newspapers Online* (London: Chadwyck-Healey, çmimi ndryshon, www.chadwyck.com). *Historical Newspaper Online* ofron si indekse, ashtu dhe tekste të plota të *The Times-it* londinez nga viti 1970 deri në fillim të viteve 1970; si dhe indeksin e Nju-Jork Tajmsit (1851-1923).

Shumica e web-sajteve individuale bibliotekare kanë linke për revista dhe gazeta të dobishme elektronike. Shumë prej këtyre gazetave u kushtojnë shumë bibliotekave, por ato janë vënë në dispozicion, përmes faqes së Internetit apo sistemeve të ndryshme të referencës, pa pagesë për publikun. Ky fakt duhet reklamuar në masë të madhe, sidomos në mesin e studentëve dhe mësimdhënësve.

Gazetat, radioja dhe televizioni

Në Internet: Gale Database of Publications and Broadcast Media. Farmington Hills, MI: Gale Group, 1965 e tutje, gjysmë-vjetore, http://www.gale.com. Tarifa ndryshon.

Në shtyp: 1969 e tutje, vjetore, 3 vëll. $395.

Gazetat janë të shënuara në *Ulrich's* dhe *The Serials Directory* dhe gjenden edhe te udhëzues të tjerë. Për informacion më të plotë, ndërkaq, organizuar në format standard, më i miri është *Gale Directory.* Si i tillë, ai është artikull standard në shumicën e bibliotekave të referencës. Materiali është i radhitur sipas shtetit (dhe sipas provincave në Kanada) dhe pastaj sipas qytetit dhe bashkësive. Sipas qytetit, ka tri nënndarje themelore – gazetat, revistat dhe radiotelevizionet. Janë ofruar të dhëna mbi 8 000 gazeta, ditore, javore apo mujore. Këto të dhëna përfshijnë titullin e gazetës, datën e themelimit, shpeshtësinë e botimit, orientimin politik, tirazhin, emrat e anëtarëve kryesorë të stafit dhe informacionin mbi çmimet e reklamave. Gjatë vitit botohet edhe një shtojcë dhe një servisim plotësimesh.

Përpos gazetave, ky udhëzues përfshin edhe 11 000 të përkohshme të regjistruara detyrimisht, sipas vendit të botimit. Informacioni është i njëjtë, si dhe për gazetat, por dukshëm më i kufizuar nga ai që gjendet te *Ulrich's* apo bibliografi të tjera standarde. Prandaj, ndonëse *Gale Directory* është i dobishëm në gjetjen, të themi, se sa revista botohen në Albani të

Nju-Jorkut, ai nuk ofron informacion të detajuar që kërkojnë shumica e bibliotekarëve.

Hartat gjenden në vëllimin e tretë me nga një hartë në secilin shtet dhe provincë kanadeze, si dhe një për Porto-Rikon. Kjo pjesë pasohet nga numrat telefonikë dhe adresat e botimeve të veçanta. Vëllimi i tretë përmban një numër indeksesh për materialet që janë përfshirë në dy vëllimet e para.

Informacioni themelor për stacionet radiotelevizive, si dhe për sisteme kabllovike, është i ngjashëm me të dhënat për gazeta. Por, ka dhe shtojca jetike, siç janë ftesat, numrat a kanaleve, rrjetet degë, voltazhet, fushat e ndikimit të stacionit, orët e transmetimit e të ngjashme. Janë përfshirë edhe çmimet e reklamimit. Vështirë të gjendet mbulim më i plotë për radio dhe televizion, të paktën në një libër të përgjithshme të referencës, siç është ky.

Versioni në Internet ka të njëjtin material, si dhe ai në vëllimin e shtypur, por ndryshon në atë se ky plotësohet dy herë në vit, në vend se një herë në vit; dhe përfshin 11 000 buletinë të shtypur dhe 15 500 udhëzues në shtyp.[12]

Working Press of the Nation (Nju-Jork: R.R. Bowker, 1924 e tutje, 3 vëll., $395) është konkurrent i Gale-it dhe mbulon pothuajse të njëjtin material. Vëllimi i parë mbulon gazetat; i dyti shënon afro 5 500 revista dhe 1 600 gazeta (që paraqet vetëm një pikë në oqeanin proverbial krahasuar me atë të botuesit *Ulrich's* dhe *Magazine for Libraries (Revista për Biblioteka);* kurse vëllimi 3 përfshin televizionin dhe radion.

Cili është më i miri? Varet se cila fushë konsultohet. Gale është superiore në regjistrimin e revistave dhe televizionit, kurse Bowker ka një përparësi te gazetat. Mirëpo, për shumicën e bibliotekave cilado do të bënte punë.

Seritë: Listat e Unionit

"Cila bibliotekë ka gazetat X dhe të përkohshmet Y?". Kjo pyetje bëhet kur një bibliotekar apo shfrytëzues gjen artikullin e duhur në një revistë apo gazetë, por pastaj zbulon se biblioteka nuk e ka atë artikull. Rëndom ai mund të porositet përmes huazimit ndërbibliotekar apo përmes faksimit. Po ashtu, mund të ndodhë që teksti i plotë i artikullit të revistës të jetë edhe në Internet. Sidoqoftë, faksimi dhe metoda përmes Internetit janë të

[12] Versioni në Internet përfshin *Directory of Publications*, si dhe atë që gjendet në versionet e shtypura: *Directions in Print* dhe Newsletters in Print.

shtrenjta dhe shumica e njerëzve përdorin qasjen standarde ndërbibliotekare.

Ndonëse tani ka lista të unionit të panumërta në formë të shtypur të serive, shumica e bibliotekave të mëdha varen nga ajo që gjejnë në Internet, rëndom përmes OCLC, RLIN dhe rrjeteve të tjera.[13] Këtu vetëm sa duhet shtypur emri i serisë së kërkuar dhe arrihet informacioni standard që nga të dhënat themelore të botimit e deri te, ç'është me më rëndësi, lokacioni i titullit. Të dhënat mbi botimin kanë të bëjnë kryesisht me botimin e parë dhe janë aq të plota dhe gjithëpërfshirëse sa dhe ato që gjenden në udhëzuesit e të përkohshmeve. Në Internet mund të gjenden shënime për të paktën 55 000 gazeta të SHBA-ve. Dosja vazhdon të rritet dhe eventualisht do të përmbajë të gjitha gazetat amerikane, si dhe tituj të zgjedhur të huaj.

Përtej Internetit dhe bibliografive të shtypura nuk duhet harruar se shumica e bibliotekave shtetërore dhe lokale mbajnë shënime të veta mbi gazetat rajonale apo të qytetit. Ato rëndom bëhen pjesë e shënimeve në Internet, por një pjesë e madhe e informacionit shtypet në më shumë detaje te bibliografitë apo materialet shtetërore apo lokale. Programet e deponimit të këtyre të dhënave shpesh mbështeten me fonde federale dhe zhvillohen në bazën e koleksioneve të deponuara.

SHËRBIMET KËSHILLËDHËNËSE PËR LEXUES

Shërbimet këshillëdhënëse për lexues janë të rëndomta në bibliotekat publike dhe shpesh janë pjesë e shërbimeve të referencës. Ato janë definuar në mënyrë të ngjeshur nga Biblioteka e Lirë e Filadelfisë si "udhërrëfyes leximi, përzgjedhje e materialeve që përmbushin një interesim apo nevojë të caktuar, udhëzime për përdorimin e bibliotekës apo të një libri të veçantë, me rastin e kërkimit të një përgjigjeje apo referim nga agjenci të tjera apo burime informacioni jashtë bibliotekës". Në të vërtetë, shumica e bibliotekave janë paksa të kufizuara në definimin e tyre dhe definojnë e "udhëzimeve për lexim" si diçka që u ndihmon njerëzve për të gjetur librat që duan t'i lexojnë, si dhe si asistim në blerjen e atyre librave.

[13] Union List of Periodicals (Lista e Unionit e të Përkohshmeve), si pjesë e National Union Catalog (Katalogut Kombëtar të Unionit) ofron lokacionet e më se 800 000 serive, si dhe të dhëna bazë bibliografike për secilën seri. Lista plotësohet dy herë në vit kryesisht nga përmbajtjet e bibliotekave kontribuese.

Në një kuptim, bibliotekari i referencës shërben vazhdimisht si udhëzues i lexuesit në përzgjedhjen e materialeve, qoftë specifike, qoftë të përgjithshme. Kjo vlen sidomos si ndihmë në llojin e pyetjeve të hulumtim-kërkimit. Këtu bibliotekari do t'i ndihmojë lexuesit ta gjejë materialin jashtë koleksionit të referencës.

Në një etapë joformale, sidomos te bibliotekat e vogla dhe të mesme, me staf të kufizuar, bibliotekari i referencës mund të ndihmojë në përzgjedhjen paternaliste të një "leximi të mirë". Për shembull, dikush mund të sorollatet në sallën e referencave duke kërkuar një roman historik apo vepër publicistike mbi rrethimin e Trojës. Anëtari i stafit të referencës, si për mungesë të mbështetjes nga stafi, ashtu dhe për interesin e vet mund të ndihmojë në gjetjen e librit të dëshiruar, rëndom në koleksionet e përgjithshme.

Sa u përket listave ato janë të panumërta dhe një nga qendrat e llojeve më të popullarizuara mbi librat "më të mirë" në një situatë të caktuar bibliotekare. Listat, përkundër disa të metave të caktuara, janë të dobishme për këto raste:

1. Vlerësimi i koleksionit. Një metodë normale e vlerësimit të vlefshmërisë relative të një koleksioni bibliotekar është ta kontrollojë koleksionin sipas rastit apo në thellësi sipas listave të shënuara;

2. Krijimi i koleksionit. Aty ku biblioteka fillon pa asnjë libër por me një buxhet të arsyeshëm, shumica e këtyre listave janë kyçe me rastin e blerjes së koleksioneve bazë;

3. Ndihma për klientin në gjetjen e një vepre të veçantë në një fushë tematike. Shumica e listave janë të renditura sipas një lloj qasjeve tematike dhe ndër më të mirat të këtij lloji, shërbejnë për të ndihmuar shfrytëzuesin për ta gjetur materialin mbi temën e dëshiruar.

Përparësia e listës është se ajo është e hartuar nga një grup ekspertësh. Rëndom ka një redaktor dhe një autoritet, apo disa autoritete, që asistojnë në secilën fushë tematike. Mirëpo, një nga të metat e kësaj qasjeje komisioni është se këtu mëton të mbisundojë mediokriteti, ndërkaq që libri, si qëndrim jashtëzakonisht i guximshëm, mund të mos përfshihet, qoftë në përmbajtje apo në stil.

E përdorur me mençuri, bibliografia "më e mirë" është një udhëzues;

dhe ajo nuk duhet të jetë më shumë se kaq. Bibliotekari duhet të bëjë konkludimet e duhura lidhur me atë se çfarë duhet e çfarë nuk duhet të përfshihet në një koleksion. Nëse nuk është në gjendje ta bëjë këtë, bibliotekari duhet të shqyrtojë edhe një herë shkallën e vet të shkollimit bibliotekar dhe të heq dorë para se ta shkatërrojë koleksionin bibliotekar. Kur një grup bibliotekarësh diskuton pro dhe kundër listave të librave më të mirë, mendimi mbizotërues i shprehur është se listat e tilla janë "të mira", por kjo ka mbështetje shumë të dyshimtë.

Një e metë tjetër e qartë është se lista normalisht krijohet për një auditor të caktuar. Së fundi, përkundër përpjekjeve për ta mbajtur të aktualizuar listën (dhe këtu politika e Uilsonit e botimit të shtojcave të shpeshta ofron ndihmë të vërtetë), shumë prej tyre thjesht nuk mund të mbajnë hapin me shkallën e prodhimit të librave. Porsa të ketë dalë një listë e librave "më të mirë" të antropologjisë, kur një studiues tjetër boton veprën definitive në atë fushë që i bën të tjerat historikisht interesante, por jo veçanërisht të rëndësishme për nevojat aktuale.

Kontribuuesit këshillëdhënës për lexuesin

CD: The Reader's Adviser on CD-ROM. Bot. 15-të. Nju-Jork: R.R. Bowker, 1996. $400.

E shtypur: The Reader's Adviser. 1996, 6 vëll. $350.

Në Internet: NoveList. Ipswitch, MA: EBSCO, www.epnet.com, 1996 e tutje. $500.

CD: Good Reads. Provo, UT: Retro Link Associates, 1996 e tutje, çerekshe. $500.

E shtypur: Fiction Catalog, bot. 13. Nju-Jork: H.W. Wilson Company, 1995-1999, me katër shtojca vjetore. $80.

E shtypur: Public Library Catalog, bot. 10. Nju-Jork: H.W. Wilson Company 1993-1997, me katër shtojca vjetore. $180.

Reader's Adviser (Këshilluesi i lexuesit) është udhëzues standard në mesin e dhjetëra regjistruesve të përgjithshëm të "librave më të mirë". Fillimisht i planifikuar për shitës të librit që duan të krijojnë deponim bazë, ky komplet

gjashtë-vëllimesh tani përdoret gjerësisht në biblioteka. Ky botim ka lista me 55 000 tituj.

Renditja e secilës vepër ndjek një plan të caktuar. Së pari, ka një hyrje të përgjithshme tematike, pastaj vijnë listat e shkurtuara të veprave themelore të referencës dhe, së fundi, janë biografitë dhe bibliografitë për autorë individualë në një fushë të caktuar. Të pesë vëllimet kalojnë nga "veprat më të mira në prozën, poezinë, eseistiken, biografinë letrare, bibliografinë dhe referencën amerikane dhe britanike", në vëllimin e parë, te "veprat më të mira në literaturën shkencore, teknologji dhe mjekësi", në vëllimin e pestë. Secila pjesë është e hartuar nga një ekspert në atë temë dhe ky libër është fundamental për këdo që kërkojnë titujt themelorë.

CD-ja e *Reader's Adviser* ka të gjitha të dhënat që janë në versionin e shtypur por, për fat të keq, ka një sistem të ndërlikuar të kërkimit. Shpesh është më lehtë të shfletojmë një nga të gjashtë vëllimet e shtypura. (Natyrisht, në mungesë të sensit për humor, botuesi nxjerr një doracak prej 70 faqesh për të udhëzuar, ndër të tjera, edhe se si të gjenden në CD veprat e Mark Tuenit apo diçka që ka të bëjë me tregimet aventureske Brenda kohës sa ju duhet të studioni me kujdes këtë doracak, Tueini do të kishte shkruar Tom Sojerin).

Përgatitur nga ekspertë për laikë dhe bibliotekarë, CD-ROM-i *NoveList* dhe shërbimet e *Good Reads* ofrojnë qasje mbi temën, autorin, titullin, apo zhanrin të librave "më të mirë" për një situatë, apo për një lexues të caktuar. Në këtë aspekt, ato janë të ngjashme me versionin e shtypur; por dallojnë në dy raste të tjera pos formatit. Së pari, hiperteksti lidh libra të ngjashëm, që është një ndihmesë e mirë për kështilluesin e lexuesit, i cili ballafaqohet me pyetjen, "a mund të më gjeni një libër si atë të fundit?". Së dyti, ka një qasje shumë më të gjerë tematike nga ajo që gjendet në udhëzuesit e shtypur.

NoveList ka përparësinë e përfshirjes së 75 000 titujve, si dhe prozës, me afro 30 000 vështrime të plota tekstesh nga *Booklist, Kirkus, Library Journal* dhe *Publishers Weekly* që nga viti 1996. Titujt e ri dhe vështrimet shtohen në çdo çerek viti. Listave mund t'u qasemi qoftë sipas tematikës, qoftë sipas fjalës kyçe, apo titullit dhe autorit. Një tipar shtesë: ka linke të faqeve të ueb-it të autorëve apo të web-sajteve që kanë të bëjnë me temën. Ka artikuj të plotë tekstualë mbi libra, si dhe mbi tematikën e ngjashme. Opsioni i "krahasimit të romanit" i mundëson përdoruesit "të përdor një libër që e keni lexuar për të gjetur tituj të rinj". Ka udhëzues të tjerë, siç është ai i llojit "përshkruani thurjen", apo "përshkruani llojin e prozës", si

dhe i listave të titujve të shpërblyer. Po ashtu, kërkimi mund të kufizohet sipas moshës dhe niveleve të leximit.

Good Reads ka një bazë themelore të të dhënave të 10 000 romaneve, me tituj të rinj që shtohen në çdo çerek viti. Kur të jetë gjetur një titull i caktuar, ka një përshkrim të shkurtër të thurjes dhe të personazheve kryesore.

Për shumë vite, Kompania Uilson, me ndihmën e konsulentëve të kualifikuar ka ofruar lista të librave të zgjedhur për bibliotekat shkollore dhe publike. Konsulentët që përcaktojnë se cilët tituj do të përfshihen normalisht vijnë nga degë të ndryshme të Shoqatës Amerikane Bibliotekare. Rrjedhimisht, nga pikëvështrimi i autoritetit dhe besueshmërisë, listat e Uilsonit konsiderohen themelore për shumicën e qëllimeve të koleksioneve bibliotekare.

Ka pesë tituj në atë që është bërë e njohur si Seria Standarde e Katalogut Uilson.[14] Ato kanë një organizim pak a shumë të njëjtë, duke ndryshuar kryesisht në gjerësi dhe i dalluar për nga titulli, si për shembull, *Children's Catalog (Katalogu i Fëmijëve), Middle and Junior High School Library Catalog (Katalogu i bibliotekës së shkollës së mesme dhe të lartë), Senior High School Library Catalog (Katalogu i bibliotekës së maturantëve të shkollës së mesme)* dhe *Public Library Catalog (Katalogu i Bibliotekës Publike). Fiction Catalog (Katalogu i prozës)* u dedikohet pothuajse të gjitha grupmoshave, ndonëse ai shërben kryesisht si një shtojcë e *Public Library Catalog (Katalogut të Bibliotekës Publike)*, i cili nuk regjistron prozën artistike. Të gjithë katalogët e tjerë përmbajnë dhe njësi proze.

Tipike për këtë grup, *Public Library Catalog* fillon me një renditje të klasifikuar të afro 7 500 veprave joartistike. Secili titull është regjistruar sipas emrit të autorit. Informacioni i plotë bibliografik është dhënë bashkë me një shënim të shkurtër informativ. Pos disa fjalëve të atykëtushme përshkruese që i kanë shtuar hartuesit, shumica e shënimeve janë citime nga një a më shumë vështrime. Vështrimet janë dhënë sipas emrit, do të thotë *Choice, Library Journal* etj., por nuk ka citime të mëtejme sipas vitit, muajit apo faqes. Citimet janë zgjedhur për të treguar përmbajtjen dhe vlerën, por kjo e fundit është e pritur, ngaqë këtu janë futur vetëm

[14] Duke filluar nga mbarimi i vitit 2000, me edicionin 17 të *Children's Catalog (Katalogu i Fëmijëve),* H.W. Wilson nisi një program sistematik për të bartur të gjitha katalogët e tyre të zhvillimit të koleksioneve në Internet. Versioni në Net do të përfshijë edhe të katër shtojcat vjetore midis edicioneve të katalogëve. Si versioni i shtypur ashtu dhe ai në Internet i edicionit 18 të *Children's Catalog* do të jenë në dispozicion nga mesi i vitit 2001.

librat “më të mirë”.

Nga pikëpamja e referencës së pjesërishme që kërkohet, bibliotekari mund të bëjë një përzgjedhje të një titulli përmes leximit të shënimit, apo mund ta ftojë lexuesin kureshtar t’i hedhë një sy përshkrimit. Qasja e mëtejmë bëhet sipas titullit të detajizuar, autorit dhe indeksit tematik.

Që të mund të bëhet freskimi i shërbimit, një vëllim vjetor në formë softueri i zgjedhjeve të reja botohet për çdo vit deri në botimin e edicionit të ri. Kjo metodë e freskimit aplikohet nga Uilson në të gjithë seritë standarde të katalogëve.

Fiction Catalog ndjek të njëjtin format, si dhe udhëzuesi i bibliotekës publike. Në të ka mbi 5 000 tituj me shënime kritike. Afro 2 000 tituj të tjerë do të shtohen në shtojcat. Ai është veçanërisht i dobishëm për indekset e detajuara tematike, që kanë lista të librave nën jo vetëm një fushë, por në shumë fusha të përafërta tematike. Për më tepër, temat e gjera ndahen sipas fushës gjeografike dhe historike dhe veprat e reja dhe ato me tematikë të përzier analizohen sipas pjesëve të ndryshme. Shumica e titujve gjenden në shtyp dhe kushdo që është orvatur të këshillojë një shfrytëzues lidhur me titullin “më të mirë” në një fushë të caktuar tematike do ta gjejë këtë libër si tepër të vlershëm.

Problemet evidente me *Reader’s Adviser* dhe me udhëzues të tjerë është çmimi i tyre i lartë dhe gjerësia e tepërt. Për individë, asgjë nuk mund të matet me botimin e 23-të të *Good Reading* (Nju-Jork, R.R. Bowker, 1990). Kjo listë leximi është e njohur për shumë laikë, pasi që ajo kufizohet në 2 500 libra “më të mirë”, renditur sipas një tematike të gjerë. Secila ka nga një shënim të shkurtër, kurse vepra mbulon të gjitha temat e mundshme, përfshirë krijimtarinë letrare prej sumerianëve deri në ditët moderne. Përzgjedhja dhe shënimet janë bërë nga 34 ekspertë. Dhe, secila pjesë hapet me një hyrje të shkurtër. Stili është tërheqës, si dhe shumë nga përzgjedhjet. Kjo është një listë ideale për një individ që do të ngrihet. Udhëzuesi kushton 44 dollarë. Kjo nuk është shtrenjtë, por është më e lirë se të tjerat.

Botuesit gjithnjë e më shpesh janë duke botuar lista të ngjashme si për CD-ROM, ashtu dhe për sajte Interneti. Këto janë zënë në gojë gjatë tërë këtij teksti. Vëmendja përqendrohet në burimet informative dhe jo në stafin e listave të përmendura më lart të librave. Kjo mund të ndryshojë gjerësinë, në rastin kur dhe nëse dikush i kthehet Ueb-it për lexim rekreativ, si dhe për të dhëna reference.

Blerja e librave në Web

Të gjitha llojet e librave, si dhe të mediave të tjera, mund të blihen përmes kompjuterit. Një emër i zakonshëm shtëpiak për libra, *Amazon.com* (www.amazon.com) prin në gjetjen e titujve të kërkuar përmes Ueb-it të Internetit. Pas tij vijnë *Barnes and Noble* (www.barnesandnoble.com) dhe *Borders* (www.borders.com). Shitësit me shumicë të librit, si *Baker & Taylor*, ofrojnë shërbime por kufizohen te bibliotekat dhe organizatat e ngjashme.

Bibliotekarët e referencës janë të prirur të kanalizojnë blerjet te sektori bibliotekar i blerjes, por kohë pas kohe është e dobishme të dihet se deri te titujt mund të arrihet më shpejt me përdorimin e burimeve komerciale dhe në rast të librave jashtë profitit që t'u drejtohemi disa burimeve të titujve të përdorur dhe të antikuarëve.

Bookwire (www.bookwire.com) është i dobishëm ngaqë përmban lista të qindra dilerëve. Në mesin e librarive më të mira për të gjetur libra *të vjetër* të referencës: *Powell's Books* (www.powells.com); *Bookfinder.com* (www.bookfinder.com); *Alibris* (www.alibris.com) dhe *ABE/Advanced Book Exchange* (www.abebooks.com). Ka dhe dhjetëra të tjerë, por ato mëtojnë të kenë zgjedhjet më të gjera. Ka dhe burime të tjera të shumta mbi librat. Zgjedhja varet po aq sa shërbimi sa dhe nga oferta. Bibliotekarët e referencës do të mësojnë shpejt se cilat burime në Internet janë më të mirat për nevojat e tyre të veçanta.

Shënim: Gjetiu në këtë tekst, ka një diskutim të hollësishëm lidhur me botimin e librave përmes Internetit dhe të shkarkuar për lexuesin e veçantë. Këtu preokupimi është vetëm se si të gjenden librat më të mirë të shtypur.

SUGJERIME PËR TË LEXUAR

Baker, Nicholson, "The Authors vs. The Library" (Autorët kundruall bibliotekës), *New Yorker,* 14 tetor 1996, f. 50-62. Kampioni i katalogut në letër dhe armik i Bibliotekës së atëhershme të riorganizuar Publike të San Franciskos shpjegon në këtë artikull me ndikim se pse lexuesit duhet të vijnë në rend të parë dhe teknologjia në rend të dytë. Ai është kundër "entuziastëve telekomunikues që marrin në dorë bibliotekat e

mëdha kërkimore dhe përpiqen t'i ribëjnë ato... si vende ekspozimi për teknologjinë informative".

Balas, Jant, "Make New Friends...", *Computers in Libraries*, prill 1999, f. 38-40. Një diskutim në Internet të shërbimeve të librit, për tituj të rinj dhe të vjetër. Shembujt me URL të cituar. Shih, po ashtu: "Byuing Used Books", *Yahoo! Internet Life*, mars 1999, f.122; dhe "On the street-Out of Print Searching...". *Against the Grain*, prill 1999, f.62-64.

Dilevko, Juris dhe Moya Mason, "Why You Should Read the Papers", *Public Libraries*, mars/prill 2000, f.85-87. Mos gjeni vetëm artikuj gazetash për lexues, por lexoni gazetat rregullisht vetë. Kjo është kërkesa në një artikull që i dedikohet premisës se shërbimi i referencës mund të përmirësohet kur bibliotekarët lexojnë rregullisht gazetat. Fatkeqësisht, stafi që nuk u kushton vëmendje ngjarjeve aktuale mund të "arrijë një nivel shërbimi që nuk është aq i mirë sa ç'do të duhej".

Pack, Thomas, "New Stream", *Online*, janar/shkurt 2000, f. 17-24. Disa kompani tani ofrojnë një kombinim të gazetave, raporteve, dokumenteve qeveritare, e të tjera, me qëllim të ofrimit të informacionit aktual për korporatat. Autori shqyrton dy nga këto (Wavo dhe NewsEdge). Derisa biblioteka mund të dëshirojë të abonohet te një a dy, kënaqësia më e madhe me artikullin është se ai i sjell bibliotekarit një sërë idesh praktike se si të prezantojë informacionin aktual të biznesit.

KAPITULLI V
SHËRBIMET E INDEKSIMIT DHE TË ABSTRAKTIMIT: TË PËRGJITHSHME DHE TË KOLEKSIONEVE

Indeksi i revistave është vendi për të gjetur informacion mbi çdo gjë dhe për çdo kë. Me pak fat, përvojë dhe ndihmë nga ana e bibliotekarëve, kërkuesi do ta gjejë të paktën një artikull, mbase edhe me dhjetëra, për t'i plotësuar nevojat e një studimi, fjalimi, interesimi personal, apo kureshtjeje të thjeshtë.

Deri në fillim të viteve 1990, bibliotekari i referencës u drejtohej indekseve të shkruara. Sot, pos kërkimit për artikuj të botuar para mesit të viteve 1980, ai përdor pothuajse ekskluzivisht indekset digjitale. Arsyeja: ato janë të shtrenjta. Një indeks digjital mund të kushtojë dhjetëra herë më tepër se versionet tradicionale të shtypura. Në anën tjetër, shpesh nuk ka zgjedhje tjetër. Shumica e indekseve të përgjithshme janë vetëm në Internet.

Pse janë aq të popullarizuara indekset në Internet ? Kryesisht, kjo është çështje praktike. Kur dikush dëshiron të kërkojë për ndonjë periudhë kohe, që ka të bëjë me muaj dhe me vite, duhet skanuar disa botime të indeksit të shkruar – një punë që merr shumë kohë, sidomos kur dikush tjetër është duke shfletuar indeksin për materialin që kërkon shfrytëzuesi. Në kompjuter, indeksi i plotë mund të kërkohet përnjëherë.

Indekset e shtypura, si dhe indekset digjitale, udhëzojnë shfrytëzuesin në një artikull, i cili pastaj do të gjendet në bibliotekë. Në Internet, shumë indekse jo vetëm që ofrojnë citime, por shtojnë edhe tekstin e artikullit të

plotë. Bibliotekari mund të gjejë një citim të një artikulli dhe ta lexojë atë në Internet brenda pak minutash. Aty ku aplikohet versioni i shtypur do të kërkohet pesë deri në gjashtë herë më shumë kohë për ta gjetur po të njëjtin material.

Sot, përkundër kujtimeve të mira për indekset e shkruara, askush, që nga një kërkues amator e deri te një ekspert, nuk dëshiron të kthehet në një sistem të vjetruar që merr më shumë kohë, nëse jo dhe më shumë durim, sesa mesazhi i bartur elektronikisht. Laikët nuk bezdisen shumë sa u përket formateve – një nocion të cilin nganjëherë bibliotekarët e harrojnë. Ndërkaq, ata janë të vëmendshëm kur të kenë zbuluar atë që kërkojnë, ngaqë udhëzuesit në Internet, mostrat e të kërkuarit dhe rrugët janë aq të ngatërruara.

Indekset e shtypur

Të paktën për disa vite të ardhshme, indekset e shtypur nuk mund të shmangen. Ata janë të vetmet indekse në dispozicion për pjesën më të madhe të kërkimit retrospektiv dhe, në biblioteka të vogla dhe të mesme, mund të jenë indekset e vetme alternative kundruall atyre elektronike. Problemi i sotshëm është se studiuesit dhe laikët, që janë mësuar me kompjuterin, shkojnë në bibliotekë (apo përmes kompjuterit të tyre personal në shtëpi) për të gjetur indekse elektronike. Nëse biblioteka ka një indeks superior të shtypur për nevojat e tyre, qoftë nga mosdija apo me qëllim, ata do të parapëlqejnë të përdorin një indeks më pak të përpiktët përmes Internetit. Në këtë pikë, do të ishte punë me mend që bibliotekari të shpjegojë se çfarë ka në dispozicion pos versionit në Internet.

GJERËSIA DHE PËRMBAJTJA E INDEKSIT

Në nxitim për të gjetur shtegun më të mirë të qasjes për një autostradë informative, nuk duhet harruar se gjërat esenciale kurrë nuk ndryshojnë. Që nga indeksuesi i parë e deri te kompjuteri i fundit, përmbajtja vjen e para për nga rëndësia. Bibliotekari i sotshëm i referencës mund të jetë në gjendje të gjejë vendkalimin e duhur të hyrjes dhe të skicojë rrugën për përdoruesin individual. Kjo kërkon një kuptim të sofistikuar të specifikave që kanë të bëjnë me përmbajtjen.

1. *Të përkohshmet*

a. Indekset e përgjithshme mbulojnë shumë të përkohshme në një fushë të gjerë apo specifike tematike. *Reader's Guide to Periodical Literature (Udhëzuesi i lexuesit për në literaturën e të përkohshmeve)* ka qenë më i njohuri i këtij lloji indeksi. Sot, ai është sfiduar nga indekse më masive, si EBSCO, Bell-Howell, IAC, etj. Për të gjitha këto bëhet fjalë në këtë kapitull.

b. Indekset tematike mbulojnë jo vetëm disa të përkohshme, por edhe materiale të tjera që gjenden në libra të rinj, pamflete, raporte dhe dokumente qeveritare. Qëllimi është të indeksohen materialet në një fushë të ngushtë tematike. Shembuj të këtij lloji indeksi janë *Applied Science & Technology Index (Indeksi i shkencave aplikative dhe teknologjike)* dhe *Library Literature (Literature Bibliotekare).*

2. *Gazetat.* Ka indekse të shumtë gazetash në Shtetet e Bashkuara. Më i njohuri është *The New York Times Index (Indeksi i Nju-Jork Tajmsit).* Sot, ka shumë shërbime që ofrojnë indekse për disa gazeta. Për shembull, *The National Newspaper Index (Indeksi Kombëtar i Gazetave),* si dhe indekse të tjerë më të mëdhenj të përgjithshëm në Internet, që bartin nga dy muaj deri në një vit indeksimin e gazetave të mëdha, p.sh. të *The New York Times, The Wall Street Journal* dhe *The Christian Science Monitor.*

3. *Seritë.* Ka indekse për raporte, të botuara dhe të pabotuara; dokumente qeveritare; procesverbale konferencash dhe kongresesh, si dhe vazhdimësi; ka po ashtu materiale të tjera që janë përcaktuar si seri, do të thotë, çdo botim që është qarkulluar pjesërisht për një kohë të pacaktuar kohe.

4. *Mediat.* Indekset i ndihmojnë shfrytëzuesit ta gjejë çdo formë të medias, që nga grafika e filmi e deri te reproduktimet e artit.

5. *Indekset e librave.* Indekset e librit përdoren rrallë nga bibliotekari i referencës. Ato do t'i sugjerohen lexuesit vetëm kur ai apo ajo mund të

kenë gjetur librat mbi një temë të caktuar. Në këtë pikë, pritet që lexuesi të jetë mjaft inteligjent sa për të konsultuar indeksin e librit individual.[1] Shënim: Gradualisht, Indekset në Internet janë duke përfshirë edhe indekset mbi librat e zgjedhur në shërbimet e tyre, ndonëse rëndom kjo bëhet në fusha të specializuara tematike. Se sa larg do të shkojë kjo është vështirë të thuhet.

Shërbimet e abstrakteve

Abstrakti ofron një analizë objektive të asaj që përmban një artikull, libër, film, e kështu me radhë. Abstrakti informativ përfshin mjaft nga të dhënat sa për t'i dhënë përdoruesit një ide të saktë të përmbajtjes. Një abstrakt nuk është kurrë vlerësues, të paktën jo qëllimisht. Një abstrakt tipik përbëhet nga 100 deri në 300 fjalë, por mund të jetë dhe më i shkurtër apo më i gjatë varësisht nga shërbimi i veçantë i indeksimit.

Përdoruesit pëlqejnë, madje dhe kërkojnë, indekse që përfshijnë dhe abstrakte, ngaqë një abstrakt i shkruar si duhet i mundëson përdoruesit: (1) që të vendosë nëse e vlen mundin që kërkohet artikulli, libri, dokumenti, apo burimi tjetër; (2) që të vendosë vetëm sa ta përdor informacionin në abstrakt.

Kërkesa në shtim, madje edhe insistimi, për abstrakte i ka detyruar të gjitha firmat e indeksimit të përgjithshëm që t'i përfshijnë ato në vitet e fundit. Një shërbim i përgjithshëm pa abstrakte duhet të shmanget. Kjo vlen për indekset tematike. Arsyeja e thjeshtë është se shumë indekse të vogla nuk janë konkurrentë dhe duhet të jenë në bibliotekë me apo pa abstrakte.

Cilin nga indekset?

Cilin indeks duhet përdorur për të gjetur përgjigje në një pyetje të caktuar?

Për pyetje tipike për studentë dhe laikë u drejtohemi indekseve të

[1] Ne mund të "lexojmë" një indeks libri. Për shembull, shih indeksin te libri i Mark Amory-it, *Life of Lord Berners (Jeta e Lordit Berners),* (Londër, 1998). Nën "Berners", në indeks, mund të gjendet një lloj tregimi i shkurtër: "Raportet me nënën… i mungojnë shokët në fëmijëri… nota rinore të balietit… homoseksualiteti… depresioni dhe deprimimi… noton në Helespont… diletantizmi… flama… pianoja në makinë… Diaghilevi përmban baletin nga… takim i supozuar me Hitlerin… poezi shpotitëse mbi hundën dhe lulen… ngacmon Ualtonin… nuhat… fyen Nensi Astorin… i shteret dëshira për seks… supozohet të ketë marrë kokainë… nuk pranon terapinë profesionale… në shtëpinë e përkujdesjes në Riçmond". Berners (1883-1950) nuk ishte vetëm një baron me një rrëfim të jashtëzakonshëm jetësor, por edhe kompozitor.

përgjithshëm, kurse për pyetje më të detajuara, konsultojmë indeksin tematik. Shumica e indekseve paraqesin suazat e tyre në titull. Është lehtë të imagjinohet e përmbajtjes së *Art Index.* Në një nivel më të ndërlikuar, bibliotekari njihet me disa fusha tematike dhe është në gjendje që t'i gjejë shpejt emrat e indekseve tepër të specializuar brenda një fushe tematike. Po qe se nuk është në gjendje të mbajë në mend, atëherë ai i kthehet *Guide to Reference Books, American Reference Books Annual, Magazines for Libraries* dhe udhëzuesve të tjerë, ku indekset themelorë janë të renditur sipas temave.

Ku është indeksuar?

Ne duam të dimë se ku është indeksuar një e përkohshme e popullarizuar. Ju thjesht duhet ta konsultoni një indeks të përgjithshëm që mbulon të përkohshmet e popullarizuara – që nga *Readers' Guide* e deri te *Guide to Expanded Academic Index* – dhe ka gjasë se do ta gjeni titullin tuaj të indeksuar në atë shërbim. Pa dyshim që një revistë e popullarizuar tematike do të gjendet, po ashtu, edhe në një indeks të popullarizuar tematik që nga *General Science Index* e deri te *ERIC.*

Ka raste kur e përkohshmja është ezoterike dhe titulli zbulon pak nga përmbajtja. Atëherë po ai informacion do të mund të gjendet më shpejt me konsultimin e një a dy burimeve: (1) *Ulrich's International Periodical Directory,* që sugjeron një a dhjetëra vende ku është indeksuar e përkohshmja në fjalë. Shikoni emrin e revistës dhe ka një informacion të plotë, përfshirë dhe indekset që analizojnë rregullisht atë titull; (2) Një burim tjetër themelor i informacionit është *Magazines for Libraries.* Secili nga afro 8 000 titujsh themelorë përmban dhe informacion lidhur me atë se ku është indeksuar një titull. Që të dy këta udhëzues shpjegojnë se çfarë indeksesh ka në formë të shtypur, në Internet, në CD-ROM dhe në formate të tjera.

Qasja më e sofistikuar për të gjetur një indeks për një të përkohshme të caktuar gjendet në *Periodical Titles in OCLC FirstSearch.* Përkundër titullit të prapët, ky shërbim është një metodë Interneti ku përdoruesi hyn në emrin e një të përkohshmeje dhe shërbimi tregon se ku është indeksuar dhe abstraktuar ajo. Ai mbulon të gjithë indekset kryesorë dhe disa dytësorë, si dhe përfshin mbi 120 000 tituj të të përkohshmeve. Po ashtu, një temë apo emër mund të qaset dhe monitori të tregojë disa dhjetëra të përkohshme që mbulon të njëjtën fushë. Një shteg tjetër është të shtypet emri i indeksit. Mund të kërkohen të gjithë titujt në indekse, apo vetëm

për titujt me tekste të plota në indekse. Për secilën njësi ka një emër të së përkohshmes, numri ISSN, data e fillimit të indeksimit në shërbim, si dhe i muajit kur ka filluar teksti i plotë – nëse ka. Problemi këtu qëndron në atë se për të parë të gjitha të përkohshmet e indeksuara në ABI/INFORM duhet vështruar 74 ekrane.

KËRKIMI I NJË INDEKSI

Shërbimet e indekseve lavdërohen për shtigjet e ndryshme të kërkimit të suksesshëm.

Përdoruesit mesatar, përfshirë edhe shumë bibliotekarëve, kjo nuk u bën përshtypje. I njohur me librat masivë udhëzues (në formë të shtypur), si dhe me programet kompjuterike po aq përbindësh, laiku do të kërkojë udhë të shkurtra për t'i ikur mbamendjes së hartave të softuerëve kompjuterikë. E njëjta gjë ndodh edhe me indekse e sidomos me shërbimet që kanë të bëjnë me tematikë. Një vështrues i rëndomtë i përditshëm i një pike referimi – në shkollë, ambient publik apo akademik – e sheh se si edhe indeksi më i sofistikuar kërkohet nga qytetari i rëndomtë – me shkurtesa.

Me kërkim të informacionit mbi turizmin apo me kërkim të kuptimit të jetës, njeriu mesatar vetëm sa mëton një gjë: të gjejë një a më shumë artikuj në mënyrë të lehtë lidhur me atë temë. Me shpresë se do të kenë një njohur kompjuterike, bibliotekari i udhëzon ata të shikojnë në kompjuter, mbase të kërkojnë një indeks pas një interviste të shkurtër reference dhe t'i lënë që ata vetë të gjejnë atë që u duhet.

Dhe, si do të kalojnë Gjoni dhe Maria me çështjen se "ku gjendet artikulli"? Kjo varet nga fati. Ata e dinë të vetmen rrugë për në informacion. Shtypin një fjalë kyçe apo një sërë fjalësh kyçe, madje edhe një fjali të tërë, ulen dhe presin se ç'do të ndodhë. Nëse u ndihmon Zoti, paraqiten dy a tre artikuj, që janë të ngjashëm me atë që u duhet.

Tekstet e plota në Internet kanë shtuar kënaqësinë e kërkuesit mesatar. Ata tashmë nuk kanë nevojë të vendosin nëse biblioteka e ka revistën ku ka dalë artikulli. Një ikonë përfton për t'i informuar se mund të shkarkojnë apo të shtypin artikullin, pa vrarë mendjen që të lexojnë abstraktin, apo madje edhe titullin.

Vetëm në raste të rralla – rëndom kur ndeshen shtypësi dhe kompjuteri – ata ankohen se nuk kanë arritur të gjejnë asgjë. Pothuajse të gjithë janë të kënaqur me këtë teknologji të re, me mundësinë për t'u futur në

autostradën informative.

Bibliotekarët me përvojë të referencës mund të ankohen sa të duan mbi mungesën e entuziazmit për pika më të mira të indeksimit për laikë. Nga ana tjetër, gjërat nuk kanë ndryshuar aq shumë. Para disa vitesh, babai apo motra e të njëjtit person do të mund të kishte shfletuar disa botime të shtypura të *Readers' Guide to Periodical Literature*, të kishte gjetur (nën rubrikën tematike) disa artikuj gjegjës, të kishin shtypur revistën, fotokopjonin disa faqe dhe do ta kishin lënë bibliotekën të molisur, por të kënaqur. Shtegu në këtë proces tani është më i shpejtë, më efikas dhe më i lehtë për përdoruesin, por pothuajse nuk është ndryshe.

Siç është dëshmuar gjatë tërë këtij teksti, shumë të rinj (që nga shkolla e mesme e deri në kolegj e universitet) kanë braktisur tërësisht burimet e shtypura të referencës. Ata mbështeten plotësisht në kompjuter dhe në të shumtën e rasteve nuk janë në njohuri të ekzistimit të indekseve në Internet, aq më pak për mënyrën se si shfrytëzohen. Roli kryesor i bibliotekarit të sotshëm është t'i edukojë ata, qoftë edhe në mënyrën më të thjeshtë lidhur me atë se çfarë mund e çfarë nuk mund të gjendet në Internet. Ka dy përgjigje pos "edukimit" të gjithëpranishëm për qasje të kënaqshme në indekse nga laikë: (1) bibliotekari mund të marrë parasysh mundësinë e kërkimit vetanak për një personin... një pikë, e cila është diskutuar gjetiu; (2) botuesit e indeksimit dhe shitësit janë duke thjeshtësuar gradualisht programet e tyre për t'i bërë më të kapshëm nga qytetari mesatar.

Duhet pasur kujdes në rastet kur publiku është duke u mbytur në informacion, apo kur është duke u çmendur për të gjetur atë që i duhet. Bibliotekari duhet të kuptojë përdorimin e indekseve, ndërlikueshmërinë e sistemeve të caktuara, si dhe metodën më të mirë të kërkimit.

Kërkimi dhe kryetitujt tematikë

Ka një konsensus se mënyra më e mirë për të kërkuar një indeks është përmes kryetitullit të shënuar tematik. Rëndom, indeksuesi shikon artikullin, përcakton temat e mbuluara dhe pastaj shënon kryetitujt tematikë. Makinat kompjuterike të kërkimit bëjnë pothuajse të njëjtën gjë – qoftë përmes kompjuterit, apo përmes njerëzve të vërtetë, të drejtpërdrejtë – apo duke përftuar zgjedhje të shumta sipas renditjes së paraqitjes. Nga këto dy sisteme, i pari, ai i kryetitujve tematikë është dukshëm më i saktë,

më kursimtar në kohë dhe me më pak telashe.

Gjatë kërkimit të indekseve të shtypura, bibliotekari duhet të krahasojë temën apo konceptin kërkimor me termin e përdorur nga indeksuesi. Kjo vlen, po ashtu edhe për kërkimin elektronik, sidomos aty ku kërkohet saktësi.

Nëse indeksuesi ka përdorur termin *banim*, përdoruesi nuk do të gjejë asgjë nëse kërkesa është bërë për *shtëpi*, ndonëse në shumë raste mund të ketë një ndër-referencë sipas regjistrit për "shtëpi", që thotë "shih: banim". Po të kishte mjaft ndër-referenca nuk do të kishte problem të vërtetë, por do të kishte një indeks gjigant në Internet apo në formë të shtypur. Zgjidhja ka qenë një kompromis. Indeksuesi skanon tekstin dhe pastaj përpiqet të shënojë kryetitujt tematikë, që do të mund të përdoreshin nga shumica e përdoruesve.

Ku i marrin indeksuesit këto terma? Ato vijnë drejtpërdrejt nga ato që quhen lista të kryetitujve tematikë "të kontrolluar". Ato mund të jenë të dobishme për bibliotekarin e referencës që kërkon një term specifik tematik:

1. *Lista e kryeartikujve tematikë.* Shumë indekse përdorin një formë të fjalorit të kontrolluar. Kryetitujt tematikë janë të paracaktuar dhe artikulli krahasohet me një listë autoritative të kryetitujve tematikë. Indeksuesi përzgjedh nga një deri në tre, apo edhe më shumë, terma nga lista, që përshkruajnë më së miri përmbajtjet e artikullit. Të dy listat bazë të kryetitujve tematikë që konsultohen nga bibliotekarët e referencave dhe kataloguesit janë:

   a. *Library of Congress Subject Headings (Kryetitujt tematikë të Bibliotekës së Kongresit),* (Uashington, DC: Biblioteka e Kongresit, data të ndryshme). Ky është kompleti i njohur, i trashë, shumëvëllimor, rëndom i lidhur në të kuqe (prandaj edhe quhen shpesh *librat e kuq).* Ky komplet përmban lista të kryetitujve tematikë standardë të Bibliotekës së Kongresit në renditje alfabetike. Nëse dikush dëshiron të shohë se si është regjistruar historia e Anglisë, atëherë do të kërkojë njësinë "Anglia" dhe pastaj të gjejë referencën "shih: Britania e Madhe – Historia". Ky hap i vetëm i jep përdoruesit një kryetitull të caktuar tematik dhe i kursen shumë kohë në vend se të sorollatet në indeks Interneti apo të shtypur për të kërkuar për libra joekzistues të historisë

angleze, të paktën nën kryetitullin tematik dhe që mbulimin e tërë rajonit të Britanisë së Madhe. Ka ndër-referenca, sinonime dhe pjesë të tjera udhëzuese dhe asistimi për ta ndihmuar përdoruesin në gjetjen e kryetitullit të duhur tematik. (Shih shpjegimin e simboleve, organizimit etj., në fillim të vëllimit të parë).

Lista e Bibliotekës së Kongresit plotësohet me edicione të reja dhe, mes edicioneve, shtimeve dhe ndryshimeve në *Cataloging Service Bulletin.* Siç kanë vërejtur shumë kritikë, kryetitujt tematikë janë profil i kohës sonë, sidomos në disa vite të fundit derisa ekspertët e kryetitujve tematikë pranuan me më simpati ndryshimet.[2]

b. Sears List of Subject Headings (Lista e Sirsit e kryetitujve tematikë), (Nju-Jork: H.W. Wilson Company, data të ndryshme). Ky është një ekuivalent i barabartë me *Library of Congress Subject Headings* për biblioteka të vogla. Ka më pak kryetituj tematikë. Sirsi paraqet një edicion të shkurtuar, me ndryshime për t'iu përshtatur koleksioneve më të vogla nga ato të Bibliotekës së Kongresit.

Në rastin e kërkimit kompjuterik është dhënë edhe një udhëzues mbi kryetitullin tematik. Rëndom, shumica e bazave të të dhënave kanë të shënuar kryetituj tematikë. Në këtë aspekt, ata ndjekin fjalën e sugjeruar nga versionet e tyre të shtypura. Në të njëjtën kohë, ka pika të tjera të shumta të qasjes. Në saje të aftësisë së kompjuterit për të kërkuar fjalët kyçe, mundësitë për të gjetur një pjesë informacioni janë shtuar dukshëm. Kërkimi kompjuterik mundëson qasje të shpejtë në terma të reja dhe në mënyra të reja dhe të ndryshme të shqyrtimit të një teme.

Duke përdorur një kërkim elektronik, nuk lidhemi me trillet e kryetitujve tematikë të shënuar nga dikush që nuk e çmon sa duhet mënyrën se si njerëzit kërkojnë informacion. Por, mos harroni së përdorimi i kryetitujve tematikë përmirëson gjithmonë lehtësinë e qasjes dhe saktësinë e kërkimeve.

[2] Biblioteka e Kongresit është e vetëdijshme për përgjegjësinë – si dhe kritikë të shumtë, kryesori nga të cilët ishte Sandy Berman. Megjithëkëtë, ka një debat të vazhdueshëm midis bibliotekarëve dhe Bibliotekës së Kongresit lidhur me plotësimet e terminologjisë së re (nga rrëshqitja në Internet deri te plotësimet e kryetitujve të fesë islame). Në një botë mediale tepër ndryshuese, LC-ja e ka të vështirë të mbajë hapin me terminologjinë e televizionit, Internetin dhe këndin e rrugës.

2. *Thesaurusi. Thesaurusi* është i ngjashëm me listën e kryetitujve tematikë në kuptim se ai përmban listë të termave të përdorura për indeksim dhe për kërkim. Është shoqërues i shpeshtë i secilit që është duke bërë kërkim. Përkundër dikujt që lexon tekstin dhe vendos se cilin kryetitull tematik të shfrytëzojë, thesaurusi thjesht mbështetet në fjalët kyçe të vetë dokumenteve apo të dokumenteve të ngjashme në atë fushë tematike. Rëndom thesaurusi përdoret në fusha të caktuara tematike. Nuk është i përshtatshëm për indekse të përgjithshme të të përkohshmeve.

Thesaurusi tregon raportin ndërmjet termave. Ne mund të shohim se çfarë janë konceptet në kuptim të gjerë dhe të ngushtë brenda strukturës hierarkike të ndërtuar mbi një a më shumë kategori themelore të termave. Termi familje në *shërbimet referuese*, për shembull, do të mund të përfshinte terma për lloje të ndryshme të shërbimeve. Këtu mund të gjejmë termin *intervistë reference* me termin me të gjerë, *kërkimi informativ* dhe me termin e ngushtë *shenjëzimi verbal*. Është e dëshirueshme që të kemi thesaurusin në formë të shtypur dhe në atë të Internetit. Po të kemi kohë për ta konsultuar, pa marrë parasysh se në cilin format, do ta bëjë kërkimin më të saktë dhe rëndom shumë më të shpejtë. Kryetitujt e caktuar tematikë, thesaurusi tematik dhe ndjenja e thjeshtë që kemi për terma që mund të përdoren në një indeks do të na mundësojnë të kemi një kërkim më të shpejtë dhe më të lehtë.

Bibliotekarët veteranë të referencës e vlerësojnë shumë saktësinë e kryetitujve tematikë të caktuar dhe thesaurusin. Për fat të keq, të pakët janë ata laikë që kuptojnë (apo madje që çajnë kokën) për çështje të tilla. Si rrjedhojë, një shfrytëzues mesatar i bibliotekës, pa ndihmën e bibliotekarit, hyn te fjalët kyçe dhe shpreson të gjejë, me kohë, atë që i duhet. Ndryshimi ndërmjet këtyre dy qasjeve është si të përdorni një magnet gjigant për të gjetur një gjilpërë në një mullar me sanë, duke hedhur tej sanën pareshtur me shpresë se do të gjendet ajo që kërkojmë.

DISPONUESHMËRIA E TEKSTEVE TË PLOTA

Pse një bibliotekar reference përzgjedh një indeks apo shërbim abstraktues kundruall një tjetri? Siç mund të pritet, këtë e përcakton

baza e të dhënave me përmbajtjen e duhur të temës. Dhe, aty ku ka më shumë indekse për kërkesën, atëherë ajo do të jetë ajo që është më e lehta për t'u përdorur. Një faktor i tretë për t'u përcaktuar për zgjedhjen është disponueshmëria me tekst të plotë, që citohet si arsyeja numër një në përzgjedhjen mes indeksimit apo shërbimit abstraktues X dhe Y. "Shfrytëzuesit zaten duan tekstin e plotë", shpjegon një bibliotekar, "mundësisht me grafika dhe e duan që atë ta gjejnë në një web-sajte që ka lehtësinë e një sërë opsionesh të nxjerrjes dhe të qasjes".[3]

Shumica e problemeve me pyetjen "ku gjendet ky artikull?", janë zgjidhur përmes praktikës së thjeshtë të vendosjes së artikullit në Internet. Ne mund të gjejmë një citim, të përdorim një ikonë të nevojshme dhe artikulli paraqitet në ekran, që të mund të shkarkohet, të shtypet apo thjesht të lexohet.[4] Të gjithë indekset e përgjithshme dhe shumë indekse tematike kanë artikuj me tekste të plota. Shërbimi i indeksimit, i cili do ta ofrojë tekstin e plotë të një reviste, kontrakton me botuesin për t'i paguar X qindarka apo dollarë atij botuesi sa herë që dikush të kërkojë tekstin e plotë nga revista e botuesit. Indeksuesi, pastaj, ia kalon këtë pagesë bibliotekës.

Ndonëse kjo paraqet një kosto shtesë për bibliotekën, teksti i plotë në Internet është ideal për lexuesit. Problem i vetëm është se jo çdo gjë e indeksuar është në dispozicion në këtë mënyrë. Një ditë, në një të ardhme jo të largët, të gjitha, apo 99 % të artikujve do të gjenden me tekste të plota në terminalin kompjuterik. Ndërkohë, ka disa mënyra për t'iu qasur problemit të mosekzistimit të tekstit në Internet: (1) Përdorni metodën e vjetër të shënimit të citimit dhe të kërkimit të tij në bibliotekë për ta gje-

[3] Carol Tenopir, "Database Use in Academic Libraries" (Përdorimi i bazës së të dhënave në bibliotekat akademike"), *Library Journal,* 1 maj 1999, f. 38. Dhe, tani këkohet më shumë se teksti i plotë. Botuesit dhe indeksuesit i premtojnë se shfrytëzuesi do të jetë në gjendje që të kalojë lehtë nga një citim i një artikulli gazetaresk në përmabjtjen e një fusnote me një rënie apo të dy të minit kompjuterik. *The New York Times,* 18 nëntor, 1999, f. G3. Më 2000, për shembull, Shtypi akademik filloi të bashkëpunojë me 12 botues të mëdhenj shkencorë dhe studimorë për t'u mundësuar studiuesve të lexojnë përmbajtjen e fusnotave. Nga mesi i viteve 2000, afro 3 milionë arikuj nga mijëra revista janë lidhur me këtë shërbim.

[4] Për shembull, sistemi Info Trac IAC përdor ikonën e një faqeje, d.m.th. "tregon se teksti i plotë është në dispozicion për t'u shtypur apo ofruar." Një ikonë e librit të hapur "tregon se nuk ka tekst në dispozicion për t'u shtypur apo ofruar, por përmbajtja e plotë i shënimit (d.m.th. revista dhe artikulli) mbahet në bibliotekë". Një zarf i mbyllur: tregon se nuk është në dispozicion as përmbajtja e plotë dhe as teksti i plotë, por se ju mund të dërgoni shënimin… në një adresë të postës elektronike".

tur revistën;[5] (2) Nëse revista nuk gjendet në bibliotekë, porosia për artikullin përmes huazimit ndërbibliotekar dhe/apo përmes metodave të tjera që kërkojnë kopje faksi për ta dërguar përmes e-malit, apo Internetit.

Kërkimi i tekstit të plotë

Disponueshmëria me tekst të plotë përpos përparësisë ka dhe dobi të tjera. Kërkimi është i zgjeruar nga fjalët kyçe apo abstrakti dhe kryetitulli tematik te fjalët në tekst. E meta, ndërkaq, është e qartë: ka tepër material për çdo gjë, pos nëse kërkuesi është fare specifik. Kërkimi i fjalës "qen" në një revistë mbi përkujdesjen e shtazëve do të rezultojë me faqe të tëra të materialit të padiferencuar. Anasjelltas, kërkimi për një lloj të rrallë të qenit, siç është qenushi tibetan-kinez do të dëshmojë se çfarë do të kenë lënë jashtë praktikat standarde të indeksimit.

Një tipar tjetër i dobishëm, nën emra dhe ikona të ndryshme nga shërbime rivale, është mundësia për të ofruar nënndarje të temës në kërkim. Për shembull: "ilustrimi i librave" është ndarë në disa nëntituj periodikë (shek. XVI) deri te "temat, motivet". Lidhur me këtë është edhe linku; "shihni artikuj të tjerë lidhur me këto tema". Në këtë rast, pesë njësi paraqiten nga kopertina e librit e deri te romanet e ilustruar të F. Skot Ficxheraldit.

Kërkimi i shtigjeve dhe i metodave

Si mund të mësojmë pikat më të mira të kërkimit të një indeksi digjital? Nga përvoja. Përtej kësaj është më rëndësi të lexohen udhëzimet (në shtyp apo në formë digjitale, apo që të dyja), të cilat i shoqërojnë indekset. Po japim disa sugjerime për kërkim të suksesshëm. Shihni, po ashtu për artikuj të shpeshtë që paraqiten në zhurnalë që nga *Online* deri te *Computers in Libraries.* (Më të mëdhatë janë të regjistruar dhe cituar në sektorin e "të përkohshmeve bibliotekare" të *Magazines for Libraries).*

Çështja është se pothuajse çdo kush mund të gjejë diçka nga indeksi digjital pa kurrfarë njohurie të kërkimit. Nga ana tjetër, përse të investohet

[5] Shumica e shërbimeve elektronike të indeksimit i mundësojnë bibliotekës të tregojë shënimet për çdo njësi. Ky shënim paraqet se a është apo jo në dispozicion revista (me artikullin) në bibliotekë; rëndom ofrohet datat e materialeve, d.m.th. 1973 e këtej, 1993 deri në 2000, e kështu me radhë. Po ashtu, mund të hyjmë edhe në një shënim negativ, si p.sh., "Nuk është në dispozicion në këtë bibliotekë. Kërkoni nga bibliotekari i referencës që t'u ndihmojë".

në një veturë të fuqishme për të udhëtuar nga shtëpia në shitore një rrugë më larg. Ka shumë të dhëna në dispozicion, por kërkohet mjeshtri për të kërkuar të gjendet pikërisht ajo që duhet, më parë se çdo gjë me përshkrues identikë, për të cilën nuk kemi nevojë.

Në këtë tekst, indekset janë përshkruar kryesisht në kuptim të asaj se si përdoren dhe se si kërkohen. Kjo do të kërkonte shumë hapësirë dhe pos kësaj, mostrat e të kërkuarit mëtojnë të ndryshojnë pothuajse çdo vit dhe patjetër nga indeksi në indeks. Mirëpo, duhet thënë se vetëm të përshkruhet ajo që përmban një indeks nuk mjafton. Ky është një hap esencial fillimtar, por kilometri tjetër duhet kaluar nga ndonjë studiues i vëmendshëm, i cili i kushton kohë studimit të mostrave të kërkimit.

VLERËSIMI I INDEKSIT[6]

Ka dy vendime themelore që duhet të marrë një bibliotekar i referencës lidhur me një indeks.

Së pari, cila nga kompanitë e indeksimit të përgjithshëm ka indeksin më të mirë për shfrytëzuesin mesatar? Shërbimi duhet t'i përshtatet buxhetit, përmbajtjeve të revistave dhe misionit të bibliotekës.

Së dyti, cila nga mijëra indekse tematike – indeksimi nga bujqësia e deri te revistat mbi zoologjinë – duhet t'i marrë parasysh biblioteka? Këtu, zgjedhja është e kufizuar. Rrallëherë ka më shumë se një indeks që mbulon një temë specifike, të ngushtë, siç është literatura bibliotekare apo revistat për fëmijë.

Faktorë të shumtë ndikojnë në vendimet e përcaktimit. Një indeks paraqet një analizë, rëndom sipas emrit dhe temës, të një dokumenti. Pasi që shumica e librave, revistave, raporteve dhe burimeve të tjera merren përmbajtje që janë të ndryshme, indeksuesi duhet të përzgjedh terma kyç si do të mund të kenë vlerën më të madhe për lexuesin. (Emri *indeks* vjen nga trungu i foljes latine *dicare* që do të thotë për të treguar). Një indeks i mirë ofron mjaft pika qasjeje, që nga autori e titulli e deri te tema dhe botuesi për t'ia mundësuar përdoruesit ta gjejë pikërisht atë që i duhet. Indeksi duhet të jetë aktual dhe duhet të ketë qasje të tillë, që të mos ketë

[6] David R. Majke, "Remote Host Databases: Issues and Contents" (Bazat e të dhënave me largësi: Çështje dhe përmbajtje", në *Reference Services Revieë,* vjeshtë/dimër 1997, f. 23-35. Kjo është një analizë e shkëlqyer ende aktuale e indekseve bazë të përgjithshëm. Për më tepër, bibliotekari i referencës ofron një pasqyrë praktike të situatës fluide dhe të asaj se si duhet vlerësuar indekset e ndryshëm. Një pikëpamje tejet superiore dhe praktike.

nevojë për ndonjë kurs katërjavësh trajnimi për të zbuluar se si mund të gjendet një material.

Vlerësimi themelor i burimeve të informacionit është pothuajse i njëjtë për formë të shtypur dhe për formatin elektronik. Në të vërtetë, bibliotekari duhet të ketë njohuri të njëjtë mbi bazën e të dhënave sa dhe për versionin e shtypur, ndonëse ka më shumë detaje për t'u mbajtur në mend. Pos tjerash, ne mund të shikojmë në formën e shtypur të *Psychological Abstracts* dhe, përmes provës dhe gabimeve, të zbulojmë mostrën e prezantimit. Në Internet kjo është e mundur, por është punë më e vështirë.

Në një analizë të indekseve duhet pasur parasysh 10 pika themelore. Disa prej tyre janë përpunuar në këtë pjesë dhe më vonë kur bëjmë fjalë për indekset individuale.

1. Numri i të përkohshmeve të indeksuara dhe sa prej tyre gjenden me tekst të plotë. Indekset elektronike janë përqendruar në zgjerimin e numrit të titujve të indeksuar. Shumica e tyre indeksojnë mes 1 200 e 200 tituj zakonisht me gjysmën deri në dy të tretat të të indeksuarve janë në dispozicion me tekste të plota në Internet. Formatet e shtypura merren më shumë me tituj themelorë, d.m.th. nga 180 deri në 600. Për fat të keq, shumë biblioteka më të vogla mund të bëjnë vetëm me formë të shtypur, madje edhe në këtë kohë të kompjuterëve të lirë. Ato kanë fatin të kenë më shumë se një indeks në Internet. Dhe, pasi që varen nga forma e shtypur, horizontet e lexuesve kufizohen vetëm në numrin e të përkohshmeve që janë jo vetëm të indeksuara, por që janë në dispozicion edhe të gatshme. Me kohë, shpresojmë, kjo gjë do të ndryshojë dhe e tërë bota e të përkohshmeve dhe indekseve do të hapet për të gjitha bibliotekat dhe për tërë publikun.[7]

2. Nëse një numër X i të përkohshmeve janë indeksuar, edhe sa të tjera janë në dispozicion në bibliotekë? Nëse jo në bibliotekë, a

[7] Mund të shtrohet pyetja se pse në një vend, i cili i kushton rëndësi të madhe informacionit, arsimit dhe lavdit të familjes dhe biznesit, një bibliotekë në një vend me të ardhura të ulëta duhet të ketë qasje vetëm në artikujt e 350 revistave, derisa një vend tjetër me të ardhura të larta mund t'iu ofrojë përdoruesve çdo gjë për të cilën kanë nevojë deri në dhjetë herë më shumë se ai numër? Kjo pyetje, të cilën do ta vërejë një vëzhgues i rastit është ngritur sa e sa herë në forma të ndryshme gjatë tërë këtij teksti, si një tef i ndryshkur në skajin e praruar të sistemeve informative amerikane.

gjenden ato në dispozicion me tekst të plotë te shërbimi, apo artikujt individualë mund të porositen pa vështirësi dhe shpejt nga shërbimi indeksues – dhe me çmim të arsyeshëm? Nëse jo, atëherë a ka biblioteka qasje te huazimet efikase ndërbibliotekare dhe/apo dokumente nga institucione të tjera?

3. Çfarë është dhe nuk është pikërisht në indekse të një reviste të caktuar? Disa shërbime, për shembull, indeksojnë vetëm artikujt kryesorë; të tjerë indeksojnë pothuajse tërë të përkohshmen.

4. Llojin e dokumenteve – që nga të përkohshmet dhe raportet e deri te librat dhe diskutimet – që nuk janë përfshirë apo përjashtuar?

5. Cilat vite janë mbuluar? Dosjet digjitale fillojnë kryesisht me vitet 1980, disa me vitet 1970 dhe vetëm disa prej tyre nga vitet 1960. Theksi për bazat e të dhënave bie mbi artikuj të fundit, p.sh., nga një deri në katër vjet. Versioni i shtypur fillon me botimin e parë të para dhjetë, njëzet apo njëqind vjetëve.

6. Sa shpesh pasurohet baza e të dhënave – çdo ditë, çdo javë, apo katër herë në vit?

7. Temat dhe nën-temat e mbuluara dhe, cilat fusha të ndërlidhura mund t'i interesojnë shërbimit?

8. Cili është intervali i indeksimit ndërmjet kohës kur është botuar revista, është indeksuar dhe paraqitet në indeksin standard? Intervali mund të jetë disa ditë, disa javë, apo edhe muaj.

9. Çfarë kushtesh janë plotësuar për arkivat, d.m.th. Sa larg prapa shkon indeksi dhe mund të bëhen kërkime që marrin parasysh vetëm një numër të caktuar vitesh?

10. Cili është çmimi? Kjo është vështirë të vërtetohet, pasi që shërbimet kanë pako të shumta me çmime të shumta që bazohen në gjëra të tilla, si numri i të përkohshmeve të indeksuara, disponimi me tekste të plota, buxheti bibliotekar etj.

Pikat e kërkimit

Kërkimi drejtohet nga konsiderata të tjera. Para së gjithash, softueri duhet të jetë i lehtë për t'u kuptuar. Po ashtu:

1. Sa janë të efektshme pikat e qasjes që ofrohen? Ne do të donim të dinim termat më të mira të qasjes (temën, titujt, abstraktet, fjalët kyçe, kodet etj.) për një shërbim të caktuar. Po ashtu, ne mund të krahasojmë shërbime të ngjashme, ndonëse në këtë pikë, cilësia dhe lloji i indeksimit ndryshojnë aq shumë nga shërbimi në shërbim saqë një krahasim valid vështirë mund të bëhet;

2. A ka kryetituj tematikë të caktuar dhe, ç'është me më rëndësi, sa bëhen përpjekje për caktimin e kryetitujve të tillë? A ka fjalor në dispozicion? Sa shpesh plotësohet ky fjalor (apo listë e fjalëve)?

3. Llojet e koncepteve të kërkimit në raste kur nuk ka fjalor dhe leksiku është i pakontrolluar;

4. Relacioni ndërmjet fjalorëve të kontrolluar dhe të pakontrolluar, brenda bazës së të dhënave të të dyjave;

5. Kodet dhe fjalët kyçe që mund të përdoren për ta shkurtuar kërkimin;

6. A ofron botuesi një "linjë të nxehtë" në mënyrë që kërkuesit të mund të kërkojnë ndihmë në kërkimet e vështira? A boton botuesi informatorë apo ndonjë plotësues për t'u ofruar shfrytëzuesve sugjerime mbi ndryshime të mundshme apo për të ofruar ankesat e tyre lidhur me veçoritë e bazave të të dhënave?

Për ta vlerësuar një indeks lipset një masë e konsiderueshme e kohës dhe e përpjekjeve. Rrjedhimisht, shumica e bibliotekarëve mbështeten në vështrime apo në këshillat e ekspertëve, apo në të dyja, sidomos me rastin e shqyrtimit të një shërbimi të specializuar. Përparësitë e përvetësimit të metodave të vlerësimit janë për t'i treguar bibliotekarit se si janë të ndër-

tuara (apo se si duhet të jenë të ndërtuara) dhe të hulumtuara indekset apo abstraktet, në mënyrë që të zbulohen pikat për pranueshmëri apo refuzim.

Gidat

Në qoftë se një bazë elektronike e të dhënave kërkon një doracak prej 50 a më shumë faqesh, gjë që nuk është gjithnjë aq e pazakonshme, atëherë kjo ose do të jetë një shembull i shkëlqyer i mundësive të sofistikuara të kërkimit apo një konfuzion pamundësish. Për fat të keq, të shumtë janë ata që mëtojnë të jetë kjo e fundit, dhe kjo i ngjan një gide tipike VCR apo një libri mbi atë se si mund të bëhet një gjë, që e gjeni në desktopin e një kompjuteri. Gjatësia nuk është i vetmi mjet i shpejtë vlerësues i gidave të bazave të të dhënave. Ka dhe të tjerë:

1. *Zhargoni*. Gida duhet të jetë në gjuhë të kuptueshme për personin laik. Ndonëse fjalët "interface" apo "media toolbar" mund të jenë të qarta për hakerët anglishtfolës, për fillestarët janë të pakuptimta. Po ashtu, kushdo që kërkon një zhargon për të shpjeguar funksionimin e një CD-ROM-i do të hasë në një produkt, që është jashtë arritjes së një personi të cilit i dedikohet ai;

2. *Programet tutoriale*. Udhëzimet duhet të jenë të drejtpërdrejta. Pak njerëz janë të gatshëm të kërkojnë përmes një programi tutorial që do t'i ushtrojë ata në çdo aspekt të kërkimit;

3. *Ilustrimet*. Ilustrimet, grafiket, hartat dhe të ngjashme janë të dobishme përderisa (1) mund të kuptohen pa iu referuar ndonjë doracaku tjetër dhe (2) nuk përsërisin çdo gjë në disk, rëndom si pjesë e menysë;

4. *Udhëzimet e shkruara mirë*. Së fundi, e tërë pakoja e udhëzimeve duhet të jetë logjike, e shkruar mirë dhe që kuptohet lehtë. Prapë, "të jetë i lehtë për t'u kuptuar" nga fillestarë dhe jo nga ndonjë fans i përkushtuar kompjuterik.

PROBLEMET E VLERËSIMIT DHE KOSTOJA

Kur flasim për një indeks "Online", kjo do të thotë se indeksi është: (a) drejtpërdrejt nga botuesi dhe ka qasje në Internet, zakonisht me një tarifë të konsiderueshme. Pagesa e tarifës bëhet nga ana e bibliotekës, kurse

shërbimi në rrjet bëhet edhe në bibliotekë edhe/ose në shtëpinë e studentit apo anëtarit të fakultetit; (b) nga ndonjë shitës standard, siç është DAILOG apo OCLG. Edhe këtu, bëhet një pagesë tarife sipas përcaktimit të bibliotekës. Shitësi mund të ofrojë indeksin përmes rrjetit të ofruesit, apo edhe përmes Internetit.

Bazat e të dhënave të botuesit nuk distribuohen drejtpërdrejt te ata, p.sh., Kompania H. U. Uilson, por nga shumica e shitësve kryesorë. DIALOG, më i madhi në këtë grup, ofron afro 500 baza të të dhënave, shumica prej të cilave janë indekse. OCLG, shërbimi joprofitues bibliografik, ka në dispozicion përmes "First Search" të saj afro 100 baza të të dhënave. Ofertuesi komercial në Internet, ofron vetëm disa sosh dhe asnjë prej tyre nuk është shërbim i madh indeksues. Rrjetet dhe shërbimet e tjera që nga RLIN e deri te OVID kanë aranzhmane të ngjashme. Bibliotekat vendosin vetë se cilin nga këta bartës do ta shfrytëzojnë, nëse duan ta bëjnë këtë, bazuar në strukturën çmimore, shpejtësinë e shërbimit dhe në pothuajse të gjitha pikat e përmbledhura në shkallën e mëparshme të vlerësimit.

Rrjetet e mëdha bibliografike bartin, mes shërbimesh të tjera, edhe indekse individuale dhe kapacitet të plotë tekstual. Një prej tyre është, për shembull, *OCLC: Electronic Collections Online.* Ajo ofron link nga indekset që vijnë nga OCLC First Search e deri te tekstet e plota të artikujve.[8]

Në përshkrimin, vlerësimin dhe krahasimin e indekseve të ndryshme Online (si dhe, në masë më të vogël, të afërmve të tyre CD-ROM), ka probleme të tjera, të cilat nuk do të zhduken shpejt. Ato janë me interes për studiuesit. Sapo të jetë dhënë një përshkrim në detaje të një indeksi, ndodh ndryshimi. Për shembull, këtë muaj një botues mund ta indeksojë një X numër titujsh dhe të ofrojë një Y numër në tekst të plotë. Një javë apo një muaj më vonë, numri rritet dhe/ose disa tituj të listës bazë mund të hiqen. Sivjet ka katër nëndarje të indeksit bazë. Vitin e ardhshëm, ky numër është rritur apo zvogëluar dhe, për ta bërë më interesant, emrat ndryshojnë. Çmimet për sisteme të ndryshme është vështirë të gjenden, por edhe ato ndryshojnë shumë shpesh.

Strukturat tarifore

Përllogaritja e tarifave të bazës elektronike të të dhënave është të shumtën aspekti më i vështirë i shërbimeve të referencës së indekseve elektronike. Ka aq shumë variante të ndryshme dhe opsione çmimore sa dhe botues dhe

[8] Kostoja e kësaj për bibliotekat është ralativisht e ulët, por kërkon një sërë llogarish, që nga abonimi të revista individuale para shfrytëzimit të tyre online. Pritet që kjo të thjeshtësohet.

ofertues. Të dhënat e kompanisë H. U. Uilson ofrohen në një çmim të vetëm për një apo për një grup bazash të të dhënave (me variante varësisht nga numri i shfrytëzuesve). *First Search* e OCLC-së u mundëson shfrytëzuesve të bibliotekës të kërkojnë sa të duan dhe të hapin aq shënime sa të kenë nevojë për një tarifë të caktuar. Fatkeqësisht, tarifa e OCLC-së ka shumë fusnota. DIALOG kishte iniciuar një abonim me tarifë të caktuar në mbarim të viteve 1990. Tarifa përcaktohet në bazë të një plani të involvuar, ndonëse klientët mund të blejnë qasjen për të gjitha bazat e të dhënave të DIALOG-ut apo të indekseve të fushave të ndryshme tematike. Indekset qeveritare të DIALOG-ut, siç është ERIC, janë pa pagesë në Net.

Që nga viti 2001, nuk gjenden indekse substanciale në Net, pos atyre të sponsorizuara nga qeveria apo atyre arsimore, të cilat janë pa pagesë. Kjo është një çështje madhore të cilën bibliotekarët dhe laikët duhet ta kenë parasysh, sidomos këta të fundit, që duan të kërkojnë pa ndonjë indeks apo që mendojnë se shërbimet e indeksimit nuk paguhen nga biblioteka. Këtu ka nevojë për një punë të konsiderueshme të marrëdhënieve publike.

Licencimi është një faktor me rëndësi në përcaktimin e kostos. Çdo furnizues, botues dhe prodhues ka qasje të ndryshme lidhur me atë se sa do të duhet të paguajë një bibliotekë për një X numër shfrytëzuesish për qasje në një bazë të të dhënave, ku gjenden ato, se si e shfrytëzojnë sistemin e të tjera. Ka ndryshime varësisht nga numri dhe kostoja e stacioneve. Për shembull, a i mundëson prodhuesi bibliotekës të mbajë disqet e vjetra CD-ROM, apo ato duhet të kthehen? Nëse kërkimi përmes rrjetit involvon një masë X të kohës a është shkalla e tarifës më e ulët në krahasim kur të shfrytëzohet një sasi Y e kohës? A ka shkallë të ndryshme tarifore për bibliotekarin, studentin, anëtarin e fakultetit dhe shfrytëzuesin laik? Disa biblioteka bashkohen në konsorciume për të negociuar çmime të mira, të tjerët këtë e bëjnë vetë. Sidoqoftë, për krahasim të çmimeve duhet bërë krahasime të hollësishme të secilit rast.

INDEKSET E PËRGJITHSHME TË PERIODIKËVE[9]

Indeks "i përgjithshëm" është ai që indekson revistat dhe gazetat në të gjitha fushat tematike dhe që nuk synon vetëm një interes të veçantë. Këtë

[9] Në zhargon, i cili ndryshon nga viti në vit, shumë nga këto shërbime të mëdha indeksimi janë quajtur "baza të largëta të të dhënave" dhe "qendra përplotësimi". Këto të fundit, kanë një ngjyrë oruelliane pasi që u ikin njerëzve të relacioneve publike që janë të angazhuar nga shërbimet.

hyjnë kryesisht produktet e pesë botuesve të mëdhenj: EBSCO; Gale Group Information Access Co. (IAC); Bell-Howell; H. W. Wilson Company dhe LEXIS-NEXIS, që është një botues i përgjithshëm ligjor i indeksimit dhe shërbimeve përkatëse. Që të gjitha këto u shërbejnë bibliotekave. Indekset e tyre kanë dy gjëra të përbashkëta: (1) përfshijnë revistat që kërkohen më së shumti në publik dhe në biblioteka akademike apo shkollore. Disa firma kanë indekse të veçanta për lloje të ndryshme të bibliotekave, ndonëse bazë e shumicës së tyre janë 100 deri në 1 000 tituj; (2) dosjet arkivore janë në dispozicion, ndonëse vetëm një periudhë të kufizuar - kryesisht nga mesi i viteve 1980 deri në fillim të viteve 1990.

Ndonëse në këtë kapitull janë diskutuar vetëm sistemet e mëdha dhe më të përdorura të indeksimit, lexuesi duhet të dijë se ka me dhjetëra sisteme të tjera, p.sh. shih listën e mundësive në *Gale Directory of Databases.*

Indeksi i përgjithshëm është vend ideal për të gjetur përgjigje në pyetje që janë të papërcaktuara. Lexuesi nuk e di krejtësisht se sa mund të jetë e gjerë apo e ngushtë një temë dhe se ku duhet bërë kërkimin. Përtej kësaj arsyeje të gjerë, ky është vendi për të kërkuar kur pyetja: *(a)* kërkon material aktual; *(b)* kërkon më shumë se një opinion, një pikëpamje të temës; *(c)* kërkon më shumë material nga ai që gjendet në librat mesatarë të referencës; *(d)* kërkon të dhëna në një fushë të re tematike që nuk ka gjasë të gjendet në referencat standarde.

Të gjitha indekset e përgjithshme kanë të përbashkëta disa pika:

1. Pos citimeve (d.m.th. emri i autorit, emri i artikullit dhe ku është botuar ai), këto shërbime kanë rezyme prej 100 deri në 150 fjalë, që përshkruajnë përmbajtjen e artikullit;

2. Ato ofrojnë nga një e treta deri në një të dytën të titujve të indeksuara me tekst të plotë. Aty mund të gjendet një citat dhe pastaj në vend se të kërkohet biblioteka që ka atë artikull, thjesht mund të lëvizni kursorin mbi një ikonë dhe të nxirrni të tërë artikullin;

3. Përpos periodikëve, shumica e shërbimeve ofrojnë indeksim të kufizuar të *Nju-Jork Tajmsit,* si dhe të *Uoll Strit Xhernellit* dhe *Krishçën Sajens Monitorit;*

4. Asnjëra prej tyre nuk përmban arkiva apo fajle retrospektive. Kjo do të thotë se shërbimi është i mirë për të kërkuar periodikët e muajit apo vitit të kaluar, por rëndom jo më shumë se katër deri në dhjetë vjet më herët. Për më tepër, disa indeksues kanë një sistem në të cilin shtojnë për çdo muaj, një muaj të ri, dhe shlyejnë një muaj paraprak, të themi, të para tri vjetësh. Vetëm versioni i shtypur i *Reader's Guide* i bën të mundur

shfrytëzuesit të thellohet në periodikët e përgjithshëm të para viteve 1970;

5. Të gjitha kanë sisteme të ndryshme kërkimi, por kryesisht ofrojnë kërkime prej një fjale kyçe dhe sipas logjikës së Booleanit. Shumë prej tyre, gjithashtu, mundësojnë kërkime sipas vitit të artikujve të shqyrtuar, të gjuhës etj. Secila ka softuerin e vet të kërkimit, ndonëse është e mundur përmes furnizuesve të bëhet standardizimi i kërkimit;

6. Çmimet ndryshojnë dukshëm. Disa fusin harduerin dhe softuerin në çmim, disa përfshijnë edhe tekstin e plotë parcial dhe të tjerët kanë çmime të ndryshme të shfrytëzuesve, stacioneve, shiritit magnetik dhe kështu me radhë.

Në një përpjekje të suksesshme për t'i zgjeruar suazat e veta (si dhe margjinat e përfitimit) sistemet e përgjithshme të indeksimit janë degëzuar. Ato tani ofrojnë më shumë se produktet e veta të indeksimit. Ajo që ka nisur si një shërbim i vetëm i indeksimit tani është shndërruar në një supermarket të shërbimeve të shumëfishta. Ky është një shteg informativ i shkelur mirë. Më herët, hostët në Internet që nga OCLC e deri te DIALOG dhe LEXIS-NEXIS kanë pasur të njëjtën ide dhe janë shndërruar në gjigantë të furnizimit me të dhëna nga baza të ndryshme të të dhënave. Kjo lojë është e njohur për të gjithë ata që ndjekin tregun e stoqeve: blej, bashkëngjit dhe shto për ndërtimin e një korporate sa më të madhe.

EBSCO, për shembull, ka në dispozicion një sërë indeksesh të tjerë të ndryshëm nga botues të tjerë. Ato sillen në një fushë të caktuar, p.sh., PsycInfo (*rezymime psikologjike)* e deri te ERIC.

Së fundi, një apo dy nga të pestët do të shkrihen me konkurrentët e vet. Droja është se një firmë e vetme gjigante jo vetëm që do t'i kontrollojë indekset, por edhe shumë nga kanalet përmes të cilit kalojnë informacionet.

Përpos kuptimit të mostrave themelore të indekseve shpesh të ngjashme, është me rëndësi të kuptohet se çfarë mund të ofrojë kompania X apo Y, në kuptim të shërbimit të shpejtë dhe efikas. Pasi që kjo ndryshon dhe është relative për bibliotekën në fjalë, studiuesit dhe bibliotekarit duhet t'i mjaftojë që ta mësojë rregullin e qartë lidhur me indekset: I provoni, i testoni, e vlerësoni çmimin, para se të nënshkruani. I pyesni bibliotekarët e tjerë në situata të ngjashme se ç'mendojnë dhe çfarë kanë mësuar.

Indekset H. W. Wilson

Të gjitha të poshtëshënuarat të botuara nga: *H. W. Wilson Company* (New York, NY: www.hw Wilson.com)[10] mbi web-sajtin Wilson.

Online: Readers' Guide Abstracts, 1984 e tej, javore. $1,995. Po ashtu OCLC.
CD: *WilsonDisc: Readers' Guide Abstracts.* 1984 e tej, mujore. $1 500.
Shtyp: Readers' Guide to Periodical Literature, 1900 e tej, për 17 vjet. $220.

Internet: Wilson's OmniFile and Select Full Text Plus, 1998 e tej, mujore. Çmimet ndryshojnë. Po ashtu OCLC.

Kompania H. W. Wilson është më e njohur për një indeks: *The Readers' Guide to Periodical Literature.* (Online dhe në CD-ROM i quajtur *Readers' Guide Abstract).* Ky gjendet në shumicën e bibliotekave për shkak të kostos së tij të ulët dhe reputacionit. Në veçanti, ky është zgjedhje e bibliotekave të vogla dhe të mesme me buxhete të kufizuara. Wilson grumbullon indekset e veta të shumta në Internet sipas emrit "Wilson Web" për të paraqitur një apo disa prej tyre Online nga Wilson përmes Internetit. Këto indekse përfshijnë nga mbulimi i arteve deri te shkencat nga *Readers' Guide.*

Shërbimet kryesore të përgjithshme të indeksimit janë themeluar nga mesi i viteve 1980. Kompania H. W. Wilson mund të gjurmohet që nga një shekull më herët, në vitin 1898. Ajo është dukshëm nga më të njohurat dhe shumë bibliotekarë janë të mendimit se ky është shërbimi më i mirë i indeksimit. Përmban më se 40 indekse me tekste të plota dhe abstrakte – në formate bazore: të shtypur, Online, CD-ROM dhe shirit magnetik.

Kompania Wilson mund të mburret se: (1) ka indeksim më të thellë sesa rivalët e tij; (2) tekstet e plota, kur janë në dispozicion, janë kom-

[10] Këtu, si dhe kudo në këtë kapitull dhe në tekst si tërësi, adresat e abonimit (d.m.th. me një tarifë) në bazat e të dhënave në Internet janë ato të botuesit dhe jo të bazës aktuale të të dhënave. Për të gjetur bazat e të dhënave pa tarifë (që shënohet në çmimin e abonimit): a) kërkoni web-sajtin e bibliotekës suaj. Baza e të dhënave rëndom është e shënuar aty me linkun e web-sajtit; (b) provoni një bibliotekë tjetër në rrethinën tuaj që ofron shfrytëzuesve qasje të lirë ndaj bazave pa pagesë të të dhënave; (c) përdorni adresën Online të botuesit të dhënë këtu. Do të ketë nevojë që të kërkoni titullin specifik në katalogun e botuesit në internet apo sistemin e kërkimit. Porsa ta keni gjetur, botuesi mund të iu ofrojë një a dy orë pa pagesë për kërkime mostrash. Hyni drejtpërdrejt në adresë për baza të dhënash pa pagesë, dmth., ato që janë të shënuara me 'free'.

plete dhe paraqesin tërësinë e asaj që është indeksuar. (Jo gjithherë është rasti me shërbime të tjera); (3) numri i të përkohshmeve të indeksuara mund të jetë më i vogël se te të tjerët dhe kjo është një konsideratë me peshë, zgjedhjet bëhen me qëllim të reflektimit të nevojave themelore të bibliotekave. Po ashtu, numri i kufizuar i indeksuar, pak a shumë siguron që revista të jetë në dispozicion – shpesh shumë vite prapa – në bibliotekë.

Mostrat e kërkimit

Kërkimi në indekset elektronike të Wilson-it është çështje e thjeshtë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar për t'i bërë ato sa më të qasshme për publikun e gjerë. Mostra e kërkimit e kompanisë H. W. Wilson mund të aplikohet përgjithësisht për pothuajse të gjitha kërkimet e indekseve në Internet. Për këtë arsye, është ide me vend që të njihemi në mënyrë të plotë me metodën Wilson.

Wilson ndjek mostra bazike të kërkimit për shërbimet e veta digjitale. Ka disa modele të ndryshme të kërkimit: Modeli i thjeshtë, i fillestarëve, është kur përdoruesi shtyp një fjalë apo temë kyçe që sjell një indeks apo titull, ose ç'është e mundshme, artikuj që përmbajnë fjalën kyçe. Mund të vazhdohet me nxjerrjen e temës së kërkuar edhe atëherë kur titulli i njëjtë i kërkuar është mbyllur, por jo edhe titulli i njëjtë i përdorur nga botuesi. Mund të gjendet edhe shqiptimi i saktë, apo ndonjë term më i gjerë apo më i ngushtë brenda indeksit në ekran.

Përpos "shpalosjes" së gjithpranishme, si hap i parë në pothuajse çdo sistem kërkimi në Internet, botuesi ofron edhe mostra të tjera më të sofistikuara dhe të detajuara. Mostra të ngjashme kërkimi gjenden edhe te konkurrentët e tij, ndonëse me specifika të ndryshme. Nëse diç është e qartë, atëherë kjo është se kompanitë duan të krijojnë sisteme që mund të kërkohen lehtë nga përdoruesi laik.

Modeli i dytë është për individin me pak njohuri të sistemit, si dhe të kërkimit Online. Këtu, treguesi në ekran ofron disa fusha të kërkimit nga emri i autorit deri te fjalët e temës, fjalë titujsh, fjalë kyçe në abstrakte, e kështu me radhë. Logjika Booleane mund të përdoret për kërkimin e temës dhe të titullit. Ky sistem është lehtë për t'u zotëruar dhe po aq lehtë për t'u kuptuar. Shpesh ai parapëlqehet edhe nga fillestarë, pasi që është më i shpejtë dhe më i përpiktë sesa modeli shpesh i mundimshëm i "shpalosjes".

Niveli i tretë i kërkimit përdoret më shumë nga ekspertë. Këtu, sofistifikimi dhe përvoja është kyç për sukses. Jo vetëm që përdoret logjika e thjeshtë Booleane, por janë të mundshme edhe kualifikime të tjera nga "nesting" e deri te kërkimi i një tipari fizik, siç është grafika apo ilustrimi, si pjesë e artikullit të dëshiruar.

Vlen të theksohet: po këta hapa fillestarë apo të avancuar në kërkim pasohen nga pothuajse të gjitha shërbimet e indeksimit Online. Disa janë më të mirë. Shumica ndjekin mostrën Wilson të indeksimit.

Readers' Guide[11]

Readers' Guide indekson dhe abstrakton 240 nga revistat më të popullarizuara në Shtetet e Bashkuara dhe në Kanada, përfshirë edhe 'Nju-Jork Tajmsin'. Shumë prej tyre gjenden nëpër kiosqe dhe mund të blihen përmes abonimit. Zgjedhja është e gjerë, që nga *Consumer Reports* deri te *Foreign Affairs* dhe ky shërbim ofron një pjesë të veçantë për opinionin publik në nivele të ndryshme lexuesish. Në formë të shtypur, *Readers' Guide* është ruajtur që nga viti 1900, kurse versionet digjitale janë vetëm nga viti 1984. Ky shërbim plotësohet çdo dy javë, krahasuar me plotësimin javor në Internet dhe mujor në CD-ROM. Abstrakte të shkëlqyera (me nga 50 deri në 150 fjalë gjatësi) dhe indeksim superior, sidomos në përcaktimin e titujve të temave, shpjegojnë faktin pse shërbimi Wilson konsiderohet kryesori nga shumë bibliotekarë.

The Readers' Guide Abstracts Full Text (me $2.795) përfshin tekstin e plotë të të përkohshmeve. Një mini-edicion (me $1.095) përfshin më pak revista me tekst të plotë. Dhe, ka konfiguracione të tjera për lloje dhe madhësi të ndryshme të bibliotekave, por rekomandohen vetëm *Readers' Guide Abstracts* dhe mundësisht ato me tekst të plotë. Pa marrë parasysh fushën e kërkimit, aty ofrohet një listë artikujsh, të cilët tregojnë se kanë, të paktën, fjalët kyçe (temat etj.), që shënohen nga personi që bën kërkimin. Qasja e shkurtër jep burimin dhe datën, si dhe titullin e artikullit. Pastaj, duhet kërkuar artikullin e veçantë me një abstrakt të detajizuar dhe me titujt përkatës të temës, që një kërkues këmbëngulës mund ta përdorë për t'i gjetur pjesët përkatëse.

Tastet 'tab' japin informacion mbi 'bibliotekat me njësinë' apo 'get/dis-

[11] Që nga viti 1994, *Readers' Guide for Young People* ka pasur qasje në Internet. Është bërë për K-8 dhe për të ndihmuar fëmijët në zotërimin e indekseve elektronike dhe të burimeve të tjera të referencës. Ky sajt përfshin revistat bazore, si dhe biografitë, prezantimet e librave, si dhe vështrimet mbi muzikën dhe filmin. Disa nga abstraktet dhe artikuj me tekst të plotë.

play item' (që përdoret vetëm kur tekstet e plota janë në dispozicion) apo 'e-mail records'. Metoda të tjera për të 'nxjerrë njësinë' jepen që nga faksi e deri te huazimi ndërbibliotekar, shpesh me tarifë.

Të gjitha indekset Wilson të digjitalizuar ndjekin këtë mostër themelore – si dhe shumica e indekseve të tjera me variante sa i përket materialit që i prezantohet kërkuesit dhe simboleve që tregojnë se çfarë është e çfarë nuk është në dispozicion me tekst të plotë në Internet.

Wilson's OmniFile dhe Select Plus

Jo si rivalët e tij, deri në vitin 1997, Kompania H. W. Wilson nuk ka pasur bazë masive të të dhënave të të përkohshmeve dhe nëndegë të ndryshme me tarifë. Në vend të kësaj, ajo ofronte indekse të veçanta me tematikë të gjerë, p.sh. *Humanities Index, Social Sciences Index* dhe *Applied Science and Technology Index.* Në një lëvizje të mençur, kjo kompani vendosi nga fundi i viteve 1990, që të kombinojë disa nga indekset e veta më të njohur. Fajli i kombinuar në një të vetëm përmban indeksim të mbi 2 220 të përkohshmeve. Kjo e vë atë në konkurrencë me kompani të tjera të mëdha të indeksimit. Përpos 2 220 titujve të indeksuar, ka dhe afro 830 të tjera me tekst në plotë me qasje përmes *Wilson Select Full Text Plus.* "OmniFile" krahasohet favorshëm me ofertat e rivalëve të Wilson-it. Këtu indekset tematike paraqiten bashkërisht, përfshirë: *Readers' Guide Abstracts Full Text, Social Sciences Abstracts Full Text, Wilson's Business Abstracts Full Text, General Science Abstracts Full Text, Humanities Abstracts Full Text* dhe *Educational Abstracts Full Text.* Po ashtu, janë shtuar edhe afro 180 tituj të përzgjedhur nga indekset e tjera Wilson. Efektivisht, shfrytëzuesi kërkon përmbajtjen e të gjitha këtyre indekseve me një kërkim, duke mënjanuar nevojën e kërkimit të tyre një nga një dhe duke krijuar kështu një indeks të madh të përgjithshëm në Internet.

Wilson ka një numër të 'OmniFiles' të tjera të ngjashme për disiplina të dhe biblioteka madhësish të ndryshme. E tërë kjo, s'do mend, u shërben bibliotekave me pako për të cilat kanë nevojë dhe mund t'i blejnë.[12]

Përtej kësaj, kompania është tani duke kontraktuar shumicën e indekseve të veta me shitës të përzgjedhur, si OCLG dhe Bell-Howell. Për shembull, Bell-Howell ka një marrëveshje kontraktuese me Wilson-in për të bartur, si pjesë e shërbimet të vet ProQuest Direct Online, shumicën e indekseve të Wilson-it, p.sh., *Social Science Plus Text* (400 të përkohshme me gati gjysmën e tyre me tekst të plotë); *General Science Plus Text* (169/

12 Ka pesë a më shumë OmniFiles.

një e treta me tekst të plotë); *Education Plus Index* (427/ afro një e treta me tekst të plotë) e kështu me radhë, deri te librat përkatës të referencës, si *Current Biography* dhe *World Authors,* për të cilët bëhet fjalë në kapitullin mbi bibliografinë në këtë tekst. Indekset Wilson janë të qasshme edhe përmes asaj që kompania i quan të tjerët 'partnerë informacioni', siç janë OVID, DIALOG dhe Westlaw.

EBSCO

EBSCO Information Services (Ipswitch, MA: www.epnet.com).

Online: EBSCO Online *Academic Abstracts Full Text Elite,* 1984 e tej, e përjavshme. Çmimi ndryshon).

CD: Academic Abstracts, 1984 e tej, mujore. Çmimi ndryshon.[13]

EBSCO është tani shërbimi më i madh abonues në Shtetet e Bashkuara (d.m.th. biblioteka porosit të përkohshmet nga EBSCO dhe jo nga botues individualë). Me hyrjen në fushën e indeksit Online, në fillim të viteve 1990, ajo menaxhon veprimtarinë e vet botuesit dhe kompjuterin me të cilin klientët lidhen drejtpërdrejt. Tani për tani, ajo vazhdon të ofrojë versione në CD-ROM të indeksit Online.

Ajo ka një 'masterfile' të vetëm (d.m.th., të ngjashëm me OmniFiles të Wilson-it), që indekson prej 3 200 deri në 4 000 të përkohshme – me afro 1 800 prej tyre me tekst të plotë. Kjo bëhet që nga mesi i vitit 2000. Ky numër do të rritet çdo vit, si dhe ai i konkurrentëve të saj. Kjo tejkalon ofertën e çdo indeksi tjetër të përgjithshëm dhe mburr kompaninë si "konsorciumi më i madh informativ në botë".

EBSCOhost, term ombrelle për shërbimet e ndryshme të EBSCO-s në Internet, ka në thelbin e saj seritë nga viti 1993, ndonëse disa janë edhe më të hershme, kurse disa më të vonshme.[14] Gjithashtu, disa prej versioneve përfshijnë edhe *The New York Times* prej vitit 1989, *The Wall Street Journal*, prej vitit 1993 dhe *The Christian Monitor,* prej vitit 1995. Titujt mund të gjenden me tekst të plotë prej 1984 apo 1990 e deri më sot.

---

[13] Ka varianta të kësaj për biblioteka më të vogla, p.sh., MAS (*Magazine Article summaries)* mbështetet në të njëjtin Masterfile themelor të 3 200 titujve, të cilët i ndanë për bibliotekat shkollore dhe publike. Indekset (prapë me nëntituj parësorë, elitorë dhe të përzgjedhur) vijnë me çmime të ndryshme varësisht nga ajo se sa tituj janë të indeksuar dhe sa janë me tekst të plotë.

[14] Po ashtu, kjo firmë loz me 'EBSCO online' në reklamat e veta, si dhe si 'EBSCO host'. Sidoqoftë: EBSCO është identifikues kyç.

Që nga viti 2000, EBSCO u ka mundësuar bibliotekave blerjen përmes Internetit, ose në disa raste në CD-ROM, por jo edhe versionin e shtypur *Academic Abstracts Full Text Elite* (940 a më tepër të gazetave të indeksuara/abstraktuara, prej të cilave 160 janë me tekst të plotë); *Academic Abstracts Full Text Ultra* (940/470 me tekst të plotë); *Academic Search Select* (3000/600 me tekst të plotë); *Academic Search Plus* (3000/840); *Academic Search International* (870/620). I tërë shërbimi i EBSCOhost ofrohet me një tarifë të lartë në një indeks. Po të zvogëlohet përzgjedhja në bazën e të dhënave, çmimi mund të ulet për bibliotekat me nevoja dhe buxhete të ndryshme.

Një karakteristikë e të gjitha shërbimeve është se çdo krijon vetë një përmbledhje të të përkohshmeve dhe të indekseve kundruall llojeve dhe madhësive të ndryshme të bibliotekave. Në të vërtetë, ka indekse të ndryshme me të njëjtën bazë për biblioteka akademike, publike dhe shkollore. Për shembull, *Middle Search Plus* hartohet Online për shkolla të mesme dhe të larta, me tipare të veçanta për këtë grup. Janë të indeksuar 170 tituj, prej të cilëve afro 55 janë me tekst të plotë. Pos kësaj, dhe në kuptim të auditorit, ky shërbim përfshin edhe një enciklopedi, dokumente me interes historik dhe një kërkim të tekstit të plotë për mbi 100 pamflete.

EBSCO degëzohet në indekse të shumta tematike, shumë prej të cilëve janë diskutuar në këtë tekst. Shembujt, me tituj vetësqarues janë: *Business Source*, *Health Source* dhe *Newspaper Source*.

Me këtë, EBSCO shton bazat e jashtme të të dhënave (nga *Books in Print* dhe *ERIC* deri te *PAIS)* për t'i dhënë bibliotekës një pako të plotë indeksimi, madje edhe të titujve që nuk janë drejtpërdrejt nën kontrollin apo editimin e tyre. Si edhe te konkurrentët, me këtë shpresohet se biblioteka do të ketë nevojë t'i kthehet vetëm një burimi për indekse të përgjithshme dhe tematike.

Dhe, për t'i bërë gjërat sa më pak konfuze, kjo kompani, prapë si dhe konkurrentët e saj, ka një zakon të këndshëm të ndryshimit të emrave të shërbimeve, si dhe të shtimit apo heqjes së titujve të indeksuar dhe të atyre me tekst të plotë. Në këtë proces, çmimet herë rriten dhe herë ulen dhe shpesh anashkalohen për të akomoduar sa më shumë klientë që është e mundur.

Mostrat e kërkimit

Kërkimet e EBSCO-s ndjekin një mostër standarde, d.m.th., përdoruesi mund të kërkojë një material me anë të një fjale kyçe apo të aplikojë logjikën Boolean. Edhe këtu ka mjete, si 'find more' ('gjej më shumë') dhe 'find best part' ('gjej pjesën më të mirë') për të ngushtuar apo zgjeruar kërkimin. Rezultatet e këtyre dy metodave të fundit pastaj renditen sipas rëndësisë. Kërkimi i natyrshëm i fjalëve i mundëson përdoruesit të fusë fjalë kyçe, fraza apo madje edhe fjali të plota. Kufizimet janë vetëm për artikujt e shikuar dhe kronologjitë që paraqiten. Një përparësi e jashtëzakonshme për fillestarë është tastatura relativisht e qartë me të kuptuar të lehtë të ikonave të kërkimit.

Në pjesën e epërme të ekranit, përdoruesi ka mundësi të shumta, siç janë 'kërkimi i rafinuar', 'gjej më tepër', kërkimi me fjalë kyçe, kërkimi i avancuar, opsionet, e të ngjashme. Një faqe e hapur tregon nëse një citim mund të gjendet me tekst të plotë, kurse ka dhe shënime nëse biblioteka e ka atë të përkohshme apo jo. E tërë kjo, si dhe karakteristika të tjera të shumta, janë të lehta për t'u përdorur. Si rezultat, kjo është një nga seritë më të mira të indekseve, sidomos për bibliotekat publike.

Grupi Gale: IAC[15]

Gale Group, Farmington Hills, MI: Information Access Company, www.galegroup.com.

Online: Expanded Academic ASAP, 1980 e këtej, mujore. Çmimi i negociuar për të gjitha indekset Online.

Online: General Reference Center, 1980 e këtej, mujore.
CD: InfoTrac: Academic Index, 1976 e këtej, mujore $2.700.
CD: General Reference Center, 1976 e këtej, mujore.

E themeluar nga mesi i viteve 1970, kompania Information Access (IAC) është degë e Thomson Business Information, që ka në pronësi grupin Gale. Botues i madh i referencave, si dhe *Peterson Guides*, në arsim

[15] Si pjesë e këtij shërbimi, Grupi Gale ofron atë që ata e quajnë 'InfoTrac Web' apo 'Infotrac Total Access', që është një metodë e organizimit të indekseve dhe të shërbimeve të tjera Gale në Internet.

dhe *Primary Source Media.* IAC, si dhe EBSCO, është botues në vete dhe distributor i indeksit Online dhe, edhe ky si dhe EBSCO, ofron baza më të përgjithshme të të dhënave kundruall ERIC dhe PAIS.

IAC është rival, si i EBSCO-s, ashtu dhe i kompanisë H. W. Wilson në kuptim të numrit të indekseve që u ofrohen bibliotekave. CD *InfoTrac* dhe Online e IAC-së, si dhe Online *SearchBank* indekson afro 2 500 të përkohshme, apo afro 1 000 më pak se EBSCO. Teksti i plotë është në dispozicion për afro 1 000 tituj.

Expanded Academic është impresiv. Ai indekson 1 500 të përkohshme, kryesisht në tema që mbulohen nga shumica e kolegjeve dhe universiteteve amerikane, si dhe revista të tipit të kiosqeve të karakterit të përgjithshëm. Ghithashu, janë të përfshirë gjashtë muaj të 'Nju-Jork Tajmsit'. IAC, si dhe te indekset e tjera të përgjithshme, ka një politikë të ofrimit të indekseve për vitin në vijim, si dhe tre vjet të arkivës. Çdo muaj shtohet nga një indeksim mujor, kurse një muaj nga tri vjet paraprake hiqet. Prandaj, indeksi kurrë nuk mbulon më shumë se tri vjet vijues.

Partneri junior (*Academic ASAP)* ndjek një mostër të ngjashme, por është më pak i shtrenjtë, meqë ka vetëm 550 tituj me 250 prej tyre me tekst të plotë.[16] *General reference Center*[17] është një indeks gjithëpërfshirës për biblioteka të madhësisë së mesme dhe të mëdha publike dhe akademike. Ka 1 100 të përkohshme të indeksuara, me 700 prej tyre me tekst të plotë. Shumica prej tyre janë tituj të popullarizuar dhe gjysmë të popullarizuar, që përdoren kryesisht nga studentë dhe që ofrojnë përgjigje për shumicën e pyetjeve të referencave, që kanë të bëjnë me ngjarjet aktuale. Nuk është e rastësishme që këtu, si dhe te konkurrentët, indeksi shton botimet relativisht të vona (të dy muajve të fundit) të *New York Times, Wall Street Journal* dhe *Christian Science Monitor.*

Mostrat e kërkimit

[16] Si the rivalët e tij, IAC ka një indeks për bibliotekat shkollore (fillore, të mesme dhe të larta) me pak tituj të analizuar dhe me çmim shumë më të ulët. Ka dhe një kolekcion Gale School Group Collection, I bërë për klasë të caktuara që nga shkolla fillore deri tek ajo e lartë. Duhet ditur, po ashtu, se ka dhe një indeks të përgjithshëm në gjuhën spanjolle (në CD dhe në internet), që quhet Informe.

[17] Duke ndjekur mostrën standarde, IAC ofron këtë me çmim më të ulët si General Periodicals ASAP Abridged. Kjo përkthehet në 150 tituj, prej të cilëve 125 janë me tekst të plotë të shoqëruara me CD-ROM.

Ka nivele të ndryshme të kërkimit, p.sh., me fjalë kyçe, temë, relevancë, të avancuar. Të gjitha janë të shënuara qartë në shiritin e menysë me shpjegimin e llojit specifik të asaj që kërkimi mund të arrijë apo të mos arrijë. Varësisht nga tema e kërkuar, një karakteristikë tjetër e dobishme është "shikimi i artikujve të tjerë që kanë të bëjnë me këto tema". Për shembull, ju mund të kërkoni në linkat enciklopedikë në Ephraim Chambers (të enciklopedisë që mban emrin e tij), si dhe te librat që kanë lidhje me të, përfshirë fjalorët.

Duke ndjekur mostrat e indekseve të tjera të digjitalizuara, ka një "opsion të kufizimit të kërkimit aktual", që i mundëson përdoruesit të kërkojë vetëm "artikujt me tekst", apo të "revistave të vështruara". Kufizimet e tjera janë të mundshme. Rëndom, aty ka abstrakte të mira, kur janë në dispozicion, që pasohen me tekst të plotë të artikullit.

Çmimi për të gjitha këto ndryshon, si dhe i botuesve të tjerë të përgjithshëm. Varet shumë nga numri i përdoruesve. Nga ana tjetër, në rastin e një biblioteke të madhe, si për shembull në një sistem të madh arsimor shtetëror me afro 300 000 përdorues të mundshëm (dhe kjo 'të mundshëm' duhet të potencohet, pasi që vetëm një numër i vogël i 300 000 të përdoruesve ka gjasë ta gjejnë ndonjë bibliotekë), kostoja vjetore për indeksin kryesor të IAC-së është $190 000. Esencialisht, siç është theksuar më parë, çmimet varen në bazë të negocimit dhe bibliotekat më të mëdha zakonisht kalojnë më mirë.

Bell-Howell

Information and Learning, (ProQuest), Ann Arbor, MI: Bell Howell, www.umi.com/proquest.

Online: ProQuest Direct: Online Service, 1988 e tej, e përditshme. Abonimi vjetor: $4.000; bibliotekat publike dhe akademike, $12 370.

Online: Periodical Abstracts, 1986 e tej, mujore. Çmimi ndryshon.[18]

Bell-Howell, më parë i njohur si UMI, University Microfilms, është pjesë e kompanisë së Informacionit dhe Diturisë Bell-Howell. UMI u themelua në vitin 1938 për krijimin e të përkohshmeve në mikrofilm, gjë

[18] Ka disa indekse të përgjithshme të Bell-Howell-it me emra zakonisht të ndryshëm.

që vazhdon ta bëjë, si dhe me botimin dhe ofrimin e shërbimeve të indeksimit. Familja Bell-Howell e indekseve të përgjithshme ka qasje si në Internet ashtu dhe në CD-ROM (me një term të përbashkët, "ProQuest"0. ProQuest mëton të indeksojë dhe abstraktojë artikuj nga 'mbi 6 000 të përkohshme'.[19] Ato ndahen në indekse të përgjithshme dhe tematike. Përpos kësaj, ka dhe mbulim me tekst të plotë të *The New York Times, The Wall Street Journal*[20] dhe të disa botimeve, siç është ai *Baron.* Ndryshe nga shumica e shërbimeve me tekst të plotë, UMI ofron mbulim me imazh të plotë (d.m.th., faqen e plotë siç duket në botim) të afro 2 000 titujve dhe mbulim vetëm të teksteve (d.m.th., ASCII) edhe të 1000 të tjerëve. Nëse shtohen edhe citimet e 1.5 milionë disertacioneve, kjo përbën njërin nga shërbimet më të plota të indeksimit të përgjithshëm.

Kur të gjendet një citim që tregon se artikulli është me tekst të plotë, përdoruesi mund të kërkojë disa formate: imazhin me faqe të plotë, tekstin dhe grafiket, apo vetëm tekstin ASCII.

Imazhet mëtojnë të jenë më të qarta sesa në shërbimet e tjera, sidomos pasi që kërkohen faqet për lexim. Në rezolucion të lartë, Bell-Howell është larg më i mirë. E meta është në shpejtësinë me të cilën ato paraqiten në ekran. Mëton të jetë e ngadalshme dhe shumica e kërkimeve, përkundër grafikeve të shkëlqyera, është më e shpejtë nëse kërkoni vetëm tekstin.[21]

Abstraktet e të përkohshmeve (pjesë e sistemit ProQuest) është indeksi kryesor i Bell-Howell-it. Ai mbulon më se 1 800 të përkohshme, si dhe indeksimin e *New York Times* dhe të *Wall Street Journal.* Dosjet arrijnë deri në vitin 1990, me disa deri në vitin 1986. Shoqëruesi i tij shkollor, *Resource/One Select* ka në dispozicion 180 të përkohshme të përgjithshme me tekst të plotë (si në CD ashtu dhe në Internet nga viti 1986). *Resource/One Select,* më i kufizuar, ka 60 tituj me tekst të plotë.

Magazine Express, me qasje vetëm në CD me 'fajla' nga viti 1991 e tej, është krijuar për biblioteka të vogla dhe shkolla. Ajo indekson 180 tituj,

[19] Aktualisht bibliotekat mund të zgjedhin se cilat të përkohshme do t'i indeksojnë.

[20] Nga mbarimi i vitit 1997, Bell-Howell dhe Doë Jones i bashkuan forcat për të ndarë përmbajtjen e shërbimeve të tyre të indeksimit, si dhe të klientëve të mundshme. Duke u koncentruar në bibliotekat korporative, Dow Jones i lë fushën tjetër Bell-Howell-it. Kjo marrëveshje i mundëson Bell-Howell-it që të shtojë tekstin e plotë të *The Wall Street Journal* jo vetëm për disa vite, por duke filluar që nga vitet 1960. Shërbime të tjera financiare, si ai i Baronit, u bënë pjesë e shërbimit Bell-Howell.

[21] Formati "Bell-Howell Text-Only" është më ngjyra. Ngjyra është vetëm për tekste të zgjedhura.

shumica e njohur për përdoruesit e *Readers' Guide*. Pos kësaj, mëton të ketë artikuj me imazh të plotë (d.m.th., me faqe të plotë) prej afro 80 % të titujve të indeksuar. Kjo do të thotë 125 nga 180 të përkohshme me tekst të plotë me mbulim prej vitit 1991. *USA Today* (nga viti 1991) dhe *New York Times Current Events Edition* (nga viti 1998) janë pjesë të kësaj pakoje.

Bell-Howell bën disa pohime, që duket se janë të mbështetura gjatë përdorimit, që i japin një përparësi ndaj konkurrentëve të tij: (a) ka një hendek më të vogël ndërmjet botimit të revistës dhe kohës që duket në indeks – rëndom afro një muaj; (b) ka më shumë formate për tekst të plotë, d.m.th., zgjedhje vetëm të tekstit (d.m.th., ASCII), apo tekst dhe ilustrime ose imazh të plotë të faqes.

Mostrat e kërkimit

PorQuest ofron softuerin e rëndomtë për fillestarë dhe kërkues me përvojë. Si në shumicën e sistemeve të këtij lloji, ai ka nivele dhe lloje të ndryshme të mostrave të kërkimit. Mostra më e drejtpërdrejtë, më e lehtë për përdorim është kërkimi temë/subjekt. Përdoruesi hyn në një temë dhe ai subjekt, si dhe temat e përafërta, paraqiten në ekran me numrin e artikujve për secilin prej tyre. Pastaj, mund të përshkruhet se për çfarë keni nevojë dhe të kërkoni një a dy mostra citimesh, rëndom me abstrakte.

Një hap i avancuar është përdorimi i logjikës Booleane, kur kërkuesi mund t'i kombinojë termat për një kërkim më të sofistikuar. Me këtë rast, është i dobishëm një fjalor si udhëzues për të kaluar nëpër termat dhe nocionet e lidhura me to. Përdoruesit, gjithashtu, mund të kërkojnë vetëm sa për të nxjerrë artikujt me tekst të plotë, të ndryshojë bazat e të dhënave sipas dëshirës, të vështrojë titujt e temave të ndryshme, e të tjera.

Në disa nga bazat më të popullarizuara të të dhënave të Bell-Howell-it bibliotekari mund të kërkojë statistika të gjeneruara që tregojnë numrin e shënimeve të printuara gjatë një periudhe të caktuar kohore, si dhe numrin e kërkimeve të bëra, masën e kohës që është përdorur një bazë e të dhënave, e kështu me radhë.

Edhe tarifat ndryshojnë. Bell-Howell ofron sistemin e rëndomtë të çmimeve për një pako të X numri të të përkohshmeve të indeksuara dhe Y numër të titujve me tekst të plotë. Mirëpo, pos kësaj, ai i ofron bibliotekës mundësinë për ta paguar vetëm nga artikulli në artikull. Në rastin

e dytë, opsionet e tjera përfshijnë gjëra të tilla, si përdorimi vetëm i citimit, teksti i plotë në tërësi, teksti me grafikë etj.

LEXIS-NEXIS

Ka edhe një shërbimi tjetër, i madh, që gjendet nëpër biblioteka dhe, ndonëse mund të klasifikohet si "i përgjithshëm" ai shpesh përdoret në atë mënyrë. LEXIS-NEXIS është një indeks ligjor me një komponentë të madhe të përgjithshme të indeksimit në NEXIS.

Reed-Elseiver; New Providence, NJ., www.lexis-nexis.com.[22]
Online: LEXIS-NEXIS. "Academic Universe", 1973 e tej, e përditshme, www.cispubs.com. Çmimi ndryshon, duke filluar nga $9 000.[23]

Krahu NEXIS i LEXIS-NEXIS filloi në vitin 1979 si metodë e zgjerimit të indeksimit ligjor. Shumë biblioteka abonohen te LEXIS-NEXIS dhe përdorin pjesën NEXIS si indeks i përgjithshëm. Ideja atëherë dhe sot është që t'u ofrojë kërkuesve artikuj nga gazeta, revista, botime etj., që do të ishte zgjerim i asaj që është gjendur në burime të pastra ligjore. Tani ka mbi 7 000 burime të veçanta të të dhënave të indeksuara, prej të cilave mbi 1 000 janë revista. Theksimi kryesor mbi ligjin, me një komandë dytësore të shumicës së burimeve kryesore të lajmeve dhe biznesit, e bën atë mjaft të dobishëm për bibliotekarë si në nivelin e përgjithshëm, ashtu dhe në atë të specializuar.

Shërbimi LEXIS fokusohet në informacionin aktual ligjor, me ligjet federale dhe shtetërore, rregulloret, statutet, vendimet e të ngjashme në bazën e të dhënave. Ai ofron, gjithashtu edhe indekset e njohura dhe shumë të përdorura të qeverisë, botuar nga *CIS Congessional Information Service*, si dhe "universi statistik". Dobia më e madhe për bibliotekarë, biznes, juristë etj., është se ky jo vetëm që indekson, por edhe ofron tekst

[22] Një nocion i madhësisë së këtij shërbimi është ofruar nga botuesi: 'bazuar në Dejton, Ohajo [shërbimi] punëson 6 700 individë nëpër tërë botën. Sot, 1.3 milionë profesionistë nga mbarë bota janë të abonuar. Ata kryejnë mbi 300 000 kërkime në ditë'.

[23] Academic Universe" është një version i LEXIS-NEXIS me çmim të ulur për biblioteka, p.sh., (2000): $9.000 rata bazë. (Kjo përfshin 6 000 tituj kundruall burimeve të plota prej 7 000). Kjo "ofron një qasje në një sërë lajmesh dhe informacionesh biznesi, ligjore dhe të referencës", me një theks në punët e biznesit dhe të qeverisë, si dhe në çështje ligjore. Për një përshkrim të detajuar vlerësues, shih "Database & Disc Review", Library Journal, 15 shkurt, 2000, f. 207-208. Një bazë tjetër e të dhënave për laikë dhe të interesuar në biznes, është Nexis.com (www.lexis-nexis.com).

të plotë të pothuajse tërë grupit të botimeve të indeksuara. Kjo do të thotë transkripte të radio programit, artikuj nga një gazetë, buletinëve informativë, ligjeve, raste të Gjykatës së Lartë etj.

Është i shtrenjtë, por mbase shërbimi më i mirë i tërë grupit për indeksim të besueshëm dhe tekst të plotë.

LEXIS-NEXIS boton, po ashtu, edhe të ashtuquajturin botim 'të universit skolastik', për studentë të shkollave të larta. Pa dyshim, ky është po aq punë e relacioneve publike, sa dhe mënyrë praktike e nxjerrjes së fitimeve. Porsa që studentët e shkollave të mesme të kenë mësuar të përdorin këtë shërbim, ata do ta kërkojnë atë në vend pune dhe, ç'është me më rëndësi, edhe në bibliotekat akademike. Kjo ndjek mostrën e versioneve të tjera të kufizuara të punës kryesore, por që ka të gjitha karakteristikat e indeksit parësor të kërkimit. Përmban afro 40 revista dhe 65 gazeta të indeksuara. Tele-shërbimet, burimet e lajmeve në gjuhë të huaja dhe transnkripte transmetimesh janë disa nga karakteristikat e tjera. Po ashtu, mund të shpalosen edhe hulumtime ligjore, statistika dhe legjislacione (të gjitha në mënyrë të kufizuar).

Mostrat e kërkimit

Kërkimi lëviz nga sistemi i 'kërkimit të fjalëve kyçe' në lloje të kërkimeve më të sofistikuara dhe të avancuara. Kufizimet mund të jenë në mënyrat standarde, si dhe në përzgjedhjen e fushave tematike, si lajmet, biznesi, hulumtimi ligjor, mjekësi dhe referencë. Secila nga këto fusha të gjera, ka nëndegë të kërkimit. Dhe, ju mund të kufizoni kërkimin tuaj te të përkohshmet, gazetat, apo burime të ngjashme informacioni për gjashtë muaj deri në një vit të mëparshëm. (Vërejtje: shërbimi ka një shpjegim të qartë në Internet të metodave të kërkimit).

Cilin?

Krahasimisht, është vështirë të dallohen indekset, nga që të gjitha kanë përmbajtje të pasura të të përkohshmeve të indeksuara dhe secili ofron pika që nuk gjenden te tjetri. Figura jetike sasiore kalon te LEXIS-NEXIS "Academic Universe" (afro 7 000 tituj, por jo të gjitha të përkohshmet) dhe te EBSCO, me afro 3 200 deri në 4 000 tituj kundruall Bell-Howell-it (me maksimum) 1 800, kundruall IAC-së me 1 550, kundruall Wilson's *Readers' Guide* me 240. Disponimi me tekst të plotë i secilit shërbim ndjek

së pari një renditje të ngjashme me LEXIS-NEXIS dhe EBSCO. Problemi evident me analizën sasiore është se figurat ndryshojnë shpesh dhe numrat lakuriq nuk mjaftojnë – në fakt, kjo mund të jetë një e metë për përdoruesit ekspertë, që do të kenë zgjedhje tepër të gjerë.

Çështja e çmimit nuk diskutohet, ndonëse tani pjesa më e madhe e konkurrencës është pothuajse e njëjtë për një numër X të titujve të indeksuar dhe/apo Y numër të titujve me tekst të plotë.

Praktikat e kërkimit janë pothuajse të njëjta për të gjitha indekset. Por, me këtë, ka dhe ndryshime subtile të një rëndësie të madhe për bibliotekarin. Për shembull, *InfoTrac* e IAC-së ofron një opsion të avancuar që i mundëson bibliotekarit të kërkojë dhjetëra indekse për një temë të vetme me përdorimin e trungimit, çerdhëzimit të sofistikuar etj. Përkundrazi, EBSCO (të paktën në studimet në Universitetin Shtetëror të Nju-Jorkut në Albani), është më i lehti për përdorim për fillestarë.

Një çështje madhore për shumë përdorues është se sa aktual është materiali i indeksuar, si dhe disponimi me tekst të plotë. Këtu, LEXIS-NEXIS dhe Pro-Quest janë më larg me një hapësirë kohore prej një a dy ditësh deri në tre javë ndërmjet paraqitjes së artikullit dhe indeksit. EBSCO, IAC dhe Wilson qëndrojnë prapa me një ngecje prej mesatarisht katër deri në tetë, apo madje edhe deri në dhjetë javë.

Në kuptim të sofistikimit dhe nevojës së përdoruesve, grupi Wilson është më i miri për shkolla dhe laikë. Në anën tjetër të renditjes, kërkuesi profesionist do ta gjejë LEXIS-NEXIS-in si më të kënaqshëm.

E vetmja përgjigje e vërtetë se "cili" është ai që duhet provuar një bibliotekë individuale është sistemi i përgjithshëm i indeksimit. Vendimi do të varet nga nevojat e bibliotekës, më parë se nga gjykimi që nxirret prej këtu, apo prej vështrimit të burimeve të tjera.

Indekset e përgjithshme kanadeze dhe britanike

Online: Canadian Periodical Index. Foster City, CA: Information Access Company, Gale Group, www.galegroup.com, 1988 e tej, mujore. Çmimi ndryshon.
CD: 1988 e tej, mujore. Çmimi ndryshon.
Shtyp: 1947 e tej, mujore, Çmimi ndryshon.

CD: British Humanities Index Plus. New York, NY: R. R. Bowker, 1985 e tej, çerekshe. $1 500.

Shtyp: 1962 e tej, çerekshe. $1 150.

Indeksi më i njohur kanadez është *Canadian Periodical Index,* një formë e zgjeruar e *Readers' Guide.* Ky shërbim ndjek mostrën e rëndomtë të indeksimit dhe analizon 400 revista kanadeze dhe afro 30 amerikane me mbulim ndërkombëtar. Ai përfshin tituj në gjuhën angleze dhe atë frënge. Vështrimet mbi librat jepen me tituj nën një titull të përbashkët sektorial, si dhe sipas autorit dhe temës, në tërë indeksin.

British Humanities Index është një udhëzues i shërbyeshëm dhe i përgjithshëm i afro 320 gazeta britanike që mbulojnë tema të tilla si politika, ekonomia, historia dhe letërsia. Ka një përdorim të kufizuar në fushën e materialeve aktuale, pasi që botohet vetëm çdo tre muaj me përmbledhje vjetore.

WORLDWIDE WEB NË INTERNET

Të gjithë indekset e përgjithshëm të të përkohshmeve deri më tani përdorin Worldwide Web-in në Internet (www), si bartës të shërbimeve të tyre. Jo si pjesa më e madhe e informacionit në Ueb, ka një tarifë substanciale për përdorimin e këtyre indekseve. Prandaj, indekset kërkohen përmes bibliotekës, korporatës, apo ndonjë lloji tjetër të organizatës. Pak individë paguajnë për shërbimet. Meqë indeksimi në këtë shkallë është i shtrenjtë, nuk ka indekse të krahasueshme pa tarifë në net. Në fakt, asgjë nuk mund t'i afrohet sofistifikimit privat të indekseve të përgjithshme për profit. Indekset me tarifë në Internet janë në dispozicion, mes të tjerëve, përmes botuesve dhe shitësve, siç janë DIALOG, LEXIS-NEXIS, OCLC, etj. Këto janë të preferueshme për kërkime serioze, meqë para së gjithash janë të besueshme dhe kanë krijuar mostra shumë të kujdesshme kërkimi. Tri karakteristika: (a) janë të shtrenjta; (b) secila prej tyre kërkon një metodë të ndryshme kërkimi; (c) secila prej tyre ka pika qasjeje dhe fjalëkalime të posaçme.

Në anën tjetër, siç do të shihet në kapitullin e ardhshëm, ka disa indekse tematike qeveritare, siç është ERIC, të cilat janë pa pagesë. Ato janë po aq të shkathta sa dhe ato të bëra nga botues privatë. Megjithëkëtë, ato janë indekse tematike dhe jo indekse të përgjithshme.

Shërbimet pa pagesë të indeksit në net kundruall bazave komerciale të

të dhënave përmblidhen në mënyrë të thukët nga bibliotekari: ajo që i duhet kërkuesve është cilësia e informacionit. Kjo është ajo pyetja e përhershme që shtrojmë gjithnjë. Sa është i plotë ky informacion? Sa është aktual? Sa është i besueshëm? Sa është lehtë të nxirret? Sa mirë është indeksuar? Kërkues me përvojë ankohen se shpenzimi i kohës në Internet nuk është gjithmonë një përpjekje produktive. Ata mund të marrin përgjigje më shpejtë nga një bazë tradicionale e të dhënave, pa pagesë. Mund të jetë bjerrje kohe kalimi nga një web-sajte në tjetër e tjetër... burimet [pa pagesë] të informacionit në Internet japin përshtypjen e jostabilitetit. Nuk ka garanci se të dhënat do të qëndrojnë në Internet. Informacioni mund të pësojë ndryshime sipas tekeve brenda natës.[24]

Indekset jo të shtrenjta në net

Ka disa indekse me çmime te arsyeshme në Ueb, që nuk e kanë fuqinë e indekseve të përgjithshme të shtrenjta. Këto duhet të përdoren vetëm nëse shërbimet e përgjithshme me bazë bibliotekare nuk janë në dispozicion. Një a dy shembuj:

Electric Library (www.elibrary.com), kushton $9.95 në muaj dhe ofron indeksim të plotë të afro 150 gazetave dhe afro 900 revistave. Ju mund të kërkoni deri në 12 faqe të titujve të revistës sipas rendit alfabetik, si dhe të gazetave. Kërkimi bëhet me fjalë kyçe. Krahasuar me indekset komerciale ky është pothuajse i papërpunuar, por duke pasur parasysh çmimin e ulët, numri i madh i revistave dhe gazetave, e vlen mundi i madh për të gjetur titullin e kërkuar.

Nëse kërkoni 'for free' (pa pagesë), atëherë *FindArticles* (www.findarticles.com) mund t'u ndihmojë. Gati sa një e treta e masës së *Electric Library*, kjo indekson, nga viti 1998, afro 300 revista. Shumica prej tyre janë tituj të përgjithshëm, me theks të veçantë në lajmet dhe ngjarjet aktuale. Përndryshe, ajo përfshin edhe disa revista shëndetësore ezoterike, si *Nature Biotechnology* dhe *WorldWide Biotech.* Kjo ka disa përparësi të veçanta. Pasi që përmbledh një numër të kufizuar të revistave, përgjigjet, d.m.th. citimet, janë më të pakta dhe zakonisht më të sakta dhe precize sesa ato që gjenden në shërbime më të mëdha të indeksimit. Dhe, plusi i madh: pothuajse të gjithë artikujt janë me tekst të plotë në Internet. Dhe, e vlen të përsëritet, janë falas. E meta është reklamimi, ndonëse kjo është

[24] Marydee Ojala, "The Haze of Future Business Research", *Online,* janar/shkurt, 1998, f. 80.

problem i vogël krahasuar me softuerin e shkëlqyer të kërkimit. Se çfarë do të sjellë e ardhmja e këtij shërbimi, është vështirë të thuhet, por Gale Group nuk po e vë atë në Internet vetëm sa për të ofruar informacion falas.

Shënim: Ka dhe qasje të tjera 'të lira' ndaj indekseve. Pasi që pothuajse të gjitha nga mbi 800 gazetat Online mund të kërkohen pa pagesë, ky është një burim për të paktën informim aktual. (Arkivat janë të pakta). Po ashtu, disa nga këto shërbime përfshijnë indeksim të kufizuar të të përkohshmeve të përafërta, p.sh., *Financial Times* i Londrës (/www.FT.com) lavdërohet se është 'burimi më i madh i biznesit në botë, që përmban 2000 publikime nga mbarë rruzulli dhe mbi 10 milionë artikuj, me nga 25 000 që i shtohen çdo ditë'. E tërë kjo, të paktën për tani, është falas.

Ka disa indekse me përfshirje të kufizuar që janë falas. Një shembull: *North Canadian Periodicals Index* (http://fringe.lib.ecu.edu/Periodicals/scope.html). Një indeks aktual me afro 500 revista dhe buletinë të botuar në Karolinën e Veriut, kjo është me vlerë të kufizuar krahasuar me të tjerët. Këtu është shënuar si një shembull e asaj se çfarë mund të jetë në dispozicion nga biblioteka lokale publike apo akademike, që indekson revistat me orientim shtetëror dhe ofron indeks pa pagesë individit dhe të gjithë të tjerëve.

Shënim: Indekse të tjera pa pagesë apo me pagesë të ulët dhe shërbimet e ngjashme bibliotekare nga kompani private në Ueb janë diskutuar diku tjetër në këtë tekst.

PËRMBAJTJET AKTUALE

Online: ContentsFirst. Dublin, OH: OCLC, 1990 e tej, e përditshme, www.oclc.org/oclc/menu/home1.html. Çmimi ndryshon.

Online: ArticleFirst. Dublin, OH: OCLC, 1990 e tej, e përditshme, www.oclc.org/oclc/menu/home1.html. Çmimi ndryshon. Nuk ka format në CD apo të shtypur.

Një metodë e dobishme e kërkimit të një numri të madh revistash, qoftë edhe në mënyrë të përciptë, është kthimi te përmbajtjet aktuale. Kjo esencialisht i ofron përdoruesit mundësinë që ta vështrojë tabelën e përmbajtjeve, prej këtu edhe 'përmbajtjet aktuale', të një apo deri në 17 000 a më shumë të përkohshmeve. Koleksioni i indekseve në OCLC 'First

Search' përfshin *ArticleFirst* dhe *ContentsFirst*. Këta janë shembuj kryesorë se si funksionojnë përmbajtjet aktuale.

ContentsFirst përmban tabelën e përmbajtjes së mbi 12 000 gazetave në të gjitha fushat, nga shkencat deri te humanitetet.[25] Secili shënim i paraqet shikuesit përmbajtjet e një botimi të gazetës. Pos komandave specifike, baza e të dhënave kërkohet duke e kërkuar një gazetë të caktuar sipas emrit (nëse nuk është e shënuar data, baza e të dhënave do të tregojë shënimin mbi faqen e përmbajtjes të botimit të fundit). "Të shoh përmbajtjen e botimit të qershorit të vitit 2000 të *Library Journal*". Kjo paraqitet në monitor dhe përdoruesi pastaj përcakton se cilin artikull/j të lexojë. Varësisht nga e përkohshmja e caktuar, përmbajtjet e revistës mund të paraqiten një muaj a më shumë prapa apo përpara versionit të shtypur. Ka dhe mundësi të tjera të kërkimit me anë të fjalëve kyçe, temës etj., por qasje parësore është sipas tabelës së përmbajtjes. Një karakteristikë shtesë e dobishme: shënimi tregon nëse biblioteka juaj e ka atë revistë ose se kush e ka në rajonin tuaj. Ky informacion nuk është gjithmonë i saktë, prandaj është mirë që të kontrollohet në ndonjë katalog apo bibliografi rajonale.

Ndonëse informacioni i huazimit ndërbibliotekar jepet për këto shërbime, OCLC-ja ofron edhe: (1) së paku dy furnizues dokumentesh, njëri prej të cilëve është rëndom botuesi, për shumë nga artikujt (nëse jo për të gjithë). Përdoruesit mund të porosisin artikullin drejtpërdrejt përmes First Search dhe të paguajnë me kartela krediti, apo përmes xhirollogarisë së bibliotekës. Dorëzimi mund të bëhet me faks apo përmes postës konvencionale. Pos kësaj, ka një opsion FastDoc që do të faksojë artikujt brenda një ore apo më pak; (2) teksti i plotë Online për disa gazeta, por jo për të gjitha. Eventualisht, pothuajse të gjitha të përkohshmet me tekst në Internet do të jenë në dispozicion Online, përmes e-mailit, apo faksit.

OCLC përmbyll bazën e të dhënave *ContentsFirst* dhe del me pasuesin e parë, *ArticleFirst*. Mbi 12 000 gazeta analizohen kryesisht sipas temës. Në vend se të shtypni në një tabelë përmbajtjeje (ndonëse edhe kjo është një mundësi kërkimi), duhet të kërkoni temat specifike apo autorët. Baza e të dhënave pastaj tregon se ku paraqiten këto fjalë kyçe në një abstrakt të shkurtër (në qoftë se gazeta ka diç të tillë), apo në titujt e artikujve në bazën e të dhënave. Ky nuk mund të thuhet se është një kërkim i llojit

[25] EBSCO ka një shërbim të ngjashëm, Current Citations dhe Current Citations 2.0. Ato ofrojnë qasje në tabela përmbajtjeje të nga 10 000 deri në 14 000 gazeta dhe procedime konferencash.

preciz. Nuk përdoren kryetitujt e temës dhe suksesi apo dështimi varet nga paraqitja e fjalëve kyçe në një titull artikulli, titulli gazete, apo abstrakti. Në të njëjtën kohë, do të mund të gjeni një numër citatesh duke përdorur vetëm *ContentsFirst.* Përafërsisht shtohen një milion shënimeve brenda vitit.

Dy shërbime të tjera duhet të përmenden, pasi që gjenden në shumë biblioteka.

CARL, një version më i vogël për profit i OCLC-së dhe RLIN-së, ofron kërkime të tabelës së përmbajtjes për mbi 17 000 të përkohshme. Kjo kërkohet shumë, si dhe grupi OCLC. Kërkimet, jo si ato të OCLC-së, janë falas. E meta është se për të lexuar çfarëdo përmbajtje përdoruesi (d.m.th., rëndom biblioteka) duhet të paguajë tepër për çdo artikulli, faqe etj.

Një kandidat tjetër është *Dawson Information Quest*, një shërbim në Internet i shitësit seria, Faxon. Ky sjell informacion mbi të përkohshme të veçanta me hyrje në tabela përmbajtjeje nga afro 20 000 gazeta dhe mundësi desktopi të artikujve gazetareskë me tekst të plotë.

Instituti për Informacion Shkencor, botues i *Science Citation Index*, ofron një numër titujsh të përmbajtjeve aktuale: *Life Science: Physical, Social, and Behavioral Sciences;* e kështu me radhë. Këto botime reprodukojnë faqet e titujve të gazetave, rëndom në kohën e botimit të tyre apo madje edhe disa javë para botimit. Përdoruesi mund të skanojë përmbajtjet aktuale dhe t'i bëjë të ditur bibliotekarit se çfarë mund të presë dhe çfarë mund të ketë a të mos ketë vlerë dhe pastaj t'i dërgojë përdoruesit ose citimet ose artikullin në hard copy.

KËRKIMET RETROSPEKTIVE

Online: Periodicals Contents Index. Alexander, VA: Chadwyck-Healey, Inc., 1998 e tej. Me qasje përmes Bell-Howell, OCLC dhe Chadwyck-Healey, www.chadwyck.com.

Shtyp: Poole's Index to Periodical Literature, 1802-1906, vëll. 1: 1802-1881. Boston: Houghton Mifflin Company, 1981, vëll. 2 deri në 6, plotësimet 1 deri 5: 1882 – 1907. Boston: Houghton Mifflin Company, 1888 – 1908, 6 vëll. Rishtypur në 7 vëll. Gluocester, MA: Peter Smith Publisher, 1963.

Përkundër mrekullisë së indeksit elektronik, problemi kryesor është mungesa e çdo mundësie reale për të kërkuar të përkohshmet para fillimit të viteve 1980. Nëse diçka ka ndodhur para kësaj kohe, procedura e rëndomtë është mbështetja në indekse të shtypur. Me kohë, pa mëdyshje, indekset do ta tejkalojnë këtë të metë, por tani për tani ka vetëm një qasje të kufizuar në gazetat retrospektive.

Një zgjidhje është *Periodicals Contents Index*, që indekson në Internet të përkohshmet në shkencat humanitare dhe shoqërore, në disa raste edhe deri në vitin 1770. Më vonë, kjo do të përfshijë indeksim retrospektiv të mbi 3 500 gazetave. Ndonëse, indeksimi bëhet vetëm përmes tabelës së përmbajtjes, dhe jo sipas artikujve individualë. Rezultati është se ju vetëm mund të shpresoni që faqja e përmbajtjes të jetë mjaft përshkruese për të plotësuar nevojat e kërkuesit, p.sh., si në diskutimin e mëhershëm të indeksit *ContentsFirst*. Baza e të dhënave përmban gazeta kryesisht në anglisht, por ka dhe në frëngjisht, gjermanisht dhe në gjuhë të tjera perëndimore. Sistemi është në dy pjesë. Pjesa e parë mbulon titujt nga viti 1770 deri më 1990-1991. E dyta, me një çmim më të ulët, mbulon vitin 1960 deri në vitin 1993. (Pas vitit 1993, indekset e rregullta elektronike hyjnë në punë për të vazhduar kërkimin deri në ditët e sotshme).

Indeksi *Poole* ishte indeksi i parë i përgjithshëm i revistave dhe pararendës i *Readers' Guide*. Ai ishte një shpikje e William Frederick Poole-it, pionier në shkencën bibliografike dhe bibliotekare, që e bëri të mundshëm këtë indeks. Duke ditur se shumë të përkohshme të vjetra nuk po përdoreshin për shkak të mungesës së indeksimit të duhur, ai iu përvesh punës për indeksimin e 470 të përkohshmeve amerikane dhe britanike, që mbulonin periudhën prej vitit 1802 e deri më 1881. Pasi e kreu këtë punë, ai botoi edhe pesë plotësime, që përmbyllën indeksimin deri në mbarim të vitit 1906.

Përdoruesi modern nganjëherë frustrohet nga fakti se gazetat e cituara nuk kanë datë, por identifikohen vetëm sipas vëllimit në të cilin janë botuar dhe sipas numrit të faqes së parë. Për shembull, artikulli "Dress and Its Critics", është nga *Nation*, 2:10. Një "Chronological Conceptus", në secilin vëllim, tregon vitin.

Nuk ka qasje autoriale. Indeksimi bëhet tërësisht sipas temës. Indeksi me autorë në 300 000 referenca në kompletin e parë dhe në plotësimet u sigurua më vonë nga C. Edward Wall, *Cumulative Author Index for Poole's Index* (Ann Arbor, MI: Pierian Press, 1971, 488 f.). Ky indeks është i bërë me kompjuter dhe nuk është gjithaq i lehtë për ta ndjekur, por paraqet

një ndihmesë të madhe për atë që kërkon një njësi autoriale në *Poole*.

Me gjithë të metat e saj, puna me Poole konsiderohet një e arritur e madhe dhe një qasje e paçmueshme në të përkohshmet e shekullit XIX. Dekada e fundit e shekullit trajtohet më mirë në *Nineteenth Century Readers' Guide to Periodical Literature*, 1690-1899, me indeksim plotësues nga viti 1900 deri më 1922 (Nju-Jork: H. W. Wilson Company, 1944, 2 vëll.). E kufizuar në 51 të përkohshme (kundruall 470 të Poole-it), kjo gidë indekson në tërësi të përkohshmet sipas autorit dhe tematikës për vitet 1890 deri më 1899. Katërmbëdhjetë revista janë të indeksuara ndërmjet viteve 1900 e 1922.

Projekte të shumta, të përmendura në tërë këtë tekst, janë duke punuar në synimin ambicioz të vendosjes së të gjitha shënimeve të të përkohshmeve në formë elektronike. Një shembull: *Internet Library of Early Journals* (www.bodley.ox.ac.uk/ilej/start.html), që ofron tekste të kufizuara të plota të të përkohshmeve nga shek. XVIII e XIX.

INDEKSET E PËRGJITHSHME: FORMATI I SHTYPUR

Children's Magazine Guide. New York: R. R. Bowker, 1948 e tej, nëntë botime në vit. $45.

Popular Periodical Index. Roslyn, PA: Popular Periodical Index, 1973 e tej, çerekëshe. $40.

Access. Evanston, IL: Access, 1975 e tej, tri botime në vit. $157.50.

Përkundër revolucionit elektronik, ka një numër indeksesh të përgjithshme që janë në dispozicion vetëm në formë të shtypur. Shpjegimet janë të ndryshme, por arsyet parësore janë ngaqë kjo vepër tashmë nuk plotësohet (p.sh. *Poole's Index)* apo botuesi nuk beson se përdoruesi do të ketë një kompjuter (p.sh. *Children's Magazine Guide).* Mungesa e një CD-ROM-i apo kërkimi në Internet nuk humb aspak nga rëndësia.

I vetmi udhëzues për revistat e fëmijëve është një shembull i mirë lidhur me atë se si mund të jenë shërbimet e specializuara të abstraktimit dhe indeksimit në bashkëjetesë me sistemet më të sofistikuara elektronike për dekadat e ardhshme. Këtu, në *Children's Magazine Guide*, lexuesit e rinj, mësuesit dhe prindërit, kanë një qasje të besueshme tematiken përmbajtjet e afro 50 titujve. Kjo është e dobishme për lexim rekreativ, si dhe për

nxënës (të moshës prej 5 deri në 14 vjeç) për gjetjen e materialeve për hartime. Mësuesit e përdorin jo vetëm për indeks, por edhe për sugjerime praktike mbi përdorimin e revistave të fëmijëve dhe për shënime të shkurtra mbi revista të reja, punëtori e kështu me radhë. Ai ka mbi 16 000 abonentë.

Ka dhe dy indekse të tjera të shtypur që shërbejnë për zgjerimin e shërbimeve të ngjashme elektronike. Në ta janë të abonuar shumë biblioteka, për tri arsye: (1) kostoja është e ulët; (2) mbulojnë tituj të popullarizuar që nuk gjenden në formën e shtypur të *Readers' Guide* dhe (3) janë relativisht aktualë dhe të saktë.

Indeksi më i hershëm që përfshin mangësitë e *Readers' Guide* është *Popular Periodical Index*, që përmban afro 37 tituj që nuk gjenden në indeksin Wilson. Bibliotekari/botuesi, Robert Botorff, përfshin tituj tematikë nga vështrimet, filmat, regjistrimet, e të ngjashme. Aty ku një titull nuk përshkruan përmbajtjen, redaktori shpesh shton një fjalë apo një a dy fjali me shpjegimin e përmbajtjes së artikullit. Ndonëse ky nuk mund të quhet abstrakt, në të jepet informacion i bollshëm sa për ta bërë mjaft të përdorshëm indeksin.

Access është një indeks tjetër i përgjithshëm. Ai vë në pah veprat e muzikës së popullarizuar, revistat e udhëtimit, krijimtarinë shkencore, si dhe titujt e zanateve dhe të arteve. Është sidomos i fuqishëm në mbulueshmërinë e revistave të qyteteve dhe të rajoneve. Vlera e tij për bibliotekarët është si një rrjet i gjerë në indeksimin e titujve vërtet të popullarizuar, që nuk gjenden në shërbime të tjera të përgjithshme. Ai përfshin afro 140 të përkohshme, të indeksuar në secilin botim. Indeksi ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë është mbi autorin, kurse e dyta mbi tematikën. Pas botimeve me kopertina të buta, në qershor dhe tetor, ka dhe një botim përmbledhës me kapakë të fortë, në dhjetor, për të përmbyllur tërë vitin.

Ndonëse teknikisht, do të duhej që *Catholic Periodical and Literature Index* (Haverford, PA: Catholic Library Association, 1930 e tutje, shërbim dymuajsh), të klasifikohej si indeks fetar, aktualisht ai është shumë më i gjerë në përfshirje. Ai indekson sipas autorit, temës dhe titullit, afro 160 të përkohshme, shumica prej të cilave janë katolike, por ndryshojnë dukshëm sa i përket përmbajtjes editoriale. Në fakt, shumë nga titujt do të mund të klasifikoheshin si revista të përgjithshme. Po ashtu, indeksi përmban edhe analiza të librave nga dhe mbi katolikë. Ka pjesë për vështrime librash, vështrime filmash dhe kritikë teatri. Ndonëse ky është me një vlerë të kufizuar në shumë biblioteka, ai mund të merret parasysh nga

bibliotekat publike dhe shkollore, që u shërbejnë popullatave katolike.

Indekset alternative dhe minoritare: Formati i shtypur

Online: Alternative Press Index. Baltimore: Alternative Press Center, 1988 e tej. Informacioni: www.nisc.com/factsheets/api.html. Çmimet ndryshojnë.
Print: 1969 e tej, çerekshe. $100.

Print: Hispanic American Periodicals Index (HAPI). Los Angeles: University of California, 1970 e tej, vjetore. $240.

Online: International Index to Black Periodicals Full Text. Ann Arbor, MI: Bell-Howell, 1999 e tej, mujore, www.umi.com. Çmimi ndryshon.
Print: Index to Black Periodicals. Boston, G. K. Hall, 1950 e tej, vjetore. $95.

Përkundër numrit impresiv të indekseve të përgjithshme, vetëm disa prej tyre merren me revista nga e majta politike, e drejta sociale dhe pothuajse nga çdo skutë tjetër, pos qendrës. Një bibliotekë mund të mos ketë revista të tilla në dritën e buxheteve të ngushtuara dhe lexuesve të kufizuar, por është një ide e mirë për të pasur indekse që dëshmojnë se ka më shumë se një pikëpamje të Amerikës.

Indekset minoritare duhet të jenë në rend të parë *prioritet i parë* nëse minoritetet janë auditor parësor apo dytësor që shërbehet nga biblioteka.

Alternative Press Index ka qenë i pranishëm për mbi 25 vjet dhe ai indekson me besnikëri afro 380 tituj. Të gjitha këto janë nga qendra e majtë. E djathta nuk përfaqësohet për shkak të mendimit të editorit, qoftë ai i mirë a i keq, sipas të cilit konservatorët kanë zërin e tyre në indekse dhe shërbime të tjera. Sido qoftë, ky indeks i shërben qëllimit të shkëlqyer të hapjes së një dere të re për mënyra të reja të vështrimit të çështjeve. Mekanizmi i kërkimit në Internet është i thjeshtë për t'u ndjekur dhe madje edhe një fillestar rëndom mund të gjejë atë që kërkon. Në versionin e shtypur aranzhimi është bërë sipas temës dhe aty ka disa vështrime librash sipas autorit dhe titullit. Ndonëse botohet në çdo tre muaj, ky indeks mëton të ngecë.

Hispanic American Periodicals Index shqyrton afro 250 të përkohshme,

shumica e të cilave botohen në Amerikën Latine apo nga grupe latino-amerikane në Shtetet e Bashkuara. Derisa revistat e popullarizuara nuk janë të përfshira, grupi përfaqësues i titujve të tjerë pasqyron trendet dhe idetë në Amerikën Latine dhe në mesin e hispanikëve që jetojnë në Shtetet e Bashkuara.

International Index to Black Periodicals lëshohet nga Bell-Howell, por botohet nga filiali i tij ChadwyckHealey. Ai mbulon afro 150 të përkohshme, si të atyre të popullarizuara ashtu dhe atyre shkollore, që nga viti 1910 dhe 30 prej tyre, me tekst të plotë, janë në dispozicion që nga viti 1998. Seritë janë kryesisht nga vende anglishtfolëse, por ka dhe disa nga Afrika dhe Amerika Latine. Një indeks i mirëseardhur si standard, (shih paragrafin e ardhshëm) mbetet fare prapa në mbulueshmërinë e tij.

Edicioni i shtypur i *Index to Black Periodicals* është gjithmonë i vonuar. Mungesa e fondeve është arsye për këtë vonesë, si dhe për publikimet që mbështeten nga indeksues vullnetarë, apo që paguhen dobët, me punë të përkohshme. Ka 37 tituj të popullarizuar dhe shkollorë të indeksuar në këtë shërbim. Ndonëse i dobishëm për indeksim retrospektiv deri në vitin 1950, ai tejkalohet nga versioni në Internet.

Ethnic NewsWatch (Stamford, CT: Softline Information, 1991 e tej, e përmuajshme, www.sofline.Web.com/softliNeweb/ethnicBanner.html) është në dispozicion në Internet përmes, të paktën, OCLC-së. Siç sugjeron titulli i saj, kjo mbulon gazetat dhe revistat etnike, minoritare dhe vendore. Përparësi e saj është vënia në dispozicion e shumicës së materialeve, herë-herë vështirë e arritur, në Internet dhe me linka për huazime ndërbibliotekare. Ka përparësinë e mbulimet të fushave të interesit që ndryshe nuk mund të gjenden në shumicën e gazetave dhe revistave, p.sh., ka mbulim të mirë jo vetëm të Afrikës, por edhe të afrikano-amerikanëve dhe Lindjes së Mesme, Azisë, Paqësorit, Evropës Lindore dhe hispanikëve e hebrenjve.

INDEKSET PËR MATERIALET NËPËR KOLEKSIONE

Online: The Columbia Gragner's World of Poetry Online. Nju-Jork: Columbia University Press, 1999 e tej, e parregullt, www.grangers.org. Çmimi ndryshon.

CD: 1991 e tutje, e parregullt. $495-$1.905.

Print: The Columbia Gragner's Index of Poetry, ed. 11, 1998, 2078 f. $199.

Online: Essay and General Literature Index. Nju-Jork: The H. Ë. Wilson Company, 1985 e tej, gjysmëvjetore, www.hwWilson.com. $34 deri $50 në orë.
CD: 1985 e tej, vjetore. $695.
E shtypur: 1953 e tej, vjetore. Çmimi ndryshon.

Antologjitë dhe koleksionet janë një fat apo fatkeqësi e veçantë për bibliotekarin e referencave. Shumë prej tyre janë të padobishme, të tjerat janë aty në kufi dhe fare pak janë të vlefshme në përqendrimin e vëmendjes së lexuesve në materiale që përndryshe do të mund të injorohej. Koleksionit i shërbejnë bibliotekarit të referencave, i cili kërkon fjalime të veçanta, ese, poezi apo drama; por dobia e antologjive varet nga indekset e tyre përkatëse.

Ky lloj materiali qaset nga përdoruesi mesatar në disa mënyrë. Ai/ajo mund ta dinë autorin dhe duan të identifikojnë një dramë, një poezi, apo formë tjetër të autorit. Emri i veprës mund të jetë i njohur, por më me gjasë mund të mos jetë i njohur. Një qasje tjetër është të duash diçka lidhur me një temë të caktuar në një dramë, poezi, apo tregim. Rrjedhimisht, indekset më të dobishme në artikujt e koleksioneve janë të organizuar në atë formë që të mund të kenë qasje sipas autorit, temës dhe titullit të një vepre të veçantë. Indekset e këtij lloji u shërbejnë dy qëllimeve të tjera të dobishme. Ato mbulojnë libra apo materiale të tjera që janë analizuar. Pasi që analiza mëton të jetë selektive, bibliotekari ka një udhëzues të ndërtuar për kuptimin më të mirë të librave në atë fushë. Për shembull, *Essay and General Literature Index* sjell përzgjedhje nga shumica e koleksioneve të jashtëzakonshme të eseve.

Një përfitim tjetër, sidomos në këtë kohë të bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet bibliotekave, është se indekset mund të përdoren për të kërkuar librat që nuk janë në bibliotekë. Pasi të ketë bërë kërkesën për një ese dhe pa pasur titullin, me të cilin paraqitet eseja, bibliotekari kërkon librin apo artikullin duke dhënë informacion specifik dhe të saktë bibliografik që gjendet në indeks.

Indekset mëtojnë të favorizojnë shkencat humane, sidomos letërsinë. Ka pak nevojë për ndihmë të tillë për shkencat shoqërore dhe natyrore. Aty ku ekziston nevoja, kjo zakonisht bëhet përmes ndonjë shërbimi abstraktues apo indeksues. Indekset e diskutuara në këtë pjesë janë më të mirat që njihen, por ka dhe të tjera që paraqiten për çdo vit. Ato përfshi-

jnë udhëzues për literaturën shkencore, informacion mbi zanatet, kostumet, fotografitë, e kështu me radhë. Porsa të jetë njohur forma, ndryshimi i vetëm bazor në kërkim është në temat e mbuluara dhe gjithëpërfshirjen, apo mungesën e saj, në aranzhimin dhe thellësinë e analizës.

Një libër i vetëm më se i dobishëm për një bibliotekë, që mund të jetë si një hyrje në koleksionet e ndryshme të artikujve, është *Essasy and General Literature Index*. Esetë e analizuara mbulojnë një llojllojshmëri të gjerë temash. Ka njësi tematike në përmbajtjen e afro 300 veprave të koleksionuara në çdo temë, që nga arti deri te mjekësia.

Një edicion tipik vjetor do të ketë afro 4 000 ese. Emrat e koleksioneve, nga të cilat janë nxjerrë, jepen me informacion të plotë bibliografik për secilin në mbarim të vëllimit. Një njësi tipike përfshin emrin e autorit të esesë, titullin e esesë dhe pastaj një "in", me një titull të shkurtër dhe editorin e vëllimit nga i cili është nxjerrë eseja individuale.

Një tregim i shkurtër eluziv mund të gjurmohet në *Short Story Index*. Tani i botuar një herë në vit, ky indeks regjistron tregimet nga koleksionet dhe të përkohshmet. Një indeks i vetëm identifikon tregimin sipas autorit, titullit dhe temës. Një mjet tematik është ndihmë e përshtatshme për bibliotekarin e referencës, që përpiqet ta gjejë një temë të duhur studimore për një studiues, i cili mund të mos dëshirojë ta lexojë tërë librin mbi luftën civile apo mbi jetën në Alaskë. Emrat e librave dhe të revistave të analizuara janë të regjistruar këtu. Çdo vit përfshihen në të më se 3 000 tregime. Një vëllim themelor mbulon koleksione të botuara nga viti 1900 deri më 1949, si dhe ka përmbledhje pesë-vjeçare apo nga viti 1984 deri më 1988, një grup prej nëntë vëllimesh për t'u kërkuar. Është, po ashtu edhe *Short Story Index: Collections Indexed 1900-1978*, i cili ka të regjistruar 8 400 koleksione të analizuara.

Pos nëse përdoret tepër (që ndodhë rrallë në shumicën e bibliotekave) versioni i shtypur i *Gragner's* është shumë kursyes. (Është gjithashtu një përfitim financiar për Columbia University Press, që raporton se nga mbarimi i shekullit, një e katërta e të ardhurave vijnë nga ky libër). I dhënë, formati elektronik përfshin njësi shtesë, tekst të plotë të 14 000 poezive dhe 3 000 citateve poetike, por asnjëra prej tyre nuk është e nevojshme për shërbim ditor të referencës dhe që të dyja janë një luks i shtrenjtë pa të cilin mund të bëjë një bibliotekë. Indeksi i njohur ndjek formën e mostrën e shumë edicioneve të mëhershme. Ka një indeks të plotë të vargjeve të para të afro 7 000 poezive, një indeks tematik me afro 3 500 kategori dhe indekset e pritura të autorëve dhe titujve. Një karakteristikë

shtesë në edicionin e dhjetë është një indeks me 12 500 vargje të fundit, që mund të jetë e paçmueshme me rastin e kërkimit të citateve. E tërë kjo është nxjerrë nga 400 antologji të poezisë. Mirëpo, duhet pasur kujdes, se ai nuk indekson veprat e poetëve individualë. Kështu, *New and Collected Poems* e Geoffrey Hill-it nuk është i indeksuar, por *Oxford Book of Modern English Verse* përfshin Hillin, si një ndër poetët dhe në tërë atë antologji ju mund të gjeni të paktën disa nga poezitë që gjenden në koleksionin individual, më të gjerë, të Hillit.

Nëse *Grugner's* nuk është një njësi e kërkuar në formatin elektronik, kjo nuk është mohim i kënaqësisë për ta kërkuar atë Online, apo në CD-ROM. Për një çast, mund të gjeni një varg të parë, vargun e fundit, autorin, temën, titullin dhe, ç'është me më rëndësi, fjalën kyçe. Ky është një bonus i madh për këdo që përpiqet të gjejë një citat apo një poezi kur dihet vetëm një version i mjegullt i titullit apo i vargut të parë. Nëse, për shembull, përdoret vetëm një fjalë në "Sunday Morning", të Wallace Stevens-it, siç është fjala "vetëkënaqësitë" ("complacencies") dhe "penjuar" ("peignoir") në vargun e parë, apo në një nga dy fjalët e titullit, atëherë, presto, poezinë e kemi në dorë. Megjithëkëtë, përfitimi më i madh për ata që nuk dëshirojnë të largohen nga ekrani kompjuterik është qasshmëria me tekst të plotë të 14 000 poezive. Pashmangshmërisht, për të gjetur atë që dëshironi nga 70 000 mundësi kërkon, prapë, që lexuesi të largohet nga karrigeja dhe të gjejë antologjinë në ndonjë bibliotekë.

Ka burime pa pagesë të Net-it për identifikimin e poezive dhe të poetëve, si dhe të tematikës së poezive dhe të fjalëve të përdorura në poezi. Asnjëra prej tyre nuk është aq e plotë sa *Gragner's* por, të paktën, ofrojnë një mundësi për të gjetur një poezi që vështirë gjendet. Ato janë sidomos të dobishme pasi të jenë kërkuar të gjitha fjalët, ndërkohë që *Gragner's* regjistron vetëm vargun e parë të poezisë. Kështu, nëse dikujt i kujtohen disa fjalë nga mesi i një poezie të T. S. Eliotit, nuk është mirë të përdoret *Gragner-i*.

Sidoqoftë, ju mund t'i ktheheni cilitdo nga këto shërbime të Net-it:

Poem Finder on the Web (www.poemfinder.com). Botuesi pohon se ky 'sajt' ka mbi 650 000 citime të poezive, që mund të kërkohen me anë të cilësdo fjalë në titull, varg të parë, varg të fundit, autor, temë apo sipas disa fjalëve kyçe. Ky është një indeks, i cili orienton përdoruesin në një poezi të plotë nga afro 3 000 antologji, 5 000 të përkohshme dhe 4 500 vepra të veçanta autorësh. Pos kësaj, janë edhe 6 000 e më shumë poezi me tekst të plotë (dhe të kërkueshme përmes fjalëve kyçe). Për disa njësi

gjenden edhe biografi të shkurtra dhe fotografi. Ka një tarifë ($600+) për përdorimin e këtij 'sajti', që e bën të domosdoshëm vlerësimin e tij në kuptim të çmimit dhe thellësisë së indeksimit, siç gjenden në njësinë e *Gragner's.* Më e mira e punës, biblioteka do të duhej t'i kishte që të dyja.

British Poetry 1780-1910 (http://etext.lib.virginia.edu/britpo.html). Siç sugjeron edhe titulli i saj, kjo përmban vetëm poezi romantike britanike dhe në Online kryesisht për studimin nga studiues. Megjithëkëtë, teksti i plotë lejon kërkim.[26]

Mostrat e kërkimit

Edhe këtu, si një shumicën e bazave të përdorura të të dhënave me përdorim të gjerë, janë të mundshme tri nivele të kërkimit. Kjo vlen për të gjitha indekset e koleksioneve dhe plotësimeve me tekst të plotë. Wilsoni, natyrisht, ndjek mostrën e vet standarde, që është diskutuar më herët në këtë kapitull. Të tjerët ndjekin një kërkim fare "standard", apo një qasje të detajuar, apo thjesht hyjnë në një nivel më ezoterik të komandimit për kërkim të sofistikuar. Kjo modë e fundit, mundëson zhvillimin e shprehjeve komplekse të kërkimit dhe të kërkimit me elemente të dhënash. Kjo presupozon se përdoruesi e njeh sintaksën e komandës dhe kodet e të dhënave.

Burimet e tjera

Sado të specializuara që janë këto indekse për të gjetur tregime të shkurtra, poezi dhe artikuj, ka dhe burime të tjera në dispozicion. Ndërmjet tyre: (1) katalogu Online, që mund të ketë njësi për drama të gjata apo të njohura, tregime të shkurtra, poezi etj.; (2) indekset e përgjithshme dhe sidomos *IAC Expanded Academic Index*, që përfshin tregimet e vogla dhe dramat e mëdha që janë botuar në të përkohshme gjatë katër apo pesë vjetët e fundit; (3) *Wilson Humanities Index* (i diskutuar në kapitullin e ardhshëm) ka qasje në tregime sipas autorit dhe titullit, të dramave dhe të disa poezive, që janë botuar në revista nga viti 1907 e deri më sot.

[26] Ka dhe do të ketë indekse të tjera të poezisë me tekst të plotë. Shih, për shembull, një nënkapitull të Literature Online, një përpjekje ambicioze nga Chardwyck-Healey për të sjellë të gjithë letërsinë angleze dhe amerikane në Online (përgjithësisht jo me të drejtë autoriale). (http://lion.chardwyck.com/html/homenosub.html). Nënkapitulli është "American Poetry" me një tarifë të lartë prej afro $9.000.

SUGJERIME PËR TË LEXUAR

Herring, Susan, "Journal Literature on Digital Libraries: Publishing and Indexing Patterns, "*College* & *Research Libraries*, janar, 2000, f. 1-39. Cilat janë konditat më efikase, më të lehta për t'u kuptuar të indeksimit për kërkim Online? Autori shqyrton mostrat ekzistuese nga viti 1992 deri më 1998 dhe gjen pak apo aspak konsekuencë mes botuesve kryesorë të revistave. Kërkimi tematik për nxjerrje të plotë të tekstit mund të jetë një gjë e së kaluarës. Fjalët kyçe mund të jenë përgjigja.

Humphrey, Susanne, "Automatic Indexing of Documents from Journal Descriptors", *Journal of the American Society for Information Science*, vëll.50, nr. 8, 1999, f. 661-674. Autorja ofron edhe një qasje tjetër të automatizuar në indeksimin e qindra mijëra dokumenteve. Kjo është një qasje e re e të ndryshmeve, por analiza e autores është tipike për një sistem të ri relevant. Të marrim argumentin e saj, apo ta lëmë, por ai është bindës.

Internet Reference Services Quarterly, vëll. 3, nr. 3, 1998. E tërë çështja i dedikohet një diskutimi të serive në Net dhe asaj se si mund të shfrytëzohen ato në shërbimet e referencës. Po ashtu, edhe një theks mbi atë se si revista të tilla Online do të mund të ndryshonin rolet e bibliotekarëve nga sektori i katalogimit deri te tavolina e referencës.

Tenopir, Carol, "Human or Automated, Indexing is Important", *Library Journal (LJ)*, 1 nëntor 1999, f. 34-38. Kolumnistja e rregullt e LJ-së shpjegon dallimet në qasjen ndaj indeksimit nga ana e kompanive të mëdha, që nga kompania H. W. Wilson e deri te LEXIS-NEXIS. Kalimthi, ajo shpjegon rëndësinë e indeksimit specifik dhe rëndësinë e ndërhyrjes njerëzore në përcaktimin e nivelit të saktësisë së indeksit.

Wiley, Deborah L., "Beyond Information Retrieval", *Database*, gusht/shtator, 1998, f. 19-22. Autorja vë në pah se hapi i ardhshëm i indeksimit/abstraktimit do të jetë një përdorim më i stërholluar, i sofistikuar i informacionit në Ueb. Makinat kërkimore do të përshtatin shumë metoda të indeksimit të mirë dhe kështu t'ua sjellin informacionin njerëzve, të cilët më parë kanë përfunduar në një fundosje të dhënash.

KAPITULLI VI

INDEKSIMI DHE ABSTRAKTIMI I SHËRBIMEVE: SUBJEKTI DHE GAZETA

Shumica e librave të citimeve kanë diku prej 1 500 deri 2 500 indekse periodike. Këto indekse i mbulojnë në përgjithësi revistat dhe shkrimet gazetareske, të veçanta dhe të përgjithshme, të subjektit.

Nëse kopertina i ka të gjitha informatat që na duhet, atëherë pse do ta lodhnim veten për të shkuar te indekset e temës apo të subjekti?

Përgjigjja: Thënë të drejtën, në të shumtën e rasteve libraritë nuk lodhen fare për këtë gjë.

Gati të gjithë indekset gjeneralë u shërbejnë 99 % kërkesave të studentëve, prej klasave fillore deri te ato universitare. Përqindja është edhe më e lartë për njerëzit të cilët nuk kanë nevojë speciale për këto indekse. Për ata, një libër me indekse të përgjithshme është i mjaftueshëm.

International Periodicals Directory i Ulrich identifikon më shumë se 3000 tema të indekseve. Revista e Librarive "Magazines for Libraries" selekton diku rreth 300 indekse si më të mirat dhe të domosdoshme. Si qëndrojnë ato në biznes dhe kush i përdorë ato? Përgjigja është shumë e thjeshtë. Ato janë publikuar për arsyen se ka mjaft specialistë dhe mjaft njerëz me vetëdije të ngushtë për temat që e arsyetojnë ekzistencën e tyre. Çdo vit kur dija ndahet shfaqen indekse te reja te temave dhe subjekteve. Nëse një temë e zakonshme i përmbledh diku prej 250 deri më 3000 tituj, kush i indekson rreth 120 000 tituj të tjerë. Përgjigja është në këtë kapitull.

Në të shumtën e rasteve, puna në temën e caktuar është mënyrë shumë efikase për t'u përgjigjur në pyetjen që e shtron një student ose një person

joprofesional. Indekset janë perfektë kur pyetja është vetë subjekti ose tema, p.sh., "Çfarë është statusi i ECU së Evropës?" (ABI/ Informim do të ishte indeksi i temës si një përgjigje e shpejtë dhe efikase); Apo për shembull tjetër, "Cilët artistë modern i ilustrojnë librat?" (Indeksi i Artit); apo tjetra "Unë jam duke kërkuar informata lidhur me plan programet e historisë për klasën e 3-të." (ERIC- është përgjigja). Është shumë më lehtë për të gjetur material në tre indekset lidhur me biznesin, artin dhe edukimin sesa duke shikuar indekset e përgjithshëm, disa mijëra faqesh.

Janë tri arsye që duhet të merren në konsideratë përveç temës së indeksit. Dhe, kjo vlen jo vetëm për ekspertë, por në rast nevoje, edhe për opinionin publik: (1) analizon në detaje artikujt që janë shpjeguar në Indekset e përgjithshme; (2) tema e indeksit është i njëjti që përdoret për t'i indeksuar të gjithë artikujt, e jo zgjedhjen e vetëm disa prej tyre; (3) abstraktet janë më të gjata dhe kanë më shumë informata sesa në indekset e përgjithshme; (4) shumica e temave të indekseve shkojnë me dekada prapa, në vend se te shkojnë vetëm prapa për disa vite. Është e vërtetë se këto versione janë hedhur në bojë dhe është goxha e vështirë t'i përdorësh ato pasi je mësuar më përdorimin e indekseve elektronike. Mirëpo, ato nuk i përfshijnë "vitet e humbura" që nuk mund t'i gjesh në indekset e përgjithshme.

Fusha e temës së indekseve

Kur një bibliotekarë e kupton mesataren e indeksit të përgjithshëm, ai apo ajo do bëjë një progres të jashtëzakonshëm në fushën e indekseve. Kur shikoni indekse të tilla, atëherë duhet të kihen parasysh tri fakte:

1. Të shumtët e tyre përfshijnë një fushë të tërë, ku edhe vetë titulli i tyre do të tregojë, si p.sh. titujt me fjalët "Art," apo "Edukim." Fushat e ngjashme shpesh konsiderohen kështu. Kështu, çdo kush që bën një analizë të thellë dhe të detajuar të temës, duhet te marrë në konsiderim indekset që prekin fushat dytësore;
2. Shumica e temave të indekseve nuk janë të mbyllura si në revista. Ato përfshijnë libra, monograme, buletinë të ndryshëm, e po ashtu dokumentacion qeveritar;
3. Një numër shumë i madh kanë përmasa ndërkombëtare. Ato i përmendin çdo gjë në gjuhën angleze, edhe nëse botimi në fjalë është botuar jashtë SHBA-ve.

Çfarë ka të mirë në mësimin e një botimi të posaçëm që flet për një artikull të veçantë dhe pastaj të mos jesh në gjendje ta marrësh atë artikull? Një bibliotekar duhet të jetë në gjendje ose ta marrë diku me qira atë artikull, ose ta ketë një kopje të artikullit, ose së fundi ta hedhë të gjithë tekstin Online.

Kombinimi i të dhënave

Në vend se të ofroni indeks vetëm për një subjekt të caktuar, Interneti me trendin Online, në një mënyre i përfshin të dhënat e njëjta për indeksim. The Literature Resources Center është njëra nga qendrat Online për indeksimin e të dhënave, që po rritet dita ditës. Në këtë qendër, ju keni qasje në publikimet standard te Gale Group siç janë: Contemporary Authors, Dictionary of Literary Biography dhe në selektimin e kritikave prej Contemporary Literary Criticism dhe po ashtu Webster's Encyclopedia of Literature. Ju mund të kërkoni informata në këto fusha duke shkruar temën, autorin, titullin, datën e publikimit etj. Kjo qendër Online përfshin më shumë se 900 000 autorë prej të gjitha vendeve dhe prej të gjitha kohëve. Po ashtu, duke e futur të gjithë tekstin e artikullit prej 24 artikujve të përgjithshëm të letërsisë, ju mund të gjeni këtu prej përmbledhjeve për artikuj e deri te kritikat për librat dhe autorët e caktuar.

Duke i dhënë këto informata, botuesi mund të vazhdojë të shtojë referenca, link-a të ndryshëm, botime të herëpashershme, dhe gjithçka që është e nevojshme për t'u përgjigjur në çdo pyetje, që shtrohet nga personat e thjeshtë apo ekspertët lidhur me letërsinë.

Variacioni në temat, "Gale Group InfoSuites," lejon bibliotekat të ndërtojë një sistem të indeksimit sipas nevojës. Janë edhe shumë fjalë dhe sisteme të tjera. Gale nuk është sistemi i vetëm Online që po mundohet ta përfshijë çdo të dhënë. Kjo po bëhet, nga ata, për të qëndruar afër me konkurruesit e tyre. Mirëpo, problemi është se një bibliotekar mesatar i referencave humbet në emra - në emrat dhe përshkrimet, që duket se ndryshojnë prej një menaxheri në tjetrin, dhe në secilën agjenci të marketingut.

HUMANITETET

Arts & Humanities Citation Index. Shiko faqen 177.
Online: Humanities Abstracts, Teksti i plotë. New York: H.W. Wilson Company,

1995 e deri më tani, e përjavshme, www. H. W. Wilson.com. $2,995. Po ashtu edhe OCLC.[1]

CD: Humanities Abstracts, 1994 e deri më tani, e përmuajshme, $1,725.

Shtypi: Humanities Index, 1974 e deri më tani, çdo 3 muaj. Shërbim.

H.W. Wilson Company ka lëshuar indekse që i lidhin temat e përgjithshme me ato specifike. Të gjitha përdorin qasje te njëjtë. Autori dhe tema që shënohen janë në alfabetin e vetëm. Janë të përfshira po ashtu edhe referenca të kryqëzuara. (Disa indekse sikurse Applied Science dhe Technology Index, merren vetëm me temat). Titujt e temave janë të përmirësuara në të shumtën e rasteve, dhe po ashtu në shërbime, librat e shqyrtuara janë të ranguara në një kapitull të veçante. Secili indeks ka lëshimet e tij, mirëpo leximi i një materiali do t'i shpjegojë edhe poentat kryesore të atij materiali të caktuar.

Nga shtjellimi i të gjitha anëve të humaniteteve, nuk ka asgjë të tillë si Humanities Abstracts (Abstraktet e humaniteteve). Indeksi i ofron një personi mesatar shtegun se prej nga kanë ardhur informatat për religjionin, artet, kritikën letrare, filozofinë, gazetarinë dhe shumë fusha të tjera që hyjnë nën ombrellën e "humaniteteve". Rastësisht, kjo përfshin edhe historinë, që të tjerët do ta klasifikonin nën shkencat sociale. Diku afro 460 tituj janë të indeksuar, prej të cilëve 325 deri më 380 janë të përfshirë në tre indekset e përgjithshëm, që i diskutuam në kapitujt paraprakë. Editimi Online i të gjitha teksteve përfshin 96 tituj, përshirë edhe tekstet.

[1] Këtu dhe gjatë gjithë këtij kapitulli, po ashtu në tekstin e përgjithshëm, adresat për përshkrime në Online bazat e të dhënave janë ato te botuesit, dhe jo te bazës së të dhënave. Për të gjetur çmimet e bazave të të dhënave (që është i dhënë nga çmimi i përshkrimit): (a) Kthehu te web-sajti i bibliotekës suaj. Bazave e te dhënave është e shkruar aty dhe linku i veçantë për web-sajte; (b) Provo në ndonjë bibliotekë tjetër në fushën tënde e cila ofron përdoruesve qasje në bazat e te dhënave me çmim; (c) Përdore adresën Online te botuesit të dhënë aty. Ndoshta, ju duhet te kërkoni tituj specifikë në katalogun Online te botuesit ose provo në sistemin e kërkimit. Nëse e gjeni, botuesi ndoshta do t'ju ofrojë një orë ose dy pa pagesë që t'ju tregojë si të kërkoni materiale. Shko direkt te adresa për bazat e të dhënave pa pagesë, p.sh. me ato të shënuara "Pa pagesë."

Indeksi i shtypit është i klasifikuar sipas autorit dhe subjektit në fjalë, që është i analizuar nga vetë libri. Ka disa komponentë unike: (1) Analiza e operave dhe filmave janë të radhitura nën titullin e temës përkatëse, si p.sh. "Analizat e operave" dhe "Mocionet e analizës së fotografisë"; (2) Poemat mund të jenë të radhitura sipas emrit të autorit nën seksionin e veçantë, "Poemat". Procedura e njëjtë ndiqet edhe për analizat e tregimeve të shkurtra; (4) Është një seksion i veçantë për analizën e teatrit. Duke i dhënë këto diferencime, puna është valide vetëm nëse e bëni atë duke i kontrolluar mendimet e sotshme kritike për variacionin e gjerë të temave ne fushën e humaniteteve.

Humanities Abstracts ndjek formatin e njëjtë të kërkimit 1-2-3 si në të gjitha kërkimet elektronike të Wilson indekseve. (Shih kapitullin para-prak, që flet për këtë lloj të softuer-it). Përdoruesi, i cili e shikon indeksin e temës është shumë e mundur të jetë më i informuar për temën në fjalë sesa personi, i cili ulet dhe bën kërkime në indeksin e përgjithshëm. Zakonisht, kërkimi Online duhet të fillojë në nivelin e dytë ose të tretë, e jo prej atij të parit. Personi që bën kërkimin ka mundësi t'i shkruajë fjalët kryesore, të cilat janë të njohura vetëm në një fushë të caktuar. Me logjikën e Boolean-it, rezultatet nga kërkimi mund të identifikohen më lehtë.

SHKENCAT SHOQËRORE

Indeksi i Shkencave Shoqërore, shih faqe 177.
Online: Social Science Abstracts, (Abstraktet e Shkencave Sociale) Teksti i plotë. New York: H.W. Wilson Company,
1994 e deri më sot, e përmuajshme, www.hwwislon.com. $ 2.295.
CD: Social Science Abstracts, 1994 e deri më sot, 9/vjet. $2.295.
Shtypi: Social Science Index. 1975 deri më sot, tremuajshe. Shërbime.

Burimet e Shkencave Sociale. Ipswitch, MA, EBSCO, 1988 e deri më sot, e përmuajshme, www.epnet.com. Çmimi ndryshon.

Online: PAIS International. New York: Public Affairs Information Service, 1972 e deri më sot, përmuajshme, www.pais.org. DIALOG file 49. Çmimi ndryshon.
(Shënime: Në vitin 2000 PAIS dhe OCLS janë bashkuar, mirëpo Zyra në New York e PAIS qëndron... dhe në gjysmën e vitit 2000 titulli i

vërtet është OCLC. Marrëdhëniet Publike dhe Informacionet e Shërbimit.)

CD: PAIS International, 1972 e deri më sot, tremuajshe, $1.600. PAIS Select, 1994 e deri më sot, e përmuajshme $495.

Online: SIRS Researcher. Boca Raton, FL: Çështjet Publike dhe Seria e Rezervat,

1994 e deri më sot, ars.sirs.com. $1 350. OCLC dhe të tjera.

Print: 1971 e deri më sot. Çmimi ndryshon.

Social Science Abstracts[2] (Abstraktet e Shkencave Sociale) përfshin rreth 550 periodikë të gjuhës angleze.

Versioni i tekstit të plotë Online, me mbi 200 tituj, është ndoshta sistem edhe më i përparuar. Kur është e mundur, bibliotekat duhet të provojnë që të kenë edicionet me tekstet e plota.

EBSCO që është rivale e W.W. Wilson Company me Social Science Abstracts (Abstraktet e Shkencave Sociale), është edituar për një audiencë të përgjithshme të opinionit publik, si dhe për shkolla të mesme, duke mos lënë anash as kolegjet dhe universitetet. Social Sciences Sources (Të dhënat e Shkencave Sociale) ka diku rreth 400 tituj. ESBCO përfshin tekstet komplete të pothuajse 40 indekseve të artikujve.

PAIS International

PAIS (Shërbimi i Informatave te Marrëdhëniet Publike) International ofron burime të përgjithshme të informatave për ekspertë, si dhe për njerëz të zakonshëm. Shumë bibliotekarë e konsiderojnë atë si indeksin e përgjithshëm të shkencave politike dhe sociale. Në këto burime, çdo njëri mund të kërkojë informata për qeveritë, legjislacionin, ekonominë, sociologjinë, si dhe shkencat politike. Raportet periodike, dokumentacioni qeveritar, pamfletet, raportet, si dhe disa libra në fushat e qeverisjes, administratës publike, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ekonomike janë indekse.

Çdo vit janë të indeksuara rreth 3 600 artikuj dhe diku 6 000 njësi të tjera (prej librave e deri te raportet). Trajtimi është ndërkombëtar. Aranzhimi është alfabetik, në radhë të parë sipas temës apo subjektit që trajtojnë. Vetëm disa nga këto të dhëna kanë një hyrje përshkruese të

[2] Social Science Abstracts, Full Text ofrohet Online nga Wilson, e po ashtu edhe nga Bell-Howell.

shkurtër për qëllimin dhe përmbajtjen.

PAIS është një lloj i sistemit të mbushjes dhe i shënimit të indekseve, jo vetëm shërbim i drejtpërdrejtë për ata që janë të interesuar në shkencat politike dhe në fushat e njëjta si kjo. Nuk e indekson çdo artikull prej një raporti apo shënimi të gjetur në një apo më shumë shërbime; në të vërtetë, i zgjedh vetëm ata artikuj që kanë të bëjnë me interesin e përdoruesve të sistemit PAIS. PAIS, po ashtu ofron indeksimin për periodikë që nuk gjenden në bazën e të dhënave të përgjithshme.

Për ta shpjeguar shënimin e titujve aq te diversifikuar siç është "Korporata e Fermerëve" dhe "Aksioni Kovert" në secilën çështje të indeksit.

E bërë për njerëz joprofesionistë dhe studentë, PAIS Select është degë e PAIS International. Që të dyja kanë indekse dhe tekst të plotë prej afro 2 200 artikujve dhe pamfleteve të zgjedhura. Teksti i plotë është marrë nga 177 botime ose artikuj dhe disa raporte (krahasuar me 2 100 ditarëve dhe mbi 8 000 raporteve në shërbimin primar). "Grremçi" këtu është fakti se asnjë shkrim apo artikull më i gjatë se 25 faqe nuk është përfshirë këtu, gjë që i eliminon shumë raporte, e pamflete që është e vështirë të gjenden të shkruara.

Shënim: Të gjitha tekstet e plota apo komplete janë të cituara në PAIS International. Kjo do të thotë se përdoruesit e indeksit të madh do të gjejnë referenca të kryqëzuara, të cilat i ndikojnë artikujt e gatshëm me tekst të plotë në PAIS Select.

SIRS

Më shumë shërbime të rishtypura sesa një indeks, edhe pse mund të përdoret në ndërtimin apo shënimin e indekseve, SIRS, d.m.th. seria e të dhënave për çështjet sociale, që përfshin tekstet komplete të materialeve prej diku rreth 1 500 periodikëve amerikanë dhe ndërkombëtarë. Fokusi është në ngjarjet aktuale, e posaçërisht ngjarjet që mund të gjenden lehtë në klasën K-12, dhe atyre studentëve fillestarë universitarë. Artikujt janë të përzgjedhur. Ky nuk është një indeks prej 1 500 periodikëve, mirëpo është një indeks që është përzgjedhur nga redaktorë të revistave të ndryshme. Formati Online është më i preferuar për arsye se edicioni i shtypur është i prezantuar në më shumë se 30 fletore që rishkruhen shpesh.

Është shumë interesant fakti se kur është bërë një studim me bibliotekarë,

kjo ishte njëra nga digjitalet e pakta (e jo shtypi) të titujve të referencave, që ishte zgjedhur si një referencë e domosdoshme në të gjitha llojet e bibliotekave. Ndër komentet ishte edhe ky: "jashtëzakonisht i kërkuar" apo " qasje e shpejtë në informatat aktuale" ose " adhurimi i teksteve të plota". [3]

SHKENCA

Indeksi i Citimeve të Shkencës, shih faqe 178

General Science Index Abstracts, Full Text. New York: H.W. Wilson Company, 1995 e deri më sot, e përmuajshme, www.hwwilson.com. $2.295.
CD: General Science Abstracts, 1984 e deri më sot, e përmuajshme. $1 995.
Shtypi: General Science Index, 1979 e deri më sot, e përmuajshme. Shërbim falas.
Online: Applied Science & Technology Abstracts, Tekst i plotë, 1993 e deri më sot, e përmuajshme, www.hwwilson.com. $1.875.
CD: Applied Science & Technology Abstracts, 9/vit. $1.875.
Shtypi: Applied Science & Technology Index, shërbim mujor.

Janë shumë më shumë dokumente të shtypura dhe indekse Online në dispozicion për shkencë sesa për humanitete apo shkenca sociale. Arsyeja është se janë diku katër apo pesë herë më shumë periodikë në këtë fushë sesa në humanitet apo shkencat sociale. Qeveria dhe biznesi janë më të gatshëm të financojnë shkencën sesa disiplinat e tjera. Bazat e të dhënave Online për shkencë kanë qenë më të hershme sesa ato të disiplinave të tjera për shkak të interesit më të madh dhe financimit të mirë. Në të njëjtën kohë, shpenzimet e indeksimeve në shkencë dhe në periodikë janë përjashtime në krahasim me fushat e tjera. Shembull ekstrem i kësaj që po themi është ky: një nënshkrim i një ditari apo dokumenti të fizikës nukleare që u botua në Holandë kushton afro $6 000. Ka më shumë se 11000 faqe, mirëpo çmimi nuk është i qëndrueshëm.

The General Science Index Abstracts (Abstraktet e Indeksit të Përgjithshëm të Shkencës), teksti i plotë përfshin 220 periodikë, prej të cilëve 60 e më shumë janë në tekst të plotë. Përqendrimi këtu është në atë

[3] Field Tested Reference Titles," Booklist, prill, 1998, f. 1532

"të famshmen" që indeksi është bërë për shkollat publike dhe bibliotekat universitare në nivelin themelor të instruksioneve nga shkenca. Kjo nuk është punë e kërkuesit. E disenjuar për nivelin e jo profesionalistëve, përfshin të gjitha shkencat, prej biologjisë dhe kimisë e deri te oqeanologjia dhe zoologjia. Versionet e tjera të shtypura dhe në CD i mbulojnë sferat e njëjta, mirëpo nuk e kanë tekstin e plotë.

Duke lëvizur prej të përgjithshmes te ajo specifike, Applied Science & Technology Abstracts, teksti i plotë ka indekse të më shumë se 620 titujve. Prej tyre, afro 200 janë të gatshme në tekst të plotë. Dallimi në mes të këtij dhe General Index, apo përkthyer, Indeksit të përgjithshëm, është fakti se këtu nuk janë të përshirë vetëm një numër më i madh i titujve të indeksuar, por përqendrimi është në të dhënat bazike për secilën disiplinë. Po ashtu, është një studim më i plotë i degëve të asaj disipline, p.sh. disa degë të inxhinierisë prej elektrikës e deri te kemikaliet. Kjo është ndoshta fushë për ekspertë ose për studentë, të cilët nuk mund të gjejnë çfarë është kërkuar në General Science Index (Indeksi i Përgjithshëm i Shkencës).

CITIMI I INDEKSEVE

Më poshtë janë dhënë të gjitha indekset e publikuara nga Instituti i Shkencës Informative në Filadelfia, SHBA (www.isinet.com)

Online: Arts & Humanities Search. 1974 e deri me sot, e përjavshme. Fajli DIALOG 439;
DataStar and OCLC. Çmimi ndryshon.
CD: Arts & Humanities, Indeksi i Citimeve. 1990 e deri më sot, çdo tri vjet. Çmimi ndryshon.
Shtypi: 1976 e deri më sot. $5.000

Online: Social SciSearch. 1972 e deri më sot, e përjavshme. DIALOG, fajli nr. 7; DataStar;
DIMDI. Çmimi ndryshon.
CD: Social Science Citation Index with Abstract Edition, 1992 e deri më sot, e përmuajshme, Edicioni CD-ROM 1981 e deri më sot, çdo tre muaj. Çmimi ndryshon.
Shtypi: Social Science Citation Index, 1969 e deri më sot, çdo tri vjet. $ 5.920.

Online: SciSearch, 1974 e deri më sot, e përjavshme. DIALOG, fajli 34. 434; DataStar;
DIMDI. Çmimi ndryshon.
CD: Science Citation Index with Abstracts Edition, 1991 e deri më sot, e përmuajshme.
Versioni CD-ROM, 1980 e deri më sot, çdo tre muaj. Çmimi ndryshon.
Shtypi: Science Citation Index, 1961 e deri më sot, çdo dy javë. $11.650
Online: ISI Basic Science Index. ISI Basic Social Sciences Index. 1999 e deri më sot, e përmuajshme. Çmimi ndryshon.

Citimet e indekseve janë shumë të rëndësishme për shumë arsye, mirëpo në rend të parë për faktin se ato i indeksojnë shkrimet, si asnjë shërbim tjetër, në mënyrë periodike. Titulli tregon fushën e përmbledhjes së çdo indeksi. Aty përfshihet çdo titull nga fushat siç janë: humanitetet, shkencat shoqërore dhe shkencat e tjera. Asnjë shërbim tjetër nuk indekson kaq shumë ditore dhe artikuj në fushën e subjektit. Arts& Humanities: 1.150 ditore, duke përfshirë dhe duke zgjedhur edhe më shumë se 7 000 ditarë nga shkenca dhe shkencat e tjera sociale. Social Sciences: 1.700, plus 5.600 artikuj të tjerë të zgjedhur. Shkencë:

Më shumë se 3.500 (versioni më i gjerë përfshin 5 600) tituj.[4]

Pengesa më e madhe është çmimi- SciSearch (Science Citation Index) mund të shfrytëzohet në Internet prej $72 për shënimet nga versioni i botuar e deri më $142 për orë, për përshkrimet e hollësishme, plus 50 cent më shumë për çdo shënim. CD-ROM-i kushton diku $12.650 dhe nëse klienti dëshiron edhe shënime të tjera, të hollësishme, atëherë çmimi mund të arrijë deri në $17.000. Dy shërbimet e tjera janë diku të njëjta në çmim.

Citimi i indekseve është unik për faktin se bën një qasje krejt tjetër në kërkime. Këtu bëhet qasje nga referencat që janë të cituara në artikuj, po kështu edhe nga emri i shërbimit. Është shumë më lehtë ta kuptosh këtë sistem kur i shikon versionet e botuara. (Mjaft çuditshëm, në kërkimet ditore, versioni Online është shumë më i mirë). Materialet e botuara janë

[4] Përmbajtja e tanishme e shërbimeve siç është OCLC's ArticleFirst i regjistron më shumë tituj- diku rreth 17 000- mirëpo këto nuk janë analitike në asnjë mënyrë. Të papërdorshme ashtu siç janë, përmbajtja e tanishme e shërbimeve ka dështuar në kërkimin që është i mundur gati në çdo indeks tjetër, e po ashtu edhe me indekset e cituara.

të organizuara në një mënyrë të veçantë.

The Citation Index, i cili i radhit artikujt sipas alfabetit dhe autorit. Titulli i artikullit shënohet pas emrit të autorit dhe ndër çdo artikull është një listë e atyre që e kanë cituar punën e autorit përkatës. Shumica e materialit është i shënuar me shkurtesa.

The Source Index jep informacione standarde bibliografike për secilin artikull në The Citation Index.

The Permuterm Subject Index indekson artikujt për nga tema e tyre, pra nga fjalët e veçanta në tituj.

Ky sistem pret nga shfrytëzuesit që ta dinë emrin e autorit në fushën e caktuar. Kjo vlen edhe për kërkuesit në fushën elektronike. P.sh. një njeri që është duke kërkuar material për vullkanet japoneze, do të duhej ta dinte se eksperti më i mirë në këtë fushë është Kazuo Iskiguro.

Më pas, përdoruesi do të duhej të kthehej te Iskiguro, Kazuo në Citation Index. Poshtë emrit të tij janë të shënuar shtatë emra të njerëzve të tjerë, të cilët e kanë cituar atë (dhe artikujt e tij në libër). Supozimi real është se ndoshta që të gjithë këta, 7 njerëz, gjithashtu kanë shkruar për vullkanet japoneze. Për më shumë, duke e cituar Iskiguro ata dinë për autorin dhe për fushën e caktuar.

Më pas, mund të kthehesh te ata shtatë emrat në Source Index dhe të gjesh artikuj ose libra të tyre.

Është e qartë se "Grremçi" këtu nënkupton se një njeri, i cili po kërkon informata duhet ta njohë së paku një ekspert në atë fushë. Nëse jo, zgjidhja e vetme është që: (1) të përdoret ndonjë indeks tjetër ose (2) të kthehesh prapa te Permutern Subject Index.

The Permutern Subject Index është i aranzhuar sipas rendit alfabetik (fjalët kryesore në kontekstin e caktuar). Temat janë të ndara prej fjalëve që shfaqen në titujt e artikujve të të dhënave. Çdo fjalë e rëndësishme është e koordinuar me termat e tjerë, në mënyrë që të prodhojë një kuptim të qartë për termat në fjalë.

Çka është unike për këtë sistem është fakti se derisa rivalët e tij kanë shemat triviale. Ky sistem është një rrjet, i cili i lidh autorët që citojnë dokumentet ose artikujt e njëjtë gjatë viteve të tanishme. Me fjalë të tjera, në kërkimin për një subjekt të caktuar, ju keni një dokument shumë të rëndësishëm ose një analize të artikullit në një fushë të caktuar, ose ndoshta emrin e autorit, atëherë konsultohuni me Citation Index për nga autori. Më poshtë se emri i autorit janë të radhitura, në mënyrë kronologjike, publikimet nga ai autor, që është cituar në vitet e fundit;

mirëpo së bashku edhe me autorët e tjerë të cituar (si të dhëna) që i janë referuar një pune të caktuar. Nëse ju vazhdoni të kontrolloni autorët e cituar në The Citation Index, ju do të keni një proces përsëritës, që jep rezultate të përziera. The Source Index pastaj është përdorur për t'i themeluar referencat e plota bibliografike te autori i cituar.

Indeksi i cituar ka një përparësi të madhe që e bën jashtëzakonisht të përshtatshëm për vetëlëvizje. Indeksuesit nuk duhet të jenë specialistë në atë fushë dhe nuk është nevoja të lexohen artikujt për titujt e tyre. Të gjitha që duhet të bëhen janë këto: (1) shkruaj emrin e autorit, titullin, dhe citimin e plotë në formë të lexueshme dhe (2) shëno të gjitha citimet që janë përdorur në artikullin e parë, duke shkuar me rend dhe duke filluar me autorin, titullin dhe citimin e plotë në formë të lexueshme. Si pasojë, një nëpunës i kujdesshëm ndoshta do të përgatisë material për kompjuter. Kjo bën që ky proces të shkojë edhe më shpejt dhe bën të mundur që indeksi t'i marrë në konsideratë dhe t'i shqyrtojë edhe shumë materiale të tjera.

Ka shumë të meta në vëllimet e botuara, ndër të cilat edhe forma e shkrimit që është shumë e vogël, mirëpo klasifikohet dhe duket si shumë e madhe në krahasim me shkurtesat e ngatërruara. Pengesa më e madhe është mungesa e kontrolluar e fjalorit. Kjo është në rregull në shkencë, mirëpo dështon kur përdoret në humanitete dhe në shkencat sociale. Vëllimet e shumta e bëjnë këtë botim shumë të ndërlikuar dhe të vështirë për ta përdorur. Kjo do të thotë se vlera e tij elektronike është më e madhe.[5]

Botuesi i "Web of Science" ofron qasje në të gjitha bazat e sofistikuara të të dhënave në sistemin Online. Kjo është e ndarë në "kërkimin e shpejtë" pa zëra dhe në "kërkimin e plotë" për ekspertë në këtë fushë. Veçanërisht, është e përdorshme ngase i heq disa pengesa në indekset e cituara. Në secilën situatë, ekzistojnë versioni i shtypur dhe ai elektronik.

Shumë pak biblioteka, duke përjashtuar ato të mëdha, mund t'i ofrojnë të gjitha apo disa indekse periodike të këtyre shërbimeve. Mirëpo, ata mund të marrin libra hua nga bibliotekat e tjera dhe dokumente që duhet

[5] Botuesi ISI ka një numër të madh të bazave të dhënave të citimeve siç është Chemistry Citation Index and Neuroscience Citation Index. Duke e përdorur të dhënat fondamentale, botuesi i ka lëshuar edhe Current Book Contents ne disa fusha te veçanta. (Kjo tregon tabelën e te shënimeve e periodikëve në subjektin e caktuar). Po ashtu, janë edhe shumë publikime dhe botime të tjera që janë më shumë të koncentruar në shkencë. Menyja e botimeve mund te gjendet në Internet në adresën a botuesit (www.isinet.com)

të dërgohen shpejt. Po ashtu, botuesi do t'i furnizojë ata me letra nga 1 apo 1000 artikuj që janë të nevojshëm, natyrisht për një çmim të caktuar.

Për ta gjetur një publik, sa më të madh dhe për ta zvogëluar çmimin e indekseve Online, ISI ofron dy versione të reduktuara të shërbimeve të saj, si p.sh. ISI Basic Indexes (për shkencat shoqërore dhe për shkencë). Këtu, ata e zvogëlojnë numrin e ditoreve dhe artikujve në 500 për shkencat sociale dhe 800 për shkencat e tjera. Edhe pse ka filluar në vitin 1999, këto indekse përfshijnë 10 vjetët e mëpërparshme dhe informatat e reja futen gati çdo muaj. Duke e përdorur më lehtë këtë Ueb bën që indekset të jenë më të kapshme sesa ato që janë të cituara në standarde.

INDEKSET E TEMAVE SPECIFIKE

Çka do të tregohet në vijim janë shembujt e formave elementare të temave të indekseve që përbëjnë 3 000 ose më shumë indekse në këtë kategori. Këto që ne i diskutojmë këtu gjenden lehtë në shumicën e bibliotekave te mesme dhe të mëdha. Çdo bibliotekë ka titujt e caktuar për nevojat e veçanta të atij komuniteti.

TEZAT

Online: ProQuest Digital Dissertation. Ann Arbor, Mi: Bell & Informacioni dhe Mësimi Howell/ UMI, 1861 e deri më sot, e përmuajshme, www.umi.com.

Po ashtu: DIALOG fajli 35. $96. për orë, 40 cent për çdo incizim. OCLC , plus shpenzimet e tjera.

CD: Dissertation Abstracts. 1961 e deri më sot, e përmuajshme. $ 1.995 (Edicion backfile, tri disqe; $7.999)

Print: Disertation Abstracts International. 1938 e deri më sot, e përmuajshme. $140 komplet.

Print: Comprehensive Dissertation Index. 1973 e deri më sot, përvitshme. Çmimi sipas marrëveshjes.

Në të shumtën e rasteve, tezat nuk janë shpjeguar sikurse indekset e përgjithshme, mirëpo për shkak se ato mbulojnë aq shumë fusha, ato meritojnë së paku të kenë qasje dhe vend kur ndokush kërkon informata

të detajuara dhe bibliografi për një temë të caktuar.

Mbulimi i më shumë se 1.6 milionë tezave të doktoranturës (dhe atyre master) prej universiteteve amerikane që nga gjysma e shekullit XIX, bën që Dissertation Abstracts është e rëndësishme gati në çdo temë dhe në çdo fushë. Shumica e temave janë të orientuara ekskluzivisht në këtë formë. Botuesi thotë se më shumë se 3 000 tema në fusha të caktuara janë mbuluar nga ata. Kështu, që nga 1980, fusha e mbulimit është zgjeruar aq shumë, duke i përfshirë këtu 200 institute nga vendet e ndryshme, në rend të parë nga Azia dhe Evropa Perëndimore.

Duke i shtuar edhe 3 500 incizime, për çdo muaj, është garancioni se diçka interesant dhe me interes do të shfaqet në atë kërkim, pavarësisht nëse kërkuesi po kërkon zbulime mbi kafshët e buta ose fizika.

Tezat janë shumë të rëndësishme për një bibliotekar, i cili dëshiron të ketë informata specifike për një artikull të pabotuar në një temë, vend apo person të caktuar.

Qëkur tezat përmbajnë një shumëllojshmëri bibliografike dhe shënime plotësuese, ato mund të përdoren si bibliografi jozyrtare për disa fusha të caktuar. Ka shanse të mëdha që teza ka bibliografinë e vet ose që i cekë burimet më të mëdha.

Një problem me tezat është arsyeja që disa bibliotekarë nuk i huazojnë ato. Rregullat janë të ndryshme, por arsyet për mos huazimin e tyre janë si vijon: (1)Është vetëm një kopje dhe nuk mund të zëvendësohet; (2) Një kopje e mikrofilmit mund të blihet prej UMI, e cila po ashtu e boton edhe indeksin. Në të vërtetë, shumica e bibliotekarëve i marrin këto kopje nga rrjeti i bibliotekave, siç është OCLC.

Si mund ta gjeni një tezë? Kërkimi i formës së shtypur bëhet shumë më shpejtë Online. Janë disa elementë që duhet të përfshihen këtu, mirëpo për të mos e komplikuar shumë ju shënoni subjektin, si p.sh shiko për fjalë të rëndësishme në titull dhe/ose në abstrakt. Shumë mënyra të tjera të kërkimit janë në përdorim, por janë shumë të komplikuara për shumë arsye.

Nëse dikush dëshiron ta printojë, vendi i parë ku duhet të shikohet është Comprehensive Dissertation Index. Ky indeks është i ndarë në disa kategori si shkenca, shkenca sociale dhe humanitete dhe çdo njëra nga fusha të zgjeruara ka nënfushat e veta, si p.sh shkencat biologjike, kimia. Duke e vendosur vëllimin e atij materiali, që është mjaft e mundur të përfshijë temën përkatëse deri te titulli, e më pastaj duke i klasifikuar tezat për nga titulli i tyre i plotë dhe sipas emrit të autorit. Po ashtu, shënimi është i mundur duke shkruar emrin e autorit. Pra, vëllimi final dhe pjesë

e gjithë këtij kërkimi janë vëllimet indeksore të autorit.

Pas çdo shënimi të ri është citimi te Dissertation Abstracts, ku bibliotekari pastaj kthehet dhe kërkon abstraktin e plotë. Citimi i referohet vëllimit dhe numrit të faqes në Dissertation Abstracts. P.sh., në indeks ju mund të gjeni "përshkrimi i rolit të bibliotekës/personeli medial..." emri i autorit, vendi i diplomimit (universiteti), numri i faqeve dhe pastaj: "43.06A, p. 1733. Ky sistem është shumë lehtë të përdoret në atë moment kur e kupton se si funksionon.

Dissertation Abstracts International është e ndarë nga indekset, por është e publikuar nga i njëjti botues. Sikurse indeksi, shfaqet në tri forma.

Derisa indeksi vjetor botohet, botimi mujor i Dissertation Abstracts duhet të shikohet në mënyrë individuale. Secili nga këto tri seksione ka indeksin e vet. Botohet çdo muaj dhe është i aranzhuar sipas një numri të madh të titujve dhe sipas temave në fushat e caktuara e deri te indeksi. Çdo shënim përfshin abstraktin e plotë.

Për arsye se ka shumë vëllime dhe forma të ndryshme të kërkimit në shtyp, është shumë më lehtë të përdoret versioni elektronik. Po ashtu, këto vëllime zënë një hapësirë mjaft të madhe. Ka shumë pak arsye pse duhet mbajtur formati i shtypit.

Arti

Online: Art Abstracts. New York: H.W. Wilson Company, 1984 e deri më sot, e përmuajshme, www.hwwilson.com. $2.495.

CD: 1984 e deri më sot. $2.495.

Shtypi: Art Index, 1929 e deri më sot, shërbim mujor.

Art Abstracts indekson diku më shumë se 400 periodikë brenda SHBA-ve dhe jashtë. Buletinët muzeore, librat e përvitshëm, analizat dhe materiale të tjera të vlefshme janë të përfshira në të. Abstraktet janë të përfshira në indekse, që nga viti 1994. Një nga ciceronët më të hershëm të revistave të artit, Art Index, filloi më 1929. Kompania Wilson, që është lider absolut në indeksimin e dokumenteve, ka përfshirë në versionin digjital të gjithë indekset nga fusha e artit. E quajtur Art Index Retrospective me CD-ROM që përfshin gjithë periudhën e indeksimit, që nga viti i largët 1929 e deri më 1984 kur edhe kishte hyrë në sistem CD-ROM i quajtur Art Abstracts[6].

[6] Për një shpjegim të shkurtë të programit retrospektiv shiko: Carol Tenopir, "Recaptirng the Past Online," Library Journal, 1 shkurt, 1999, f. 41-42.

Për më shumë informata në punët e artit, shfleto dhe lexo: (1) RILA (Repertoire International de la Litterature de l'Art). Ky shërbim është publikuar nga Instituti Clark i Artit, në qytetin amerikan Williamstown, MA. Ky shërbim ofrohet Online sikurse Art Literature International (DIALOG fajli 191) dhe përfshin periudhën e njëjtë sikurse versioni i shtypur, pra që nga viti 1973 e deri më tani. Për më shumë, ky shërbim ripërtërihet me informata çdo çerek viti. Disa mijëra periodikë, libra, raporte, buletinë muzeorë, e kështu me radhë, janë të përfshira në botimet e përvitshme të saj. Ky indeks përshin disiplinat e artit në Evropë prej shekullit IV e deri në ditët e sotme.

ART bibliographies Modern (Santa Barbara, Kaliforni: ABC-CLIO, 1993 e deri më sot, e përvitshme, www.abc-clio.com). Për dallim nga dy indekset e cekura më lart, ky indeks më shumë merret me indekset e artit nga shekulli XX dhe XXI. I inkason diku 350 periodikë e po ashtu edhe shumë libra të tjerë të zgjedhur, teza, katalogë të muzeve etj. Në të njëjtën kohë, po ashtu do të indeksojë edhe artikujt abstraktë që trajtojnë periudhat e mëhershme, që dosido kanë lidhje me shekujt e tanishëm. (Indekset e Fotografisë është e mbuluar që nga fillet e saj të para, pra viti 1839 e deri më sot).

Duhet të ceket fakti se nën disiplinën "art" janë të përfshira të gjitha indekset prej shumë fushave, duke filluar nga piktura e skulptura, fotografia, arkitektura, e disenji i brendshëm. Po ashtu, aspektet shkencore, sociale dhe politike të botës mund të gjenden këtu, natyrisht kur arti është temë qendrore.

Biznesi

Online: ABI/Inform, Ann Arbor, MI: Bell & Howell Inforamtion and Learning/ UMI, 1971 e deri më sot, e përjavshme, www.umi.com. DIALOG fajli 15. $132 për orë.

CD: ABI/ Inform, 1992 e deri më sot, e përmuajshme, $4950.

Online: General Business File ASAP, Farmington Hills, MA; Gale Group, 1989 e deri e deri më sot, e përmuajshme, www.galegroup.com
CD:General Business File ASAP, 1989 e deri më sot, e përmuajshme qe katër vjet me radhë. $4.000.

Online: PROMT, Farmington Hills, MA: Gale Group, 1970 e deri më sot, e përditshme, www.galegroup.com. DIALOG file 16. $126 për orë.
CD: Predicasts F&S Index Plus Text. 1991 e deri më sot, e përmuajshme. $6.000
(Vetëm në SHBA: $2.500: Vetëm jashtë SHBA-ve, $3.500).

Shtypi: Predicasts F&S Index United States, 1960 e deri më sot, e përmuajshme. $850; International- e tanishme botohet çdo muaj.

Online: Business Source Elite, Ipswich, MA: EBSCO, 1998 e deri më sot, e përjavshme, www.epnet.com. Çmimi ndryshon.
CD: Business Sources. 1998 e deri më sot, e përmuajshme.

Dow Jones & Company, Princeton, NJ, SHBA: Factiva (apo Dow Jones Retuters
Business Interaction) prej 1990 e deri më sot, e përditshme, www.factiva.com. Çmimi ndryshon.

Online: New York; H.W.Wilson Company, Business Abstracts, Full Text, 1995 e deri më sot, e përmuajshme, www.hwwilson.com. $2,995. Po ashtu, OCLC.

CD: Business Abstracts, 1990 e deri më sot, e përmuajshme. $ 2.495.
Shtypi: Business Periodicals Index, 1958 e deri më sot, shërbim mujor.

Interesi në biznes është duke u rritur, si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, po ashtu edhe në anët e tjera të botës. Gati çdo njeri është i njoftuar me baticat dhe zbaticat ekonomike dhe me të ardhmet politike. Radio, televizioni, Interneti dhe fjalët e rëndomta, duke pirë kafe ose një gotë qumësht, në të shumtën e rasteve kanë të bëjnë me biznesin. Nga kjo rrjedh se kjo fushë, pra fusha e biznesit, është goxha e specializuar për nga shërbimet e referencave. Shumë biblioteka të mesme dhe të mëdha kanë seksione të veçanta vetëm për biznes, ekonomi dhe fushave të tjera të ngjashme. Kështu, një bibliotekar i referencave që dëshiron të jetë i specializuar në këtë fushë duhet t'i mësojë referencat e specializuara të të dhënave. Pra, është e mundur që të sugjerohen vetëm ato të dhëna të referencave që janë fundamentale për shumicën e bibliotekave.

Është e rëndësisë së madhe të ceket se indekset e biznesit mund të kra-

hasohen dhe të merren sugjerime edhe nga fushat e tjera, si psikologjia, arti e shkenca. Në fakt, për shkak të natyrës së ndryshme të temave, një indeks tipik i biznesit është jashtëzakonisht i mirë si e dhënë e dytë.

Lajmet më aktuale nga biznesi janë të gatshme në Online për shkakun se mund të merren vetëm brenda disa sekondave. Dhe, shumica e shërbimeve të tjera, që janë gati falas, mund të gjenden edhe në Internet. Pra, ato janë shumë afër personit të rëndomtë të ditëve të sotshme, në krahasim me vitet e mëparshme.

Janë shumë ciceronë për të dhënat biznesore, duke përfshirë disa pjesë nga Guide to References Books, American Reference Books Annual, e kështu me radhë.

Një nga ciceronët më të mirë dhe që në të shumtën e rasteve është i pajisur me informata të reja, çdo ditë, quhet International Business Information (Fenix, SHBA, AZ; Shtypshkronja Oryx, 1998, f. 445) Ky ciceron, i cili është mjaft mirë i përgatitur e që ka të bëjë me informatat për referencat biznesore, është shumë e mundshme që t'i ndihmojë edhe ekspertët e lëmive të caktuar dhe atyre njerëzve që kërkojnë informata të përgjithshme. Ky ciceron përmbledh një mori të madhe të web-sajteve, të dhënave elektronike dhe të shtypit. Po ashtu, ai përfshin edhe shënime përshkruese dhe komente të mira në atë se si të dhënat duhet të përdoren në biznesin ndërkombëtar. Keni parasysh se në kohët e sotshme, "ndërkombëtare" është fjalë tjetër për të përshkruar interesin e zgjeruar amerikan.

Bell- Howell: ABI/ Inform[7]

Ky indeks biznesi është gati nga më të preferuarit nga ana e bibliotekarëve. ABI/ Informed ka fituar reputacion të madh për shkak se ka indekse superiore nga tekstet më të rëndësishme, të plota dhe abstraktet përshkruese më të mira, të shkruara, për të gjithë artikujt më të madhenj të indeksuar. Për më shumë, përfshirja është më se superiore: diku më shumë se 2 000 nga ditarët më të rëndësishëm biznesor, revistat, gazetat, dhe buletinët informative. Këto janë marrë më shumë nga SHBA, mirëpo ka edhe indekse nga skena ndërkombëtare. Në të vërtetë, botuesi thotë se 350 titujt të gjuhës angleze që vijnë nga jashtë, pra nga SHBA, janë të

[7] Sikurse edhe u tha më parë, deri më 1999 kjo është quajtur UMI. Mirëpo, pas këtij viti, kompanisë iu tha emri Bell-Howell, Information and Learning (Informacion dhe Mësim)

indeksuar.

Versioni Online çdo ditë përtërihet me informata dhe është teksti i plotë që mund të gjendet këtu. Teksti i plotë vjen në dy formate. E para, ju keni një zgjedhje fotografike të plotë të faqeve. Dhe, e dyta, është teksti i plotë plus vizatimet, kur e para është e ngadalshme në shkarkim. Janë diku rreth 700 tituj të teksteve të plota prej titujve të indeksuar.

IAC General Business File

IAC's General Business File ASAP i indekson diku rreth 1 000 periodikë biznesorë Online me gati 460 tekste të plota. Botuesi i saj thotë se: "110.000 tekste të plota të radhitura sipas kompanive, 50.000 tekste të plota të raporteve nga investimet dhe qindra mijëra tekste të plota PR nga Rrjeti i Lajmeve," janë të përfshira këtu. Kjo do të thotë se indeksi nuk është një vend i mirë vetëm për të parë se çka mund të gjendet në revista, mirëpo, po ashtu, edhe për informata të drejtorive. Ky shërbim sikurse edhe gjithë indekset Online nga biznesi, me disa përjashtime, përfshin indeksime njëvjetore nga seksione të ndryshme të biznesit si The New York Times dhe The Wall Street Journal, e edhe botimi çdo gjashtë mujor i gazetës se përjavshme The Asian Wall Street Journal.[8]

Sikurse edhe me të gjithë indekset IAC, mbulimi është katër vjeçar, tri vitet e mëparshme plus viti aktual. Çdo muaj i ri nënkupton se do të hiqet një muaj prej katër viteve të mëparshme. Predicasts (Predikuesit) është një koleksion me disa qendra të të dhënave, ku secila prej tyre shërben për një qëllim të caktuar. PROMPT është version Online në Internet i Predicats. Këto shërbime të shumta i indeksojnë më se 3 000 ditore dhe artikuj të tregtisë, në SHBA dhe jashtë, periodikë biznesorë, dokumente qeveritare, raporte, publikime statistikore, letra bankare, predikime të ndryshme dhe shumë materiale të tjera. Edhe pse biznesi është si fokus kryesor, ky subjekt i përfshin miliona materiale në arkiva, duke filluar nga bujqësia te edukimi dhe shkencat sociale. Të dhënat e informatave mund të kërkohen duke përdorur fjalorë dhe enciklopedi të ndryshme për produkte, organizata, ngjarje dhe lokacione gjeografike. Disa nga fajlat përdoren për llogaritje dhe korrigjime; pra, është e mundur të bëhen llogaritje algjebrike, statistikore dhe predikime të rastit, dhe po ashtu të futen të dhëna në të. Që të dy këto opsione janë të mundshme dhe kërkime në Internet

[8] Në këtë shërbim, sikurse edhe në shërbimet e tjera, numri dhe lloji i gazetave rritet/do të rritet prej vitit në vit.

është falas, mirëpo shumica e këtyre fajlave përdorin Sistemin e Klasifikimit Standard Industrial (SIC). Ky është një sistem hierarkik i numrave që është themeluar nga Qeveria e Shteteve te Bashkuara të Amerikës, në mënyrë që ta klasifikojë ekonominë totale në disa segmente industriale. Duke përdorur numra specifikë, ju mund të gjeni një ”gjilpërë” në miliona materiale e shënime.

EBSCO Business Source Elite i indekson diku rreth 1 500 periodikë të famshëm nga biznesi (përshirë financat, industrinë, industrinë, bankat, etj., në gjithë botën). Prej tyre, 800 janë me tekst të plotë. Është një përzgjedhje e indekseve të 50 gazetave të biznesit, duke përshirë The Wall Street Journal.

Dow Jones

Dow Jones Company, sikurse tregon edhe emri i botuesit, në rend të parë është i involvuar me informacionet e përditshme për tregjet financiare nga e gjithë bota. Më 1999, Dow Jones Interactive u bashkua me English Reuters Business Briefing për ta themeluar FACTIVA-në. Parimisht, një shërbim për profesionistë nga biznesi dhe bibliotekarë me eksperiencë në referenca; nuk është i dedikuar për njerëz të thjeshtë (joprofesionistë). Të dhëna të reja përshijnë: diku më shumë se 7 000 të dhëna nga biznesi; arkivat e Dow Jones dhe të Agjencisë së Lajmeve Reuters; arkivat e The Wall Street Journal; dhe ofron shërbime në 11 gjuhë të ndryshme. Çmimi ndryshon, mirëpo është i bazuar në ratën e abonimit.

Sikurse edhe shumë Online shitës të tjerë, Dow Jones prodhon dhe i fut në rrjet shërbimet e veta financiare. Të gjitha bazat e të dhënave, apo arkivat, janë të gatshme vetëm përmes sistemit të kompanisë për shitësin e saj. Quhet Dow Jones Interactive, që filloi të ofrohet në Internet diku nga viti 1999. Qasja përfundimtare nuk ofrohet më- një kompani e lojërave të fatit është e gatshme të marrë në dorë këtë sistem dhe ta bëjë më lehtë të përdorshëm dhe të kuptueshëm për shfrytëzuesit e shumtë. Për shembull, Dow Jones News raporton lajmet më të reja lidhur me biznesin dhe financat. Më 1998, Dow Jones Interactive u bashkua me Bell-Howell, duke e zgjeruar kështu Dow Jones News (kërkimin e lajmeve) dhe përshiu shumë informata të rëndësishme prej të dhënave të Bell-Howell, sikurse ABI/ Inform. Teksti i plotë i shumicës së materialit mund të gjendet Online.

Dow Jones ofron një web-sajt pa pagesë për shfrytëzuesit nga biznesi

dhe në veçanti, për ata që bëjnë shkëmbime ditore në tregun Online: (www.Dowjones.com).

I hapur më 1999, ky web-sajt i përfshin web-sajtet e tjera shumë të njohura nga financat, siç janë shkëmbimet në bursë dhe shërbimet e citimeve. Më shumë se 2 000 web-sajte nga biznesi janë të lidhura me këtë sistem. Po ashtu, ata ofrojnë edhe lajmet më të reja nga rrjeti i tyre i lajmeve dhe shumë shërbime të tjera, që ju hyn në punë jo vetëm njerëzve profesionistë në biblioteka, mirëpo edhe atyre të thjeshtë. (Sa gjatë do të vazhdojë ky shërbim "pa pagesë" varet nga fakti se sa marketingu dhe reklamat do ta mbështesin atë).

Web-sajte të tjera, të njëjta, për bursa dhe shkëmbimet ditore përfshijnë: Quicken, seksioni financiar i Yahoo! Kërkim i informatave; CBS Marketwatch; këto të gjitha mund të shfrytëzohen shumë lehtë Online derisa njerëzit janë duke kërkuar të dhëna të reja për tregjet e ndryshme.

H.W.Wilson Business Abstract

I vetmi printer i biznesit të indeksit është H.W.Wilson periodical index, që kthehet prapa në vitin 1958. Që versionet digjitale mbulohen në 400 periudha të biznesit në gjuhën angleze. Abstrakti i biznesit të Uilsonit Online dhe në CD-ROM është i njëjti kapacitet, po fillon bashkë me indekset në 1982 bashkë me abstraktet prej 1990. Në Online dhe CD-ROM bizneset abstrakte, si dhe tekstet e plota përveç the Wall Street Journal dhe seksionet e biznesit të New York Times ."Teksti i plotë" në Online i bie që 400 indekse periodike disa 158 janë në tekste të plota prapa te 1995.

Aty ka shënime të tjera biznesi dhe indekse të ngjashme, p.sh., shiko në revistat për dhe/ose ''ulrichinternational periodical directory" për titujt. Për shembull, 'bell-howell's business dateline' mbulon afër 500 burime të biznesit (prej atyre raportuese deri te të përkohshmeve) dhe kthehet deri në vitin 1985 dhe është në Online bashkë me të përditshme e javore. Shërbimi i përditshëm nga RDS dhe përgjegjësia e bazës së shërbimeve është i preokupuar bashkë me aktivitetet e kompanisë dhe të industrisë, të përfaqësuara në revistat themelore, në lajme dokumentare, biznese të përgjithshëm shtypi dhe gazeta ndërkombëtare. Ky është biznes dhe industri. Të dy shërbimet janë të disponueshme prej numrave të shitjeve, përveç OCLC.

NË WEB

Në kuptimin e fjalës atje janë me mijëra faqe të lira të Ueb-it, të cilat u dedikohen bizneseve. Disa janë pa pagesë sepse sponsorët do të kenë diçka të reklamojnë. Disa janë të sigurt. Disa nuk janë. Ku është, që pyetja e këshillave të investimeve përdorimet duhet t'i kontrollojë disa herë. Dhe, në të njëjtën kohë shumë web-sajte janë të sigurta dhe me vlera dhe janë po ashtu falas. I vetmi shembull: bizzed [www.bizzed.com] që është ardhur nga citibank, "dhe ofron shumë web-sajte dhe burimeve speciale dhe interesante të bizneseve të vogla. Atje janë tri deri në katër që përfshijnë artikuj dhe mandej ''lajme për ta rritur biznesin" bashke me veglat për ta forcuar biznesin" dhe rrjeti për t'u udhëhequr. Secila prej kësaj hapësire prej shumë faqeve, si dhe sugjerimet ku dhe si t'i gjeshë informacionet për problemet specifike. Shërbimet janë paguar për nga banka dhe mundimet e dallueshme që kanë për t'i rritur klientët.

Edukimi

Online: eric: U.S educational resources information center: Washington, DC;

ZYRA QEVERITARE E SHTYPIT, 1996 mujorja deri më sot pa pagesë: www.eric.org. DIALOG dosja 1. edhe i lire OCLC dhe të tjera. Çmimi ndryshon.

CD:1966 deri më sot, çereku është 650 dollarë [retrospektivë disku, bashkë me vazhdim

Në Disk:1.200].

Shtypi: 1966 deri më sot, mujorja 56 dollarë.

Shënim: vazhdimi i indekseve të revistave të edukimit, 1969 deri më sot është pjesë e eric above Online edhe në CD-ROM. Version i shtypur: 1969 Deri më sot është çereku. $199 prej shtypit oryx.

Online: edukimi abstrakt, tekst i plotë. New York: H. W. WILSON COMPANY, 1996 deri më sot dy herë në javë, www.hwwilson.com.$2,410.

Print: indeks i edukimit. 1929 e deri më sot, shërbimi mujor.

Më e mira shitje në librari, ERIC është pagesë, me e ulët se në Online. Pse?

Sepse është bazë e të dhënave të Qeverisë dhe nga mesi i vitit 1990 u mor një vendim për ta bërë këtë ritmikë dhe burime të tjera qeveritare, pa pagesë të bibliotekarit dhe për personat që nuk kanë qasje në kompjuterë. Parashikohet e parëndësishme, bile të konsiderojë versionet elektronike të printuara prej marrëveshjeve private, në qoftë se gjithë baza e të dhënave është pa pagesë.[9] Disa biblioteka kanë të dyja - elektronik dhe në shtyp, sepse këta kanë filluar bashkë me këtë sistem dhe preferojnë që ta mbajnë kështu siç është. Ndërsa, studentët dhe mësuesit dhe personat e thjeshtë kanë qasje pa pagesë në biblioteka, qoftë edhe si format. Bonusi është që e njëjta qasje, pa pagesë, është hapur të çdokush i parëndësishëm se ku janë vendosur bashkë me përfitimin e bibliotekës. Por, kapja është që shumë kanë për t'i zënë të hutuar ngase kanë për ta provuar ta përdorin sistemin nëpër shtëpi.

ERIC/IR (qendra e të dhënave informatike të edukimit/bllokimi i shtëpive për të dhënat informatike) mund të konsultohet për të dyja origjinale dhe të dytat e materialit të edukimit, sigurisht në fushat përkatëse prej bibliotekave shkencore të dendura dhe titujt e shkencave sociale. Sistemi përfshin [1] për të cituar raportet e pabotuar [burimet në edukim] dhe artikujt e indeksit [current index to journals in education] të dyja janë përfshirë në vetmin e elementeve në versionin elektronik, bashkë me secilën çështje problematike, si dhe shkëputjeve printerë të indeksit]; [2] si dhe fjalimet e subjektit të vazhdueshëm përfaqësohen shpesh në futje të reja të informatave të zbulimit të enciklopedisë të ERIC; [3] përhapja e sistemit që heq kryesisht prodhimet e materialeve të indekseve të mikrofilmit dhe të dhënat e mikrofilmit nëpër biblioteka; dhe [4] decentralizimi i organizatave strukturë për përvetësimin dhe zhvillimin e dokumenteve të indekseve abstrakte.

Pjesa e parë e ERIC është burimi i edukimit, në të cilin janë listat e raporteve të pabotuara dhe gjërat e lidhura. Secila hyrje ka radhitje abstrakte të 200 fjalive e më shumë. Abstraktet janë të shkruara nga autorët. Raportet janë dorëzuar të ERIC secilin muaj, po më pak se 50 % janë refuzuar më së shumti për mungesën e shtypit të shkathët të kapaciteteve. Selektimet janë bërë të një të 16 të zyrës qendrore. Secili, në të cilat konsiderohen hollësisht subjektet. Ekspertët e vlerësojnë dorëzi-

[9] Departamenti i edukimit net ka katër mbajtje kryesore të hyrjes ne ERIC. Kryesorja është "informacionet e teknologjisë."Këtu data fillon në 1989. Për një hulumtim të plotë përdore"riprodhimin e shërbimeve" dhe datën në të cilën kthehet në 1966.

min e materialit.

Çdo vit gjenden ndërmjet tyre dhe në indekse afro 15 000 gjëra. Raportet janë ndarë ndërmjet tyre në tri kategori njësoj: Hulumtime dhe raporte teknike; veprime, keqtrajtim, para shtypit dhe letra të prezantuara në konferencë; si dhe programe mësimore, edukimi i nxjerrjeve të ligjeve dhe planet e përgatitura për mësimin në klasë.

Pothuajse rrallë janë botuar të dhënat e materialeve të indekseve. Këto mjete përdoren për disa sende: [1] raportet janë burimet e shkëlqyera të mbulesës më të mirë të sipërfaqes së brendshme. Studimet paraqesin një pikëpamje unike, sidomos edhe nganjëherë metodat e hulumtimit të imagjinuar. ERIC është një argument i shkëlqyer për ta zbuluar se çka është në periferi të një subjekti. Dhe, disa subjekte nuk janë gjetur askund; [2] raportet zakonisht janë të mbushura me bibliografi, lexime dhe që t'i hulumtojë më tepër sugjerimet. Këto janë në fillim të shkëlqyera më shumë gjatë raporteve; [3] hulumtimet teknike janë shumë të ngjashme dhe shumë të imagjinuar, saqë shumë prej tyre mund që të përdorin shkrime të ngjashme lidhur me studimet. Në këtë fjalë kjo është një burim i pafund të një ideje origjinale. Po, sigurisht disa janë të pavlefshme. Udhëtimet për peshkim do të shkarkojnë lloje të çuditshme të jashtëzakonshme, në qoftë se jo atëherë gjithmonë balenën.

INDEKSET AKTUALE NË RRUGËN E EDUKIMIT, është një punë e printuar e ndarë, por është një pjesë përbërëse e formave elektronike të indeksuara janë afër 800 periudha të edukimit. Megjithëse është botuar nga firma e reklamave qasjet janë pajisur nga 16 ERIC në zyrën qendrore. CIJE është hulumtuar në të njëjtën mënyrë si burimet e edukimit. Megjithatë, nga të dhënat ato duan vetëm gazeta artikujsh, ose raportet e pabotuara dhe dy qasje mund të kërkohen në Online të ndara në njëshe. Vetëm në qoftë se janë të kërkuara, rezultatet e kërkuara prezantojnë tërë përfshirjen e ERIC.

Megjithëse shkuarja e ERIC paraqet zakonisht sistemet dokumentare, si për shembull krijimin nga kombëtarja aeronautike dhe vendi i administrimit, është përafërsisht 80 % e dokumenteve abstrakte në burimet e edukimit janë të gatshme në mikrofilm. Nga 350 deri në 400 biblioteka, përdorimet e gjejnë kërkimin e citatit në burimet të edukimit dhe tani në vend që të keni laburistin shikoni për gjërat abstrakte dhe koleksionet thjesht kthehen në mikrofilm. Këto gjëra janë vendosur nga ardhja e numrave. Kjo është një sistem total informacionesh dhe, jo normale, dyanësi e bibliografikes së referencës në kërkim të se cilës i gjen abstrak-

tet ose gjërat e indekseve dhe përdoruesit i duhet të provojë që t'i gjejë dokumentet, artikujt ose librat që biblioteka nuk i ka në dispozicion.[10]

Mënyra ideale e informatave totale të sistemit mund të propozohet me gjërat ndihmëse të ERIC indekset aktuale të gazetave në edukim [CIJE], duke përfshirë edhe mikrofilmat. Nuk është pse këtu indekset dhe abstraktet janë për artikuj gazetash. Çmimi për ta bartur secilin artikull në kartelën e mikrofilmit, pa përmendur problemet e kopjimeve me botues, e bën çmimin të ndalet në sistemin total të informatave për një kohë. Në të njëjtën kohë, botimi shtetëror, "të cilët printojnë artikujt ndërmjet tyre janë afër 65 % e gazetave, artikujsh në CIA janë në dispozicion në universitetin e mikrofilmit". Duhet ta dini që ribotimi është në dispozicion, sepse "ribotimi: UMI" është shpallur pas secilit citat ku edhe shërbimi është në dispozicion. Mënyra për t'i porositur këto informacione është dhënë në secilën faqe të botimit.

Raportet janë të identifikuara nga "ed" dhe artikuj gazetash nga "ej" në Online, edhe shtypjet e citateve janë të ndara nga "burimet ditore" ose "si ta sigurojmë këtë doc" për dokumentet. Më vonë, në qoftë se nuk është në dispozicion në një bibliotekë të madhe, mund të porositet me një çmim jo aq të shtrenjtë prej ERIC, si "mikrofilm, print, fax, ose kopjime elektronike-gjithashtu nga telefoni ose në Online".

Pyete ERIC [http://askeric.org] është version i ERIC botuar te mësuesit asistues. Libraria virtuale ka një numër të planeve të mësimit të faqeve të afërta të terreneve. Disa nga planet kanë qenë të dërguar nga mësuesit punësues dhe janë ndarë në subjekte të plota bashkë me reparte, në ngritje të klasave dhe krahasimi. Paraqitja e suplementit është shërbimi "pyetja dhe përgjigjet" pyetja mund të dërgohet të ekspertët, të cilët e kthejnë përgjigjen jo më shumë se 48 orë përmes e-mailit.[11] Edhe faqja, gjithashtu ka tarifë të rregulltë të ERIC për raporte dhe artikuj gazetash.

---

[10] Projekti i pilotit që është lëshuar në vitet e vona 1990, do t'i sjellë këto raporte në Online pa pagesë-pa së paku të librarit. DEPOSITA FEDERALE E PROGRAMIT TË LIBRARISË dhe projekti pilot të bibliotekës digjitale te ERIC"do të japë pjesëmarrësve informata për ta menaxhuar një kërkesë të lartë koleksionesh të teksteve të plota dokumentesh në një ambient elektronik. "Sistemet në magazinë janë që janë mbajtur nga OCLC në të cilën i mban raportet në dispozicion gjatë hulumtimit të parë.

[11] Ka disa burime ritmike të planit për mësim dhe materiale të afërta për fillestarë dhe mësues asistues të shkollës në Internet. Shiko, për shembull enciklopedia kryesore Encarta/online. Por, më së miri megjithëse është vetëm shembull: kanali i historisë [www.historychannel.com]; QENRA VIRTUALE E GJUHËS ANGLEZE [www.comenious.com]; QENDRA E GJEOMETRISË [www.geom.umn.edu]; POZITA E LËSHIMIT TË EDUKIMIT TË MUZIKËS [www.talentz.com].

ABSTRAKTET E EDUKIMIT

Konkurrenca në H.W.Wilson KOMPANIA e edukimit të abstraktëve merret vesh lehtë për varfërinë e dytë të fuqisë së kombinuara të ERIC me 800 tituj të analizuara që janë të krahasuar me vetëm 580 [duke përfshirë monografët dhe librat e viteve] në edukimin e abstrakteve. [Tekstet e plota janë në dispozicion me përafërsisht 200 indekse artikujsh].

Faktikisht indekset dhe shërbimet abstrakte kanë dy herë më shumë numra të analizave të artikujve, që është gjetur në CIJE. Më vonë duhet mbuluar më shumë tituj. Por, hapja e Wilsonit ka gati dyfish numra për citime. Për ta dhënë atë është absolutisht e nevojshme në çdo bibliotekë dhe kurrsesi nuk është e zëvendësuar nga CIJE. Në fakt, disa nga indekset duhen të përdoren së bashku.

Abstraktet e Wilsonit janë prej vitit 1994 dhe indekset fillojnë në 1983 me tekste të plota më shumë se gjysma e titujve, që ishin në 1996. Gjithashtu, edhe versioni printer sepse [edukimi i indekseve] ka qenë në dispozicion qysh nga 1929 kishte qenë gati institut i disa bibliotekave.

Janë edhe disa indekse të rrugës së edukimit. Këto vazhdojnë të rriten dhe të zhvillohen. Për shembull, Bell-Howell ka Online ndërprerja kolektive të edukimit profesional. E gatshme që nga viti 1999, këto indekse janë 250 edukime profesionale dhe gazeta media të bibliotekave. Dëgjuesit: ”krahina e shkollës shikon përveç një mjet efektiv për të mbështetur një shtyllë të ndërmarrjes së nevojshme.”

Historia[12]

Online: Amerika : Historia dhe Jeta # Përmbledhjet Historike. Santa Barbara, Kaliforni:

Qendra Bibliografike amerikane Clio Press, 1964 me kohën, *Abstraktet*, 1955 deri më sot, www.abc-clio.com. $6.800 + / tre për vit.

CD: 1964 për datë, tre për vit $ 5.500+.

Shtypur: 1964 për datë, pesë për vit. Tarifa ndryshon

[12] Cheryl LaGuardia dhe Christie oka, "Accesing History," Library Journal (Lidhja me Internet ofrohet si shtesë), Vjeshtë, 2000, f. 14-19. Shiko këtë artikull të mrekullueshëm përshkrues dhe vlerësues për një pasqyrim dhe analizë të plotë mbi indekset kryesore historike, duke përfshirë edhe të gjitha ato të listuara këtu.

Online: Përmbledhjet Historike. Santa Barbara, Kaliforni:
Qendra Bibliografike Amerikane Clio Press, të datës 1967, mujore, http://abc-clio.com. $6.800+.
CD: të datës 1982, mujore. $5.500+.
Shtypur: deri më sot

Çfarëdo pyetjeje historike, qoftë për Amerikën Veriore ose për botën, mund t'i gjendet përgjigje, duke përdorur dy indekset e lëshuara nga Qendra Bibliografike Amerikane.

Amerika: Historia dhe Jeta # Abstrakte Historike mbulon Shtetet e Bashkuara dhe Kanadanë, që nga parahistoria e deri më sot. Rreth 2 000 shënime historike apo të ngjashme nga e tërë bota janë të indeksuara dhe abstraktuara. Jo vetëm përgjigje nga historia, por edhe nga sociologjia, religjioni, shkenca politike dhe studime ndërdisiplinore mund të gjenden këtu. Versioni digjital është i preferuar.

Edicioni i shtypur përmban tri seksione, me një indeks vjetor. Materiali është i mbledhur ndër tema të gjëra të interesit dhe pavarësisht nga subjekti dhe autori, indeksi i secilës çështjeje është paksa kompleks për t'u përdorur. Indeksi nuk përmban vetëm citime artikujsh, por gjithashtu shqyrtime librash dhe disertacione. Edicioni i pestë është një përmbledhje vjetore.

Abstrakte Historike është "referenca e juaj komplete ndaj historisë së botës," së paku kështu mendon botuesi. Është e vërtetë mirëpo, me një rezervë të madhe- historia sipas këtij indeksi fillon në vitin 1450. Katër mijë e diçka vjet më parë nuk janë të përfshira dhe për këtë nevojiten indekse të specializuara, jo vetëm në histori, por edhe për klasiken. (Për këto shërbime indeksesh shiko *Udhëzues për Libra Reference*). Përmbledhjet janë në anglisht. Veç kësaj, aty ka shqyrtime librash, disertacione, raporte etj.

Një kërkim elektronik i përfshin të gjitha metodat e zakonshme, duke filluar nga fjalët kyçe dhe autorët deri te logjika Booleane. Versioni i shtypur, si dhe titulli amerikan, është i përfshirë në pjesë të ndara të indekseve vjetore. (Dy Seksionet: Pjesa A: *Historia Moderne 1450 deri 1914;* dhe pjesa B: *Shekulli i njëzetë nga viti 1914 e gjer më sot.* Për ta kursyer kohën përdorni versioni digjital.

Botuesi i këtyre indekseve, i njohur i ABC-Clio, disponon një numër të konsiderueshëm të bibliografive dhe indekseve të tjera, si dhe punime

themelore referencash. Për një listë komplete, si dhe informacione të detajuara rreth temave historike të lartpërmendura shiko web-sajtin [www.abc-cio.com].

Burimet e ndërlidhura: Qendra e Burimeve Historike [shiko në kapitullin e enciklopedisë]; *Gazeta Online Historike*, një indeks për "*The Time*" nga Londra dhe "*The New York Times*" që nga botimi i parë deri më 1980 te (www.historynews.chadwyck.com).

Ligji

Online: LEXIS. New Providence, NJ:Reed-Elsevier. www.lexis-nexis.com/lncc.Kosto: ndryshon sipas skedarit[13].

*Online:*WSTLAW. Eagan, MN: West Publishing Corporatio. www.westlaw.com. Kosto: Ndryshon sipas skedarit.

*Online: Index to Legal Periodicals & Books. New York:*H. W. Wilson Company, dy herë në javë, 1981 deri më sot, www.hwwilon.com. $1.495.

CD: 1981 deri më sot, mujore. $1.495.

Shtypur:1955 deri më sot, mujore. $295.

Online: LegalTrac. Fargminton Hills, MI: Gale Group, 1980 e deri më sot, mujore, www.gale.com. Tarifa ndryshon. Gjithashtu: Skedar DIALOGUES 150. $130 për orë, plus bartje të tjera.

CD: 1980 deri më sot, mujore. $5.000 (çmimi përfshin edhe harduerin).

Shumë çështje ligjore mund të zgjidhen, duke përdorur në veçanti ligjet federale dhe shtetërore, apo kode qytetesh. Mirëpo, kjo kërkon kërkim të avancuar special. Në këtë aspekt, LEXIS dhe WESTLAW janë mjaft të dobishëm. Në mes gjenden mjaft çështje ligjore të përgjithshme, të cilat mund të shtrihen duke përdorur PAIS ose vetëm *Udhëzuesin e lexuesve* apo *Indeksi i revistave.*

[13] Për diskutim të LEXIS-NEXIS (indeks i ligjit i kombinuar me indekset më të përgjithshme) shiko Kapitulllin 5.

Dy indekset kryesore ligjore janë në dispozicion vetëm në Internet. Ata janë LEXIS dhe WESTLAW. Të dy janë të ndërtuar mbi baza të të dhënave të veçanta dhe të ndara siç janë *Westlaw Admiralty Database* dhe *Westlaw Tax Base.* Në mes ndodhen dhjetëra baza të dhënash. E njëjta gjë vlen edhe për LEXIS. Të dy përmbajnë pjesë individuale që janë në dispozicion edhe të shtypura. Për shembull, LEXIS përfshin H.W. Wilson Company's *Indeksi i Botimeve Periodike Ligjore*. Shërbimet zakonisht janë të kufizuara në biblioteka ligjesh të mëdha dhe të mesme deri te firma të mëdha ligjore.

Të dy shërbimet furnizohen nga botuesi dhe jo përmes palës shitëse. Ata kanë çmime komplekse varësisht nga shfrytëzimi dhe përdorimi[14].

LEXIS disponon me kopje identike të rasteve në versionin e shtypur. Për shembull, opinionet e gjykatave federale dhe shtetërore, statutet e Kodit të Shteteve të Bashkuara, apo vendimet e Gjykatës Supreme. Datat e rasteve të mbuluara nga LEXIS ndryshojnë, derisa i tërë skedari vazhdimisht pasurohet. Rregullimi është bërë 'sipas bibliotekës': kështu pra *Biblioteka Publike e Nju Jorkut* do të ketë *Raportet e Nju Jorkut* dhe ndër të tjera edhe *Ligjet e konsoliduara*. Biblioteka Federale e taksave do të ketë *Kodin Interno të ardhurave vjetore,* si dhe çështje të tjera mbi taksat. Kërkimet ndjekin një strukturë normale dhe komplet teksti mund të kërkohet si i tillë, që nuk është vetëm sipas titullit dhe autorit, por edhe sipas fjalëve që gjenden në materialet ligjore. Terminologjia e kërkuar duhet të përkufizohet, ose në të kundërtën përfundimi është qindra citime nga të dhëna jo relevante. Një tjetër vështirësi me kërkimet me tekst të plotë është se më parë regjistruesit nuk ishin të kujdesshëm në shqiptimin e emrave, prandaj shpesh kërkimet mund të mos jenë të plota për shkak gabimeve drejtshkrimore.

WESTLAW është e ngjashme me LEXIS-in. Ai, gjithashtu jep të dhëna të ndryshme, komplete rreth ligjeve dhe vendimeve të gjykatave federale etj. Ashtu si LEXIS edhe WESTLAW mbulon lije të ndryshme shtetërore. LEXIS ka një përparësi me metodën Shepard të citimit dhe gëzon një prestigj ndër avokatë. West përdor KeyCite, prodhuar nga kompjuterët për dallim nga Shepard që është ndërtuar nga njerëzit.

Të dy shërbimet janë në garë të vazhdueshme me njëri tjetrin. Edhe pse të dy, pak a shumë, përfshijnë të njëjtin material, qëndron një dallim

[14] Te dyja shërbimet janë të njohura si 'vlerësim transaksional'. Shuma rritet nga çdo ligjëratë, çdo shkarkim (download), në të vërtetë nga çdo klikim virtual që shfrytëzuesi ndërmerr. Atje janë të vendosura çmimet mujore për çdo rast.

në mes programeve të tyre. Disa mendojnë se WESTLAW është i lehtë për t'u përdorur; disa mendojë të njëjtën gjë për LEXIS. Sidoqoftë ekziston një dallim i vogël në llojet e materialeve që përdoren për t'i pasuruar apo freskuar skedarët, që mund ta bëjnë njërin shërbim më të përshtatshëm se tjetrin në situata të caktuara.

Kryesisht është çështje e (1) përcaktimit se cili shërbim është më i volitshëm dhe (2) vendosja e çmimit.

Gjatë mesit të vitit 2000 të dy kompanitë ishin përfshirë në luftë çmimesh. Gjersa të dy kompanitë vazhdojnë t'u ofrojnë qasje falas studentëve të juridikut, në baza të dhënash shumë të shtrenjta, ato kanë fillu-ar t'u qasen bibliotekave. Studentët nuk do të marrin më disketa falas. Në vend të tyre ata do të duhet të inkuadrohen në web-sajtet, ku të dy kompanitë ofrojnë informacion falas. Instruksioni është i mundshëm përmes bibliotekës.

Për personat joprofesionistë

Duke marrë parasysh më pak burime teknike, ekzistojnë dy indekse të materialit ligjor në shumë biblioteka publike dhe akademike.

Regjistrimet e *LegalTrac*-it shkojnë prapa në vitin 1980 dhe përfshijnë, indekse për 800 publikime ligjore të nxjerra nga rishqyrtime ligjesh dhe gazeta asociacionesh të ndryshme avokatësh. Kanë një përfshirje ndërkombëtare dhe ofrojnë përafërsisht 9 përgjigje në dhjetë pyetje rreth ligjeve.

Indeksi i Wilson-it i njohur si *Index to Legal Periodicals & Books* përfshin vetëm 940 protokolle dhe publikime ligjore. Ka subjekt standard dhe indekse autorësh. Megjithatë, për çdo rast ligjor shtohet nga një indeks, dhe shumica e shënimeve të rasteve gjenden në fund të titujve të temës. Gjersa një sasi e madhe e materialit është veçse teknik, një bibliotekar i kujdesshëm do të gjente material, që është mjaft i përshtatshëm për informim të personave laikë. Mund të konsiderohet si një ndihmë e konsiderueshme në çdo fushë, që ka lidhje me vendime juridike.

Biblioteka

Online: Library Literature Information Science Full Text. New York: H.W. Wilson Company, 1984 deri më sot, dyjavor, www.hwwilson.com $1.095.

CD: 1984 deri më sot, $1.095. në tre muaj.
Print: 1936 deri më sot, shërbim dymujor. (shënim: Kompilimi përfshinë 77 protokolle (zhurnalë) nga 1921 deri më 1936).

Online: Information Science Abstarct.Medford, NJ: Information Today, nga 1966 deri më sot, mujore. DIALOG file 202. $132 për orë.
CD: 1966 deri më sot,. $1.095 në tre muaj.
Print: 1966 deri më sot, $515 në muaj.

Online: Library and Information Science Abstracts (LISA). East Grinstead, England: Bowker-Saur, 1969 deri më sot, mujore. DIALOG file 61. $66 për orë.
*CD:*1963 deri më sot. Mujore. Çmimi dallon.
*Print:*1969 deri më sot. $ 500 në muaj.

Library Literature &Information Science ofron tema dhe artikuj autorësh që janë shfaqur në 290 biblioteka të orientuara periodikisht. Gati një e treta e dokumenteve ka të bëjë me publikime jashtë SHBA-ve. (Rreth 30 prej tyre nuk janë anglisht). Gjithashtu, janë të përfshira libra, teza shkollore, punime akademike etj. Online versionet e teksteve të plota ofron qasje në 93 zhurnalë të indeksuar- një shërbim që ka filluar në janar të vitit 1998.

Sa i përket indekseve të specializuara të Wilson-it, përmbajtja e librave është analizuar sikur të ishin raporte apo pamflete, që lidhen me shkencën e informacionit. Indeksi i jep shfrytëzuesit një pamje mjaft komplete në fushën e subjektit në fjalë. Biblioteka digjitale *Library Literature* (jo tekst i plotë) përmban të dhëna vetëm nga viti 1984. Shumë vështirë i gjen të dhënat, të cilat në versionin e shtypur arrijnë deri te viti 1921. Sidoqoftë, formati digjital është adekuat kur është fjala për një kërkim të zakonshëm.

Library and Information Science Abstracts (LISA) si një ndihmë shtesë, është rrallëherë e pranishme. Protokollet kryesore janë të indeksuara ashtu si dhe shërbimet abstrakte të raporteve, punimeve dhe monografive të tjera të selektuara. Numri i abstrakteve tani është ngritur në katër mijë për çdo vit. Është një përfshirje e shkëlqyeshme e raporteve të Qeverisë së SHBA-ve, kryesisht për arsye se Shërbimi i Kombëtar Informacionit Teknologjik i SHBA-ve i lejon LISA-s t'i rishtypë përmbledhjet e veta. Në anën tjetër, formati i shtypur *Library Literature* është një version tradicional i renditjes së autorëve në bazë të alfabetit. LISA mbështetet në një

sistem klasifikimi në renditjen e materialit. Sidoqoftë, këto renditje vështirë vërehet kur shërbimi ushtrohet në Internet apo CD-ROM.

Një qasje edhe më e sofistikuar ofrohet në *Information Science Abstract Plus.*

Theksi bie në mbi 450 botime periodike teknike, libra, raporte, diskutime dhe materiale të tilla. Dhe, gati tetë mijë përmbledhje të lëshuara çdo vit, një sasi e pafund e materialeve, që lidhen me aspekte mbi automatizmin, komunikimin, kompjuterët, matematikën, inteligjencën artificiale etj. Është një shërbim, para së gjithash, dedikuar kërkuesve dhe shfrytëzuesve nga shkenca e informatikës. Çdo botim i shtypur ka një indeks autori dhe një tjetër mbi subjektet e parvjetshme.

Literatura

Online: MLA International Bibliograph. New York: Modern Language Association of America, 1963 deri më sot, mujor, www.mla.org. Gjithashtu: OCLC dhe bartës tjerë. Çmimi ndryshon.

*CD:*1963 deri më sot, $1.495 në tre muaj.

Print:1922 deri më sot, $750 në vit.

MLA International Bibliography është indeksi që imagjinon secili kërkues. MLA ofron literaturë virtuale në çdo cep të botës. Si literaturë është e preokupuar me çdo aspekt të jetës së njeriut. Indeksi mund të hyjë në punë jo vetëm për të kërkuar një X material rreth një autori, libri, apo formule teorike. Për shembull, çdokush që kërkon të dhëna mbi historinë e gazetave shkencore mund të gjejë mjaft material, madje edhe burime mjaft specifike mbi shkencat siç është *Shkenca mbi Indeksimin e Citimit.*

Rreth 1.3 milionë citime prej gjashtë mijë botimeve periodike janë në dispozicion. Është mjaft thjesht, vetëm duhet shënuar subjekti apo autori dhe ju do të keni një rreth të plotë ose pjesërisht të plotë të citimeve. Duke kontrolluar "Subjects Covered", që ndodhet në fund të secilit citim, ju mund të keni një mori shtesë të temave dhe autorëve që lidhen më timen që ju keni kërkuar. Një qasje më specifike është nëse përdorni fjalorin, që është krijuar brenda bazës elektronike të të dhënave. Fatkeqësisht, këtij versioni i mungojnë konspektet.

Versionet e shtypura janë një ankth i vërtetë për t'u përdorur. Ato janë të ndara në disa nënvëllime me disa nëntituj shtesë. Organizimi i tyre është aq i komplikuar sa nevojitet një ekspert i një fushe të caktuar i literaturës për ta bërë kërkimin. Fatmirësisht, që nga edicioni i vitit 1981 gjërat kanë

ndryshuar për të mirë. Indeksi i çdo subjekti është shtuar. Kjo përfshin çdo kategori apo disertacion zhurnal (si dhe shumë libra) që është selektuar.
Medicina, Kimia dhe Biologjia

Online: MEDLINE. Bethesda, MD: U.S. National Library of Medicine, 1996 e deri më sot, ditor, www.nlm.nih.gov/medlineplus/medline/. Gjithashtu: Falas në Internet, *PubMed:* www.ncbi.nih.gov/PubMed/overview. html. DIALOG File 152 -155, që nga 1964 deri më sot, ditor. OCLV dhe bartës të tjerë.[15]

CD: 1984 deri më sot, $3.500 në muaj.

Print: Index Medicus, 1960 deri më sot, $250 në muaj. Përmbledhja vjetore $275.

Online: BIOSIS *Previews and Biological Abstracts.* Philadelphia, PA: BIOSIS.

1969 deri më sot, javor. DIALOG files 5 dhe 55. Internet: www.biosis.org/homedeluxe. Çmimi ndryshon. OCLC dhe bartës tjerë.

CD: Biological Abstracts, 1985 deri më sot, $9.700 në tre muaj.

Print: 1926 deri më sot, $3.650 në dy javë.

Online: CA Search. Columbus,OH: Chemical Abstracts Service, 1967 deri më sot.

Dy herë në jave, www.cas.org. CDP Online, $106 në orë. Në dispozicion edhe online përmes shumë shërbimeve tjera. (Shënim: Nuk ka version në CD.[16]

Print: Chemical Abstracts. 1907 deri më sot, $9.200 në javë.

Medicina dhe Shëndeti

MEDLINE është një indeks tjetër qeveritar pa pagesë për cilindo në Internet.[17]

[15] Në këtë publikim falas të Qeverisë janë gjërat mjaft të ngjashme me ato të dhjetëra shitësve të MEDLINE në kompakt disk (CD), Internet si dhe në versionin e shtypur. Versionet e vetë MEDLINE janë të shumta, për shembull MEDLINE/clinical collection, MEDLINE/collection, MEDLINE/professional, MEDLINE/standard etj. Nëse është falas pse atëherë të shkojmë përmes rrjetit bibliografik? Sepse sistemi i kërkimit është shumë më i sofistikuar. Si dhe shumica e rrjeteve ofrojnë minimumin e çmimit për këtë shërbim.

[16] Ekzistojë disa versione retrospektive të CD-ve, (12 koleksione indeksesh që përshijnë vitet 1987 deri 1991, për $16.000 deri $ 25.000.)

[17] Është bërë falas për laikët vetëm në vitin 1997. Web-sajti i MELINE tani vizitohet nga miliona njerëz në ditë.

Siç ishte rasti me indeksin qeveritar ERIC, që diskutuam më herët edhe ky indeks bëhet falas në fund të viteve '90-të. Ideja ishte të përfshihej secili që di ta përdorë këtë shërbim, duke filluar nga personat laikë e deri te mjekët. MEDLINE është një dhuratë e vlefshme për çdo bibliotekë.

Atëherë, çka është MEDLINE në të vërtetë?

Ka filluar në vitin 1960 si *Index Medicus* në versionin e shtypur. Që edhe sot vazhdon të shtypet. Është indeksi mjekësor më i plotë dhe ndoshta më i njohuri në botë. Prodhuar nga Biblioteka Kombëtare e Medicinës dhe shitur përmes Zyrës Qeveritare të Shtypit, prezanton qeverinë në mënyrën më të mirë. Rreth 9 000 botime gazetareske në gjuhën angleze dhe gjuhë të tjera janë të indeksuara më përpikëri. Gjithashtu, është edhe një indeksim mjaft i pasur i raporteve, eseve dhe editorialeve. Botimet mujore të shtypura janë të renditura sipas autorit dhe subjektit. Kjo bashkë me dy baza të tjera të dhënash (Index to Dental Literature and International Nursing) përfshijnë bazën elektronike të dhënave MEDLINE. Baza e të dhënave përmban citime, me konspekte, si dhe artikuj të botuar në SHBA dhe 70 vende të tjera të botës.

Titujt e subjekteve janë të rëndësisë më të madhe në profesionin e medicinës. Ato janë të varura nga një listë speciale: *Medical Subject Headings.* Kjo zakonisht citohet si MeSH.

MEDLINE një ndër katër apo pesë bazat e të dhënave të përdorura më së tepërmi në botë, ofron shfrytëzuesve një llojllojshmëri të madhe opsionesh kërkimi. Më e rëndësishmja, për shkak të subjektit, në kuptim të plotë të fjalës, kjo tenton ta përfshijë tërë botën. Ka një potencial të madh të literaturës jashtë medicinës. Në saje të skedarit prej 10 milionë citimeve, MEDLINE mund të përdoret për të gjetura të dhëna nga fusha e psikologjisë, edukimit, antropologjisë, sociologjisë, teknologjisë, bujqësisë dhe gati në çdo fushë tjetër-duke përfshirë edhe politikën-që në një mënyrë ose një tjetër kanë lidhje me medicinën.

Biblioteka Kombëtare e Medicinës (BKM) mbështet MEDLINE me një procedurë të efektshme huadhënie të artikujve. Rreth dy mijë kërkesa për materiale pranohen çdo ditë. Para se kërkesat të arrijnë në BKM ato filtrohen, duke kaluar nëpër tri burime të mundshme të dhënash. Bibliotekari mund t'i dërgojë kërkesat te një bibliotekë lokale (që është më e madhe apo që përfshin botime gazetareske nga medicina); pastaj te libraria e burimeve, zakonisht në ndonjë shkollë medicine; ose te njëra prej 11 bibliotekave regjionale të medicinës, që përfshijnë dhe mbulojnë regjione gjeografike të definuara mjaft mirë. Dhe, përfundimisht nëse

asnjëra prej tyre nuk ofron të dhëna, atëherë kërkesat përfundojnë në BKM. Me fjalë tjera, BKM-ja shërben si burimi i fundit për kërkesat që nuk gjejnë përgjigje të kënaqshme në tri nivelet e para.

Biblioteka e BKM-së mundë t'i përmbushë rreth 80 deri 85 % të kërkesave që pranon. Kërkesat e papërmbushura dërgohen përmes kompjuterit në Bibliotekën Qiradhënëse të Britanisë, në Boston, Spa të Anglisë. Transferimi bëhet aq shpejt saqë më shpejt merren materialet nga Anglia sesa nga ndonjë pjesë e SHBA-ve apo Kanadasë.

Përveç bibliotekës ekziston edhe një tarifë mbi dërgesat individuale. Kërkimi në Internet nuk mund t'ju kushtojë asgjë, mirëpo për të lexuar artikullin përdoruesi duhet të shkojë në bibliotekë/ose ta porosisë atë në BKM. Kjo do të ndryshojë. Shumica e gazetave shëndetësore së shpejti do të jenë në Internet, me tekst të plotë, por përsëri me pagesë. Për shembull, EBSCO në vitin 1998 ofroi *Comperhensive MEDLINE with Full Text,* që shkon prapa në vitin 1997 dhe lidh citimet e MEDLINE me citimet aktuale korresponduese në më shumë se 60 gazeta kryesore shëndetësore. (Disa gazeta janë në dispozicion në tekst të plotë, që nga viti 1990).

Gjersa shumica e bazave shkencore të të dhënave janë komplekse, së paku për shumicën e laikëve ose bibliotekarëve, MEDLINE ofron një numër të konsiderueshëm të rrugëve të qasjes. Kërkuesi mund të kërkojë sipas fjalëve kyç në konspekte, apo titujve, ose t'i referohet MeSH (Medical Subject Headings) për asistencë. Meqë kjo kërkon pak përvojë, ju mund të kërkoni në MeSH duke përdorur hierarkinë e ndërtuar në formë të pemës. Kjo lejon qasje në fusha specifike interesi. Është edhe një numër i konsiderueshëm i hyrjeve të tjera, duke filluar nga autori, shtetet, ISSN apo numri i gjeneve. Është një dokumentim i shkëlqyeshëm si për versionin elektronik, ashtu edhe për atë të shtypur, të cilët vazhdimisht pasurohen nga BKM-ja.

Internet qasja pa pagesë në MEDLINE quhet *PubMed.* Kjo thjeshtëson qasjen në burime esenciale mbi shëndetësinë, jo vetëm për bibliotekat, por për të gjithë, si në shtëpi apo në zyrë. Përveç kërkimit të thjeshtë apo atij më të avancuar nëpër bazat themelore të të dhënave, sistemi siguron web-sajte të reja të kësaj natyre, të cilat mbajnë të dhënat në vazhdimësi orë pas ore, ditë pas dite[18]

[18] Medline/Plus www.nlm.nih.gov/medilineplus) përshin jo vetëm indeksin, por edhe një hollësi shtesë apo "plus": lajme mbi kërkimin që shfrytëzuesi është duke e bërë. Për shembull dikush kërkon artikujt e fundit mbi "puçrrat" dhe papritmas i paraqitet një mori e lehtë e raporteve, studimeve, projekteve, etj., të cilat janë në progres apo ende nuk janë publikuar. Kjo mund të duket shumë për shumicën, mirëpo është një bekim për ata që kërkojnë një temë në thellësi.

Janë disa variacione dhe linka të ndryshëm të sponsorizuar nga Qeveria e SHBA-ve, të cilat ndihmojnë personat e thjeshtë dhe bibliotekarët. Ndër më të mirat nga to janë: (a) Healthfinder (www.healthfinder.gov). Kjo ofron diku rreth 1 500 linka të web-sajteve mjaft të mira përsa i përket shëndetit. Linkat janë për publikimet e ndryshme dhe grupeve që e ndihmojnë vetveten e po ashtu edhe për web-sajte. Janë të sponsorizuara nga Departamenti i Shëndetit të SHBA-së dhe Shërbimet Njerëzore; (b) National Library of Medicine, sponsor i MEDLINE, po ashtu ofron qasje në bibliotekën e saj nga medicina, e cila bibliotekë përfshin lajme dhe zbulime lidhur me të arriturat më të reja nga fusha e mjekësisë.

Përveç versionit të gjithëpranishëm MEDLINE, kompanitë e indekseve më të përgjithshme më të mëdha ofrojnë një numër më të vogël ose të kufizuar të indekseve mjekësore. Duhet thënë se këtu theks i veçantë iu jepet materialeve për personat e thjeshtë e jo materialeve për doktor ose për profesionistët medicinalë.

EBSCO ka shumicën e bazave të të dhënave mbi medicinën që përfshin bazën e të dhënave "Comprehensive MEDLINE with Full Text" (Tekst të Plotë), e cila ka linka për leximin e artikujve të plotë nga medicina në më shumë se 60 shënime medicinale. Më e përdorshme për personat e thjeshtë është Health Source Plus (1990 e deri më sot, e përditshme). Health Source Plus që ofrohet në versionin Online dhe atë CD-ROM nuk dallon shumë nga botimet e tjera mbi këtë familje të indekseve.[19] The Gale IAC Health Reference Center ka ndarje të tjera. Njëra nga më gjithëpërfshirëset është e ashtuquajtura "Academic", e cila i indekson më se 205 tituj dhe ka rreth 150 artikuj me tekste të plota. Të gjitha shënimet e përgjithshme dhe bazike nga medicina janë të mbuluara në të, p.sh. ata artikuj që janë me interes personal e të thjeshtë. Për më shumë, shënimet themelore mbi fushën e motrave medicinale janë të indeksuara-mirëpo në këtë rast janë më shumë të dedikuara për shkollat e motrave medicinale e jo për njerëzit e thjeshtë. Çka është më interesante dhe për indeksimin e së ardhmes që tashmë ka arritur: për më shumë se indeksimin e revistave, ky shërbim përfshin indekset e limituara të librave të referencës, buletinëve informativë, artikujve gazetareskë (mirëpo jo i tërë

[19] Indekset e lidhura përfshijnë:
Health Source- me më se 300 shënime të indeksuara ku 55 prej tyre janë me tekst të plotë. Ofrohet në versionin online dhe CD-ROM. Përfshin edhe 1 000 indekse të pamfleteve.
Health Start- Kjo është nga Biblioteka Nacionale e Medicinës, e jo nga EBSCO e cila ofron vetëm shërbimin. Pikë së pari, ofrohet për administratorët medicinalë.

artikulli), dhe vepra të tjera të referencës, duke përfshirë edhe rreth 500 pamflete të ndryshme. Shumica e tyre janë me tekst të plotë. Po ashtu, këtu ofrohen edhe linka mjaft të mirë të web-sajteve të kësaj natyre. Duke ndjekur shembullin e IAC, versioni CD-ROM përfshin indekset e tri viteve plus viti në të cilin hidhet në shtije. Po ashtu, ofrohet edhe versioni që përshin indekset e 4 viteve, plus viti i botimit që ofrohet Online.

BIOSIS (Abstraktet biologjike)

BIOSIS dhe Chemical Abstracts të cilat vijnë më pastaj janë shumë të specializuara në shërbimet teknike, të cilat kërkojnë trajnim të barabartë dhe të specializuar për përdorim. Ato mund të gjenden vetëm në bibliotekat e mëdha ose bibliotekat e specializuara mbi një subjekt të veçantë. Bibliotekat e tilla përmenden shumë pak në këtë vëllim jo për shkakun se janë të parëndësishme, mirëpo për shkak të mungesës së hapësirës në këtë libër.

Aspektet e medicinës janë një pjesë shumë e rëndësishme e botimit shumë të njohur Biological Abstracts. Këtu janë përfshirë abstrakte nga më se 5 500 shënime. Ndër to janë të përfshira edhe ato nga bio-medicina e po ashtu edhe nga shkencat biologjike dhe njerëzore.

Si shërbim më i madh i indeksimit dhe abstraktimit, ky version është nga më të njohurit ndër bibliotekat shkencore sikurse Index Medicus and Chemical Abstracts. Zakonisht, që të tria gjenden si një tërësi e vetme në të shumtën e rasteve Online.

Për shkak të natyrës mjaft të gjerë, BIOSIS u përgjigjet mjaft dyshimeve shkencore dhe atyre nga shkenca shoqërore. Indeksi i subjektit përdor fjalë kryesore në kontekst të caktuar. Temat mund të kërkohen, po ashtu duke përdorur koncepte të gjera të subjektit; klasa e gjallesave, dhe emrat e organizmave; kategoritë e mëdha taksonomike; dhe autori. BIOSIS, që hyn në përdorim mjaft shumë, është një shërbim ideal për kërkimin Online.

Kërkimi CA (Abstraktet Kimike)

Kërkimi CA që quhet në Online, ose Chemical Abstracts sikurse titullohet në versionin e shtypur, është njëri nga shërbimet më të mëdha në botë për sa i përket abstrakteve. I abstrakton më se 15 000 të përkohshme

shkencore dhe teknike prej më se 150 vende të botës. Në rrethin e shumë seksioneve në të, një seksion i cili i përkushtohet mënyrave dhe metodave është nga më të përdorurit.

Sikurse edhe në të gjitha shërbimet e shtypura, abstraktet janë të aranzhuara apo të radhitura sipas subjektit, mirëpo këtu rreth 80 seksione me subjekte klasifikohen në pesë grupe të mëdha. Secili botim shtypi përfshin indekset për autorin dhe fjala kryesore i kap frazat prej abstraktit dhe titullit. Po ashtu, botimet kanë në vete edhe "Index Guide" tok së bashku me një numër të madh seksioneve ndihmëse. Sistemi është aq i komplikuar dhe ndahet në shumë pjesë të ndryshme saqë kërkimin e suksesshëm mund ta bëjë vetëm një ekspert i kërkimit me subjekte, i cili është jashtëzakonisht mirë i njohur me literaturën e kimisë dhe fushave të tjera të ndërlidhura me të.

Psikologjia

Online: PscyINFO (Psychological Abstracts). Uashington, DC: Asociacioni i Psikologëve Amerikan, 1967 e deri më sot, e përmuajshme, www.apa.org.

Çmimi ndryshon. DIALOG file 11. Po ashtu e gatshme në: OCLC dhe botimet e tjera.

CD: PsyLit, 1974 e deri më sot, e çdo tre muajshe, $4.495.

E shtypur: Psychological Abstracts, 1927 e deri më sot, e përmuajshme.

$1.350.

Psychological Abstracts është e njohur për shumë njerëz pikë së pari për arsyen se sikurse pak shërbime të tjera të abstraktimit të subjektit (sikurse ERIC), mund të përdoret edhe në shumë fusha të tjera të ngjashme. Për shembull, një seksion i rëndësishëm ka të bëjë me komunikimin që përfshin abstraktet nga gjuha, fjalimet, letërsia, e ndoshta edhe arti. Çdo njëri i involvuar në të, le të themi një inxhinier apo një artist do ta përdorte një burim të tillë të informacionit. Personi më i edukuar, i cili kërkon informata në atë se pse shoku flet vet me vete në gjumë apo pse njerëzit që dinë dhe nuk dinë shkrim-lexim do ta përdorin këtë index.

Shërbimi i analizon mbi 1 400 të përkohshme prej më se 50 vendeve të botës, ani pse 90 % e materialit është në gjuhën angleze. Për më shumë, i analizon përmbajtjet e 400 deri 500 librave çdo vit (prej vitit 1987 e deri më sot).

Janë diku rreth 3 000 abstrakte në çdo botim mujor. Sikurse edhe në shërbimet e tjera të këtij lloji, është një indeks i grumbullua, mirëpo abstraktet si abstrakte nuk janë të grumbulluara apo të përmbledhura.

Psychological Abstracts (Online: PsycINFO) ofrohet prej furnizuesve më të mëdhenj. I përmbledh vitet që nga 1967 edhe freskohet me informata çdo muaj. Përdoruesit i ofrohen edhe shumë përparësi të tjera së bashku me veçoritë themelore që i ka ky botim. Një njëri që bënë kërkim në materialet e gjuhës së huaj mund t'i gjejë ato vetëm në bazat e të dhënave e jo në versionin e shtypur. E dyta, tezat mund të gjenden vetëm Online. Rezultati i kësaj është ai që në ditët e sotme shërbimet Online ofrojnë diku prej 25 deri 30 % më shumë materiale sesa versionet e shtypura. (Gjendet edhe një shërbim tjetër më i vogël i quajtur PsycFIRST i cili përfshin apo mbulon materialet e njëjta, mirëpo vetëm për vitin në fjalë dhe për tri vitet në vijim.

Abstraktet në version e shtypur janë të radhitura në 16 kategori të mëdha të subjekteve, duke filluar nga intervenimet psikologjike e deri te personaliteti. Kjo i lejon përdoruesit që nuk ka kohë t'i shikojë shpejt fushat e subjektit me interes për të, pa u penguar nga titujt dhe fushat që nuk i interesojnë vetë shfrytëzuesit. Si një ciceron për ata përdorues me më pak eksperiencë, është një indeks i autorit një indeks i shkurtër i subjektit në secilin botim. [20] Qasja në subjekte zgjerohet dhe modifikohet në indekset përmbledhëse që botohen çdo gjashtë muaj. (Kur nuk jeni të sigurt për subjektin, shikoni përmbledhjen e jo botimet individuale). Një ndihmesë e madhe është Thesaurus of Psychological Index Terms. Sikurse gati me të gjitha sistemet e rangut të parë, ky botim e ka terminologjinë themelore dhe bazike për ta ndihmuar kërkimin.

NGJARJET AKTUALE: GAZETAT, INDEKSET DHE NDIHMA E REFERENCAVE

Ku i gjejnë lajmet amerikanët? Bazuar në raportin e Pew Research Center për njerëzit dhe mediat del se shumica e popullatës ende preferojnë gaze-

[20] Një përparësi e versionit të shtypur është fakti se e lejon kërkimin retrospektiv deri te viti i largët 1927. Mirëpo, për një kërkim retrospektiv të vërtetë, shiko: Historic PsycINFO, a Silver Platter CD-ROM i cili mbulon indekset e psikologjisë nga shënimet e vitit të lartët 1887 deri më 1966 kur edhe hyri në funksion versioni Online që përdoret nga ai vit deri në ditët e sotme.

tat ditore. Për më shumë, nuk është shumë habitëse as fakti se në një ditë të zakonshme të javës "Gati më shumë njerëz përdorin Internetin sesa shpenzojnë kohë duke lexuar revista. Diku rreth 20 % e amerikanëve të rritur, ose 36 milionë njerëz, marrin lajmin nga Interneti më së paku një herë në javë." [21] Në të njëjtën kohë, përqindja e amerikanëve, të cilët marrin lajme nga televizioni është diku 40 %. Vetëm 38 % e njerëzve në Amerikë e përshkruajnë veten si njerëz që i ndjekin lajmet qendrore të mbrëmjes në TV. Kjo përqindje para 5 vjetësh ishte diku 60 %.

Në vitin 2000, ishin diku 800 gazeta të përditshme në SHBA që mund të lexoheshin edhe në Internet. Duke i shtuar këtij numri edhe gazetat javore, ky numër shkon prej 800-2 300. Shumica e tyre ofrohen falas. Përjashtim është the Wall Street Journal, e cila mund t'ju detyrojë të paguani për shërbimet e saj, për shkakun se ato shërbime janë unike. Shpërndarja elektronike e lajmeve në Internet është i njohur për shumë amerikanë, e në veçanti për njerëzit më të rinj. Ata dinë se si t'i kërkojnë bazat e të dhënave Online rreth ngjarjeve më aktuale. Grremçi për individin është ai se derisa ai mund t'i shohë në ekran të gjitha lajmet aktuale ditore, në anën tjetër nuk ia vlen barra qiranë përsa i përket virtualitetit që të hysh në Internet dhe të kërkosh fakte dhe numra nga vitet e kaluara. Në ditët e sotme, gati të gjitha gazetat e mëdha ofrojnë një far lloji të kërkimit retrospektiv (arkivor) që ofrohet falas. [22]

Prej pikëvështrimit të bibliotekarit, që merret me punë referencash, janë tri aspekte të ndryshme të lajmeve dhe shërbimeve të referencave: (1) Ju mund t'i lexoni gazetat e përditshme Online. Kjo përdoret më shumë nga shfrytëzuesit ditorë sesa nga bibliotekarët e referencave. Posaçërisht të njohura: gazetat e përditshme të huaja dhe letrat prej pikëvështrimit të shfrytëzuesit; (2) Ju, po ashtu, mund të shikoni veprat mbi referencat standarde për materiale nga e kaluara ose ngjarje të cilat kanë hyrë në histori; p.sh. Facts on File ose një enciklopedi e mirë mund t'i tregojë përdoruesit më shumë lidhur me kushtet ekonomike, vitin e kaluar në Japoni, sesa duke humbur kohë dhe duke kërkuar këto informacione në indeksin e gazetës.

---

[21] "Poll shows cable news catching up" The New York Times, 8 qershor, 1998, f. D7. Sondazhet e mëvonshme më 1999-2000 tregojnë se numri po rritur deri në 30 %, në veçanti për artikujt dhe gazetat e huaja të specializuara.

[22] Arkivat shkojnë prapa në kohë deri te mesi i viteve '90-të ani pse disa janë më të hershme e disa më të vonshme. Gati të gjitha gazetat do t'u detyrojnë juve që të paguani në raste se shkarkoni arkivat e tyre, të cilat janë disa ditë të vjetra.

Tani shtrohet një pyetje. Pse të shqetësohemi me indekset e gazetave të shtypura? Përgjigjja është ajo e vjetra, mirëpo që është shumë e njohur për të gjithë ne: (1) Asnjë indeks i gazetës nuk shkon më larg sesa 10, 15, apo 20 vjet. Shumica e tyre filluan në vitet '90-të. Mirëpo, edicioni i shtypur i The Times në Londër filloi më 1875; (2) Indekset e shtypura janë më të rafinuara, më të kompletuara sesa simotrat e tyre Online; (3) Shumë më shpejtë mund të përdoret indeksi në versionin e shtypur për një projekt të kërkimit.

Gazetat

Për nga tirazhi i shitjes (viti 2000), 10 gazetat më të shitura në SHBA janë: The Wall Street Journal, USA Today, The New York Times, The Los Angeles Times, The Washington Post, NewYork Daily News, Chicago Tribune, Newsday, Houston Chronicle dhe Chicago Sun-Times.[23] Bibliotekat e mëdha i kanë të gjitha këto gazeta në disa formate. Gazetat ditore lokale mund të gjenden të shtypura në botimet njëmujore. Pas asaj, gazeta do të ofrohet si arkiv në mikrofishe (formati më i preferuar), CD-ROM, në vëllimet e caktuara, apo Online. Botimet aktuale dhe arkivat e gazetave më të mëdha nuk do të ofrohen me indekse Online. CD-ROM dhe microfishe do të zhduken.

Një bibliotekë e madhe i abonon të gjitha ato çka lexohen në gazetat e përditshme nacionale. Bibliotekat e vogla dhe ato të mesme do të dëshirojnë abonimet prej katër ose pesë prej tyre. Fondet e tyre janë shumë të limituara për të pasur materialet e The New York Times apo mundësisht The Wall Street Journal.

Për më shumë, biblioteka do të dëshirojë abonimet e gazeta të përditshme lokale, p.sh. njëra drejtpërdrejt nga komuniteti e po ashtu edhe gazetat që konsiderohen gazeta të të dhënave në atë hapësirë të caktuar. Në përjashtim të indeksit Newsbank, shumë pak gazeta lokale janë të indeksuara mirë. Zgjidhja ka dy përgjigje: (a) Gazeta në vetvete do të ketë një indeks, i cili mund të përdoret nga koha në kohë nga bibliotekari i referencave; (b) Biblioteka do t'i indeksojë gazetat. Kjo ishte një gjë që nënkuptohej, mirëpo në ditët e sotme është shumë e rrallë, në përjashtim të situatave speciale.

Në Internet (web-sajte)

[23] Edicioni më i ri i Magazines for Libraries ka një shënim përshkrues dhe vlerësues të gazetave të tilla të mëdha dhe po ashtu të tjerave. Këtu merren parasysh versionet elektronike dhe ato të shtypura.

Biblioteka mund ta qetësojë vetveten, duke besuar se abonimet e përditshme të gazetave të mëdha nuk është e nevojshme për arsyen se ato mund të lexohen gati në tekste të plota edhe në Internet. Dy gjëra këtu: (a) Shumica e njerëzve preferojnë të lexojnë gazetat me një filxhan kafeje ose një gotë qumësht dhe jo në kompjuter; (b) Më e rëndësishme, disa nga të ashtuquajturat gazeta me tekst të plotë shumë rrallë i kanë të gjitha Online. Shumica e reklamave dhe publiciteteve nuk futen aty. Vetëm gazeta e shtypur është e pranueshme për ata njerëz që dëshirojnë ta lexojnë gazetën nga faqja e parë e deri te e fundit.

Me këtë, mrekullia e mileniumit të ri është e gatshme dhe ofrohet falas në web-sajtet e shumicës së gazetave të mëdha... vetëm ndonjëra nga to me tekst të përgjysmuar. Pse, me përjashtim të Amerikës, ky shërbim ofrohet falas? Një arsye për këtë është fakti për ta mbrojtur klasifikimin e reklamave në web-sajte. Tjetra është ajo se botuesit besojnë që Interneti është e ardhmja ani pse ata duhet të gjejnë mënyra të tjera si të përfitojnë para nga Interneti. Mirëpo, në radhë të parë ata janë të influencuar nga shpirti i Irving Berlin, i cili e përfundon një këngë të tij kështu: "çdo njëri është duke e bërë tani."

The New York Times në faqen e plotë të reklamave u shpjegon reklamuesve atraksionin e Internetit për botuesit e gazetave. "Me më shumë se 7.1 përdorues të regjistruar, nytimes.com lejon krijimin e përmbajtjes me informata të kërkuara dhe me mekanizma të shitjes... Reklamuesit tani mund të monitorojnë dhe t'i menaxhojnë përgjigjet... Shiko rastin e kompanisë së kozmetikës, e cila lidhi një kontratë për një sërë programesh në nytimes.com për ndërtimin e një trafiku të shitjes... Me mesazhet reklamues të dedikuara vetëm për femra që punojnë në fushën e tregtisë, kjo fushatë pati përgjigje dhe rezultate më të mëdha se ndonjë fushatë tjetër ndonjëherë.[24]

Shërbimet e ndryshme Online dhe mekanizmat e kërkimit japin ose i

[24] Si medium i reklamimit Online (me faqe të plotë të reklamimit), The New York Times, 3 maj, 1999, f. C11. Po ashtu, shiko; "Hidden in the Web," The New York Times Magazine, 11 korrik, 1999, f. 22-24. Zëdhënësi i kësaj faqeje shpjegon më tej se si Times dhe gazetat e tjera në Internet shpresojnë të fitojnë para duke e dhënë gazetën e tyre. Reklamat kanë për objektiv grupe të caktuara të cilat më pastaj kanë linka të web-sajteve ku ata mund t'i blejnë menjëherë. Grremçi: "Investimi në mbledhjen e informatave duke u bazuar në metodat konvencionale të gazetarisë është duke rënë me të madhe. Interneti është një vend i mrekullueshëm për të mbledhur informatat fillestare. Mirëpo, nuk është edhe aq vend i mirë për të gjetur raporte dhe lajme origjinale dhe të besueshme.

kanë të vetat freskimet me informata të reja. American Online, për shembull, thotë se 14 deri 15 vizitorë mujorë i bëjnë freskimet me informata duke përfshirë këtu edhe Bloomberg News dhe Reuters. Dhoma e lajmeve në TV dhe radio stacione sikurse MSNBC (www.msnbc.com) kanë shërbime të njëjta. Këto janë shumë të përdorshme për individët, mirëpo janë shumë pak të frytshme për bibliotekat për shkakun se arkivat janë të limituara dhe metodat e kërkimit janë jo fort të mira.

Janë disa lloje të shërbimeve, të gjitha falas, të cilat ndihmojnë shfrytëzuesin/përdoruesin të organizojë listën e tij/saj me gazetat e preferuara. Në zhargonin e përditshëm, këto njihen si "filtered news services" dhe / ose "custome pages." Ato ndryshojnë shumë në termat dhe përmbajtjen e referencave dhe në organizim. [19] Crayon, një shkurtesë për "krijoje gazetën tënde," e lejon lexuesin t'i zgjedhë se cilat gazeta dëshiron t'i lexojë. Linkat janë të dhënë, po ashtu, për shkakun se nëse përdoruesi kthehet prapë te web-sajti, lajmet e ditës (prej atyre të përgjithshme e deri te ato të zgjedhura nga përdoruesi) shfaqen në ekran prej një, apo shumë gazetave. Crayon është te:

(www.crayon.net).

Disa web-sajte të tjera përfshijnë një grup të gazetave për subjekte të caktuara. Moreover.com (www.moreover.com) përfshin gazetat më të mëdha e po ashtu edhe televizionet si BBC, CNN dhe të tjera. Më pas, i radhit ato apo i liston pyetjet për subjektin e caktuar me titujt që kanë lidhje me pyetjen. Po ashtu, ofrohen edhe linka nga web-sajtet.

Biblioteka e Kongresit Amerikan ka linkat më të mirë të burimeve të gazetave. Shiko "Newspaper Indexes/Archives/Morgues" (http://lcweb.loc.gov/rr/news/oltitles.html). Ndër gjërat e tjera, ky burim superior ofron edhe linka të web-sajteve dhe të burimeve të arkivave, sikurse edhe metoda të kërkimit në arkivat e gazetave. Janë edhe disa të dhëna dogmatike në gjëra sikurse "Indekset e gazetave amerikane, ne përdorim shpesh ose nuk i kemi parë ato në listë" e po ashtu edhe "Indekset e gazetave amerikane (zakonisht të vjetra, lokale, edhe disa herë të specializuara). Me fjalë të tjera, ky është vendi më i mirë për të filluar kërkimin për gazetat që nuk gjenden sipas emrit individual ose në grupin e bazave të të dhënave sikurse Bell& Howell Information and Learning/ProQuest "Newsstand" ose Gale Group/IAC "National Newspaper Index" e po ashtu edhe "Info Trac Custom Newspaper."

[25] "Online Journalism," New York Times, 12 korrik, 2000, f. C1, C16. Është një analizë e mrekullueshme e asaj se çka ofrohet.

Lista më e mirë me linka për gazeta specifike përfshin:

U.S. News Archives on the Web (http://metalab.unc.edu/slanews/internet/Archiveso-w.html) prej Asociacionit të Bibliotekave Speciale. Këtu, ju mund të kërkoni çështjet apo temat (zakonisht prej vitit 1990 ose 1995 e më tutje) e po ashtu edhe ngjarjet aktuale sipas frazave, fjalëve ose zakonisht sipas "të gjitha fjalëve." Gazetat janë të aranzhuara ose të radhitura sipas shtetit me datat e arkivës, së bashku me çmimin për rigjetjen e artikujve me tekst të plotë. Kërkimi është falas, mirëpo në të shumtën e rasteve artikujt ofrohen për një çmim të caktuar. Faqet freskohen me informata rregullisht.

News Library (www.newslibrary.com/about). Këtu lexuesi mund të kërkojë arkivat e më se 65 gazetave amerikane, përfshirë ato aktuale dhe ato nga e kaluara me terma të gjëra të kërkimit. Është një çmim standard prej $1.95 për çdo tregim, pa marrë parasysh nëse është i vjetër ose i ri. Kërkimi i ndjek standardet e sistemit të madh të ashtuquajtur "gjetja e fjalëve dhe e frazave, të cilat shfaqen në artikuj". Më pastaj, lexuesit i prezantohen një listë e titujve prej të cilave lexuesi i zgjedh ato që i hyjnë në punë.

News Directory (www.newsdirectory.com/archive/press). E sponsorizuar nga Biblioteka Elektronike, kjo i liston gazetat e përditshme amerikane sipas regjionit dhe i përfshin më pak gazeta sesa shërbimet e tjera. E tillë, rekomandohet vetëm në raste kur burimi i mëparshëm i lajmeve dështon të japë çka nevojitet.

Grupimi i Indekseve të Gazetave

Online: National Newspaper Index. Farmington Hills, Mi: Gale Group, viti aktual, plus tri vjet të tjera, e përditshme, www.galegroup.com. Çmimi ndryshon.

DIALOG file 111. $120 për orë. E gatshme me shërbimet e tjera.

CD: 1982 e deri më sot, e përmuajshme. $4.000.

Online: Newspaper Source. Ipswitch, MA: EBSCO. 1990 e deri më sot, e përditshme, www.epnet.com. Çmimi ndryshon.

Online: ProQuest Newsstand. Ann Arbor, MI: Bell & Howell Information and

Learning (ProQuest). 1996 e deri më sot, e përditshme, www.umi.com/proquest. çmimi ndryshon.
Online: Newsbank InfoWeb. 1991 e deri më sot, e përditshme, www.leeca,org/infopre/newsbank. çmimi ndryshon.
CD: Newsbank, 1991 e deri më sot, e përmuajshme. $1.800-3.100.

Pse të mos hyhet drejtpërdrejt te gazeta? Pse të përdoret sistemi i grupimit të indekseve të gazetave, p.sh. njëra që i përfshin jo vetëm një por disa gazeta? Përgjigjja: Rafinimi i kërkimit. Mundi kolektiv, shembujt e të cilit janë të listuara këtu ofrojnë metoda të sofistikuar të kërkimit në vend të fjalëve ose frazave, të cilat mund të përdoren si fillim për hyrje në fajlat individualë të gazetave Online.

Një prej indekseve më të njohura të gazetave në bibliotekat amerikane është IAC's National Newspaper Index. Ofron indeksimin dhe abstraktimin e pesë gazetave më të mëdha në SHBA.: The New York Times, The Wall Street Journal, The Christian Science Monitor, The Washington Post, dhe The Los Angeles Times. Derisa indeksi shkon disa vjet prapa, teksti i plotë i ngjarjeve dhe tregimeve Online, zakonisht është i limituar, pra vetëm 90 ditë. Metodat e kërkimit janë ndër më të lehtat për t'u përdorur. Kjo përfshin tekstin e plotë të tri shërbimeve, që ua japin gazetave shumicën e tregimeve nga biznesi. Sikur DIALOG File 649, ju mund të kërkoni këto shërbime që freskohen me informata çdo ditë. Shumica e tyre shkojnë prapa deri te viti 1985. Këto tri shërbime përfshijnë Raportin financiar të Reuters, Kyodo's Japan Economic Newswire dhe PR Newswire (agjenci e lajmeve). Theks i veçantë u jepet lajmeve nga biznesi dhe kështu, edhe pse i përdorshëm, shërbim ka pak vlera te dikush që kërkon tregime për njerëzit.

InfoTrac Custom Newspaper (www.galegroup.com) lëshoi një dimension të ri në vitin 2000 te shërbimi Online i gazetës i Gale. Ky dimension apo shërbim i ri përfshin diku më shumë se 50 gazeta të përditshme në gjuhën angleze edhe pse fokusi qendror është në SHBA, e më pak në Angli dhe vendet e tjera. Shtesë këtu është ajo se tekstet e plota, të cilat nuk kanë grafike, tabela, apo diagrame, llogaritet si pjesë e sistemit të indeksit.

Newspaper Source nga EBSCO ka indeksimin e gazetave më të mëdha amerikane, duke përfshirë abstraktet dhe indekset e: The New York Times, The Wall Street Journal, USA Today, The Christian Science Monitor, The Los Angeles Times, dhe The Washington Post. Po ashtu, përfshin edhe shumë gazeta ndërkombëtare.

Bell Howell

ProQuest Newsstand lejon përdoruesin/ose bibliotekën të caktojë prej 2 deri 125 gazeta të ndryshme (nacionale, lokale, apo ndërkombëtare) që të indeksohen. Të gjitha këto janë të gatshme dhe ofrohen Online[26]. Janë diku 27 fusha të indekseve të kërkuara e po ashtu edhe të dhëna opcionale. Një sistem i veçantë i kërkimit ofrohet për ata njerëz që nuk e njohin Boolean logic dhe metodat e tjera bazike të kërkimit. Secili regjistrim përfshin citimin dhe një abstrakt. Kur përdoruesi e gjen citimin, ai/ajo mund të ketë qasje në tekstin e plotë. Një mundësi e mirë këtu është fakti se gazetat freskohen me informata çdo ditë dhe kështu ju mund të kërkoni dhe të shfletoni në gazeta të caktuara. Po ashtu, gjenden edhe arkivat për shumicën e titujve.

Një version tjetër i Bell & Howell indeks është: Newspaper Abstracts (www.umi.com/proquest), ku gjenden 30 tituj regjionalë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës përfshirë gati të gjitha gazetat e mëdha. Indeksimi fillon zakonisht prej vitit 1990.

NewsBank është përgjigjja, ani pse e njëpjesëshme, për indeksimin e rreth 500 gazetave më të vogla dhe diku rreth 200 periodikëve. Nuk i indekson në tërësi gazetat, mirëpo bën kërkim për materiale nën titujt e gjerë që kanë edhe nën kategori. Këto janë fort ngushtë të lidhura me plan-programin K-12 përderisa ky shërbim është më shumë për shkolla dhe për bibliotekat e vogla dhe të mesme publike. Zgjedhja e tregimeve më të rëndësishme, zakonisht me interes për komunitetin lokal, NewsBank i indekson çdo muaj rreth 60 000 deri 65 000 artikuj prej gazetave amerikane dhe ato kanadeze dhe tregime të tjera që merren nga agjencitë e lajmeve.

Dhe...

Të gjitha shërbimet e indekseve të përgjithshme, duke filluar nga EBSCO e LEXIS e deri te Gale kanë së paku disa indeksime të gazetave. Dhe, në shumicën e rasteve është e mjaftueshme. Po ashtu, edhe furnizuesit (pala shitëse) ofrojnë indeksime. Kategoria DIALOG “News” ofron Online gazeta të përgjithshme dhe ato me një subjekt të caktuar, zakonisht me tekst të plotë mbi ngjarjet aktuale dhe me kufizime për të arritur t’i sig-

[26] "An Online Newsstand", Database, qershor, korrik 1998, f. 42+. Ky është një diskutim komplet i bazave të të dhënave dhe se si ato i kërkojnë gazetat.

urojë artikujt e mëhershëm (p.sh. zakonisht për artikujt që janë më të vjetër se 90 ditë). Secila nga këto është si një qendër e të dhënave më vete dhe shpesh mund të jetë e shtrenjtë. Përparësia e kësaj është ajo se ofron metoda të sofistikuara të kërkimit që rrallë gjenden në shërbimet e tjera.

Indeksimet Individuale të gazetave [27]

Online: The New York Times Index. Nju Jork. New York Times Company. 1980 e deri më sot, e përditshme. Falas në Internet: www.nytimes.com.

CD: Ann Arbor, MI: UMI, 1992 e deri më sot, e përmuajshme. $2.450.

E shtypur: 1851 e deri më sot, çdo dy javë (plus përmbledhjet 3 muajshe dhe vjetore). $1.281.

Pa marrë parasysh formën e saj, indeksi më i mirë i gazetës në SHBA. është ai i botuar nga The New York Times. Një përparësi shumë e madhe e The New York Times Index është fusha e gjerë dhe fakti se është relativisht mjaft e kompletuar. The Times mundohet të mbulojë ngjarjet dhe lajmet më të rëndësishme, ato nacionale dhe ndërkombëtare. Edicioni i mëngjesit i Times është i gatshëm dhe ofrohet në të gjitha qytetet kryesore të Amerikës. Shtypet jo vetëm në Nju Jork, por edhe në Seattle, San Francisko, Los Anxhelos, Çikago, Dallas dhe në shumë qytete të tjera veri-lindore të SHBA-së.

The New York Times Index ofron informata shumë të vlefshme dhe shumë shpesh përdoret edhe pa referenca te esetë individuale dhe tregimet në lajme. Si pasojë, dikush që kërkon një fakt të vetëm, sikurse emrin e një zyrtari, datën e një ngjarje të caktuar, ose titullin e një drame, shpesherë mund t'i gjejë në indeks të gjitha që i nevojiten. Po ashtu, për arsyen se i gjithë materiali është i datuar, The New York Times Index shërben edhe si shënim në gazetat dhe revistat e tjera të paindeksuara. Për shembull, nëse përdoruesi është i pasigurt në atë se në cilën ditë është fundosur një anije e caktuar dhe dëshiron të shohë se si kjo ngjarje e tmerrshme ishte mbuluar nga mediat ose revistat, The New York Times Index e ngushton kërkimin, duke ofruar datën e asaj ngjarje.

[27] Shiko edicionin më të fundit të Magazines for Libraries ku janë diskutuar indekset e gazetave më të mëdha, e po ashtu edhe burimet e shumta të indeksimit.

Kërkimet themelore ofrojnë subjektin e zakonshëm, autorin dhe pikat kryesore të shënimit. Për më shumë, ju mund të bëni kërkim të mëtutjeshëm duke shënuar fjalë kryesore në abstrakte ose përshkrime. Disa metoda të tjera të kërkimit janë sipas vendeve gjeografike, ilustrimeve, emrave të njerëzve, datën e botimit, seksionin e titullit, e ndoshta edhe numrin identifikues të asaj ngjarje.

Edicioni i shtypur i The New York Times Index (e cila shkon prapa deri në vitin e largët 1851) është e organizuar në formë të fjalorit me një numër të mjaftueshëm të referencave kryqëzore të emrave dhe temave të ngjashme. Ngjarjet nën secilin titull janë të radhitura në mënyrë kronologjike. Recensionet e librave dhe teatrit janë të radhitura nën titujt repektivë. Disa biblioteka abonojnë vetëm përmbledhjen vjetore të indeksit në versioni e shtypur. Ky vëllim shërben si indeks dhe ciceron për aktivitetet nga viti paraprak. Në saje të abstrakteve të plota, hartave dhe diagrameve, shfrytëzuesi mund të përdorë vëllimin përmbledhës si një burim reference më vete. Përmbledhja vjetore është e mirë, mirëpo botohet shumë vonë. Zakonisht, botohet 6 deri 7 muaj pas përfundimit të vitit.

Indeksi The Times Online ka të dhëna që nga viti 1980. Dy gjëra: Jo të gjitha gjërat dhe artikujt janë të mbuluara në botimin Online ose në indeks. Kur kërkoni Online, në ngjarjet pas vitit 1998, Encyclopedia Britannica është e përfshirë, po ashtu me tekstet e plota nga viti paraprak, p.sh. arkiva e 365 ditëve të kaluara. Kërkimi dhe përmbledhjet janë falas, por nëse dëshironi artikullin e plotë, atëherë ai kushton $2.50 pa marrë parasysh gjatësinë e tij. Për më shumë informata shih: (http://archives.nytimes.com/archives).

Po ashtu, ke parasysh faktin se The New York Times ofrohet Online si pjesë e indekseve më të mëdha të përgjithshme prej EBSCO dhe IAC. Në këto raste, biblioteka paguan për indeksin dhe mbulimi i materialeve nuk shkon më larg sesa viti 1994 me tekste të plota Online që ofrohen vetëm për ato tekste që janë jo më të vjetra se 90 ditë. Pa tekstin e plotë, mirëpo me shërbimin e indeksimit dhe abstraktimit, LEXIS-NEXIS ofron gazeta edhe nga viti i largët 1969.

Një shtesë jashtëzakonisht e mirë e The New York Times Index është: The Personal Name Index to The New York Times, 1851-1974, e cila vazhdohet me shtesa të ndryshme nga viti 1974 e tutje. (Sparks, Nevada: Roxbury Data Interface, datat ndryshojnë, 28 vëllime, plus shtesat e shumta). E redaktuar nga Bryon dhe Valeria Falk, kjo përfshin diku rreth 5 milionë citime të personaliteteve, që janë paraqitur në gazeta që nga

botimi i saj i parë në vitin 1999. (Shtesat botohen çdo katër vjet). Ke parasysh se versioni Online i The New York Times nuk fillon as t'i përmbledhë numrin e madh të vëllimeve të shtypura, që datojnë prej vitit 1851. Për më shumë, sikurse edhe përpiluesit thonë "një mori emrash janë harruar nën titujt kryesorë sikurse vdekjet, personat e zhdukur, koncertet, teatrot e ndryshëm. Nën kushtet e tilla, përdorimi i The New York Times Index nuk është më çështje e shkencës së bibliotekës, por është një përdorim super i shkëlqyeshëm."

Rishqyrtimi: Për disa vjet me radhë botuesit e gazetave më të mëdha në SHBA. kanë thënë se tirazhi i tyre është duke u zvogëluar. Shifrat që vijnë nga Byroja e Tirazhit- që është e pavarur në këto statistika- tregojnë se tirazhi është duke rënë prej 1 deri 2 % deri 5-10 % çdo vit.

Rënia më e madhe është duke ndodhur në vendet urbane amerikane. Pse kjo rënie e madhe? "Industria e gazetave është ballafaquar me zbulimet sikurse televizioni, që pasqyron pse kjo rënie është duke ndodhur," raporton një analistë i raporteve.[28]

Shumë interesant dhe befasuese për bibliotekarët e referencave, të cilët ende besojnë shumë në interesin e lexuesit mesatar në gazeta si burim i informatave.

Zbehja e besimit të njerëzve në media ka bërë që të ketë një ndryshim shumë të madh në burimet e referencave larg prej gazetave dhe mediave të ngjashme.

Ngjarjet aktuale

Online: Facts on File. Nju York: Facts on File News Services, 1980 e deri më sot, e përjavshme, www.fofweb.com.$1,350. Ofrohet edhe në OCLC.

CD: 1980 e deri më sot, tremujore. $795.

E Shtypur: 1940 e deri më sot, e përjavshme. $525.

Në esencë, shërbimi i jep bibliotekarit një përmbledhje objektive të ngjarjeve nga java, muaji i kaluar, apo në përmbledhje, nga viti i kaluar. Theksi i veçantë është në lajmet e ngjarjeve që ndodhin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, tok së bashku edhe me mbulimin ndërkombëtar. Më së shumti, këtu flasim për lajmet mbi marrëdhëniet amerikane.

[28] "Newspaper Industry Fails to Stem Circulation Drop," The New York Times, 4 maj, 1999, f. C8.

Materiali grumbullohet më së shumti nga 100 gazetat, revistat dhe burimet qeveritare më të mëdha. Më pastaj, të dhënat futen apo shndërrohen në raporte objektive, të shkurtra dhe të bazuara në fakte.

Botuesi i cekë disa mënyra se si shërbimi mund të përdoret: Shiko të dhënat në indeks, vështro çështjet javore për t'u përgatitur për testet në marrëdhëniet aktuale, lexo vendimet e Gjykatës Supreme, ose skano rubrikën " SHBA. dhe marrëdhëniet botërore" nëse dëshironi artikuj të shkurtër. Janë edhe qindra mijëra mënyra të tjera, edhe pse mënyra më e mirë mbetet ajo e cila thërret për të dhëna specifike aktuale.

Facts on File që ofrohet Online ofron një rrugë të shkurtër për të ardhur deri te gjetja e kohës dhe vendit të caktuar se kur një ngjarje ka ndodhur. Kërkimi në baza e të dhënave Online mund të bëhet jo vetëm duke shënuar fjalët kryesore apo subjektet, mirëpo duke i shënuar edhe çështjet primare, ngjarjet dhe emrat e njerëzve në lajme. Kështu që, ju mund të shënoni Kentucky Derby ose Rezultatet e Zgjedhjeve Presidenciale për të marrë një vështrim të shkurtër dhe të shpejtë për një vit apo për disa vjet. Janë diku afër 300 000 referencave të kryqëzuara për të përshpejtuar materialin si material. Janë shumë linka, përfshirë edhe referencën në Facts on File- vëllimi i shtypur. Kjo është shumë e përdorshme për informatat e kualifikimin, posaçërisht para vitit 1980.

Kur Facts on File u kthye në shërbim Online, ofroi disa veçori për nga vëllimi: (1) Facts on File ka materiale që nga viti 1981; (2) Editorial on File (një emër vetëpërshkrues) i botuar nga po i njëjti botues; (3) Issues and Controversies on File dhe Today's Science on File; (4) Përmbajtjet e zgjedhura prej World Almanac dhe Funk & Wagnalls Encyclopedia; (5) Si shtesë, ofrohet edhe shërbimi, apo agjencia e lajmeve në gjuhën angleze Reuters.

Duke ofruar të gjithë këtë dhe përshkrimet mjaft të thjeshta të paragrafëve lidhur me lajmet në secilën problematikë të edicionit të shtypur janë zgjeruar nga koha në kohë. Po ashtu, ngjarjet e lidhura apo të përafërta janë të lidhura së bashku kur kjo është e domosdoshme. Me shkas, secila nga këto komponentë mund të kërkohet në vete ose në kombinim, dhe zakonisht ofrohet edhe kërkimi me shënimin e fjalës kryesore ose forma të tjera më të avancuara të kërkimit.

Megjithëkëtë, që u tha, mund të thuhet se për shkak se ka shumë shërbime Online, është shumë më lehtë të shikohet versioni i shtypur i Facts on File në rastin kur duhen informata drejtpërdrejt mbi ndonjë vend. Versioni Online është i shkëlqyer, mirëpo në të shumtën e rasteve mund

t'u marrë shumë kohë, veçanërisht në rastet kur një bibliotekarë kërkon një emër, datë etj.

I shtypur dy herë në muaj, indeksi me ngjyrë të kaltër është i rregulluar apo aranzhuar nën katër tituj primarë: "Marrëdhëniet e SHBA", "Marrëdhëniet Ndërkombëtare", " Lajmet Botërore" dhe "Të përziera". Pastaj, nën këta tituj ju mund të gjeni tituj të tjerë, sikurse "Financa", "Ekonomia" dhe kështu me radhë. Çdo dy javë, çdo muaj, e pastaj çdo tre muaj apo vit lëshohet në botim një indeks i detajuar, i cili mbulon çështjet e mëparshme. Po ashtu, është edhe indeksi Five-Year Master News Index që ishte botuar në vitin e largët 1950.

Indeksi i subjektit (i cili përfshin një numër të madh të emrave të njerëzve në lajme) ka opsionin, ku shënohet emri i artikullit e më pastaj e jep referenca e datës dhe ngjarjes së caktuar, faqja në botimin e Facts on File, e po ashtu edhe shënimet anësore në faqe dhe numrin e shtyllave. Për shembull, nën titullin Jugosllavia, ju mund të gjeni "Masat e jashtëzakonshme OK'd 5-15" (Data, 15 maj 1999) "367 faqe numër G3" (letra në faqen e shënimeve 367, shtylla e tretë).

Në fund të indeksit është seksioni i "Korrigjimeve." Ky seksion jep informata të sakta me faqe dhe shtylla, si për shembull: "148A1 udhëheqës (jo president)" dhe "358D2 Symms (Jo Simms)." Ky opsion mund të gjendet në secilin botim.

Shumë vende perëndimore kanë shërbime të njëjta edhe pse njëra nga shërbimet më të përdoruara në bibliotekat amerikane është Keesing's (Londër: Longman Group Ltd., Keesing's Contemporary Archives, 1993 e deri më sot, e përmuajshme, çmimi ndryshon). Ofrohet edhe në Internet kurse në versionin e shtypur ofrohet që nga viti 1931 e deri më sot. Botohet çdo muaj. Fokusi këtu ndryshon nga ai në Facts on File në dy gjëra kryesore: (1) fillimisht dhe më së shumti mbulon Anglinë, Evropën dhe Mbretërinë Britanike; (2) raportet e detajuara të subjekteve në fusha të caktuara shumë shpesh janë të inkorporuara në të (raportet janë nga ekspertë dhe disa herë i vonojnë publikimet javore për disa ditë). Po ashtu, këtu gjenden edhe tekstet e plota nga fjalimet dhe dokumentet. Megjithatë, Keesing's nuk i mbulon në detaje shumë ngjarje, që botuesi i konsideron si "më pak të rëndësishme" sikurse sporti, ekspozitat nga arti dhe filmat (që të gjitha këto janë të përfshira në Facts on File).

Radhitja është sipas shtetit, territorit, ose kontinentit me disa nëntituj të mëdhenj të subjektit, sikurse "Religjioni", "Aviacioni", "Artet Pamore". Indeksi botohet dhe është një përmbledhje 3 muajshe ose vjetore.

SUGJERIME PËR TË LEXUAR

Brown, M. Suzanne et al., "A new Comparison of the Current Index to Journals in Education and the Education Index: a deep analysis of indexing." Journal of Academic Librarianship, Maj, 1999, f. 216-222. Derisa kjo është një Ekzaminim themelor i dy indekseve, studentët do ta gjejnë shumë Interesante këtë botim për të parë metodat e kërkimit. Qasja në analizën e indekseve mund të përdoret për çdo indeks ose shërbim të abstraktimit. Jo pa qëllim, gjykuesit kanë disa pika fascinante për të bërë për secilin nga këto indekse të analizuara dhe të ekzaminuara.

Burchinal, Lee G. "The Tale of Two ERICs," Journal of the American Society for Information Science, vëllimi i 51, nr. 6,2000, f. 567-575. Një histori e Shkurtër e zhvillimit të ERIC prej vitit 1959 e deri më 1967. "The History of two ERICs ilustron se si dija dhe ekspertiza... ka ndryshuar Zhvillimin e shërbimeve më të mëdha të informatave në botë.

Foust, Dean, "Go, Speed Trader," Yahoo Internet Life, Prill, 1999, f. 107-109, 133. Një analizë e shkurtër e tregtisë ditore dhe se si bëhet kjo punë në Internet. Autori sugjeron disa web-sajte të besueshme për t'i mposhtur "të këqijat." Bibliotekarët e referencave duhet të jenë të informuar me këtë proces, nëse jo edhe me rezultatet.

Hodge, Gail dhe Jessica Milstead, Computer Support to Indexing. Filadelfi: Federata Nacionale e Shërbimeve të Informatave dhe Abstraktimeve, 1998. E mbështetur në eksperiencën dhe intervistat me botuesit e bazave të të dhënave dhe producentët. Autorët kanë vënë vizat e kaltërta në indekset digjitale- përfshirë zhvillimin në Internet. Ky është një freskim me informata, i botimit të vitit 1992.

Jasco, Peter, "Analyzing the Journal Coverage of Abstracting/ Indexing Databases Library & Information Science Research, nr.2, 1998, f. 133-151. Një studim shkencorë, i cili tregon disa të meta në besueshmërinë e plotë të indekseve standarde dhe shërbimeve të abstraktimit. Shumica e indekseve dështojnë në atë se materiali i indeksuar është

shumë më i vjetër sesa data e indeksit; indeksimi është shumë i rrezikshëm, kështu që mund të mos i përfshijë të gjitha çka i nevojiten shfrytëzuesit; ka edhe shumë kopje të bërë.

Krumenaker, Larry, "Check 'em All: The Mathematics of Online Newspapers," Searcher, maj, 2000, f. 38-47. Këtu jepet një këshillë praktike në atë se si të kërkohet në DIALOG dhe dy shërbimet e tjera për t'i gjetur të gjitha gazetat e ofruara Online. Po ashtu, sekretet e gjetjes së gazetave më të mira janë të përmendura.

Paul, Nora, "News Archives on the Web for the "Big Five," Searcher, qershor, 1999, f. 32. Një ekzaminim i rregullave të arkivës Online të pesë gazetave më të mëdha, duke filluar nga The New York Times deri te Wall Street Journal. Këtu përmendet se disa nga këto gazeta kanë arkiva që shkojnë prapa deri te viti 1984, kurse disa të tjera i kanë këto arkiva nga vitet '90-të. Autori bën vlerësimin individual të çdo gazete jo vetëm në kriteret e arkivës, por edhe në atë se sa lehtë gjendet materiali në çdonjërën nga këto gazeta.

Plat, Nina, "Legal Periodical Indexes on the Web," Database, tetor/nëntor, 1998, f. 45-50. Një analizë e detajuar e katër indekseve ligjore duke përfshirë Wilson Index e deri te Legal Periodicals&Books. Derisa është me shumë interes për indekset nga fusha e judikaturës, qasja, metodat e vlerësimit mund të përdoren për të gjykuar çdo lloj të indeksit.

Tenopir, Carol, "Getting What You Pay For?" Library Journal, 1 shkurt, 200. Pse është indeksimi i komercializuar Online një ndër më të mirët, dhe çfarë pyetjesh duhet të bëjnë bibliotekarët për të vendosur se cilin shërbim ta blejnë? Këtu përfaqësuesit e këtyre çështjeve të mëdha sugjerojnë se çka bibliotekarët duhet t'u tregojnë atyre që kanë për detyrë blerjen e shërbimeve të bibliotekave.

Woudhuysen, H.R. "Vandals of Colindale," The Times Literary Supplement, 18 gusht, 2000, f. 14-15. Një tregim në detaje i asaj se si gazetat e vjetra, shumica e të cilave janë që nga shekulli XIX, janë vazhdimisht duke u shkatërruar për shkak të imazhit të tyre në mikrofilm, mirëpo, kurrsesi për shkak të shtypit. Fokusi kryesor këtu është

në aktivitetet e Bibliotekës Britanike. Një vepër e njëjtë mbi shkatërrimin e gazetave në bibliotekat amerikane ishte shkruar nga Nicholson Baker në botimin e 24 qershorit të The New Yorker, f. 42-61. (Baker shkroi më herët mbi shkatërrimin e katalogëve të bibliotekave amerikane). Kritikët e quajnë këtë aktivitet të gazetave si krim. Të tjerët e shikojnë si diçka që bëhet për të ruajtur hapësirë. Autori i qëndron besnik anës që argumenton siç u cek më lart.

KAPITULLI VII
ENCIKLOPEDITË: E PËRGJITHSHME DHE KOMPLETET TEMATIKE[1]

Enciklopeditë e ditëve të sotme janë vendi i parë dhe burimi më i sigurt për studentë dhe njerëzit e tjerë që dëshirojnë informata komplete, koncize dhe që kanë të bëjnë me çdo gjë në univers. Nga shpjegimi i karakteristikave të përgjithshme të Zairit, enciklopedia është çelësi i secilit person për t'u përgjigjur në pyetjet komplekse. Në një vend të vetëm, bibliotekarët gjejnë përgjigje në pyetje. Për të bërë një gjë të tillë në Internet, nevojitet shumë kohë. Mirëpo, enciklopeditë që ofrohen në Internet dhe që janë Online janë bërë promovim i suksesshëm. Sa e rëndësishme është kjo për bibliotekarë do të flasim pak më vonë.

Janë dy lloje të enciklopedive: të përgjithshme dhe specifike (apo për një subjekt të caktuar). E para, pra enciklopedia e përgjithshme, me të cilën fillon edhe ky kapitull, i merr të dhënat nga të gjitha fushat e dijes. Në anën tjetër, enciklopedia për një subjekt të caktuar është e specializuar dhe e ngushton fushën e studimit në një temë apo subjekt të caktuar. Grupimi i temës apo subjektit është nga disa fragmentime të dijes në mënyrë që të jetë sa më i kuptueshëm. Kjo pyetje e tregon dallimin në mes tyre: "Pse ne nuk mund ta duam njëri-tjetrin?" Enciklopedia e

[1] Për një histori të shkurtë të enciklopedisë, shiko çdo enciklopedi. Po ashtu shiko edhe kapitullin për enciklopeditë nga Bill Kats në "Cuneiform to Computer: a History of Reference Sources (Latham, Md: Scarecrow Press, 1998). Për një shembull të thjeshtë nga enciklopeditë e hershme shiko: Omne Bonum, enciklopedi e shekullit të XIV mbi njohuritë universale. Kjo ishte botuar nga Harvey Miller në dy volume më 1999.

përgjithshme do ta shpjegojë "dashurinë". Në anën tjetër, enciklopedia për subjekt të caktuar, që shkon prej filozofisë, religjionit, analizave psikike, e deri te letërsia, përgjigjet në pyetjen në bazë të hierarkisë së opinioneve, mendimeve dhe kërkimit.

Përgjigja është e limituar në gjetjen e një disipline, apo të një pjese të saj.[2] Ndarja në mes të enciklopedive të përgjithshme dhe atyre për një subjekt të caktuar ka ndodhur shumë vonë. Enciklopedia është definuar si një qark mësimi, apo punë që ka informacione në të gjitha fushat e dijes. Definicioni që daton që nga koha e romakëve të vjetër e që zgjati deri gati në shekullin XVIII, kur edhe personi i fundit, i cili dinte diçka (pra prej leximit ose korrektimit të një enciklopedie) vdiq. "Më pastaj, enciklopeditë u bënë shumë të specializuara. Fusha e dijes njerëzore pasi ka përqafuar librat, gjithmonë do të jetë një fushë e vështirë për t'u studiuar." [3] Dhe, pastaj lindi grupimi i subjektit të caktuar, ku një fushë studiohej plotësisht. Pra, enciklopeditë, sikurse edhe tani, ishin vetëm për një studim të shpejtë, mirëpo kurrsesi për informacione më të hollësishme.

Qëllimi

Gati çdo enciklopedi do të përfshijë: (a) artikuj të analizuar në detaje, në të shumtën e rasteve me bibliografi në fusha të caktuara; (b) material shpjegues që është i shkurtër; (c) informata përmbledhëse sikurse lindjet dhe vdekjet e personave të rëndësishëm, lokacionet gjeografike dhe ngjarjet historike. Kjo e bënë enciklopedinë ideale për punë referencash.

Në nivelin fëmijëror, është një keqkuptim i madh: një enciklopedi, pa marrë parasysh sa e mirë është, nuk është një zëvendësim për lexime të mëtutjeshme ose për përmbledhjen e referencave mbështetëse nga librat. Në këtë frymë, disa shitës dhe njerëz të marketingut janë të mendimit se një fëmijë që lexon enciklopedi është në të vërtetë një fëmijë i edukuar.

---

[2] A mundet ndokush të japë përgjigje të plotë në pyetjen: "Pse ne nuk mund ta duam njëri-tjetrin?" Kërkimet tregojnë se nuk ka përgjigje të mjaftueshme prej asnjërës, as prej enciklopedive të përgjithshme e as prej atyre të subjekteve. Mësimi: jo të gjitha pyetjet kanë përgjigje, apo jo gjithmonë ai që bënë pyetje merr përgjigjen e merituar. Çka bën një bibliotekistë në një situatë të tillë? Përgjigja: e pranon se nuk mund të gjejë një përgjigje adekuate dhe ju sugjeron disa vende, ku mund ta kërkoni përgjigjen. Dhe, nëse keni kohë, Interneti është vend i mirë për të bërë pak kërkime.

[3] Frederick Raphael, "The Seduction of Reason," Times Literary Supplement, June 26, 1998, p.3. Kjo e hapë një analizë të thellë dhe të gjatë për enciklopeditë e subjektit: Routledge Encyclopedia of Philosophy. Është një shembull i mrekullueshëm si të shkruhet një analizë e hollësishme mbi një enciklopedi.

ENCIKLOPEDITË ELEKTRONIKE KUNDRUALL ATYRE TË PRINTUARA

Disa botues të enciklopedive të përgjithshme kanë, ose janë gati të japin versionet e shtypura të këtyre enciklopedive.[4] Pse? Për arsye se është shumë më lirë, pra ekonomike. Të botosh versione elektronike- mbi të gjitha, vetëm paramendo sa drunj janë ruajtur. Po ashtu, publiku tani është shumë i mësuar me Online ose me CD-ROM edicionet që janë 10 deri 20 herë më të lira se ato të shtypurat.

Një CD apo dy prej tyre e zgjidhën problemin e çështjeve të librave për vëllimet e kufizuara.[5] Dhe, kështu, në vend që të besojë te vjetarët, blerësi shpreson se botuesi do t'i dërgojë atij më të rejat gjatë vitit, për çmim minimal, më së paku një herë në vit.

Kur enciklopedia mund të gjendet në CD-ROM ose Online, të gjitha arsyet që tashmë dihen për sukses janë evidente. Janë animacione dhe klipe të ndryshme filmike (150-200); ilustrime dhe harta (10000-25000); zëra (10-20 orë) dhe shumë e shumë zile e fishkëllima të tjera, që janë për t'u zbavitur dhe për t'u informuar. Pyetjet serioze për informacion janë të ndihmuara nga Boolean – kërkimi (pa marrë parasysh si emërtohet nga botuesi) e cila lejon gjetjen e informatave duke shënuar fjalët kryesore dhe fjalët apo frazat që kanë të bëjnë me atë informacion. Shumë informata mund të gjenden vetëm brenda disa sekondave për dallim nga leximi i vëllimeve të ndryshme që do të merrte orë të tëra.

Disa mijëra linka për web-sajte mund të bëjnë një kërkim informatash 5 minutash në vend se të humb orë të tëra në Haydn, mbase edhe ditë të tëra duke kërkuara dhe gjetur informata të panevojshme. Linkat janë diçka shumë e ngjashme me definicionin në fjalorë, ku më pastaj t'i shikojë lart e poshtë nëpër faqen e caktuar për të gjetur gjëra të tjera.

---

[4] Kur Britannica u bë Online dhe pa pagesë- e mbështetur nga reklamat- ishte thënë se versioni i shtypur nuk do të botohej më. Së paku, ky ishte plani. Po ashtu, Compton's e shiti versionin e shtypit te një firmë tjetër. Të drejtat elektronike të Colllier-it u blenë nga Microsofti. Ajo nuk vazhdoi as me versionin elektronik. Kompanitë e tjera pritet të ecin në rrugën e njëjtë, pra të mos botojnë versionet e shtypura.

[5] Nga viti 2000, të gjitha enciklopeditë e përgjithshme në CD-ROM janë standarde (një disk i vetëm) dhe (versioni me 2 disqe). Zhvendosja në mënyrën me dy disqe shpjegohet nga Compton's, e cila ofron tekstin e njëjtë në versionin me një disk si dhe me atë me dy disqe. Mirëpo, ofron po ashtu edhe shumë animacione, fotografi, e video. Çmimi për dy disqe nuk është se 10-20$ krahasuar me çmimin që paguan për një disk. Pra oferta me dy disqe gjithmonë është më e mirë.

Shumica e enciklopedive të popullarizuara dhe të njohura janë të postuara në Ueb. Të gjitha ato vuajnë prej problemeve dhe të mirave, të njëjta. Ana pozitive e tyre është: (1) të gjitha nga ato janë më aktuale se versionet e shtypura ose ato në CD-ROM. Çdo muaj, apo çdo tre muaj janë të freskuara me informata. Problemi është se këto freskime me informata janë të parregullta dhe më shumë fokusohen në gazetat e njohura dhe storiet televizive, në vend që të ketë rishikim në thellësi dhe materiale sensacionale; (2) të gjitha nga ato kanë linka për t'i gjetur artikujt dhe web-sajtet, në të shumtën e rasteve me ilustrime. Kjo, në mënyrë mjaft të madhe e zgjeron fushën e studimit të enciklopedive Online, që po ashtu luajnë rolin e fultereve. Përshtypja është se redaktorët i marrin vetëm web-sajtet më të mira.

Një kënaqësi e madhe është se nga viti 1999 Encyclopaedia Britannica ofrohet falas në Internet. (Pra, pagesa prej $50 në vit, sa në fakt kushton që të përdoret kjo enciklopedi mbulohet nga reklamues të shumtë). Pyetja është se sa botues do t'i vazhdojnë hapat e Britannica-së. Përgjigja: ata do ta ndjekin shembullin e Britannica nëse profiti bëhen prej burimeve të tjera e jo prej përshkrimeve. (Shënim: Pa marrë parasysh se çka ndodh, gati 2000 enciklopedi në fusha të caktuara iu ofron provë disa-ditësh falas që mund të jetë jashtëzakonisht e frytshme për studentë).

Grove, që është botues i disa enciklopedive në fusha të caktuara, ofron një shembull perfekt për atë se pse enciklopeditë elektronike do t"i mposhtin ato të shtypurat: (1) The New Grove Dictionary of Opera Online (www.groveopera.com) i ka të gjitha klipet muzikore për të ilustruar hyrjet (kapitujt) e mëdha. Lexo dhe dëgjo; (2) The Grove Dictionary of Art Online (www.groveart.com) në 34 vëllimet e saj ka diku 15 000 fotografi dhe diku 750 harta të ndryshme. Mirëpo, Online, duke iu falënderuar linkave nga muze të ndryshëm dhe bibliotekave të artit, ofron diku rreth 100 000 fotografi; (3) Versioni elektronik kushton $1500 në vit, kurse enciklopedia në versionin e shtypur kushton diku prej $ 6 000 deri $8 800. Shumica e bibliotekave të mëdha i kanë që të dyja versionet; (4) Kërkimi Online është shumë më i shpejtë dhe efikas sesa përdorimi i versioneve të indekseve të shtypura dhe referencave të kryqëzuara.

Grove ofron shumë tipare, prej audiove te ato të shikimit, që janë të gjitha tipare të enciklopedive të përgjithshme dhe atyre te subjekteve në ditët tona. (Është e vërtet se jo të gjitha punët e bëra në subjekte të caktuara ofrohen Online, mirëpo kjo do të ndryshojë në dekadën e ardhshme.) Me çfarëdo çmimi, edhe disa nga karakteristikat e përmendura për Grove, tregojnë qartë

popullaritetin e enciklopedive elektronike përkundër atyre të shtypura.

Analistë të punëve elektronike sikurse edhe bibliotekarët, kanë matur sa gjatë do t'i duhej një njeriu për të gjetur X or Y në CD-ROM ose në versionin e shtypur.

Këtu është një krahasim në kërkimin që bëhet përmes CD-ROM-it dhe me enciklopedinë e shtypur: "Ne i vendosim dy kërkues- njëri nga ata me një enciklopedi prej 12 vëllimeve dhe tjetri me Britannica CD-ROM - me detyrën për të gjetur, sa shumë kohë iu nevojitet atyre për të gjetur përgjigje në këto tre pyetje:

1. Kush e udhëhoqi invadimin e parë Roman të Britanisë dhe kur? (Jul Cezari në shekullin I para lindjes së Krishtit).
2. Cilët janë tre ashtat në mesin e veshit dhe cilat janë funksionet e tyre? (Kocka dëgjimore: malleusi/hammeri, incusi/anvili, stapesh/stirrupi).
3. Në cilin vit u botua Lufta dhe Paqja dhe sa vjet ishte Tolstoy? (1869, 41 vjeç).

Libri:

1. I mori tri referenca dhe iu nevojitën 5 minuta për ta gjetur përgjigjen.
2. Dy minuta dhe dy referenca për t'i gjetur.
3. E gjeti një informacion, 6 minuta.

CD-ja:

1. E gjete përgjigjen në "Romakët dhe Britania", për tre minuta.
2. E vështirë për të gjetur detaje të caktuara. Iu deshën 15 minuta.
3. Vetëm tre minuta.[6]

Shpejtësia është, në mënyrë fare elektronike, kur është e vështirë të gjenden, zakonisht fjalë jo të indeksuara, fraza dhe ide që janë të humbura diku në vëllimet e botuara. Kërkuesi i shënon fjalët kryesore dhe normalisht më pastaj vjen pyetja për informacionet e domosdoshme. Kjo merr diku disa sekonda ose minuta krahasuar me versionin e shtypur që mund të marrë orë të tëra. Anasjelltas, dikush që është duke kërkuar një datë të caktuar, një biografi të shkurtër të një personi të famshëm, apo një sqarim të shkurtër për proceset e zakonshme mund ta

[6] The Independent (Londër), 13 janar, 1998, f.10.

ketë më të lehtë të bëjë këtë në versionin e shtypur. Ju mund të shikoni fjalët një nga një, ndoshta në mënyrë alfabetike dhe në shënimet që janë në tekst, gjë që do të merrte shumë më shumë kohë në versionin elektronik.

Diku rreth 50 % e shtëpive amerikane nuk kanë mjete për t'i përdorur enciklopeditë digjitale, p.sh. ata nuk kanë kompjuterë. Duke mos qenë i njoftuar me qasjen elektronike, ata u besojnë më shumë vëllimeve të shtypura që gjenden në biblioteka. Mund të thuhet se justifikimi më i mirë për përdorimin e qasjeve jo elektronike është fakti se ky version e kënaq publikun më shumë (së paku publikun më të vjetër) për të lexuar dhe për t'i kontrolluar format e vjetra.

Një bibliotekar dhe specialist i mediave e përmbledh kështu:

"Më dhimbset shumë zhdukja e ngadalshme e versioneve të shtypura... dhe kjo është arsyeja pse: Komforti: Libri gjithmonë punon dhe kurrë nuk griset! Studentët zakonisht dëshirojnë vetëm fakte dhe të gjitha zilet dhe fishkëllimet që i kënaqin ata, kur kanë kohë të lirë... vetëm ngadalësoi pakëz ata dhe bën punën, që ata të kenë për detyrë që të bëjnë kërkime. Njëra nga CD-ROM e enciklopedive më të përdoruara është shumë e vjetër, vetëm version i tekstit *World Book...Managment*: Secili që është përgjegjës për monitorimin e 27 adoleshentëve që kërkojnë në Internet, në një sistem të pafiltruar kur dihet se në të shumtën e rasteve ndjenjat dhe hormonet tona luajnë rol më të madh në jetën tonë sesa një detyrë për romakët e vjetër. Kërkimet e reflektojnë këtë. Pa marrë parasysh sa fantastike janë enciklopeditë Online, nuk mund të krahasohen e as të maten me World Wrestling Federation apo me sex.com... Harxhimi: Enciklopeditë në CD-ROM mund të jenë lirë për t'u blerë, mirëpo mënyra që t'i riparojmë ato, t'i freskojnë me informata të reja, apo për të blerë pjesë të reja, që mund t'i përdorim këto CD, kushton shumë. Ne nuk mund ta ofrojmë këtë.[7]

CD-ROM-i kundër Online-it

Përshtypja se CD-ROM-at shumë shpejt do t'i ndjekë shembulli i versioneve të shtypura në biblioteka, dhe po ashtu, në shtëpi, nuk qëndron për enciklopedi. Në të vërtetë, ndoshta më shumë njerëz përdorin CD-ROM-a sesa versionet Online të enciklopedive. Pse? Përgjigjja: (1) vetëm

[7] Nancy D. Swider, "Letters" për editorin, Library Journal, 1 shkurt, 1999, f. 8. Zonja Swider është bibliotekist në Shkollën e Mesme Goodrich, Fond du Lac, WI, SHBA.

20 deri 30 % e atyre që kanë kompjuter kanë qasje në Internet nga shtëpitë e tyre. Mirëpo, në anën tjetër, të gjithë ata kanë qasje në CD-ROM dhe për këtë arsye, ky format është i preferuar në të shumtën e rasteve; (2) shumë shpesh, CD-të apo disku ka më shumë tipare sesa versioni Online, p.sh., videot, zërat etj. Po ashtu, kjo mund të bëhet edhe Online, mirëpo me një çmim shumë të lartë; (3) botuesit shpesh e shohin fitim apo profitin në CD, duke qenë shumë të zënë me dhënien e informatave falas në versionin Online; (4) janë edhe shumë arsye të tjera të përdorimit më të lehtë të CD-ve dhe çmimi më i ulët, që ndoshta janë shenja se versioni i CD-ve të enciklopedive do të ketë jetë të gjatë, pasi enciklopeditë në versionin e shtypur tani po zhduken.

Me kohë, për të qenë i sigurt, versioni CD-ROM do ta humbë luftën me Online, mirëpo kjo nuk do të ndodhë aq shpejt sa disa njerëz predikojnë. Kjo është për të treguar se pse përqendrimi i këtij kapitulli është më i madh sesa në kapitujt e tjerë.

Online/ Internet: Paralajmërim

Të gjitha përmbledhjet standarde të Online/Internet janë të pranueshme. Ke kujdes: shumica e të këtyre (dhe ka linka të enciklopedive në Internet) përmbledhjeve janë të pavlera, ose së paku nuk janë të dobishme për punë referencash. Shumica e tyre janë përmbledhje e temave apo subjekteve që mundohet t'i mbulojnë të gjitha fushat prej artit e deri te zoologjia.

Duke kaluar nëpër web-sajtet e ndryshme do të shihni linkat që tregojnë se ku mund të gjenden enciklopedi të ndryshme, si pjesë e titujve të këtyre enciklopedive. Shumë rrallë, këto janë enciklopedi tradicionale ose një frazë e vërtetë e një termi që ju jeni duke e kërkuar. Shpesh, ato përdorin enciklopeditë për të radhitur listën e të dhënave- që nuk është e jashtëzakonshme për shumë vepra të botuara. Për shembull, *Panic Encyclopedia* (www.freeedonia.com:80/panic) është një përgjigje mjaft argëtuese në pyetjen "pse panik"? Ju mund të gjeni të radhitura në mënyrë alfabetike shumë shkrime të shkurtra sikurse "kauboji që bën panik" ose "ginset panic". Janë disa qindra shembuj të tjerë po aq argëtues ose thjeshtë të padobishëm.

Është e vërtetë, janë shumë pak enciklopedi pa pagesë në Internet që me të vërtetë mund të shërbejnë, apo ku mund të gjesh informatat që të nevojiten. Në anën tjetër, duke e zgjeruar kërkimin në "fushën e dijes" vetë Interneti është një

enciklopedi pa fund.[8] Në këtë kuptim, (edhe nëse "enciklopedia" injorohet si një lloj përshkruesi i shumicës së web-sajteve pa pagesë), i gjithë Interneti është enciklopedi e përgjithshme dhe enciklopedi për një subjekt të caktuar. Mijëra web-sajte në Internet mund të konsiderohen enciklopedi në natyrë, mirëpo jo në emër. Shumica e tyre janë më se të mira. Një shembull mjafton: web-sajti e NASA-së (www.nasa.gov). Derisa "enciklopedia" nuk është asgjëkund, e ashtu quajtura "web-sajt" është një enciklopedi e vërtetë në një temë apo subjekti të caktuar, që ka të bëjë me hapësirën dhe të gjitha informatat lidhur me NASA-në. Këtu, ju mund të gjeni çdo informatë prej orareve të fluturimit në gjithësi e deri te historiku i hapësirës dhe shumë shpjegime të tjera të termave planetare dhe të hënës.

VLERËSIMI I ENCIKLOPEDIVE

Shumica e bibliotekarëve dhe njerëzve, jo profesionistë, kthehen t"i shikojnë një apo dy të dhënave në mënyrë që të bëjnë një vlerësim objektiv të enciklopedive në të dy versionet (formatin elektronik dhe atë të shtypur). Këto janë shumë të besuara, të provuara dhe të vërteta.

Një nga të dhënat bazike për analiza është e famshmja "Reference Books Buletin" në The Booklist, për të cilën kemi folur më parë në këtë libër. Një analizë e gjatë është bërë për gati çdo problem, më shumë si një enciklopedi e subjektit. Këto janë dokumente të detajuara, objektive dhe shumë të përpikta. Shqyrtimi më i mirë i mundshëm për përmbledhjet standarde ofrohet nga i njëjti shërbim në mes të problemit të 15 shtatorit. "Encyclopedia Update," (Enciklopedia që mbushet me informata të freskëta) përfshin materiale të botuara më parë për përmbledhjet e përgjithshme 10-12. Është një përmbledhje e ngjeshur me pikat kryesore të secilit titull elektronik dhe të shtypur.[9]

PIKAT VLERËSUESE[10]

Bibliotekarët i bëjnë dysh mendjet e tyre për faktin se cilat janë enciklopeditë më të mira. Vendimi merret apo formohet më shumë në përdorimin

[8] Ndoshta, një përshkrim më i mirë në traditën e kërkimit është ajo se web është një "indeks" i pafund. Në fakt, web-et e kërkimit janë indekse të komplikuara të njohurisë Online të enciklopedive. As njëra nga këto nuk ka rëndësi, mirëpo i rikujton të gjithë bibliotekistët se më shumë zbulime ka më shumë deja vu.

[9] Kjo është ri-botuar me shumë pikë tjerë të vlerësimit të enciklopedive, duke përfshirë që të dy versionet. Purchasing an Encyclopedia: 12 Points to Consider (Çikago: Asociacioni i Bibliotekave të SHBA-ve, 1999 e deri më sot, e përvitshme.

[10] Këto janë pikat që përdoren për të vlerësuar përmbledhjet e shtypura. Po ashtu, përmbajtja e versionit elektronik është shumë e ngjashme. Kështu, pikat janë të aplikueshme edhe në formatet e tjera.

e përditshëm. Mirëpo, janë edhe shumë pika të tjera specifike për të gjitha punët e referencave që duhet të merren në konsideratë kur bëhet ky vlerësim: (1) fusha, apo horizonti që mbulon, theksi i veçantë dhe audienca së cilës po i drejtohet; (2) autoriteti, i cili përfshin saktësinë dhe besimin nga publiku; (3) pika e përqendrimit dhe objektiviteti; (4) stili i të shkruarit; (5) freskimi që nënkupton planet e korrektimit, nëse ka ndonjë, nga ana e botuesit; (6) aranzhimi dhe të hyrat; (7) indeksimi i referencave në atë se si ju mund të gjeni qasjen për informatat në atë përmbledhje; (8) formati, që përfshin formatin fizik dhe ilustrimet; (9) çmimi; (10) prania e bibliografive.

Reklamimi i dikton ndryshimet dhe kjo ka efekte më të mëdha te enciklopeditë elektronike. Gati çdo vit, është një dallim i madh në tituj. E vetmja ngjashmëri duket të jetë emri i botuesit, p.sh. "Microsoft", "Grolier", "World Book" etj. Shembujt e variacioneve të emrave prej vitit në vit: (a) *Compton's Interactive Encyclopedia tek Compton's Encyclopedia, Deluxe Edition; (b) Microsoft Encarta Multimedia Encyclopedia tek Microsoft Encarta Encyclopedia Deluxe; (c) New Grolier Interactive në Grolier Multimedia Encyclopedia Deluxe*. Që do të thotë se në cilindo emër që ka një enciklopedi, bibliotekari shpejt është në gjendje ta dijë apo ta bëjë ndarjen në emra.

Sfera

Sfera apo horizonti i enciklopedive të specializuara është evidente nga emri i tyre dhe është më se e qartë te ne. Horizonti që mbulohet në enciklopedinë e përgjithshme është i diktuar në radhë të parë nga dy gjëra: për çfarë moshe dhe theksi.

Mosha për të cilën ofrohet. Enciklopeditë e fëmijëve sikurse ajo e World Book janë të lidhura me planprogramin mësimor. Në këtë drejtim, ato përfshijnë materiale të zgjeruara në temat me interes të përgjithshëm për nxënësit e shkollave fillore dhe atyre të mesme sesa përfshijnë enciklopeditë për të rritur, sikurse ajo Britannica. Shumica e botuesve të enciklopedive dëshirojnë marketingun më të madh të bëjnë te të rriturit nëpërmes fëmijëve. Të gjitha enciklopeditë standarde thonë se një publik që përfshin klasën e 6-të deri te ajo e 12-të mund t'i kuptojnë edhe t'i përdorin punët përkatëse. Kjo ndoshta është e vërtetë me rastin e fëmijëve shumë

të zgjuar, mirëpo shumicës së bibliotekarëve i është thënë se duhet të kontrollojnë moshën e blerësit apo shfrytëzuesit të materialit, dhe jo vetëm të bëjnë reklamim të moshës për të cilën ofrohet.

Janë dy pasoja nga tentimi që të etiketohen të njëjtat gjëra për të gjitha moshat: (1) në të shumtën e enciklopedive për të rritur ku materiali apo dokumenti përfundohet shkurtimisht, në mënyrë që edhe fëmijët ta kuptojnë atë, humbasin të rriturit; dhe (2) mundi për ta bërë sa më të qartë për moshat më të vogla në të shumtën e herëve rezulton në thjeshtësim aq sa nuk duhet për gjëra mjaft të ndërlikuara.[11]

Nëse mosha dikton një qasje në një fushë të caktuar, atëherë theksi i veçantë i editorit duhet të bëhet në fushat e tjera. Në të kaluarën, kanë qenë shumë variacione në fokusimin e gjëra sesa janë sot; një përmbledhje mund të ketë qenë jashtëzakonisht i mirë për shkencë, e një tjetër për letërsi. Sot, theksi është çështje e se çfarë kompromisi do të bëhet ndërmjet diturisë dhe popullaritetit. P.sh. pse i jepet shumë më shumë hapësirë temës së marketingut sesa demokracisë gati në të gjitha enciklopeditë për të rritur? Kjo nuk është për të bërë replikë apo për t"i argumentuar meritat e një fushe të caktuar. Në të vërtetë, është për të thënë se theksi i ekzaminimit është metoda për gjetjen e fushës.

Fusha Online CD-ROM. Në termin elektronik, fusha e mbulimit apo horizonti do të thotë se sa shumë/ apo pak hapësirë dhe informata ka përfshirë botuesi në CD-ROM, Online versionin apo diku tjetër. Duke e krahasuar atë me versionin e shtypur, kjo nuk është më e aplikueshme. Pyetja e vërtetë (që shtjellohen më në detaje te "formati") është se sa material ekstra duhet të përshihet në enciklopedi. Si shtim i zërave, ilustrimeve të ndryshme etj., gati të gjitha përmbledhjet për adoleshentët e shkollës së mesme dhe studentët në fakultete e kolegje i shtojnë referencat standarde të librave prej fjalorëve dhe atlaseve e deri te librat e kuotimit dhe kalendarët. A janë të domosdoshëm? Sa shumë ky ekstra material është i inkorporuar në kërkimi?

[11] Më 1999 Britannica shkroi për lexuesit e tij të ardhshëm "Si një i rritur inteligjent...Britannica CD ju mundëson juve të bëni gjëra që ju kurrë nuk i keni paramenduar." Disa paragrafë më vonë shkruan: "Duke folur për fëmijët, prindërit pajtohen se Britannica CD është një e dhënë jashtëzakonisht e rëndësishme për edukimin e tyre. " E-mail-at që vijnë çdo dit në adresat tona elektronike janë të njëjtë. Botuesit duan të shesin atë në çdo mënyrë. Kjo përmbledhje është i përshtatshëm si për të vjetrit po ashtu edhe për fëmijët që janë në hapat e tyre te parë.

Besueshmëria

Një pyetje e rëndësishme që duhet t'i shtrohet çdo libri të referencave ka të bëjë me autoritetin apo besueshmërinë e vet atij libri. Nëse libri është i besueshëm dhe ka autoritet, në të shumtën e rasteve ai libër është objektiv, i kohës dhe shumë i saktë.

Besueshmëria është evidente edhe në emrat e shkencëtarëve dhe dijetarëve apo ekspertëve, të cilët i nënshkruajnë ata artikuj ose që janë të radhitur diku në atë përmbledhje. Kjo, po ashtu është e shoqëruar edhe me emrin e botuesit, i cili e distribuon përmbledhjen.[12] Janë tri gjëra, në të cilat mund të matet besueshmëria: (1) njohja e një emri eminent, posaçërisht e autorit më të mirë të ndonjë libri në atë fushë të caktuar; (2) një inspektim i shpejtë i fushës së lexuesit për të parë nëse liderët që udhëheqin në atë fushë të caktuar janë të prezantuar në listën e kontribuesve; dhe (3) më në fund, të shihet dhe të vendoset nëse kualifikimet e kontribuesit (nga pozita, shkalla e shkollimit, profesioni dhe kështu me radhë) janë të lidhura me artikullin (artikujt).

Lexuesi merr një indikacion për kualitetin e një enciklopedie dhe për vitin e botimit të saj prej njohurive të tij mbi autorët. Disa kontribues mund të jenë të vdekur, e edhe pse një numër i caktuar i vdekjeve të këtyre autoriteteve është plotësisht i pranueshëm, shumë raste në këtë kategori do të tregonin ose kopjime të shumta prej përmbledhjeve më të vjetra ose për mungesë të një recensioni të mirëfilltë.

Për fat të keq, çdo enciklopedi përmban ose ka disa gabime dhe disa gjëra që i lë anash. Të shumtat e tyre përmirësohen kur vetë botuesi merr vesh për to. Testi real, natyrisht, se sa gabime të tillë ka një përmbledhje e caktuar. Përmbledhjet që trajtohen në këtë libër, edhe pse jo në mënyrë të përkryer, në të shumtën e rasteve nuk mund t'u gjeshë shumë gabime.

Pikëpamja dhe objektiviteti

Prej kur se enciklopeditë janë botuar si libra, që shiten dhe janë fituar para me to, qëllimi kryesor i tyre është ta joshë audiencën më të madhe dhe të

[12] Numri i botuesve, numri i përmbledhjeve (në formë elektronike dhe të shtypur) i enciklopedive të përgjithshme vazhdon të zvogëlohet. Botuesit e versionit të enciklopedive të përmbledhjeve të përgjithshme të aprovuar nga Asociacioni Amerikan i Bibliotekave janë shumë të paktë, p.sh. Grolier, Britannica, World Book, Compton's dhe Microsoft. Më nuk janë as kompanitë e mëdha sikurse Collier dhe Funk & Wagnall formatet elektronike. Është e mundur që shumë shpejt vetëm një ose dy prej këtyre botuesve do t"i kontrollojë përmbledhjet e përgjithshme të enciklopedive.

mos ofendoj asnjë njeri. Përkundër faktit se ato ndonjëherë thonë se janë objektive, ato janë të motivuara nga arsyet komerciale. Vetëm disa vjet pas nxitjes aktive të femrave për barazi gjinore, enciklopeditë filluan të përgjigjen në këtë segment të tregut dhe dhanë një kontribut të çmuar në barazinë gjinore, d.m.th. duke mos ia mbajtur anën asnjërës palë.

Anësimi i zhurmshëm gjinor dhe seksual është eliminuar nga enciklopeditë standarde dhe të pranueshme, mirëpo kjo nuk është ende e rivendosur mirë e aq më pak natyrale. Një rrugë për të parë këtë fushë të caktuar është vështrimi i emrave të femrave eminente, në veçanti atyre me prejardhje afrikane (zezake) apo spanjolle, dhe të shohësh sa mirë janë ato të prezantuara (nëse janë të prezantuara). Shiko dhe kontrollo, po ashtu edhe artikujt sikurse ngacmimi seksual, homoseksualizmi dhe aborti. Një kërkim i ngjashëm mund të bëhet edhe në fushat e tjera kontraverse prej hipnozës deri te vdekja e lehtë.

Një mënyrë tjetër për t'u parë pikëvështrimi është të shikosh çka ka futur dhe çka ka lënë anash, ta theksojnë apo mos ta theksojnë vetë korrektuesit.

Asgjë tjetër nuk mund të japë datë të saktë për ekzistimin e enciklopedive sikurse artikujt për idetë, që sot ose nuk janë të pranueshme ose interesi për to është shumë i vogël. Çdo enciklopedi që i ofrohet lexuesit perëndimor është shumë e mundshme të japë shumë më pak shpjegime për lexuesit në Egjipt krahasuar me ata të Nju-Jorkut. Po ashtu, vetëm zonja në gojë e Egjiptit nuk do të ishte gjë e mençur aspak, posaçërisht në pikëpamjen e historisë antike dhe futja e Afrikës si një forcë e re në botë.

Online CD-ROM Authority & Viewpoint. Të gjitha rregullat e lartpërmendura janë të aplikueshme te versionet elektronike të enciklopedive. Dhe, derisa nuk ka asnjë lloj problemi në caktimin e besueshmërisë sipas reputacionit të botuesit dhe autorëve në versionet e shtypura, në disa raste kjo bëhet mjaft e vështirë për enciklopeditë elektronike. Pse? Sepse shumë shpesh asnjëra palë, as botuesit e as autorët nuk kanë besueshmëri që duket. Kjo nuk është e vërtetë, natyrisht, në përmbledhjet e shtypura me homolog. Mirëpo, është një problem i madh me: (a) nuk ka indikacion se kush është botuesi ose sponsori i enciklopedisë dhe/ose cili është linku që është përdorur nga ajo enciklopedi. Edhe kur jepet emri, shumë shpesh nuk ka rrugë për ta matur sa legjitim është kjo besueshmëri e autorit dhe botuesit; (b) të dhënave faktike u mungojnë citimet, ose

shprehur më mirë datat, autori etj.; (c) publikimet në atë web-sajte mund të ndikojnë anshmëri; (d) dhe shumë shpesh është vështirë të thuash apo të gjykosh nëse enciklopedia, web-sajti, ose gjithçka tjetër është punë e një punëtori të madh, që ka pikëpamje ose e dikujt që ka qëllimin e mirëfilltë të informimit.

Të gjitha këto metoda në matjen e besueshmërisë dhe objektivitetit për punët e shtypura duhet të përdoren për titujt elektronikë dhe, sikurse u tha më parë, duke pasur kujdes të veçantë.

Stili i të shkruarit

Kur dikush shikon te stili i të shkruarit në enciklopeditë e ditëve të sotshme, ai/ajo vëren se asnjë nga përmbledhjet e përgjithshme nuk i adresohet ekspertëve. Duke e parë se njerëzit e thjeshtë janë shumë më shumë në numër sesa numri i shkencëtarëve dhe dijetarëve dhe blejnë shumë më shumë vëllime, firmat e enciklopedive dëshirojnë që të pushtojnë tregun në një metodë të veçantë: Disa tituj ose tema të caktuara u jepen kontribuesve dhe një diagram, ku shkruan se çka pritet nga ata. Dorëshkrimet e tyre pastaj dorëzohen te redaktorët (stafi redaktues i enciklopedive të mëdha përfshin diku prej 100 deri 200 njerëz që punojnë me orar të plotë), të cilët i përmirësojnë ato- të gjitha këto bëhen për ta bërë materialin të kuptueshëm për lexuesit. Korrektimi ose redaktuara dallon nga enciklopedia në enciklopedi dhe audiencat e tyre. Mund të jetë mjaft e gjëra për enciklopeditë e fëmijëve (ku vështirësitë në fjalë dhe gjatësia e fjalive janë të rëndësishme gati sa edhe vetë përmbajtja), ose mund të jetë e limituar për versionet e të rriturve.

Duke shërbyer si një urëlidhëse ndërmjet atyre që e shkruajnë (kontribuesit) dhe lexuesve, redaktori apo mundohet ta bëjë materialin sa më të lexueshëm, duke e hequr vokabularin e komplikuar dhe zhargonet e rrugës, dhe termat që janë të pakuptueshëm për njerëzit e thjeshtë ose të rinj. Qëllimi i kësaj është ri-frazimi i specializuar i mendimit në gjuhë jo të ndërlikuar dhe duke mos e pakësuar atë mendim- ose duke e ofenduar një autor eminent. Në punët për humanitetet dhe shkencat sociale, kjo në të shumtën e rasteve ka sukses. Dijetarët që kontribuojnë duhet të jenë të gatshëm për inicialet e tyre në versionet që kanë qasje më të lehtë në punët e tyre.

Recensione: Korrektimi i vazhdueshëm

Si gati të gjitha kompanitë më të mëdha të enciklopedive që lëshojnë versione të reja të përmbledhjeve të tyre, ose vëllime të ripunuara gati çdo vit, po ashtu në të përfshijnë ndryshimet më të reja. Bazat e të dhënave elektronike e bëjnë këtë proces jashtëzakonisht të lehtë; redaktorët mund të fusim materiale të reja, të fshijnë ato, dhe t"i korrigjojnë pa e shikuar artikullin e caktuar nga fillimi.

Pa marr parasysh çfarë procedura teknologjike duhet të bëhen për futjen e informatave të reja, një bibliotekar duhet të dijë: (1) vetëm disa enciklopedi të përgjithshme përdorin "redaktim" si një indikacion i punës së tyre aktuale. Për shembull, edicioni i 14 i Britannica-së pati jetë nga viti 1929 e deri më 1974 kur u botua vëllimi i 15-të; (2) të dhënat relative të të shtypurit do të gjenden në faqen e titullit, mirëpo kjo në vetvete nënkupton shumë pak për arsyen se nuk ka një matje të sofistikuar se sa shumë dhe sa shpesh është korrigjuar një enciklopedi e caktuar. Shumica e botuesve të mëdhenj thonë se çdo vit i korrigjojnë 5 deri 10 % të materialit. E thëna se botuesit i korrigjojnë dhe rishikojnë artikujt është shumë aktuale në ditët e sotme për ata botues që janë të përshirë me shitjen e këtyre përmbledhjeve te bibliotekat. Arsyeja pse një bibliotekë nuk do ta blejë versionin e ri të enciklopedisë së njëjtë është nuk ka shumë korrigjime në të; (3) shumica e enciklopedive i korrigjojnë materialet në çdo version të shtypur apo elektronik. Shtypja bëhet çdo vit, ose më së largu çdo dy vjet.

Derisa erdhi puna elektronike, botuesit më shumë i besonin botimit të përvitshëm, kështu që t'i mbanin enciklopeditë në hap me kohën. Kjo ishte më shumë gjë psikologjike dhe një mbështetje sesa një përpjekje e vërtetë për freskimin e këtyre enciklopedive me informata. (Shiko, një seksion më vonë, që flet për vjetarët).

Recensioni digjital. Është normale që enciklopeditë digjitale, sikurse edhe shumë punë të tjera referencore, janë të freskuara me informata në dy mënyra: (1) botuesi thjeshtë duron, në të shumtën e rasteve çdo vit, një version të ri të enciklopedisë CD. Kjo është me një çmim më të lirë duke u bazuar në blerjen iniciale dhe marrëveshjen për të vazhduar çdo vit blerjen e versioneve të reja; (2) botuesi ofron versioni të rishikuara dhe me informata të reja, gati ditore ose mujore, përmes Internetit. Freskimet

Online me informata konsistojnë me artikuj të korrigjuar që reflektojnë të arriturat e reja në shkencë, marrëdhëniet ndërkombëtare etj.

Është një gjë që duhet përmendur se teknologjia moderne i bën të mundshme freskimet e shpejta dhe efektive me informata. Është gjë tjetër të kesh staf të njerëzve që i bën ato ndryshime. Analizat e ndryshme tregojnë, kohë pas kohe, se edhe përkundër mrekullisë së korrektimit digjital, shumica e botuesve nuk bëjnë më shumë ribotime apo freskime me informata sesa që bënin me versionet e shtypura.

Në mënyrë për të qenë në hap me kohën, botuesit e enciklopedive i përgatisin versionet e reja, duke i shkurtuar versionet më të vjetra. Kjo ndoshta është e arsyeshme, mirëpo ka shumë të meta për bibliotekarët, të cilët mund të jenë të interesuar për të dhëna historike, bibliografi dhe materiale për të cilat botuesi nuk beson më, që janë në interes të lexuesve. Bibliotekat e mesme dhe ato të mëdha, e posaçërisht ato që përdoren për kërkime, kanë më pak vështirësi me problemet për shkakun se i ruajnë përmbledhjet më të vjetra.[13] Mirëpo, shtrohet pyetja se si një njeri mund t'i ruajë këto përmbledhje, që janë Online një ditë ose një vit, dhe të nesërmen nuk i sheh më? Kjo pyetje ka përgjigje shumë komplekse.

Rregullimi dhe shënimet

Rregullimi tradicional i enciklopedive të printuara apo të shtypura është i njëjtë sikurse qasja alfabetike te materialet, me shumë referenca të

[13] Një bibliotekë e kërkimit gjithsesi i përfshin punët më të vjetra dhe edicione të caktuara të Britannica-së. Edicioni 11 (1911) për shembull është një përmbledhje e mrekullueshme e shekullit XIX, dituri që nuk mund të gjendet në përmbledhjet e tashme. Një bibliotekist akademik e quajtur Susan Kraats jep dy shembuj se pse punët ose enciklopeditë e vjetra janë të rëndësishëm: (1) Ka një referencë të së djeshmes për një autori quajtur Burmann i cili shkroi veprën e quajtur Anthologia Veterum Lationorum Epigrammatum et Poematum. Deshi të dijë emrin e plotë, nacionalitetin e autorit, dhe punët e tjera të tij, etj. Kështu, që unë gjeta këto informata në OCLC dhe e pashë që emir i tij ishte Pietro Burmanni... Natyrisht, sikurse edhe doli, emri i tij ishte Piter Burmann, (Secundus), një dijetar Holandez i shekullit të XVIII. Mirëpo, çka nuk dija unë ishte në edicionin 11 të Britannica Encyclopaedia. (2) Matematicientit zviceran, Leonhard Euler në edicionin më të fundit të Britannica i janë dhënë lëvdata të shumta për kontributet e tij art. Informatat faktike që po ashtu kanë mungesë të kualiteteve njerëzore. Për këtë arsye, unë u ktheva tek një artikull tjetër në edicionin 11. Këtu janë detajet e shumta për jetën e tij sikurse "Ai vdiq prej apoleksis në shekullin XVIII, muaji shtator 1783, derisa ai po e argëtonte vetveten me një çaj dhe po luante me nipin e tij." Dhe: "Ai do të mund ta përsëriste Aeneid të Virgjilit prej fillimit deri në fund pa hezitim, dhe po ashtu tregon rreshtin e parë dhe të fundit të secilës faqe të edicionit që ai përdor."

kryqëzuara dhe indekse. Përdoruesit mesatar janë të mësuar me radhitjen alfabetike të informatave, ose me shënimet e veçanta. Këtu, informatat janë të ndara në pjesë të veçanta, mirëpo të dhënat janë të organizuara sipas alfabetit.

Rregullimi digjital. Formati elektronik nuk është i preokupuar me rregullimin dhe radhitjen; mirëpo, përdoruesi është i vendosur në pozitën që është i varur në programet e besueshme softuere të kërkimit, në mënyrë që të gjejë çfarë ai/ajo mund të zbulojë, duke përdorur referencat e kryqëzuara, radhitjen alfabetike të indekseve. Në këtë kuptim "rregullimi" apo radhitja është shumë e rëndësishme për versionet elektronike. Duhet të jenë shumë rrugë për kërkim prej Logjikës Boolean deri te indeksi aktual.

Indeksi

Disa botues kanë ardhur në përfundim se fjalën e përshtatshme det dhe me referencën e njëjtë det, radhitja alfabetike i shërben eliminimit të indekseve.

Një argument shumë i rëndësishëm që jepet për indekse është ai që indeksi më i thjeshtë, sesa një artikull që ka në përbërjen e tij shumë emra të njerëzve dhe të ngjarjeve të ndryshme, të cilat nuk mund të ndahet nëse nuk ekziston një vëllim i detajuar i indeksit dhe që është i ndarë.

Indeksi digjital. Kërkimi i enciklopedive elektronike bëhet në të shumtën e rasteve duke shtypur një fjalë të caktuar dhe/ose duke përdorur logjikën Boolean. Indeksi nuk është esencial. Megjithatë, indeksi mund të jetë një ndihmë e madhe, në veçanti për të zbuluar termat që janë të radhitur në mënyrë alfabetike për gjënë që jeni duke bërë kërkim. Po ashtu, indeksi elektronik ndihmon në përmirësimin e gabimeve drejtshkrimore, ose së paku për ato fjalë që shkronja e parë dhe e dytë janë të sakta. Sistemet më të mira kanë, po ashtu indekse të modifikuara, sikurse edhe referenca të kryqëzuara tradicionale.

Formati

Një format i mirë i përfshin pikat sikurse madhësia adekuate, ilustrimet, lidhjet dhe radhitjen apo rregullimin e tërësishëm. Kur flasim për formatin, duhet të kemi parasysh:

Ilustrimet (Fotografitë, Diagramet, Tabelat dhe Hartat). Asgjë tjetër nuk ka ta bëjë me vlerësimin e enciklopedisë sesa një shikim i shpejtë e retrospektiv i ilustrimeve në atë enciklopedi. Duke shikuar ato, lexuesi e kupton sa aktuale është vetë enciklopedia. Mirëpo, vetëm se ilustrimet janë aktuale nuk do të thotë se ato janë të përshtatshme. Ato janë të përshtatshme vetëm atëherë kur kanë lidhje të drejtpërdrejtë me tekstin dhe me interesimet e lexuesve. Një bibliotekar mund të pyes: A i theksojnë ato çështjet e rëndësishëm, apo janë shumë të përgjithshme? A janë ato funksionale, apo vetëm atraktive për sy? A janë fotografitë adekuate?

Hartat janë pjesë shumë e rëndësishme e çdo enciklopedie dhe dallojnë në numra. Shumica e hartave janë të përgatitura nga Rand McNally ose C.S. Hammond dhe në të shumtën e rasteve janë harta për lakmi. Në përmbledhjet për të rritur, hartat kryesore shfaqen zakonisht në vëllime të ndara me indekse. Enciklopeditë e adoleshentëve dhe ato për fëmijë zakonisht i kanë hartat brenda tekstit dhe nëse ky është rasti, atëherë ato duhet të përshfijnë, nëse është nevoja, edhe referencat me indekse dhe referencat e kryqëzuara. Bibliotekari duhet të kontrollojë sa harta janë përdorur për t'i treguar qytetet më të mëdha në botë, zhvillimet historike, ndryshimet politike, përdorimi i tokës, moti dhe kështu me radhë. Vlerësimi aktual i hartave diskutohet në kapitullin mbi gjeografinë.

Shumica e versioneve digjitale mbështen apo ndjekin një rrugë standarde. Grolier Multimedia Encyclopedia ka diku 1 200 harta (Americana diku 900; World Book diku 850, e kështu me radhë). Pjesa më e madhe e tyre mund të printohen, bardh e zi, apo edhe me ngjyra. Të gjitha nga këto kanë një funksion "të veçantë", i cili i lejon lexuesit të zhvendosen prej hartës së një vendi të caktuar, në një qytet apo vend tjetër. Gjatë gjithë tekstit ka shumë linka për hartat politike dhe tematike. Dhe, po ashtu janë edhe një numër i madh i hartave të gërshetuara. Për shembull World Book lejon mbulimin (harta të veçanta), i cili tregon çdo gjë mbi një fushë të caktuar prej popullatës, klimës dhe industritë kryesore. Sado që të gjitha këto mund të hyjnë në përdorim dhe mund të jenë mjaft të shfrytëzueshme, harta e shtypur është shumë më lehtë të përdoret dhe po ashtu ofron një analizë më të thellë të fushave të caktuara.

Madhësia e formës. Madhësia e shkronjave dhe formatit është shumë i rëndësishëm sikurse edhe hapësira ndërmjet rreshtave dhe gjerësia e shtyllave apo kolonave. Të gjithë këta faktorë kanë rëndësi të madhe në lexueshmërinë e vetë asaj vepre.

Lidhjet. Enciklopeditë duhet të jenë të lidhura në atë mënyrë që të jenë të përdorshme edhe për përdorim të tepruar sikurse ai në biblioteka. Po ashtu, blerësit duhet t'i tregohet se metoda aktuale e rritjes së çmimeve të enciklopedive bëhet për qëllim që shfrytëzuesi ta ndërrojë enciklopedinë e tij, që në të shumtën e rasteve nuk është e lidhur më keq sesa kjo e reja dhe shumicën e rasteve qëndron më shumë.

Madhësia e vëllimit. Së fundi, konsideratë e veçantë duhet t'i bëhet madhësisë së vëllimit. A është fort e përshtatshme për ta mbajtur në duar? Aq e rëndësishme mund të jetë edhe hapja e saj e lehtë.

Formati CD-ROM Online: Derisa lidhja e enciklopedive dhe madhësia e tyre nuk është problem për botuesit e enciklopedive Online, çdo gjë tjetër që u përmend më lartë vlen edhe për to. Kualiteti dhe freskimi me informata të reja duhet të shoqërohen me ilustrime të mira dhe kualitative. Këtu, duhet të shtohet edhe fakti se sa kanë zërime, video klipe dhe animacione enciklopeditë Online . Natyrisht, botuesit e kanë shumë të qartë se shitja e këtyre vëllimeve dhe vlerësimi i kualitetit të tyre nuk është e vështirë të bëhet në ditët e sotshme.

Duke përdorur titullin "deluxe" ose "enciklopeditë e përshtatshme" botuesit tani shtojnë referenca të veçanta nga librat. Për shembull, Grolier Multimedia Reference Suite i përfshin, përmes të tjerash, edhe Barlett's Familiar Quotations, Hammond Atlas of the World, si dhe një kalendar. Sa është shtuar ai material, që "referenca e përshtatshme" na hyn në punë? Secili bibliotekar dhe njeri duhet ta pyesë veten për këtë. Mirëpo, mund të jetë pyetje më akademike sesa duket. Pse? Për arsye se shumë gjëra vizuale nuk janë përshirë, p.sh. përmbledhjet e CD-ROM-it kushtojnë nën $40. Edhe përkundër çmimit të lirë, kalimi nga pika A në atë B ndoshta nuk ia vlen edhe përkundër çmimit të ulët. Një enciklopedi e thjeshtë e shtypur mund të jetë shumë me efektive dhe më e lehtë për ta përdorur.

Çmimi

Disa përmbledhje të përgjithshme tani ofrohen falas në Internet, p.sh. *Britannica, Encarta* etj. Shumë të tjera do të bëhen së shpejti. Kjo ndoshta është apo nuk është gjë e mirë për bibliotekat që mbështeten në të dhëna objektive, mirëpo absolutisht është e rëndësishme për njerëzit dhe bibliotekat profitabile. Në të njëjtën kohë, të gjitha bibliotekat i kanë të dy versionet, versionin e shtypur dhe atë digjital.

Jo vetëm çmimet dallojnë shumë prej përmbledhjeve të ndryshme të shtypura, që shkojnë nga $1 000 e deri te shuma e mijëra dollarëve për të njëjtën gjë. Duke e parë aspektin e marrëdhënieve me publikun, botuesit e përmbledhjeve të përgjithshme japin zbritje të mira në çmime. Për shembull, kjo është e vërtetë për të gjitha përmbledhjet që konsiderohen këtu, *The Encyclopedia Americana* kushton diku $1 000 për biblioteka dhe dijetarët. Në shitore, ajo shitet $1 400. Çmimi i *The World Book* në shitore është diku prej $560 e deri më $679. Për bibliotekat kushton vetëm$550.

Bibliotekat blejnë vetëm 5 deri 6 % të të gjitha enciklopedive të shtypura që shiten dhe vetëm 1 % të versioneve elektronike. Ndërkaq, fitimi i botuesit nuk është në atë se sa shet ai, por sa është në aprovimin e vulës. Nëse botuesi e ka atë, atëherë ai duhet të jetë i mirë- dhe me atë, lexuesi nxiton për të blerë një kopje të enciklopedisë së bibliotekave ose enciklopedive.

Drita e njëjtë e gjelbër i inkurajon edhe personat joprofesionistë për t' i blerë enciklopeditë për një subjekt të caktuar. Këtu, po ashtu, biblioteka është një faktor kryesor në suksesin apo dështimin financiar të asaj enciklopedie. Sa më personal dhe i shtrenjtë që të jenë enciklopeditë në subjekte të caktuara, ato mund të shiten më lehtë te gati të gjitha bibliotekat ekskluzive. Pa këto blerje, botuesi do të ketë humbje të mëdha.

Është një konfuzion i madh në atë se cili është çmimi real i versionit CD-ROM dhe/ose enciklopedive Online edhe pse të gjitha nga to janë më të lira sesa versionet e shtypura; p.sh. kur botuesit konkurrentë eksitojnë. Çmimi i versionit CD-ROM sillet prej 30 deri 50 dollarë. Shumica e CD-ROM-ve kanë dy ose tri çmime: një për shitore, një për librari dhe një për shitësit e rrugës, ku çmimi më i vogël ofrohet nga shitësit e kompjuterëve. Po ashtu, shumica e enciklopedive CD-ROM shiten në këtë mënyrë dhe vetëm disa prej tyre shiten drejtpërdrejt te bibliotekat. Çmimet Online ndryshojnë shumë dhe duhet të shiten dhe të krahasohen edhe me bibliotekat e tjera.

KRAHASIMI I ENCIKLOPEDIVE TË MËDHA

	Artikujt	Ilustrimet	Hartat	Videot	Linkat	Indekset
Për të rritur Americana						
E Shtypur	45,000	23,000	1,300			354,000
CD-ROM	45,000	2,180	830		155,000	
Online	45,000	3,000	830		155,000	

Britannica						
E Shtypur	70,000	25,000	2,000			790,000
CD-ROM	83,000	6,500	1,600	40	30,000	
Online	80,000	10,000	dallon	dallon	144,000	
Versioni për të rritur Grolier (AcademicAmericana)						
E Shtypur	30,000	18,000	2,400			250,000
CD-ROM	37,000	15,000	1,200	177	26,000	
Online	37,000	6,000	850	150	55,000	
Encarta (Pa version të shtypur)						
CD-ROM	42,000	18,000	628	165	21,500	
Online	41,000	12,200	628	115	19,000	
Funk & Wagnalls						
E shtypur	32,000	16,000	800			135000
CD-ROM	32,000	16,000	653	50		
Online	32,000	12,000	653	100		
Collier's						
E shtypur	23,000	14,500				450,000
CD-ROM	23,000	18,000	400	100	3,000	
Online	23,000	18,000	400		3,000	
Për fëmijë						

Funk & Wagnalls						
E shtypur	32,000	16,000	800			135000
CD-ROM	32,000	16,000	653	50		
Online	32,000	12,000	653	100		
Collier's						
E shtypur	23,000	14,500				450,000
CD-ROM	23,000	18,000	400	100	3,000	
Online	23,000	18,000	400		3,000	
Për fëmijë						

World Book						
E shtypur	17,000	28,000	2,000			173,000
CD-ROM	20,000	9,500	1,060	122	15,000	
Online	20,000	8,100	960		15,000	
Compton's						
E shtypur	40,000	23,000	480			30,000

CD-ROM	40,000	16,000	470	600	4,000	
Online	40,000	15,000	704		4,000	

Shënim: Numri i artikujve nuk tregon asgjë për përmbajtjen e tyre dhe gjatësinë. Krahasimi është i vitit 2000. Të dhënat ndryshojnë, mirëpo ndryshimet relative nga viti në vit janë gati të njëjta.

ENCIKLOPEDITË PËR TË RRITUR[14]

Online: Britannica Online, Çikago: Encyclopedia Inc., 1994 e deri më sot, e tre muajshme, http://britannica.com. Çmimi ndryshon. Britannica.com. 1999 e deri më sot, www.eb.com. Pa pagesë.

CD: Britannica CD Multimedia Edition, 1993 e deri më sot, e përvitshme. $110.

E Shtypur: The New Encyclopedia Britannica. Edicioni i 15-të. 1771 e deri më sot. 32 vëllime. Çmimi $1 500. Versioni Ready Reference, 1998 e deri më sot, 12 vëllime. $500.

Online: Encyclopedia Americana Online. Danbury, CT: Grolier Intercorporated, 1997 e deri më sot, e përvitshme, http://ea.grolier/com. çmimi ndryshon.

CD: The Encyclopedia Americana në CD-ROM, 1995 e deri më sot, e përvitshme, $179.

E Shtypur: The Encyclopedia Americana. 1883 e deri më sot, 30 vëllime, $995.

Diku nga fundi i vitit 1999, *Britannica* ishte ajo që shpalli dhe që vendosi një standard që versionet Online të ofroheshin pa pagesë. Joshja falas është ajo që të marrë sa më shumë lexues dhe si shpërblim, ta mbulojë atë pagesën falas prej 50 dollarëve me reklama dhe publikime.

Deri nga mesi i vitit 2000, kompania ofroi dy versione Online. Versioni i The *Britannica.com* nuk është aq i mirë sa është *Britannica Online*, e cila ofron më shumë përmbajtje dhe tipare të veçanta, si dhe adresa të kërkimit. Anasjelltas, kjo mund t'i kushtojë një biblioteke diku

[14] Shënim: Këtu dhe gjatë gjithë kapitullit, duke mos lënë anash as tekstin, adresat për abonim apo nënshkrim (p.sh. pa pagesë) në bazën e të dhënave Online janë ato që janë dhëna nga ana e botuesit, a jo nga vetë qendra e të dhënave. Nëse dëshironi të gjeni baza të të dhënave falas atëherë: (a) Kthehu te web-sajti i bibliotekës suaj. Baza e të dhënave zakonisht është e shënuar aty me linkun për në web-sajt; (b) Provo ndonjë bibliotekë tjetër në lokacionin tuaj e cila ofron qasje falas në bazat e të dhënave; (c) Përdori adresat e dhëna nga botuesi. Ndoshta do t'ju duhet juve të kërkoni për tituj specifikë në katalogun Online të botuesit ose në sistemin e kërkimit. Nëse e gjeni, atëherë botuesi ndoshta do t'ju ofrojë 1 ose 2 orë falas për t"i parë shembujt e kërkimit. Shko drejt te adresat për bazat e të dhënave falas, sikurse ato që janë të shënuara me "Falas."

mijëra dollarë. Nuk ka shumë dallim të madh që t'i jepet garanci bibliotekës, e cila paguan, posaçërisht kur edhe përmbledhjet e tjera janë të gatshme.

Britannica është enciklopedia më e mirë dhe më e njohur në botën perëndimore. E botuar për herë të parë më 1768, ajo përshkroi shumë korrigjime dhe revizione derisa arriti te edicioni IX i mrekullueshëm i vitit 1889. Ky ishte edicion i "dijetarëve" me artikuj shumë të gjatë të shkruar nga njerëz sikurse Arnold, Swinburne, Huxley dhe disa mendje të ndritura angleze të shekullit të XIX. Nga fundi i shekullit XX-të, kjo enciklopedi është bërë mjaft e famshme, mirëpo mbetet e vetmja enciklopedi që është e mirë si për njerëzit joprofesionistë ashtu edhe për bibliotekarët.

Dy disqet e CD-ROM versionit kanë tekstin më të gjatë se secila enciklopedi tjetër (44 milionë fjalë), mirëpo ka mungesa të shumta në ilustrime (diku 10 000) dhe ka një rekord mjaft të varfër të tipareve multimediale, që u mungojnë ngjyrat, mocionet dhe është shumë e vështirë t'i përdorësh. Me këtë që u tha, është CD-ja ajo që kërkon jo vetëm disa rreshta por ndoshta disa faqe për t'u përgjigjur në këtë dyshim apo pyetje. Janë diku rreth 30 000 linka në Internet. Po ashtu, edhe atë që janë shtuar: *Rand McNally's New Millennium World Atlas dhe Meriam-Webster's Collegiate Dictionary*.

Vizatimi nën Vjetarin e shtypur, një "analist" jep informacione dhe të dhëna në 200 shtete të ndryshme dhe religjione. Kjo është aktuale. Një ecje nëpër kohë mundëson krahasim të mirë (prej letërsisë te shkenca) të ngjarjeve historike prej fillimit të tyre 9 000 P.L.K. e deri në ditët e sotme, ku edhe versionet Online ofrojnë artikuj nga poetë dhe shkrimtarë të famshëm nga edicionet paraprake.

Online. Online falas, *Britannica* është "blerja më e mirë" e përmbledhjeve Online. (Është e vërtetë se versionet Online bëhen goxha të shtrenjta, mirëpo bibliotekat duhet të jenë më se të kënaqura me versionet Online që ofrohen falas).

Duke e konsideruar faktin se sa shpejt dhe shpesh enciklopeditë Online freskohen me informata, enciklopeditë Online janë një gjë e domosdoshme për çdo bibliotekë, e cila ende nuk i ka ato për shkak të çmimit shumë të lartë të versioneve të shtypura. Në radhë të parë, ato përfshijnë përmbledhjen e plotë të atyre të shtypura, plus rreth 3 000 artikuj që nuk gjenden në edicionet e shtypura. (Diku totali është 80 000 artikuj).

Janë disa ilustrime në versionin e shtypur (diku 10 000) e po ashtu edhe atlas të plotë. Kjo i jep disa veçori. E para dhe gati kryesorja, edicioni Online freskohet me informata gati çdo ditë, e posaçërisht për llojin e artikujve që kanë të bëjnë me faqet e para të gazetave. Po ashtu, duhet të ceket se këto freskime me informata të reja më shumë janë të bazuara nga linkat e Internetit sesa me materiale në enciklopedi. Artikujt standardë mbi njerëzit, vendet dhe gjërat e tjera janë të ngjashme sikurse freskimi me informata i enciklopedive të shtypura, të cilat rishikohen diku prej 10 deri 15 % të materialit. E dyta, ofrohen po ashtu edhe të dhëna të gatshme mbi referencat (prej Book of Year) prej gati 200 vendeve të ndryshme të botës. Përsëri, kjo përmbledhje gjithashtu freskohet me informata. E treta, i gatshëm është edhe edicioni më i ri i *Merriam Webster's Collegiate Dictionary* (kjo firmë është në pronësinë e *Britannica*). Dhe, së katërti, janë shtuar disa ese, disa prej të cilave janë mjaft të gjata, të cilat janë marr prej disa edicioneve më të hershme të *Britannica* ("Britannica Classics") të shkruara nga njerëz të njohur sikurse Albert Ainshtajn dhe Orville Right. Në interesin historik, megjithatë këto demonstrojnë shumë qartë si përmbajtja dhe stili i të shkruarit nga përmbledhjet e vjetra i ofrohet një audience më të sofistikuar që nuk ka mundur të imagjinohet në ditët e sotshme. Po ashtu, 144 000 linka të ndryshëm të web-sajteve duken si shumë, mirëpo shpeshherë hyjnë në punë.

Dallimi në mes të fjalës pa pagesë dhe punë pa pagesë Online është $5 në muaj për njerëzit që i përdorin ato. Bibliotekat paguajnë më shumë. Është një diferencë shumë e vogël në mes këtyre dy gjërave që i përmendëm, mirëpo disa bibliotekarë mund të mendojnë se ia vlen për t"i kërkuar dallimet ndërmjet tyre. (Shih: www.eb.com/diff.html për sqarimet e botuesit për opinionet me dhe pa pagesë.)

E gjithë kjo është goxha gjë e këndshme, mirëpo duke e shikuar në prizmin e punës së një bibliotekari bëhet pyetja se sa i mirë është Net versioni i *Britannica*-s ose thënë më mirë çdonjëra enciklopedi në Net? Një bibliotekar i një universiteti thotë se "derisa ka shumë gjëra për t"i rekomanduar versionit Net të *Britannica*-s dhe titujve të referencave në Ueb (qasje më të lehtë), ato megjithatë kanë pengesat e njëjta me vetë Ueb-in. Ngjeshja e Internetit, apo qasja në Internet me një kompjuter të vjetër, modem të ngadalshëm dhe qasje të dobët të serverëve mund të kenë

[15] Karen Schlegl, "The Reference World Expands" Kompjuterët në Biblioteka, maj, 1998, f. 63.

ndikim të madh jo vetëm në atë se sa kohë iu merr kërkimi Online, mirëpo edhe në atë se sa një njeri kënaqet me atë se çka merr nga një web-sajt.[15] Duhet cekur se teknologjia është duke përparuar me hapa gjigant dhe derisa lexuesit arrijnë deri në atë pikë, ndoshta problemet më të mëdha do të kapërcehen.

Britannica/Shtypi

Teksti i gjetur në përmbledhjet e shtypura është identik, me përjashtim të informatave të reja, me atë që është gjetur në versionin elektronik. Dallimi më i madh është ajo se enciklopeditë e shtypura kanë më shumë ilustrime, mirëpo u mungojnë linkat nga Interneti. Përmbledhjet e enciklopedive të shtypura kanë këto elemente:

1. *Micropaedia* me 12 vëllimet e saj ka një material të paktë sa i përket referencave të gatshme, që janë të radhitura sipas alfabetit. Kjo është si një imitim i të hyrave që janë gjetur në punimet apo doreshkrimet e ndryshme në Evropë. Janë diku 65 000 futje të informatave dhe gati sa gjysma e këtij numri janë referenca të kryqëzuara. Gjatësia mesatare e një informate të futur është diku rreth 30 fjalë. (Disa prej tyre që janë për vendet, personalitetet e rëndësishme dhe idetë – shkojnë në më shumë se 3 000 fjalë, mirëpo këto janë përjashtime). Çdonjëra nga këto shërben për t'i përmbledhur dhe për t'i nënvizuara temat e caktuara. Shumë shpesh, më shumë detaje mund të gjenden në pjesën e përmbledhjes së quajtur *Macropaedia*.

Versioni i quajtur *Ready References i Britannica*-së është pak më shumë sesa një përmbledhje e versionit të shtypur nga Micropaedia. Shitet në shitoret e librave me çmim prej $500 dhe në të shumtën e rasteve hidhet në treg si një libër për gjetjen e shpejtë të referencave sesa për kërkim të hollësishëm. Ky libër iu hyn në punë disa blerësve, edhe pse një libër tjetër më një vëllim gjithashtu do të kryente punë. Duhet cekuar se kjo nuk i duhet bibliotekave, që e kanë gjithë përmbledhjen;

2. Pjesa e dytë e përmbledhjes, që njëjtë sikurse *Micropaedia* mund të përdoren vetëm, është *Macropaedia*. Të 17-të vëllimet ndjekin traditën e shekullit XIX duke ofruar artikuj të gjatë e me detaje të shumta (20-100 faqe), të cilat po ashtu janë të radhitura sipas alfabetit. Secili vëllim i ka diku 40 artikuj. Pra, të gjitha vëllimet i kanë diku rreth 675 artikuj. Në këtë pikëpamje, lexuesit i janë ofruar edhe analiza të shkurtra dhe tregime

mbi persona të caktuar, fusha, apo edhe për idetë në esetë e caktuara.

Udhëzuesi i ekzaminimit të hollësishëm është tabela e përmbajtjes në fillim të çdo eseje. Për shembull, në studimin bërë nga West Indies, në vend që të ndahen ishujt sipas alfabetit (sikurse bëhet në të shumtën e enciklopedive) ato janë trajtuar si tema të veçanta në *Macropaedia*. Pjesa që ka të bëjë me personat i trajton shumë vende dhe ishuj, mirëpo gjithmonë në kontekstin e artikullit kryesor. Kështu, të gjitha informatat që janë aty kanë lidhje logjike që rrallë gjenden në enciklopedi;

3. Bibliografitë e tanishme mund të gjenden në fund të artikujve të *Macropaedia,* mirëpo vetëm pas vitit 2000. Janë diku gati 25 000 ilustrime në Micropaedia. Ato zakonisht janë të në ngjyrat bardh e zi;

4. Të dy përmbledhjet mbahen së bashku nga dy vëllime të përbashkëta të indeksit dhe *Prapedia*, që në fakt është një udhëzues i indekseve që gjenden në këto dy vëllime. Duke iu referuar shprehjes nga marketingu si "dituri e shkrimit të lirë" ky vëllim i vetëm është i aranzhuar sipas subjekteve të gjëra. Ideja këtu është të bëjë një shkrim të lirë mbi diturinë e qenieve njerëzore, të tregojë marrëdhënien ndërmjet ideve, personave dhe ngjarjeve të ndryshme. Prapaedia është një zhgënjim i rekomandueshëm për arsye se kompleksiteti i diturisë nuk e lejon një qasje kaq të thjeshtë. Në anën tjetër, indeksi është njëri nga indekset më të mira për ndonjë përmbledhje dhe ka diku rreth 790 000 informata të gatshme.

Pikat e dobëta. Ngjashëm sikurse edhe përmbledhjet e tjera, Britannica ka një të metë të veçantë. Zakonisht i freskon me informata materialet që janë në lajme apo në klasë. Kompjuterët dhe rezultat nga zgjedhjet presidenciale freskohen me informata të reja. Kjo praktikë dështon të bëjë më shumë me informata "standarde" prej historisë së pikturës e deri te jeta e presidentit Grant. Botuesi thotë se 12 % e recensionit apo rishikimit të përvitshëm është i saktë, ani pse janë edhe shumë artikuj të tjerë që kanë nevojë t'u bëhet një rishikim.

Ndarja e përmbledhjeve të shtypura në dy kategori të veçanta është mjaft konfuze, që edhe pse formati i shërben shumë librave për referenca të gatshme, është shumë e paqartë për njerëzit e thjeshtë dhe joprofesionistë. Një tjetër vështirësi e madhe është ajo se shumë artikuj të detajuar në Macropaedia janë shumë teknikë (p.sh. shiko Matematikën) që janë të pakuptueshëm gati për të gjithë, përveç ekspertëve. Në të njëjtën kohë, shumë më sfiduese bëhet edhe freskimi me informata i artikujve të njëjtë në përmbledhjet e tjera.

Ilustrimet e vogla në Micropaedia janë në rregull, mirëpo shumë pjata e ilustrime të tilla nuk kanë fort lidhje me artikujt në fjalë. Kjo shihet të jetë posaçërisht e vërtetë për punën e disa artistëve, arkitektëve dhe disa njerëzve të tjerë të veçantë në grafikë. Artikulli i parë do të përfshijë dy ose tri ilustrime, mirëpo ilustrimet e tjera mund të shpërndahen në vëllime të ndryshme. Gjithashtu, ngjyra është përdorur me masë.

The Americana

The Encyclopedia Americana është e bazuar në edicionin e shtatë të enciklopedisë gjermane të quajtur *Brockhaus Conversations Lexicon*. Në fakt, përmbledhja e parë e botuar (1829 deri më 1833) konsistonte në artikuj të vjedhur e të përkthyer nga gjermanishtja. Më 1903 u bë e qartë se *Americana* ishte një përmbledhje e re, një libër i ri, ku shumica e artikujve, po ashtu ishin marrë nga *Brockhaus*. Kjo përmbledhje ishte ribotuar në vitin 1918 me disa ndryshime, edhe pse përsëri me materiale nga *Brockhaus*. Thuhet se kjo është enciklopedia më e vjetër amerikane që ekziston.

Sikurse edhe vetë titulli tregon, gjëja kryesore e kësaj përmbledhje është ta forcojë dhe ta theksojë historinë amerikane, gjeografinë dhe biografinë e saj. *The Americana* pa dyshim i kushton vëmendje të veçantë këtyre fushave, sikurse asnjë enciklopedi tjetër dhe është posaçërisht e dobishme për gjetjen e materiale për SHBA, që janë shumë pak të njohura. Megjithatë, vështrimi i përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara konsiston me gjetjen në enciklopeditë e tjera.

Për dallim nga *Britannica*, audienca e *The Americana* nuk janë nxënësit nga kolegjet dhe universitetet, mirëpo njerëzit e thjeshtë dhe jo specialistë. Stili i të shkruarit është shumë e lehtë të ndiqet dhe të kuptohet sesa në *Britannica*, dhe artikujt janë shumë më specifikë. Në anën tjetër, informatat kryesore të futura, sikurse ato për Japoninë, janë prej 100 e deri në 150 faqe. Duhet të ceket se këtu janë edhe indekset e shkëlqyera që kapin numrin 350 000.

Americana CD-ROM

Versioni i CD-ROM-it i *Americana* që erdhi së fundi (filloi së pari më 1995), është versioni elektronik që përmbledh 30 vëllime të përmbledhjeve të shtypura, edhe pse me një numër të konsiderueshëm të

ilustrimeve (diku prej 2 000 ilustrimeve në CD-ROM versioni përkundër 23 000 në versionin e shtypur). 45 000 artikujt janë ndër artikujt më të mirë që mund të gjenden në ditët e sotme, p.sh. shiko komentet në versioni e shtypur.

Çka po mungon: çmimi i ulët. Nuk ka zëra, video, ose kënaqësi të tjera elektronike. Këtu ka vetëm tekst dhe vetëm tekst. Kjo përmbledhje është për studentë seriozë dhe jo për ata që janë duke kërkuar të dhëna me zëra argëtues apo video dëfryese.

Çka është unike në CD-ROM? Shtesat: *Merriam – Webster Collegiate Dicitonary; Chronology of World History dhe Dictionary of Science and Technology*. Edhe pse nuk mund të përdoret shumë, asnjë nga këto nuk është aq e domosdoshme.

Janë diku rreth 155 000 tekste të nënvizuara me linkat e tyre, të cilat mund të gjenden vështirë në ekranin kryesor, që është një ekran me shumë foldera e shenja. Kjo i jep shtytje një qasjeje të re në informata, dhe në disa indekse më të përdorshme. Mirëpo, duhet thënë se kjo është më shumë punë sesa është e nevojshme për çdo njëri përveç hakerëve të kompjuterëve.

Një plus shumë i madh për këtë versioni është përzgjedhja shumë e mirë faqeve në Internet. Janë shumë përshkrime të hollësishme të cilat ndihmojnë shumë të vendosësh për një nga shumë zgjedhjet që ofrohen.

Grolier Online

Nën titullin "Grolier Online," kompani në fjalë ofron tri enciklopeditë kryesore të saj në një paketë speciale dhe të vetme, *Encyclopedia Americana Online, Multimedia Encyclopedia Online, New Book of Knowledge Online*, dhe *Nueva Enciclopedia Cumbre en line* për të cilën botuesi thotë se është "enciklopedia e parë Online në gjuhën spanjishte". Kjo paketë e përbashkët e këtyre tri enciklopedive kushton prej $325 për shkollat e deri më $695 për bibliotekat publike dhe ato akademike. (Çmimi bazohet në numrin e shfrytëzuesve e po ashtu edhe atë se sa përmbledhje janë zgjedhur- minimumi është 2 nga 3.) Një bibliotekar ose njeri i thjeshtë e joprofesionist e zgjedh punën apo materialin që ka gjasa më shumë që t"i përgjigjet pyetjes së tij/saj. Është një zgjidhje shumë e vështirë nga shkaku se *Americana* ofron të dhëna të shumta dhe në detaje derisa Multimedia është më e fuqishme në dhënien e përgjigjeve të shkurta dhe të shpejta me anë të animacione e video të ndryshme. *New Book of Knowledge* është për

fëmijë. Njerëzit shpresojnë se botuesit e tjerë do të ndjekin shembullin e njëjtë për skemën Online.

Duke e ndjekur modelin e zakonshëm, *Americana Online* i përfshinë të gjitha 45 000 artikujt që gjenden në versionin e shtypur dhe CD-ROM, plus përfshijnë edhe artikuj të tjerë kur Online shërbimi freskohet me informata gati çdo tre muaj. Grremçi, që nuk përmendet në publikime dhe reklama, është ajo se freskimi me informata i versionit Online është shumë përzgjedhës (artikujt në lajme, ngjarjet e rëndësishme lokale dhe ndërkombëtare etj.). Megjithatë, prapëseprapë versioni Online është shumë më përpara se versioni CD-ROM apo ai i shtypur.

Në Internet janë disa ilustrime (rreth 3 000) që mund të gjenden në vëllimet standarde[16]. Është e vërtetë, hartat, tabelat dhe gjërat nga arti janë aty, mirëpo ato nuk janë prodhim kolorit i artit dhe sporeve artistike apo diçka të tillë.

Americana /Versioni i Shtypur

Nëse *Americana* lexohet më lehtë sesa *Britannica*, nëse theksi kryesor herë-herë vihet mbi hobit (prej shtëpive e deri te modelet e hekurudhave) sikurse në politikë, fokusi është gjithmonë i lidhur me plan-programin e shkollave dhe me dëshirat apo interesimet e një personi të zakonshëm. Bejsbolli mund të jetë një atraksion, mirëpo artikujt mbi abortin dhe edukatën seksuale janë gati si të barabarta gjithandej, dhe nëse çdo gjë tjetër, duhet të jenë të balancuara dhe objektive.

Një plus shumë i madh për këtë përmbledhje është fakti se është aktuale. Çdo vit të gjitha 45 000 artikujt parimorë freskohen me informata dhe ilustrime të reja apo të përmirësuara futen në të. Bibliografitë, po ashtu shpeshherë freskohen me informata të reja.

Stili i të shkruarit është shumë i qartë, rregullimi dhe aranzhimi është për t'u admiruar, indekset janë të mira dhe formati i përgjithshëm (duke i përfshirë ilustrimet dhe madhësinë e shkronjave) janë mjaft adekuate. Një veçori apo tipar që jep ndihmë të madhe është përfshirja e përmbledhjeve të shkurtra, e tabelës së përmbajtjes në fillimin e çdo artikulli disa faqesh. Enciklopedia apo përmbledhja redaktohet dhe

[16] Për të qenë më të saktë (nga mesi I 2000): 800 harta, 1 000 tabela, 1 200 vizatime, dhe 275 flamuj. Racionale është ajo se 130 000 linka në Internet prej të cilëve shumica kanë ilustrime, e kompensojnë mungesën në përmbledhjen bazë. Ky është një arsyetim i pavend. Po ashtu, shumë shpesh linkat mund të na udhëheqin në vende qorre, p.sh. dorëshkrimet nuk kanë asgjë sa i përket ilustrimeve.

adresohet për njerëz të rritur që kanë të kryer fakultetin. Nuk është fort e përshtatshme (duke përjashtuar dëshirën e madhe të drejtave të autorëve) për fëmijët në shkollat fillore dhe të mesme.

Ilustrimet kanë lidhje me vetë tekstin. Hartat janë shumë të qarta dhe të lehta për t'u lexuar dhe kuptuar, ani pse hartat e detajuara për qytete të caktuara nuk janë gjithmonë aq të mira.

Theksi i veçantë është vënë mbi referencat e gatshme që janë të shkurtra, specifike, e që janë ideale dhe hyjnë në punë për punë me referenca. Megjithatë, disa herë ndodh që të ketë artikuj të gjatë, në veçanti ato që flasin për qytetet, shtetet dhe ngjarjet historike. Enciklopedia *Americana* është e jashtëzakonshme sepse ka artikuj konciz dhe shumë pak artikuj që bëjnë analiza të detajuara.

Pikat e dobëta. Edhe pse ky version bën punë të mirë në korrigjim e shumë artikujve dhe personaliteteve që ne shumë shpesh i shohim në lajme, kjo nuk qëndron edhe nuk është e vërtetë në korrigjimin e artikujve bazë. (Kjo deri diku qe ndihmuar nga programi dyvjeçar i freskimit me informata, 1997-1999, mirëpo ende ekziston si problem.) Mungesa e freskimit me informata të artikujve në kohë të caktuar në disa sfera mund të jetë një pengesë shumë e madhe, në veçanti në shkollat ku planprogrami është i lidhur me diturinë e përgjithshme. Versionet elektronike janë zgjedhja e parë dhe më e mirë për arsyen se ato janë më aktuale sesa përmbledhjet e shtypura.

Puna në art ende është shumë e varfër. Shumica e ilustrimeve janë në ngjyrat bardh e zi dhe ngjyrat e pikuara janë shumë larg atyre të vërtetave. Plani i përgjithshëm i tyre ndjek këtë shembull, e jo atë sjelljen depresive për grafikët. Pra, grafikët përbëjnë grupit që më së paku i kushtohet rëndësi.

Cila është më e mira

Shumica e bibliotekave duan t'i kenë të dy këto versione standarde të enciklopedive për të rritur. Qasja më e ndjeshme është ajo që ka qasje në formatin digjitale në të dy versionet. Nëse fondet e lejojnë një gjë të tillë, një bibliotekë do të duhej ta blinte, një vit versionin e shtypur e në vitin tjetër atë në CD-ROM.

ENCIKLOPEDITË E NJOHURA PËR TË RRITUR DHE ATA TË SHKOLLAVE TË MESME

Online: Grolier Multimedia Encyclopedia Online. Danbury, CT: Grolier Incorporated,
1996 e deri më sot, çdo katër muaj, http://gme.grolier.com. Çmimi fillon nga $395 e më lartë. Shënim: Në vitin 2000, të dy versionet, pra ai Online dhe CD-ROM e kanë të ngjitur edhe botimin "Year 2000 Grolier..." Edhe pse ndonjë herë përdoret emër tjetër, është botimi i njëjtë.
CD: Grolier Multimedia Encyclopedia (e titulluar po ashtu edhe si: New Grolier Interactive Encyclopedia. 1985 e deri më sot, e përvitshme. $60.
E shtypur: Academic American Encyclopedia, 1980 e deri më sot, 21 vëllime. $725.

Online: Encarta Online Deluxe. Redmond, WA: Microsoft Corporation, 1996 e deri më sot, e përvitshme, http://encarta.msn.com/EncartaHome.asp. Ofrohet falas në Internet.
CD dhe DVD: Microsoft Encarta Multimedia Deluxe Encyclopedia, 1993 e deri më sot, e përvitshme. $30. Edicioni deluxe me tri disqe, $70. Versioni DVD:
Encarta Reference Suite 200-DVD, 2000 e deri më sot, e përvitshme. $99.

Online: Funk & Wagnalls Encyclopedias. New York: Versaware, 1998 e deri më sot, freskohet me informata çdo ditë,
www.fuckandëagnalls.com .
Falas *CD dhe DVD*:
Funk & Wagnalls Multimedia Encyclopedias; 1998 e deri më sot.
$25. (Shënim: Versioni gati si i njëjtë është edhe Simon & Schuster New Millennium Encyclopedias që kushton vetëm 20 dollarë. New York: Simon & Schuster, 1999 e deri më sot.)

CD: Collier's Encyclopedias. New York: Sierra Online (i.e., Microsoft) 1996 e deri më sot, e përvitshme. 50 deri 80 dollarë.
E shtypur: New York: Collier Newfield, 1951 e deri më sot, 24 vëllime. $850.
Dy konkurrentët më të mëdhenj në fushën e enciklopedive për të rrit-

ur/të rinj janë *Grolier* dhe *Encarta Microsoft* që kanë version të shkëlqyer të CD-ROM dhe versione Online shumë të mira. (Collier's ia shiti të drejtat e tij elektronike Microsoft-it, kështu që versioni elektronik i Collier's është një produkt tjetër i Microsoft.) Që të dy këto ndërmarrje kanë numër të njëjtë të artikujve dhe ilustrimeve dhe që të dyja kushtojnë si njëjtë. Cila prej tyre është më e mirë? Asnjëra nga to, për arsye se çdonjëra e kompleton tjetrën dhe iu duhet t'i keni që të dyja.

Grolier Multimedia/Online

Grolier (versioni deluxe) ka diku rreth 10 milionë fjalë dhe diku rreth 37.000 artikuj (Encarta ka 10.5 milionë); Grolier thotë se ka 15.000 fotografi dhe 177 video e animacione. (Encarta: 12 500 fotografi, 4 000 këngë dhe kaseta të incizuara dhe 140 video dhe animacione). Grolier ka 26 000 linka të web-sajteve kurse Encarta ka vetëm 13 500 sosh.

Sipas të dhënave statistikore, çdo njëri mund ta vërejë se cila nga këto dy enciklopedi është më e mirë në fushë të caktuar, dhe anasjelltas. Këto janë dy nga versionet elektronike më të sofistikuara. Dhe, prej 37 000 artikujve, 5 000 prej tyre janë unikë dhe nuk gjenden në versionet e tjera Online. Sikurse teksti që freskohet me informata çdo muaj, nga fundi i vitit mund të gjenden artikuj në Grolier që s'mund të gjenden në ndonjë vend tjetër. Pengesat apo dobësitë kryesore të Grolier janë këto: (a) janë shumë pak ilustrime, pra 15 000 ilustrime përkundër 18 000 sosh në versionin e shtypur; (b) jo sikurse në CD, janë shumë pak tipare interaktive ose video-klipe.

Duke e përcjell filozofinë që thotë se sa më shumë aq më mirë, versioni Grolier CD-ROM jo vetëm që përfshin enciklopedinë e përgjithshme, mirëpo: (1) ka qasje Online në librat apo punimet e tjera të mëdha të kompanisë, p.sh. Americana dhe New Book Knowledge; (2) përfshin një libër të vogël të quajtur How to Improve Your Grammar and Usage; (3) një libër për të bërë edhe teste të ndryshme; (4) Bartlett's Familiar Quotations, edicioni më i ri; (5) The Hammond Atlas of the World, përsëri, edicioni më i ri; (6) The Wall Street Journal Almanac; (7) The New York Times Book of Science Questions; (8) një kalendar të ngjarjeve; (9) panorama prej 100 deri 360 shkallë, 163 video dhe diku më shumë se 50 cicerone turistike; (10) një atlas më 1 200 harta.

Po ashtu, janë edhe 26 000 linka për të pasur qasje në web-sajte të caktuara e relevante. Këto, në "indeksin e Internetit" janë gjithmonë

përkrah subjektit të cilin jeni duke e kërkuar. (Mirëpo, nuk ka rrugë të lehtë për të parë të gjithë indeksin. Ju mund të shikoni së pari subjektin, personin, vendin etj., për të pasur një indeks relevant në ekranin tuaj.)

Përkundër peizazheve, videove dhe grafikëve të shumta dhe ndonjëherë dhe fascinonte, shumë tipare të tjera janë futur këtu për të inkurajuar punën në shkolla.

Më e mira nga ato është seksioni i "Research Starters" i cili përfshin lëndët kryesore prej historisë e deri te shkencat fizike. Secila nga këto ka tekstin e vet, zërin, videot dhe çdo gjë tjetër, që duket interesante për një lexues të moshës së re. (Kjo mund të ketë vlerë të paktë për të rriturit, mirëpo Grolier koncentrohet më shumë në studentë).

Pyetje: A është kjo enciklopedi apo një tregim i përgjithshëm? Përgjigjja: Përmbledhja si përmbledhje është në rregull, mirëpo lundrimi nëpër të gjitha këto informata të tepërta në të shumtën e rasteve merr më shumë kohë sesa t'i hedhësh një shikim në versioni e shtypur. Po ashtu, mund të bëhet shumë konfuze posaçërisht për të rinjtë. Megjithatë, shumë njerëz iu pëlqejnë këto video dhe zëra. Magjia e këtij vëllimi është integrimi i të dhënave. A është kjo e vetmja arsye për çka shërbejnë enciklopeditë? Përgjigjja varet nga vetë përdoruesi.

Academic American/ E shtypur

E botuar për herë të parë më 1980 nga një firmë holandeze, e cila më vonë ia shiti këtë Grolier, the *Academic American Encyclopedia* është përgatitur posaçërisht për studentë të shkollave të mesme dhe për njerëz të thjeshtë. Kjo përmbledhje me 21 vëllime ka diku rreth 30 000 artikuj, shumë ilustrime (diku 18 000) dhe një stil të të shkruarit që kuptohet lehtë dhe krijon shumë pak vështirësi në termat e kuptimit të fjalëve ose shtrimit të ideve komplekse. Përmbledhja e shtypur freskohet me informata rregullisht ku gati 10 % e gjithë materialit ndryshohet ose ndërrohet i tëri brenda një viti. Pra, redaktorët e këtij botimi janë shumë të kujdesshëm dhe mundohet të jenë sa më në hap me kohën sa i përket ngjarjeve. Kjo përmbledhje është një prej më të mirave për të gjetur legjislacionin e ri të aprovuar nga Kongresi Amerikan ose për ngjarjet se kush e fitoi këtë apo atë çmim në sport, apo letërsi në vitet e kaluara. Bibliografitë, po ashtu freskohet me informata.

Një veçori apo tipar i jashtëzakonshëm i përmbledhjes së shtypur janë

ilustrimet që janë shumë të pastër, të ndritshme, të zgjedhura mirë dhe shumë tërheqëse. Ato janë të pranishme gati në çdo faqe dhe përfshijnë fotografi, vizatime të ndryshme, harta, tabela, e po ashtu edhe ilustrime bombastike, të cilat tregojnë për shembull brendësinë e një anijeje apo një aeroplani.

Bazuar në të thënat e botuesit, 18 000 ilustrimet zënë gati 20 % të të gjithë përmbledhjes. 75 % të tyre janë me ngjyra. Në procesin e korrigjimit të tyre, redaktorët shtojnë ngjyra të reja dhe fotografi të reja gati çdo vit dhe niveli i përgjithshëm i ilustrime po vie duke u rritur. Përbërja e faqes nga ana grafike dhe forma e përgjithshme e saj janë ndër më të mirat.

Kjo përmbledhje, pra përmbledhja e shtypur, shumë mirë i eliminon paragjykimet dhe anësimet në shënimet biografike dhe ato të artikujve. Mirëpo, duhet bërë edhe më shumë në përfshirjen e më shumë grave të spikatura të botës moderne. Dhe, përfshirja e minoriteteve nuk është ajo që dëshirohet.

Indeksi me mbi 205 000 citime është një nga më të sofistikuarit në ditët e sotshme, që është po ashtu jashtëzakonisht i lehtë për t'u përdorur. Fatkeqësisht, botuesi nuk na jep referenca të mjaftueshme të kryqëzuara në këtë përmbledhje- është një mangësi e madhe ngase studentët shumë herë i harrojnë indekset dhe mbështeten më shumë në referenca të tilla. Një bibliografi prej më shumë se 200 faqesh ofron diku rreth 12 500 tituj duke i ndarë ata në subjekte të gjera dhe të ngushta.

Pikat e dobëta. Derisa shumica e materialeve janë çdoherë nën korrigjim dhe korrektim dhe derisa "lajmet" janë gjëra mjaft aktuale, faktet tregojnë që disa artikuj nuk janë të tillë. Edhe pse kualiteti i ilustrimeve është përmirësuar dukshëm, disa prej tyre ende nuk shihen mirë dhe nuk kanë lidhje me subjektin për të cilin bëhet fjalë. Pra, si përfundim, është shumë e vështirë të kritikohet kjo përmbledhje në fushat më të rëndësishme.

Encarta/ CD-ROM[17]

Një nga versionet më të mira të CD-ROM për enciklopeditë me subjekt të përgjithshëm është Encarta, që është një nga zbulimet më të mira të Microsoft.

Puna kryesore e tij është versioni i shtypur *Funk & Wagnalls* (32 000

[17] Më 1998, Microsoft lëshoi në shitje një nga enciklopeditë e parë në formatin DVD: The Funk & Wagnalls Unabridged Encyclopedia. Bazuar në botuesin, ky version është një kombinim i enciklopedisë së versionit deluxe, atlasit, dhe referencave të gatshme nga Bookshelf. Çmimi sillej diku 130 dollarë, mirëpo po shitej me çmim të përgjysmuar nëpër shitore.

plus artikujt)[18]. Duke filluar nga viti 1999, Microsoft i përfshiu edhe 3500 artikuj të tjerë prej Colliers. Është një bindje e përgjithshme se *Colliers, Funk & Wagnalls* dhe *Encarta* do të bëhen bashkë, apo që të tri punimet dhe përmbledhjet nga to do të kenë konfiguracion dhe përmbajtje të njëjtë, mirëpo mundësisht do të shiten me çmime të ndryshme.

Zbulimet janë fushat e tilla sikurse "rrethet virtuale", të cilat e lëvizin lexuesin nga brendësia e Westminster Abbey deri te hapësira sovajke. Janë edhe fotografi dhe pika avantazhi të cilat lejojnë një fotografi nga të gjitha skajet. Kërkimi është bërë goxha i lehtë, dhe shumicën e herëve videot, dhe pamjet vizuale janë të përziera me tekst ose filtrohen ashtu sikurse lexuesi dëshiron. Shiko, po ashtu, edhe "organizimin e kërkimit" e cila i ndihmon studentët të organizojnë tekstin dhe tiparet vizuale për projektet e tyre apo detyrat.

Shfletimi i quajtur "browse" ofron shumë qasje prej fjalës në fjalë e deri te termat e indekseve aktuale, që janë të shënuara me po, qenie njerëzore. Duhet cekur, po ashtu se ju mund të shfletoni "indeksin" sikurse mund ta bëni edhe me indekset në enciklopedinë e shtypur. Një gjë shumë e mirë për ata njerëz që nuk e pëlqejnë leximin është opsioni "sidebars" i cili ofron dokumente dhe përmbledhje të shkurta për atë se çka është gjetur në artikullin primar.

Sikurse edhe me enciklopeditë e *Grolier, Encarta* në mënyrë të vazhdueshme e zgjeron versionin e saj CD-ROM. Janë diku 5 disqe në versioni e saj deluxe. Për kundër përmbledhjes si përmbledhje, janë edhe: (a) *Microsoft Bookshelf*, i shpjeguar më herët, i cili i përfshin nëntë libra të referencave prej fjalorëve e deri te libri i citateve; (b) teksti që futet në kërkimin e fjalive që shumicën e rasteve bëhet më shumë për publicitet sesa ka ndonjë vlerë të veçantë, p.sh. ju mund të përdorni qasjen gojore duke shtruar pyetje, mirëpo vetëm ai daktilografi është më i shpejtë. (Kjo do të ndryshojë shumë shpejt dhe sipas të gjitha gjasave do të ndryshojë për të mirë). Janë edhe disa veçori të tjera prej "organizimit të kërkimit" që u cek më parë, të cilat ndihmojnë studentin t'i gjejë, t'i organizojë dhe

[18] Artikujt e shkurtër që nuk janë në lajme shpeshherë janë të njëjtë me edicionin e shtypur. Artikujt më të gjatë, në veçanti ata që gjenden në lajme e përfaqësojnë materialin e ri dhe korrigjimet e F & W.A ku krahasimi tregon se artikulli mbi Irving Berlin është shumë më i zgjeruar në versionin e shtypur dhe artikulli tjetër mbi Gaza është shumë më ndryshe. Në anën tjetër, artikujt e shkurtër, në të shumtën e rasteve ndjekin shembullin e versionit të shtypur. Shiko versionin elektronik të jetës së Bill Gates (nën atë të William Henry Gates III). Të gjitha në një vend. Kjo nuk mund të gjendet në versionin e shtypur.

t'i shkruajë esetë e ndryshme deri te "shikimi vizual i globit". Grremçi është fakti se kjo kërkon shumë hapësirë, pra 5 disqe. Në anën tjetër, është një nga versionet CD-ROM të enciklopedive më e lehta për t'u përdorur.

Versioni DVD i *Encarta* (i cili i ka disa emra, edhe pse emri *Encarta* shfaqen në çdo njërin nga ta) ka një avantazh kundër versioneve të tjera për faktin se e përmbledh të gjithë materialin në vetëm një disk, kështu eliminon nevojën për 5 disqe. DVD i përfshin të gjitha referencat *e Encarta* e po ashtu edhe linkat e web-sajteve të caktuara. Kur një bibliotekë ka DVD mjetin, ky version është shumë më i rekomanduar sesa versioni i CD-së.

Versioni Online i CD-ROM nga *Encarta* është një nga versionet e vlerësuara më së paku nga publiku. Po ashtu, artikujt janë të njëjtë.

Faqet e Internetit iu hyn në punë shumë profesorëve apo arsimtarëve. Në fakt, duket sikurse ky version i është dedikuar atyre pasi theksi kryesor është në materialet për mësuesit, planet e mësimit dhe gjëra të tilla. Është një mësim i mirë për organizimin e punës sipas subjekteve. Botuesi thotë se të gjitha materialet janë testuar nëpër klasat e shkollave. Freskimi me informata, për çdo muaj, shton plane të reja, tema, subjekte, si shtesë te mësimet paraprake. *Encarta* ofron 21 500 linka të web-sajteve të klasifikuara sipas moshës dhe klasave shkollore, fletëve të punës dhe udhëzimet kryesore.

Duke e zgjeruar krahun e referencave të kompanisë Microsoft, *Encarta* e përfshinë "globin vizual" dhe gjëra të tjera sikurse "artikujt aktualë prej më shumë se 800 revista, gazeta dhe të dhëna të tjera." Kjo është në hapat e gjetjes së mundësive të tjera, si p.sh. *Electric Library*. Duke filluar me ndonjë enciklopedi dhe duke ndërtuar biblioteka Online duket që është rruga më e mirë që kanë zgjedhur kompanitë më të mëdha Online. Grremçi: t'i duhet të paguash $9.95 çdo muaj nëse dëshiron ta përdorësh këtë shërbim. Ata ofrojnë një periudhë testuese falas. URL: (http://encarta.msn.com/library).

Funk & Wagnalls/Print

Një gjë që mund ta hasni në shumë supermarkete, *Funk & Wagnalls New Encyclopedia* është shembull i përkryer i një përmbledhje shembullore, në disa raste edhe e nënvlerësuar për arsyen e emrit të kompanisë që e mban atë. Disa nga veçoritë që i janë pranuar edhe nga Asociacioni i Bibliotekave Amerikane janë korrikjet e shpeshta, formati shumë i mirë, dhe çmimet shumë të ulët e bëjnë atë shumë joshëse te secili person. Së

paku është më e lira nga versionet e shtypura të enciklopedive.

Funk & Wagnalls ka përafërsisht numrin e njëjtë të fjalëve me enciklopedinë shumë më mirë të disenjuar *Academic Americana*. Këto dy enciklopedi janë diku si njëjtë në numrin e materialeve që përmbledhin dhe që të dyja janë goxha të mira në disa fusha.

Duke përjashtuar çmimin e ulët, *Funk & Wagnalls* i habit shumë njerëz me paraqitjen e thjeshtë të saj. Formati me dy kolona apo shtylla për çdo faqe nuk është tërheqës te lexuesit. Artikujt në të janë shumë të shkurtërjo më të gjatë sesa ¼ e faqes- dhe ilustrimet janë të shumta, mirëpo shumë pak tërheqëse. A është ky materiali që mund të gjendet në enciklopeditë tradicionale? Po, sepse në enciklopeditë e tilla artikujt janë të shkruar shumë mirë, nga njerëz me influencë dhe të mençur (janë diku rreth 1000 kështilltarë të jashtëm), janë artikuj aktualë dhe të ilustruar mirë. Ju mund të shkoni te kjo përmbledhje për çdo gjë apo artikuj dhe të jeni të sigurt se do ta gjeni. Në këtë aspekt, ky version jashtëzakonisht i mirë për nxënësit e shkollave të mesme ose për të rriturit që rrallëherë përdorin enciklopedi. Mundësia e përdorimit të lehtë ndihmohet prej më shumë se 135 000 shënimeve të indekseve nga vëllimi i saj i fundit. Duke i shtuar kësaj edhe seksionin e përzgjedhur me bibliografi që është në vëllimin final, ju keni përpara jush përmbledhjen që do t'ju hyjë në punë më së shumti. Edhe pse jo gjithmonë aktuale, shumica e zgjedhjeve nga kjo enciklopedi janë të përdorshme dhe të përshtatshme për audiencën që e ka cak kjo enciklopedi.

Pikat e dobëta. Ndoshta njëra nga dobësitë më të mëdha, edhe pse është ndërtuar nga kundërvështrimi i audiencës, është tretmani jo i barabartë i materialit. Materialeve që janë më aktuale dhe më popullore u jepet më shumë rëndësi sesa materialeve apo artikujve standardë e historikë. Është i kuptueshme fakti se kjo përmbledhje me fjalët më të pakta nuk mund të shpresojë që t'i shtjellojë artikujt në detaje- dhe kjo do të ishte një mangësi e madhe. Në anën tjetër, për audiencën e saj artikujt e shkurtër si duket janë shumë të përdorshëm për një vështrim të thjeshtë dhe të lehtë për t'u kuptuar.

Ana më e dobët e saj janë humanitetet dhe artet. Këtu, për disa arsye shumë të vjetra, shumica e artikujve janë të panjohur me progresin në letërsi ose me zhvillimet e hovshme në pikturë. Redaktorët, kohë pas kohe, thonë se këto seksione apo kapituj duhet të korrigjohen. Ilustrimet këtu nuk janë të indeksuara dhe disa tituj kontravers sikurse kontrolli i

armëve dhe burimet e naftës nuk janë të mbuluar ashtu si duhet.

Versioni CD-ROM i përshin tekstet komplete prej 29 vëllimeve dhe këtu janë përfshirë edhe rreth 50 video, 400 klipe zëri dhe 51 animacione. Numri i ilustrimeve është i njëjtë me atë në versionin e shtypur, pra rreth 10 000. Freskimi me informata të reja bëhet gati çdo muaj, mirëpo nuk ka linka të web-sajteve në artikujt e shkurtër. Një tipar i veçantë i versionit CD-ROM: lexuesi mund të blejë ose të shkarkojë librat shtesë elektronik prej *Merriam Webster's Biographical Dictionary* tek *Oxford Dictionary of Art*. Është një link, po ashtu për te *Fund & Wagnalls Knowledge Center,* që është web-sajti e shërbimit me lajme nga Agjencia Reuters.

Kjo enciklopedi Online mund të gjendet në Internet edhe falas, si enciklopedi e përgjithshme shumë e besueshme. I përfshin materialet nga përmbledhja e shtypur duke shtuar edhe shumë audio dhe video klipe. (Meqë ra fjala, këto ndryshojnë nga Encarta, e cila e ka Funk & Wagnalls në zemrën e saj).

Më shumë kënaqësi falas: *Random House Webster's College Dictionary* dhe informatat, çdo orësh, nga Agjencia e Lajmeve Reuters. Pse falas? Zëdhënësi i kompanisë shpjegoi se shpresat e botuesit janë që të përdorë këtë web-sajte në mënyrë që t'i inspirojë vizitorët ta blejnë versionin CD-ROM, i cili përfshin shumë më shumë artikuj.

Collier's/CD-ROM

Versioni CD-ROM nga Collier (po ashtu produkt i Microsoft) i përfshin tekstet e plota të përmbledhjeve të shtypura, diku mbi 4 000 ilustrime (totali arrin në 18 000) dhe gjashtë orë videoincizime. Për më shumë: *Atlasi Rand McNally,* fjalori *American Heritage,* që ka rreth 3 000 linka të web-sajteve të ndryshme. Një kërkim i vetëm mund ta gjejë një enciklopedi, atlas dhe po ashtu fjalor. Çka është shumë interesante në këtë version është fakti se mbi 95 % e fotografive janë unike dhe gjenden vetëm në këtë version CD-ROM dhe vetëm 5 % të tjera janë marrë nga enciklopeditë e shtypura. Rritja e fotografive ju lejon t'i shikoni fotografitë prej më së afërmi dhe, po ashtu ju mundëson shikim të detajuar të objekteve, dhe të ndërtesave të ndryshme. Rezultati i gjithë kësaj është ajo se ka shumë më shumë fotografi të mira në versionin CD-ROM. Duke ia shtuar edhe kalendarët apo imitimet, e duke mos lënë anash as përdorimin shumë të lehtë të saj, vijmë në përfundim se është një kënaqësi e madh ta përdorësh këtë përmbledhje. Për shembull, artikujt janë të treguar në një

pjesë të ekranit, derisa ka edhe opsione të tjera, duke përfshirë planin kryesor të përmbledhjes mund të gjenden në një seksion tjetër. Mundësitë e videove dhe animacioneve të ndryshme janë shumë të lidhura me tekstin që trajtohet. Të gjitha këto materiale freskohen shumë shpesh me video dhe animacione të reja, duke shkarkuar gjëra të reja nga Interneti, që nuk është metoda më e mirë, mirëpo si thonë është më mirë se asgjë. Filmat dhe zërimet janë të shkurtra, që disa herë nuk janë më të gjata se disa sekonda. Megjithatë, ato kanë lidhje me temat që shtjellohen.

Janë disa mangësi në këtë përmbledhje të enciklopedisë: (a) nuk ka bibliografi, edhe pse janë të shënuara disa mijëra linka të web-sajteve të ndryshme për të gjetur informatat kryesore; (b) është një numër shumë i madh i videove, mirëpo shumica e tyre zgjasin vetëm disa sekonda; (c) ani pse është e lehtë të gjenden web-sajtet, koha prej gjetjes së web-sajtes e deri te qasja në të merr më shumë kohë sesa në ndonjë përmbledhje tjetër. Shënim: Më 1998-1999 versioni CD-ROM ishte radhitur nga PC Data si enciklopedi që shitet më së shumti nga versionet elektronike. Thuhet se këto burime mbështeten në numrin e enciklopedive që ishin shitur nga shitoret e ndryshme.

Collier's/E shtypur

Stili i të shkruarit mund të jetë paksa i vështirë për disa njerëz, mirëpo ka shumë përparësi në fushën e qartësisë. 23 000 artikujt janë shumë mirë të organizuar dhe kjo përmbledhje është e jashtëzakonshme për arsyen se theksi kryesore i saj është në artikujt e gjatë e jo të shkurtër. Pra, ata artikuj, të gjatë, të cilët në të shumtën e rasteve janë të shoqëruar nga disa biografi apo edhe fjalorë të fjalëve. Artikujt më të gjatë shumicën e herave i përfshijnë fjalorët e subjekteve që trajtohen, që është sikurse një opsioni i mirëseardhjes për të gjithë përdoruesit.

Disa njerëz ankohen se artikujt apo materialet në *Collier's j*anë shumë të gjatë. Në fakt, një artikull mund të jetë i gjatë prej 40 deri në 70 faqe për një vend të caktuar. Në të njëjtën kohë, është një indeks goxha i mirë i cili ka diku rreth 450 000 shënime- gati dy herë më shumë sesa enciklopeditë e tjera konkurrente. Një plus tjetër e kësaj enciklopedie është fakti se vëllimi final i saj është seksioni apo kapitulli i bibliografive. Diku 12 000 tituj janë të radhitur apo aranzhuar nën 31 subjekte të gjera, të cilat më pastaj janë të ndara. Shumica e shënimeve janë aktuale dhe lista e leximit u ofron të rriturve dhe nxënësve një zgjidhje shumë të mirë me

materiale të jashtëzakonshme që gjenden në këtë enciklopedi.

Bazuar në botuesin, 145 000 ilustrimet përbëjnë 20 % të të gjithë kësaj enciklopedie. Më shumë se gjysma e tyre janë ilustrime me ngjyra. Në procesin e korrigjimit, redaktorët po ashtu shtojnë fotografi me ngjyra nga viti në vit dhe aspekti i përgjithshëm i kualitetit të ilustrimeve po përmirësohet nga viti në vit. Faqja si tërësi dhe dukja e enciklopedisë janë nga më të mirat. Kjo përmbledhje ia arrin ta mposhtë çdo tendencë për anësi dhe jokorrektësi në shënimet biografike dhe ato të artikujve.

Pikat e dobëta. Derisa shumica e materialeve dhe e artikujve janë në një korrigjim të vazhdueshëm, dhe gjërat nga "lajmet" janë gjithmonë aktuale, ekziston bindja se disa artikuj kryesorë nuk janë të tillë. Edhe pse kualiteti i ilustrimeve po përmirësohet, disa prej tyre u duhet edhe shumë përmirësim dhe nuk kanë lidhje fort me subjektin që trajtojnë. Përfundimi është ky se është e vështirë t'i vihet faji kësaj përmbledhje për lënien anash të ndonjë kriteri shumë të rëndësishëm.

FËMIJËT DHE ADOLESHENTËT

Online: Chicago: *World Book*, 1997 e deri më sot, www.worldbook.com. çmimi ndryshon.

CD: World Book Multimedia Encyclopedia, 1989 e deri më sot, dy disqe, edicioni deluxe. $69.95.

E shtypur: The World Book Encyclopedia, 1917 e deri më sot, 22 vëllime. $769.

Shënim: *World Book*, sikurse edhe gjithë enciklopeditë e tjera, në vazhdimësi fut variacione të ndryshme në emrin e saj, p.sh. në vitin 2000 ishte *The World*

Book Millennium 2000 Encyclopedia; dhe në versioni CD-ROM: *The World Book Millennium 2000 Deluxe* CD.

S'ka rëndësi kjo gjë: ju duhet të shikoni vetëm për një emër: *World Book*.

Online: Compton's Encyclopedia Online. Redmond, WA: Microsoft Corporation, 1996 e deri më sot, e përvitshme, www.comptons.com. $30 për çdo vit.

CD: Compton's Interactive Encyclopedia, 1989 e deri më sot. Edicioni deluxe, Çmimi $40.

E Shtypur: Compton's Encyclopedia, 1922 e deri më sot, 26 vëllime, $480.

World Book/ CD-ROM

Edhe pse versioni i CD-ROM nga *World Book* dështoi në fillimet e saj, me ndihmën e kompanisë IBM, ky version u bë një nga më të mirët në këtë kategori. Numri i artikujve të prezantuar në këtë përmbledhje, pra në CD-ROM, është gati i njëjtë me atë në versionin e shtypur, mirëpo versioni elektronik i ka 3 200 artikuj unikë në të.

Është e vërtetë se kjo përmbledhje nuk ka ilustrime të mira, dhe ato janë në minimum (9 500 përkundër 28 000 sosh në versioni e shtypur) mirëpo janë shumë informata tjera shtesë: diku rreth 800 video, shumë animacione dhe diku rreth 880 harta të jashtëzakonshme. 18 000 linka për qasje në web-sajt janë përzgjedhur me shumë kujdes për kategorinë e fëmijëve/adoleshentëve. Një veçori e jashtëzakonshme është opsioni i "magjisë së detyrave të shtëpisë" që është i lehtë për t'u përdorur. Këtu, duke e marr në konsideratë edhe moshën e shfrytëzuesve dhe eksperiencën e tyre, programi e merr përdoruesin dhe e përcjell prej zgjedhjes së subjektit apo temës e deri te përfundimi i esesë. Një qasje shumë e mirë në problemet që vështrohen si të vështira nga lexuesit.

Metodat e përcjelljes mund të ndiqen shumë lehtë, me sistemin e filtrimit, i cili i tregon materialet sipas rëndësisë së tyre. Sistemi i kategorizimit, sikurse me kërkimet Online, mund t'ju bëjë nervoz disa herë, mirëpo së paku është një përpjekje për të kontrolluar një numër enorm të të dhënave. E ashtuquajtura "imazhet vizuale" mund të gjendet këtu me një rrotullim deri 360 shkallë të ndërtesave dhe fushave të ndryshme. Kjo, me që ra fjala, e përfshin edhe tavanin e Sistine Chapel.

Versioni shumë i lirë deluxe me tre disqe përfshin në vete: opsionin e gjetjes dhe njohjes së fjalimeve; Biblioteka e Referencave e quajtur *Merriam-Webster* me definicionet dhe fjalët për adoleshentët; *Information Please Almanac*, dhe të gjitha opsionet dhe veçoritë e tjera gjenden në modelet më të thjeshta. Sikurse edhe me versionet CD-ROM nga enciklopeditë konkurrente, njohja e zërit në të shumtën e rasteve nuk mund të bëhet dhe problemi kryesor këtu është sa kohë merr për ta përdorur një gjë të tillë. Integrimi i disa librave dhe materialeve të tjera të referencave është i kënaqshëm, mirëpo edhe një herë duhet bërë pyetja: a duhen të gjitha këto gjëra në një enciklopedi të tillë, dhe a nuk do të ishte më e dobishme për t'iu kthyer punës nga individualët. Një e mirë tjetër e kësaj

përmbledhje është opsioni për të lëvizur nga një subjekt në tjetrin shumë lehtë.

Versioni Online është shumë i ngjashëm me atë të CD-ROM, edhe pse çmimi ndryshon prej në biblioteke në tjetrën, pra është më i lartë. Një përparësi është freskimi me informata të reja për ngjarje të ndryshme gati çdo ditë, p.sh. "Prapa titujve kryesorë". Pyetja: E kuptuam, mirëpo sa fëmijë janë të përfshirë në ngjarjet aktuale prej ndonjë enciklopedie. Është një opsioni tjetër mujor edhe më i mirë, i cili merr në konsideratë çdo artikull apo punë tjetër që ka lidhje me programet shkollore apo edhe me kalendarët vjetorë. Janë edhe shumë linka dhe qasje të menjëhershme në gati 25 000 artikuj periodikë që janë me tekste të plota.

Kërkimi është relativisht i lehtë. Fokusi është në artikujt kryesorë në enciklopedi. Me këtë, janë edhe linka relevantë të web-sajteve sikurse edhe referenca të kryqëzuara për subjektet në fjalë. Duke i shtuar edhe asortimentin e gjerë të gjërave të tjera sikurse "videot dhe animacionet" kjo është enciklopedi a gati nga më të mirat Online- së paku për ata lexues apo shfrytëzues që e kanë parë.

World Book/ Versioni i shtypur

Triumfi i vërtetë i *World Book* është fakti se kjo enciklopedi është mjaft mirë e planifikuar, kujdesshëm i ka të kombinuara shumë elemente, pra ka një balancim mjaft të mirë në mes tekstit dhe ilustrimeve që mbështetësin ato tekste. Stili i qartë i të shkruarit dhe një numër i madh i ilustrimeve të jashtëzakonshme e vënë këtë enciklopedi shumë parapara konkurrentëve të saj. Pra, me një fjalë, kjo enciklopedi nuk ka konkurrentë realë. Pashmangshëm, në të shumtën e rasteve kritikët e vlerësojnë mirë atë, ndërsa bibliotekat e blejnë. Popullariteti e bën atë versionin më të shitur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Audienca dhe lexuesit që ajo i ka në cak janë nxënësit e moshës prej 10-16 vjeçare.

World Book e ndjek modelin e qasjes duke shkuar nga më e lehta te e vështira për artikujt e gjatë, rregull e cila në të shumtën e rasteve vlen për enciklopeditë për të rritur dhe librat e tjerë të referencave. Për shembull, një artikull i gjatë mbi energjinë fillon jo vetëm me një fjalor të lehtë të fjalëve, mirëpo edhe me një qasje të kujdesshme te definicionet dhe shpjegimet e fjalëve dhe frazave të vështira. Duke shkuar më tej, le të themi pasi i kalon dy kolonat e para, materiali apo artikulli bëhet më i

sofistikuar, pra më i vështirë. Në pjesën më të madhe, kjo rregull vlen vetëm për artikujt e gjatë dhe me shumë detaje. Të gjitha pjesët e shkurtra, të cilat janë prapavija e përmbledhjes, mund të kuptohen lehtë nga një nxënës mesatar i shkollës fillore, apo edhe të mesme. Redaktorët e ndjekin shumë afër paralajmërimet se cila është shkalla e leximit duke u bazuar në planprogramet mësimore në SHBA.

Vëllimi apo edicioni i fundit, që është ai i 22, përfshin indekse të jashtëzakonshme të rreth 173 000 shënimeve. Për arsyen se kjo përmbledhje ka një numër të madh të referencave të kryqëzuara, indeksi mund të mos u nevojitet shumicës së studentëve dhe shumë rrallë mund t'i hyjë në punë edhe librave apo punimeve për referenca të gatshme.

Aspekti më dramatik i gjithë kësaj përmbledhje janë ilustrimet në secilën faqe. Ka më shumë ilustrime se çdo përmbledhje tjetër, për të rritur apo fëmijë, me diku 28 000 ilustrime, ku shumica e tyre janë me ngjyra. Ilustrimet zënë gati 1/3 e gjithë kësaj enciklopedie.

Derisa të gjitha versionet apo përmbledhjet e enciklopedive për fëmijë janë shumë aktuale, shkalla e korrigjimit të tyre dallon shumë. World Book është më i miri në këtë aspekt, për faktin kryesor se theksi i veçantë vihet në ngjarjet aktuale dhe të dhënat mbi biografitë freskohen me informata rregullisht.

Pikat e dobëta. Shumë pak nga enciklopeditë arrin me të vërtetë ta sfidojnë lexuesin në disa pika apo çështje kontraverse. Botuesi në këto raste është më i koncentruar që të mos i shikojë prindërit sesa vetë fëmijët e tyre. Artikulli mbi riprodhimin njerëzor e përjashton dhe nuk flet fare për marrëdhëniet mashkull-femër si pjesë përbërë e formulës. Redaktorët, duke e ditur ose jo, i lënë pjesët kryesore që prindërit t'ua shpjegojnë fëmijëve të tyre. *World Book* që është shumë e lidhur me planprogramin e shkollave, ka shumë kujdes dhe nuk përfshin ndonjë aspekt që do të ishte kontravers. Në të njëjtën kohë, është shumë objektive në trajtimin e temave mbi abortimin, duke e shikuar nga pikëpamja religjioze dhe ajo edukative. Shumë shpesh dështon të theksojë faktin se marrëdhëniet ndërkombëtare kanë efekt të madh në politikën amerikane. Publiciteti dhe shpalljet për *World Book* mund të fajësohen për faktin se thonë që kjo enciklopedi është për fëmijët e rinj. Në të vërtetë, është për fëmijët që janë së paku 9 vjeçar, apo diku prej 10 -12 vjeçar, duke vazhduar deri te nxënësit e shkollave të mesme.

Compton's/CD-ROM

Me 40 000 artikuj (prej të cilëve mbi 1 000 nuk gjenden në versionin e shtypur) 600 video, zërime dhe mbi 100 video të animuara, *Compton's* është një qasje e qëlluar e informimit për fëmijët dhe tinejxherët e rinj. Artikujt shumë lehtë ndiqen dhe në të shumtën e rasteve janë mirë të ilustruar (diku gjysma e atyre që gjenden në version e shtypur, p.sh. 16 000 apo diçka e tillë) janë shumë të përshtatshme për shumicën e projekteve që bëhen brenda klasave apo detyrave.

Një kritik në emër të ilustrimeve është ajo se derisa numri i madh i ilustrimeve është impresive, shumë shpesh "sasia e madhe i shkon në dëm kualitetit. Mos harroni se ka edhe shumë fotografi mediokre që gjenden në këtë përmbledhje." [19]

Ndër përparësitë e saj janë: shëtitja që mund të bësh nëpër fotografi me opsionin "slide show" të arteve dhe komunikimeve. Një sistem planetar që lejon përdoruesin t'i zbulojë xhenetet dhe pastaj me një klikim të vetëm ta lexojë artikullin që flet për të. Gjenden edhe shumë harta të mira dhe fjalori.

"Përmbledhja e ngjarjeve aktuale", e cila është e aranzhuar sipas radhitjes kronologjike, me shtesat mujore që shkarkohen shpesh nga Interneti, përfshin më shpesh artikuj të shkurtër sesa përmbledhje të gjata mbi ngjarjet aktualet. Referencat janë të marra nga artikujt primarë në librin komplet. Prezantimet vizuale janë bërë të mundshme nga versioni digjital 3-D.

Botuesi fut video, zërime dhe prezantime të reja në çdo edicion të ri vjetor, duke shtuar diçka e duke hequr diçka tjetër. Theksi kryesor vihet mbi lajmet dhe tregimet aktuale dhe materialet me prapavijë që janë në gjendje ta zgjojnë kërshërinë e lexuesve të rinj.

Janë diku 7 000 linka të web-sajteve të ndryshme, natyrisht që kanë lidhje me artikujt në fjalë, duke përshirë këtu edhe qasjen në Bibliotekën *Electric Library*. Ke parasysh se ky është vetëm një periudhë testuese që zgjat 30 ditë, dhe më pastaj ju duhet të paguani një shumë të caktuar parash për t"i përdorur indekset me testet e plota të materialeve prej revistave.

Një tipar i jashtëzakonshëm quhet "*Ask the Librarian*" (Pyete bibliotekarin) ku shumë studentë mund t'i parashtrojnë pyetjet e tyre dhe të

[19] Peter Jaco, "The 1999 Editions of General Interest Encyclopedias," Computers in Libraries, qershor, 1999, f. 31. Kjo është një përmbledhje vjetore që është e shkurtër, kritike, dhe me shumë rëndësi e vlerë për bibliotekistët.

marrin përgjigje për to (shumicën e rasteve edhe me referencat për artikujt në enciklopedi apo web-sajte të caktuar). Dy deri në tri ditë pritje për kthimin e përgjigjes është normale.

Një përparësi kolosale e *Compton*'s është softueri superior, i cili bën të mundur kërkimet e sofistikuara sikurse edhe qasjen fjalë për fjalë nga përdoruesit fillestarë. (Shënim: është një filtër për përdoruesit nën moshën 5 vjeçare, 13-17 vjeçare etj. Kjo qasje tenton të japë informata të njëjta secilës grupmoshë.

Prapë, web-sajti e *Compton*'s është shumë më pak e sofistikuar sesa CD-ROM. Mungesa e artikujve të detajizuar, fotografitë dhe veçoritë e tjera e bëjnë këtë përmbledhje një zgjedhje jo të preferuar. Në të njëjtën kohë, është një burim shumë i mirë për gjetjen e web-sajteve në fushat, ku po e bëni kërkimin. Këto web-sajte janë shumë me përmbajtje më të mirë sesa ato që gjenden në enciklopeditë e tjera. (Si shtesë e tij, qëndron edhe mbishkrimi: *Compton*'s është pjesë e pakos së ofruar nga *America Online*).

Compton's/Versioni i Shtypur

Compton's është unike për indekset e saj të quajtura "Fact Index" në vëllimin final të saj. Opsionet dhe veçoritë shërbejnë si indekse në secilin vëllim dhe po ashtu edhe si të dhëna të referencave të gatshme në pyetjet bazë. Botuesi thotë se janë diku 30 000 artikujt aktualë të shkurtër në të ashtuquajturin "Fact Index." Këto të dhëna dhe shënime të referencave të gatshme i mbulojnë shumë çështje, sikurse edhe vende e njerëz të ndryshëm. Po ashtu, shumë të përdorshme janë edhe udhëzuesit e leximit që korrektohen në mënyrë që të jenë në shërbim dhe sa më të përshtatshme me subjektet që janë në planprogram dhe për t'iu dhënë lexuesve të rinj materiale që ju hyjnë në punë.

Stili i të shkruarit është mesatar, edhe pse shumë larg të qenit i përsosur, prapëseprapë është i kuptueshëm. 40 000 artikujt marrë në përgjithësi janë të shkurtër, ani pse titujt dhe subjektet kryesore që preken këtu mund të jenë disa faqe. Titujt dhe subjektet kontraverse janë deri diku të analizuara, mirëpo me një maturi të madhe. Janë diku rreth 23.000 ilustrime prej të cilave 2/3 e tyre janë me ngjyra.

Kjo përmbledhje është shumë mirë e organizuar. Ndër enciklopeditë, ky vëllim apo version është ndër më të lehtët për t'u përdorur, e posaçërisht për ata që janë në klasat V, VI, VII dhe VIII të shkollave fillore, dhe për nxënës të shkollave të mesme. Për më tepër, kjo enciklopedi preferohet të përdoret edhe si enciklopedi familjare.

Pikat e dobëta. Subjektet e prekshme shumë shpesh vetëm kalohen ose thjeshtësohen në masë të madhe. Lexuesi ndoshta nuk e ka as idenë më të vogël se tema në fjalë është kontraverse. Artikujt mbi abortin përfshijnë vetëm disa fjalë nga njerëz që janë pro dhe kundër abortit. Aranzhimi apo radhitja me pjesën e indeksit në "Fact Index" mund të jetë konfuz dhe jo i kuptueshëm ngase e bën radhitjen e tyre shkronjë për shkronjë në vëllimin kryesor, në vend se ta bëjë atë fjalë për fjalë.

Procedura e freskimit me informata është shumë e çuditshme. Ngjarjet aktuale, derisa nuk janë të një rëndësie shumë të madhe, janë të larguara nga "Fact-Index."

Kur një artikull primar duhet të freskohet me informata, procedura e zakonshme është futja e informatave të reja në fund të artikullit të vjetër.

PËRMBLEDHJE TË TJERA PËR FËMIJË

Childcraft

World Book boton një përmbledhje prej 15 vëllimesh e quajtur *Childcraft,* për fëmijët parashkollorë, e cila në të shumtën e rasteve është një gjë luksoze si për prindërit ashtu edhe për bibliotekat. Edhe pse shumë e përshtatshme dhe shumë mirë e ilustruar dhe e paraqitur, 750 000 fjalët e saj dhe 4 600 ilustrimet kushtojnë 170 dollarë. Shumë vëllime japin shqiptimet për fjalët e reja dhe fjalitë, duke treguar si duhet të përdoren fjalët me vend. Artikujt janë të radhitur sipas temës që trajtojnë, mirëpo secili vëllim ka indeksin i tij, me indeksin e përgjithshëm në vëllimin e fundit.

Radhitja e temave sipas shkencës, literaturës së fëmijëve, studimet sociale dhe kështu me radhë, është i njëjti me atë shembullin e rafteve të bibliotekave që mundohen t'i përgjigjen kërshërisë së lexuesve dhe interesimeve të tyre. A është kjo një enciklopedi apo vetëm një përmbledhje e artikujve të imagjinuar, të vërtetë dhe aktiviteteve të tjera? Përgjigja varet nga ju. Kështu, kjo enciklopedi iu hyn më shumë në punë familjeve sesa vetë bibliotekave.

New Book of Knowledge (Libri i ri i dijes)

The New Book of Knowledge (Danbury, CT: Grolier Incorporated, 1911 e deri më sot, 21 vëllimeve, çmimi $659) është një enciklopedi që

vëmendjen kryesore e ka në fëmijët prej moshës 7 - 13 vjeçare. Është një enciklopedi e vërtetë dhe jo përmbledhje e materialeve të lexuara sikurse ndodhte me dekada të tëra. Duke iu falënderuar korrigjimit të gjerë, kjo përmbledhje i bashkon shumë fakte dhe biografi, duke mos lënë anash as projektet apo aktivitetet, të cilat shumë qart bëhen pjesë e artikujve, p.sh. pjesa mbi njerëzit gaztorë ka një seksion se mbi artikujt, tregimet, apo poemat që janë shkruar mbi temat e shkruara. Janë 85 000 shënime në indeks dhe secili vëllim ka indeksin e tij individual.

Më shumë se 1/3 e gjithë hapësirës i është lënë ilustrimeve prej të cilave 94 % janë me ngjyra. 28 000 ilustrimet dhe hartat i afrohen numrit të paraqitur nga *World Book* dhe janë në përparësi mbi përmbledhjet e tjera të enciklopedive për fëmijë, duke përjashtuar këtu *World Book*. Brenda shumë artikujve të gjatë janë të përfshirë shumë diagrame, grafike dhe përmbledhje sikurse është materialet e "referencave të shpejta".

Artikujt janë shumë mirë të shkruar dhe në fakt stili i të shkruarit është shumë më i mirë sesa ai që mund të gjendet në shumë përmbledhje të botuara nga *Compton's*. Përpjekja për të qenë sa më të pastër dhe të qartë vërehet lehtë dhe shumica e artikujve janë të shkurtër me definicione të sakta dhe shpjegime të cilat zakonisht janë të shoqëruara me ilustrime.

Pikat e dobëta. Duke e konsideruar grupmoshën (shkollat fillore) për të cilën edhe është e disenjuar, dhe duke marrë për bazë vështrimin e kujdesshëm në interesimet e kësaj grupmoshe, kjo përmbledhje ka shumë pak të meta. Nuk është fort e duhur, sikurse disa kanë rekomanduar, për fëmijët më të rritur që kanë probleme me të lexuarit. Fusha e mbulimit të vendeve, përveç SHBA-së, është shumë e thjeshtë.

The New Book of Knowledge Online (http://nbk.grolier.com/login/nbk_login.html) ndjek metodën e njëjtë sikurse në versionin e shtypur, mirëpo duke mos i përfshirë shumicën e ilustrimeve. Megjithatë, janë disa veçori të freskimit me informata të reja me ngjarjet më aktuale që mbulohen çdo javë, p.sh. "NBK News", e cila është një që i përgatitë lajmet për lexuesit e rinj. Pesë deri në gjashtë tregime do të jenë aktive për gati një muaj, dhe më pastaj, ato do të hiqen ose do të përfshihen në materialin kryesor. Shënim: Në çmimin +$395, kjo ofertë është shumë e shtrenjtë dhe në të vërtetë nuk është një zgjedhje e mirë për versionin Online.

Children's Britannica (Chicago: Encyclopedia Britannica, 1960 e deri më sot, 20 vëllime, çmimi $369) është një enciklopedi e papër-

shkrueshme, e cila përmban rreth 4 000 artikuj të shkruar për fëmijë prej moshës 8-14 vjeçare. Është e redaktuar dhe e botuar në Angli, mirëpo shitet si përmbledhje amerikane. Duke përjashtuar disa ndryshime të vogla për amerikanët, kjo enciklopedi iu dedikohet nxënësve anglezë. 6.000 ilustrimet, të shumtat e të cilave janë bardh e zi, nuk janë fort të mira për sy. Edhe pse është e rekomanduar nga Asociacioni Amerikan i Bibliotekave, nuk është e rekomanduar nga ky autor. Paratë tuaja mund të shfrytëzohen më mirë në versioni CD-ROM ose një përmbledhje sekondare e nga *World Book,* e cila kushton më pak sesa enciklopedia *Children's Britannica*.

Lidhjet e para: *The Golden Book Encyclopedia* (East Lansing, MI: Hartley Courseware, 1993 e deri më sot $90-150) është përmbledhja e njohur *Golden Book* në formatin CD-ROM. Duke pasur audiencë fëmijët prej moshës 5-10 vjeçare, të cilët kanë njohuri elementare mbi kompjuterin, kjo duket si një blerje e mirë. Zërimi, audio, (diku rreth 60 minuta) është absolutisht imagjinuese. Animacionet iu dedikohen fëmijëve duke filluar nga klasat VI dhe VII-të. Më shumë se 3 000 harta dhe ilustrime janë mjaft adekuate. Për më shumë, teksti kuptohet lehtë.

Grremçi në të është ai fakti se kjo përmbledhje redaktohet më shumë për reklamim. Vetëm disa artikuj në të vërtetë korrigjohen. Shënimet kryesore shpeshherë kapërcehen. Materiali është goxha aktual, mirëpo jo gjithmonë në hap me kohën. Kjo përmbledhje është treguar mjet i suksesshëm për të zgjuar kërshërinë e fëmijëve në botën e informatave dhe si i tillë mund të përdoret në shkolla. Në të njëjtën kohë, ky nuk është vendi i duhur ku fëmijët përgjigjen për pyetjet e fëmijëve që kanë të bëjnë me referencat. Duke e konsideruar faktin se opsionet dhe veçoritë e kësaj enciklopedie janë shumë joshëse dhe duke e marr për bazë edhe çmimin e ulët, kjo përmbledhje do të mund të blihej për lexim dhe shfletim. Megjithatë, s'duhet harruar se kjo enciklopedi nuk i plotëson të gjitha kriteret.

Eyewitness Children's Encyclopedia (New York: DK Multimedia, 1998 e deri më sot, $40). Versioni CD-ROM është për fëmijët prej moshës 7-11 vjeçare duke paraqitur shumë animacione me zërime mekanike që lexon çdo gjë që gjenden në ekran. Teksti është shumë aktiv, i gjallë, sikurse edhe shumë veçori të tjera të këtij versioni. Argëtimit i jepet më shumë rëndësi sesa informatave të para. Prapëseprapë, është një rrugë e mirë për t'i njoftuar fëmijët me të dhënat dhe informatat e sofistikuara.

Në Web

Në këtë seksion që është vazhdimësi e përmbledhjeve apo enciklopedive standarde dhe të përgjithshme, nuk ka ndonjë enciklopedi në Internet që është e veçantë. (Keni parasysh se sa për pa pagesë, të gjitha përmbledhjet në vazhdim ofrohen falas në Internet dhe rekomandohen për përdorim.)

Enciklopeditë falas mund të gjenden në Internet. Vetëm disa prej tyre ia vlen barra qiranë për t'u shkruar. Nëse përmbajtja nuk është pika më e mirë e enciklopedive që gjenden në Internet, së paku ato ofrohen falas. Ndër versionet standarde që më së shpeshti mund të gjenden në Internet, të cilat janë të radhitura sipas vlerës së tyre, janë:

1. *Free Internet Encyclopedia* (http://clever.net/cam/encyclopedia.html) është njëra nga enciklopeditë më të hershme dhe më të mira që mund të gjendet në Internet. Nuk ka version të shtypur apo në CD-ROM. Është falas dhe është e menaxhuar nga Cliff Davias dhe Margaret Fincannon. Përmbledhja e të dhënave është e bazuar në një princip të thjeshtë- t'i bësh së bashku informatat në një rrjet apo web-sajt (të cilat vazhdimisht korrigjohen, dhe freskohen me informata). "Kjo është një enciklopedi që përbëhet nga informatat që janë të gatshme në Internet. Janë dy pjesë kryesore të saj. "Macro Reference" e cila përfshin referenca në fusha të gjëra të dijes... dhe "Micro Reference" e cila përfshin informata të shkurtra dhe referenca specifike mbi subjekte të caktuara e disa herë edhe me instruksione për gjetjen e referencave të subjekteve të caktuara brenda referencave të përgjithshme. Edhe pse titullin i këtij kapitulli apo seksioni tingëllon njëjtë sikurse ai i *Encyclopedia Britannica*, nuk kanë shumë ngjashmëri. Për shembull, kërkimi është më pak i drejtpëdrejtë.

"Macro Reference" hapet apo fillon me një listë alfabetike të subjekteve nga "Afrika", "alternative," dhe "ateizmit", nën shkronjën A, ku nën çdo shkronjë të alfabetit janë të radhitura prej pesë deri dhjetë subjekte të tilla. Nëse ju dëshironi të dini për "librat" janë diku rreth 30 linka të ndryshëm prej *Book Wire* dhe librave Online e deri te "librat për filma në Internet." Nuk ka mekanizëm të kërkimit fjalë për fjalë. E gjitha duhet të bëhet duke i caktuar që më përpara titujt e subjekteve. Mirëpo, shtrohet pyetja, sa e përdorshme është e gjithë kjo? Jo shumë për arsyen se ka shumë pak lidhje dhe rregull sikurse mund të gjendet në shënimet e

Britannica, ku janë të shënuara referencat e kryqëzuara relevante, të cilat tregojnë shkallën e lartë të subjektit të atij "libri".

2. *Encyberpedia* (www.encyberpedia.com/eindex.html). "Linkat e publicitetit dhe të reklamimit tashmë janë të gatshëm", është një nga gjërat e para që ju bie në sy kur e hapni faqen. Një anëtar i "MonteCristo Information Service," thotë se kjo enciklopedi sugjeron se përgjigjet në financimin e artikujve të tillë mund të bëhen vetëm nga publiciteti dhe marketingu. Natyrisht, përdoruesi më shumë i intereson materiali.

Janë dy qasje se si mund të bëhet kërkimi. E para nga to është përdorimi i vendit për kërkime. Ju shkruani fjalën kryesore ose temën, dhe nëse kërkimi gjen ndonjë artikull, tekst, apo diç tjetër, ua tregon atë. Zgjedhja e dytë është ajo kur ju i merrni dhe i shikoni subjektet e gjëra. Këto janë lista të gjata nën "përmbledhjen e shkurtër të indekseve që janë të përcjella me shkurtesat nga linkat kryesor. Për shembull, nën fjalën "ambient", përdoruesit i ofrohen "shumë linka të mirë dhe të ri mbi Agjencinë Amerikane të Mbrojtjes së Ambientit, Ambienti Australian Online, Dituria mbi Ambientin Kanadez dhe disa web-sajte mbi oqeanografinë prej të gjitha anëve të botës." Të tjerat janë më pak komplekse, qartazi me më pak informata. Linkat e biografive në "Biography.com"- Kërkimi i ri me më shumë se 15 000 biografi të personaliteteve më të njohura..." Të dhënat këtu iu ofrohen deri diku atyre që ofrohen në enciklopeditë më modeste. Lufta civile në Amerikë i referohet "BullRun.com- që është një nga përmbledhjet më të plota të informatave mbi referencat në Internet për këtë luftë civile. Pra, është e mbushur me informata deri në fund.

Shumë web-sajte jo tradicionale mund të gjenden brenda temave që trajtohen, që deri diku janë web-sajte të mira, mirëpo që nuk ka lidhje me formatin e enciklopedisë. Ndër to janë edhe: Bibliotekat me linka për bibliotekat Online; Muzetë, Electric Library, të cilat thonë se ofrojnë "tekstet e plota të mbi 900 revistave, 150 gazetave, 20 000 librave e enciklopedive, dhe mbi 20 000 fotografi e harta."

3. *Knowledge Adventure Encyclopedia* (www.letsfindout.com). Duke i shënuar fjalët kryesore, frazat, ose duke përdorur logjikën e quajtur Boolean, e cila u lejon të gjithë shfrytëzuesve të kërkojnë enciklopedi deri në pakufi. Nuk ka ndonjë formulim të qartë mbi arsyen dhe qëllimin e kësaj, edhe pse kjo enciklopedi është për tinejxherë ose për të rritur që dëshirojnë informata të shkurtra. Për shembull, nën "abortin" paraqiten

gjashtë alternativa që sugjerojnë tituj. Njëri, "jeta e drejtë, e kujt?" rezulton në 300 deri 400 shënime, të cilat shumë mirë i paraqesin përparësitë dhe dobësitë, duke ofruar po ashtu edhe një vështrim shumë objektiv mbi çështje të caktuara. Problemi që është i njëjtë për shumë të dhëna të tilla, është fakti se ka shumë pak të dhëna pas vitit 1980. Ani pse kjo përmbledhje ka materiale për fëmijë (në radhë të parë fotografi dhe pak tekst për hapësirën dhe dinozaurët) është një enciklopedi që iu dedikohet fëmijëve në tërësi, sikurse të dhënat lënë të kuptohet.

SHTOJCAT NË ENCIKLOPEDI: VJETARËT, CD-ROM-ët, ONLINE

Së bashku me enciklopeditë digjitale, botuesi i përmbledhjes standarde të një enciklopedie siguron blerësin se enciklopedia në fjalë, çdo vit, do të freskohet me informata. Kjo bëhet duke i dërguar blerësit, me postë, një vjetar, zakonisht për një çmim të volitshëm. Ky vjetar ishte si një lloj "përmbledhje e vitit" me shumë artikuj të gjatë për ekonominë dhe trendet ekonomike e shkencore, ku kishte edhe shënime të shkurtra mbi njerëzit dhe vendet që zinin vend qendror në lajme në vitin paraprak. Kishte shumë pak lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet shënimeve në përmbledhjen kryesore. Në fakt, një staf i ndarë, pra një grup i ndarë i kontribuesve ishin punësuar për ta bërë këtë vjetar.

Vjetarët standardë vazhdojnë të botohen në versionin e shtypur, mirëpo së bashku me përmbledhjet primare duket sikurse së shpejti nuk do të botohen më. Aranzhimi apo radhitja është e madhe, ku theksi i veçantë vihet në temat e gjera, duke filluar nga bujqësia e deri te "investitorët e rinj latino-amerikanë". Këto shënime janë drejtpërsëdrejti të lidhura me materialin kryesor sikurse që është ky shënim "Ky artikull i freskuar me informata të reja nga *Britannica*, për shembull, është artikull i *Macropaedia*..." Shumica e materialit nuk përfshihet në korrigjimet e mëvonshme.

Vjetarët i shërbejnë dhe kanë qëllim më të madh sesa futja e informatave të reja dhe freskimi me të dhëna të enciklopedive kryesore. Këta vjetarë janë të shkëlqyeshëm në pasqyrimin e ngjarjeve nga viti i kaluar, dhe disa prej tyre, sikurse *Britannic*a kanë edhe shtesa të tjera që bartin shumë informacione, të cilat mund të gjenden në kalendarë apo në vjetarët politikë. Për shembull, në *Britannica* ekziston një seksion shtesë me mbi 350 deri 400 e quajtur "Britannica World Data", e cila është një analizë e vendeve të ndryshme dhe që mund të gjendet në një format pak më

ndryshe te *Statesman's Yearbook of Europa*. Këtu janë të dhënat aktuale mbi të dhënat demografike, statistika të mirëfillta, ekonomitë e vendeve, tregtia botërore etj., për çdo vend të botës. Përsëri duhet thënë se këto materiale kanë shumë pak lidhje të drejtpërdrejtë me materialin e prezantuar në enciklopedi. Shënim: diku nga fundi i viteve '90-të, *Britannica* shumë shpesh po shtonte "të dhëna për informacione më të hollësishme me adresa në Internet për gati çdo vend.

Në vend se të ofrojë vjetarë elektronikë, *Encarta* ofron "freskime mujore me informata të reja" në "Encarta Yearbook Builder" (www.encarta.msn.com/downloads). Këto janë të dhëna mbi ngjarjet aktuale sikurse edhe veçoritë e tjera që më vonë janë futur në version vjetor në CD-ROM. Një gjë e tillë bëhet më shpesh në edicionet Online të enciklopedisë.

Freskimi me informata që bëhet Online shumë shpejt do t'i zë vendin versionit të shtypur. Një gjë të tillë e ka bërë në shumë drejtime. Përparësia e versionit mujor i freskimit me të dhëna është fakti se është shumë më në kohë dhe aktual në vend se njeriu të presë deri në fund të vitit për një vjetar. Përparësia tjetër e versionit vjetor të CD-ROM nuk është ajo se është më aktual sesa versionet më të vjetra, mirëpo sikurse edhe veprat Online, është një integrim i plotë i informatave. Ju nuk jeni i detyruar të shkoni prej enciklopedisë te vjetari për të gjetur për shembull legjislacionin e fundit federal në SHBA, për të parë zbulimet e fundit shkencore, ose emrin e atij/asaj që së fundi fitoi shpërblimin më të çmuar në gazetari. Mishërimi i të dhënave nga vjetarët me të dhënat nga versionet elektronike e bën më të shpejtë dhe më të lehtë kërkimin e informatave. Nuk është çudi e madhe pse ato janë më të favorizuara përkundër formateve të vjetra të shtypura.[20]

Nupedia (www.nupedia.com). E mbështetur nga Bomis, e cila është një portal i fuqishëm në Internet, kjo vepër e ofruar pa pagesë paguan redaktorin e vet. Të gjithë punojnë pa pagesë dhe për asgjë në mënyrë që të jenë pjesë e asaj që redaktori është "pasuria e madhe e informacionit". Shënimi,

[20] Ah, mirëpo ekziston një grremç një këtë teknologji të re të vjetarëve të shtypur. Në versioni e shtypur, lexuesi mund të shoh me sytë e tij çka është e re, dhe çka është futur qoftë edhe indirekt në përmbledhjen e caktuar. Kjo nuk qëndron edhe për versionet elektronike ku masa e korrigjimeve nuk mund të matet me përjashtim të ngjyrosjes, dhe ekzaminimin jo të frytshëm të artikull pas artikulli. Një botues duke dashur që të ruaj sa më shumë para, nuk do fus material edhe aq të ri, që natyrisht nuk ofrohet në shumicë në versionet elektronike sikurse në ato të shtypura ku materialet dhe artikujt mund të maten nga viti në vit.

po ashtu, është falas për çdonjërin që është i interesuar. Më shumë iu dedikohet nxënësve të shkollave të mesme e deri te më të rriturit edhe pse niveli shkencor dhe akademik i saj është vështirë për t'u vlerësuar për faktin se deri në mesin e vitit 2000 vetëm disa nga kapitujt ishin kompletuar. Çka e bën këtë enciklopedi të dallojë nga të tjerat që ofrohen, po ashtu falas, është premtimi se të gjithë ata që kanë shkruar artikuj për këtë enciklopedi do t'i shikojnë dhe do t'i korrigjojnë tekstet e kolegëve të tyre, kështu që do të bëhet një analizë kolegjiale. (Shumica e veprave pa pagesë kurrë nuk e thonë kush çka ka shkruar). Pyetja shtrohet: a do të funksionojë si e tillë? Vetëm koha dhe bashkëpunimi i autorëve të njohur do ta tregojë këtë.

ENCIKLOPEDITË ME NJË VËLLIM

Online: The Columbia Encyclopedia, edicioni i 5-të., New York: Columbia University

Press, 1997 e deri më sot, www.bartleby.com. çmimi ndryshon.

CD: 1999, $195.

E Shtypur: The New Columbia Encyclopedia, edicioni 6, 2000, 3.200 faqe, $125.

Online: The Concise Columbia Electronic Encyclopedia, edicioni i 3-të. New York:

Columbia Unversity Press, 1993 e deri më sot, www.bartleby.com. Është e gatshme edhe Biblioteka Elektronike, OCLC, dhe të tjera. Çmimi ndryshon.

CD: The Concise Columbia Encyclopedia in Microsoft Bookshelf. Renton, WA: Microsoft, 1994 e deri më sot. $99.

E shtypur: 1994, 975 faqe, $99.

E shtypur: The Random House Encyclopedia, edicioni i 3-të. New York: Random House

1990, 3.000 faqe. Çmimi prej 95-130 dollarë.

E shtypur: The Cambridge Encyclopedia, edicioni i 3-të. New York: Cambridge

University Press, 1997, 1.344 faqe. $55.

Kur kishte lindur George Chapman? (1560); çfarë teksti është Rorschact? (Njolla të ngjyrës që tregojnë për tendencat psikologjike të njerëzve); Ku rriten

farat e pistakos? (Në Azinë Lindore dhe në regjionin e Mesdheut); Sa është popullata e Egjiptit? (735 000); Pyetjet e tilla, të cilat përgjigja duhet të jepet shumë e shkurtër mund të gjenden më së miri në enciklopeditë me një vëllim. Këtu ndoshta ndonjë njeri mund të thotë dhe të argumentojë se në kuptim të kohës dhe lehtësia e kërkimit në enciklopeditë standarde me një vëllim. Zakonisht është më e lehtë t'i kthehesh versionit të shtypur sesa t'i shkosh fund e krye versionit Online apo atij CD-ROM. Mirëpo, kjo nuk është gjithmonë kështu. Ne po flasim këtu për referencat ditore që në të shumtën e rasteve gjenden shumë lehtë në versionet me një vëllim (apo edhe seksioni Macropaedia nga Britannica) që është nga më të sofistikuarit dhe më efikasit.

Mangësia kryesore është pyetja që mbështetet në elementin e kohës (pyetja në popullatën e Egjiptit). Shumica e versioneve të shtypura me vetëm një vëllim kanë datën e vet. Nga ana tjetër, shumica e CD-ROM dhe Online versioneve janë mjaft aktuale. Duke u mbështetur në atë se cila është më e mira në aspektin e freskimit me informata, me këtë rast mund të injorohet rregulla e artë e veprave të shtypura.

Enciklopedia Columbia

Columbia është njëra nga enciklopeditë më të mira në grupin e atyre me vetëm një vëllim, e cila i përfshin gati 18 tituj të ndryshëm. Vetëm tre apo katër nga ta mund të rekomandohen. Edicioni i 6-të i *Columbia* ndjek metodën e njëjtë të edicioneve paraprake. I ka diku rreth 6.6 milionë fjalë, ose diku rreth 3 deri 4 milionë fjalë më pak sesa përmbledhjet nga *Compton's* e deri te *Funk & Wagnalls*.

Madhësia shumë e madhe e saj, gati 6 kilogramë e rëndë, është e barabartë me kategorinë më të lartë të unazave që peshojnë. Duke iu falënderuar historisë së saj të gjatë, botuesit akademikë dhe shumë këshilltarëve dhe shkruesve te *The Columbia Encyclopedia* shumë lehtë i mblodhi të gjitha autorët e mëdhenj në një anë. Edhe pse e shkuar për të rritur, shumica e studentëve nga shkollat e mesme mund ta përballojnë lehtë dhe të ndjekin shënimet e shkurtra. Artikujt më të gjatë përfshijnë bibliografi mbresëlënëse dhe shumë aktuale. Vizatimet bardh e zi i vënë pikë faqes me tri kolona. Ato japin përfytyrimin e punës nga dijetarët që është shumë pak tërheqëse për syrin.

Versioni digjital i *Columbia* mund të kërkohet duke shtypur fjalë apo fraza, si të shënime nga enciklopedia apo në tekst. Është shumë e thjeshtë për t'u përdorur, edhe pse përsëri duhet thënë që edicioni i shtypur mund

të jetë po aq i lehtë për t'u përdorur. (Shënim: Shumicën e rasteve, ky version është i gatshëm dhe ofrohet vetëm për bibliotekat apo shërbimet komerciale. Si rezultat i kësaj, janë shumë pak adresa të web-sajteve).

Vepra digjitale ka diku mbi 80 000 linka të nënvizuar brenda tekstit. Edhe pse nëse vini deri te pika, ku ju duhen më shumë të dhëna mbi referencat e gatshme, atëherë është shumë më efektive të filloni me përmbledhjet standarde dhe jo me enciklopeditë me një vëllim, për shkakun se ka më shumë linka për subjektet relevante.

Një kompliment i njëjtë dhe një kritikë i duhet bërë edhe partnerit tjetër të kësaj përmbledhjeje, pra *Concise Columbia Encyclopedia*. Këtu, "concise" (e ngjeshur) përkthehet në qasjen e quajtur *Reader's Digest*, ku janë diku 1 milion fjalë përkundër 6. 6 milionë fjalëve në vëllimet më të mëdha dhe 1/3 e numrit të faqeve. Ndërkohë që 150 ilustrime nuk vlerësohen fare. Librat më të vegjël bile kanë përparësi më të madhe në çmim ($39.95, ku zakonisht shiten me zbritje) dhe për shumë njerëz kënaqësia është edhe më e madhe pasi peshon vetëm sa 1/3. As sjellja minimale nuk reflektohet barabartë në të gjithë artikujt. Pra, shumicës së tyre u mungon kjo, natyrisht ka shumë pak shënime që e kanë këtë. Mirëpo mbi të gjitha, për gati të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me referencat e gatshme, i arrin dhe i tejkalon nevojat mesatare të një lexuesi. E mira aq sa është, nuk është e rekomanduar për biblioteka, që u thuhet t'i blejnë versionet më të plota.

Në versionin e saj të CD-ROM, *Concise Columbia Encyclopedia* nuk ia vlen të shqyrtohet. Duhet pasur parasysh faktin se Microsoft Corporations e shet këtë version me çmim të lirë së bashku me tituj të tjerë të referencave që kanë disi vlerë të njëjtë. Në moda tipike nga Microsoft, seksioni i enciklopedive i përfshin shumicën e ilustrimeve sikurse edhe animacionet, zërat dhe muzikën. Në shumicën e rasteve shitet për jo më shumë se $99. Pra, Bookshelf është një blerje shumë e mirë. Pakoja nuk përfshin vetëm enciklopedinë që kushton $50, mirëpo edhe vepra të tjera me referenca që kushtojnë diku $150, që po ashtu shoqërohen me fotografi, shqiptime të fjalëve dhe kështu me radhë. Këto përfshijnë në vete edhe *The Encarta Dictionary, The American Heritage Dictionary, Roget's Thesaurus, Bartlett's Familiar Quotations, Hammond Atlas, The World Almanac*, e po ashtu edhe *Concise Columbia Dictionary of Quotations*.[21] Duke iu falënderuar punës, mjaft të mirë, të

[21] Çdo vit, kompania Microsoft dhe njerëzit e saj tentojnë të freskojnë me informata, ta ndryshojnë, ose në të kundërtën ta përmirësojnë Bookshelf. Bookshelf do të ketë një përmbajtje krejt tjetër në vitet në vijim.

softuerit të kërkimit, një klikim i thjeshtë dhe i vetëm zakonisht e gjen informatën që duhet. Janë shumë referenca të kryqëzuara që njëherësh janë edhe të integruara në vete. Duke i pasur të gjitha veçoritë dhe pesë veprat kryesore mbi referencat, *Microsoft Bookshelf* është blerja më e qëlluar si për biblioteka ashtu edhe për personat e tjerë. *Version Concise* mund të gjendet Online ndërmjet OCLC, Bibliotekës Elektronike dhe web-sajteve të tjera. Edhe pse është goxha e mirë për njerëzit e thjeshtë e joprofesionistë nuk rekomandohet për përdorim në seksionin e referencave.

The Random House Encyclopedia

Versioni i shtypur nga *The Random House Encyclopedia* ka një histori që dallon nga të tjerët. I ka diku 3 milionë fjalë dhe është vetëm gati sa gjysma e madhësisë së *NewColumbia*. Kjo për dallim nga *Columbia*, theks të veçantë vë mbi ilustrimet. Në fakt, vizatimet primare dhe kryesore, posaçërisht ato ndërmjet shitësve, janë vizatime të jashtëzakonshme, pra vizatime, grafike, diagrame dhe fotografi me ngjyra shumë të mira. Pa kurrfarë dileme, kjo përmbledhje nuk ka konkurrent në aspektin e paraqitjes dhe të ngjyrave. Është një blerje e qëlluar për të rinjtë. Mund të gjendet në çdo bibliotekë nën *Columbia*.

Sikurse edhe me dy edicionet e mëparshme, është e ndarë në dy pjesë a kapituj. I pari quhet "Alphapedia" dhe është goxha i shkurtër me shkrime të përdorshme. Kjo është pjesë që më së shumti freskohet me informata në edicionin e ri dhe është shumë i vlefshëm për pyetjet që parashtrohen për referencat e kryqëzuara mbi lajmet aktuale dhe personalitetet e famshme. ("Maj", sepse shumica e të dhënave janë tashmë të gatshme, me çmim më të lirë, në përmbledhjet standarde prej *World Almanac* e deri te vjetarët bazikë të enciklopedive).

Pjesa e dytë ("Colorpedia") është vendi ku ju mund t'i gjeni ilustrimet më të mëdha, zakonisht me ngjyra dhe esetë e gjatë mbi çdo subjekt, duke filluar prej natyrës së gjërave e deri te historia botërore. Është një kënaqësi vizuale dhe me shumë interes për lexuesit e rinj, por edh për të rriturit të cilët kënaqen me *The National Geographic*. Mbi të gjitha, është një përmbledhje që përdoret me shumë kënaqësi.

Edhe pse nuk është e njohur për kualitetin e lartë të tekstit të saj, vepra me një vëllim të vetëm është disenjuar dhe paketuar në një mënyrë lehtë për t'u imagjinuar. E redaktuar për të gjitha tregjet, edhe jo vetëm për

vendet që flasin gjuhën angleze, kjo përmbledhje disi gjen mesin e përkryer dhe mundohet ta kënaqë gjithsecilin.

Fëmijët duket se kënaqen me MTV- sikurse edhe formati dhe nëse informata nuk shkon shumë thellë, atëherë shkon tok me stilin. Prindërit dhe bibliotekarët do të ishin më të kënaqur me versionin CD-ROM të enciklopedisë, mirëpo nëse ofrohet ndonjë version i shtypur, që është me një vëllim, më i lirë dhe që nevojitet, atëherë kjo është përgjigjja.

Enciklopedia për fëmijë me një vëllim, e quajtur *Random House* tani është bërë *The Random House Children's Encyclopedia* (New York: Random House, 1991, 664 f., $50). Ky nuk është një edicioni i korrigjuar i *Random House Encyclopedia*. Në të vërtetë, është version shumë pak i modifikuar i *Children's Illustrated Encyclopedia* në anglisht, e cila (pjesa tjetër për të rritur), është përkthyer në shumë gjuhë. Është një material që gjendet shumë rrallë, duke u bazuar në faktin se shumë pak enciklopedi të fëmijëve janë me një vëllim të vetëm. Po ashtu, është enciklopedia më e madhe e llojit të saj me më shumë se 3 500 ilustrime atraktive. Shumica e shënimeve që kapin numrin 400 janë shumë të gjëra në fushat që trajtojnë dhe nuk janë të gjata prej 1 deri 4 faqe, gjithherë duke mos e kaluar kufirin prej 6 faqesh.

Në aspektin e peshës, *Cambridge* është mbrapa *New Columbia* me vetëm 3 kilogramë më pak (*Columbia* peshon diku 5.5 kilogramë). Derisa informatat e paraqitura në të dy këto versione janë mjaft të besueshme, Versioni me një vëllim të vetëm, në gjuhën angleze, ka shumë më pak tekst: 26 000 shënime, një seksion me referenca të gatshme që është i gjatë diku 130 faqe, atlasi që është 24 faqe dhe diku afër 600 ilustrime. Problem tjetër për lexuesit amerikanë është animi anglez, që është i kuptueshëm për faktin se e gjitha u besohet ekspertëve që vinin nga Mbretëritë e Bashkuara. Pikëpamja Evropiane-Angleze e bën këtë një shtesë, jashtëzakonisht të mirë të *Columbia* ose *Random House* dhe shumë të përdorshme për bibliotekat e mëdha. Prapëseprapë, sado e mirë që të jetë, është vetëm zgjedhja e tretë.

Nuk shkojnë as gjashtë muaj kur disa firma ofrojnë enciklopedi si përmbledhje e përgjithshme me vetëm një vëllim për të rritur dhe për adoleshentë. (Sikurse u theksua më lart, enciklopeditë me një vëllim për fëmijë janë të rralla). Në vitin 2000, *Books in Print* e bëri listën me 30 tituj edhe pse disa prej tyre mund të futen në kategorinë e veprave mbi temat e caktuara. Duke e thënë këtë, shtrohet pyetja se sa prej tyre ia vlen barra qiranë për t'i marrë në konsiderim? Asnjë prej tyre, përveç atyre që janë të radhitura këtu.

ENCIKLOPEDITË ME DISA VËLLIME TË BOTUARA JASHTË SHBA-ve/ VERSIONI I SHTYPUR[22]

Për amerikanët, pyetjeve që më së shumti kanë të bëjnë me referencat mund t'u jepet përgjigje shpejt dhe shumë thjeshtë nga enciklopeditë amerikane. Ka raste kur një gjuhë e huaj, pra jo angleze, është shumë më e përshtatshme. Është shumë e qartë se enciklopeditë e huaja, pra jo angleze, do të përfshijnë historinë e vendit prej nga vijnë, shumë më shumë sesa atë amerikane, duke përfshirë këtu edhe biografitë nacionale, statistikat, vendet dhe ngjarjet e ndryshme.

Edhe për vetë shfrytëzuesit që kanë njohuri elementare të gjuhës, shumë nga veprat apo enciklopeditë jo amerikane janë të përdorshme për nga ilustrimet e tyre dhe hartat. Për shembull, *Enciclopedia Italiana* i ka disa nga ilustrimet më të mira në krahasim me enciklopeditë e tjera, posaçërisht në fushat e artit. Një enciklopedi, jo amerikane, është po aq e përdorshme dhe hyn në punë edhe për nga pika e vështrimit: Disa lexues amerikanë mund të jenë të befasuar me mënyrën se si, për shembull, Lufta Civile në SHBA trajtohet në enciklopeditë gjermane dhe në ato franceze. Për më shumë, vlerësimi i shkrimtarëve amerikanë dhe i heronjve nacionalë, në këto vepra, është në të shumtën e rasteve i barabartë me mënyrën se si evropianët i gjykojnë SHBA-të. Për të qenë më specifik, enciklopedia jo amerikane është goxha e përdorshme dhe e vlefshme për figurat, jo edhe aq të njohura dhe të pranishme në enciklopeditë angleze dhe ato amerikane. Këtu përfshihen bibliografitë nga gjuhët e huaja, hartat e detajuara të qyteteve dhe të regjioneve, si dhe informata të tjera, të cilat shkojnë prej novelave dhe muzikës, jo edhe aq të njohur, deri te identifikimi dhe emërimi i vendeve.

Në Evropë, sikurse edhe në SHBA, janë vetëm dy apo tre botues të mëdhenj (përfshirë edhe *Encyclopedia Britannica* që i ka kontratat e bashkëbotimit me shumë kompani të tjera). Këto gjigante janë: (1) *Brockhaus and Herder* në Gjermani, (2) *Larousse* në Francë dhe (3) *Garzanti* në Itali. Kur një bibliotekar gjen njërin nga këta emra në ndonjë përmbledhje të re apo të korrigjuar, seancat janë që kualitet të jetë 99 % të rasteve i mirë.

Një problem sikurse edhe me shumicën e enciklopedive evropiane është radhitja alfabetike. Çdo student, i cili pak a shumë dinë diçka për

[22] Përmbledhjet bazë janë të aranzhuara sipas vendeve dhe gjuhëve me shkurtesa të shkurtra.

gjuhët e huaja shpejt e kupton se edhe pse alfabeti latin përdoret shumë, ka shumë dallime në shkronja. Për shembull, spanjishtja i ka dy shkronja të cilat nuk gjenden në alfabetin e gjuhës angleze, si "ch" dhe "ll". Po ashtu, ka edhe shumë dallime të tjera të mëdha në emra. Në gjuhë të tjera, emri John shndërrohet në Giovanni, Jan, Juan, Johannes apo Jehan. Si pasojë, përpara se të fajësohet një enciklopedi, jo amerikane, për mungesë të shënimeve, përdoruesi së pari duhet të jetë i sigurt dhe të shikojë shumë kujdesshëm të gjitha shënimet, ngase gjuha dhe shkronjat këtu luajnë rol të madh.

Çka do të pasojë tani në shpjegimin tonë janë shembujt e përmbledhjeve më të mëdha evropiane. Në të vërtetë, gati të gjitha vendet nga Italia e deri në Kinë, Australi e deri te Afrika Jugore mund t'i rrisin me materiale versionet e tyre të enciklopedive. Shkurtesat janë shumë mirë të radhitura, posaçërisht te *Guide to Reference Books* dhe *Guide to Reference Materials*. Të dy këto vepra të referencave kanë edhe nën subjektet e tyre më titull "enciklopeditë". Çdo njëri, për shembull, i cili kërkon ndonjë vepër në gjuhën finlandeze apo atë hebraike do ta gjejë atë këtu. Në anën tjetër, përfshirja e gati të gjithë materialeve nga bota është e limituar dhe për çdo shpjegim të detajuara në atë se çka ofrohet mund të shikohet në bibliografitë, në veprat e referencave të vendit përkatës që po e kërkoni.

Versioni i popullarizuar dhe shumë i famshëm CD-ROM/DVD dhe ato versionet Online të enciklopedive në gjuhën angleze deri diku e kanë mbuluar globin- së paku deri aty ku kuptohet gjuha angleze. Kjo duket se do të ndryshojë, edhe nëse shumë pak, atëherë kur teknologjia e re do të ofrohet shumë më shumë sesa në qytetërimin perëndimorë.

Francez[23]

Versioni i Shtypur: Grand Dictionnaire Encyclopedique Larousse. Paris: Larousse, 1982-1989, 10 vëllime, $1.250 (Distribuohet edhe në Shtetet e Bashkuara nga botuesit evropianë dhe amerikanë).

Emri *Larousse* është shumë i njohur në Francë, sikurse *Encyclopedia Britannica* në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pierre Larousse ishte themeluesi i kësaj shtëpie botuese, e cila vazhdon të botojë dhe të jetë përgjegjëse për enciklopeditë themelore franceze. Në fakt, *Larousse* në

[23] Të gjitha enciklopeditë joamerikane që janë të listuara këtu përshijnë vetëm përmbledhjet e tyre të shtypura

Francë zakonisht përdoret si sinonim për enciklopedi.

Larousse vazhdon me atë politikën e saj, që të ofrojë shkrime të shkurtra, shënime specifike, mirëpo po ashtu trajton mjaft disa subjekte komplekse. Për shembull, gjatësia e artikujve për vendet dhe personalitetet e rëndësishme është shumë e ngjashme me ato që gjenden në enciklopeditë amerikane. Duke u kthyer te një koncept i vjetër mbi enciklopedinë, *Grand Dictionnaire* është e gjitha ajo çka jepet të kuptohet nga vetë titulli. Kjo nënkupton se ajo nuk përfshin vetëm të dhëna specifike të enciklopedive, mirëpo edhe definicione të fjalëve. Theksi i veçantë vihet në ilustrimet që janë brilante, zakonisht të tëra në ngjyra. Secila faqe përfshin fotografi, diagrame, harta dhe të ngjashme. Pavarësisht se çka mendoni për këto enciklopedi franceze, ju do të kënaqeni me ilustrimet që ofrohen.

Një tjetër përmbledhje mjaft e mirë gjendet, po ashtu, në bibliotekat amerikane: është ajo e quajtur *Encyclopaedia Universalis*, edicioni 2. (Ofrohet në Shtetet e Bashkuara prej *Encyclopedia Britannica*, 1993, 30 vëllime, plus vëllimi 2 si shtesë. $1.600). Kjo vepër është e ngjashme me stilin e Macropaedia në atë se artikujt janë të gjatë, me shumë detaje, për dijetarë, që janë shumë mirë të ilustruara. Vëllimet 23 dhe ai 24 janë disi të ngjashëm me veprat për referencat e gatshme, ku ka shënime të shkurtra. Dy vëllimet e tjera me radhë quhen *Symposioum* që konsistojnë me mbi 180 ese, me theks të veçantë mbi trendët e tashme politike dhe ato ekonomike. Kjo është përmbledhur në dy vëllime. Indeksi, më të dhëna të shkurtra faktike, përfshin vëllimet nga 27 deri te 30.

Gjermane

Print: Brockhaus Enzyklopadie, edicioni 19. Wiesbaden: Brockhaus, 1986, 24

Vëllime. $4.000. Plus shtesat e tjera që vijnë me botimin.

E botuar për herë të parë nga *Frauenzimmer Lexikon* (ndërmjet viteve 1796 dhe 1808), ishte enciklopedi që në përbërjen e saj, sikurse shihet edhe nga titulli, fokusi kryesor i kushtohej qeshjeve me interes për femrat. Botuesi origjinal i saj, ndoshta për shkak të numrit të vogël të shitjeve, e la krejt këtë punë. Në vitin 1808, Friedrich Brockhaus e bleu këtë përmbledhje dhe e botoi vëllimin e fundit. Si një njeri i mençur, Brockhaus vazhdoi t'i ofrojë dhe t'i shesë këto botime, jo për qëllime dhe punë akademike, mirëpo duke u premtuar njerëzve se këto libra garanto-

jnë që t'i japin një edukim mesatar gruas dhe burrit gjerman. Duke bërë kështu, ai ishte më se në hap me kohën dhe në fakt ishte aq larg nga konkurrentët e tij amerikanë dhe anglezë saqë ata lirshëm i huazuan tekstet e tij, nëse jo edhe metodat e tij të shitjes. Sikurse që u tha edhe më parë, veprat e botuara nga Brockhaus qenë bazat mbi të cilat u shkruan dhe u ngritën versionet e para të Americana dhe Chamber's.

Brockhaus e zhvilloi idenë e shkrimeve të shkurtra dhe të lehta për t'u lexuar. Disa artikuj qenë vetëm pak më të gjatë sesa disa fjali ose paragrafë. Si pasojë, të gjitha enciklopeditë nga *Brockhaus*- dhe është një familje e tërë e tyre- janë një përzierje ndërmjet enciklopedive dhe fjalorëve. (Familja e enciklopedive nga *Brockhaus* përshin përmbledhjen bazike me 24 vëllime, një përmbledhje të korrigjuar me 12 vëllime, edhe një enciklopedi tjetër prej 1 vëllimi).

Sikurse edhe mund të pritej, artikujt më të gjatë, ku disa prej tyre shkonin në më se 100 faqe, fokusoheshin më shumë në shtetet evropiane. Në shumë aspekte, enciklopedia Brockhaus është shumë më nacionale sesa ajo e *Larousse*. Dhe, derisa është një burim i mrekullueshëm për materiale mbi historinë dhe personalitetet gjermane, në të mund të kërkohen edhe artikuj të tjerë.

Për shkak të kufijve të përmbledhjes, *Brockhaus* përdoret në bibliotekat kërkuese apo aty ku popullata flet gjuhën gjermane. Megjithatë, kjo enciklopedi mbetet ndër zgjedhjet e fundit të enciklopedive jo amerikane për faktin se çmimi i saj shkon deri në $4.000 plus çmimi i shtesave që vijnë me të.

Italiane

E shtypur: Enciclopedia Europea. Milano: Garzanti, 1976-1984, 12 vëllime. $3.600.

Kjo enciklopedi është njëra nga enciklopeditë më moderne italiane, e cila freskohet me informata nga koha në kohë. Kjo enciklopedi është e rëndësishme për tri arsye: (1) Ka shënime të shkurtra dhe specifike, të cilat ofrojnë një përmbledhje të mrekullueshme të historisë, kulturës dhe shkencës evropiane dhe asaj italiane; (2) Janë artikujt e tjerë të gjatë që janë të një rëndësie të konsiderueshme, veçanërisht në aspektin e përfshirjes së shkencave sociale dhe shkencave të tjera; (3) Ka ilustrime të mrekullueshme.

Një prej dëshmive më të mëdha të arteve evropiane është enciklopedia italiane e quajtur *Enciclopedia Italiana* (Romë: Istituto della Enciclopedia Ialiana, 1929-1936, 35 vëllime, plus shtesat që jepen nga viti 1958 e deri më sot, çmimi ndryshon. Në vitin 1995 kushtonte $17.500). Enciklopeditë e botuara para Luftës së Dytë Botërore mund të gjenden gati në të gjitha bibliotekat për shkak të ilustrimeve të saj superiore dhe për shkak të artikujve shumë të dokumentuar dhe akademikë. Edhe pse artikujt mbi qeverisjen janë shumë larg nga paanshmëria, përfshirja e përgjithshme është e shkëlqyeshme. Pra, mund të thuhet se kjo enciklopedi ishte një nga enciklopeditë më të mira që u botua para Luftës së Dytë Botërore.

Japoneze

E shtypur: Kodansha Encyclopedia of Japan. New York: Kodansha International, 1983 e deri më sot, 9 vëllime plus shtesat me të $900.

Është një enciklopedi jo e zakonshme dhe shumë e mirë, e cila analizon, shpjegon dhe po ashtu kritikon Japoninë për periudhat e kaluara dhe ato të tashme. E tërë enciklopedia Amerikano-Japoneze përfaqëson punën e diku mbi 1 300 autorëve dhe dijetarëve prej më se 27 vende të botës, duke përfshirë Japoninë dhe SHBA-të. Teksti ishte shkruar dhe i dedikohej personave të thjeshtë mesatarë në aspektin profesional edhe pse shumica e këtij materiali më shumë u intereson personave specialistë. Stili i të shkruarit është shumë më lartë sesa ai mesatar. Janë diku rreth 10 000 shënime dhe 4 milionë fjalë. Kategoria e vetme më e madhe e shënime ka të bëjë me historinë japoneze, e po ashtu edhe me artin dhe gjeografinë. Diku afër 1 000 artikuj janë të shkruar mbi biznesin dhe ekonominë japoneze. Artikujt janë mjaft objektivë dhe ishte bërë shumë përpjekje që asnjë ngjarje nga historia e kaluar e Japonisë të mos ngritet në qiell apo të injorohet.

Në vitin 1993 botuesi i njëjtë lëshoi në treg enciklopedinë e quajtur Japan: An Illustrated Encyclopedia (2 vëllime, 1 924 faqe $250). Si një version më i shkurtër i përmbledhjes së gjatë dhe komplekse, ky version ka përparësi të madhe për shkak të ilustrimeve mjaft të mira (përmbledhja kryesore ka mungesa të shumta në këtë aspekt) dhe të dhënave aktuale mbi politikat japoneze, sikurse edhe ato kulturore. Këtu, lexuesi mund të gjejë këshilla se si të përgatisë Sushi sikurse edhe meditimet filozofike.

Çmimi është mesatar, duke e konsideruar faktin se sa e mirë është kjo përmbledhje.

Rusisht

E shtypur: The Great Soviet Encyclopedia, edicioni 3. New York: Macmillan, 1973-1983, 32 vëllime. $2.500. (E botuar në Rusi prej vitit 1970 deri në vitet 1980-të me emrin Bol'shaia Sovetskaia Entisklopediia, ose BSE).

Me frymën e Luftës së Ftohtë që tani është lënë pas, kjo përmbledhje tani është më shumë e vlefshme si material historik dhe si informatë statike në fushat sikurse janë gjeografia, muzika dhe artet e ndryshme. Mbi këtë, ofron edhe shumë materiale që goxha mbajnë anësi.

Versioni BSE është deri diku i një vlere të njëjtë me versionin e vjetër të *Britannica*. E gjithë përmbledhja ka diku më shumë se 21 milionë fjalë dhe mbi 100 000 artikuj. Duke i përfshirë shënimet specifike dhe ato mbi formatet e gjera të subjektet, kjo enciklopedi është një kombinim ndërmjet një fjalori të zakonshëm dhe artikujve gazetareskë me shumë detaje, artikujt të gjatë që mbulojnë gati të gjitha aspektet e interesit sovjetik.

Pasi që shumica e lexuesve amerikanë përdorin përkthimin anglisht, dy gjëra duhet të thuhen këtu: (1) Indeksi është i nevojshëm për shkakun se radhitjes jo të zakonshme alfabetike të secilit vëllim, që është si pasojë e dallimeve ndërmjet alfabetit rus dhe atij latin. Për shembull, vëllimi apo edicioni i parë i përkthyer "Nga A deri në Z" përfshin shënimet për "Alean Stage" dhe "Lufta Zulu e vitit 1879); (2) Përkthimi është i mirë. Versioni amerikan ndryshon nga ai rus për shkak se vështirësitë me para bënë që versionin rus të mos i përfshijë hartat e shumta.

Gjenden edhe shumë libra të tjerë aktualë në Rusi në ditët e sotme dhe këto libra duhet të shikohen dhe të lexohen nëse doni të gjeni përgjigje në mëdyshjet tuaja. Prej më të mirave është: *The Cambridge Encyclopedia of Russia and the Former Soviet Union* (New York: Cambridge University Press, edicioni 2, 1993).

Spanjisht

Online: Nueva Enciclopedia Cumbre en Linea. Danbuary, CT: Grolier Incorporated,
1999 e deri më sot, çdo tre muaj, http://grolier.com. çmimi ndryshon.

E shtypur: Enciclopedia universal ilustrada Europea-Americana (Espasa). Barcelona: Espasa, 1907-1933, 108 vëllime, duke përfshirë shtesat vjetore, 1934 e deri më sot. $8.995.(Distribuohet në SHBA nga botuesit francezë dhe ata evropianë).

Enciklopedia aktuale në gjuhën spanjishte për të rritur dhe adoleshentë e quajtur *Nueva* është një shtesë e mirëpritur te familja e enciklopedive Online. Përfshin më shumë se 15 000 shënime dhe aftër 8 000 ilustrime, tabela, harta etj. Artikujt janë të lehtë për t'u lexuar dhe ani pse anojnë nga kultura dhe interesat latino-amerikane, përfshirja dhe mbulimi i përgjithshëm është ndërkombëtar. Duke përdorur logjikën Boolean, kërkimet më komplekse janë ato më të mirat. Shënimi i vetëm një ose dy fjalëve duket të jetë shumë i përgjithshmi dhe aspak specifik. Për më shumë, disa artikujt janë më të gjatë e disa më të shkurtër pa arsye të qartë pse bëhet ajo. Ka linka të web-sajteve, mirëpo që janë pak të përdorshme.

Edhe pse ka shumë lëshime në të, *Grolier* është për t'u lavdëruar për arsyen se ka ndërmarrë hapin e parë në drejtim e duhur. Është e sigurt se veprat dhe enciklopeditë Online do të përmirësohen nga viti në vit. Kjo përmbledhje është një enciklopedi që do të duhej ta kishte çdo bibliotekë me një grup shefash spanjollë.

Lider i padiskutueshëm është *Espasa*. Zakonisht i cituar thjeshtë si *Espasa*, kjo enciklopedi është një vepër e mrekullueshme dhe e jashtëzakonshme. E para, duket që kurrë nuk përfundon. Me korrigjimet e vazhdueshme ose edicionet e reja, botuesi po vazhdon ta shtojë familjen e tij të enciklopedive me 80 edicione (ku 70 prej tyre janë enciklopedi e 10 të tjera janë shtesa) me shumë shtesa vjetore, të cilat janë të aranzhuara dhe të radhitura sipas kategorive të subjekteve, që po ashtu përfshijnë indekse. (Termi "vjetor" mund të merret vetëm për qëllimi reklamimi pasi këto shtesa nuk botohen prej 3 deri 5 vjet pas periudhës së mbuluar. Për shembull, vëllimi i vitit 1981-1982 u botua në vitin 1985).

E dyta, *Espasa* përfshin në vete numrin më të madh të shënimeve-botuesi thotë se janë mbi 1 milion sosh. Pasi ato nuk mund janë edhe fort të "besueshme", asnjë artikull nuk është i nënshkruar, edhe pse nënshkruhen në shtesat e botuara pas vitit 1953. Përsëri duhet thënë, se sikurse edhe enciklopeditë në gjuhën gjermane dhe atë frënge, theksi kryesor këtu vihet mbi shënimet e shkurtra të stilit të njëjtë si të fjalorit. Megjithatë, janë të përfshirë edhe artikuj të gjatë, veçanërisht në fushat që kanë të bëjnë me shkrimtarët eminentë spanjollë, latino-amerikanë etj.

ENCIKLOPEDITË ME NJË SUBJEKT TË VEÇANTË

Enciklopeditë me një subjekt të veçantë, qofshin ato me një vëllim apo me shumë të tillë, ku çmimi i tyre shkon prej 35-90 000 dollarë, po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme. Numri i tyre rritet dita ditës pasi shoqëria po bëhet më profesionale dhe e specializuar. Gati të gjitha disiplinat, çdo subjekt, çdo objekt i kërshërish, tash mund të njihet në enciklopeditë me subjekt të caktuar. Ndër 1 200 enciklopedive në versionin e shtypur, po flasim këtu për enciklopeditë me një subjekt, dallimi në tema është i shumë i qartë kur i shikojmë titujt e botuar në fund të viteve '90-të dhe fillim të vitit 2000: *The Mafia Encyclopedia; Encyclopedia of Animal Rights & Animal Welfare; Encyclopedia of Mental Health; The New Encyclopedia of the American West; The Cat Encyclopedia; The Encyclopedia of Mummies; The Encyclopedia of Conflict Resolutions; Encyclopedia of the Consumer Movement dhe Encyclopedia of the War of 1812*. Shiko botimin vjetor "Outstanding Reference Sources" (Burimet më të mira të referencave) nga Asociacioni i Bibliotekës Amerikane (i cili në shumicën e rasteve lëshohet në përdorim më 15 prill nga *Library Journal*). (Në bibliotekat amerikane botohet diku nga 1 maji). Nga rreth 50 deri në 60 titujt më të mirë të zgjedhur nga viti i më përparshëm, ju mund të gjeni shumë lehtë edhe shumë enciklopedi të tjera mbi subjekt të veçantë. Shumica e tyre janë në versionin e shtypur, mirëpo vetëm disa nga ta, posaçërisht ata të botuar në CD-ROM, janë në versionin elektronik.

Botuesit e enciklopedive me një subjekt të caktuar e ndjekin filozofinë e audiencës ose të publikut special. Në përgjithësi, rezultatet janë stimulues për bibliotekarët e referencave në veçanti kur: (1) pyetja mbi referencat e gatshme është aq e komplikuar saqë nuk mund t'i jepet përgjigja nga enciklopeditë e përgjithshme, ose (2) përdoruesit i nevojitet një përmbledhje më e gjerë dhe më e detajuar e një subjekti sesa që mund të gjendet në enciklopeditë e përgjithshme. Sa më i limituar që të jetë buxheti i bibliotekave për veprat e referencave dhe titujt e përgjithshëm, ka më shumë arsye për t'i shikuar enciklopeditë mbi një subjekt të veçantë.

Përshkrime të tilla sikurse "shok", "manual" apo "fjalor" mund të tregojnë një subjekt në enciklopedinë prej një-tre vëllime apo edicione. Për shembull, *Oxford University Press* është e njohur për seri të njëjta, sikurse *The Oxford Companion to American Theater* dhe në fushat më të thjeshta *The Oxford Companion to Chess*. Janë shumë e shumë vepra të tillë që janë

redaktuar nga ekspertë shumë të njohur. Është e qartë se ato janë të radhitura alfabetikisht sipas subjekteve. Ju mund të thoni se këto nuk janë enciklopedi, mirëpo forma të tjera të pakove me informata. Nuk ka rëndësi, gjëja kryesore është ajo se radhitja, kufiri dhe publiku për secilën nga to e gjen veten shumë mirë. Më shumë e rëndësishme se kjo është fakti se ato shpesh shërbejnë si burime të shpejta të referencave, shpesh me përgjigje shumë të thella në pyetjet e zakonshme.

Vlerësimi

Duhet përdorur të njëjta teknika dhe metoda të vlerësimit si për enciklopeditë me subjekt të caktuar e edhe për ato të përgjithshmet. Edhe pse me një njohuri të kufizuar me fushat që ato i mbulojnë, bibliotekarët mund t'i vlerësojnë enciklopeditë. Duke përdorur përmbledhjet edhe inspektimet ose ekspertët që i vlerësojnë veprat e shtrenjta është mjaft e dobishme. Përmbledhjet apo enciklopeditë që trajtojnë një subjekt të caktuar vlerësohen periodikisht nga dijetarët, të cilët i shqyrtojnë ato në shumë më shumë detaje sesa inspektimet standarde.

Shih: *ARBA Guide to Subject Encyclopedias and Dictionaries* (Englewood, CO: Libraries Unlimited, Inc., datat janë të ndryshme). Kjo shumë shpesh korrigjohet edhe është një përmbledhje, e cila përfshinë rishikime kritiket të cilat shfaqen në edicionet e hershme të *American Reference Books Annual*. Nga Allan Mirwis: *Subject Encyclopedias* (Feniks, Arizona, Oryx Press, 1999, dy edicione) i liston këto rishikime kritike nga rëndësia e tyre sikurse edhe nga indeksi i temës që trajtojnë, pra diku rreth 1.129 tituj.

Hapësira nuk e lejon një diskutim të gjerë dhe të plotë të shumë enciklopedive mbi subjekte të caktuara, që janë goxha të mira. Fokusi kryesor këtu vihet mbi veprat që janë më të njohura dhe gjenden në shumë biblioteka të mëdha.

Shumica, jo të gjitha, janë botuar së voni. Kjo qasje, e jo qasja arbitrare, i jep një vezullim çështjes se në cilin drejtim po shkojnë enciklopeditë e botuara mbi subjekte të caktuara.

Afrika dhe Amerika

Online: Africana. New York: Time-Warner, 2000 e deri më sot, Edicione të ndryshme, www.Africana.com, çmimi ndryshon.
CD: Encarta Africana. Redmond, WA: Microsoft, 1999, e përvitshme.

$39.95.

E Shtypur: Africana: The Encyclopedia of the African and African American
Experience, New York: Perseus Book Company, faqe 2.144, 1999. $90.

CD: The American Indian: A Multimedia Encyclopedia. New York: Faktet, 1993, $295.
E Shtypur: Carl Waldman, Encyclopedia of Native American Tribes. New York: Faktet, 1988. $29.95.

Versioni me dy disqe i quajtur *Encarta Africana* është një punë e përbashkët ndërmjet Microsoft, botuesit, si dhe Henry Louis Gates Jr, një akademik dhe intelektual i vërtetë, i cili është edhe drejtor i Bordit të Studimeve mbi Amerikano- Afrikanët në Universitetin e Harvardit dhe bën pjesë në grupin e dijetarëve afrikano-amerikanë. Ky version i ka diku rreth 2 milionë fjalë, 3 000 artikuj dhe më shumë se 2 500 video dhe zërime, incizime të zërit dhe harta, të cilat i tregojnë rrënjët e afrikano-amerikanëve prej kohëve të lashta e deri më sot. Mbulimi i diasporës afrikane dhe asaj amerikane është i jashtëzakonshëm.

Zotëri Gates shpreson se kjo enciklopedi do ta zgjojë kërshërinë e fëmijëve dhe do t'i futen botës së kompjuterit. "Disa studime kanë treguar se fëmijët afrikano-amerikanë kanë shumë më pak shanse dhe mundësi që të kenë kompjuter dhe qasje në Internet sesa fëmijët e tjerë amerikanë. Arsyeja kryesore për këtë, natyrisht, është fakti se shumica e këtyre fëmijëve afrikano-amerikanë jetojnë në familje dhe lagje të varfra në krahasim me fëmijët e bardhë.[24]

Duke u bazuar në enciklopedinë e famshme të Carl Waldman e quajtur *Encyclopedia of Native American Tribes*, versioni CD-ROM ka shumë materiale të tjera shtesë dhe përmbledh më shumë se 150 fise të vendit që kanë jetuar në atë çka sot quhet SHBA. Ilustrimet standarde (prej 250 prej 900 sosh janë me ngjyra) janë të shoqëruara me tekstin e plotë e

[24] Filluesit e Africana.com (Profesori nga Harvardi, Henry Louis Gates Jr. Dhe Kwame Anthony Appiah) e shitën këtë sajt te Time Warner në mënyrë që ta mbanin atë aktiv. Bazuar në fjalët e Gates, ky sajt kishe nevojë për para në mënyrë që të vazhdonte të ishte aktiv. Me fokus në kulturën historike që të këshilloj në subjektet e përgjithshme prej shëndetit e deri te financat, Africana.com është më pak e popullarizuar sesa rivalët e saj, p.sh. NetNoir (www.netnoir.com) i cili më shumë interesohet në yjet e famshëm apo BlackVoices (www.blackvoices.com) i cili është shumë i fuqishëmsi web-sajt për bisedat Online.

dokumenteve që vijnë nga burimet qeveritare dhe ato të fiseve. Hartat, diagramet, kalendarët dhe materialet e tjera të tilla janë futur, po ashtu, në materialin e përgjithshëm. Po ashtu, përfshin edhe veçoritë e tjera ekstra, sikurse referencat e kryqëzuara që kanë lidhje me materialin në fjalë, dhe shpeshherë është e mundshme që këto harta dhe vizatime edhe të printohen. Kjo përmbledhje ka përfshirë në vete edhe disa këngë nga këto fise që janë në të vërtetë këngë shumë të mira. Kur thuhet kjo, atëherë disa nga ju mund të thonë e pyesin se pse versioni CD-ROM konsiderohet si më i mirë sesa enciklopedia kryesore nga Waldman. Përgjigjja në këtë është vështirë për t'u gjetur. Bibliotekari duhet që : (1) ta blejë versionin e shtypur të *Waldman* (me çmim më të ulët se $30) dhe (2) të investojë në *Handbook of North America Indians* (Uashington, DC; Smithsonian Institution, 1978 e deri më sot). Vëllimet apo edicionet individuale sillen prej 25- 50 dollarë dhe diku 20 sosh do të botohen. Prej vitit 1995, diku rreth gjysma e tyre ofrohen dhe mund të blihen. Duke ju falënderuar stilit shumë të thjeshtë dhe të qartë të të shkruarit, ilustrimeve shumë të mira dhe të një indeksimi shumë të kujdesshëm, këto enciklopedi u hyjnë në punë si dijetarëve ashtu edhe njerëzve të thjeshtë. Që të dyja nga këto mund të kushtojnë pak më shumë sesa versionin CD-ROM, mirëpo që të dyja bashkë përfaqësojnë enciklopedinë më të mirë në këtë fushë.

E gjitha kjo bëhet për të treguar se edhe atëherë kur bazat e të dhënave elektronike për punë të referencave hyjnë shumë në punë dhe janë jashtëzakonisht të frytshme, ka raste kur posaçërisht në disa enciklopedi të subjekteve të caktuara është më mirë të përdoret versioni i shtypur.

ARTI DHE ARTET

Online: The Grove Dictionary of Art Online. New York: Grove, 1998 e deri më sot, www.grovereference.com/TDA/online/Index. çmimi ndryshon, mirëpo sillet diku rreth 1.500 dollarë në vit.[25]

E Shtypur: The Dictionary of Art. New York: 1996. 34 vëllime. $8.000.

[25] Më parë sesa kjo përmbledhje, enciklopedia standarde e artit ishte Encylopedia of World Art (New York: McGraw Hill Book Company, 1968, 5 volume, $1,500. Dy shtesat e kësaj përmbledhjeje 1983 dhe 1987). Artikujt shumë mirë të ilustruar (ku pjatat janë tek fundi i çdo volumi) vazhdojnë ta bëjnë këtë përmbledhje një vend shumë të frekuentuar për kërkim. Shumica e materialeve shpjegohet në Dictionary of Art mirëpo këtu ju mund të gjeni opinione dhe qasje të ndryshme. Është një përmbledhje që ja vlen të shikohet jo vetëm për pyetjet mbi referencat e gatshme.

E shtypur: International Encyclopedia of Dance. New York: Oxford University Press, 1998, 6 vëllime. $1.250.

The Dictionary of Art që botohet nga botuesi i një përmbledhje tjetër të quajtur *The New Grove Dictionary of Music and Musicians* është një nga enciklopeditë më mbresëlënëse krahasuar me të gjitha enciklopeditë e tjera mbi subjektet e caktuara. [26]

Statistikat flasin vetë: 34 edicionet peshojnë diku 75 kg; janë diku 32.600 faqe të cilat i përfshinë të gjitha aspektet dhe fushat e artit dhe artistëve, duke filluar prej kohës së shpellave (14 000 para Lindjes së Krishtit) e deri te epoka moderne. 41 000 artikujt janë të shkruara nga 6.700 ekspertëve dhe autorëve. Kjo punë pasqyrohet edhe me 15 000 fotografi dhe diku 750 harta. E fundit, po jo më pak e rëndësishme, është fakti se është e shtrenjtë, pra kushton 8 800 dollarë. Nëse e krahasoni atë me një version CD-ROM të enciklopedisë së përgjithshme që kushton 50 dollarë, shihet që çmimi është i lartë.

A ia vlen? Deri diku mund të thuhet që "po" edhe për faktin se kjo përmbledhje apo enciklopedi mund të gjendet në secilën bibliotekë të madhe. Artikujt janë shumë të lehtë për t'i lexuar dhe kuptuar dhe shumica e tyre nuk kanë zhargon akademik. I një rëndësie të veçantë është fakti se theks kryesor është vënë mbi artit jo perëndimor dhe nuk ka ciceron më të mirë se kjo mbi kulturat e reja dhe të vjetra jashtë qytetërimit perëndimor. Të gjithë artikujt përfshijnë bibliografi me shumë ilustrime të mira. Indeksi është më se i mirë. Rivali i vetëm i kësaj enciklopedie që është kompania gjermane Theime-Becker që filloi punën më 1907 dhe është ende duke e përmirësuar punën e vet. [27]

Indeksi komplet së bashku me të gjithë përmbajtjen e versioni të shtypur të 1996, u ofrua Online më 1998. Përparësitë më të mëdha dhe të dukshme, përveç çmimit, janë të përmbledhura nga vetë botuesi: "Përdoruesit do ta pëlqejnë faktin se ata do të jenë në gjendje të kërkojnë dhe të gjejnë informata më shpejt përmes 34 vëllimeve vetëm duke prekur miun e tyre të kompjuterit". Veçoritë e tjera të futura në versionin Online

[26] Për informata më të hollësishme mbi versionin në Internet, shiko "Art on Line", The New York Times, 13 maj, 1999, f. G1/G9.

[27] E emëruara sipas Ulrich Theime dhe Felix Becker, kjo përmbledhje ka tani 37 edicione apo volume mirëpo kjo ishte në vitin 1950 dhe prej asaj kohe asnjë volum tjetër nuk është botuar. Edhe pse shumë më e mirë se Dictionary of Art për nga numri i bibliografive, ky version është përkthyer në gjuhën angleze.

përfshinë: linkat për më se 100 000 fotografi te web-sajtet e tjera në Internet (përfshirë fotografi të bibliotekave dhe koleksione nga muzetë e mëdha nga e gjithë bota). Freskimi me informata, çdo tre muaj, tash, edhe pse deri në vitin 2000 kjo bëhej çdo muaj; referencat e kryqëzuara që janë të nënvizuara. Dhe, të jeni të sigurt se kjo enciklopedi ofron edhe mënyrat e ndryshme se si mund të kërkohen artikujt apo materialet e tjera, pra duke e shënuar fjalën apo edhe vetë titullin e artikullit. Po ashtu, freskohet me informata jo gati 3 apo 5 vjet, mirëpo çdo muaj.

Shumë më pak të organizuara janë një numër i madh i web-sajteve Online për institucionet specifike të artit. Këto shkojnë nga Prado në Madrid e deri te Galeria Nacionale në Londër. Po ashtu, shiko katalogët e muzeve individualë sikurse janë: *National Gallery Complete Illustrated Catalogue* në CD-ROM (Galeria Nacionale e Londrës, 1998, $95). Këtu janë edhe fotografitë dhe imazhet sikurse edhe informatat për historinë 2.300 materialet, plus që ofrohen edhe informata për artistët.

Duhet thënë tri gjëra për enciklopedinë e shkëlqyeshme "Encyclopedia of Dance", pika që janë të aplikueshme gati për të gjitha përmbledhjet e tjera me shume edicione. E para, është e shtrenjtë dhe mbi buxhetin që mund të ofrojnë shumica e personave. Pra, është shumë më e arsyeshme për ta pasur në bibliotekë. E dyta, është e gatshme dhe ofrohet vetëm në versionin e shtypur (së paku deri në vitin 2000). Arsyeja e qartë për këtë është ajo se botuesi shpreson që t'i fitojë milionat që i shpenzoi kur e botoi këtë enciklopedi dhe nuk mendon se këtë ta bëjë duke ofruar këtë në një version CD-ROM me çmim më të lirë. E treta, është një punë nga dijetarët që vijnë nga vende të ndryshme të botës. Nuk i dedikohet një vendi të caktuar, ose një stafi redaktues të caktuar.

E shtrenjtë, e ofruar vetëm në versioni e shtypur dhe me autorët që janë ekspertë. Të gjitha këto elemente mund të thuhen për gati çdo enciklopedi vëlliminoze të llojit të tillë.

Në veçanti, kjo enciklopedi përfshinë vallëzimet prej të gjitha periodave, të gjitha vendet dhe më shumë se 600 specialistë zhvendosen prej antropologjisë e deri te arti, pa ndonjë vështirësi. Ato thonë se vallëzimi nuk është një ngjarje më vete, mirëpo pjesë e kulturës. Ata i mbështesin ndonjëherë artikujt e gjatë me bibliografi shumë të detajuara, të cilat nuk përfshijnë vetëm libra, mirëpo edhe të dhëna mbi videot dhe disqet. Të gjitha këto mbështeten prej 2 000 ilustrimeve, referenca të kryqëzuara shumë të gjata dhe indeks të detajuar. Mirëpo, ka edhe disa të meta: kjo

përmbledhje është e dobët në biografi ndoshta për shkakun se informatat janë marrë nga *International Dictionary of Ballet* (Londër: St.James, 1993). Sikurse edhe në të gjitha veprat e tjera mbi referencat që bëhen në bashkëpunim, janë vërejtur mospajtime në mes së diturisë së autorëve dhe stilit të prozës. Prapëseprapë, është një vend shumë ideal për ta shikuar çdo aspekt të vallëzimit dhe gjendet në shumicën e bibliotekave.

Folklori

E shtypur: An Encyclopedia of Beliefs, Customs, Tales, Music, and Art. Santa Barbara,
Kaliforni: ABC-CLIO, 1997, 2 vëllime. $150.

Enciklopedia e folklorit është një nga enciklopeditë e pakta mbi subjektet e caktuara, e cila zgjon kërshërinë e shumë përdoruesve në Internet. Në vend që t'i drejtohet vetëm një grupi që është praktikë e zakonshme e enciklopedive mbi subjektet e caktuara, kjo enciklopedi i drejtohet çdonjërit nga shkolla fillore, te studentët e edhe më gjerë. Pretendon, sikurse po tregon edhe nëntitulli i saj, se folklori përfshin një fushë të gjerë të interesimeve, pra ka një audiencë shumë të madhe. Ky nocion, deri diku, mbështetet në përmbajtjen: 240 artikujt shumë të lehtë për t'u lexuar, prej 1 deri në disa faqe, definicione dhe shpjegime të termave, një analizë e shkurtër historike, që është e ngjashme me vendin dhe shënimin në skenën e sotme dhe bibliografi shumë aktuale. Ka një indeks të kënaqshëm. Pra, horizonti, sikurse u tha më parë, është shumë i gjerë duke filluar nga "folklori i fëmijëve" (diku 7 faqe) te folklori në Afrikë, Indi etj. Ke parasysh se nuk ka bibliografi edhe pse emrat mund të gjenden në indeks. Po ashtu, shih: *Dictionary of Chicano Folklore* (Santa Barbara, CA: ABC-CLIO, 2000, 330 f.), e cila është një kombinim i definicioneve dhe historisë mbi këtë subjekt.

Historia

E Shtypur: Chronicles of World History. Shih Indekset e Subjekteve, Kapitulli 6.

E Shtypur: Civilization of the Ancient Mediterranean: Greece and Rome. Nju Jork:

Charles Scribner's Sons, 1988, 3 vëllime, $259.

E Shtypur: Dictionary of the Middle Ages. Nju Jork: Charles Scribner's Sons, 1982-1989, 13 vëllime. $1.300.

Scribner, apo që quhet ndryshe edhe *Charles Scribner's Sons* (pjesë e Macmillan) janë liderë të padiskutueshëm në enciklopeditë mbi historinë dhe vepra e tjera të referencave të kësaj natyre. Janë shumë të besueshme dhe mjaft të përfytyrueshme që të ofrojnë tituj të rinj, çdo vit ose duke i freskuar me informata, botimet ekzistuese. Këtu është një thjeshtësim i këtyre veprave vetëm në shkurtimin e shumë titujve.

Greqia dhe Roma zënë vend të konsiderueshëm në enciklopeditë e përgjithshme me disa vëllime, mirëpo nuk janë të trajtuara në thellësinë që do t'i duhej edhe një eksperti. Pra, në atë se ekspertit do t'i duhej të dijë, për shembull, se si ka qenë pozita e gruas në të dy këto shoqëri në një kohë të caktuar. Është për pyetje të tilla për të cilat ju ktheheni dhe shikoni enciklopedi sikurse kjo, apo edhe enciklopeditë në fushat e tjera si p.sh. enciklopedia shumë e mirë me një edicion Oxford History of the Classical World (Nju Jork; Oxford University Press, 1988).

Enciklopedia me tri vëllime nga Scribner përfshin shkencën, shkencat shoqërore, edhe po ashtu edhe humanitetet në të dy civilizimet, mirëpo duke marrë një qasje të ndryshme. Në vend se të përdoret një sistem kronologjik, janë diku 95 ese individuale prej shumë ekspertëve. Të organizuara nën tituj të subjekteve mjaft të gjera, secili artikull e shqyrton një problem apo çështje në thellësi. Ilustrimet shoqërojnë disa nga këta artikuj dhe gjenden, po ashtu edhe indeksi në vëllimin final të saj.

E botuar nga Scribner më 1995, *Civilization of the Ancient Near East* (4 edicione), plotëson enciklopedinë mbi grekët dhe romakët. Këtu një grup i ekspertëve, të cilët shkruajnë në nivelin e mirë aq sa e kuptojnë subjektin në fjalë, përfshijnë kulturën prej Kohës së Gurit, 3 200 para lindjes së Krishtit, e deri te pika më e lartë e civilizimit grek, 325 para lindjes së Krishtit. Asnjë enciklopedi tjetër nuk i ka pasqyruar kulturat më mirë në këtë interval kohor.

Shumë botues janë të joshur nga historia, mirëpo sikurse u tha më parë, lider në enciklopeditë mbi historinë është *Scribner.* Për shembull, në mes viteve 1983 e 1990, ata botuan edicionin e parë të *Dictionary of the Middle Age*. Vepra apo edicioni 13 (me një indeks të detajuar) i shtjellonte ngjarjet nga viti 500 e deri te përfundimin i kësaj periudhe. Janë diku mbi

5 000 artikuj nga disa prej historianëve më të mira që ka bota sot në këtë fushë. Një gjë shumë fascionuese është fakti se kjo enciklopedi i adresohet jetës së përditshme të personit mesatar të ditëve të sotme. Ju shihni lëvizjen prej manastireve te fermat, e jo vetëm prej kështjellës te mbreti. Për më shumë, janë shumë copa biografike në figurat e mëdha të historisë dhe ato më pak të njohura. Gjenden edhe disa ilustrime në bardh/zi apo edhe disa janë edhe me ngjyra, mirëpo pjesa më e rëndësishme e kësaj përmbledhje është teksti, e jo ilustrimet. Artikujt janë të shkruar nga 1 300 dijetarë që vijnë nga rreth 30 vende të ndryshme. Mund të lexohet si libër i historisë e po ashtu edhe si vepër e referencave - në një situatë ideale. Shih, po ashtu edhe enciklopeditë e tjera të kësaj natyre nga i njëjti botues: *Encyclopedia of the Renaissance* (1999, 6 vëllime. $695). Kjo enciklopedi i përfshin 1 200 artikuj, harta, ilustrime dhe puna nga ekspertët në periudhën nga viti 1350 e deri më 1650.

History Resource Center, e botuar nga Gale Group: (www.galenet.com) përfshin në vete enciklopeditë nga familja Scribner e po ashtu edhe indekset bazë historike prej ABC-CLIO dhe të dhënat e tjera. Prej Scribner, jo bazë gjigante e të dhënave i përfshin edhe disa enciklopedi të tjera relevante mbi historinë: tekstin e plotë e *Dictionary of American History, Encyclopedia of American Social History, The Presidents: A Reference to History*, dhe shtesat sikurse vëllimi 9 dhe 10 i *Dictionary of American Biography.* Për më shumë, ky është një indeks i rreth 65 shënimeve historike (shumica e tyre janë të gatshme Online me tekstin e plotë). Janë edhe tekstet nga dokumentet e mëdha historike prej *Mayflower Compact* e deri te Raporti i quajtur Warren. 6 000 fotografi janë futur në këtë enciklopedi, e po ashtu janë të shënuara edhe veçoritë e tjera dhe veprat e tjera të referencave. Ka mënyra të shumta për të bërë kërkime, shumica e të cilave janë fort të kuptueshme. Me një theks të veçantë në tekstin me cilësi të larta dhe me një numër shumë të vogël të lëshimeve e gabimeve, kjo enciklopedi është një vend i duhur të fillosh kërkimin elementar mbi një fushë të gjerë të historisë amerikane.

Një vështrim i shpejtë mbi Books in Print tregon se ka shumë zgjedhje ndërmjet enciklopedive të historisë. Këtu, pak më poshtë janë të përmendura nga më të mirat. Ke parasysh se për një shumë modeste të parave, një bibliotekë mund të blejë enciklopedi me një vëllim sikurse *Encyclopedia of World History* (Nju-Jork: Oxford University Press, 1999, 784 f. $30), e cila ka rreth 4 000 shënime të radhitura sipas alfabetit. Paragrafët përshkrues janë të shkurtër dhe zhvendosen prej njerëzve e vendeve te ngjarjet e caktuara.

Shkenca e bibliotekave

E Shtypur: Encyclopedia of Library and Information Science. Nju Jork: Marcel Dekker,
1968 e deri më sot, 35 vëllime, plus shtesat. $115.

Edhe pse është shumë kontravers, *Encyclopedia of Library and Information Service* nuk mund të fajësohet për mbulim e gjerë dhe përpjekjet ambicioze të saj. Disa njerëz mendojnë se ka shumë material, e të tjerët thonë se fushat nuk janë mbuluar ashtu siç do të duhej, në veçanti nga autorët që janë të përfshirë. Shtesat që botohen mesatarisht gati çdo vit janë përpjekje për ta mbajtur këtë enciklopedi në hap me kohën. Në të vërtetë, artikujt e gjatë në këto shtesa të botuara në të shumtën e rasteve janë më të mirë sesa artikujt e botuar në enciklopedinë kryesore dhe janë burime shumë të mira të informatave për trendët në biblioteka dhe informata.

Është shumë befasues fakti se kjo enciklopedi nuk ofrohet në formatin elektronik. Mirëpo, arsyetohet se lexueshmëria, interesi dhe fondet e limituara nuk janë të përçmueshme për version CD-ROM ose për versionet Online të enciklopedive mbi subjekte të veçanta- edhe në raste kur kemi të bëjmë me bibliotekë dhe shkencën e informacionit.

Duhet thënë se versioni në anglisht i *International Encyclopedia of Information and Library Science* (Londër; Routledge, 1997. 235 f.) është një aranzhim alfabetik i të dhënave dhe i opinioneve mbi shkencën e informatave. Shumë regjione të botës shqyrtohen në artikujt e kësaj enciklopedie, duke filluar nga "komunikimi" e deri te "menaxhimi i informatave". Redaktorët John Feather and Paul Strangle kanë ekspertë në ekipin e tyre, të cilët kanë aftësi të shkruajnë njëjtë sikurse edhe autorët e eseve.

Letërsia

E Shtypur: Benet's Readers' Encyclopedia, edicioni 3. Nju Jork: HarperCollins, 1987, 1091 f. $45.

Këtu gjenden shënime të udhëzuesve një dhe dy vëllimesh të letërsisë, shumica e të cilëve janë shumë të përshtatshëm për pyetje mbi referencat e gatshme: "Kur kishte lindur R. R. Boyd? "Kur kishte vdekur ajo?" "Çka

kishte shkruar?" "Sa e rëndësishme është vepra e saj *Tale of Three Horses* në krahasim me veprat e tjera të saj?" E kështu me radhë. Ju mund t"i gjeni përgjigjet në këta udhëzues.

Nuk ka vepër më të mirë sesa ai i referencave të letërsisë me një vëllim të vetëm i quajtur *Benet's Readers' Encyclopedia.* E emëruar sipas botuesit të saj të parë, William Rose Benet, kjo ka radhitje alfabetike, një format me shënime të shkurtra të letërsisë dhe artit botëror. Gati 9 500 shënimet kanë të bëjnë me personalitet biblike e edhe me shkrimtarët më të njohur, duke përfshirë këtu edhe vitin 1987. Shumica e të dhënave janë të shënuara në një tabelë skicë-vizatim. Nuk janë të përfshira vetëm të dhënat mbi letërsinë, mirëpo edhe ato të arteve të tjera prej pikturës e operës e deri te ushtria. Shpjegimet janë të shkurtra, të qarta dhe të shkruara mjaft bukur.

Benet, sikurse quhet nga bibliotekarët, e meriton ta ketë një vend në raftin me librat mbi referencat e gatshme përkrah enciklopedive të tjera sikurse Barlett dhe World Almanac. Është një botim që të ndihmon shumë dhe që i rekomandohet që t'i bëjë dhuratë dikujt për ditëlindje.

Muzika

Online: The New Grove II Dictionary of Music and Musicians Online, Nju Jork:

Grove. 2000 e deri më sot, www.grovemusic.com. çmimi ndryshon.

E shtypur: edicioni 2. 2000. 28 vëllime. $4.250.

Edicioni apo vëllimi 29 i *New Grove II* është pa dyshim përmbledhja më e mirë në fushën e muzikës. Sikurse edhe edicionet e mëparshme, informata në të janë të besueshme dhe serioze, duke u bazuar edhe në përvojën dhe aftësitë e mbi 2 500 autorëve të shkrimeve në të. (Shënim: Vëllimi 20 në vitin 1980 ka qenë dhe mbetet "blerja më e mirë" nëse mund të gjenden në versioni e shtypur për 500 dollarë apo edhe më pak. Vëllimi 20, i përdorur, mund të gjendet dhe të blihet për më pak se 1 500 dollarë. Shumica e informatave në të janë të përdorshme dhe ndryshimi i vetëm ndërmjeti tij dhe edicionit të ri është në sasi, e jo në kualitetin e materialit redaktues, ilustrimeve etj.).

Derisa shumë e vlefshme për bibliotekarët e referencave, në radhë të parë për artikujt e detajuar në muzikën dhe muzikantët para shekullit të XX, edicionin i fundit tanimë përfshin informata të hollësishme në jetën

e muzikës moderne, duke përfshirë jo vetëm kompozitorët dhe muzikantët klasikë të kohës, mirëpo edhe ata nga muzika në trend, përfshirë këtu pjesën më të madhe të muzikës folklorike.

Janë diku 29 000 artikuj me 3 500 ilustrime të cilat, sipas botuesit, zënë 7 % të hapësirës të këtij edicioni. Për më shumë, janë disa qindra mijëra materiale të hollësishme mbi muzikën dhe skeçet e gjata biografike, pra ka shumë bibliografi. Këto nuk gjenden vetëm në fund të artikujve, mirëpo shumicën e rasteve këto janë shënime të veçanta si p.sh. "Gjermania dhe Austria: Biografia e Muzikës e viteve1 600". Theks i njëjtë vihet mbi radhitjen e veprave të kompozitorëve të ndryshëm. Mirëpo, shihet qartë në disa pjesë të kësaj enciklopedie se është një konsensus, në gati të gjitha analizat e përmbledhjes, që pikat më të larta janë biografitë. Këto biografi janë më të mirat që mund të gjenden në ndonjë burim të referencave dhe zgjidhja e parë për bibliotekarët.

Versionit Online i ndryshon çmimin prej diku $600 në vit. I ka të gjitha përparësitë e zakonshme të veprave elektronike. Nga përparësitë më të mira të saj është sistemi i lidhjes, i cili bën lidhjen në mes të artikujve individualë dhe artikujve të tjerë të të njëjtës natyrë, që mund të gjenden në ueb. Freskimi me informata çdo tre muaj janë të planifikuar dhe përfshinë shtesat në biografi dhe zërimet digjitale. Shumica e bibliotekave i dëshirojnë që të dy versionet, të shtypur dhe atë Online. Mirëpo, nëse buxheti lejon blerjen e vetëm njërës prej tyre, atëherë versioni Online është zgjidhja e parë.

Sikurse edhe me të gjitha enciklopeditë që mbulojnë një subjekt të veçantë, të dhënat Online e kompletojnë fushën e muzikës. Ju mund të gjeni informata shumë të mira për gati të gjithë kompozitorët, këngëtarë, ose ndokush tjetër që ka lidhje me muzikën dhe që informatat e tij gjenden në Internet. Një ekspert nuk ka fort vështirësi në ndarjen e asaj çka është e mirë dhe asaj që është e keqe. Mirëpo, personat fillestarë në shumicën e rasteve i kanë blerë enciklopeditë standarde të ofruara Online dhe në versioni e shtypur, sikurse këto që janë të radhitura më poshtë.

Një përparësi e madhe e shtegut të informatave elektronike është fakti se ky është një sistem sistematik. Mirëpo, duhet cekur edhe procedurat e ngadalshme për të pasur qasje në arkivat Online. Le ta marrim shembull muzikën, duke filluar nga mesi i vitit 2000 shumica e dorëshkrimeve të kompozitorit Bah mund të gjenden te *Bach Digital Library* (www.bachdigital.org). Ky projekt ishte lansuar me postimin e 180 faqeve nga vepra e Bahut "Mas në B-Minor".

The New Grove Dictionary of American Music (1986, 4 vëllime, $695)

pikë së pari duhet thënë se është një vepër origjinale. Ju mund të gjeni këtu shënimet që gjenden edhe në *The New Grove Dictionary of American Music and Musicians*, mirëpo askund të shtjelluara në detaje sikurse në këtë version të ri. Për shembull, "Muzika popullore," është në enciklopedinë e parë, mirëpo në këtë version është shumë më shumë e shtjelluar, në gati 22 faqe. Kur ata thonë se 70 % e materialit që gjenden në këtë botim është origjinal, kanë shumë të drejtë. Autorët e këtyre shkrimeve janë po ashtu të nënshkruar në tekstet dhe artikujt e tyre. Kjo enciklopedi është shumë e përdorshme për pasqyrimin e skicave biografike dhe materiale të tjera mbi autorë më pak të njohur. Në edicionin e dytë është futur për herë të parë edhe indeksi në vëllimin 29, që në të vërtetë është një përparësi e madhe.

Vepra të tjera, shumë të mira, të botuara nga i njëjti botues janë edhe: *The New Grove Dictionary of Jazz* (1988, 2 vëllime. $350); *The Encyclopedia of Popular Music,* edicioni in tretë. (1998, 8 vëllime. $750). Kjo letër ka diku mbi 350 faqe me indekset e këngëve dhe më se 50 000 tituj. Përfshirja dhe shtjellimi është komplet për muzikën jo klasike të shekullit XX, prej muzikës "kantri" e deri te repi.

Filozofia

CD: Routledge Encyclopedia of Philosophy. Londër: Routledge, 1998. $2.995.

E Shtypur: 10 vëllime. $2.995. (Shënim: Versioni i shtypur dhe ai CD-ROM
të kombinuar kushtojnë 3.495 dollarë).
Versioni i ngjeshur në një vëllim, 1999. $40.
E Shtypur: The Encyclopedia of Applied Ethics. Orlando, Florida, 1997. 4 vëllime. $625.

Routledge Encyclopedia of Philosophy e zgjidh problemin e konkurrencës në çmime duke e rritur çmimin e versionit CD-ROM dhe duke e bërë të njëjtë me versionin e shtypur. (Është edhe versioni i kombinuar i CD-ROM dhe asaj të shtypur që kushton vetëm 500 dollar më shumë). Disku apo CD-ja ka tekstin komplet nga versionin i shtypur sikurse edhe përparësitë tjera elektronike sikurse kërkimi dhe drejtimi. Versioni i ngjeshur ka numër të njëjtë të shënimeve sikurse edhe enciklopeditë më voluminoze, mirëpo ata janë pak më të shkurta për shkakun se kujdes kryesor

këtu u kushtohet përmbledhjeve. Ky version nuk është më i miri, mirëpo mund të blihet në rastet kur buxheti është i vogël.

Shumë më e rëndësishëm është përmbajtja e më se 2 000 shënime të gjata prej diku 1 300 autorëve. Edhe pse e botuar në Angli me botues Universitetin e Kembrixhit, ekspertët vijnë nga pjesë të ndryshme të botës. Kjo enciklopedi ka dy përparësi shumë të mëdha: (a) ka informata shumë aktuale dhe të freskëta, që përfshinë jo vetëm aspektet nga lëvizjet historike dhe ato filozofike, mirëpo në të vërtetë edhe sugjeron debate që mund të bëheshin për këto fusha; (b) është një nga qasjet dhe enciklopeditë më të mirë për këtë subjekt edhe nga fakti se tani të gjitha materialet ofrohen në këtë enciklopedi të vetme.

Autoriteti ndërkombëtar i saj, duke përfshirë disa disiplina, deri diku e shpjegon aspektin shumë pragmatik të etikëve në enciklopedinë me shumë vëllime të quajtur *Encyclopedia of Applied Ethics*. 282 temat dhe subjektet e ndryshme janë të analizuara në detaje. Për shembull, literatura shtjellohet së bashku me problemet më të dukshme, të cilat janë të lidhura me medicinën moderne dhe me shkencë. Edukata seksuale, për shembull, i përfshinë të mirat dhe të metat e këtij subjekti dhe, sikurse të gjitha artikujt, e ka edhe fjalorin dhe një bibliografi mjaft aktuale.

Shumë referenca të kryqëzuara sikurse edhe një indeks mjaft i zgjeruar janë të bashkangjitura në të. Shënim: web-sajtet në Internet: (www.academicpresscom/ethics) është një përpjekje për t'i mbajtur këto informacione të freskëta, në veçanti duke shtuar lexime dhe lajme të ndryshme). Megjithatë, nuk e ka gjithë tekstin e përmbledhjes.[28]

Një tjetër burim i mirë, edhe pse përfshin materiale përtej filozofisë, është çka Reference Book Bulletin e ka quajtur "një reference klasike e ndërmjetshme"[29]. Kjo është enciklopedia e quajtur Encyclopedia of Aesthetics (Nju Jork: Oxford University Press, 1998, 4 vëllime). Këtu janë rreth 600 artikuj të gjatë mbi njerëz, teori, e lëvizje të ndryshme. Mbulimi i fushave është ndërkombëtare dhe kjo enciklopedi mund të përdoret si nga ekspertët ashtu edhe nga njerëzit e thjeshtë e joprofesionistë.

---

[28] Për situata më specifike sikurse në rastin me gati të gjitha përmbledhjet mbi subjekte të gjëra, ka edhe vëllime të vetme, të cilat i mbulojnë dhe shpjegojnë aspektet specifike të filozofisë. Shumica e tyre janë cekur në Rooutledge. Për shembull: Encyclopedia of Classical Philosophy (Westport, CT, Greenwood, 1997, 614 f.) e cila shqyrton filozofinë greke dhe romake prej shekullit të VI para Krishtit e deri te shekulli i VI.

[29] 1 shkurt, 1999, f. 989.

Psikologjia

E Shtypur: Encyclopedia of Psychology, edicioni 2. Nju Jork: Wiley Interscience, 1994, 4 vëllime. $475.

Si fituese e çmimit për enciklopedi, kjo enciklopedi ka qasje bazike mbi psikologjinë dhe fushat e tjera të lidhura me të. Mund të gjenden në libraritë e mesme dhe ato të mëdha. Mbulimi dhe trajtimi është i gjerë duke filluar nga një histori e mrekullueshme dhe artikujt për të kaluarën e deri te materialet specifike dhe artikujt mbi terapinë dhe kërkimin, të cilat ndryshojnë nga regjioni në regjion dhe nga vendi në vend. Të gjitha mospajtimet e ekspertëve mund të gjenden këtu, që shpesh mund të hasen edhe në botime dhe artikuj në gazeta të përditshme.

Si psikologjia që i prek shumë fusha të qenies njerëzore, ju mund të gjeni këtu edhe artikuj mbi muzikën, sociologjinë, artin, shkencën, biznesin, ligjin dhe kështu me radhë. Në çdo rast kur duhen informata për persona të caktuar për njerëz apo personalitete, të cilët janë pjesë e komedisë/tragjedisë njerëzore, ju medoemos do të gjeni diç në këto 4 vëllime. Dyshimin tuaj në artikujt dhe copat e tjera të shkrimit e shuajnë emrat e mrekullueshëm dhe indekset e mira mbi subjektin. (Po ashtu, vëllimi 4 ka një bibliografi aktuale me informata të reja, sikurse edhe skica biografike e personaliteteve më të njohura nga fusha e psikologjisë).

Diku 400 autorët që kanë nënshkruar punën e tyre janë përgjegjës për shkrimin e më se 2 500 artikujve. Shumica e tyre përfshinë edhe diagrame, grafike dhe ilustrime të tjera të përdorshme. Qëllimi është mbulimi, sa më i mirë, i kësaj fushe dhe nuk ka asnjë tendencë për ta thjeshtësuar materialin e shumtë. Zhargonet nuk janë gati fare të pranishme, edhe pse një lexim i vëmendshëm (në disa raste me fjalorë afër jush) do të ishte e domosdoshme.

Botuesi, po ashtu ofron edhe botimin e shkurtuar në vetëm një vëllim dhe titullohet *Concise Encyclopedia of Psychology*, i cili kushton 100 dollarë. Grremçi këtu është fakti se është i bazuar kryesisht në edicionin e parë. Edicioni i ri planifikohet të botohet brenda një ose dy vjetëve.

Në të njëjtën kohë, për ato biblioteka që kanë buxhet të mjaftueshëm dhe që janë të interesuara në botimet e reja, një enciklopedi që rishtazi është botuar në këtë fushë titullohet *The Encyclopedia of Psychology* (Oxford: Oxford University Press, 2000, 8 vëllime $995). Duke qenë dy

herë më e madhe sesa konkurrenti i saj (dhe dy herë më e shtrenjtë), kjo enciklopedi përfshin materialet pothuajse të njëjta sikurse edhe enciklopeditë e mëparshme. Përparësia më e madhe e saj është shumë e qartë: kjo enciklopedi ka informata më të reja, edhe pse ndokush mund t'i preferojë enciklopedinë nga konkurruesi i saj, për shkak të stilit më të mirë të të shkruarit dhe artikujt e dokumentuar. Blerja është një luks, mirëpo një enciklopedi është shumë e mirë për bibliotekat e mëdha.

Religjioni[30]

E shtypur: The Enciclopedia of Religion. Nju Jork: Macmillan Company, 1986,
16 vëllime. $1.400. (Më 1993 kjo enciklopedi u botua si enciklopedi me 8
vëllime duke u shitur me çmim prej 750 dollarëve).

E Shtypur: The Encyclopedia of Christianity. Nju Jork: Eerdmans, 1999 e deri më sot,
vëllimi i parë (A-D). $100.

CD: Encyclopedia Judaica. Shaker Heights, OH: Judaica Multimedia, 1997. $595.
E shtypur: 1972. 16 vëllime. Vjetarët. 1974 e deri më sot.

Shënimet në *Encyclopedia of Religion* janë aktuale dhe të radhitura sipas rendit alfabetik me referenca të kryqëzuara dhe me një indeks për lakmi. Bibliografitë janë të shkëlqyera. Mbulimi ndërkombëtar dhe i religjioneve të ndryshme ndryshon lehtë, qetë, e pastër nga hebrenjtë dhe historia myslimane deri te ritet dhe besimet hinduse. Gjenden shënime të jashtëzakonshme për fushat e afërta sikurse alkimia e ateizmi. Duhet posaçërisht të përmendet stili i të shkruarit dhe redaktimi i mirë, i cili zgjon kërshërinë jo vetëm te studentët e religjioneve, mirëpo edhe lexuesit e zakonshëm.

E planifikuar që të përfundohet nga viti 2004, *The Encyclopedia of Christianity* është një përkthim i enciklopedisë gjermane *Evangelisches*

[30] Janë disa qindra vepra dhe punime të cilat shtjellojnë temën e religjionit në stilin e enciklopedive emrin enciklopedi në titullin e tyre. P.sh. America's Religion for one. Shiko edhe Guide to Reference Books, "Reference Sources for Non-Christian Religions," si dhe Booklist, 1 tetor, 1997, f. 345-349.

Kirchenlexikon. Mbulimi i religjionit është ndërkombëtar dhe i përfshinë të gjitha sektet dhe besimet krishtere. Po ashtu, ke parasysh se ka edhe artikuj të lidhur me këtë temë, si për shembull artikujt mbi etikën e deri te politika, kontrollin dhe kolonizimin etj. Shënimet e dijetarëve janë objektive dhe prezantojnë shumë anë të çdo çështje të dyshimtë dhe kontraverse. Kjo enciklopedi është një blerje e domosdoshme për çdo bibliotekë që është e interesuar në këtë subjekt, pra religjionin.

Enciklopedia tjetër e quajtur *Encyclopedia Judaica* është një enciklopedi standarde në këtë fushë dhe duke iu falënderuar versionit të saj në CD-ROM, kjo enciklopedi është shumë më aktuale dhe me informata të reja tani. E botuar në 16 vëllime në vitin 1972, shumë shpejtë u bë enciklopedi me informata të datuara (duke përjashtuar këtu faktet kryesore historike të cilat përbëjnë ¾ e kësaj përmbledhje).

Vjetarët dhe koleksionet dhjetëvjeçare janë futur si versione me informata të reja. Mirëpo, vetëm versioni i CD-së i bën ato bashkë për një kërkim dhe studim më të lehtë të tyre. Kjo është edhe më e lehtë me futjen edhe të indeksit nga versioni i shtypur, i cili mund të shfletohet, të shënohet fjala kryesore (key word) apo duke përdorur logjikën Boolean. Rezultati i gjithë kësaj është një enciklopedi shumë e mirë mbi religjionin, e cila mbi 25 000 artikuj prej më se 2 200 autorëve dhe ekspertëve. CD-ja ka edhe klipe filmike, incizime të zërit, prezantime me "slide-show" dhe linka standardë për web-sajte të ndryshme. Mirëpo, përmbledhja bazike ende është e njëjtë sikurse ajo e shtypur me artikuj shumë të besueshëm që shkojnë nga hebreu i parë në historinë biblike deri te konfrontimet politike në Lindjen e Afërt. Duke iu falënderuar mbulimit të saj shumë të gjerë, sikurse edhe përmbledhjet e tjera (p.sh. Catholic Encyclopedia) ofron burime të ndryshmet të personave të ndryshëm që janë munduar t'i pasqyrojnë të dhënat historike dhe biografike gjatë kohëve.

Një përmbledhje më e re është enciklopedia *Encyclopedia of Judaism* (Nju Jork: Muzeu i Trashëgimisë Hebraike. Distribuuar nga Continuum Publishing, 1999, 3 vëllime, $250). Kjo i prek 120 subjekte të kësaj fushe, që të gjitha të shkruara nga dijetarë e autorë të mëdhenj. Subjektet në këtë fushë lëvizin prej Detit të Vdekur, te holokausti, e deri te Izraeli modern.

Për fat të keq, e ka një indeks shumë të varfër.

Shkenca

Online: Access Science. Nju Jork: McGraw- Hill, 2000 e deri më sot, e përditshme, www.accessscience.com. çmimi ndryshon.

CD: McGraw-Hill Multimedia Encyclopedia of Science and Technology. 1995 e deri më sot. $795.
E shtypur: *McGraw-Hill Encyclopedia of Science and Technology*, edicioni 8. Nju Jork: McGraw Hill, Inc.,1997, 20 vëllime. $1,995.

CD: Science Navigator. Nju Jork: McGraw Hill, 1977 e deri më sot, e përvitshme.$150.
E shtypur: McGraw Hill Concise Encyclopedia of Science & Technology. 1994 e deri më sot, e përvitshme. $150.

CD: Mammals: A Multimedia Encyclopedia. Uashington, DC: Shoqëria Nacionale e Gjeografisë, 1990 e deri më sot. $99-$150.
E shtypur: Book of Mammals. Shoqëria Nacionale e Gjeografisë, 2 vëllime.
Çmimi ndryshon.

CD: Eyewitness Encyclopedia of Nature. Nju Jork: DK Multimedia, 1998. $39.95.

Enciklopeditë e shkencës janë posaçërisht të rëndësishme për bibliotekat. Bibliotekarët prej bibliotekave publike dhe ato akademike kur ishin pyetur se "cilat libra janë më të kërkuara në biblioteka, ata kishin thënë se librat e shkencës janë ndër më të kërkuarat." [31]

Enciklopedia më e mirë në fushën e shkencës dhe teknologjisë është The *MacGraw Hill Encyclopedia of Science & Technology*, e cila e mban këtë pozicioni për faktin se: (a) ka artikuj dhe materiale shumë të lehta për t'u kuptuar për personat joprofesionistë sikurse edhe për studentët; (b) i ka 13 000 ilustrime të jashtëzakonshme, shumica me ngjyra, të cilat e shpjegojnë dhe e kompletojnë tekstin; dhe (c) ka një indeks për lëvdata. Në këtë enciklopedi janë përfshirë rreth 7 500 shënime në 20 vëllimet e saj dhe në secilin edicion të ri 15-20% e artikujve janë të rishikuar dhe me informata të reja. Indeksi është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë i ka rreth 170 000 shënime, kurse e dyta është e ndarë në më se 80 disiplina.

[31] "Science at Your Fingertips," Library Journal, 1 prill, 1999, f. 86.

Enciklopedia në versionin Online dhe atë CD-ROM i përfshin në vete të gjitha tekstet që gjenden në versioni e shtypur prej 20 vëllimeve, mirëpo numri i ilustrimeve është shkurtuar prej 13 000 në 2 000 sosh. Kjo i jep hapësirë botuesit të shtojë rreth 60 minuta zërim narrativ dhe 60 minuta të tjerë me sekuenca të animacionit. Për më shumë, është edhe pjesa e rezervuar për më se 15 000 termat që quhet *McGraw-Hill Dictionary of Scientific and Technical Terms* (edicioni i –të, 1999, 2 300 f. $150). Duke u rishikuar dhe duke u freskuar me informata gati çdo pesë vjet, kjo pjesë përfshin definicione në atë se çka gjendet në enciklopedi. Nëse ka mundësi, një bibliotekë duhet t'i ketë që të dyja këto, pra versionin e shtypur dhe atë CD-ROM, për arsyen se secila nga to ka përdorim të veçantë në punët e referencave. Kur përdoret shpesh, versioni Online, ani pse më i shtrenjtë, preferohet sepse vazhdimisht freskohet me informata nga e përjavshmja Science News dhe "freskimet me informata nga kërkimi", të cilat gati gjithmonë janë të pranishme në vjetarin e kësaj enciklopedie.

Vëllimi i vetëm i *McGraw-Hill Concise Encyclopedia of Science & Technology* (që ofrohet si në versionin e shtypur, po ashtu edhe në atë CD-ROM me emrin *Science Navigator*) është një version më i shkurtuar me 20 vëllime. Është enciklopedi ideale për shtëpitë dhe bibliotekat, të cilat duan t'i freskojnë veprat e tyre, jo më shpesh sesa në 4 apo 5 vjet. (Materiali historik nuk ka datë të caktuar dhe titulli i vëllimit shërben si lloj vjetari për veprat apo enciklopeditë më të mëdha). Versioni konciz ka më shumë se 8 000 artikuj – që është afërisht i njëjtë me numrin që gjenden në enciklopedinë kryesore- mirëpo këtu janë të shkurtuar. Në të njëjtën kohë, janë disa qindra mijëra shënime të reja dhe ilustrime, të cilat e freskojnë enciklopedinë kryesore.

Enciklopeditë më të njohura të shkencës me titujt e tyre mjaft shpjegues mund të gjenden në shumicën e bibliotekave të mesme dhe ato të mëdha: *The Facts on File Encyclopedia of Science, Technology and Society* (Nju Jork: Facts on File, 1999, 3 vëllime) dhe *The International Encyclopedia of Science and Technology* (Nju Jork: Oxford University Press, 1999, 471 f.).

Një enciklopedi mjaft e njohur gati për të gjitha bibliotekat është *Van Nostrand's Scientific Encyclopedia* (Nju Jork: J.W., edicioni 8, 1999, 2 vëllime). Kjo është enciklopedi ideale për të shikuar shpejt referencat e gatshme për arsyen se shënimet janë të shkruara për fillestarë. Informacioni është i shkurtër dhe i lehtë për t'u kuptuar. 7 000 artikujt shtesë janë të

gatshëm në CD-ROM. Ky version vazhdimisht freskohet me informata dhe i ka të gjitha përparësitë e zakonshme të kërkimit apo "search". Ndoshta e ka një të metë: kushton $350.

E përgatitur nga Shoqëria Nacionale e Gjeografisë për fëmijët prej moshës 10 deri 16 vjeçare, *Mammals: A Multimedia Encyclopedia* ka fotografi shumë të mira me shpjegime përkatëse. Mirëpo, kjo është vetëm fillimi. Nëse përdoruesi dëshiron informata për shtazët atëherë: (1) ai/ajo do të ketë mundësi t'i shikojë 45 klipe të plota të gjitarëve dhe sisorëve në aksion; (2) mund të dëgjojë 155 vokalizime digjitale; (3) të luajë lojëra; (4) të gjejë definicione; (5) të dëgjojë se si narratori i thotë emrat e shtazëve dhe shumë e shumë gjëra të tjera. Shumica e klipeve filmike vijnë nga prodhimet e televizioneve shumë të njohura. Fëmijët e kontrollojnë prezantimin duke përdorur një ikonë gjeografike. CD-ROM nuk gjendet më në përmbledhjen prej dy vëllime të Shoqërisë Nacionale të Gjeografisë e quajtur *Book of Mammals.*

Enciklopedi për të njëjtën temë, por shumë ndryshe nga kjo që u përmend më parë, është edhe versioni CD-ROM i *McGraw-Hill Multimedia Encyclopedia of Mammalian Biology* (1992. $495). Duke u bazuar në enciklopedinë legjendare *Grimzek's Encyclopedia of Mammals*, versioni elektronik e ka tekstin e plotë sikurse edhe ilustrime të shumta në të. Arsyeja e blerjes së kësaj enciklopedie elektronike është fakti se ofron veçori të tjera mbi tekstin si tekst, duke filluar nga zërat, video klipet e deri te grafiket. Kjo enciklopedi është për studentët e suksesshëm të shkollave të mesme dhe për të rritur.

Shkenca duket sikurse është shumë e përshtatshme te veçoritë mbi tekstin si tekst dhe si e tillë gjenden edhe shënime të mundësive për të rritur, fëmijë dhe për audiencë të përbashkët. Për shembull: *Multimedia Audubon's Birds* (Portland, OR: CMC Research. $49.95) dhe enciklopedia nga kompania e njëjtë *Multimedia Audubon's Mammals* ($49.95). Të gjitha kanë të përfshira në vete zërime, mocione dhe kënaqësi për përdoruesit pa marrë parasysh se në çfarë moshe janë ata.

Kompania DK Multimedia ka zënë një vend të veçantë dhe të respektuar në prodhimin e enciklopedive shkencore, lehtë të kuptueshme dhe të famshme, sidomos në version CD-ROM. Audienca e saj është zakonisht prej shkollave fillore e deri te të rriturit. Poenta e tyre është të shpjegojnë aspekte të shumta të shkencës te njerëzit e thjeshtë e jo te ekspertët. Tipike është *Eyewitness Encyclopedia of Nature*, e cila shpjegon bletët, gushëkuqtë e deri te peshqit. Pyetjet tipike se si p.sh. bletët i ndërtojnë pirgjet dhe se si flenë lakuriqët e natës janë të shpjeguara dhe të shtjelluara mirë në tekst, panorama, video dhe rekreacione nga më të mirat e natyrës. Edhe pse nuk është një enciklopedi, ku do të mund të gjenit

informata në hollësi, prapëseprapë ofron një shpjegim solid për lexuesit që janë mesatarisht të përfshirë në rrjedhat e përgjithshme.

Ndër enciklopeditë e tjera që rekomandohen e që janë pjesë e kompanisë DK Multimedia në versionin CD-ROM dhe që gjenden në biblioteka janë: *Eyewitness Encyclopedia of Science* (një enciklopedi më e përgjithshme, e cila shtjellon matematikën, kiminë dhe shkencat natyrore), e po ashtu edhe "Eyewitness" që flet për hapësirën.

Në Internet

Janë së paku disa dhjetra ose më shumë enciklopedi të subjekteve (pra që shtjellojnë një subjekt të caktuar) që ofrohen falas në Internet. Shumica e tyre, jo vetëm që nuk janë të besueshme, mirëpo po ashtu edhe janë të pajisura me informata të vjetra dhe vlera e tyre është e barabartë me zero. Disa prej këtyre enciklopedive janë vetëm në versionin elektronik sikurse Catholic Encyclopedia (www.newadvent.org/cathen). Kjo enciklopedi nuk është e njëjtë me versionin e saj të shtypur, i cili është një version për lakmi.

Prania e "edu" në adresë është thelbësore dhe tregon në të shumtën e rasteve enciklopeditë që ia vlen të shikohen në Internet. Mirëpo, nuk ka shumë të tilla. Shembuj të enciklopedive të mira në Internet që ia vlen të shikohen:

Stanford Encyclopedia of Philosophy (http://plato.stanford.edu). E mbajtur nën mbikëqyrjen e Qendrës për Studime të Gjuhës dhe Informatave të Universitetit të Stanfordit, ky sponsor thotë se "kjo enciklopedi është shumë e përshtatshme për përdorim si nga studentët ashtu edhe njerëzit profesionistë". Kjo enciklopedi nuk është për personat e thjeshtë. Ani pse ofrohet falas, është një lajmërim i të drejtave autoriale (copyrights) e cila thotë se autorët e shkrimeve e kanë të drejtën e tyre mbi këto materiale, sikurse edhe Universiteti i Stanford dhe asgjë nuk mund të ribotohet, pra artikujt mund të përdoren vetëm për "përdorim të ndershëm". Ndryshe nga enciklopeditë e tjera të përgjithshme "këtu autorët e shkrimeve janë të thirrur zakonisht me ftesa nga një anëtar i Bordit të Redaktorëve". Kjo enciklopedi Online dhe që ofrohet falas është një vepër mjaft gjithëpërfshirëse. Nuk jep vetëm informata për të kaluarën, mirëpo po ashtu shërben edhe për freskimin me informata enciklopeditë aktuale nga filozofia. Mekanizmi i kërkimit është i sofistikuar dhe ofron shumë qasje sikurse shënimin e termave, fjalëve, apo emrave. Është sajuar nga redaktorët për t'ju shërbyer dijetarëve dhe ekspertëve. Duhet thënë se i shërben mjaft mirë qëllimit të saj. Shënim: Kjo është një enciklopedi në progres dhe shumicën e rasteve ky progres

është i ngadalshëm. Për shembull, në vitin 1999 nga 600 shënime që ishin planifikuar, vetëm 70 nga to ishin të gatshme Online. Është i ngadalshëm, mirëpo i sigurt.

Persus Project (www.perseus.tufts.edu). Ky prototip (mostra, e jo e gjithë puna në tërësi) i kësaj enciklopedie shtjellon botën antike greke. Materialet romake janë të planifikuara të përfshihen në të. E mbështetur nga Tufts, Yale, Shoqata Nacionale e Shkencës dhe Universiteti i Harvardit, kjo enciklopedi ofrohen në versioni Online dhe në atë CD-ROM. Yale University Press e ka botuar CD-ROM versionin e plotë dhe kushton 350 dollarë. Përfundimisht, i gjithë ky format do të transferohet në Online.

Encyclopedia Smithsonian (www.edu/resources/faq/start). Pikë së pari, kjo është një seri e përgjigjeve në pyetjet që bëhen më së shpeshti. Është e aranzhuar nën titujt nga subjektet e gjera: forcat ushtarake, antropologjia, muzikë, shkencat fizike, shërbimet, tekstili, biseda, transporti, historia dhe zoologjia. Nuk lejohet kërkimi fjalë për fjalë dhe ju duhet patjetër të shkoni te titujt kryesorë dhe nën titujt për temat që janë mjaft të limituara. Disa fjalë për gjitarët nga Egjipti, një prej tre nëntitujve nën antropologji, është i shkurtër, mjaft mirë i shkruar dhe që i ofrohet studentëve mesatarë të shkollave të mesme dhe personave joprofesionistë. Shënimet më shumë të detajuara mund të gjenden në enciklopedi të tjera. Ani pse kjo është një enciklopedi mjaft e mirë dhe e përshtatshme për shfletim, është një zëvendësim mjaft i dobët i enciklopedisë së përgjithshme e specializuar në çfarëdo formati dhe metoda të kërkimit.

Kjo është e vërtetë edhe për subjekte të tjera nga muzika deri te zoologjia. Problemi është koha. Merr shumë më shumë kohë të fusësh një informatë në ueb sesa në një enciklopedi specifike në versionin e shtypur/ CD-ROM/ apo Online. Kur përdoret ashtu si duhet, web-sajti është e mirë për gjetjen e informatave të tjera jashtë atyre që gjenden në përmbledhjet standarde. [32]

Sugjerime për të lexuar

Auchter, Dorothy, "The Evolution of the Encyclopedia Britannica: From

[32] Gati çdo çështje në Web Guide Monthly ose Yahoo! Internet Life, sikurse edhe shpjegimet në Choice, Library Journal dhe Booklist do të tregojnë llojin e sajtit të enciklopedisë. Për shembull shiko: "Surfing History", Booklist, 1 shkurt, 2000, f. 1040; "Arts & Literature" Web Guide Monthly, korrik, 1998, f. 32 + informata të shumta për sajte. Po ashtu, provo edhe "Web Watch," Library Journal, 1 maj, 1998, f. 28 + për informata tjera mbi web-sajtin mbi artin.

Macropaedia to Britannica Online," Reference Services Review, numër 3, 1999, f. 291-299. Autori këtu ekzaminon provat testuese të Britannica-s kur ajo dështoi t'i marrë përparësitë e shërbimeve Online, e cila pati probleme të mëdha e më pastaj iu kthye Internetit. Rezultati përfundimtar ka qenë një rilindje e enciklopedive të mëdha në bibliotekat pothuajse në gjithë botën. Shumica e asaj çka është raportuar këtu është e aplikueshme te ndërrimi nga versioni i shtypur te Online apo vepra të tjera të referencave.

Dahlin, Robert, "You're As Good Ad Your World," Publishers Weekly, 15 nëntor, 1999. f. 33-7. Si mund ta bëni ju një enciklopedi të zgjojë kërshërinë e masave dhe prapëseprapë të ruajë kredibilitetin e saj? Autori i jep përgjigjet e botuesve, së paku në redaktimin e enciklopedive me një vëllim. Po ashtu, shumica e artikujve merret me atë se si fjalorët freskohen me informata nga një rishikim i tërësishëm i përmbajtjes dhe formatit.

Inglis, Kari, "A Comparison of the Online Encyclopedias," Ohio Media Spectrum, Dimër 2000, f. 42-3. Është një analizë e shkurtët dhe shumë e mirë e Britannica Online. Ky libër ofron ndihmë për t'i vlerësuar enciklopeditë e tilla.

Nauman, Matt, "Grove Dictionary," Against the Grain, Prill 1999, f. 56. Një përmbledhje e shkurtër e historisë dhe planeve të ardhshme të botuesve të enciklopedive më të mëdha të subjekteve.

Shneidman, Edwin, "Suicide on My Mind, Britannica on My Table," American Scholar, Vjeshtë, 1998, f. 93-104. Një profesor i shkencës mbi vdekjen (thanatology) përfshin materialet se si vetëvrasja është shtjelluar nga Britannica në mbi 220 vjet. Ai thotë se ka diçka që mund të mësohet nga studimet e Britannica edhe në fjalët e tjera të prekshme shkencore. Ai sugjeron "pse të mos shikohet një fjalë edhe në fjalorët e së kaluarës? Një drejtues imagjinativ dhe shumë i qartë se si veprat e referencave mund të përdoren për të ndjekur hapat e kulturës historike.

KAPITULLI VIII
BURIMET E GATSHME TË REFERENCAVE: KALENDARËT, VJETARËT, MANUALET DHE UDHËZUESIT

Bibliotekarët i quajnë këto pyetje të "referencave të gatshme". Këto janë pyetje me përgjigje nga fakti i thjeshtë. Përgjigjet gjenden shpejt dhe lehtë për vepra lehtë të identifikueshme të referencës dhe të "gatshme" - Online ose në shtyp.

Njerëzit bëjnë pyetje të referencave të gatshme për shumë arsye. Pyetjet mund të jenë të lehta: "Sa është popullsia e Nju-Jorkut?" (8 milionë). Ato mund të jenë relativisht të vështira: "Si ka shkuar periudha e jetës së Xhorxh Uashingtonit (67-vjeçar) krahasuar me jetën mesatare nga fundi i shekullit XVIII? (afro 35 vjet). Pyetjet mund të jenë pothuajse të pamundshme: "Sa i kushton vendit pirja e duhanit?". Përgjigja varet nga aq shumë variante saqë kjo kalon nga një pyetje e referencës së gatshme në pyetje hulumtimi). Pastaj, është po ashtu edhe pyetja e llojit të etiketës, që shpesh kufizohet me humoristikën dhe urtësinë: "Si mund njeriu t'ia bëjë me dije, në mënyrë të sjellshme, një predikuesi fetar që t'i largohet nga dera?". (T. H. White, një autor i njohur me një mjekër të gjatë e dha këtë përgjigje. U thoni "Shkëlqyeshëm. Unë jam Jehova. Si na venë punët?").

Kush, çka, kur, ku dhe pse, janë pyetje tipike të referencave të gatshme. Kush është njeriu im në Kongres? Çfarë është kostoja aktuale e jetesës?

Kur ka mbaruar Lufta e Dytë Botërore? Ku gjendet Sietëll? Pse macet ndjekin zogjtë? Bëni kujdes se mbase do të ketë nevojë për më shumë se një përgjigje e shkurtër e drejtpërdrejtë. Rrallë ndodhë që të keni nevojë të konsultoni më shumë se një burim.

Kjo është lloji më i madh i pyetjeve në bibliotekën publike dhe është shpesh e dëgjuar në bibliotekat shkollore dhe akademike. Nuk është për t'u habitur pse bibliotekarët me përvojë të referencës kërkojnë të kenë një sërë mjetesh për referencën e gatshme (si në shtyp ashtu dhe në formë digjitale), si blloqe të rëndësishme ndërtimi në një koleksion reference.

Pyetjet gjenden shpejt për shkak të organizimit dhe të të kuptuarit të mirë të grupit të veprave të referencës. Shumica prej tyre përdoren edhe sot, po aq shumë në formatin e shtypur sa edhe në atë elektronik. Dy titujt kryesorë të preferuar të referencës (nga të gjitha fushat dhe disiplinat) janë: *The Statistical Abstract of the United States* dhe *The World Almanac* – që të dyja vepra reference dhe janë në dispozicion në Online. Aty mund të gjendet çelësi i të gjitha referencave: *World Book Encyclopedia*.

Pse këto të tria? Sepse "ato mbulojnë atë që njerëzit duan ta dijnë", një bibliotekare e referencës është përgjigjur. Ajo po fliste në emër të të gjithëve kur u pyetën për veprat që përmenden më së shumti te referencat. Faktorë të tjerë që përcaktojnë përdorime të shumta janë: (a) mosha. "Shumica e titujve kanë qenë pjesë e koleksioneve të referencave të bibliotekës për shumë kohë; (b) Konsekuenca. Titujt që janë grumbulluar rreth kreut të listës kanë ardhur prej të gjithave llojeve të bibliotekave; (c) Shtypi. Megjithëse atje janë "një numër titujsh elektronikë në listë, përmendet vetëm një, *SIRS Researcher* me të njëjtën shpeshtësi sa dhe resurset e shtypura. "(Lista të tjera, të tjera supozime, lidhur me atë se cilat janë më të popullarizuara botohen rregullisht. Është inkurajuese që ka një pajtueshmëri se janë diku prej 30 deri në 50 tituj që janë absolutisht bazikë.[1]

Bibliotekat e arsyetojnë gjatë këtë situatë dhe gati në çdo bibliotekë ka

[1] "Field Tested Reference Titles", Booklist, prill 1998, f. 1532-1534. Kjo bazohet në një sondazh joformal, për një vit, të bibliotekistëve të referencës nga bibliotekat më të mëdha deri te ato më të vogla, që nga ato akademike, publike dhe shkollore. Shih, po ashtu, edhe Brian Coutts dhe John B. Richard, "50 Sources for the Millennium", Library Journal, 15 nëntor 1999, f. 8, një listim një-faqesh i "50 burimeve më të mira të referencës të mileniumit të kaluar, që janë ende në përdorim sot". Nr. 1: Webster's Third New International Dictionary, pasuar nga World Almanac, Times Atlas of the World, Statistical Abstract of the United States dhe Oxford English Dictionary. Të gjitha janë në dispozicion në format digjital dhe të shtypur. Ato diskutohen më në gjerësi në këtë tekst. Shih, Kapitullin I për vepra të tjera bazike të referencës.

koleksione të vogla me burime të shtypura, zakonisht afër tavolinës së referencave, në të cilën mund të jenë me etiketa për veprat e gatshme të referencës.

Në përgjigjet e pyetjeve faktike, trajtimi më efikas është që të krahasohen pyetjet me një burim të njohur. Kalendarët, për shembull, janë të shpejtë për të gjetur 10 qytetet më të mëdha në botë. Udhëzuesi do t'i japë adresat për kompaninë X ose Y. Një burim citimi do të jetë vendi për të gjetur kush çfarë ka thënë. Të gjitha këto parasupozojnë se bibliotekari është i njohur me familjen e referencave, në qoftë se jo me faqet specifike ose titujt.

Kur burimet standarde (shumë nga të cilat janë diskutuar më këtë kapitull) dështojnë, atëherë ka edhe disa ikje emergjente: (1) ftojeni një bibliotekë afër jush, veçanërisht aty ku keni ndonjë mik; (2) ia shtroni pyetjet ndonjë eksperti apo drejtpërdrejt në Internet; (3) udhëzime të panumërta do t'u ndihmojnë të gjeni emrat e ekspertëve, organizatave dhe vendet e sigurta, ku pyetjet e referencave të gatshme mund të vihen, për shembull, *The Encyclopedia of Assocations*, për të përmendur vetëm një.

Çdo pyetje është e rëndësishme, madje edhe ajo triviale, p.sh.: "Ku është babadimri?", dhe "Si mund të fitoj në garën me kuaj? (në market, në dashuri, etj.)[2] Të tjera pyetje tipike triviale përfshijnë: (1) Kush ka qenë lideri i shtetit që është intervistuar në pizhame në vitin 1959 në Edward R. Murrow TV Show? (Përgjigjja: Fidel Kastro); (2) Cili ka qenë amerikani i parë që e ka luajtur golf më hënë? (Përgjigja: Alan Shepard); (3) Cila fjalë e anglishtes përmban që të pesë zanoret e alfabetit? (Përgjigja: fjala facetious).[3]

Bibliotekarit i këshillohet të marrë seriozisht secilën pyetje - vetëm në qoftë se rezidon në Bibliotekën e Vatikanit, ku gida e shtypur e bibliotekës mban një paralajmërim që çdo lexues që bën më shumë se tri pyetje "të pakuptim" do të përjashtohet. (Pos se askush nuk shpjegon se çka është pyetje e *pakuptim).*

Në të njëjtën kohë, një pyetje triviale e një personi është një fillim i shkallës për të folur, ose për bisedë shoqërore. Dikush do të dijë kuptimin

[2] "Këto lloje të pyetjeve janë zgjedhur nga qindra faqe të web-it bashkë me përgjigjemjaft pergjigje të cilësuara. Shumë sajte ofrojnë përgjigje të mjaftueshme për ta bërë dikë të habitur rreth autoritetit të rrjetit

[3] "Sfida e gjërave të parëndësishme. Shpejt në bibliotekë", The Christian Science Monitor, 4 mars 1997, f. 17. Ky është një raport i shkollës së mesme i një nxënësje të Kalifornisë mbi problemet e zgjedhura të kontesteve prej të cilave ishin marrë pyetjet dhe përgjigjet.

e “Albany Doctor” (puhia e detit në Australinë Perëndimore), ose për të mbushur fjalëkryqin me pyetje ose për të zgjidhur problemet urgjente për motin në Australi. Dikush tjetër do të ketë nevojë për informacione për popullsinë për Borneon Qendrore (955 000) për ta përcaktuar mençurinë e hapjes së biznesit atje, ose një student i shkollës së mesme mund të përdorë të njëjtin njoftim për të bërë një argument për Qeverinë e Indonezisë.

Pyetjet e referencave të gatshme mund të zhvillohen në pyetje të involvuara kur (1) nuk mund të përcaktohen me urgjencë burimet e përgjigjes dhe duhet qe të shpenzohet shumë kohë për arritjen e përgjigjeve, ose (2) pyetja bëhet temë e kërkimit ose rikërkimit, sepse personi që pyet është me të vërtetë në nevojë më shumë për njoftime sesa në kuptimin e pyetjeve. Dikush që ka nevojë për një adresë të një korporate mund të mos i nevojitet vetëm adresa, por edhe informatat se si të aplikojë për një pozicion në atë firmë, për të paraqitur një ankesë, për të gjetur të dhëna për të përgatitur një dokument, ose për të bërë investime. Pyetjet e referencave të gatshme mund të jenë vetëm një hapje rasti për personin, që e përdorë atë për të filluar dialogun intervistues.

Është ky zhvillim i vonshëm - mundësia që një pyetje e referencave të gatshme mund të bëhet më shumë komplekse – që mbron pikëpamjen se bibliotekarët profesionalë duhet të jenë ne detyrë pranë tavolinës së referencës. Ndonëse është e vërtetë që dikush me trajnim minimal është i aftë që të gjejë në web-sajte librin për t’iu përgjigjur pyetjes për titujt apo adresat, është e nevojshme që ta gjesh një ekspert për t’i ditur kur pyetja është vërtetë një hapje e një sërë pyetjesh të tjera komplekse mbi një temë të njëjtë apo të përafërt.

Të shtypura apo digjitale?

Kur është më së miri për t’i përdorur shifrat ose burimet e referencave të gatshme të shtypit?

Përgjigja: përdoreni burimin aty ku përgjigja mund të gjendet shpejt. Po ashtu, iu ktheni vendeve ku informacioni është i saktë dhe aktual.

Përtej shpejtësisë, saktësisë, aktualitetit dhe vlefshmërisë, ka dhe disa mundësi që përcaktojnë mediumin më të mirë. Online mund të jetë më modern. Një vëllim i shtypur nuk mund të ketë një të afërt digjital. Hulumtimi në Online mund të jetë, gjithashtu konsumim kohe. Rrjeti

mund të ofrojë 'sajte' të shumta, asnjë prej të cilave nuk mund të jetë e varur nga tjetra, e kështu me radhë.

Sidoqoftë, në balancim, shumica e bibliotekarëve të referencave u kthehen formave të shtypura për të gjetur shpejt përgjigjet në pyetje faktike. Askund nuk shihet avantazhi i referencave të shtypura më qartë se te titujt e referencave të gatshme. Shumica e veprave faktike të shtypura janë të lehta për t'i përdorur. Të dhënat e duhura mund të gjenden brenda sekondash. Anasjelltas, gjetja e informacioneve në Internet "mund të jetë një ankth", shpjegon Barbara Berliner, koordinatore e NYPL-EXPRESS, shërbim i pavarur kërkimor e Bibliotekës Publike të Nju-Jorkut. "Me një almanak të shtypur, kjo është më e shpejtë, më e lehtë dhe më e saktë".[4]

Web-sajtet e bibliotekave dhe referencat e gatshme

Pa përjashtim, faqet e Internetit të bibliotekave të mëdha akademike dhe publike kanë pjesë të veçanta dedikuar referencave në përgjithësi dhe posaçërisht referencave të gatshme. Për shembull, Universiteti Shtetëror i Nju-Jorkut në Albany ka ''bibliotekë virtuale" (www.albany.edu/library), që ka një nënndarje. Ndarja kryesore është "koleksioni i referencave", në të cilën ofrohen linka në "tavolinat e referencave", d.m.th., referencat e gatshme, të cilat ofrojnë linke në sete të thjeshta prej "akronimeve dhe shkurtimeve" dhe "kuotimeve Bartletts" të kodit postar. Mbi një duzinë a më shumë linke janë kryesisht udhëzuese. Në një shkallë më të gjerë Albany, si te biblioteka të tjera, kalon pastaj te "hulumtimi i subjektit" dhe ofron linke në 'sajte' të thjeshta prej arteve dhe popullsisë e deri te ndihma sociale. Në qoftë se web-sajtet lokale janë me përdorim të kufizuar, të tjera biblioteka këshillojnë zgjidhje të problemeve të vështira. Ato mund t'i regjistrojnë referencat e veprave që nuk janë konsideruar nga biblioteka. Edhe më asistues janë qendrat e mëdha të referencave në Internet, të cilat jo vetëm që ofrojnë burimin, por aty ku është e mundur, sjellin linke ndaj teksteve aktuale. Në mesin e referencave më të mira të gatshme:

1. *Michigan Electronic Library. The Reference Desk.* (www.mel.lib.mi.us).

Ky fitues i përgjithshëm në shërbimin e referencave ofron një meny alfabetike specifike dhe kryesore të vendeve të referencave të gatshme.

[4] "The old fashioned almanac thrives in the age of the Internet," The New York Times, 22 dhjetor, 1997, f. D10.

'Sajtet' kryesore me linke të drejtpërdrejtë të burimeve janë të përmbledhura aty. Ato numërojnë afro 30. Në mesin e referencave të gatshme kryesore janë: almanakët, asociacionet, citimet legale, profesionale, mjekësore, bursat, popullsia, statistikat dhe veçoritë demografike, stilistika, telefonat, moti, peshat dhe masat. Nën secilën ka linke prej pesë deri në njëzet a më shumë burime të rrjetit, që zakonisht ofrojnë metoda më të lehta të kërkimit për t'i gjetur përgjigjet.

Po ashtu, ka mbi 100 burime të tjera të vogla dhe të mëdha që nga librat për radion e deri te video-termat dhe definicionet. Një vështrim i shpejtë në ekran i rikujton shpesh përdoruesit vendin e mundshëm për t'i gjetur shpejt përgjigjet e fakteve të kërkuara.

Qendrat e tjera të referencave ofrojnë shërbime të ngjashme, por pak prej tyre janë shumë të qëndrueshme kundruall nevojave mesatare të personit ose bibliotekarit.

2.*The Internel Public Library. Ready-reference Collection*. (www.ipl.org).

Kjo bibliotekë ka një faqe, të bërë enkas për asgjë tjetër pos për pyetje të referencave, shumë prej të cilave mund të kualifikohen si pyetje faktesh. Madje, ka edhe pajisje për t'iu përgjigjur referencave individuale të pyetjeve përmes e-mailit. Në përshkrimin e koleksioneve të referencave të gatshme, ky 'sajt' shpjegon këtë "se nuk është menduar që të jetë listë gjithëpërfshirëse e të gjitha web-sajteve në çdo subjekt, por më mirë një koleksion i shënimeve të zgjedhura për të ndihmuar në përgjigjet në pyetje specifike shpejt dhe më efektivisht". Burimet zgjidhen sipas lehtësisë së përdorimit, cilësisë dhe sasisë së informacionit, shpeshtësisë së përditësimit dhe autoritetit.

Hulumtimet mund të bëhen sipas grupeve mediale apo titujve individualë.

Ndonëse kjo ka edhe tituj të njëjtë, të gjetura në *Michigan Electronic Library*, kjo nuk është edhe aq e detajizuar. Ndarjet me tituj specifikë të kërkuara, përfshijnë: almanakët, të dhënat e regjistrimeve, lajmet dhe telefonat. Fuqia reale nuk është edhe shumë në burimet faktike sa në renditjen e veprave të referencave në fusha të mëdha nga arti e popullsia e deri te shkenca. Bibliotekari i referencave me përvojë gjendet gjithandej. Kjo është edhe një mënyrë tjetër për ta riaftësuar elementin njerëzor në konstruktimin dhe kontrollimin e ndihmësve të mëdhenj, siç është ky.

Ka edhe dhjetëra 'sajte' komerciale të referencave të gatshme në ueb, por një nga më kryesoret dhe nganjëherë më me vlerë është: *Reference: Best Sources for Facts on the Net* (http://refdesk.com). Kjo është një përzierje

me informata aktuale prej motit dhe kryeartikujve e deri te tregu i stoqeve. Ajo mbështetet nga almanaku standard dhe të dhënat enciklopedike, që të dyja sipas titullit. *(Encyclopaedia Brittanica, Merck Manual, American Heritage Dictionary*, etj.), si dhe sipas temës (shkallët e kamatës, gjetja e kolegjeve, përgatitja e taksave etj.). Ka edhe linke për mekanizma standardë të kërkimit. Megjithëse, kjo është e miratueshme për të rinjtë ose njerëzit jo profesionalë, mostrat standarde të kërkimit janë tepër të gjera për një kërkim standard të referencës së gatshme.

VLERËSIMI

Rregullat kryesore për ta vlerësuar një vepër të referencës, prej audiencës e deri te çmimi, janë të aplikueshme për tituj të referencave të gatshme. Disa vepra kanë pika specifike të vlerësimit dhe këto do të jenë të konsiderueshme gjatë elaborimit të këtij kapitulli.

1. *Aranzhimi.* A është lehtë për t'u konsultuar vepra e shtypur për fakte të shpejta? Indeksi është absolutisht i domosdoshëm. Përjashtimi i vetëm është nëse përdoret rendi i fjalorit me njësi të shkurtra, si në fjalorin kritik *Brewer's Dictionary of Phrase & Fable* (Londër: Cassell, 1870 e tej). Kjo vepër ka kaluar nëpër shumë edicione dhe është njësi thelbësore për t'i plotësuar faktet e panjohura, sidomos të natyrës letrare.

Në formë digjitale, aranzhimi ka një zëvendësim natyral në qasshmërinë e mjeteve të navigimit, që shërbejnë si indeks.

2. *Informacioni aktual.* Ky problem tejkalohet nga almanakët, vjetarët dhe titujt që plotësohen njëherë në vit. Të tjerët kanë shtojca gjashtëmujore ose më shpesh.

Aty ku të dhënat duhet të jenë nga minuti në minutë dhe në hap me kohën, nuk ka asgjë për t'u krahasuar me bazat e të dhënave Online.

3. *Ilustrimet.* Përderisa shumica e pyetjeve të referencave të gatshme janë verbale dhe mund të përgjigjen në mënyrë të njëjtë, vjen një kohë kur një ilustrim vlen më shumë se njëmijë fjalë. Prandaj, aty ku është e përshtatshme, duhet testuar veprën e referencave të gatshme për ilustrime adekuate.

4. *Autoriteti*. Shumica e veprave standarde të referencave dhe veçanër-

isht ato që janë gjetur në biblioteka, vit pas viti, janë vërtetuar të jenë autoritative. Fakti është fakt në shtyp ose Online. Kjo është bërë qëndrim i vetëdijshëm si për botuesin ashtu dhe për hartuesin, ashtu si dhe për editimin e shpeshtë të fakteve. Nga ana tjetër, edhe për botuesit më të respektuar, edhe vepra më e njohur mund të ketë të meta. Për shembull, edicioni i dytë i *Cambridge Biographical Encyclopedia* (Cambridge University Press, 1998) vë në pah se novelistja amerikane, Sara Jewett ishte presidentja e parë e Vassar College. Ashtu? Datat janë prej vitit 1862 deri më 1865, kur autorja ishte 13 apo 15-vjeçare. Një shikim në *The World Almanac* tregon se ky kolesh ishte formuar në vitin 1861 dhe jo më 1862. Një kontrollim i *Britannica*-s tregon se Ms. Jewett ishte në shtëpi në moshën 12 apo 13-vjeçare, ku po edukohej nga babai i saj.

Secila arrin qëllimin kur ‘’fakti”është me rëndësi të madhe, të themi për një biograf të Sarës, apo për një student që është duke përgatitur një fjalim të shkurtër, duhet kontrolluar dy herë.

Në një masë të caktuar, ne të gjithë besojmë në atë që veprat e referencave e quajnë fakt, por këto duhen të testohen rregullisht. A është fakt a opinion? A nuk është ky fakt më i vërtetë, do të thotë, a është tejkaluar ai me gjetje të reja? Për shembull, çfarë të bëhet me librin, që pohon kategorikisht se “bebet duhet mbajtur sa më pak që është e mundur”. Një nocion (fakt) ky i zakonshëm në shekullin XIX, ky besim është anuluar nga eksperimentët dhe praktikat në shekullin XX.

Një mënyrë e paçmueshme për ta kontrolluar shpejt faktin është të shohim burimin origjinal .*World Almanac*, si shumica e veprave të referencave të gatshme tregon qartë se ku është gjetur informacioni.

Në qoftë se një vepër e referencës nuk e tregon burimin e fakteve, atëherë duhet të jemi dyfish të kujdesshëm. Kjo është sidomos e vërtetë kur gjurmojmë përmes Internetit. Siç është dëshmuar më parë, gjahu i madh në Internet është në atë se kush çka thotë. Në qoftë se fakti vjen prej burimeve të sigurta (d.m.th., është e njohur nga bibliotekari si e vërtetë), nuk ka problem. Anasjelltas, në rrjet disa nga anët e njohura të titujve që janë diskutuar këtu japin informata të mjaftueshme për burimet për të miratuar gjithçka pos skepticizmit.

LIBRAT E FAKTEVE TË PËRGJITHSHME

Titujt e diskutuar konsiderohen “bazikë” nga bibliotekarët e referencave, megjithëse çdo bibliotekë, bibliotekar, apo situatë mund të kenë lista

të ndryshme.

Më mijëra libra të fakteve botohen nëpër botë çdo vit. Sapo njëra prej tyre del prej shtypit dy ose më shumë vërsulen. Të gjitha këto, apo të paktën ato që botohen nga një firmë e sigurt, mund të përdoren në bibliotekë. Si dhe me libra të citateve, ato mund të jenë tepër të shumta. Ka gjithmonë një rast të dyshimtë dhe fakt të pazakontë, që mund të dalë jashtë strehimit të këtyre titujve të njohur.

Megjithëse ka shumë burime të specializuara të referencave të gatshme, bibliotekari nuk duhet t'i harrojë vendet kryesore për t'i kërkuar përgjigjet. Enciklopeditë, veçanërisht janë të mira për izolimin e fakteve të referencave të gatshme. Njeriut menjëherë do t'i shkojë mendja te *Micropaedia* e *Britannica*-s apo te faktet e shkurta në *World Book*. Në mënyrën tjetër, këto mund t'i lexoni më shpejt në Online. Shumë shpesh, bibliotekari mund të jetë shumë i gatshëm t'i ballafaqojë përgjigjet specifike të pyetjet specifike që një enciklopedi e mirëfilltë i ka anashkaluar. Pastaj, gjithashtu, nuk ka vend më të mirë për t'u kthyer sesa te indekset e shumta të gazetave dhe sidomos *The New York Times Index* apo *Newspaper Abstracts*. Vetëm *Abstraktet* mund t'i prodhojnë përgjigjet e nevojshme. *Facts on File* është një tjetër burim i shkëlqyer.

Faktet bashkërisht

CD: *Microsoft Bookshelf*. (Shënim: në vitin 2001, paralajmëruar nga *Encarta Reference Suite*) Renton, WA: Microsoft, 1994 e tej, njëvjeçare, www.encarta. msn.com/products/info/refsuite.asp. $54.95.

Një qasje në akceset e shpejta dhe të lira për vepra të referencave të gatshme, është të paketohen shumë prej tyre në një CD-ROM të vetëm. Kjo ka përparësi në bibliotekën ndaj asaj Online ngaqë pagesa bëhet vetëm për diskun, por jo edhe për përdorimin e vazhdueshëm nga dhjetëra persona shumë të kushtueshëm në shërbimin Online.

Microsoft Bookshelf është një CD vjetore me dhjetë vepra të referencës, prej të cilave gati gjysma janë referenca të gatshme titujsh dhe të tjerat janë të përdorura shpesh për t'iu përgjigjur këtyre llojeve të pyetjeve. Referencat e titujve në disk: *The Encarta Dictionary; The American Dictionary of the English Language; The Microsoft Bookshelf Internet Directory; The People's Chronology; The Columbia Dictionary of Quotations; The World Almanac and Book of Facts; The Original Roget's Thesaurus of*

English Words and Phrases; The Emcarta Desk World Atlas; The Encarta Desk Encyclopedia; The National Five-Digit Zip Code and Postal Office Directory; The Microsoft Bookshelf Computer and Internet Dictionary. (Shënim: Titujt specifikë ndërrohen nga viti në vit, por llojet e materialeve të mbuluara, prej fjalorëve e deri te librat e fakteve, që qëndrojnë pothuajse të njëjta.). Më 2001, kjo ka qenë një shtesë nga *Encarta Reference Suite* me më pak burime, i.e., *Encarta Encyclopedia*; Interactive World Atlas; World English Dictionary; Africana; Ttimeliness. Po ashtu, arkivat me artikuj prej vitit 1938 deri më 2000. Çdo plotësim paraqet metoda të reja kërkimi. Një rënie e vetme tasti mund të sjellë çdo vepër individuale te referencave dhe ka dhe rënie të tjera që nga krijimi i fusnotave automatike e deri te linket në më shumë se 40 000 web-sajte. Siç thekson dekani i CD-ROM kritike, Cheryl LAGuardia: "Kjo mbase është mjeti më i dobishëm i referencës së gatshme në desktop, që është në dispozicion sot për para. Nëse nuk keni CD-ROM tjetër, ju duhet të jeni pronar i kësaj".[5]

Botues të tjerë sot ofrojnë pako të ngjashme, p.sh., *Gale Ready Reference Handbooks* (Farmington Hills, MI: Gale Group, 1999, 4 vols. $500). Në formë shtypi dhe digjitale nga kjo janë: *Fast Answers to Common Questions; Fast Help for the Medical Conditions; First Stop for Jobs Industries; Where to Go and Who to Ask*. Faktikisht, një pjesë e madhe e materialit gjendet në botime të tjera të Gale, por ai është grumbulluar këtu në mënyrë të përshtatshme.

Fakti i rrallë

CD: Guiness Multimedia Disk of Records. New York: Facts on File, 1993 e tej, vjetore. $99. (Plotësim vjetor, $49).

Shtypi: The Guiness Book of Records, New York: Sterling, 1995 e tej, vjetore. $26.00

Online: *Kane, Joseph*, Famous First Facts, *5th ed., New York: H. W. Wilson Co.,1999 dhe më, www.hwilson.com.price ndryshon.*

CD: WilsonDisk, 1999 e tej. $150.

Shtypi: 1998,1,122 f. $95.

5 Library Journal, 15 tetor, 1997, f. 103.

"Problemi me shumicën e librave të referencës është se ato sikur asnjëherë nuk u japin informatat që dëshironi t'i gjeni. Doja të dija, për shembull, se sa rosa janë në botë... mundohuni ta gjeni këtë në ndonjë enciklopedi. Kot; nuk do ta gjeni".[6]

Shumë nga gjerat që konsiderohen më pak të rëndësishme nga editorët e enciklopedisë gjenden në atë që mund të quhet "vepra të referencave të rralla". Në krye të listës është *The Guiness Book of Records*, i cili nuk ka nevojë për prezantim – ai është në mesin e 10 librave më të shitur të të gjitha kohërave dhe e njohur pothuajse për të gjithë lexuesit. I ndarë në pjesë të gjera, ai përfshin çdo gjë prej rezultateve të fundit të ndeshjeve të futbollit dhe bejsbollit e deri te ato të ragbit dhe tenisit. Ka ilustrime, disa prej të cilave me ngjyra. Gjithashtu, ai përfshin shumë gjëra triviale prej dasmës më të shpejtë e deri te rekordi i shpejtësisë në shtyrjen e karrocave të bebeve. Për shembull, Bozo Miller i hëngri 27 pula njëkilëshe në një seancë; Alan Peterson mban rekordin në ngrënien e 20 hamburgerëve për 30 minuta. Ky është vendi për të gjetur informacione pothuajse për çdo fitues, kurse kërkimi bëhet përmes një indeksi të shkëlqyer.

Titulli plotësohet çdo vit dhe edicionet e kaluara janë të dobishme nganjëherë për fakte të shmangura. Një pjesë e mirë e çdo edicioni të *Guiness* konsiston në rekordet e shënuara nga notuesit, alpinistët, pilotët, vrapuesit dhe të tjerët të vendosur për të shënuar rekorde të qëndrueshmërisë së pafund dhe aventurizmit. Përderisa nuk ka kufij fizikë në këtë anë të gjithësisë, aventurizmi sot do të thotë t'i bësh gjërat e vjetra në një mënyrë të re.

CD-ROM shton të dhëna nga disa vepra të Ginisit. Qasja e hipertekstit bëhet si për fakte ashtu edhe për kënaqësi. Aty ka, pos afro 4 000 rekordeve, edhe përafërsisht 600 fotografi, video klipe të thyerësve të rekordeve në aksion, si dhe shumë tinguj të murmurimave, kërcitjeve dhe duartrokitjeve.

Shënim: Siç është në modë këtyre ditëve, titujt e veprave të gatshme të referencave ndryshojnë paksa nga viti në vit. Për shembull, Guiness, zgjodhi mileniumin për ta quajtur botimin e vet të vitit 2000: *Guinness World Records 2000, millenium edition*.

Famous First Facts (Faktet e para të famshme), të quajtura thjesht

[6] "Odd Books of the Week", The Independent (i Londrës), 1 nëntor, 1997, f. 12. Faktikisht, përgjigja mund të jetë në ndonjë enciklopedi, por jo ajo që përdoret nga autori i artikullit. Çështja është se "librat e referencës së rrallë" janë një ndihmë e madhe në një vepër reference edhe për pyetje po aq të rralla.

"Kane", sipas hartuesit, merret kryesisht me "të parët" amerikanë në çdo gjë, prej brushës së parë të dhëmbëve deri te zbulimi i parë i madh. Është botuar që nga viti 1933 dhe sipas botuesit, ka pasur më shumë se 150 000 kopje në shtyp. Kjo referencë u ka shërbyer brezave të tërë të studiuesve". Është përgatitur kronologjikisht, në mënyrë të tillë që të mund të gjeni një fushë tematike dhe që qoftë me shfletim qoftë me kërkim të gjeni faktin e parë esencial. Për shembull, nën titullin "Biblioteka" do të gjendet katalogun *e parë* të bibliotekës (Biblioteka e Kongresit); katedra e parë e bibliotekës në një shkollë bibliotekarie (Universiteti i Kolumbias); revista e parë bibliotekare *(Library Journal)*; ndërtesa e parë e bibliotekës (Filadelfi); e të tjera. Me edicionin e pestë u iniciua një indeks i ri tematik. Ju mund të kërkoni një ngjarje sipas vitit, muajit dhe ditës së ngjarjes, emrave të personave të përfshirë dhe shteteve dhe komunave ku ngjarja ka ndodhur. Versionet elektronike kanë lehtësinë e rëndomtë të shtimit të pikave të reja të hyrjes në fakte, p.sh., versioni elektronik lejon përdoruesin të gjejë lojën e parë të bejsbollit gjatë natës, duke përdorur kërkimi Boolean. Ndonëse pak më shumë nga versioni i shtypur, CD-ROM është më i preferueshëm, ashtu si dhe edicioni në Online.

Kjo vepër është dëshmuar aq e suksesshme saqë prej tij kanë dalë dhjetëra botime, që nga *Facts About American Wars* dhe *Facts About the Presidents* deri tek *Facts About China* dhe *Facts About the World Languages*.

Në edicionin e pestë (1999), Steven Anazon dhe Janet Podell plotësuan dhe edituan Kane-in. Këta do të vazhdojnë për ta bërë këtë me edicionet e ardhshme. Po ashtu, ata janë editorë të një vepre të përafërt: *Famous First Facts International Edition* (New York: H. W. Wilson Co., 2000). Kjo ndjek pothuajse të njëjtën mostër si dhe Kane, por zgjeron mbulueshmërinë edhe përtej Shteteve të Bashkuara.

Librat e referencave të fakteve janë bërë një çerdhe e industrisë së botimit. Në çfarëdo kohe, ka me dhjetëra në shtyp. Biblioteka i ka të gjitha, ose të paktën, të gjitha ato, të cilat konsiderohen autoritative.

Në mesin e titujve relativisht të ri mund të gjenden edhe vepra "të rralla", si:

The Book of Mosts (New York: St.Martin's, 1997). Përgjigjet në atë që janë pyetje më të larta, më të ulëta dhe të tjera, që kanë të bëjnë me fakte dhe shifra, janë të organizuara në të nën 22 kryetituj të gjerë tematikë, që nga "automobilat" deri te "filmat". Secili fakt është i dokumentuar, (megjithëse nganjëherë tepër shkurt), kurse listat e shumta dhe tabelat

janë të lehta për t'i ndjekur. E meta kryesore: nuk ka indeks.

The World in One Day (Londër: Dorling Kindersley,1998). Kjo është një përmbledhje madhështore mbi "24 orë mesatare të jetës në tokë". Çka ndodhë, për shembull, çdo ditë? Përgjigja: 26 000 qifte kineze martohen, 101 000 makina të larjes prodhohen dhe dy persona vdesin nga gjarpërinjtë në Shri-Lankë.

ALMANAKËT DHE VJETARËT

Ndonëse almanakët dhe vjetarët janë lloje apo forma të ndryshme të veprës së referencës, ato janë mjaft të përafërt mjaft të përdorshme sa për t'u trajtuar këtu si një klasë e vetme e ndihmësve të referencës së gatshme.

Almanaku. Almanaku është një përmbledhje e të dhënave dhe statistikave të volitshme për vende, personalitete, ngjarje, subjekte dhe të ngjashme. Është një lloj enciklopedie e njësive specifike të liruar nga ndajshtimet dhe ndajfoljet dhe që është i kufizuar në skelet të informacionit.

Yearbook/Vjetari. Vjetari është një përmbledhje vjetore e të dhënave dhe statistikës. Qëllimi themelor i vjetarit është të regjistrojë aktivitetet e vitit sipas vendeve, temave, apo fushave të specializuara. Në veprën e referencave të gatshme, lloji që është përdorur më së shumti është zakonisht e kufizuar në fushat e interesit të veçantë.

Compendium/Përmbledhja. Përmbledhja është një rezymim i shkurtër i një vepre më të madhe apo fushe të diturisë. Për shembull, *Statistical Abstract of the United States* është një përmbledhje në kuptim të rezymimit të të dhënave masive në dosjet e Zyrës së Regjistrimit të SHBA-ve.

Qëllimi

Këto lloje të veprave shërbejnë për disa qëllime të përcaktuara në bibliotekën mesatare. Kjo vlen si për atë në shtyp, ashtu dhe për formën digjitale. Çka e ndjek gjerësisht është e vërtet për të gjitha format. Në mes më të rëndësishme:

Aktualiteti. Pa marrë parasysh formën dhe prezantimin, përdoruesi i kthehet një vjetari ose një almanaku për informacion relativisht të ri mbi një temë a personalitet. Qëllimi i shumë prej këtyre veprave është që t'i plotësojnë tekstet standarde që mund të botohen apo që rrallë revidohen në tërësi. Një vjetar enciklopedik, për shembull, është një kompromis – madje dhe shfajësim - që nuk i ka rishkruar, në secilin vit, të gjithë artikujt në enciklopedi.

Ndonëse shumica e almanakëve dhe vjetarëve janë të datuara 2000, 2001 e kështu me radhë, mbulimi vërtet është për vitin e mëparshëm. Almanaku apo vjetari i vitit 2000 mbase ka një ndërprerje të fundit të vitit 1999. Koha e përpunimit duhet të kuptohet. Në qoftë se në mes apo në fund të vitit 2000, kërkojmë për të dhënat e vitit 2000, atë thjesht nuk do ta gjejmë. Ekuivalenti digjital mund të mburret se përditësohet rregullisht dhe për këtë arsye ai preferohet të shtypet. Çështja kryesore, ndërkaq, është nëse versioni Online është më aktual? Përgjigja: kjo varet nga botuesi.

Faktet e shkurtra. Aty ku kërkohet një figurë a fakt i vetëm, normalisht pa beneficionin e shpjegimit, almanaku është i dobishëm. Vjetari do të jetë më i dobishëm në qoftë se lexuesi dëshiron një masë të kufizuar të sfondit informatik mbi një zhvillim të fundit apo kërkon një fakt që nuk gjendet në një almanak standard.

Trendet. Për shkak të aktualitetit të tyre, almanakët dhe vjetarët, qoftë drejtpërdrejt, qoftë tërthorazi, shfaqin trende në zhvillim, apo, thënë ndryshe, regresionin e civilizimit. Përparimet shkencore kronikohen, si dhe ngjarjet, personat dhe vendet e rëndësishme gjatë vitit paraprak. Një arsye për ta mbajtur një linjë të caktuar të almanakëve dhe vjetarëve është për të treguar trendet e tilla. Në *World Almanac* të vitit 1908, kishte 22 faqe dedikuar hekurudhave. Botimi i vitit 2000 përmban gati një faqe, ndërkohë që aktorët televizivë kanë afro16 faqe. Interneti, kompjuterët dhe artikuj të përafërt janë tani njësi. Bartja e qartë e interesimit të amerikanëve gjatë 50 vjetëve të kaluara pasqyrohet në koleksionet e vjetarëve dhe almanakëve.

Indeksi joformal. Shumica e vjetarëve dhe almanakëve të besueshëm citojnë burime të informatave dhe kështu mund të përdoren si indekse joformale. Klientët e rregullt që interesohen më shumë për shitje me

pakicë do të gjejnë informatat kryesore në çdo almanak apo vjetar të mirë. Këto publikime, nga ana e tyre, do të citojnë burime, si *Fortune, Bussiness Week*, ose *Moody's Industrials*, të cilat do të sjellin informacion shtesë. Citatet specifike të burimeve qeveritare të statistikës së shpejti do të mund ta udhëheqin lexuesin në materiale parësore që ndryshe është vështirë të gjenden.

Udhëzuesi dhe informacioni biografik. Shumë vjetarë dhe almanakë përfshijnë materiale të gjetura gjithashtu në udhëzues. Për shembull, vjetari ne një fushë speciale mund të përfshijë emrat e udhëheqësve kryesorë në atë fushë, bashkë më adresat e tyre dhe ndoshta edhe skeçe të shkurtra të biografisë së tyre. *The World Almanac*, mes të tjerash, regjistron shoqatat dhe shoqëritë, me adresa.

Browsing/Shfletimi. Të hedhura në qoshet e braktisura të pothuajse çdo vjetari ose almanaku janë masat e copëzave të pacaktuara, shpesh magjepsëse të informatave. Një dashnor i vërtetë i fakteve – dhe Shtetet e Bashkuara janë një vend përplot këso dashnorësh – do të kënaqet duke u kredhur në shumë vepra të këtilla. Nga pikëpamja e bibliotekarëve të pasionuar të referencës, ky qëllim mund të shihet si i paqëndrueshëm, por ai është magjepsës për vëzhguesit e sjelljes njerëzore.

Almanakët

Online: World Almanac and Book of Facts. Manwah, NJ: Primedia: 1997 deri më sot, www.facts.com/k3ref. htm. Çmimi ndryshon. I gatshëm në OCLC dhe nga shumë shitës.
CD: in Microsoft Bookshelf (shih faqe. 238).
Shtypi: 1868 deri më sot. $29.95; kopertinë të butë, $10.95.

Online: Information Please Almanac. Boston: Houghton Miffin Company,
1997 deri më sot, www.infoplease.com.free.
Shtypi 1947 deri me sot. $21.95; letra, $9.95.

Shtypi: Whitaker's Almanac. London: J. Whitaker & Sons, Ltd., 1869 deri më sot. $92. (e distribuuar në Shtetet e Bashkuara nga Gale Reaserch, Inc.).

Titujt e regjistruar këtu janë thjesht almanakë të përgjithshëm të gjetur në shumicën e bibliotekave të Amerikës. Për përdorim dhe rëndësi, ato renditen si në vijim: *(1) World Almanac; (2) Information Please Almanac* dhe *(3) Whitaker's Almanac*. Radha e preferencës është bazuar në familjarizimin me to. Shitja e *World Almanac* (mbi 2 milionë kopje) tash i tejkalon shitjet e kombinuara të dy rivalëve të tij kryesorë.

Me përjashtim të *Whitaker's*, të gjitha janë kryesisht të interesuara për të dhënat me interes për lexuesit amerikanë. Në shkallë të ndryshme, ato mbulojnë të njëjtat çështje të subjektit themelor dhe, megjithëse ka shumë duplifikime, kostoja e tyre e ulët bënë të mundur për t'i pasur dy ose tri në tryezën e referencave. Më e mira është ajo që i përgjigjet pyetjeve specifike në atë moment. Sot, mund të jetë *World Almanac*, nesër *Whitaker's.* Mirëpo, në kuptim të kërkimit, rëndom preferohet të fillohet me *World Almanac* dhe të punohet përmes rendit të preferencës të dhënë më sipër.

Të gjithë almanakët kanë disa pika të përbashkëta: (1) ata kanë shitje të majmë dhe gjenden në shumë familje; (2) ata varen dukshëm në burime qeveritare për statistika. Lexuesit shpesh e gjejnë të njëjtat burime (kur jepen), të cituara në të gjithë almanakët; (3) përveç përditësimit dhe revidimit, materiali i njëjtë themelor bartet nga viti në vit.

Botuesit i dëshirojnë almanakët dhe vjetarët, sepse ato mund t'i sjellin librat e reja secilin vit relativisht me një çmim relativisht të ulët dhe një tepricë përfitimi. Megjithëse, secilin vit materiali i ri përditësohet dhe plotësohet, esencialisht almanaku riciklohet nga viti në vit, pa ndryshuar. Gjithashtu, ato nuk kanë nevojë të paguajnë tarifa për autorët.

World Almanac

World Almanac do t'i tregojë lexuesit të gjitha që dëshiron të dijë lidhur me efikasitetin e vozitjes, shkallën e analfabetizmit në Zimbabve dhe ngritjen e qytetit Albany të Nju-Jorkut. Ai sjell pjesë të shkurtra të eseve mbi tema të interesit aktual. Për shembull, ka disa kapituj mbi dietën dhe një pjesë kushtuar parashikimit të së ardhmes. Megjithëkëtë, fuqia e vërtetë e kësaj vepre qëndron në fakte, fakte dhe më shumë fakte. Një indeks i shpejtë i referencave, bashkë me 60 deri në 75 tituj temash të gjera nga aktorët deri te kodet postare, ofron qasje në këtë vepër. Ka një pjesë prej 16 deri 20 faqesh mbi hartat dhe flamujt, në ngjyra.

Versioni në Online ka një përparësi të zakonshme për të bërë një freskim të informatave rregullisht, por me botimin e formës së shtypit çdo vit, është një fakt i rrallë që duhet të verifikohet se ai është më aktual në Online sesa në shtyp.

Botuesi, që nga viti 1995, nxjerr nga të njëjtat 1 050 faqe të edicioneve për të rritur të rezymuara në rreth 350 faqe. Kjo shndërrohet në *The World Almanac for Kids*, apo për fëmijë. Ai ofron pjesën më të madhe të të dhënave të njëjta, por me grafike, tabela dhe ilustrime shtesë që është lehtë për t'i ndjekur. Kjo është një vepër ideale e referencës për klasat fillestare. Edicioni për të rritur është i kështillueshëm për shkollat e mesme.

Information Please/Informata, ju lutem

Një i afërt me *World Almanac* paraqet njësi diskursive më të gjera mbi tema të tilla si arte të bukura, shkencë, edukim dhe mjekësi. *Information Please Almanac* ka zgjeruar përmbajtjet e veta për të përfshirë medicinën, ekonominë dhe zhvillimet politike e botërore. Për vëmendjen e bibliotekarëve ai është më tërheqës për indeksin e detajizuar. Ai është më i plotë sesa në *World Almanac*, si dhe më i saktë. Ka edhe disa faqe me ngjyra të hartave. *Information Please* graviton më shumë nga metodat e vjetarëve enciklopedikë sesa nga format standarde të krijuara nga almanakë tradicionalë. *Yearbook* në nëntitull vë në pah këtë fokus, si dhe reklamimi, që thekson se ky është "libri më i plotë, më i përditësuar dhe më i lehtë i referencës për shtëpi, shkollë dhe zyrë". Ndonëse këto pohime vijnë nga Houghton Mifflin, ai pa dyshim është i shkëlqyer. Përbërja e tij është mjaft tërheqës me tipin më të gjerë dhe hapësirë më të madhe sesa *World Almanac*.

Në web-sajtin falas (www.infoplease.com), *Information Please Almanac* ka përparësinë që përfshin të gjitha botimet simotra, prej edicioneve të sporteve dhe argëtimit deri te *Infoplease Dictionary* dhe edicioni i shkurtër i *The Columbia Encyclopedia*. Hartat dhe disa prej informacioneve politike janë marrë nga vepra qeveritare të referencave. Përveç kërkimeve përmes fjalëve kyçe, menyja ofron zgjedhje të thjeshta prej popullit deri te bizneset. Gjithashtu, ky 'sajt' ka një përditësim të vazhdueshëm: shih "Spotlight" dhe "Daily Almanac", në të cilën ka përmbledhje shënimesh mbi ngjarje dhe njerëz.[7]

[7] Një veçori tjetër: Ask Jeeves [wwwask.com]. Këtu mund të shtrohen pyetje dhe të shpresoni për përgjigje që nuk gjenden në almanak. Gjithashtu , edhe linku shërben për të freskuar informacionet themelore në almanak.

Prapëseprapë, si dhe te *World Almanac*, kur një bibliotekar është duke kërkuar një fakt specifik (dhe veçanërisht për një fakt që nuk duhet të ketë ndryshim drastik ndërmjet edicioneve vjetore) është shumë e dobishme për ta konsultuar indeksin e detajuar në versionin e shtypur.

Whitaker's

Whitaker's Almanac, siç thotë një reporter anglez "ofron një gidë magjestriale për establishmentin mbi dallgët e larta të projektuara, rekordet e reja sportive dhe rrogat e mareshalëve në terren.[8] *Whitaker's* me rreth 1 300 faqe është dallohet në atë që, siç dhe mund të pritet, i vë theks të dukshëm qeverive të Britanisë së Madhe dhe evropiane. Për shembull, edicioni ka pothuajse një udhëzues të plotë të Mbretërisë britanike dhe moshës së fisnikëve të vendit, me 150 faqe të tjera dedikuar qeverisë dhe zyrave publike. Veçoritë e tjera përfshijnë një udhëzues mbi arsimin, listat e gazetave dhe të përkohshmeve kryesore, si dhe të dhëna legjislative. Çdo vit, almanaku përfshin kapituj specialë mbi artikuj lajmesh. Zakonisht prej 60 deri në 75 faqe i dedikohen kësaj pjese të "ngjarjeve të vitit". Ka prej 250 deri në 300 faqe mbi vendet e komonueltit dhe aktivitetet e tyre, si dhe pothuajse të gjitha vendeve kryesore të botës. Veçori të tjera unike përfshijnë edhe të dhëna që vështirë gjenden si lista e pagave të shërbimit të lartë civil, përfshirë edhe stipenditë e personaliteteve të Kishës së Anglisë.

Asnjë almanak nuk ofron shumë të dhëna të fundit, të besueshme mbi Britaninë e Madhe dhe Evropën... një pohim që nuk është harruar në *Dracula*-n e Bram Stokerit. Jonathan Harker, i cili aranzhon udhëtimin në Angli për Drakulan, habitet kur zbulon se biblioteka e Drakulas është e ngjashme me seksionin e referencës në një bibliotekë londineze. Ajo përmban një udhëzues londinez, listat e ushtrisë dhe të marinës dhe, gjithsesi, *Whitaker's Almanac*. Para se të invadojë Anglinë, Drakula i studion këto libra në detaje.

Almanakë të tjerë[9]

Duke shfrytëzuar sloganin e vetë "gazetë e rekordeve", *The New York*

[8] The Weekend Telegraph, 27 nëntor, 1983, f.28.

[9] Në qoftë se i kthehemi makinës së kërkimit në Internet thjesht me një "almanak", do të ketë prej 1 500 deri në mbi 2 000 koordinime. Asnjëra prej tyre nuk kualifikohet si standard i përgjithshëm almanaku. Shumica janë aq të ngushtë në përfshirje, saqë mund të përdoren vetëm nga specialistë, p.sh., Astronomy Almanac, Nautical Almanc, Hawaiian Almanac e të ngjashëm.

Times Almanac (Nju-Jork: Penguin Reference Books, 1997 e tej, e parvjetshme) i referohet vetes si "almanak i rekordeve". Përveç anës retorike, çka vetëkupton kjo? Përgjigja: një përqendrim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të dhëna ndërkombëtare që konsiderohen bazike. I ndarë në gjashtë pjesë - prej shkencës dhe teknologjisë deri te sportet – fokusimi bëhet mbi artikuj aktualë kryesorë të lajmeve të vitit paraprak. Të dhënat janë ndërtuar në një bazë të zakonshme të fakteve standarde, siç janë kodet postare dhe adresat e asociacioneve. Ka, përveç sportit, edhe trivialitete të përfshira. Nuk ka fotografi, me harta që janë të vetmet ilustrime. Këtu nuk ka as ese apo përpjekje për t'i tërhequr lexuesit e përditshëm. Kjo është për fakte dhe vetëm fakte. Vini re, gjithashtu edhe indeksin e detajuar. Me $10.95, ky është një ndihmës ideal i referencës. Kjo më tepër zgjeron sesa që zëvendëson almanakët standardë.

The Old Farmers's Almanac (Dublin, NH: Yankee Publishing, 1792 e deri më sot, e parvjetshme. $3.95) nuk është vetëm almanaku më i vjetër në Amerikë, por në saje të distribuimit të afro 4 milionë kopjeve nëpër supermarkete dhe shitore, është ndër më të njohurit. Kopertinat e njohura të verdha gjenden pa pagesë në Net, (www.almanac.com), megjithëse pjesa më e madhe e përmbajtjes së uebit ka një sharm folklorik me theks në të mbjellat (kopshtari), motin (versioni Online mundëson parashikimin personal të motit), si dhe trivialiteti lidhur me atë se çfarë ka ndodhur në këtë apo atë ditë.

Ky nuk është as një almanak i nostalgjisë, e as një që ka të bëjë kryekëput me raporte të motit. Keqkuptimet e mëparshme vijnë si pasojë e themelimit të tij në shekullin XVIII, kur nocioni i motit bazohej në parashikimet herë-herë të jashtëzakonshme të tij. Këtu nuk ka "formula sekrete" për këtë, por ka një qasje të mirë meteorologjike.

VJETARËT REPREZENTUES

Ka dy lloje të vjetarëve. E para, dhe ndoshta më e njohura, është vepra e përgjithshme që mbulon, siç sugjeron titulli, aktivitetet e vitit të kaluar. Lloji që gjendet në shumicën e bibliotekave është vjetari enciklopedik që është përdorur për t'i kontrolluar emrat, datat, statistikat, ngjarjet dhe gati çdogjë tjetër që ka qenë e paralajmëruar në vitin e kaluar. Indekset e gazetave, prej *National Newspaper Index* deri te *The New York Times Index*, zakonisht shërbejnë për të njëjtin qëllim, ashtu si dhe javorja *Facts on File*.

Pothuajse çdo fushë e interesit njerëzor ka përmbledhjen tematike, apo

vjetarin. Është përtej qëllimit të këtij teksti për t'i renditur fjalë për fjalë qindra tituj. Çfarë pason? Pra, është një grup përfaqësues dhe, më hollësisht, ato vepra "bazike" ose "klasike" që përshkojnë shumë disiplina dhe janë të përdorura në disa biblioteka po aq shpesh sa dhe indekset e njohura, enciklopeditë, apo almanakët e përgjithshëm.

Vjetarët përdoren për të gjetur të dhëna dhe sfondin e materialeve mbi vende, njerëz dhe gjëra që kanë ndryshuar apo që kanë krijuar lajmet në vitin e mëparshëm. Llojet e pyetjeve të përgjigjura: Sa është popullsia aktuale e Austrisë?

Sa para shpenzohen për edukim në Irlandë? Kush është shef i shtetit në Francë? Cilat janë importet/eksportet kryesore në SHBA?

Vjetarët shërbejnë për të dhënë informacion të hollësishëm, për shembull, mbi detaje shoqërore, ekonomike dhe politike të një vendi të caktuar. Vjetarët mëtojnë t'i plotësojnë artikujt e vjetër që janë standardë në çdo enciklopedi me reputacion. Për shembull, historia e Francës do të gjendet në një enciklopedi, por kur duam të gjejmë numrin e popullsisë së Parisit për këtë më i miri do të ishte vjetari. Shumica e enciklopedive freskohen me një vjetar të shtypur Online dhe, deri në një masë të madhe edhe edicionet digjitale.

Përderisa stresi është për aktualen, vjetari është ideal dhe i përshtatshëm për format digjitale. Apo jo? Prapë, si dhe te almanakët, vjetari i shtypur mesatar është më lehtë për t'u konsultuar sesa ai në Online – të paktën për fakte të veçanta kur diçka që duam është e njohur dhe plotësisht specifike. Në anën tjetër, kur përdoruesi ka vetëm një ide të zbehtë lidhur me atë që kërkohet, versioni digjital është më i shpejtë për ta përdorur.

Qeveritar: Ndërkombëtar

Shtypi: Europa World Yearbook. Londër: Europa Publications, Ltd., 1926 deri më sot, 2 vol.,e përvitshme. $815.

Shtypi: Statemar's Year-Book. Nju-Jork: St. Martin's Press, Inc., 1864 e tej. $120.

CD: World Country Analysis. Farmington Hills, MI: Gale Group, 1997 deri më sot, e përvitshme. $425.

Shënim: Që nga fundi i viteve 2000, asnjëra prej këtyre nuk gjendet në Online. Brenda disa viteve të ardhshme ka gjasë që të gjitha të jenë në dispozicion në format digjital.

I botuar për mbi një shekull, *Statesman's Year Book* ofron informacion aktual mbi 166 kombe. Bashkë me një enciklopedi të përgjithshme dhe një almanak, ky është një gurthemel për vepra të referencës në pothuajse çdo lloj të bibliotekës. Ka një përparësi të dallueshme për librin e referencave të gatshme: Është aktuale dhe mund të mbështetemi në të për një kohë të pacaktuar. Ka një indeks superior. Indekset përfshijnë emrat, vendet dhe kategorinë e produktit.

Informacioni është i vendosur sistematikisht. Nëntitujt tipikë pothuajse për çdo hyrje kanë të bëjnë me udhëheqësit e qeverisë, rajonin dhe popullsinë, kushtetutën dhe qeverinë, edukimin, stacionet hekurudhore, aviacionin dhe njësitë matjes. Ka bibliografi të shkëlqyera për të gjetur informacion të mëtejmë statistikor dhe të përgjithshëm, si dhe harta të shumta që tregojnë gjëra të tilla, si zonat kohore dhe shpërndarjen e burimeve natyrore.

Evropa

The Europa World Yearbook mbulon pothuajse të njëjtin territor, si dhe rivali i tij, por ka disa përparësi: (1) Kjo vepër është po aq aktuale sa edhe *Statesman's Year-Book;* (2) Ky prin për nga numri i fjalëve dhe sasia e informatave; (3) Vëllimi i parë mbulon Kombet e Bashkuara dhe mbi 1 650 agjenci speciale dhe organizata ndërkombëtare sipas temës dhe vendeve evropiane; (4) Vëllimi i dytë mbulon vendet joevropiane, për plot 250 vende dhe territore. Gjithandej ka një format njëformësh. Secili vend fillon me një hyrje të shkurtër, pasuar me një profil statistikor, si kushtetuta, qeveria, partitë politike, përfaqësuesit diplomatikë, sistemi juridik, feja, shtypi, botimet, radio dhe televizioni, tregtia dhe industria, transporti, edukimi i lartë dhe fakte të ndryshme karakteristike për atë vend. Ky mbulim i gjerë, sidomos sa u përket mediave, i jep një vend prijetar për pyetje të referencave të gatshme kundruall dy veprave të tjera. Balancimi ndërmjet vendeve është i mirë.

Ka edhe një sërë titujsh që mbulojnë pothuajse të njëjtin territor, megjithëse gjithmonë paksa në mënyra të ndryshme. *Europa*, për shembull, ka botuar gjashtë tituj të përafërt, të cilët thjesht zgjerojnë faktet e gjetura në veprën themelore, për shembull, *Africa of the Sahara*, *The Middle East and North Africa*, si dhe *Western Europe*. Shih, për një shembull tjetër, pjesën e të dhënave të *Britannica Yearbook*.

Analisti i vendeve botërore

Duke u fokusuar në mënyrë specifike te interesi i biznesit, *World Country*

Analyst ndryshon prej profileve të përgjithshme të vendeve, siç janë gjetur në *Statesman's Year-Book*. Ai fokusohet në çështjet kyçe për investitorët jashtë vendit. Kërkimi mund të bëhet sipas temës, vendit, si dhe nga fjala kyçe e interesimit. Afro 200 vende janë të analizuara në thellësi. Informacioni është kombinuar nga burime të qëndrueshme, relativisht aktuale, të qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Ju mund të kaloni nga informacioni i përgjithshëm, të themi, mbi Francën, te informacioni specifik, siç është vera dhe restorantet, të cilët paraqiten në ndarje dhe nënndarje. Ka edhe harta të shumta dhe skica që ndjekin vijën kryesore të pyetjeve.

Bibliotekarët e zgjuar të referencave do ta bëjnë llogarinë përfundimtare mbi publikimet Gale. Si? Duke kërkuar nga Departamenti i Tregtisë i Shteteve të Bashkuara për disk të papaguar (nr.1), të quajtur *National Trade Bank*. Kjo ka pothuajse të njëjtat të dhëna si dhe *World Country Analyst*.[10]

Gale nxjerr botime të ngjashme me *World Country Analyst*. I përshtatshëm sidomos për shkolla dhe biblioteka publike: *CD-ROM: Discovering Nation, States & Cultures*. Këto lidhen me të dhënat standarde për vendet me informacion kulturor prej kushteve të jetesës e deri te trashëgimia kulturore. *World Encyclopedia of Nations* freskohet me të dhëna në çdo katër vjet dhe përdoret më shumë për informacion themelor sesa për atë aktual. Përmban të dhëna në mbi 200 vende, me njësi prej katër deri në 30 faqe e më shumë. Një vëllim i dorëzohet Kombeve të Bashkuara. Një botim i ngjashëm i të njëjtit botues është *Worldmark Encyclopedia of Cultures and Daily Life*. I ndarë në katër regjione gjeografike ai shqyrton fusha të tilla, si gjuha, feja, folklori, jeta e familjeve, argëtimi etj.

Dhe...[11]

Informacioni i përgjithshëm mbi vende gjendet në dispozicion në enciklopeditë standarde. Përtej enciklopedive themelore janë veprat më të specializuara që përqendrohen vetëm në vendet e botës. Megjithëse nuk janë

[10] Për një krahasim të hollësishëm të dy CD-ROM-ve, shih një vështrim konceptual nga Nancy Van Atta në botimin e dimrit, 1997 të Reference and User Service Quarterly, (f. 208-209).

[11] Shih "Referencat në web: vendet dhe kulturat në Online", Booklist, 1 dhe 15 qershor, 2000, f. 1936+ për vjetarët dhe vepra të referencave të afërta të regjistruara dhe të pajisura me shënime nga vendet kryesore. Dy seritë Gale janë vetëm një shembull i asaj që ofrohet. Disa tituj të tjerë të Gale, njëlloj të dobishme, ku buxheti është i madh dhe nevoja është aty: Worldmark Encyclopedia of the States and Countries of the World and Their leaders Yearbook; Handbook of the Nations.

të përcaktuara si vjetarë, ato plotësojnë mirë botimet vjetore statistikore.

Më e mira:

1. *Lands and People*. (Danbury, CT: Grolier Incorporated, 1997, 6 vol. $259). Një komplet impresiv që mbulon vendet e botës në detaje objektive. Ndonëse ai duhet plotësuar nga vjetarët për informatat aktuale, është i shkëlqyer për sfondin e të dhënave. Ka dhe ilustrime të shumta të zgjedhura. I përshtatshëm si për të rinj ashtu dhe për të rritur.

2. Të parapara për nxënës nga klasa e pestë deri në fund të shkollës së mesme, *The World Book Encyclopedia of People and Places* (Çikago: World Book, 1998. 6 vëll. $160) mbulon afro 200 kombe në gjuhë që lexuesit mund t'i kuptojnë. Vendet janë sipas renditjes së alfabetit. Vizualisht është pothuajse i njëjtë si *Lands and People*, bashkë me riprodhimet me ngjyrë të plotë, plus grafika, skica dhe pjesët më interesante, kjo ende është më tërheqëse për lexuesit fillestarë. Në kuptim të grupmoshave, që të dyja plotësojnë dhe zëvendësojnë njëra tjetrën.

3. *Culturegrams: The Nations Around Us*. (Provo, UT: Bringam Young University/Qendra e Botimeve Kennedy, 1985 deri më sot. $80 për kompletin). Kryesisht për klasat fillore deri në shkolla të mesme, kjo mbulon vendet kryesore. Disa prej vendeve më të vogla nuk janë të përfshira. Aktivitetet kulturore prej muzikës dhe artet e deri te ushqimet dhe kostumet janë të mbuluara në detaje. Llojet e rralla të informatave sikur i kënaqin studentët dhe janë shpëtim për shumë pyetje të referencave të gatshme, pavarësisht nga grupemoshat. Shënim: *Culturegrams* është i inkorporuar brenda *Microsoft Virtual Globe*, CD-ROM, e cila plotësohet çdo vit.

Në web-sajt

Faktet specifike, siç janë popullsia e qytetit X ose Y, mund të gjenden shpejt në Online, thjeshtë me të shtypur të emrit të vendit në hulumtim në kutinë e kërkimit. Anasjelltas, ku kërkohet një masë e madhe e të dhënave të prezantuar në bazë të renditjeve të moderuara, veprat e shtypura janë më të shpejta përderisa këto janë më të lehta për t'i shfletuar. Demografia aktuale e Kinës, ekonomia kombëtare, edukimi, transporti dhe të ngjashme, janë të përmbledhura shpejt në një vjetar të shtypur, ndërkaq që do të duhej shumë kohë që këto të dhëna të gjenden në rrjet. Teorikisht, rrjeti dhe burimet e shtypura janë të kombinuara për hulum-

time detajesh.

Një ndër 'sajtet' më të njohura pa pagesë në rrjet vjen për ju nga Agjencia Qendrore e Inteligjencës; *World Factbook* (www.odci.gov/cia/publications/factbook). Kjo ka të dhëna themelore për vendet, siç gjenden në veprat standarde, si *Statesman's Year-Book*, por me një ndryshim - të dhënat janë mbledhur jo vetëm nga CIA, por nga qindra ose më shumë agjenci qeveritare. Është e mbuluar e tërë bota dhe të dhënat për secilin vend janë gjithëpërfshirëse, megjithëse, çuditërisht jo gjithnjë të freskuara.

Kërkimet bëhen sipas vendit, apo nga kategori të tilla, si qeveria, komunikimi, gjeografia etj. Shënim: *The World Factbook* është në dispozicion në shtyp, si edhe në CD-ROM.[12]

Ngjarjet vjetore, libri i ditëve, kronologjitë

Online: *Chase's Calendar of Events Online*. Çikago: NTC/Contemporary
Publishing Group, 2000 deri më sot, vjetore (www.chases.com/buy/buy.html.$150).

Shtypi: *Chase's Calendar of Events*. 1957 deri më sot, vjetore, 752 faqe.$60.
Shtypi: *American Book of Days*. Nju-Jork: H. W. Wilson Company, 1978, 1212 faqe. $75.
Shtypi: *Timelines of the Arts and Literature*. Nju-Jork: Harpers Collins, 1994, 712 faqe. $30.
Shtypi: *Chronolgy of World History*. Santa Barbara: ABC-CLIO, 1999, 4 vëll., $375.

Pyetjet, si për shembull: "Çka ka ndodhur më 23 nëntor?", ose "Jam duke bërë një artikull për Xhorxh Uashingtonin. Kush tjetër ka lindur në ditën e lindjes së tij?", "Cilat janë mënyrat e preferuara për kremtimin e ditës së quajtur 'ground hog'?", kanë përgjigje në burime të shumta. Më së shpeshti përdoret kronologjia, që regjistron ngjarjet sipas ditëve

[12] Dy referenca të Agjencisë Qendrore të Intelegjenës janë në dispozicion nga NITS në një CD-ROM të vetëm, ose në shtyp: World Fact Book dhe Handbook of Internacional Economic Statistics. Çmimi është $59 plus $5 për transport nga: National Technical Information Services, U.S. Department of Commerce, Springfield, VA, 800/ 553-6847.

dhe/apo viteve.

Një shembull i mirë është *Chase's Calendar of Events Online*. E botuar në çdo dimër dhe i plotësuar shpesh me të dhëna freskuese, ai kërkon ngjarjet e vitit të mëparshëm, si dhe shënon kremtet e vitit që vjen. Për çdo kremte ose ngjarje, ai jep emrin e sponsorit. Me interes të veçantë është përkujdesja ndaj trivialiteteve. Për shembull, më 1 janar shënon një kthesë në ngjarje, por gjithashtu është edhe koha kur bëhet "shpallja e dhjetë shakave më të mira të vitit" dhe kjo hap Muajin Kombëtar të Hobit. *Chase*, gjithashtu përfshin më shumë informata të rëndësishme, për shembull, një biografi e mirë dhe e shkurtër e E. M. Forsterit dhe shënime të sakta të "përvjetorit të Deklaratës së Emancipimit". Versioni në Online dyfishon punën e shtypit, por me avantazhin e qartë të ofrimit të shumë mënyrave të njësisë që nuk gjenden në shtyp.

The American Book of Days është klasike që përditësohet kohë pas kohe. Është ndër ndihmës të paktë të referencave të gatshme që kanë nevojë për pak revidim. Materialet themelore – si dhe pse t'i festojmë pushimet – ndryshon pak nga viti në vit, nga gjenerata në gjeneratë. Nën secilën ditë të vitit gida fut në listë ngjarjet kryesore dhe të parëndësishme. Shumica prej tyre shpjegohen në ese të detajuara që e sugjerojnë, gjithashtu, metodat tradicionale të kremtimit. Veçanërisht e vlefshme për shkolla, ajo vë theksin sidomos në ditët kryesore të kremtimit.

Tituj të shumtë në këtë fushë përfshijnë nga *Annivarsaries and Holidays* (*Përvjetorët dhe Festat* – Çikago, American Library Association, 2000) që ofron të dhëna të përmbledhura dhe pjesë leximi plotësuese; deri te *Holidays and Anniversaries of the World*, bot. 2 (Detroit, MI: Gale Group, 1990); si dhe librin klasik *The Book of Days* (Londër: W. R. Chambers, 1864), që ribotohet kohës pas kohe. Kjo është më e hershmja nga gjinia e vet dhe sot ka vlerë si kuriozitet, si profil i historisë viktoriane dhe pikëpamjeve kulturore. Shih, po ashtu, *Let's Celebrate Today,* (Englewood, CO: Libraries Unlimited, 1998) një listë të kremtesh dhe ngjarjesh të bërë posaçërisht për studentët e klasës K-12.

Itineraret e arteve

Kronologjitë, një ndër format më të vjetra të referencave, para së gjithash u tregojnë lexuesve çka ka ndodhur në çdo kohë në historinë e botës. Dy

[13] Provoni, gjithashtu: Chronology of World History (Santa Barbara: ABC-CLIO,1996), që është një version i shkurtër i të katër vëllimeve me një çmim prej rreth $50.

shembuj janë përmendur këtu. Ka me dhjetëra.[13]

Njësia e parë në *Timelines* quhet "Letërsia" dhe thotë: "Shenjat në eshtra tregojnë për përdorimin e mundshëm të sistemeve numëruese në veriperëndim dhe në qendër-jug të Evropës (30 000 P.K.)". Artet vizuale, artet e shfaqura dhe ngjarjet botërore pasojnë si kategori kryesore, siç ndodh në tërë kronologjinë, bashkë me shtesat në shekujt e mëvonshëm të "Teatrit dhe varieteteve", "Muzikës dhe vallëzimit" dhe nga viti 1920, "Filmat dhe shfaqjet". Ky informacion ka lidhje kohore deri në vitin 1500, kur është futur në listë nga viti në vit.

Si përdoret një libër i tillë? Disa shembuj mjaftojnë. Një autor që shkruan romane historike do të dijë çka ka qenë duke ndodhur në art dhe në botë, në vitin 1893, kur karakteret e tij arrijnë në nivel të krizës. Kur Andrew Jackson ishte zgjedhur për president (1828), kush ishte duke lexuar çfarë në Amerikë? Në vitin Bahu kompozoi Tundimin e Shën Mateut, a kishte edhe ndonjë vepër tjetër të krahasueshme në art? Kalimi para e prapa në kohë, kontrapunkti i një ngjarjeje me tjetrën është mbuluar në referencat e veprave superiore, e edhe më shumë me indekset e detajeve.

Chronology of World History është kronologjia më e detajuar në dispozicion ajo kalon nga "Parahistoria" deri më 1491 AD e te Bota moderne", prej vitit 1901 deri në 1998. Dizavantazhi: aty ka një indeks të detajuar për çdo vëllim, por jo një gidë të plotë të asaj që botuesi e quan rekord për mbi 70 000 ngjarje. Ndonëse një referencë e shkëlqyer me njësi të grupuara sipas vitit dhe temave, si p.sh., "art dhe ideja- muzika", etj., ajo ka një disavantazh madhor: çmimin. Siç vë në pah Ken Kister, në recensionin e tij, duhet konsideruar të tjera alternativa. Sipas fjalëve të tij: "Kjo është kronologjia më e madhe dhe më e shtrenjtë e historisë së përgjithshme në tregun e Amerikës Veriore. Shumica e bibliotekarëve që kanë botimin më të lirë njëvëllimësh të *Encyclopedia of World Facts and Dates* (Nju-Jork: Harper Collins, 1993,o.p.), që mbulon 50 000 ngjarje, do ta gjejnë atë të përshtatshme për nevojat e tyre".[14]

[14] Shumica e fushave tematike kanë kronologjitë e veta, p.sh.., Timeliness of African History, (Berkeley, CA: Berkeley,1994) mbulon pesë shekuj të historisë afro-amerikane nga viti nga vit. Në Microsoft Bookshelf të lartpërmendur është edhe The People's Chronology. Një tjetër në CD-ROM është dukshëm më e detajuar, p.sh., Chronicle Encyclopedia of History (Nju-Jork: DK Multimedia, 1998, $39.95). Kjo është një kronologji e shkruar si seri lajmesh të ngjarjeve mbi përvijimet standarde të kohës. Akcesi është sipas fjalës kyç, ngjarjeve, personaliteteve, etj. Përfshin audiovizuale dhe ilustrime. Tjetër shembull: A handbook of Dates, (Cambridge: Cambridge University Press, 2000. 200 f. $19.95). Për një listë të përzgjedhur të kronologjive, shih: "What happened When", Booklist , 1 janar, 2000, faqe 966-67.

DORACAKËT DHE MANUALET

Doracakët dhe manualet janë ana "si bëhet kjo" e pyetjeve të referencave të gatshme. Manuali mund të klasifikohet nga ajo se si të bëhet një dasmë (etiketë) e deri te se si të gjesh një vend pune (manuale profesionale). Doracaku, që është pothuajse njësoj si the manuali, presupozon që lexuesit e njohin mirë fushën dhe i kthehet asaj për t'i rifreskuar njohuritë që kalojnë nga mjekësia (*The Merck Manual*) deri te rezymimet e ligjeve.

Gidat lidhur me pyetjet "si bëhen këto", janë ndërmjet më të vjetërve në repertorin e referencave. Ato fituan pranueshmëria të përnjëhershme kur libri i shtypur ishte në dispozicion. Afro 500 vjet dhe në vazhdim kjo mbeti një gjë e njëjtë. Derisa një lexues i shekullit XX, në kërkim të sjelljes së mirë, do t'i kthehej librit të Castligione-s, *The Book of the Courtier* (1528, me edicione të panumërta), sot përgjigja mund të gjendet në Emily Post Dr.Spock ose Dr. Michele Savonarola's... *Of Newborns to their Seventh Year*, që ua tërheq vërejtjen etërve të mos jenë tepër të ashpër me fëmijët e tyre gjatë viteve të para të shkollës. Së bashku, i japin lexuesit nga shekulli në shekull një peizazh të pasur të kulturës së përditshme të të paktën pozitës mesatare. (Prej këtu vjen edhe interesi i bibliotekave të mëdha hulumtuese për të mbajtur edicione të shumta të doracakëve dhe manualeve).

Ka pothuajse aq doracakë dhe manuale sa ka dhe fusha të interesit. Të rejat shfaqen për çdo vit, derisa disa prej të vjetrave zhduken ose kalojnë me një emër tjetër. Më sa duket, është e pamundur për t'i kujtuar të gjitha. Në praktikë, bazuar në lehtësinë e rangimit, apo masën e përdorimit, bibliotekarët i adaptojnë favoritet. Me disa përjashtime, shumica e manualeve dhe doracakëve kanë një gjë të përbashkët –një përfshirje të kufizuar. Ato përqendrohen në një fushë specifike të interesit. Në fakt, vlera e tyre e veçantë është në thellësinë e informacionit në një fushë të ngushtë.

Ajo që pason janë disa shembuj të zgjedhur për një numër kohësh, ato që do t'i kërkojë një bibliotekë, si dhe për shkak të tingëllimit të njohur të shumë prej titujve të tyre.

Etiketa

Shtypi: Emily Post's Etiquette, bot. 16, Nju-Jork: Harper Collins, 1997.$35.

Çfarëdo që ka ndodhur me sjelljet e mira... vajtimi mbi dështimin e civilitetit është bërë çështje e industrisë dypartiake".[15] Në *Civility* (New Haven: Yale University Press, 1998), profesori juridik i Universitetit Yale, Stephen Carter, shpjegon krizat aktuale në moralin dhe sjelljet amerikane. Qindra libra të tjerë dhe shënime të artikujve merren me këtë çështje. Librat e etiketës shiten më shpejtësi, dhe jo vetëm në biblioteka. Duhet parë, gjithashtu, edhe një numër të revistave dhe gazetave të kolumneve këshillëdhënëse. Të gjitha këto i kontribuojnë më shumë civilitetit, jo më pak.

Librat e etiketës marrin një qëndrim neutral, duke shpallur sjelljet e mira dhe rregullat e ndryshimit dekorativ, por ka standarde, të cilat çdo njeri duhet t'i synojë. Nëse, për shembull, pak kush çan kokën se si duhet ngrënë pulën, librat e etiketës vënë në pah rëndësinë e veprimeve mjedisore, si të mos hedhen kanaçet e lëngjeve në bar, por të ruhen për riciklim të mëtejshëm.

Çfarë manualesh të etiketës duhet të gjenden në bibliotekë? Biblioteka ka standardet prej Emily Post deri te Amy Vanderbilt, Judith Martin (Znj. Mirësjellja) e deri te Letitia Baldrige.

Përderisa gjenealogjia moderne e etiketës filloi në shekullin XVI, sot emri kryesor mbisundues, qoftë edhe fantazues, është Emily Post. Ajo kuptoi se një grup i ri i kamur i klasës së mesme kishte nevojë për ta ndihmuar se ku do ta fuste sfurkun e dytë. Dhe, në vitin 1992, ajo solli edicionin e parë të një vepre madhore, që është e njohur në gjithë botën. Suksesi i saj vazhdon, vazhduar nga botuesit dhe familja e saj. (Ajo vdiq në moshën 90-vjeçare, më 1960).

Librat e sotshëm të etiketës ndjekin pothuajse mostrën e Postit, pilotuar nga stërmbesa e Emilisë, Peggy Post. Ajo i drejtohet Mary dhe Joe-it mesatar, jo aristokratëve apo atyre që udhëheqin në Fortune 500. Si e tillë, kjo gidë është një levë e fortë, një forcë demokratike. Është e tepër të thuhet se brez pas brezi pohohet se mirësjellja ka degjeneruar. Ndoshta, por shitjet e librave të etiketës janë në rritje. Çdo bibliotekë duhet të ketë standarde dhe zëvendësime kur vidhen disa prej këtyre librave.

Tash ka edhe disa libra bazikë të etiketës, por rival i vetëm tradicional kundruall Emily Post-it është libri i njohur *Amy Vanderbilt Complete Book of Etiquette* (Nju-Jork: Doubleday, 1995). Autori apo kursi, është i

15 "Polite Society", Lingua Franca, mars, 1998, f. 11.

vdekur, por çdo edicion i ri ka hartues të tjerë. Në këtë edicion të vitit 1995 (i fundit ishte në vitin 1978), hartuesit janë Nancy Tuckerman dhe Nancy Dunnan. Sidoqoftë, kjo zakonisht ndjek modelin e këshillave praktike në ç'gjë, që nga telefonat celularë (është sjellje e keqe që ta nxirrni telefonin poshtë tavolinës se darkës) deri te mënyra e dhënies së bakshishit, sjellja në dasma e funerale.

Bibliotekarët kanë zbuluar se tri shqetësimet më të rëndomta që kanë të bëjnë me mirësjelljen dhe formën janë: (1) aranzhimet e dasmave, varrimeve dhe ngjarjeve të veçanta; (2) mënyra e duhur e komunikimit me dikë në zyrë, edhe në qoftë se bëhet fjalë për një politikan apo prift; (3) rregullat e sjelljes personale me rastin e drekave a darkave, në biseda dhe në ambientin e punës.

Në Web

Nuk ka asgjë në Ueb që do t'u afrohej standardeve të librave të etiketës dhe kur eventualisht Post dhe kompania mund të jenë në rrjet, tash për tash vëllimet e shtypura janë të vetmet në dispozicion. Një shembull i vetëm i afërt është *Good Housekeeping* (http://goodhousekeeping.woman.com/gh/advice/etiquette/00post21.html). Aty keni një këshillë nga Peggy Post të njohurive themelore prej pyetjeve të martesave deri te ato të biznesit dhe Ditës së Babait. Komandat janë të shkurta, por praktike dhe të bazuara në praktikën aktuale. Në qoftë se kërkohet informatë e mëtejshme, ka një e-mail "ask Peggy Post", që do t'u kthejë përgjigje për disa ditë.

Letërsia dhe hartimet provuese

CD: Masterplots Complete. Hackensack, NJ: Salem Press, data ndryshon. $650.

Shtypi: (All Salem Press). *American Fiction Series*, 1986; *Short Story Series*,

1986; *British dhe Commonwealth Fiction Series*,1987; *Worldfiction Series*, 1988; *Nonfiction Series*, 1989; *Drama Series*, 1990; *Juvenile dhe Young Adult Fiction Series*, 1991; *Cyclopedia of World Authors*, 1989; *Cyclopedia of Literary Charachters*, 1990. Shënim: Të gjitha kanë numra të ndryshëm të vëllimeve në komplete dhe të gjitha kanë shto-

jca.

Online: Monarch Notes në online, si pjesë e: *Study World*. Oakwood Management, www.studyWorld.com. Pa pagesë.
CD: Monarch Notes. Parsippany, NJ: Zyra Botimeve Elektronike, 1992, pa plotësime. $99.
Shtypi: Më se 200 pamflete të ndara. Çmimet janë të ndryshme.

Online: Barron's Book Notes. Hauppauge, NY: Barron's Educational Series, 1993 deri më sot, www.cheatbooks.com, të gatshme në America Online. Çmimi për një orë ndryshon.

Studentët shpesh kërkojnë rezymime të përmbajtjes dhe shkurtesa të tjera të leximeve. Që në kohën e Mesjetës ka pasur të ashtuquajtura 'djepe' për t'i asistuar studentët që përgatiten për provime apo që janë duke punuar në ndonjë punim. Nuk ka asgjë të re për këtë medium, dhe në vendin e vet, kjo është një formë e çmuar e referencës. Bibliotekari mund të ketë vlerësime të ndryshme për përshtatshmërinë e punës së tillë për studentët, por ky është një problem që studentët, mësimdhënësit dhe prindërit duhet ta zgjidhin së bashku. Është gabim ta refuzosh një vend në raftet e referencës kundruall burimeve 'të djepit', pavarësisht se si ato mund të përdoren apo të keqpërdoren.

Emri më i njohur në këtë fushë është libri i Frank N. Magill, *Masterplots*, një kondensim i gati çdo klasiku të rëndësishëm në gjuhën angleze. Jo vetëm që janë karakteret kryesore të shpjeguara mirë, por ka gjithashtu edhe një kritikë të pikave të thurjes dhe të pikave të mira dhe të këqija. Ka shumë thjeshtër, kushërinj dhe të afërt të vëllimeve kryesore të *Masterplots*, që gjenden nëpër biblioteka nën tituj dhe nëntituj të ndryshëm kryesorë.

The Masterplots Complete në CD-ROM (botuar për herë të parë më 1997) përfshin 7 500 tituj dhe 12 000 ese mbi librat. Këto janë nxjerrë nga 100 vëllime, që përbëjnë kompletin themelor të shtypur të *Masterplots*. CD-ja ka korrigjime, plotësime dhe editime të kompletit, që për herë të parë dolën në fillim të viteve 1940. Ka edhe njësi madhore nga vepra të tjera të ngjashme, si *Cyclopedia of World Authors*, por para së gjithash, CD është një binjake elektronike e veprës së shtypur.

Masterplots në CD-ROM është më pak e shtrenjtë sesa vëllimet e mbledhura. Ashtu siç është përdorur më së shumti, kjo është një pazar i

mirë për shumicën e bibliotekave. Softueri mundëson mostra standarde të kërkimit dhe është lehtë për t'u përdorur. Autorët, titujt, gjinia dhe temat janë pika të rëndomta të qasjes. Udhëzimet në ekran mund ta udhëheqin lexuesin edhe më shumë për hulumtim të sofistikuar, si për shembull kërkime sipas "fiction of manners" apo "roman á clef".

Nën rubrikën "Magill's Choice", botuesi ofron tituj si *Explorers, Notable Poets, Notable Novelists, Civil Rights*, etj. Brenda çdo vëllimi (dhe disa tituj janë multi-vëlliminozë), mund të gjenden skica biografike, studime kritike, artikuj etj. Disa, nëse jo të gjitha nga këto figura gjenden në *Masterplots* dhe të afërmit e saj. Kompleti i veçantë "Chioce" kushton prej $55 deri $175. Një shembull i përkryer i pashmangshëm për bibliotekarët për të kontrolluar me kujdes informacionet e tepërta dhe tepër i mirë për një çmim mjaft të lartë.

Libër-shënimi

Forma e shtypur e *Monarch Notes*, seritë e pamfleteve prej 35 deri 80 faqe janë të njohura për pothuajse çdo nxënës të shkollës së mesme apo student kolegji. Si një 'shtëpizë', *Notes* janë të dobishme për rezymime tematike apo përmbajtjeje, analiza karakteresh, komentime të tekstit, të dhëna mbi autorë, e kështu me radhë. Të afërta me kurset e maturantëve të shkollave të mesme dhe të kolegjeve të anglishtes, CD-ROM-i relativisht i lirë, i cili përfshin të gjithë udhëzuesit, është tepër i dobishëm për t'u anashkaluar. Hulumtimi ndjek mënyrën standarde, sipas autorit, titujve, temave, apo një kombinimi. Dhe, ndonëse logjika Boolean është e mundur, është tepër e involvuar për shumicën e situatave, ku mjet i vetëm i navigimit është vetëm titulli apo autori. Prapë, meqë çmimi është i ulët, mostrat e kërkimit janë fillestare dhe nganjëherë kërkojnë përsëritje të shumta. Për shembull, disa njësi mund të gjenden me pikësim, kurse të tjerat nuk munden.

Si pjesë e shërbimit Online të konsumatorit, American Online, *Barron's Book Notes* ofron tekstin e plotë të 100 'krevateve' të prodhuara nga Barrons. Shumica janë vepra klasike nga Beowulf deri te Shekspiri dhe Heminguej. Qasja është e ngjashme me *Monarch Notes* dhe përderisa pa asnjë konsideratë për bibliotekat, kjo do të jetë mjaft e dobishme për punë të studentëve në shtëpi. *Barron's* është gjithashtu e gatshme në format të shtypur.

Cliff Notes (Lincoln, NE: Cliff Notes, 1980 deri më sot), përmban

ndihmës edhe më të njohur. Kjo firmë u themelua nga Cliff Hillegass, mjeshtër i artit të kondensimit të librit në 70 deri në 90 faqe të lehta për t'i lexuar. Brenda çdo viti, shiten afro pesë milionë kopje me kopertina të buta. Audienca më e madhe për këto shënime, janë nxënësit e klasës së dhjetë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë. Nxënësit e klasave 10 dhe 11 janë përdorues të mëdhenj, por në vitin e fundit të mësimit heqin dorë. Dhjetë bestsellerët më të mëdhenj, pa ndonjë renditje të posaçme, janë *Odiseja, Hamleti, Pritjet e Mëdha, Hardhitë e zemëratës, Hakëlberi Fin, Getsbi i madh, Jul Qesari, Makbethi, Tregimi për dy qytete dhe Letra e kuqe*. *Notes* nuk janë në dispozicion në asnjë formë elektronike, ndoshta sepse është duke u shitur mirë në formë të shtypur.

Në Web

Ana e errët e çdo rrjeti të Internetit ka disa aspekte. Të marrim një punim të rishkruar provimi.

Mulliri i shkrimit të një punimi është i njohur për studentët e shkollave të mesme dhe të kolegjeve, si dhe mësimdhënësit agilë. Reklamimi për punime të rishkruara botohen në gazeta, siç është *Rolling Stone*. Fjala e gojës ka qenë reklama më e mirë, të paktën deri vonë, kur rrjeti erdhi në përdorim.

Punimet e gatshme të parashkruara të provimeve mund të gjenden në Internet, në dhjetëra 'sajte'. Thjesht hapet "term paper" (punimi i provimit) në pothuajse çdo kuti të makinës së kërkimit dhe mundësitë janë gjithandej. Edhe më shumë mundësi do të gjenden në grupe të lajmeve, p.sh., provoni *Deja News* (www.dejaNews.com). Shkruani "term paper" dhe do të ofrohen mbi 1 000 komente, burime të punimeve të provimeve dhe informacione të përgjithshme mbi atë temë. Shumica e kompanive kanë një tarifë (prej $6 deri në $10 faqen). Disa 'sajte' ofrojnë punime pa pagesë, që janë dërguar nga shkolla të mesme për maturantë.

Cilësia e punimeve ndryshon nga punimi në punim dhe jo gjithaq nga kompania në kompani. Disa, madje do të shkruajnë për një punim me porosi, në vend se të hulumtojnë për punime të stërpërdorura. Këto mëtojnë të jenë me cilësi paksa më të mirë.

Asnjë, absolutisht asnjë, nuk mund t'i kalojë pa u vërejtur një mësimdhënësi i shkathët, veçanërisht nëse punimi është më se i përcaktuar. Për shembull, profesori mund të kërkojë nga një student që të shkruajë një punim të përgjithshëm lidhur me *Zemrën e errësirës* të Konradit (një mate-

rial i përgjithshëm dhe i përshtatshëm për shtëpitë e punimeve të parashkruara). Mësimdhënësi më i mençur është më specifik, p.sh., eksperienca e autorëve dhe si influencojnë ata në pikëpamjen e Konradit ndaj civilizimit, që reflektohet në *Zemrën e errësirës*, është një punë më i vështirë për një punim standard provimi.

Profesorët automatikisht do ta kishin ngelur një student që do të përpiqej të kalonte përmes një punimi të parashkruar të blerë, për të kaluar me ndonjë punim të gatshëm të blerë, apo të gjetur pa pagesë, në ndonjë prej 'sajteve' të panumërta të hartimeve. Shumë institucione shkojnë edhe më larg dhe e përjashtojnë fare studentin për shkak të kopjimit.

Përdorimi i punimeve të parashkruara nuk është shumë i jashtëligjshëm. Prandaj, të gjitha kompanitë pohojnë se ato ofrojnë punime me qëllim të asistimit dhe jo si punime që do të prezantohen nga studentët si punimeve vetanake. Një shembull:

Term Papers on File (www.termpapers-on-file.com), bën një dallim më të mirë lidhur me punime të tilla. "Qëllimi i synuar i punimeve tona të provimit është që ato të përdoren si modele për të asistuar në përgatitjen e punimeve tuaja. Në pajtim me Statutet e NJ 2A:17-77.16-18 dhe statutet e ngjashme që ekzistojnë në shtete të tjera, as (ne) dhe asnjë degë e jona... nuk ka kurrë për t'ia shitur një punim model ndonjë studenti për çfarëdo arsye që do të na ofrojë për të besuar se ai nuk do të parashtrojë punimin tonë, pjesërisht apo në tërësi, për ndonjë notë akademike në çfarëdo institucioni në emrin e vet".

Profesionet dhe karrierat

Online: Occupational Outlook. Washington, DC: U.S. Department of Labor, Government Printing Office, 1994 e deri më sot, tremujore, http://stats.bls.gov/ocohome.html. Pa pagesë.
Shtypi: Occupational Outlook Handbook,1929 deri më sot, dyvjeçare. $25.

CD: In Discovering Careers & Jobs. Farmington Hills, MI: Gale Group,1994 e deri më sot, njëvjeçare. $495.
Shtypi: 1929 deri më sot, dyvjeçare. $22.

Online: So You Want to get a Career (Pra, dëshironi të keni një karrierë). Princeton, NJ: The Princeton Review, online, www.review.com. Pa

pagesë.

Shtypi: Princeton Review Guide to Your Career, New York: Random House, 1996 e deri më sot.

Shtypi: Encyclopedia of Careers and Vocational Guidance, 10th ed.Chicago: J.G. Ferguson, 1987, 4 vëll. $150.

Në biblioteka më të mëdha gida profesionale zakonisht nuk është pjesë e shërbimit te referencave, por është në masë të madhe në bibliotekat e mesme dhe të vogla dhe, sigurisht në shkolla. Kur u jepet një këshillë profesionale studentëve nga këshilltarë të trajnuar, pashmangshmërisht ka një sulje nga të rinjtë dhe të rejat që kërkojnë material shtesë, qoftë për arsye personale, qoftë për përgatitjen e punimeve klasore. Nxitimi është rritur aq shumë saqë edhe bibliotekat e vogla do të nxitojnë të përfshijnë një masë të konsiderueshme të materialeve profesionale në dosjen vertikale.

Kushdo qe shikon për punësim do të përkulet jo njëherë, por tri herë në Internet. Aty, për të parën herë mund t'i bëni dy gjëra: (1) të përcaktoni llojin e punësimit dhe se si janë mundësitë në afat të gjatë në atë punë të veçantë dhe profesionale. Kjo bëhet përmes *Occupational Outlook, Discovering Careers & Jobs*, ose *So You Want to Get a Career*; (2) mundësitë reklamuese për punësim të menjëhershëm janë te gatshme në tërë vendin në disa 'sajte' Internetit. Faqet e web-sajteve freskohen kohë pas kohe.

Occupational Outlook Handbook është sidomos i dobishëm. Ky është një botim qeveritar u Shteteve të Bashkuara. Afro 700 profesione janë të diskutuara në terma që janë të kuptueshëm nga çdokush. Secila prej këtyre eseve tregon se çfarë mund të ofrojë çdo vend pune në kuptim të avancimit, punësimit, vendndodhjes, pagës dhe kushteve të punës. Trendet dhe perspektivat janë vënë në pah për t'i dhënë lexuesit një ide mbi gjasat e rritjes në një linjë të caktuar të punës. Fatkeqësisht, autorët nuk janë më tepër të saktë në parashikimet e tyre më shumë se ekonomistët apo parashikuesit e fituesve në vrapimet me kuaj. Titulli përditësohet më shpesh në Online dhe në formë të shtypur përmes së përkohshmes *Occupational Outlook Quarterly* (Washington: Government Printing Office, 1957 e tej, çerekshe). Kjo e përkohshme përmban informacione mbi trendet dhe mundësitë e punësimit.

Occupational Outlook është në shoqëri me kompani të tjera të dobishme të shtypit. Në mesin e tyre: (1) *US Dictionary of Occupational Titles* (Washington: Government Printing Office, data të ndryshme), që regjistron të gjitha karrierat legjitime të punës që i njeh qeveria. Kjo është sa një mjet i kujtesës sa dhe një rikujtim se ka me mijëra profesione pos

atyre të pilotëve dhe modelimit; (2) *Gale's Career Advisor Series* (Farmington, MI: Gale Group, data të ndryshme) është një komplet librash në gjashtë vëllime, i cili plotësohet shpesh. Secili vëllim përmban një përshkrim të plotë të punës, si dhe mënyrën se si të përgatiteni për një profesion. Pos kësaj, ai ofron këshilla të mira lidhur me intervistimin, rezymenë, e të ngjashme. Kjo seri është po aq e dobishme edhe për nxënësit e shkollave të mesme dhe studentë universitarë që janë në kërkim të një karriere. *Gale's Career Advisor Series* në CD-ROM inkorporon edhe *Occupational Outlook Handbook* dhe seritë e shtypura, siç janë: *DISCovering Careers & Jobs*, ka pjesën më të madhe të informacionit të domosdoshëm, si dhe një këshillë specifike lidhur me karrierat dhe profesionet që tërheqin studentët. Një meny e ngjashme i mundëson shfrytëzuesit të *DISCovering* që të kërkojë për ndonjë karrierë sipas temës, do të thotë "kategoria e karrierës"; sipas punësuesit, me 30 000 firma në prekje të gishtërinjve të përdoruesit; dhe sipas titullit të vendit të punës, që nga bibliotekari deri te mekaniku. Literatura aktuale ofron informacion nga afro 1 000 artikuj, me rezymime dhe tekste të plota.

So You Want to Get a Career është një web-sajt komercial që fton studentët e vitit të fundit të shkollave të mesme dhe ata të kolegjit të kërkojnë në *Princeton Review Guide to Your Career* sipas karrierës. Ka disa qindra zgjedhje me mesatarisht tri deri në katër faqe të shtypura. Secila prej tyre mbulon: jetën e përditshme, kërkesat arsimore, si dhe pozitën e ardhshme për dy, pesë apo dhjetë vjet edukimi. Rëndom ka një profil të dobishëm të kërkesave themelore, d.m.th. për *bibliotekarin* kjo përfshin numrin e njerëzve në këtë profesion (141 000), përqindjen e meshkujve dhe femrave, 35% dhe 65%, rrogën mesatare shartuese etj. Ka, po ashtu edhe disa tituj filmash, librash dhe emisionesh televizive, në të cilat bibliotekarët paraqiten si personazhe. Shoqatat e mëdha dhe punëdhënësit përmbyllin skicën. Të dhënat janë aktuale dhe të besueshme.

Vende pune në Web

Përtej informacionit në prapavijë lidhur me karrierën qëndron pyetja e vërtetë se ku mund të gjendet një vend i vërtetë pune. Këtu shkëlqen rrjeti botëror i Ueb-it (World Wide Web – ose www.) Ai mund të mos u jap një vend pune, por ai pa dyshim u jep mundësinë të gjurmoni fushën e gjerë të mundësive në çdo ditë të vitit. Letralisht, ka dhjetëra shërbime të tilla Online, por dy më të mirat, sidomos për bibliotekarët, janë:

CareerPath (www.careerpath.com). Reklamime të klasifikuara të vendeve të punës prej dhjetëra gazetash kryesore të vendit. (Nga *New York Times* deri tek *Sacramento Bee*) ofrojnë pasqyra të drejtpërdrejta se çka është në dispozicion, si dhe shkallën e pagës. Afro 100 000 shpallje janë të paraqitura, të cilat mbulojnë të gjitha, prej pozicioneve të larta profesionale deri te vendet e shërbimeve nëpër zyra ose në restorante. Është lehtë për t'u përdorur dhe hulumtimi mund të bëhet në bazë të punës së dëshiruar, regjionit, apo fjalëve kyçe. Ju mund të zgjidhni një fushë të gjerë, si për shembull ligji dhe të shfletoni në atë që është në dispozicion në tërë Shtetet e Bashkuara ose thjesht të fokusoheni në rajone të ngushta. Karakteristika të tjera janë edhe këshillimi lidhur me përgatitjen e rezymeve, metodat e intervistimit, statistikat e punësimit etj. Fatkeqësisht, nuk ka asnjë e-mail adresë për punësuesit e mundshëm, por janë numrat e telefonave dhe të postës së tyre.

The Monster Board (www.monster.com) regjistron afro 397 000 vende pune të futura aty nga punësues individualë, jo nga gazetat. Kjo ngushton fushën, por në disa mënyra ka përparësinë e të qenit më specifik, veçanërisht në kuptim të asaj se kush është duke bërë punësimin. Kërkimi është relativisht i lehtë dhe mundëson kërkesat në bazë të rajonit, nivelin e përvojës (prej fillestarit deri te eksperti) dhe karakteristika të tjera, siç është mundësia për punësim jashtë Shteteve të Bashkuara. Shih, gjithashtu, gjëra të tilla, si profilet e punëdhënësit dhe të kompanisë, grupet e diskutimit dhe studimit, si dhe regjistrimit, që i japin mundësi përdoruesit të kërkojë për talentin e vet me rastin e hapjes së një vendi të punës.

Interneti ka afro 30 000 borde pune, të ngjashme në qëllimin e tyre, nëse jo në gjerësi, në *Monster Board*. Shumica janë shumë të specializuara, d.m.th., të orientuara në profesione apo fusha të caktuara, si Accounting.com apo Utah-Jobs.com. Këto faqe ofrojnë më shumë se regjistrime. Disa, përfshirë edhe *Monster Board*, kanë rezyme individuale, të cilat mund t'i dërgohen punëdhënësit. Kërkuesit e punës mund zakonisht të aplikojnë për disa vende pune, duke shtypur pullën, e cila dërgon menjëherë rezymetë e tyre te punëdhënësit e ardhshëm. Disa shërbime të tjera faktikisht administrojnë testet e punësimit Online për t'i ndihmuar punëdhënësit.

Pavarësisht të gjitha këtyre, shpalljet për vende pune në gazeta vazhdojnë të lulëzojnë, sepse këto mëtojnë të jenë lokale dhe, ç'është me e rëndë-

sishme, jo gjithë numri i punëkërkuesve janë të informuar se çka është e gatshme në Online – një fakt ky që mund të përmirësohet deri diku nga bibliotekat.

Në një renditje të përdorimit relativ (që nga mesi i vitit 2000), *Monster Board* është më i popullarizuari, pasuar nga: *Jobsonline.com; Careerpath.com; Headhunter.net; HotJobs.com; Careerbuilder.com; Jobs.com; Dice.com*. Të gjitha janë faqe me vlerë për hulumtim për bibliotekarët që punojnë në këtë fushë. (Të gjitha URL-të të paraprira me www., si p.sh., www.jobsonline.com).

Me gjithë këtë ndihmë që ofrohet nga Online, vendi më i vetëm dhe më i mirë për të gjetur punë në një komunitet janë shpalljet në Online lokale dhe në gazetë të shtypur. "Për një vëllim të plotë të vendeve të punës, web-sajti e gazetës suaj lokale është më i mirë se çdo 'sajt' kombëtar për të gjetur vende të reja të punës në rajonin tuaj".[16] Këtu, "lokale" duhet të interpretohet së pari sipas komunitetit, e pastaj sipas shtetit dhe së fundi sipas rajonit.

Citatet

Online: Familiar Quotations. Nju Jork: Columbia University Press, 1997 e deri më sot, i parregullt, www.bartleby.com/100/. Pa pagesë.

Bartlett's Familiar Quotations, 16th ed. Boston: Little, Brown and Company, 1996 deri më sot, e përvjetshme. Në Microsoft Bookshelf. *Shtypi*:16th ed. 1992, 1.405 f. $49.

*CD: The Oxford Dictionary of Quotations,*5th ed. New York: Oxford University Press, 1999. $40.
Shtypi: 5th ed.1999, 1.061 f. $45.

Shtypi: Chambers Dictionary of Quotations. New York: Larousse, 1997. 1.527 f. $40.

Online: Gale's Quotations: *Who Said What* (Kush tha çka). Farmington Hills, MI: Gale
Group, 1994, www.gale.com, pa plotësime. $400.

[16] Yahoo! Internet Life, maj, 1998, f. 121. Shih edhe. "Career Sites", The New York Times, 4 tetor, 1999, f. C5.

Citatet janë të dashura nga çdonjëri dhe ato mund të dalin gjithkund. Ato mund të shërbejnë për të hedhur kripë në çdo fjalim të pas darkës, të shkaktojnë të qeshura në ndonjë emision të vonë televiziv, ose për ndonjë shkëlqim në letërsi. Është e vërtetë se dashuria për citime është duke u zhdukur. Ç'është dhe më keq, citimi mund të jetë i rrezikshëm, sepse kohëve të fundit pakkush e di se folësi apo autori është duke cituar dikë. Prapëseprapë, të vazhdojmë me citime.

Në qoftë se dëshirojmë të gjejmë burimin e saktë të një citimi, është e domosdoshme të kërkojmë në një libër citatesh. Bibliotekari mund të shpresojë: (1) që citimi ishte i vërtetë dhe jo citim i shpikur apo që është ndryshuar nga kërkuesi; (2) që fjalët janë të përafërta, nëse jo me saktësi, atëherë korrekte; (3) dhe që aktorët parësorë të involvuar në citim janë emëruar si duhet.

Një libër i mirë citimesh do ta tregojë burimin, zakonisht një vepër e shtypur. Në mungesë të një burimi, ngelim në mëdyshje, veçanërisht kur kemi të bëjmë me ndonjë pyetje se kush ka thënë "ti miu i ndytë", ose "syçelësia e përjetshme është çmimi i lirisë".

Përpos standardeve, citateve të përgjithshme të titujve, ka prej 250 deri në 300 libra të specializuara citatesh. Normalisht, këto kufizohen në një fushë të caktuar tematike, siç janë citate për dentistë apo mjekë, mësues, ose, po, bibliotekarë etj. Disa prej këtyre mund të kalojnë, por ka edhe disa që vërtetë e meritojnë. Ja një shembull i shkëlqyer: *African American Quotations*, (Phoenix, AZ: Oryx, 1998).

Si bëhet një frazë apo disa fjali citime të paharrueshme? Ka dy apo tri rregulla që udhëheqin hartuesit. Së pari, nëse është e njohur dhe e paharrueshme, citimi përfshihet në mënyrë automatike. Thënia e Shekspirit, "Ç'do të thotë një emër? Ai që ne e quajmë trëndafil me ndonjë emër tjetër do të kishte shijen e ëmbël", gjendet në shumicën e librave të citateve. Së dyti, citimi mund të pasqyrojë ndjenjat dhe qëndrimin aktual. Së treti, ai mund të shërbejë për ta ilustruar një gjë lidhur me moralin, mençurinë e kështu me radhë.

Derisa të dy rregullat e para janë të aplikueshme në gati të gjitha veprat, e treta duhet të mos harrohet gjithashtu. Për shembull, fjalët e fundit të gjeneralit të Luftës Civile, John Sedgwick, do t'i përshtatej mirë një libri të citateve të fjalëve të fundit apo të humorit 'të zi', por jo një libri që përshkruan zotësitë e gjeneralëve. Ky citat është me gjasë komenti i fundit i gjeneralit, kur ngriti kokën mbi parapet në Betejën e Egërsisë:

"Nonsens, nuk do të mund të godisnin as një elefant në këtë dist...".

Bibliotekarët dhe lexuesit që duan të kursejnë kohë dhe frustrim u kthehen librave të shtypur të citateve. Lehtë për t'u përdorur, lehtë për t'u kuptuar, burimi i shkruar i citateve përdoret pa ndonjë ndërmjetës kompjuterik.

Një rregull profesional: së pari duhet të shfletoni *Bartlett-in* apo *Oxford-in*, pastaj një vijë dytësore në libra, si *Chambers.* Nëse këto dështojnë, atëherë mund t'i ktheheni burimit elektronik *Gale's Quotations.* Nëse nuk e gjeni as aty, atëherë këtu fillon kënaqësia e vërtetë. Atëherë duhet të kërkoni, libër pas libri, të çdo titulli në bibliotekë. (Natyrisht, duhet përjashtuar të gjitha ato që janë kooptuar në bazën e të dhënave Gale).

Bartlett's Familiar Quotations është më e njohura në botë. Është më e vjetra. Hartuar nga një librar, John Bartlett, në vitin 1855, burimisht përmbante citate nga 169 autorë. Edicioni i tashëm ka mbi 2 500 autorë me mbi 20 000 citime të renditura kronologjikisht. (Citati i parë është nga Kënga Egjiptiane e Harfës, nga 2 600 p.k.. E fundit, në mënyrë mjaft të përshtatshme, është nga një proverb 'anonim' spanjoll). E lehtë për t'u përdorur, pothuajse një e treta e vëllimit është dhënë në një indeks të detajuar.

Duhet t'i shmangeni versionit pa pagesë në Internet të *Bartlett-it.*[17] Ndonëse i sponsorizuar nga Universiteti i Kolumbias, kjo është një bjerrje kohe. Ai ka vetëm afro 12 000 citate, asnjë prej të cilave nuk është pas vitit 1919. Kolumbia mbështetet në edicionin e nëntë (1901) dhe të dhjetë (1919). Kjo është plotësisht e pavlerë pa asnjë shënim pas vitit 1919.

The Oxford Dictionary of Quotations është një libër i popullarizuar që gjendet në shumë biblioteka. Edicioni i pestë paraqet një revidim substancial. Sipas parathënies së shkruar me admirim, përzgjedhja mbështetet në atë që është e njohur për shumicën e njerëzve dhe, në këtë rast, derisa

[17] Nuk ka libër të kënaqshëm pa pagesë në Internet të citateve të përgjithshme, përkundër faktit se Bartleti shpesh konsiderohet si burim i dobishëm në web. Madje, edhe një kopje e dorës së dytë e edicionit të shtypur të shek. XX e Barteltit është më e mirë. Nga ana tjetër, për citime të specializuara, interneti është i dobishëm. Shih, për shembull, Mother of All Quotes (Nëna e të gjitha citateve) (http://users.com/dboger/html/movies.html). Pop kulturë në shkallë të lartë, kjo konsiston nga citate që janë nxjerrë nga televizioni, filmat, kongreset, fjalime presidenciale dhe nga kudo ku ka dalë ndonjë citat që e vlen të njihet. Renditja, drejtshkrimi, vetë citatet mund të jenë të tmerrshme, por ky është një sajt i dobishëm për të gjetur mesazhe që vështirë gjenden në media.

paragjykimi është britanik, shumica prej 17 000 citateve (nga 2 000 burra e gra), paraqet një ton të dukshëm ndërkombëtar dhe është po aq i njohur te amerikanët e arsimuar. Edhe këtu, "fjalët e famshme të fundit" (që nga Mbreti Xhorxh V deri te vrasësi i shpallur Garry Gilmore, i cili përshpejtoi rënien e tij me fjalët "t'i japim fund"). Edicioni në CD-ROM përfshin *The Oxford Dictionary of Modern Quotations* (1984, f. 384, $45). Kjo e fundit ka 6 000 përzgjedhje nga figurat e shekullit XX.

Një shtojcë e dobishme (dikush do ta quante zëvendësim) e *Oxford Dictionary of Quotations* është *Chambers Dictionary.* Fokusimi këtu është në personalitete angleze dhe evropiane e botërore, me citatet e renditura sipas alfabetit, në bazë të emrit individual (dhe me secilën pjesë kronologjikisht). Krahasimet tregojnë se *Chambers* mëton të ketë më shumë citate nga figura të njohura nga ato që gjenden në *Oxford.* Një shfletim i rastit do të dëshmojë për më shumë autorë modernë nga pjesë të ndryshme të rruzullit. Natyrisht, me kohë, *Oxford* dhe të gjithë rivalët e tij do të inkorporojnë shumicën e personazheve në edicionet e tyre të ardhshme. *Chambers* vë në pah nevojën që bibliotekarët të kenë burime sa më aktuale, sa dhe standarde historike të citateve, aq sa u lejon buxheti dhe hapësira.

The Oxford Dictionary of Literary Quotations (Oxford: Oxford University Press, 1997, f. 479, $30.), është një shembull i librave të citimit tematik. Në dy pjesë, pjesa e parë përbëhet nga afro 3 500 citate që kanë të bëjnë me letërsinë në përgjithësi (nga blloku i shkrimtarit deri te kanonet). Pjesa e dytë janë citate nga afro 600 autorë, britanikë dhe të huaj, aranzhuar alfabetikisht nga Kingsley Amis deri te Yeats. Theksi është kryesisht mbi shkrimtarët anglishtfolës që nga Çoseri deri te ditët tona. Nën 'origjinalitete', për shembull, është edhe citati i famshëm i Sam Goldwyn-it: "Të bëjmë sa më shumë klishe".

Nëse gjendet në dispozicion në Online në bibliotekë vendi më i mirë për citate dhe vendi i parë ku duhet shikuar është *Gale's Quotations,* që ka mbi 117 000 citate të rëndomta, të nxjerra kryesisht nga burime me të drejta autoriale. Rëndom, të paktën për shkak të numrit të citateve, ajo që na duhet mund të gjendet këtu.

Gale's Quotations mund të kërkohet, siç do të mund të pritej, sipas emrit të autorit apo folësit, sipas një fjale apo fraze kyçe dhe sipas vitit të origjinës së citatit. Ky tipar i fundit është i dobishëm kur dikush citohet në gjerësi, siç janë presidentët dhe personalitetet amerikane; por pasi që numri i njerëzve të tillë është i vogël, atëherë kjo ka pak vlerë praktike.

Është një gjë të kufizoheni në kërkim të fjalëve të Xhon F. Kenedit e tjetër ta përdorni atë për Shekspirin, Biblën, apo për dr. Xhonsonin, kur shumica e përdoruesve nuk kanë as idenë më të vogël të viteve të involvuara.

Pse nuk ka një bazë gjigante të të dhënave Online? Përgjigja: Çdo libër citatesh me të drejtë autoriale vjen nga një botues tjetër. Secili përfaqëson punën e një hartuesi apo ekipi të ndryshëm hartimi. Secili dëshiron të jetë i paguar. Secili beson se një dasmë elektronike me 100 apo 1 000 libra të tjerë citatesh, do t'i mohonte të ardhurat potenciale. Ai do t'i ikte kësaj duke përdorur tituj që u kanë dalë të drejtat autoriale, siç ka bërë Gale, por kjo do t'i eliminonte fjalët magjike të pesëdhjetë vjetëve të mëparshëm. Përfundimisht, problemi i të drejtave autoriale do të zgjidhet, por deri atëherë kemi *Gale*-in, i cili është ta paktën, fillim impresiv.

KËSHILLË DHE INFORMACION

Një çështje e përbashkët në shërbimin e referencës është që të jepet informacion, të jepen këshilla dhe se kur të jepen. Normalisht, theksi është mbi informacionin, jo këshilla. Dallimi është me rëndësi, nga që këshilla dhe informacioni përzihen sa herë që ndihma në mjekësi, gjyqësi, apo konsum kërkohet nga ndonjë laik. Shumica e bibliotekarëve janë të gatshëm të ofrojnë të dhëna konsumuese, madje edhe këshillë (siç mendon ky autor se këshilla duhet dhënë edhe për libra të referencës dhe materiale përkatëse), por disa hamenden në ofrimin e të dhënave mbi mjekësinë dhe gjyqësinë.

Nuk ka arsye që të mos jepen informacione lidhur me gjyqësinë apo mjekësinë. Kjo nuk do të thotë se bibliotekari është duke ofruar udhëzime. Trendi i sotshëm është që t'i mirëpresë pyetjet legale dhe mjekësore. Prapëseprapë, dyshimet mund të paraqiten:

1. "Mendoj se jam duke ushtruar gjyqësinë (mjekësinë) pa licencë". Nuk ka bibliotekë që është emëruar ndonjëherë mbrojtëse në ndonjë proces gjyqësor mbi këtë bazë. Natyrisht, bibliotekari nuk duhet të përpiqet të diagnostifikojë situatën apo të ofrojë trajtim (legal apo mjekësor), por thjesht sjell informacionin e kërkuar, pa marrë parasysh në ç'masë dhe në ç'formë.

2. "Nuk di shumë për gjyqësinë (mjekësinë) për ta gjetur informacionin e kërkuar". Ka shumë libra, artikuj, pamflete dhe shirita televizivë

dhe të radios që janë në dispozicion për një laik. Këto janë të pasqyruara në shumicën e mediave standarde të referencës. Për më tepër, si dhe për çdo fushë tematike, bibliotekari mund të njoftohet shpejt me mënyrat se si të vlerësohet një titull për besueshmëri, aktualitet, apo stil të të shkruarit.

Në saje të mijëra web-sajteve mjekësore, e tërë kjo është akademike. Njerëzit në të vërtetë nuk çajnë kokën për brengat e mundshme etike të bibliotekarit. Dhe, nëse bibliotekari nuk i ndihmon, atëherë ata do t'i kthehen vetë Internetit.

Pjesët që pasojnë, mbi mjekësinë, gjyqësinë dhe këshillimin konsumator, vënë në pah problemet e veçanta dhe veprat e referencës. Është punë me mend të mos harrojmë se shumë pyetje themelore gjyqësore apo mjekësore mund të kenë përgjigje gjithashtu përmes konsultimit të indekseve themelore të të përkohshmeve.

Shëndetësia dhe mjekësia

MEDLINE. Shih Kapitullin 6.[18]

Online: Mayo Health Oasis. Minneapolis, MN: IVI Publishing Inc. 1997 e tej, e përditshme, www.mayohealth.org. Pa pagesë.
CD: Mayo Clinic Family Health Book, 1993 e tej. $69.95- $99.95.
Shtypi: New York: William Morrow, 1900. $34.95.

Online: Scientific American Medicine. New York: Scientifc American, 1990 e tej, mujore, www.samed.com. Pa pagesë.
CD: Scientific American Medicine on CD-ROM. 1900 e tej, çerekshe, $645 (CD individuale, $395).
Shtypi: Scientific American Medicine. 1978 e tej, e kohëpaskohshme, www.cpmcnet.columbia.edu/texts/guide. Pa pagesë.

Online: The Merck Manual of Diagnosis and Therapy. Rahway, NJ: Merck and Company, 1996 e tej, www.merck.com. Pa pagesë.
CD: The Merck Manual in Physician's Desk Reference Library on CD-ROM. 1990 e tej, çerekshe. Çmimi ndryshon.
Shtypi: The Merck Manual of Diagnosis and Therapy. 1899 e tej. $45;

[18] Për çdo çështje të thelluar mjekësore, bibliotekisti duhet të konsultojë indeksin MEDLINE dhe konfiguracionet e tij të ndryshme. Ajo që është regjistruar këtu janë më shumë ndihmës pak a shumë të përgjithësuar.

letër, $24.

Online: PDR Net. Montvale, NJ: Medical Economics Company, 1999 e deri më sot, e kohëpaskohshme, www.pdr.net. Pa pagesë.
CD: Physician's Desk Reference Electronic Library, 1990 e tej, çerekshe, $595-$895.
Shtyp: PDR/Physicians' Desk Reference Pharmaceutical Specialities and Biologicals. 1947 e tej, vjetore. $82.95.

Vizitoni çfarëdo biblioteke të madhe lokale. Shkoni te sektori i mjekësisë/shëndetësisë. Do të gjeni qindra tituj për laikë të renditur sipas grupimit "të përgjithshme" dhe pastaj sipas çdo problemi të mundshëm që nga puçrrat e fytyrës deri te ksenofobia. Në Internet, sasia e informacionit shëndetësor është dërrmues. Vëllimi i madh i të dhënave është indikacion për interesimin e madh për çështje shëndetësore.

Bibliotekat ndjekin pothuajse të njëjtën mostër, të paktën më sa lejon buxheti i librit. Nuk ka vend në rafte për libra të rastësishme mjekësorë apo shëndetësorë. Ky fakt duke publikuar me të madhe. Biblioteka është një filtër i paçmueshëm që heq brengat e një laiku nëse një burim X apo Y është i besueshëm apo jo – një konsiderim ky madhor për këdo që ka një pyetje mjekësore. Filtri i blerjes i jep bibliotekës një përparësi të dukshme kundruall edhe ekspozitave më të mira librare, ku çdo gjë që është në shtyp është në dispozicion.

Bibliotekari duhet të jetë i skrupulltë lidhur me burimet e blera të referencës mjekësore dhe të dhënies së informacionit në Ueb. Përdoruesi duhet të jetë në gjendje të kuptojë librat (web-sajtet) që kanë të bëjnë me informacionin mbi shëndetin e konsumatorit. Kjo mund të sigurohet përmes: (1) blerjes së librave të shkruara për laikë; (2) blerjes apo ofrimit të qasjes në Ueb të informacioni teknik, që nuk është përtej të kuptuarit nga njerëz më të arsimuar apo laikë më pak të involvuar.[19] Intervista e referencës duhet të na sigurojë saktësisht se çfarë informacioni kërkohet dhe në ç'nivel sofistifikimi është. Shumë bibliotekarë e ndjejnë veten paksa të

[19] Nuk ka mungesë gidash lidhur me librat më të mirë të mjekësisë. Që të gjitha vështrimet standarde, që nga Library Journal to Choice, kanë pjesë mbi problemet shëndetësore-mjekësore. Shih, po ashtu: Doody's Rating Service: A Buyer's Guide to the Best Health Science Books (New York: Doody, 1996 e tej, e përvjetshme), është një përmbledhje e opnioneve nxjerrë nga vështrime, kritika dhe botues lidhur me librat më të mirë të mjekësisë për laikë. Secili titull është dhënë i shkurtuar dhe përzgjedhja është e besueshme.

druajtur nga që mendojnë se informacioni që ata kërkojnë është më shumë personal nga ç'duhet. Pastaj, ka gjithashtu edhe probleme të tjera që kalojnë nga ofrimi i "lajmeve të këqija" lidhur me ndonjë sëmundje të caktuar për përdoruesin që mëton të flasë sa më shumë lidhur me një hall personal. Megjithëkëtë, bibliotekari është moralisht i obliguar të qëndrojë objektiv, të japë informacionin përkatës dhe të përmbahet nga paragjykimet qoftë lidhur me klientin apo këshillën që ofrohet në një burim të caktuar.

Fjalorët

Përpos vëllimit të shënuar në fillim të kësaj pjese, si i përshtatshëm për bibliotekën, ka një numër fjalorësh standardë mjekësorë; mes tyre më i shpeshti që haset nëpër biblioteka është *Dorland's Illustrated Medical Dictionary* (Philadelphia: W. B. Saunders Co., 1900 e tej). I reviduar shpesh, kjo është vepër e mbi 80 konsultuesve, të cilët përpunojnë të gjitha njësitë, si dhe ilustrimet e shumta. *Stedman's Medical Dictionary* (Baltimore: William & Wilkins: 1911 e tej), është një vepër tjetër e reviduar shpesh, që ka disa nga njësitë më të reja.[20]

Indekset

Këtu është vendi i duhur për t'i rikujtuar indekset e shkëlqyer mjekësorë që janë diskutuar në këtë kapitull lidhur me indekset tematikë. Në veçanti, bibliotekari i referencës do të dëshirojë të ftojë MEDLINE të Bibliotekës Kombëtare të Mjekësisë për kërkime të sofistikuara dhe për tema që nuk janë mbuluar në thellësi në burimet standarde të referencës. *PubMed* (www.ncbi.nim.nih.gov/PubMed) përfshin dhe MEDLINE.

Interneti

Spitalet, shkollat e mjekësisë dhe entet komerciale shëndetësore (si dhe individët që mund apo nuk mund t'u besohet) po u drejtohen laikëve përmes Internetit. Derisa pjesa më e madhe e informacionit Online është i besueshëm, e njëjta rregull vlen edhe vlerësimin e këtyre 'sajteve' siç

[20] Stedman's mund të gjendet me një çmim prej $69-99, në CD-ROM nga botuesi i versionit të shtypur. Ai përmban afro 85 000 definime nga Merriam-Websters Tenth New Collegiate Dictionary. Ai përditësohet sipas 'nevojës', por nuk ka ndonjë përparësi të veçantë kundruall versionit të shtypur.

aplikohet te çdo vepër e referencës. Nganjëherë burimi dështon, p.sh., sipas një studimi të afro 400 faqeve të Ueb-it, është zbuluar se të paktën gjashtë për qind përmbanin informacion të gabuar dhe gati një e treta e tyre nuk i ishin nënshtruar ndonjë kontrollimi. Në të gjitha rastet ku ofrohet vetëm ndonjë këshillë e vogël, doktorët paralajmërojnë pacientët që të bisedojnë me ta. "Kushdo është në gjendje të fusë informacion në Internet lidhur me çfarëdo gjendjeje shëndetësore", dhe kjo mund të jetë apo të mos jetë e besueshme.[21]

Mayo

Mayo Health Oasis në Internet është një kombinim e asaj që gjendet në formë të shtypur, *Health Book* dhe artikujve aktualë të revistave, si dhe materialeve të tjera të sponsorizuara nga Mayo. Ky web-sajt ka mbi dhjetë punëtorë editorialë me orar të plotë, të cilët botojnë lajme ditore mjekësore. Tre mjekë bëjnë vështrimin e secilit artikull dhe kjo ofron këshillim teknik dhe mjekësor për ata që nuk janë në gjendje të vizitohen në klinika – me afro 40 000 vizitues në muaj. Ky 'sajt' mbulon pothuajse të gjitha temat shëndetësore me interes për individë mesatarë. "Newsstand" përmban tekstin e plotë të artikujve aktualë. "Resources" mbulon materialet nga *Mayo Clinic Health Letter,* termat mjekësore, përkujdesjen ndaj fëmijëve etj. Një tipar karakteristik: ka një pjesë të pyetje/përgjigjeve që fton lexuesit për të shtruar pyetjet e tyre.

Esencialisht, kjo mund të kërkohet përmes shkaqeve, simptomave dhe trajtimit, si dhe sipas titujve të gjerë tematikë (dieta dhe të ushqyerit; qendra e sëmundjeve të zemrës, shtatzënia dhe fëmijët etj.). Ka një bazë të madhe mjekësore, me më se 8 000 ilaçe me receta dhe pa to, bashkë me materiale të ngjashme që gjenden në PDR. Efektet përshkruhen në mënyrë të qartë. Sipas këtij 'sajti', ka më shumë se 1.5 milionë vizitues në secilin muaj.

Ndonëse i mungojnë plotësimet ditore, versionet e shtypura dhe në CD-ROM kanë përparësi definitive. CD-ROM-i ka shtuar kënaqësinë edhe me 500 ilustrime në ngjyra, 45 animacione dhe pothuajse dy orë audio materiale. Pyetjet mund të gjejnë përgjigje duke përdorur fjalët dhe frazat kyçe, si dhe sipas logjikës Booleane. Teksti është i qartë dhe i saktë.

[21] "Informacioni mjekësor në Internet nuk kalon testing e besueshmërisë", The New York Times, 3 gusht 1999, f. G2. Shih, po ashtu: "Rreziqet për shëndetin nga mjekësia e tastaturës". Ibid, 31 gusht 1999, f. F1, F6.

Për ata që kanë kohë më shumë, ka meny të rëndomta dhe fusha të gjera të diskutimit: përkujdesja bashkëkohore mjekësore, sëmundjet njerëzore, ciklet jetësore, bota përreth nesh dhe mbajtja e kondicionit. Pjesa e përkujdesjes mjekësore jep këshilla diagnostike, përkujdesjeje dhe trajtimi. Medikamentet gjenerike dhe emrat e firmave janë të mbuluara, bashkë me një atlas të shkëlqyer të trupit të njeriut. Një tipar i jashtëzakonshëm është një lloj ndër-reference në formë të ndarjeve anësore që i referohen lexuesit për të paralelizuar temat e interesimit. Mbi të gjitha, ky është një CD-ROM e dorës së parë për çdo bibliotekë dhe, madje, edhe për shumë shtëpi.

Versioni i shtypur i titullit të Mayo-s, është pothuajse identik nga përmbajtja, si dhe në CD-ROM. Ndonëse atij i mungon animacioni dhe zëri, ai e kompenson këtë me çmimin e ulët dhe lehtësinë e përdorimit. Po ashtu, ilustrimet janë paksa më mirë të definuara sesa ato në monitorin kompjuterik.[22]

Scientific American

Në CD-ROM, në formë të shtypur, apo në Internet, shërbimi *Scientific American Medicine* është pothuajse i njëjtë. Dallimi i vetëm i vërtetë është mundësia për të kërkuar me shpejtësi në formën elektronike, ndonëse ndër-referencat dhe indeksimi në versionin e shtypur janë po aq të mira.

Scientific American Medicine, me fletë të palidhura, freskohet çdo muaj, duke e bërë atë një nga shërbimet më aktuale të referencës së gatshme të shëndetësisë. (Versioni Online është me një itinerar të tillë. CD-ROM del vetëm njëherë në katër muaj). Përgatitur dhe hartuar nga kërkues dhe doktorë mjekësie, ky shërbim është i ndarë në 15 pjesë, që nga dermatologjia deri te reumatologjia. Brenda secilës pjesë gjejmë ilustrime, harta, tabela dhe grafike të tjera, që shpjegojnë detajet e kohë-pakohëshme teknike. Stili i të shkruarit është përgjithësisht i lehtë për ta ndjekur, ndonëse parasupozon një lexues që është student kolegji, apo i barabartë me të.

Kolumbia

Një nga sajtet më të mira të mjekësisë në Internet është *Columbia*

[22] Mayo Clinic është një pjesë në web-sajtin Mayo. Aty ka një sfond të klinikës së famshme botërore.

University Complete Home Medical Guide. Më e mira ngaqë ofron, virtualisht, të tërë përmbajtjen e vëllimit të shtypur dhe jo vetëm pjesë e pjesëza. Më e mira ngaqë mbulon ankesat më të shpeshta në një gjuhë që kuptohet lehtë. Më e mira për shkak të ilustrimeve, të pakta, por të shkëlqyera. Dhe, më e mira, ngaqë është lehtë të navigohet – dhe është pa pagesë.

Këto gide të përgjithshme janë vetëm shembuj. Ka së paku disa vepra të tjera që janë, po aq të mira apo të shkëlqyera në një fushë të caktuar. Bibliotekari i referencës do ta ruajë aktualitetin e koleksionit, duke shtuar titujt e rekomanduar juridikisht (p.sh., ato që kanë pasur vlerësime të favorshme në *Choice*, *Library Journal*, *Booklist*, etj.). Dy shembuj: *John Hopkins Family Health Book* (New York: Harper Resource, 1999, f. 1.689, $50), i renditur i pari ndër spitale nga *US News & World Report* (1999). *The Gale Encyclopedia of Medicine* (Farmington Hills, MI: Gale Group, 1999, 5 vëll., $499), ka përparësinë e të qenit më gjithëpërfshirës nga gide të tjera të përgjithshme dhe të metën e të qenit afro dhjetë herë më i shtrenjtë. *The Harvard Medical School Family Health Guide* (New York: Simon & Schuster, 1999, 1.192 f., $40), është relativisht unike nga që lidh tekstin e printuar me web-sajten e shkollës. Po ashtu, ndonëse përmbajtja e saj është gati e njëjtë me atë që gjendet në gidat e tjera, shumë artikuj kanë më shumë thellësi dhe mund të gjenden dhe të përdoren më lehtë.

Herët a vonë, dhe më mirë herët sesa vonë, për ata që duan të kenë jetë të gjatë, doktori tund kokën dhe sugjeron një test mjekësor, "vetëm sa për të parë nëse ky problem është me rëndësi". Ah, por çfarë involvon testi? A do të dëshmojë se jam nisur drejt vdekjes? Përgjigja rëndom gjendet në *Yale University School of Medicine Patient's Guide to Medical Tests* (New York: Houghton, 1997, 620 f., $40). Me nëntitullin "përshkrime të hollësishme të procedurave më të zakonshme të diagnostifikimit", ai ka 29 kapituj që flasin për çdo test të mundshëm në detaje. Aty janë përfshirë detaje të plota, bashkë me vizatime anatomike dhe peshën e dhembjes së involvuar.

Manuali Merck

Një vepër shumë e përdorur teknike, ndonëse e përshtatshme për situata të caktuara bibliotekare, është *Marck Manual of Diagnosis and Therapy.* E botuar për shumë vjet si manual për mjekë, kjo vepër është e kuptueshme për laikë me një fjalor mjekësie në dorë. Sëmundjet dhe lëngatat janë për-

shkruar në një gjuhë relativisht teknike, janë dhënë simptomat dhe shenjat dhe janë sugjeruar diagnozat dhe trajtimet. I plotësuar në çdo pesë vjet, edicioni i shtatëmbëdhjetë i vitit 1999 përfshin tema të shumta të reja që nga edicioni i gjashtëmbëdhjetë i vitit 1992: terapinë e medikamenteve për më të moshuarit, problemet me ndërprerjen e pirjes së duhanit, sindromën e lodhjes kronike etj.

Versioni në Internet, është më rëndësi të vihet në pah, mëton të jetë më shumë se një reklamim i edicioneve të shtypura dhe në CD-ROM. Manuali i Ueb-it është dy a më shumë vjet i vjetër dhe, ndonëse ende i dobishëm, nuk është vendi më i mirë për të kërkuar informacion tjetër pos atij të përgjithshëm.

Duke kërkuar një auditor më të gjerë, Merck botoi në vitin 1998, një version të shkurtuar, të rishkruar, të manualit të rregullt, *The Merck Manual of Medical Information, Home Edition.* Ky mbulon një pjesë të materialit të njëjtë, si dhe vepra më e gjerë, por është shkurtuar për lexuesin laik. Të 24 pjesët shqyrtojnë çdo problem të mundshëm dhe janë të shkruara në terma që kuptohen lehtë. Një indeks i mirë dhe karakteristika të tjera të shumta e bëjnë këtë një artikull të kërkuar në shumicën e bibliotekave, ndonëse ai assesi nuk mund ta zëvendësojë origjinalin më të detajuar të *Merck Manual.* (Gjendet në dispozicion edhe në CD-ROM, nga McGraw-Hill për $40), por me animacion, audio dhe afro 1 800 shqiptime të termave mjekësore).

PDR

Vepra më e njohur dhe që më së shpeshti përdoret si vepër farmakologjike në biblioteka është *Physicians' Desk Reference*. Zakonisht kësaj vepre, njerëzit i referohen shkurt si *PDR*. Kjo vepër ofron informacione për rreth 4 000 medikamente, sipas emrit të produktit dhe emrit të prodhuesit. Botuesi thekson se "informacionet janë dhënë nga prodhuesit e vet këtyre medikamenteve". Në të njëjtën kohë, Administrata e Ushqimit dhe e Medikamenteve ka aprovuar materialin e dërguar nga prodhuesit. Edhe dikush që ka pak përvojë, mund lehtë ta kontrollojë përmbajtjen e këtij apo atij medikamenti. (Indeksi i emrit kimik dhe atij të përgjithshëm është një mjet mjaft i dobishëm kërkues). Për secilin medikament jepet kompozicioni i tij, e po ashtu edhe të dhënat e tjera si p.sh. efektet anësore që mund të ketë medikamenti, doza me të cilën duhet të përdoret. Një seksion i këtij libri pasqyron më shumë se 1 000 fotografi, tabela dhe kapsula, me emrin ident

ifikues të produktit. Gjashtë seksionet e këtij kapitulli janë të ndarë për mrekulli dhe janë të aranzhuar në atë mënyrë që të mund të përdoren lehtas.

Versioni Online i *PDR* Net është version i njëjtë sikurse ai i versionit të shtypur/CD-ROM, mirëpo në të janë shtuar disa materiale, posaçërisht për mjekët dhe motrat medicinale. Një seksion më i vogël i dedikohet "konsumatorëve". Edhe pse versioni Online nuk është më lehtë i kuptueshëm sesa versioni CD-ROM apo ai i shtypur, prapëseprapë është më i lehtë për t'u përdorur.

Versioni CD-ROM Pysicians' Desk Reference Electronic Library merr shumë gjëra nga versioni i shtypur. Mirëpo, shton edhe disa tituj të rinj sikurse: *Pysicians' Desk Reference for Nonprescripted Drugs, The PDR for Herbal Medicians,* si dhe *Physicians' Desk Reference for Ophthalmology.* Teksti komplet i *The Merck Manual*, si dhe fjalori i quajtur *Stedman's Medical Dictionary* mund të merren më një ofertë speciale që kushton rreth $300. Kërkimi në të mund të bëhet në mënyrë të pavarur, apo mund të përdoren referencat e kryqëzuara të të gjithë titujve. Për më shumë sesa lehtësinë e kërkimit, ky botim ka përparësi karshi formatit të shtypur për shkak se versioni CD-ROM modifikohet me informata çdo tre muaj, e jo çdo vit.

The Physician's Desk Reference for Nonprescription Drugs në formatin CD-ROM shqyrton më se 1 000 produkte të tjera medicinale. Aranzhimi, rregullimi dhe përmbajtja janë të njëjta me veprën kryesore, duke përfshirë këtu edhe një seksion me fotografi të tabelave dhe të dukjes së barnave. Ky version është shumë i përdorshëm për analizat objektive, jo vetëm në atë se çka këto medikamente premtojnë, mirëpo edhe efektet e tjera të këqija dhe të dëmshme të tyre. Versioni i shtypur (që filloi në vitin 1980 dhe vazhdon edhe në ditët e sotme) botohet një herë në vit prej botuesit të PDR-së.

Një web-sajt falas ofron informacione të konsiderueshme rreth medikamenteve. Ky web-sajt quhet RxList (www.rxlist.com), e cila përmban në vete informacione të ngjashme me ato që mund të gjenden në PDR, edhe pse në një format të shkurtuar. Një plus mjaft i madh i këtij web-sajti është se: bibliotekari mund të hulumtojë dhe të kërkojë informacione për një medikament, jo vetëm sipas emrit, por edhe sipas numrave të shtypur në medikamente, p.sh. numrat që janë të skalitur në barëra apo në kapsula.

Ka edhe shumë web-sajte të tjera të besueshme në të cilat mund të gjenden informacione rreth barërave: Administrata e Ushqimit dhe e Medikamenteve (www.fda.gov/cder/drug.html) vë theks të veçantë në

historinë dhe të dhënat mbi sigurinë e përdorimit të barërave dhe në ato medikamente, që nuk janë lejohet të përdoren nga qeveria. CenterWatch www.centerwatch.com) është një vend i mirë për të kërkuar informacione rreth më shumë se 7 000 testime klinike të barërave. Të dhënat janë shumtë të besueshme, edhe pse vijnë nga një web-sajt komercial. *IMS Health* (www.ims-health.com) tregon shitjet e të gjitha medikamenteve me recetë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Është një web-sajt mjaft me vlerë për investitorët, dhe më se e rëndësishme për njerëzit, të cilët hulumtojnë dhe duan t'i identifikojnë medikamentet më të njohura për raste të caktuara.

Pharmacy Online, e cila shet medikamente, është jashtë shërbimeve të referencave. Megjithatë, bibliotekarët që punojnë me burime medicinale duhet t'i kuptojnë daljet e tilla digjitale të këtyre barnatoreve të mëdha. Ata mund t'ua kursejnë paratë shfrytëzuesve, mirëpo përbën në vete një rrezik: Sa vigjilente janë këto web-sajte në paralajmërimin e shfrytëzuesve rreth reagimeve të mundshme e të rrezikshme medicinale? Web-sajtet e besueshme e japin referencën e doktorit, ndërsa të tjerat nuk e bëjnë këtë.[23]

Në Internet

Për më shumë sesa burimet në Internet që u cekën më parë, janë edhe disa mijëra web-sajte të tjera, të cilat mbulojnë dhe janë të koncentruar në mbulimin e gati çdo aspekti medicinal dhe shëndetësor. Fatkeqësisht, shumica e këtyre web-sajteve përfaqësojnë interesa komerciale dhe janë më shumë të përfshirë me shitjet e medikamenteve, e më pak me dhënien e këshillave të mira. Kur përdorni Internetin, duhet të jeni i sigurt që i keni kontrolluar mirë dhe i keni ekzaminuar në mënyrë të saktë web-sajtet komerciale dhe/apo mundohuni që të përdorni web-sajtet me prapashtesat "org", "edu", "gov", që së paku përfaqësojnë shenja të besueshmërisë. Një numër i madh i web-sajteve komerciale (.com) janë të mrekullueshme, mirëpo më së miri është ta kuptoni se ato web-sajte mund të jenë fatkeqësi e vërtetë. Përveç përparësisë së zakonshme, pra që ofrohen në Internet, burimet medicinale dhe shëndetësore në Internet janë të vlefshme pikë së pari për shkak se janë aktuale dhe të lehta dhe ndjekin, ndonjëherë edhe në baza ditore, zhvillimet në mjekësi. Po ashtu, Interneti

[23] Për një diskutim më të gjerë rreth këtij web-sajti, shih: Yahoo! Internet Life, gusht, 1999, f. 139-142.

ka një interesim të zgjeruar në web-sajtet multimediale, të cilat janë të fokusuara në informacionet vizuale dhe orale, në një mënyrë që janë lehtë të kuptueshme për të gjithë. Një minus i vërtetë i tyre është fakti se këto web-sajte nuk janë të kontrolluara dhe në to mund të gjenden informacione të shumta që mund t'i dezinformojnë lexuesit. Studenti apo bibliotekari duhet gjithmonë ta kontrollojë burimin e të dhënave. Po ashtu, janë diku afër rreth 50 apo më shumë bazat të besueshme Online të të dhënave, pra rreth mjekësisë/shëndetësisë, që ofrohen nga shitësit më të mëdhenj Online si DIALOG, EBSCO, IAC, si dhe LEXIS-NEXIS.

Medscape (www.medscape.com). Disa njerëz besojnë se ky web-sajt është web-sajti më e mirë medicinale në Internet. Pse? Për shkak se: (a) ka një bord redaktorial jashtëzakonisht të mirë, i cili udhëhiqet nga ish redaktori i *Journal of the American Medical Association*; (b) është një burim i vazhdueshëm, i cili mbulon lajmet aktuale rreth mjekësisë, duke filluar nga artikujt deri te përmbledhjet e konferencave; (c) më e rëndësishmja: ju ofron doktorëve përmbajtje të plota dhe aktuale, si p.sh. artikujt mund të përmblidhen shkurt ose të mbështeten me të dhëna teknike, të cilat zakonisht ofrohen vetëm për profesionet medicinale; (d) po aq me vlerë është edhe: procesi i kërkimit dhe i hulumtimit është i lehtë të përdoret dhe fut brenda tij çdo gjë duke filluar nga MEDLINE deri te kërkimet rreth medikamenteve të ndryshme, tretmanët, e madje edhe fushat e specializuara prej kardiologjisë deri te përkujdesja respirator. Grremçi këtu është fakti se ky web-sajt është për profesionistët, pra për ata që merren me mjekësinë, dhe jo për personat laikë. Në fakt, regjistrimi është i obligueshëm në mënyrë që të mund të tregohet statusi profesional, dhe kështu bibliotekat mund të bëhen Online pa pasur vështirësi në këtë. Duke e thënë këtë, del përfundimi se personat laikë, që janë më të dedikuar, dhe më profesionalë, do të gjejnë informacione jashtëzakonisht të sakta dhe qasje profesionale për mjekësinë. Nëse përdoret ashtu siç duhet, bëhet vendi i parë dhe më i preferuar se ku duhet ndalur për të gjetur përgjigje në pyetjet medicinale.

Ndër web-sajtet e tjera të besueshme, pra burime medicinave në Internet, të cilat dalin nga firmat komerciale janë edhe këto: Përpjekja grupore nga John Hopkins dhe Aetna U.S. Healthcare: *IntelHealth* (www.aetnaushc.com). Ky web-sajt po modifikohet vazhdimisht dhe thotë të ketë mbi dy milionë faqe me të dhëna. I rëndësishëm të ceket është fakti se ky web-sajt ka një dizajn të mrekullueshëm dhe përpjekja e saj që t'i adresojë kërkesat e përdoruesve të zakonshëm; (2) *Medcast*

Networks (www.medcast.com) sponsorizohet nga Rrjeti i Lajmeve Greenberg. Edhe pse i adresohet në radhë të parë fizikanëve, "lajmet e përditshme" janë shumë të përshtatshme për lexuesit të cilët kanë interes në problemet mjekësore; (3) *Medicine Net* (www.medicinenet.com) e cila është vënë së bashku nga fizikanët për personat laikë. Ky web-sajt mbulon procedurat, sëmundjet dhe medikamentet, duke ofruar linka nga web-sajtet e tjera; (4) *Health Central* (www.healthcentral.com) është një nga web-sajtet komerciale më të mira. Për më tepër, është një web-sajt mjaft i besueshëm. Në radhë të parë, ky web-sajt është i mirë në opinionet dhe të dhënat, si p.sh. menyja fillon me "lajmet" nga kolumnistët më të njohur, duke u zhvendosur në emision e njohur televiziv të quajtur "Dr. Dean show", "barnatorja e njerëzve", "shëndeti im" dhe web-sajte të tilla të ngjashme. Linkat që jepen këtu janë të jashtëzakonshëm. Duke theksuar, po ashtu se këtu ofrohen edhe linka për forumet, ku zhvillohen diskutime rreth problemeve të zakonshme medicinale dhe shëndetësore, për analizat e librave më aktualë, e kështu me radhë; (5) Emergency Medicine (www.Emedicine.com). Dy fizikanët nga Universiteti i Mjekësisë së Çikagos dhe të Spitalit Qendror të Bostonit janë prapa kësaj baze gjigante me të dhëna mjekësore, bazë e cila ofrohet falas. Edhe pse filloi vetëm për profesionistët për situatat e dhomës së emergjencës, tashmë kjo bazë e të dhënave është shndërruar në një bazë, e cila ka informacione të përgjithshme dhe specifike medicinale. Sponsori thekson se ata kanë më shumë se 400 000 vizitorë në ditë, të cilët shfletojnë tekstet e kësaj baze që përfshijnë video-e dhe ilustrime. Libri është teknikë, mirëpo mund të kuptohet nga çdokush që ndihet mirë me botimin tjetër Merck. Ofrohet falas për shkak se sponsorizohet në radhë të parë, nga kompanitë farmaceutike dhe dy doktorët, që janë njëherësh edhe themeluesit e saj.

Disa web-sajte të tjera mbresëlënëse dhe të besueshme që kanë të bëjnë me shëndetin:

Healthfinder (www.healthfinder.gov) është një nga web-sajtet më popullore që sponsorizohet nga Departamenti Federal i Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore. Është i rëndësishëm për shkak se: (a) përfshin dhe mbulon lajmet aktuale rreth çështjeve mjekësore; (b) ka seksione të rregullta që flasin rreth sëmundjeve kryesore, duke filluar nga kanceri deri te diabeti; dhe (c) pika ndoshta që është edhe më e rëndësishmja për bibliotekarët e referencave është fakti se ofron linka rreth informacioneve që vijnë nga agjencitë shtetërore të shëndetësisë, grupet publike dhe profe-

sionale medicinale, universitetet, grupet mbështetëse dhe ditarët medicinal. Në të, kërkimi mund të bëhet thjeshtë sipas fjalëve kryesore apo sipas subjektit, duke mos harruar as opsionin e kërkimit të tekstit të plotë. Shënim: Ky web-sajt zgjerohet vazhdimisht në mënyrë që të ofrojë një qasje më të mirë për konsumatorët dhe lexuesit e saj. Vazhdimisht shton burimet e saj. Në listën e burimeve mjekësore të një bibliotekari, ky web-sajt duhet të jetë në majën e top listës së tij.

Medical Matrix (www.medmatrix.org/index.asp) Ky web-sajt ofron linka për burimet medicinale/shëndetësore dhe përparësia fillestare e saj është fakti se web-sajtet dhe linkat janë të radhitur sipas besueshmërisë së tyre. Po ashtu, ky web-sajt modifikohet rregullisht me informata. Burimet janë fort mirë të pajisura me shënime dhe kjo zakonisht mjafton që ta drejtojë shfrytëzuesin në drejtim e duhur. Të dhënat e tjera në këtë web-sajt përfshihen: ditarët elektronikë dhe lajmet nga mjekësia, duke mos harruar edhe informacionet e tjera që iu kushtohet posaçërisht fizikanëve.

American Medical Association Physician Select (www.ama-assn.org). E mbështetur nga Asociacioni Medicinal Amerikan, ky web-sajt shërben për dy apo tri qëllime. E para, jep informacione bibliografike rreth trajnimeve, doktorëve. E dyta, ndihmon bibliotekarët e referencave për të gjetur një doktor në një fushë të caktuar të mjekësisë. Dhe e fundit, mbulon materialet në detaje të atilla si p.sh. nëse doktori pranon pacient të ri apo në orët e tjera, numrat e telefonit, e zakonisht edhe një hartë për të treguar lokacionin e doktorit/doktoreshës.

Legjislacioni

LEXIS-NEXIS. Shiko Kapitullin 6.

Online: FindLaw. Mt. View, CA: FindLaw, 1999 e deri më sot, e përditshme, www.findlaë.com. Falas.

Pyetjet që kanë të bëjnë me legjislacionin janë të ngjashme si ato të mjekësisë në aspektin se që të dyja kërkojnë më shumë sesa një njohuri mesatare të fushës së caktuar. Për këtë pjesë të bibliotekave profesionale juridike, shumica e bibliotekarëve konsultohen dhe lexojnë vepra të përgjithshme, e po ashtu edhe vepra të tjera specifike të ligjeve në shtetet

e ndryshme, në qytete a regjione. Diskutimet e indekseve në kapitujt paraprak tregon se vendet kryesore për të kërkuar të dhëna aktuale, specifike dhe të përgjithshme janë ato si p.sh. LEXIS-NEXIS.

Kush pyet çka? Në një studim mbi bibliotekat publike, është gjetur se njerëzit që bëjnë pyetje ligjore janë në radhë të parë studentët dhe biznesmenët. Njerëzit e tjerë dëshirojnë të dinë më shumë rreth divorcit, rregullit të amaneteve, ligjeve mbi taksat dhe procedurat e imigrimit. Tri pika kryesore duhet të merren parasysh kur blejmë një udhëzues ligjor: (1) A është aktual? (2) A është i shkruar për të tjerët, e jo për avokatët? Në të njëjtën, kohë, nuk duhet të thjeshtësohet edhe shumë; (3) A e tregojnë qartë veprat se kur duhet të konsultohet një avokat?

Janë edhe shumë udhëzues të tjerë të përdorur në kërkimet ligjore, mirëpo këto janë për bibliotekarin. Personi i zakonshëm laik dëshiron informacione, e jo një libër të tërë se si duhet të gjendet ai informacion. Udhëzuesi më i mirë për njerëzit jo avokat është *Legal Research* nga Stephen Elias (Berkeley, CA: Nolo Press, redaktime dhe data të ndryshme). Jep instruksione, hap pas hapi, dhe modifikohet shpesh. Për më tepër, është një udhëzues mjaft i besueshëm.

Në Internet

E mbështetur nga Libraritë Ligjore të Kalifornisë Veriore, *FindLaw* që ofrohet falas në Internet ofron linka të ndryshëm për web-sajte të ndryshme, të cilat në një mënyrë apo në një tjetër adresojnë gati shumicën e pyetjeve- pra duke ushtruar avokatët dhe bibliotekarët ligjorë, e po ashtu në një masë më të vogël edhe personat laikë. Pra, shfrytëzuesi mund të shkruaj fjalët kryesore ose termat për të gjetur informacione, që kanë të bëjnë me shkollat juridike, firmat ligjore, konsullatat, si dhe zyrat ligjore. Informatat e sakta mbi ligjin mund të gjenden në "Laws: Cases and Codes" e po ashtu edhe në materialet që gjenden në titullin "Legal Subject Index".

Ndihmesat për konsumatorin

*Online: Consumer Reports Full Text. Yonker*s, NY: Consumers Union, 1982 e deri më sot, e përmuajshme, www.consumerreports.org. Falas. DIALOG fajlli 646, $60 për orë. Ofrohet edhe nga firmat e tjera.

CD: Palo Alto, CA: DIALOG Information Systems, 1984 e deri më sot, çdo tre muaj. $375; modifikimet çdo vit, $235.
E shtypur: 1936 e deri më sot, e përmuajshme. $24.

Bibliotekari i referencave zakonisht i shtrohet një nga këto tri pyetje rreth produkteve, si dhe mbrojtjes së konsumatorit: (1) "Cili është produkti më i mirë që i përgjigjet nevojave të mia"? (2) "Te cili njeri mund të ankohem, apo cilit njeri mund t'i kërkoj informacione rreth një produkti apo shërbimi"? (3) Si mund ta mbrojë veten nga produktet e kualitetit të dobët apo nga shërbimet jo në nivel"? Asnjë burim apo vepër e referencave nuk i përgjigjet të gjitha këtyre pyetjeve, edhe pse disa nga to janë të vlefshme në vendosjen e disa burimeve të mundshme. Përgjigjja më e mirë për produktin mund të gjendet në shumë vende të ndryshme, përfshirë këtu artikujt e indeksuar në *Readers' Guide* apo në indekset e tjera të përgjithshme digjitale.

Grabitjet e konsumatorit, gjithmonë sipas Qendrës për Krime, raportohen nga më shumë se 40 % e amerikanëve. Shumica e këtyre njerëzve ankoheshin për riparimet e panevojshme, mirëpo shumica e atyre që ju përgjigjen në këtë studim "thanë se ata kishin humbur para, për shkak të skemave të Internetit, vjedhjeve përmes kartave kreditore, si dhe mashtrimeve investuese".[24] Me këtë që u cek më lart, ka mjaft arsye që bibliotekat, së bashku me grupet e tjera, si dhe me agjencitë qeveritare, t'i ndihmojnë viktimat e krimit.

Duke marrë parasysh popullaritetin e informacioneve që ndihmojnë konsumatorët, shumë biblioteka publike dhe shkollore, e zgjidhin këtë problem apo kërkesë duke themeluar dhe vënë në shfrytëzim një seksion apo përmbledhje të veçantë për ndihmë konsumatorëve. Këto seksione mund të përfshijnë ndoshta të gjitha numrat e Dewey dhe çdo gjë tjetër duke filluar nga web-sajtet, deri te librat, revistat si dhe videot. Koleksioni përdoret për referenca e po ashtu edhe në rastet kur nuk ka shumë materiale për të mbuluar titujt apo ngjarjet popullore.

Një burim shumë praktik dhe i besueshëm informacioni rreth produkteve mund të gjendet në botimin e njohur *Consumer Reports*. Versioni elektronik i këtij botimi përfshinë informacione nga viti 1982 dhe përfshinë: *Consumer Reports Travel Letter* dhe *Consumer Reports on Health*. Të gjithë artikujt kanë tekstet e tyre të plota.

[24] "As Swindlers Branch Out..." The New York Times, 25 maj, 1999, f. C25.

Në Internet, shfletimi i Consumer Reports mund të bëhet falas. Mirëpo, kjo vlen vetëm për botimin aktual. Për numrat e kaluar, lexuesit duhet të paguajnë $2.95 për çdo muaj, në mënyrë që të jenë në gjendje të hulumtojnë arkivat që përfshijnë materiale nga viti 1982. Një hulumtim më i gjerë, mirëpo me një çmim më të lartë, ofrohet edhe nga firmat e tjera, si p.sh. nga DIALOG.[25] Pyetjes "Te kush mund të ankohem"? mund t'i përgjigjeni në shumë mënyra. Në nivelin lokal, një thirrje në Byron për Biznes më të Mirë mund të kryej punë. Mirëpo, në rastin kur dikush po provon të marrë në telefon dhe ta kontaktojë prodhuesin e produktit, vështrimi në kutinë e produktit mund t'ua tregojë adresën. Nëse edhe kjo nuk kryen punë, apo nëse ju nevojiten më shumë informacione, merrni një udhëzues.

Një nga vendet më të mira për të gjetur adresat e kompanive dhe të personelit të tyre është: *Thomas Register* (Nju-Jork: Thomas Publishing Company, 1905 e deri më sot, e përvitshme). Edicioni shumë i madh i shtypur që ngërthen në vete shumë vëllime (32 sosh) është zëvendësuar nga shumë biblioteka me një version elektronik, që në fakt kushton më lirë. Online apo me version CD-ROM, me tetë CD, ju mund të gjeni informacione për më shumë se 5 100 kompani amerikane. Kjo bëhet përmes katalogëve të këtyre kompanive, katalogë që janë thelbi i këtij regjistri. Për më shumë, indeksi lejon hulumtimin e 156 000 burimeve që janë nën 58 000 tituj produktesh dhe shërbimesh. Po ashtu, janë të përfshirë markat e produkteve (emrat). Përmbledhja CD-ROM kushton $210 kurse Online (DIALOG fajlli 535) kushton vetëm $15 për orë, plus $1.70 për shënimet e plota. Ofrohet edhe një shërbim falas i shkurtuar në Internet në adresën: (www.thomasregister.com).

Shënim: Një shërbim falas, më pak i kompletuar, por gjithsesi i përdorshëm që ofrohet në Internet është: *Online Guide to Companies* (www.companiesonline.com). Diku rreth 100 000 kompani private dhe publike janë të listuara në këtë adresë, mirëpo vetëm informatat kryesore jepen për to. Numrat e telefonave, si dhe adresat e kompanive jepen në të. Për informata më të shumta: *Standard & Poor's Register* (www.standardpoor.com). Ky është versioni elektronik i udhëzuesit të shtypur shumë të

[25] Informacionet e pavlerësuara rreth produkteve mund të gjenden në Consumer Index (Ann Arbor, MI: Pierian Press, 1973 e deri më sot, çdo tre muaj, me përmbledhje vjetore). Kjo përshin dhe mbulon raportet mbi produktet në më shumë se 100 periodike. Po ashtu, ofrohet edhe Online (përmes OCLC dhe kompanive të tjera) si dhe në versionin CD-ROM.

njohur, i cili jep informacione mbi 75 000 korporata, si dhe emrat e më shumë se 40 000 shefave të këtyre korporatave. Për ta jepen edhe biografi të shkurtra dhe numri i biografive arrin në 70 000. Për çmimet, shiko web-sajtin e shërbimit S & P.

Në Internet

Interneti është një vend ideal për të kërkuar informacione mbi çdo produkt apo kompani. Thjesht shkruaj emrin e kompanisë dhe/apo shkruaj emrin e produktit të caktuar në kutinë kërkuese dhe në të shumtën e rasteve, rezultatet janë mbresëlënëse.

Grremçi – që është mjaft i rëndësishëm- është fakti se shumica e informacioneve rreth produktit X apo Y jepen nga prodhuesi i vet produkteve X apo Y. Pra, përfundimi i thjeshtë është se këto informacione nuk janë të paanshme, edhe pse disa nga këto informacioneve mund të jenë të sakta dhe të vërteta. Ka jashtëzakonisht shumë mundësi që konsumatori të gjendej ndihmë këtu, mirëpo është mirë të fillohet me:

Consumer World (www.consumerWorld.org). Një këshillues privat i Komisionit Amerikan Për Tregti, që ka të dhëna të jashtëzakonshme për mbrojtjen e konsumatorit, qëndron prapa këtij web-sajti. Ky web-sajt ofron linka për më shumë se 1 600 web-sajte që kanë të bëjnë me konsumatorin. Këtu ofrohen një sistem kërkimi-hulumtimi shumë i lehtë, që jep sugjerime të detajuara mbi subjektet, lejon kërkuesin që të gjejë produkte të caktuara. Në të mund të gjenden edhe shumë informata të përgjithshme rreth parave dhe kredive, agjencive të konsumatorëve, si dhe zhvillimeve në fushën e udhëtimeve.

U.S. Consumer Gateway (www.consumer.gov) ka përparësinë që është një burim objektiv për informata të lira – përfshirë këtu edhe një seksion i cili i kushtohet "alarmeve kundër vjedhjeve dhe mashtrimeve". Diku rreth 40 agjenci federale kontribuojnë me materiale në këtë web-sajt qeveritare, i cili mbulon çdo gjë nga shëndetësia deri te produktet.[26]

UDHËZUESIT

Informacionet udhëzuese janë ndër informacionet që kërkohen më së

[26] Për web-sajte të tjera të konsumatorit, shiko "Consumer Protection", Yahoo!, mars, 1999, f. 126.

shumti në biblioteka, posaçërisht në bibliotekat publike. Zakonisht, njerëzit provojnë që të gjejnë vendndodhjen e njerëzve të tjerë, ekspertëve, si dhe organizatave duke përdorur adresat, numrat e telefonit, kodet postare, titujt, emrat, e kështu me radhë.

Udhëzuesit që japin informacione rreth stafit të kompanive gjenden më shumicën e bibliotekave. Në ditët e sotme, ato janë pjesë edhe e websajteve të bibliotekave, mirëpo duhet thënë se disa prej tyre ende ruajnë burimet e shtypura/ të shkruara me makinë shtypi/apo edhe doreshkrime. Udhëzuesi i zakonshëm i bërë nga një bibliotekë lokale përfshin informacione të tilla si numrat më të kërkuar telefonikë, emrat e individëve dhe agjencive në atë komunitet, burimet për ndihmë në raste kur ka pyetje të vështira, emrat e kërkuar të zyrtarëve shtetërorë dhe federalë, si dhe shumë e shumë informacione të tjera. Për shembull, në referencën e saj të stafit, Biblioteka Publike e qytetit të Çikagos i liston të gjithë fajllat e stafit si burimet më të përdorshme të referencave në ditët e sotme, të cilat ofrohen vetëm nga *World Book Encyclopedia* si dhe *W7orld Almanac*.

Definicionet

ALA Glossary of Library Terms e definon udhëzuesin si "një listë të personave apo të organizatave që është e aranzhuar në mënyrë sistematike, zakonisht sipas rendit alfabetik, që jep adresat si dhe informacionet e ngjashme rreth individëve, si dhe adresat, zyrat, funksionet dhe informacione të ngjashme për organizata". Qëllimi i udhëzuesve është i qartë në definicion, mirëpo në shumicën e rasteve kur përdoret, përdoret kur kërkohet: (1) adresa e një individi apo firme (përfshirë adresën elektronike), apo numri i telefonit; (2) emri i plotë i një individi, firme, apo organizate; (3) një përshkrim i një produkti apo shërbimi të caktuar; apo (4) emri i presidentit të një firme të caktuar, apo emri i udhëheqësit të një shkolle, apo emri i personit përgjegjës, le të themi për reklamim.

Rastet më të rralla kur përdoret udhëzuesi janë ato kur shfrytëzuesit kërkojnë: (1) informacione bibliografike të kufizuara, mirëpo aktuale, për një individ, pa marr parasysh nëse ai person është ende president, kryetar bordi me këtë apo atë kompani; (2) të dhëna historike dhe aktuale rreth një institucioni, firme, apo grupi politik, si p.sh. informacione të tilla se ku është formuar, sa anëtar kishte në fillim etj; (3) të dhëna për përdorim komercial, si p.sh., zgjedhja e një liste të individëve, kompanive, apo organizatave për qëllime postare në një rajon të caktuar. Për shembull,

udhëzuesi i doktorëve dhe i dentistëve shërben si një listë, në bazë të së cilës shërbehen shitësit e librave medicinalë dhe (4) kur bëhen studime të rëndomta apo qëllimore sociale apo komerciale, në të cilat ata merren si bazë. Udhëzuesit shumë shpesh përdoren nga shkencëtarët socialë për të izoluar një grup të caktuar për qëllime studimore. Për shkak se udhëzuesit janë në radhë të parë të preokupuar me qeniet njerëzore, si dhe me organizatat e tyre, ato u shërbejnë më shumë qëllimeve sesa mund të imagjinohet nga mendja e njeriut.

Gjithëpërfshirja

Udhëzuesit janë të lehtë për t'u përdorur, krahasuar me çdo mjet apo material tjetër të referencave, pikë së pari për shkak se përmbajtja e tyre zakonisht tregohet në titull, si dhe lloji i informacioneve është i kufizuar. Për më shumë, ato informacione të prezantuara jepen dhe tregohen dhe renditen sipas rregullit. Ka mënyra të shumta për t'i kategorizuar udhëzuesit, mirëpo prapëseprapë udhëzuesit mund të ndahen sipas kategorive në vijim:

Udhëzuesit lokalë. Në radhë të parë, janë dy lloje të tilla: librat e telefonit si dhe udhëzuesit e qytetit. Megjithatë, në këtë kategori mund të përfshihen edhe llojet e tjera të botuara të udhëzuesve, si p.sh., udhëzuesit e shkollave lokale, klubeve kopshtare, shitoreve, teatrove, si dhe grupeve sociale.

Udhëzuesit qeveritarë. Ky grup përfshin udhëzuesit e postave, armatë dhe të marinës, si dhe qindra mijëra udhëzues të shërbimeve që ofrohen nga qeveritë lokale, shtetërore, si dhe federale. Këta udhëzues mund të përfshijnë edhe udhëzuesit e agjencive ndërkombëtare.

Udhëzuesit institucionalë. Këto janë listat e shkollave, fondacioneve, bibliotekave, spitaleve, muzeve, si dhe organizatave të ngjashme.

Shërbimet investuese. Këto shërbime, që janë goxha të ngjashme me udhëzuesit e biznesit dhe të udhëtimit, japin raporte të detajuara rreth korporatave dhe kompanive publike dhe private.

Udhëzuesit profesionalë. Këto janë listat e mëdha të organizatave profesionale sikurse të atyre organizatave që kanë të bëjnë me legjislacion, med-

icinë, si dhe me biblioteka.

Udhëzuesit e Tregtisë dhe të Biznesit. Këto janë lista të prodhuesve që japin informacione rreth kompanive, industrive, si dhe shërbimeve.

Burime të tjera rreth udhëzuesve

Zakonisht, kalendari dhe vjetari përfshijnë informacione të ngjashme si ato të udhëzuesve, sikurse që ndodh edhe me shumë burime të tjera të informacioneve udhëzuese:

1. Shumë shpesh, enciklopeditë identifikojnë shumë organizata, posaçërisht ato më të njohurat, të cilat merren me aktivitete të caktuara politike;

2. Gazetat, librat udhëzues, si dhe atlaset japin informacione rreth industrive të caktuara, vendeve historike, muzeve, e kështu me radhë;

3. Një masë e madhe e publikimeve qeveritare përfshijnë në masë të madhe informacione të tipit të udhëzuesve. Po ashtu, disa vepra janë udhëzues në emër *(Ulirch's International Periodicals Directory*, për shembull), të cilat lidhen shumë ngushtë edhe me formatet e tjera (periodikët dhe gazetat). Shumica e tyre mendohet të jenë ciceronë e më pak udhëzues.

Formatet

Bazuar në definicion, përdorimi më i mirë i udhëzuesit bëhet atëherë kur përdoret formati elektronik. Duke qenë shërbim Online, udhëzuesi mund të modifikohet me informata, shumë shpesh, përderisa një gjë e tillë me formatet e shtypura bëhet një herë në vit, apo më së shpeshti një herë në gjashtë muaj. Versioni elektronik merr pak hapësirë, kështu që nuk ka nevojë për raftet e bibliotekës, si dhe për botimet me disa edicione që duhet ruajtur për vite të tëra. Dhe, së fundi, është shumë më e lehtë të kërkohet informacioni Online, sesa duke shfletuar indekse të panumërta. Në ditët e sotme, shumica e udhëzuesve janë në formatin elektronik. Nuk ka dyshim se ky është formati që duhet ta blejnë bibliotekat.

Udhëzuesit e udhëzuesve

Online: Directories in Print in Gale Database of Publications and Broadcast Media,
Farmington Hills, MI: Gale Group, 1990 e deri më sot, çdo gjashtë muaj, www.galegroup.com. DIALOG fajll 469, $84 për orë
E shtypur: 1977 e deri më sot, e përvitshme. 2 vëllime. $315; shtesat, $185.

Lista themelore e udhëzuesve është *Directories in Print*. Ky botim i liston më shumë se 16 000 tituj të rinj apo të korrigjuar, të cilët hyjnë nën 26 kategori të mëdha të subjektit, duke filluar nga biznesi deri te kategoritë profesionale dhe shkencore. Në të gjenden indekse të detajuara të subjektit, si dhe një titull i indeksit. Informacionet për çdo shënim përfshijnë emrin e udhëzuesit, botuesin e tij, adresën dhe numrin e telefonit, si dhe një përshkrim të plotë të veprës. Një seksion i posaçëm i liston më shumë se 8 000 botues të udhëzuesve, duke thënë kështu informacionet e nevojshme prej adresës deri te numrat e telefonit. Qasja këtu është edhe gjeografike duke filluar nga shtetet dhe, po ashtu, në të gjenden edhe indekse të tjerë që ndihmojnë goxha shumë. I ashtuquajturi "indeksi alternativ" i liston vetëm ata udhëzues, të cilët ofrohen në versionin elektronik. Po ashtu, përfshin edhe informacionet e adresave, si dhe të postave elektronike. Shtesa e këtij botimi shton çdo gjashtë muaj më shumë se 1000 tituj të rinj apo të korrigjuar.

Gale Ready Shelf përbëhet në tërësi nga publikimet e Gale, apo më saktësisht nga 11 udhëzuesit kryesorë. (Titulli nuk është edhe shumë përshkrues i përmbajtjes së vërtetë të tij). Përveç *Directories in Print*, si dhe *Gale Directory of Publications and Broadcast Media,* janë diku rreth 300.000 listime të tjera të marra nga botime të tjera, sikurse *Encyclopedia of Associations apo Government Research Centers*. Kërkimet apo hulumtimet këtu mund të bëhen nga udhëzuesit e udhëzuesve, apo përmes gjithë fushave të tjera, që gjenden në shënime. Çmimet ndryshojnë dhe varen kryesisht nga fakti se sa njerëz apo firma përdornin shërbimin Online. Duhet të mos harrohet dhe të përmendet fakti se ekzistojnë edhe plane të tjera.

Një udhëzues i udhëzuesve, pak më i lirë në çmim, që ofrohet vetëm në versionin e shtypur, është edhe *Guide to American Directories* (Nju-Jork: Todd Publications, 1985 e deri më sot, e përvitshme. $95). Këtu mund të gjenden informacione të mjaftueshme për më shumë se 10 000

udhëzues, informacione të cilat janë të aranzhuara sipas rendit alfabetik dhe sipas subjektit. Në disa situata të caktuara, fushat tematike janë të organizuara edhe gjeografikisht, pra sipas shtetit.

Association Central (Bethesda, MD: Association Central, www.associationcentral.com, 2000 e deri më sot. Çmimet ndryshojnë) është një web-sajt Online hulumtuese (si google), e cila është e kufizuar kryesisht në gjetjen e informacioneve për më se 15 000 organizata tregtare dhe profesionale, kryesisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Hulumtimi-kërkimi këtu mund të bëhet duke shënuar fjalët kryesore apo/edhe në hulumtimin e kufizuar, i cili gjendet nën titujt e gjerë që fillojnë nga artet, humanitetet, deri te shkenca, shoqëria dhe kultura. Artet & Humanitetet – Muzetë japin më shumë se 30 asociacione me adresa të plota dhe informacione të tjera shtesë. Kështu që pastaj, ju mund të kërkoni një grup apo asociacion të caktuar.

Udhëzuesit e qytetit

Dy nga udhëzuesit kryesorë dhe ndoshta më të përdorur të udhëzuesve lokalë janë libri i numrave të telefonave, si dhe udhëzuesi i qytetit. Edhe pse këto dy botime janë botime të ndara të shtypura, këto botime dita-ditës janë duke u kombinuar më shumë në versionin Online. Udhëzuesi i qytetit është posaçërisht me vlerë për të gjetur informacione mbi një individ të caktuar kur e dini vetëm emrin e rrugës apo adresën e lagjes ku jeton. Një pjesë e udhëzuesit të qytetit përfshin një listë të aranzhuar sipas rendit alfabetik të rrugësve dhe lagjeve në rajone të caktuara, duke dhënë aty edhe emrat e banuesve (me përjashtim të komplekseve banesore, ku emrat e banuesve mund edhe të mos përfshihen). Zakonisht, banuesi identifikohet sipas profesionit të tij/saj, dhe nëse ai/ajo ka shtëpi të veten. Disa udhëzues të qytetit, mirëpo jo të gjithë nga ta, kanë edhe shërbime shtese të numrave të telefonit, pra diçka të tillë si "Udhëzues i Numrave të Telefonit". Nëse ju e dini numrin e telefonit, atëherë ju mund të gjurmoni emrin si dhe adresën e personit, i cili e ka atë numër telefoni.

Seksioni klasik i udhëzuesit është një listë komplete e bizneseve dhe profesioneve, që dallon shumë nga "yellow pages" e librave të telefonit për faktin se inkuadrimi në të duhet të paguhet, gjë që le të kuptohet se të gjitha firmat mund të mos gjenden aty. Sikurse edhe libri i telefonit,

[27] Udhëzuesit e qytetit të Shteteve të Bashkuara (www.citydirectories.psmedia.com) gjendet në Internet - me çmime që dallojnë. Të gjithë udhëzuesit më të mëdhenj historikë përfshihen këtu, duke filluar nga viti 1859-1898. Kjo shërben për hulumtim serioz gjenealogjik.

udhëzuesit e qytetit zakonisht botohen çdo vit apo çdo gjashtë muaj.

Shumica e udhëzuesve të qytetit publikohen nga R. L. Polk Company nga qyteti i Detroitit. Kjo kompani është formuar në vitin e largët 1870, dhe boton më se 800 publikime. Përveç udhëzuesve të saj të qytetit, boton edhe një udhëzues për banka.[27]

Përdorimi dhe përpilimi i udhëzuesve të qytetit ngjall shumë pyetje etike. Për shembull, mbledhësit e faturave shumë shpesh i thërrasin bibliotekat e mëdha publike për të marrë informacione, të cilat mund të gjenden vetëm në udhëzuesit e qytetit, si p.sh. numrat e telefonit si dhe adresat dhe emrat e "komshinjve", pra atyre që banojnë afër atij njeriu që po kërkohet nga mbledhësi i faturave. Disa bibliotekarë besojnë që këto informacione nuk duhet të jepen përmes telefonit. Ata theksojnë se kjo ndihmon mbledhësit e faturave në zhvillimin e një aktiviteti antisocial duke thënë se kjo bie ndesh me të drejtat private.

Logjikisht, kjo rregullativë mund edhe të pranohet, mirëpo një gjë e tillë është dyshuese në praktikë. Kjo e bën më të vështirë, por jo të pamundur, përdorimin e udhëzuesve. Autori i këtij teksti do të thoshte se bibliotekari është aty ku është për të dhënë informacione, e jo të shtrojë pyetje nga kush apo si përdoren ato informata. Shumica e bibliotekave të mëdha urbane japin informacione të tilla përmes telefonit.

Shumica e informacioneve që gjenden në udhëzuesit e qytetit ofrohen edhe në Internet, përmes librave Online të telefonave, si dhe udhëzuesve të adresave elektronike. (Këto çështje diskutohen në seksionin e ardhshëm). Hulumtimet-kërkimet, të cilat kërkojnë më shumë informata, mund të bëhen në web-sajtet komerciale, të cilat po zgjerohen dita ditës. Dy shembuj nga to janë: *Knowx* (www.knowx.com). Këtu, shërbimet falas bëjnë kërkime mbi çdo gjë, duke filluar nga falimentimi personal deri te dokumentet publike, siç janë të dhënat mbi martesat, blerjet e pronave etj. Kërkimet e ngjashme përmes LEXIS-NEXIS, si dhe *West Publishing* (bazat ligjore të të dhënave u diskutuan më herët) disa herë ofrohen falas e disa herë duhet paguar nga $65. *Peoplefinder* (www.peoplefinder.com) ka qasje në mbi 2 miliardë shënime publike. Nëse gjeni informacionin që kërkoni, atëherë duhet paguar $40.

Mirëpo, shtrohet pyetja: çka ndodh me jetën dhe gjendjen private të një individi me udhëzuesit e qytetit si dhe shërbimet komerciale Online? Përgjigjja: preket shumë pak. Shumica e informacioneve personale për ju mund të bëhen publike, Online apo në botimet e shtypura, pa asnjë problem. Madje, edhe numrat e telefonit që nuk janë të listuar mund të kërkohen kom-

panive të caktuara, të cilat mund ta kenë atë numër për qëllime faturash apo gjendet në udhëzuesin e vjetër. Pra, përpara se individi kishte telefonuar dhe kishte kërkuar që numri i tij të mos listohej më. Individë të ndryshëm mund të hulumtojnë në bazën e të dhënave të 'peoplefinder' dhe në udhëzuesit, që t'i heqin emrat e tyre. Mirëpo, kjo është gati një gjë e pamundshme.

Udhëzuesit e telefonit dhe udhëzuesit e adresave elektronike (e-mail)

CD: Business Phone Book USA: The National Directory of Addresses and Telephone
Numbers. Detroit: Omnigraphics, 1985 e deri më sot, e përvitshme. Çmimet
ndryshojnë.
E Shtypur: 1985 e deri më sot, e përvitshme, 2 vëllime. $165.

CD: Direct Phone. Marblehead, MD: ProCD Incorporated, 1994 e deri më sot, çdo tre
muaj. $149. Përfshinë 72 milion lista, plus 7.5 milionë lista të bizneseve.

CD: PhoneDisc. Bethesda, MD: Digital Directory Assistance Incorporated, 1993 e deri
më sot, çdo tre muaj. $249. Pesë disqe: Qytetet Western, Central, Middlewest, Northwest, dhe Southeast. Përfshin më se 90 milionë lista të banorëve si dhe të bizneseve.

Online: The Ultimates. Infosekk, 1997 e deri më sot, e përditshme, www.theultimates.com. Ofrohet falas në Internet.

Dita kur bibliotekat kishin rafte të shumta të mbushur me libra telefonash tashmë ka kaluar. Në ditët e sotme, një bibliotekë e zakonshme ka një CD-ROM version, si dhe një shërbim Online, të cilat mund të marrin një numër të caktuar emrash prej gati çdo pjese të Shteteve të Bashkuara, Kanadasë dhe pjesës tjetër të botës. Sigurisht se librat lokalë të telefonave e po ashtu edhe librat e tjerë të telefonave të qyteteve të mëdha në atë rajon janë ruajtur dhe mbajtur për shkak të përdorimit të lehtë të tyre e jo për shkak të kërkesës së madhe për informacione të tilla. Dhe, sipas këndvështrimit të një historiani apo gjeneologjisti, librat e telefonit janë një çelës magjik në gjetjen e informatave rreth individëve të pakapshëm.

Varësisht nga niveli i softuerit, qasjet e ndryshme elektronike për numrat e telefonit në përgjithësi kanë shumë gjëra të përbashkëta. CD-ROM-ët përdoret në të shumtën e rasteve si librave të zakonshëm telefoni. Nëse shfrytëzuesi e di emrin, e shënon atë emër dhe për një çast të vetëm, në ekran do të shfaqet numri i telefonit si dhe adresa e tij/saj. Mirëpo, për dallim nga versioni i shtypur, hulumtuesit kanë shtigje të ndryshme: (1) ata mund të shikojnë numrin e ditur të telefonit dhe prej aty të gjejnë emrin e personit ose të biznesit si dhe adresën; (2) nëse ata e dinë adresën, aty shfaqet menjëherë numri i telefonit si dhe emri. Ata mund ta ngushtojnë kërkimin e tyre duke shtypur kodin postar, kodin rajonal, të qytetit, shtetit, apo një kombinim ndërmjet tyre. Të gjithë njerëzit që jetojnë në një rrugë të caktuar apo bizneset do të ndiqen dhe të gjenden adresat apo numrat e tyre. Seksioni i biznesit mund të kërkohet sipas Standard Industrial Classification, sipas vendit, kodit postar, e kështu me radhë. Në përgjithësi, të dhënat elektronike janë të sakta, mirëpo nga koha në kohë, ju mund të hasni edhe numra të gabuar telefoni, emra gabim, kode qytetesh që nuk janë të sakta, e kështu me radhë. Ky mendohet të jetë faji i kompanive të telefonave, e më pak e botuesve të udhëzuesve.

Një përparësi mjaft e madhe e sisteme elektronike të CD-ve është fakti se ato modifikohet me informata, gati çdo tre muaj, dhe këto modifikime mund të merren duke paguar një çmim më të ulët. Shumica e shërbimeve ofrojnë variacione të ndryshme rreth temave të ndryshme, pra ofrohen me çmime të ndryshme. Duke iu falënderuar konkurrencës, shumica e këtyre çmimeve janë mjaft të arsyeshme.

Kjo anë apo përparësi e librit lokal të telefonit, pran një vëllimi tjetër të shtypur, e bën mjaft të kërkuar nga bibliotekarët e referencave. “Mbahet afër telefonit për t’u dhënë përgjigje të ndryshme pyetjeve që kanë të bëjnë me referencat e gatshme”.[28] *The Business Phone Book USA* jep tri arsye se pse ky botim përdoret shumë në biblioteka: (1) i liston, nëntitujt të ndryshëm, llojin e numrave të telefonave të të gjithë shtetit. Pra, ata numra telefoni që njerëzit i kërkojnë më shumë. Vëllimi i parë është një listë sipas emrave të organizatave. I dyti, apo lista e ashtuquajtur “yellow pages” i liston emrat e ngjashëm sipas subjektit apo temës së tyre; (2) subjektet përfshijnë çdo gjë, duke filluar nga asociacionet, universitetet, deri te hotelet dhe spitalet, që gjenden në qendrat e vogla dhe të mëdha të shtetit; (3) në të përfshihen edhe informacionet shtesë, si numrat e faks-makinave,

[28] "Field Tested Reference Titles", Booklist, 1 maj, 1998, f. 1532.

adresat e postës elektronike (e-mali), kodet postare etj. Janë diku afër 140 000 lista, përfshirë gati 1 500 çështje të huaja, e po ashtu edhe numra të bizneseve të mëdha dhe të qeverisë. Në përmbledhje, duhet thënë se është një botim mjaft i lehtë për t'u përdorur. Është aq i lehtë për t'u përdorur saqë nuk ju duhet të shikoni CD-ROM versionin, e botuar nga po e njëjta firmë. Ky version përdoret vetëm në rastet kur kemi të bëjmë me hulumtime më komplekse, si p.sh. me hotelet ne veri-perëndim të SHBA-së që akomodojnë 800 mysafirë. Shënim: Botuesi i njëjtë boton edhe tituj të tjerë të njohur si: *Toll-Free Phone Book USA; WebSite Source Book; FaxUSA; Government Phone Book*, me modifikimet e përvjetshme, si dhe me versionet e shtypura, që kushtojnë nga $145 deri $230.

Njerëzit që botojnë PhoneDisc, ofrojnë edhe shumë versione të tjera duke filluar nga *PhoneDisc QuickRef* (me 100 000 numrat më të zakonshëm të bizneseve, qeverisë, si dhe institucioneve edukative, për vetëm $69) deri te *PhoneDisc California*. Versioni tjetër *The DirectPhone* ka në të edhe një paketë tjetër të quajtur *SelectPhone*, një paketë me 4 disqe që kushton $300 dhe që mbulon shumë rajone të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Disqet më të lira (nën vlerën e $300) janë të lehtë për t'u përdorur për shkak se përmbajnë më pak informata dhe më pak pika qasjeje. Normalisht, në të ju thjeshtë shkruani emrin dhe numri i telefonit të atij personi shfaqet në ekran. Probleme ka në rastet e tilla kur janë me qindra persona me emra të njëjtë, si p.sh. John Smith, për të cilët nuk tregohet vendbanimi i tyre, apo edhe në rastet kur ju shënoni emrin e personit, megjithatë nuk ka emër telefoni për të.

Në Internet

Asnjë nga bazat elektronike të të dhënave që ofrohet falas dhe që përdoren për të gjetur numrat e telefonit, adresat elektronike, adresat e rrugëve, nuk është e përkryer. Megjithatë, këto që do i cekim më poshtë janë shumë të mirë- për më shumë nga fakti se ato mund të përdoren njëkohësisht edhe nga bibliotekari edhe nga personi laik. Të mbështetur nga reklamat, shumica e këtyre web-sajteve kanë pak gabime. Në të vërtetë, në shumicën e rasteve mënyra më e lehtë, efikase dhe e shpejtë, është thjeshtë metoda e vjetër e thirrjes së operatorit për ndihmë, kuptohet përmes telefonit.[29]

[29] Nëse kontaktohet operatori, atëherë merr më pak se një minut kohë për të gjetur kodin e një rajoni (edhe pse disa herë ky shërbim duhet të paguhet). Në Internet, kjo gjë mund të marr 3 , 10, deri 15 minuta kohë, për shkak se ju duhet të shfletoni listën e gjatë.

1. *Infospace* (www.infospace.com). Me modesti, botuesi i saj e quan "udhëzuesi themelor" dhe thekson se përbën në vete më shumë se 100 milionë lista në Shtetet e Bashkuara, e shumë më shumë në Evropë. I afrohet shumë afër së vërtetës. Ndër gjërat e tjera, shfrytëzuesi i saj mund t'i gjejë shpejt numrat e telefonave personal, si dhe adresat në gjithë Amerikën. Është edhe një seksion i "yellow pages", që shoqërohet me 800 numra. Numrat e kundërt të telefonit, po ashtu identifikohen. Është edhe një grup i numrave i quajtur "ndërkombëtar". Megjithatë, ky grup nuk është i kompletuar fare. Shërbimet e tjera, të cilat në radhë të parë janë të përkrahura nga reklamat dhe marketingu, zhvendosen nga gjetja e një banese deri te blerja në Internet, si dhe numrat qeveritarë telefonikë. Pa asnjë dyshim, ky është një ndër shërbimet ideale që ofrohet falas si për bibliotekarët ashtu edhe për personat laikë. (Shënim: për vetëm $5, shfrytëzuesi mund të porosisë një profil të plotë të ndonjë biznesi që gjendet në web-sajte).

2. *Big Yellow*. Bell Atlantic (Verizon) Electronics/Database America (www.bigyellow.com) ka një përparësi dhe kjo përparësi është fakti se mbështetet nga Verizon (apo ish Bell Atlantic). Këtu, theksi kryesor vihet mbi 17 milionë lisa të bizneseve, të cilat janë të aranzhuar nën subjektet e njohura të librave të telefonit, në të cilat jepen edhe sugjerime për përdorimin e subjekteve të tjera. Informacionet këtu përfshijnë numrat e telefonit e po ashtu edhe linkat për hartat. Është një nga seksionet "yellow pages" më të mira në Internet, edhe pse ka pak vlerë për dikë që është duke kërkuar një emër specifik.

3. *Switchboard* (www.switchboard.com). Si një udhëzues i AltaVista, personat përgjegjës për këtë web-sajte theksojnë se në të gjenden më shumë se 120 milionë lista. Ky web-sajt ndjek metodat e njëjta si të konkurrentëve të tij, p.sh. adresat elektronike, numrat e telefonit etj. Një veçori specifike, që është futur këtu është opsioni "knock-knock button", i cili tregon nëse ata njerëz me adresat elektronike dëshirojnë të marrin e-mail nga hulumtuesit-kërkuesit.

Së paku një herë në vit, revista *Yahoo!* ofron sugjerime se si mund të gjenden njerëzit përmes Internetit, p.sh. në botimin e shkurtit të vitit 1999, (f. 127), kjo revistë i mbuloi dhe i tregoi shumicën e web-sajteve të cilat i përmendëm më lart. Po ashtu, ata rekomanduan edhe web-sajtet e tilla si: Bigfoot (www.bigfoot.com); dhe kuptohet web-sajtin *Yahoo! People Search* (http://people.yahoo.com).

Adresa elektronike

Gjetja e një adrese elektronike në Internet është deri diku e lehtë dhe zakonisht është pjesë e udhëzuesve të numrave të telefonit që gjenden në Internet. Adresat merren nga burimet e tilla si, forume, buletine Online etj. Zakonisht, njerëzit i ndryshojnë adresat elektronike (e-mail) e tyre, mirëpo ia vlen që të provohet.

E sponsorizuar nga web-sajti kërkuese e quajtur Infoseek, *The Ultimates*, pjesë e familjes së madhe në Internet, e cila përfshin rreth 25 shërbime udhëzuese. Këto përfshijnë faqet e gati të gjitha librave të telefonit përreth Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Qasja këtu bëhet sipas emrit, në mënyrë që të mund të gjeni numrin e telefonit, si dhe e-mail adresën. "Yellow pages" po ashtu janë të përfshira në to. Njëra nga to që përdoret më së shumti quhet "Ultimate E-Mail Directory". Kjo përfshin në vete gjashtë udhëzues të ndryshëm me e-mail adresa të individëve, përfshirë këtu edhe *Infospace*. Nëse njëra nga të gjashtat nuk kryen punë, atëherë provoni tjetrën. Është një nga paketat më të mira që mund të gjenden në Internet dhe për më shumë në 95 % të rasteve, gjithmonë e jep edhe adresën. Shënim: ai që kërkon adresën duhet ta dijë së paku përafërsisht lokacionin dhe adresën e atij, që po e kërkon për shkak se mund të jenë dhjetëra njerëz me emra të njëjtë. Është edhe një "ndërrim" në dy nga web-sajtet kërkuese. Në njërën, ju mund të shkruani e-mail adresën e personit dhe nga adresa të gjeni emrin e personit apo të institucionit. Ka edhe mënyra dhe nënvizime të tjera për të ardhur deri te adresat elektronike. Disa nga to janë shumë të specializuara, p.sh. *WhoWhere?* (www.whowhere.lycos.com) ka një sasi të madhe të adresave që janë të vështira dhe gjenden shumë rrallë në vendet apo botimet e tjera.

Asociacionet dhe Fondacionet

Online: Associations Unlimited. Farmington Hills, MI: Gale Group, 1986 e deri më sot, Çdo gjashtë muaj, www.galegroup.com. Çmimet ndryshojnë. DIALOG fajlli 114.

$102 për orë. Po ashtu, ofrohet edhe nga OCLC dhe firma të tjera.

CD: 1995 e deri më sot, e përvitshme. $725.

E Shtypur: Encyclopedias of Associations. 1956 e deri më sot, e përvitshme, 3 vëllime. $380 deri $490.

Online: Foundation Directory. Nju Jork: Foundation Center, 1987 e deri më sot, e përvitshme, www.fconline.fdncenter.org. Çmimet ndryshojnë. DIALOG fajlli 26. $60 për orë.
E Shtypur: 1960 e deri më sot, e përvitshme, 3 vëllime. $435.

Kërkimi apo hulumtimi i udhëzuesit nuk është një nga gjërat më të mira në punën e referencave. Mirëpo, duke pasur pak imagjinatë, ka arsye se pse duhet bërë. Nëse marrim në konsiderim versionin e shtypur të *Encyclopedia of Associations* nën botimin "National Organizations of U.S", ju mund të gjeni më shumë se 23 000 grupe. E ndarë në kategori të mëdha sipas subjektit, që shoqërohen me indekse të detajuara, ky botim është një profil i realiteteve amerikane dhe i ëndrrës amerikane. Përfshin materiale duke filluar nga "American Assocations of Aardvark Aficionados" (me 600 anëtarë, të cilët i adhurojnë shtazët) deri te "Zippy Collectors Club" ("filatelistët që janë të pasionuar në mbledhjen e kodeve postare"). Ky katalog apo përmbledhje e organizatave e bie pamjen e thatë të tregtisë amerikane në një horizont me shumë ngjyra. I njëjti botim, i cili përfshinë në vete "Financial Accounting Federation", po ashtu e boton edhe "Electrical Women's Round Table" si dhe "Pressure Sensitive Tape Council".

Një shënim i zakonshëm i shtypur përfshin diku prej 15 deri 20 pika rreth organizatës, nëse ka dhjetëra anëtarë apo mijëra, nëse është duke bërë biznes të mirë apo jo, si p.sh. shiko "The Flying Funeral Directors of America" (të cilët "e krijojnë dhe punojnë për interesat e përbashkëta në shtytjen, si dhe përmirësimin e shërbimeve të funeraleve"). Informacionet për çdo shënim përfshijnë emrin e grupit, adresën, emrat e zyrtarëve, numrat e telefonit, qëllimi dhe aktiviteti, anëtarësia, si dhe publikimet e tyre (që në shumicën e rasteve janë udhëzues të lëshuar nga asociacionet individuale). Është edhe një indeks i aranzhuar sipas radhës alfabetike, mirëpo vëllimi i dytë mund të thuhet se është indeks i vëllimit të parë për shkak se liston të gjithë zyrtarët, të cilët janë përmendur ne vëllimin paraprak, duke mos harruar t'i japë adresat e plota, si dhe numrat e telefonit. Një seksion tjetër i ri-aranzhon asociacionet sipas lokacionit gjeografik, apo shtrirjes gjeografike. Vëllimi i tretë është lëshuar në botim në mes të dy edicioneve të tjera. Ky vëllim i modifikon informacionet duke raportuar më se 3 000 ndryshime nga vëllimi i parë, apo përmbledhja e parë.

Është zakon i botuesve të udhëzuesve që të zhvillojnë "spin off". Një

rast i tillë është edhe ky: *Encyclopedia of Associations: Regional, State and Local* (Detroit, MI: Gale Research Inc., 1988 e deri më sot). Lëshuar për herë të parë në treg në vitin 1988, duke premtuar se modifikimet me informata do të ishin shumë të shpeshta, ky botim ndjek metodat e botimit të parë. Megjithatë, ky botim është paksa më i kufizuar ngase përfshin vetëm 113 000 asociacione lokale, shtetërore dhe regjionale. Në të gjenden pesë vëllime (që ofrohet për një shumë rreth $570). Nëse ka humor dhe patos në udhëzuesin e organizatave kombëtare, atëherë ju mund të imagjinoni se çka mund të haset në shënimet që janë të aranzhuar sipas radhës alfabetike; së pari sipas shtetit, pastaj sipas qytetit dhe vendit, dhe më në fund sipas emrit të asociacionit. Indeksi i subjektit është pak më shumë sesa një qasje sipas fjalës kryesore (key word), që do të thotë se e gjen fjalën kryesore në titull. Dhe, në rastin kur ajo fjalë nuk shpjegon subjektin, lexuesi apo shfrytëzuesi i saj humbet fare. Pra, është e vërtetë se redaktorët fusin subjekte të reja, mirëpo kjo nuk mjafton.

Në formatin Online të *Assocations Unlimited* është përfshirë teksti i njëjtë, mirëpo në të janë disa gjëra shtesë të cilat përfshijnë: (1) udhëzuesit regjionalë, shtetërorë dhe lokalë, të cilët u përmendën më lart dhe (2) seksioni i quajtur International Organizations, i cili përfshin më se 450 000 shënime, të cilat mund të hulumtohen dhe të kërkohen Online përmes 22 fushave të ndryshme, duke filluar nga titulli dhe fjalët kryesore deri te subjekti. Versioni Online ka përparësinë e të qenit më aktual sesa botimi i shtypur, për shkak se modifikimi me informata bëhet çdo gjashtë muaj. (Shënim: I gjithë botimi i *Encyclopedia of Associations* po ashtu ofrohet edhe në ofertat e tjera më të mëdha të udhëzuesve nga *Gale's Ready Reference Shelf*, e cila u diskutua më herët në këtë kapitull).

Ka mënyra të shumta për kërkimin e versioneve Online, duke filluar nga subjekti dhe emri i një grupi deri te adresa, si dhe vendndodhja gjeografike, apo lokacioni. Duke përdorur logjikën Boolean, ju mund të kufizoni kërkimin tuaj p.sh. vetëm në asociacionet që vijnë nga shteti i Oklahoma, që kanë më shumë se 3 000 anëtarë dhe që kanë një buxhet tepricë prej $ 4 000. Është jashtëzakonisht e rëndësishme për shfrytëzuesi të dijë, madje edhe disa nga fjalët kryesore sikurse "bowling" apo "restorante". Kërkimi mund të japë si rezultat organizatat, të cilat kanë të bëjnë me "bowling", si dhe me ushqimin që ato ofrojnë.

Nëse dikush e llogarit çmimin e të gjitha shërbimeve elektronike, pra

çmimin përfundimtar-posaçërisht për kërkimet Online që nuk bëhen shpesh- në të vërtetë është më i vogël se do të ishte për vëllimet e shtypura. Udhëzuesit Online apo ata në CD-ROM kanë një përparësi jashtëzakonisht të madhe në krahasim me botimet e shtypura, për shkak se kanë edhe bazat Online të të dhënave.

Fondacionet dhe Grantet[30]

Foundation Directory Online, që modifikohet çdo vit me informata, përfshin në vete edhe botime të tjera të botuara nga i njëjti botues, si udhëzuesin e quajtur *National Directory of Corporate Giving*. Kjo bazë e të dhënave përshkruan më shumë se 12 000 burime potenciale, të cilat ofrojnë ndihma financiare (grante). Po ashtu, në të janë të përfshira edhe organizatat private, bizneset, si dhe organizatat e komuniteteve. Aty jepen informacione të plota lidhur me shumën e parave që ofrohet dhe po ashtu, ka goxha informacione ku tregohet se çka në të vërtetë (pra çfarë formularësh) duhet plotësuar. Më e rëndësishëm është fakti se adresat, numrat e telefonit, emrat e personelit, e kështu me radhë bëjnë të mundur marrjen e më shumë informacioneve, ku dhe kur duhet. Vëllimi i mëhershëm në versionin e shtypur përfshinte vetëm fondacionet që kishin pasuri prej më pak se $2 milionë. Në të jepen afër 7 000 lista. Njëkohësisht, vëllimi i dytë përfshin edhe 4 000 fondacione të tjera "të mesme". Ndërsa, vëllimi i tretë është një botim shtesë, i cili lëshohet në botim çdo gjashtë muaj pas botimit të vëllimit të parë dhe të dytë. Ndoshta nuk do të ishte e mërzitshme të përmendet fakti se versioni Online preferohet më shumë kur kemi të bëjmë me hulumtime-kërkime më komplekse, mirëpo vëllimi i shtypur ndoshta është blerje më e mirë kur konsultohet udhëzuesi.

The International Foundations Directory (Nju Jork: Evropa, 1974 e deri më sot, jo e rregulltë) liston rreth 1 500 fondacione nga 107 vende të ndryshme të botës në tetë edicionet apo vëllimet e saj (1998). Ndjek metodat e njëjta sikurse Foundation Directory.

Nëse provoni të gjeni ndihma financiare (grante), atëherë përdorimi i këtyre dy udhëzuesve është mjaft i nevojshëm. Ndihmë mund të gjeni

[30] Shih botimin e korrikut të vitit 1998 (f. 1900+) në "Reference Books Bulletin", nga Booklist për një udhëzim mbi "burimet , ndihmat financiare, si dhe fondet financiare." Çdo shënim ka në vete edhe një përshkrim vlerësues, ku përfshihet të gjitha aspektet rreth fondacioneve dhe fushave të tjera.

edhe në botimin Oryx Press (Feniks, AZ). *GrantSelect* (1999 e deri më sot, e përvitshme, www.grantselect.com. $1 500). Këtu janë rreth 10 000 mundësi, të cilat jepen nga më se 3 400 organizata jofitimprurëse – shumica e të cilave janë të listuara edhe në burimet e shtypura. Përparësia e këtij botimi është fakti se modifikimi i saj bëhet çdo ditë dhe kërkimi në të mund të bëhet në mënyra të ndryshme, gjë e cila nuk vlen për botimet e shtypura. Metodat e kërkimit nuk janë të përkryera, mirëpo me pak durim...

Në Internet

Përderisa asgjë që ofrohet falas në Internet nuk mund të krahasohet me Association Unlimited, më poshtë jepen disa linka për të dhënat e asociacioneve:

Associations on the Net. Biblioteka Publike e Internetit (www.ipl.org). Një listë me mbi 500 web-sajte në Internet, të organizuara sipas rendit alfabetik, ofron informacione rreth asociacioneve profesionale dhe atyre tregtare. Ky web-sajt përfshin edhe lista të organizatave kulturore e të artit, të partive politike, të sindikatave të punëtorëve, të shoqërive akademike e intelektuale etj. Në të jepen dy qasje kërkimi. E para është kërkimi sipas subjektit, i cili është i ndarë në linka dhe nën-kategori, p.sh. Artet, Humanitetet dhe Kultura përfshin: artet, etnografinë, historinë, bibliotekat, letërsinë, mediat, muzetë, filozofinë, si dhe religjionin. Qasja e dytë është kërkimi sipas titullit.

Përderisa dikush nuk dëshiron të shpenzojë orë të tëra duke kërkuar lloje apo emra të organizatave në Internet, atëherë nuk ka asgjë më të sofistikuar sesa titujt falas që ofrohen këtu.

Arsimi

Online: Peterson's College Database. Princeton, NJ: Peterson's, 1997 e deri më sot, e përvitshme, DIALOG fajlli 214, $30 për orë. Ofrohet edhe nga botuesit e tjerë.

CD: 1987 e deri më sot, e përvitshme. $595.

E shtypur: Peterson's "Core Library Set". Data të ndryshme, e përvitshme, 15 vëllime.

CD: Lovejoy's College Counselor. Filadelfi: Intermadia Active Software, 1994 e deri më
sot, e përvitshme. $99; edicioni profesional, $199.
E Shtypur: Lovejoy's College Guide. Nju-Jork: Monarch Press, 1949 e deri më sot, çdo gjashtë muaj. E shtypur, $14.95.

Udhëzuesit Peterson janë ndër botimet më të gjera, në të cilat mund të gjenden informacione të shumta rreth kolegjeve, universiteteve, shkollave të tregtisë nga gjithë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Edhe pse shumica e tyre kanë përmbajtje të njëjtë, vendi ku duhet filluar me kërkimin e informatave është përmbledhja e shtypur. (Këto vëllime mund të blihet edhe individualisht, apo një nga një). Botimi më i rëndësishëm është përmbledhja me katër vëllime: *Scholarships, Grants and Prizes, College Money Handbook*, si dhe *Four Year Colleges and Two Year Colleges.* Një tjetër pjesë mjaft e rëndësishme e përmbledhjes është vëllimi i gjashtë i quajtur *Guides to Graduate Study*. Në të jepen informacione të shumta për më shumë se 2 000 institucioneve (universitete katër vjeçare) dhe 1 500 kolegje dyvjeçare. Aty përshkruhen më se 800 000 bursa për studentë, ku ofrohet edhe një seksion i veçantë, në të cilin tregohet se si duhet aplikuar për këto ndihma financiare. Më se 1 600 ndihmesa financiare janë të përshkruara bukur në librin e parave apo në *Money book*. Për më shumë, përmbledhja përfshin gjashtë libra që analizojnë programet e magjistraturës në disiplinat kryesore dhe gjashtë vëllime të tjera që tregojnë rreth mundësive të punësimit.

Një ndër listat më të mira të universiteteve dhe kolegjeve është ajo nga seria e botimeve elektronike Peterson, që njëherësh ofrohet falas. Të gjitha institucionet e vendit (SHBA) të edukimit të lartë gjenden në botimin e shtypur *Guide to Two Year Colleges and Guide to Four Year Colleges*, të cilat formojnë një bazë elektronike të dhënash. Hulumtimet apo kërkimet mund të bëhen sipas logjikës Boolean dhe kështu kërkimi mund të kufizohet vetëm për një institucion, subjekt, fushë, çmim, apo diçka të tillë. Të dhëna të plota jepen rreth kërkesave për programet pas-diplomike, programet e trajnimeve speciale, si dhe për numrin e profesorëve dhe studentëve.

Peterson ka edhe një web-sajt që ofrohet falas në Internet. Ju mund ta vizitoni atë në këtë adresë: (www.petersons.com). Disa kërkime mund të bëhen falas, mirëpo për pjesën tjetër duhet paguar. Peterson duhet të merret në konsiderim për blerje nga bibliotekat që zgjedhin të mos

bashkëpunojnë apo nuk blejnë nga firmat komerciale të mëdha. Po ashtu, shiko edhe konkurruesin komercial të Peterson, p.sh. *College Board*, e cila po ashtu lëshon në botim disa udhëzues mbi arsimin. Produktet e tyre shpesh përdoren nga njerëzit këshilltarë të shkollave të mesme. Nëse dëshironi t'i shikoni ofertat e tyre, atëherë vizitoni: (www.collegeboard.com).

Një shërbim i njëjtë quhet Peterson's GRADLINE (ofrohet Online dhe në CD-ROM) ofron përshkrime në detaje për më shumë se 30 000 programe nga fakulteti dhe ato nga magjistratura në më shumë se 1 500 kolegje dhe universitetet të akredituara. E modifikuar me informata çdo vit, CD-ROM versioni kushton $695 kurse kërkimi Online në DIALOG fajlli 273 kushton $60 për orë. Pjesa më e madhe e bibliotekave dëshirojnë shërbimin e parë nga shërbimet e tjera. Universitetet i dëshirojnë që të dyja.

Botimi i shtypur që korrigjohet shpesh quhet *Comparative Guide to American Colleges* (Nju-Jork: HarperCollins). Në të shpjegohet shkolla më e mirë për personin që është duke kërkuar shkollën më të mirë në aktivitetet sociale apo ato akademike, apo që të dyja. Në të përshihen të gjitha informacionet, duke filluar nga kërkesat dhe gjërat që duhet për t'u pranuar, përbërja raciale dhe etnike e studentëve, deri te jeta sociale e studentëve. U jep përgjigje pyetjeve se sa meshkuj dhe femra janë të rregulltë brenda kompleksit studentor apo çfarë përqindje e studentëve mund të shkojnë në shkolla pasdiplomike. Shumica e studentëve theksojnë se është mjaft i saktë. Listat jepen sipas emrit të qendrës akademike dhe në fund të librit gjendet një indeks sipas subjektit. Pra, nga kontabiliteti deri te bibliotekat shkencore dhe zoologjia.

Një vepër standarde në këtë fushë është edhe *American Universities and Colleges*, (Nju-Jork: Walter deGruyter, 1928 e deri më sot) e cila jep informacione të hollësishme për më shumë se 1 900 institucione. Në të, lexuesi mund të gjejë përgjigje për pyetjet e tipit se kush çka shpjegon, numri i studentëve, forma dhe zgjatja e programeve edukative profesionale dhe atyre pasdiplomike. Shkollat janë të listuara sipas shtetit dhe qytetit, mirëpo jepen edhe indekse dhe disa shtesa të tjera, të cilat listojnë shkollat ROTC, kodet e veshjes, e kështu me radhë. Qindra udhëzues njëvëllimësh në formatin e shtypur ofrojnë detajet dhe informacionet që kërkojnë shumica e studentëve dhe prindërve. Merreni për shembull, stafin arsimor, i cili tregohet këtu në numër, e po ashtu edhe sipas gjinisë dhe rolit të tyre. Informacione rreth së kaluarës, historisë dhe së tashmes së sis-

temit amerikan të arsimit jepen në çdo edicion. Mirëpo, kjo ka edhe një të metë. Zakonisht, të dhënat statistikore janë tre apo katër vjet pas datës kur ishte lëshuar në botim edicioni i kaluar dhe botohen çdo katër apo pesë vjet. (Edicioni 15 u botua në vitin 1997 për një çmim prej $199.95).

Informacione të hollësishme për kolegje, universitete, shkolla ekonomike, programe pasdiplomike dhe aspekte të tjera të arsimit të avancuar mund të gjenden në linkat që jepen në udhëzues.[31] Shumica e tyre janë në formate elektronike e po ashtu edhe në formatet e shtypura. Ju mund ta parashikoni kohën kur të gjitha këto linka dhe udhëzues në formatin e shtypur do të zëvendësohen nga një bazë elektronike Online e të dhënave.

Në Internet[32]

Në të shumtën e rasteve, çdo kolegj, universitet dhe shkollë ekonomike në Shtetet e Bashkuara apo në Kanada, e po ashtu edhe në pjesët e tjera të botës, ka web-sajtin e saj apo diçka të tillë në Internet. Vetëm shënoni emrin e një shkolle në kutinë e web-sajtit kërkues dhe menjëherë, ju do të shihni më shumë informacione sesa ndoshta do të dëshironit. Ka edhe filtër të ndryshëm për këto informacione. Edhe pse është një vend i mirë për të filluar kërkimin, web-sajti e shkollës apo e kolegjit, që po kërkoni, është pak më shumë sesa një broshurë e marrëdhënieve me publikun që ofrohet Online, të cilës zakonisht i bashkohen edhe disa katalog. Megjithatë, mos harroni gazetat e kolegjeve. *The College Press Network* (www.cpnet.com) ka linka për më shumë se 300 gazeta.

Zgjedhja më e mirë, dhe e parë, janë udhëzuesit e shtypur dhe elektronikë, që u përmendën më lart. Përveç tyre, ofrohen edhe linka për web-sajte akademike, të cilat shfrytëzohen më shumë për detaje të caktuara

---

[31] Peterson dhe Lovejoy janë zgjedhur në këtë libër për shkak se janë tipike. Mirëpo, nuk janë vetëm këto dy botime që rekomandohen, nga shumë tituj tjerë të referencave. Megjithatë, këto dy vepra janë përfaqësuese të tyre. Për shembull, shumica e bibliotekistëve favorizojnë College Blue Book (Nju Jork: Macmillan, edicioni 27, 1999, 5 vëllime) i cili është një udhëzues superior për mijëra kolegje dhe universitete në Amerikë dhe Kanada. Ofrohet në versionin e shtypur dhe në CD-ROM- për një çmim të njëjtë: $250. Shënim: Kjo vepër modifikohet me informata shumë shpesh.

[32] Për diskutimin e këtyre ueb faqeve si dhe web-sajteve të tjera, shiko Yahoo! Internet Life, shkurt, 1999, f. 126, Web-sajtet "Preparing for College", të cilat ndihmojnë me testet që duhet për t'u pranuar në këto kolegje. Po ashtu, shiko edhe: "Site Seeing-College Searches", The New York Times, 28 shtator, 2000, f. G7. Dhjetëra web-sajte "për studentët të cilat po fillojnë kërkimet për kolegje".

sesa për informacione aktuale.

Disa nga përfaqësuesit e web-sajteve që ofrohen falas janë:

College Net (www.collegenet.com). Në radhë të parë, ky web-sajt e vë në kontakt shfrytëzuesin me web-sajtet e universiteteve dhe të kolegjeve në Shtetet e Bashkuara dhe në Kanada. Varësisht nga web-sajti lokale, vizituesi i web-sajtit mund të bëjë çdo gjë, duke filluar nga gjetja e numrit të programeve në studimin X apo Y deri te bursat, që ofrohen dhe kërkesat për pranim në atë kolegj apo universitet. Disa ju lejojnë që t'i dërgoni aplikacionet tuaja Online. Duke ju falënderuar një programi të kërkimit që është mjaft i rafinuar, ju mund të kërkoni kolegje duke vlerësuar disa kategori si shteti, pagesa, niveli i arsimit, si dhe numri i studentëve. Ky sistem modifikohet rregullisht dhe ka një ndër dizajn më të mirë në Internet.

Money Magazine (www.money.com/money) e cila çdo vit lëshon në treg një botim rreth kolegjeve dhe universiteteve, ka futur këto të dhëna edhe në Internet. Tani, studentët mund të kërkojnë për kolegjin më të mirë duke përdorur 42 faktorë të ndryshëm, duke filluar nga çmimi i shkollës dhe i dhomës, deri te numri i ditëve me diell në lokacionin ku gjendet kolegji. *U.S. News and World Report*, që ofrohet Online dhe në versionin e shtypur, ofron një shërbim të njëjtë duke listuar 25 shkollat më të mira: (www.usNews.com). Një web-sajt më objektive është: *College Rankings* (www.library.uiuc.edu/edx/rankings.htm). Këtu, radhitja e kolegjeve vendoset nga Daniel Burgard, bibliotekar në Universitetin e Illinois. Informacionet merren nga burime të besueshme, të cilat kanë shumë pika shënimi.

Pure Advice (www.pureadvise.com) është një shërbim falas, i cili ofron sesioni këshilluese, kokë më kokë, për t'i ndihmuar studentët e shkollave të mesme, që të vendosin se cili kolegj është më i miri për nevojat dhe mundësitë e tyre. Kjo kushton rreth $75 për një bisedë 45 minutash me një këshillues me përvojë. Kjo ndiqet nga një përmbledhje e shkruar e sesionit. Ky shërbim duket se është i besueshëm. Shënim: një pjesë e tij ofrohet falas, p.sh. të dhëna të shumta rreth kolegjeve dhe universiteteve të caktuara në SHBA. Në anën tjetër, organizata rivale *Achieva* (www.achieva.com) bën po të njëjtën gjë dhe gati më të njëjtin çmim. Për më shumë, ata i ndihmojnë studentët në përgatitjet e tyre për teste, aplikacione, strategji, rezyme, CV etj.

BIBLIOTEKAT

Shih Kapitullin 4, Bibliografitë.

STATISTIKAT

Online: CIS Statistical Universe, Bethesda, MD: Congressional Information Service,
1973 e deri më sot, www.lexis-nexis.com. Çmimet ndryshojnë.
CD: Statistical Masterfile, Bethesda, MD: Congressional Information Service,
Incorporated, mesi i viteve 1960ta e deri më sot, çdo tre muaj. Çmimet ndryshojnë.
E Shtypur: American Statistics Index. 1973 e deri më sot, çdo muaj. *Statistical*
Reference Index. 1980 e deri më sot, e përmuajshme, *Statistical Reference*
Index. 1983 e deri më sot, e përmuajshme. Shënim: Çmimet ndryshojnë, mirëpo çdo njëra nga to kushton diku rreth $2.000 në vit.

Online: Statistical Abstract of the United States, Uashington, DC; Byroja e Regjistrimit, 1995 e deri më sot, e përvitshme, www.census.gov/statab/www. Ofrohet falas.
CD: 1993 e deri më sot, e përvitshme. $50.
E Shtypur: 1879 e deri më sot, e përvitshme, 980 f. $30.

Statistikat janë një labirint i madh. Në ditët e sotme, Tezeut të sofistikuar i duhet shumë për të drejtuar një labirint, as më shumë e as më pak sesa të takohet me njeriun e njohur nga grekët si Minotauri. Nëse i kapërcen disa mijëra vjet, poeti skocez Andrew Lang të gjithë këtë e përmblodhi kështu: "Një njeri përdor statistikat sikurse ai njeriu i dehur që përdor shtyllën e dritës - pra më shumë për mbështetje sesa për ndriçim".

Natyrisht, se pak njerëz e kuptojnë labirintin statistikor. Ata e fshehin mungesën e besimit duke treguar disa mahi të mençura. Kjo duket si e vërtetë në mesin e bibliotekarëve që preferojnë më shumë kënaqësinë njerëzore sesa faqet e mbushura me kolumne dhe me shifra. Problemi më

i madh i një bibliotekari të referencave është identifikimi i një burimi, i cili do të përdorej për t'u përgjigjur në një pyetje të fshehtë, pra që është një pyetje e specializuar statistikore; po aq i vështirë është edhe përkthimi apo kthimi i pyetjes në terminologjinë statistikore. Duke pasur përpara një numër burimesh, nuk është fort çudi që në bibliotekat e mëdha eksperti në statistikë është po aq i rëndësishëm sa edhe bibliografi i subjektit. Normalisht, ky bibliotekar është i vendosur në dokumentet qeveritare ose në seksionin e biznesit.

Një vepër me referenca statistikore është mjaft e specializuar. Ky libër tregon burimet kryesore dhe të përgjithshme, të cilat duhet t'i dijë çdo fillestar. Qeveria Federale, e ndjekur nga qeveritë shtetërore, si dhe ato lokale ofrojnë numrin më të madh të dokumenteve statistikore. Një numër i agjencive botojnë këto dokumente rregullisht, dhe si të tilla janë një burim i rëndësishëm për të parashikuar edhe sektorin privat.

Në edicionin e vitit 2000, *Statistics Sources* (Farmington Hills: MI: Gale Group, 1962 e deri më sot, e përvitshme) listoj më shumë se 3 000 dokumente statistikore, të cilat qenë radhitur nën 20 000 tituj të subjekteve. Për të qenë më të saktë, duhet thënë se jo të gjitha këto dokumente janë botuar nga burimet qeveritare. Megjithatë, shumica e burimeve nga Qeveria Amerikane, e po ashtu edhe burimet nga 200 vende të tjera të botës janë të listuara në këtë botim.

Sa të besueshme janë të dhënat statistikore? Nëse ato të dhëna vijnë nga agjencitë federale, si dhe agjencitë më të mëdha shtetërore, atëherë është shumë e mundshme që këto burime të jenë të sigurta e të besueshme edhe pse ka përjashtime të caktuara. Shumica e gabimeve gjenden lehtë, mirëpo kur kemi të bëjnë me të dhënat statistikore ndërkombëtare gabimet janë më të shpeshta për shkak se ka kufizime ligjore mbi agjencitë që edhe i mbledhin këto materiale. Organizatat dhe agjencitë që i mbledhin statistikat ndërkombëtare kanë ndikim të madh në atë, nëse të dhënat statistikore të prezantuara janë valide dhe të sakta. Natyrisht, këto të dhëna nuk janë ideale për shkak të kufizimeve politike apo për shkak se qeveritë, thjeshtë, nuk kanë fonde të mjaftueshme për të bërë kërkime dhe për të grumbulluar të dhëna statistikore.

Është gjë e ndryshme që të mbledhësh statistika e krejt tjetër çështje që t'i kuptosh dhe t'i interpretosh ato të dhëna. A ka ndonjë njeri, i cili nuk e ka dëgjuar shprehjen: "Të dhënat statistikore gënjejnë"? Statistikat janë më shumë pjesë e artit sesa e shkencës. Numrat do të thonë shumë pak

nëse nuk interpretohen drejt. Dhe, kjo është pikërisht fakti që i bën të padobishme dhe hutuese shumë vepra statistikore të botuara nga qeveria. Shumë rrallë jepen këshilla se si duhet interpretuar të dhënat dhe për të kuptuar se çka thonë.

Indekset

Secili që ndihet në siklet me statistikat duhet ta urojë Zotin për tre indekset, që janë botuar nga Congressional Information Service, kompani e cila është pjesë e grupit botues të njohur, të quajtur LEXIS-NEXIS. Gati çdo pyetje që ka të bëjë me të dhënat statistikore mund t'i përgjigjesh duke përdorur këtë shërbim. Nëse përgjigjja nuk gjendet, zakonisht tregohet se ku duhet kërkuar përgjigja. Duke ju falënderuar abstrakteve të mrekullueshme, ju shumë rrallë jeni të detyruar që të shkoni te dokumenti i plotë. Së paku, kjo vlen atëherë kur kemi të bëjmë me pyetje rreth referencave të gatshme.

Indekset e shtypura, e po ashtu edhe ato elektronike, ndjekin një metodë themelore: (1) botohen çdo muaj, kanë një indeks i cili botohet çdo tre muaj dhe është përmbledhës, si dhe së fundi botohet indeksi i plotë një herë në vit. Kur kërkoni vëllimet në versionin e shtypur, ju duhet të filloni me indekset e përvitshme (pra që botohen një herë në vit) për të kuptuar titujt e subjektit dhe aranzhimin e përgjithshëm të indeksit; (2) indeksi, i cili është një seksion apo vëllim në vete, i tregon shfrytëzuesit dokumentin që është marrë nga botimi kryesor. Materiali është i indeksuar sipas subjektit, titullit, agjencisë apo shtëpisë botuese, individët të cilat kanë të bëjnë me dokumentin, e kështu me radhë. Secili dokument apo seri është e abstraktuar dhe në të jepen informacione të plota rreth agjencisë botuese, si dhe një histori e domosdoshme rreth statistikave. Shënimet në seksionin kryesor janë të aranzhuar apo të rregulluara sipas numrave. Gati të gjitha dokumentet ofrohen edhe në mikrofibe nga ERIS dhe shërbimet e tjera të ngjashme. Për më shumë, jepet edhe numri i kontrollit për të klasifikuar dokumentin. Duke dhënë një sistem mbështetës të tillë, bibliotekari ka një përmbledhje të jashtëzakonshme me të cilën mund t'i përgjigjet gati çdo pyetjeje statistikore.

Indekset, në versionin e shtypur dhe atë Online, janë shumë të lehtë për t'u përdorur posaçërisht për shkak se kanë shumë abstrakte të detajuara. Nuk ka vështirësi në gjetjen e një dokumenti. Në të vërtetë, shu-

micën e herëve abstraktet janë të mjaftueshëm në shumë pyetje që kanë të bëjnë me kërkim-hulumtimin.

Që të tre mbulojnë fusha të ndryshme. *American Statistics Index*, i indekson dhe abstrakton gati të gjitha burimet statistikore – gati 500 - të cilat botohen nga qeveria federale. Ky botim përfshin edhe përmbajtjen e më shumë se 800 periodikëve. Ka shënime për gati 10 000 raporte të ndryshme, studime, artikuj, e të ngjashme. Botimi binjak i tij, *Statistical Reference Index* indekson dhe abstrakton dokumentet shtetërore. Pra, nuk i përfshin dokumentet federale. Në të përfshihen edhe shumë dokumente statistikore që nuk kanë të bëjnë me qeverinë. Këtu hyjnë ato dokumente të cilat janë botuar nga firmat private apo individët, bizneset, organizatat jo fitimprurëse e deri te asociacionet. *Index to International Statistics* përfshin botimet dhe të dhënat statistikore më të mëdha qeveritare, të cilat vijnë nga e gjithë bota. Theks i veçantë vihet në vendet e Evropës Perëndimore, përfshirë komunitetin evropian. Është një burim i jashtëzakonshëm i të dhënave statistikore i Kombeve të Bashkuara. Sikurse edhe në indekset e tjera, edhe këtu analizohen periodiket (rreth 100). Gati të gjitha botimet janë në gjuhën angleze, mirëpo ka edhe disa që janë në gjuhën spanjolle.[33]

Kërkimi i indekseve të ndryshëm është i mjaftueshëm. Shiko dhe kërko subjektin apo emrin. Shiko për numrin apo numrat që ju jepen dokumenteve. Pastaj, kthehu në faqen e parë të vëllimit. Në të, ju do të gjeni një abstrakt nga përmbajtjet e dokumentit.

Versioni Online i *Statistical Universe*, sikurse edhe ai në CD-ROM, *Masterfile*, ka një përparësi të madhe për shkak se lejon një kërkim të vetëm. Kërkimet mund të bëhen në disa mënyra, edhe pse qasja në titull, agjenci apo subjekt është më e drejtpërdrejtë. Versioni Online ka një përparësi të jashtëzakonshme për faktin se lejon shfrytëzuesin të kërkoj tri shërbime në të njëjtën kohë. Pastaj, gjendet edhe një indekse i vlefshëm i "kategorizuar", i cili analizon të dhënat në disa kategori si viti, të hyrat financiare, shtetet, lloji i legjislacionit, e kështu me radhë. Mbi të gjitha, versioni Online është superior në krahasim me formatin e shtypur. Për më tepër, versioni Online mund të përdoret shumë më lehtë nga personat laikë.

[33] Për një shpjegim më të detajuar se çka ofrohet në versionin e shtypur dhe atë Online, shiko web-sajtin e CIS Statistical Universe në adresën (www.lexis-nexis.com/cispubs).

Vjetarët

Statistical Abstracts of the United States është burimi kryesor i të dhënave statistikore amerikane, të cilat shfrytëzohen gati nga të gjitha bibliotekat. E mbushur me më shumë se 1 500 tabela dhe grafike, kjo vepër shërben për të përmbledhur trendët sociale dhe ekonomike. Udhëzuesi është i ndarë në 34 seksione kryesore-prej arsimit dhe popullsisë deri te tokat shoqërore – me një indeks të detajuar prej 40 deri 50 faqe, i cili përfshin fushat nga aborti deri te zoologjia. Po ashtu, duhet theksuar edhe seksioni përfundimtar, i cili mbulon të dhënat statistikore kryesore të shteteve. Pa marrë parasysh indeksin e mirë, gati mbi 500 000 të dhëna statistikore nuk janë edhe fort lehtë të kuptueshme. Për shembull, ka nevojë për një shpjegim më të mirë të figurave. Bibliotekarët e referencave duhet të studiojnë me kujdes çdo edicion.[34] Si një profil i Amerikës, botimi *Statistical Abstracts* fokusohet kryesisht në gazetari. Në çdo vëllim, që botohet një herë në vit, përfshihet një grup me tregime nga revistat dhe gazetat. Kjo ka të bëjë me faktet e çuditshme dhe të dhënat statistikore. Një shembull tipik, edhe pse shkrimi i tij është më i mirë se të tjerët, është tregimi i shkruar nga një shkrimtar anglez. *Abstract* raporton se "në një vit, afro 400 000 amerikanë kanë pësuar lëndime si pasojë e shtretërve dhe jastëkëve... Ajo që dua të them këtu nuk është fakti se në SHBA jemi më të paaftë dhe të ngathët nga pjesa tjetër e botës, kur kemi të bëjmë me gjumin dhe shtrirjen në krevat; ajo që dua të them është se të dhënat statistikore të cilat grumbullohen në këtë vend nuk pushojnë kurrë".[35]

Ka edhe shumë botime të tjera të referencave statistikore, të cilat kanë raporte po aq interesante për opinionin publik. Një shembull i mirë, që duhet të jetë pjesë përbërëse e çdo përmbledhje të referencave, është edhe: *Statistical Handbook on the American Family* (Feniks, AZ: Oryx Press, 1999, $62.50).

---

[34] Statistical Abstract gjendet në domenin publik sikurse edhe të gjitha botimet dhe dokumentet e tjera të mëdha të referencave të botuara nga Qeveria, pra nuk ka të drejta autoriale për to. Si rezultat i kësaj, botuesit shpesh i marrin këto botime, i shtojnë disa veçori dhe i ribotojnë- zakonisht për një çmim më të lartë. Shembull: The Statistical Abstracts of the United States, Library Edition (Lanham, MD: Bernan, 1998, $50). Ky botim është identik me atë botimin qeveritar, por vëllimi i tij është dy herë më i madh sesa i botimit qeveritar. Për më shumë ky botim ka dy përparësi: "shkronjat në të janë 25 % më të mëdha", bazuar në atë çka thotë botuesi, dhe së dyti "formati ynë... ka një studim...bindës".

[35] Bill Bryson, "You See, Doctor, My Pillow Hit Me", The New York Times, 20 maj, 1999, f. 26.

Dy tituj të tjerë të vlefshëm, të cilët mbulojnë të dhënat statistikore rreth historisë amerikane janë *Historical Statistics of States of the United States* (Westport, CT: Greenwood Press, 1994, 478 f.), si dhe *Historical Statistics of the United States* (Uashington: Government Printing Office, 1976, CD-ROM, 1997. $195). Botimi i parë ka 18 artikuj të dhënash, për secilën dekadë, duke filluar nga 1970 deri në vitin 1990, dhe për secilin shtet. Theks i veçantë vihet edhe në territore. Kurse botimi i dytë shtjellon dhe tregon të dhënat historike nga viti 1790 deri në vitin 1970, mirëpo kësaj radhe këto të dhëna tregohen për të gjithë vendin (SHBA). Këtu, ju mund të gjeni të dhënat dhe shifra, ku krahasohen rrogat, prodhimi, bujqësia, e kështu me radhë. Shënim: Versioni CD-ROM i vitit 1997 nuk ka të dhëna shtesë nga vëllimet e shtypura, p.sh. nga viti 1970.

Shumica e vendeve perëndimore ndjekin shembullin e njëjtë të krijuar dhe të përdorur nga Qeveria amerikane në botimin e botimeve të ngjashme si *Statistical Abstracts* dhe informacioneve të specializuara statistikore. Për shembull, Anglia boton veprën *Annual Abstracts of Statistics* (Londër: Her Majesty's Stationery Office, 1854 e deri më sot). Në skenën ndërkombëtare, botimi më ekuivalent i tij është *United Nations Statistical Yearbook* (Nju Jork: The United Nations Publications, 1949 e deri më sot, e përvitshme), e cila mbulon të dhënat kryesore prej më shumë se 150 vendeve të botës. Të dhënat janë të ndara në disa kategori nën titujt e subjektit.

Informacionet statistikore vështirë se mund të kufizohen dhe të përfshihen vetëm në këto burime. Të dhëna të tjera, shumë të vlefshme, do të gjenden edhe në indekset e tjerë siç janë: *Public Affairs Information Service Bulletin*, ABI/INFORM, *Business Periodicals Index*, dhe çdo shërbim tjetër i cili raporton rregullisht në aktivitet e qeverisë dhe bizneseve si p.sh. *Predicasts.* Botimi *Facts on File* përfshin në vete të dhëna statistikore dhe siç u tha më parë është një vend i mirë për të gjetur më shumë të dhëna rreth një çështjeje të caktuar. Një botim tjetër, goxha i ngjashëm me të, është edhe *A Matter of Fact* (Ann Arbor, MI: Pierian Press, 1984 e deri më sot, e përvitshme), e cila ofrohet në versionin e shtypur dhe atë Online. Ky botim merr të dhëna statistikore nga përafërsisht 300 gazeta dhe periodikë, si dhe shumë dokumente qeveritare. OCLC e ofron këtë botim Online me emrin *Fact Search.*

Shumica e profesioneve kanë edhe librat e tyre që u shërbejnë shumë fillestarëve në statistika. Në botën e bibliotekës për shembull, udhëzuesi më i mirë është *Descriptive Statistical Techniques for Librarians* (edi-

cioni 2. Çikago: Asociacioni i Bibliotekës Amerikane, 1997. 497 f. $55). Ky tekst, që është redaktuar nga Arthur Hafner është lehtë i kuptueshëm në aspektin se si duhet përdorur të dhënat statistikore në vlerësimin dhe paraqitjen e shërbimeve të bibliotekës. Pjesa më e madhe e tij vlen për të gjitha llojet e të dhënave statistikore.

Në Internet [36]

Duhet thënë se nuk ka edhe shumë web-sajte statistikore në Internet. Si edhe një numër i madh i veprave të tjera të referencave, të dhënat statistikore janë shumë të rëndësishme për botuesit, kështu që ata nuk mund t'i ofrojnë vetes që këto të dhëna t'i ofrojnë falas në Internet. Fatmirësisht, Qeveria ka një filozofi tjetër. Me përjashtim të *Statistical Abstracts,* që ofrohet falas, ofrohet edhe një bazë qeveritare me të dhëna statistikore e quajtur *FedStats* (www.fedstats.gov). Duke marrë të dhëna statistikore nga më shumë se 70 agjenci shtetërore të Qeverisë amerikane, ky web-sajt është vendi më i mirë, që të kërkohen të dhëna të sakta statistikore, të cilat janë mbledhur nga Qeveria e SHBA-së. Kërkimi këtu bëhet duke shënuar fjalët kryesore, subjektet, apo edhe agjencitë. Për shembull, "të hyrat financiare të klasës së mesme shoqërore" do të rezultojë në tetë citime të cilat kanë edhe shënimet e tyre, dhe nëse është nevoja jepet qasje edhe te teksti i plotë i dokumentit. Duke filluar kërkimin mbi të ashtuquajturat "rrënime" ambientale dhe me Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit, kërkimi është i kufizuar te një grup i caktuar i të dhënave statistikore, dhe i cili tregon në mes të gjërave të tjera edhe 10 substancat më të rrezikshme për ambientin. Është i lehtë për t'u përdorur si për fillestarë ashtu edhe për ata që merren me statistikë.

Po ashtu, shiko edhe: *U.S. Census Bureau* (www.census.gov). Profili më i mirë statistikor i vendit tonë (SHBA) mund të gjendet në kategoritë e subjekteve që lexohen lehtë dhe që janë indeksuar mrekullueshëm nga shkronja A deri te Z. Edhe pse në radhë të parë u kushtohet ekspertëve (thelbi kryesor i statistikave gjenden në *Statistical Abstracts*), kjo mund t'i

[36] Paula Bernstein, Finding Statistics Online. (Medford, NJ: Information Today, 1998). Ky botim ka të bëjë me atë se si duhet drejtuar burimet statistikore të cilat mund të përdoren falas nga personat laik dhe nga bibliotekistët përmes Internetit. Në të jepet një numër i madh i adresave të web-sajteve, si dhe një analizë mbi ata të cilët mblodhën të dhënat statistikore. Në seksionet e mëvonshme, autori i tregon lexuesit hapat kryesor në mbledhjen e të dhënave statistikore, duke dhënë edhe shem-

kryej goxha punë edhe njeriut tjetër laik, i cili kërkon të dhëna statistikore aktuale. Modifikimi me informata bëhet rregullisht dhe me një sasi të madhe të materialeve, përfshirë këtu edhe qasjen në regjistrimin e popullsisë. Temat janë shumë mirë të definuar dhe zakonisht u japin përgjigje pyetjeve të zakonshme që mund të shtrohen. Po ashtu, në të jepen edhe linka për web-sajte të tjera relevante.

Komuniteti evropian duket se ndjek shembullin e njëjtë që është dhënë nga Qeveria Amerikane- pra shumë web-sajte ofrohen falas. Në statistikë, kjo do të thotë që të shikoni dhe ta vizitoni web-sajtin e *Organization for Economic Cooperation and Developement* (www.oecd.org). Këtu jepen të dhëna statistikore që krahasohen në mes vete jo vetëm nga vendet e Bashkimit Evropian, mirëpo edhe nga shumë vende të tjera evropiane. Pra, është vendi më i mirë që duhet vizituar për shkak se të dhënat janë të kuptueshme. Po ashtu, është web-sajti, e cila i jep përgjigje çdo pyetjeje për vendet jashtë Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Një burim më i madh i lajmeve nga biznesi dhe ekonomia mund të gjendet në web-sajtin e Departamentit Amerikan të Tregtisë: *Stat-USA Internet* (www.stat-usa.gov). Kjo është "një ndalesë në Internet, në të cilën mund të kërkosh informacione nga biznesi, tregtia, si dhe ekonomia". Ndahet në dy pjesë kryesore: "Gjendja e vendit" e cila ofron qasje në botimet ekonomike dhe biznesore, siç janë ato nga *Federal Housing Finance Board, State and Government Bond Rates*, etj. Pjesa e dytë e quajtur *Globus and NTDB* (National Trade Data Bank), ka informacione dhe të dhëna mbi komunikatat e kaluara dhe ato të tashme mbi tregtinë në tregun ndërkombëtar. Ky sistem modifikohet me informata, orë pas ore.

The Dismal Scientist (www.dismal.com) është një burim i mrekullueshëm dhe i jashtëzakonshëm rreth informacioneve aktuale dhe të dhënat statistikore të biznesit dhe fushave të ngjashme. Ky shërbim, që ofrohet falas, i merr të dhënat më të fundit statistikore nga agjencitë qeveritare mirëpo edhe ato private. Në të shumtën e rasteve, të dhënat janë të shpjeguara dhe janë të lehta për t'u kuptuar. Në aspektin biznesor, këto të dhëna japin shifra rreth aktiviteteve aktuale ekonomike, duke filluar nga papunësia deri te inflacioni. Edhe pse nuk është botim që mund të përdoret apo të këshillohet për investime, prapëseprapë mund të përdoret nga tregu i bursave (aksioneve). Po ashtu, duhet të keni parasysh faktin se në të mund të gjenden edhe të dhëna të tjera statistikore, të cilat mund t'i hyjnë në punë demografit, shkencëtarëve të shkencave shoqërore dhe gati

çdo njeriu, i cili merret me statistikë. Ka edhe përparësi të tjera, të shumta, të këtij web-sajti siç janë: raportet e paanshme rreth trendëve ekonomike dhe zhvillimeve. Ky web-sajt jep edhe linka të tjerë për web-sajte të tjera relevante. Emri i këtij web-sajti ka ardhur nga fjala e urtë dhe shumë e vjetër: "Shkenca e zymtë: ekonomia", apo nëse doni, në vend të saj mund të shënoni "shkenca shoqërore", "shkenca politike" etj.

Sugjerime për të lexuar

Arant, Wendi and Brian Carpenter, "Where is the Line", Reference & User Services Quarterly, Pranverë, 1999, f. 235-240. Ku e "shënon vijën e kuqe" bibliotekari kur ofron të dhëna legjislative, posaçërisht te njerëzit që luajnë rolin e avokatit të vetvetes? Të dy autorët ofrojnë një numër të madh të këshillave, të cilat do të ndihmojnë në zgjidhjen e këtyre problemeve. Po ashtu, ata japin edhe këshilla praktike se si duhet të ballafaqohen bibliotekarët me pyetjet ligjore.

Baker, Lynda M. Et al., "The Provision of Consumer Health Information..." Public Libraries, Korrik/Gusht, 1998, f. 250-255. Një raport mbi atë se çka bëjnë bibliotekat publike të shtetit të Miçiganit për të ofruar informacione medicinale shfrytëzueseve. Po ashtu, ky libër përfshin edhe një studim dhe një analizë nga letërsia. Në përgjithësi, shumica e bibliotekarëve pajtohen dhe e shfrytëzojnë një shërbim të tillë edhe pse kanë mëdyshje më mënyrën se si është shkruar dhe kompozuar.

Barnes, Julian, "Post Modernism: Adventures in Etiquette", The New Yorker, 12 prill, 1999, f. 102-109. Novelisti anglez shpjegon dallimin ndërmjet etikës profesionale angleze dhe asaj amerikane sikurse që tregohet edhe në edicionin e fundit të Emily Post. Autori zbulon se një libri i duhet më shumë vëmendje sesa autoritet dhe spontanitet të vazhdueshëm, p.sh. Amerikanët "duhet të relaksohen paksa".

Bell, Rudolph, How to Do It: Guides to Good Living for Renaissance Italians. Çikago: University of Chicago Press, 1999. Një studim-analizë rreth përdorimit të shpeshtë të udhëzuesve dhe manualeve në Renesancën Italiane, pra është një libër informative dhe argëtues. Madje, edhe analfabetët kënaqeshin duke shikuar udhëzuesit apo duke

dëgjuar dikë që i lexonte. Këshillat këtu jepen prej asaj se si duhet kujdesur për fëmijët deri te të rriturit dhe të moshuarit. Po ashtu, shikoni edhe titullin e ngjashëm: Mark Caldwell, A Short History of Rudeness, Nju Jork: Picador, 1999. Ky libër fokusohet më shumë në "sjelljet dhe rregullat në Amerikën moderne".

Di Su, "Quick Access: Find Statistical Data on the Internet", Information Outlook, Maj, 1999, f. 35+. Një bibliotekar i kërkimit ofron këshilla themelore se si duhet gjetur web-sajte të besueshme me të dhëna statistikore në Internet. Shumica prej tyre ofrohen falas. Analiza e Di Su dhe shpjegimet e web-sajteve është aq i mirë saqë artikulli i saj është pikënisje për çdo njëri, që tani ka nisur punën me të dhënat statistikore apo është një punëtor me përvojë në këtë fushë.

Freudenheim, Milt, "Medical Web Sites Transforming Visits to Doctors", The New York Times, 20 maj, 2000, f. 1&14. Edhe doktorët edhe personat laikë janë duke gjetur përparësi të mëdha në web-sajtet në Internet që kanë të bëjnë me mjekësinë. web-sajti, në mënyrë të jashtëzakonshme, përmirëson kujdesin mjekësor për pacientët që jetojnë larg nga qendrat medicinale. Edhe individët mund të gjejnë informacione rreth sëmundjeve dhe dhimbjeve, kështu që mund ta kursejnë veten nga vizitat nëpër mjekë. Artikulli i liston web-sajtet që më së shumti vizitohen nga mjekët.

Goldberg, Matt, "To Crib or Not to Crib? "Yahoo, Shkurt 2000, f. 162. Një shënim informativ i shkurtër për disa artikuj Online – që duhet paguar për të marrë shënimet nga web-sajti.

Janes, Joseph and Charles McClure, "The Web as a Reference Tool", Public Libraries, Janar/Shkurt, 1999, f. 30. Sa mirë mund t'u përgjigjesh pyetjeve rreth referencave të gatshme, duke përdorur Internetin? Varet ku dhe çfarë viziton. Nëse bibliotekarët janë duke kërkuar pyetjet, atëherë më shpejt do të gjendeshin nëse përdoret versionin i shtypur edhe pas niveli i përgjithshëm i tyre është i njëjtë. Mirëpo, Interneti ofron shumë më shumë mundësi sesa ato që mund të gjenden në botimet e shtypura. Është e qartë se bibliotekat duhet të shpejtojnë qasjen në Internet dhe bibliotekarët e referencave duhet të trajnohen më shumë.

Pagell, Ruth, "Information", Database, Shkurt/Mars, 1999, f. 34+. Një shpjegim i qartë se si botimet statistikore të nxjerra nga qeveria ribotohen më pastaj nga firmat private dhe i ofrohen publikut (apo bibliotekave). Këtu jepen burime specifike që edhe vlerësohen, përfshirë edhe web-sajtet Online. Pika më e rëndësishme janë sugjerimet se si duhet vlerësuar të dhënat statistikore e po ashtu edhe ribotimin e këtyre të dhënave nga firmat e tjera.

Poovey, Mary, A History of the Modern Fact. Çikago: University of Chicago Press, 1998. I nën titulluar si "problems of knowledge in the sciences of wealth and society". Ky libër është më shumë sesa një vështrim i thjeshtë mbi burimet e referencat e gatshme. Autori është shumë i brengosur me fakti sepse një lloj i përfaqësimit (faktet dhe shifrat) janë bërë të tilla saqë nuk mund të interpretohen. Pra, është një studim i jashtëzakonshëm, i cili ilustron gabimin që shumë njerëz dëshirojnë një fakt. Pra, njerëzve u duhet shumë më shumë sesa ajo që ata zakonisht marrin nga bibliotekarët.

White, Marilyn, "Historical Statistics of the United States..." Reference Services Review, Pranverë, 1998, f. 15. Mbulon zhvillimin historik të veprës përgjatë tri edicioneve dhe dy botimeve shtesë. Problemet e shumta, në radhë të parë ato financiare, e kanë bërë të pamundur modifikimin më të shpeshtë të kësaj vepre. Po ashtu, autori tregon edhe çështjet me të cilat u përballën autorët gjatë shkrimit të librit.

Zuger, Abigail, "Takes Some Strychnine and Call Me in the Morning", The New York Times, 20 Prill, 1999, f. F1, F9. Në 100 vjetorin e udhëzuesit Merck Manual, doktori shpjegon se si u zhvilluan udhëzuesi gjatë viteve dhe pse ka një rëndësi të madhe për doktorët, si dhe për personat laikë. Optimistët marrin kurajë në faktin se që nga edicioni i parë, nuk ka pasur shumë zbulime në mjekësi, p.sh. shih sugjerimet për mjekim në titullin e këtij artikulli. Dhe, kjo nuk është shaka.

KAPITULLI IX
BURIMET BIOGRAFIKE

Çfarë ka të përbashkët shtesa e gazetës të së dielës *Parade me Who's Who in America, The Dictionary of National Biography, dhe Stipple, Wink & Gusset: Men and Women Who Gave Their Names to History*? Përgjigjja: të gjitha këto libra u tregojnë lexuesve se çka njerëzit kanë bërë dhe janë duke bërë. Këto janë burime të thashethemeve, fakteve dhe piktura të jetës së përditshme. Këto janë gurë të çmuar të informacionit biografikë.

Në bibliotekë, në shitore të librave dhe në shtëpi, skica biografike ose libri janë të popullarizuar tej mase. Parada jetëshkurtër shpjegon statusin e *Spice Girls*. *Who's is Who in America* i radhitë aktivitetet e njerëzve eminentë, burra e gra, si dhe adresat se ku p.sh. mund të kontaktohet këngëtarja *Madona*. Dhe, *Dictionary of National Biography* ku kushtet e saj për të qenë në të janë që njeriu të jetë i vdekur, ofron disa orë të leximit zbavitës për njerëzit, sikurse Guy Burgess, spiun rus; John Christie, atentator i shumë njerëzve; mbretëresha Victoria, si dhe piktori Gwen John.

Në punën e referencave, përdorimi më i madh i biografisë është: (1) të fusë apo t'i listojë njerëzit e famshëm në profesionet e tyre, detyrat, ose karrierën e tyre; (2) ta vendosë materialin mbështetës për individët, për çdo arsye prej letrave të rënies së Romës e deri te një studim i sistemit të

frenave te automobilat modernë dhe (3) të fusë emrin e mundshëm të foshnjës.[1]

KËRKIMI I BURIMEVE BIOGRAFIKE

Në përcaktimin se cilin burim biografik duhet kërkuar, bibliotekari do të dëshirojë të dijë sa shumë histori nga jeta personale e personit të caktuar i duhet përdoruesit/shfrytëzuesit dhe çfarë të dhëna duhen domosdo. Pyetja se çfarë lloji i të dhënave është më e shpeshtë në situatën e referencave të gatshme. Mëdyshjet tipike janë këto: Cila është adresa dhe numri i telefonit i X personit?, "Si shkruhen emrat Y?", "Cila është mosha e personit R?", "Kur ka vdekur Betoveni?". Përgjigjet mund të gjenden në fjalorët mjaft të njohur biografikë dhe burimet nga udhëzimet. Qasja ndryshon me secilin titull, mirëpo të gjithë janë të njëjtë në atë se i listojnë emrat sipas rendit alfabetikë dhe në minimum japin profesionet dhe pozitat të personave të caktuar. Në raste të rralla, këto burime japin edhe informata të plota nga e kaluara, duke filluar nga data e lindjes dhe e vdekjes e deri te publikimet, emrat e fëmijëve dhe kështu me radhë. Informatat janë të zakonshme, edhe pse në formë të përmbledhjes. Shumë rrallë është në formën kritike.

Lloji i dytë më i madh i pyetjeve lidhur me biografinë vijnë nga personi/personat, që dëshirojnë informata të pjesshme apo komplete mbi një individ të caktuar. Pyetësi mund të shkruajë një letër, ta përgatisë një fjalim, ose është duke kërkuar material kritik mbi të kaluarën e atij personi. Dyshimet më të zakonshme janë këto: "Si mund ta shkruajë një artikull mbi Herman Melville?" "çka keni në (X), një shkencëtar eminent

[1] Janë shumë të dhëna të marra nga veprat, siç janë The Perfect Name of the Perfect Baby deri tek What Shall We Call the Baby? Diku e një vlere më të vogël, por për të njëjtin qëllim, Oxford University Press mbulon këtë fushë me dy vëllime: A Dictionary of First Names (1996) e cila përfshin më shumë se 7 000 emra prej të gjithë Evropës dhe Amerikës Veriore me shtesa në botën arabe dhe nën kontinentin indian. 480 faqet shpjegojnë arsyet e rënies dhe ngritjes së rëndësisë së emrave. A Dictionary of Surnames (1997) ka më shumë se 70 000 shënime me shpjegime për origjinën. Derisa janë shumë libra mbi emrat e foshnjeve, që mund të gjenden në biblioteka, një shikim i shpejtë në internet mund të bëhet tek Michigan Electronic Library (http://mel.lib.mi.us). Këtu mund të gjenden mijëra linka të "emrave" prej emrave të foshnjeve dhe Baby Names Online (për njerëzit që kurrë nuk marrin sasinë e mjaftuar të gjërave të mira) deri te Baby Names in Michigan. Një përdorim më i gjerë ugjerohet te linkat e: Nom de Guerre Pseudonyms të përdorur nga personat më të famshëm të të gjitha kohërave - The Pet Name Page.

amerikan?" "A ka ndonjë libër për Xhorxh Uashingtonin dhe për qershinë?" Përgjigjet mund të gjenden në burimet e referencave biografike, të cilat në fokus i kanë esetë (me shënime prej 300 fjalëve deri te disa faqe të gjata).

Si ndonjëri mund t'i gjejë veprat apo librat mbi referencat biografike në një bibliotekë të mesme apo të madhe publike ose në bibliotekën akademike? Janë disa qindra indekse digjitale dhe 20 deri 500 burime të shtypura, varësisht nga nevoja. Në të vërtetë, bibliotekës, sot i nevojiten shumë pak vepra të shtypura. Shumica e veprave mbi referencat biografike të shtypura janë shndërruar në formatin elektronik. Në formën Online, ato mund të kërkohen shumë më lehtë dhe të mbahen sa më aktuale.

Diskutimi këtu është i kufizuar vetëm në titujt e referencave. Nëse bibliotekari kalon nga seksioni i referencës në atë të leximit, ai do të gjejë mijëra biografi dhe autobiografike individuale. Personi që dëshiron informata biografike do të përdorë përmbledhjen e përgjithshme e po ashtu edhe seksionin e referencave.

VLERËSIMI

Etja për informata mbi të vdekurit dhe të gjallët i ka bërë të pasur shumë botues, përmbledhës librash dhe biografë (pa i përmendur këtu yjet e Holivudit që shkruajnë autobiografi). Nëse numri masiv i biografive që botohen çdo vit e ka bërë lexuesin dhe bibliotekarin më të pasur, është një çështje tjetër.

Si e di një bibliotekar nëse të dhënat e referencave biografike në formatin e shtypur ose bazat elektronike të të dhënave janë legjitime, autoritative dhe janë të mbështetura në material të saktë? Rregulla e gishtit të madh vlen edhe këtu si në të gjitha rastet e tjera: Titulli do të duhet të jetë i listuar në biografitë themelore, siç janë *Guide to Reference Books* dhe *Walford, American Reference Books Annual*, ose në shërbimet e recensioneve aktuale.

Shënim: Një përmbledhje mjaft e mirë e analizave është marrë nga ARBA prej vitit 1986-1997 është ARBA Guide to Biographical Sources (Englewood, CO: Libraries Unlimited, 1998, 400 f.).

Emri i botuesit është po ashtu një element tjetër që tregon për autoritetin e veprës. Katër botues janë përgjegjës për gati shumicën e titu-

jve mbi referencat biografike që janë të gatshme. Këto janë *Gale Group, H.W.Wilson Company, St.Martin's Press, dhe Reed/Reference publishing*. Nëse bibliotekari nuk e njeh botuesin dhe në veçanti nëse nuk është njëri nga këta katër botues, që i përmendëm më sipër, atëherë do të duhet të bëhen analiza të mëtutjeshme mbi atë botues. (Botuesit në treg prej Random House deri te Harper&Row botojnë burime të famshme biografike, mirëpo shumë pak tituj referencash).

Kujdes!

Duke pasur punë më shumë me egon dhe krenarinë individuale sesa me arritje dhe fakte, burimet e hershme të referencave biografike ishin burime të jashtëzakonshme të të ardhurave për ata që ndonjëherë quhet "brigada e filxhanit të vogël". Këta ishin njerëz që u vendosën në komunitete, i formuan librat biografikë të atij komuniteti dhe më pastaj i fusin të paguajnë njerëzit për çdo shënim tjetër. Këto "libra" janë shumë larg nga veprat legjitime që do të duhej të ishin. Mirëpo, historianët janë shumë falënderues për informatat që u japin amerikanëve, posaçërisht në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX.

Edhe sot ka libra të tillë me vlerë jo fort të lartë. Për shembull, një botues biografikë nga Karolina e Veriut, SHBA. Firma e tij në fillim të vitit 1998 i shkroi Brighton-it, një banor i Anglisë, duke i thënë se ai do të mund të hynte në librin e biografisë së personave më të rëndësishëm të mileniumit, i quajtur "Millenium Hall of Fame Book". Hall i përfshin emrat e njerëzve, të grave dhe burrave, të cilët e kanë bërë shekullin më të mirë.

Ky titull jo i mirë referencor kushton $3.75. Duke i shtuar $750 më shumë, ju mund të blini një pllakatë dhe një statujë. Në raportimin e kësaj, personi i "famshëm" do të thoshte: "Unë jam duke e lodhur trurin tim për t'i kujtuar të gjitha ato kontribute që i kam bërë për njerëzimin. Është e vërtetë se unë kam pasur një artikull të botuar në gazetën tuaj së fundi..."[2] Në këto lloje të burimeve biografike, gjithsecili luan një lojë "fer" për "krenari."

Zilet dhe dritat e kuqe duhet të rrahin fort dhe të ndizen kur botuesi insiston që personi i famshëm ta blejë librin(at) përpara se një shënim është i mundshëm. Ky është një shenjë e vjedhjes. Natyrisht, edhe burimi më legjitim shumicën e herëve sugjeron që individi ta blejë librin; mirëpo,

[2] "Letters," The Times (Londër), 6 shkurt, 1998, f. 21.

ka dallim të madh në mes të sugjerimit dhe "insistimit". Për shembull, *Reed Who's Who in America* e përfshin emrin e individit në libër, pa e detyruar atë individ që ta blejë librin. Në të njëjtën kohë, një valë e letrave do ta shtyjë për ta bërë blerjen "disa gjëra posaçërisht për ju". Këto tregojnë "simbolin e fundit të të arriturave tuaja," dhe kushtojnë prej $65 deri në $150. Aq sa duket e çmendur, është shumë e leverdishme për kompaninë. E gjithë kjo është legjitime. Blerja e një libri ose një pllakatë të murit nuk ka të bëjë asgjë me pranimin apo refuzimin e *Who's Who in America.*

Pikat e tjera të vlerësimit

Përveç botuesit, si e di bibliotekari nëse burimi biografik është i besueshëm ose jo? Pyetja kryesore këtu vlen si për burimet e shtypura, ashtu edhe për bazat elektronike të të dhënave. Janë disa teste:

Zgjedhja. Pse është i zgjedhur emri (ose i refuzuar) për shumë ndihmë të referencave biografike? Ky proces është goxha i lehtë për t'u treguar. Përmbledhësi i materialit i përfshin të gjithë emrat, të cilat kualifikohen për temën e librit sikurse në *American Men and Women of Science* ose *World Authors*. Në të dy rastet, Interneti më i gjerë përfshin autorë dhe figura që janë me interes. Ka edhe të meta, mirëpo ato janë aq të mëdha për t'i shkaktuar vështirësi përmbledhësit.

Botuesi mund t'i fusë në përdorim standardet automatike të selektimit (zgjedhjes) ose të refuzimit të burimit biografik. Shkurt (1) personi duhet të jetë ose i gjallë ose i vdekur; (2) individi duhet të jetë banor i një vendi të caktuar, regjioni, ose qyteti; (3) personi duhet të jetë i punësuar në profesion të caktuar apo lloj të punës. Një apo disa nga këto matje mund të përdoren në veprat referencore.

Redaktorët e veprave me reputacion të madh kanë krijuar edhe disa objektiva të tjera ose direktiva për përfshirje. *Who's Who in America* i përfshin disa njerëz "arbitrarisht duke u thirrur në pozicionet e tyre zyrtare". Kjo do të thotë se anëtari i Kongresit Amerikan, një guvernator, një admiral, gjeneral, ose një fitues i Çmimit Nobël është i përfshirë këtu automatikisht. Shumë njerëz të tjerë, në kategori të tjera, sikur e kanë vendin aty vetëm e vetëm për shkak të pozicioneve që mbajnë. *International Who's Who* është shumë i saktë në dhënien e informatave mbi anëtarët e të gjitha familjeve mbretërore që sundojnë. *The Dictionary of American Biography* e ka një qasje më strikte. Njeriu duhet të jetë i

vdekur për t'u përfshirë në të. Pasi të plotësohet ky kusht, redaktori fillon të bëjë selektimet dhe zgjedhjet e tij.

Janë disa shkallë të ekskluzivitetit. Është më e vështirë për të qenë i përfshirë në *Who's Who in America* sesa në *Who's Who in American Art*. Në disa raste është sikurse ajo thënia: "Mos na thirrni neve, ne do t'ju thërrasim" dhe përfshirja në libër ose jo varet edhe nga disa të arritura publike. Për të qenë i listuar në burime e tjera referenciale varet edhe nëse nuk je anëtar i ndonjë grupi profesional. Është shumë e vështirë të jeni jashtë titujve të tillë sikurse *Who's Who in the United Nations*, nëse ju punoni atje, ose në *Who's Who in Golf*, ju duhet të jeni ose profesionist ose fillestar shumë i njohur. Pjesëmarrja apo listimi në titujt biografikë varet edhe nga ajo nëse personi i përgjigjet kërkesës së botuesit për ta plotësuar një formë të shënimit. Dështimi për t'iu përgjigjur mund të thotë dështim në atë se personi i caktuar nuk do të futet në listë. Ka përjashtime në rastet kur personi është zyrtar i lartë i OKB-së ose një sportist golfi shumë i njohur, për të cilët botuesi i merr informatat lehtë.

Pastaj, po ashtu, ka edhe përjashtime automatike. Në rastin e veprave biografike me subjekt reference, përjashtimi është zakonisht evident në titull: Ju nuk shikoni për poetët në *Who's Who in American Art* ose *American Men and Women of Science*. Edhe pse *Dictionary of National Biography* tashmë i përfshinë disa kriminelë të njohur, disa burime biografike e ndalojnë zgjedhjen apo selektimin e personave prej yjeve të Holivudit deri te personat e njohur të sportit. Të tjerët llogarisin se çdo person i rëndësishëm, i pranueshëm, e i respektuar ose jo, duhet të përfshihet. Në të kaluarën, nënshkrimi i një letre me të cilën bëhej futja e personit në librin e referencave biografike ishte shenjë e moralit. Mirëpo, sot kjo vlen vetëm për pak libra. Një rregullativë editoriale më e matur dhe e mirë do të përfshinte çdo njërin, për të cilin dëshiron të dëgjojë opinioni publik - një rregullativë, e cila aplikohet nga *The New York Times Biographical Services* e po ashtu edhe nga *Current Biography*.

Një kundërshtim tipik për rregullat e selektimit dhe rregullat në *Who's Who* është bërë nga kritikët: "Është jo fort e vështirë për të parë në këto vepra (burime biografike) se si këta njerëzit e përfshirë në të janë të bukur dhe se si pjesa tjetër nuk vlen as pesë para... *Who's Who* është vetëm një vend ku të gjithë personat i shkundin CV-të e tyre. Të gjithë ne duhet ta presim ditën tonë dhe unë jam shumë i shqetësuar për të thënë se në këtë

[3] The Spector, 4 shkurt, 1995, f. 28. Në vitin 200, përmbledhja e njëjtë është e vërtetë edhe pse tani shumë më shumë femra janë të përfshira krahasuar me disa vjet më parë.

fole zogjsh, femrat dhe fëmijët nuk janë të parët". [3]

Audienca. Shumica e veprave referencore për biografi janë të botuar dhe si fokus kanë të rriturit, ani pse janë edhe disa (posaçërisht ato që kanë të bëjnë me libra dhe shkrimtarë) për njerëz më të rinj. Për një kërkues të rritur, veprat mund të ndahen sipas qëllimit, shkallës së shkollimit të përdoruesit/shfrytëzuesit, e kështu me radhë.

Gjatësia e shënimit. Pasi emri është zgjedhur, pyetja është: Sa hapësirë zë figura e caktuar, pesë apo gjashtë rreshta të faqes? Qëllimi dhe kufijtë e vetë librit mund të sugjerojnë përgjigjen e pjesshme. Të dhënat nga *Who's Who* thonë ose kërkojnë një përmbledhje të shkurtër të fakteve. Fjalori biografikë mund të jetë jo edhe aq i përmbledhur; lloji i esesë do të ketë qasje të njëjtë në shënimin e të dhënave konform formës së tij. Pa marrë parasysh qasjen, redaktori prapëseprapë duhet të vendosë rreth balancës dhe gjatësisë.

Autoriteti. Biografia filloi si një formë e pranueshme e aprovimit.

Ecclesiasticus (44:1) ka rreshtat e famshëm, "Le të fillojnë tash t'i lavdërojmë njerëzit e famshëm", dhe kjo ishte arsyeja e biografisë deri gati në shekullin XVII. Pas një periudhe relativisht sinqeriteti, duke përfshirë të famshmes nga *Boswell Life of Johnson* dhe *Johnson's own Lives of the Poets*, forma ndryshoi dhe u kthye në një lëvdatë të uniformuar në periudhën triumfale të shekullit XIX. Me influencën e Frojdit, në shekullin XX, lëvdatat e pafrenuara u futën në formë. Moda e ditëve të sotme është e vërteta në biografi, së paku për figurat historike. Njerëzit e gjallë, të cilët janë më në qendër të mediave dhe publikut sesa në sferën e fakteve do të punësonin një shkrimtar profesionist për ta shkruar biografinë e tyre- posaçërisht nëse është ese ose libër. Mirëpo, është shumë e vështirë për bibliotekarin të thotë e t'i ndajë faktet nga të thënat.

Mungesa e saktësisë dhe vërtetësisë së atyre që janë të listuar e që kombinohen edhe me redaktorët, jo shumë të mirë, rezulton në shënime bizare. Shirley Povich, një prej kolumnistëve më të mirë në sport në SHBA tha se gjëja më e çuditshme që i ka ndodhur ishte listimi i tij në *Who's What in American Women* në vitin 1958. "Redaktorët e kishin marrë një paragraf të tij në *Who's Who in America*, edhe pse ai paragraf thotë qartë se ai ishte martuar me Ethyl. Vitin e ardhshëm, ai thotë se ata e kishin hequr atë, sikurse do të bënin edhe në *New York Social Register*,

[4] The New York Times, 7 qershor, 1998, f. 35. Shënim: emri "Shirley" për mashkuj nuk ishte i pazakonshëm në shtetin Maine ku zotëri Povich kishte lindur në vitin 1906.

sepse ai ishte martuar më një striptizere - pra një hiç.[4]

Burimet e informatave. Sot, pyetja mbi autoritetin dhe besueshmërinë duhet të fillojë me një tjetër pyetje: Kush i shkroi shënimet biografike - editori, subjekti, një autoritet në këtë fushë, apo sekretaresha?

Disa mendojnë që qasja në rregullat biografike është shumë kritike në atë se subjekti për të cilin shkruhet ofron shumicën e materialit. Atij ose asaj i kërkohet që ta plotësojë formën standarde të botuesit dhe ta kthejë atë te botuesi. Pyetjet në këtë formë standarde janë nga më të ndryshmet duke filluar nga mosha, shkollimi, deri te të arriturat dhe adresat. Saktësia ose shënimi pastaj varet plotësisht në ndershmërinë e individit i cili/e cila e plotëson formularin. *Who's Who* (për shembull) nuk është aq shumë puna referenciale e biografie sesa është një autobiografi- pra ka dallim ndërmjet këtyre dy formave. Kjo ndoshta nuk çon automatikisht në tregimin e të pavërtetave, por i heqë ato fakte të autorit që janë të sekletshme për vetë autorin.

Në përgatitjen e gati çdo materiali, duke i përjashtuar informacionet statistikore, personi i cili i shkruan shënimet do të bëjë pa dyshim anësi të menduara ose të pamenduara. Edhe në rastin e prezantimit vetëm të të dhënave, nëse personi i biografisë i ka dhënë informatat (që ndodhë shumicën e rasteve në ditët e sotshme), mund të ketë edhe nënvlerësimi ose ekzagjerime sa i përket moshës (meshkujt gënjejnë më shumë për këtë sesa femrat), shkollimit dhe eksperiencës. Burimet biografike, që plotësisht mbështeten në ndershmërinë individuale nuk mund të besohen plotësisht. Kjo na çon në dyshim e ardhshëm: A janë cituar edhe informata të tjera mbi biografinë e atij personi, përveç informatave të dhëna nga po ai person? Paradhënia duhet t'i shpjegojë këto dy gjëra shumë qartë.

Është shumë mirë të dihet nëse biografia është përgatitur nga stafi redaktues i botuesit, nëse është redaktuar deri në një masë nga stafi i njëjtë dhe nëse i përfshin edhe të dhënat e shkruara nga njerëzit jashtë kompanisë botuese, pra nga ekspertët. Pika e fundit është procedura e zakonshme për biografitë e gjata dhe në formë të eseve.

Kur puna mbi referencën biografike është e dyshimtë në vlerë, duhet të verifikohet në një ose më shumë tituj të biografive. Nëse ende ka diçka që nuk mund të zgjidhet, çka duhet të bëhet? Zgjidhja e vetme është të tentohet e të ndiqet informata nga burimet e dorës së parë, sikurse janë gazetat, biografitë bashkëkohore, ose artikujt mbi individët ose familjarët apo shokët e tij/saj. Një shembull mjaft i mirë mund të gjendet në debatet aktuale në detajet e jetës së Shekspirit ose përpjekjet për t'i ndrequr faktet nga jeta e Sir Thomas Malory, autori i tregimeve mbi Mbretin Arthur dhe

kalorësit e tij.

Koha dhe shpeshtësia e botimit. Shumica e burimeve të referencave biografike botohen në një kalendar të rregulltë. Disa botohen ose lëshon në treg çdo vit, ose ndoshta çdo muaj derisa të tjerat freskohen me informata çdo tre ose pesë vjet. Me yjet e filmit dhe Holivudit që vijnë e shkojnë shumë shpejtë, është shumë e rëndësishme të dihet koha që e mbulon ajo shtesë ose ai botim. Shumica (edhe pse jo të gjitha) e librave të referencave biografike nuk janë libra të mirë për arsyen se nuk kanë procedura të rregullta në atë se kur freskohen me informata. Ky problem është eliminuar, në një pjesë, me bazat elektronike të të dhënave.

Pikat e tjera. A ka fotografi? A është materiali biografik nga personi që flitet e po ashtu edhe nga të dhënat e jashtme? A është libri i indeksuar mirë dhe i pajisur më numër të mjaftueshëm të referencave kryqëzore? (Kjo është e rëndësishme kur kërkohen lidhje të individëve me figura të mëdha, që mund të përmenden vetëm si pjesë e një skice të madhe biografike). A është puna dhe materialet të aranzhuara në mënyrë logjike? Qasja alfabetike është e zakonshme edhe pse disa vepra apo libra mund të aranzhohen ose rregullohen në mënyrë kronologjike sipas ngjarjeve, datave të lindjes, periudhave historike, ose fushave të interesit për vetë lexuesin. Nëse është në formën digjitale, ndihmësi ose udhëzuesi, i quajtur navigator duhet të kontrollohet shpesh.

Në të vërtetë në praktikë, pak nga këto teste vlerësimi përdoren. Nëse personi është mjaft i njohur, problemi nuk qëndron në burimet, mirëpo në shikimin dhe hulumtimin e disa burimeve të detajuara. Nëse individi është i errët, çdo burim është i mirëseardhur.

Në web-sajt (Internet)

Janë dy të meta kryesore te burimet biografike në Internet që ofrohen falas: (1) e para, e cila përmendet shumicën e herave në tekste, është mungesa e besueshmërisë dhe autoritetit të shumicës së web-sajteve. Për shembull, mund të thuhet se presidenti Kenedi ishte vrarë nga mafia, nga FBI, ose nga komunistët, ose nga (duke përmendur emrin ose personin). Thashethemet për personat dhe figurat aktuale nuk duhet të merren si fakte dhe po ashtu lidhjet për figurat historike nuk duhet të bëhen dhe të bazohen në sponsorët e web-sajteve, të cilët nuk dinë shumë nga historia për arsyen se nuk kanë të kryer më shumë se dy lënda të historisë. Përsëri,

identifikuesit kryesorë sikurse "edu," "org" ose "gov" të cilët shfaqen në adresa janë tregues të mirë për besueshmërinë e këtyre web-sajteve. Nëse është web-sajti individual ose komercial, kërkimet e mëtutjeshme duhet të bëhen për web-sajtin- së paku nëse informatat janë për më shumë se për argëtim dhe humbje kohe; (2) Interneti nuk jep përgjigje të menjëhershme në pyetjet për biografi. Shumicën e rasteve, një kërkim digjital është shumë më i lodhshëm dhe i gjatë sesa konsultimi me një burim standard të referencave.

Interneti bën punë shumë të mirë në rastet kur flasim për personat më pak të njohur, sikurse Ernest Shephard (ilustrator i *A.A. Milner's Winnie the Pooh*). Në fakt, Interneti shpesh mund t'i gjejë informata që s'mund të gjenden në ndonjë vend tjetër. Shih ndonjë president amerikan, ndonjë aktor të njohur, kompozitor ose artist dhe ju do të shihni materiale brilante dhe inferiore, të cilat mund t'ju harxhojnë orë të tëra. Një burim tipik i referencave i filtron këto materiale të panevojshme dhe kështu i kursen kohë lexuesit.

Michigan Electronic Library ofron një seksion shumë të mirë i cili përfshin qindra mijëra burime të biografive që ofrohen në Internet. Shih (http:mel.lib.mi.us) ku faqja e biografisë fillon me 4 000 vjet të gruas në shkencë dhe mbaron me 30 web-sajte sikurse ai i *TV Guide Motion Picture Database*, e cila ofron biografitë e aktorëve, regjisorëve, producentëve dhe filmbërësve. Këto ndryshojnë shumë kur flasim për gjatësinë e shënimeve dhe kohën në të cilën janë shkruar. Përsëri, web-sajtet më të mira shumicën e herëve janë më pagesë.

INDEKSET NË BIOGRAFI

Online: Biography Master Index. Farmington Hills, MI: Gale Group, 1991 e deri më sot, e përvitshme, www.galegroup.com). DIALOG file 287, $30 për orë.

CD: Biography and Genealogy Master Index. 1993 e deri më sot, e përvitshme. $1.250. Botimi me informata të reja çdo vit, $565.

E Shtypur: 1980, 8 vëllime., 1981-1985 e përmbledhur, 5 vëllime. Përmbledhja e 1986-1990, 3 vëllime. $810; Përmbledhja 1991-1995, 3 vëllime, $900. Shtesat vjetore, 1996 e deri më sot. $348 secila.

E Shtypur: Abridged Biography and Genealogy Master Index. 1995, 3 vëllime. $432.

E Shtypur: Almanac of Famous People, edicioni 6. 1994, 2 vëllime.

$115.
Online: Biography Index. Nju-Jork: H.W. Wilson Company, 1994 e deri më sot,
Çdo tre ditë, www.hwwilson.com). $25 deri $40 për orë. Po ashtu ofrohet edhe në OCLC.
CD: 1984 e deri më sot, tremuajshe. $1.095.
E Shtypur: 1947 e deri më sot, tremuajshe me përmbledhje vjetore. $135.

Online: World Biographical Index. Nju-Jork: K.G. Saur North America. 1998 e deri më sot, www.saur-wb1.de). Çmimi ndryshon.

Janë dy lloje të indekseve në biografi. E para përfaqësohet nga *Biography and Genealogy Master Index*, e cila është çelës i mbi 11 milionë shënimeve dhe diku rreth 450 000 që shtohen çdo vit. Me shtimin e shënimeve, numri i vërtetë i njerëzve të përfshirë në të është diku 4 milionë, të cilët mund të gjenden në më shumë se 900 fjalorë biografikë dhe fjalorë të tjerë, sikurse *Who's Who in America*. Qëllimi është të reduktohet kërkimi në udhëzimet themelore dhe aktuale që humbin shumë kohë.

Lloji i dytë i indeksit, i përfaqësuar nga *Biography Index*, përfshin citime të biografive që shfaqen në periodikë ose libra të zgjedhur. Qëllimi është të ofrojë një çelës në informatat biografike të personave të gjallë dhe atyre të vdekur prej një numri të madh të burimeve.

Lloji i parë mund të përdoret për referenca të gatshme kur lloji i të dhënave dhe i informacionit është i detyrueshëm. Lloji i dytë mund të përdorej atëherë kur kërkohen informata të detajuara për shkrime, projekte kërkimi, fjalime, ose prezantime. Për shembull, një përdorues që dëshiron ta gjejë adresën e Mary Doe duhet ta shikojë *Biography and Genealogy Master Index* për burime të të dhënave më të shkurtra në disa fjalorë biografikë të indeksuar. Përdoruesi ose shfrytëzuesi, i cili dëshiron ta shkruajë një letër mbi të arriturat e Doe-s dhe i nevojiten shënime të plota, duhet t'i shikojë informacionet biografike në periodikë, sikurse u tha në *Biography Index*.

Në kërkimin fillestar, ku jo shumë çka dihet për individin, *Master Index* preferohet si zgjedhje e parë. Nëse personi është mjaft i njohur për kërkuesin dhe faktet esenciale i ka në dorë, kërkuesi duhet të shkojë së pari dhe të kërkojë te *Biography Index*. Dy format themelore të veprave referenciale mund të përdoren ndaras ose së bashku, mirëpo ato janë hapi

i parë në çdo kërkim biografik.

Botuesi i *Biography and Genealogy Master Index* lëshon, çdo vit, nga një vëllim të ri dhe i përmbledh vëllimet vjetore çdo 5 vjet. (CD-ROM dhe versioni Online çdo vit freskohen me informata). Puna këtu është e aranzhuar në një alfabet të vetëm sipas mbiemrave të individëve. Pas emrave janë të shënuar datat e lindjes dhe të vdekjes dhe pastaj çelësi për një ose më shumë burime, në të cilat mund të gjenden shënime të shkurtra ose ese për individë të caktuar. Njerëzit e famshëm mund të kenë disa dhjetëra citime, mirëpo në të shumtën e rasteve nuk përfshijnë më shumë se dy ose tre citime.

Në mesin e 900 veprave biografike të indeksuara janë të dhënat e llojit *Who's Who* dhe lloji i esesë si *Dictionary of National Biography*. Në vitet e para, fokusi kryesor ishte tërësisht në stilin ose llojin e të dhënave, mirëpo kjo ka ndryshuar nga shkaku se botuesit janë duke indeksuar më shumë e më shumë burime biografike. Shumica e veprave standarde të botuara nga pesë botuesit më të mëdhenj të referencave biografike janë të indeksuara në *Master Index*.

Sa e përdorshme që mund të jetë e gjithë kjo për bibliotekarin, indeksi është shumë larg të qenit i përkryer. Botuesi, thjeshtë, i boton ose i publikon emrat e gjetur nga burimet. Nëse, për shembull, Joe Doaks e citon emrin e tij në këtë formë në *Who's Who in America*, mirëpo preferon Joe Vincent në *Who's Who in American Rat Catchers* dhe *Joseph V.P. Doaks në American Businesspeople*, emri i tij në mënyrë alfabetike do të aranzhohet në tri mënyra të ndryshme. Natyrisht, mund të jenë tre Doaks të ndryshëm, por data e lindjes tregon se ndoshta është personi i njëjtë. Vetëm për t'i bërë gjërat edhe më të paqarta, data e lindjes për personin e njëjtë mund të ndryshojë dhe kjo varet nga cili burim është indeksuar. Po ashtu, mund të jetë edhe listim i thjeshtë i emrit të njëjtë për katër ose pesë burime të ndryshme. Me të gjitha këto keqkuptime, një poemë tregon se si keqkuptimi mund të lindë: "Dewey e mori Manilën/ dhe shpejt pasi zbuloi sistemin decimal/ i cili i mban bibliotekarët nga kolapsi deri në ditët e sotme. Shumë nëna filluan shumë shpejtë t'i quajnë foshnjat e tyre meshkuj "Dewey", emër që e bënte atë të dobët... Në ëndrrat e tij, ai pa libra të bibliotekës me numra nga qumështi/ me anijen e tyre të shpejtë në Bregdetin Bay.[5]

[5] John Ashbey, "Memories of Imperialism, The Times Literary Supplement, 30 prill, 1999, f. 29. Për të qenë të sigurt, Ashbey i di dallimet në Deweys e tij, mirëpo i përdor vetëm dy emra në shërbimin për licencë poetike.

Janë disa versione të vëllimit të shtypur *Master Index*.

1. *Abridged Biography and Genealogy Master Index*. Ky e përfshin përmbledhjen themelore plus vëllimet shtesë, në të cilat shënimet janë shkurtuar nga 11 milionë në vetëm 2.2 milionë. Diku 226 burime aktuale dhe shumë të përdorura janë të analizuara. Bazuar në të thënat e botuesit, seleksionimi i burime biografike është bazuar në një analizë/studim mbi bibliotekat e vogla dhe të mëdha si p.sh. vetëm burimet standarde biografike janë të indeksuara. Freskimet me informata janë planifikuar të bëhen çdo pesë vjet.

2. *Almanac of Famous People*. Me qëllimin për ta sjellë këtë botim në ato kushte financiare që mund të ofrohen nga bibliotekat, kjo vepër ka të dhëna për më se 30 000 njerëz.

Sa gjatë Gale do t'i mbajë këto vepra në versioni e shtypur nuk është e sigurt, mirëpo shanset janë që këto botime të shtypura do të shndërrohen në një bazë të të dhënave Online, p.sh. *Biography Master Index*. Në çdo çmim, versioni Online është shumë më i shpejtë dhe i lehtë për t'u përdorur.

Janë disa argumente dhe fjalosje për kërkimin në bazën e të dhënave Online: (1) kërkimi mund të bëhet me datë të lindjes ose vitin e vdekjes. Pasi bëhet kjo, ekrani tregon të gjithë njerëzit që kanë vdekur ose që kishin lindur në kohën që është shënuar nga shfrytëzuesi; (2) kërkimi mund të bëhet edhe për nga viti i burimit, pra bibliotekari mund të pyesë për listimin e të gjithë fjalorëve biografikë të botuar në një vit të caktuar; (3) kërkimi mund të kufizohet në shënimet me përshkrim (portret); (4) dhe, çka është më e rëndësishme, kërkimi mund të bëhet duke shënuar profesionin, një gjë e cila nuk ofrohet nga vëllimet e shtypura të botuara nga Gale.

Disa herë, edhe *Biography and Genealogy Master Index* dështon-pra emri nuk mund të gjendet. Janë shumë arsye për të shpjeguar këtë lënie anash. Ndoshta ai person nuk është edhe aq i dukshëm. Pra, emri mund të jetë një karakter dhe kështu emrat e tillë nuk mund të gjenden në ciceronët standardë biografikë për njerëzit realë. (Një përjashtim, edhe pse i kufizuar në karaktere të shumta të bazuara në njerëz të vërtetë, ato janë të listuara në *Biography Index*). Nëse ndonjë dyshon se kjo mund të jetë situata, shumë ciceronë ose udhëzues letrarë, sikurse edhe enciklopeditë e përgjithshme, kanë shënime për çdonjërin, duke filluar nga Simon Legree

e deri te Holden Caulfield. Dy shembuj: *Dictionary of American Literary Characters* (Nju-Jork: Facts on File, 1990) ka shënime të shkurtra në mbi 11 000 personalitete prej novelave amerikane të botuara në mes vitit 1789 dhe vitit 1980. *Characters in 20th Century Literature* (Gale Group, 1990) është një burim tjetër, i cili shtjellon karakteret e mbi 250 novelave. *Masterplots* është vendi i tretë më i mirë për të kërkuar personazhe letrare.

World Biographical Index nga Saur përfshin gati 3 milionë artikuj biografikë për gati 2.5 milionë individë që vijnë nga Amerika Veriore dhe Jugore e po ashtu edhe nga Evropa. Biografitë janë të shkurtra. E ka përparësinë e të pasurit material në subjektet që ofrohen Online, pa pasur nevojë për kërkim të mëtutjeshëm. Po ashtu, përfshin arkivat e burimeve të hershme biografike, prej SHBA-ve në Angli dhe në Evropë. Kjo hyn në punë shumë kur jeni duke kërkuar njerëz më pak të njohur, të cilët i kanë lënë gjurmët e tyre, të themi në 1750-at. Mirëpo, duhet cekur se e mbulon më pak se ¼ të njerëzve që gjenden në botimin nga Gale.

Biografitë në botimet periodike

Kur informacioni nga artikujt periodikë është më i domosdoshëm për detaje të mëtutjeshme sesa mund të gjenden në fjalorët standardë biografikë, *Biography Master Index* është zgjedhja e parë. *Biography Index* ka më shumë se 3 000 revista të ndryshme dhe gazeta, të cilat janë të analizuara për material biografik. Po ashtu, edhe 1 800 libra që përfshijnë biografi individuale.

Kjo i mundëson përdoruesit të ketë në shfrytëzim një sasi të madhe të të dhënave, të cilat shkojnë nga materiale të famshme deri te ato konfidenciale. Rezultati përfundimtar i kësaj është shumë rrallë dëshpërues. Kur kërkohet me disa vite të tëra, domosdo diçka do të gjendet dhe zakonisht kjo "diçka" mund të jetë goxha e detajuar. Aranzhimi në versionin e shtypur është sipas emrit të personit. Një bonus i shtuar janë datat e lindjes dhe të vdekjes, nacionaliteti, profesioni dhe, natyrisht, janë të dhëna edhe citimet e periodikëve.

Një tjetër veçori shumë e mirë është indeksi sipas profesionit. Dikush që është duke kërkuar material në arkiva për një arkitekt, duhet të shikojë në këtë indeks, sikurse edhe ndonjë individ tjetër që kërkon të dhëna biografike mbi dentistët. Shënim: Jo sikur *Biography and Genealogy Master Index,* ku profesioni mund të kërkohet vetëm në versionin digjital,

Biography Index lejon kërkimin e njëjtë në të dy versionet, atë digjital dhe të shtypur. Sikurse shumica e bibliotekarëve që janë të mësuar me edicionet e shtypura, kjo është një gjë që duhet të merret në konsiderim.

Indeksi ka edhe shënime të posaçme të biografive individuale dhe autobiografike në versionin e shtypur, sikurse edhe të përmbledhjeve. Një gjë e mirë është edhe futja e disa (jo të gjitha) personazheve nga proza letrare. E njëjta gjë vlen edhe për poezinë, dramën, e kështu me radhë. Vdekjet janë të indeksuara, duke përfshirë ato nga *The New York Times.* Po ashtu, ofrohet edhe një indeks shumë i përdorshëm nga *The New York Times Biographical Service.*

Në web-sajt (Internet)

Nuk ka indeks qendror falas të shënimeve biografike në Internet. Për shembull, nëse dikush është duke kërkuar të dhëna mbi John Ridley, një artist jo shumë i famshëm amerikan i shekullit XIX, ai duhet të kërkojë e t'i shikojë një sërë burimesh. Mënyra më e shpejtë është që së pari të konsultohet me *Biography and Genealogy Master Index* për të parë indekset që ofrohet falas. Po ashtu, aty do të tregohen edhe burimi/burimet rreth Ridley. Në Internet, ju mund të shkruani emrin e tij në kutinë e kërkimit për të vërtetuar nëse personi për të cilin jeni duke kërkuar informata është pjesë e ndonjë web-sajt që ofrohet falas. Kjo nuk do të thotë se ju do të gjeni shënime të shumta biografike. Mirëpo, kjo nuk vlen në rastet kur ju kërkoni informata për një figurë të njohur historike, një yll filmi.

BURIMET BIOGRAFIKE AKTUALE DHE UNIVERSALE

Burimet biografike universale përfshijnë shënime prej të gjitha pjesëve të botës ose së paku prej atyre pjesëve që janë zgjedhur nga redaktorët. Në rastet e shumta, ata i listojnë aty personalitetet e gjalla dhe të vdekura. Rezultati i kësaj është një përmbledhje relativisht mjaft e mirë për personalitetet e njohura prej të gjitha periudhave dhe vendeve.

Fjalorët biografikë

E shtypur: Webster's Biographical Dictionary, Springfield, MA: G. & C. Merriam Company, 1995, 1,170 f. $27.95.

E shtypur: Chambers Biographical Dictionary, edicioni 6, Londër: Chambers, 1997, 2 088 f., $55.

Online: Biography. A and E History Channel (www.biography.com). Falas.
E shtypur: The Cambridge Biographical Encyclopedia, edicioni 2, Kambrixh: Cambridge University Press, 1998, 1 179 f., $55.

Përpara ardhjes së *Biography and Genealogy Master Index*, fjalori biografik ishte vendi i parë dhe i vetëm për t'i identifikuar, për t'i kualifikuar dhe në përgjithësi për t'i zbuluar faktet themelore për një individ të caktuar. Fjalorët biografikë, në ditët e sotme, janë të jashtëzakonshëm për informatat e lindjes, vdekjes, profesionit dhe kështu me radhë. Pa dyshim, më i miri prej fjalorëve biografikë është ai i Websterit, i cili jep biografi të shkurtra për gati 30 000 njerëz prej fillimit të historisë e deri në fillimin e viteve '90-të. Kontributi individual primar është i shënuar së bashku me nacionalitetin, datën e lindjes dhe të vdekjes dhe shqiptimin e emrit. Të gjithë personat e shënuar në të janë të vdekur. Kontributi primar i tij është ajo se ofron informata për njerëz më pak të njohur. Shkalla e lartë e mbulimit e bën këtë fjalor më të mirin, mirëpo si edhe me të gjitha veprat e tjera referenciale, nevojitet ndihmë, p.sh. për personat që janë ende gjalle, ose për një numër të grave të famshme ose emrat e minoriteteve.

Edicioni i gjashtë i *Chambers Biographical Dictionary* shënon 100 vjetorin e tij. Si një udhëzues standard biografik, ai mund të gjenden në shumicën e bibliotekave në gjuhën angleze prej SHBA-ve deri në Australi. Shënimet që kapin numrin e 17 500 për personat e gjallë dhe të vdekur, mbulojnë figurat më të mëdha prej fillimit të historisë amerikane deri në fillimin e viteve '90-të. Aranzhimi sipas alfabetit përfshin shënimet mbi nacionalitetin, profesionin, datën e lindjes (vdekjes), një shënim i shkurtër mbi karrierën, informacione biografike dhe kur e lejon rasti, edhe filma. Figurat e mëdha janë të vendosur në kuti me shënime më të gjata.

Cambridge Biographical Encyclopedia ka diku rreth 26 000 emra. Shënimet mesatare shkojnë nga 250 deri 300 fjalë për secilën biografi. Këto mbulojnë të gjitha nacionalitetet dhe periudhat kohore sipas rendit alfabetik të mbiemrit. Po ashtu, në të janë të përfshirë edhe njerëzit e gjallë. Për më shumë, është një seksionim me "referencë të gatshme" në fund

të tij, i cili liston shumicën e shënimeve sipas subjektit, duke filluar "nga liderët politikë dhe sunduesit" deri te "sportet dhe lojërat konkurruese".

web-sajti *Biography* është një produkt i televizionit A & E dhe programit "Biography." Në fakt, ky është një version elektronik i *Cambridge Biographical Encyclopedia*. Po ashtu, ofrohet edhe një listë alfabetike e emrave në lajme. Materiali futet çdo javë Online. Nuk duhet harruar se ky material freskohet me informata nga materiali në *Biography Magazine*. Derisa është shumë i përdorshëm dhe mjaft frytdhënës për personalitetet historike, është edhe më i mirë për emrat aktualë. Po ashtu, gjendet edhe një listë e 10 biografive më të shituara të muajit, "E lindur në këtë datë" dhe një kalendarë i titujve të njëjtë të A & E.[6]

Përdorimi i Cambridge në Internet është i mirë nëse individi ose biblioteka nuk e ka versioni e tij të shtypur- gjë të cilën duhet ta ketë. Në të kundërtën, është shumë më e lehtë dhe e shpejtë për ta shikuar versionin e shtypur.

Një gjë e njëjtë nga televizioni te biografitë mund të gjendet edhe te *CNN Chat* (www.cnn.com/chat). Këtu janë të përfshire liderët botërorë, duke filluar nga politika deri te sportet. Materiali është marrë nga dosjet e CNN-it që janë përdorur në televizion. Këto shënime janë zakonisht të shkurtra dhe më shumë janë argëtuese sesa kanë fakte reale. Shënim: biografia është vetëm një pjesë e vogël e shumë fushave me interes te *CNN Chat*.

Pseudonimet

E shtypur: Pseudonyms and Nicknames Dictionary, edicioni 3. Detroit, MI: Gale Research Company, 1987, 2 vëllime. $143.

Mbulimi i të gjitha periudhave dhe shumicën e botës, kjo është një listë e diku 55 000 pseudonimeve dhe nofkave prej Johnny Appleseed (John Chapman) deri te Mark Twain (Samuel Clements). Informatat këtu përfshijnë datën e lindjes dhe të vdekjes, nacionalitetin dhe profesionin. Kur dikush kërkon apo kërkon pseudonime ose nofka të personave, po ashtu mund të gjendet edhe një referencë për emrin origjinal dhe për

[6] Një tjetër web-sajt Lives, the Biography Resource (www.amillionlives.com) është një burim shumë i varfër për figurat standarde dhe biografitë e tyre, mirëpo është jashtëzakonisht e mirë për figurat më pak të njohura. Vetëm të vdekurit janë të listuar këtu. Po ashtu, ofrohen edhe linka për web-sajte biografike.

informata primare. Burimet e cituara janë, po ashtu të përfshira dhe këto mund të gjenden në më shumë se 200 libra me biografi themelore. Duke u aranzhuar sipas rendit alfabetik, udhëzuesi është shumë i lehtë për t'u përdorur. Freskohet me informata nga dy shtesa, të cilat lëshohen në treg në mes edicioneve të punës së parë.

UDHËZUESI: FORMA WHO'S WHO

Online: Marquis Who's Who. Provinca e Re, NJ: Reed Reference Publishing, 1992 e deri më sot, www.marquiswhoswho.com. Çmimi LEXIS-NEXIS

Ndryshon. DIALOG file 234, $90 për orë. Po ashtu, ofrohen edhe disa të tjera.

CD: The Complete Marquis Who's Who. Provinca e Re, NJ: Reed Reference Publishing, 1992 e deri më sot, çdo tre muaj, çmimi ndryshon.

E shtypur: Who's Who in America. 1899 e deri më sot, e përvitshme, 3 Vëllime. $575.

CD: Who's Who, Londër: A & C Black, 1849 e deri më sot, e përvitshme, 1897-1999. Çmimi ndryshon.

E shtypur: Who's Who. Çmimi ndryshon. (Distributor është St. Martin's Press për Shtetet e Bashkuara të Amerikës).

CD: The International Who's Who 2000 CD-ROM. Londër (SHBA: Florence, KY): Europa Publications Ltd., 2000 e deri më sot, e përvitshme. $560.

E Shtypur: International Who's Who. 1935 e deri më sot, e përvitshme. $365.

Struktura e shkrimit të *Who's Who* filloi me një botim të vetëm të *Who's Who* në Angli, u zgjerua më pastaj në Amerikë me po të njëjtin titull, dhe më tutje shkoi në Lindje dhe Perëndim.[7] Nga fundi i Luftës II Botërore

[7] Who's who e anglezëve kishte qëllim demokracinë, mirëpo ky nuk ishte rasti me veprat e njëjta të botuara në Evropë moderne. Gati një shekull më parë u shfaq Almanach de Gotha i botuar nga qyteti Sakson i Gotha. Ky vëllim u botua çdo vit duke filluar nga viti 1763 deri më 1943. Ushtria sovjetike e okupoi këtë qytet thirri ndalesën për të gjitha veprat të cilat përmbanin diçka mbi prejardhjen ose sovranitetin e oborreve mbretërore të Evropës. Nga viti 1771, redaktori i futi këtu edhe artikujt e llojit të enciklopedisë që kishin të bënin prej matematikës e deri te ajo se si duhet të mbahen brejtësit si kafshë shtëpiake. Në vitin 1998, një edicion i korrigjuar nga një botues tjetër londinez u botua. Ky botim ka një rregullore redaktoriale shumë më të ndryshme.

botuesit e kishin shumë të qartë faktin se secili dëshironte, ose dukej sikurse dëshironte një pjesë të famës, e cila vinte nga listimi i emrit të personit në burime biografike. Prej kësaj u zhvilluan dimensionet gjeografike të *Who's Who* prej *Who's Who in the West* tek *Who's Who in California*. Më pastaj arriti ekspansioni i profesioneve me auto-përshkrime të titujve sikurse ajo *Who's Who Among Artists* (Kush është kush në mesin e artistëve).

Botimet mund të klasifikohen për nga fusha që e trajtojnë si ndërkombëtare, nacionale, lokale, profesionale ose biznesore, religjioze ose raciale, dhe kështu me radhë. Zakonisht, kjo mund të vërehet që nga titulli. Udhëzimet janë të ndryshme për nga fushat që mbulojnë ose trajtojnë, dhe shpesh edhe në kohë dhe saktësi, por qëllimi i tyre kryesor është i njëjtë: të prezantojnë fakte objektive dhe zakonisht jo kontraverse për individë të caktuar. Qasja dhe stili janë monotonë. Shumica janë të aranzhuara sipas emrit të personit në radhë alfabetike. Paragrafi i statistikave të rëndësishme zakonisht i përfshin adresat e personit dhe numrat e telefonit.

Informacioni zakonisht kompletohet duke dërguar një pyetësor te kandidati, i cili më pastaj është i lirë të japë apo të mos japë informata në atë se për çka është pyetur në pyetësor. Botuesit më të kujdesshëm i kontrollojnë dhe i kthejnë prapa të pavërtetat e shkruara nga personat. Disa botues të tjerë mund të besojnë në sinqeritetin e individit, i cili ka shumë pak arsye për të mos e thënë të vërtetën, edhe pse - dhe kjo është një "edhe pse" e madhe, disa kandidatë mund të japin informata shumë të rrejshme.

Udhëzimet janë ndër më të përdorurat për burime biografike. Pyetje që më së shumti u përgjigjen janë këto: (1) Ku jeton personi X, ose ku e merr postën? (2) Cila është mosha dhe profesioni i personit X? (3) Çka ka shkruar personi X? (4) Çfarë shpërblimesh ka marrë ky person? Këto janë vetëm disa nga pyetjet që shtrohen. Udhëzuesi e bënë një listë me njerëzit e gjallë dhe për disa arsye, vetëm për njerëzit që janë në pozicione më të rëndësishme. Përsëri, shumica janë të indeksuara në *Biography and Genealogy Master Index*.

Amerika: Who's Who (Kush është kush)

Who's Who në Amerikë ka një histori të gjatë të besueshmërisë. Është burim i informatës i më se 128 000 emrave të njerëzve eminentë amerikanë, burra e gra, e po ashtu edhe të disa të huajve me influencë në

SHBA, për arsyen se popullata e Shteteve të Bashkuara është diku 270 000 milionë, si ia dalin redaktorët të bëjnë selektimin dhe të vendosin se kush duhet dhe kush nuk duhet të përfshihet në të? Përgjigjja është mjaft komplekse, mirëpo zakonisht është e mbështetur në të arriturat personale të individit. Pyetja natyrore nga kjo ka të bëjë me atë se sa valide janë këto. A është seksioni i Y i bazuar në dëshirat e Y për të qenë i përfshirë (i mbështetur edhe nga gatishmëria për ta blerë vëllimin në fjalë, ose në disa raste të rralla për të paguar për një vend në këtë botim), ose a është e bazuar në vendimin e redaktorit mbi eminenten, ku paraja nuk ka peshë fare? Të gjitha veprat e përmendura këtu janë plotësisht legjitime. Rruga e një njeriu deri te fama nuk mund të blihet me para. Kjo nuk do të thotë se nuk ka vend për kritika.

Askush nuk do të pajtohet me të gjithë emrat e zgjedhur ose të refuzuar, le ta marrin si shembull në *Who's Who in America*. Deri diku, përzgjedhja është adekuate nëse jo edhe brilante. Në vitet '90-të, dukej sikurse kishte tendenca për t'i futur më shumë njerëzit që shprehnin gatishmëri për të blerë librin sesa ata që me të vërtetë e meritonin. Duke lënë anash përzgjedhjen automatike (prej presidentëve e deri te udhëheqësit e kompanive të mëdha), procesi i përfshirjes nuk është edhe aq i qartë. Disa edhe mendojnë se vëllimi është i mbushur me persona që nuk e kanë vendin aty.

Të dhënat mbi personat që hyjnë në këto libra ndryshojnë shumë në gjatësi, mirëpo jo edhe në stil, ngase secili anëtar i librit e plotëson pyetësorin me informata themelore që përfshin pyetjet si data e lindjes, shkollimi, të arriturat dhe adresa. Kjo formë është përdorur për t'i hartuar shënimet dhe një kopje e shënimit i dërgohet individit për ta shikuar edhe një herë.

Përmbledhja, po ashtu përfshin edhe një listë të atyre që kanë vdekur edhe atyre që kanë shkuar në pension, që nga botimi i fundit. Veçoria ose opsioni "mendime në jetën time" po ashtu është e përfshirë në shënimet. Kjo është një formë shumë komerciale për t'iu përgjigjur egos së individëve. Këtu, personat në fjalë, pra ata që futen në libër, pyeten që të thonë mendimet dhe filozofitë e tyre që i kanë përcjellë ata gjatë jetës. Kjo mund të duhet si budallëllëk, mirëpo është një rrugë shumë e mirë për t'i ndrequr faktet në udhëzues.

Duke shkuar edhe më tej në kënaqjen e këtyre egove, botuesi u ofron secilit në botim- i famshëm apo jo- "informatat familjare" dhe/ose "informatat profesionale" për një "çmim prej vetëm $75 për çdo shtim". Nëse

zgjidhet, kjo edhe botohet në *Who's Who in America* dhe në "ndonjë publikim tjetër Marquis për të cilin ju jeni përzgjedhur". Komentet janë të limituara në vetëm 100 fjalë secila. Kjo edhe ashtu nuk ka fort vlerë.

Kërkimi i vëllimeve të shtypura është çështje e thjeshtë e shikimit të emrit (emrave) që janë sipas rendit alfabetik. Vëllimi i tretë i shtypur lejon kërkimin sipas fushave gjeografike dhe interesimeve profesionale. Titujt e subjekteve në kategorinë e shkronjave janë shumë të gjera, mirëpo zgjidhja është të përdorësh versionin Online, kur është e mundshme. Këtu, sikurse zakonisht në formatet elektronike, kërkuesi mund të ketë më shumë se 40 pika të ndryshme për t'i shënuar, duke filluar nga emri i personit e deri te adresa, kompania, ose informata të tjera. Mundësitë gjeografike janë edhe më të mira. Për shembull, numri i femrave eminente amerikane që jetojnë në Çikago ose raporti në mes të avokatëve në Los-Angjelos dhe San Francisko krahasuar me numrin e përgjithshëm në udhëzues ose të atyre që nuk gjenden në udhëzues. Një tjetër përparësi është ajo se lajmet e freskëta mund të futen gati çdo tre muaj.

Shërbimet Online (me diku 800 000 shënime) dhe CD-ROM, që përfshin 15 tituj të tjerë, të njëjtë, të iniciuar nga Marquis si pjesë e "Who's Who" përfshin edhe *Who was Who in America* (Kush ishte kush në Amerikë). Shumica e këtyre titujve të shtypur individualë mund të gjenden nëpër biblioteka. Titujt regjionalë janë: *Who's Who in the East, Who's Who in the Midwest, Who's Who in the South and Southeast, dhe Who's Who in the West. Titujt aktualë: Who's Who in the World, Who's Who of American Women, Who's Who in Finance and Industry, Who's Who in American Law, Who's Who in Entertainment, Who's Who in Advertising.* Bazat e të dhënave mund të kërkohen për persona të caktuar ose për të gjithë.[8]

Angli: Who's Who (Kush është kush)

Who's Who anglez është e vetmja që nuk është përcaktues, pra e llojit të tillë sikurse Who's Who in Siberia, Who's Who in America dhe kështu me radhë. Pse? Duke mos pasur pikat fort delikate, nuk ka kurrfarë nevoje për

[8] Online përmes NEXIS janë edhe dy baza t♪7 tjera të të dhënave: Marquis Who's Who Regional Library, e cila përfshin Who's Who in America, por vetëm titujt regjional. Marquis Who's Who Topical Library është e kufizuar vetëm te subjektet e fushave dhe nuk i përfshin Who's Who in America.

të shkuar më shumë se *Who's Who* (Kush është kush). Duhet të jetë një grup i përzgjedhur britanik, ose përndryshe nuk do të ishte një britanike në të vërtetë.

Who's Who ishte botuar së pari më 15 janar 1849 në Britani, 50 vjet përpara se të kishte numër të mjaftueshëm të amerikanëve eminentë për ta bërë një gjë të tillë në SHBA. Gjatë 47 vjetëve të saj të para, *Who's Who* ishte një libër shumë i hollë me diku 250 faqe, të cilat i listonin anëtarët e klasave zyrtare dhe ato klasike. Në vitin 1897, u shndërrua në fjalor biografik. Edicioni i vitit 1999 i ka gati 2 500 faqe. Përzgjedhja nuk është më e bazuar në fisnikëri, mirëpo në "të arriturat personale dhe në dominim". Shumica e shënimeve janë për britanikë, mirëpo vëllimi përfshin edhe disa fisnikë të tjerë prej vendeve të tjera. Dhe, në dekadën e kaluar, theksi i veçantë i ishte dhënë zbavitësve eminentë, njerëzve profesionalë, dhe liderëve politikë e industrialë në gati 30 000 shënime.

Versioni digjital i *Who's Who* jo vetëm që lejon kërkimin e të gjitha shënimeve për britanikët, për gjatë një shekulli të tërë, mirëpo po ashtu ofron edhe disa metoda të tjera të kërkimit. Për më shumë se emri, ju mund të kërkoni edhe profesionet, universitetet e kryera nga ata, librat e shkruar nprej tyre e kështu me radhë. Për shembull, ju mund të shkruani shkollën Eton dhe nën te do të radhiten më se 1 400 emra. Prek dy herë dhe shënimi i *Who's Who* për emrin e caktuar është në ekranin tuaj.

Udhëzuesi i parë i "zgjedhur", i cili shpesh gjendet në bibliotekat amerikane e po ashtu edhe si një përmbledhje gjeologjike, diku tjetër, është *Burke's Peerage and Baronetage* (Londër: 1826 e deri më sot. Në SHBA: Çikago: Fitzroy Dearborn, vëllimi 2. $395). Edhe pse u ndal përkohësisht në vitin 1970, përsëri filloi botimin në vitin 1998. Këtu janë diku 12 000 tituj trashëgimie nga familjet britanike, të cilat disa herë janë të shoqëruara edhe me shënime shumë të gjata. Për më shumë, duke iu falënderuar ndihmës së kompjuterit, janë diku rreth 100 000 emra në indeksin që është më se 200 faqe i gjatë.

Po ashtu, nuk duhen harruar as esetë e mrekullueshme mbi mbretëritë, të cilat e fillojnë vëllimin e parë. Jane Austin e pagoi haraçin e tij në udhëzuesin *Persuasio*n ku Sir Walter Elliot "i cili për qejfin e tij" kurrë nuk lexoi ndonjë libër tjetër përveç *The Baronetage.* Këtu, ai gjen "profesionin për një orë plogështim dhe ngushëllimin në po atë orë". Kjo vlen gati për shumicën e biografive në këtë kapitull.

Who's Who - ndërkombëtar (Kush është kush)

Varësisht nga madhësia dhe lloji i audiencës që i ofrohet, shumica e bibliotekave publike amerikane dhe ato universitare do ta kenë *Who's Who in America* dhe mundësisht edhe *Who's Who* për arsyen se figurat e njohura janë objekte të pyetjeve në *Who's Who* që është e mbuluar nga *Who's Who* –ndërkombëtare, e cila fillon me një seksion të emrave të "familjeve sunduese" e më pastaj zhvendoset te një radhitje alfabetike e më se 20 000 biografive të shkurtra të njerëzve eminentë, burra e gra, të kohës sonë. Mbulimi është i madh dhe i përfshin të gjithë ata që janë të njohur në marrëdhëniet ndërkombëtare, qeveri, administratë, diplomaci, shkencë, medicinë, ligj, financa, biznes, edukim, religjion, letërsi, muzikë, art dhe argëtim. Shënim: Edicioni i parë në CD-ROM (2000) i mungojnë mundësitë e kërkimit të sofistikuar të gati të gjitha CD-ROM-ve të tjerë. Nën këto kushte, është më së mirë të ruhen paratë dhe të blihet edicioni në versionin e shtypur.

Duke iu falënderuar mbulimit të saj, gjithë botëror, udhëzuesi i saj është shumë më shumë i lexuar sesa ai standardi *Who's Who*. Shumica e të dhënave, si zakonisht, janë të dhëna nga vetë ata që marrin pjesë në të. Krenaria njerëzore është shumë e fortë. Figurat më pak të njohura mund të kontribuojnë me diku 100 rreshta, ndërsa Zonja Theçër, kryeministrja e mëparshme, është shumë modeste dhe ka shënuar vetëm 29 rreshta.

Gati çdo vend në këtë botë ka një përmbledhje të njëjtë të udhëzuesit Who's Who (kush është kush) që është një vepër themelore për personat e famshëm dhe një përmbledhje për ata që kanë vdekur. Shumica e tyre janë të botuar nga botues shumë të njohur e të famshëm të listuar në biografitë standarde, sikurse *Guide to Reference Books* dhe *Guide to Reference Materials*. Për shembull, është një botim kanadez i *Who's Who* (Toronto: University of Toronto Press, 1910 e deri më sot, çdo tre vjet). Kjo përfshin një numër të madh të skicave biografike prej të gjitha sferave të jetës, duke përfshirë edhe njerëzit e biznesit, autorët, artistët dhe mësuesit.

Sipas gjinisë dhe racës

Who's Who of American Women (Çikago: Marquis Who's Who, Inc., 1959 e deri tek data e bienales) është një fjalor mbi femrat eminente amerikane që ende jetojnë. E ndjek metodën ose mënyrën e njëjtë të përgjithshme

sikurse edhe veprat e tjera Marquis. Një edicion, mesatarisht i përfshin emrat e 30 000 grave. Ndarja e 1 000 skicave nga ditori do të thotë se duke u bazuar në profesionin, shanset e gruas për të pasur një shënim janë të mëdha nëse ajo është lider klubi, religjiozi, ose e shoqërisë civile (9.6 % e të gjitha biografive).

Janë edhe udhëzime të tjera shumë-kulturore të ndara. Një shembull nga ata është *Who's Who Among Black Americans* - Kush është kush në mesin e amerikanëve të zi (Farmington Hills, MI: Gale Group, 1976 e deri më sot, gati çdo dy vjet). Kjo i liston më se 20 000 njerëz prej të gjitha fushave të jetës. Shënimet përfshijnë llojin e materialit standard dhe po ashtu gjenden edhe referencat kryqëzore, nëse ato janë të nevojshme. Indeksi i profesionit liston edhe më shumë, ndonëse jo të gjithë, emra në më se 150 kategorive. Është një indeks gjeografik, i cili duhet të përmirësohet.

Pa dyshim, fjalorët biografikë, të cilët fokusohen në profesione janë një ndihmë e madhe referenciale dhe si të tilla, i shërbejnë një qëllimi të vërtetë. Kalo nga titujt me subjekt profesionin te listat e femrave dhe kulturave të ndryshme, do të shihni se ky territor bëhet mjaft i mjegulltë. Një rast i veçantë mund të bëhet në kundërshtim me ndarjet shumë kulturore sikurse edhe me ato për femrat. Nëse njerëzit në këto grupe janë vërtet një sukses, ata duhet të jenë pjesëmarrës në veprën e parë *Who's Who,* ku edhe fillon e gjithë kjo. Më së miri do të ishte që ata të ishin në *Who's Who* për nga gjeografia ose *Who's Who* me subjekt profesionin. Mënyra më e mirë për t'i ndarë këto libra kurrsesi nuk është ajo ndarje sipas kulturës dhe gjinisë, sepse kjo ndarje në disa raste është edhe fyese.

Në Internet

Nuk ka asgjë falas që ofrohet në Internet e që i afrohet serive të *Who's Who* në kuptimin e shënimeve të kufizuara, që janë më të mirat në atë "fushë". Diskriminimi mund të mos jetë i madh, mirëpo janë disa web-sajte të mira për të dhëna të llojit *Who's Who.* Ndër më të mirat janë:

Biographical Dictionary. Notable Citizens of Planet Earth (www.tiac.net/users/parallax). Nën juridiksionin e Eric Tentarellit prej Universitetit Kornell, kjo ofron të dhëna të shkurtra biografike me fakte të vërteta për 18 000 "njerëz fisnikë, duke filluar nga kohët antike e deri më sot". Kërkimi mund të bëhet sipas emrit, fjalëve kryesore dhe nëse

është e nevojshme edhe sipas datës.

The Obituary Page (http://catless.ncl.ac.uk/obituary). Edhe pse nga jashtë Anglisë, mirëpo e mbledhur dhe botuar nga një ligjërues i shkencave kompjuterike në Universitetin e Newcastle, kjo është një listim i çuditshëm i njerëzve të famshëm që kanë vdekur. Emri, data e lindjes dhe e vdekjes dhe disa fjalë mbi famën e personit janë dhënë në të. Fillon nga i vdekuri i fundit dhe vazhdon në mënyrë kronologjike deri te ai i parë (1994), kur edhe filloi botimin. Pikat e shënimit janë të ndryshme, mirëpo në esencë kjo është çështje e leximit listës.

Format e Esesë të burimeve biografike

Online: Current Biography: New York: H.W. Wilson Company, 1940 e deri më sot, www.hwwilson.com. $545; ripërtëritja vjeçare $175 (1983 e deri më sot, e përmuajshme, $295; ripërtëritja vjeçare, $175).
CD: 1995 e deri më sot, e përvitshme. $189.
E shtypur: 1940 e deri më sot, e përmuajshme në përjashtim të Gushtit. $58.

Online: The New York Times Biographical Service. Nju-Jork: The New York Times. 1990 e deri më sot, e përditshme. Kjo është pjesë e gazetës Online te (http://nytimes.com).
E shtypur: 1970 e deri më sot, e përmuajshme, $120.

CD: Encyclopedia of World Biography, Farmington Hills, MI: Gale Group, 1999. $975.

Current Biography është e vetmja ndihmesë biografike e gjatë që është e lehtë për t'u përdorur në të gjitha llojet e bibliotekave. E botuar çdo muaj, është e përmbledhur zakonisht me skica të korrigjuara në vëllimet vjetore, që shoqërohet po ashtu edhe nga një indeks përmbledhës i mrekullueshëm. Duke iu falënderuar formatit dhe fotografive shumë të mira në kopertinë, *Current Biography* duket si një revistë, e cila mund të lexohet faqe për faqe.

Fokusi kryesor në botimin vjetor është në më se 200 personalitete ndërkombëtare, në radhë të parë ato personalitete, të cilat në një mënyrë ose tjetrën, kanë pasur ndikim në skenën amerikane. Artikujt janë aq të

gjatë sa për t'i përfshirë të gjitha informatat vitale për personin, mirëpo jo edhe aq të gjata për ta prishur vëmendjen e shkurtër të përqendruar të studentëve. Zakonisht, këto shënime janë objektive. Një staf special i përgatitë skicat, të cilat i marrin informatat prej burimeve të tjera biografike dhe prej personit për të cilin flitet në atë artikull. Personave në fjalë, që janë edhe pjesëmarrës në libër, u jepet mundësia për ta parë kopjen e botimit përpara se të botohet, dhe kështu t'i aprovojë fotografitë, që e shoqërojnë çdo skicë në libër. Fokusi është duke u rritur shumë në kulturën popullore. Po bëhet gati e njëjtë me version studentor të *People Magazine*. Mirëpo, po ashtu figurat e njohura publike, duke filluar nga publikimet e autorëve dhe të shkencëtarëve janë të futura në të.

Burimet e referencave janë të cituara. Lajmet e vdekjes me referenca nga *The New York Times Obituaries Index*, janë të listuara/ radhitura për ata të cilët së paku një herë të vetëm janë shfaqur në vepër. Secili botim e ka një indeks përmbledhës mbi ngjarjet e vitit të kaluar, dhe me numrin 12, titulli publikohet sikur një vjetar. Vjetari, po ashtu ka në vete edhe një indeks ndihmës, që është indeks sipas profesionit, i cili është shumë i përdorshëm për të gjetur liderët në shumë fusha.

Formatet elektronike përfshijnë "më shumë se 13 500 biografi dhe 8 500 lajme të vdekjeve, duke mbuluar më se 15 000 individë", prej botimit të parë në vitin 1940 e deri më sot. Që të dyja mund të kërkohen sipas emrit, profesionit, gjinisë dhe datën e lindjes. Duhet pasur kujdes që CD-ROM freskohet me informata, çdo vit, derisa versioni Online çdo muaj, një përparësi shumë e madhe e versionit elektronik.

The New York Times Biographical Service i shërben qëllimit të njëjtë dhe zakonisht edhe audiencës së njëjtë, sikurse *Current Biography*. Dallimi kryesor është ai se *Current Biography* është i shkruar nga stafi me referenca nga burimet. Biografitë e *The NewYork Times* zakonisht janë të shkruara nga reporterët, të cilët nuk i tregojnë burimet e as i citojnë ato. Si e tillë, është e botuar Online si pjesë e gazetës dhe çdo ditë freskohet me informata. Ai që kërkon informata duhet të kërkojë arkivat për biografitë paraprake në këto seri. Në versionin e shtypur, botohet çdo muaj. Versioni i shtypur është zgjedhja e parë për bibliotekat e mesme dhe ato të mëdha. I përfshin informatat mbi vdekjet, "njeriu në lajme" dhe ka në të edhe tregime mbi dramën, teatrin, sportin, librin dhe seksioni i revistës të së dielës. Skicat shpesh raportojnë në mënyrë kontraverse e më pak admiruese për individët. Shumica e raporteve janë objektive. Secila faqe është një rishtypje e materialit biografik, i cili është shfaqur më parë në

The New York Times. Seksioni i botimit mujor ka indeksin e vet, i përmbledhur çdo 6 muaj dhe çdo vit.

Mungesa e një indeksimi Online aktual paraqet një problem të madh. Një mënyrë efektive për t'i kërkuar emrat është shikimi i asaj se ku *The New York Times* është i indeksuar, si p.sh. *Newspaper Index or Newspaper Abstracts*. Duke pasur parasysh mungesën e një seksioni të veçantë Online për këtë shërbim, është shumë më e lehtë për t'u kërkuar versioni i shtypur.

Audienca e planifikuar e *Encyclopedia of World Biography* janë studentët prej klasave 6-12, opinioni publik dhe disa të diplomuar me kërkesa më modeste. Është shumë e lehtë për t'u lexuar. Janë një sërë ilustrimesh të jashtëzakonshme, dhe - e gjitha për qëllimin e referencave- përfshin edhe njerëz, që nuk mund të gjenden në ndonjë tjetër vepër, të stilit ese mbi referencat biografike. Emrat e shtuar janë yje kulturorë aktualë prej filmit, muzikës e televizionit.

Janë diku 7 500 shënime të njerëzve të gjallë e të vdekur prej të gjitha anëve të globit, edhe pse fokusi kryesor është në Perëndim. Shumica e eseve janë të shkurtra rreth 1 200 fjalë dhe shumica e tyre janë të shoqëruara nga portrete të shtypura. Shënimet më të gjata janë në ato raste kur flitet për figura të njohura historike e aktuale. Në versionin CD-ROM, ofrohen linka që bëjnë të mundur kërcimin në skicat Online. Redaktorët janë shumë demokratë në atë se Madona dhe Medeline Albright zënë hapësirë të njëjtë. Vëllimi i fundit i shtypur është një indeks i gjatë sipas subjekteve, nacionaliteteve, profesioneve, personazheve etj.

ESETË BIOGRAFIKE RETROSPEKTIVE

Online: American National Biography Online (më parë ishte *Dictionary of American Biography,* shih më poshtë). Nju-Jork: Oxford University Press, www.anb.org. Çmimi ndryshon, $550 për një përdorues.

E Shtypur: 1999, 24 vëllime. $2 500.

CD: Dictionary of American Biography on CD-ROM. Nju-Jork: Charles Scribner's Sons, 1997. $600.

E Shtypur: 1974, 10 vëllime. Tetë shtesa, 1977 e deri më sot.

Çmimi ndryshon; komplet, $1 400.

CD: Dictionary of National Biography on CD-ROM. Londër: Oxford University Press, 1997. $550.
E Shtypur: Stephen, Leslie, and Sidney Less, eds. Dictionary of National Biography. 1885-1901; e ribotuar, 1938, 22 vëllime, me botimet shtesë. $2 250 përfshirë edhe botimet shtesë.

Listimi në ANB, DAB ose DNB është një mënyrë e mirë për të siguruar se reputacioni i një personi të caktuar do të jetojë përgjithmonë. Zakonisht, kandidati që futet në listë është i vdekur për më së paku 10 deri 20 vjet përpara se emri i tij/saj konsiderohet për nderim. Gjykimi i punës ose veprës është goxha kut ku secili duke filluar nga historianët e deri te politikanët e vlerëson dhe e matë rëndësinë e individit në fjalë. Festimi i postumit final është dhënia e titullit të kalorësit, ani pse shumicën e herëve jepet si diçka e errët dhe shumë pak i përkujton njerëzit.

Si *Dictionary of American Biography* ashtu edhe e reja *American National Biography* janë të preokupuara me amerikanët eminentë të vdekur. Nuk është e sigurt nëse libri i vjetër do të vazhdojë të botojë botime shtesë, më pak ose më shumë se edicioni i ri. Në të njëjtën kohë, biblioteka ka përparësi të madhe të dy veprave referenciale të mrekullueshme, të cilat i përfshijnë njerëzit e njëjtë, mirëpo në një mënyrë tjetër. Që të dy përmbledhjet rekomandohen për t'u blerë.

The Dictionary of American Biography (ose DAB sikurse thirret shpesh) me botime shtesë, përfshin më se 19 200 figura, që kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në jetën amerikane.[9] Gati të gjithë janë amerikanë, mirëpo janë të përfshirë edhe disa të huaj që kanë kontribuar shumë në historinë e SHBA-ve. (Në këtë rast, ata persona duhet të kenë jetuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për një kohë të caktuar). Për më shumë, asnjë oficer britanik "që ka shërbyer në Amerikë, pasi kolonitë shpallën pavarësinë" nuk është i përfshirë.

Rreth 3 000 kontribute shkencore i japin një stil të veçantë kompilimit. Si pasojë e kësaj, shumica e shënimeve, të cilat shkojnë nga disa para-

[9] The Concise Dictionary of American Biography, edicioni 5 (Nju-Jork: Charles Schribner's Sons, 1997, 2 vëllime. $235) përfshin të gjitha shënimet prej përmbledhjes kryesore, mirëpo shënimet këtu janë të shkurtuara. Po ashtu, përfshin edhe indekset e datave të lindjes, profesionit etj. Një vepër e mrekullueshme e referencave të gatshme nëse biblioteka nuk ka para për përmbledhjen. Duhet pasur kujdes me hapësirën. Rivali tjetër i American National Biography do të ofrojë shënime të njëjtë të shkurtuara, me versionin që kushton më lirë, për bibliotekat dhe njerëzit joprofesionistë.

grafë gjatësi deri në disa faqe, mund të lexohen si ese e jo si një listë e lidhjeve me fakte të thata. Përmbledhja origjinale dhe botimet shtesë janë të indeksuara në një vëllim të vetëm, i botuar në vitin 1990, si *Dictionary of American Biography: Comprehensive Index*. Indeksi i ka gjashtë seksione: biografitë e personave, datat e tyre të lindjes, shkollat dhe kolegjet e vijuara nga ata, profesionet, temat e diskutuara në ato shënime biografike, dhe emrat e kontribuesve në këto ese biografike. Indeksi i profesioneve (me politikanët, mercenarët, e mashtruesit) reflekton më të mirat dhe më të këqijat e amerikanëve. Janë edhe një sërë referenca të kryqëzuara në secilin seksion, gjë që e bënë indeksin shumë të lehtë për t'u përdorur. Është një gjë e detyrueshme për çdo bibliotekë me botimin themelor dhe botimet e tjera shtesë.

Në mënyrë që të mbajë sa më aktual botimin e vjetër, botuesi filloi botimin dhe lëshimin në treg të disa botimeve shtesë në vitin 1998, me një titull të ri: *The Scribner Encyclopedia of American Lives*. Në vitin 1999, dy vëllime ishin të gatshme për treg, pra vëllime që përfshinin njerëzit që kishin vdekur nga viti 1981 e deri më 1990. Shënimet janë të ngjashme sikurse ato në botimin origjinal shtesë të DAB, kurse vëllimet e reja do të botohen çdo pesë deri tetë vjet, p.sh. nëse ato nuk hidhen mënjanë nga versioni i ri *American National Biography*.

Versioni CD-ROM ka përparësinë e çmimit më të lirë. Pra, kushton përgjysmë më lirë sesa vëllimet e shtypura, plus që ofron metoda shumë të mira të kërkimit për më se 19 000 shënimet. Përdoruesi i këtij versioni mund ta bëjë kërkimin duke shënuar emrin, profesionin, datën e lindjes, datën e vdekjes etj.

American National Biography

American National Biography (ANB) është tërësisht një vepër e re, e cila i kalon konkurruesit e saj pikë së pari me fjalorin e njohur *Dictionary of American Biography*. Kjo punë e re është e mbështetur nga Qendra Amerikane për Shkencat e Mësuara (një federatë me mbi 61 shoqëri të shkencës).

Këto dy përmbledhje ndryshojnë në katër pika: (1) këtu janë të përfshira më se 17 500 shënime biografike krahasuar me 19 000 që mund të gjenden në DAB; (2) janë shumë figura, të cilat nuk mund të gjenden në DAB. Janë më shumë gra, minoritete dhe figura nga koha para koloniale që janë të përfshira këtu e që nuk mund të gjenden në përmbledhjet më të vjetra. Përfaqësuesit amerikanë, më shumë se politikanë, klerikë e

njerëz të biznesit, janë evidentë këtu. Botimi ANB ka diku gati 40 % të biografive, të cilat nuk mund të gjenden në DAB. Kjo përfaqëson 6 082 biografi të reja, të cilat janë të ndryshme sa i përket gjatësisë, pra shkojnë nga 750 deri 7 500 fjalë. Subjektet e biografive (prej edicionit të vitit 1999) duhet që të kenë vdekur përpara vitit 1996; (3) shënimet "kolektive" përfshijnë personat, të cilët funksionuan si grup në zbulime, shkencë etj. Diku rreth 6 000 ekspertë kontribuan për këtë përmbledhje dhe fokus të veçantë i dhanë shënimeve me aspekte nga jeta politike dhe ajo shoqërore. Po ashtu, vepra e re ka informata më aktuale. (Mbulimi i DAB mbaron në vitin 1980); (4) për ndryshim nga botimi origjinal DAB, versioni i ri ANB përfshin edhe të huajt, të cilët ndikuan në zhvillimin e SHBA-ve, si p.sh. Kolombo, Gjenerali John Burgoyne, Antonian Dvorak, etj. Seksioni i parë dhe ai i fundit përmbledhin kontributet e personit. Të gjitha shënimet janë të nënshkruara.

Udhëzuesi i 24 vëllimeve bëhet nga katër indekse të mëdha: subjekti, kontribuesit, vendi i lindjes dhe profesioni. Janë edhe titujt e zakonshëm duke filluar nga presidentët te zbuluesit. Po ka edhe tituj nga më të pazakonshmit: këngëtarët, hajdutët, banditët, viktimat e vrasjeve dhe aventurierët. Ne do t'i përmendim vetëm nga titujt fascinues. Për shembull, duka holandez i Uindzorit është i radhitur në kategorinë e aventuristëve kurse Sally Stanford, (i cili ishte kryetar i Sausalito, Kaliforni), është i radhitur nën kategorinë e mbajtësve të shtëpive publike. Hetty Green që është gruaja më e pasur në Amerikë, e cila jetoi në varfëri, është anëtare e një grupi të çuditshëm, ndërsa Ida Lewis është e radhitur në kategorinë e mbajtësve të shtëpive me drita. Shumë njerëz janë pjesë e titujve të tillë. John Jacob Astor IV, për shembull, është i radhitur si lider i patundshmërive e po ashtu edhe si viktimë e Titanikut.

Versioni Online i ka të gjitha përparësitë e zakonshme, duke filluar nga kërkimi me fjalët kryesore në tekst e deri te gjetja e shpejtë e personit, duke shënuar datën e lindjes, vendin e lindjes, datën e vdekjes, profesionin etj. Po ashtu, gjenden edhe linka të ndryshëm për subjekte të tjera brenda ANB-së, e po ashtu edhe burime të tjera biografike në Internet.

A i nevojiten bibliotekës këto dy përmbledhje? Po dhe jo. Biblioteka e madhe kërkuese e ka DAB për arsye se aty mund të gjenden më shumë njerëz sesa në ANB - pra ata e kanë versioni e vjetër në raftet e tyre. Bibliotekat më të vogla dhe ato që i shërbejnë opinionit publik mund të hezitojnë kur shohin çmimin prej 2 500 dollarëve të librit të ri biografik. Për ta, është me e arsyeshme të vazhdojnë me DAB-in dhe me botimet

shtesë të saj. Vepra e re biografike mund të blihet kur (a) kur ofrohet me çmim më të lirë/ ose (b) kur versioni Online është më i arsyeshëm sesa edicioni i shtypur.

DNB [10]

Dictionary of National Biography përfshin shënimet për më se 40 000 njerëz të vdekur "gra e burra britanikë e irlandezë, të cilët kanë arritur sukses dhe janë shquar në ndonjë fushë të jetës". Po ashtu, i radhitë të vendosurit e parë në Amerikë dhe "personat e lindur jashtë SHBA-ve, por që janë bërë të njohur në Shtetet e Bashkuara". Botimi shtesë i vitit 1986-1990 ishte botuar në vitin 1996 dhe i përfshin 450 individë të shquar të asaj kohe në jetën britanike.

Chronological and Occupational Index to the Dictionary of National Biography (Nju-Jork: Oxford University Press, 1985) është pikë së pari një indeks, i cili i ndan shënimet në më se 20 kategori për nga profesioni. Është një listë tjetër e ndarë kronologjike për secilën nga këto kategori. Ky është një indeksi i madh (gati 1 000 faqe) i botimit primar dhe botime shtesë.

Një vëllim shtesë e i pazakonshëm ishte botuar në vitin 1993 me nëntitullin Personat e Zhdukur. *Oxford University Press* i punësoi ekspertët për të shkuar para e për të kontrolluar vëllimet nga DNB dhe me këtë të sugjerojnë se kush duhet të shtohet në kategorinë e "personave të zhdukur". Sugjerimet rezultuan në 1 086 shënime prej personit të parë Thomas Tuberville (1295), personi i parë në Britani, i cili u ekzekutua për spiunazh, deri te Julian Maclaren-Ross (1912-1964) një shkrimtare boheme dhe shumë e guximshme.

Duke përdoruar logjikën Boolean ose duke bërë kërkimin fjalë për fjalë, versioni CD-ROM i DNB-së është një rrugë e shpejtë në gjetjen e

[10] The Concise Dictionary of National Biography (Nju-Jork: Oxford University Press, 1992, 3 vëllime, 3 334 f., $195) është titull zëvendësues për bibliotekat të cilat nuk kanë fonde të mjaftueshme, ose hapësirë, për ta blerë përmbledhjen primare. Concise përfshin ose mbulon çdo shënim që gjenden në versionin primar që nga viti 1981. Problemi qëndron në atë se shumica e skicave biografike janë shkurtuar aq shumë sa që titulli mund të kuptohet si një sfidë mendore dhe intelektuale, pra pak kush e merr vesh shënimet. Shekspiri i ka pesë shtylla (krahasuar me 49 faqe që i kushtohen atij në botimin primar) derisa Janë Austin i ka vetëm nëntë rreshta. Në përgjithësi, Concise është e mirë kur nevojiten fakte primare, mirëpo jo edhe për komente kritike. (E njëjta gjë mund të thuhet edhe për botimin e lartpërmendur Concise Dictionary of American Biography).

informatave të izoluara e të panjohura e që janë shumë të vështira për t'u gjetur në indeksin standard. Këtu është jeta e gati 40 000 personave, pra numër i njëjtë me ata në versionin e shtypur, mirëpo këtu ata mund të vendosen në disa pika të caktuara, duke filluar nga profesioni deri te data e lindjes. Kërkimi i ndjekë, deri diku, metodat e njëjta sikurse CD-ROM për *Dictionary of American Biography.*

Duke filluar në mesin e viteve '90-të, botuesi lëshoi në treg programin me edicionin e ri dhe të kompletuar. Të dhënat e përafërta të këtij edicioni të ri (që do të quhet *The New Dictionary of National Biography*) janë nga viti 2004 e deri më 2010. Numri i shënimeve do të jetë nga 40 000 deri në 50 000 dhe të gjitha materialet e vjetra biografike do të korrigjohen dhe do të rishkruhen, nëse është nevoja. Ideja këtu është zhvendosja prej opsioneve origjinale të kontribuesve fitues në diçka krejt të re. Gjatë kësaj rruge do të futen edhe shënime të reja për grupe, duke u fokusuar më shumë në kontribuesit shoqërorë e jo vetëm në personat e famshëm. Shënimet që do të futen, diku përafërsisht 10 000, do të jenë marrë nga *National Portrait Gallery*. Do të ofrohen të dy versionet, ai digjital dhe ai i shtypur.

Forma biografike, e cila i nderon të vdekurit mund të gjenden në gati të gjitha vendet. Një shembull mjaft i mirë, i cili i ngjashëm me ata në SHBA është ai i quajtur *Dictionary of Canadian Biography* (Toronto: University of Toronto Press, 1966-1990, 12 vëllime). Gati çdo pesë ose gjashtë vjet një vëllim i ri, i cili mbulon një kohë të caktuar, lëshohet në botim. Për shembull, vëllimi 12 u botua në vitin 1990 dhe në të përfshihen njerëzit prej vitit 1891-1900. Kjo përmbledhje ka edhe skica biografike të mësuesve, figurave ushtarake, njerëzve të zanateve të ndryshme, e kështu me radhë. I botuar në gjuhën angleze, e po ashtu edhe në atë angleze, ky botim konsiderohet një ndër burimet më të rëndësishme të të dhënave biografike në Kanada. Një indeks përmbledhës në pjesën e parë të atyre serive u botua në vitin 1991, i cili në njëfarë mënyre e zgjidhi problemin e indeksimit të shumëfishtë. Duket pasur parasysh posaçërisht biografitë e përdorshme. Vëllimet pasuese janë në përgatitje e sipër.

Indekset e gazetave ofrojnë një çelës të mirë për biografitë retrospektive të personave të famshëm dhe jo të famshëm. Disa kolumne për të vdekur, në gazeta, sikurse *The Times* i Londrës dhe në një masë më të vogël *The New York Times* kanë opinione dhe pikëvështrime të ndryshme për personat që nuk mund të hyjnë në DAB ose në DNB.

Në Internet (web-sajt)

Një numër i konsiderueshëm i biografive gjenden rrallë në Internet. Përjashtime ka vetëm në rastet e enciklopedive standarde Online - të cilat ofrohen falas ose me pagesë:

Britannica's Lives (www.eb.com/people/). Kjo listë e emrave, me 50-70 fjalë për jetën e çdo personi, ndryshon çdo ditë. Mund të shkojë nga 3-4 faqe, deri në dhjetëra, dhe të përfshijë në vete njerëzit e lindur në ditën e caktuar, kur edhe po bëhet kërkimi. Të gjitha janë versione të shkurtuara të asaj se çka mund të gjenden në edicionin e fundit të *Encyclopedia Britannica*, në versionin e shtypur ose në formatin digjital. Aranzhimi dhe radhitja këtu shkon sipas datave më aktuale të lindjes. Për shembull, 17 prilli mund të hapet me një gjerman imunolog, i cili ka lindur më 17 prill të vitit 1946 dhe mbaron - 6 faqe më tutje - me Maximilian-in të po 17 prillit të vitit 1573.

BIOGRAFITË PROFESIONALE DHE ATO TEMATIKE

Gati çdo listë e botuesit/botueses do të përfshijë vepra biografike, duke filluar nga biografitë individuale deri te veprat përmbledhëse e po ashtu edhe te listat për individët në profesion të caktuar. Rritja e numrit të profesioneve (gati çdo amerikan thotë se është njëfarë profesionisti) e ndjekur edhe nga përparimi në shkollim ka rezultuar në shtimin e burime biografike të specializuara.

Çka ishte thënë për biografitë e përgjithshme vlen edhe këtu: Vërtetësia e disa veprave është në pyetje, pikë së pari, për faktin se gati të gjitha (ndonjëherë të gjitha) informatat i jepen botuesit nga subjekti ose personi për të cilin shkruhen biografia e caktuar. Shumë pak korrigjim ose fare bëhet në këto raste, duke përjashtuar rastet kur ka mëdyshje të mëdha për vlerën e asaj biografie. Shënimet, zakonisht janë të shkurtra, duke dhënë emrin, datën e lindjes, vendin e lindjes, shkollimin, adresën etj.

Vlera primare e veprave biografike të specializuara është si:

1. Burim i adresës;
2. Burim i drejtshkrimit të rregulltë të emrave dhe titujve;
3. Burim i informatave të ndryshme për ata që konsiderojnë një person për ta punësuar ose si një i ftuar;

4. Si një ndihmë e madhe për historianët, të cilët kërkojnë informata që i përkasin së kaluarës (nëse vepra është mbajtur për vite të caktuara).

Shembujt në vijim janë vetëm disa nga burimet profesionale dhe të subjektit. Janë edhe qindra të tjera. Kur bëni kërkim për një individ të caktuar, zakonisht është më e lehtë dhe e shpejtë të filloni me *Biography and Genealogy Master Index* ose një nga botimet e tij shtesë. Përjashtim duhet të bëhet vetëm në rastet kur profesioni i individit është i njohur dhe është e qartë se ai/ajo do të jetë i listuar në njërën nga burimet biografike profesionale ose të subjektit.

Literatura

Online: Contemporary Authors. Farmington Hills, MI: Gale Group, 1994 e deri më sot, gjashtëmuajshe, www.galegroup.com. Çmimi ndryshon.

CD: Contemporary Authors on CD, 1960 e deri më sot, gjashtëmuajshe, $4 197, plus $914 për freskimet vjetore dhe gjysme vjetore
Me informata.

E shtypur: Contemporary Authors, 1960 e deri më sot, mesatarisht 110 Vëllime, e freskuar me informata çdo vit. $120 për çdo vëll.

Online: Literature Resource Center. Farmington Hills, MI: Gale Group, 1998 E deri më sot, e përmuajshme, www.galegroup.com. Çmimi ndryshon.

Online: WorldAuthors: 800 para lindjes së Krishtit - deri më sot. H.W. Wilson Company, 1997 e deri më sot, www.hwwilson.com. Çmimi ndryshon. E gatshme edhe në OCLC.

CD: 1997 e deri më sot. Çmimi ndryshon.

E shtypur: World Authors, 1980-1985. Nju-Jork: H.W. Wilson Company, 1990, 1000 f., $80. Botimet shtesë: *World Authors* 1975-1980, 1985,
831 f. $68; *World Authors* 1970-1975, 1979, 893 f. $73. World Authors 1950-1970, 1975, 1340 f. $90. *World Authors* 1990-1995, 1999, 863 f. $95.

Gati të gjithë shkrimtarët e botuar amerikanë janë të përfshirë në

Contemporary Authors. Kushtet për t'u futur në të, sipas një shkrese për opinion nga botuesi janë që: "autori duhet të ketë të botuar së paku një libër nga botues komercial ose botues universitarë në tri ose katër vitet e fundit. Novelistët, poetët, dramaturgët, shkrimtarët e rinj, shkrimtarët e shkrimeve mbi shkencat sociale dhe humanitetet janë të gjithë të përfshirë". Në fakt, gati çdo kush që ka botuar diçka (libër teknik apo diç tjetër) është i listuar në të. Reporterët e televizionit dhe të gazetës, kolumnistët, redaktorët dhe skenaristët janë, po ashtu të përfshirë. Informatat janë të mbledhura nga pyetësorët, që dërgohen te autorët dhe të dhënat janë të radhitura në të dhëna personale; të dhëna nga karriera; shkrimet; dhe njoftime të rastit, të cilat përfshijnë shënime jo fort të lidhura mbi autorin dhe punën e tij/saj. Nga viti 2000, ky shërbim përfshin diku rreth 100 000 shkrimtarë/autorë. Kjo e bën *Contemporary Authors* një prej burimeve biografike më gjithëpërfshirëse të këtij lloji.

Derisa botimet e shtypura me vëllime të shumta janë shumë të ndërlikuara - janë më shumë se 100 - është shumë më e lehtë për ta shikuar versionin Online CD-ROM.[11] Në versionin e shtypur, kërkuesi duhet të kalojë nëpër indeksin e komplikuar ose një numër të tyre. Në kompjuter, është çështje e thjeshtë e shënimit të emrit , titullin e veprës, ose fjalë kryesore nga e kaluara e autorit, sikurse janë çmimet ose nacionaliteti.[12]

Një burim tjetër, i vetëm, më i mirë për *Contemporary Authors* është baza e dytë e të dhënave Online nga *Gale: Literature Resource Center* (www.galenet.com). Kjo nuk i përfshin vetëm Contemporary Authors, mirëpo edhe bazat e tjera të njëjta të të dhënave nga Gale, duke filluar nga *Black Writers dhe Children's Literature Review* deri te *World Literature Criticism* dhe *Yesterday's Authors of Books for Children*. Kërkimi këtu bëhet i llojit "kërkimi me një hap të vetëm" gjë që kërkohet nga shumica e njerëzve, të cilët kërkojnë informata lidhur me kritikat mbi punën e autorit, plus informata mbi autorin dhe përpjekjet letrare të tij. Janë diku afër 130 000 autorë, të cilët kanë shënime të detajuara. Të tjerët kanë shënime më skicore, pra me më pak fjalë. Në të ardhmen, baza e të dhënave do të përshijë në vete disa vepra Macmillian, sikurse edhe seria e autorëve Twayne, e elaboruar më poshtë. Ju mund ta bëni kërkimin po

[11] Mirëpo, mos i leni mënjanë kolumnet e shtypura. Për fat të keq, versioni Online nuk i përfshin të gjitha materialet që gjenden në versionin e shtypur.

[12] Gale i boton dy tituj referencorë mjaft të ngjashëm dhe shumë të përdorur- së paku nga studentët dhe të diplomuarit. Këto janë: Contemporary Literary Criticism, 1973 e deri më sot, dhe Dictionary of Literary Biography, 1978 e deri më sot, vepër deri diku e njëjtë me veprat në CD-ROM të DISCovering Authors dhe DISCovering Poetry.

ashtu edhe sipas titullit të librit. Janë diku rreth 140 000 shënime titujsh.

World Authors është një nga librat më të mirë mbi autorët dhe përfshin jo vetëm informacione të domosdoshme biografike, por edhe vepra biografike nga autori dhe për autorin. Burimi i të shumtës së materialit është vetë autori, nëse është i gjallë kuptohet; ose një kërkim i kujdesshëm nga këshilluesit nëse autori është i vdekur. Disa nga shënimet janë të shkruara, fjalë për fjalë, si i ka shkruar autori dhe janë lexime argëtuese në një masë. Shumica e veprave biografike, të kushtuara për subjektin ose profesionin përmbajnë në vete shënime të vogla.

Një shembull i këtyre serive është *World Authors 1950-1970* e redaktuar nga John Wakeman me Stanley Kunitz si këshilltare. Edhe pse me mbulim ndërkombëtar, këtu gjenden ese të gjatë dhe jo të lidhura me njëra tjetrën.

Dhe...

Dy bazat e mëdha të të dhënave dhe seritë e vëllimeve të shtypura janë vetëm burime të mëdha të biografisë letrare. Ka edhe shënime dhe botime të tjera nga konkurrues të tjerë - asnjë nga ato materiale për t'u përdorur si ese ose si përmbledhje e përgjithshme - që ofrohen Online ose në CD-ROM.

Dallimet më të mëdha janë në atë se kush e ofron tekstin e plotë. Këtu janë dy shembuj:

1. *Twayne's World Authors* (Nju-Jork: Simon & Schuster, 1998. CD-ROM, $995). Kjo përfshin tekstet e 190 librave me fokus të veçantë në ata autorë të shekullit XIX dhe XX, të cilët nuk kishin të drejta autoriale. Ju mund ta bëni kërkimin duke shënuar fjalën kryesore, emrin, periudhën kohore, nacionalitetin etj. Përdoruesi mund të bëjë kërkimin në tekstin e plotë të të gjitha librave, ose mund ta kufizojë kërkimin në vetëm një ose dy libra. Shumica e librave mund të gjenden në biblioteka. Versioni standard i shtypur i *Twayn's Author Series* ofron një histori të detajuar nga e kaluara e punës së autorit, duke filluar në mënyrë kronologjike nga jeta e autorit, kritikat mbi punën dhe veprat e tij, deri te biografia gjithëpërfshirëse. Vëllimet, një për autor, janë të kompozuara nga ekspertët. Ky botim nuk është i domosdoshëm për të gjitha bibliotekat përveç bibliotekave të mëdha kërkuese.

2. *Major Authors on CD-ROM* (Nju-Jork: Primary Source Media, 1998. CD-ROM. $2 395). Secila CD është për një autor të caktuar, si p.sh. për *The Brontes, Walt Whitman, Cervantes,* ose *Virgina Wolf*. Edhe pse vetëm

për kërkim, ky botim përfshin tekstet e plota të novelave dhe shkrimeve të tjera si material dorëshkrimi, letra, vizatime, pikura, komente dhe çdo gjë tjetër, që ka të bëjë me autorin, që kushtojnë nga $2 000 deri 2 400 për çdo disk. Jo ngjashëm si përmbledhja Twayne, ky është një projekt me një vlerë të madhe për dijetarët dhe studentët e diplomuar.

Në Internet

Çdo njeri, i cili është duke kërkuar informata specifike, ose më shumë të dhëna në autorë, duhet të shikojë disa web-sajte dhe grupe të lajmeve. Formati i tyre mund të gjendet, thjesht, duke shënuar emrin e autorit, në thonjëza, në kutinë për kërkim ose (search). Për shembull, nëse shënoni emrin e një autori mund të shfaqen mbi 300 web-sajte të ndryshme.

The Literary Menagerie (http://sunset.backbone.olemiss.edu/ egcas). Këtu mund të gjendet web-sajti ideale për dikë, i cili ka bërë një kërkim të detajuar dhe shumë të gjatë mbi një autor të caktuar, zakonisht mbi një autor me reputacion dhe famë ndërkombëtare. Pasi jepet një përshkrim i shkurtër biografik, më pastaj mund të zgjidhen artikuj dhe libra të ndryshëm biografikë për atë shkrimtar, e po ashtu edhe për veprat e tij. Gati për secilën prej këtyre jepen, po ashtu, edhe informata të përgjithshme mbi të kaluarën dhe informata të hollësishme për studentët dhe lexuesit e interesuar. Nuk jepen linka për web-sajte të tjera për referenca individuale të autorit. Ky botim është një vepër e përpiluar nga doktorë shkencash dhe profesorë anglezë.

Yahoo! Authors (www.yahoo.com/arts/humanities/literature/authors). Kjo është një listë mjaft e mirë e web-sajteve të autorëve nëpërmes *Yahoo!*. Kërkimet mund të bëhen duke shënuar emrat e autorëve, e po ashtu edhe nëpërmes kategorive të ndryshme, si p.sh. autorët e romancave, romaneve, mistereve etj. Këto web-sajte ndryshojnë shumë si për nga besueshmëria ashtu edhe për nga sasia e informatave që mund të gjenden në to. Më se mirë është të përdoret për gjetjen e autorëve q vështirë gjenden në versionet standarde ose ato CD-ROM të burimeve biografike.

Catharton: Authors (www.catharton.com/authors). Një makinë kërkuese, e cila i dallon materialet në Internet për autorët që janë më të njohur për stilet e tyre sesa për marrëdhëniet e tyre me *Star Trek*. Shëno

emrin dhe ndër gjërat tjera, web-sajti ofron linka për web-sajte, lista të e-mail-ave, e po ashtu edhe forume të ndryshme. Më pastaj, vjen edhe një listë me veprat e autorit përsëri me linka të analizave dhe komenteve mbi ato vepra. Shumë aspekte të tjera të Catharton janë të përdorshme prej analiza të librave deri te "autorët fillestarë".

Gjenealogjia [13]

E shtypur: Printed Sources: A Guide to Published Genealogical Records, Salt Lake City: Ancestry (Prejardhja), 1998, 840 f. $50.

E Shtypur: Raymond Wright. The Genealogy's Handbook. Çikago: Asociacioni
Amerikan i Bibliotekave, 1995, 280 f. $40.

Klientët e shumë bibliotekave janë goxha të interesuar në gjenealogji (prejardhje). Kërkimi i informatave mbi historinë familjare është fascinuese, mirëpo në anën tjetër edhe shumë konfuze. Si rezultat i kësaj ka ekspertë të provincave të caktuara, mirëpo janë edhe disa ciceronë dhe udhëzues shumë të mirë, të cilët mund të përdoren nga bibliotekari (ose personi joprofesional) për ta përgatitur dhe për ta përfunduar një projekt nga gjenealogjia ose prejardhja.

Si një udhëzues për labirintin e të dhënave të publikuara, *Printed Sources* është edhe për fillestarin edhe për ekspertin. Kapitulli i parë jep informata të përgjithshme nga e kaluara e kërkimit. Kjo më pastaj vijohet nga katër seksione dhe kapituj të tjerë, të cilët i tregojnë shkurtimisht konceptet kryesore dhe të dhënat e përgjithshme e themelore se ku duhet të shikohet për informata. Ky botim, i cili është i jashtëzakonshëm për të dhëna të detajuara, është ndalesa e parë për çdonjërin që kërkon informacione gjenealogjike.

The Genealogist's Handbook i tregon hapat e nevojshëm që duhet të merren për ta kompletuar pemën familjare. Autori shpjegon këtu hapat themelorë dhe më pastaj tregon rrugët, shtigjet dhe aksidentet, që mund

[13] Thomas Kemp, "The Roots of Genealogy Collections," Library Journal, 1 prill, 1999, f. 57. Një listë e shkurtër e udhëzuesve kryesorë nga një prej ekspertëve më të mirë në SHBA Po ashtu shiko edhe: "Genealogy Bookmarks" plus edhe disa faqe të tjera mbi burimet referencore të gjenealogjisë në Booklist, 1 maj, 1999, f. 1 618 +, 10 qershor, 1997, f. 10 për të parë listën e web-sajteve.

të ndihmojnë ose të pengojnë gjatë konstruktimit të pemës familjare. Po ashtu, gjendet edhe një kapitull mbi atë se si duhet të shkruhet mbi të parët ose stërgjyshërit. Është një udhëzues shumë i mirë për gati çdo bibliotekë. Për vëllimin e njëjtë të freskuar me informata plus materiale shtesë, shiko një vepër tjetër nga Asociacioni Amerikan i Bibliotekave: Dahrl Moore, *The Librarian's Genealogy Notebook* (1998, 160 f., $32). Po ashtu, kjo është një përmbledhje shumë më e mirë, posaçërisht për bibliotekat më të vogla.

Në Internet (web-sajt)

Janë disa qindra vende në Internet për të gjetur informacione gjenealogjike (nga prejardhja). Vështirësia ekziston në atë se jo të gjitha janë informacione të besueshme. Ndërsa, fokusi i pjesës tjetër është aq i ngushtë në disa fusha saqë është e vlefshme vetëm për disa njerëz. Qasja më e mirë këtu është shënimi i qytetit ose shoqërinë historike të shtetit në kutinë për kërkim (search). Gati të gjitha kanë fajla ose dokumente mbi prejardhjen, që mund të hapen për kërkim Online.

Kështu, web-sajtet më të mira sipas madhësisë dhe saktësisë janë:

Family Search (www.familysearch.org) është web-sajt gjenealogjik e kishës Mormon Church, e cila u ofron qasje miliona shfrytëzuesve në bibliotekën më të madhe gjenealogjike. Kjo ofrohet për anëtarët e kishës e po ashtu edhe për ata që nuk janë anëtarë të saj, dhe mund të përdoret për të gjetur të dhëna për gati çdo emër. Është e mbështetur nga disa qindra mijëra dokumente dhe bazuar në disa gjenealogjistë profesionalë, është web-sajti më e mirë për kërkime të tilla. Dokumentet e vërteta mund të mos jenë Online dhe ato duhet të porositen nga biblioteka në qytetin Salt Lake City, Utah.

Genealogy Home Page (www.genhomepage.com) ofron linka për burime gjenealogjike, me theks të veçantë, më shumë në atë se si "duhet të bëhet" sesa në të dhëna konkrete. Të një rëndësi të madhe janë veçanërisht linkat për koleksionet gjenealogjike në bibliotekat dhe burimet komerciale. Po ashtu, ofrohen edhe çelësat për gazetat më të mëdha dhe FAQs. Opsioni Roots Surname i liston më se 85 000 mbiemra dhe e vendos kërkuesin në lidhje me të tjerët njerëz ose shfrytëzues që punojnë ose kërkojnë emrin e njëjtë/emrat e njëjtë. Është e mbështetur dhe përkrahur

nga Stephen A. Wood.

Cyndi's List of Genealogy Sites on the Internet (www.cyndislist.com). Zyrtarët e këtij burim individual thonë se kanë më se 20 000 linka për web-sajte gjenealogjike. Linkat janë të radhitur sipas rendit alfabetik.

BIOGRAFITË GRUPORE TEMATIKE

Online: Gale Biography Resource Center. Farmington Hills, MI: Gale Group,
1999 e deri më sot, biblioteka, www.galegroup.com. $3 000+,
Çmimi ndryshon.

Online: Wilson Biographies Plus Illustrated. Nju-Jork: H.W. Wilson Company,
1999 e deri më sot, http:// hwwilson.com. $1,500; botimet vjetore të Korrigjuara, $395.
CD: 1999 e deri më sot, e përvitshme, $945, një përdorues.

Online: Bowker Biographical Directory. Nju-Jork: R.R. Bowker, 1993 e deri më sot, freskimet me informata ndryshojnë në kohë. DIALOG File 236,
$90 për orë.

Në trendin për të cilin është e sigurt që do të rritet edhe më shumë, Kompania H.W. Wilson Company i merr dhe është duke i marrë jo vetëm një, mirëpo gati 100 referenca të shtypura biografike dhe është duke i ofruar ato si një përmbledhje e vetme Online. Lehtësia absolute, kursimi i kohës, dhe zbritja e çmimit do të thonë se ky lloj biznesi domosdo se do të vazhdojë. Kjo nuk është asgjë më pak për bibliotekarët sesa një vepër e artë, ani pse dështimi për të nënvizuar burimet zakonisht rezulton në kërkime të gabuara.

Gale Biography Resource Center ofron informata të ndryshme për më se 230 000 individë. Të dhënat janë të marra prej më se 50 botime nga Gale duke përfshirë këtu edhe *Contemporary Authors*. Po ashtu, janë marrë të dhëna nga Indeksi i përgjithshëm i Gale (IAC), që ofron të dhëna biografike të marra nga gazetat dhe periodikët.

Problemi i vetëm, gati si me të gjitha përpjekjet grupore të llojit të tillë

që marrin informata prej një numër burimesh, është ai se nuk ka një qasje të caktuar për shënim. Për shembull, këtu disa biografi përfshijnë emrin, profesionin dhe datat. Të tjerat biografi e harrojnë profesionin dhe ndonjëherë edhe datat. Po ashtu, listimi jo i kujdesshëm i emrave bën që kjo listë të jetë shumë larg nga ajo që do të duhej të jetë. Është një keqpërdorim i përgjithshëm i titujve të subjektit për burimet nga grupet e mëdha.

Këtu, sikurse edhe në biografitë e tjera grupore të diskutuara më parë, ju mund të bëni kërkimin Online në disa pika, duke filluar nga data e lindjes dhe e vdekjes deri te profesioni, gjinia, nacionaliteti etj. Për shkakun se gjendet një numër i madh i artikujve me tekste të plota dhe jo vetëm informacione të llojit udhëzues, i gjithë procesi i gjetjes së biografisë mund të jetë më i shkurtër.

Si zakonisht, ka disa lloje ose kategori të kërkimit, duke filluar nga shënimi i fjalëve kryesore deri te logjika e sofistikuar Boolean. Për shkakun se shënimet zakonisht janë të ndryshme, si p.sh., emri i personit mund të shkruhet para mbiemri, mbiemri i pari ose e kundërta, ose nofka mund të përdoret ose mos të përdoret në shënim fare, disa kërkime janë larg nga të qenit perfekt. Mirëpo, kur shikohet në përgjithësi, rezultati i përgjithshëm është i kënaqshëm dhe nëse kërkuesi nuk është i kënaqur, ai gjithmonë mund të shkojë prapa dhe të bëjë kërkimin përsëri. Shënim: Bibliotekat mund të marrin lloje të ndryshme të bazave të të dhënave të tipit *Marquis Who's Who* në sistemet e tyre- mirëpo që kushtojnë. Këto përfshijnë më se 20 tituj nga *Who's Who* dhe mbi 900 000 shënime, shumica e të cilave mund të gjenden po ashtu edhe në të dhënat biografike.

Wilson

Thuhet se *Wilson Biographies* "mbulon në përgjithësi më se 72 000 figura, prej kohës antike e deri më sot". Diku 1 000 emra të rinj shtohen çdo vit.

Kërkimet mund të bëhen Online ose në version CD-ROM duke shënuar emrin, vendin e origjinës, profesionin, datën e lindjes dhe fjalë të tjera kryesore. Ndër vëllimet që janë kthyer në format Online ose CD-ROM janë: Current Biography Yearbooks prej vitit 1940 e deri më sot (kjo i përfshin më se 59 vëllime nga 100 vëllimet sa thuhet se i ka ky sistem). *World Authors Series*, 800 para lindjes së Krishtit- deri më sot.(14

vëllime të tjera), dhe më pastaj vëllimet e vetme nga *World Artist and Popular American Composers* deri tek *Nobel Prize Winners dhe American Songwriters*.

Ky sistem përfshin 27 000 fotografi të subjekteve. Kërkimi lejon shfrytëzuesin të kërkojë një artist eminent ose një trajner zebre, pa e ditur emrin e tij. Pikat e tjera të gatshme të kërkimit janë ato nga shënimi i fjalëve kryesore deri te vendi i lindjes.

Derisa te Wilson nuk mund të gjenden aq biografi sa mund të gjenden në Gale, prapëseprapë Uilson e ka përparësinë e shënimeve më të gjata, gati gjithmonë edhe me fotografi. Nëse biblioteka duhet të zgjedh në mes këtyre dyve, Wilson preferohet më shumë. Bibliotekat më të mëdha duhet të kenë versionin Gale gjithsesi.

Bowker

Duke kombinuar tre fjalorët biografikë, R.R. Bowker Company e botoi versionin Online *Bowker Biographical Directory*. Listat këtu përfshijnë llojin tipik të informatave të Who's Who dhe në radhë të parë përdoren për adresa, tituj dhe të dhëna të shkurtra mbi të kaluarën e individëve. Janë diku rreth 160 000 shënime. Në mënyrë sasiore: janë diku 11 500 biografi në *Who's Who in America Art*; 26 000 në *Who's Who in American Politics*; dhe mbi 120 000 në *American Men and Women of Science*[14] (përveç titullit, përmbajtjet e shërbimeve të arteve dhe shkencave përfshijnë ato kanadeze dhe amerikane). E freskuar me informata çdo dy-tri vjet, numrat ndryshojnë, mirëpo përmbajtja qëndron e njëjta në masë të madhe. Vetëm disa persona hyjnë ose dalin nga botimi.

Versioni Online është më i mirë sesa vëllimet e shtypura individuale prej të cilave edhe është ndërtuar baza digjitale e të dhënave. Për shembull, versioni i shtypur i *Who's Who in American Art* është i aranzhuar sipas rendit alfabetik. Janë disa disiplina të indekseve prej bibliotekarëve deri te kritikët e artit. Shërbimi Online lejon qasjen e njëjtë, sikurse edhe atë duke shënuar gjininë, datën e lindjes dhe të vdekjes, vendin e lindjes, e

[14] American Men and Women of Science (1906 e deri më sot, çdo tri vjet, $900) me shërbimet elektronike gjendet në shumicën e bibliotekave. Versioni i shtypur me tetë vëllime i shton dhe i heq më se 4 000-5 000 emra në çdo edicion dhe kështu ruan balancën numrit të shënimeve në 120 000. Të dhënat për çdo person janë të llojit Who's Who. I një rëndësie të veçantë është indeksi i cili përfshin 190 disiplina në 10 fusha të ndryshme të studimit. Për burimet e tjera shkencore biografike, shiko Booklist, 1 dhjetor, 1998, f. 694, faqja "Reference Books Bulletin" në "Lives in Science."

kështu me radhë.

Në përjashtim të situatave të caktuara, si për shembull një bibliotekë e muzeut të artit, shumica e shërbimeve përdoren jo shumë shpesh. Duke u bazuar në çmimin e versioneve të shtypura, është shumë më ekonomike për të qëndruar me qasjen Online.

Sugjerime për të lexuar

Carlson, Tucker, "The Hall of Fame," Forbes FYI, Pranverë, 1999, f. 63-66. Autori e vë në dyshim procesin e përzgjedhjes në Who's Who in America dhe jep disa argumente, të cilat e vërtetojnë idenë e tij se botuesi është më shumë i interesuar në përfitime materiale sesa në përzgjedhjen e kujdesshme. Po ashtu, ai jep edhe disa shembuj të mirë mbi atë se si botuesi i lidh produktet e tij me njerëzit, që janë pjesëmarrës në librat e tij. (Shënim: Forbes FYI është një botim i veçantë më shumë për publicitet e për reklama.)

Conway, Jill, When Memory Speaks. Nju-Jork: Alfred A. Knopf, 1998. 205 f. Një përpjekje e njohur historike për të shpjeguar si autobiografitë u bënë një zhanër letrar. Prej Shën Augustinit e deri te veprat moderne të ditëve të sotme, historia "kërkon të shpjegojë si kongreset e gjinive gjithmonë nëpër histori i kanë vendosur format se si meshkujt dhe format do të shkruajnë kur ata shkruajnë për jetën e tyre". Kjo premisë nuk është vërtetuar ende, mirëpo kjo do të thotë se autobiografitë më të mira e bëjnë këtë libër me vlera.

Lane, Anthony, "True Lives," The New Yorker, 27 korrik, 1998, f. 68-76. Pse gazetat britanike mbi vdekjet janë aq fascionuese, në veçanti kur krahasohen me ato të tipit amerikan? Autori britanik shpjegon në këtë studim të shënimeve të vdekjeve se si ato njoftojnë dhe në të njëjtën kohë edhe argëtojnë. "Deri kah fundi i shekullit XIX unë nuk isha i njoftuar se sa të rëndësishme, të pasura dhe të shkëlqyera janë shënimet mbi vdekjet". Me këtë, autori lëshoi një fjalë dhe një shpjegim që do ta bënin çdo njërin ta shikojë këto lexime.

McCullough, David, "The Art of Biography," The Paris Review, Vjeshtë, 1999, f. 35-43. Biografi i njohur amerikan shpjegon dhe shtjellon këtu

çka duhet për të shkruar e për të bërë kërkim mbi një biografi që ka fituar çmimin Nobël. Autori është shumë i njoftuar me aftësitë që duhen dhe nevojiten për të shkruar biografi dhe kështu ai jep disa shembuj dhe sugjeron, ndonjëherë edhe në mënyrë indirekte, në atë se si të vlerësohen veprat referenciale biografike. Përveç kësaj, është një libër që lexohet me kënaqësi.

Morgan, Edmund and Marie Morgan, "Who's Really Who," The New York Review of Books, 9 mars, 2000, f. 38-43. Në analizë e gjatë e American National Biography, e cila është mjaft e mirë për t'u lexuar për tri arsye. E para, autorët demonstrojnë kënaqësitë e një pune të tillë referenciale. E dyta, ata tregojnë përparësitë dhe të metat e edicionit të ri. Dhe, e treta, e më e rëndësishmja për bibliotekarët, ata ofrojnë një model se si do të duhej të dukej një analizë e detajuar referenciale. Ah, dhe në proces e sipër, ata japin një pikëpamje unike mbi jetën amerikane.

Morrison, Susan, "The Use of Biography in Medieval Literary Criticism," The Chaucer Review, vëllimi 34, nr. 1, 1999, f. 1-69. Një artikull shkencor, i cili tregon se si biografia përdoret në teoritë letrare. Autori tregon, po ashtu, edhe detaje të një kërkimi të tillë. Artikulli e thotë qartë se biografia në biblioteka disa herë është e lidhur me çështje, e jo vetëm me p.sh. një ese shkollore dyfaqëshe, ose një ese për argëtim.

Watson, H., "Constructing American Lives: Biography and Culture," Reviews in American History, mars, 2000, f. 45-49. Në këtë libër analitik, autori shpjegon elementët përbërës dhe themelorë të një biografie të besueshme dhe të mirë. Shërben jo vetëm si një model për analizimin e biografisë, mirëpo edhe si një kandar për bibliotekarët në ato raste kur ata duhet të vendosin për të blerë ose për të mos blerë një vepër të caktuar.

Woody, Donna. "African American Biographies," Journal of Youth Services in Libraries, nr. 1, viti 2000, f. 5-9. Një diskutim i asaj se çka nevojitet për të ndërtuar një koleksion të literaturës së zezë në bibliotekat shkollore.

Këtu jepen edhe sugjerime në atë se çka duhet të shikohet në biografitë e pranueshme dhe se ku mund të gjenden ato.

KAPITULLI X
FJALORËT

Fuqia e fjalëve është demonstruar në një kontest ndërkombëtar gazetaresk. Njerëzit ishin pyetur që të zgjidhnin 20 fjalë, të cilat më së miri e përmblidhnin shekullin XX. Televizioni erdhi si e para fjalë e më pastaj u pasua nga: teknologjia, komunikimi dhe kompjuteri. Globalja dhe globalizimi ishin zgjedhur si fjala e pestë më e preferuar. Top 20-shi pas fjalës globalizim përfshin fjalët: çipat nga silikoni, holokausti, automacioni, bikini, zbulimi, Interneti, progresi, shpejtësia, mikro-çipat, fshati global, media, efekti i fluturës (një shembull i kaosit dhe i teorisë së shkatërrimit në matematikë dhe shkencë), ndryshimi, gjenocidi dhe penicilina.[1] Është shumë interesant fakti që e vetmja fazë ose fjalë që nevojitet një lloj shpjegimi për të është efekti i fluturës.

Definicioni i fjalëve dhe drejtshkrimi i tyre janë arsyet kryesore pse përdoren fjalorët. Fjalori tregon dijen e lexuesit dhe disa herë njohuritë e tij mbi gjuhën amtare. Organizata joprofitabile, sikurse Libra për të burgosurit, tregon që fjalorët janë ndër më të lexuarit në mesin e të burgosurve. Botuesit thonë se fjalorët janë po aq të popullarizuar edhe për njerëzit jashtë burgjeve. Tani do të vazhdojmë me pjesën tjetër të tregimit.

Fjalorët janë instrumente shumë më shumë efektive për nënshtrimet e panumërta gjuhësore sesa që janë librat e lutjeve për format dhe lutjet e

[1] Libri i cili e përmbledh shpirtin e asaj kohe, "The Times (E Londrës) 14 mars, 1998, f. 7. Ndër fjalët që nuk hyjnë në mesin e top 20 fjalëve të shekullit XX ishin: vetvetja, buka e prerë dhe lunaparku.

panumërta shpirtërore. Lexuesi mund ta shikojë fjalorin për të parë jo vetëm kuptim dhe drejtshkrimin e asaj fjale, mirëpo edhe për të parë shqiptimin e saj, kuptimin dhe ndarjen e fjalëve, sikurse edhe pika të tjera të rëndësishme. Ndodhë shumë rrallë, që të shkojë një ditë e një person të mos ketë nevojë për fjalorë, edhe nëse ai i duhet vetëm si ndihmë në enigmën e madhe të fjalëve.

Një keqkuptim i shpeshtë ndodhë atëherë kur fjala nuk mund të gjendet fare. Shumica e njerëzve mendojnë që nuk ka fjalë të tillë. Në një botë ku po jetojmë ne, e cila ndryshon shumë shpejtë, është e natyrshme dhe mjaft e dhimbshme që disa leksikografë i heqin disa fjalë, duke besuar se ato fjalë janë shumë të çuditshme, ofendojnë në baza racore, janë shumë vulgare, e kështu me radhë. Një tjetër gabim është paramendimi se rregulli dhe rendi i definicionit, i drejtshkrimit, ose i shqiptimit ka të bëjë me preferenca. Dhe, në fund, shumica nuk i kuptojnë etiketimet, si "i gjuhës së folur". Studentët shpesh mendojnë që kjo do të thotë "regjionale" ose "jo e mirë" dhe nuk e kuptojnë domethënien e vërtetë të "gjuhës së folur".

Çka mbulojnë dhe çka përfshijnë fjalorët

Fjalorët mbulojnë gati çdo fushë të interesit. Janë tetë kategori të përgjithshme e të pranuara në formatet digjitale dhe ato të shtypura të fjalorëve: (1) fjalorët e përgjithshëm të gjuhës angleze, të cilët përfshijnë titujt e pashkurtuar (p.sh., ata me mbi 265 000 shënime) dhe fjalorët për universitete dhe kolegje (prej 139 000 deri 180 000 shënime). Këta janë fjalorë për të rritur dhe për fëmijë; (2) fjalorët në fund të librit ose fletës, të cilët nuk mund të kenë më shumë se 30 000-55 000 fjalë dhe të cilët zakonisht janë mjaft të lirë dhe të lehtë për t'u bartur me vete; (3) fjalorët historikë, të cilët tregojnë historinë e fjalës prej datës kur ishte prezantuar si fjalë e deri më sot; (4) titujt e specializuar shkencorë, të cilët fokusohen në një periudhë të caktuar kohore ose në një vend sikurse Fjalori i anglishtes së vjetër; (5) fjalorët etimologjikë, të cilët janë disi si fjalorët historikë, por të cilët fokusohen më shumë në analizimin përbërësit që kanë lidhje me gjuhët e tjera; (6) titujt e gjuhëve të huaja, që janë fjalorë dygjuhësorë për arsyen se ata e japin fjalën në një gjuhë dhe kuptimin e saj në gjuhën tjetër; (7) veprat mbi një subjekt të caktuar, ku theksi i veçantë vihet në definicionin e fjalëve në një fushë të caktuar, sikurse në shkencë dhe në teknologji; (8) fjalorë "të tjerë", të cilët përfshijnë gjithçka prej shkurtimeve deri te fjalët nga gjuha e rrugës dhe shqiptimi i mirëfilltë i fjalëve.

Përpilimi

Si përpilohet një fjalor prej fjalëve të shkruara dhe të shqiptuara dhe cilat janë burimet? Sot, shumica e botuesve të mëdhenj, duke filluar nga Houghton Mifflin deri te *Merriam – Webster* dhe *Random House* kanë stafe të mëdha dhe leksikografë shumë të mirë.

Kompanitë e fjalorëve në Angli, sikurse edhe ato në Amerikë përfitojnë shumë nga *British National Corpus (BNC),* e cila i ofron Online mbi 300 000 fjalë, në të cilat mund të ketë qasja nga kompjuteri juaj duke shënuar (http://info.ox.ac.uk/bnc/). Fjala bankë ndihmon për të treguar se si një fjalë e dhënë është inkorporuar në fjalime dhe shkrime. Për shembull, fjala "ngjet" shfaqet rreth 25 % të kohës në kuptimin e fjalës "ndodhë" derisa shumica e njerëzve e përdorin atë term për të nënkuptuar "për t'u bërë i njohur ose për të treguar". Kjo ende është një çështje diskutabile, mirëpo për shumicën e njerëzve definicioni i fjalës "ndodhë" duket më i përdorshëm. Kështu, ky është vetëm një shembull i "rregullës", e cila thotë se fjalët nënkuptojnë atë çka duket se nënkuptojnë varësisht nga konteksti dhe rasti.

Fjala procesi i bankës është shumë i ndryshëm prej firme në firmë, mirëpo në esencë, kjo është në dy faza. Lexuesit e pavarur dërgojnë brenda përdorime të reja ose të pazakonshme të fjalëve të marra nga revistat, gazetat dhe burime të tjera. Veprat e reja, ose librat ndryshe nga ata më të vjetrit (sikurse shembulli i përdorimit të "pjesës së fortë - hardware" në relacion me kompjuterë ka ndryshuar plotësisht) janë të incizuar dhe të shënuar në kartat prej 5-7 cm, ose në ditët e sotshme ato janë të futura në memorien e kompjuterit. Në fazën e mëvonshme, ato konsiderohen për futje në libra, duke u bazuar në fuqinë e tyre "qëndruese", pra në atë se sa do të zgjasë përdorimi i tyre.[2]

VLERËSIMI

Për atë të cilët dëshirojnë që të bëjnë vlerësimin e fjalorëve, rregulla e parë ajo që nuk duhet pritur që fjalori të jetë i përkryer. Dr. Johnson tha: "Fjalorët janë si orët: më i keqi është më mirë se hiq, ndërsa më i miri

[2] Një rast për të ilustruar këtë poentë: "misandry" është mos pëlqimi i meshkujve, që nuk mund të gjendej në fjalorët përpara lëvizjes së gruas. Fjala e kundërt e kësaj është "misogny" që është mos pëlqimi i femrave; misandy u shfaq diku në vitin 1946. Në anën tjetër, misogny u shfaq shumë më herët nga fundi i shekullit XVII. Mbi historinë e këtyre fjalëve, si gjejnë vend ato në fjalorë, dhe në atë kuptim, edhe në letërsi e fjalime, shiko: "In the Battle of The Sexes, This Word is a Weapon", The New York Times, 25 korrik, 1999, f. 2.

duhet të paramendohet si më i miri". Nuk ka fjalorë të përkryer dhe kurrë nuk do të ketë të tillë, derisa elemente të tilla, sikurse gjuha e një vendi të bëhen komplet statike. Gjuha ndryshon çdo ditë dhe zhvillohet për shkak të ardhjes së fjalëve të reja dhe ndryshimi i kuptimit të fjalëve të vjetra.

E botuar në mesin e vitit 1999 dhe shumë e reklamuar nga kompania botuese, *Encarta World English Dictionary* e ngrit në qiell fotografinë paradhënëse të H. Gates, në f. 738. Shënimi mbi njërin nga themeluesit e *Microsoft* (botues i fjalorit) është i kuptueshëm, mirëpo duhet pyetur pse nuk ka në të asnjë fotografi të presidentit John F. Kennedy? Rivalët dhe konkurrentët shpejt i vunë në dukje edhe gabimet e tjera në fushën e sportit në botimet e shtypura dhe ato digjitale. Disa shembuj tregojnë qartë rëndësinë dhe nevojën e vlerësimit të kujdesshëm të fjalorëve: (1) Etiketat paralajmëruese sensitive paralajmërojnë për përdorimin e fjalës "shoqe" ose "ka probleme me dëgjim" si fjalë mjaft fyese. Një pasthirrmë mjaft e njohur, shumë e preferuar nga ushtarët, e përdorur në filma dhe në shumë gjëra të tjera etiketohet si fyese gati 20 herë në një fragment të vetëm; (2) Shqiptimi i Niagara Falls (Ujëvarat e Niagarës) është "naiagra fallz"; (3) George Gordon Meade ishte gjeneral gjatë Luftës Revolucionare të SHBA.-së. Në të vërtetë ishte Lufta Civile; (4) Një fotografi e karriges është e etiketuar si "sallë". Në edicionet e më vonshme, këto gabime ishin përmirësuar dhe ishin modifikuar.

Asnjë fjalor nuk është i mjaftueshëm. Secili nga ta i ka përparësitë dhe pikat e mira e po ashtu edhe defektet.

Kjo është e vërtetë për versionet digjitale, të cilat normalisht nuk kanë asgjë më shumë sesa fjalët nga versioni i shtypur të bartura ne formatin elektronik. Vlerësimi i fjalorit digjital është gati i njëjtë me atë të shtypur.

Rregulla kryesore dhe themelore e vlerësimit duhet të jetë e vetë-dukshme, mirëpo në shumë pak raste respektohet dhe ndiqet: Konsultohu me parathënien dhe shënimet shpjeguese në fillim e fjalorit. Arti i përdorimit të suksesshëm të fjalorit ose të ndonjë vepre referenciale kërkon një kuptim të mirë të pjesës se si fjalori është bërë gati për botim. Kjo është e rëndësishme për shkakun të përdorimit konstant të shkurtesave në fjalorë si shkurtimet vetëm me iniciale, metoda të ndryshme të cilat tregojnë shqiptimin dhe nocionet gramatikore.

Pikat e vlerësimit

Përveç pikave të përbashkëta se fjalori nuk është i përkryer dhe se paradhënia e çdo fjalori duhet të lexohet, janë edhe disa pika të tjera, të cilat duhet të kontrollohen dhe të shikohen përpara se të vendosni nëse do ta bleni fjalorin e caktuar ose jo:

Autoriteti i botuesit. Është një numër i vogël i botuesve të fjalorëve. Ndër botuesit më me reputacion hyjnë: *Merriam – Webster; Oxford University Press; Random House; Scott-Foresman; Doubleday; Macmillian; Simon & Schuster; dhe Houghton Mifflin* që është ndër botuesit më të mëdhenj dhe më të njohur (në Angli, katër botuesit më të mirë të fjalorëve janë *Oxford, Collins, Longman* dhe *Edinburg based Chambers*). Një lider i padiskutueshëm është *Merriam-Webster*. Fjalorët e kolegjeve shkojnë nga pesë deri gjashtë botime, çdo vit, dhe brenda vitit shiten deri në disa miliona kopje. Në fushat e specializuara dhe në disa fusha të tjera, ku nevojiten fjalorët, ka edhe botues të tjerë, mjaft të mirë dhe me reputacion. Arsyeja pse janë relativisht vetëm disa botues të fjalorëve është e njëjtë si ajo që u përdor për të shpjeguar se pse ka aq pak vepra mbi enciklopeditë e përgjithshme- pra çmimi. Fjalori është mjaft i shtrenjtë.

Titulli "Webster" në fjalor mund të jetë shenjë e mirë dhe e sigurisë se fjalori është i mirë dhe shumë shpesh titulli është një ndër principet kryesore për fjalorët. *G & G Merriam Company,* e cila i bleu kopjet e pashitura të fjalorit Noah Webster, kur ai vdiq në shekullin XIX, e pati famën e emrit të mirë. Për disa vjet, përdorimi i emrit *Webster* ishte subjekt gjyqësor. *Merriam-Webster* përfundimisht e humbi këtë rast gjyqësor kur e drejta autoriale e emrit përfundoi. Tani ky emër është një pasuri e përgjithshme, e cila mund të përdoret nga secili botues që dëshiron. Si rezultat emri "Webster's" mund të ketë ose mos te ketë asgjë të përbashkët me veprën origjinale prej së cilës vjen edhe emri. Përderisa emri i botuesit është i njohur "Webster" përse nuk do të thotë asgjë.

Fondi i fjalëve. Fondi i fjalëve mund të vlerësohet në termat se në çfarë kohe të gjuhës është shkruar fjalori e po ashtu edhe në numrin e fjalëve dhe të shënimeve. Veçoritë e tjera speciale nga fondi i fjalëve mund të përfshijnë edhe gjuhën e folur, dialektet, format e humbura, ose termat shkencore dhe teknike.

Llojet e fjalorëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të ndarë në mes fjalorëve me tituj të pashkurtuar (mbi 260 000 fjalë) dhe ata të shkurtuar (prej 50 000 deri 265 000 fjalë). Shumica e fjalorëve janë të shkur-

tuar ose të kufizuar mbi një subjekt ose titull të caktuar. Dy fjalorët e pashkurtuar kanë prej 46 000 shënimeve te botimi i Webster deri në 315 000 te fjalori nga *Random House. Oxford English Dictionary* ka diku rreth 500 000 fjalë, mirëpo nuk konsiderohet një fjalor i përgjithshëm. Shumica e fjalorëve të tavolinave, sikurse fjalori shumë i përdorur *Merriam-Webster's Collegiate Dictionary* ose ai *American Heritage* kanë diku prej 150 000 deri 170 000 fjalëve dhe frazave konsiderohen më se të mjaftueshme për nevojat e shfrytëzuesit mesatar.

Gjuha LS. Fjalorët, në ditët e sotme, përfshijnë edhe zhargonet themelore. Ky është një vendim kontravers nga ana e redaktorëve të fjalorëve, posaçërisht në rastet kur fjalori dështon të specifikojë se fjala e caktuar nuk duhet të përdoret në një kompani "të sjellshme dhe serioze". "Duhet t'u bëhet e qartë të gjithë lexuesve se ky lloj i populizmit nuk është fort demokratik... Ndoshta, kjo është kështu nga fakti se çfarë po kërkon publiku nga fjalorët është korrektësia. Zhargonet mund të bëhen dhe të gjenden nga vetë lexuesit".[3]

Përkundër dëshirës së pakicës, që ta fshijë zhargonin nga fondi i fjalëve në fjalor, shumica e botuesve i përfshijnë zhargonet në botimet e tyre. Pse? Sepse derisa zhargonet mund të mos jenë të pranuara nga shoqëria, ato përdoren me të madhe. Shumë botues kanë mënyra të ndryshme se si t'u tregojnë lexuesve se fjalët ose zhargonet e tilla janë fyese "nuk duhet të përdoren në publik", "zhargon", e kështu me radhë.

Me përfshirjen e zhargonëve dhe fjalëve të quajtura "fjalët me katër shkronja", asnjë vit nuk shkon pa pasur ndonjë problem. Në vitin 1999, *American Online* e hoqi versionin elektronik të Merriam-Webster të Merriam's College Thesaurus "për korrigjim" pasi u gjet se një listë e fjalës "homoseksual" i përfshinte edhe disa sinonime të tjera nga zhargoni i rrugës, për të cilat nuk ishte bërë ndonjë paralajmërim për mospërdorimin e tyre. Tani është kthyer prapë Online me paralajmërimet e qarta për zhargonet e tilla. Versioni i vitit 2000 nga *Random House Webster's College Dictionary* ka edhe opsionin e "hapjen syve lexuesit".

Diku rreth 300 fjalë janë të shënuara si fyese, si p.sh., "kjo është një ndër fjalët më fyese në gjuhën angleze" është e dhënë si paralajmërim për ndonjë zhargon racial. Madje, edhe përpara se të jepet definicioni "holly roler" është e etiketuar "një zhargon, i cili nuk duhet përdorur. Kuptohet

[3] "Too Many Words to the Street Wise" The Guardian Weekly, 6 shtator, 1998, f. 26.

si një ofendim". Fjala "politikisht jokorrekt" vjen si një paralajmërim më i butë. "Babe" (vajzushë) është e definuar me sinjal si politikisht jokorrekt.

Në të njëjtën kohë, po ashtu shënohet dhe tregohet se *babe* është "një fjalë që përdoret nga mashkulli ose femra përkundrejt partnerëve të tyre, në vend të fjalës zemër".

Freskimet me informata. Korrigjimi i fjalorit është një çështje gjithmonë në proces e sipër dhe asnjëherë e përfunduar. Edicione të reja zakonisht lëshohen në treg, çdo 7 deri 10 vjet, mirëpo mijëra ndryshime bëhen në çdo version të shtypur, Online, ose në CD-ROM. Kjo përfshin futjen e fjalëve të reja, korrigjimin e definicioneve të fjalëve të vjetra, të cilat tani kanë marrë një kuptim të ri dhe heqjen e disa termave teknikë të cilët nuk përdoren më. Një kontroll i fjalorit të pashkurtuar ose të atij të tavolinës, për të cilët thuhet se janë të freskuar me informata, duhet t'i përfshijë edhe fjalët e shfaqura dhe të paraqitura në gjuhë nga televizioni, radio dhe filmi.

Botimet shtesë janë një metodë me të cilën tentohet që këta fjalorë të mbahen të freskët me informata të reja, duke e korrigjuar gjithmonë veprën primare.[4] Shembull i tillë është: *Dictionary of New Words* (edicioni 2. Nju-Jork: Oxford University Press, 1997, 366 f., $30). Sikurse edhe titulli tregon, ky është një fjalor i më se 2 000 fjalëve të reja shumica e të cilave nuk mund të gjenden në shumicën e fjalorëve aktualë. Nëse këta fjalorë zgjasim më shumë se një gjeneratë, ata do të ruhen ose mbahen derisa shumica e sfidave të reja verbale janë më shumë të modës sesa ndonjë gjë tjetër. *The Dictionary of New Words*, sikurse edhe botimet e tjera simotra, ka vlerë të madhe pikë së pari për shkak se reflekton një numër të fjalëve të njohura, të cilat jepen brenda një kohe të caktuar. [5]

Përparësi e padiskutueshme e fjalorit digjital është fakti se mund të freskohet me informata shumë shpesh dhe shpejt, thjesht duke futur fjalë dhe definicione. Mirëpo, dikush prapëseprapë duhet të bëjë pak më shumë. Arsyeja se fjalori është elektronik nuk do të thotë se është më aktual sesa versionet e tjera të shtypura të fjalorëve.

---

[4] Shiko David Insaacson "New Word Sources..". Reference Services Review, Verë, 1997, f. 53-64, 72. Ky është një fjalor përshkrues dhe listues i fjalëve të reja të cilat po ashtu janë të shënuara me shkurtesa. Autori i fjalorit e jep një listë rreth disa shënimeve duke përfshirë këtu edhe titullin nga Oxfordi.

[5] Për një diskutim më të hareshëm të kësaj dhe veprave tjera të cilat e freskojnë me informata të reja, shiko Jenny Diski "Diary" The London Review of Books, 1 janar, 1998, f. 33.

Formati. Një numër i konsiderueshëm i formatit të shtypur është një lidhje e ngushtë në mes të fjalorëve. Si individët po ashtu edhe bibliotekat duhet të blejnë edicionet origjinale të shtypura, sepse librat me kopertina të forta dhe të lidhura mirë mund t'i qëndrojnë përdorimit më të gjatë. Një tjetër anë, që duhet shikuar është ajo se si fjalët janë të radhitura ose të aranzhuara. Shumica e fjalorëve tani i ndajnë fjalët në disa kategori, pra në disa fjalë kryesore. Nëse fjalori nuk e bënë këtë dhe i futë disa fjalë në një shënim të vetëm, sikurse është fjala "lay", lexuesi duhet të kërkojë për fjalën "lay" fjalë të tjera, sikurse "layout" ose "lay-by".

Faktorë të tjerë të rëndësishëm, që duhet të merren në konsiderim janë edhe madhësia e botimit dhe atë se si lexueshmëria është e ndikuar nga rreshtimi i fjalëve dhe hapësirat ndërmjet tyre, e po ashtu edhe faktorët si lloji i shkronjave, madhësia etj. Me përjashtim të disa botimeve në ngjyra, shumica e ilustrimeve të fjalorëve janë bardh e zi... përjashtim është botimi i vitit 2000 i *American Heritage Dictionary.* Një fjalor mesatar i punës/tavolinës ka diku prej 600 deri 1 500 ilustrime, kurse fjalori i pashkurtuar prej 7 000 deri 12 000. Fjalorët Online dhe atë përdorim në kompjuterë, shumë rrallë japin ilustrime, mirëpo edhe në rastet kur ata ofrojnë një gjë të tillë, ilustrimet mund të jenë bardh e zi e ndoshta edhe me ngjyra.

Materiali nga enciklopedia. Disa fjalorë janë kombinim i fakteve të gjetura në enciklopedi dhe në fjalorë. Për shembull, *New Oxford Dictionary of English* (Oxford: Oxford University Press, 1998) e ka një seksion të veçantë me më shumë se 4 500 emra të vendeve dhe më se 4 000 shënime biografike. Ky seksion "thotë se përfshin të gjitha ato terma, që përbëjnë dijen themelore të folësit anglez". Problemi është se përzgjedhja është shumë e vogël. Dhe, si thotë një kritik "nëse unë dua informata nga enciklopedia, unë edhe do ta përdorë atë".[6] Në përgjithësi, është shumë më mirë që një fjalor t'i eliminojë informatat e llojit të enciklopedisë.

Drejtshkrimi. Kur janë disa forma të drejtshkrimit, ato duhen edhe të tregohen. Webster's identifikon drejtshkrimin britanik me një etiketë "Brit"; fjalorë të tjerë normalisht e tregojnë këtë variant thjesht duke e treguar drejt-

[6] "Mind Your Language" The Spectator, 29 gusht, 1998, f. 16. Janë edhe disa kontrollime këtu në atë se çfarë ka seksioni i enciklopedisë dhe çfarë nuk ka. Zakonisht, edhe dështon.

shkrimin amerikan si të parin, si p.sh. analyze, analyses, ose theater, theatre. Në të shumtën e rasteve jepen dy forma të ndryshme të drejtshkrimit, çdonjëra që është e pranueshme. Përdoruesi ose lexuesi duhet të vendosë se në cilën formë do ta përdorë fjalën. Për shembull, addable ose addible, lollipop ose lollypop (është e udhës që të rikujtohen bibliotekarët dhe njerëzit e thjeshtë që shpjegimet e tilla mund të gjenden edhe në paradhënien e fjalorit).

Disa pika të tjera të kundërshtimit janë: eye-opener apo eye opener; dumfond apo dumbfound; gladiolus (shumës) apo gladiolus's.

Anketa nga *Oxford English Dictionary* gjeti se fjalët më të vështira për t'u shkruar drejt janë ato me origjinë jo angleze (nil dessperandum: mos na dëshpëro; hoi-polloi: turma); shumë i turbulltë (poetaster: një poet inferior). Fjalët që tingëllojnë si të njëjta ose që kanë kuptim të njëjtë po ashtu krijojnë shumë konfuzion.

Etimologjitë. Të gjithë fjalorët e mëdhenj tregojnë etimologjinë e fjalës duke e shënuar atë në kllapa. Procedura normale fillon me tregimin e rrënjës së fjalës në latinisht, greqisht, frëngjisht, gjermanisht, anglishte të vjetër, ose ndonjë gjuhë tjetër. Aq i mirë është ky opsion saqë studenti i etimologjisë do të ishte i kënaqur vetëm me studime historike.

Historia e fjalëve dhe si ato fjalë janë zhvilluar nuk është krejt akademike. Një studim i tillë mund të sqarojë nocionet e vjetra dhe t'i rrëzojë pohimet e rreme që janë të lidhura me ato fjalë. Një shembull: Sa fjalë i kanë eskimezët për dëborën? Një përgjigje tipike është ajo se ata kanë mbi qindra fjalë për të. Në gjuhën angleze, ky numër është i kufizuar në disa dhjetëra. Kjo ide filloi me Frank Boaz, një antropolog eminent, i cili në vitin 1911 shpjegoi se gjuhët e tjera, jo anglishtja, mund t'i shpjegojnë gjërat nga një rrënjë e vetme. Eskimezët përdorin rrënjët e veçanta për dëborën në tokë "aput"; ose "qana" për dëborën që po bie; ose "qimuqsuq" për pirgun e dëborës, e kështu me radhë. Në vitin 1940, një linguist fillestar e përdori këtë sistem të rrënjës për të thënë se eskimezët kanë shumë fjalë për dëborën. Kjo thënie u dëgjua nga një gazetar gazete dhe *The New York Times* nga viti 1988 filloi të ngulmonte se janë më se 50 fjalë eskimeze për dëborën. Në të vërtetë, janë vetëm dy rrënjë të mundshme: "quanik" që do të thotë bora në ajër ose *snowflake* dhe "aput".[7]

Definicionet. Fjalorët zakonisht e japin në fillim kuptimin ose defini-

[7] "Outwitted by Inuit" Independent, 15 janar, 1998, f. 10. Burimi i sigurt i inforacionit korrekt: C.W. Shultz-Lorentzen's Dictionary of the West Greenlandic Eskimo Language (1927).

cionin modern të fjalëve. Përjashtimet janë në rastet kur kemi të bëjmë me fjalë që bazohen në anglishten e vjetër, si dhe publikimet nga *Merriam-Webster* dhe *Webster's New World*. Derisa nuk kuptohet shkalla dhe procedura e definicionit, një lexues (i cili nuk e ka lexuar parathënien e fjalorit) do të lë fjalorin në vendin ku e ka marrë, duke kapur në mendjen e tij kuptimin antik të fjalës. Po ashtu, kuptimi mund të jetë i saktë, mirëpo mund të shtyjë në "qarqe" në të cilat fjalët me vështirësi dhe kuptim të njëjtë përdoren për ta shpjeguar njëra tjetrën. Kualiteti i definicionit ose i kuptimit varet nga shumë faktorë. Kuptimet e ndara dhe të veçanta duhet të theksohen qartë në fjalorë. Kjo zakonisht bëhet duke i numëruar kuptimet e shumta. Definicioni më komplet dhe i përkryer duhet të jetë i qartë, mirëpo në situata më teknike dhe më abstrakte, kjo gjë nuk është e mundur. Për shembull, çfarë është definicioni i fjalës dashuri?

Pastaj janë edhe definicionet, të cilat mund të ikin si gabim ose thjesht përfaqësojnë një mënyrë ose rrugë se si disa persona i shpjegojnë disa fjalë duke futur pak humor dhe ironi. Në fjalorin *Chambers Dictionary* (Londër: Chambers, 1998) nën gjarprin e detit - "një kafshë gjigante e formës së rrumbullakët, shpesh e parë dhe e përshkruar nga detarët e llahtarisur dhe gënjeshtarët e zakonshëm" (i formës së rrumbullakët? A është ky definicioni i të rrumbullakëtës?) *Try eclair*- një torte e madhe për nga madhësia, mirëpo e shkurtër për nga kohëzgjatja. (Çka?) Ndreqësi i fotografive - "dikush që i pastron dhe i mban dhe disa herë i prish fotografitë e vjetra". Pastaj, është edhe fjalori tjetër *Macmillian Dictionary of Psychology* (Londër: Macmillion, 1989). Nën fjalën psikolog shfaqet definicioni "një person, i cili merr para nga të tjerët me pretendimin se është për të mirën e atij tjetrit". (Pa koment).

Shqiptimi. Në versionin e shtypur, janë disa metoda të cilat tregojnë shqiptimin e fjalës, mirëpo shumica e botuesve në Amerikë e përdorin atë diakritik. Në fjalorin *Marriam-Webster's Collegiate Dictionary*, sistemi i shqiptimit të fjalëve duket se është mjaft i detajuar, përveç për ekspertët dhe goxha konfuz. Në fjalorin American Heritage Dictionary, procesi i shqiptimit është shumë më lehtë i kuptueshëm.

Të gjithë fjalorët e vënë në funksion përdorim e thjeshtë fonetik, që është edhe i njohur gati për të gjithë. Kjo do të thotë se një lexues, i cili është duke përkuar për fjalën "lark" e gjen se "r" shqiptohet sikurse në fjalën park. Pa marrë parasysh se cili mund të jetë theksi i personit, zëri i

transformuar do të jetë i njëjtë me atë në fjalën park. Theksat regjionalë mund të luajnë rol dhe mund të dallojnë në atë se fjala park mund të shqiptohet edhe si "pock" "pawk" e madje edhe "pack". Në të njëjtën kohë, fonetikat i marrin për bazë edhe dallimet e ndryshme sikurse shqiptimi i tomato, potato, ose economics, të cilat fjalë ndryshojnë nga regjioni në regjion, dhe madje nga personi në person. Në rastet e këtilla, jo vetëm një shqiptim i vetëm është i saktë.

Një përparësi e versionit Online dhe atij CD-ROM është fakti se këtu përdoruesi mund ta dëgjojë shqiptimin e më se 1/3 së fjalëve të fjalorit. Zakonisht, kjo bëhet duke përdorur zërin e femrës dhe të mashkullit. Pothuajse të gjithë fjalorët standardë Online tani e kanë këtë opsion, pra shqiptimin me zë. Një shembull: *Encarta English Dictionary* website (www.encarta.com) ka diku rreth 100 000 fjalë prej të cilave diku rreth 60 000 prej tyre mund të dëgjohen në shqiptimin me zë.

Rrokjezimi. Të gjithë fjalorët tregojnë, zakonisht me një shtyllë qendrore ose të nënvizuar, se si fjala duhet të ndahet në rrokje. Informacioni është aty për t'i ndihmuar lexuesit, shkruesit, redaktorët dhe sekretaret, që të jenë në gjendje t'i ndajnë fjalët në fund të rreshtit. Po ashtu, ofrohen edhe fjalorë të vegjël të dorës ose të tavolinës të cilët thjesht tregojnë rrokjezimin e fjalëve të shpeshta pa dhënë definicionin dhe shqiptimin e tyre.

Sinonimet. Përdoruesi mesatar dhe i zakonshëm nuk e hap fjalorin e përgjithshëm për sinonime, mirëpo futja e sinonimeve në fjalorë ndihmon në ndarjen e fjalëve të njëjta. Disa fjalorë të dorës tregojnë dallimin dhe ngjashmëritë në kuptim, duke dhënë ese të shkurtra në përfundimin e shumë definicioneve.

Informatat gramatikore. Informata më e rëndësishme gramatikore, e cila i ndihmon lexuesit e fjalorit është tregimi i asaj se cilës pjesë së ligjëratës i takon fjala e caktuar. Të gjitha shënimet e vetme janë të klasifikuara si emra, mbiemra, folje dhe kështu me radhë. Përveç kësaj ndarje të madhe, fjalorët dallojnë edhe në metodën se si ata i tregojnë ndajfoljet, mbiemrat, shumësin, pjesët kryesore të foljes, koha e shkuar e foljeve të parregullta. Zakonisht, metoda është shumë qartë e cekur. Mirëpo, përsëri parathënia e fjalorit duhet të studiohet në mënyrë për të kuptuar çdo prezantim të caktuar në fjalor.

Përdorimi. Aspekti më kontravers i vlerësimit të fjalorit është ajo se a është cekur përdorimi me vend i fjalorit apo nuk është cekur. Në ditët e sotme është një ndarje në mes të atyre njerëzve të cilët dëshirojnë që fjalori të jetë informativ (p.sh. të tregojë në mënyrë kronologjike dhe të qartë çka është mirë e çka jo, pra përdorim të aprovuar) dhe atyre që dëshirojnë fjalorë përshkrues (p.sh. duke përshkruar thjesht gjuhën ashtu si flitet dhe shkruhet, pa dhënë ndonjë gjykim, nëse kjo është e pranuar nga kultura e zakonshme apo jo). Fjalorët dallojnë shumë në atë se si e trajtojnë aspektin e përdorimit. Në një ekstrem është vepra, e cila thotë se çdo gjë është e mirë derisa është e pranueshme (p.sh. shumica e fjalorëve të *Merriam-Webster*). Në anën tjetër, është fjalori i cili është kritik dhe parashtron rregulla mbi përdorimin e mirë (për shembull fjalori *Webster's New World Dictionary nga Simon & Schuster)*. Në mes këtyre dy ekstremeve është fjalori i shkollave, i cili është më shumë pragmatik sesa përshkrues ose informativ (si *The American Heritage Dictionary*). Shumica e njerëzve besojnë se fjalorët duhet të jenë përshkrues e informativë duke vënë rregulla mbi atë se çka është përdorim i mirë e çka jo, mirëpo edhe duke përfshirë fjalë ashtu si përdoren nga shumica e njerëzve.

Çka e bën anglishten e një personi "korrekte"? Disa thonë se përgjigja në këtë pyetje është e pamundshme. Ka aq shumë gjëra që shkojnë nga definicioni deri te kuptimi i konkurrencës semantike. Përdorimi është bërë themel, jo vetëm për linguistikën përshkruese, mirëpo edhe për gramatikën. Studimi dhe mësimi i anglishtes së folur është bërë më e rëndësishme sesa gjuha angleze e shkruar. Situatat e ndryshme sociale dhe kulturore i kanë rregullat e tyre. Besimin në gramatika tradicionale është një dënim në atë se gjuha angleze moderne është me e keqe sesa ajo e gjeneratave të mëparshme për arsyen e dështimit për ta mësuar këtë gramatikë teknike.

Udhëzimi për Fjalor: Versioni i shtypur

E Shtypur: Kister, Kenneth. Kister's Best Dictionary for Aduls & Young People: A Comparative Guide. Feniks, Arizona: Oryx Press, 1992, 448 f. $39.50.

E Shtypur: Loughridge, Brendan. Which Dictionary?, Londër: Asociacioni i Bibliotekave Botuese, 1990, 177 f. $26.

Që të dy nga këta titujt të fjalorëve, apo udhëzues, janë goxha të vjetër, mirëpo janë shumë të përdorshëm në atë se derisa edicione të reja të fjalorëve shfaqen rregullisht, metoda e të shkruarit dhe dallimet janë të njëjta. *Kister's Best Dictionaries* është një prej udhëzuesve më të mirë për fjalorët në gjuhën angleze. Janë më se 132 shënime për veprat ose fjalorët për të rritur duke filluar nga *Oxford English Dictionary* deri te fjalorët e lirë në fundin e librave. Diku rreth 168 fjalorë për fëmijë janë të vlerësuar këtu. Një parathënie për lakmi në këtë udhëzim i vendos rregullat se si të vlerësohen fjalorët. Informatat e nevojshme nga e kaluara janë të dhëna gati për çdo botues, dhe çdo fjalor elektronik të botuar. Për secilin nga titujt jepet një analizë e detajuar, që në disa raste shkon edhe deri disa faqe. Diagramet e mira dhe grafiket janë shumë të përdorshme. Edhe pse i botim i vjetër, është një botim që hyn në punë shumë.

Në Angli, *Loughridge's Which Dictionary*? Ka një qasje të njëjtë si ai nga *Kister.* Në *Which Dictionary?* Janë shtatë kategori të ndara të fjalorëve, duke filluar nga fjalorët standardë deri te fjalorët gruporë. Për dallim nga *Kister, Loughridge* përfshin shumë tituj të "çuditshëm", prej atyre që mbulojnë fjalëkryqet deri te fjalorët mbi një subjekt të caktuar. Jo sikurse kushëriri i tij amerikan, mirëpo duke përfshirë një pjesë më të madhe, publikimi nga Asociacioni i Bibliotekave është një shtesë e shkëlqyer për bibliotekat e mëdha. Mirëpo, në asnjë mënyrë nuk e zëvendëson *Kister*-in.

Analiza ose rishikimi më i mirë i fjalorëve aktualë mund të gjendet në veprën "Reference Books Bulletin" nga *Booklist.*

Në Internet

Fjalori ishte një nga veprat e para nga familja e veprave referenciale, i cili u shndërrua në formatin digjital, e në veçanti si pjesë e softuerit të kompjuterit (duke filluar nga kontrollimi deri te ndërtimi dhe shkrimi i definicioneve). Në versionin CD-ROM, fjalori i shtypur bëhet një fjalor që flet. Në Internet gjendet një numër i madh i titujve të fjalorëve, vepra mbi subjekte dhe botime ndihmëse shtesë. Udhëzuesit e tipit të fjalorit po ashtu mund të gjenden me një prekje të miut nga kompjuteri juaj.

Tanimë, kërkuesi e din instinktivisht kur i duhet atij/asaj fjalori elektronik dhe kur i duhet fjalori në versionin e shtypur. Gati në të gjitha rastet kur është në fjalë kontrollimi i një fjale të vetme në shqiptim, definicion, drejtshkrim, ndarje të fjalëve, versioni i shtypur është rruga më

e lehtë dhe më efektive për ta bërë një gjë të tillë. Në Internet, ofrohen disa dhjetëra fjalorë falas, disa prej të cilëve do të shpjegohen më vonë, mirëpo përsëri po themi se është, jo fort gjë e mençur, të shikohet një fjalë në Internet kur kjo mund të bëhet në mënyrë shumë më efektive në fjalorin e shtypur.

Kur ju mundoheni të gjeni një fjalë, e cila më së miri mund t'i përshtatet një definicioni të caktuar ose jeni duke testuar disa drejtshkrime, fjalori digjital është më i mirë. Përdorimi i fjalëve kryesore (key words), natyrisht është çelësi i suksesit- një metodologji që nuk mund të zbatohet në vëllimet e shtypura të fjalorëve. Nëse përdoruesi i fjalorit është ambicioz, ai/ajo mund të kërkojë edhe citate, definicione që nuk gjenden lehtë, histori të fjalëve. Pra, të gjitha këto bëhen shumë lehtë në formatin digjital.

Madje, edhe një përdorues mesatar i Internetit zbulon shpejt se janë disa dhjetëra e qindra fjalorë, të cilët ofrohen Online nga botues të vegjël e të mëdhenj. Të gjithë, po ashtu vijnë edhe në formatin CD-ROM. Bëhet pyetja: Pse kaq shumë? Kjo quhet licencim digjital, pra një mënyrë e re e burimit të të ardhurave. Licenca digjitale e *Houghton Mifflin (American Heritage Dictionary)* kishte profite mbi $ 1 milion në vitin 2000, ose më shumë se 10 % të fitime që ata i morën nga shkëmbimet e kompanisë dhe ndarjet e referencave. Shifra të njëjta dhe entuziazëm i njëjtë për të hyrë në formatin digjital mund të vërehet te të gjithë botuesit e mëdhenj.

Linkat, te një numër i madh i fjalorëve në gjuhën angleze dhe në ndonjë gjuhë të caktuar mund të gjenden në web-sajtet e shumicës së bibliotekave. Për shembull, shih *Michigan Electronic Library* (http://mel.lib.mi.us) ku ka më shumë se 20 fjalorë të përgjithshëm dhe disa fjalorë të tjerë në gjuhë të caktuar (p.sh. anglisht-spanjisht). Faqja fillon me linka te "Afrikano-Amerikan", të cilët shkojnë në gjuhë standarde angleze dhe gjuhët standarde të Evropës dhe përfundojnë më një link për "Urdu-English". Një faqe e vetme do t'i plotësojë nevojat e më se 99 % të numrit të studentëve dhe atyre që bëjnë kërkim. Nëse nevojiten më shumë informata, shiko: *A Web of On-Line Dictionaries* (http://www.bucknell.edu/rbeard/diction.html). E zhvilluar nga një individë përmes Universitetit Bucknell, kjo ka linka për fjalorë dhe libra të fjalëve në më se 100 gjuhë të ndryshme të botës, përfshirë këtu natyrisht edhe gjuhën angleze.

Web-sajte të tjera që rekomandohen- dhe këto janë web-sajte të thjesh-

ta, përfshijnë: (1) *OneLook Dictionaries* (www.onelook.com). Ky web-sajt komercial ofron definicione prej më se 500 fjalorëve të përgjithshëm dhe të specializuar. Përdoruesi mund të shënojë një fjalë të caktuar dhe/ose të zgjedhë një fjalor të caktuar, apo/ose të zgjedhë një fushë të posaçme të mbuluar nga fjalori; (2) *Vocabulary* (www.vocabulary.com). Është një fjalor shumë i mirë për arsyen se ju vetëm shënoni fjalën dhe kështu web-sajti u tregon më se 10 kuptime të asaj fjale, së bashku me sinonimet dhe po ashtu u tregon edhe fjalën e njëjtë në më se 10 gjuhë të ndryshme; (3) *The Word Detective* (www.word-detective.com). Këtu, përdoruesi mund ta gjejë historinë dhe rrënjët e fjalëve, e po ashtu edhe komentet nga Evan Morris, i cila i ka të botuara disa libra dhe kolumne mbi fjalët.

FJALORËT E PASHKURTUAR

CD: Random House Webster's Unabridged Dictionary. Nju-Jork: Random House, 2000, Freskimet me informata të pacaktuara. $28.

E Shtypur: Random House Unabridged Dictionary, 1993, 251 f., $89.95.

CD: Webster's Third New International Dictionary. Springfield, MA: Merriam-
Webster Inc., 2000, Freskime me informata të pacaktuara. $69.95.

E Shtypur: 1961. 2752 faqe. $119. Botimet shtesë, 1976 deri më 1988, disa faqe, secila nga $10.95.

Në vitin 1988 u quajt *The Random House Dictionary of the English Language*. Nga fillimi i viteve '90-të, departamenti i marketingut e vërejti përparësinë e ndërrimit në fjalor të "pashkurtuar". Pyetja, më pastaj ishte kjo: A është vërtetë i pashkurtuar? Përgjigjja është "po" në atë se botuesi thotë se ka më se 315 000 shënime, e 2 500 harta dhe ilustrime të vogla. Pra, këto shifra janë shumë më të larta sesa mesatarja prej 130 000 deri 265 000 fjalëve të gjetura në botimet më të vogla. Përgjigja në pyetje është "jo" nëse ajo krahasohet me konkurrentët e saj. *Webster's* thotë se ka diku 450 000 shënime ose diku gati 135 000 shënime më shumë se *Random House.*

Sot, gjendet vetëm një fjalor i vërtetë i pashkurtuar dhe komplet në gjuhën angleze. Ky është *Webster's Third New International*. Dikush mund

ta fusë *The Oxford English Dictionary (OED)* në këtë kategori, mirëpo në të vërtetë ky fjalor më shumë është i preokupuar me etimologjinë sesa me definicionet, dhe nuk është botuar për të qenë një fjalor që përdoret çdo ditë.

Në esencë, "i pashkurtuar" është ajo çka botuesi dëshiron të shpjegojë. Derisa këto janë në kufijtë e arsyes, sikurse rasti me *Random House*, pak njerëz do të thonë diçka apo do të argumentojnë. Mirëpo, ku i çon kjo bibliotekat? Shumica e bibliotekave duhet ta kenë *Webster's* (i cili ka më shumë fjalë) e po ashtu edhe *Random House* (i cili është më aktual).

Pa marrë parasysh se si botuesi dëshiron ta thërrasë fjalorin *Random House*, ky fjalor ka një reputacion solid. Ky fjalor ka ne vete disa opsione sikurse fjalorët e ngjeshur, dygjuhësorë, që janë mjaft praktik në gjermanisht, frëngjisht, spanjisht dhe italisht. Ka diku rreth 30 faqe të hartave që të gjitha me ngjyra. Edhe pse jo aq i madh sa *Webster's*, *Random House* ka një përparësi të madhe i të qenit aktual. Mesatarisht 50 000 fjalë të reja ishin futur në të ose ishin korrigjuar kur u botua edicioni i dytë. Pasthirrmat janë goxha të përdorshme dhe shumë fjalë me katër shkronja janë futur në këtë fjalor. Këto, natyrisht janë të etiketuara si "vulgare".

Fjalori *Random House* është përshkrues. Lexuesi, i cili kërkon diçka duhet ta gjejë atë pa shumë ndihmë. Kundërshtimet rreth fjalës "hopefully" (shpresojmë) janë të shënuara, e po ashtu edhe termat e tjerë të njëjtë janë të përshkruar. E pranon fjalën "infer" (nxjerr) në kuptimin e përgjithshëm si "për të konkluduar" e po ashtu edhe sinonimin "të implikojë" ose "të sugjerojë", mirëpo është edhe shënimi ku thuhet se dallimi në mes të fjalëve është i madh.

Definicionet janë të qarta dhe në to përdoren fjalë, të cilat kuptohen nga personi me njohuri mesatare. Shumica e shënimeve përfundojnë me sinonime dhe antonime që ndihmojnë shumë.

Versioni CD-ROM i *Random House Unabridged Dictionary* (me emrin *Webster,* të shtuar në titull) konsiston në edicionin e fundit të shtypur e po ashtu edhe me shënime të reja, të cilat janë futur gati çdo vit. Pra, derisa versioni CD-ROM freskohet me informata, deri diku qëndron i njëjtë sikurse versioni i shtypur me më se 315 000 shënime. Në anën tjetër, i eliminon shumë nga veçoritë e stilit, që mund të gjenden në versionin e shtypur.

Versioni *Random House CD-ROM* i ka të gjitha përparësitë e zakonshme. Vlera e vërtetë e këtij versioni është mundësia për të bërë kërkimin e fjalëve në definicion. Pra, përdoruesi i këtij versioni mund të bëjë

kërkimin për fjalë të përafërta, për citime, sinonime, duke e klikuar miun e kompjuterit. Kjo ofrohet për të gjithë në biblioteka si një ndihmë shtesë në kërkimin me kompjuter. Dhe, në fund, e ka përparësinë ngase nuk zë shumë vend.

Webster's

Përveç datës së botimit (1961), *Webster's* është gati krejtësisht i njëjtë. Çdo edicioni i ri në versionin CD-ROM apo në atë të shtypur përfshin fjalët e reja, ose ndryshime në kuptim të fjalëve të vjetra. Për shembull, shiko termat aktualë nga kompjuteri, politika dhe sociologjia. Shumica e tyre përfshihen në botim, nëse jo në botimin primar, atëherë në botimet shtesë të shtypura dhe në CD-ROM, të cilat shtojnë diku rreth 22 000 fjalë, përveç 450 000 që tashmë gjenden në botimin primar. Versioni CD-ROM nga *Webster's* i ka përparësitë e njëjta sikurse ai i *Random House* dhe CD-ROM versionet e tjera në atë se kërkimi këtu është i lehtë. Mirëpo, në Webster janë disa përparësi që ofrohen sikurse shtypja e fjalës dhe më pastaj duke shkruar "rimat" ose "e cituar nga autori.."., etj.

Noah Webster ka qenë i përfshirë në botimin e fjalorëve gati gjatë gjithë shekullit XIX. Është shumë me rëndësi të theksohet se 1909 ishte viti kur u botua për herë të parë një fjalor i pashkurtuar. Edicioni i dytë u botua në vitin 1934 dhe i treti në vitin 1961. Fjalori në versionin e shtypur, që u botua në vitin 2000 ka disa data të autorësisë (të drejtës autoriale): 1961- data e korrigjimit origjinal dhe data të tjera- zakonisht secila pas pesë vjetësh- të cilat tregojnë se ka pasur korrigjime të fjalorit pas vitit 1961. Botuesi nuk jep indikacione kur do të jetë gati për botim edicioni i ri edhe pse kjo pritet të bëhet në vitin 2003 (libri është botuar në vitin 2001). Derisa në këtë vit, çdo bibliotekë duhet ta ketë fjalorin Webster's si një nga fjalorët më të mirë të pashkurtuar (komplet), së bashku me fjalorin tjetër më kohor, pra ai nga *Random House*.

Për shkak se autoriteti i tij është i njohur, shumë njerëz pohojnë se *Webster's* duhet të jetë informativ dhe t'i braktisë ligjet verbale. Mirëpo, nuk e bën një gjë të tillë. *Webster's* është fjalor përshkrues dhe disa herë është e vështirë, përkundër etiketimeve, për të treguar përdorimin e mirë, të keq ose indiferent të fjalës. Po ashtu, ky fjalor ka një sistem aq të ndërlikuar të shqiptimit saqë shumica e njerëzve nuk kuptojnë asgjë se si duhet të shqiptohen fjalët e caktuara.

FJALORËT PËR KOLEGJE (FJALORËT E TAVOLINËS)[8]

Online: Merriam-Webster's Collegiate Dictionary, Springfield, MA: Merriam- Webster Inc. 2000 e deri më sot. (www.m-w.com). Falas. Po ashtu, ofrohet edhe në web-sajte të tjera.

CD: Merriam-Webster's Collegiate Dictionary and Thesaurus. 2000, $199.

E Shtypur: Merriam-Webster's Collegiate Dictionary, edicioni 10, 2000, 1 559 f., $24.95.
Online: The American Heritage Dictionary. Somerville,
MA: Houghton Mifflin Interactive, 2000. Çmimi ndryshon. Ofrohet edhe në web-sajte.
CD: The American Heritage Talking Dictionary. Edicioni 4, Boston: Houghton Mifflin Company, 2000, $42.95.
E Shtypur: edicioni 4, 2000, 2 074 f., $75.

CD: The Random House Webster's Dictionary and Thesaurus College Edition.
Nju-Jork: Random House, 2000, $99.
E Shtypur: The Random House Webster's College Dictionary, 2000, 1 600 f. $24.95.

CD: Webster's New World Dictionary of American English, in The Software Toolworks Reference. Novato, Kaliforni: Software Toolworks, Inc., 1991 e deri më sot, e përvitshme. $99.
E Shtypur: Webster's New World Dictionary of American English, edicioni 4. Nju-Jork: IDG Books Worldwide, 1999. 1 574 f., $18. 1 600 f. $17.95.

Katër fjalorët e listuar këtu janë katër më të mirët dhe shumicën e herave ata mund të gjenden në biblioteka, e po ashtu edhe në shtëpi. Të gjithë

[8] Botuesi ofron një numër të madh të zgjidhjeve të fjalorëve për kolegje ose fjalorët e tavolinës me çmime po ashtu të ndryshme. Për shembull, Random House fillon me fjalorin e saj kolegjial e më pastaj shton: Webster's American Family Dictionary ($24); Random House Large Print Dictionary ($40); Random House Webster's Large Print Thesaurus ($40).

ofrohen edhe në formatin digjital. Duhet pasur kujdes me edicionet e reja, pra për freskimet me informata të këtyre 4 fjalorëve. Fjalorët e botuar nga botuesit standardë korrigjohen në mënyrë periodike dhe të gjithë janë autoritativë. Të katërt nga ta në tërësi shesin më se 2.5 milionë kopje, çdo vit. Versionet digjitale janë mjaft të popullarizuara. Në shtëpi dhe në zyra të ndryshme, ato shpesh janë pjesë e një sistemi më të madh referencial, sikurse është *Microsoft Bookshelf*. Nuk është fort e sigurt nëse fjalori digjital do ta zëvendësojë vëllimin e njohur në versionin e shtypur.

Pra, pjesa më e rëndësishme në biznesin e botimeve për botuesit e fjalorëve është fjalori i tavolinës ose versioni i fjalorit për kolegje. Definicionet janë të shkruara për ata që janë me njohuri nga fakulteti, edhe pse ata mund të përdoren nga të gjitha grupmoshat dhe nga çdo njeri, i cili di shkrim-lexim. Zakonisht, këta fjalorë përfshijnë prej 139 000 deri 180 000 fjalë, kanë ilustrime dhe ofrojnë materiale shtesë, sikurse shënime biografike dhe gjeografike. Fjalorët digjitalë, zakonisht përfshijnë në vete edhe fjalorë të shkurtër, udhëzues etj.

Në fjalorët e tillë, dallimet janë esenciale në format, në aranzhim, në sistemet që tregojnë shqiptimet dhe në gjatësinë e definicioneve. Të gjithë përfshijnë sinonime, antonime dhe etimologji. Dallimi në çmim është shumë i vogël. Pyetja natyrale që shtrohet është ajo se cili nga ta është më i mirë dhe përgjigja gjithmonë varet në radhë të parë nga nevojat personale. Të gjitha kanë gati numër të njëjtë të fjalëve dhe të gjitha i kapërcejnë testet vlerësuese për fjalorë, par excellence.

Fjalori për kolegj nga Webster's

Merriam-Webster Online, i cili ofrohet falas në Internet ka përparësinë e kombinimit të fjalorit me thesarin gjuhësor. Ka edhe shtesa të shumta sikurse transkriptet nga emisionet në radio si "Word for the Wise", i cili tregon historinë e fjalëve. Sikurse edhe me të gjithë fjalorët e tjerë të mëdhenj për kolegje, versioni i këtij fjalori mund të gjenden në disa web-sajte, zakonisht i kombinuar me burime të tjera referenciale. Po ashtu, përdoret edhe në sistemet kompjuterike. Mirëpo, më e lehtë për përdoruesin që të gjejë këtë fjalor është të shkojë drejt e te web-sajti e botuesit. Megjithatë, duhet thënë fakti se për shumicën e njerëzve versioni i shtypur është më i lehtë për t'u përdorur. Versioni Online është shumë më i thjeshtë në vete ngase: ju mund të shikoni definicionin, shqiptimin, etimologjinë, drejtshkrimin e fjalës dhe të bëni edhe shumë gjëra të tjera në versionin Online

te *Merriam-Webster's Collegiate Dictionary*". Në përgjithësi, shumica e njerëzve shënojnë një fjalë dhe e gjejnë se si shqiptohet ajo fjalë, se cilës pjesë së ligjëratës i takon, etimologjinë dhe definicionin e shkurtër si p.sh. çdo gjë që mund të gjendet në edicionin e fjalorit të tavolinës. Është edhe një kapitull/seksion i thesarit të fjalëve me sinonime, i cili kapitull i ndjekë po te njëjtat metoda të shpjegimit. Shëno fjalën që të nevojitet dhe ju do të shihni sinonimet dhe antonimet të shfaqura në ekran, shumicën e herëve me definicion të mjaftueshëm.

Merriam-Webster's Collegiate Dictionary bazohet në botimin e tretë të fjalorit të pashkurtuar. I ka diku rreth 160 000 fjalë dhe më se 700 ilustrime. Reflekton filozofinë e veprave të mëdha dhe fokus të veçantë vë në definicionet dhe shqiptimet aktuale. Sikurse edhe në fjalorin primar, mënyra këtu është përshkruese edhe pse theks më i madh vihet në shënimet e përdorshme (të shpjeguara në detaje në pjesën hyrëse). "Jo standard" është paralajmërimi për përdorimin e fjalës "ain't" (s'janë-s'është) dhe kjo më pastaj ndiqet nga një paragraf i shkurtër, i cili diskuton përdorimin aktual të fjalëve. Në këtë rast tregohet se "edhe pse nuk është e pranuar si fjalë standarde, mirëpo që është mjaft e shpeshtë në gjuhën e folur të njerëzve me më pak shkollim, fjala ain't është mjaft e pranishme në anglishten amerikane". Kur fjalët me katër shkronja shpjegohen, më të rëndësishmet nga to përfshihet, dhe shënimi për përdorimin e tyre është "konsiderohen si pahijshme" ose "konsiderohen vulgare". Në edicionin më të fundit (p.sh. 2000) rreth 200 fjalë kanë shënim se janë fjalë racore, religjioze ose seksuale, që nuk duhet të përdoren. Shumë grupe kanë dërguar peticione të ndryshme, duke i bërë thirrje botuesit për t'i hequr këto fjalë nga fjalori, mirëpo botuesi refuzoi, duke thënë se fjalori i regjistron fjalët dhe nuk bën censurë.

Janë edhe disa pasuse që mund të gjenden në fjalor edhe pse numri i tyre është shumë më i vogël sesa që mund të gjenden në fjalorin *American Heritage Dictionary*. Historia e fjalëve zakonisht tregohet në të, së bashku me datën se kur u shfaq për herë të parë fjala. Sistemi i shqiptimit ende mbetet një problem serioz. Simbolet në fjalor janë të gjitha të listuara në kopertinat e përparme dhe të prapme të fjalorit, ndërsa një version i shkurtër mund të gjendet në fundin e çdo faqeje në të djathtë. Në përgjithësi, kjo gjë është goxha e ndërlikuar dhe nevojitet një seksion/kapitull i veçantë për të "Guide to Pronunciation", që është një përpjekje për t'ua shpjeguar procesin lexuesve. Rezultati përfundimtar është jo fort i kënaqshëm.

Edhe pse enigma e simboleve të shqiptimit mund të jetë e komplikuar, definicionet janë të përmirësuara. Te nxjerra prej versionit të fjalorit të pashkurtuar, definicionet janë shumë më të thjeshtësuara dhe të qarta. Ato janë të dhëna në mënyrë kronologjike me kuptimin modern që vjen i fundit. Për shembull, explode (shpërthim) fillon me definicionin arkaik "për t'u tërhequr nga skena duke kundërshtuar".

12 000 emrat gjeografikë dhe 6 500 emra personalë nuk janë të përfshirë në alfabetin primar, por janë të dhëna shtesë në shtojcat e fjalorit, gjë që nuk ndodhë me fjalorët e tjerë. Shtesat, po ashtu përfshijnë edhe fjalë dhe fraza të huaja.

American Heritage

Një tjetër fjalor standard që ofrohet Online është ai i quajtur *American Heritage*. Ky fjalor vjen si një bonus me disa reklama komerciale Online. Versioni Online përmban tekstin komplet nga versioni i shtypur dhe kërkimi në të mund të bëhet si bëhen kërkimet e zakonshme të definicioneve, citateve etj.

Fjalori i famshëm amerikan *American Heritage Dictionary* është transformuar në formatin digjital. Versioni digjital përmban të gjitha informatat nga versioni i shtypur, plus disa informata të tjera. Versioni CD me "tituj të gjatë" është pjesa e cila e bën këtë fjalor aq të shitur. Shumica e fjalëve shqiptohen për lexuesin. Më shumë se atë, fjalori e ka edhe *Roget's II: The New Thesaurus*. Metodat e bërjes së kërkimit janë shumë të qarta dhe ju mund të kaloni nga definicionet më të thjeshta të një fjale deri te krahasimi i asaj fjale me sinonime, pjesë të ligjëratës, përdorimin e mirë ose jo të mirë e kështu me radhë. Lidhjet janë të jashtëzakonshme, derisa disku mund të përdoret si për historinë e gjuhës, po ashtu edhe për gjetjen e definicionit të një fjale të vetme.

American Heritage fokusohet në shënimet informative. Përdorimi i shënimeve është i nevojshëm për të udhëzuar personin mesatar se si duhet të kërkojë dhe të gjejë nëse një fjalë mund ose nuk mund të përdoret në vende publike. Kjo përcaktohet nga një panel, derisa rezultati përfundimtar kolektiv është shumë i nevojshëm për personat joprofesionalë. Shënimet përmbledhin pikëpamjet e ndryshme të panelit dhe është mirë që ato të lexohen.

Në mesin e fjalorit standard të tavolinës, atij të kolegjit dhe fjalorit të pashkurtuar, *American Heritage* ka më shumë fjalë, pra rreth 200 000 sosh

përkundër vetëm 160 000 shënimeve nga konkurruesit e saj. Botuesi thotë se janë mbi 10 000 fjalë të reja në edicionin e vitit 2000, duke filluar nga termat kompjuterik si "laptop" dhe "pixel" deri te fjalët e reja nga jeta sociale si "prind i vërtetë" dhe "ngulitje". Edicioni i katërt ka një format tradicional superior. Shënimet janë me ngjyrë të zezë. Rreth 40 000 ilustrimet (shumica me ngjyra), tipografi dhe skica të përgjithshme janë shumë më të mira se ato çka ofrojnë konkurrentët në treg. Janë diku 30 000 shembuj se si fjalët përdoren dhe kur duhet të përdoren. Këto janë përgatitur nga stafi redaktues i fjalorit dhe në disa raste shembujt që jepen janë mjaft qesharak. Në anën tjetër, ato janë shumë të kuptueshme dhe të përcjella me citime historike. Fjalori *The American Heritage* është një prej fjalorëve më të mirë të tavolinës për etimologji, i cili jep shumë detaje në burimet gjuhësore të shumicës së fjalëve.

New World Dictionary nga Webster's

Si pjesë e një tërësie më të madhe, *Webster's New World Dictionary* është në versionin CD-ROM i shoqëruar me disa publikime të tjera referenciale nga *Simon & Schuster,* si p.sh. *Webster's New Thesaurus, Webster New World Guide to Concise Writing*, dhe pesë vepra të tjera. Kërkimi në të bëhet në mënyrë të zakonshme si në të gjitha versionet e tjera, edhe pse për shkakun se disku ka shumë njësi, më shumë përdoret për drejtshkrim dhe definicionin e fjalëve. Kjo, në mënyrë të madhe e ulë vlerën e versionit CD-ROM, posaçërisht për faktin se freskimet vjetore me informata i përfshijnë edhe materialet e reja dhe shiten me gjysmë të çmimit në krahasim me versionin origjinal.

Përsëri, ne duhet thënë se është shumë më e lehtë që të përdoret versioni i shtypur në shumicën e rasteve dhe pyetjeve; pra versioni i shtypur është mjaft superior. *Webster's New World Dictionary of American English* nuk është nga Merriam-Webster dhe këto dy vepra shpesh përzihen njëra me tjetrën.

Botuesi thotë se janë më se 170 000 shënime dhe rreth 800 ilustrime bardh e zi. *New World* e ka këtë emër, sepse fokusi kryesor i tij është në gjuhën e folur dhe të shkruar amerikane. Në të gjenden posaçërisht definicione të mira, të cilat janë shumë afër të folurës aktuale. Definicionet janë të radhitura në radhë historike e jo nga definicioni më i ri i një fjale.

Ylli që mund të gjenden në ndonjë shënim do të thotë se ajo është fjalë ose

shprehje amerikane. Janë diku 11 000 të tilla. Kuptimi ilustrohet me fjali dhe fraza të ndryshme të shkruara nga autorët. Shqiptimi është i qartë, derisa çelësi mund të gjendet në pjesën e poshtme në çdo faqe të djathtë. Janë vetëm disa ilustrime - pra diku rreth 800 - mirëpo që të gjitha janë adekuate.

Ky është ndër fjalorët më informativë, madje edhe më shumë se *American Heritage*. Favorizohet shumë nga gazeta *The New York Times* e po ashtu edhe nga disa shërbime të tjera të shtypit. Duke dhënë këtë lloj të rekomandimit, ky botim tanimë ka shumë lexues.

Random House

The Random House Webster's College Dictionary ofron një prej trajtimeve më të mira të fjalëve dhe frazave amerikane. Ky është një fjalor, i cili mburret për shkakun se në secilin edicion të ri të tij i përfshin edhe fjalët më të ndërlikuara dhe të pazakonshme të cilat tanimë janë pjesë e fjalorit amerikan. Po ashtu, ka më shumë fjalë dhe definicione sesa konkurrentët e tjerë të fjalorit të tavolinës. Edicioni i korrigjuar i botuar në vitin 2000 për shembull përfshin shumicën e termave nga Interneti e po ashtu edhe disa zhargone nga televizioni (politikisht korrekt, e-mail, tomi i dytë etj). Është gati si i njëjtë me fjalorët e tjerë të tavolinës dhe të kolegjit dhe si i tillë mund të gjendet në shumicën e bibliotekave.

Versioni i shtypur i *Random House*, sikurse *Merriam Webster's*, u kompletua duke u bazuar në fjalorin më të madh nga po e njëjta shtëpi botuese, pra në fjalorin e quajtur *The Random House Unabridged Dictionary*. E ka dhe kaptinën "User's Guide" (udhëzim për përdoruesin) në fillim të fjalorit, pra në parathënie, ku bibliotekarët mund të konsultohen për informatat e përgjithshme të fjalorëve. Fatkeqësisht, jo shumë njerëz është e mundshme që do ta lexojnë parathënien. Shënimet në këtë fjalor janë të njëjta sikurse në vëllimin primar. Sikurse edhe në vëllimin më të madh, ky fjalor mund të konsiderohet si më i mirë në disa fusha: një trajtim i mirë i zhargonit nga ana e fjalorit; definicionet e ngjeshura dhe të qarta; dhe qasja shumë përshkruese për fjalët.

Versioni CD-ROM nga *The Random House* përfshin tekstet nga versioni i shtypur ku janë më se 180 000 fjalë, e po ashtu edhe të dhëna të tjera biografike dhe gjeografike. Thesari në të ka tekstet e plota nga *Random House Thesaurus* me më shumë se 275 000 sinonime dhe antonime. Versioni CD-ROM ka shumë përparësi shumica e të cilave mund të gjenden edhe në versionet e tjera CD-ROM të konkurrentëve. Ndër to

janë edhe: (1) Mundësia për të lëvizur dhe zhvendosur para-prapa prej një fjale në fjalor në sinonime që nevojiten nga thesari. Nëse për shembull, përdoruesit i nevojitet një sinonim tjetër për fjalën "sarkastik" çelësi do të tregojë sinonimet për këtë fjalë. Nëse nuk jeni të sigurt në kuptimin e sinonimeve, një çelës tjetër i definon dhe jep kuptimin edhe për sinonimet. Dhe, kjo vazhdon; (2) Logjika Boolean lejon përdoruesin që të gjejë fjalë për frazën për të cilën përdoruesi nuk është i sigurt.

Dhe ...

Janë disa dhjetëra fjalorë, përveç atyre të botuar nga katër botuesit më të mëdhenj, të cilët u përmendën më lart. Shumica e këtyre fjalorëve janë goxha të mirë. Tre nga botuesit më të mëdhenj janë: *Oxford University Press, Chambers* dhe *Collins*. Më afër shtëpisë, shiko *Canadian Oxford Dictionary* (2000) për të cilën thuhet se ka diku rreth 2000 "fjalë dhe definicione të veçanta kanadeze" prej numrit total të shënimeve që kap shifrën 130 000. Kjo nuk është për të thënë se ky fjalor është më i mirë se ata që botohen në Angli ose në vendet e tjera, ku flitet gjuha angleze. Firmat e tjera konkurrojnë në tregun e lirë, kështu që përpara se të zgjidhni se cilin fjalor do të bleni, ju duhet të jeni të kujdesshëm dhe të zgjidhni fjalorin më të mirë.

Madje, edhe fjalori standard i tavolinës mund të modifikohet, p.sh., *Encarta World Dictionary* (Nju-Jork: St. Martin's Press, 1999, 2 078 f. $50). Pas një starti të dobët (siç u shpjegua më lart) dhe pas disa shtimeve dhe korrigjimeve erdhi dhe u bë më shumë një vepër për kuriozitet sesa një fjalorë i vërtetë. E botuar në Angli e që shitet në versionin e shtypur dhe atë Online edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ky fjalor ka vetëm 100 000 shënime. Dallimi është se prek këtyre shënime më se 3 000 sosh terma jo amerikane prej territoreve, sikurse Karaibet, Afrika, Azia Jugore dhe në fakt nga gati e krejt bota. Të gjitha janë në gjuhën angleze. Një tjetër pikë e shitjes: shumë fjalë të reja dhe zhargone edhe pse secila është e modifikuar dhe ka paralajmërime si politikisht korrekt në atë se si dhe kur duhet të përdoren fjalët. Kjo ka pak sukses. Dhe, në përfundim: futja e *Roget's Thesaurus*, një fjalor kompjuterik, një udhëzues i stilit, kalendar si dhe libër i citateve e shndërron këtë fjalor më shumë në një enciklopedi e po ashtu edhe në fjalor. A ia vlen që të blihet? Jo. Pasi shumica e veprave standarde i kanë fjalët e njëjta, definicione më të mira dhe, po ashtu edhe më se 50 000 fjalë të reja të përfshira, që shiten për gjysmë çmimi më lirë.

Në të njëjtën kohë, bibliotekat më të mëdha do të duhej ta kishin këtë botim, nëse jo për diçka tjetër atëherë për argument linguistik.

Një fjalor i një niveli të njëjtë është edhe fjalori nga *Encarta,* të cilin kritikët e kanë kritikuar shumë. Ata thonë se paralajmërimet "politikisht korrekt" janë të tepërta, sikurse edhe definicionet që përsëriten shumë dhe janë jo të qëdrueshme.

Fjalorët me fjalë të reduktuara

Shumë fjalorë janë të kufizuar në 60 000 e më pak fjalë. Disa prej tyre ofrohen në fundin e librave prej botuesve të njëjtë të veprave ose fjalorëve të tavolinës. Fjalorët e tjerë me pak fjalë janë të botuar nga firma të tjera të njohura. Për shembull, *Oxford American Dictionary* (Nju-Jork dhe Londër: Oxford University Press) ka vetëm 30 000 fjalë. *The Concise Oxford Dictionary of Current English* nga botuesi i njëjtë ka diku rreth 50 000 fjalë. Po ashtu, ofrohen edhe versione të tjera të fjalorëve të shkurtër nga Oxford.

FJALORËT PËR FËMIJË

CD: Macmillan Dictionary for Children. Nju-Jork: The Macmillan Company, 200
E deri më sot, çmime ndryshojnë. $60.
E Shtypur: 2000, 900 f., $15.

CD: The World Book Dictionary in the World Book Multimedia Encyclopedia.
Çikago, IL: World Book Publishing, 1992 e deri më sot, e përvitshme. $395.

E Shtypur: 2000, 2 vëllime. $79. Print: Scott, Foresman Beginning Dictionary.
Glenview, IL: Scott, Foresman, 2000, 832 f., $17.95.

CD: Merriam-Webster's Dictionary for Kids. Springfield, MA: Merriam-Webster, Inc., 2000, $59.95.
E Shtypur: Webster's Elementary Dictionary, 2000, 607 f. $12.95.

Janë disa dhjetëra ose qindra fjalorë për fëmijë, si edhe për të rritur. (Shih: "Children's Dictionaries", Booklist: Reference Books Bulletin, 15 Tetor, 2000, f. 475+ ku të gjithë titujt e fjalorëve për fëmijë analizohen shkurtazi). Arsyeja pse ka një numër aq të madh të fjalorëve për fëmijë është e thjeshtë: Janë aq shumë biblioteka shkollore dhe të gjithave nga to u nevojitet jo vetëm një fjalor, por fjalorë të ndryshëm që u përshtaten klasave dhe niveleve të ndryshme shkollore. Pra, ky është një treg mjaft profitabil për botuesit.

A janë fjalorët për fëmijë të rëndësisë së njëjtë? Është tregimi i njëjtë sikurse edhe për fjalorët e të rriturve. Pak botues janë përgjegjës dhe i botojnë titujt më të pranueshëm. Dhe, këta "disa" botues janë pothuajse të njëjtët botues, të cilët edhe i botojnë fjalorët për të rritur. *World Book; Scott Foresman*; dhe *Macmilla*n janë përjashtime në atë se këta botues koncentrohen më shumë në fjalorët për fëmijë dhe adoleshentë sesa në ata për të rritur.

Veprat ose fjalorët zakonisht janë të destinuar për parashkollorët deri për klasat e shkollës fillore, për klasat 5-8 dhe për shkollat e mesme. Përkimi ndodh për faktin se nxënësit e klasave 5-8 duhet të jenë në gjendje që të përdorin fjalorët e tavolinës për të rritur e jo të ketë nevojë për botime speciale për moshën e tyre. Shumë qartë, disa mësues (bibliotekarë) nuk pajtohen me këtë. Nëse ata pajtohen, nuk do të kishte fjalorë specialë për njerëzit e rinj. Një gjë e tillë mund të thuhet për shkollat fillore dhe klasat fillore, ku fjalori për të rritur nuk mund të përdoret, pra nevojitet botim i veçantë.

Katër fjalorët e listuar më lartë janë ndër fjalorët më të gjetur në shkolla dhe në biblioteka publike, së bashku edhe me fjalorët e tjerë standardë edhe për mosha më të vjetra. Janë 4 fjalorë nga totali, që kap numrin 50. Shumica e këtyre 50 fjalorëve janë disi si shtojcë e katër fjalorëve kryesorë. Për shembull, *Macmillan* ka diku rreth 10 vepra të ngjashme. Në anën tjetër, *World Book* ka vetëm një fjalor të vetëm. Versioni CD-ROM nga *Macmillan Dictionary* është fjalor tipik i asaj që mendohet se është zhvillim grupor. E ka tekstin komplet nga vëllimi i shtypur (12 000 fjalë e mesatarisht rreth 1 000 ilustrime) plus edhe animacione të tjera dhe efekte të zërit, të cilat e bëjnë kërkimin dhe shikim e fjalëve shumë më argëtues. Po ashtu, ofrohen edhe disa lojë me fjalë. Për më shumë se definicionet, shumë lehtë të kuptueshme dhe të shkrimit të tyre të kujdesshëm, ky fjalor ofron historitë e fjalëve dhe shënime gjuhësore. Karakteri i animuar "Zac" ofron një ciceron rrethi, i cili tregon se si duhet

të fillohet. Nga koha në kohë, "Zac" jep edhe komente të ndryshme për këtë apo atë fjalë. E gjithë kjo bëhet për lexuesin, i cili është nga mosha 7-12 vjeçare edhe pse mund të përdoret nga adoleshentët dhe fëmijët më të vegjël.

Bibliotekarët në të shumtë e rasteve i japin përparësi vëllimit të shtypur *Macmillan Dictionary* për arsye se: (1) ka diku rreth 35 000 shënime për klasat 2-6 të shkollës fillore, edhe pse mund të përdoret edhe nga më të rriturit ose më të vegjlit; (2) ka diku rreth 1 000 ilustrime me ngjyra; (3) përdor definicione që janë lehtë të kuptueshme me shumë ilustrime, fraza e fjali; (4) shqiptimet që jepen në fund të definicionit janë shumë të qarta; (5) ngërthen në vete edhe materialet shtesë sikurse hartat, listat e presidentëve dhe kështu me radhë.

E gjithë kjo e bën shumë të mirë këtë fjalor për fëmijë, i cili përfshin edhe fjalët e reja, që mund të përdoren rregullisht, si p.sh. në MTV.

Si rezultat, për shkakun se është aq i lehtë për t'u përdorur dhe për t'u kuptuar, bibliotekarët thonë se ky është ndër fjalorët më të kërkuar nga fëmijët.

Fjalori për fëmijë nga *World Book Dictionary* ka diku rreth 225 000 shënime. Ka diku prej 125 000 deri 200 000 fjalë sesa rivalët e tij. Kjo e bën këtë vepër fjalor "të pashkurtuar" për fëmijë dhe adoleshentë. Fjalori e ndjekë sistemin e njohur të *Thorndike-Barnhart* të përdorimit të definicioneve ku përdoren vetëm ato kuptime ose definicione që mund të kapen ose të kuptohen nga lexuesi. Pra, lexuesi nuk ka nevojë që të kthehet te shënimet për ta gjetur kuptimin e fjalës, të cilën e ka gjetur në definicion. Definicionet janë shembuj të qartësisë edhe pse shumë të rriturve mund t'u duken tejet të thjeshta. Formati është i mirë derisa ilustrimet, edhe pse jo në numrin e njëjtë me ato të *American Heritage*, janë së paku të qarta dhe të vendosura në vendet ku duhet. *World Book Dictionary* po ashtu ofrohet edhe në CD-ROM si pjesë e versionit digjital të enciklopedisë. Ky fjalor ka përparësinë e të qenit shumë ngushtë i lidhur me veprat e informatave. Ju mund të kërkoni definicionin e fjalës dhe shpjegimin nga enciklopedi ose ndaras.

Scott, Foresman boton një seri të fjalorëve të cilët përfshijnë titujt e fjalorëve që u kushtohen klasave të shkollave fillore e duke vazhduar deri te shkollat e mesme. Versioni fillestar ishte për klasat fillore 1-5 dhe është i bazuar në sistemin *Thorndike-Barnhart*, i cili mbështetet shumë në ilustrime. Rreth 75 % e fotografive janë me ngjyra. Disa fjalë kanë edhe historitë e tyre, të cilat shfaqen në disa kuti me ngjyra. Në përgjithësi, ky

është një fjalor me një format për lakmi, mirëpo që më shumë preferohet për udhëzim sesa për definicione.

Fjalor i një rëndësi të njëjtë ndër bibliotekarët është edhe *Webster's Elementary Dictionary*. Është deri diku i njëshëm me shënimet e *Macmillan* në kuptimin e numrit të shënimeve (33 000), në atë se me sa kujdes përdoren definicionet dhe kështu me radhë. Në anën tjetër, është një dallim shumë i madh ndërmjet tyre për faktin se botuesi u adresohet të gjithëve, në vend se të zgjedhë një grup të caktuar moshor. Rezultati i kësaj është një fjalor tipik për nxënësit e klasave 5-8 fillore sesa një fjalor i specializuar për fëmijë. Versioni CD-ROM, i cili bazohet në vëllimin e shtypur ka një emër të ri *Merriam Webster's Dictionary for Kids* dhe distribuohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga kompania *Mindscape.* Për herë të parë u botua në vitin 1994 dhe përfshin në vete numër të njëjtë të fjalëve dhe definicioneve, si edhe vëllimi i shtypur. Versioni digjital ka shqiptime fonetike për 20 000 deri 33 000 shënimet, ka rreth 200 animacione, 500 ilustrime me ngjyra, lojëra me fjalë dhe mesatarisht rreth 200 efekte të zërit.

Cili prej këtyre fjalorëve për fëmijë është më i miri? Për të arritur një konsensus, krejt varet në atë nëse fjalori është përdorur në klasë, në shtëpi, ose në bibliotekë. Ndër titujt e fjalorëve të listuar këtu, çdo fëmijë ose i rritur i cili do të merrte njërin nga ta nuk do të bënte gabim. Duke marrë në konsiderim fjalorët që janë bërë duke filluar nga parashkollorët deri te shkollat e mesme, e po ashtu edhe numrin e botimeve shtesë, çdo fjalor i ndonjë nga firmat e listuara këtu do të ishte i shkëlqyer.

Thesarët - sinonimet dhe antonimet

Online and CD-ROM: Shih kapitullin "Desk (College) Dictionaries" Shumica e fjalorëve themelorë të kolegjeve nuk ofrohen Online ose në CD-ROM, mirëpo përfshijnë një thesar të fjalëve. Po ashtu, pjesë e Microsoft Bookshelf.

E Shtypur. Roget's Thesaurus of English Words and Phrases. Nju-Jork: Penguin Books, 1998, 1 381 f. $19.

Librat e sinonimeve zakonisht janë ndër librat më të kërkuar dhe më të popullarizuar në biblioteka. Ata ofrojnë çelësin për gjetjen e fjalëve në fjalëkryq dhe i shërbejnë çdokujt, që dëshiron ta rrisë nivelin e tij në gjuhën angleze. Janë diku rreth 50 fjalorë, të cilët i japin edhe sinonimet

edhe antonimet në gjuhën angleze, mirëpo titujt e shënuar më lart shfaqen më shumë dhe mund të gjenden më shpesh nëpër biblioteka. Shumë qartë, ndër më të njohurit ndër këta fjalorë është vepra nga Peter Mark Roget (1779-1869), doktor në një repart mental anglez. Ai filloi punën në moshën 71 vjeçare dhe kur i bëri 90 vjet, ai kishe arritur të botonte edicionin 20 (termi "thesaurus"- thesar do të thotë "pasuri" "një grumbullim" dhe *Roget's* është i tillë).

Ndihma e tij optimiste ishte që të ndante dhe t'i klasifikonte të gjitha mendimet njerëzore nën një sërë kategorish verbale. Pra, vepra e tij është e aranzhuar sipas kësaj që u shpjegua. Janë mesatarisht diku rreth 1 000 klasifikime. Në secilin seksion/kapitull, i cili fillohet nga një fjalë kryesore, janë të radhitura pjesa e ligjëratës, fjalët ose frazat prej të cilave lexuesi mund të zgjedhë sinonimin e duhur. Antonimet zakonisht janë të vendosura menjëherë pas listës kryesore: kështu "e mundshme/e pamundshme", krenari/poshtërim".

Përparësia e *Roget's* është fakti se të gjitha idetë janë të vendosura së bashku. Një mangësi e madhe e këtij fjalori është se *Roget's* nuk ofron një udhëzues ose shënime; ndërsa, një shfrytëzues shumë e zellshëm mund të zgjedhë një sinonim ose një antonim, i cili duket si i mirë, mirëpo që është larg asaj fjale të vërtetë, me të cilën do të shprehnit atë që doni të thoni. Edhe pse *Roget's* shumë herë keqpërdorohet dhe abuzohet, posaçërisht në stilin e të kërkuarit, fjalori/libri mbetet një prej arritjeve më të mëdha në gjuhën angleze. Çdo gjuhë ka fjalorin e saj, mirëpo jo çdo gjuhe i nevojitet një thesar i fjalëve. Në rastin kur fjalori ofron definicione, thesari sugjeron asocimet; derisa fjalori ndjek metodën ku shkohet nga fjala deri te gjërat e caktuar, metoda e thesarit është e kundërt; derisa fjalori është një libër që zbulon arsyen, thesari është një punë e lidhjeve dhe imagjinatës; fjalorët mbërthejnë fjalë dhe i bëjnë ato statike derisa thesari i bën ato fjalë të lira dhe i bën ato të lëvizshme. Fjalorët janë për ata që merren me gramatikën e gjuhës e thesari është për ëndërruesit. Më e mira nga të gjitha është ajo se thesari nuk ngërthen në vete histori, nuk sugjeron traditën dhe nuk bën asnjë përpjekje të sqarojë, të justifikojë, ose t'i shpjegojë shënimet që gjenden në të. Është një prozë e vërtetë.[9]

Janë së paku disa tituj të cilët lirshëm përdorin emrin *Roget's*. Sikurse

[9] Ian Sanson, "Midwife and undertaker to the imagination", Guardian Weekly, 23 Gusht, 1998, faqe 29.

edhe *Webster's*, emri Roget nuk ka të drejta autoriale dhe mund të përdoret falas nga çdo botues. Shumica e këtyre titujve, të cilët përdorin emrin Roget janë shumë të varfër, pra një kopje e vjetër e botimit origjinal.

Edicioni *Penguin* i redaktuar nga Betty Kirkpatrick ndjek metodat tradicionale, mirëpo duke shtuar më se 5 000 fjalë dhe fraza moderne si p.sh. "air kissing" (puthja në ajër) me "salutation" (nderimin) dhe "Le Shuttle" me "Orient Express". Ky është botimi i parë i korrigjuar në 10 vjet.

Një numër i madh i versioneve Online dhe ato CD-ROM nga Roget e ndjekin një master plan të njëjtë. Përparësia, së paku për disa, është se shumë shpesh fjalët janë të radhitura sipas rendit alfabetik.

Në Internet

Me disa thesare në versionin e shtypur, të cilat janë po ashtu të kombinuara me fjalor standard në Internet, nuk ka arsye për të shikuar një thesar specifik në Internet. (Po ashtu, natyrisht, programet kompjuterike në kompjuter përfshijnë thesare). Mirëpo, nëse dikush dëshiron ta bëjë një gjë të tillë, pra të gjejë thesar të fjalëve në Internet, janë disa prej tyre. Ndër më të mirët janë:

Synonym Dictionary (http://vacouver-Webpages.com/synonyms.html).

"Ju lutemi, shënoni një fjalë në gjuhën angleze, një emër njëjës si p.sh. automobil ose shkallë". Dhe, kjo është e gjitha që duhet të bëni. Më pastaj, shfaqen sinonimet. Më shumë kërkime mund të bëhen duke shënuar një mënyrë ose më shumë se si shkruhet fjala, p.sh. "automobil, veturë". Po ashtu, mund të shënohen klasat e fjalëve. Duke iu falënderuar opsioneve te reja, ky web-sajt e universitetit është e përdorshme posaçërisht për kërkim më të komplikuar mbi sinonimet.

Roget's Internet Thesaurus (www.thesaurus.com). Ky thesar është i njëjtë për t'u përdorur sikurse fjalori Online. Shëno në kuti fjalën që dëshiron e më pastaj do të shihni sinonimet dhe antonimet e shfaqura në ekran. ("Ndihmë" rezulton në 14 shënime). Nëse nevojitet një definicion për ndonjë nga fjalët - sinonimet, vetëm klikoni dy herë mbi atë fjalë për të marrë definicionin komplet.

Stili i dorëshkrimeve dhe si përdoren

CD: The Chicago Manual of Style, edicioni 14. Çikago: University of Chicago Press, 1993, në Microsoft Bookshelf.
E Shtypur: 936 f., $40.

E Shtypur: The Columbia Guide to Online Style. Nju-Jork: Columbia University Press, 1998, 224 f. $34; në letër, $17.50.
E Shtypur: Turabian, Kate. *A Manual for Writers of Term Papers, Theses, and Dissertations*, edicioni 4. Çikago: University of Chicago Press, 1987, 300 f. $20. Libri i xhepit, $7.95.

E Shtypur: Webster's Dictionary of English Usage. Springfield, MA: Merriam-
Webster, Inc., 1989, 980 f. $18.95.

"Kush përdor udhëzues gjuhësorë?", pyet autori John Updike. "Redaktorët, duke kërkuar që të vënë një rend, rregull dhe qartësi në shkrimet dhe prozat, që gjenden në publikimet e tyre, kërkojnë ndihmë te këta udhëzues.[10] E njëjta gjë mund të thuhet edhe për personat joprofesionistë dhe studentët, të cilët dëshirojnë "të vënë rregull, rend dhe qartësi" në shkrimet e tyre. Kjo është e tëra pse janë dhe pse përdoren udhëzuesit e stilit.

The Chicago Manual of Style është një udhëzues standard për anglishte të mirë. E para dhe më e rëndësishmja, Manual-i është një ndihmë e madhe në përgatitjen e artikujve, qoftë për publik qoftë për klasë. E dyta, tregon se si duhet të përdoren bazat elektronike të të dhënave, duke filluar nga indeksimin deri te shënimet në fund të faqes. E treta, ka një këshillë të mrekullueshme në çështjet më të thjeshta, duke filluar nga përdorimi i rregullt i inicialeve të autorit deri te rregullimi i citateve dhe referencave, shënimeve në fund të faqes, leximeve plotësuese, e kështu me radhë. Në të gjenden edhe disa seksione/kapituj me definicione nga librat dhe artikujt, informacione mbi te drejtën autoriale dhe nga fusha të

[10] John Updike, "Fine Points: Why we should still care about Fowler seventy years on", The New Yorker, 20/30 dhjetor, 1996, f. 148.

ngjashme.

Bazat elektronike të të dhënave paraqesin një problem për rregullat tradicionale të stilit. Shumica e titujve standardë të listuar në këtë libër kanë seksione/kapituj në atë se si duhet të citohet, ose p.sh. tekstin e plotë Online. Është duke u rritur numri i udhëzuesve (manualëve) që të gjithë në versionin elektronik. *Columbia Guide* nga Janice Walker dhe Todd Taylor është një nga udhëzuesit më të mirë. Pjesa e parë e tij është me shembuj të citimeve, që janë të bazuar në formën e *Modern Language Association*. Kjo është më se e mjaftueshme për shumicën e lexuesve. Njerëzit me njohuri më të mëdha dhe ata, të cilët janë të përfshirë drejt-përdrejt me publikimet Online, do ta përdorin pjesën e dytë të tij, e cila shpjegon stilet e dokumenteve Online. Për format e stileve dhe për citimet themelore Online, e po ashtu edhe për freskimet nga koha në kohë, shih: (www.columbia.edu/cu/cup/cgos). Këtu nuk mund të gjendet i gjithë libri, por vetëm freskimet me informata.

The MLA Style Manual (edicioni i 2-të. Nju-Jork: Modern Language Association, 1998, 350 f. $25) është një udhëzues standard për studentët e kolegjeve dhe universiteteve, mësuesit dhe dijetarët. Kalon nga procesi i publikimit në atë se çka është e përfshirë prej idesë fillestare deri te libri i përfunduar. Kapitulli i dytë ka të bëjë me çështjet ligjore, duke përfshirë këtu edhe të drejtat autoriale. Por, pjesa më e madhe e këtij udhëzuesi i ndërton dhe i tregon rregullat stilistike për mbledhje të mëdha dhe atë se si të përgatiten artikuj ose teza. Edicioni i dytë ngërthen në vete dhe ndihmon në atë se si të citohen burimet ose veprat Online e po ashtu edhe materiali që merret nga CD-ROM. Shënim: Një variant i këtij udhëzuesi (manuali) është *MLA Handbook for Writing Research Papers*, i cili freskohet shumë shpesh me informata. Ky botim u dedikohet posaçërisht studentëve dhe nxënësve të shkollave të mesme se si të përgatisin dhe të shkruajnë artikuj.

Turabian, ose siç quhet shpesh *A Manual for Writers*, është një vepër edhe më specifike për studentë. Freskohet me informata rregullisht dhe është, në kuptimin e plotë të fjalës, një version i shkurtuar i *Chicago Manual*. Në këtë botim, lexuesi mund të gjejë rregulla specifike për çdo gjë, duke filluar nga gramatika dhe shënimet në fund të faqes deri te ajo se çfarë lloji të artikullit duhet shkruar për raste të caktuara. Po ashtu, në libër diskutohet edhe se si duhet të citohen burimet nga kompjuteri, materialet jo të botuara, kuptimin e katalogëve në publikime, e madje

edhe atë se si autori duhet ta frazojë një artikull, kur e dërgon dorëshkrimin e tij te botuesi.

Webster's Dictionary of English Usage ofron këshillë të drejtpërdrejtë dhe instruksione të qarta për përdorimin e fjalëve. U rekomandohet të gjitha bibliotekave si një udhëzues mjaft aktual dhe i lehtë për t'u lexuar. I aranzhuar sipas rendit alfabetik, duke filluar nga shkronja "a" deri te "z", është shumë i lehtë për t'u përdorur. Redaktorët duket se e ndjekin filozofinë përshkruese, sikurse edhe botuesi, mirëpo këtu diskutohen pikëvështrime të ndryshme. Për shembull, shiko fjalën e kudogjendur "ain't" (s'është) dhe 10 shtylla, që shpjegojnë këtë fjalë dhe e ilustrojnë atë me shembuj të ndryshëm. Janë diku rreth 20 000 citime të tilla, të cilat përdoren për të theksuar një rast kur fjala përdoret ose një rast tjetër. Po ashtu, shiko edhe: *A Dictionary of Modern American Usage* (Nju-Jork: Oxford, 1998), i cili është më i ngushtë për nga përmbajtja por i rëndësishëm për shkak të fokusimit të tij në fjalimet e thjeshta.

The New Fowler's Modern English Usage (Oxford: Oxford University Press, 1996) është një korrigjim i veprës së famshme dhe të njohur nga H. W. Fowler, nga viti i largët 1926. Udhëzuesi i vjetër mbetet një emër i shënuar për ata të cilët besojnë në rregullat gramatikore përshkruese. Madje, u paraqiten edhe disa ndryshime të mëdha në qasjen tradicionale kur u botua edicioni i riredaktuar nga R.W. Burchfield. Edicioni më i fundit bën përjashtime të mëdha të rregullave, të cilat ishin vënë nga shkolla angleze përshkruese e "King's English". Bibliotekat këshillohen që t'i kenë në sirtarët e tyre të dy edicionet, edicionin më të fundit dhe atë më të hershmin për arsye se ka dallime të mëdha ndërmjet tyre.[11]

Në Internet

Ka shumë pak udhëzues në Internet në krahasim me atë se çka dhe sa materiale mund të gjenden në udhëzuesit gramatikorë dhe të shtypur. Më i pranueshmi nga ta në Internet është *Guide to Grammar and Writing*, i cili sponsorizohet nga kolegji *Hartford Connecticut* (http://webster.comment.edu/grammar/index.html). Në radhë të parë, ky botim është një

[11] Shih Updike, op.cit., faqe 142-149 për një analizë më të hollësishme të versionit të ri Fowler. Versioni Online Fowler ofrohet falas (www.barleby.com/116), mirëpo vetëm edicioni i parë i vitit 1908. Gjatë viteve, ky version është rishkruar dhe freskuar me informata në masë të madhe. Si pasojë e kësaj, shumë nga "rregullat" janë të kaluara.

udhëzues për gramatikë elementare, që u kushtohet studentëve. Edhe pse është udhëzues mjaft i mirë, nuk iu hyn shumë në punë lexuesve më të ngritur dhe më njohuri më të mëdha. Ka linka të shkëlqyer të web-sajteve të ngjashme.

The Slot (www.theslot.com). Redaktori nga gazeta e njohur *The Washington Post Bill Walsh* e udhëheq këtë web-sajt, i cili është e koncentruar në pikat më të përsosura të anglishtes së mirë. Kapitulli kryesor i emëruar "The Curmudgeon's Stylebook" është e ndarë në tetë kategori (fjalë për të zgjedhur deri te ajo se si të bëhet shqiptimi i fjalëve) ku gjenden edhe një indeks fjalë për fjalë i gjatë diku rreth 20 faqe. Indeksi fillon me përdorimin e përshtatshëm të akronimeve dhe përdorim e fjalës "deri". Në të ndiqen metodat e njëjta të diskutimit dhe të shpjegimit të gjërave, kështu që studenti ose personi joprofesional i hutuar mund t'i gjejë të gjitha përgjigjet mbi mëdyshjet e stileve në këtë burim informativ të mrekullueshëm- një burim i cili freskohet me informata në mënyrë të vazhdueshme. Shënim: Redaktori bazohet në *Associated Press Stylebook*.

MLA-Style Citations of Electronic Sources. Universiteti i Floridës Jugore (www.cas.usf.edu/english/walker/mla.html). Duke përdorur shembuj specifikë të artikujve të shkruar nga studentët, Janice Walker që është anëtare e Departamentit të Gjuhës Angleze në Universitetin e Floridës Jugore tregon dhe demonstron rregullat e Asociacionit të Gjuhës Moderne, ku hyn citimi i materialeve nga Interneti dhe burime të tjera elektronike. Një udhëzues i shkëlqyer dhe shumë i lehtë për t'u ndjekur për studentin, që duhet ta shikojë këtë kur ka nevojë të citojë materiale nga Interneti.

Shënim: Mbi problemet komplekse të citimit, shih *The Internet Public Library Citing Electronic Resource* (www.ipl.org). Këtu mund të gjenden linka të shumtë, të cilët flasin mbi rregullat e citimit dhe burime të tjera të shtypura.

Fjalorët historikë

Online: Oxford English Dictionary (OED) Online, Nju-Jork: Oxford University Press, 200 e deri më sot, www.oed.com. Për bibliote-

ka: $759+. Për individ: $550.

CD: The Oxford English Dictionary (OED) 2nd Edition on CD-ROM. 1992
E deri më sot, nuk ka freskime me informata. $895.
E Shtypur: 1989, 20 vëllime, $2,500. (Në shitje: 1998-1999: $995).
Botime Shtesë: vëllimi 1 (234 f.); vëllimi 2 (234 f.), vëllimi 3 (234 f.). $35 secila nga to.

CD: The New Shorter Oxford English Dictionary on CD-ROM, Nju-Jork: Oxford University Press, 1998. $75.
E Shtypur: *The New Shorter Oxford English Dictionary*, 1998, 2 vëllime. 3 776 f. $100.

Ndër të gjithë fjalorët në gjuhën angleze, fjalori *Oxford English Dictionary*, (i cili filloi të botohej së pari me emrin *New English Dictionary on Historical Principles*) është fjalori më i mirë, ashtu si e quajti edhe H.L. Mencken, "fjalori që është babai i të gjithë fjalorëve të tjerë". Qëllimi i këtij fjalori është ndjekja e historisë së gjuhës angleze. Kjo është bërë me definicione dhe citime, që tregojnë ndryshimet në kuptimin dhe përdorimin e fjalëve.

Autori dhe kritiku Hugh Kenner e quan fjalorin OED si fjalorin e vetëm "epik" ndër veprat referenciale, ose fjalorin epik të shekullit XIX. Nëse libri *Paradise Lost* është libri epik i shekullit XVII, *Gibbon's Decline and Fall* i shekullit XVIII dhe *Joyce's Ulysses* i shekullit XX, atëherë fjalori OED është një nga të arriturat më të mëdha në shekullin XIX. Puna e mrekullueshme në fjalor filloi në mesin e shekullit të Viktorisë dhe Tennyson-it.

Ky fjalor i definon më se 616 500 fjalë dhe i mbështet këto definicione të fjalëve dhe të përdorimit të tyre me më shumë se 2.5 milionë citime. Në *Webster's New World Dictionary*, etimologjia i zë rreth pesë rreshta për derisa në fjalorin OED i zë rrafsh 23 rreshta. Shënimi në "vetëm" këtë fjalor është i gjatë 60 000 fjalë. Nëse bëjmë krahasimin atëherë del që *Milton's Paradise Lost* ka më i shkurtër se 80 000 fjalë. Fjala "poentë" në fjalorin OED zë 18 shtylla, derisa fjala "vendos" zë 30. (Ky është vetëm një vrojtim e kurrsesi një vërejtje. Duhet thënë se derisa Webster's ka vetëm një vëllim të vetëm, OED ka 20 të tillë).

Sistemi i kërkimit në versionin Online të OED është shumë i thjeshtë. Shfrytëzuesi mund të shënojë një fjalë për të bërë një kërkim të shpejtë dhe atij do t'i shfaqen një numër i madh shënimesh nga fjalori në version-

in e shtypur. Janë metoda të shumta, që mund ta bëjnë kërkimin më të gjerë ose më specifik, p.sh. ju mund të zgjidhni fjalë nga Bibla ose nga artikujt e shekullit XX (1900-1941). Suksesi i këtij sistemi bazohet në një analizë të kujdesshme të pjesës së softuerit nga mësuesit dhe bibliotekarët. Duke u bazuar në një kërkim të bërë, tani është kompani ajo që përkujdes, e jo shitësi, e cila përkujdeset për edicionin Online.

Versioni digjital OED është blerja më e qëlluar për bibliotekat, sepse ato paguajnë më pak se $800 për shumicën (p.sh. për bibliotekat e mëdha) çmimi mund të arrijë edhe në shifrën $8 500. Kjo, ndoshta do t'i ndalonte ata që ta blejnë atë edhe për arsyen se mund të mos ketë shumë njerëz, të cilët e përdorin versionin Online. Duhet thënë që versioni Online është shumë më i kompletuar sesa ai i shtypur dhe çka është më e rëndësishme, versioni Online i jep shfrytëzuesit qasje në disa poenta dhe materiale, që është e pamundshme të gjenden në versionin e shtypur. Mirëpo, çka mund të bëjë shfrytëzuesi në versionin digjital përveç se t'i kontrollojë historitë e fjalëve, definicionet, shqiptimin e tyre e kështu me radhë? Në të vërtetë, mund të bëjë shumë gjëra tjera: (1) të bëjë kërkim e citimeve, duke shënuar vetëm fjalën kryesore prej më se 2.5 milionë citime që gjenden në të. Citimet mund të kërkohen edhe me datë, autor, sipas titullit të artikullit/citimit, ose edhe të tekstit. Përdoruesi mund të gjejë të gjitha citimet për fjalën "futboll"; (2) mund të gjejë fjalë nga definicionet, pra nëse ju nuk e dini çka do të thotë fjala "conspicuously bad" (e keqe e dukshme) atëherë kompjuteri do të tregojë fjalën tjetër "egregious"(skandaloze) si një fjalë e ngjashme; (3) Fileri mund t'i klasifikojë fjalët edhe sipas pjesëve të ligjëratës; (4) mund t'i ndjekë dhe t'i shikojë më se 600 000 referenca të kryqëzuara për të gjetur një fjalë ose një ide; (5) mund t'i listojë të gjitha fjalët, që kanë hyrë në gjuhën angleze nga gjuha frënge, gjermane, e kështu me radhë; (6) mund të bëjë listën e çdo fjale, e cila mbaron me shkronjën "q" dhe të ketë në ekran çdo ndajfolje, e cila nuk mbaron me "ly" (kuptohet, në gjuhën angleze); (7) të zgjedhë shënimet në bazë të citimeve më të hershme. Mirëpo, ka edhe shumë mundësi të tjera.

Duke iu falënderuar disa herë faqeve të ndryshme me citime për një fjalë, frazë, apo koncept, fjalori OED është një thesar i sofistikuar dhe i mrekullueshëm. Për shembull, sa fjalë janë aty për baltën dhe vendet e baltës? Këtu, ju mund të shikoni thesarin dhe nëse dëshironi një regjistrim të kompletuar dhe informata të hollësishme, së paku në gjuhën angleze, atëherë një zgjidhje edhe më e mirë është versioni CD-ROM nga fjalori OED. Pyetni për të gjitha definicionet e fjalës "baltë"dhe rezultatet janë fascionuese. Në të gjithë fjalorin janë më se 111 fjalë me definicionin

e "baltosur" (lloçit) dhe diku rreth 313 fjalë, të cilat në definicionin e tyre përfshijnë edhe fjalën "baltë". Herën tjetër kur dëshironi një sinonim, pse të mos provohet: ngjathtësi: një pellg me baltë ose shkurt "puddle"; ose riley; që është baltë shumë e trashë; ose limicolous: të jetosh në baltë. Nëse ju shkoni dhe më poshtë në këtë kategori, ju do të jeni njeri i baltosur "besmotted", ose dikush i njollosur me baltë.[12]

Redaktorët kanë edhe një seksion/kapitull të veçantë, ku i fusin fjalët dhe neologjizmat e rinj. Për shembull, fjalori OED e konsideron fjalën "fashionist", si një fjalë që ka hyrë në botën e modës dhe do të thotë një njeri, i cili e ndjek modën; në rastet ekstreme, do të thotë viktimë e modës.

Puna në edicionin e tretë filloi në fillim të viteve '90-të dhe u botuan nga botuesi disa vëllime në vitin 2000, të cilat do të bëhen pjesë e korrigjimit të propozuar, i cili identifikohet si *Oxford English Dictionary Additional Series*. Vëllimi 2 u botua në vitin 1997 dhe është tipik i njëjtë me familjen e vëllime të tilla. Janë diku rreth 18 000 shembuj të "mençur", të cilët vijnë në Oksford, çdo muaj, prej më se 60 lexuesve nga e gjithë bota. Citimet vijnë jo vetëm nga librat, mirëpo edhe nga gazetat, revistat, udhëzuesit (manualët), televizioni, e madje edhe nga fjalorët. Ndër fjalët dhe frazat e reja janë edhe: "bungee-jumping", "feelgood" (të ndjehesh mirë) "post structuralism" (post-strukturalizmi) dhe "virtual reality" (realiteti virtual). Secili nga dy vëllimet e para përfshin më se 3 000 fjalë, definicione, ose citime të hershme të fjalëve. Në të vërtetë, kjo shërben si një botim shtesë e përmbledhjes kryesore, derisa edicioni i tretë të jetë botuar. Dhe, bëhet pyetja: Kur do të botohet komplet edicioni 3? Duke u bazuar në *Oxford Press University*, kjo do të bëhet nga mesi i vitit 2010. (Edhe pse edicioni digjital do të absorbojë fjalë të reja dhe shtesa të reja pasi ato të jenë bërë gati për edicionin e shtypur. Si rezultat i kësaj, versioni Online do të konsiderohet, si gjithnjë, më aktual sesa versioni i shtypur.) Sot, disa mijëra vullnetarë janë duke ndihmuar për t'i mbledhur korrigjimet, gjërat e reja, etimologjitë e reja dhe informacionet bibliografike

[12] "Weather wise", The Independent, 9 mars, 1998, f. 2.

[13] Çmimi i këtij projekti në vitin 2000 kushtoi jo më pak se 50 milionë dollarë. Edicioni i ri do t'i ketë minimum 30 vëllime dhe jo 20 sa i ka edicioni i tashëm. Për artikuj fascinues dhe të shkëlqyer të korrigjuar shiko: "The Oxford English Dictionary Revision Program" në web-sajtin e OED që është www.oed.com. Po ashtu, shiko edhe: David Tyckoson, "What Were They Thinking" Against the Grain, shtator, 2000, f. 38-42. Ky ekspert i referencave jep një prezantim të mirë mbi çështjen se sa kushton vepra Online dhe çka duhet bërë për të ulur një çmim të tillë. "The OED Adds the Web to its Lexicon", The New York Times, 5 nëntor, 1998, f. G1+, 7 mars, 2000, f. 13; The Times, 16 mars, 2000, f. 19.

prej gati çdo literature dhe nga çdo dijetari. E gjithë kjo do të jetë pjesë e edicionit të ri.[13] Pyetja kryesore është kjo: A do të nevojitet edicioni i shtypur, nëse i gjithë fjalori OED i korrigjuar ofrohet në versionin Online?" Përgjigjja për shumicën e bibliotekave është ajo se këto biblioteka duhet të kenë edicionin digjital, posaçërisht atë Online. Vetëm qendrave dhe bibliotekave të mëdha do t'u nevojitet versioni i shtypur.

OED- i shkurtuar

Versioni CD-ROM i *Shorter Oxford English Dictionary* ka në të, pikërisht të gjithë atë që mund të gjendet në edicionin e shtypur. Për definicionet e thjeshta, mund të përdoret çdo fjalor tjetër, mirëpo për definicione më të komplikuara dhe për kërkime më në detaje, versioni CD-ROM gjithnjë është fitues. Përveç kërkimit të thjeshtë të një fjale, përdoruesi mund të kërkojë edhe indeksin e shkurtimeve, frazave, fjalëve kryesore etj. Nëse kjo nuk mjafton, është edhe opsioni tjetër i kërkimit të tekstit të plotë (si për shembull kërkimi do të rezultojë në citime me dardha dhe molla në citime). Metodat e veçanta të kërkimit lejojnë kërkimin e rimave, fonetikave etj. Janë vetëm rreth 170 000 shënime nën 100 000 fjalë kryesore (fjalë-titull në maje të fletës). Në të vërtetë, asnjë fjalor tjetër i punës nuk ka më shumë definicione se ky, mirëpo lexuesi nuk do të gjejë këtu histori, shembuj më të rinj dhe fjalë më të reja. Është një burim i shkëlqyer për të ndjekur dhe për t'i parë hapat e historisë së fjalëve, por këtu historia fillon vetëm nga viti 1700. Çdo gjë tjetër më e vjetër se viti 1700, duhet të shikohet në fjalorin OED.

Fjalorët regjionalë amerikanë

E Shtypur: Dictionary of American Regional English (DARE). Cambridge, MA: Harvard University Press, 5 vëllime- në proces e sipër. Çmimi ndryshon.

Përderisa fjalori OED mbetet "bibël" për linguistin ose për njeriun joprofesional, në mënyrë që të ndjekë historinë dhe shumësinë e kuptimeve të fjalëve, ky fjalor nuk është fort i mirë për të parë përdorimin e mirëfilltë të fjalorëve, së paku jo për amerikanët. Amerikanët që flasin gjuhën angleze dhe anglezët që flasin gjuhën angleze gati përdorin dy gjuhë të ndryshme, e cila natyrisht regjistrohet në OED. Vendimi u mor

që vëmendje më e madhe në botimet shtesë të OED t'u kushtohej fjalëve amerikane, posaçërisht atyre të cilat tanimë janë shumë të njohura për evropianët ose shikuesit e televizioneve amerikane dhe filmave, gazetave, e revistave amerikane. Në fakt, që nga viti i largët 1970, fjalori OED është shumë fjalor më i mirë për amerikanët se të tjetër, për shkak se ofron definicione të kujdesshme dhe histori të zhargoneve të reja dhe të vjetra nga anglishtja amerikane.

The Dictionary of American Regional English përmbledh shprehje të ndryshme dhe definicionet e tyre nga mëse 50 shtete të ndryshme të Amerikës. Ky projekt monumental filloi së zbatuari në vitin 1965 ku punëtorët e specializuar dhe të trajnuar i kaluan pesë vjet duke intervistuar 3 000 indianë në më shumë se 1 000 komunitete. Për më shumë se këto intervista, materiali për fjalorin *Dictionary of American Regional English*, që zakonisht njerëzit i referohen edhe si DARE, është një material i përmbledhur nga një numër i madh i burimeve të shtypura, duke përfshirë novela regjionale, shënime nga folklori, gazeta dhe ditarë.

Përveç kuriozitetit, çfarë vlere të vërtetë ka një fjalor i tillë si DARE për njerëzit jo profesionistë? Një shembull: paramendoje sikurse ju jeni një i diplomuar nga fakulteti i medicinës, i cili është rritur në shtetit amerikan Seatlle. Puna e parë e juaja është në Appalachians. Si do të mund ju t'i daignostifikoni ankesat si "ground itch" ose "dew poison", "sore leader" ose "pones" nëse ju nuk e keni me vete DARE në duart tuaja në mënyrë që të përktheni sëmundjet lokale në zhargonin medicinal. Po ashtu, gjendet edhe një "Unabomber", i cili ishte ndjekur dhe përcjellë për shkak të përdorimit të gjuhës- një gjuhë e cila mund të gjendet në shumë fjalorë përfshirë këtu edhe fjalorin DARE. Shumë qartë, kjo vepër është e një vlere të njëjtë për të gjithë bibliotekarët. Mirëpo, çka me ato fjalë, të cilat nuk mund të gjenden në fjalor. Në atë rast, redaktori kërkon ndihmë, p.sh. ju mund t'i kontaktoni ata në (http://polyglot.lss.wisc.edu/dare/dare/html). Shënim: Fjalori si edicion i vitit 2000 nuk gjendet Online, por mund të bëhet Online në kohën kur kjo faqe do të lexohet.

Në çdo diskutim mbi historinë e gjuhën amerikane, është një vepër mbi të gjitha, që është edhe kënaqësi për t'u lexuar nga faqja në faqe. Kjo është vepra *The American Language nga Henry Mencken* (Nju-Jork: Alfred A. Knopf, Inc., 1919 deri më 1948). Në tri vëllimet e këtij libri, saga e Baltimorit i ekzaminon në masë të konsiderueshme fjalët amerikane në stilin dhe mënyrën që janë zbavitëse dhe të mira për t'u lexuar. Vëllimit të vetëm të kësaj vepre nga viti 1919 i ishin shtuar edhe botime të tjera

shtesë, dy, disa vjet më vonë. Të gjitha lexohen shumë lehtë dhe secila ka nga një indeks të detajuar.

Speaking Freely: A Guided Tour of American English From Plymouth Rock to Silicon Valley (Nju-Jork: Oxford University Press, 1997). E redaktuar për herë të parë nga Stuart Flexner me emrin *Listening to America and I Hear America Talking*, ky korrigjim që po jepet këtu është bërë nga Ann Soukhanov. Mirëpo, kjo nuk ka rëndësi. Qëllimi është i njëjtë - listimi në radhë alfabetike i fjalëve dhe i frazave që i habisin dhe i vënë në mëdyshje lexuesit. Në vepër ka edhe shkrime nga historia dhe thashethemet. Për shembull, Benjamin Franklin ka pasur më shumë se 200 sinonime për fjalën "i/e dehur". Ndër to ishin edhe fjalët nimptopiscal, cherry-merry dhe oiled.

Duke shikuar historinë e fjalëve, fjalori OED shkon pas, vetë deri te vepra *Northman Conquest* (1066). Me këtë ngjarje "anglishtja moderne" filloi të formohej dhe u kompletua diku nga viti 1 500. Anglezët e parë dhe historitë e para do të gjendeshin në fjalorin *Dictionary of Old English*, një projekt i komplikuar dhe i gjatë më se 30 vjet nga Universiteti i Torontos (në vitin 1999, puna e stafit kishte arritur deri te shkronja G, mirëpo, me fat dhe me financa të mira, kjo vepër do të kompletohet deri në vitin 2012). Ky fjalor do të tregojë dhe do të hartojë përafërsisht diku rreth 35 000, fjalë të cilat kanë qenë në përdorim ndërmjet viteve 600 AD, kur krishterizmi erdhi në Britani, deri në vitin 1100 AD, menjëherë pas invazionit norman.

Zhargoni

E Shtypur: Random House Historical Dictionary of American Slang. Nju-Jork: Random House, 1994 e deri më sot, 3 vëllime. Çmimi ndryshon.

Në të kaluarën, shumica e fjalëve vulgare, fjalët me katër shkronja nuk ishin të përfshira në fjalorë. Sot, edhe fjalori i tavolinës i përfshin në vete fjalët dhe shprehjet normale. Shumica e tyre janë të etiketuara si "ofensive".

Fjalorët e zakonshëm të tavolinës, po ashtu i listojnë dhe tregojnë definicionet e fjalëve që përshkruajnë njerëz, të cilët nuk janë në rregull ose fizikisht ose mentalisht (budalla, trashaluq); termat e zhargonit për grupet etnike ose religjioze (prej WASP deri te wop); emërtimet për femra

(domate); termat e zhargonit për homoseksualët, e kështu me radhë. Të gjithë këta terma duhet të etiketohen qartë dhe të tregohet se ato nuk janë të pranueshme në gjuhën standarde. Sot, komiteti i "Buletinit të Veprave Referenciale" e konsideron fjalorin si të mangët nëse nuk i përfshin edhe ato fjalë që janë të etiketuara si "vulgare" ose të "papranueshme". Disa analistë të tjerë, përveç atyre të cilët vlerësojnë veprat e fëmijëve, kanë opinion të njëjtë mbi këtë çështje.

Një biblioteke i duhet një fjalor i zhargonit për arsye se: (1) shumica e fjalorëve nuk tregojnë ndryshimet në kuptim, duke dhënë termat e zhargonit ose të fjalëve. Shumë pak tregojnë historinë e tyre, e cila në të vërtetë është pjesë e kulturës popullore të historisë së SHBA-ve; (2) lexuesit i hasin shprehjet që nuk janë të shpjeguara mirë në fjalor të rregullt; (3) autorët kërkojnë fjalë, në mënyrë që të transmetojnë informata mbi të kaluarën, klasën, ose profesionin e një karakteri dhe fjalori i zhargonit është një vend i mirë për t'i kontrolluar edhe një herë fjalët e tilla; (4) lexuesit që tregojnë një kuriozitet të thjeshtë dhe interesim mbi gjuhën.

Një aspekt fascinues i zhargonit është ajo se si koncept shfaqet goxha vonë. Chaucer dhe Shekspiri kanë përdorur gjuhën vulgare, mirëpo nuk ka indikacion se autori apo audienca e ka sistemuar këto fjalë në një kategori të veçantë. Poenta, kështu është e qartë. Përpara se ju mund të keni zhargon, opinioni publik duhet të jetë i njoftuar mbi gjuhën standarde. Vetëm me edukimin e masës së madhe në shekullin XIX njoftimi i opinionit me zhargon u përhap aq shumë.

Vëllimi i parë i *Random House Dictionary of American Slang* u shfaq për herë të parë në vitin 1994 derisa vëllimi i tretë dhe ai final u botuan në fund të vitit 2000. Më shumë se 300 000 shënime janë punë e J. E. Lighter, një profesor i gjuhës angleze në Universitetin e Tenesisë, i cili kaloi më shumë se dy dekada duke kërkuar historinë e fjalëve të pazakonshme. Fjalori i kompletuar do të incizojë informacione leksikografike në të gjitha fjalët e mëdha të zhargonit dhe frazat që janë hasur në Shtetet e Bashkuara prej kohës së kolonive angleze deri më sot. Sikurse edhe me fjalorët e tjerë të mëdhenj historikë, këtu fjala është e definuar dhe e shpjeguar së pari e më pastaj tregohet zhvillimi i asaj fjale, që nga përdorimi i saj i parë. Citimet janë të përdorura si një evidencë mbështetëse. Në fakt, ky është "udhëzuesi i vetëm për gjuhën angleze, ndonjëherë i botuar, në të cilin mund të hasen më shpesh citimet si "Tradhtar i Popullit" dhe "The Valley Girl Handbook", sesa ato nga Henry James apo Bibla.

Fjalët dhe frazat janë marrë në mënyrë të barabartë prej Shekspirit te

Penthouse, Beckett - te Butt-head dhe prej një numri të madh të spektakleve televizive. Datat janë të dhëna në radhë prej shfaqjes së parë. Në vëllimin e vitit 1997, për shembull "jashtë për drekë" daton që nga viti 1955 derisa fjala tjetër "hong hair" (intelektuale) është që nga viti 1920. Vëllimi i vitit 1997 (H deri në O) fillon me "happy camper" dhe "hair hopper" (dikush që e ndryshon stilin e flokëve shumë shpesh) deri te "ootchimagootchi" (dëshiron të bëjë dashuri) dhe fjala "out of sight" (nuk shihet).

Redaktori i *Random House Historical Dictionary of American Slang* thekson se "zhargoni më shumë përdoret në subkultura, të cilat flasin një gjuhë dhe kanë një fjalor fjalësh, që është shenjë e statusit, solidaritetit ose e përfshirjes: ndër to, për shembull, edhe tinejxherët, përdoruesit e drogës, atletët, grupet etnike dhe personelin ushtarak. Aspekti i sjelljes shoqërore që duket se ka prodhuar shumicën e zhargoneve është fjala seks.[14] Në dekadat e fundit, komunikimi masiv e ka shpejtuar në masë të madhe propagandimin dhe përhapjen e zhargoneve dhe ndryshimet aktuale në sjelljet politike, racore dhe ato kulturore janë reflektuar shumë në përdorimin e zhargoneve në dy aspekte: në atë të futjes së zhargoneve të reja në përdorim dhe ndryshimin e kuptimit të frazave të vjetra".[15]

Janë edhe shumë botime të tjera më të lira të fjalorëve të zhargonit shumica e të cilëve mund të gjenden në *Guide to Reference Books*. Ata janë të botuar çdo vit. *The Cassell Dictionary of Slang* (Londër: Cassell, 1999) është një nga ata. Ky fjalor ka mëse 70 000 fjalë dhe shprehje prej shekullit XVI e deri më sot, nga bota e të folurit anglisht. Po ashtu, *Cassell Dictionary* i liston të gjitha web-sajtet.

Fjalorët e gjuhëve të huaja (fjalorët dygjuhësorë)

E Shtypur: The Harper Collins Series, të gjitha të botuara nga Harper Collins of New York and London. Edicione të ndryshme, data të ndryshme, numërime që dallojnë, e kështu me radhë. HarperCollins –Robert French Dictionary, HarperCollins Spanish Dictionary, HarperCollins German Dictionary e të

[14] Fjala me më së shumti ndryshime- dhe me më së shumti faqe (12) gjenden në vëllimin e parë është një fjalë vulgare që fillon me shkronjën F

[15] Books of Times, 18 nëntor, 1997, f. E6. Çdo njëri që dëshiron t'i studiojë zhargonet në mënyrë kulturore dhe historike kështillohet që ta shikojë botimin e mrekullueshëm Swearing: A Social History of Foul Language, Oaths, and Profanity in English (Nju-Jork: Penguin, 1998).

tjerë. Çmimi ndryshon, prej $7.99 për fjalor në
fund të faqes deri në $55.00 për fjalor të plotë.

Lexuesit janë të njoftuar me fjalorët e shtypur tipik dygjuhësorë, të cilët ofrojnë fjalët nga gjuhët e huaja dhe fjalën e njëjtë në gjuhën angleze. Ky proces, më pastaj bëhet në anë të kundërt, ku fjala në gjuhën angleze vjen e para e ndjekur nga fjala e njëjtë në gjuhën tjetër. Përveç se për biblioteka publike, akademike, ose biblioteka speciale, fjalorët dygjuhësorë të shtypur janë mjaft të mirë. Shënimet në *HarperCollins* janë standarde, si fjalorët e njohur të tavolinës. Shumica e shënimeve kanë kaluar nëpër një sërë korrigjimesh nga shumë redaktorë. Shqiptimi i fjalës është i dhënë shumë qartë edhe për ata fillestarë, derisa fjalët e përkthyera në gjuhën tjetër janë të sakta. Gati të gjithë fjalorët përfshijnë zhargone, shkurtesa, idioma dhe më shumë terma të përditshëm nga disa fusha të caktuara. Numri i shënimeve kryesore është nga 40 000 në fund të librave deri në 120 000 ose 13 000 në botime të veçanta.

Janë disa botues me reputacion të fjalorëve gjuhësorë standardë në versionin e shtypur. *Cassell* (nga Sterling Publishing në SHBA); *Random House, Charles Scribner's Sons, Simon and Schuster, Oxford University Press* si dhe *Cambridge University Press* janë vetëm disa nga shtëpitë botuese më të njohura dhe më të besueshme, veprat e të cilave botohen prej France deri në Suahili.

Bibliotekat e mëdha dhe të specializuara kanë fjalorët e vendeve të tjera. *Laroousse* është botues francez i fjalorëve (dhe enciklopedive). Bibliotekat universitare është shumë e mundshme t'i kenë disa nga botimet ose fjalorët dygjuhësorë nga *Larousse,* siç janë *Larousse French Dictionary* ose *Petit Larousse en Couleurs,* një titull që mund të gjendet shpesh në shtëpitë franceze. Fjalorët e tjerë, të njëjtë, mund të blihen nga vendet e tjera.

Personi, i cili dëshiron vetëm fjalë ose frazë nga gjuha e huaj, mund ta gjejë përgjigjen në gati çdo fjalor të tavolinës, si pjesë e fjalorit kryesor ose si një kapitull i veçantë në edicionin special. Mirëpo, kur vjen puna te fjalët më të komplikuara, të sofistikuara, zgjidhja e vetme është që të shikohen fjalorët dygjuhësorë. Edhe ata, të cilët nuk kanë lidhje me gjuhën spanjishte, mund të shikojnë fjalorët e gjuhës spanjishte për shënime më të detajuara nga ato që mund të gjenden në edicionet dygjuhësore. Numri i këtyre personave është duke u rritur gjithnjë. Individët që kërkojnë informacione në gjuhë tjetër nga gjuha e tyre

amtare janë shumë më pak të brengosur, sepse në fjalorët dygjuhësorë zhargonet dhe termat e rrugës nuk gjejnë vend aty. Këtu, *HarperCollins* i nënvizon fjalët e tilla me një yll të vogël. Në fjalorin nga *HarperCollins Spanish Dictionary*, përdoruesi i cili sheh një yll në fjalë do të thotë se "shprehja, edhe pse nuk është pjesë e gjuhës standarde, përdoret nga të gjithë njerëzit e edukuar në një situatë të relaksuar". Tre yje do të thonë "fjalë fyese në të shumtën e rasteve". Shënim: Janë edhe shumë udhëzues dhe enciklopedi, të cilat marrin në trajtim gjuhë të ndryshme. Një ndër më të mirat është edhe: *Encyclopedia of the Language of Europe* (Oxford: Blackwell, 1998) e cila është udhëzues e më se 300 gjuhëve, në përdorimin e tanishëm dhe në atë që nuk flitet më. Po ashtu, duhet shikuar edhe *Dictionary of Languages* (Nju-Jork: Columbia University Press, 1999), një udhëzues enciklopedik i më se 400 gjuhëve ekzistuese.

Ka edhe fjalorë dygjuhësorë digjitalë/elektronikë të gjuhëve të huaja, ndihmës për përkthime, ose edhe mësime nga gjuha. Forma digjitale është e përdorshme në tri situata të ndryshme: (1) për ta dëgjuar shqiptimin e rregullt të një fjale; (2) kur dikush dëshiron të krahasojë ose të gjejë fjalë në më shumë se një gjuhë, dhe (3) kur përdoruesi dëshiron ta shohë vetëm përkthimin e thjeshtë të një fjale specifike nga biznesi, teknologjia, shkenca, e kështu me radhë. Këto dhe programe të tjera përkthyese ofrohen dhe shiten për një çmim më të vogël se $60.

Një numër i madh i CD-ROM-ve ndihmojnë shumë fillestarët për ta bërë hapin e parë drejt njohjes më të mirë të gjuhës. Njëra ndër më të mirët dhe më të lirët është: *Berlitz Passport to 31 Languages* (Nju-Jork: Learning Corporation, 1999 e deri më sot, $30 për tre disqe). Kjo është shumë e mirë për punë referenciale, nëse jo për individët që u nevojiten një ose dy gjuhë në CD. Për secilën nga gjuhët janë rreth 2 500 fjalë kryesore, të cilat tregohen në ekran. Këtyre iu shtohen edhe 300 fraza, prej porositjes së ushqimit deri te gjetja e banjës. E gjithë kjo mund të mësohet prej fjalorëve arabë, kinezë, turk e deri te ai vietnamez. Mësimi se si duhet pyetur për një gotë ujë në 31 gjuhë hyn shumë në punë, natyrisht, për atë i cili mundohet që të bëjë bisedë në tavolinën e bukës në një aheng.

Natyrisht, mund të vijë dita kur udhëtari mund të bartë me vete vetëm një incizues, i cili do ta marrë fjalën në gjuhën e huaj, do ta përkthejë atë dhe do t'i japë atë në gjuhën angleze shfrytëzuesit. Mirëpo, nevojitet edhe shumë kohë për këtë. "Asnjë përkthyes nuk do ta humbë vendin e punës

për shkak të një makine përkthyese, as edhe në të ardhmen e parashikuar, thotë eksperti në qendrën e sistemit të kompjuterëve dhe i kompanisë këshilluese"[16]. Në të njëjtën kohë, kompjuteri mund ta ndihmojë personin joprofesional në atë rast kur makina është një udhëzues jo i mirë dhe nuk jep përkthimin përfundimtar.

Në Internet (web-sajt)

Është një numër mjaft impresiv i fjalorëve nga gjuha angleze-në gjuhë të huaj ose nga një gjuhë e huaj-në gjuhën angleze, të cilët ofrohen në Internet. Shumica e këtyre web-sajteve janë punë e dijetarëve dhe janë web-sajte shumë të besueshme. Në fakt, një përparësi e Internetit është ajo se ka një numër të madh të fjalorëve dygjuhësorë, në gjuhë pak më të vogla, e po ashtu edhe të atyre të mëdha si frëngjisht, gjermanisht, anglisht etj.

The Michigan Electronic Library. Fjalorët nga *Specific Language* (http://mel.lib.mi.us/reference/REF-dict.html) është vendi më i mirë dhe numër një për gjuhë e huaj-anglisht, fjalor që ofrohet në Internet. Gati rreth 24 fjalorë janë të listuar sipas radhës alfabetike dhe janë të dhënë edhe linkat për të gjithë ata. Atëherë kur fjalorët e rinj ofrohen në Internet, këta fjalorë të rinj futen në listë. Derisa kërkimi ndryshon nga titulli në titull, në shumicën e këtyre fjalorëve nuk duhet shkruar më shumë se fjalën (në gjuhën angleze ose në gjuhë të huaj). Si rezultat, definicioni dhe fjala në gjuhën e dytë jepet dhe shihet në ekran. Një web-sajt mjaft i mirë për gjuhë më pak të njohura, duke filluar nga Bjellorusia deri te Suahili.

Shënim: web-sajte të njëjta: *Language Dictionaries and Translators* (http://rivendel.com/?ric/resources/dict.html) jep një listë të mirë të fjalorëve Online më linka të përkthyesve. Kjo listë ndryshon në varësi nga puna e *Icelandic Translation Center,* që është një fjalor, i cili liston 202 fjalë gjermane dhe fjalët e njëjta në austrialisht. Edhe pse është goxha i përzier

[16] The New York Times, 30 prill, 1998, f.G7. Sikurse edhe ky artikull që e bënë të qartë, as reklamimi dhe publiciteti nuk përkthehen mirë nga software-et përkthyes. Për shembull, reklama nga M&Ms "Melts in your mouth not in your hands" (Shkrihet në gojën tënde, e jo në duart tuaja) në frëngjisht kalon në "Funtes dans votre bouche, pas dans des vos mains", që do të thotë "Pig iron and cast iron in your mouth, not in your hands". (Gizë në gojën tënde, e jo në duart tuaja), pra diçka krejt ndryshe.

dhe konfuz, është një ndihmë e mirë.

Vendi më i mirë për të parë kur është fjala për fjalorë të gjuhëve të huaja në Internet është *Eurodicautom* (www.2.echo.lu/edic). ECHO, Komisioni Evropian i Organizatës Mikpritëse (European Commission Host Organization) e cila është degë e komunitetit evropian, ofron një fjalor unik. I quajtur si "shoku më i mirë në Internet i përkthyesit" ofron gjetjen e fjalës së njëjtë të një fjalë në një gjuhë tjetër. Shënimi në gjuhën angleze mund të jetë "book" (libër) ndërsa në atë gjermane "buchen". Disa dhjetëra gjuhë ofrohen këtu. Përdoruesi mund të shkruajë fjalën "book" në frëngjisht e ta marrë përgjigjen për fjalën e njëjtë në spanjisht. Këtu ofrohen edhe shumë shërbime të tjera, duke filluar nga FAQs i zakonshëm deri te "forumet për diskutime".

Wordbot. Washington University (www.cs.washington.edu/homes/kgolden/wordbot.html). Termi "wordbot" do të thotë "roboti asistues për të parë përkthimet, definicionet, sinonimet, antonimet, referencat etj., të fjalëve që shfaqen në dokument". Theksi kryesor këtu është në shikimin e fjalëve në gjuhët standarde evropiane prej italishtes deri te spanjishtja. Ju mund të shikoni definicionet, e po ashtu edhe fjalët prej gjuhës angleze në atë gjermane dhe prej gjermanishtes në atë spanjolle etj. Ky sistem ofron dhe bën shumë më shumë, mirëpo për përdoruesin e zakonshëm dhe mesatar, përkthimet dhe definicionet këtu janë më se të mjaftueshme.

Now ePals.com është një web-sajt i edukimit te (www.epals.com). Kjo ka një qasje të veçantë për fansat e mëdhenj dhe me interes të posaçëm në e-mail. Në këtë web-sajt, përdoruesi mund ta shkruajë mesazhin në gjuhën angleze e më pastaj ta ndërrojë atë në gjuhë të tjera, si në frëngjisht, gjermanisht, japonisht, italisht, spanjisht, ose portugalisht, pra e përkthen mesazhin nga gjuha angleze në gjuhë të tjera. Sponsori i këtij web-sajti thotë se ky është shërbim i parë në Internet, sa i përket përkthimit të e-mail-ave. Po ashtu, duhet të merren parasysh edhe veçoritë e tjera që ofron ky shërbim: emrat e shkollave me programet në gjuhët e huaja në 182 vende dhe me materiale nga dijetarët, që kanë lidhje me përkthimet dhe me kulturat, jashtë Shteteve të Bashkuara.

Alta Vista Translation Services (www.babelfish.altavista.digital.com) ka një program të ngjashëm. Këtu, ju mund të shënoni letër, shënim, ose një novelë në gjuhën angleze e më pastaj ta konvertoni atë në ndonjë gjuhë tjetër. Asgjë më shumë sesa të shkruash atë që dëshiron ta përkthesh. Të gjitha gjuhët kryesore janë të përfshira këtu. Për shembull, ju mund të

lëvizni nga frazat në gjuhën frënge në ato angleze, ose nga një fjali në gjuhën angleze në një në gjuhën gjermane etj. Duhet thënë se përdoruesi duhet të jetë i kujdesshëm në disa raste, ku ka edhe përkthime të çuditshme. Megjithatë, çmimi i lë mënjanë shprehjet, fjalët ose frazat që kanë më shumë se një kuptim.

Një web-sajt i ngjashëm është edhe: *E-Lingo* (www.e-lingo.com), e cila nuk është aq e mirë sa edhe *WebTranslator* ose *AltaVista,* mirëpo prapëseprapë mund të përdoret si një kontrollues në rastin e fjalëve të vështira.

The Human-Language Page (www.june29.com/htp). Ky është një link me web-sajte të fjalorëve historikë dhe linguistikë, ata modernë dhe ata antikë. Edhe pse në radhë të parë u dedikohet gjuhëtarëve, ky web-sajt ofron dyer të hapura për t'i parë fjalorët, më pak të njohur, të gjuhëve të huaja, përkthime dhe informata në më se 50 gjuhë të ndryshme.[17]

Fjalorët tematikë

Fjalorët mbi një subjekt të veçantë shpjegojnë kuptimin e posaçëm të një fjalë të posaçme në kuptimin e profesionit, ose fushave që janë me interes për subjektin. Në të kundërtën, natyrisht, shumica e materialit mund të gjendet në fjalorët e pashkurtuar dhe ata të tavolinës, të cilët rregullisht freskohen me fjalë të reja dhe tregojnë një interesim në futjen e termave të rinj.

Derisa të gjitha pikat e vlerësimit për fjalorët e tjerë vlejnë edhe për këta fjalorë, janë edhe disa aspekte të tjera, të cilat duhet shikuar me kujdes. Pyetja më e madhe që duhet të bëhet, atëherë kur vendosni se cilin fjalor të subjektit duhet blerë është kjo: A ofron ky fjalor diçka që nuk mund të gjendet në fjalorët standardë të bibliotekave? Është mjaft befasuese, me theks të veçantë në shkencat sociale dhe humanitete, se sa shumë informacione që duhen ofruar, tashmë edhe në fjalorët e përgjithshëm të anglishtes. Po ashtu:

1. A janë ilustrimet me vend dhe a i ndihmojnë specialistit apo personit jo profesional? Kur një vepër teknike i dedikohet një audience mesatare dhe jo profesionale, duhet të ketë edhe një numër të diagrameve,

[17] Shënim: Për të parë më shumë web-sajte shiko revistën Yahoo! (prill, 1999, f. 129).

fotografive, ose formave të tjera të artit grafik, të cilat do ta bëjnë më të lehtë kuptimin e termave.

2. A janë definicionet thjeshtë fjalë të shkurtra apo është bërë përpjekje për të dhënë kuptimin dhe shpjegimin e plotë të fjalës në kontekstin e subjektit?

3. A është fjalori i dedikuar për një audiencë ndërkombëtare, apo i dedikohet vetëm audiencës amerikane? Kjo është një pyetje mjaft e mirë për shkencëtarët. Disa botues e kanë plotësuar këtë nevojë, duke ofruar fjalorë dygjuhësorë shkencorë.

4. A janë termat aktualë? Përsëri, kjo është e domosdoshme në shkencë, e deri diku më pak në fjalorin e shkencave sociale dhe në studimet e humaniteteve.

Shumica e fjalorëve tematikë duken si enciklopedi, në kuptimin e informatave dhe të prezantimit. Përdoret e njëjta formë specifike e shënimeve, mirëpo shënimet në fjalorë mund të jenë më shumë sesa definicione të thjeshta.

Janë disa qindra e mijëra fjalorë të subjektit në gjuhën angleze, duke filluar nga *Microsoft Press Computer Dictionary* (Renton, WA: Microsoft, 1999 e deri më sot. Rregullisht e freskuar me informata) deri te *The Oxford Classical Dictionary* (edicioni 3. Oxford: Oxford University Press, 1997). Shënimet përshkruese mund të gjenden në fjalorin e fundit *Guide to Reference Books* dhe *Guide to Reference Materials*. Ju vetëm duhet të emëroni një profesion, hobi, ose një tregti dhe menjëherë do të shihni se ka fjalorë të veçantë për të.

Në Internet

Zakonisht në Internet mund të gjenden fjalorët standardë, por studentët duke i pasur fjalorët e tyre specialë, ndoshta do të ishte më mirë të fillonin me *Ultimate Silicion Slang Page* (www.sabram.com/site/slang.html), e cila definon dhe i jep kuptim zhargoneve të tilla si "idea hamsters", pra njerëzit të cilëve idetë u lëvizin më shpejtë se brejtësit: "Ai djalë është një 'idea hamster' i vërtetë". Një fjalor më aktual në version e shtypur në këtë fushë është edicioni 3 i *The New Hacker's Dictionary* (Cambridge: MIT Press, 2000), pra një vend i mrekullueshëm për ata që mësojnë shumë.

Tani vijnë me radhë edhe fjalorët e tjerë, që ofrohen falas në Internet. Për të gjetur lloje të tjera të fjalorëve të subjektit, nuk duhet bërë shumë pasi botuesit zakonisht vetë i tregojnë ata fjalorë. Duhet pasur parasysh se

shumica e këtyre fjalorëve që ofrohen ose janë pak të besueshëm në atë se këta fjalorë ofrohen nga individë me shkollim të ndryshëm, ose mund të ketë raste edhe kur ofrohen në Internet edicionet e para të fjalorëve pa të drejta autoriale.

Dy shembuj janë dhënë këtu, mirëpo të tillë ka edhe shumë:

One Look Dictionary (www.onelook.com.) Ky web-sajt komercial ofron një shumësi të madhe të fjalorëve të subjektit (rreth 300 me më se 1.75 milionë fjalë), duke filluar nga sporti e religjioni. Përdorimi i tij është mjaft i lehtë. Zgjedh një subjekt të caktuar dhe më pas nën të mund të gjenden fjalorët. Kur dihet fusha e interesimit, që ju duhet juve, shënoni fjalën ose fjalët dhe shërbimi do të tregojë sasinë e çifteve në fjalorë të tjerë të subjektit. Definicionet janë të shkurtra, por të sakta dhe përfshijnë të gjithë fjalorët që e kanë atë fjalë. Shumica e këtyre fjalorëve janë Online dhe vetëm disa nga ta janë në versionin e shtypur ose në CD-ROM. Si rezultat i kësaj, shumë fjalorë mund të mos kenë më shumë se 980 deri 1 000.

Free On-line Dictionary of Computing. Dennis Howe (http://foldoc.doc.ic.acouk/foldoc/index.html). Ky është një fjalor i ndërtuar nga kontribuesit, i cili ndjek metodat e zakonshme të kërkimit, pra me përdoruesin, duke shënuar fjalën që i nevojitet. Duhet të merret parasysh edhe fakti se ky fjalor është i kufizuar në termat e kompjuterëve dhe nuk është një fjalor i përgjithshëm. Ka definicione dhe materiale nga shënimet e ngjashme. Ky web-sajt mbahet nga njerëz në Britani të Madhe dhe disa nga fjalët dhe definicionet, nga më se 700 kontribues të FOLDOC, në disa raste mund edhe t'i mos i plotësojnë kërkesat e njerëzve nga Amerika e Veriut.

Shkurtimet dhe akronimet

E shtypur: Acronyms Initialisms, and Abbreviations Dictionary, Farmington Hills, MI: Gale Group. E freskuar rregullisht me informata. 3 vëllime. Çmimi ndryshon.

Udhëzuesi primar në këtë fushë është publikimi nga kompania *Gale*. Ky publikim i ka tri vëllime. Vëllimi i parë ka më shumë se 520 000 shënime për akronimet, inicialet dhe materiale të ngjashme. Këto janë të radhitura sipas alfabetit, ku më pas jepet definicioni i plotë i termit. Fokusi

kryesor është në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mirëpo janë të përfshira edhe akronimet nga Evropa Perëndimore. Vëllimi i dytë është një vëllim më i shkurtër, apo një edicion shtesë, që u botua në mes të botimit të parë dhe atij të tretë. Në të janë futur më se 15 000 akronime të reja në dy sekuenca, sipas akronimit dhe sipas kuptimit. Vëllimi i tretë është "i ndryshëm" "i kundërt" me vëllimin e parë. Këtu duhet të shikohen më se 520 000 shënime për ta gjetur një akronim. Për shembull, lexuesi do ta kërkonte këtu akronimin për *Dictionary of American Regional English* (DARE).

Një version më i shkurtër është fjalori nga *DeSola,* i quajtur *Abbreviations Dictionary* (Nju-Jork: disa edicione), i cili ka diku rreth 180 000 shënime dhe kushton $65.

Fjalëkryqi

CD: Webster's Official Crossword Puzzle Dictionary. Springfield, MA: Merriam- Webster, Inc., 1992, freskime të parregullta me informata. $29.95.

E Shtypur: 1992. Në fund të faqes, $4.99.

Versioni CD-ROM i fjalorit tipik të fjalëkryqit lejon shënime nga: (1) fraza ose definicioni që përdoret në fjalëkryq ose (2) nga një fjalët e caktuara. Në të vërtetë, kur shikohet versionin CD-ROM, atëherë vërtet nuk ia vlen për të bërë fjalëkryqe. Në fakt, ata që i bëjnë fjalëkryqet thonë se fjalori nuk duhet konsultuar apo këshilluar në raste të tilla. Mirëpo, kur jeni bllokuar dhe jeni nervozuar për arsye se nuk po mund ta plotësoni fjalëkryqin, atëherë zgjidhja e vetme është hapja e fjalorit për të parë sinonimet dhe antonimet. Ndihmesat, pra shënimet tipike, janë të listuara sipas rendit alfabetik në veprat e shtypura me fjalët kryesore për t'u plotësuar në kuti. Shumë pak i lihet rastit dhe një eksperiment tregon se prej 50 % deri 70 % e dyshimeve që i ka lexuesi kur mbush fjalëkryq mund të gjenden këtu.

Sugjerime për të lexuar

Appleyard, Bryan, "e-English Rules the Waves", The Sunday Times, 19 mars, 2000, f. 47-49. Një analizë e hollësishme e Oxford English

Dictionary-Online, e cila tregon historinë dhe lëvdatat që i bëhen aktualisht këtij fjalori.

Arnold, Martin, "Loved Strictures in a Lenient Age", The New York Times, 24 qershor, 1999, E3. Këtu bëhet analiza dhe jepet historia e një prej udhëzuesve më të famshëm të përdorimit të gjuhës amerikane: William Strunk dhe E.B. White The Elements of Style (Nju-Jork; Allyn & Bacon, 1999). Edicioni i katërt është i bazuar në veprën origjinale nga viti 1999. A është e famshme? Paj, deri kah fundi i vitit 1999, u shitën deri në 10 milionë kopje- në radhë të parë për studentët e kolegjeve dhe të shkollave të mesme.

Deam, Paul, "Opening the Billgates", The Times Literary Supplement, 1 tetor, 1999, f. 3-4. "Encarta i ka disa thënie të mira". Dhe, shumica prej tyre duke u bazuar në këtë kritik janë të krekosur. Dean beson se ka dështuar si fjalor dhe është shndërruar në një enciklopedi konfuze. "As fjalori e as enciklopedia nuk janë edhe aq të besueshme". Kjo analizë nuk është fort e rëndësishme për gjykimin e fjalorit sa është me vlerë për metodat e përdorura dhe metodologjinë në të - një metodologji, e cila mund të përdoret për ta vlerësuar çdo fjalor.

Hullen, Werner. English Dictionaries 800-1700. Oxford: Clarendon Press, 1999, f. 525. Një histori, e cila mbulon gati çdo zhvillim të madh dhe të vogël në fjalorët e gjuhës angleze prej shekullit I deri në shekullin XVIII. Stili i tij është pak si i qytetëruar dhe detajet janë të shumta e të lodhshme, por asnjë burim tjetër nuk përfshin dhe nuk mbulon kaq shumë materiale.

"In the Dictionary Game", The New York Times, 22 gusht, 1999, f. WK7. Si vendosin botuesit e fjalorëve se cilat fjalë të reja duhet të futen në fjalorët e tyre? Fuqia dhe historia ndihmojnë në këtë por ka edhe disa rregulla të tjera. Këto rregulla janë të shtjelluara me shumë shembuj nga botuesit e pesë fjalorëve kryesorë të tavolinës.

Johnson, Paul, "Want to Know Us? Watch our Lips", The Spectator, 1 prill, 2000, f. 43-44. Çka e bën anglez një person", pyet ky historian. Përgjigjja: Gjuha, e cila e ka treguar poentën e saj duke u bërë gjuhë globale e jo e kufizuar, vetëm në vendet që flasin gjuhën angleze.

Johnson ndjek zhvillimin e gjuhës nëpërmes shkrimtarëve të saj dhe fjalorëve.

Willinsky, John, Empire of Words: The Reign of the O.E.D., Princton, NJ: Princeton University Press, 1995. Thelbi kryesor i kësaj historie fascinuese të OED është fakti se kjo është më shumë sesa një katalog i gjuhës angleze. Ishte pjesë e një procesi të ndërtimit të kombit. "Shfaqet në periudhën e perandorisë, në të cilën Britania e Madhe po influenconte botën në të gjitha aspektet".

Winchester, Simon, The Professor and the Madman: A Tale of Murder, Insanity and the Making of the Oxford English Dictionary. Nju-Jork: Viking, 1998. Një tregim i mrekullueshëm, që është i vërtetë dhe flet për një vrasës paranoik dhe leksikograf, i cili i kalon 40 vjet në burg. Një kohë e gjatë ai e kalon në bibliotekën e tij personale në qelinë e tij, ku punoi mbi tezat, historinë dhe definicionet e fjalëve për fjalorin Oxford English Dictionary. Biografia më e shitur u futi frikën dijetarëve, të cilët panë edicionin e parë të fjalorit gjatë 70 vjetëve të botimit të tij.

KAPITULLI XI

BURIMET GJEOGRAFIKE

Ata që merren me gjeografi e quajnë "renesancë gjeografike". E mbështetur në zbulimet e reja në shkencë dhe në kompjuterë, gjeografia është bërë, jo vetëm disiplinë në vete, mirëpo edhe një urëlidhëse ndërmjet disiplinave të tjera. Një kuptim i asaj se çka mund të bëhet me harta, sondazhe, studime dhe automatizime "i shtyjnë njerëzit që t'i lidhin idetë e tyre, gjë që nuk do ta bënin në të kundërtën", thotë profesori i Harvardit.[1]

Theksi akademik i gjeografisë në fund të viteve të '90-të erdhi pas 50 vjetëve të neglizhencës. Shumë universitete i kishin eliminuar departamentet ose katedrat e gjeografisë dhe studentët që studiuan pas viteve '60-të shumë rrallë kishin pasur të bënin me principet e gjeografisë. "Gjeografia ishte një art nëse t'i punon në Rand McNally ose luan lojën 'jeopardy'". Por, kur dijetarët amerikanë shtronin pyetje të vazhdueshme si p.sh. pse industrializimi filloi së pari në Evropë e jo në Kinë apo në Indi, gjeografia ishte ajo, e cila e shpjegonte këtë mëdyshje.[2]

Në dhënien përgjigje në këto dyshime, ju mund të përdorni materiale edhe nga epidemiologjia, sociologjia, zoologjia, antropologjia, botanika dhe historia, mirëpo shumë qartë gjeografia është çelësi për ta zbuluar enigmën. Një njeri mund të thotë se kultura evropiane e bazuar në krish-

[1] David Landes, i cituar në The New York Times, 21 mars, 1998, f. B7.
[2] Ibid.

terizëm dhe hebraizëm dhe vlerat e periudhës së përndritjes janë arsyet kryesore për suksesin ekonomik të Perëndimit. Në të njëjtën kohë, studenti duhet të llogarisë edhe në gjeografinë e një vendi sikurse edhe të reshurat që garantojnë të korra të bollshme. Dijetarët nuk pajtohen se faktori gjeografik është faktori më i rëndësishëm. Fakti është se gjeografia tani është vënë në qendër të diskutimeve të tilla.

Gjeografia është, në pjesë të madhe, pjesë e koleksioneve referenciale të një biblioteke. Përveç librave që gjenden në raftet e bibliotekave e që janë një koleksion në lidhje më një subjekt të caktuar, seksioni i referencave fokusohet në harta dhe në atlase. Ka edhe gjëra të tjera në këtë koleksion, duke filluar nga indekset e deri te librat e udhëtimit dhe revistat.

Baza e të dhënave me informacione gjeografike

Programet digjitale me informacione gjeografike janë shumë të shpeshta në ditët e sotme. Softuerët e shumtë lejojnë analizimin e të dhënave dhe ofrojnë edhe lidhje për lokacione specifike. Kjo i mundëson shfrytëzuesit të gjejë lagjen më të mirë të mundshme për hapjen e një picerie ose të një shtëpie të operës. Informacionet e censuruara qeveritare, të futura në programet gjeografike u ndihmojnë kompanive që të vendosin për mundësitë e shitjes së produkteve të tyre. Softuerët me regjistrimet e përgjithshme u lejojnë shfrytëzuesve që ta përdorin opsionin zoom (afrim) në kontinente, vende, shtete, qytete dhe seksione më të vogla të një qyteti, si për shembull një ndërtesë ose një bllok banesor. Mund të përdoret për të ndjekur dhe për të vëzhguar çdo gjë, duke filluar nga trendët popullore deri te numri, mbulesat e ndryshme.

Bashkimet formale dhe ato joformale ndërmjet hartografëve dhe botës së të dhënave kanë paraqitur një lloj të ri të bibliotekës, e cila është në përkujdesje qendrore (“geografical information managment”) dhe që mund ta përdorë edhe sistemin e të dhënave të quajtur “geografical information system” (GIS). Kjo lloj e bibliotekës përfshin informacione teknologjike dhe ato të politikës. Kjo bibliotekë është në gjendje të japë informata të dorës së parë dhe të besueshme në çdo gjë, prej listës komplete të fabrikave që gjenden në San Francisko e deri te sugjerimet për zbutjen e probleme në trafik në Nju-Jork. Mundësia për të krijuar harta në terminalin e kompjuterit e po ashtu edhe pasjen për objektiv kryesor grupet e ndryshme nga klasa e lartë shoqërore në një qytet ose regjion,

të cilat familje ose grupe do të ishin të interesuara për të blerë produktin X ose Y, jep një dimension të ri grafikeve, raporteve të shkruara dhe hartave. Po ashtu, shfrytëzuesi mund t'i vë në hartë edhe nevojat arsimore, medicinale dhe profesionale për një qytet, vend ose regjion të caktuar.

Ana e errët

Është edhe ana tjetër te ky këndvështrim optimist i hartave. "Fatkeqësia e Galipolit, fushata e parë në Luftën I Botërore, në të cilën humbën jetën 42 000 trupa nga forcat e aleatëve, ishte shkaktuar në masë të madhe nga kualiteti i dobët i hartave, të cilat ishin përdorur nga oficerët... trupat në terren nuk e kishin as idenë më të vogël se si ishin të shtrira forcat turke në terren. Oficerët u besuan hartave prej udhëzuesve turistikë, të cilat ishin së paku 10 vjet të vjetra".[3]

Rregullativat e Qeverisë ruse mbi publikimet e rrejshme të hartave (me rrugë të gabueshme, qytetet e vendosura në vende të gabuara e madje edhe me emra gabim) thuhet se kanë bërë shumë në ndaljen e forcave gjermane gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në vitin 1999, drejtori gjeneral i Agjencisë së Inteligjencës Amerikane (CIA) tha se CIA e kishte goditur gabimisht Ambasadën Kineze në Beograd gjatë sulmeve ajrore të NATO-s mbi Jugosllavinë. Aksidenti ishte shkaktuar si pasojë e mungesës së hartave. "Dy harta komerciale jugosllave prej 1989 dhe vitit 1996 dhe një e botuar në Shtetet e Bashkuara në vitin 1997 ishin përdorur në këtë rast. Asnjë nga këto harta nuk e tregoi lokacionin aktual të Ambasadës Kineze, e cila ishte ndërtuar në vitin 1996. Vetëm pasi fatkeqësia ndodhi, CIA u fut në dokumentet e saj dhe e vendosi lokacionin e Ambasadës Kineze".[4]

Dhe, ende...

Çuditë gjeografike, që u thanë më lartë, shumë rrallë mund të hasen nga një bibliotekar i përgjithshëm. Në shumicën e bibliotekave, pyetjet gjeografike janë më të zakonshme: "Ku mund ta gjejë hartën e (këtij apo atij shteti, qyteti, vendi etj,)" ose "Ku është i pozicionuar qyteti Albany, ose Oregon?" ose "Sa larg është në mes Londrës, Ontarios dhe

[3] The Sunday Times, (Londër), 21 mars, 1999, f. 12.
[4] "In a Fatal Error..". The New York Times, 23 qershor, 1999, f. 10.

Hamiltonit?" Atlaset standarde, hartat e rrugëve dhe vepra të këtilla bazike referenciale ofrojnë përgjigje të gatshme.

Burimet gjeografike mund të përdoren edhe në nivelin e rëndomtë. ("Ku është?") ose në mënyrë më të sofistikuar të ndihmojë në sqarimin e lidhjeve ndërmjet shkencave humane. Bibliotekarët e referencave i dinë mirë këto dy qasje. E para, dhe më e shpeshta, është pyetja tipike mbi atë se ku gjendet lokacioni i këtij ose atij vendi, distanca ndërmjet pikës X dhe Y, dhe çfarë lloji të rrobave do të nevojiten nëse udhëtoni në Itali në dhjetor. Duke u zhvendosur nga mëdyshjet me referenca të gatshme, ju do të përfshiheni në marrëdhëniet që kanë të bëjnë me klimën, ambientin, mallrat, kufijtë politikë, historinë dhe çdo gjë tjetër, në të cilën janë të interesuar gjeografët.

Kur një bibliotekar pyetet që ta identifikojë dhe ta gjejë një qytet ose një shtet, ky bibliotekar ka pak vështirësi që ta kombinojë pyetjen me burimin. Zakonisht, përgjigjja e saktë gjenden në atlas, hartë individuale, ose në një përmbledhje me të dhëna gjeografike, të cilat mund të ofrohen edhe në versionin CD-ROM ose në baza të të dhënave Online. Nëse bibliotekari pyetet që t'i tregojë elementet e njëjta ose të përbashkëta të njerëzve nga Filipinet dhe ata nga Eutopia, bibliotekari duhet të shikojë burimet gjeografike dhe veprat e ngjashme, të cilat në disa raste mund të jenë nga Statesman's Yearbook dhe një enciklopedi deri te periodikët dhe indekset nga buletinët që kanë të bëjnë me ngjarjet aktuale. E më pastaj, bibliotekari duhet të bëjë kërkim në tekstet gjeografike dhe studimet individuale ekonomike, historike e politike.

Nëse bibliotekari i referencave mendon se atlasi ose harta është qendra e vërtetë, në të cilën mund të gjenden më shumë përgjigje se në veprat e tjera referenciale, atëherë burimet gjeografike janë të një vlere të vërtetë. Ky lloj i përdorimit është i kufizuar në bibliotekat e mëdha dhe përdoret vetëm nga grupe të vogla njerëzish, të cilët pyesin më shumë sesa si mund të gjendet një hotel në Paris ose Peoria. Mirëpo, është e rëndësishme se kufijtë e kësaj qasje do të zgjerohen sa më shumë që bota zvogëlohet dhe pasi ekonomia dhe udhëtimi janë duke u përhapur shumë.

Mary Larsgaard, e cila është e mësuar me dyshimet e përditshme gjeografike edhe ato teknike, e përmbledh këtë problem kështu:

Duke dashur të vendosësh se cilat referenca duket t'i kesh, kjo është një gjë që varet nga interesat dhe nevojat e shfrytëzuesit. Bibliotekat publike që u shërbejnë një numri më të madh të klientëve dëshirojnë më shumë atlase

themelore, fjalorë dhe burime të tjera të shtypura e në forma të tjera, e po ashtu edhe harta rekreative, harta të shteteve e lokacioneve dhe udhëzues të rrugës për vende që janë metropol, të cilat zakonisht janë të botuara nga firmat komerciale. Bibliotekat akademike kërkojnë materiale më të specializuara, që i mbështesin plan-programin e tyre dhe nevojat e kërkimit të stafit të tyre. Me disa përjashtime- më së shumti në atlase (ku emrat si National Geographic, Rand McNally dhe Times/Bartholomew predominante)-shumica e publikimeve në këtë fushë janë të përgatitura dhe të botuara nga qeveritë federale, shtetërore ose ato lokale.[5]

Burimet gjeografike

Pa marrë parasysh formatin, titujt gjeografikë që përdoren në referencat e gatshme, mund të kategorizohen dhe ndahen në tri kategori të mëdha: në harta dhe atlase, fjalorë gjeografikë dhe udhëzues.

Hartat dhe Atlaset. Një hartë është, ndër gjërat e tjera, përfaqësim i disa kufijve të caktuar të tokës (ose po ashtu të hënës dhe planeteve) dhe ne në të shumtën e rasteve mendojmë për to si një sipërfaqe e rrafshët. Hartat mund të ndahen në grafike, koleksione të hartave në formë të atlaseve, globeve, e kështu me radhë. Hartografët u referohen këtyre si harta të përgjithshme, pra harta që përdoren atëherë kur kemi të bëjmë me referenca të përgjithshme.

Harta fizike i ka në vete veçoritë e shumta të tokës, prej lumenjve dhe luginave deri te malet dhe kodrat. Harta e rrugëve i tregon rrugët, hekurudhat, urat etj. Harta politike zakonisht është e kufizuar në kufij (p.sh. të qyteteve, shteteve, vendeve) mirëpo, mund të përfshijë edhe shënime topografike dhe atyre të rrugëve. Pa marrë parasysh a janë të ndara apo jo, këto tri lloje të hartave i përbëjnë një numër tjetër të madh të hartave, të cilat mund të gjenden në atlaset e përgjithshme.

Hartografia është art i bërjes së hartave, ku problemi më i madh i atyre që i bëjnë këto harta është arritja e prezantimit të saktë të veçorive të tokës në këto harta. Kjo detyrë ka rezultuar në shumë projeksione dhe në shumë metoda, të cilat përdoren për të treguar ose shfaqur sipërfaqen e një sfere mbi një planet pa shtrembërim.

[5] Mary Larsgaard, "The World at Your Fingertips: Map Resources", Library Journal, qershor, 1999, f. 57. Kjo bibliografi me shënimet themelore zakonisht shfaqet çdo vit në Library Journal në kohë të njëjtë.

Merkatori dhe sistemi i tij i ndarë në katër pjesë, që ende është ndër më të mirët, është i bazuar në vijat paralele; pra në latitudën-gjerësinë (vijat që masin gjerësinë e globit ose distanca këndore veriore ose jugore nga Ekuadori) dhe në latitude-gjatësinë (vijat që masin gjatësinë e globit, ose distancën këndore lindje ose perëndim në sipërfaqen e tokës). Ky sistem ka sukses të plotë, përveç në regjionet polare, ku i shtrembëron faktet. Kështu, pra, në çdo projektim Merkatori, Grenlanda është komplet në proporcion të zhdrejtë me Shtetet e Bashkuara. Pas Merkatorit, janë disenjuar disa mijëra projektime. Por, shtrembërimi i fakteve është gjithmonë i pranishëm dhe evidentë - nëse jo në një seksion, atëherë në tjetrin. Për shembull, projeksioni shumë i lavdëruar i azimutal ekuidistant me Polin Verior, në qendër të hartës, tregon drejtimet dhe distancat shumë më saktë, mirëpo i jep shumicës së globit zgjatime të pazakonshme dhe pamje të zgjeruar.

Prezantimi i vetëm, i saktë, grafikë i tokës është globi. Nevoja për një glob në një situatë referenciale ndoshta vihet në mëdyshje. Bibliotekari i referencave, i cili ka pasur raste kur ka përdorur një glob në vend të një harte për t'u përgjigjur në një pyetje reference, është në të vërtetë shumë i rrallë.

Hartat e përgjithshme japin një numër të madh të informatave për lokacionin, i cili mbulohet nga ajo hartë. Po ashtu, tregohen qytetet, rrugët, hekurudhat, kufijtë politikë dhe elemente të tjera kulturore. Veçoritë fizike, duke filluar nga malet e deri te lumenjtë janë të vizatuara. Relievi zakonisht tregohem me hijesime, në kontrast ose me ngjyrë.

Në radhë të parë, bibliotekat blejnë atlase, ose koleksione të hartave. Bibliotekat e tjera, që kanë shumë materiale, përfshijnë edhe harta të rrafshta dhe ato në letër, sikurse ato që distribuohen nga Shoqëria Nacionale e Gjeografisë ose harta tradicionale të shteteve, regjioneve ose rrugëve.

Një grup tjetër i madh i hartave quhen harta tematike për arsye se ato fokusohen më shumë në një aspekt të veçantë gjeografik. Referencat këtu zakonisht janë nga çështjet historike, ekonomike e politike, të cilat mund të tregohen gjeografikisht në hartë. Një shembull: *The Times Atlas of World History*.

Shënim: Kur flasim për hartat e rrafshta, atlaset, hartat e relievit, e madje globet, mendohet që lexuesi e di që shumica, nëse jo të gjitha, ofrohen edhe në formatin elektronik. Mirëpo, përmbajtja mbetet e njëjtë, pa marrë parasysh formatin.

Gazetters. Gazetters janë fjalorët gjeografikë, zakonisht me emrat e vendit. Këto burime shfrytëzohen atëherë kur dikush dëshiron ta dijë se ku është e vendosur një qytet, lum, mal ose diç tjetër. Fjalorët gjeografikë të detajuar japin informacione shtesë mbi popullatën dhe mundësisht karakteristikat ekonomike të asaj krahine ose vendi.

Udhëzuesit. Nuk duhet ndonjë definicion ose fjalë të tjera për udhëzuesit; ata ofrojnë informacione në çdo gjë prej çmimit të një dhome të motelit në Paris ose Kanzas, SHBA, e deri te atraksionet më të mira dhe më interesante të Nju-Jorkut ose Londrës.

Hartat e qeverive dhe ato lokale

Së paku 90 % e hartave të botuara, çdo vit, vijnë nga burimet qeveritare. Këto harta ofrojnë dhe japin detaje të shumta mbi çdo vend të botës, me theks të veçantë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Departamenti i hartave "blerja më e mirë" (best buy) janë ato harta, të cilat ofrohen falas në Internet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (këto harta shpjegohen më shumë në faqet në vijim). Për një pasqyrë më të mirë të asaj se çka ofrohen dhe është e gatshme, shiko *Manual of Federal Geographic Data Products* (http://www.fgdc.gov/fgpd/title.html). Këtu përfshihen informata prej agjencioneve të shumta si Departamenti (Ministria) i Tregtisë dhe Departamenti i Mbrojtjes.

Sondazhi gjeologjik i SHBA-së (USGS) ka një program të vazhdueshëm të botimeve, prej ku shumë bibliotekarë i marrin hartat e botuara. Hartat janë të detajuara, të cilat përfshijnë përmirësimin, vegjetacionin dhe aspektet kulturore. Divizioni Nacional i Hartave që është pjesë e USGS ofron informacione të hartave për bibliotekën, sikurse që bën edhe Qendra Nacionale e Informacione të Hartave (NCIC) për USGS. Bibliotekat mund të mësojnë për këto publikime të shumta ndërmjet *USGS New Publications of the Geological Catalog Survey* dhe *A Guide to Obtaining Information from the USGS*. *The Monthly Catalog of United States Government Publications* është një burim tjetër dhe prej kohës në kohë, hartat shfaqen edhe në *U.S. Government Books*, një listim 3 mujor i publikimeve më të popullarizuara.

Nga të gjithë seritë e USGS, hartat topografike janë më të njohurat

dhe të cilat përdoren më së shpeshti. Këto harta tregojnë në detaje aspektet fizike të një vendi, nga lumenjtë e malet deri te veprat e shumta, të bëra nga dora e njeriut. Dhe, këto harta janë të një vlerë të veçantë për numrin në rritje të atyre që ecin (hikers) dhe të tjerëve, që u pëlqejnë aktivitetet në natyrë. Bibliotekat kanë një koleksion në vete të këtyre hartave dhe marrin lëvdata të shumta për ofrimin e tyre publikut. Shiten nga dilerët/ose shitësit e hartave në Shtetet e Bashkuara dhe ofrohen drejtpërdrejt nga USGS, Programi Nacional i Hartave në Reston, Virxhinia.

Burimet digjitale gjeografike

Magjia e versionit të CD-ROM-ve dhe referencave gjeografike që ofrohen Online është i padiskutueshëm. Ka shumë informacione në to, sikurse emrat e gatshëm të lokacioneve të ndryshme, të cilat mungojnë në atlaset standarde. Në të njëjtën kohë, mundësia, për shembull, për t'i printuar/shtypur hartat dhe për të dëgjuar se si njeriu flet në dialektin e një vendi është më shumë si "zile e fishkëllima", që mund të jenë edhe argëtuese, e madje edhe udhëzuese; mirëpo, këto marrin kohë të çmuar nga orari i një bibliotekari.

Njerëzit që merren me veprat referenciale e vënë në pah, disa herë, faktorin e shpejtësisë dhe të lehtësisë, kur kemi të bëjmë me mëdyshje tipike gjeografike. Zakonisht është, sikurse edhe me fjalorët dhe veprat e tjera referenciale, më lehtë për t'i parë burimet e shtypura sesa të shkosh dhe t'i kontrollosh burimet elektronike gjeografike, që marrin shumë kohë. Burimet digjitale gjeografike janë më të mirat për kërkime të hollësishme dhe të sofistikuara.

Dy ekspertët e hartave, të bibliotekave dhe të përmbledhjeve/koleksioneve gjeografike vënë në pah një fakt, i cili është i vërtetë për shumicën e veprave të referencave themelore:

Edhe pse të dhënat në formatin digjital po ofrohen gjithmonë e më shumë, hartat e shtypura do të jenë të përdorshme edhe për një kohë të gjatë. Tani, përafërsisht 90 % e të gjitha të dhënave hapësinore ofrohen vetëm në dosjet origjinale, pra në letër. Materialet e reja prezantohen në formatin digjital; materialet më të vjetra...zakonisht mbeten në formatin e letrës/shtypur, derisa dikush është i gatshëm të paguajë që t'i konvertojë ato në formatin digjital. Po ashtu, dokumentet në formatin origjinal/letër janë më të përdorshme për shumicën e përdoruesve. Kjo

është e vërtetë për harta që janë më të mëdha sesa ekrani i kompjuterit.[6]

Në anën tjetër, burimet aktuale gjeografike në formatin digjital janë të bollshme dhe nuk ka asnjë arsye që një student ose një person joprofesional të mos gjejë përgjigje Online në pyetjet e zakonshme rreth problemeve gjeografike, si pyetjet e tilla se sa larg është pika X nga ajo Y ose matjen e të reshurave në një pjesë të tokës.

Gjendet edhe një numër i shumtë i burimeve të ngjashme, të cilat japin informata të detajuara rreth njerëzve të këtij globi. Ju mund të gjeni shumicën e informatave aktuale të besueshme që ndihmojnë në kuptimin e botës.

"Hartat kurrë nuk janë neutrale: ato kanë implikime politike. Kur isha në Moskë... unë e vizitova Ekspozitën e të Arriturave Ekonomike... Më mbresëlënëse ishte shitja e hartave të Moskës- harta të një madhësie të madhe me plane të detajuara të një lloji, që kurrë nuk ishin parë më parë... Harta të mira dhe të sakta; ato përfaqësonin liri. Mirëpo, ato po ashtu mund të jenë dhe përdoren si instrument i fuqisë- nga shteti ose agjentët e tij, planifikuesit e qytetit, ose inxhinierët e rrugëve".[7]

Zbulimet prej mundësisë së shfrytëzuesit që të vizatojë hartë në kompjuter deri te vendosja e më se 1.7 milionë emrave gjeografikë e ka rritur rëndësinë e atlaseve dhe të hartave digjitale. Sot, versionet digjitale jo vetëm që janë të lira, por konkurruesit e shumtë ofrojnë më shumë informata, më shumë qasje dhe më shumë mundësi filmike. Hartat, në vete, janë të shkëlqyera.

Në Internet (web-sajt)

Hartat gjenden çdokund në Internet. Kategoritë e hartave janë veçori standarde në web-sajtet e kërkimit. Këto web-sajte mbulojnë çdo gjë, duke filluar prej rrugëve të pasme dhe hekurudhave kryesore deri te metrotë dhe rrugët e autobusëve. Duke i shtuar këtu edhe hartat tematike e ato historike, gati çdo lloj i hartës ofrohet në Internet.

Për më shumë, hartat e tanishme që janë të një kualiteti të lartë mund edhe të personalizohen. Rrugët prej shtëpisë deri te salla e një koncerti, halla më e dashur ose te kështjella lokale mund të shikohen Online dhe

[6] Katherine L. Tankin dhe Mary L.Larsgaard. "Helpful Hints for Small Libraries Collections", Public Libraries, maj/qershor, 1996, f. 176. Shënim: Për materialet johartografike, si dhe për martat e atlaset, globet etj., shiko Library of Congress National Union Catalog, ndërmjet OCLC, RLIN, etj.

[7] Gavin Stamp, "Map Culture" The Spectator, 6 dhjetor, 1997, f. 58.

të printohen fare lehtë.

Çelësi kryesor në burimet gjeografike mund të gjendet në www *Virtual Library: Geography* (http://geography.pinetree.org). Këtu ofrohen linkat e departamenteve më të mëdha të gjeografisë në institucionet e arsimit e po ashtu edhe shumë linka nga fusha dhe rrethe të ndryshme gjeografike.

Për një analizë më të thellë të kuptimeve të sofistikuara gjeografike dhe të hartave, shiko: The Alexandria Project (http://alexandria.sdc.ucsb.edu). Kjo është një shoqëri/partneritet e kërkuesve, zhvilluesve dhe të arsimuesve, që i zgjerojnë sektorët akademikë, publikë dhe ata privatë, duke zbuluar një numër të madh problemesh, që kanë të bëjnë me distribuimin e bibliotekave digjitale për informacionet gjeografike referenciale. Ka edhe shumë linka të tjerë, të cilët përfshijnë vepra të ngjashme.

VLERËSIMI

Versionet gjeografike të CD-ROM-ve dhe hartat Online, problemet e tyre individuale vlerësuese edhe pse përmbajtja, si gjithmonë, mbetet pjesa më e rëndësishme që mbulohet në vlerësimin gjeneral në vazhdim. Ka disa pika kyçe, të cilat duhet marrë në konsideratë atëherë kur vlerësojmë hartat, pika të cilat ndryshojnë nga vlerësimi i librave. Për shkakun se hartat dhe atlaset janë të varura nga artet grafike dhe matematika, në mënyrë që të prezantojnë informatat e mbledhura, bibliotekari duhet të vlerësojë dhe të gjykojë sipas një lloj njohurie, që zakonisht është e rëndësishme në vlerësimin e librave. Prej kohës në kohë "Reference Books Bulletin" në "The Booklist" ofron analiza të shumta të atlaseve të sapopublikuara. Divizioni i Gjeografisë dhe i Hartave, Asociacioni i Bibliotekave Speciale lëshojnë në botim një buletin, i cili të shumtën e herave ka artikuj me interes për bibliotekarët. Shkruesit e këtyre artikujve mbulojnë atlase të reja, libra dhe materiale të ngjashme në secilin botim.

Botuesit. Sikurse edhe me enciklopeditë dhe fjalorët, nuk janë më shumë se gjashtë kompani të botimit të hartave. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, botuesit kryesorë janë *Rand McNally & Company, C.S. Hammond & Company, dhe National Geographical Society*. Në Britani të Madhe, botuesit liderë të hartave janë John G. Bartholomew (Edinburg) dhe Departamenti i Hartave në *Oxford University Press* (shtypshkronja e Universitetit të Oksfordit). Kur reputacioni i një botuesi të hartave nuk është i njohur, preferohet që të shikohen botimet e tjera, nga botuesi i

njëjtë, ose të shikohet udhëzuesi i blerjeve. Hartë-bërësi mund të ndryshojë nga botuesi dhe në rastin e atlasit, duhet të kontrollohen dhe shikohen që të dy. E gjithë kjo është e vërtetë për hartat digjitale, ku shitësi ose kompania botuese mund të ndryshojnë nga kompanitë standarde që botojnë atlaset e shtypura.

Shtrirja dhe audienca. Sikurse edhe me të gjitha veprat referenciale, seksioni i gjeografisë i një biblioteke duhet patjetër të ketë një shumësi të titujve, që u shërbejnë qëllimeve të ndryshe, në bibliotekat private apo publike, për grupmoshat adekuate. Në esencë, kjo është çështje e shtrirjes së hartave, pra ajo se sa mbulojnë këto atlase. Disa atlase janë universale, të tjerat janë të kufizuara për një vend të caktuar, ose për një regjion. Grupi tjetër i hartave, madje edhe ato në veprat e përgjithshme, mund të jenë jo të distribuuara në mënyrë jo të njëjtë, kështu që 50 % ose më shumë e veprave mund t'u japin rëndësi Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, duke lënë disi mënjanë pjesën tjetër të botës.

Proporcioni. Hartat, zakonisht janë klasifikuar sipas proporcionit. Një njësi në hartë është e barabartë me një numër të caktuar të njësive në tokë, pra një inç në hartë është i barabartë me 10 ose 100 milje në tokë. Hartat e detajuara kanë proporcion më të vogël. Proporcioni tregohet në fundin e hartës me një vijë, e cila tregon distancën në kilometra ose milje, ose që të dyja.

Gjeografët përdorin proporcionin e hartave për t'u referuar në madhësinë e prezantimit të njësive në hartë. Proporcioni 1: 63.360 është 1 inç për milje (63.360 inçë). Sa më e madhe që të jetë shifra e dytë (emëruesi) aq më i madh është proporcioni i hartës. Për shembull, në hartën që tregon Shtetet e Bashkuara në tërësi, proporcioni i hartës mund të jetë 1:16 milionë (pra 1 inç është i barabartë me 250 milje). Kjo është një hartë me proporcion të madh. Hartat me proporcion më të vogël, të një pjese të Shteteve të Bashkuara, si p.sh. pjesa veriperëndimore, mund të ketë proporcionin 1:4 milionë. Në atlasin e njëjtë, proporcioni i Evropës (dhe një pjesë e Rusisë) është 1:16 milionë. Por, Franca (dhe Alpet) kanë proporcion 1:4 milionë.

Proporcioni nga harta në hartë në një atlas ndryshon shumë, edhe pse atlaset më të mirë mundohet që ta bëjnë standard punën dhe botimet e tyre. Standardizimi vendoset nga madhësia e faqes, në të cilën shfaqet harta, e po ashtu edhe nga përpjekjet e botuesit për ta përdorur propor-

cionin e njëjtë në të gjitha hartat.

Valuta. Tensioni botëror, si për shembull në territorin e ish Jugosllavisë, Kinës dhe Koresë Veriore janë në të mirë të botuesve të hartave. Hartat e reja janë të nevojshme, gati çdo javë ose muaj, madje edhe nëse janë vetëm për nevojat e gazetave, televizioneve dhe formave të tjera vizuale të komunikimit. Hartat e reja, natyrisht janë të nevojshme për bibliotekat dhe për udhëtarët. Faktikisht, çdo bibliotekë duhet t'i freskojë me informata të reja koleksionet e saj të hartave, së paku një herë në vit. Kjo detyrë ka qenë jashtëzakonisht e lehtë për t'u bërë, duke iu falënderuar hartave digjitale.

Sikurse që nuk është praktike për të bërë një atlas të ri, çdo herë kur ndryshon emri i një vendi ose lëvizin kufijtë, botuesit kanë ardhur në dy përfundime: E para, si *Rand McNally* që ofron me disa nga atlaset e saj më të shtrenjta (sikurse *Atlas of Today's World)* duhet të ofrohen harta të botës në versionin e shtypur, që ofrohen falas dhe të cilat tregojnë ndryshimet që nga publikimi i atlasit paraprak. Një qasje më e mirë është përdorimi i informatave të freskëta Online, të cilat shumë më lehtë dhe më shpejt redaktohen sesa veprat e shtypura. *Hammond* për shembull e ka bazën e saj digjitale të të dhënave hartografike, e cila përmban në vete informatat e reja konstante mbi gjendjen e botës. Kjo qendër e të dhënave lejon botuesin që t'i transferojë të dhënat e reja ose të korrigjuara në hartat e reja, jo më gjatë se për disa sekonda. Me këtë që u tha, ju shumë shpejt mund ta printoni pastaj hartën.

Duhet të ceket se data e publikimit për gati të gjitha hartat gjeografike dhe atlaset është viti më i fundit në kalendar. Në të njëjtën kohë, mund të mos jetë edicioni më i ri (p.sh. një atlas me vitin 2000 në titullin e tij ndoshta nuk është korrigjuar në tërësi që nga viti 1995). Edicioni i ri që është, atëherë kur vepra është shikuar dhe korrigjuar në tërësi dhe është ndërtuar nga një kundërvështrim tjetër, botohet gati çdo dhjetë vjet. Pse gati çdo 10 vjet? Është shumë e qartë. Kjo është koha kur bëhet regjistrimi i përgjithshëm. Bibliotekarët që e shikojnë këtë tekst, ose ndonjë burim tjetër udhëzues gjeografik, duhet të insistojnë në datën valide të vitit 2000, ose edhe më mirë vitit 2001, që do të thotë se hartat kanë përfshirë regjistrimin më të fundit në Shtetet e Bashkuara. Duke iu falënderuar trendëve të hartave aktuale digjitale, ndryshimet mund të bëhen edhe pasi të jetë redaktuar edicioni i vjetër në tërësi- qoftë ai Online ose në versionin e shtypur.

Indeksi. Indeksi gjithëpërfshirës është shumë i rëndësishëm në atlase aq sa edhe hartat. Softueri Online ose ai në CD-ROM duhet ta bëjë të lehtë gjetjen e emrit, vendit, ose për shembull të një mine. Një indeks i mirë, shumë qartë i liston të gjithë emrat e vendeve, të cilat shfaqen në hartë. Për më shumë, duhet të ketë edhe referenca për hartat e veçanta, gjerësinë, gjatësinë dhe informacionet me vija. Vetëm numri i faqes kurrë nuk mjafton. Indeksi në shumë atlase është me të vërtetë një fjalor gjeografik i shkëlqyer, pra që ofron informata më shumë se ato themeloret, ku secili shënim përfshin shënime mbi popullatën dhe për vendin. Një kontrollim: Mundohu që të gjesh katër ose pesë emra të listuar në indeks ose në harta. Sa e gjatë dhe sa e vështirë ishte gjetja e tyre? Pastaj, bëje testin ndryshe. Gjej emrat në hartë dhe mundohu që t'i pozicionosh ata në indeks. Nëse keni ndonjë vështirësi, në secilin prej këtyre testeve, atëherë do të thotë se keni probleme.

Formati. Kur ju i shqyrtoni formatet e shtypura, pyetja themelore është e thjeshtë: A mund ta gjejë lehtë në hartë atë çka po kërkoj dhe a është e qartë sikurse duket? Problemi i parë paraqitet atëherë kur ju dëshironi ta printoni një hartë, në atë mënyrë që të jetë e lehtë për t'i lexuar emrat e shumtë që mbulojnë një vend me popullatë shumë të dendur. Është gjë e ndryshme që t'i printoni hartat e regjionit të Polit të Veriut dhe atë të Jugut dhe gjë krejt tjetër ,që të jeni në gjendje ta aranzhoni llojin e simboleve, kështu që njeriu të jetë në gjendje që të gjejë rrugë nga një pikë e hartës së Nju-Jorkut, Parisit, a Londrës, në një pikë tjetër. Hartat me shumë pak informacione janë të qarta dhe të lehta për t'u lexuar. Numri i vërtetë i pikave që shfaqen në hartë është një vendim shumë i rëndësishëm redaktorial.

Formati digjital nuk është burimi më i mirë për hartat e qarta dhe të lehta për t'u lexuar. Rezolucioni në ekranin e kompjuterit është shumë më i dobët sesa në hartat e shtypura. Mirëpo, përparësia e të qenit në gjendje që ta përdorësh opsionin e "zoom-it" në një seksion të caktuar, është i jashtëzakonshëm.

Çmimi. Çmimet e atlaseve dhe hartave shkojnë nga çmimi falas deri në disa mijëra dollarë. Në shumicën e bibliotekave, çmimi i tyre është relativisht i ulët. Atlaset e shtypura standarde kushtojnë nga $30 deri $150, dhe hartat individuale, mirëpo jo ato historike, rrallë ndodh që të jenë të

shtrenjta. Versionet digjitale ose ofrohen falas ose më një çmim jashtëzakonisht modest.

Atlaset komerciale dhe hartat përdoren shumë nga biznesi dhe zakonisht janë të shtrenjta. Sa më të detajuara që janë, aq më të shtrenjta janë ato. Për shembull: ArtView GIS/Version 3.0 Redland, CA: ArtView, 1997 e deri më sot (www.esri.com/software/arcview/avsoftware). Ky është një format i thjeshtë, por i shtrenjtë digjital ($1.195 deri $1.500). Së pari i tregon hartat e shtetit, të qytetit, të komunitetit etj., e më pas janë të paraqitura edhe informata në një përmbledhje të tërë të informatave. Duke përdorur regjistrimin e përgjithshëm, për shembull, ju mund të bëni një hartë të koduar tematike, e cila zbulon gjithçka prej popullatës deri te të ardhurat. E mira e këtyre hartave digjitale, të shtrenjta, është sasia e të dhënave që ofrojnë dhe mundësia se si të manipulohen këto informata në raport me hartat.

ENCIKLOPEDITË DHE FJALORËT GJEOGRAFIKË

E Shtypur: World Geographical Encyclopedia. Nju-Jork: McGraw-Hill Companies Inc., 1995. 5 vëllime., e përkthyer nga edicioni italisht. $500.

Rritja e vjetarëve politikë, e një sërë të atlaseve dhe e numrit të enciklopedive me një subjekt të veçantë, *World Geographic Encyclopedia* përfshin një rrjet të gjerë gjeografik. Pesë vëllimet, të përkthyera nga edicioni në italisht, përfshijnë hartat e parashikuara me informatat statistikore, ato nga historia dhe kultura e kontinenteve dhe vendeve individuale. Reklamimet e ndryshme thonë se kjo vepër është bërë "nga faktet e sakta dhe aktuale gjeografike". Asnjë njëri nuk mund ta kundërshtojë këtë thënie. Secili nga pesë vëllimet e dokumentuara mirë përfshin më shumë se 1 000 ilustrime, shumica e të cilave janë me ngjyra. Teksti i saj është për nxënësin mesatar të shkollës së mesme e po ashtu edhe për të rritur. Vëllimet mbulojnë: Afrikën, Amerikën Veriore dhe Jugore, Azinë, Evropën dhe Oqeaninë. Ka edhe një indeks të detajuar.

Meriam-Webster's New Geographical Dictionary (Springfield, MA: Meriam-Webster, Inc., data të ndryshme) është botim tipik i serive të fjalorëve gjeografikë, të cilët listojnë sipas radhës alfabetike emrat gjeografikë. Ka diku rreth 48 000 shënime me më se 200 harta. Pas secilës hartë janë dhënë informata nga shënimet e shkurtra përshkruese, duke fil-

luar nga njerëzit e famshëm, të lindur në atë territor ose i pari, që ka arritur të ngjitet në një mal të caktuar.

Po ashtu, janë të shënuara lokacionet dhe definicionet, së bashku me informatat e tjera, të cilat janë shumë të vlefshme për bibliotekarët.

ATLASET DHE HARTAT

Sot, hartat mund të gjenden po aq shpesh në Internet dhe në versionin CD-ROM sa edhe në versionin e shtypur. Po ashtu, hartat janë duke u përdorur, sot, edhe në automobila. Hartat vendosen në automobil dhe e udhëzojnë shoferin të lëvizë nga vendi në vend. Një përparësi e madhe e hartave digjitale është përdorimi i shtrirjes hapësinore, e cila jep një ide shumë më të qartë, për shembull rreth lartësisë së një mali, sesa harta e shtypur. Një tjetër përparësi është lëvizja nga një e dhënë në tjetrën dhe ndryshimi i tyre. Çelësi kryesor i hartave digjitale është sasia e informatave, të cilat mund të merren, përzihen dhe lëvizja e tyre në një lokacion tjetër. Çdo gjë, prej telave të telefonave nëntokësorë deri te kufijtë e pasurisë dhe rrugët, mund të shihen me të dhëna dimensionale. E vetmja gjë e keqe në hartat digjitale është sasia e kohës që shpenzohet në të dhe paratë që duhen për t'i futur në kompjuter të dhënat primare.

Këtu jepet një shembull i thjeshtë se si hartat moderne digjitale dhe të dhënat mund të përdoren në mënyrë që ta zgjidhim një problem:

Në vitin e largët 1854, hartografët përdorën një hartë të Londrës për t'i studiuar shpërthimet e kolerës dhe për t'i gjetur pompat e infektuara të ujit që po e shkaktonin atë. Mirëpo, me hartat digjitale, shtrimi dhe paraqitja e informatave mund të jenë shumë më komplekse. Duke marrë informacione nga veteranët për qentë që u testuan pozitivë në ekspozimin e sëmundjes së limës dhe paraqitjen e hartës, e cila është rezultat i fotografimit satelitor që tregon vegjetacionin e Westchester County të Nju-Jorkut, hartografët erdhën në përfundim se bahçet e mbjella, të vendosura skaj pyllit ishin lokacionet kyçe të ekspozimit. Sot, zyrtarët e shëndetit e dinë saktësisht se kur duhet të marrin masa të kujdesit.[8]

Atlaset digjitale dhe hartat individuale kanë një dimension tjetër të rëndësishëm, i cili nuk mund të gjendet në versionet më të vjetra të shty-

[8] Jack Hitt, "Atlas Shrugged" Lingua Franca, korrik/gusht, 1995, f. 30.

pura. Këto zakonisht kanë në vete zërime dhe mocione, p.sh. ju mund të dëgjoni lamtumirën e fundit, të shikoni një video të njerëzve të mbledhur në New York Times Square. Po ashtu, ka edhe të dhëna të tjera të cilat i shpjegojnë dhe i bëjnë të qarta të dhënat statistikore. Në anën tjetër, nëse ju vetëm dëshironi që të vendosni qytetin X ose Y ose malin e caktuar, do të ishte shumë më e lehtë që të përdorej një atlas standard i shtypur ose një hartë.

Mundësisht, më e lehtë është të shikohet ndonjë enciklopedi e përgjithshme për informata gjeografike. Anët e artikujve, enciklopeditë e përgjithshme digjitale kanë opsione të njëjta gjeografike. Të gjitha kanë harta dhe video edukative, të cilat kanë të bëjnë me mjedisin dhe motin, e po ashtu edhe me fotografinë.

Të gjitha atlaset e shtypura, të listuara këtu, krenohen me veten në çështjet primare, të cilat disa i konsiderojnë si pa lidhje, mirëpo që të tjerët i quajnë dhe i vlerësojnë si shumë të vlefshme. Për shembull, në atlasin *Oxford Atlas of the World*, janë diku rreth 50 faqe me tekst përfshirë edhe diagrame, harta, vija të klimës, shifra të popullsisë etj. *The Hammond Atlas of the World* fillon me fotografi të bërë nga hapësira qiellore njëjtë sikurse edhe atlasi *The National Geographic Atlas of the World*. Atlaset digjitale, madje edhe më shumë se ato në versionet e shtypura, përfshijnë edhe gumëzhimën e bletëve dhe erupsionin e vullkaneve në video klipe. A është kjo e nevojshme? Jo, mirëpo ndihmon në shitjen e atlaseve.

Atlaset

E Shtypur: Times Atlas of the World: Comprehensive Edition: Londër: Harper-Collins, (E distribuuar në SHBA, nga Random House) 2000, 220 f., $250.

E Shtypur: The New York Times Atlas of the World, edicioni i katërt. Nju-Jork: Times Books, 2000, 288 f., $75.

CD: Encarta Interactive World Atlas (më përpara është quajtur: *Encarta Virtual Globe*). Redmond, WA: Microsoft, 2000. $50. Millenium World Atlas, Skokie, IL: Rand McNally & Company, 2000. $59.95.

E shtypur: The New International Atlas, 2000, 560 f., $99.

E shtypur: Rand McNally Premier World Atlas, 2000, 248 f., $24.95.

Online: National Geographic Map Machine. Uashington, DC: National Geographic Society, 1997 e deri më sot, www.nationalgeographic.com/resources/ngo/maps.Falas

E Shtypur: National Geographic Atlas of the World, edicioni 7, Nju Jork: Uashington: National Geographic, 1999, 280 f., $125.

CD: Hammand World Atlas, 2000. $49.95. (Me atlaset e shtypura, në vijim: $85).

E shtypur: Hammond World Atlas, 312 f., $70.

Online: World Atlas Online. New York: Faces on File News Service. 2000 e deri më sot, www.fofweb.com. Çmimet ndryshojnë.

Kjo anë e hartës së njohur, e cila mund të renditet në kategorinë e vogël (atlasi elektronik i lëvizshëm), seria më e përdorur dhe më e njohur e hartave është atlasi i gjithëpranishëm. Ky koleksion i hartave, zakonisht në shkallën e globit, vjen në të gjitha formatet, format dhe madhësitë e po ashtu edhe në çmime që shkojnë nga disa deri në mijëra dollarë. Versioni i shtypur me 350 deri 550 faqe, $50 deri $175 atlasi, është atlasi tipik që mund të gjendet në biblioteka së bashku, natyrisht, me versionet e tjera më të lira. Shumica e bibliotekave, po ashtu i kanë edhe versionet CD-ROM si dhe qasjen në hartat Online.

Atlaset e listuara këtu kanë tri deri katër gjëra të përbashkëta, përveç çmimit dhe madhësisë relativisht të njëjtë. Të gjithë atlaset janë të disenjuara mirë dhe hartat janë të një kualiteti të lartë grafik. Të gjitha ofrojnë informata shtesë, duke filluar nga të dhënat mbi popullatën dhe klimën deri te profilet e qyteteve, të shteteve, e kështu me radhë. Dhe së fundi, të gjitha kanë indekse të mrekullueshme dhe adekuate, të cilat kanë mesatarisht prej 70 000 deri 200 000 shënime (në përgjithësi, madhësia është në proporcion të drejtë me çmimin).

Duke e ditur reputacionin gati si të njëjtë të botuesve të atlaseve, pyetja është ajo se cilin nga ata duhet zgjedhur? Përgjigja: Atë që përfshin të dhëna të detajuara dhe atë për të cilin janë më të interesuar njerëzit, që e përdorin atë në biblioteka. Për shembull, një njeri do ta shikonte shënimin e Hammond për një mbulim më të zgjeruar të vendeve, të qyteteve dhe shteteve të Amerikës Veriore. Një konkurrent i afërt, për të njëjtën pjesë të botës dhe përafërsisht i mirë edhe në vendet e tjera, është *Rand*

McNally. Oxford do të ishte zgjedhja më e mirë nëse dëshironi të keni një trajtimi të hollësishëm të Evropës.

Hartat tematike janë një pjesë shtesë, shumë e rëndësishme dhe në disa raste arsyeja se pse njerëzit blejnë atlase. Këto janë harta veçanërisht të përdorshme në shkollat fillore, universitete e kolegje. Këtu mund të gjeni grafi të mrekullueshme për të vënë në pah rëndësinë e gjërave si ushqimi, energjia, mbipopullimi. Në shikim të parë, ju mund të vëreni se ku janë vendet kryesore në botë të prodhimit të naftës, të cilat do të gjenden. Po ashtu, këto harta janë fituese edhe në atë që bëjnë një krahasim shumë të mirë ndërmjet vendeve të botës, si p.sh. a do të dëshironi të jetoni në X shtet apo në Y shtet?

Atlasi Times

Atlasi *Times Atlas of the World* është atlasi më një vëllim, më i miri që ofrohet tash për tash. Është atlasi më i shtrenjtë për të vetmen arsye, sepse fokusohet në mbulimin e shumë territoreve, ka disa harta të disa vendeve dhe përqendrohet në detajet me ngjyra, të cilat nuk mund të krahasohen me asnjë botues tjetër të atlaseve.

Vëllimi i shtypur i ka tre pjesë kryesore. Seksioni i parë është një përmbledhje e shkurtër e mineraleve të botës, burimeve të energjisë dhe të ushqimit, si dhe e shumë diagrameve dhe grafikeve. Atlasi ka diku rreth 123 faqe me më se 8 harta dhe është punuar nga shtëpia Edinburg e Bartholomew. Kjo është pjesa vitale, e cila është e përkryer edhe në ngjyra edhe në shkrim. Emrat e shtypur mirë i bëjnë të mundshëm lexuesit që t'i gjejnë lehtë secilin nga miliona emrat në të. Shumësia e ngjyrave është përdorur me mençuri dhe shije për të treguar veçoritë natyrore, hekurudhat, lumenjtë, kufijtë politikë, e kështu me radhë. Një gjë e mrekullueshme për këtë atlas është fakti se i tregon gati të gjitha veçoritë gjeografike, më pak të rëndësishme, duke filluar nga shtëpitë e dritave dhe tunelet deri te moçalet - të gjitha të shoqëruara kujdesshëm me simbole shpjeguese.

Atlasi *Times Atlas* është i përshtatshëm për bibliotekat amerikane për arsye se ndryshe dhe jo si atlaset e tjerë, ky atlas u jep një rëndësi të madhe edhe vendeve të tjera joevropiane. Asnjë atlas tjetër nuk e bën më mirë mbulimin e Bashkimit Sovjetik, Kinës, Afrikës dhe Azisë, vende që po ashtu trajtohen në atlaset e tjera, mirëpo më pak të detajuara. Proporcioni i njëjtë 1: 2,5000,000 i hartës është i pranishëm gati në të gjitha hartat,

mirëpo ndryshon vetëm për Britaninë e Madhe që është 1:850 000. Hartat e tokave më të mëdha janë të përcjella me harta më të vogla e të detajuara, të cilat shkojnë nga hartat e qendrave urbane deri te hartat e rrethojave të malit Everest.

Seksioni i tretë dhe i fundit është indeksi me më shumë se 210 000 emra të vendeve, i cili për shumë arsye shërben edhe si fjalor gjeografik. Pas secilit emër, jepet edhe vendi-shteti me referenca të sakta në hartë.

Gati sa gjysma dhe me çmim të përgjysmuar të *Times Atlas of the World*, atlasi tjetër i quajtur *The New York Times Atlas* është një vepër e afërt me atë kryesoren. Derisa formati është diç më i vogël, hartat janë të ngjashme dhe të gjitha vijnë nga kompania e *John C. Bartholomew & Son in Edinburg*. Është një balancim shumë i mirë i mbulimit të botës. Indeksi është i vogël (100 000 shënime) dhe çështjet hyrëse janë më të ngjeshura. Mirëpo, në të vërtetë ky është një version modern me një çmim të volitshëm i një vepre më të madhe dhe si i tillë, është një zgjedhje e mrekullueshme për bibliotekë ose shtëpi, aty ku atlasi origjinal nuk mund të gjendet.

Atlasi Encarta Interactive World Atlas

Duke mos e pasur edicionin e shtypur, Microsoft është jashtë grupit tradicional të botuesve të hartave. Pa marrë parasysh këtë, versioni *CD-ROM Encarta Interactive World Atlas* është shembull tipik i një formati të shkëlqyer elektronik. Të gjitha atlaset digjitale dhe hartat i kanë gati të gjitha karakteristikat e versionit të Encartës dhe këtu përdoret si shembull, mirëpo jo si një botim i domosdoshëm për bibliotekë.

Prej pikëvështrimit të një bibliotekari të referencave, veçoria dhe opsioni më i mirë është mundësia për të lokalizuar jo 200 000 ose 300 000 lokacione gjeografike, mirëpo diku rreth 1.2 milionë emra gjeografikë- të cilët të gjithë janë të vendosur dhe gjenden në hartë (teknika e kërkimit “sound like” e lejon dikë të kërkojë një emër të vështirë, duke përdorur vetëm fjalën e shkruar, ku drejtshkrimi mund të mos jetë edhe tërësisht i saktë). Kjo është impresive, mirëpo botuesi *Rand McNally* i ka diku më shumë se 1.7 milionë emra gjeografikë. Që të dy botuesit i fusin emrat e rinj në këtë listë, duke treguar kështu ndryshimet e vazhdueshme. Në të, po ashtu, gjenden edhe referencat e kryqëzuara (në fund të faqes) prej emrave të vjetër dhe emrave më të rrallë.

Encarta ka edhe opsione të tjera të zakonshme, të cilat janë të shoqëru-

ara me atlase digjitale dhe harta. Ju mund ta përdorni "zoom-in" ose afrimin për të gjetur një vend. Po ashtu, ju mund ta ruani një vend në hartë, duke përdorur simbol, gjë që është mjaft e rëndësishme, atëherë kur duhet të vendosni se cilën pjesë të hartës dëshironi ta printoni. Të dhënat statistikore, sikurse shkalla e alfabetizmit në një vend deri te madhësia e një qyteti mund të jenë, po ashtu, të treguara (megjithatë, e ka edhe problemin e zakonshëm: çka do të thotë figura e shkurtuar? Në disa raste kjo është e qartë, herave të tjera është një enigme e vërtetë).

Opsionet e tjera: Një sasi e madhe e informatave që mund të gjenden edhe në veprat e shtypura. Prononcimi ose shqiptimi i fjalive të zakonshme nga folësit amtarë të gjuhës përkatëse ilustrojnë karakteristikat e dialektit, të gjuhës etj. Po ashtu, linkat për web-sajte të ndryshme ndihmojnë shumë.

Rand McNally

I emëruar shumë përshtatshëm, atlasi *Rand McNally Millenium World Atlas* është atlas që doli në shitje në prag të mileniumit të ri. Ka disa zëra që thonë se ky atlas është ideal për punë referencash për shkak se: (1) janë diku rreth 1.7 milionë emra gjeografikë, të cilët mund të vendosen në hartë. Sikurse edhe me Encartën, këto atlase nga Rand McNally po freskohen me informata në mënyrë të vazhdueshme dhe janë më aktuale edhe se versionet e shtypura ose ato Online; (2) janë disa seri të fushave me subjekte të ndryshme, duke filluar që nga popullata e klima deri te fatkeqësitë që mund të përshtaten për të dhënë një informacion të llojit të tillë, si për shembull, numrin dhe vendet se ku gjendet cikloni në pjesën qendrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës; (3) ju mund t'i bëni hartat, ashtu që t'u përshtaten juve, p.sh. lexuesi mund t'i specifikojë llojet e hartave, prej atyre të përgjithshme deri te ato politike dhe ka edhe shumë meny, që lejojnë gjëra sikurse radhitjen e shteteve sipas madhësisë ose parqet nacionale më të mëdha në SHBA; (4) ofrohen në të edhe disa opsione statistikore, të cilat lejojnë grumbullimin e informatave të tilla, siç është numri i programeve televizive në SHBA; (5) gjendet shumë tekst me opsione të shkurtimit të tij. Teksti mbulon të gjitha pikat kryesore, të cilat gjenden në atlasin e shtypur; (6) në të janë disa mijëra linka prej vendit X ose Y deri te web-sajtet e fakteve në Internet. Duke ju falënderuar popullaritetit të këtij atlasi, shumë biblioteka i kanë disa kopje të versionit CD-ROM dhe një kopje në tavolinën e tyre referenciale.

Atlasi i quajtur *The New International* ka diku rreth 160 000 shënime në indeks dhe rreth 300 harta të shkëlqyera. Si rezultat i përpjekja grupore të hartografëve ndërkombëtarë, ky atlas bën një balancim të mirë ndërmjet asaj që lexuesit amerikan i nevojitet dhe asaj të lexuesve në vendet e tjera të botës. Proporcioni është i madh me shumicën e vendeve me shirat 1: 6 milionë deri 1:3 milionë. Hartat janë të llojit me dy faqe. Materialet e atlasit (prej eseve rreth klimës deri te hartat tematike) mungojnë në këtë atlas. Fokusi kryesor është në hartat e një kualiteti të lartë.

Me hartën politike për çdo kontinent, që shoqërohet edhe me hartat e detajuara të shteteve në vete, atlasi *Rand McNally Premier World Atlas* është një atlas i lirë, që u dedikohet individëve dhe bibliotekarëve. Në të mund të gjenden pyetjet më kryesore dhe të nevojshme, p.sh. janë diku gati rreth 60 faqe të hartave për shtetet e Amerikës dhe provincat kanadeze, e po ashtu edhe për harta të njëjta për pjesët e tjera të globit. Janë diku rreth 45 000 emra të vendeve të shënuara në indeks - një bonus, pasi atlaset që shiten me çmim të njëjtë nuk e kanë një indeks të tillë. Në hartat e zakonshme të atlaseve nga Rand McNally, dobësia apo e meta kryesore, veçanërisht për atlasin referencor është mungesa e të dhënave gjeografike për shtete si shtete. Atlase të ngjashme botohen edhe nga Hammond, si p.sh. edicioni i ngjeshur *Hammond Atlas of the World.*

National Geographic[9]

Atlasi *National Geographic Atlas of the World* ofron më shumë se hartat. Në një mënyrë është edhe enciklopedi. Po ashtu, e ka edhe përparësinë që e ka korrigjimin komplet të vitit 1999. Është një atlas mjaft atraktiv, së paku për disa njerëz dhe nxënës. Këtu ju mund të gjeni disa harta tem-

[9] Po ashtu, shih edhe The National Geographic Desk Reference (Uashington: National Geographic, 1999. 700 f., $40). Në të, diku rreth një faqe është e dedikuar për secilën nga vendet e botës. Kjo faqe përfshin të dhëna gjeografike prej klimës deri te religjioni. Po ashtu: versioni CD-ROM: The Complete National Geographic. Ky atlas përfshinë gati 200 000 faqet e të gjithë artikujve, ilustrimeve të revistave të botuara nga viti 1888 deri më 1999. (Po ashtu, ofrohen freskimet me informata). E gjithë kjo ofrohet në 31 disqe për një shumë modeste prej $130, ose në katër DVD për një çmim të njëjtë. Kjo zë shumë më pak hapësirë sesa versionet e shtypura. (Një grremç: secilën herë ju e fusni një disk për të parë materialin në të, është e nevojshme që të shikoni një reklamë dyminutëshe për revistën. Marri.) Një version më i shkurtër i tij, që freskohet me informata, ofrohet edhe në Internet në adresën (www.nationalgeographic.com).

atike dhe diskutime të rezervave botërore. I ndarë në kontinente, 172 hartat janë të shfaqura në secilin kapitull, në llojin e artikujve të enciklopedive, për disa shtete (janë më shumë se 75 hartat të mëdha të formatit me ngjyra). Hartat janë shumë të qarta dhe të lehta për t'u lexuar. Ka një indeks me 140 000 shënime. Atlasi është i fokusuar më shumë në Amerikë, mirëpo nuk i injoron as vendet e botës së tretë (Afrika). Atlasi ka edhe pika të tjera, të forta në të, si për shembull proporcionet e vogla, faqet me madhësi të duhur dhe indeksin e zgjeruar, që u cek më lartë. Preferohet nga ata njerëz që duan më shumë se një atlas.

I bazuar në *National Geographic Atlas, National Geographic Map Machine* në Internet ofron gati numër dhe lloje të njëjta të hartave, të cilat gjenden në edicionet e shtypura. Sistemi Online, po ashtu i mban atlaset e shtypura aktualë. Këtu janë edhe disa çështje si më parimore, si: flamujt, kushtet e mjedisit, zhvillimet industriale etj. "Map Resources" ka linka për shumë web-sajte të tjera përfshirë këtu edhe *Perry-Casteneda Library Map Collection*. Ka dy mangësi: (a) hartat nuk janë aq të detajuara në Internet sikurse ato në versionin e shtypur dhe (b) për shkak të madhësisë së ekranit të kompjuterit, disa harta nuk tregohen në madhësinë e duhur, në mënyrë që të japin një pasqyrë të qartë të kufijve të një vendi.

Një bashkëpunim i vërtetë: *National Geographic Maps* përfshin më shumë se 500 harta të famshme në tetë disqe (versioni CD-ROM). E gjithë kjo ofrohet për vetëm $60.

Hammond

Hartat dhe atlaset nga Hammond janë ndër hartat dhe atlaset më të besueshme në botë. Kjo kompani ka, po ashtu, edhe shumë atlase individuale. Një prej këtyre atlaseve standard është ai i quajtur *World Atlas*. Ky atlas ka 167 faqe me harta të mëdha. Proporcioni mestar është 1:3 milionë me theks të veçantë në Amerikën Veriore. Duke iu falënderuar përdorimit imagjinativ të kompjuterit, hartat shoqërojnë një projektim që është i mirë në tregimin e madhësive të vendeve të caktuara. Janë diku rreth 62 harta të qendrave urbane amerikane (1.1 milionë) së bashku me hartat e tjera më të vogla. Hartat tematike, të cilat tregojnë marrëdhëniet globale janë të disenjuara mirë e në të gjenden edhe disa kapituj me tekst rreth fushave si mjedisi dhe zhvillimi i hartografisë. Indeksi ka rreth 110 000 shënime.

Lehtësia e përdorimit e bën këtë një atlas ideal në shumicën e situatave

referenciale. Kjo vlen edhe për hartat dhe atlaset e tjera nga Hammond. Si rezultat i kësaj që u tha më lartë, publikimet nga botuesi Hammond mund të gjenden në të gjitha bibliotekat.

Versioni CD-ROM nga Hammond i përdor metodat e zakonshme për lidhjen e hartave të shtypura me web-sajtet në Internet, edhe duke shtuar materiale redaktuese e opsione të tjera multimediale, si për shembull "zoom" ose afrimi i vendeve- edhe pse ky opsion është më i kufizuar sesa në versionet e tjera CD-ROM. Si i tillë, nuk është i nevojshëm që ta kenë bibliotekat.

Bibliotekat e mëdha i dëshirojnë të gjitha këto atlase. Nëse duhet të bëhet zgjedhja, atëherë *The Times Atlas* (ose *The New York Times Atlas of the World*) do të ishte zgjedhja e parë. Edhe pse atlasi International do të radhitej si zgjedhja e dytë. The Times ka reputacion të madh dhe mund të gjendet në shumicën e bibliotekave.

The Book of the World (Nju-Jork: Macmillian, 1999, 560 f., $465) është atlasi më i shtrenjtë i atlaseve të mëdha. Nuk ju duhet shumicës së bibliotekave. Në të njëjtën kohë, atlasi *Book of the World*, që peshon gati 9 kg, i ka edhe hartat e famshme Bertelsmann, një indeks prej më shumë se 100 000 shënimeve dhe fotografi impresive, të bëra nga sateliti në një madhësi të zakonshme. Përkundër mbështetjes akademike, ky atlas është bërë më shumë për t'i impresionuar komshinjtë sesa të përdoret në mënyrë aktive në referenca.

Përparësia e *World Atlas Online* është lehtësia për t'i printuar hartat dhe formati jo i caktuar i strukturës. Ky atlas e tregon strukturën e një shteti, vendi, ose kontinenti, por shënime të emrit ose vendeve të caktuara. Po ashtu, përdoruesi i këtij atlasi mund të printojë një hartë të detajuar dhe me ngjyra për më pak se katër minuta. Një tjetër përparësi: metodat e shumta të kërkimit e lejojnë shfrytëzuesin për të gjetur qytetet, lumenjtë, arkipelagët etj., vetëm duke e dorëzuar kërkesën për një gjë të tillë. Kërkesat janë të listuara, kështu që përdoruesi nuk ka nevojë që ta rikujtojë drejtshkrimin ose formatin e përshkrimit. Këtu, haset edhe metoda e zakonshme e rritjes së hartës në ekran, për të parë më shumë detaje të asaj harte. Përparësia e tretë, e që është e një rëndësia të madhe për bibliotekarët e referencave është: të dhënat nga historia deri te forma e qeverisjes dhe informatat statistikore për secilin shtet. Duhet të merret parasysh fakti se të gjitha të dhënat, përfshirë edhe hartat, janë goxha të vjetra. Dhe në fund, ofrohen edhe linka të shumtë për çdo gjë, prej regjistrimit të popullsisë deri te "shikimet e tokës dhe të hënës".

Atlaset e shkollës/tavolinës: Formati i shtypur

E Shtypur: Goode's World Atlas. Chicago: Rand McNally Company, 1999. 384 f., $35.

Çmimet e ulëta, madhësia e përshtatshme dhe përdorimi i lehtë janë tri arsyet kryesore, të cilat preferohen nga njerëzit për atlaset shkollore ose ata të tavolinës në shtëpi. Dhe, këto atlase përdoren në shumë klasë të gjeografisë të shkollave fillore. Problemi është i tillë: formati kushtëzon që proporcioni i hartave të jetë i madh, gjë e cila rezulton në shtrembërime të mëdha; nën dy, fjalori gjeografik ose indeksi, aty ku është i pranishëm, është i kufizuar në jo më shumë se 20 000 deri 36 000 emra; dhe tre, edhe pse hartat janë adekuate, iu mungon ngjeshmëria, delikatesa e atlaseve të mëdhenj.

Atlasi i lirë, i cili gjendet në shumicën e bibliotekave, në veçanti në bibliotekat e vogla publike dhe pothuajse në të gjitha bibliotekat shkollore është atlasi i quajtur Goode's. Ky atlasi korrigjohet çdo tri-katër vjet dhe përfshin informacione gjeografike, që mund të mbahen mend nga shkolla fillore. Është një atlas i vogël tipik, që shitet me një çmim të ulët. Ka një indeks me rreth 36 000 shënime dhe gati 400 harta (të cilat disa herë janë jo fort të mirë). Pasi që përdoret në shkolla fillore, të mesmet dhe në kolegje, theksi i veçantë i këtij fjalori është në elementet tematike prej të dhënave mbi popullatën deri te problemet me ambientin/mjedisin.

Ka një shumësi të panumërt të atlaseve të mesëm dhe atyre të vegjël. Le të marrim për shembull atlasin *Desk Reference World Atlas* (Çikago: Rand McNally). Ky atlas shitet për një çmim modest prej 20 dollarëve. Ka rreth 350 faqe me harta të mira dhe me një indeks që përfshin rreth 30 000 emra të vendeve. Në mes të kapitujve është një enciklopedi modeste prej 200 faqesh, e cila është e mbushur me tabela dhe fakte, me të cilat tentohet t'u jepet përgjigje mëdyshjeve nga gjeografia.

Po ashtu, shiko edhe libraritë e mëdha, të cilat shesin atlase të botuara nga disa kompani së bashku. *Barnes & Noble*, e shet *Rand McNally New Universal World Atlas* për vetëm $20, nga çmimi fillestar prej 50 dollarësh. Ky është edicioni i tanishëm me harta 11 me 14 inçë. Theks i veçantë vihet mbi Kanadanë dhe Shtetet e Bashkuara. Në të gjendet edhe një fjalor gjeografik/indeks modest me rreth 39 000 shënime.

Rand McNally boton një seri të atlaseve për fëmijë prej atij që quhet

Rand McNally Children's Atlas (7 vëllime), *Rand McNally Picture Atlas of Prehistoric Life* deri te ai i titulluar *The Rand McNally Children's World Atlas*. Hammond ofron edhe atlasin *Discovering Maps: A Children's World Atlas*.

Në Internet[10]

Prej pjesës së web-sajteve, të cilat u përmendën edhe më parë, disa prej tyre janë me interes për punën e bibliotekarëve me atlaset dhe hartat:

Perry-Castaneda Library Map Collection. University of Texas (www.lib.utexas.edu/Libs/PCL/Map_collection/Map_collection). Këtu ofrohen 3 000 harta digjitale, të cilat e tregojnë pjesën më të madhe të botës. Ka një rëndësi të madhe, posaçërisht për faktin se ka harta të vendeve gjeografike aktuale, që hasen shumë në lajme, si p.sh. Bosnja, Gaza, Bregu Perëndimor, harta të detajuara të Afrikës etj. Hartat mbulojnë të gjitha pikat e globit, edhe pse fokusi kryesor është në hartat e Shteteve të Bashkuara. Këto harta janë marrë nga Departamenti i Shtetit Amerikan, Byroja e Regjistrimit Civil etj. Ju duhet vetëm një klikim me miun tuaj në numrin e shenjës për të gjetur: referenca hartografike, harta të përgjithshme, harta të qyteteve, të lagjeve, të shteteve, të klimës dhe ato historike.

National Atlas of the United States (www.nationalatlas.gov). Përderisa është e kufizuar për Shtetet e Bashkuara, atlasi i Shërbimit Gjeodezik i Shteteve të Bashkuara përfshin në vete një numër të madh të hartave topografike të vendit (SHBA-ve) si tërësi, dhe për shtetet e caktuara në veçanti. Ju vetëm klikoni/shtypni mbi njërin shtet dhe hartat do t'ju shfaqen në ekran. Ofrohen edhe linka të ndryshëm për harta të tjera në Internet.

GAZETERËT

E Shtypur: The Columbia Gazetter of the World. Nju-Jork: Columbia

[10] "Maps", Web Guide Magazine, mars/prill 1998, f. 69-71. Kjo jep adresën dhe një shpjegim të shkurtër të bibliotekave më të mëdha të hartave historike. Janë të tilla si Library of Congress Geography and Map Reading Room (http://lcweb.loc.gov/rr/geogmap/gmpage3.html) dhe Oxford's Bodleian Library Map Room (www.Bodley.ox.ac.uk.nnj).

University Press, 1998, 3 vëllime. $750.

Online: U.S. Gazetter. Uashington, DC: United States Census Bureau, 1997 e deri më sot, www.census.gov/cgi-bin/gazetteer. Ofrohet falas.

Gazeteri - një fjalor gjeografik i përgjigjet pyetjes se "Ku gjendet lokacioni, qyteti X ose Y? Në përgjithësi, fjalori gjeografik, i quajtur në gjuhën angleze "gazetter" është një listim alfabetik i emrave që shkojnë nga numri 100 000 deri në 3 milionë, që japin gjatësinë dhe gjerësinë e një vendi të caktuar, në mënyrë që të gjendet ajo në hartë. Po ashtu, çelësi këtu mund të jetë edhe numrat dhe shkronjat e njohura, që gjenden në hartë dhe që ndihmojnë për ta ngushtuar fushën e kërkimit dhe për ta gjetur më lehtë se ku është i vendosur një vend në hartë.

Problemi me thjeshtë në vendosjen e një emri gjeografik mënjanohet në masë të madhe, duke përdorur një nga dy atlaset nga versioni CD-ROM, p.sh. *Encarta Virtual Globe* (me më se 1.2 milionë emra) ose *Rand McNally Millennium Atlas* (me 1.7 milionë emra). Në anën tjetër, atëherë kur dëshirohen informata për një vend të caktuar, fjalori gjeografik është sipas rendit alfabetik.

Përderisa ka edhe vepra më të vogla në vëllim,[11] fjalori i përgjithshëm më i mirë gjeografik është *Columbia Gazetter,* i cili ka tri vëllime. Në këtë fjalor gjeografik, më se 160 000 vende janë të radhitura sipas rendit alfabetik. Kjo shifër mund të duket e vogël kur krahasohet me shifrat në atlaset CD-ROM, por këtu ofrohet më shumë sesa një emër. Aq shumë saqë ky botim është një ndihmë e madhe referenciale. Ndër pikat kryesore në secilin shënim përfshihen: (a) përshkrimi fizik i emrit të vendit; (b) informata mbi të kaluarën ekonomike, politike dhe aspekteve historike, që është e ngjashme si versioni i shkurtuar i *Statesman's Yearbook*; (c) shqiptimet; (d) matjet e gjatësisë dhe të gjerësisë (longtitute-latitude); (e) referencat e kryqëzuara prej vendeve më të vjetra deri te ato me emrat më të rinj. Shënim: *The Columbia Gazetter of North America,* e cila botohet po nga i njëjti botues, u lëshua në treg në vitin 2000 me një çmim prej $250. Ky fjalor ka rreth 50 000 shënime, të gjitha të marra nga versioni i parë i shtypur.

U.S. Gazetteer, e cila ofron atlas, shërbim të hartës dhe fjalor gjeografik

[11] Fjalor më i vogël gjeografik është Merriam-Webster's Geographical Dictionary, i cili u diskutua më herët në këtë kapitull.

ofrohet falas dhe ka informata të hollësishme mbi komunitetet amerikane. Me të vërtetë, U.S. Gazetteer nuk është mirë të përdoret për pyetje të thjeshta se ku gjendet ky apo ai vend për shkak se është shumë i detajuar. Dikush që kërkon informata mbi popullsinë nëpërmes Internetit nevojitet vetëm që ta shënojë emrin e vendit ose të lokacionit. Më pastaj, në ekran do të shfaqet një hartë mjaft e detajuar. Kjo hartë mund të përdoret nga shfrytëzuesi për të përfshirë edhe linjat hekurudhore, hekurudhat kryesore, kufijtë brenda qytetit të caktuar etj. Në momentin kur harta shfaqet në ekran, ju mund të klikoni në hartë dhe ta ofroni hartën përmes opsionit "zoom"... ose duke e larguar hartën etj. Për më shumë, baza e informatave jep informata të shkurtra rreth komunitetit si: popullsia, kodi postar dhe kur të kërkohen informata më të shumta mbi regjistrimin e popullsisë.

Fjalorit gjeografik i mungojnë informacionet që gjenden në veprën e cekur më lartë nga Columbia, mirëpo dy atlaset nga versioni CD-ROM përfshijnë një numër të madh të emrave gjeografikë. Kjo është *GEOnet Names Server*. (http://164.214.2.59/gns/html). Këtu gjendet një fjalor gjeografik i përkryer për të gjetur gjatësinë dhe gjerësinë e një vendi në botë, p.sh. jashtë Shteteve të Bashkuara të Amerikës. "*The GEOnet Names Server* (GNS) ofron qasje në bazën e të dhënave mbi emrat gjeografikë të huaj të Agjencisë Nacionale të Hartave dhe të Fotografive. Përafërsisht 12 000 opsionet e kësaj baze të të dhënave nga numri total prej 3.3 milionë, çdo muaj janë të freskuara me informata, me emra të shumtë nga i gjithë globi. Ky web-sajt ofron të dhëna sipas emrit, koordinatës, emërtimit, e shumë opsioneve të tjera. Mirëpo, nuk ka linka për harta.

Një burim i rëndësishëm nga Interneti i fjalorit gjeografik është muzeu i famshëm botëror. I sponsorizuar nga J. Paul Getty Trust, ky web-sajt përfshin edhe thesaret artistike dhe ato arkitekturale e po ashtu edhe listën me emrat e artistëve që janë pjesë e unionit të artistëve. *Getty Thesaurus of Geographic Names* (http://shiva.pub.getty.edu/tgn_browser) që shpesh i referohen njerëzit shkurt si TGN, lejon shfrytëzuesin që të shënojë fjalën e kryesore ose të gjithë emrat. Gjatësia dhe gjerësia e po ashtu edhe informatat se në cilin kontinent, shtet, qytet, ose provincë gjendet vendi i caktuar janë të dhëna. Incizimet e vendit janë të rralla, mirëpo së paku tregojnë se ku mund të gjenden vende të tilla si "Parajsa e vogël" (Little Heaven).

HARTAT DHE ATLASET TEMATIKË

E Shtypur: Atlas of World History. Nju-Jork: Oxford University Press, 2000, 368 f., $85.

E Shtypur: Atlas of Exploration. Londër: Oxford University Press, 1997, 248 f., $40.

E Shtypur: The Times Atlas of World History. Nju-Jork: HarperCollins, 1993, 380 f., $65.

E Shtypur: Rand MnNally Commercial Atlas Marketing Guide. Çikago: Rand McnNally & Company, 1976 e deri më sot, e përvitshme. $300+, çmimet ndryshojnë.

Hartat tematike ose ato me një subjekt të caktuar janë zakonisht të kufizuara mbi një temë të caktuar ose tema të ngjashme. Gati çdo gjë, me theks të veçantë në gjeografi, mund të jetë subjekt i hartave të tilla. Hartat e listuara këtu janë përfaqësuese të një numri shumë të madh që mund të gjenden duke konsultuar librin Guide to Reference Books, American Reference Books Annual dhe natyrisht bibliografitë gjeografike.

Hartat historike mund të japin më shumë se një argument ose fakt. Në hartën në 'Dy zotërinj nga Verona', Shekspiri e kishte dërguar Proteusin që të udhëtonte me anije prej Veronës në Milano. Një hartë moderne e ditëve të sotme tregon se kjo gjë është e pamundshme. Mirëpo, një hartë e periudhës prej vitit 1483 deri më 1489 tregon një numër të kanaleve që ishin të disenjuara nga Leonardo Da Vinçi. Edhe pse këto dy qytete italiane nuk janë të lidhura përmes ujit, kanalet janë shumë të afërta- vetëm 60 kilometra prej njëra tjetrës- kështu që del fakti se pjesa më e madhe e udhëtimit me anije që thotë Shekspiri mund edhe të jetë e vërtetë.

I nëntitulluar si "from the origins of humanity to the Year 2000", atlasi *Atlas of World History* është atlasi më i fundit, i cili është superior në redaktim dhe fokusohet në gjithë botën, e jo vetëm në vendet perëndimore. Në të mund të gjenden rreth 450 harta me ngjyra, të cilat janë të shoqëruara me ilustrime. Këto harta lexohen lehtë dhe janë fort të kuptueshme. Kapitujt janë të radhitur sipas rendit kronologjik (kohës), duke filluar nga bota antike deri te kapitulli i fundit, i cili ka të bëjë me

kulturat e shumta moderne. Versioni themelor dhe ai Times mund të gjenden në çdo bibliotekë.

Atlasi *Atlas of Exploration* që është i mbështetur nga 100 harta dhe më se 300 fotografi dhe ilustrime, mbulon 5 000 vitet e zbulimeve prej atyre më të vjetrave rreth Afrikës, Evropës dhe Azisë deri te zbulimi i James Cook në Antarktik. Rrugët primare janë të vizatuara në hartat gjeografike të relievit. Po ashtu, në këtë atlas mund të gjenden hartat prej periudhave të ndryshme historike dhe ato mbi zhvillimin gradual të hartografisë. Vëllimi përfundon më një indeks dhe disa skica biografike të zbuluesve dhe hartografëve më të mëdhenj.

E freskuar me informata çdo pesë-gjashtë vjet, *The Times Atlas of World History* tregon ngjarjet historike, aktivitetet kulturore dhe lëvizjet sociale në të njëjtën kohë dhe në mënyrë paralele në Evropë, Azi, Afrikë dhe në Amerikë. Hartat janë të mëdha, të lehta për t'u lexuar dhe të vendosura në një mënyrë të tillë, që i lejojnë një personi të shohin historinë kronologjike të një ngjarje, individi, ose të një lëvizje, e cila është në zhvillim e sipër. Atlasi ka një indeks të mrekullueshëm dhe një fjalor shumë të mirë me terma të pazakonshtë historikë. Një tjetër atlas, nga po i njëjti botues, me çmim prej $40 është *The Times Atlas of European History* (1994), atlas që mbulon Evropën prej vitit 900 para Krishtit deri në vitin 1994. Tekste të shkurtra mund të gjenden në harta.

Vlera e atlasit *Rand McNally Commercial Atlas* është ajo se ky atlas korrigjohet çdo vit. Biblioteka që mund ta blejë një atlas të tillë çdo vit, është në gjendje që t'i zgjidhë të gjitha problemet që kanë të bëjnë me Shtetet e Bashkuara apo me Kanadanë. Të gjitha informacionet janë mjaft aktuale, qoftë ato të marra nga një atlas apo nga ndonjë vepër e referencave. Është një burim i jashtëzakonshëm për të gjetur të dhëna aktuale statistikore, 120 faqet e para ofrojnë: (1) harta regjionale dhe metropolitane të një vendi; (2) të dhëna mbi transportin dhe telekomunikacionin; (3) të dhëna ekonomike; (4) të dhëna mbi popullatën. Shumica e këtyre të dhënave janë të listuara sipas shtetit, pastaj sipas qyteteve kryesore me kode që tregojnë qartë shifrat.

Kapitulli më i madh i është dedikuar "hartave të shteteve të SHBA-së dhe indeksit të statistikës dhe vendeve sipas shteteve". Këtu lexuesi mund t'i gjejë hartat më të mëdha të shteteve. Të dhënat statistikore, të aranzhuara sipas shtetit, vijnë menjëherë. Këtu përfshihen edhe detaje të tilla si qytetet kryesore sipas popullsisë, të dhënat biznesore, ato të transportit, bankave, postave, të cilat më pastaj janë të ndjekura nga të dhëna

të shkurtra për Kanadanë dhe botën. MSAs (*Metropolitan Statistical Areas*) dhe BTAs (*Business Trading Areas*) përdoren për të vënë rregull në të dhënat e shumta statistikore. Përafërsisht 128 000 lokacione janë të analizuara me tabela shumë të qarta, të cilat përmbledhin gjëra të tilla si popullatën, të dhënat ekonomike dhe projektet afatgjate 2000-2015. Shfrytëzuesi mund të gjejë shpejt të dhëna mbi të ardhurat personale të një individi, e po ashtu, edhe të gjejë vende që vështirë se mund të vendosen në hartë. Hartat e hollësishme e të detajuara e bëjnë këtë atlas të jetë i kërkuar gati në çdo bibliotekë.

Atlaset me subjekt historik të vendeve dhe atlaset e përgjithshme po ashtu janë të pranishëm: *The Atlas of Literature* (Londër: De Agostin, 1996, 362 f.). I redaktuar nga Malcolm Bradbury, ky atlas mbulon këtë subjekt prej Kohës së Mesjetës deri te Lufta e Dytë Botërore dhe "Bota në Ditët e Sotme". Në secilin nga tetë kapitujt, mund të gjenden skica të autorëve, materiale mbi të kaluarën e tyre, fotografi dhe shumë harta me ngjyra që tregojnë edhe gjërat e vogla si Kalërimi i Don Kishotit i pikturuar nga Servantesi. Është një vepër referenciale me pak vlerë për studentët dhe lexuesit e tjerë. Një vepër tjetër edhe më e pavlerë: Franco Moretti, *An Atlas of the European Novel 1800-1900* (Londër: Verson, 1998, 206 f.). Diku rreth 100 harta të pikësimit mbështesin tregimet narrative. Një vepër tjetër, e cila është më shumë për fëmijë sesa për të rritur është atlasi *Atlas of the Prehistoric World* (Nju-Jork: Random House/Discovery Book, 1999, 224 f.) mbulon më se 500 milionë vjet, me theks të veçantë në periudhën e dinozaurëve përpara 65 milionë vjet para Krishtit. Fotografitë, vizatimet, hartat dhe teksti, që gjendet në të, shtojnë dhe heqin diçka në këtë saktësinë e këtij prezantimi. Ka edhe shumë atlase të tjera, por këto që u përmenden janë atlaset më të mira në një subjekt të caktuar.

HARTAT E RRUGËVE[12]

Hartat digjitale të rrugëve dhe magjistraleve janë bërë një "industri profitabile". Harta të tilla të reja botohen çdo muaj. Titujt e hartave të rrugëve të dhëna më poshtë janë më të mirat, mirëpo vetëm për një grup të madh të njerëzve, të cilët kanë interesa të caktuara dhe që janë të interesuar të udhëtojnë shumë. DeLorme, Miscrosoft dhe Rand McNally janë ndër

[12] Hartat digjitale të qyteteve. Për një analizë të mirëfilltë të tyre, së paku deri në vitin 1999, shiko: "Most Wired City Guides" Revista Yahoo, prill, 1999, f. 103-108.

botuesit kryesorë.

Hartat Online të qyteteve janë të ngjashme për shkakun se ato të gjitha përmbajnë bazën e të dhënave nacionale të hartave të rrugëve, ku përfshihen edhe parqet, hotelet dhe pika të tjera, të cilat mund të tregohen në hartë. Në mënyrë që të planifikoni një udhëtim dhe të merrni hartën e saktë të udhëtimit tuaj, shfrytëzuesi shënon së pari qytetin prej ku edhe do ta fillojë udhëtimin dhe pastaj qytetin e fundit. Nuk duhet harruar edhe shënimi i vendeve ku shfrytëzuesi mendon se do të pushojë. Softueri pastaj bën llogaritjen e rrugëve të ndryshme, rruga me e shpejtë, ajo me pamje më të mirë, e kështu me radhë. Rrugët shfaqen në ekranin e kompjuterit me përllogaritjen e afërt të vozitjes dhe sugjerimet për atraksionet që mund të vizitohen gjatë rrugës.

Një problem serioz me disa harta digjitale: ka edhe shumë "zile e fishkëllima" prej fotografive pantografike të qyteteve të mëdha deri te videot. Kjo përzihet më pastaj me qëllimin kryesor për të arritur nga pika X në atë Y. Disa herë mund të shkaktojë më shumë konfuzion sesa që ndihmon.

Gjenden edhe shumë harta të mrekullueshme të rrugëve dhe magjistraleve në Internet. Dy shembuj tipikë të tyre:

Maps on US (www.mapsonus.com). Theksi i veçantë këtu është në ofrimin e hartave prej një rruge specifike të një vendi në vendin tjetër, pa marrë parasysh nëse është brenda një qyteti amerikan ose nga një qytet në tjetrin. Është shumë i thjeshtë për ta përdorur dhe në të ofrohen edhe një udhëzuese: what next (çka pastaj), i cili ndihmon fillestarët. Ju mund të shënoni adresën e shtëpisë, e pastaj pikën e destinacionit tuaj. Si rezultat jepet harta me instruksione. Sikurse edhe me sistemet e tjera të llojit të tillë, këtu gjenden edhe shumë opsione të tjera prej zgjedhjes së rrugës më të shkurtër, ose rrugës me pamje më të mirë. Brenda qytetit ose vendit, hartat e rrugëve japin aq shumë detaje saqë nganjëherë vështirë se mund të lexohen.

MapQuest (http://mapquest.com). Ky web-sajt ofron harta të tipit "nga dera në derë" e ngjashme me planifikim e udhëtimit që e ofronte Asociacioni Amerikan i Automobilave, vetëm këtu për dallim, udhëtuesi e bën vetë hartën e udhëtimit. Ofrohet edhe një atlas amerikan interaktiv Online, i cili jep instruksione se si të arrihet prej pikës X në pikën Y dhe në disa raste duke e treguar rrugë për rrugë. Vizitori i këtij web-sajti mund

ta shënojë adresën e rrugës dhe menjëherë shfaqet harta se si të arrihet deri te ajo adresë. Informacionet rutinore të udhëtimit janë pjesë e aranzhmanit që ofrohet falas, p.sh. çdo gjë prej muzeve deri te ikonat. Ju mund të klikoni në to për të parë adresën e tyre, numrat e telefonit, emri i web-sajtit të tyre etj.

Një opsion tepër i rëndësishëm që është shumë i rrallë për web-sajte të tilla është fakti se këtu përfshihet atlasi interaktiv i gjithë botës. Në këtë atlas mund të gjenden qytetet kryesore në çdo pjesë të botës. Përderisa për pjesët e tjera të botës nuk ofrohen aq shumë detaje si për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prapëseprapë kjo është e mjaftueshme për të bërë një rrugë në mes Londrës dhe Parisit, e po ashtu edhe prej Parisit në Berlin.

Një opsion tjetër i hartave Online të rrugëve është ofrimi i informatave se sa kushton udhëtimi me aeroplan prej pikës Y deri te pika Z. Disa prej tyre përfshijnë gjithë botën. Të tjerët janë vetëm për Amerikën Veriore. web-sajtet janë posaçërisht ndihmë për të treguar çmimin më të lirë të biletës me aeroplan prej pikës X te pika Y. Web-sajtet më të vizituara deri në gusht të vitit 2000 ishin: Mapquest me 7.5 milionë vizitorë; Travelcity.com me 6.94 milionë vizitorë; Priceline.com me 6.91 milionë vizitorë; Expedia.com me 6.72 milionë vizitorë. Web-sajtet e tjera me 2.5 milionë vizitorë janë: AA.com; ITN.net; Delta.com. Këtij grupi në vitin 2001 pritet t'i bashkëngjiten edhe: *Orbitz.com,* e cila do t'i përfaqësojë pronarët ajrorë si *American Airlines, Continental, Delta, Northwest* dhe *United.*

Të tjera[13]

E shtypur: Michelin "City Streets", Paris: Michelin, 1998 e deri më sot, e përvitshme. $12.95.

CD: Rand McNally Trip Maker, Skokie, IL: Rand McNally & Company, 1994 e deri më sot, e përvitshme. Çmimet ndryshojnë.

CD: Street Atlas USA. (po ashtu i titulluar edhe si: AAA Map'Ngo)

[13] Një tjetër aspekt i planifikimit të udhëtimit dhe rrugës është edhe enigma e sistemeve të udhëzuesve të automobilave. Përfundimisht, këto mund të gjenden në të gjithë automobilat, mirëpo tash për tash llogariten si luks dhe si jashtë seksionit të referencave të bibliotekës.

Yarmouth,
ME: DeLorme Mapping, 1992 e deri më sot, e përmuajshme. $34.95.

CD: Compas 3800. Lemont, IL: Chicago Map Corporation, 1997 e deri më sot, e përvitshme. Çmimet ndryshojnë.

Botuesi i udhëzuesve të udhëtimit Michelin është një shembull i mirë i hartave të shtypura të rrugëve të qytetit. Ky botues lëshon në botim disa seri të hartave të rrugëve, të cilat mbulojnë shumicën e botës. Të gjitha këto harta janë të vogla aq sa për t'u futur në xhep dhe për të ecur me to. Proporcioni i tyre është 1:10 000 (për Romën dhe Lionin) deri në 1:17 500 (Brukselin). Në proporcionin 1: 12 000 rreth 31/2 e inçëve mbulojnë diku gati më shumë se një gjysmë milje. Të gjitha hartat mund të palosen dhe në to gjendet edhe një broshurë, e cila ka një indeks për rrugët.

Ndër hartat dhe atlaset e rrugëve më të njohura dhe më të mira për bibliotekarët janë këto: *Rand McNally Road Atlas* (Çikago: Rand McNally, e përvitshme. $17); *AAA North American Road Atlas* (Uashington, DC: AAA, e përvitshme. $11.); *National Geographic Road Atlas* (Uashington, DC: National Geographic Society. E përvitshme. $17.)

Ka një sërë hartash të ndryshme prej atyre që janë të lehta për t'u bartur deri te hartat me informacione të hollësishme për këmbësorin. Po ashtu, në botim lëshohen edhe harta falas, të cilat jepen në metro ose në stacionet e autobusëve. Asociacioni Amerikan i Automobilave (AAA) e para nisi me hartat e udhëtimit që me ngjyrë të lehtë të kuqe ose të verdhë mbi hartën e shtypur e tregonte rrugën e dëshiruar nga vozitësi. "Trip TIK" ende është një broshurë harte mjaft e popullarizuar për miliona shoferë.

Të botuar në radhë të parë për udhëtuesit dhe posaçërisht për vozitësit/shoferët, këto harta dhe planifikime të udhëtimeve janë të një rëndësie po aq të njëjtë edhe për bibliotekarët. Pika e parë është e më se e qartë, pra ajo se ato ofrojnë harta të përdorshme, të lehta për t'u lexuar për një vend të caktuar (vend, qytet ose shtet). E dyta, shumica e këtyre hartave ofrojnë edhe një sasi të madhe të informatave prej kushteve klimatike deri te lokacioni i parqeve, muzeve dhe vendeve të bizneseve më të mëdha. E gjithë kjo ka një vlerë të madhe për studentin ose personin joprofesionist, i cili tenton t'i kuptojë kushtet në një pjesë të caktuar të

Shteteve të Bashkuara (shënim: Gati të gjitha versionet hartat e rrugëve dhe të magjistrale në versionin CD-ROM dhe atë Online janë të përshkruara si për amerikanë. Megjithatë, këto harta ofrohen edhe për Kanadanë, Amerikën Qendrore dhe atë Latine, Evropën dhe pjesët e tjera të botës).

Një prej hartave më të mira të rrugës në versionin CD-ROM është bërë nga Rand McNally. Ka diku rreth 650 000 milje të rrugëve dhe diku rreth 125 000 qytete në bazën e vet të të dhënave. Shoferi që kërkon rrugën më të shkurtër nga Seatlle deri në Uashington DC thjesht mund ta shikojë *Rand McNally TripMaker* për të gjetur përgjigjen. Duke shënuar pikën e nisjes dhe të destinacionit, rruga vizatohet në hartë. Ju mund ta ndani këtë sipas qyteteve, parqeve, vendeve historike dhe gjëra të tjera, të cilat dëshironi që t'i vizitoni gjatë udhëtimit. Mund të përdoret edhe për të parë se sa distancë/kilometra janë kaluar në ditën e parë, dytë, e kështu me radhë. Dhe, për secilin komunitet ofrohet një ndarje e rrugëve dhe vendeve kryesore.

Duke përdorur atlasin *Street Atlas USA* (ose atlasin e ngjashëm nga *DeLrome AAA Map'n'Go*), përdoruesi ka shansin për ta hetuar çdo rrugë të shënuar në Shtetet e Bashkuara. Përdoruesi mund ta shikojë të gjithë vendin në ekranin e tij e po ashtu edhe mund të përdorë opsionin e afrimit (zoom) për të parë qytetin, rrugën, lagjen e tij. Vetëm shënoni pikën fillestare dhe atë të destinacionit dhe kështu harta është gati. Këtu jepen edhe vlerësimet *AAA* të hoteleve, moteleve, si dhe restoranteve, duke treguar edhe atraksionet me anë të multimedias. Botuesi thotë se versioni CD-ROM ka më se 5 milionë rrugë dhe 1.1 milionë veçori gjeografike dhe ato të bëra nga njeriu. Për më shumë se emri i rrugës, harta e projektuar jep të dhëna mbi veçoritë fizike, udhëkryqet dhe ndërtesat kryesore. Duke u afruar dhe larguar nga vendi Y, përdoruesi për shembull mund të gjejë rrugën e dëshiruar, ose rrugët sipas emrit, e madje edhe sipas kodit postar të qytetit ose vendit të caktuar. Ju mund të krijoni hartat ashtu që ju nevojiten juve. Ky atlas, që është i lehtë për t'u përdorur dhe i lirë për t'u blerë, është atlas që gjenden në shumë shkolla dhe biblioteka publike.

Atlasi *Compas* që tregon hartat e të gjitha rrugëve të Shteteve të Bashkuara, është një atlas tipik në version CD-ROM, që përdoret në referenca. Përdoruesi i tij mund të afrohet ose largohet nga rrugët duke përdorur miun e kompjuterit të tij. Janë rreth 16 nivele të opsionit të afrimit (zoom) që shkojnë nga 500 milje deri në .05.

Kërkimi mund të bëhet në shumë mënyra, mirëpo në radhë të parë

sipas qytetit, emrit të vendit dhe adresës së rrugës. Mundësitë e tjera përfshijnë edhe gjetjen e gjatësisë dhe gjerësisë, si dhe kodin postar. Softueri lejon përdoruesin që të korrigjojë hartat duke shtuar material, e duke bërë gjëra të tjera. Programi përfshin në vete edhe simbolet standarde hartografike, të cilat mund të zhvendosen në hartë.

UDHËZUESIT TURISTIKË

Online: Fodor's World View. Nju-Jork: Fodor's Travel Publications, 1997 e derimë sot, www.fodors.com. Ofrohet falas në Internet.

E Shtypur: Fodor's... Nju-Jork: Botuesit ndryshojnë, 1953 e deri më sot, e përvitshme.

E shtypur: Guides Michelin. Paris: Service de Tourism Michelin, 1905 e deri më sot, e përvitshme.

E shtypur: Birnbaum... Nju-Jork: Houghton Mifflin, datat ndryshojnë.

Udhëzuesit turistikë (të udhëtimit) janë shumë të njohur nëpër biblioteka - dhe nëpër librari. Shumica e librarive kanë seksione të mëdha me udhëzues aktualë, posaçërisht gjatë stinës së pranverës dhe verës, në mënyrë që t'i tërheqë blerësit. Një prej këtyre blerësve mund të jetë edhe bibliotekari, i cili e bën blerjen në kërkim të edicioneve të reja dhe të qasjeve të reja në udhëtimet aktuale. Koleksioni i një biblioteke duhet të ketë një sasi të mjaftueshme të udhëzuesve aktualë, së bashku me veprat e njohura për gjeografinë dhe ato me fotografi piktoreske. Librat me fotografi janë shumë të mirë, atëherë kur përzihen me udhëzuesit.

Dy pyetjeve duhet t'u përgjigjet një bibliotekar i referencave. E para ka të bëjë me vendet që janë të njohura për shfrytëzuesit e bibliotekave. Përfundimisht, zgjedhja e parë e tyre janë udhëzuesit për Shtetet e Bashkuara dhe për Kanadanë. Më pastaj, vijnë udhëzuesit e Karaibeve për banorët e Bregut Lindor, për regjionet e Paqësorit dhe për banorët që jetojnë skaj Oqeanit Paqësor. Duke u kthyer nga Evropa, Anglia sikurse edhe mund të mendohet është vendi më i famshëm evropian, që është e ndjekur më pastaj nga vendet e tjera perëndimore. Natyrisht, asgjë nga kjo nuk vlen në rastin kur një individ dëshiron një udhëzues të caktuar për një vend të caktuar në botë. Në anën tjetër, konsensusi rreth pikave të interesimit ndihmon ndarjen e koleksionit.

Pyetja e dytë ka të bëjë me atë se cilët udhëzues janë më të mirët. Duke e ditur se pikat e vlerësimit se kush është më i miri nuk janë të vendosura në tërësi, bibliotekari i referencave kthehet në botuesit e njohur dhe te analizat e pafundme të titujve të rinj. Zakonisht, vetëm çmimet ndryshojnë nga viti në vit, kështu që njerëzit mund të blejnë një version dhe të kalojnë tri katër vjet, pa u nevojitur, që ai botim të freskohet me informata. Kur ofrohet, një botim ose dy të blerë i përfshin informatat më të freskëta. Një kalendar i rregulltë, i cili siguron se freskimet e përvitshme me informata të udhëzuesve ofrohen, edhe nëse vetëm prej një ose dy botuesve, është më se i dëshiruar.

Botimet serike të botuesve mëtojnë të vënë fokus të veçantë në të dhënat e ngjashme themelore sikurse lokacioni dhe çmimet e hoteleve, orët e punës së muzeve dhe pikat e tjera më interes të veçantë dhe informatat mbi të kaluarën e vendeve dhe të njerëzve. Më tej se kjo, udhëzuesit fillojnë të ndahen në fusha të caktuara.

Udhëzuesi i parë standard është *Fodor's* (janë më se 300 të tillë me emra të shumtë sikurse ai *Fodor's Europe*), i cili ofron analizat dhe pamjet e hoteleve dhe të restoranteve. Udhëzuesit e botuar nga Michelin janë ndër më të vjetrit dhe më të besueshmit në botë. Një vëllim ka të bëjë me vendet e qëndrimit kur vizitoni vendin X ose Y, me një libër shoqërues, i cili liston të gjitha pikat e interesit dhe atraksionet që mund të vizitohen, vende për të cilat zakonisht jepen informata dhe sqarime të hollësishme. Udhëzuesit Birnbaum ofrojnë informacione të zakonshme e standarde për vendet që duhet parë dhe për ato që duhet qëndruar. Dhjetëra udhëzues të tillë, rregullisht freskohen me informata dhe janë posaçërisht të mirë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Fodor's është kompani tipike e udhëzuesve që kanë web-sajte. Në radhë të parë, web-sajti është një metodë e reklamimit të librave të shumtë. Në të gjenden disa reklama Online. Në të ofrohen "mini-udhëzues" për pushime që japin informacione rreth udhëtimit, atraksionet, dhomat me qira etj. Po ashtu, shfrytëzuesi mund të "krijojë edhe mini-udhëzuesit e tij", mirëpo bërja e një gjëje të tillë është e ngadalshme. Në këtë mënyrë, është shumë më e lehtë që të shikohet udhëzuesi, ose kontaktimi i agjentit të udhëtimeve.

"New Traveler" ("Udhëtuesi i ri") u shfaq në vitet '90-të. Informacionet në të janë marrë nga një numër i udhëzuesve që flasin për vendet e rrezikshme dhe të vështira.

Udhëzuesit e fushave janë të ngjashme me ato të *Fodor's*, edhe pse janë

një çik më të mirë. Borneo (1998) e përshkruan vetveten si një nga "udhëzuesit e aventuristëve për aventuristët". Narratori thotë: "Unë jam i lumtur këtu; i lagur deri në koc, në shoqëri të kafshëve, në mes të një xhungle primitive". Shumica e njerëzve do të dëshironin të qëndronin në shtëpi pas leximit të faqeve të para të Borneos. Ata të cilët pëlqejnë libra të tillë, mund të gjejnë ndihmë të madhe në botimin gati si të njëjtë të udhëzuesve të fushave si *The World's Most Dangerous Places* ose *Asia's Top Dive Sites* (në radhë të parë vendet me thellësi të madhe, të rrezikshme dhe tërheqëse). Botues të tjerë të udhëzuesve të udhëtimit prej *Lonely Planet* deri te *Rough Guides* ofrojnë ngushëllim të njëjtë për ata që kërkojnë që ta rrisin adrenalinën e tyre.

Në Internet[14]

Bibliotekari, i cili dëshiron material aktual mbi çdo gjë prej shfaqjeve të reja, orarit të punës së muzeve, deri te raportet ditore të motit dhe ndryshimit në këmbimore të dollarit, duhet ta përdorë Internetin. Kërkimi i thjeshtë është më i miri. Shënoni emrin e qytetit ose të vendit në katrorin e dhënë dhe shiko rezultatet. Duke shënuar Parisin ose Londrën, për shembull, do të shfaqen në ekran disa qindra vende e po ashtu edhe vende të njohura turistike rreth botës.

Studentët dhe personat joprofesionistë, të cilët kërkojnë informacione për një qytet ose një vend, shpesh gjejnë informata shumë të mira duke luajtur rolin e një turisti në Internet.[15] Shumica e web-sajteve japin informacione të hollësishme rreth vendeve historike, e skicave biografike të personaliteteve të rëndësishme prej politikës deri te sportet. Ky është në

[14] Revista Yahoo së paku një herë në vit, e disa herë edhe më shpesh, publikon për shkak të interesimit të njerëzve joprofesionistë raportet mbi web-sajtet më të mira të udhëtimit. Shkurtesat e informacioneve janë të vlerësuara dhe të krahasuara ndërmjet websajteve, p.sh. "Gold Star Travel Sites", Yahoo! qershor, 1999, f. 128+. Këtu jepet web-sajti Biztravel.com (www.biztravel.com), me etiketimin e të qenit web-sajt më e mirë për rezervimin e udhëtimeve. Po ashtu, shiko edhe krahasimet e ngjashme në The New York Times (13 Mmj, 1999, GI/G6) të "travel agent or travel site?

[15] Web-sajtet që do ta ndihmojnë udhëtuesin në fusha të ndryshme janë të shumta. Web-sajtet zakonisht hapen dhe mbyllen shumë shpejt, pra kanë një jetë të shkurtër. Të gjitha japin informata në pyetjet e udhëtimit prej hoteleve e klimës deri te vendet historike për t'u vizituar. Për llojet e web-sajteve, shiko: Around the World in 80 Clicks", Yahoo! qershor, 1999, f. 109-111. Përveç vendeve, çdo shtet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka një lloj të web-sajtit, zakonisht rreth asaj se çka i interesson turistit. Pra, vetëm shënoni emrin e shtetit në kutinë e kërkimit.

masë të madhe një lloj i kërkimit i tipit "qëllo-e huq", duke shënuar së pari vendin e qytetit. Mirëpo, nëse jeni të durueshëm, kështu mund të gjenden shumë të dhëna që do t'u hyjnë në punë.

web-sajtet e tilla më të mira:

Citysearch (www.sidewalk.citysearch.com). Artet dhe argëtimet aktuale, moti, lajmet lokale, vendet më të mira për ushqim dhe për të fjetur etj., për qytetet më të mëdha amerikane si Nju-Jork, San Francisko, Los Angjelos, Portland, Oregon, Uashington, e kështu me radhë, mund të gjenden këtu. Adresat, numrat e telefonit, udhëzimet e udhëtimit, e madje edhe harta mund të gjendet këtu. Problemi i vetëm është se ka shumë informata dhe detaje. Megjithatë, për një shikim të përgjithshëm të ngjarjeve të sotshme në një qytet të caktuar, kjo është web-sajti më e mirë.[16]

Excite. Your Guide to the World (www.excite.com/travel). Një faqe e rëndësishme me informacione gjeografike me linka për "qytetet më të mëdha", "hartat" dhe llojin e informatave. Kërkimi i fjalëve kryesore është i mundshëm derisa ofrohen edhe hartat e "top 25 qyteteve amerikane" dhe hartat e "top 25 qyteteve ndërkombëtare". Është e ngarkuar me reklama të shumta, por prapëseprapë një web-sajt i mirë.

Adventure Online (www.adventureonline.com) Derisa ky web-sajt është i mbushur me reklama, prapëseprapë është e rëndësishme për atë, i cili dëshiron që t'i hedhë një sy rrugës prej Nju-Jork-u deri në Amazonë. Informatat ndryshojnë nga raportet e menjëhershme me e-mail deri te informacionet për vendet e ndryshme gjeografike. Po ashtu, ka edhe të dhëna mbi aktivitetet aktuale arkeologjike rreth globit. Duke iu falënderuar sasisë së madhe të të dhënave politike dhe atyre gjeografike, është një web-sajt i përkryer për studentin dhe njeriun joprofesionist, i cili dëshiron informata për vende të caktuara të globit. Edhe pse metodat e kërkimit janë disa të përziera, nëse koha nuk është problem, atëherë ia vlen të vizitohen.

Expedia.(www.expedia.com) është një nga shembujt e mirë të web-

[16] Me pak zell e kërkim të kujdesshëm, mund të gjenden shumë lloje të informacioneve të tilla, si p.sh. web-sajt të caktuara për çdo gjë, duke filluar nga klima e një qyteti deri te ajo se kur është i hapur kopshti zoologjik. Për shembull, shiko City Rail Transit (http://pavel.physics.sunysb.edu/RR/metro.html). Kjo tregon hartat e metrove për qytetet e mëdha e jo vetëm për ato të voglat: pra prej hartave për Parisin deri te ato për Hoboken, deri te ato për kalimet e trenave në Nju-Xhersi.

sajteve të udhëtimit, të cilat janë bërë për ta ndihmuar individin në shumë gjëra, prej rezervimit të fluturimeve deri te gjetja dhe rezervimi i dhomave të hoteleve. Ka opsione të tilla, si "krahasimi i avio-kompanive dhe çmimeve që ato ofrojnë", ku në ekran dalin çmimet më të ulëta të biletave të aeroplanit prej vendit X në vendin Y. Ka edhe shumë web-sajte të tjera që mund të vizitohen.

Sugjerime për të lexuar

Black, Jeremy, Maps and History. Nju Haven, CT: Yale University Press, 1997. Ky udhëzues, i cili është më shumë se një histori, është po ashtu një udhëzues i shkëlqyer që tregon marrëdhëniet e hartave dhe të gjeografisë në jetën e përditshme, në ekonomi dhe në kulturë. Prej atlasit të Orteliusit, nga viti i largët 1570 e deri më sot, shkrimtari Black i gjurmon tregimet fascinuese të hartave. Shih, po ashtu, edhe vlerësimin e përafërt se çka mund të shohim ne në harta në dekadat që po vijnë.

Giles, Barbara, "The English-Language Guidebooks to Europe up to 1870" në Journey Through the Market nga Robin Myers. New Castle, 1999, f. 93-106. Një skicim i qartë e origjinal i datëlindjes së udhëzuesit dhe atë se si ishte përdorur nga individi anglez në shekullin XVIII dhe të XIX. Ka ndryshuar shumë pak në ditët e sotme. Njerëzit sot janë shumë të interesuar në pika të ngjashme.

Larsgaard, Mary, Map Relationships, edicioni 3. Englewood, CO: Libraries Unlimited, 1998. Ky është një udhëzues standard për subjektin me detaje të hollësishme në të gjitha aspektet e marrëdhënieve të hartave prej zgjedhjes së hartave deri te ajo se si përdoren hartat në shërbimet e referencës.

Lewis, G.M., J.B. Harley, dhe David Woodward, eds., The History of Cartography. Çikago: University of Chicago Press, 1987 e deri më sot. Njëri nga botuesit e këtij udhëzuesi historik, J. B. Harley, ka vdekur dhe deri në vitin 2000 kanë qenë të botuara vetëm pesë vëllime. Vëllimi i parë mbulon Evropën antike dhe atë mesjetare (botuar në vitin 1987), përderisa vëllimet e tjera flasin mbi hartografinë në vendet joperëndimore. Është një burim i jashtëzakonshëm për bibliotekat e mesme dhe

ato të mëdha. Pritet që numri i vëllimeve të rritet në 7 deri 10.

Sobel, Dave, Longtitute, Nju-Jork: Walker, 1995. 184 f. Një tregim i mrekullueshëm në atë se si të "lexohet" gjatësia (distanca në mes Lindjes dhe Perëndimit në tokën e matur me shkallë, gjatë çdo vije të gjatësisë). Enigma e marinarëve ishte zgjedhur nga John Harrison, një britanik, i cili ishte i pashkolluar. Zgjidhja, e cila i mori zbuluesit gati 46 vjet për ta perfeksionuar plotësisht, ishte një orë rezistuese e ujit që përdorej në det. Libri i Sobelit u bë bestseller (libri më i shitur).

Tenner, Elka dhe Katherine Weimer, "Reference Service for Maps", Reference & User Services Quarterly, vol. 38, nr. 2, 1998, f. 181-186. Si i gjen hartat e nevojshme bibliotekari i referencave? Pa problem nëse e ka një katalog të sofistikuar me shënime të detajuara bibliografike. Dy bibliotekarë të universitetit shpjegojnë rëndësinë e shënimeve të tilla dhe si ato duhet të ndryshohen për nevojat e sotme.

Wilford, John, "Redrawing the World", The New York Times, 6 shkurt, 2000, Kapitulli i Artit. Në faqe të ndryshme. Duke festuar edicionin e ri të National Geographic Atlas, kjo analizë e hollësishme jo vetëm i tregon meritat e një vepre të tillë, por zhvendoset dhe përdor disa qasje në gjykimin e atlasit.

KAPITULLI XII

DOKUMENTET QEVERITARE

Ç ka kanë të përbashkëta botimet si: *Atlas of United States Mortality, Flights of Discovery, Judaic at the Smithsonian, Revolutions From the Russian Archives, Coming to Grips With Your Finances, The North Dakota Tree Book* dhe së fundi *Be a Super Snooper Sleuth at Your Library*?[1]

Të gjitha këto janë dokumente qeveritare. Pra, qeveritar është çdo publikim që botohen me shpenzimet e qeverisë ose është e botuar nga një organ qeveritar. Zyra e Shtypit e Qeverisë Amerikane është përgjegjëse për publikimin e dokumenteve, mirëpo më shumë se 70 % e të gjitha botimeve qeveritare botohen nga firmat private, natyrisht që paguhen nga qeveria. Shumica e këtyre kontratave me firmat private bazohen në atë se kush ofron çmimin më të ulët dhe kushte të përshtatshme.

Publikimet janë të një spektri të gjerë prej grimit deri te intrigat ndërkombëtare dhe njerëzit e famshëm që tashmë i kanë mbushur të 100-tat. Këtu ka diçka për secilin. Me vendimin e viteve '90-të, Qeveria e

[1] "Notable Government Documents", Library Journal, 15 maj, 1998. Titujt ishin zgjedhur si "fitues" në vlerësimin vjetor nga bibliotekistët të dokumenteve qeveritare më të mira në kategorinë e më të mirës si, në lokal, në shtet federal dhe ndërkombëtar. Këta artikuj botohen çdo vit rreth 15 majit.

SHBA-së iu bashkua web-sajtit botërore të Internetit.[2] Qasja falas në gati të gjitha dokumentet ofrohet nga Qeveria.

Vula e besueshmërisë dhe e autenticitetit është e garantuar në dokumentet qeveritare. Ndoshta, dikush nuk do të pajtohet me atë se çka është shkruar aty, mirëpo kjo nuk ka të bëjë me besueshmërinë dhe saktësinë e burimit. Faktori paralel i besueshmërisë dhe i një numri të madh të informatave dhe i informatave që ofrohen falas e bën web-sajtin e Qeverisë (e cila në të shumtën e rasteve identifikohet me prapashtesën .gov), një vend ideal për të gjetur informata aktuale.

Shumë dokumente të shkruara janë futur në formatin digjital. Zyra e Botimeve/Shtypit të Qeverisë së SHBA-së ka ndërruar bazën e të dhënave të saj në atë digjital, edhe pse ende i ka formatat e shtypura për titujt e përgjithshëm dhe popullor. Ky trend po bëhet ndërkombëtar. NATO në Belgjikë, për shembull, ofron citime të gati 45 000 letrave/shkrimeve në bazën e të dhënave NATO-PCO, të botuara çdo vit që nga viti 1973. Shumica e veprave bazike nga ky kapitull ofrohen edhe Online. Përfaqësojnë vetëm një shembull të numrit të stërngarkuar të titujve që shkojnë nga Toxic Release Inventory e marrë nga *Superintendent of Documents* deri te National *Economic-Social and Environmental Database* e marrë nga Departamenti Amerikan i Tregtisë.

Dokumentet qeveritare kanë disa të meta: (1) të dhënat e ofruara në Internet janë nga vitet '80-të apo fillime i viteve '90-të. Ka shumë pak informacione të hershme në versionin digjital; (2) një sasi e konsiderueshme e përsëritjeve mund të hasen në shumë departamente dhe agjenci të ndryshme; (3) së fundi, ka probleme me shkarkimin e informatave. Të gjitha web-sajtet qeveritare ofrojnë informata të panumërta, përveç nevojave të specialistit, të studentit ose të një personi joprofesionist. Situata kur një person i thjeshtë hyn në web-sajtet e qeverisë dhe shpenzon kohë duke kërkuar gjëra të ndryshme është përmbledhur mjaft mirë nga një ekspert i çështjeve të tilla:

Gjetja e informacioneve të Qeverisë së SHBA-së në Internet shpesh duket si ecje nëpër një shtëpi të çuditshme. Kjo shtëpi ka gjëra të reja, të

[2] Ky është një akt ligjor nga Kongresi amerikan i 104 (viti 1995) me të cilin akt të gjitha informacionet federale ofroheshin falas për publikun në internet. Vendimi për t'i futur informatat qeveritare në internet ka rezultuar në një debat të ashpër midis atyre që trumbetojnë për interesat e publikut të cilët besojnë se këto informacione duhet të ofrohen falas dhe në anën tjetër të kompanive të cilat i blejnë këto të dhëna nga qeveria për t'i rishitur më pastaj.

ndryshme dhe interesante, të cilat ju kurrë nuk keni pritur se do t'i shihni, edhe nëse do t'i njihnit banuesit e asaj shtëpie. Disa herë ju gjeni dhoma të tëra në atë shtëpi, të cilat janë të mahnitshme, si një galeri arti në katin e dytë.[3]

Formati i dokumenteve

Dokumente qeveritare mund të hasen në formate të ndryshme. Ato kanë një gjë të përbashkët dhe ajo gjë e përbashkët janë numrat: në vitin 2000, *Superintendent of Documents* shiti më shumë se 100 milionë kopje të publikimeve të saj. Në fillim të vitit 2000, Qeveria Federale Amerikane po shpenzonte prej 6 deri 7 miliardë dollarë, çdo vit, në burime të informatave.

Dokumentet mund të shikohen edhe nga prizmi i agjencive, të cilat i lëshojnë ato dokumente: agjencitë kongresionale, juridike dhe ekzekutive, të cilat përfshijnë shumë departamente dhe nëndepartamente. Dokumentet klasifikohen si: (1) regjistrime ose arkë e administratave të Qeverisë; (2) si dokumente kërkimi për specialistët, përfshirë edhe një numër të konsiderueshëm të të dhënave statistikore dhe të dhënave me vlerë për shkencën dhe biznesin; dhe (3) burimet e njohura të informatave.

Përderisa ky vendim ka të bëjë vetëm me dokumente federale, organet shtetërore, të distrikteve dhe komunave, po ashtu lëshojnë në shtyp publikime. Hapësira na lejon që të përmendim vetëm dokumente lokale në

[3] Syndey Pierce, një profesor veteran i shërbimeve të referencave, thotë se "gjërat po shtohen aq shpejtë në web-sajtet e GPO (Zyrën e Shtypit/Botimeve të Qeverisë) saqë e vetmja gjë që mund të bëhet është kontrollimi i të dhënave të reja: (www.gpo.gov)". Shiko, edhe: Infomime. Universiteti i Kalifornisë (http://libwww.ucr.edu). Web-sajti i këtij universiteti ofron linka për mëse 5 000 burime në Internet, duke përfshirë këtu edhe një numër bazash qeveritare të të dhënave në të cilat dokumentet mund të kërkohen duke shënuar fjalën kryesore, subjektin, titullin, ose kombinime të tjera. Ky web-sajt është posaçërisht e dobishme për shkakun se përfshin jo vetëm agjencitë federale, mirëpo edhe disa agjenci qeveritare lokale dhe shtetërore e po ashtu edhe një përzgjedhje të mirë të qeverive dhe organizatave ndërkombëtare. Shënimet e shkurtra flasim mbi përmbajtjen, atë se çka mbulon, dhe qëllimin e linkut. Është edhe një "tabelë e përmbajtjes", e cila është e lehtë për t'u lexuar dhe për t'i gjetur informacionet e duhura. Po ashtu, gjendet edhe seksioni "çka ka të re" në të cilin seksion mund të hasen materialet e reja, të cilat janë futur brenda 20 ose 30 ditëve. Federal Web Locator (www.Infoctr.edu/fwl/). E botuar nga Qendra për Informata mbi Ligjin dhe Rregullat e Villanova University, ky web-sajt ofron linka për web-sajtet më të mëdha qeveritare. Mekanizmi i kërkimit është i lehtë për t'u përdorur dhe organizimi i web-sajtit është i lehtë për t'u kuptuar.

këtë libër, mirëpo që të gjitha këto dokumente kanë një rëndësi të madhe për biblioteka.

Disa prej mistereve që i rrethojnë dokumentet qeveritare mund të largohen vetëm nëse ju e krahasoni qeverinë me një botues mesatar privat. Procesi i botimit është përafërsisht i ngjashëm, edhe pse normalisht botimi komercial është i shprehur në një mënyrë më të përshtatshme.

ORGANIZIMI DHE PËRZGJEDHJA

Kontrolli bibliografik dhe përdorimi i përditshëm i dokumenteve në veprat referenciale është zakonisht i vështirë dhe kërkon njohuri speciale mbi atë eksperiencën e zakonshme, që mund të ketë një bibliotekar i zakonshëm. Megjithatë, ekzistojnë disa udhëzues bazikë dhe disa qasje, të cilat duhet të jenë të njohura për të gjithë bibliotekarët.

Organizimi dhe përzgjedhja e dokumenteve qeveritare është i ngjashëm, përveç në rastin kur kemi të bëjmë me biblioteka të mëdha. Bibliotekarët blejnë (ose marrin falas) një numër të kufizuar të dokumenteve në versionin e shtypur, zakonisht të kufizuar në interesimet mbi subjektet e përdoruesve ose titujt standardë, sikurse që është *Statistical Abstract of the United States.*[4] Nëse ato janë pamflete, ato zakonisht futen në bibliotekë sipas subjektit në sirtarin vertikal. Nëse janë libra, ato katalogohen dhe futen nëpër rafte si të tilla. Nëse gjenden në versionin digjital, ato janë pjesë e versionit CD-ROM dhe shërbimit Online të referencave.

Qëllimi i *Superintendant of Document* është kthimi i të dhënave nga formati i shkruar në atë elektronik. Përfundimisht, shumica e dokumenteve të shtypura do të zhduken. Ato do të zëvendësohen nga formatet elektronike dhe posaçërisht atyre Online. Kur kjo edhe ndodh, organizimi do të jetë një problem i llojit tjetër. Përderisa bëhen përgatitjet elektronike për artikujt e tillë (posaçërisht para 1990-ës), metodat e organizimit të dokumenteve të shtypura do të jenë të njëjta.

Normalisht, bibliotekari i referencave do të jetë përgjegjës për përvetësimin e dokumenteve. Konfuzioni është minimal për shkak se dokumentet qeveritare trajtohen drejt, si edhe çdo informacion tjetër, ose

[4] Përgjatë këtij libri, dokumentet dhe botimet individuale qeveritare janë përshkruar në kategoritë që u takojnë, si p.sh. në kapitullin e "Referencave të gatshme" ose në "Bibliografi". Në këtë kapitull, fokusi kryesor është vetëm në dokumente si dokumente, e jo si dokumente që janë pjesë e një tërësi referencore.

burim. Udhëzuesit, ata digjitalë dhe letrat e shumta ndihmojnë bibliotekarin që t'i radhisë dhe t'i klasifikojë dokumentet e njëjta, zakonisht me freskime të informatave Online.

Kur zhvendosemi në biblioteka më të mëdha dhe më të specializuara, metoda e organizmit ose është një koleksion më vete në dokumente qeveritare ose është pjesë integrale e dokumenteve në koleksionin e përgjithshëm, pra rasti në bibliotekat e vogla.

Madje, edhe bibliotekat e mëdha tentojnë që t'i integrojnë dokumentet qeveritare në koleksionet e tyre të përgjithshme, edhe pse integrimi i tërësishëm është shumë i rrallë. Justifikimi për një koleksion të ndarë është ai se vëllimet e publikimeve e fundosin bibliotekën dhe e bëjnë të nevojshme një qasje speciale të organizimit dhe të përzgjedhjes. Janë edhe disa arsye të tjera si ajo se bibliotekarët gjithmonë kërkojnë rrugën më të thjeshtë dhe më të mirë për t'i bërë të gatshme dhe për t'i ofruar këto dokumente. Koleksioni i ndarë dokumentar i izolon materialet nga koleksioni qendror i referencave. Bibliotekarët e referencave janë të prirur të mendojnë për të si një gjë e ndarë e shkëputur dhe në të shumtën e rasteve u përgjigjen pyetjeve me materialet që i kanë në dorë pa tentuar fare që të shkojnë dhe të kërkojnë dokumente në departamentin e caktuar.

Përdorimi i madh i shërbimeve digjitale të referencave i kanë afruar më afër koleksionin e dokumenteve me jetën e përditshme të një bibliotekari të zakonshëm të referencave. Prapëseprapë, kur vjen deri te vendosja e materialeve (të shtypura ose Online), zakonisht kjo punë i lihet specialistit.

Bibliotekat private kundrejt atyre publike

Tani që shumica e dokumenteve qeveritare ofrohen falas në Internet, pse transportuesit privatë, sikurse DIALOG vazhdojnë të ofrojnë Online dokumente të tilla dhe a i ofrojnë edhe ata falas? Përgjigjja është te shërbimi. Disa thonë se firmat private ofrojnë kërkim më të sofistikuar, dërgesa më të shpejta të dokumenteve (Online apo edhe prej fax-it apo e-mail-it).

Duke e krahasuar një shërbim privat (si *CIS's Congressional Universe*) me shërbimet qeveritare, "Reference Books Bulletin" arrin në një përfundim të mirë kur krahasohen shërbimet publike dhe ato private: Krahasuar me bazën qeveritare të të dhënave, "*Congressional Universe*

ofron një indeksim dhe abstraktim superior dhe më shumë tekst, i cili mbulon një numër të madh të viteve".[5] Ju mund edhe të habiteni e të pyesni se sa gjatë mund të vazhdojnë kompanitë private të ofrojnë dokumente më një çmim kur qeveria po i ofron ato falas në Internet? Askush nuk e di përgjigjen.[6]

Një shembull tipik i asaj se si një kompani private i merr dokumentet qeveritare dhe vendos një çmim për përdorimin e tyre mund të gjendet në *Northern Lights* (duhet të theksohet se ky është vetëm një shembull. Mund të ndryshojë nesër. Mirëpo, prapëseprapë e ilustron qasjen e përgjithshme të stilit "kthimi i dokumentit pa para në atë me para). Atëherë, çka merr biblioteka kur paguan? *Northern Lights* dhe të tjerët që janë të suksesshëm në këtë fushë, e kanë përgjigjen e gatshme: shërbim komplet dhe të shpejtë.

Shërbimi quhet *Usgovsearch* (www.usgovsearch.com). Është një web-sajt, në të cilin me një opsion të vetëm bëhet kërkimi, pra kështu eliminon nevojën për të kërkuar prej web-sajtit në web-sajt. Ky web-sajt thotë se mbulon apo indekson diku rreth 22 000 web-sajte ushtarake dhe ato qeveritare. Këtu mund të gjenden rreth 4 milionë faqe... *Northern Lights* thekson se vetëm ¼ e web-sajteve qeveritare mund të gjenden përmes mekanizmave të tjerë të kërkimit. Ata thonë se mbulojnë gati 100 % të web-sajteve të tilla. Pagesat për to ndryshojnë. Për shërbimet e *Northern Lights* paguhet prej 5 dollarëve në ditë deri në mbi $1 000 për vit.

Vlerësimi

Nuk ka probleme me vlerësimin e dokumenteve qeveritare. Nuk ka zgjidhje. Ju ose e pranoni ose e kundërshtoni, thotë *The Statistical Abstract of the United States*. Qeveria nuk ka konkurrentë dhe vlerësimi i dokumenteve të tilla në termin e përvetësimit është po aq i pafrytshëm sikurse edhe urdhërimi i deteve që të thahen. Dokumentet qeveritare janë unike dhe askush, askush fare, nuk do t'i sfidojë ato me ndonjë publikim tjetër. Në ditët e sotme, vlerësimi bëhet më shumë në atë se sa informata janë dërguar sesa vlerësimi i informatës në tërësi. Cili është softueri më i mirë

[5] Booklist, 15 qershor, 1998, f. 1 800.

[6] Kjo është një enigmë e cila i tregon dallimet e nocioneve midisi firmave private dhe atyre publike. Për shembull, një ide është se të bëhet që qeveria t'i a transferoj të drejtat e autorit dhe ato të pronësisë një botuesi në sektorin privat. Kjo do ta zgjidhte problemin e ashtuquajtur "falas në Internet", mirëpo çka do të bëhej atëherë me publikun?

në versionin e shtypur apo në digjital për tekstin e *Congressional Record*?

Bibliotekat e thesareve[7] (depozitave)

Në mënyrë që të sigurohet që dokumentet janë të gatshme dhe ofrohen, Qeveria ofron një vend ku mund të shihet kjo gjë. Këto quhen bibliotekat e thesarit, apo të depozitave. Janë diku rreth 1 400 biblioteka të thesareve apo depozitave në Shtetet e Bashkuara, së paku një në secilin distrikt kongresional. Qëllimi këtu është për të pasur qendra me dokumente qeveritare të vendosura nëpër të gjithë vendin. Në vitin 1995, Programi Federal i Bibliotekës Depozitare (DLP) e shënoi 100 vjetorin e saj të themelimit.

Agjencitë federale nuk kanë mandat që ta shpërndajnë materialin e këtij programi. Shumica e informacioneve janë humbur dhe vazhdojnë të humben edhe më tutje. Një sistem qendror, i cili siguron të gjitha depozitimet, e jo vetëm burimet e përzgjedhura të dokumenteve qeveritare, është i nevojshëm dhe kjo po ndodh, gjithmonë e më shpesh, ndërmjet Internetit. Grremçi deri më tani: mungesa e dokumenteve të hershme qeveritare dhe e një rruge për t'i detyruar të gjitha agjencitë që t'i ofrojnë dokumentet që ata i quajnë "sensitive" për publikun.

Këto biblioteka të depozitave marrin publikime falas në versionin e shtypur prej *Superintendent of Documents*. Në secilin nga 50 shtetet në SHBA, gjenden një ose më shumë biblioteka depozitare, të cilat pranojnë çdo dokument të paklasifikuar qeveritar. Vetëm pak biblioteka të tjera i pranojnë të gjitha dokumentet qeveritare (mesatarja është diku 54 % e publikimeve). Gati 2/3 e bibliotekave të thesareve apo depozitave janë akademike, përderisa bibliotekat publike përbëjnë 20 % të totalit.

Përqindja e mbetur (më pak se 14) përbëhet nga bibliotekat federale, agjencitë shtetërore, gjykatat, shoqatat historike, medicinale etj.

Problemi themelor, me të cilin përballen të gjitha e më së shumti bibliotekat depozitare është vëllimi i materialit. Shumica e tij ka përdorim të kufizuar dhe një pjesë e madhe e materialit përbën informata statistikore që s'hyjnë fortë në punë, ose të mbledhura më shumë për shkak të grum-

[7] Kur të gjitha dokumentet qeveritare do të ofrohen Online, biblioteka e thesareve apo depozitave mund të zhduket. Vetëm disa biblioteka të tilla mund të mbahen për të ruajtur dokumente retrospektive, mirëpo jo për titujt aktual të cilët tashmë mund të ofrohen në formatin elektronik. Në mënyrë që të përzgjidhet një grup i caktuar federal i bibliotekave depozitare në Internet, shiko: Federal Depositary Library Gateways. Superintendant of Documents. (www.access.gpo.gov/su_docs/aces/aaces004.html). Kjo ofron linka për mëse 20 biblioteka gjeografike prej Kalifornie deri në Merilend. Secila nga to jep instruksione se si duhet të përdoret shërbimi i bibliotekës për hyrje në dokumente.

bullimit sesa për një qëllim të caktuar. Problemi i vëllimit do të zgjidhet duke i vendosur shumicën, nëse jo të tëra, e dokumenteve në formatin digjital.

Përvetësimi[8]

Bibliotekat depozitare kanë një sërë problemesh të veçanta, mirëpo për bibliotekarin e zakonshëm, procesi i përvetësimit është më se i thjeshtë. Atëherë kur përzgjidhet dokumenti në versionin e shtypur ose në CD-ROM për blerje, përvetësimi i tij nuk është më i vështirë- në të vërtetë, shumicën e rasteve është diçka më i lehtë – sesa i një libri ose periodiku.

Pak biblioteka dëshirojnë që të mbështeten totalisht në dokumentet bazike qeveritare (ose, dokumente më konfidenciale) vetëm në formatin digjital. Përderisa kjo ndryshon, hapat e treguar më poshtë janë rregullat që duhet të ndiqen.

Pagesat mund të bëhen përpara duke blerë kuponët prej *Superintendant of Documents*. Në rastin kur kemi blerje të mëtutjeshme, llogaria bankare e depozitave duhet të hapet.

Disa dokumente mund të merren falas prej anëtarëve të Kongresit amerikan. Megjithatë, për shkak se furnizimi me dokumente është i kufizuar, anëtari i Kongresit duhet të njoftohet me shkrim përpara për nevojën në fjalë. Është posaçërisht gjë e mirë që të hyni në listën e postës elektronike të një përfaqësuesi apo senatori amerikan, në mënyrë që t'i merrni publikimet. Agjencitë e publikimeve zakonisht kanë një sërë publikimesh, të cilat duhet të porositen drejtpëdrejt prej agjencisë në fjalë. Këtu hyjnë zakonisht materialet e specializuara, prej dokumenteve ERIC deri te raportet shkencore.

Janë disa librari qeveritare, të cilat shesin dokumente. Për më shumë, disa librari të mëdha private shesin të gjitha dokumentet, ose së paku librat e botuar nga qeveria, të cilët kanë të bëjnë më subjekte të njohura prej hapësirës deri te kopshti.

Shumë qytetarë, çdo ditë, blejnë dokumente qeveritare pikë së pari për shkak të llojit të informatave të tipit "si bëhet kjo gjë" e po ashtu edhe për

[8] Përsëri, kur të gjitha dokumentet ofrohen Online, figura e përvetësimit do të ndryshojë. Atëherë mund të jetë edhe më e lehtë qasja në formatet digjitale. Megjithatë, komplikimet janë të garantuara dhe janë të pashmangshme.

hobit e tyre dhe interesat e tyre. *The U.S. Consumer Information Center* (www.pueblo.gsa.gov) është një burim i një numri të madh të dokumenteve të ndryshme qeveritare, shumica e të cilave u interesojnë dhe janë me vlerë për njerëzit joprofesionistë. Informacionet me bibliografi të plotë janë të dhëna këtu dhe ju mund ta bëni porosinë Online pasi burimi i një dokumenti të caktuar tregohet së bashku me çmimin e tij. Radhitja është sipas kategorive të mëdha të subjekteve që ndahen më pas në pjesë të tjera. Shënim: Disa (mirëpo jo të gjitha) dokumente mund të lexohen ose të shkarkohen nga individi në kompjuterin e tij/saj.

UDHËZUESIT

E shtypur: Morehead, Joe. Introduction to United States Government Information Source, edicioni 6. Englewood, CO: Libraries Unlimited, Inc., 1999, 440 f., $65.

E Shtypur: Schwarzkopf, Leory. Government Reference Books. Englewood, CO: Libraries Unlimited, Inc., 1972 e deri më sot, çdo dy vjet. $67.50.

Libri themelor apo bazik në këtë fushë është vëllimi nga *Morehead*, i cili korrigjohet gati çdo pesë vjet. Është një kombinim i mirë i fakteve, i librave të referencës së individëve dhe një shpjegim i qartë e konciz i asaj se si qeveria arrin t'i botojë dokumentet. Duke iu falënderuar organizimit superior dhe një stili mjaft të mirë të të shkruarit, ky libër është i lehtë për t'u lexuar. Edhe fillestari e edhe eksperti këtu mund të gjejnë ndihmë mjaft të madhe. Është vendi i parë, i cili duhet shikuar atëherë kur jeni të hutuar rreth disa aspekteve misterioze të përvetësimit, organizimit dhe përzgjedhjes së dokumenteve qeveritare. Edicioni i gjashtë vë theks të veçantë në atë se si informacionet digjitale e kanë ndryshuar, në mënyrë drastike, qasjen në publikimet qeveritare. Duhet shikuar në veçanti kapitulli 11, i cili është një shpjegim i qartë i shumë departamenteve dhe agjencive.

Government Reference Boooks botohet çdo dy vjet dhe është një përmbledhje e librave themelore të referencave, shumica e të cilëve nuk janë të njohur as për personin joprofesionist e as për ekspertin. Radhitja dhe aranzhimi është sipas subjekteve të mëdha, pra sipas atyre të

përgjithshme, shkencave sociale, shkencës dhe teknologjisë dhe humaniteteve. Më pastaj, dokumentet janë të indeksuara sipas autorit, titullit, dhe subjektit. Secili prej tyre shpjegohet në mënyrë të tërësishme. Çdo dy vjet shënohen rreth 1 200 tituj. Të redaktuar, në mënyrë shumë të kujdesshme dhe të lehtë për t'u përdorur, biografia *Schwarzkopf* i shtohet burimeve standarde.

Përzgjedhja më e mirë e dokumenteve qeveritare për bibliotekat e vogla dhe ato të mesme botohet, çdo vit, nga Asociacioni Amerikan i Bibliotekave të Dokumenteve Qeveritare ose shkurt GODORT. Lista e shënimeve përfshin rreth 50-75 botues federalë, shtetërorë e lokalë, e po ashtu edhe ato të botuara nga grupet ndërkombëtare. Zakonisht, lista haset në muajin maj në *Library Journal. Guide to Popular U.S. Government Publications* nga Frank Hoffman (edicioni 5. Englewood, CO: Libraries Unlimited, 1998, 300 f.). Edicioni i vitit 1998 – i cili freskohet shumë shpesh me informata, mbulon publikimet/botimet e lëshuara prej vitit 1995-1996. 1 600 titujt janë të organizuar sipas temave të gjëra.

Në Internet

Janë disa dhjetëra udhëzues për qasje në Internet në burimet e informacioneve qeveritare. Tri nga më të mirat që freskohen shpesh me informata janë: *Peter Hernon et al., U.S. Government on the Web* (Englewood, CO: Libraries Unlimited). Edicioni i parë i këtij botimi u botua në vitin '99. Si i tillë, edicioni i parë është një udhëzues i mirë për më se 1 000 web-sajte të besueshme qeveritare. Fokusi i saj më shumë është në shfrytëzuesin e zakonshëm (si p.sh., nxënësit e shkollave të mesme) e më pak për kërkuesit/hulumtuesit. Zgjedhja e parë për shumicën e bibliotekave.

Dy vëllime të tjera mbështetëse, të cilat freskohen shpesh me informata janë: *Bruce Maxwell, How To Access the Federal Government on the Internet* (Uashington, DC: Congretional Quarterly) dhe Greg Notess, *Government Information on the Internet* (Lanham, Marilend: Bernan Press). *Maxwell* përfshin përshkrimet e më se 500 web-sajteve federale në Internet. Shënimet janë plot me të dhëna dhe më instruksionet themelore se si të gjendet web-sajti e caktuar. Në të gjenden edhe disa kapituj të mirë në hapje rreth përdorimit të dokumenteve qeveritare për studim dhe kërkim/hulumtim. Notess është më pak përzgjedhje, mirëpo përfshin më shumë web-sajte, ku liston secilin prej tyre, duke dhënë po ashtu edhe shënime.

Hulumtimi në Internet

Është më se e qartë se web-sajtet e qeverisë ndjekin në masë të madhe një format standard. Ato përfshijnë, edhe pse jo gjithmonë në radhitje të tillë, të dhënat e tilla si: (1) informatat nga e kaluara dhe historia e agjencisë ose e degës; (2) stafin ose personelin kryesor, zakonisht me e-mail adresat e tyre; (3) një shpjegim i asaj se çka është duke bërë agjencia tani për tani, natyrisht duke dhënë edhe disa detaje; (4) një listë të publikimeve dhe katalogëve, të cilët mund të porositen ose në raste të rralla mund edhe të shikohen në Internet; (5) linkat për organizatat e njëjta, e po ashtu për nënagjencitë dhe divizionet.

Ekzistojnë disa mënyra për të hulumtuar apo kërkuar një dokument qeveritar në Internet. Atëherë kur dëshirohet që të gjendet web-sajti e caktuar, ju duhet t'i ndiqni metodat standarde të kërkimit, p.sh. përdorimi i logjikës Boolean, fjalët kryesore, frazat, emri i dokumentit ose i autorit.

Janë edhe disa dallime prej normales. Ju mund të gjeni me dokumente një titull specifik, duke përdorur numrin e klasifikimit të *Superintendant of Documents*. Ky numër i është vënë nga the Superintendant njëjtë sikurse edhe Biblioteka e Kongresit dhe bibliotekat individuale u vënë klasifikime decimale *Dewey* ose ndarjen Biblioteka e Kongresit. SDCN është në një format tjetër, mirëpo përdor metodat e njëjta të klasifikimit. Për shkak se ky web-sajt ka aq shumë informacione, është pak e mundur që të jetë shumë produktive, në përjashtim të rastit kur personi ka njohuri themelore rreth qeverisë.

Një metodë tjetër dhe si duket kjo është metoda më e mirë, është ndarja e web-sajteve në tre sektorë, p.sh. sektori ekzekutiv (dhe departamentet e tij), legjislativ dhe ai juridik. Për shembull, mediat e kanë treguar se sa e lehtë është për t'u arritur në Shtëpinë e Bardhë vetëm duke klikuar: (www.whitehouse.gov). Kjo është e vërtetë për dikë i cili/e cila dëshiron që të bëjë një shëtitje në Shtëpinë e Bardhë, t'i shikojë dokumentet historike, ose të marrë tekstin e plotë të deklaratave për shtyp të kësaj shtëpie. Shumica e kësaj që u tha është mjaft argëtuese për t'u bërë dhe pak arsimore, mirëpo ka aq shumë informacione saqë e lënë studentin të humbur kur ai dëshiron që materialin e gjetur ta fusë në artikullin ose esenë e tij. Në të njëjtën kohë, nëse bibliotekari është duke kërkuar tekstin e plotë të takimit të sotëm të Presidentit me mediat dhe e di se kjo është ajo çka i duhet, atëherë kjo është web-sajti primare për të.

Shënim: Vështirësitë për rregullimin e pornografisë në Internet është

më se i qartë kur dikush e vëren dallimin e vogël ndërmjet URL të Shtëpisë së Bardhë ose të një web-sajt tjetër, e cila ofron humor ose filma: (www.whitehouse.com). Dallimi i vetëm në URL është prapashtesa "gov" për qeveri dhe "com".

Kërkimi – në Internet

Rëndësia e të pasurit një web-sajt specifik për t'i kërkuar dokumentet qeveritare dhe informacionet rreth qeverisë mund të ilustrohet në mënyrë të shkurtër. Pyetja është se "Kush kontribuoi X shumë të dollarëve për Y njeriun që ishte kandidat për Kongres?"Përgjigjja mund të gjendet në gati të gjitha gazetat që ofrohen Online ose në indekset e revistave Online, por është pak e mundur që ky informacion të jetë në detajet e dëshiruara.

Basti më i mirë këtu është njohja se ku mund t'i gjesh web-sajtet, të cilat në mënyrë specifike janë të përfshira me zgjedhjet financiare dhe me qeverinë. Njohuria e punës së Komisionit të Zgjedhjeve Federale mund të jetë një fillim i mbarë. Kjo do të çojë në web-sajtet e tjera të ngjashme.

Këtu jepen tri web-sajte specifike për përgjigje specifike në pyetjen se kush dha çka.

Federal Election Commission – Komisioni Federal i Zgjedhjeve (www.fec.gov). Këtu tregohen kontributet individuale për fushatat politike e po ashtu edhe të dhënat që kanë të bëjnë me financimin e zgjedhjeve në përgjithësi. Këtu mund të gjenden edhe raportet financiare në detaje për të gjithë kandidatët dhe linkat për web-sajtet e ngjashme.

FECInfo (www.tray.com/fecinfo). Si një web-sajt komercial dhe që ofrohet falas për shfrytëzuesit në Internet, është një web-sajt që ofron një përzgjedhje të gjerë të statistikave qeveritare dhe të të dhënave mbi zgjedhjet dhe donacionet për fondet e kandidatëve zgjedhorë. Kënaqësia për shfrytëzuesin e zakonshëm është ajo se ai vetëm shkruan frazën, fjalën kryesore, ose emrin për të gjetur se çka në të vërtetë ofrohet aty. Përgjigjja do të jetë e shkurtër, mirëpo e saktë. Një pyetje tipike është e llojit të tillë si p.sh. çka ka dhënë personi X ose Y për këtë apo atë kandidat politik.

Common Cause (www.commoncause.org). Ky grup i interesit publik studion atë se si paratë ndikojnë dhe e influencojnë legjislaturën. Është shumë e njohur dhe shumë shpesh haset edhe në lajme. Materialet nga

kërkimet e saj ofrohen falas për publikun në Internet.

Ky është një shembull i thjeshtë se si të gjenden të dhënat e vështira në dokumentet qeveritare dhe në web-sajtet e ngjashme. Duhet pasur parasysh se kërkimi fillon me njohurinë mbi agjencinë qeveritare, zhvendoset te burimet e informatave private dhe përfundon, madje, me një qasje më të përgjithshme rreth problemit të parave dhe të qeverisë.

ORGANIZATA QEVERITARE

Online: In GPO Access (shih faqe 460)

CD: U.S. Government Organization Manual. Alexandria, VA: Government Counseling, Ltd., 1993 e deri më sot, e përvitshme. $99.

E Shtypur: United States Government Manual, Uashington: Government Printing
Office, 1935 e deri më sot, e përvitshme, 904 f., në fund të librit, $30.

E Shtypur: U.S. Congress Joint Committee on Printing, Official Congressional
Directory, Uashington, DC: U.S. Government Printing Office, 1809 e deri më sot, çdo dy vjet, 1625 f., në fund të librit, $15.

Normalisht, dokumentet federale zakonisht janë të ndara sipas burimit të dokumentit. Si edhe të gjithë e dimë, ndarja primare e qeverisë është në degën legjislative, ekzekutive dhe atë gjyqësore. Secila nga këto degë apo sektor qeverisës lëshon një sasi të madhe të materialeve:

1. *Presidenti/ Ekzekutivi*. Këtu janë shumë dokumente, edhe pse më të përdorurat janë urdhrat ekzekutivë dhe shpalljet presidenciale. Nën degën ekzekutive, ju mund të gjeni shumë departamente dhe agjenci;

2. *Departamentet dhe agjencitë qeveritare*. Edhe këto kanë interesat e tyre speciale dhe nëse dikush e di se çfarë lloji i publikimit mund të gjendet, le të themi NASA, është shumë e lehtë që të ngushtohet kërkimi në versionin e shtypur/CD-ROM apo në Internet;

3. *Legjislativi*. Kongresi, p.sh. Dhoma e Përfaqësuesve dhe Senati janë burime të një debati të vazhdueshëm rreth ligjeve, buxhetit dhe gati të çdo

gjëje tjetër, e cila është me interes për publikun amerikan. Ndërmjet veprimeve në praktikë dhe dëgjimeve e hetimeve, kemi një proces të vazhdueshëm të informatave;

4. *Juridik*. Kjo përfshin vendimet e gjykatave, duke filluar nga Gjykata Supreme e deri te gjykatat individuale federale përgjatë gjithë Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Manuali i Qeverisë së Shteteve të Bashkuara

Qëllimi kryesor i *Manualit* është dhënia e informatave të detajuara rreth organizatës, aktiviteteve dhe shefave ekzekutivë të të gjitha agjencive shtetërore në shtyllën legjislative, ekzekutive dhe atë juridike. Secila nga agjencitë shpjegohet në vete dhe pjesët përbërëse të tyre janë të definuar qartë. Në disa raste, jepen edhe diagrame e tabela të ndryshme. Stili i këtyre udhëzuesve është prezantimi i fakteve, në stilin përshkrues të mjaftueshëm për të mbajtur interesin e çdo njërit që është i përfshirë në çështjet e tilla.

Të dhënat udhëzuese botohen për çdo agjenci, ku po ashtu përfshihen edhe numrat e telefonave, adresat, emrat e zyrtarëve dhe adresat e zyrave regjionale për departamentet kryesore. Gjenden disa indekse, përfshirë edhe një sipas subjektit. Një opsion shumë i mirë i botimit vjetor është lista e agjencive të transferuara apo të mbyllura. Jepen edhe raportet e hollësishme. Kjo, me që ra fjala, është një justifikim për mbajtjen e udhëzuesve në rafte për vite të tëra. Ndodh shpesh, që dikush dëshiron informata për një agjenci të caktuar që mund të gjenden vetëm në edicionet më të hershme.

Dyshimet historike mund të hiqen në një tjetër vepër të mirë: *A Historical Guide to the U.S. Government* (Nju-Jork: Oxford University Press, 1997, 704 f., $95). Është një udhëzues i aranzhuar sipas radhitjes alfabetike, i cili mbulon të gjitha departamentet kryesore dhe agjencitë shtetërore e po ashtu edhe divizionet. Po ashtu, i mbulon në detaje edhe tre sektorët qeveritarë, subjektet e buxhetit, shërbimet “lighthouse” dhe Aktin e Lirisë së Shtypit. Një indeks shumë i mirë në të ndihmon shumë.

Një rrugë e shpejtë, edhe pse e shtrenjtë, për të gjetur informacione në më shumë se 200 000 vepra individuale rreth qeverisjeve federale, shtetërore dhe atyre lokale mund të bëhet ndërmjet *Carroll's Government Directory Online* (www.carrollpub.com). Me një çmim prej $1 300 për

vit, ky botim i jep bibliotekës fuqinë që të bëjë kërkime për emra në më se 20 forma të ndryshme prej shënimit të deri te titujt dhe funksionet.

Kongresi

E botuar në çdo dy vjet, *The Congressional Directory* përfshin bibliografitë e anëtarëve të Kongresit. Në kapitujt e kësaj vepre hyjnë edhe të dhënat rreth gjykatësve të Gjykatës Supreme, emrat e përfaqësuesve ndërkombëtarë dhe zyrat konsultative në Shtetet e Bashkuara, si dhe shefat ekzekutivë të departamenteve dhe agjencive të pavarura. Është vepër e llojit "kush është kush" në qeveri, së bashku edhe me adresat esenciale, numrat e telefonit, e madje edhe hartat e distrikteve kongresionale. Mangësia apo e meta: Çështjet ndryshojnë shumë shpejt në Uashington DC, derisa *Directory* bëhet çdo dy vjet. P.sh., nuk mund t'i besohet kësaj vepre për informacionet aktuale rreth detyrave të komitit ose për anëtarët që merren me mediat, të cilat që të dyja janë të përfshira. Dikush mund të mendojë që kjo vepër është aktuale, atëherë kur sapo botohet, por është gati gjashtë muaj prapa datës zyrtare të botimit. Problemi me të do të zgjidhet kur libri i referencës do të bëhet Online dhe do të freskohet me informata, atëherë kur është nevoja.

Ka shumë udhëzues të tjerë që janë më aktualë. Një shembull i tillë është *Staff Directory* (Mt. Vernon, VA: Staff Directories, 1990 e deri më sot, çdo gjashtë muaj, $395) e cila është në versioni CD-ROM dhe e cila në vete ka tri dosje të udhëzuesit, të cilat flasin rreth stafit të Kongresit, atij të sektorit juridik dhe stafit federal (rreth 30 000 qeveritarë dhe njerëzit ushtarakë). Që të tri këto dosje kanë një numër të kufizuar të bibliografive të shkurtra, e po ashtu edhe të dhëna standarde prej numrave të telefonit e titujve deri te adresat. Shumica e këtij udhëzuesi është një shënim i radhitur sipas rendit alfabetik me anëtarët e Kongresit, e po ashtu edhe komisionarët, delegatët dhe zëvendës-presidentët. Një shënim i shkurtër i llojit "kush është kush" përdoret për secilin emër.

Ndër udhëzuesit dhe burimeve biografike më të përdorura për anëtarët e Kongresit, në nivelin lokal dhe atë nacional, është *Who's Who in American Politics* – Kush është kush në Politikën Amerikane (Nju-Jork: R.R. Bowker Company, 1967 e deri më sot, botohet çdo dy vjet). Kjo vepër jep informata për më se 25 000 individë në nivelin federal, shtetëror dhe atë lokal. Të dhënat e llojit "kush është kush" përfshijnë edhe informacione për pozitat e tanishme, si dhe adresat aktuale me faktet

themelore biografike.

Ku mund të gjenden informacione për anëtarët e mëparshëm të Kongresit, të cilët nuk janë të listuar më në *Congressional Directory*? Ata do të listohen në burime të tilla, si *American National Biography* (nëse është i vdekur) ose në një enciklopedi. Mirëpo, për skica të shkurtra e objektive të gjithë senatorëve dhe të zgjedhurve në Dhomën e Përfaqësuesve, të cilët shërbyen nga viti 1774 e deri më sot, burimi më i mirë dhe i vetëm është *Biographical Directory of the American Congress*, 1774-deri më sot (Uashington: Government Printing Office, datat ndryshojnë e po ashtu edhe çmimet). Në kapitullin e parë të tij mund të gjenden qeveritarët e ekzekutivit. Shënim: Versioni Online falas ofrohet në: (http://bioguide.congress.gov). Është një botim i mirë për materialet aktuale që freskohen me informata, të cilat mund të mos gjenden në edicionet e shtypura.

Ekzekutivi dhe Juridiku

CD: U.S. Presidents. Minneapolis, MN: Quanta Press, Inc., 1990 e deri më sot, freskohet me informata kur është nevoja, $69.95.

E Shtypur: Kane, Joseph. Facts About the Presidents, edicioni 6. Nju-Jork: H.W. Wilson Company, 1993, 432 f., $75.

E Shtypur: Encyclopedia of the American Presidents. Nju-Jork: Simon & Schuster, 1994, 4 vëllime, $335.

Përgjigjet në pyetjet që kanë të bëjnë me presidentët mund të gjenden në detaje, goxha të hollësishme, në gati çdo enciklopedi e po ashtu edhe në udhëzuesit themelorë të Qeverisë, të cilët u diskutuan në këtë kapitull. Dy titujt e listuar këtu janë më të lehtë për t'u përdorur për shkak se ata ofrojnë fakte një në mënyrë të vazhdueshme dhe shumë mirë të organizuar. Natyrisht, që të dy janë të kufizuar për presidentët.

Çdo gjë që dëshirohet të dihet nga një person për një president mund të gjendet në versionin CD-ROM të U.S. Presidents. Ky disk, madje përfshin edhe fotografi të zotërinjve prej presidentit të parë e deri te presidenti i fundit, i cili u vendos në Shtëpinë e Bardhë. Përderisa të dhënat mund të gjenden në çdo enciklopedi tjetër, ky botim ka përparësi për shkak se ka krahasime statistikore dhe skicime historike të zonjave të para.

Seksioni i parë i *Kane* ka një kapitull për secilin nga presidentët, përf-

shirë edhe jetën familjare të tyre. Po ashtu, është e dhënë edhe biografia e tyre. E një përdorimi më të madh, së paku atëherë kur qëllimet janë referencat e gatshme, është pjesa e dytë, e cila është një udhëzues krahasimi i të gjithë presidentëve. Këtu mund të gjendet çdo gjë prej numrit të fëmijëve që secili ka presidentët ka pasur e deri te amaneti i tyre i fundit. Po ashtu, ofrohen edhe fakte të shumta rreth zyrës, duke filluar nga problemet juridike deri te kabineti i zyrtarëve.

Një vepër absolute në këtë fushë është vepra me katër vëllime e quajtur *Encyclopedia of the American Presidents*. Është një ëndërr e një dijetari. Ka shumë pak çka është lënë anash. Ka informacione prej dentistit të Xhorxh Uashingtonit deri te romancat e disa prej presidentëve të SHBA-së. Duke iu falënderuar indeksit të mrekullueshëm, mund të thuhet se ky është vendi apo shpresa e fundit për bibliotekarët e referencave, të cilët nuk janë në gjendje të gjejnë, për shembull, diçka më shumë rreth fatit të shtëpisë së Presidentit Clevelend, pasi ai u largua nga detyra. Po ashtu, mund të gjenden edhe shumë web-sajte të tjera shumë të mira.

Katalogët

Online: GPO Access. Uashington, DC: U.S. Government Printing Office, 1994 e deri më sot, e përmuajshme, www.access.gpo.gov/su_docs/dbsearch.[9] Ofrohet falas.

Online: Catalog of U.S. Government Publications. Uashington D.C.: U.S. Government Printing Office (GPO), 1994 e deri më sot, e përmuajshme, www.access.gpo.gov/su_docs/locators/cgp/). Falas. DIALOG File 66, $15 për orë. Po ashtu, ofrohet edhe nga OCLC dhe të tjerët.

CD: GPO, plus publikimet e tjera. 1895 e deri më sot, e përmuajshme. Çmimi ndryshon.

E Shtypur: Monthly Catalog of the United States Government Publications. 1895 e deri më sot, e përmuajshme. $199.

GPO Access është e titulluar edhe si "duke e informuar Amerikën elek-

[9] Linkat për web-sajtet e Access ofrohen në shumicën e web-sajteve të universiteteve. Një prej më të mirave, për shkak se ofron një kërkim të thjeshtë në brendi, është: GPO Gate (www.gpo.ucop.edu). Ky web-sajt mbahet nga Universiteti i Kalifornisë, në San Diego, dhe ofron shumë metoda të kërkimit të cilat nuk mund të gjenden në bazën qeveritare të të dhënave.

tronikisht".[10] E futur Online nga Zyra e Shtypit e Qeverisë Amerikane, ofron shumë gjëra. Ka linka dhe ofron qasje në web-sajtet e mëdha apo të vogla që kanë të bëjnë me dokumentet qeveritare. Ka shumë artikuj me tekste të plota, dokumente qeveritare, projektligje Online të Kongresit, ligje dhe dokumente të tjera, të cilat mund të gjendet nëpërmes këtij web-sajti. Për më shumë, përfshin edhe: (1) linka për koleksione të më se 20 apo më shumë bibliotekave universitare; (2) linkat për bazat Online të të dhënave në Bibliotekën Federale të Depozitave; (3) një "Histori të Projektligjeve", e cila ndjek hap pas hapi çka po ndodh në Kongres. Lehtësia e kërkimit ndryshon nga dokumenti në dokument, mirëpo logjika Boolean mund të përdoret në shumicën e rasteve e po ashtu edhe shënimi i fjalëve kryesore;[11] (4) jep linkat për shumicën e departamenteve dhe agjencitë qeveritare-shtetërore. Disa shembuj do të ilustrojnë se sa shumë të dhëna në të vërtetë ofrohen:

Department of Education (Departamenti i Edukimit). www.ed.gov. Është një burim informacioni për edukimin amerikan prej raporteve dy faqshe deri te seksioni statistikore si *Digest of Education Statistics*. Duke iu falënderuar softuerit të shkëlqyeshëm të kërkimit/hulumtimit, është mjaft e lehtë për të gjetur atë çka kërkohet, pra sipas subjektit, emrit etj. Shumica e materialeve ofrohen me tekste të plota Online.

Departamenti i Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore (www.os.dhhs.gov). Me fokus qendror në shëndetin për njerëzit dhe qeverinë, ky është një web-sajt i përkryer për të gjetur informacionet më të fundit rreth subjekteve të tilla si sëmundjet specifike, si dhe shuma e dollarëve që jepet për shëndetësinë nga buxheti shtetëror. Shënim: ofrohet një link për *Consumer Information Center*, kështu që shfrytëzuesi të jetë në gjendje që t'i shkarkojë tekstet e plota në kompjuterin e tij.

Departamenti i Brendshëm (www.doi.gov). Për shumicën e njerëzve të thjeshtë, interesi primar këtu në të dhënat e bollshme rreth Shërbimit të Parkut Nacional e po ashtu edhe të atij të *U.S. Fish and Wildlife*. Ka një

[10] Për një shpjegim të mirë të Access, shiko "GPO Access: Qeveria at its Best?" Baza e të dhënave, prill/maj, 1998, f. 41+.

[11] Informacionet dhe linkat rreth dokumenteve ndërkombëtare qeveritare mund të gjenden te Governments on the WWW (www.gksoft.com/govt/en/). Përfshin parlamentet, ministritë, zyrat, gjykatat shtetërore, ambasadat dhe këshillat e qyteteve prej mëse 200 vendeve të botës. (Konsiderohet si "web-sajti më i mirë" në botimin e vitit 1998 të Library Journal, 15 prill, botimi 1998, f. 48.

sasi të madhe të informatave, ku shumica e materialeve mund të përdoren për detyra shkollore, si dhe për pushime. Shënim: ky web-sajt jep informata rreth marrëdhënieve amerikano-indiane.

Departamenti i Drejtësisë (www.usdoj.gov). Ky është vendi për të gjetur informacione të bollshme statistikore për krimet. Një numër i madh i raporteve me tekst të plotë dhe studimeve ofrohen Online, web-sajt i njëjtë si ky është: *Federal Bureau of Investigation* (www.fbi.gov). Përderisa ky web-sajt është më shumë për zyrtarët ligjorë, po ashtu ofron edhe informata të përgjithshme për studentë, p.sh. ka të dhëna nga e kaluara rreth problemeve të rëndomta si zbatimi i ligjit, informatat rreth hetimeve (specifike dhe të përgjithshme) dhe informata statistikore rreth krimeve. Po ashtu, mund të shikohen edhe 10 top-personat më të kërkuar.

Departamenti Amerikan i Tregtisë Nacionale (www.statusa.gov/). Është një burim i jashtëzakonshëm për ekonominë dhe tregtinë. Ka të dhëna prej më shumë se 20 agjencive shtetërore plus më shumë se 400 000 dokumenteve. Të dhënat zhvendosen nga bujqësia dhe financimi i transportit deri te statistikat e importit dhe eksportit nga shteti dhe njerëzit privatë. OCLS thotë se "kjo është dosja më e madhe dhe që më së shumti ndihmon njerëzit në Internet rreth çështjeve ekonomike". Një web-sajt i ngjashëm është *Statistical Abstracts of the United States*.[12]

Katalogu i Botimeve të Qeverisë Amerikane (Catalog of U.S. Government Publications)

Catalog of U.S. Government Publications (po ashtu i titulluar: *Monthly Catalog of the U.S. Government Publications*) është një shënim i publikimeve nga agjencitë e Qeverisë amerikane, i llojit të tillë si *National Union Catalog* që bëhet për Qeverinë. Versioni elektronik i *Catalog* ofron një rrugë relativisht jo të shtrenjtë për të kërkuar apo hulumtuar dhe si i tillë është i njohur për gati çdo bibliotekar të referencave. Aty ku gjendet një koleksion i posaçëm i dokumenteve-dosjeve, bibliotekat zakonisht i besojnë *Catalog*-ut edhe si një mjet kërkim edhe si katalog, e po ashtu edhe si një burim për të blerë informacione.

Radhitja në versioni e shtypur në *Catalog* është sipas numrave të klasi-

[12] "Top 100 computer files in WorldCat", OCLC Newsletter, korrik/gusht, 1998, f. 16.

fikuar nga *Superintendant of Documents*. Kjo do të thotë se radhitja bëhet sipas agjencive që i kanë botuar dokumentet. Pra, shumica e dokumenteve të cilat janë botuar nga Biblioteka e Kongresit do të listohen nën emrin e agjencisë, pra shumica e jo të gjitha. Situatat e klasifikimeve të posaçme shfaqen atëherë kur dokumentet klasifikohen nën shënimin kryesor e jo sipas agjencisë, e cila e ka botuar dokumentin. Kështu që, gjithmonë është mirë të kontrollohen indekset dhe të mos mendohet se dokumentet e caktuara do të jenë të radhitura nën agjencinë, departamentin, e kështu me radhë. Janë katër indekse kryesore: autori, titulli, subjekti, seritë dhe raportet. Për referencë, indekset e subjektit dhe të titullit janë më të mira. Indeksi i subjekti dhe i titullit i listojnë dokumentet me emrat e tyre të plotë. Jepen rreth 400 000 citime të publikimeve qeveritare dhe përafërsisht 2 000 shënime, të cilat çdo muaj i shtohen katalogut.

Me këtë që u tha, versioni i shtypur nuk favorizohet më për shkak të probleme me kërkim. Në formatin digjital, e posaçërisht me logjikën Boolean, një bibliotekar me përvojë mund të gjejë atë çka kërkon, madje edhe nëse e bën kërkimin duke shënuar fjalët kryesore.

Kongresi[13]

Online: CIS. Bethesda, MD: Congressional Information Service., 1970 e deri më sot, e përmuajshme, www.cispubs.com. DIALOG File 101, $60 për orë. Po ashtu, edhe LEXIS-NEXIS dhe firma të tjera.

CD: Congressional Masterfile, 1970 e deri më sot, çdo tre muaj. Çmimi ndryshon

E Shtypur: CIS/Index to Publications of the U.S. Congress, 1970 e deri më sot, e përmuajshme. Shërbim.

Online: Congressional Universe. Bethesda, MD: Congressional Information Service Inc., 1998 e deri më sot, e përditshme, www.cispubs.com. Çmimi ndryshon. LEXIS-NEXIS dhe firma të tjera.

Online: CQ Weekly Report. Uashington, DC: Congressional Quarterly

[13] Udhëzuesi më i mirë për Kongresin dhe dokumentet e shumta të tij është vepra me dy vëllime: CQ's Guide to Congress. (Uashington, DC: Congressional Quarterly, edicioni 2000, 1 200 f. $295). Dy firmat më të mëdha komerciale për informacionet qeveritare, CIS dhe CQ ofrojnë edhe shërbimet e tyre Online. Për shkak se CIS kontrollohet nga LEXIS-NEXIS, nuk është një befasi pse indekset CIS ofrohen atje po ashtu.

Inc., 1983 e deri më sot, e përjavshme, http://library.cq.com. Çmimi ndryshon.
E Shtypur:1945 e deri më sot, e përjavshme. Çmimi ndryshon.

Online: CQ Researcher. Uashington, DC: Congressional Quarterly Inc., 1991 deri më sot, e përjavshme, http://library.cq.com. Çmimi ndryshon.
CD: 1992 e deri më sot, çdo tre muaj, $695.
E shtypur: 1923 e deri më sot, çdo tre muaj, $340.

Online: Thomas. Legislative Information on the Internet. Uashington, DC: Library of Congress, 1989 e deri më sot, e përditshme, http:/thomas.loc.gov. Falas.

Të gjithë indekset e listuara këtu, me përjashtim të Thomas, janë të publikuara nga firmat komerciale. Të gjitha, me përjashtim të Thomas, shiten me çmime të larta. Përfundimisht, të gjitha mund të hasen në biblioteka, biznes, qeveri etj., ku çmimi i lartë i tyre mbulohen nga organizatat.

Më afërsisht 300 000 citime dhe me 1 000 citime që shtohen çdo muaj, shërbimi komercial Online i informatave të Kongresit, indeksi CD-ROM dhe ai i shtypur janë vendet ku mund të gjenden publikimet e Kongresit. Këto janë shënime me abstraktet e dëgjimeve, raporteve, dokumenteve të Shtëpisë së Bardhë dhe të Senatit, e po ashtu edhe format e shtypura të projektligjeve dhe marrëveshjet e publikuara. Sikurse që thekson edhe botuesi: "Shënimet e dëgjimeve përfshijnë edhe disa nën-shënime, ku secila përmbajtje është dëshmi e të dhënave nga dëshmitarët individualë apo e një grupi dëshmitarësh".

CIS/Index është i mirë për ata bibliotekarë të referencave, të cilët kërkojnë informata rreth asaj se çfarë përparimi ka bërë një projektligj në Kongres. Aty jepen emrat e njohur të projektligjeve, ligjeve dhe raporteve të dhëna, e po ashtu edhe çështja që ka të bëjë me ato materiale. Për më shumë, indeksi mbulon materialin e njëjtë sipas numrit të projektligjit, numrit të raportit, e kështu me radhë.

Pasi që Kongresi është po aq i kërkuar dhe i gjetur sa edhe Zyra e Shtypit e Qeverisë Amerikane (dhe *Books in Print*), ka shumë pak subjekte, të cilat nuk mund të gjenden në indekset e CIS. Fushat e gjëra të ekonomisë, e biznesit dhe e teknologjisë trajtohen këtu pa u lënë anash as

shëndeti, arsimi dhe pikat kryesore të marrëdhënieve të jashtme. Duke iu falënderuar indeksit të subjektit në versionin e shtypur, i cili është një indeks mjaft i detajuar, e po ashtu edhe fjalëve, frazave, fjalëve kryesore, dhe mundësitë e kërkimit në versionin elektronik, është relativisht e lehtë për të gjetur përgjigjen për çdo pyetje që ka të bëjë me Qeverinë.

Kërkimi Online është bërë i lehtë nga një sistem me një meny të qartë, i cili e udhëheq/drejton shfrytëzuesin drejt rrugëve për t'i gjetur dokumentet e ndryshme. Shfrytëzuesi mund ta bëjë kërkimin sipas termave standarde të indeksit, të dhënave nga mbledhjet e Kongresit, emrit të dëshmitarit, titullit të seancës së dëgjimit, shënimeve të komitetit, e kështu me radhë. Një numër i madh i informatave - sikurse edhe në versionin e shtypur-jepet në ekran. Zakonisht kjo mjafton, kështu që shfrytëzuesi nuk ka nevojë që të kthehet dhe ta shikojë dokumentin e vërtetë.

Është një sistem komplet për atë bibliotekë, e cila i ka mundësitë për t'i blerë të gjithë indekset e materialeve. *CIS/Congressional Bills, Resolutions & Laws on Microsoft* ofron tekstet e plota të koleksionit në një vend. Shfrytëzuesi e vendos gjënë e dëshiruar në indeks dhe përmes një sistemi të thjeshtë të fjalës kryesore, e gjen kopjen mikrofibe. Në të vërtetë, shumica e teksteve të plota mund të jenë Online. Indeksi është i ndarë në dy pjesë: (1) seksioni i indeksit, i cili ofron qasje sipas subjektit, autorit dhe titullit. Ky seksion përmblidhet çdo tre muaj dhe botohet çdo vit; (2) seksioni i përmbledhjes jep titujt e plotë të dokumenteve dhe përfshin abstraktin e shumicës së dokumenteve dhe të artikujve, të cilët janë indeksuar.

Congressional Universe

"*Congressional Universe* është dokumenti që e ëndërron secili bibliotekar",[14] thotë *Reference Books Bulletin*. Pse? Për shkak të përdorimit të tij të lehtë Online dhe organizimit shumë të kujdesshëm. Ndoshta më e rëndësishmja është ajo se një seksion i tij ofron tekstet e plota të projektligjeve nga Kongresi 10 e deri më tash. Aty, po ashtu mund të gjenden edhe tekstet e plota të ligjeve, shumica e dëgjimeve dhe shkrimeve të komitetit. Nuk duhet lënë anash as edhe ¾ e dokumenteve të Dhomës së Senatit dhe Dhomës së Përfaqësuesve. Shumica e këtyre dokumenteve janë nga viti 1994 – 1995 e deri më sot. Janë gjithsej tetë fusha të gjëra të

[14] Booklist, 15 qershor, 1998, f. 1 800.

kërkimit, të cilat janë të mbështetura nga tekstet e plota që ofrohen Online. Këto dokumente flasin rreth temave që u përmendën më lart e po ashtu edhe për diskutimet në Kongres dhe në Uashington. Ato zhvendosen nga "Publikimet e Kongresit" deri te "projektligjet, ligjet dhe rregulloret". Një tjetër opsion i mirë: linkat e dhënë për shërbimet e njëjta.

"*Congressional Universe* ka shpejtuar rrugën drejt ofrimit të qasjes në një numër jashtëzakonisht të madh të materialeve. Lajmi më i mirë është ai se *Congressional Universe* nuk është shumë i shtrenjtë dhe mund të blihet nga bibliotekat publike dhe ato akademike".[15] Çmimi i saj Online (viti 2000) dallon me numrin e shfrytëzuesve, mirëpo fillon diku në shifrën $2 500 për vit.

Weekly Reports CQ (Raportet javore CQ)

Mbulimi më i mirë "ditë për ditë" i aktivitetit të Kongresit Amerikan bëhet nga *CQ (Congressional Quarterly) Weekly Report*. Këtu mund të gjenden përmbledhjet e të gjitha aktiviteteve të mëdha dhe të vogla të Kongresit Amerikan prej dëgjimeve e debateve deri te raportet e votave dhe zbatimi i vendimeve në praktikë. Sikurse edhe me seritë e botimeve nga CIS, çdo subjekt që mund të paramendohet mund të gjendet ose në botimin në versionin e shtypur ose në publikimet Online.

The report (raporti) e po ashtu edhe shërbimet e tjera të kësaj serie kanë dy përparësi të mëdha: (a) freskohet me informata çdo javë; (b) gati të gjitha dokumentet ofrohen Online me tekst të plotë përmes shërbimeve të tjera CQ. *The Report* publikohet nga një tjetër botues privat dhe disi e plotëson rivalin e saj, *CIS/Index*. Edhe kjo fokusohet kryesisht në aktivitetin e Kongresit.

The Report, që përdoret më shumë si ndihmë referenciale, është e ngjashme disi me versionin e Kongresit të quajtur *Facts on File*. Kjo nuk është një indeks, mirëpo është një përmbledhje e ngjarjeve të javës së kaluar, një përmbledhje, e cila zakonisht mjafton: (1) për të identifikuar një dokument qeveritar, i cili më vonë mund të gjendet në një vepër të posaçme, ose (2) si një përgjigje, në një mënyrë, rreth një mëdyshjeje referenciale. Secili botim analizon në detaje aktivitetin e Kongresit dhe aktivitetin e përgjithshëm gjatë javës. Shumica e projektligjeve ndiqen afër prej momentit kur ato prezantohen deri atëherë kur votohen dhe

[15] Ibid

futen në zbatim si ligje (ose hiqen fare gjatë kësaj periudhe). Një tabelë mjaft e mirë e legjislacionit tregon ku janë projektligjet në Kongres. Referencat e kryqëzuara për raportet javore të javëve paraprake lejojnë qasje të lehtë në material, derisa indeksi tremujor dhe ai vjetor lëshohen në shtyp.

Procesi dhe dëshira që të ndiqet në aférsi çdo projektligj apo formë legjislative, prej hartimit deri te miratimi është mjaft i vështirë. Ky proces është bërë relativisht i lehtë nga një seri Online e shërbimeve që ofrohen nga botuesi i *CQ Weekly Report*, nën ombrellën "CQ Washington Alert Service". Baza e gjithë këtij sistemi është *CQ Bill Tracking* (1983 e deri më sot, e përditshme), e cila në mënyrë kronologjike i tregon të gjitha projektligjet që janë prezantuar në Kongres prej Kongresit të 98-të. Janë të dhëna edhe referencat kryqësore për *CQ Weekly Report* dhe *Congressional Record*. Informatat e plota bibliografike ndihmojnë për të gjetur një projektligj të caktuar. Po ashtu, sistemi Online ofron përmbledhjet për projektligjet, duke filluar nga Kongresi 101. Shfrytëzuesi mund të gjejë edhe të dhëna rreth së kaluarës së anëtarëve të Kongresit, të bëjë kërkim rreth çështjeve aktuale, e kështu me radhë. Ky shërbim ofron po ashtu edhe tekstet e plota të projektligjeve dhe dokumenteve kryesore. Menyja kryesore i liston të gjitha bazat e të dhënave, të cilat mund të kërkohen nga individi ashtu siç dëshiron ai/ajo.

Congressional Quarterly Almanac, e nxjerrë në shtyp nga po i njëjti botues (1945 e deri më sot, e përvitshme, $195) është një vepër mjaft e përdorshme referenciale, që i hyn në punë gati çdo biblioteke. Botimi vjetor e ndan punën e Kongresit në 11 fusha me subjekte të ndryshme (prej ambientit dhe shëndetësisë deri te transporti dhe ligji). Përmbledhjet jepen për çdo projektligj në shumë kategori. Shumica e materialit analizohet në mënyrë objektive. Për më shumë, jepet edhe një përmbledhje e mirë rreth vendimeve të Gjykatës Supreme dhe të dhëna rreth porosive të presidentëve. Duke iu falënderuar indeksit të shkëlqyer, kjo është një vepër e përkryer referenciale në të gjitha fushat që i mbulon.

CQ Researcher

Në përpjekjet për t'u ndihmuar bibliotekave që kanë buxhet të kufizuar, botuesi i *The Report* ka lëshuar në botim që nga viti 1920 veprën shumë të lexuar dhe të përdorur të quajtur *CQ Researcher*. Pas viteve '90-të, ofrohet edhe në formatin elektronik. *Reference Book Bulletin* e lavdëron shumë këtë shërbim dhe thotë se "kjo vepër dallohet për saktësinë, objektivitetin dhe freskimet me

informata, të cilat bëhen gjithmonë në kohë". Ju shërben një shtrese të gjerë të shfrytëzuesve "prej nxënësve të shkollave të mesme, që përgatisin fjalimet e tyre dhe shkrimet, deri te një student i diplomuar i gazetarisë, i cili është duke shkuar një kryeartikull në fushat e tilla, si komunikim masiv, shkenca politike, shkenca shëndetësore dhe arsim".[16]

Analizat javore ofrojnë komente objektive, të cilat dalin nga një kërkim/hulumtim i mirëfilltë rreth çështjeve kryesore politike, sociale, apo ndërkombëtare, të cilat janë pjesë e skenës federale-ndërkombëtare gjatë javës së shkuar. Organizmi dhe mbulimi i kujdesshëm i ngjarjeve e bënë këtë një burim të mrekullueshëm të informatave.

Edhe pse e shtrenjtë për nga çmimi, është relativisht më e lirë sesa shërbimet e tjera komerciale. Në anën tjetër, *Thomas* – shih më poshtë - ofrohet falas dhe është për të njëjtin qëllim, edhe pse nuk është e organizuar aq mirë sa *Research*.

Thomas

Për dallim nga shërbimet komerciale, *Thomas* është bazë qeveritare e të dhënave, e cila ofrohet falas. Fokusohet në gjërat esenciale dhe është e lehtë për t'u përdorur. Thomas u dedikohet personave joprofesionistë dhe bibliotekarëve të rraskapitur të referencave. Ka shumë përparësi si freskimet ditore me informata, tekstet Online të shumë dokumenteve, si dhe një përmbledhje të aktivitetit të Kongresit.

Web-sajti e *Thomas*, e krijuar nga Biblioteka e Kongresit, është e një modeli të posaçëm. Përfshin këto opsione që ndihmojnë: (1) "Kërkimi i shpejtë i teksteve të projektligjeve", të cilat mund të kërkohen duke shënuar numrin e projektligjit ose nga fjala/fraza; (2) Pyetjet që shtrohet më së shpeshti; (3) Udhëzuesi i Kongresit dhe i Shtëpisë së Bardhë; (4) Linkat për shërbimet e Kongresit në Internet, si dhe ata të Bibliotekës së Kongresit.

Faqja kryesore e informacionit është e ndarë në gjashtë pjesë: Kongresi tash; Projektligjet; Shënimet nga Kongresi; Informacionet rreth Komiteteve; Procesi legjislativ (një ese rreth asaj se si bëhen ligjet dhe si zbatohen) dhe Dokumentet historike. Aty mund të gjendet edhe një përmbledhje shumë e qartë tetë faqëshe, që është e kuptueshme, e titulluar "Për Thomas", e cila duhet të lexohet nga çdo njëri që planifikon ta shfrytëzojë këtë web-sajt.

Pyetjet dhe Përgjigjet Legjislative

[16] Mary Ellis, "Another look at the CQ Researcher" Booklist, 1 & 15 janar, 1999, f. 929.

Dokumentet e shtypura federale janë aq të shumta saqë do të mund t'i zinin të gjitha raftet e bibliotekave të mëdha. Duke e dituar sasinë e madhe të materialeve, është ide e mirë që së pari të dihet mirë çka duhet në të vërtetë përpara se të filloni kërkimin e një dokumenti qeveritar. Kështu që, e para dhe më e rëndësishmja, ju duhet të keni një ide specifike rreth: (a) subjektit të çështjes, e cila kërkohet nga ju e po ashtu edhe relacionin kohor; dhe/ose (b) autori ose emri i dokumentit, i cili kërkohet. Është e mundur që nga gjithsej 10 raste, nëntë prej tyre të jenë sipas subjektit.

Me subjektin, është vetëm një qasje kryesore për të gjetur informacione rreth dokumenteve qeveritare: të dish se ku të shkosh. Kjo do të thotë të kuptosh degët apo sektorët, departamentet dhe agjencitë e ndryshme të Qeverisë. Pas kësaj, shfrytëzuesi mund të tregojë se cila agjenci për shembull mund të ketë informacione rreth problemeve të mjedisit në pjesën Veri-Perëndimore të Paqësorit. *United States Government Manual* shpjegon pjesët e ndryshme të Qeverisë Federale të Shteteve të Bashkuara dhe përgjegjësitë e tyre. *Monthly Catalog of U.S. Government Publications* tregon në mënyrë të përpiktë se çka boton secili divizion i Qeverisë.

Pyetjeve tipike legjislative mund t'u përgjigjen shumica e librave të referencës, të cilat u përmendën më lart. Për njerëzit joprofesionistë, *Thomas* është më i miri prej tyre, në shumë aspekte. Ata, të cilët dëshirojnë kërkime të detajuara do t'i përdorin shërbimet komerciale. Hapat themelorë janë përafërsisht të njëjtë:

1. "Unë jam duke kërkuar informacione rreth dëgjimeve në Kongres".[17] Shih *CIS/Index*, i cili mbulon subjektet dhe titujt e po ashtu edhe pikat e tjera, si p.sh., emri i një komiteti (kjo mund të bëhet edhe përmes *Thomas*, mirëpo CIS është më e saktë)

a. Kur mungon indeksi ose për dëgjimet që janë më të vjetra, shih *Monthly Catalog*, ku subjekti, titulli dhe komiteti i involvuar ofrojnë

[17] Kur dikush dëshiron një ligj të ri, normalisht një "dëgjim" mbahet para Kongresit (ose në Senat ose në Dhomën e Përfaqësuesve, ose në që të dyja) për të vendosur rreth atij ligji të propozuar. Dëshmia e ekspertëve jepet po ashtu. Dëgjimet në Kongres bëhet edhe për shkak të qartësimit të një çështje publike si p.sh. dëgjimi mbi buxhetin; ekzaminimi i kandidaturave të zyrtarëve; e kështu me radhë. Dëgjimet në Kongres janë të njohura për mëse 30 milionë njerëz të cilët e shikojnë C-Span (rrjeti kabllovik i televizionit). Ky program televiziv ofron mbulim të plotë televiziv të dëgjimeve në Senat dhe në Dhomën e Përfaqësuesve rreth çështjeve të caktuara dhe rreth debateve për ligjet e reja të propozuara. Raporti është rezultat i një dëgjimi dhe rekomandimeve të një organi legjislativ. Raporti shoqërohet edhe nga ligji i ri i propozuar, pra nga projektligji i cili shkon edhe Në Senat e edhe në Dhomën e Përfaqësuesve.

qasje.

b. PAIS (Shërbimi i Informatave të Marrëdhënieve me Publikun) ofron qasjen sipas subjektit në shumicën e dëgjimeve, mirëpo jo për të gjitha. Pra, është shumë përzgjedhëse. Po ashtu, duhet të kihet parasysh se PAIS po ashtu i indekson edhe periodikët dhe librat e raportet rreth dëgjimeve në Kongres. Me këtë që u tha, ky burim është ndër më të mirët për informacione mbi të kaluarën.

c. Burimet e tjera janë gazetat aktuale (zakonisht Online), sikurse *The New York Times* ose periodikët Online, që janë për një subjekt të caktuar;

2. "Çka është duke ndodhur me projektligjin, i cili i garanton tre derra të vegjël çdo familjeje amerikane?" Ju prapë duhet të shikoni *CIS/Index*, mirëpo për një qasje që është më aktuale dhe diçka më e lehtë për t'u ndjekur është ajo e ofruar nga *CQ Weekly Repor*t. Kjo e vëzhgon procesin se si kalon një projektligj në ligj. Shih kapitullin "Në foltore" dhe "Në Komitet". Po ashtu, shiko edhe tabelat e shkëlqyeshme të legjislacionit më të rëndësishëm, të cilat po ashtu i tregojnë votimet;

3. "Ku mund ta gjejë një ligj aktual?[18] Sapo është miratuar si ligj". Ligjet përmblidhen në fund të çdo seance të Kongresit në vëllimet e quajtura *Statutes at Large* (1789 e deri më sot). Më vonë ligjet organizohen në një mënyrë më të detajuar dhe bëhen pjesë e *U.S. Code*. Ligjet aktuale janë pjesë e *Statutes*, derisa ato të cilat janë pak më të vjetra janë pjesë e *Code*. Përderisa nuk mund të jepet ligji në tekstin e plotë, përmbajtja raportohet zakonisht me implikacione në *CIS/Index*, *CQ Weekly Report*, ose vepra të tjera referenciale, të cilat u përmendën më lartë.

Këta hapa do të rezultojnë në gjetjen e 90 deri 95 % të përgjigjeve në pyetjet e bëra nga bibliotekari i referencave rreth aktiviteteve të vazhdueshme të legjislacionit federal.

---

[18] Kur projektligji miratohet edhe nga Kongresi edhe nga Dhoma e Përfaqësuesve, ose nga njëra (siç është edhe procedura), projektligji bëhet ligj. Natyrisht, shumë dëgjime nuk rezultojnë as në raport e as në projektligj apo ligj. Po ashtu, Presidenti është ai i cili vë veton e tij në shumë projektligje të tjera përpara se ato të bëhet ligje. Në të vërtetë, nëse projektligj sapo është bërë ligj, gjasat janë që ai ligj të shfaqet vetëm në të ashtuquajturën "slip law" që është një pamflet e pavarur, e cila nuk është përmbledhur apo është pjesë e Statutes at Large. Këto zakonisht identifikohen me numër publik të ligjit dhe fushat të cilat janë sipas seksionit referencor të dokumentit qeveritar. Shih: FedLaw Easy Search (Feniks, AZ: Oryx, 1998). Ky version në CD-ROM ofron kërkime të shpejta në Statutes at Large dhe në United States Code, plus ofron edhe të dhëna tjera të ngjashme.

Indekset Periodike

CD: U.S. Government Periodicals Index. Uashington, DC: Congressional Information Service, 1994 e deri më sot, çdo tre muaj, $795.
E Shtypur: 1994 e deri më sot, çdo tre muaj, $795.

The U.S. Government Periodicals Index ofron qasje në 180 periodikë qeveritarë të botuar.[19] Indeksi është sikurse të tjerët me subjektin, emrin e korporatës dhe çështjet e tjera si pika të shënimit. Edhe pse është i shtrenjtë, indeksi ka një vend të caktuar në bibliotekat e mëdha. Shumica e informatave të gjetura në dritaret federale dhe në revista nuk mund të gjendet diku tjetër. Subjektet janë të ndryshme nga ekonomia e biznesi deri te satelitët dhe etika. Dhe, përderisa është e vërtetë se fokusi kryesor është në shkencë dhe teknologji, po ashtu ka informata të shumta edhe për shkencat sociale dhe ato të politikës.

Indekset dhe Librat e Regjistrimeve të Përgjithshme

Online: CENDATA. (Census Data) Uashington, DC: Byroja e SHBA-ve për Regjistrimin e Përgjithshëm, 1980 e deri më sot, e përditshme. Ofrohet Falas në Internet (www.census.gov).[20]
E Shtypur: Current Population Reports, data dhe çmimet e ndryshme.

Online: Tiger Map Server Browser. Vetëm të dhëna aktuale. Ofrohet falas në Internet (http://tiger.census.gov/cgi-bin/mapbrowse-tbl).
CD: TIGER/Line Files. Vetëm të dhëna aktuale. Çmimet ndryshojnë.

Të dhënat e mbledhura nga Byroja Amerikane e Regjistrimit të Përgjithshëm janë pjesë përbërëse e veprave statistikore, të cilat shqyrtohen në këtë libër. Zakonisht, burimet dytësore të të dhënave statistikore (sikurse

[19] Janë diku rreth 2 000 periodikë të ofruara prej Qeverisë Federale Amerikane dhe shumë shumë të tjera nga agjencitë dhe seksionet e tjera qeveritare të cilat nuk gjenden në Uashington.

[20] URL nuk është CENDATA per se, mirëpo është e ndarë në 11 pjesë, një prej të cilave është "Uncle Sam's Reference Shelf", i cili seksion jep të dhëna statistikore në çdo gjë diku filluar nga kushtet klimatike e deri tek radhitja e shteteve amerikane sipas të hyrave vjetore për person, pra në esencë ky është materiali i cili mund të gjendet në Statistical Abstract of the United States. Përveç kësaj, ofrohen edhe linka për të dhëna më të rafinuara statistikore, përfshirë këtu edhe CENDATA.

Statistical Abstract of the United States) mjaftojnë, mirëpo kur materiali primar është i nevojshëm, bibliotekari kthehet dhe shikon në Byronë Amerikane të Regjistrimit të Përgjithshëm.

Përpara se të diskutohen burimet themelore, duhet të përmenden dhe të merren parasysh edhe vendet e tjera, ku mund të shkohet për të dhëna statistikore dhe për informacione rreth Byrosë së Regjistrimit të Përgjithshëm. E para, ju duhet të shikoni *Fed Stats* (www.fedstats.gov), e diskutuar në seksionin e statistikave në kapitullin rreth Burimeve të Gatshme Referenciale, sikurse që është *American Statistics Index*. E dyta, indekset e tjera biznesore dhe të ngjashme (prej *Predicasts* deri te *CIS/Index*) analizojnë materialet rreth regjistrimeve. E treta, për një përshkrim më të detajuar të dosjeve të shumta dhe raporteve, shkoni te Byroja për Katalog të Përgjithshëm (Uashington, DC: *Government Publishing Office*, 1946 e deri më sot, e përvitshme). Në esencë, kjo byro i radhitë dhe i rregullon lajmet dhe informatat rreth të dhënave statistikore sipas subjektit, prej bujqësisë deri te tregtia. Ofrohet edhe një indeks i hollësishëm, i cili lejon shfrytëzuesin që ta gjejë materialin sipas fushës së caktuar. Shumica e të dhënave statistikore, të cilat gjenden në librat e referencës, përfshirë këtu edhe ato të cilat u diskutuan në këtë kapitull, janë të bazuara në botimin e fundit të *Census of Population*. Analiza 10 vjeçare është burimi më i mirë dhe më i shtrenjtë i informatave të llojit të tillë në botë.

CENDATA

CENDATA (*Census Data)* i merr të dhënat e saj prej regjistrimit të fundit të popullsisë (viti 2000) dhe prej sondazheve të fundit. Në Online, përparësia është në freskimet e përditshme me informata, të cilat marrin në konsiderim çdo gjë prej ekonomisë deri te raportet demografike në bujqësi dhe biznes, si dhe të mirat e prodhuara nga firmat e ndryshme. Baza e të dhënave, po ashtu përfshin informacione për të gjitha qarqet bashkiake dhe për shumicën e qyteteve të vogla dhe të mëdha.

Me fjalë të tjera, kjo është ëndrra e njeriut të statistikave. Kënaqësia e ekspertit është mishëruar me konfuzitetin e vizitorit të zakonshëm. Është një bazë e vështirë e të dhënave për të bërë kërkime në të, përkundër ndihmave dhe opsioneve të ndryshme ndihmëse. Asnjë bazë tjetër nuk është e njëjtë me të sa i përket të dhënave aktuale. Duhet të merret parasysh edhe ajo se përfshin të dhëna statistikore për më shumë se 200 vende të tjera jashtë Shteteve të Bashkuara, në gjërat e tilla si jetëgjatësia, analfabetizmi, bujqësia, e kështu me radhë.

TIGER Map (Harta TIGER)

Tiger Map Server Browser. TIGER (*Topographical Integrated Geoographic Encoding and Referencing*) nga Byroja Amerikane e Regjistrimit përdoret nga shumica e web-sajteve komerciale të hartave në Internet. E ka përparësinë e ofrimit të hartave të detajuara të rrugëve për çdo komunitet amerikan e po ashtu edhe një numër të konsiderueshëm të të dhënave të regjistrimit të popullsisë për rajonet e mbuluara nga ato harta. Në mënyrë që ta përdorë këtë, shfrytëzuesi duhet të shënoj qytetin, shtetin dhe kodin postar (qasja më e lehtë është sipas kodit postar). E pastaj, harta e rrugës jep një pasqyrim të mirëfilltë për çdo gjë, nga të ardhurat mujore deri te densiteti i popullsisë. Për shembull, në mënyrë që të mësoni më shumë për qytetin Seatle, Uashington, ju duhet të shënoni emrin e qytetit. Harta tregon se ku pozicionohet qyteti Seatle. Nëse shfrytëzuesi dëshiron ta shohë qytetin Seatle në relacion me kufijtë e shtetit, apo me aeroportet e Uashingtonit, shfrytëzuesi thjesht do të shkojë në opsionin "on box" për një pasqyrim të informatave. "Redraw" pastaj do t'i tregojë të gjitha veçoritë në hartën e re. Është një web-sajt mjaft me rëndësi për dikë që është duke bërë studim të hollësishëm për një pjesë të qytetit (shënim: një web-sajt i njëjtë për Kanadanë mund të gjendet në: *National Atlas Information Service* (www-nais.ccm.emr.co).

Edhe pse fokusohet më shumë në aspektet gjeografike dhe ato ekonomike të Shteteve të Bashkuara, TIGER mund të shikohet si i vetëm apo në lidhje me CENDATA apo publikimet e tjera të Byrosë, në versionin e shtypur apo në Online. Bibliotekat e mesme dhe ato të mëdha absolutisht do të jenë në gjendje t'u përgjigjen shumicës së pyetjeve, që kanë të bëjnë me regjistrimin dhe çështjet statistikore, nëse i kanë dhe i ofrojnë këto dy baza të të dhënave.

Raportet Tekniko-Shkencore[21]

Online: NTIS Order Now. Springfield, VA: U.S. National Technical Information Service, 1964 e deri më sot, e përmuajshme, www.ntis.gov. Falas. DIALOG File, $60 për orë.

[21] Në vitin 2000, thuhej se NTIS (National Technical Inforamtion Service) do të mbyllet dhe do ta ndërrojë arkivin e saj në Bibliotekën e Kongresit. Pse? Për shkakun se ata nuk mund t'i detyrojnë njerëzit të paguajnë për materialet të cilat ofrohen falas në Internet. Duke mos pasur mundësi për të përfituar diçka, ata nuk po kanë fitime nga ky biznes. Kongresi kundërshton që t'i paguajë ato para të humbura nga ta. Rezultati: operacionet janë zvogëluar dhe shumica mendojnë që duhet të mbyllet. Shih Library Journal, 15 shtator, 1999, f. 16-18.

CD: NTIS, 1980 e deri më sot, çdo tre muaj. Botues të ndryshëm, $2.350. Botimi i tashëm dhe ai i katër viteve më parë.

E Shtypur: Government Reports Announcments & Index, 1995 e deri më sot, çdo gjashtë muaj. Çmimi ndryshon.

Bibliotekarët që janë të njoftuar me raportet e pabotuara e që janë indeksuar nga ERIC, ndoshta nuk i dinë mirë studimet e pabotuara të cilat ofrohen nga *U.S. National Technical Information Service* (Shërbimi Nacional Amerikan i Informacioneve Teknike). ERIC në radhë të parë merret me arsimin. NTIS i shikon raportet teknike nga sponsorët amerikanë dhe jo amerikanë të hulumtimeve. Deri në fund të viteve '90-të, ofroheshin diku rreth 3 milionë raporte të tilla. Rreth 750 000 raporte të njëjta shtohen çdo vit (shënim: versioni Online mbulon vetëm raportet e fundit në katër-tetë vjetët e kaluara dhe përfshin rreth 500 000 raporte).

Fushat kryesore: biologjia, shkencat sociale dhe fizika; inxhinieria, matematika dhe informacionet biznesore në lidhje me teknologjinë dhe shkencën. Projektet shpjegohen në hollësi në abstrakte të gjata.

Të përgatitura nga agjencitë lokale, shtetërore dhe ato të Qeverisë Federale, duke mos lënë anash as ato të bëra nga grupet individuale, private dhe ato të interesit, raportet mbulojnë një spektër të gjerë të temave, përfshirë këtu edhe materialet e shumta për shkencat sociale. Në fakt, NTIS dhe ERIC i ndërrojnë disa informacione të raporteve dhe informatat e dyfishta janë të pakta.

Index (Indeksi) përfshin subjektin, autorin personal dhe atë të korporatës, numrin kontaktues dhe qasjen/numrin e raportit. Përmbledhjet vjetore mund të blihen ndaras. Në versionin e shtypur, janë dy shërbime të ndryshme: *Government Reports Announcment* dhe *Government Reports Index*. Që të dyja janë të bashkuara në formatin digjital dhe në fakt janë një version i vetëm. Seksioni i njoftimeve përfshin abstraktet e më se 70 000 raporteve çdo vit. Ato janë të ndara në 26 fusha të ndryshme sipas subjektit e më pastaj kjo ndarje vazhdon më tutje. NTIS mbështetet edhe nga shumë dokumente në mikrobike, në versionin e shtypur dhe atë Online.

Dokumentet Shtetërore dhe Lokale

CD: The USA State Factbook. Mineapolis, MN: Quanta Press, Inc., 1990 e deri më sot, e përvitshme, $49.95. E Shtypur: Book of the States. Çikago: Këshilli i Qeverisë Shtetërore, 1935 e deri më sot, çdo dy vjet,

500 f., $79.

CD: County-City Plus. Uashington, DC: Slater Hall Information Products, 1990 e deri më sot, e përvitshme. $195.

E Shtypur: County and City Data Book. Uashington, DC: U.S. Bureau of The Census, 1952 e deri më sot. Nuk freskohet me informata rregullisht. Çmimet ndryshojnë.

E Shtypur: Libraria Amerikane e Kongresit, Monthly Checklist of State Publications, 1910 e deri më sot, e përmuajshme, $26.

E bazuar në materialet prej Byrosë Amerikane të Regjistrimit të Përgjithshëm, *USA State Factbook* lejon shfrytëzuesit që të kërkojnë një version në CD-ROM për informacione të shumta rreth një shteti të vetëm. Janë të përfshira edhe territoret nga viti i largët 1776, kur edhe fillojnë të dhënat statistikore. Mirëpo, shumica e informatave janë të lidhura më situatat aktuale e më pak me ato historike. Këtu, shfrytëzuesi mund të shikojë dhe të gjejë madhësinë e qyteteve më të mëdha të shtetit të Nevadës ose kush është guvernator i Oregonit, ose sa shumë prodhohet në shtetin e quajtur Maine. Ka shumë pak informata në lidhje me subjektet politike, gjeografike, apo ekonomike, të cilat nuk janë të mbuluara në këtë burim informacioni, që është shumë i lehtë për t'u përdorur. Si një libër plot informacione për shtetet, përfshin në vete edhe shumë harta, shenja të shteteve dhe grafike e ilustrime të llojllojshme.

Botimi me emërtimin e saktë *Book of the States* është i rëndësishëm për tri gjëra. E para, në të gjenden artikuj standardë rreth çështjeve sikurse riemërimet, mbrojta e konsumatorëve, të drejtat e grave dhe çështje të tjera të njëjta. Këta artikuj freskohet rregullisht me informata në çdo botim të ri. E dyta, jepen edhe analiza të trendëve, statistikave dhe zhvillimeve në aspektin federal e lokal, që do të kenë dhe nuk do të kenë ndikim në Qeverinë e shtetit. E treta, ka informata relativisht aktuale për emrat e zyrtarëve shtetërorë. Rëndësia e këtyre informatave e bën këtë botim referencial në versionin e shtypur të rëndësishëm për çdo lloj të bibliotekës.

Të dhënat demografike për bashkitë e Shteteve të Bashkuara e po ashtu edhe të dhënat statistikore për qytetet që kanë më shumë se 10 000 banorë ofrohen në *County-City Plus CD-ROM*. Me një meny të sistemit, që është mjaft e lehtë për t'u përdorur, krahasimet ndërmjet çmimeve të shtëpive në një qytet të madh/ose bashki dhe në një tjetër, për shembull,

mund të bëhen për vetëm disa sekonda. Në fakt, përdorimi primar i kësaj baze të të dhënave bëhet për qëllime të krahasimit dhe natyrisht, për t'u përgjigjur në pyetjet specifike për një lokacion të caktuar të Shteteve të Bashkuara. Në masë të madhe, ky botim bazohet në *U.S. County and City Data Book*, por duke ofruar edhe botime të tjera shtesë. Për dallim nga libri i Qeverisë në versionin e shtypur, versioni komercial CD-ROM freskohet me informata çdo vit dhe informatat për bankat, krimet deri te arsimi dhe kujdesi shëndetësor janë goxha aktuale.

Në nivelin shtetëror, nuk ofrohet një mjet bibliografik i kënaqshëm, i cili liston shumicën e publikimeve të të gjitha shteteve. Shtetet individuale tentojnë që t'i kenë publikimet e tyre bibliografike dhe listat e tilla. *Monthly Checklist of State Publications* e përgatitur nga Biblioteka e Kongresit përfaqëson vetëm publikimet shtetërore, të cilat janë marrë nga kjo bibliotekë. Radhitja është alfabetike sipas shteteve dhe më pastaj nga agjencia, e cila e ka botuar publikimin. Shënimet zakonisht janë të kompletuara, edhe pse çmimet e tyre nuk jepen fare. Është një indeks vjetor, e jo mujor, i autorit dhe i subjektit. Indekset këtu nuk janë përmbledhës. Periodikët janë të listuar në botimet e muajit qershor dhe dhjetor.

Në Internet

Ka shumë mënyra dhe rrugë për të gjetur informacione për qeveritë lokale të komuniteteve në Internet. Të gjitha shtetet kanë web-sajtet e tyre zyrtare. Një web-sajt i tillë së paku ofron: emrat dhe adresat (përfshirë edhe e-mail adresat) e të gjithë zyrtarëve të lartë dhe të ulët shtetërorë. Informacione në atë se si qeveria funksionon së bashku me listën ku tregohen të gjitha agjencitë shtetërore; ndodh që ofrohen edhe informata historike; gjithnjë jepen informacione nga biznesi e industria.

Web-sajtet zyrtare të shteteve, po ashtu janë të mira të përdoren edhe si udhëzues turistikë për të gjetur informacione të tilla si lokacioni i muzeve, parqeve shtetërore dhe pjesëve të tjera, të cilat janë me interes të veçantë. Po ashtu, pjesë e tyre janë edhe moti, ligjet e komunikacionit, zhvillimet më të mëdha ekonomike etj. Shfrytëzuesi mund t'i gjejë linkat edhe për dokumentet shtetërore dhe projektligjet. Zakonisht, ka informacione në shkallë të njëjtë, sikurse edhe ato federale. Tekstet e plota nga mbledhjet, dëgjimet dhe të njëjta, duke mos lënë anash as projektligjet ofrohen në gati të gjitha web-sajtet zyrtare të shteteve.

Për të gjetur një web-sajt të një shteti të caktuar, ju duhet që ta shënoni

adresën, p.sh. www. shteti (shkurtesa e shtetit).us. Për shembull, për shtetin e Nju-Jorkut do të shënoni (www.state.ny.us).

Kur kërkohet më shumë se një shtet, janë disa web-sajte në Internet që bëjnë analiza. Dy shembuj:

State and Local Governments. Biblioteka e Kongresit. (http://lcweb.loc.gov/global/state/stategov.html). Ky web-sajt ofron linkat për gati të gjitha web-sajtet zyrtare të shteteve, duke mos lënë anash as web-sajtet e qyteteve të mëdha. Po ashtu, ofrohen linka edhe për Konferencën Nacionale rreth Legjislaturës Shtetërore dhe Teknologjisë Publike. Ky web-sajt është jashtëzakonisht i lehtë për t'u përdorur dhe është vendi i parë që duhet shikuar e kontrolluar kur keni të bëni me më shumë se një shtet.

State & Local Government on the Net (www.piperinfo.com/state/index.cfm). Këtu jepen linkat të qeverive lokale dhe atyre shtetërore. Megjithatë, përparësia më e madhe e këtij web-sajti janë linkat për fushat e tilla si qeveritë fisnore, e po ashtu edhe për Pasurinë e Përbashkët të Shteteve të Bashkuara dhe Territoreve. Po ashtu, duhet të shikohet edhe lista e organizatave ndërkombëtare, që u shërbejnë nevojave të qyteteve dhe shteteve. Është një web-sajt shumë i lehtë për t'u përdorur, posaçërisht opsioni "kërkimi i shpejtë".

Fjala përmbledhëse

Bëhet pyetja e thjeshtë: Si mund t'i mbajë në mend të gjitha këto një bibliotekar? Dy përgjigje këtu: Kujtesa. Kjo zhvillohet pas ushtrimeve. Një person, i cili është i specializuar në dokumentet qeveritare, mund ta gjejë përgjigjen për vetëm disa sekonda. Ata që janë më pak të trajnuar, kjo do t'iu marrë disa minuta, orë, ose kurrë nuk do ta gjejnë përgjigjen e saktë.

Në krahasimin ndërmjet kërkimit në Internet dhe "rrugës së vjetër", që është shkuarja në bibliotekë, revista *Yahoo!* ka ardhur në përfundim se pyetja e një bibliotekari rreth të dhënave të regjistrimit të përgjithshëm (numri i adoleshentëve prej moshës 15 deri 19 vjeçare në Amerikë) është rrugë shumë më e shpejtë për ta gjetur përgjigjen sesa të provosh t'i gjesh ato të dhëna në Internet. Kërkimi në Internet, pa ditur mirë se ku mund të gjenden saktë këto të dhëna statistikore qeveritare, i mori jo më pak se 47 minuta autorit të këtij libri. Kurse, bibliotekari e bëri këtë për më pak se gjysmën e kohës, pra për më pak se 23 minuta.[22]

Qasja e dytë është që së pari të shikohen librat udhëzues, të cilët u diskutuan më herët në këtë kapitull, p.sh., *U.S. Government on the Ueb*. Kjo merr kohë. Mirëpo, do t'ju kursejë juve nga momente të mërzitshme që vijnë më vonë.

Metoda e tretë, e cila edhe nuk rekomandohet, është që t'i shtrohet pyetja një personi përmes kompjuterit, sugjerohet URL si një web-sajt i përgjithshëm.

Qëllimi i këtij vëllimi të këtij udhëzuesi që ju e keni në dorë, i cili po përfundon këtu, është që t'i japë bibliotekarit mbështetjen dhe vetëbesimin për të qëndruar me personin që e shtron pyetjen. Nëse ju nuk jeni në gjendje ta bëni këtë, atëherë shkoni në një pozitë në Shtëpinë e Bardhë, që kërkon më pak dije dhe punë.

Sugjerime për të lexuar

Bouwman, Harry, and John Nouwens, "Government Electronic Publishers?The Dutch Case", Government Information Quarterly, vëllimi 16, nr. 1, 1999, f. 29-45. Një shpjegim rreth asaj se si një qeveri e përdor Internetin për t'i ofruar informata qytetarëve të saj. Ky nuk është lajm për amerikanët, mirëpo artikujt në këtë vepër zhvendosen prej Internetit deri te ajo se si "Qeveria holandeze ka provuar që ta përmirësojë qasjen në gjashtë raste specifike të botimeve elektronike". "Opsionet e mundshme-të zbatueshme" do të jenë interesante për cilindo, që është i përfshirë, apo ka interes rreth të dhënave elektronike dhe informacioneve qeveritare. Ky periodik, *Government Information Quarterly* është një burim i mrekullueshëm për aktivitetet qeveritare/bibliotekare.

Byerly, Greg, "Government Documents on the Web", School Library Media Activities Monthly, nr. 5, 1999, f. 34-36. Ndodh shpesh të harrohet se sa të rëndësishme janë dokumentet qeveritare për shkollat. Autori i këtij libri rikujton lexuesit rreth vlerës së këtyre dokumenteve dhe se si ato mund të gjenden dhe të përdoren në Internet.

Clark, Cynitha dhe Judy Horn. Organization of Document Collections and Services. Uashington, DC: Asociacioni i Bibliotekave Hulumtuese, 1998. Është një sondazh i bërë nga Asociacioni i

[22] "Researching census info", Yahoo! Internet Life, nëntor, 1999, f. 108.

Bibliotekave Hulumtuese, i cili tregon se problemet më të mëdha lidhur me koleksionet e dokumenteve janë mungesa e buxhetit, zhvillimet digjitale dhe planet e pafundme rreth riorganizimit të tyre. Autori thekson qartë se gjithmonë më shumë e më shumë biblioteka janë duke i futur dokumentet e tyre në koleksionin e përgjithshëm referencial – në veçanti dokumentet digjitale.

"*Government*", *Forbes*, 13 shtator, 1999, f. 110. Ky botim nga Forbes është dhënë përmes Internetit. Në këtë fletushkë të shkurtër shpjegohet roli i dokumenteve dhe informacioneve qeveritare në Internet. Një listë e web-sajteve jepet po ashtu prej Qeverisë.

Morehead, Joe, "Sites for Sore Eyes: A Melange", The Serials Librarian, vëllimi 27, nr. 4, viti 2000. Një studim i regjistrimeve të përgjithshme nga e kaluara dhe ato që do të bëhen në të ardhmen. Theksi kryesor vihet në regjistrimin e vitit 2000 dhe problemet që qenë shfaqur gjatë atij procesi. Nga kjo, autori zhvendoset në fushat e tjera të ngjashme, prej të drejtave autoriale deri te një web-sajt për periodikët federalë. Kjo, mbi të gjitha, është një "përzierje".

Newlen, Robert, "Fifty Years of Silent Service", American Libraries 29 (4), 1998, f. 62-64, I nëntitulluar si: "A Peak Inside the CIA Library", ky është artikulli i vetëm dhe argëtues për bibliotekën e Shërbimit Inteligjent Amerikan (CIA), i cili jep arsyen se pse mbahet kjo bibliotekë aq lart nga agjencia. Në të shumtën e rasteve, bibliotekari shërben si një burim i madh i informatave rreth problemeve me të cilat përballen agjentët e CIA-së.

Risen, James, "CIA Director Emphasizes Differences in Security Cases", The New York Times, 3 shkurt, 2000, f. A22. Drejtori i CIA-së i shpjegon Kongresit se paraardhësit e tij nuk kanë dashur e as nuk kanë tentuar për të vënë në dispozicion të agjentëve të huaj dokumentet qeveritare të klasifikuara si sekrete. Me këtë që u tha, prapë shtrohet pyetja rreth sekreteve dhe nevojës që Qeveria t'i bëjë publike të gjitha dokumentet e saj. Një sasi e madhe e artikujve dhe e librave është shkruar për këtë çështje. Shih, për shembull, librin nga James Thurman "Limiting What Bureaucrats Rubber-Stamp Top Secreat", The Christian Science Monitor, 17 nëntor, 1999, f. 2+; dhe atë nga

Lucy Komisar "Documented Complicity", The Progressive, shtator, 1999, f. 1-24.

Shill, Harold, dhe *Lisa Stimatz*, "Government Information in Academic Libraries: New Options for the Electronic Age", The Journal of Academic Librarianship, nr. 2, viti 1999, f. 94-104. Për shkak të qëndrimit dhe vendimit të Qeverisë që t'i fusë në formatin digjital të gjitha dokumentet qeveritare, bibliotekari duhet të përdorë strategji të reja për koleksione/përmbledhje dhe për kërkimin e dokumenteve. Artikulli me titull "Explores the implications of this change and describe the initiative of one medium-sized non depository library to become a government information center".